AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

BOTIME TË VEÇANTA LXXXV
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
Libri 25

HIVZI ISLAMI

STUDIME DEMOGRAFIKE

100 VJET TË ZHVILLIMIT DEMOGRAFIK TË KOSOVËS

BOTIM I DYTË I PLOTËSUAR

PRISHTINË
2008

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

SPECIAL EDITIONS LXXXV
SECTION OF SOCIAL SCIENCES
Book 25

HIVZI ISLAMI

DEMOGRAPHIC STUDIES

100 YEARS OF KOSOVA DEMOGRAPHIC DEVELOPMENT

SECOND REVISED EDITION

Approved at the Meeting of the Social Science Section,
held on 3 February 2005, on the grounds of the reports of
academician Jashar Rexhepagiq and academician Mark Krasniqi.

Editor: Ekrem Murtezai, secretary of the Social Science Section

PRISHTINA
2008

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

BOTIME TË VEÇANTA LXXXV
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
Libri 25

HIVZI ISLAMI

STUDIME DEMOGRAFIKE

100 VJET TË ZHVILLIMIT DEMOGRAFIK TË KOSOVËS

BOTIM I DYTË I PLOTËSUAR

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore mbajtur më 03 shkurt 2005, në bazë të recensioneve të akademik Jashar Rexhepagiqit dhe akademik Mark Krasniqit.

Redaktor: Ekrem Murtezai, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore

PRISHTINË
2008

P Ë R M B A J T J A

VËREJTJE HYRËSE 11

Pjesa e parë
ZHVILLIMI DEMOGRAFIK NË EPOKËN MODERNE
SHEKULLI XX – SHEKULL I KTHESAVE TË MËDHA DEMOGRAFIKE

I. ZHVILLIMI I POPULLSISË GJATË HISTORISË NË RRAFSHIN GLOBAL 21
1. Evolucioni demografik nga homo sapiensi deri në revolucionin klasik industrial... 21
2. Rrjedhat e transicionit demografik 26
3. Diferencat e mëdha regjionale në zhvillimin e popullsisë 33
4. Rezultatet themelore të projeksioneve të popullsisë së botës deri në vitin 2150 41

II. ASPEKTI NDËRKOMBËTAR I PROBLEMEVE TË POPULLSISË 43
1. Kontraverzat rreth rrugëve të zgjidhjes së problemeve të popullsisë 44
2. Çështjet demografike në pesë konferencat botërore mbi popullsinë 45
2.1. Konferenca I: fryma "pronataliste" franceze dhe qëndrimi "neomaltusianist amerikan" 45
2.2. Konferenca II: pa konfrontime të mëdha rreth problemeve të popullsisë 48
2.3. Konferenca III: ndërvarësia midis popullsisë dhe zhvillimit 49
2.4. Konferenca IV: përmbushja e detyrave nga dokemantat e Konferencës III 52
2.5. Konferenca V: kompromisi rreth lindshmërisë dhe planifikimit të familjes 54

Pjesa e dytë
LËVIZJA NATYRORE E POPULLSISË SË KOSOVËS

I. EVOLUCIONI I LINDSHMËRISË DHE I RIPRODHIMIT TË POPULLSISË 61
1. Lindshmëria (nataliteti, fertiliteti) dhe riprodhimi i popullsisë si dukuri shumëdimensionale 61
2. Përtëritja e popullsisë në vendet e zhvilluara perëndimore nga Maltusi deri sot 65
3. Specificiteti i regjimit të riprodhimit të popullsisë së Kosovës dhe të shqiptarëve 69
3.1. Funksioni riprodhues në shoqërinë tradicionale shqiptare 71
3.1.1. Domosdoshmëria e natalitetit të lartë 74
3.1.2. Martesa, familja dhe lindja si vlera të larta 77
3.2. Funksioni riprodhues në shoqërinë shqiptare të kohës sonë 79
3.2.1. Determinantet e transicionit të vonuar demografik 82
3.2.2. Shkaqet e një thyerjeje demografike në fund të shekullit XX 86
3.2.3. Femra dhe roli i saj në ndryshimin e regjimit të riprodhimit 89
3.2.4. Fertiliteti sipas radhës së lindjes, moshës së nënës, përgatitjes shkollore dhe profesionit 91

3.2.5. Niveli dhe lëvizja e natalitetit dhe e fertilitetit sipas kombësisë 97
4. Planifikimi i familjes dhe përtëritja biologjike e popullsisë në sfidat e civilizimit bashkëkohor 105
4.1. Konceptimi i planifikimit të familjes 106
4.2. Mikroniveli dhe përtëritja biologjike e popullsisë 110
4.3. Individualizmi dhe egoizmi si konsiderata të rëndësishme në riprodhimin e popullsisë 113
4.4. Problemi "i planifikimit të familjes" dhe "i kontrollit të lindjes" në dy vende karakteristike 117
5. Hipokrizia e ish-Jugosllavisë: fryma neomaltusianiste sui generis 125

II. EVOLUCIONI I VDEKSHMËRISË (MORTALITETIT) TË POPULLSISË ... 133
1. Tipi tradicional i mortalitetit 134
2. Mortaliteti sipas gjinisë dhe moshës 141
3. Mortaliteti i foshnjave dhe shkaqet e tij 143
4. Zgjatja e mesatares së jetës të të posalindurve 150
5. Diferencimi shoqëror i vdekshmërisë 152

III. DINAMIKA E SHTIMIT NATYROR DHE E RRITJES SË PËRGJITHSHME TË POPULLSISË 157

Pjesa e tretë
STRUKTURAT E POPULLSISË SË KOSOVËS DHE NDRYSHIMET NË PËRBËRJEN E EKONOMIVE FAMILJARE

I. STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS MOSHËS DHE GJINISË 169
1. Shtrirja e popullsisë së përgjithshme sipas moshës dhe gjinisë 170
2. Kontingjentet funksionale të popullsisë sipas moshës dhe gjinisë 172

II. ARSIMI DHE LËVIZJA E ANALFABETIZMIT 177
1. Roli i shkollës në sigurimin e shkrim-leximit 178
2. Dobësitë metodologjike në evidencimit e analfabetëve 182
3. Anatomia e analfabetëve 182
4. Shkaqet e analfabetizmit 187

III. PËRBËRJA KOMBËTARE E POPULLSISË DHE SPEKULIMET SERBE 191
1. Manipulimet serbe rreth dimensionit etnikodemografik të Kosovës 192
2. Spekulimet më të reja serbe për përbërjen etnike të Kosovës dhe zhvillimin demografik të shqiptarëve 198

IV. STRUKTURA EKONOMIKE E POPULLSISË 209
1. Disa veçori themelore të zhvillimit ekonomik të Kosovës 209
2. Popullsia bujqësore dhe lëvizja e saj 212
2.1. Çështje metodologjike të zbatimit të definicionit të popullsisë bujqësore 212
2.2. Lëvizja e numrit të popullsisë bujqësore në periudhën 1948-1981 215

2.3. Aspekti territorial i popullsisë bujqësore 219
3. Popullsia aktive dhe karakteristikat e saj 220
4. Dendësia e përgjithshme dhe dendësia agrare 222

V. EKONOMITË FAMILJARE DHE TRANSFORMIMI I TYRE 227
1. Përkufizimi i koncepteve familje dhe ekonomi familjare 227
2. Ndryshimet në numrin dhe përbërjen e ekonomive familjare 229
3. Ekzistimi i familjeve të mëdha 233

Pjesa e katërt
SHQIPTARËT NË TROJET E TJERA ETNIKE

I. DISA VEÇORI DEMOGRAFIKE TË SHQIPTARËVE NË TROJET E TJERA ETNIKE 241
1. Shqiptarët në Maqedoni 241
2. Shqiptarët në tri komunat e Luginës së Preshevës 246
3. Shqiptarët në Mal të Zi 249
4. Shqiptarët në viset e tjera të ish-Jugosllavisë 251

Pjesa e pestë
MIGRIMET E POPULLSISË DHE SPASTRIMET ETNIKE

I. MIGRIMET E POPULLSISË SË KOSOVËS DHE SPEKULIMET SERBE ... 255
1. Lufta kundër faktorit demografik shqiptar si strategji antishqiptare 256
2. Manipulimet dhe spekulimet serbe rreth migrimeve të popullsisë në vitet e 80-ta të shek. XX 260
2.1. Atraktiviteti i "amave kombëtare" dhe i qendrave të mëdha urbane 261
2.2. Migrimet e popullsisë sipas kombësisë dhe motivet e tyre pas vitit 1981 .. 263
2.3. Maqedonia si territor provues për ndjekjen e shqiptarëve 265

II. HEGJEMONIZMI SERB DHE POLITIKA SERBE E SPASTRIMEVE ETNIKE TË SHQIPTARËVE 269
1. Nocioni dhe ideja e "spastrimeve etnike" 269
2. Hegjemonizmi serb si koncepcion afatgjatë i politikës dhe i shoqërisë serbe .. 272
3. Shqyrtimet etnodemografike dhe gjeopolitike të Cvijiqit në favor të ekspansionizmit serb në Ballkan 274

III. PROJEKTET SERBE TË PJESËS SË PARË TË SHEK. XX PËR DËBIMIN E SHQIPTARËVE DHE SERBIZIMIN E TROJEVE TË TYRE 283
1. Politika kolonizuese serbe dhe reforma agrare në funksion të dëbimit të shqiptarëve midis dy luftërave botërore 283
2. Elaboratet gjenocidale serbe të viteve të 30-ta 289
3. Elaboratet gjenocidale serbe të viteve të 40-ta 294

IV. PROJEKTET SERBO-JUGOSLLAVE PËR SHTYPJEN DHE SHPËRNGULJEN E SHQIPTARËVE NË GJYSMËN E DYTË TË SHEK. XX 301
1. Kriza e Kosovës dhe fillimi i shkatërrimit të Jugosllavisë së Dytë 301
2. Shpërngulja e shqiptarëve dhe valët e kolonizimit serb të Kosovës në vitet e 50-ta e të 60-ta të shekullit XX 310
3. Programi jugosllav për Kosovën në funksion të kolonizimit dhe të ndjekjes së shqiptarëve 316
4. Tezat dhe kërkesat serbomëdha të tipit fashistoid sheshelian 322
5. Gjenocidi faktik masiv ndaj shqiptarëve në dhjetëvjetëshin e fundit të shek. XX 333

V. VERSIONET SERBE PËR NDARJEN DHE RIKOMPONIMIN TERRITORIAL TË KOSOVËS 339
1. Ndryshimet në madhësinë territoriale të Kosovës 340
2. Zgjidhja e çështjes së Kosovës nga copëtimi deri te spastrimi etnik 340
3. Projektet më të reja të rikomponimit territorial 343

Pjesa e gjashtë
ASPEKTI DEMOGRAFIK-FUNKSIONAL I VENDBANIMEVE TË KOSOVËS

I. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË VENDBANIMEVE 349
1. Vendbanimet si vatra të para të bashkësisë njerëzore 349
2. Shtrirja, ndryshimet në madhësi dhe klasifikimi i vendbanimeve 350

II. BASHKËSIA RURALE NË RRJEDHAT SOCIODEMOGRAFIKE 357
1. Struktura homogjene dhe e pazhvilluar 357
2. Fillimi i transformimeve socialdemografike dhe krijimi i grupeve të reja socioprofesionale 358
3. Problemi i përvetësimit dhe i zgjerimit të inovacioneve në fshat 361
4. Lëvizja dhe përbërja e popullsisë rurale 363
5. Çështje të urbanizimit dhe të standardit të vendbanimeve rurale 366
5.1. Procesi i urbanizimit dhe tendencat e zgjerimit të strukturave urbane infrastrukturore 366
5.2. Shkolla fillore dhe efektet e saj në fshat 372
6. Zgjerimi i risive materiale dhe shpirtërore në fshat dhe në bujqësi 374
7. Gjendja e banimit në fshat 378
8. Ushqimi dhe konsumi i popullsisë 381
9. Përvijimi midis fshatit tradicional dhe fshatit bashkëkohor 383

III. BASHKËSIA URBANE DHE PROBLEMET E SAJ 385
1. Rrjedhat specifike të urbanizimit 386
2. Rritja demografike e qyteteve 389
3. Shkalla e urbanizimit sipas kombësisë 392

4. Imigrimi i popullsisë dhe kultura urbane....393
5. Prishtina: nga qyteza deri te metropoli kaotik....397
5.1. Evolucioni popullativ....398
5.2. Ana funksionale e urbanizimit....401
5.3. Urbanizimi i dhunshëm dhe problemet aktuale....402

Pjesa e shtatë
DIASPORA SHQIPTARE

I. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË DIASPORËS HISTORIKE DHE BASHKËKOHORE SHQIPTARE....407
1. Ndarja nga trungu i përbashkët gjeokombëtar....407
2. Shkaqet dhe pasojat e shprishjes....408
3. Shqiptarët (arvanitasit) në Greqi....412
4. Shqiptarët (arbëreshët) në Itali....416
5. Shqiptarët në Bullgari, Rumani, Rusi dhe Dalmaci....422
6. Shqiptarët në Turqi....424
7. Shqiptarët në SHBA dhe në vendet e tjera....431
8. Shqiptarët në Evropë....433
9. Lidhjet e diasporës me vendlindjen....434
10. Disa probleme të diasporës sonë të sotme....435
10.1. Shpërnguljet si humbje dhe si dobi....435
10.2. Dy fatkeqësitë e mërgatës sonë....438
10.3. Diaspora nën mëshirën e fatit....439

Pjesa e tetë
PROJEKSIONET E POPULLSISË SË KOSOVËS

I. PARASHIKIMET AFATGJATA DEMOGRAFIKE....443
1. Disa vërejtje rreth projeksioneve të popullsisë....443
2. Kosova dhe Serbia: dy pole të kundërta demografike në perspektivë....446

Pjesa e nëntë
DISKURSI RRETH DISA PROBLEMEVE AKTUALE TË POPULLSISË SË KOSOVËS DHE NDARJES SË KOSOVËS

I. DISKURSI RRETH REGJISTRIMEVE TË POPULLSISË....461
1. Rrjedhat dhe problemet e regjistrimit të popullsisë....461
1.1. Koncepcionet dhe njësitë e përfshirjes në regjistrim....462
1.2. Programi i aktiviteteve për realizimin e regjistrimit....464
1.3. Bojkoti i regjistrimit të popullsisë të vitit 1991 nga ana e shqiptarëve....465
2. Regjistrimi civil dhe votues: dilemat dhe problemet....468
2.1. Dallimet midis regjistrimeve....469
2.2. Gabimet në të dhëna dhe jokonsekuenca në zbatimin e kritereve....472

3. Manipulimet me numrin e serbëve 473
3.1. Vardisja e udhëheqjes shqiptare 477
4. Bashkëpunimi i organizatave të huaja me ekspertë shqiptarë
në sferën demografike 480
4.1. Mënjanimi i ekspertëve vendorë 480
4.2. Dilemat rreth shkuarjes në Bordeaux 482
5. Rezultatet absurde të një publikimi të Entit Statistikor të Kosovës....483
5.1. Asnjë anketim nuk mund ta zëvendësojë regjistrimin e popullsisë....483
5.2. Dëmet e shumëfishta nga improvizimet statistikore 485
5.3. ESK-ja po e ndihmon shtyrjen e regjistrimit të popullsisë 486

II. DËSHTIMI I REGJISTRIMIT TË POPULLSISË PAS NXJERRJES SË LIGJIT MBI REGJISTRIMIN TË VITIT 2004 489
1. Bllokadat dhe pengesat në realizimin e projektit....489
1.1. Ministrja e Shërbimeve Publike - bartëse e dështimit të regjistrimit 491
1.2. Kulmi i papërgjegjësisë me pasoja të rënda dhe politike....491
2. Dështimi i dy regjistrimeve provuese....494
3. Kosova - vendi me specifika më të mëdha demografike në Evropë....496

II. DECENTRALIZIMI AKTUAL SI NDARJE SPECIFIKE TERRITORIALE-POLITIKE E KOSOVËS 499
1. Versionet serbe të ndarjes së Kosovës....500
2. Modeli i ndarjes së Kosovës sipas ndërkombëtarëve para M. Ahtisarit....505
3. Decentralizimi si ndarje e Kosovës sipas Grupit Negociator të Kosovës 507
4. Decentralizimi sipas dokumentit final të M. Ahtisarit 509
5. Vështirësitë e implementimit të planit të M. Ahtisarit.... 510
6. Përdorimi i kadastrës si mjet për grabitjen e territorit dhe manipulimet e Beogradit me të dhëna etnodemografike 513

Pjesa e dhjetë
SHTOJCA GRAFIKE

KONKLUZION 543
SUMMARY 549
CONTENTS 555
LITERATURA DHE BURIMET.... 563
INDEKSI I EMRAVE.... 581

SHQYRTIME HYRËSE

Kthesa të mëdha në evolucionin demografik të botës, siç dihet, ndodhën në kohën moderne, sidomos në shekujt XVIII dhe XIX, të cilët edhe shënojnë një etapë shumë të rëndësishme jo vetëm në rritjen demografike, por edhe në zhvillimin e përgjithshëm të njerëzimit të kushtëzuara nga ndryshimet në shumë sfera të jetës. Mirëpo, shekulli XX dhe veçanërisht pjesa e dytë e tij në rrafshin demografik në nivel botëror, rajonal dhe nacional është shekull i kthesave të mëdha, me shkaqe dhe konsekuenca të shumënduarshme. Derisa prej vitit 1800-1900 popullsia e botës rritet për rreth 80%, në periudhën prej vitit 1800-2000 ajo shtohet për afër 600%. Prej vitit 1800 e deri në përfundim të shekullit XX pasqyra demografike e botës do të tregojë një tendencë të papritur për shumë qarqe: në vitin 1800 bota kishte rreth 1 miliard banorë, në vitin 1930 rreth 2 miliardë, në vitin 1960 rreth 3 miliardë, në vitin 1975 rreth 4 miliardë, në vitin 1987 rreth 5 miliardë, në vitin 1999 rreth 6 miliardë dhe në fund të dhjetorit 2007 rreth 6,7 miliardë.

Vetëm këto 100 vjetët e fundit popullsia botërore rritet gati për katër herë ose prej 1,6 miliard më 1900 në rreth 6,3 miliardë banorë sot. Shtohen edhe dallimet në vëllimin, lëvizjen dhe përbërjen e popullsisë sipas kontinenteve, regjioneve, vendeve dhe shtresave sociale, ku rreth 80% e popullsisë së botës sot jeton në rajonet më pak të zhvilluara. Dyfishimi i popullsisë botërore bëhet për 41 vjet, në vendet e pazhvilluara për 33 vjet (Kosova si tërësi për rreth 30 vjet, madje edhe më pak dhe shqiptarët e Kosovës për rreth 25 vjet) dhe në vendet e zhvilluara për 139 vjet. Evolucioni i tillë demografik lidhet me të arriturat epokale shkencore dhe me revolucionin teknik, sanitar, social dhe ekonomik. Shekulli XX nga disa autorë u cilësua si shekull i ndryshimeve të mëdha ekonomike, sociale dhe demografike në planin global si rrjedhojë e industrializimit të shoqërisë, e modernizimit të teknologjisë dhe e rritjes ekonomike, si dhe shekull i shpresave të mëdha në shumë rrafshe, veçanërisht i kalimit nga civilizimi agrar në civilizimin terciar.[1]

---

[1] Jean Fourastié, ekonomist dhe sociolog i njohur francez, duke studiuar për një kohë të gjatë rrjedhat ekonomike dhe demografike të zhvillimit shoqëror në rrafshin botëror, konstatoi se progresi teknik është faktori kryesor në kalimin e shpejtë nga shoqëria agrare në shoqërinë terciare. Shekullin XX e quajti shekull të një periudhe tranzitore nga civilizimi agrar (tradicional) në civilizimin terciar (bashkëkohor), që do të dominojë në shekullin XXI, dhe shekull të shpresave të mëdha për njerëzimin. Në shqyrtimet e tij

Në anën tjetër, në shekullin XX kemi disa ngjarje të rëndësishme, të cilat sollën ndryshime të mëdha demografike: dy lufta botërore, që shkaktuan humbje të mëdha të drejtpërdrejta dhe indirekte demografike; midis këtyre luftërave ndodh kriza e madhe ekonomike, me pasoja të konsiderueshme edhe demografike (rënia e natalitetit); periudha e kompensimit demografik pas Luftës II Botërore; rritja e shpejtë e popullsisë në vendet e pazhvilluara; rënia e lindshmërisë si në vendet perëndimore, ashtu edhe në ish-vendet socialiste, si në qytetet, ashtu edhe në fshatrat e tyre, etj. Te qarqet shkencore, ekonomike e politike rritet interesi për njohjen e ndryshimeve në zhvillimin e popullsisë dhe për arsye të pajtueshmërisë së plotë të të gjitha qarqeve se duhet të luftohet vdekshmëria e lartë dhe të ruhet e të zgjatet jeta e njeriut, e para në këtë shekull konstituohet politika në sferën e mortalitetit. Ky interesim nxit edhe zhvillimin e demografisë si disiplinë shkencore, ndërsa këto 50 vjetët e fundit popullsia bëhet fushë e kërkimeve shumëdisiplinare. Por, interesi për njohjen dhe studimin e problematikës demografike nuk ka qenë kurrë më i madh se sa që është sot si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në vendet dhe rajonet më pak të zhvilluara dhe në institucionet ndërkombëtare.[2]

*

* *

Popullsia si dukuri masive e shumëdimensionale shoqërore, me ligjet e veta specifike të zhvillimit e të manifestimit[3] ka nisur të studiohet

teorike, theksonte se popullsia duke u transformuar nga veprimtaritë primare të produktivitetit të ulët në ato sekondare, përqendrohet në sferën e shërbimeve, në sektorin terciar dhe kuartar, që janë sot sektorë dominantë në vendet me zhvillim të lartë industrial dhe teknologjik dhe me ndarje mjaft të degëzuar të punës (Shih më hollësisht studimet: J. Fourastié, *Le grand espoir du XX ème siècle,* Presses Universitaires de France, Paris, 1953; "De la vie tradicionnelle à la vie tertiaire", *Population,* No 3, Institut National d'Études Démographiques (INED), Paris, 1959).

[2] *The State of World Population*, UNFPA, New York, 1966; United Nations, W*orld Population Trends and Policies 1987*, New York, 1988; J. Dupâquier, *La population mondiale au XX-e siècle,* PUF, Paris, 1999; G. Tapinos, *Éléments de démographie,* A. Colin, Paris, 1985; P. Ehrlich, *The Population Explosion,* New York, 1990; *Recent demographic developments in Europe 2000,* Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2000; *Images économiques du monde 2004*, A. Colin, Paris, 2003; *Les grandes tendances du monde, 2003*, IFRI-Dunod, Paris, 2003.

[3] Popullsia është dukuri masive shoqërore, me ligjet e veta specifike të zhvillimit, ka karakter afatgjatë dhe nuk i nënshtrohet situatave eksperimentale. Mosnjohja e metodave demografike në hulumtimin e dukurive dhe proceseve demografike, si dhe mosnjohja e ligjësive themelore të popullsisë domosdo sjell deri te interpretimet dhe përfundimet e gabueshme. Kur të zbërthehet nocioni *popullsi*, atëherë del se është fjala për një bashkësi

relativisht vonë, vetëm pas konstituimit të demografisë si disiplinë e veçantë shkencore në shek. XX dhe veçanërisht në pjesën e dytë të tij, ndonëse edhe më parë ka pasur përpjekje për hulumtimin e aspekteve të ndryshme të zhvillimit të popullsisë, por gjithnjë në kuadër të statistikës, shkencës ekonomike dhe shkencave të tjera sociale. Problemet e popullsisë në nivel botëror për herë të parë u gjendën në fokus të interesimit pas formimit të OKB-së (1945) dhe shërbimeve të saj të specializuara, kështu që vetëm një vit pas themelimit u ngrit Komisioni Popullativ i Kombeve të Bashkuara. Që nga formimi i saj kjo organizatë në mënyrë sistematike i ka shqyrtuar problemet e zhvillimit të popullsisë, duke kërkuar rrugët e zgjidhjes së drejtë të tyre. Si një nga preokupimet themelore të shërbimeve profesionale të kësaj organizate ishte edhe ndriçimi i retrospektivës demografike dhe hartimi i projeksioneve të popullsisë, të cilat shtroheshin si problem universal dhe njohja e rrjedhave bile aproksimative të numrit të popullsisë në të ardhmen do të bëhej e domosdoshme për njohjen si të realitetit të përgjithshëm demografik, ashtu edhe të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të botës.

Mirëpo, pos aktivitetit të dendur të OKB-së në hulumtimin e të gjitha aspekteve të zhvillimit demografik, popullsia e botës dhe e rajoneve të saj u bë objekt i hulumtimit të shumë qendrave shkencore të karakterit rajonal dhe kombëtar, më ç'rast u themeluan një varg organizatash dhe asociacionesh dhe u mbajtën shumë konferenca, kongrese, simpoziume e tubime të tjera. Për studimin kompleks të zhvillimit demografik,[4] në kuadër të këtyre bërthamave shkencore u angazhuan shumë demografë dhe ekspertë të fushave të ngjashme (sociologë, ekonomistë, gjeografë, mjekë, psikologë, filozofë etj.). Në këtë periudhë edhe demografia[5] si shkencë shoqërore

specifike të individëve në një territor në të cilin çdo person merr pjesë me karakteristikat e veta të veçanta. Popullsia e një territori me veçoritë e veta dallon nga vetë individët, që janë pjesë përbërëse të saj. Popullsia ndryshon për nga veçoritë e saj dinamike e strukturale sipas ligjësive karakteristike për një periudhë historike (L. Henry, "Réflexions sur l'observation en démographie", *Population*, No 2, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1963, pp. 233-262; i njëjti, *Demographie – Analyse et modèles,* Librairie Larousse, Paris, 1972, pp. 13-15).

[4] Nocioni zhvillim demografik është sinonim i procesit kompleks të zhvillimit të popullsisë.

[5] Demografia është shkencë shoqërore e cila studion gjendjen numerike dhe shtrirjen territoriale të popullsisë, komponentet e lëvizjes natyrore (nataliteti e fertiliteti, mortaliteti, shtimi natyror, gjendja martesore) dhe mekanike (emigrimet, imigrimet, saldoja migruese), strukturat e popullsisë (sipas gjinisë, moshës, strukturës socioekonomike, arsimore etj.), familjen, ekonominë familjare dhe vendbanimet në të cilat popullsia si bashkësi specifike e personave jeton, pastaj ka si objekt studimi politikën popullative e të fuqisë punëtore dhe projeksionet e popullsisë. Demografia nuk merret vetëm me përshkrimin e gjendjeve, lëvizjes dhe strukturave të popullsisë dhe nuk përqëndrohet vetëm në zbulimin e faktorëve

definitivisht konstituohet si disiplinë e veçantë shkencore, objekt studimi i së cilës është zhvillimi i popullsisë dhe ligjësitë themelore të tij në hapësirë, në kohë dhe në tip të caktuar të shoqërisë; brenda saj krijohen disiplina të shumta të ngushta dhe përsosen procedetë metodologjike të hulumtimit. Përparimi i statistikës demografike, i teknikës llogaritëse dhe instrumentariumit tjetër krijoi një bazë solide për material empirik (regjistrimet e popullsisë, statistika vitale, informatat vijuese statistike, anketat etj.) për hulumtimin e popullsisë së përgjithshme dhe të pjesëve të saj të veçanta dinamike dhe strukturale. Demografia bashkëkohore, në hulumtimin e popullsisë, pos metodave të saja, sot gjithnjë e më shumë po zbaton njohuritë dhe metodat e shumë disiplinave të tjera shkencore: të sociologjisë, të ekonomisë, të mjekësisë, të psikologjisë, të psikologjisë sociale, të demogjeografisë etj., në aspektin përmbajtësor, dhe të logjikës, të statistikës dhe të matematikës, në aspektin metodologjik.

Në gjysmën e dytë të shekullit të fundit popullsia bëhet fushë e interesit dhe e kërkimeve shumëdisiplinare. Përmes indikatorëve demografikë mund të vërehet qartë se si frymon një bashkësi etnike e kombëtare, një sistem socioekonomik, një shoqëri, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e tyre. Nisur nga këto fakte, demografia, pos si shkencë në vete dhe si pjesë integrale e shkencave sociale, nuk ka pse të mos konsiderohet edhe si shkencë nacionale, aq më tepër kur faktori demografik është bërë çelës i zgjidhjes së problemeve dhe raporteve politike në shoqëritë multietnike, para së gjithash në hapësirën ballkanike, ku konfliktet ndëretnike ishin të pranishme gjatë gjithë shekullit XX dhe duket se ende nuk kanë përfunduar. Mirëpo, demografia dhe të dhënat mbi popullsinë shpeshherë janë keqpërdorur për qëllime politike nga qarqe, regjime dhe

---

që ndikojnë në popullsi, por ajo depërton thellë në tendencat e përgjithshme të zhvillimit të popullsisë, përpiqet të gjejë dhe formulojë ligjësitë themelore të zhvillimit të popullsisë në hapësirë dhe në kohë të caktuar. Zhvillimi i popullsisë është proces historik, prandaj edhe ligjësitë e zhvillimit demografik janë historikisht të kushtëzuara dhe ligje të ndryshueshme në hapësirë e në kohë. Lëvizja dhe struktura e popullsisë kushtëzohen, në një anë, nga faktorët biologjikë, socialë, ekonomikë, kulturorë, sociopsikologjikë, ndërsa, në anën tjetër, janë reciprokisht të lidhura e të kushtëzuara dhe së bashku manifestohen në zhvillimin e përgjithshëm shoqëroro-ekonomik (Shih më gjerë: Ph. M. Hauser - O. D. Duncan, *The Study of Population: An Inventory and Appraisal,* The University of Chicago Press, 1959, pp. 29-44; United Nations, *Dictionaire démographique multilingue,* Vol. français, UIESP, Liège, 1981, pp. 3-4; A. Wertheimer-Baletić, *Demografija (stanovništvo i ekonomski razvitak),* Školska knjiga, Zagreb, 1982, ff. 26-30; G. Tapinos, *La Démographie (Population, économie et sociétés),* INÉDIT, Sciences sociales, Paris, 1977, pp. 24-34; D. Breznik, *Demografija (metodi, analize i modeli),* Centar za demografska istraživanja (CDI), Institut društvenih nauka (IDN), Beograd, 1977, ff. 8-24; L. Henry, *Po aty*, pp. 233-262; J.-C. Chesnais, *La démographie*, PUF, Paris, 1998, pp. 3-4).

ideologji të ndryshme në shekullin XX. Shembull tipik i këtij keqpërdorimi, siç do të shohim, janë pikërisht regjimet serbo-jugosllave ndaj zhvillimit demografik të shqiptarëve.

*

* *

Jemi dëshmitarë se preokupimet dhe sfidat e civilizimit bashkëkohor janë të mëdha dhe shumëdimensionale. Në qarqe shkencore, ekonomike, politike e të tjera si në rrafshin nacional e rajonal, ashtu edhe në atë global shtrohen dilema të ndryshme dhe shfaqen brengosje të shumta për të tashmen dhe të ardhmen e njerëzimit. Si probleme që e përcaktojnë dhe sikur e kufizojnë rritjen në planetin tonë dhe e preokupojnë njerëzimin në nivele përkatëse sot dhe në perspektivë, përveç tjerash, mund të veçohen popullsia me rritjen e saj, industrializimi dhe prodhimi i hovshëm industrial, urbanizimi intensiv dhe i pakontrolluar, prodhimi i ushqimit, resurset natyrore dhe ndotja e mjedisit. Supozimi i fillimit të viteve të 70-ta të shek. XX se planeti ynë është i kufizuar dhe nëse vazhdon rritja e popullsisë dhe e prodhimit industrial me tempo të deritanishme, në gjysmën e shekullit XXI do të vijë deri te çrregullimi i ekuilibrit global dhe do të pasojë kriza me përmasa katastrofike zgjoi interesim të madh në qarqe të ndryshme, me orientime contra apo pro rritjes demografike dhe industriale. Nga takimi i njohur në Romë në vitin 1968 i rreth 30 dijetarëve, ekonomistëve, humanistëve, industrialistëve etj., nga 10 vende doli i ashtuquajturi "Klubi i Romës". Në botë atëherë jetonin rreth 3 miliardë e gjysmë banorë, ndërkaq më 12. 10. 1999 ky numër arriti në 6 miliardë njerëz. Ndonëse në botë këto vitet e fundit çdo ditë mesatarisht lindnin rreth 360.000 fëmijë ose në çdo orë në jetë vinin afër 15.000 foshnje apo në një minutë lindnin rreth 250 foshnje, banori i gjashtëmiliardtë, sigurisht për arsye simbolike, u numërua një bebe e Sarajevës. Kur të zbritet numri i të vdekurve (në ditë rreth 140.000, në çdo orë rreth 5.800 dhe në minutë gati 100 veta), del se shtimi natyror mesatar vjetor këto vitet e fundit është rreth 80 milionë njerëz, në ditë rreth 220.000 banorë, në orë për afër 9.200 dhe në minutë diçka mbi 150 veta. Në fund të dhjetorit 2007 shtimi natyror ishte në ditë rreth 255.000, në orë rreth 10.000, në minutë rreth 166 dhe në sekond rreth 2,7 banorë.

Pas Romës takimet rreth dilemave të atëhershme dhe të ardhme të njerëzimit vazhduan në Bern, Kembrixh dhe Masaçuset (1970), nga të cilat, në

vitin 1972, në Nju- Jork u paraqit projekti "Kufijtë e rritjes",[6] që jehoi si një "bombë", me vlerësime mjaft kontraverze dhe ekstreme. Neomaltusianistëve, të cilët natyrisht gjithnjë ishin dhe mbetën në anën e priftit dhe ekonomistit anglez, T. R. Maltusit (1766-1834), ky projekt u përgjigjej, sepse inkuadrohej plotësisht në bindjet e tyre pesimiste se "Botës po i afrohej fundi" (!), ndërkaq kundërshtarët e tyre e cilësuan projektin si çmendi, verbësi apo utopi. Shkenca demografike, shkencat e tjera sociale dhe disiplinat e planifikimit të zhvillimit shoqëror u gjendën para një sfide dhe detyre serioze dhe me përgjegjësi: si ta shpjegonin evolucionin demografik, shkaqet dhe konsekuencat e tij si dhe dilemat lidhur me ardhmërinë e njerëzimit.

Për qarqet maltusianiste të cilat, tashmë një kohë të gjatë, nga Maltusi e deri te neomaltusianistët e sotëm, zhvillimin e popullsisë e shohin me shqetësim, sikur problemi kryesor që po e rrezikuaka njerëzimin dhe po e çekuilibruaka botën bashkëkohore reduktohet në numrin e madh të popullsisë dhe rritjen e shpejtë të saj në disa rajone të botës, të cilësuar si "eksplosion demografik",[7] ndërkaq në qarqet raciste shfaqen brengosje edhe për krijimin e raporteve të reja në strukturën e popullimit midis bashkësive të ndryshme etnike, gjuhësore, raciale e konfesionale. Zgjidhjen e problemeve të popullsisë dhe përparimin ekonomik në vendet jo mjaft të zhvilluara, këto qarqe e shohin jo në eliminimin e pasojave të sundimit të gjatë kolonial të vendeve të zhvilluara dhe në marrëdhëniet jo të drejta ekonomike ndërkombëtare në dëm të vendeve të pazhvilluara, por në zvogëlimin e shkallëve të natalitetit dhe të shtimit natyror. Përkundër këtyre qëndrimeve e tendencave, në qarqet me pikëpamje racionale dhe pa paragjykime, problemet në raportet globale midis popullsisë dhe resurseve e kundërthëniet midis vendeve të zhvilluara e vendeve të pazhvilluara nuk kërkohen me çdo kusht në "ekspansionin demografik" dhe efektet e tij, por në shtrirjen jo të harmonizuar të popullsisë në raport me shtrirjen e pasurive natyrore dhe valorizimin e tyre deri në shkallë të finalizimit dhe veçanërisht në marrëdhëniet e padrejta midis të pasurve dhe të varfërve. Vendet në zhvillim rritjen e popullsisë e shohin jo si shkak të moszhvillimit, por si pasojë, duke insistuar në raportet e drejta midis tyre e vendeve të zhvilluara dhe në një rend të ri ekonomik.

---

[6] D. H. Meadows et. al., *The Limits to Growth*, Universe Books, New York, 1972, pp. 1-205; përkthimi freng: *Halte à la croissance,* Fayard, Paris, 1972.

[7] Nocionet "ekspansion demografik", "eksplosion demografik", "bombë demografike" etj., të përdorura për vendet dhe popujt në zhvillim, i përkasin periudhës së neokolonializmit modern dhe ideologjive neomaltusianiste të pas Luftës II Botërore. Qarqet neokonialiste dhe neomaltusianiste i përdornin, por edhe sot e gjithë ditën i përdorin për t'i justifikuar politikat e tyre të sundimit kolonialist mbi vendet dhe popujt e pazhvilluar dhe deri dje të robëruar në formën më klasike.

*

* *

Pothuajse te të gjithë popujt, në të gjitha periudhat historike dhe në çdo shkallë të zhvillimit të tyre, ka ekzistuar interesimi për njohjen, ndërsa në kohën moderne edhe për studimin e gjendjes dhe të tendencave demografike. Për secilin komb sikur nuk ka gjë më të rëndësishme se njohja e zhvillimit të tij demografik. Vendet dhe popujt, duke njohur situatën e tyre demografike, veçanërisht gjendjen numerike e reproduktive, veçoritë dinamike e strukturale të popullsisë, kanë dëshiruar ta njohin edhe qenien, forcën dhe perspektivën e tyre demografike e kombëtare. Mirëpo, si dhe më parë, ashtu edhe sot e gjithë ditën popujt nuk janë indiferent as ndaj faktit se çka po ndodh në rrafshin demografik edhe me vendet dhe popujt e tjerë, veçanërisht me ata fqinj. Dëshmi më e mirë për këtë është diskursi irracional, neomaltusianist dhe racist i Serbisë dhe i ish-Jugosllavisë ndaj natalitetit të shqiptarëve. Nën pretekst kinse të rrezikimit të hapësirës serbo-jugosllave dhe prosperitetit gjeodemografik, kombëtar, politik dhe ekonomik të sllavëve të jugut, Serbia dhe ish-Jugosllavia jo vetëm që nisën haptazi t'i numërojnë shqiptarët dhe ta shtrijnë shqiptaro-fobinë në të gjitha rajonet dhe shtresat shoqërore të popujve jugosllavë, por me të gjitha institucionet dhe mekanizmat represivë u angazhuan për mposhtjen e epërsisë numerike dhe reproduktive të shqiptarëve dhe të vënies së baraspeshës etnike përmes kolonizimit të serbëve dhe dëbimit të shqiptarëve. Ndërkaq sot, edhe në rrethana të realiteteve të reja, qarqet pushtetore dhe intelektuale serbe po vazhdojnë të jetojnë me mite të së kaluarës dhe të projektojnë versione të ndryshme të interesave të Serbisë në Kosovë, duke vizatuar harta për rikomponime të reja territoriale të Kosovës në favor të serbëve dhe Serbisë.

Sikundër edhe të gjithë popujt, ashtu edhe shqiptarët, ndoshta edhe më shumë se të tjerët kanë arsye ta njohin dhe studiojnë zhvillimin e tyre demografik. Sepse edhe historikisht marrë, numri, rritja demografike dhe shtrirja territorialisht kompakte etnike e shqiptarëve ishin ndër faktorët më shqetësues për qarqet antishqiptare, por edhe ndër faktorët më të fuqishëm të rezistencës ndaj asimilimit dhe rrjedhimisht të ruajtjes së substancës së tyre kombëtare. Popullsinë shqiptare në Kosovë dhe në trojet e tjera etnike edhe sot e gjithë ditën e karakterizon një gjendje specifike demografike, që është rezultat e rrethanave të ndërlikuara e të rënda historike, shoqërore, ekonomike, arsimore, kulturore e shëndetësore për një kohë të gjatë. Ky specificitet edhe shtron domosdoshmërinë e hulumtimit të të gjitha aspekteve të zhvillimit demografik të shqiptarëve në Kosovë dhe në trojet e tjera. Analizat dhe hulumtimet e zhvillimit të popullsisë së Kosovës dhe të shqiptarëve për periudhën njëshekullore janë rezultat i punës shumëvjeçare studimore të autorit

dhe bazohen në të dhënat e regjistrimeve të popullsisë, në statistikën vitalo-demografike, në faktet nga literatura shkencore dhe njohuritë e tjera teorike.

Të dhënat e para të treguesve vitalë të popullsisë së Kosovës (nataliteti, mortaliteti, shtimi natyror) i hasim jo më herët se viti 1911, ndërsa për numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës kemi një vlerësim që nga viti 1880. Ndonëse këto të dhëna nuk janë të plota, megjithatë kanë një rëndësi të veçantë për njohjen e retrospektivës demografike të Kosovës. Në mungesë të të dhënave për disa periudha dhe vite, në shumë raste të dhënat për komponentët e lëvizjes natyrore, strukturat demografike dhe socioekonomike dhe numrin e gjithmbarshëm të popullsisë janë të rrumbullaksuara dhe të vlerësuara, por duhet të kihet parasysh edhe fakti se regjistrimi i fundit të popullsisë është bërë në vitin 1981.[8] Mirëpo, para shqyrtimit të zhvillimit të popullsisë së Kosovës këto 100 vjetët e fundit do të japim një pasqyrë të evolucionit të deritanishëm demografik dhe disa tendenca të zhvillimit të popullsisë sot dhe nesër në rrafshin global, botëror.

Botimi i dytë, në mungesë të regjistrimit të popullsisë pas luftës dhe të dhënave nga hulumtimet statistikore të Entit Statistikor të Kosovës, ndonëse nuk ka pësuar ndryshime të mëdha, megjithatë është plotësuar me disa të dhëna të reja, para së gjithash për komponentët e lëvizjes natyrore. Janë shtuar edhe dy kaptina të reja te pjesa e nëntë, ku bëhet fjalë mbi diskursin rreth problemeve aktuale të popullatës kosovare, konkretisht të regjistrimeve të popullsisë dhe rikomponimeve të brendshme territoriale të Kosovës, që njihet si decentralizim i një modeli sui generis. Ky botim është plotësuar në fund edhe me shtojcën grafike, si pjesë e dhjetë, ku pasqyrohet evolucioni i indikatorëve themelorë demografikë të botës, të Kosovës dhe të shqiptarëve.

---

[8] Prej hyrjes së forcave ndërkombëtare më 12 qershor 1999 e deri më sot, përveç dy anketimeve të karakterit demografik dhe socioekonomik, të realizuara së bashku me disa organizata të huaja, por me rezultate jocilësore dhe problematike, Enti Statistikor i Kosovës nuk bëri asnjë hulumtim statistikor në rrafshin e popullsisë, sikundër që nuk siguroi një fond të të dhënave as për pjesë të ndryshme të popullsisë (statistikat ekonomike, të shkollimit, të shëndetësisë, të standardit jetësor, të migrimeve etj.). Por absurdi më i madh është se ky institucion vazhdon të botojë disa publikime kinse statistikore, por duke marrë të dhëna nga ministritë dhe agjencitë e caktuara (!), në vend se të ndodhë e kundërta: këto ministri dhe agjenci t'i referohen të dhënave të Entit Statistikor të Kosovës. E vetmja punë e vlefshme që u bë në këtë institucion ishte aktivizimi i statistikave vitale (lindjet, vdekjet, kurorëzimet), i mbështetur nga agjencitë dhe qeveritë e huaja. Kështu në fund të vitit 2004 doli publikimi i parë dhe më i plotë për statistikat vitale për vitet 2002-2003, i përgatitur nga Divizioni i Statistikave të Popullsisë, me autorë G. Kadriu dhe K. Sojeva (Shih: *Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2004, ff. 1-91 dhe formularët në shtojcë). Edhe për vitet vijuese janë publikuar këto statistika, por pa të dhënat e popullatës serbe.

Pjesa e parë

ZHVILLIMI DEMOGRAFIK NË EPOKËN MODERNE

SHEKULLI XX - SHEKULL I KTHESAVE TË MËDHA DEMOGRAFIKE DHE I KONTRAVERZAVE RRETH RRITJES SË POPULLSISË

I. ZHVILLIMI I POPULLSISË GJATË HISTORISË NË RRAFSHIN GLOBAL

1. Evolucioni demografik nga homo sapiensi deri në revolucionin klasik industrial

Gjatë gjithë historisë së njerëzimit, evolucioni demografik, shkaqet dhe pasojat e tij dhe veçanërisht gjendja numerike e popullsisë kanë tërhequr vëmendjen e autorëve dhe qarqeve të ndryshme. Vlerësimet e tyre flasin se deri në fillim të epokës sonë dhe përgjithësisht deri në fillim të kohës moderne, veçori themelore e popullsisë së botës si tërësi ishte rritja e ngadalshme dhe fluktuimi i saj, por me dallime të theksuara në pikëpamje territoriale dhe në periudha të caktuara, të gjata kohore, si pasojë e ndikimit të një varg faktorëve, që kishin ndikim para së gjithash limitues. Ndonëse nga paraqitja e paraardhësit të njeriut, të drejtuar në këmbë, kanë kaluar rreth 1.700.000 vjet dhe të homo sapiensit (njeriut si qenie e arsyeshme, e vetëdijshme) rreth 60.000 vjet dhe me gjithë kërshërinë e qarqeve të ndryshme, për evolucionin e popullsisë së botës nuk kemi njohuri të mjaftueshme, veçanërisht për të kaluarën e largët.

Në kohën antike, në vatrat kulturore dhe popullative, në Kinë, në Egjipt, në Mesopotami, në Perandorinë Romake etj., edhe pse jo të plota, janë bërë disa regjistrime të kategorive të caktuara të popullsisë (ushtarët, robërit, obliguesit e tatimeve etj.), sikundër edhe në Evropën mesjetare dhe në Perandorinë Otomane është regjistruar popullsia, ku njësia themelore statistike ka qenë shtëpia ose oxhaku, ndërsa regjistrimet kadastrale turke (defterët) ofrojnë jo vetëm të dhëna demografike, por mundësojnë edhe rikonstruimin e gjendjes sociale dhe ekonomiko-juridike. Në kohën tonë me zhvillimin e arkeologjisë, antropologjisë, demografisë si shkencë dhe të disiplinës së saj, demografisë historike, por edhe disiplinave të ngjashme shtohen përpjekjet që në baza shkencore të jepen përgjigje në shumë çështje që kanë të bëjnë me retrospektivën demogjeografike, ku të dhënat mbi gjurmët e vendeve të banuara dhe të veglave të punës kanë një rëndësi të madhe.

Njeriu është qenie biologjike, shoqërore dhe intelektuale, ndërsa modifikimet e caktuara fizike nuk mund ta prishin unitetin biologjik, shoqëror dhe intelektual të tij. Përkundër dallimeve të dukshme në tiparet e jashtme të njeriut, çfarë janë madhësia, ngjyra e lëkurës, e flokëve, e formës së syve etj., të paraqitura që në etapat e hershme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, si rezultat i përshtatjes së organizmit të tij në mjedise të ndryshme gjeografike, *gjinia njerëzore është një dhe unike.* Gjatë luftës së gjatë për ekzistencë

elementare, njerëzit nga çerdhja e tyre e parë janë zgjeruar anembanë në Tokë, por të gjitha njohuritë flasin për një shtrirje karakteristike oazore dhe disperzive. Para revolucionit neolitik bujqësor (rreth 8.000 vjet para epokës sonë) vlerësohet se numri i njerëzve ishte i vogël dhe pjesa dërmuese e ekumenës së sotme kishte dendësi shumë të rrallë të popullsisë.[1]

Në fazat e hershme të ekzistimit besohet se njerëzit jetonin të ndarë, ndërsa më vonë do të bashkohen në grupe e kolektive më të mëdha dhe më të organizuara shoqërore. Së pari ishin të grupuar në hapësirat e caktuara, që kishin pozitë të volitshme gjeografike dhe kushte të tjera të përshtatshme natyrore për zhvillimin e jetës (relievi, klima, uji, vegjetacioni, fauna etj.) të cilat do të luanin rol të madh në jetën e ngulitur dhe formimin e vendbanimeve të para. Pas revolucionit bujqësor, civilizimet e para paraqiten në Egjipt (rreth 6.000 vjet para epokës sonë), Mesopotami (rreth 5.400 vjet), Kinë (3.400 vjet), pastaj në Greqi (rreth 3.000 vjet p. e. së re) etj., të cilat, besohet se për rrethanat e atëhershme ishin dendur të banuara. Luginat e lumenjve (Nili, Indi, Mesopotamia, Hoangho etj.) njihen si vatra të njohura kulturore dhe popullative, ku bujqësia e ngulitur dhe punimi i tokës ishin veçori themelore të ekonomizimit dhe të mënyrës së jetës. Këto janë edhe vatrat e zgjerimit të ekumenës në fazat e mëvonshme të zhvillimit të njerëzimit.[2]

Në epokën e egërsisë,[3] bazë ekzistenciale e jetës ishte mbledhja e frutave të gatshme, në formën që e jepte natyra, dhe gjuetia e peshkimi, ndërsa mortaliteti ishte shumë i lartë, mesatarja e jetës së të posalindurve shumë e

---

[1] Për evolucionin e popullsisë botërore prej 40.000 vjet p. e. së re deri në fund të shek. XX shih hollësisht: A. Varagnac, L'*homme avant l'Histoire,* Paris, 1959; L. Naugier, *Géographie humaine préhistorique,* Paris, 1959; V. D. Glass - D. E. C. Eversely, *Population in history. Essays in historical Demography,* London, 1965; M. Reinhard, A. Armengaud, J. Dupâquier, *Histoire générale de la population mondiale,* III éd., Paris, 1968; J.- N. Biraben, "Essai sur l'évolution du nombre des hommes", *Population,* No l, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1979; D. J. Durand, *Historical estimates of World Population: an evaluatin,* Population Studies Center, University of Pensylvania, 1974; C. McEvedy-R. Jones, *Atlas of World Population History,* Harmondsworth, New York, Victoria, Penguin Books Ltd, 1978; G. Tapinos, *La démographie. Population, économie et sociétés,* Paris, 1996.

[2] M. Reinhard, A. Armengaud, J. Dupâquier, *Po aty***,** pp. 9-38.

[3] Etnologu dhe sociologu i njohur amerikan *Henri L. Morgan* (1818-1881), i cili u mor me studimin e jetës dhe të dokeve të indianëve amerikanë, bëri periodizimin e bashkësisë së parë njerëzore në tri epoka: *të egërsisë, të barbarisë* dhe *të civilizimit.* F. Engelsi përqafoi këtë ndarje të Morganit dhe në mbështetje të materialeve dhe rezultateve shkencore të tij, në vitin 1884 shkroi librin "Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit", ku, duke zhvilluar këtë periodizim, merr për bazë nivelin e zhvillimit teknik dhe tipin e ekonomizimit, por thekson edhe dallimet midis shoqërisë klasore dhe pa klasa (F. Engelsi, *Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit,* Prishtinë, 1976, ff. 27-35).

ulët, kurse *rritja demografike tepër e kufizuar.* Më vonë, në epokën e barbarisë njerëzit veprimtarinë e tyre ekonomike e zgjerojnë në blegtori dhe bujqësi (punimi i tokës), duke qenë ende shumë të varur nga rrethanat natyrore, para së gjithash nga kullosat, pyjet dhe sipërfaqet e punueshme, në një anë, dhe nga organizimi i punës kolektive dhe rregullimi fisnor, në anën tjetër. Paraqitja e bujqësisë dhe ngulitja e njerëzve për territore të caktuara kushtëzon kalimin nga mënyra nomade apo endacake e jetës në mënyrën e jetës së ngulitur dhe krijimin e vendbanimeve të përhershme, të cilat, përveç suazave të caktuara hapësinore tash kanë edhe veçoritë e tyre prodhuese. Zhvillimi i këtyre degëve të ekonomisë, por edhe i disa zejeve dhe përsosja e mëtejme e mjeteve të punës mundësuan jo vetëm që të plotësoheshin nevojat vetanake ekzistenciale, por të krijohej edhe njëfarë teprice e prodhimit. Në këtë kohë, nga bashkësia farefisnore bëhet ndarja e familjeve të vogla në njësi të pavarura ekonomike, të cilat vetë prodhojnë dhe kësisoji shfaqen diferencat përkatëse në bazë ekonomike dhe paraqiten format e para të pronës private e të shoqërisë klasore. Diferencimi i njerëzve në bazë ekonomike do të kushtëzojë shkatërrimin e bashkësisë së parë njerëzore dhe paraqitjen e shoqërisë me dy klasa, të shoqërisë skllavopronare.[4]

Duke shqyrtuar trendin e popullsisë botërore që nga *homo sapiensi* e deri më sot, vërehet një lëvizje karakteristike: stagnime të gjata, rënie dhe rritje; në periudha të caktuara, në disa pjesë të ekumenës së sotme ndodhte edhe shpopullimi i përkohshëm. Të gjitha vlerësimet e autorëve të ndryshëm, më vonë edhe të shërbimeve të specializuara të Kombeve të Bashkuara, flasin se deri në fillim të epokës sonë dhe përgjithësisht deri në fillim të kohës moderne (zbulimet e mëdha gjeografike), karakteristikë themelore e lëvizjes së popullsisë së botës ishte rritja e ngadalshme dhe fluktuimi i saj, me dallime të theksuara në pikëpamje hapësinore dhe në periudha të caktuara, të gjata kohore, si rezultat i ndikimit të një varg faktorësh limitues.

Sipas vlerësimeve të përgjithshme, para rreth 40.000 vjetëve para epokës sonë (paleoliti i epërm) në botë jetonin rreth 500.000 banorë, ndërsa 5.000 vjet më vonë ky numër rritet në rreth 4 milionë njerëz. Kjo gjendje numerike, me fluktuime të konsiderueshme, ku, pos rrethanave të tjera, ndikim të madh ka pasur ndërrimi i klimës, nuk ndryshon deri para 10.000-5.000 vjet para epokës sonë, kur paraqiten vendbanimet e para bujqësore (revolucioni neolitik agrar).[5] Kjo periudhë, kohësisht e përvijuar midis 8.000 e 10.000 vjet para epokës sonë

---

[4] Shih më gjerë: T. Vlaškalić, Postanak ljudskog društva i osnovne karakteristike prvobitne zajednice, Rad, Beograd, 1976; S. Popović, Osnovne karakteristike robovlasničkog i feudalnog sistema, Rad, Beograd, 1976.

[5] P. Baud-S. Bourgeat-C. Bras., *Dictionnaire de géographie,* 2 ème éd., Hatier, Paris, 1997, p. 300.

dhe fillimit të epokës së re[6] njihet edhe si "revolucion neolitik demografik", që përputhet me periudhën e zëvendësimit të ekonomisë mbledhëse e të gjuetisë dhe të mënyrës endacake të jetës me ekonominë bujqësore dhe jetën e ngulitur, ku bazën kryesore e përbënin lavërtaria dhe rritja e kafshëve shtëpiake.[7] Prej atëherë vlerësohet se bota shënon një përparim demografik, kur numri i popullsisë së saj rritet prej rreth 5 milionë në rreth 300 milionë njerëz në fillim të epokës së re, të shtrirë në një pjesë relativisht të madhe të hapësirës së sotme të banuar,[8] ndërkaq, pas zbulimeve të mëdha gjeografike, në vitin 1650 në rreth 500 milionë njerëz dhe në vitin 1750 në rreth 730 milionë njerëz.[9] Kjo do të thotë se lëvizjen e popullsisë sa i përket anës së saj kuantitative e shquante një ngecje e gjatë, që është një nga veçoritë themelore të evolucionit demografik të botës. Autorët që janë marrë më hollësisht me evolucionin e popullsisë theksojnë se popullsia e botës në dhjetë shekujt e parë të epokës sonë, me fluktuime të dukshme, sillej prej 256 milionë në vitin 14 deri në 280 milionë në vitin 1000.[10]

Shkallët e të dy komponentëve riprodhues (nataliteti dhe mortaliteti) ishin në nivel shumë të lartë, por midis tyre nuk ekzistonte dallim i madh: shpeshherë në disa pika kohore, madje edhe në periudha të gjata mortaliteti ishte baras me natalitetin ose, në disa vite e periudha të shkurta, edhe më i lartë. "Në epokën tradicionale vdekja ishte në qendër të jetës, sikurse që ishte varri në qendër të fshatit".[11] Prandaj shtimi natyror ishte zero ose madje negativ, ndërsa jeta mesatare e të posalindurve sillej rreth 20, madje edhe nën 20 vjet. Vlerësohet se shkalla e lindshmërisë ishte mjaft e lartë, mirëpo numri mesatar i fëmijëve të lindur gjallë në një grua nuk ishte i madh pikërisht për shkak të jetës së shkurtër të grave, të cilat i përjetonin vetëm disa vite të periudhës së përtëritjes biologjike.[12]

---

[6] D. J. Durand, "Historical Estimates of World Population: An Evaluation", *Population and Development Review,* No 3, New York, 1977.

[7] G. Acsádi-J. Nemskeri, *History of Human Life: Span and Mortality,* Akademiai Kiedó, Budapest, 1970.

[8] D. J. Durand, "The Modern Expansion of World Population", në *Proceedings of the American Philosophical Society,* Vol. III, No 3, 1967, pp. 137; J.- N. Biraben, "Essai sur l'évolution du nombre des hommes", *Population,* No 1, INED, Paris, 1979, pp. 23-24.

[9] A. M. Carr-Saunders, W*orld Population,* Oxford University Press, Fair Laun, 1936; W. W. Willcox, *Studies in American Demography,* Cornell University Press, Itaca, 1940; United Nations, *The Determinants and Consequences of Population Trends,* Vol. I, New York, 1973.

[10] C. Clark, *Population Growth and Land Use,* MacMillan, New York, 1967 (tabela III. 1), p. 64.

[11] J. Fourastié, "De la vie tradicionnelle à la vie tertiaire", *Population,* No 3, INED, Paris, 1959, p. 418.

[12] D. Breznik, *Demografija (Analiza, metodi i modeli),* CDI, IDN, Beograd, 1977, f. 58.

Deri në revolucionin klasik industrial pothuajse nuk kishte dallime në nivelin e lindshmërisë dhe të vdekshmërisë midis vendeve sot të zhvilluara dhe vendeve sot në zhvillim, ndërsa pas kësaj kthese, veçanërisht në shekullin tonë ato do të rriten shumë. Konsiderohet se në kushtet e moszhvillimit të përgjithshëm normat e natalitetit dhe të mortalitetit silleshin deri në kufijtë e tyre fiziologjikë, midis 50 dhe 80 promilë.[13] Mirëpo, sjellja riprodhuese deri në këto norma fiziologjike nuk ka mundur të mbahej për një kohë të gjatë për arsye të ndryshimeve në strukturën e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë; nataliteti fiziologjik është edhe funksion i këtyre strukturave biologjiko-demografike.

Si faktorë kryesorë të përparimit të ngadalshëm demografik deri në kohën moderne është pra vdekshmëria e lartë si pasojë e sëmundjeve endemike dhe epidemike[14] e viteve jo të frytshme, thatësive, vërshimeve, urisë, luftërave të shpeshta etj.[15] Në rrethana të tilla shkalla e lindshmërisë duhej të ishte patjetër shumë e lartë. Mirëpo, njohësit e rrethanave historiko-demografike theksojnë se përveç vdekshmërisë së lartë, në shkallën e latë të lindshmërisë kanë ndikuar edhe faktorët e tjerë si përcjellës iskonikë të pjesës dërmuese të njerëzimit: lufta për ekzistencë jo vetëm deri në revolucionin bujqësor, por edhe gjatë epokës "agrare" kërkonte më tepër fëmijë si krah të punës (mbledhës të frutave, gjuetarë e peshkatarë dhe bujq e blegtorë). Periudha e gjatë e civilizimit agraro-blegtoral, e bazuar në mënyrën ekstensive të shfrytëzimit të të mirave natyrore, kërkonte familje të tipit të zgjeruar.[16] Për këtë periudhë, për shkak të pasigurisë së përgjithshme ekzistenciale, në shumë mjedise gjeografike dhe bashkësi etnike e konfesionale janë krijuar edhe legjenda të ndryshme lidhur me jetën dhe vdekjen.

Gjendja e stagnimit demografik zgjat deri në periudhën e zbulimeve të mëdha gjeografike. Në Evropën mesjetare, p. sh., derisa nuk ishin sjellë kulturat e reja nga "Bota e Re" (misri dhe patatja) mortaliteti i lartë ishte në lidhje të ngushtë me urinë. Pas këtyre zbulimeve, me gjithë ngadalësimin në ritmin demografik, si pasojë e mungesës së ushqimit (midis viteve 1600 dhe

---

[13] United Nations, *The World Population Situation in 1970,* New York, 1971, p. 6.

[14] Ndër sëmundjet epidemike të kohës paraindustriale, që merrnin jetëra të shumta, njiheshin murtaja, lia, kolera, tifoja, malaria, tuberkulozi, dizenteria etj. Ndër këto sëmundje, veçanërisht deri në shek. XVII, duket se murtaja bënte kërdinë më të madhe në popullatën e të gjitha moshave (M. Livi Bacci, "Définition des crises de mortalité: théorie, pratique, méthodes", *Prilozi demografskim i ekonomskim naukama,* SANU, Knj. 103, Beograd, 1994, pp. 74, 79).

[15] A. Armengaud, *Démographie et sociétés,* Stock, Paris, 1966, pp. 13-43.

[16] M. Rašević, "Kretanje stanovništva sveta sa osvrtom na modernu epohu", *Ekonomska misao,* nr. 3, Beograd, 1974, f. 116.

1700 në Evropë shënohen 34 vite jo të frytshme) dhe sëmundjeve epidemike,[17] vërehet një rrjedhë e ndjeshme e zgjimit demografik dhe në periudhën prej vitit 1650-1750 popullsia e botës rritet për 44%, ndërsa në periudhën prej 1750-1800 shënohet një zvogëlim relativ (rritja për 25%); për një shekull e gjysmë popullsia e botës rritet vetëm përreth 80% dhe mesatarisht rreth 4,5 promilë në vit (tabela 1).

Tabela 1. Lëvizja e popullsisë së botës prej zbulimeve të mëdha gjeografike deri në revolucionin klasik industrial, sipas vlerësimeve të përgjithshme.[18]

Viti	Në milionа	Dendësia e popullsisë	Rritja në %		Rritja mesatare vjetore në promilë	
1650	505	3,3	1650-1750	44	1650-1750	4,4
1750	728	5,5	1750-1800	25	1750-1800	4,9
1800	907	6,8	1650-1800	80	1650-1800	4,5

2. Rrjedhat e transicionit demografik

Kthesa të mëdha në ritmin demografik do të ndodhin, siç theksuam, në kohën e re, meqë shekujt XVIII dhe XIX shënojnë një etapë shumë të rëndësishme në zhvillimin e përgjithshëm të njerëzimit, pra edhe në zhvillimin demografik, të lidhur ngushtë me të mbërrimet epokale shkencore, teknike, materiale dhe sanitare. Revolucioni klasik industrial, i cili u paraqit në truallin e vendeve sot të zhvilluara të Evropës dhe transformimet e tjera që pasuan janë bazë edhe për revolucionin popullativ, përkatësisht transicionin demografik,[19]

[17] J.-N., Biraben, *Les hommes et la peste,* Mouton, Paris, 1976.

[18] M. Reinhard - A. Armengaud, *Histoire générale de la population mondiale,* Domat-Montchrestien, II éd., Paris, 1961; M. Friganović, *Demogegrafija (Stanovnišvo svijeta),* Školska knjiga, Zagreb, 1990, f. 64; J.–M. Poursin, *La population mondiale*, Editions du Seuil, Paris, 1976, p. 19; J.-C. Chesnais, *La population du monde de l'Antiquité à 2050,* Paris, 1991.

[19] Për idenë dhe përmbajtjen e nocionit të transicionit demografik shih: A. Landry, *La révolution démographique (Études et essais sur les problèmes de la population),* Librairie Sirey, Paris, 1934 (réédition INED, Paris, 1982, pp. 1-230); I njëjti, *Traité de démographie,* Payot, Paris, 1949, pp. 387-394; K. Davis, "The World Demographic Transition", in *The Annals of Anerican Academy of Political and Social Science,* no 237, pp. 1-11; W. Thompson, *Population and Peace in the Pacific,* University of Chicago Press, Chicago, 1946; W. F. Notestein, "Population in the long view", in T. Shultz (éd.), Food for the World, University of Chicago Press, Chicago, 1945, pp. 36-57; i njëjti, "Economic Problems of Population Change", in *Proocedings of the Eight Inernational Conference of Agricultural Economists*, Oxford University Press, New York, 1963, pp. 13-31.

që i ka përfshirë sot të gjitha vendet e botës. Fillimi i transicionit demografik[20] lidhet me rënien graduale të mortalitetit të popullsisë, proces ky që do t'i paraprijë transicionit edhe në sferën e natalitetit. Ky proces, së pari, qysh në fillim të shek. XVIII nis në Francë,[21] për t'u zgjeruar më vonë, nga fundi i shek. XVIII dhe fillimi i shek. XIX në vendet nordike (Suedia, Norvegjia) dhe perëndimore të Evropës,[22] pastaj në SHBA, Kanada, Australi, Zelandë të Re dhe në Evropën Lindore. Në shumicën e këtyre vendeve procesi i transicionit tashmë është kryer, ndërsa në stade të ndryshme të tij gjenden pothuajse të gjitha vendet e botës[23], prandaj për të sot mund të flitet si për një proces botëror.[24]

Zvogëlimi i mortalitetit në vendet sot të zhvilluara është rezultat i zhvillimit të shkencës së mjekësisë, zbulimit të medikamenteve të reja dhe efikasitetit të zbatimit të tyre (vaksinat, antibiotikët, insekticidet etj.), si dhe

---

[20] Sipas teorisë së transicionit demografik, transicioni demografik nënkupton së pari rënien e mortalitetit nën 30 promilë dhe, më vonë, edhe rënien e natalitetit gjithashtu nën 30 promilë. Mirëpo, transicioni demografik, sipas teorisë së transicionit demografik nuk nënkupton vetëm transformimin e regjimit të riprodhimit biologjik prej tipit tradicional në tip bashkëkohor, por edhe ndryshimet në komponentet dhe strukturat e tjera të popullsisë. Kjo teori shqyrton procesin e zhvillimin të popullsisë nëpër etapa të caktuara të zhvillimit shoqëroro-ekonomik, duke u mbështetur në përgjithësimin e fakteve empirike të ndryshimit të komponenteve të lëvizjes natyrore të popullsisë të vendeve të zhvilluara të Evropës Perëndimore.
Mirëpo, teoria e transicionit demografik paraqet vetëm kornizën e përgjithshme të shqyrtimit të procesit të zhvillimit demografik. Në shpjegimin e këtij procesi, veçanërisht të përtëritjes biologjike dhe në këtë kuadër të fertilitetit, duhet hulumtuar një varg shkaqesh specifike, që dalin jashtë skemës së përgjithësimit të transformimit të komponenteve vitale të popullsisë, siç i parashihte teoria e transicionit demografik. Kësaj teorie sot, me gjithë përparësitë e mëdha që ka në shpjegimin e evolucionit demografik në rrafshin teorik, mund t'i bëhen edhe shumë vërejtje (Për format, heterogjenitetin dhe shumëdimensionalitetin e transicionit demografik shih: J.-C. Chesnais, "L'effet multiplicatif de la transition démographique", *Population,* No 6, Institut national d'études démographiques, Paris, 1979, pp. 1138-1144; D. Noin, *La transition démographique dans le monde,* PUF, Paris, 1983; J.-C. Chesnais, *La transition démographique (étapes, formes, implications économiques)*, Études de séries temporelles relatives à 67 pays, PUF, Paris, 1986).

[21] J. B.-Pichat, "Évolution générale de la population française depuis le 18ème siècle", *Population,* INED, No 4, Paris, 1951, pp. 635-672; Y. Blayo, "Mouvement naturel de la population française de 1740 à 1829", *Population* (Numéro spécial), INED, Paris, 1975, pp. 15-64; ; M. Reinhard-A. Armengaud, *Po aty,* p. 126; J. Dupâquier (dir.), *Histoire de population française,* 4 volumes, PUF, Paris, 1988.

[22] J.-P. Bardet et J. Dupâquier (dir.), *Histoire des populations de l'Europe*, tome I et tome II, Fayard, Paris, 1997 et 1998.

[23] Poursin J.- M. *Po aty*, pp. 81-91.

[24] D. Tabutin-T. Eggerickx-C.Gourbin, *Transitions démographiques et sociétés,* Actes de la Chaire Quetelet 1992, Louvain-la-neuve, Academia-L'Harmathan, 1995, pp. 1-694.

zhvillimit të shëndetësisë dhe higjienës publike, me ç'rast u eliminuan shumë sëmundje epidemike dhe endemike si përcjellës shekullorë të shëndetit dhe jetës së njerëzve. Zbatimi efikas i mbrojtjes shëndetësore, preventive dhe kurative në ditët tona i përfshiu pothuajse të gjitha vendet dhe popujt e botës.[25] Në rënien e vdekshmërisë, në një anë, dhe në rritjen demografike në anën tjetër, rëndësi të veçantë në disa vende luajtën zbatimi i risive në bujqësi dhe rritja e prodhimtarisë agrare në vendet atëherë të zhvilluara dhe sigurimi i ushqimit, ku në shumë rajone të botës uria si dukuri u eliminua ose u reduktua maksimalisht, pastaj zhvillimi i komunikacionit, që mundësoi distribuimin e ushqimit në vendet që kërcënoheshin nga uria dhe sëmundjet infektive.[26]

Në shek. XX, në rënien e vdekshmërisë dhe në progresin demografik në vendet dhe rajonet e pazhvilluara rol edhe më të rëndësishëm do të luajnë të arriturat e shkencës së mjekësisë, rritja e sasisë së ushqimit dhe zhvillimi i komunikacionit. Përveç kësaj, në ndryshimet e mëdha demografike e sociale do të paraqitet një faktor i ri, *solidariteti i njerëzimit.* Pas Luftës II Botërore OKB-ja dhe organizatat e saj të specializuara, sikurse Organizata e KB-së për Ushqim dhe Bujqësi (FAO),[27] Organizata Ndërkombëtare e Shëndetësisë (WHO),[28] Fondi Ndërkombëtar i Fëmijëve për Nevoja Urgjente (UNICEF)[29] etj. bëhen bartëse të solidaritetit ndërkombëtar, duke u ndihmuar vendeve dhe popujve të rrezikuar nga uria dhe sëmundjet e ndryshme. Mirëpo, procesi i shpejtuar i transicionit demografik në sferën e mortalitetit në shumë vende dhe popullata nuk përcillej edhe me transformimin ekonomik dhe shoqëror, por më tepër ishte i kushtëzuar nga zgjerimi i mjeteve moderne mjekësore dhe sanitare.[30]

Pas zvogëlimit të mortalitetit, në shek. XIX dhe me një tempo të shpejtuar nga fundi i tij dhe fillimi i shek. XX.,[31] në vendet e zhvilluara të Evropës nisi të zvogëlohej edhe nataliteti i popullsisë dhe harta demografike e kësaj pjese të Evropës pësoi ndryshime të konsiderueshme. Para kësaj kohe procesi i lindjes në këto vende nuk ishte "i dirigjuar", por i përkiste të ashtuquajturit tip "natyror".[32] Rrjedha e rënies së natalitetit në këto vende shkonte krahas intensitetit të procesit të industrializimit e të zgjerimit të

[25] P.-J. Thumerelle, *Les populations du monde,* Nathan, Paris, 1996, p. 29.
[26] A. Armengaud, *Po aty,* ff. 45-68.
[27] FAO (Food and Agriculture Organisation).
[28] WHO (World Health Organisation).
[29] UNICEF (United Nations International Children Emergency Found).
[30] United Nations, *Population Bulletin,* No 6, New York, 1963, pp. 16-18.
[31] M. Vovelle, *La mort et l'Occident de 1300 à nous jours,* Gallimard, Paris, 1983, pp. 1-794.
[32] P. Festy, *La fécondité des pays occidentaux de 1870 à 1970*, INED, Cahier no 85, PUF, Paris, 1975, pp. 7-47.

strukturave urbane, të shkrim-leximit, të ngritjes së nivelit kulturo-arsimor, të përmirësimit të pozitës materialo-sociale e qeverisëse të femrës në familje e në shoqëri, të moshyrjes në martesë të një kontingjenti të femrave apo hyrjes së vonshme në bashkësi martesore të një numri tjetër të tyre, pastaj të zvogëlimit të mortalitetit të foshnjave, të mobilitetit më të madh hapësinor e social, të shkatërrimit të familjes tradicionale dhe ndryshimit të funksioneve të saj, të socializimit të aspekteve kyçe të jetës etj.[33]

Rënia e natalitetit në këto vende pasoi pra jo me zgjerimin e zbatimit masiv të mjeteve kontraceptive apo të zbatimit të ndonjë politike demografike të konceptuar qartë, por pikërisht me ndryshimet radikale të tipit të ekonomizimit dhe kushteve të tjera jetësore, të cilat ndikuan që individët e çiftet bashkëshortore fuqimisht t'i ndryshojnë normat, qëndrimet dhe sistemin e vlerave që e përcaktojnë nivelin e përtëritjes së popullsisë dhe të formojnë qëndrime krejtësisht të reja ndaj numrit të fëmijëve dhe madhësisë së familjes. Në këto vende faktori më i rëndësishëm i drejtpërdrejtë i karakterit sociologjik të rënies së nivelit të lindshmërisë ishte përvetësimi i të ashtuquajturit kontroll i lindjes, që u shpreh më së shumti në kohën e depresionit të madh ekonomik në vitet e 30-ta të shekullit XX.[34]

Edhe pse disa elemente të kontrollit të lindjes (metodat tradicionale) i hasim qysh në shoqëritë e pazhvilluara dhe në bashkësitë primitive, megjithatë, nën ndikim të fuqishëm të ndryshimeve shoqëroro-ekonomike, që pasuan pas revolucionit industrial, ky faktor do të luajë rol të madh në zvogëlimin e natalitetit në vendet evropiane.[35] Këto dhe determinantet e tjera të zhvillimit mundësuan edhe formimin e një sistemi modern demografik, ku nataliteti i lartë dhe familja e tipit të zgjeruar do të humbnin funksionin e tyre ekonomik e shoqëror, ndërsa me përparimin industrial dhe teknologjik dhe me krijimin e kushteve të reja të punësimit produktiv mbi këtë bazë do të ndërpritet nevoja e angazhimit të fëmijëve në jetën ekonomike, e cila në ekonominë natyrale agrare ishte dhe mbeti shumë e madhe.

---

[33] R. A. Bulatao-R. D. Lee, *Determinants of Fertility in Developing Countries,* Academic Press, New York, 1983, 2 vol., pp. 642 dhe 846; A. Armengaud, *Po aty,* pp. 45-68.

[34] Në gjysmën e këtyre viteve fertiliteti bie nën nivelin që siguron përtëritjen afatgjate të popullsisë në Francë, Angli, Gjermani, Austri, Zvicër, vendet nordike etj. Pas periudhës së kompensimit demografik në vitet e 50-ta, në këto vende përsëri pason rënia e fertilitetit nën nivelin e riprodhimit të brezave.

[35] Planifikimin e familjes me elemente pro dhe contra lindshmërisë e gjejmë edhe në Evropën Antike. Studimet antropologjike, etnologjike, kulturologjike etj. tregojnë se si metodë më efikase për kufizimin e lindjeve qysh herët është shfrytëzuar aborti, i cili edhe më vonë, në fillim të fazës së transicionit demografik, ishte mjeti kryesor i planifikimit të familjes, ndërsa që nga fundi i kësaj faze do të dominojë zbatimi masiv i mjeteve kontraceptive.

Eksperienca e zhvillimit demografik të vendeve sot të zhvilluara, të cilat e kanë kaluar etapën e transicionit demografik, tregon se rënia e mortalitetit dhe e natalitetit janë zhvilluar në përputhje me transformimet radikale të bazës ekonomike të shoqërisë dhe me ndryshimin e rrethanave sociale-ekonomike të popullsisë në kuptim të gjerë. Historia demografike e këtyre vendeve, veçanërisht e vendeve evropiane[36] dhe prosperiteti i tyre ekonomik e shoqëror i demantuan në themel pikëpamjet pesimiste të Maltusit[37] dhe ithtarëve të tij, si dhe neomaltusianistëve[38] të shekullit njëzet lidhur me zhvillimin e popullsisë dhe të mirave materiale në të ardhmen. Zhvillimi material, social e mendor tregoi gjithashtu se ligjësitë e zhvillimit të popullsisë nuk janë të përhershme, por varen nga ndryshimi i kushteve shoqërore në kohë dhe hapësirë.

Shumë vende të zhvilluara të Evropës ballafaqohen sot me probleme të mëdha në zhvillimin e tyre demografik, veçanërisht në sferën e riprodhimit të popullsisë dhe atë si në fshat, ashtu edhe në qytet. Në disa vende shtimi natyror

---

[36] Bardet J.-P. et Dupâquier J., *Histoire des populations de l'Europe*, Paris, 1997-1999.

[37] Tomas Robert Malthus-i (1766-1834), i popullarizuar me veprën "Essay on the Principle of Population" ("Mbi parimet e popullatës", të botuar në Londër në vitin 1798), lindshmërinë dhe popullsinë në përgjithësi i konsideronte madhësi të pandryshuar në hapësirë dhe kohë. Popullsia dhe varëfërimi i saj, sipas tij, nuk vareshin nga kushtet shoqëroro-historike dhe institucionet sociale, por nga të ashtuquajturat ligje konstante natyrore. Sipas tij, meqenëse do të ndodhte kufizimi i mjeteve për ekzistencë, gjë që nuk e vërtetoi zhvillimi i mëvonshëm material e mendor i njerëzimit, duhej ndërmarrë një varg masash të karakterit preventiv dhe pozitiv për zvogëlimin e lindjeve. Preferonte që numri i lindjeve të kufizohej me abstenim moral dhe ngurrim seksual, me shtyrjen e martesave dhe me moshyrje në martesa (celibati), si *pengesa preventive*, dhe me epidemi, uri e luftëra, si *pengesa pozitiv*e. Teoria e Maltusit dhe ithtarëve të tij ishte thellësisht antishkencore dhe antihumane (Shih edhe versionin në gjuhën frënge: Thomas R. Malthus, *Essai sur le principe de population,* Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1980, pp. 1-166).
Maltusianizmi si doktrinë lindi në Angli, por, për shumë arsye, më së gjati gjeti shprehje në praktikë në Francë. Shih për këtë në: A. Armengaud, *Le français et Malthus,* PUF, Paris, 1975, pp. 1-142; A. Sauvy, *La prévention des naisances*, PUF, col. "Que sais-je?", No 988, 3ème éd., Paris, 1967, pp. 1-128.

[38] Pas Maltusit dhe teorisë së tij paraqitet doktrina tjetër gjithashtu pa mbështetje shkencore e humane, *neomaltusianizmi*, që del në formë të neomaltusianizmit të hershëm dhe zgjatë nga vdekja e Maltusit e deri në Luftën II Botërore, dhe të neomaltusianizmit bashkëkohor, që paraqitet pas kësaj lufte në disa vende perëndimore.
Dallimet midis doktrinës maltusianiste dhe asaj neomaltusianiste qëndrojnë vetëm në mjetet e ndërmarra, ndërsa qëllimet i kanë të njëjta. Neomaltusianistët insistojnë që problemet ekzistuese socialo-ekonomike të zgjidhen me kufizimin e lindjeve dhe pengimin e rritjes së numrit të popullsisë, duke zbatuar mjetet kontraceptive, abortimet, madje edhe sterilizimin (R. Pressat, *Dictionaire de démographie,* PUF, Paris, 1979, pp. 138-139; shih edhe në: UN, *Višejezički demografski rečnik, srpskohrvatska verzija,* CDI, IDN, Beograd, 1971, pika 90).

ka tashmë tendencë negative (Gjermania në fshat dhe në qytet; Austria në qytet; Franca në fshat etj.) me mundësi që të hyjë në një fazë të thellë të shpopullimit (denataliteti).[39] Rreth dy të tretat e vendeve të këtij kontinenti ka kohë që kanë normën e riprodhimit neto nën një, që nuk siguron pra as riprodhimin e thjeshtë të popullsisë së tyre. Dhe tendenca është negative: në vitin 1970 në Evropën Perëndimore një grua kishte lindur 2,4 fëmijë, [40] në vitin 2002 ky numër kishte rënë në 1,5 fëmijë. [41] Ndërkaq, për t'u mbajtur një gjendje stabile demografike një grua duhet të lind së paku 2,1 fëmijë.

Imigrimet e fuqisë punëtore dhe të popullsisë nga vendet e pazhvilluara duket se i shpëtuan shumë vende të zhvilluara dhe zhvillimin e tyre demografik dhe ekonomik. Po të mos ishte imigrimi i fuqisë punëtore dhe i popullsisë nga rajonet e tjera të pazhvilluara, sidomos nga Siujdhesa Ballkanike e Pirineje, Italia Jugore etj., dhe vendet e tjera, shumë shtete të Evropës do të ballafaqoheshin me një krizë serioze demografike, me implikime të mëdha për zhvillimin e tyre shoqëror dhe ekonomik (mungesa e fuqisë punëtore, ngarkesa e fondeve pensionale dhe mirëqenies sociale etj.). Stabilitetin demografik në Gjermani p. sh. e mbajti imigrimi. Shumë vende evropiane, me masa të ndryshme stimulative, sot po bëjnë përpjekje për rehabilitimin e procesit të lindshmërisë, por rezultatet nuk janë të kënaqshme. Procesi i moshënimit demografik do të jetë i tmerrshëm për Evropën në qoftë se nuk arrihet që familjet të kenë më shumë se dy fëmijë, gjë që është pak e besueshme. Parashihet që në vendet e Bashkimit Evropian, duke përfshirë Bullgarinë dhe Rumaninë si anëtare të reja, numri i popullsisë të zvogëlohet nga 482 milionë banorë sa kishte më 2004 në 454 milionë banorë në vitin 2007. Ose, nëse vazhdon trendi i sotëm demografik në Gjermani, ky vend mund të ketë rënie të numrit të përgjithshëm të popullsisë nga 82 milionë më 2004 në 24 milionë në fund të këtij shekulli!

---

[39] Dukuria e denatalitetit nënkupton shtimin negativ natyror, rënien e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe shpopullimin si pasojë e zvogëlimit të natalitetit dhe rritjen relative dhe absolute të numrit të vdekjeve në një popullatë (R. Pressat, *Dictionaire de démographie,* PUF, Paris, 1979, pp. 46-47; UN, *Višejezički demografski rečnik,* f. 83 (pika 930).

[40] Në vitet 1970-1975 neto norma e përtëritjes biologjike në vendet e Evropës Perëndimore ishte një, e mjaftueshme për një gjendje stabile demografike (United Nations, Concise Report on the Population Situation in 1970-1975 and its long-rang implications, New York, 1974, p. 70).

[41] Më gjerë në: Conseil de l'Europe, É*volution démografique récente en Europe 1995*, Strasbourg, 1995, pp. 1-334.

Tabela 2. Lëvizja e popullsisë së botës prej revolucionit industrial deri në fund të shek. XX, sipas burimeve të ndryshme dhe vlerësimeve të përgjithshme[42]

Viti	Në mili-ona	Dendësia e popullsisë (pjesa e banuar tokësore)	Indeksi i rritjes 1800=100	Rritja mesatare vjetore në promilë
1800	907	6,8	100	6,5
1850	1.175	8,9	130	6,3
1900	1.620	12,8	180	8,8
1920	1.834	13,8	203	10,0
1930	2.008	15,1	221	11,2
1940	2.216	16,7	244	12,4
1950	2.476	18,3	273	15,5
1960	2.972	22,4	328	21,0
1970	3.610	26,5	398	20,0
1975	3.968	29,2	437	19,0
1980	4.432	32,8	489	18,0
1985	4.826	35,7	532	17,0
1990	5.292	37,9	583	17,0
1995	5.773	41,0	636	16,0
2000	6.115	43,1	673	15,0
2007	6.773	46,2	746	14,5

Vërehen dallime të dukshme kohore sa i përket vëllimit dhe intensitetit të rrjedhave demografike në planin global: deri në fund të shek. XIX popullsia e botës karakterizohet me rritje më të ngadalshme, ndërsa në shek. XX shënohet një "bum" i vërtetë demografik. Procesi i rritjes shpejtohet veçanërisht në pjesën e dytë të tij, ku dyfishimi i popullsisë bëhet vetëm për disa dhjetëvjetësha: në periudhën 1930-1975 për 45 vjet, ndërsa në periudhën 1950-1986 madje për 35 vjet. Dinamika e shpejtimit të kohës për rritjen e numrit të popullsisë së botës duket kështu: derisa për rritjen prej 1 deri 2 miliardë (midis viteve 1800 dhe 1930) banorë nevojiteshin rreth 130 vjet dhe për rritjen prej 2 deri 3 miliardë (1931-1960) afër 30 vjet, ndërsa realizimi i shtimit prej 3 deri 4 miliardë (1961-1975) bëhet vetëm për 14 vjet, prej 4 deri 5 miliardë (1976-1987) për 11 dhe për 5 deri 6 miliardë (1988-1998) për 10 vjet.

[42] A. Sauvy, *De Malthus à Mao Tse Tung. Le problème de la population dans le monde,* Danoël, Paris, 1958; United Nations, *Demographic Year Book, 1958-1965. Statistical Year Book,* New York, 1975; United Nations, *World Statistics in brief,* New York, 1981; M. Friganović, *Po aty,* ff. 32, 35; I. M. Poursin, *Po aty,* p. 19; *Images économiques du monde 2004,* A. Colin, Paris, 2004, p. 31; web-faqja www.ibiblio.org/lunarbin/wordpop.

Tabela 3. Ora e popullsisë botërore në vitin 1995[43]

Koha	Numri i lindjeve	Numri i vdekjeve	Shtimi natyror	
	1995	1995	1995	2007
Në vit	139.387.000	51.024.000	88.363.000	83.950.000
Në muaj	11.615.583	4.252.000	7.363.583	7.666.000
Në ditë	381.882	139.792	242.090	255.000
Në orë	15.912	5.825	10.087	10.000
Në minut	265	97	168	166
Në sekond	4,4	1,6	2,8	2,7

Shtimi më i madh i njerëzimit përputhet me kohën pas revolucionit klasik industrial dhe, lidhur me të, të kthesave të tjera që pasuan. Prej vitit 1800-1900 popullsia e botës rritet përreth 80%, në periudhën prej 1800-1950 për më se 170% dhe prej vitit 1800-2000 për afër 600%. Derisa në vitet e 50-ta shtimi natyror i popullsisë së botës ishte rreth 50 milionë veta mesatarisht në vit (137.000 veta në ditë), ndërkaq në vitet e 80-ta dhe në gjysmën e parë të viteve të 90-ta ky shtim është rreth 90 milionë veta ose rreth 246.000 veta në ditë. Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO), gjatë vitit 1997 çdo ditë lindën nga 365 mijë fëmijë, ndërsa vdiqën 140 mijë persona, që do të thotë se në ditë janë shtuar 225 mijë persona; shtimi i përgjithshëm absolut për këtë vit ishte rreth 80 milionë banorë, afër 10 milionë më pak se mesatarja vjetore e viteve të mëparshme.

3. Diferencat e mëdha regjionale në zhvillimin e popullsisë

Në kuadër të ligjësive të zhvillimit të përgjithshëm të njerëzimit, popullsia si në pikëpamje kohore, ashtu edhe atë hapësinore nuk ka pasur evolucion të njëjtë. Rreth vitit 1800 dallimet në normat e lëvizjes natyrore midis rajoneve të zhvilluara dhe rajoneve më pak të zhvilluara ishin fare të vogla, ndërsa pas këtij viti pason diferencimi i theksuar midis tyre, së pari në shkallën e mortalitetit e pastaj edhe në shkallën e natalitetit (tabela 7). Në të gjitha komponentët e dinamikës natyrore dallimet midis këtyre territoreve do të rriten sidomos në pjesën e dytë të shek. XX, kur edhe ritmi i rritjes demografike shpejtohet në vendet dhe rajonet më pak të zhvilluara më tepër për shkak të zvogëlimit të vdekshmërisë (lufta kundër sëmundjeve infektive, zhdukja e insekteve, sigurimi i ujit të pijshëm etj.) dhe ruajtjes së nivelit të lartë të shkallës së lindshmërisë se sa të përmirësimit të gjendjes ekonomike-sociale. Është vlerësim i përgjithshëm se përmirësimi sadopak i situatës shëndetësore, rënia e mortalitetit dhe lidhur më të

[43] Burimi: Për vitin 1995: *Population Today, Population Reference Bureau*, Washington, 1996; P.-J. Thumerelle, *Les populations du monde,* Nathan, Paris, 1996, p. 9; për vitin 2007: web-faqja www.ibiblio.org/lunarbin/wordpop.

edhe rritja e kontingjentit të popullsisë në periudhën fertile dhe rritja e numrit të bashkësive martesore, në disa prej këtyre vendeve ka kushtëzuar madje edhe rritjen e normës së natalitetit, gjë që nuk mund të jetë krejtësisht identike me rritjen e shkallës së natalitetit në periudhën e kompensimit demografik, që ndodhi në shumë vende dhe popullata pas Luftës II Botërore.

Mirëpo, midis vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim, përkundër dallimeve të vogla në mortalitetin e përgjithshëm, sa i përket vdekshmërisë së foshnjave dallimet janë shumë të mëdha: rreth vitit 1990 në vendet e para norma e mortalitetit të foshnjave ishte rreth 15 promilë, ndërsa në të dytat rreth 80 promilë. Dallimet janë gjithashtu të mëdha edhe sa i përket mesatares së jetës të të posalindurve, si indikator sintetik i nivelit dhe intensitetit të vdekshmërisë së një popullate, ku në vendet e zhvilluara rreth viteve të 90-ta të shekullit XX sillej rreth 74 vjet, kurse në vendet në zhvillim rreth 60 vjet. Ose, të ardhurat mesatare të vendeve të varfra janë rreth 40 herë më të ulëta se të vendeve të pasura; rreth gjysma e njerëzimit jeton me më pak se dy dollarë amerikanë në ditë. Vendet më pak të zhvilluara në vitin 2001 kishin 1.274 dollarë per capita, Evropa Qendrore dhe Lindore 3.850 dhe vendet e UE rreth 23.000 dollarë amerikanë (bota 7.377). Nuk është gjendja e volitshme as sa i përket indikatorëve të tjerë të zhvillimit njerëzor: shkalla e shkrim-leximit të të rriturve në vitin 2001 ishte në vendet e zhvilluara rreth 75%, në vendet më pak të zhvilluara rreth 53%, ndërsa në vendet subsahariene dhe arabe rreth 60%. Në shkallën e përfshirjes në shkollim dallimet po kështu janë të mëdha: vendet më pak të zhvilluara 43%, vendet e Evropës Qendrore rreth 80% dhe vendet e UE rreth 80%.[44] Dallimet në këta indikatorë tregojnë gjithë peshën e problemeve shëndetësore të popullsisë dhe të zhvillimit kompleks socialo-ekonomik me të cilat ballafaqohen vendet në zhvillim dhe rajonet në zhvillim.

Dallimet do të bëhen edhe më të mëdha si midis rajoneve të zhvilluara, ashtu edhe rajoneve në zhvillim në raport me mesataren botërore, ku rritja mesatare vjetore për periudhën 1950-2000 për botën si tërësi është 18-19 promilë, ndërsa dendësia e popullsisë është rreth 30 banorë në një kilometër katror (pjesa e banuar tokësore) dhe rreth 25 banorë (gjithë pjesa kontinentale). Sipas të dhënave të OKB-së, në periudhën 1985-1990 popullsia e botës dyfishohej për 41 vjet, ndërsa pjesa e zhvilluar për 139 vjet (sa edhe popullsia e Serbisë) dhe pjesa e pazhvilluar e botës për çdo 33 vjet (sa edhe dyfishimi i popullsisë së Kosovës sot).

Në vitin 1650 pjesa dërmuese e popullsisë së botës shtrihej në Azi (60,0% dhe në vitin 1800 rreth 66%), pastaj në Afrikë (18,3%) dhe në Evropë (16,5%), në Amerikën Qendrore e Jugore edhe më pak (3,2%), në territorin e

[44] *L'État du monde 2004,* La Découverte, Paris, 2003, p. 589.

ish-BRSS-së (2,4%), në Australi dhe Oqeani edhe më pak (2 milionë ose 0,4%), ndërsa Amerika Veriore kishte vetëm rreth l milion banorë ose 0,2%. Në shekujt e mëvonshëm, veçanërisht në gjysmën e dytë të shek. XX, dallimet në gjendjen numerike dhe në intensitetin e rritjes së popullsisë shtohen dukshëm, kështu që në fund të këtij shekulli (rreth vitit 1990) këto raporte ndryshojnë shumë, ku vendin e parë përsëri e zë kontinenti i Azisë, por me përqindje më të vogël (rreth 60,0%), pastaj vjen Afrika (rreth 13,0%), Evropa (rreth 9,0%), Amerika Latine (rreth 8,0%), ish-BRSS-ja (rreth 5,0%), Amerika Veriore (rreth 5,0%) dhe Oqeania (0,5%). Deri në vitin 1970 Evropa kishte numër më të madh të popullsisë se Afrika; barazohen rreth vitit 1980, ndërsa në vitin 1990, për shkak të rënies së mortalitetit, nivelit të lartë të natalitetit dhe rritjes së shtimit natyror, popullsia e Afrikës shënon rritje të lartë.[45] Mirëpo, dallime më të mëdha në intensitetin e rritjes dhe në shtrirje dalin edhe në një aspekt tjetër hapësinor: Bota e Vjetër (Azia, Afrika, Evropa), që përbën rreth 63% të territorit të banuar, ishte dhe mbeti vatër dominante popullative, ku jeton rreth 86% e njerëzimit, ndërsa "Bota e Re" (Angloamerika, Amerika Latine dhe Australia me Oqeani), e cila përbën rreth 37% të ekumenës, karakterizohet me numër më të vogël të popullsisë (vetëm rreth 14%) dhe me dendësi të rrallë. Lëvizja e numrit të popullsisë sipas kontinenteve shihet nga tabela nr. 4.

Baza natyrore-gjeografike përmes relievit, klimës, ujit, vegjetacionit, truallit dhe botës shtazore duket se ka qenë njëra nga kushtet kryesore në formimin e strukturës së popullimit të botës në etapën e popullimit themelor në të kaluarën. Kur të vështrohet harta e popullimit në botë, vërehet se pjesa dërmuese e popullsisë së botës (rreth 50%) aktualisht shtrihet në zonën e mesme (20-40 shkallë të gjerësisë veriore gjeografike), në Hemisferën Veriore rreth 88%, në "Botën e Vjetër" rreth 85%, në kontaktet midis kontinentit (tokës) dhe ujit, në pjesët e jashtme të kontinenteve, rreth liqeneve, lumenjve e luginave të tyre, rreth rrugëve, rrëzë maleve, në anët e kthyera nga dielli, në rajonet e zhvilluara industriale, në qendrat e mëdha urbane etj. Rreth 80% e popullsisë së botës jeton në lartësi mbidetare nën 500 metra.[46] Ndërsa si rrjedhojë e përshtatshmërive natyrore-gjeografike dhe e proceseve të caktuara shoqërore-historike janë krijuar territoret e koncentrimit të fuqishëm popullativ. P. sh. në një hapësirë prej rreth 12% jetojnë afër 70% të popullsisë së botës (Azia JL, që përfshin rreth 8% të sipërfaqes së botës, me më se 50% të

---

[45] Për lëvizjen natyrore dhe shtrirjen gjeografike të popullsisë së botës sot shih më hollësisht: *Fond des Nations Unies pour les activités de population: Etat de la population mondiale, 1994:* Choix et responsabilités, New York, 1994.

[46] D. Noin, *Géographie de la population,* Masson, Paris-New York-Barcelone-Milan, 1979, pp. 74-80.

popullsisë së botës, Evropa JP me 3% të sipërfaqes dhe 13% të popullsisë dhe pjesa verilindore e SHBA-ve me 1% të territorit dhe 3% të popullsisë botërore).

Tabela 4. Lëvizja dhe shtrirja e popullsisë së botës sipas kontinenteve prej vitit 1650-2003[47]

Viti	Bota	Afrika	Amerika Latine	Amerika Veriore	Azia	Evropa	Oqeania	BRSS
Popullsia (në miliona)								
1650	545	100	12	1	327	90	2	13
1750	750	100	12	1	480	125	2	30
1800	960	100	20	6	630	157	2	45
1900	1.650	150	65	81	930	288	6	130
1950	2.516	224	165	166	1.375	392	13	180
1960	3.019	280	217	199	1.669	425	16	214
1970	3.693	361	283	227	2.102	459	19	242
1980	4.450	479	361	252	2.584	485	23	265
1990	5.246	645	451	275	3.058	499	26	292
1996	5.804	719	490	296	3.471	506	29	293
2003	6.301	851	543	623	3.823	726	32	-
B. Distribuimi (në %)								
1650	100,0	18,3	3,2	0,2	60,0	16,5	0,4	2,4
1750	100,0	18,3	1,6	0,1	64,0	16,7	0.3	4,0
1800	100,0	10,4	2,1	0,6	65,6	16,4	0,2	4,7
1900	100,0	9,1	3,9	4,9	56,4	17,5	0,4	7,9
1950	100,0	8,9	6,6	6,6	54,7	15,6	0,5	7,2
1960	100,0	9,3	7,2	6,6	55,2	14,1	0,5	7,1
1970	100,0	9,8	7,7	6,1	56,9	12,4	0,5	6,6
1980	100,0	10,8	8,1	5,7	58,0	10,9	0,5	6,0
1990	100,0	12,3	8,6	5,2	58,3	9,5	0,5	5,6
1996	100,0	12,4	8,5	5,0	59,9	8,7	0,5	5,0
2003	100,0	13,5	8,6	5,1	60,6	11,5	0,5	-

[47] A. M. Carr-Saunders, W*orld Population,* Oxford University Press, Fair Laun, 1936; J. D. Durand, "World Population Estimates 1750-1900", *Proceedings of the World Population Conference***,** Belgrade, 1965, Vol. II, pp. 16-22; P. Paillot, *Problèmes démographiques d'aujourd'hui,* Hatier, Paris, 1976, pp. 6-11; United Nations, W*orld Population Trends and Policies, 1987***,** New York, 1988; D. Breznik, "Osnovne tendencije u razvitku stanovništva SR Jugoslavije i sveta", *Prilozi demografskim i ekonomskim naukama,* SANU, Odeljenje društvenih nauka, knj. 103, Beograd, 1994, ff. 91-92; *The State of World Population,* UNFPA, New York, 1996, pp. 122-131 (për vitin 1996, në bazë të disa burimeve të tjera, janë bërë disa korrigjime, veçanërisht për Azinë dhe Afrikën); *L'État du monde 2004,* La Découverte, Paris, 2003, pp. 598-601.

C. Rritja (në %)

1650-1750	37,6	0,0	0,0	0,0	46,8	38,9	0,0	130,8
1750-1800	28,0	0,0	66,7	500,0	31,2	25,6	0,0	50,0
1800-1900	71,9	50,0	225,0	1250,0	47,6	83,4	200,0	188,9
1900-1950	52,5	49,3	153,8	104,9	47,8	36,1	116,7	38,5
1950-1960	20,0	25,0	31,5	19,9	21,4	8,4	23,0	18,9
1960-1970	22,3	28,9	30,4	14,0	25,9	8,0	18,7	13,0
1970-1980	20,5	32,7	27,6	11,0	22,9	5,7	21,0	9,5
1980-1990	17,9	34,6	27,6	9,1	18,3	2,9	13,0	10,1
1990-1996	10,6	11,4	8,6	7,6	14,9	1,4	11,5	0,3
1996-2003	8,5	18,3	10,8	10,1	10,1	43,4	10,3	-
1990-2003	20,1	31,9	20,3	18,5	25,0	45,4	23,0	-
1950-2003	150,4	279,3	229,0	96,3	178,0	85,2	146,1	-

Vërejtje: Në Amerikën Latine janë përfshirë edhe Karaibet. Deri në vitin 1996 Evropa pa disa shtete të ish-BRSS-së; deri në këtë vit përfshihet popullsia e gjithë ish-Bashkimit Sovjetik, 15 ish-republikat, sot shtete të pavarura. Në vitin 2003 në Evropë është përfshirë edhe popullsia e disa shteteve të ish-BRSS-së, sot shtete të pavarura (Rusia 143 milionë, Ukraina 48,5, Bjellorusia 9,0, Moldavia 4,3 milionë dhe vendet baltike: Lituania 3,4, Letonia 2,3 dhe Estonia 1,3 milionë), që përbëjnë gjithsej rreth 213 milionë banorë. Në vitet e mëparshme këto shtete dhe shumë shtete të tjera në lindje, që sot hynë në kontinentin e Azisë, ishin të përfshira brenda ish-BRSS-së.

Pasqyra e shtrirjes dhe e dendësisë së popullsisë së botës edhe sot tregon ndikimin dominant të bazës natyrore. "Nuk janë rastësisht më dendur të banuara viset e ulëta dhe fushore në gjerësitë e mesme gjeografike, e as e rastit që në këto hapësira të ekumenës njeriu ka shkuar më larg në veprimtaritë e tij, në shkallën e shfrytëzimit dhe të transformimit të mjedisit të mëparshëm natyror. Nuk kanë rastësisht dendësi më të madhe as rajonet bregdetare, në të cilat njeriu qysh herët i ka njohur përparësitë e jetës në kontaktin midis dy ambienteve natyrore, të përshtatshme secili në mënyrën e vet, sikundër që nuk janë rastësisht më të banuara rrëzat nga malet dhe rrafshinat, ku në mënyrë të kombinuar i ka shfrytëzuar dy mjediset dhe më lehtë ka ekzistuar".[48] Mirëpo, në anën tjetër, në botë ka plot vise, që karakterizohen me veçori të përshtatshme natyrore-gjeografike, por kanë mbetur rrallë të banuara, që do të thotë se kanë ndikuar faktorët e tjerë me përmbajtje shoqërore, me ndikim të diferencuar hapësinor. Edhe pse shkenca dhe teknika kanë mundësuar që njeriu të qëndrojë për një kohë të shkurtër në çdo pjesë të globit, megjithatë, në shumë drejtime, rëndësi të madhe ka qëndrimi i përhershëm i njeriut dhe më

[48] M. Friganović, *Po aty,* f. 189.

tepër i popullsisë dhe i ndikimit të saj në transformimin e mjedisit, në valorizimin e tij dhe në krijimin e strukturës së re të popullimit.

Në anën tjetër, dallimet në vëllimin dhe rritjen e popullsisë sot sikur reduktohen midis vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim. Në rënien e shpejtë të mortalitetit në vendet e pazhvilluara, si duket, më tepër ushtruan ndikim faktorët e përmendur se sa zhvillimi ekonomik dhe social dhe ngritja e standardit jetësor në përgjithësi, gjë që ndikoi që shkalla e natalitetit të mbetej në nivel shumë të lartë, madje në shume rajone dhe vende, në periudha të shkurta apo të gjata, të shënojë edhe rritje, kryesisht në saje të përmirësimit të rrethanave shëndetësore dhe ushqimit, rritjes së përqindjes së popullsisë në periudhën e riprodhimit dhe ngritjes së mesatares së jetës. Në këtë mënyrë këto vende shënuan rritje të shtimit natyror dhe të shtimit të përgjithshëm të popullsisë, ku u arrit dyfishimi për 25 vjet, ndërsa me këtë dallimet kontinentale dhe rajonale të rritjes dhe shtrirjes së popullsisë thellohen deri në atë shkallë sa, duke abstraktuar proceset e zhvillimit historik dhe dominimet kolonialiste, sot botën e ndajnë në pjesën e zhvilluar dhe pjesën e pazhvilluar, në atë të pasur dhe në atë të varfër. Në këtë ndarje, shumë qarqe, fajin kryesor pa të drejtë do t'ia hedhin faktorit demografik të vendeve dhe popujve të pazhvilluar.

Tabela 5. Vlerësimet dhe projeksionet e popullsisë së botës dhe rajoneve të saj prej 1650-2000, sipas variantit të mesëm (në miliona)[49]

Viti	Bota		Rajonet e zhvilluara		Rajonet më pak të zhvilluara	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
1650	507	100,0	106	20,9	401	79,0
1750	791	100,0	201	25,7	590	74,3
1800	978	100,0	248	25,6	730	74,4
1900	1.650	100,0	573	34,7	1.077	65,3
1950	2.516	100,0	752	29,9	1.766	70,1
1990	5.292	100,0	1.089	20,6	4.203	79,4
1996	5.804	100,0	1.171	20,2	4.633	79,8
2000	6.261	100,0	1.143	18,3	5.008	81,7

[49] A. M. Carr-Saunders, W*orld Population,* Oxford University Press, Fair Laun, 1936; W. W. Willcox, *Studies in American Demographie,* Cornell University Press, Ithaca, 1940; United Nations, *The World Population Situation in 1970,* New York, 1971; United Nations, *Long-range World Population Projections. Two Centuries of Population Growth, 1950-2150,* New York, 1992; *The State of World Population 1966,* UNFPA, New York, 1996.

Pas Luftës II Botërore, përkatësisht në vitin 1950 vetëm 4 shtete kishin më shumë se 100 milionë banorë (Kina 556.613, India 358.293, BRSS-ja 178.547 dhe SHBA-ja 152.271), ndërsa në vitin 2002 ky numër rritet në 11 vende dhe 6 prej tyre përbëjnë më se gjysmën e popullsisë së botës (Kina, India, SHBA-ja, Indonezia, Brazili dhe Rusia); vetëm Kina përbën më se 1/5 e popullsisë botërore (tabela 6).

Tabela 6. Vendet me më shumë se 100 milionë banorë në vitin 2002 (në miliona dhe në përqindje) dhe më dendësi të ndryshme të popullsisë[50]

Vendi	Numri	%	Dendësia	Vendi	Numri	%	Dendësia
Kina[51]	1.280.700	20,6	133,4	Pakistani	143.500	2,3	180,3
India	1.049.500	16,9	319,2	Bangladeshi	133.600	2,1	927,8
SHBA	287.400	4,6	30,7	Nigeria	129.900	2,1	9,7
Indonezia	217.000	3,5	113,9	Japonia	127.400	2,0	337,2
Brazili	173.800	2,8	20,3	Meksika	101.700	1,6	51,9
Rusia	145.300	2,3	8,4				

Tabela 7. Normat e vlerësuara (të rrumbullaksuara) të lëvizjes natyrore të popullsisë në rajonet e zhvilluara dhe në rajonet më pak të zhvilluara prej 1750-2000, sipas periudhave 50-vjeçare dhe 10-vjeçare (në promilë)[52]

Periudha	Rajonet e zhvilluara			Rajonet më pak të zhvilluara		
	N	M	SHN	N	M	SHN
1750-1800	38	34	4	41	37	4
1800-1850	39	32	7	41	36	5
1850-1900	38	29	9	40	38	2
1900-1950	26	18	8	41	32	9
1950-2000	20	10	10	37	14	23
1900-1910	34	21	13	41	34	7
1910-1920	26	23	3	40	37	3
1920-1930	28	16	12	41	13	10
1930-1940	22	14	8	41	29	12
1940-1950	20	15	5	40	28	12
1950-1960	22	10	12	43	22	21

[50] *Images économiques du monde 2004*, A. Colin, Paris, 2004, p. 27.
[51] Pikërisht më 6 janar 2005 Kina arriti në 1.300.000 banorë.
[52] United Nations, *The World Population Situation in 1970, Populations Studies*, No 49, Department of Economic and Social Affairs, New York, 1971, p. 7; P. Paillot, *Problèmes démographiques d'aujourd'hui,* Hatier, Paris, 1976, p. 11.

1960-1970	20	9	11	41	17	24
1970-1980	19	9	10	38	13	25
1980-1990	19	10	9	34	10	24
1990-2000	18	10	8	29	8	21

Edhe pse si midis shkencëtarëve dhe ekspertëve, ashtu edhe midis vendeve e qeverive të ndryshme ekzistonin dallime në pikëpamje teorike, praktike dhe ideologjike, megjithatë në këto 50 vjetët e fundit u shënuan arritje të mëdha në njohjen e situatës demografike nga aspekti human, shëndetësor, social, ekonomik, politik etj. Në këtë periudhë, shumë shkencëtarë e politikanë ndërruan mendimet dhe orientimet sa i përket gjetjes së rrugëve të zgjidhjes së problemeve popullative. Insistimet e disa ekspertëve dhe qeverive të tyre që në rastin e zbatimit të politikës popullative patjetër duhej të inkuadrohej komponenti i zvogëlimit të natalitetit gjithnjë ka nxitur kundërthënie e mospajtime dhe idenë e politikës popullative e ka shndërruar, madje edhe degraduar në kontroll të lindjes dhe planifikim të familjes, me ç'rast janë krijuar mosmarrëveshje në përdorimin e këtyre nocioneve. Por, nuk duhet të ngatërrohen politika e planifikimit të familjes me politikën popullative, sepse qenësisht dallojnë midis tyre, sikundër që përmes planifikimit të familjes nuk duhet të realizohen qëllimet demografiko-politike. Këto qëllime mund të arrihen vetëm kur përmes masave të politikës ekonomike, sociale, arsimore, shëndetësore etj. ushtrohet ndikim në rrjedhat e lindshmërisë, të migrimeve dhe komponentëve të tjerë të popullsisë.

Tabela 8. Lëvizja natyrore e popullsisë në vendet e zhvilluara dhe në vendet më pak të zhvilluara në vitin 1995 në miliona (vlerësimi)[53]

	Lindjet	Vdekjet	Shtimi natyror	Mortaliteti i foshnjave
Bota	139,4	51,0	88,4	8,60
Vendet e zhvilluara	14,0	12,0	2,0	0,14
- Vendet e BE	4,1	3,7	0,4	0,03
Vendet më pak				
të zhvilluara	125,4	38,9	86,5	8,16
- Azia	83,0	27,0	56,0	5,20
- Kina	21,6	7,9	13,7	0,95

[53] Burimi: *Population Today and World Population Data Sheet,* Population Reference Bureau, Washington, 1966; P. J.-Thumerelle, *Les populations du monde, N*athan, Paris, 1996, p. 16.

- India	26,5	8,4	18,1	1,96
- Pakistani	5,1	1,3	3,8	0,46
- Afrika	29,5	9,4	20,1	2,70
- Nigeria	4,4	1,2	3,2	0,31
- Amerika Latine dhe Karaibet	12,4	3,1	9,3	0,54

4. Rezultatet themelore të projeksioneve të popullsisë së botës deri në vitin 2150

Pas Luftës II Botërore, Seksioni i demografisë i OKB-së, pos angazhimit studimor në rrafshin teorik, metodologjik dhe empirik të popullsisë së botës dhe rajoneve të saj, kishte edhe përpilimin e projeksioneve demografike dhe, lidhur me këtë, edhe zhvillimin e metodave dhe të teknikës së re. Këto dhjetëvjetëshat e fundit, demografët e OKB-së, nga projeksionet me kohëzgjatje afatmesme kaluan në hartimin e projeksioneve afatgjata. Kështu, duke u bazuar në *metodën analitike,* ekspertët hartuan katër projeksione të tilla të popullsisë së botës dhe të rajoneve të saj për periudhën deri në vitin 2150 dhe atë në shtatë variante. Revidimi i fundit i vlerësimit dhe projeksionit të popullsisë së botës, i bazuar në të dhënat e regjistrimeve të popullsisë dhe të një ankete të vitit 1990, i referohet periudhës 1950-2025 (projeksionet afatmesme), ndërsa projeksionet afatgjata (2025-2150) janë vazhdim i këtyre projeksioneve afatmesme, ku si popullatë bazë janë rezultatet e vitit 2025 dhe hipotezat e dhëna mbi mortalitetin, fertilitetin dhe migrimet e popullsisë për grup-moshat pesëvjeçare sipas moshës dhe gjinisë në periudhën 2025-2150. Qëllimi kryesor i këtyre vlerësimeve dhe projeksioneve është njohja e vëllimit të popullsisë dhe zhvillimi racional i saj, shfrytëzimi ekonomik i potencialeve njerëzore dhe ndërvarësia e ngushtë midis popullsisë, resurseve natyrore dhe mjedisit jetësor në planin botëror, kontinental dhe rajonal.[54]

[54] United Nations, *Long-range World Population Projections. Two Centuries of Population Growth, 1950-2150*, New York, 1992, pp. 1-36.

Tabela 9. Vlerësimet dhe projeksionet e popullsisë së botës dhe rajoneve të saj prej 1650-2150 sipas variantit të mesëm (në miliona)[55]

Viti	Bota		Rajonet e zhvilluara		Rajonet e pazhvilluara	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
1650	507	100,0	106	20,9	401	79,0
1750	791	100,0	201	25,7	590	74,3
1800	978	100,0	248	25,6	730	74,4
1900	1.650	100,0	573	24,7	1.077	65,3
1950	2.516	100,0	752	29,9	1.766	70,1
1990	5.292	100,0	1.089	20,6	4.203	79,4
2000	6.261	100,0	1.143	18,3	5.118	81,7
2050	10.019	100,0	1.243	13,3	8.786	87,7
2100	11.186	100,0	1.202	10,7	9.984	89,5
2150	11.543	100,0	1.191	10,3	10.352	89,7

Sipas vlerësimeve të OKB-së, në vitin 1650 në botë jetonin rreth 500 milionë njerëz, ndërsa në vitin 1800 ky numër gati dyfishohet, por raporti midis rajoneve të pazhvilluara dhe atyre të zhvilluara megjithatë mbetet i madh (3:1). Pas revolucionit industrial procesi i transicionit demografik u zgjerua shpejt dhe i përfshiu të gjitha vendet sot të zhvilluara, duke iniciuar ndryshime të mëdha në zhvillimin e popullsisë, kështu që në shekullin tonë dhe sidomos pas Luftës II Botërore, me eliminimin e shumë sëmundjeve endemike dhe epidemike, zgjerimin e mjeteve preventive, përmirësimin e kushteve jetësore të nënave dhe fëmijëve, rritjes së sasisë së ushqimit etj., në vendet e pazhvilluara u zvogëlua dukshëm mortaliteti, veçanërisht i foshnjave, që në rrethanat e natalitetit të lartë ndikoi në rritjen e shtimit natyror. Ky ishte edhe njëri nga burimet kryesore të rritjes së numrit të popullsisë në këto vende dhe i thellimit të raportit numerik midis tyre dhe vendeve të zhvilluara sot (9:1). Ndërsa sipas variantit të mesëm të projeksionit afatgjatë prej vitit 2025-2150, që sipas hartuesve duket se është më real, popullsia e botës nga më se 6 miliardë sa ka sot, sipas parashikimeve do të dyfishohet në vitin 2150, ndërsa pjesa dërmuese e saj do të shtrihet në rajonet dhe vendet e pazhvilluara.

[55] A. M. Carr-Saunders, W*orld Population*, Oxford University Press, Fair Laun, 1936; W. W. Willcox, *Studies in American Demography*, Cornell University Press, Ithaca 1940; United Nations, *The World Population Situation in 1970*, New York, 1971; United Nations, *Long-range World Population Projections. Two Centuries of Population Growth, 1950-2150*, New York, 1992, pp. 1-36; United Nations, W*orld Population Prospects, The 1994 Revision,* New York, 1994, pp. 1-888.

II. ASPEKTI NDËRKOMBËTAR I PROBLEMEVE TË POPULLSISË

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) u themelua në qershor të vitit 1945 si organizatë ndërkombëtare e vendeve për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në botë dhe zhvillimit të bashkëpunimit midis popujve. Mirëpo, përmes shërbimeve të saj të specializuara kjo organizatë që nga themelimi merret edhe me shumë çështje të tjera. Problemet e popullsisë në nivel botëror[1] për shembull për herë të parë u gjendën në fokus të interesimit në kuadër të OKB-së, ku vetëm një vit pas themelimit të saj u ngrit Komisioni Popullativ. Që nga formimi i saj, kjo organizatë në mënyrë sistematike i ka shqyrtuar problemet e popullsisë, duke kërkuar rrugët e zgjidhjes së drejtë të tyre. Si një nga preokupimet themelore të shërbimeve profesionale të kësaj organizate

[1] Që nga themelimi i OKB-së u mbajtën shumë tubime shkencore, konferenca dhe kongrese, ku u shqyrtuan çështje të ndryshme të popullsisë botërore. Shih materialet dhe vështrimet mbi këto tubime, veçanërisht dokumentet kryesore të tyre, siç janë rezolutat, platformat, porositë, planet aksionale etj., të cilat edhe i shfrytëzojmë në këtë pjesë të studimit: L. Tabah, "Le Congrès mondial de la population", Rome, 31 août - 10 septembre, 1954, *Population,* No 2, Institut National d'Études Démographiques (INED), Paris, 1955, pp. 217-238; A. Sauvy, "Le deuxième congrès mondial de la population", Belgrade, 30 août - 10 septembre, 1965", *Population,* No 6, INED, Paris, 1965, pp. 941-947; "Svetska konferencija o stanovništvu u Beogradu 1965", *Stanovništvo,* nr. 4, CDI, IDN, Beograd, 1965, ff. 276-298; "Congrès général de l'Union internationale pour l'étude scientifique de la population", Londres, 3-12 septembre, 1969*", Population,* no 1, INED, Paris, 1970, pp. 9-48; United Nations, *The World Population Situation in 1970, Population Studies,* No 49, Department of Economic and Social Affairs, New York, 1971; United Nations, *Causes et conséquences de l'évolution démographique,* New York, 1973; "Svetska konferencija o stanovništvu", Bukurešt, 19-30. avgust 1974, *Stanovništvo,* nr. 3-4/1973 - 1-2/1974, CDI, IDN, Beograd, ff. 227-243; A. Sauvy, "La Conférence mondiale de la population à Bucarest", 19-30 août, 1974, Le Centre démographique O. N. U. - Roumanie (C. E. D.). R.), *Population,* No 6, INED, Paris, 1974, pp. 1005-1014; "Le Congrès général de l'Union internationale pour l'étude scientifique de la population", Liège, 27 août - 1er septembre, 1973, *Population,* No 1, INED, Paris, 1974, pp. 11-40; "Le Congrès général de l'Union internationale pour l'étude scientifique de la population", Mexico, 8-13 août, 1977, *Population,* No 6, INED, Paris, 1977, pp. 1081-1122; "Osvrt na medjunarodnu konferenciju o stanovništvu", Grad Meksiko, 6-14. avgusta 1984, *Stanovništvo,* nr. 1-4/1984-1985, CDI, IDN, Beograd, 1985, ff. 147-180; "Le plan d'action mondial de la population" (1974), *Population,* No 1, INED, Paris, 1975, pp. 103-138; "Medjunarodna konferencija o stanovništvu i razvoju", Kairo, 5-13. septembar, 1994, *Stanovnšitvo,* nr. 1-4, CDI, IDN, Beograd, 1995, ff. 135-149; United Nations, *Program of Actions of the United Nations International Conference on Population and Development,* International Conference on Population and Development, Cairo, 5-13 September, 1994.

ishte edhe ndriçimi i retrospektivës demografike dhe hartimi i projeksioneve të popullsisë, të cilat shtroheshin si problem universal, ku njohja e rrjedhave bile aproksimative të numrit të popullsisë në të ardhmen do të bëhej e domosdoshme për njohjen si të realitetit të përgjithshëm demografik, ashtu edhe të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të botës.

Mirëpo, në pjesën e dytë të shekullit XX, përveç angazhimeve të Kombeve të Bashkuara në hulumtimin e zhvillimit demografik, popullsia e botës dhe e rajoneve të saj u bë objekt i hulumtimit të shumë qendrave shkencore të karakterit regjional dhe kombëtar; për këtë qëllim u themeluan edhe shumë organizata dhe asociacione dhe u mbajtën shumë konferenca, kongrese, simpoziume e tubime të tjera, ku u angazhuan shumë ekspertë nga demografia dhe fusha të ngjashme. Në këtë periudhë edhe demografia si shkencë shoqërore definitivisht konstituohet si disiplinë e veçantë shkencore, brenda së cilës krijohen disiplina të shumta të ngushta dhe përsosen procedetë metodologjike të hulumtimit. Përparimi i statistikës, veçanërisht i statistikës demografike, i teknikës llogaritëse dhe i instrumentariumit tjetër krijoi një bazë solide për mbledhjen dhe studimin e materialit empirik (regjistrimet e popullsisë, statistika vitale, informatat vijuese statistike, anketat etj.) për hulumtimin e popullsisë së përgjithshme dhe të pjesëve të saj të veçanta dinamike dhe strukturale. Në këtë periudhë popullsia bëhet fushë e interesit dhe e kërkimeve shumëdisiplinare.

1. Kontraverzat rreth rrugëve të zgjidhjes së problemeve të popullsisë

Në gjysmën e dytë të shekullit XX diskutimet e shumta mbi problemet e popullsisë botërore, veçanërisht me rritjen e saj, u shtruan shumë dilema dhe u propozuan rrugë të ndryshme për zgjidhjen e tyre. Disa qarqe mendonin se problemet e popullsisë janë rezultat i rritjes së shpejtë të saj dhe se "eksplozioni demografik" është burim i varfërisë dhe i mjerimit ekonomik në shumë rajone dhe vende të botës. Si kusht për zhvillim të shpejtë ekonomik dhe për zgjidhjen e shumë problemeve të tjera sociale, sipas ithtarëve të këtij qëndrimi, ishte e ashtuquajtura "rrugë demografike", që konsistonte në kufizimin e natalitetit përmes zbatimit të kontrollit të lindjes (politika popullative e variantit antinatalist). Duke u trajtuar shumë çështje të zhvillimit të popullsisë në kongrese e konferenca të ndryshme mbi popullsinë, ishte arritur deri në përfundim se "rruga demografike" e zgjidhjes së problemeve të popullsisë nuk jep rezultate të dëshiruara dhe se kësaj rruge i vjen era maltusianizëm. Ithtarët e zgjidhjes së dytë, duke konsideruar se joharmonizimi midis rritjes së popullsisë dhe mjeteve për ekzistencë ishte rezultat i

marrëdhënieve të padrejta shoqërore midis të zhvilluarve dhe të pazhvilluarve, kërkonin që të intensifikohej zhvillimi ekonomik, shoqëror dhe kulturor i këtyre të fundit, të përmirësohej pozita e femrës në familje e shoqëri, e nënës dhe fëmijës, të zvogëlohej vdekshmëria e foshnjave, të ndërroheshin raportet ekonomike në botë etj. Të gjitha këto ndryshime edhe do të sjellin deri te kontrollimi i popullsisë dhe rritja racionale e saj. Kjo ishte e ashtuquajtura "rrugë shoqëroro-ekonomike". Kjo rrugë e zgjidhjes gjithnjë e më shumë fitonte përkrahje të gjerë këto dekadat e fundit. Qarqet e treta theksonin se kombinimi i këtyre dy alternativave si "zgjidhje e tretë" është më e pranueshme, sepse jep rezultate të kënaqshme.

Trajtimi i problematikës së popullsisë në nivel botëror, veçanërisht në konferencat mbi popullsinë, si duket, gjithnjë e më tepër shkonte në drejtim të "zgjidhjes së mesme": transformimi ekonomik dhe social në një anë dhe planifikimi i madhësisë së familjes duke u mbështetur në të arriturat e shkencës bashkëkohore (informimi dhe shërbimet e duhura për ta realizuar prindërit vendimin e lirë mbi lindjen e fëmijëve, numrin e tyre, intervalin kohor midis lindjeve dhe vitin e fillimit dhe të përfundimit të lindjes). Për hulumtimin e trendëve të popullsisë dhe të ndikimit të faktorëve shoqëroro-ekonomikë në këto rrjedha dhe e kundërta, OKB-ja e ngarkoi Komisionin Popullativ. Në këtë komision që në fillim, në rastin e hartimit të programit të punës u ndeshën pikëpamje të ndryshme rreth shkaqeve dhe veçanërisht pasojave të rritjes së popullsisë. Qëndrimi se për përparimin social dhe mirëqenien materiale duhet ndërmarrë masa për zvogëlimin e rritjes së popullsisë në vendet dhe rajonet e pazhvilluara, që e përkrahnin kryesisht vendet anglosaksone, hasi në kundërshtim të rreptë të Francës dhe të vendeve të Evropës Lindore.

2. Çështjet demografike në konferencat botërore mbi popullsinë

2.1. Konferenca I: fryma "pronataliste franceze" dhe qëndrimi "maltusianist amerikan"

Diskutimet për çështje të ndryshme demografike në botë OKB-ja së bashku me organizatat e tjera do t'i vazhdojë, duke i ngritur në nivele më të larta, e këto janë konferencat botërore mbi popullsinë, të cilat do të mbahen çdo dhjetë vjet. Në këto konferenca janë formuluar qëndrime të ndryshme rreth zgjidhjes së problemeve të popullsisë në botë, por kur të vështrohen nga perspektiva e sotme, hetohet një ndryshim interesant i angazhimit të OKB-së dhe i opinionit profesional mbi popullsinë. *Konferenca I Botërore mbi*

Popullsinë[2] dhe njëkohësisht tubimi më i rëndësishëm deri atëherë ndërkombëtar, të cilin e organizuan Kombet e Bashkuara në bashkëpunim me Unionin Ndërkombëtar për Studimin Shkencor të Popullsisë (IUSSP)[3] dhe agjencitë e tjera të specializuara, sikurse janë FAO,[4] ILO,[5] UNESCO[6] etj., u mbajt në Romë në vitin 1954. Në këtë konferencë morën pjesë më se 400 delegatë, shkencëtarë e ekspertë nga 58 vende. Në të dominuan kryesisht pikëpamjet e demografëve francezë dhe e ashtuquajtura fryma "pronataliste franceze" dhe e atyre të SHBA-ve dhe të ashtuquajturat qëndrimet "maltusianiste amerikane", ndërkaq ekspertët e vendeve socialiste mbronin tezën se problemet socioekonomike në vendet e tyre nuk janë rezultat i shtimit natyror dhe rritjes së popullsisë, por i shkallës së ulët të zhvillimit shoqëroro-ekonomik për një kohë të gjatë dhe në këtë mënyrë ishin shumë afër pikëpamjeve franceze. Meqë konferenca nuk preku në normat religjioze, morale dhe etike të njeriut, të familjes dhe të grupeve etnike, delegatët e vendeve katolike dhe kisha katolike, pos në diskutimet profesionale, nuk ishin të zëshëm në aspektet e tjera të përgjithshme të zhvillimit të popullsisë. Diskutimet në konferencë ishin kryesisht të përqendruara rreth thellimit të njohurive demografike, zhvillimit të mëtejmë të demografisë si lëndë shkencore dhe konstituimit definitiv të saj, si dhe të afirmimit të hulumtimeve demografike, por në anën tjetër nuk u la pa u shtruar edhe çështja e planifikimit të familjes. Ndonëse në këtë konferencë nuk u nxor ndonjë dokument, megjithatë sikur doli porosia se para shkencës demografike dhe organizatave ndërkombëtare shtrohen angazhime që të ballafaqohen me problemet socialodemografike që dalin nga trendi i rritjes së popullsisë.

Deri në Konferencën e ardhshme ndërkombëtare mbi popullsinë, Komisioni Popullativ i OKB-së disa herë diskutoi për situatën demografike në botë, duke theksuar problemin e shtimit të popullsisë dhe implikimet socioekonomike që rrjedhin nga kjo rritje.[7] Mirëpo, ky komision nuk formuloi asfare parimesh politike në sferën popullative, por iu la qeverive të vendeve përkatëse që vetë të vendosin për bazat e politikës së tyre popullative. Me kërkesën e disa vendeve (12) dhe të një numri të madh të shkencëtarëve me

---

[2] L. Tabah, "Le Congrès mondial de la population", Rome, 31 août - 10 septembre, 1954, *Population,* No 2, INED, Paris, 1955, pp. 217-238.

[3] International Union for Scientific Study of Population.

[4] *Food and Agriculture Organisation* (Organizata për Ushqim dhe Bujqësi).

[5] *International Labour Organisation* (Organizata Ndërkombëtare e Punës).

[6] *United Nations Education, Science and Culture Organisation* (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë).

[7] Më hollësisht shih: United Nations, *The World Population Situation in 1970, Populations Studies,* No 49, Dapartment of Economic and Social Affairs, New York, 1971; United Nations, *Causes et conséquences de l'évolution démographique,* New York, 1971.

renome u bë një deklaratë ku kërkohej nga Kombet e Bashkuara që të ndërmerrnin iniciativën për zbatimin e politikës së kufizimit të rritjes së popullsisë së botës, duke marrë parasysh konsideratat shëndetësore, sociale, ekonomike etj. Në fund të vitit 1962 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së për herë të parë shqyrtoi problemet e popullsisë dhe miratoi rezolutën me titull "Rritja e popullsisë dhe zhvillimi ekonomik". Supozimet nga të cilat u nis Asambleja e Përgjithshme në këtë rezolutë mund të përmblidheshin në faktin "se progresi ekonomik dhe social i vendeve në zhvillim varet nga aftësia e tyre që njerëzve të vet t'u ofrojnë kushte për arsimim dhe standard përkatës jetësor; se zhvillimi ekonomik dhe rritja e popullsisë janë të lidhura reciprokisht ngushtë; se shëndeti dhe mirëqenia familjare kanë rëndësi shumë të madhe jo vetëm për shkaqe humane, por edhe nga aspekti i përparimit ekonomik dhe social, që kërkon kujdes të veçantë në rajonet me shkallë të lartë të shtimit të popullsisë; se është detyrë e çdo qeverie që vetë të vendosë për politikën e saj dhe të nxjerrë programet për aksion; se rritja e popullsisë gjatë dekadës së fundit, sipas rezultateve të regjistrimeve të popullsisë, ishte shumë e lartë në vendet më pak të zhvilluara me të ardhura të ulëta; se është e domosdoshme puna e mëtejme kërkimore me qëllim të plotësimit të njohurive mbi shkaqet dhe pasojat e trendëve demografike, veçanërisht në vendet më pak të zhvilluara etj."[8]

Këtë rezolutë dhe sidomos pikën që bënte fjalë për pengimin e rritjes së popullsisë përmes zgjerimit të të ashtuquajturit kontroll të lindjes, e ku OKB-ja duhej të ofronte ndihmë teknike, e kundërshtuan përfaqësuesit e disa vendeve katolike. Në fund rezoluta u miratua, por pa pjesën ku bëhej fjalë për ndihmën teknike nga ana e OKB-së, që nënkuptonte dhënien falas të mjeteve kontraceptive me qëllim të reduktimit të numrit të lindjeve. Komisioni Popullativ e vazhdoi aktivitetin e vet në fushën e popullsisë pandërprerë, duke theksuar gjithnjë nevojën e harmonizimit të rritjes së popullsisë me zhvillimin ekonomik e social të vendeve në zhvillim.

[8] United Nations, *Population Growth and Economic Development,* Resolution No 1838, New York, 18 December 1962.

2.2. Konferenca II: pa konfontime të mëdha rreth problemeve të popullsisë

Konferenca II Botërore mbi Popullsinë[9] u organizua në Beograd në vitin 1965 nën patronatin e OKB-së dhe në bashkëpunim me Unionin Ndërkombëtar për Studimin Shkencor të Popullsisë, Organizatën Ndërkombëtare të Punës, Organizatën e KB për Ushqim dhe Bujqësi, Organizatën e KB për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, Organizatën Ndërkombëtare të Shëndetësisë (WHO)[10] dhe Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim. Në të morën pjesë rreth 850 shkencëtarë e ekspertë për çështje popullative dhe të planifikimit të familjes nga 88 vende. Problem qendror në të ishin ndërlidhja e popullsisë me zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, niveli dhe lëvizja e fertilitetit, çështja e planifikimit të familjes dhe natyrisht përparimi i metodologjisë në hulumtimin e problemeve të popullsisë. Në dritën e argumenteve shkencore dhe të konsideratave humaniste u diskutuan edhe problemet e ndjeshme dhe kontraverze. Konfrontime të mëdha në qëndrime nuk pati midis delegatëve të vendeve kapitaliste dhe të atyre socialiste. U arrit pajtueshmëri e plotë se çiftëve bashkëshortorë duhej ndihmuar me informata dhe njohuri përkatëse në aftësimin e tyre për të lindur numrin e fëmijëve që ata e dëshirojnë.

As në këtë konferencë nuk u nxor ndonjë rezolutë, platformë apo porosi. Mirëpo, vetë vëllimi dhe ndërlikueshmëria e problemeve demografike në suaza botërore dhe qasjet e reja për studimin dhe zgjidhjen e tyre bënë që të shtohej interesimi dhe aktiviteti i OKB-së në sferën e popullsisë. Kështu viti vijues (1966) do të bëhej vit i kthesave të rëndësishme në angazhimin e KB në lëmin e popullsisë me nxjerrjen e "Deklaratës mbi popullsinë" dhe të rezolutës së re me titull "Rritja e popullsisë dhe zhvillimi ekonomik". Në këtë mënyrë lind ideja që konferenca e ardhshme mbi popullsinë të ngritet nga niveli i shkencëtarëve dhe ekspertëve në nivel të karakterit politik.

Mbi bazë të "Deklaratës mbi popullsinë" (1966), të nënshkruar së pari nga 12 shefa të shteteve apo qeverive, ndërsa një vit më vonë edhe nga 18 përfaqësues të tjerë të shteteve, me rastin e Ditës së të Drejtave të Njeriut, sekretari i atëhershëm i përgjithshëm i OKB-së U Tant proklamoi të drejtën e prindërve që lirisht të vendosin për lindjen e fëmijëve dhe kohën midis lindjeve si të drejtë themelore të njeriut. Në Deklaratë pasi theksohej rëndësia

[9] A. Sauvy, "Le deuxième congrès mondial de la population", (Vues générales sur le 2e congrès mondial de la population), Belgrade, 30 août-10 septembre, 1965, *Population,* No 6, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1965, pp. 941-947; "Svetska konferencija o stanovništvu u Beogradu 1965", *Stanovništvo,* nr. 4, CDI, IDN, Beograd, 1965, ff. 276-298.

[10] WHO (World Health Organisation).

e problemeve demografike për planifikimin e zhvillimit ekonomik dhe vënien e paqes afatgjate, thuhej se qëllimi i planifikimit të madhësisë së familjes është pasurimi i jetës së njeriut.

Rezoluta mbi "Rritjen e popullsisë dhe zhvillimin ekonomik" mbështetej kryesisht në njohuritë e përmbledhura në Konferencën II dhe në rezultatet e hulumtimeve shkencore mbi varshmërinë reciproke të popullsisë dhe zhvillimit shoqëroro-ekonomik. Theksohej se pesha e problemeve demografike në botë është serioze, por me kontraste dhe specifika të mëdha, prandaj kërkohej shqyrtimi në tërë kompleksitetin e tyre, varësisht nga situatat konkrete, natyrisht duke ruajtur çdo vend të drejtën e vet që në mënyrë autonome të formulojë qëndrimet lidhur me politikën popullative. Me iniciativën e OKB-së dhe të organizatave të specializuara do të pasojë programi i gjerë i aksioneve në sferën e popullsisë dhe në vitin 1967 do të formohej Fondi i KB-së për Financimin e Aktiviteteve në Sferën e Popullsisë, të cilin do ta ndihmojnë vendet më të pasura. Qëllimi i themelimit të këtij fondi ishte tashmë transparent: ndërmarrja e masave për pengimin e rritjes së popullsisë në vendet e pazhvilluara, me shkallë të lartë të shtimit demografik. Banka Ndërkombëtare kërkonte nga vendet që i kreditonte informatat mbi gjendjen demografike, si dhe programet e kontrollit të zhvillimit të popullsisë. Mirëpo, këto qëndrime të Bankës dhe të vendeve bartëse të mjeteve nuk u pranuan nga vendet e pazhvilluara, të cilat kundërshtimin e mbështetnin në faktin se ndërhyrja si e organizatave ndërkombëtare, ashtu edhe e qeverive përkatëse në procesin e riprodhimit cenonte rëndë vullnetin individual të bartëseve të këtij procesi, ndërsa vendet e zhvilluara me kërkesën për zvogëlimin e shkallës së lindjes dëshironin t'i fshihnin shkaqet e vërteta të problemeve demografike dhe socioekonomike, të cilat në të vërtetë ishin pasojë e politikave kolonialiste të vendeve imperialiste.

2.3. Konferenca III: ndërvarësia midis popullsisë dhe zhvillimit

Interesi për njohjen, studimin dhe zgjidhjen e problemeve të popullsisë gjithnjë do të rritej, por do të ngritej edhe niveli i tij. Kështu Asambleja e Përgjithshme e OKB-së vitin 1974 do ta shpallë si vit të popullsisë, me çka do të shënohet një fazë e re dhe afatgjate në zgjidhjen e vështirësive që dalin nga popullsia, vëllimi dhe veçoritë e saj dinamike dhe strukturale, në një anë, dhe moszhvillimi, në anën tjetër. Në kuadër të këtij viti KB-ja e thërret dhe e organizon *Konferencën III Botërore mbi Popullsinë,*[11] e cila u mbajt po atë vit

[11] A. Sauvy, "La Conférence mondiale de la population à Bucarest. Le Centre démographique O. N. U. - Roumanie (C. E. D. O. R.)", 1974, *Population,* No 6, INED,

në Bukuresht dhe kishte para së gjithash karakter politik. Organizimit të saj i paraprinë shumë tubime të tjera të shërbimeve të specializuara të OKB-së, të Unionit Ndërkombëtar për Studimin Shkencor të Popullsisë (IUSSP)[12] dhe tubime të tjera në nivel rajonal dhe nacional. Në të marrin pjesë delegacionet e 135 vendeve, anëtare të OKB-së ose të agjencive të specializuara, ndërsa pa të drejtë vote ishin ftuar edhe përfaqësuesit e lëvizjeve çlirimtare e të organizatave joqeveritare, si dhe përfaqësuesit e shërbimeve të specializuara të KB-së, të Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Atomike, të Bankës Rajonale për Zhvillim etj.

Çështjet formale të popullsisë që janë shqyrtuar në këtë konferencë ishin: ecuritë demografike në të kaluarën dhe në të ardhmen, popullsia dhe zhvillimi shoqëroro-ekonomik, popullsia dhe familja, popullsia dhe mjedisi jetësor dhe plani aksional në sferën e popullsisë. Mirëpo qëllimi kryesor i kësaj konference ishte që të gjitha çështjet demografike të shqyrtoheshin në kontekst sa më të gjerë ekonomik, social dhe humanitar, sikurse janë avancimi i njohurive shkencore mbi popullsinë dhe ndikimi i saj në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror dhe e kundërta, rritja e mirëkuptimit dhe e vetëdijes mbi problemet e popullsisë dhe riprodhimin biologjik të saj (nataliteti, mortaliteti, shtimi racional natyror, madhësia e familjes dhe planifikimi i saj etj.), zgjerimi i mësimit në të gjitha nivelet e arsimit, harmonizimi i qëndrimeve rreth shkaqeve, pasojave dhe mënyrave të zgjidhjes së problemeve demografike, përpjekjet e përbashkëta rreth politikës unike botërore në sferën popullative, natyrisht duke i respektuar specifikat diferencuese hapësinore, kohore, sociale, etnike, konfesionale etj. dhe të zgjerohej bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e popullsisë.

Në Konferencën III u arrit pëlqimi i plotë mbi ndërvarësinë dhe ndërlidhmërinë midis popullsisë dhe zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe dominoi mendimi se në vendet në zhvillim si burim kryesor i standardit të ulët jetësor dhe i varfërisë është jo rritja e shpejtë e popullsisë, por moszhvillimi në tërë kompleksitetin e tij. Ndërkaq u theksua se zhvillimi i shpejtuar ekonomik, social e kulturor i këtyre vendeve dhe i zvogëlimit të rritjes së popullsisë së

Paris, 1974, pp. 1005-1014; "Le plan d'action mondial de la population", *Population,* No 1, INED, Paris, 1975, pp. 103-138; "Svetska konferencija o stanovništvu", Bukurešt, 19-30. avgust 1974, *Stanovništvo,* nr. 3-4/1973 - 1-2/1974, CDI, IDN, Beograd, 1974, ff. 227-243.

[12] Vetëm midis dy konferencave, të Beogradit (1965) dhe të Bukureshtit (1974), u mbajtën dy kongrese të Unionit Ndërkombëtar për Studimin Shkencor të Popullsisë. Shih: "Congrès général de l'Union internationale pour l'étude scientifique de la population", Londres, 3-12 septembre 1969, *Population,* No 1, INED, Paris, 1970, pp. 9-48; "Le Congrès général de l'Union internationale pour l'étude scientifique de la population", Liège, 27 août-1er septembre 1973, *Population,* No 1, INED, Paris, 1974, pp. 11-40.

tyre nuk ishte i mundur në raportet që mbretëronin atëherë në botë midis këtyre dhe vendeve të zhvilluara, që bazoheshin në eksploatimin material dhe në diskriminim.[13] Fundja, "ngecja në zhvillim e shumë vendeve në botë, zhvillimi jo i shpejtë aktual, ndërkaq në instancë të fundit edhe 'eksplozioni demografik' i kanë rrënjët e tyre në sundimin e gjatë kolonial, në marrëdhëniet jo të drejta ekonomike ndërkombëtare, në çmimet e ulëta të atyre prodhimeve që i kanë vendet më pak të zhvilluara. Zvogëlimi i rritjes së popullsisë nuk i zgjidh problemet e përmendura vetvetiu, por është i domosdoshëm zhvillimi sa më i shpejtë i vendeve më pak të zhvilluara dhe vetëm në kushte të tilla mund të pritet se do të zgjidhen edhe problemet demografike".[14] Shumica e delegatëve, madje edhe ata të cilët dikur ishin ithtarë të flakët të zgjidhjes së problemeve sociale-ekonomike përmes frenimit të "eksplozionit demografik" e ndërruan mendimin dhe në këtë tubim botëror mbi popullsinë u angazhuan që problemet popullative të zgjidhen vetëm në kuadër të planeve të zhvillimit intensiv shoqëroro-ekonomik.[15]

Në këtë konferencë, edhe pse u paraqitën mospajtime deri në nivel të ideologjive dhe koncepcioneve të ndryshme mbi zhvillimin dhe popullsinë si një nga faktorët kryesor të tij, megjithatë, në *Planin Botëror të Aksionit në Sferën e Popullsisë* (World Population Plan of Action), si dokument themelor i saj, politika popullative u shtrua vetëm në kontekst të politikës së zhvillimit shoqëroro-ekonomik, duke i respektuar efektet indirekte të ndikimit të këtij zhvillimi në procesin e përtëritjes biologjike të popullsisë dhe duke pasur parasysh konsideratat humane në kuadër të humanizimit të raporteve midis

---

[13] Autori i njohur suedez, për studimin e interaksionit midis popullsisë dhe zhvillimit nënvizonte: "Shkatërrimi i strukturave të tashme kombëtare e ndërkombëtare të vendosjes është parakusht i domosdoshëm për zhvillim ekonomik dhe shoqëror të vendeve të Botës së Tretë. Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror i këtij lloji është domosdoshmëri nëse duhet të vijë deri te zvogëlimi i shpejtë i numrit të lindjeve...Nuk është e mundur të kuptohet situata e sotme botërore nëse nuk kuptohet se forcat imperialiste i kontrollojnë marrëdhëniet midis vendeve të pasura dhe vendeve të varfëra, dhe, tërthorazi, gjithashtu edhe marrëdhëniet brenda vendeve të varfra. Derisa këto forca të mos neutralizohen dhe eliminohen, nuk do të arrihet te zhvillimi i vërtetë i vendeve të Botës së Tretë. Ndërkaq, zhvillimi ekonomik dhe shoqëror është parakusht i domosdoshëm për rënien e shpejtë të numrit të lindjeve në vendet të cilat sot i karakterizon rritja e shpejtë e popullsisë" (E. Hofsten, "Spor oko planiranja porodice", *Ekonomska misao,* nr. 3, Beograd, 1974, ff. 109-111).

[14] D. Breznik, "Demografska kretanja u SR Srbiji i mere za rešavanje problema", *Stanovništvo,* nr. 3-4/1975 - 1-2/1976, CDI, IDN, Beograd, 1976, ff. 28-29.

[15] J. D. Rockefeller 3rd: "Population Growth: The Role of Developed World", *Lecture Series on Population,* International Union for the Scientific Study of Population, Bucharest, 1974; A. W.-Baletić, *Demografija (Stanovništvo i ekonomski razvitak),* Zagreb, 1982, f. 67.

gjinive dhe të raporteve të përgjithshme njerëzore.[16] Plani Botëror i Aksionit është ndërtuar mbi disa parime të rëndësishme si: popullsia dhe zhvillimi janë reciprokisht të lidhura e të kushtëzuara; politika popullative është pjesë përbërëse e politikës së zhvillimit shoqëroro-ekonomik; e drejta sovrane e çdo vendi që në harmoni me vlerat, nevojat dhe qëllimet kombëtare ta formulojë dhe realizojë politikën popullative; respektimi i nevojshëm i diferencimit hapësinor dhe kohor të situatës demografike; zhvillimi i vërtetë nuk mund të realizohet në kushtet e dominimeve kolonialiste e neokolonialiste, të varshmërisë dhe diskriminimit racor, etnik e konfesional; përmirësimi i pozitës së gruas dhe integrimi i plotë i saj në formulimin dhe zbatimin e politikës zhvillimore dhe të asaj popullative; që çiftët bashkëshortorë dhe individi për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi mbi numrin e fëmijëve të lindur dhe intervalin kohor midis tyre si e drejtë themelore e njeriut të kenë të drejtë në informim, arsimim dhe mjete të duhura për ta realizuar këtë të drejtë dhe për ta mbrojtur shëndetin reproduktiv të tyre etj. Në këtë dokument për të parën herë në nivel ndërkombëtar popullsia si faktor i zhvillimit dhe i përparimit marrin edhe verifikimin politik në formulimin: "Avancimi i zhvillimit dhe i cilësisë së jetës kërkon aksion në të gjitha sferat e rëndësishme socioekonomike, përfshirë popullsinë, e cila është burim i pashtershëm i krijimtarisë dhe faktor determinues i progresit" (Paragrafi 1).

2.4. Konferenca IV: përmbushja e detyrave nga dokumentet e Konferencës paraprake

Konferenca IV Botërore mbi Popullsinë,[17] të cilën po kështu e thirri dhe e organizoi OKB-ja, u mbajt në Meksiko Siti në vitin 1984.[18] Kjo ishte konferenca e dytë me karakter politik, ndërsa në të morën pjesë delegacionet e 145 vendeve dhe përfaqësuesit e agjencive të specializuara të KB-së, të disa organizatave joqeveritare dhe të lëvizjeve çlirimtare. Në konferencë u miratuan dy dokumente kryesore: *Deklarata mbi Popullsinë dhe Zhvillimin* (Declaration on Population and Development) si dokument për opinion të gjerë dhe *Porositë për Realizimin e Mëtejmë të Planit Botëror të Aksionit* (Recommendations for the further implementation of the World Population

[16] "Le plan d'action mondial de la population", *Population,* No 1, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1975, pp. 103-138.

[17] "Osvrt na medjunarodnu konferenciju o stanovništvu", Grad Meksiko, 6-14. avgusta 1984, *Stanovništvo,* nr. 1-4, CDI, IDN, Beograd, 1984/1985, ff. 147-180;

[18] Edhe kësaj konference i paraprinë shumë tubime shkencore mbi popullsinë dhe problemet e saj, që u mbajtën në vetë qytetin Meksiko (Shih: "Le Congrès général de l'Union internationale pour l'étude scientifique de la population", Mexico, 8-13 août 1977, *Population,* No 6, INED, Paris, 1977, pp. 1081-1122.

Plan of Action) si dokument politik. Me dokumentin e dytë konferenca mori përsipër përmbushjen e detyrave për realizimin sa më të suksesshëm të dokumentit të Bukureshtit, Planit Botëror të Aksionit në Sferën e Popullsisë. Në *Porosi,* që i dedikohen qeverive dhe organizatave joqeveritare, përfshihen këto pesë çështje kyçe: zhvillimi shoqëroro-ekomomik, mjedisi jetësor dhe popullsia; roli dhe pozita e femrës; zhvillimi i politikës popullative; avancimi i dijes dhe politikat.

Është me rëndësi të theksohet se për mbajtjen e kësaj konference sikur ishin të interesuara më tepër vendet në zhvillim se sa vendet e industrializuara, të cilat deri në këtë tubim ishin shumë aktive në organizimin e tyre dhe në realizimin e qëndrimeve të marra në to. Ky ndërrim i qëndrimeve të vendeve të zhvilluara mund të shpjegohet me faktin se ato vetë u ndeshën me gjendjen e pavolitshme demografike, ku nataliteti kishte rënë aq shumë sa që ishte rrezikuar riprodhimi normal i popullsisë së tyre, madje deri në shkallë të shpopullimit natyror (denataliteti). Derisa kishin ardhur në situatë që për vete të angazhoheshin për rehabilitimin e procesit të lindshmërisë, për vendet në zhvillim ishte vështirë të kërkohej planifikimi i familjes dhe masat energjike për zvogëlimin e natalitetit. Fundja, përpjekjet për zvogëlimin e tij me masa të ndryshme jozhvillimore dhe jocivilizuese nuk kishin dhënë rezultate të kënaqshme në pjesën dërmuese të vendeve në zhvillim, që ishte tipik shembulli i Indisë si popullatë e madhe në kontinentin e Azisë, por edhe në botë. Kthesë radikale në qëndrime prej Bukureshtit (1974) deri në qytetin Meksiko (1984) shënuan SHBA-të, ku formuluan qëndrimin tjetër se rritja e shpejtë e popullsisë nuk do të thotë se paraqitet si pengesë për zhvillim; ato u bënë edhe kundërshtarë të rreptë të ndërprerjes me dhunë të shtatzënësisë.[19] Një qëndrim të tillë e përfaqësuan edhe në Konferencën V mbi Popullsinë (1994); në favor të këtij angazhimi dhe veçanërisht kundër abortit shkonte edhe prononcimi i kryetarit Klinton në fund të vitit 1996. SHBA-ja, e cila më parë investonte mjete të mëdha në planifikimin e familjes me qëllim të reduktimit të rritjes së popullsisë në vendet në zhvillim, por më vonë të zhgënjyera nga mossuksesi (shembulli i Indisë), ka disa vjet që ia ndërprenë ndihmën financiare edhe Fondit të OKB-së për aktivitete në sferën e popullsisë dhe Federatës Ndërkombëtare për Planifikimin e Familjes. Në vitin 1987 Kongresi i SHBA-së refuzoi t'i jep ndihmë financiare Kinës me arsyetim se atje me mjete jocivilizuese po ushtrohej një presion i paparë në sferën e lindshmërisë.[20]

---

[19] P. Demeny, "Bucarest, Mexico City and Bleyond", *European Journal of Population,* No 1-2, 1985, pp. 132-134; *Stanovništvo,* nr. 1-4/1984-1985, f. 149.

[20] Ajo që ndërmerrej në Kinë me direktivat partiako-shtetërore, në vitet e 70-ta e të 80-ta, në frymën e apelit: të nxiten çiftet bashkëshortore që të kenë një fëmijë, ta kontrollojnë

2.5. Konferenca V: kompromisi rreth lindshmërisë dhe planifikimit të familjes

Konferenca V Botërore mbi Popullsinë[21], e mbajtur në Kajro në vitin 1994, është tubimi i fundit, i cili gjithashtu u organizua nën patronatin e OKB-së. Në të morën pjesë delegacionet e 154 vendeve, si dhe përfaqësuesit e shumë organizatave e agjencive të ndryshme të specializuara. Edhe kësaj konference i paraprinë shumë tubime tematike të ekspertëve në nivel ndërkombëtar e rajonal dhe aktivitete të OKB-së, që iu kushtuan temave të ndryshme të lidhura drejtpërdrejt me problemet demografike (popullsia, mjedisi jetësor dhe zhvillimi; politika popullative dhe programet; popullsia dhe femrat; planifikimi i familjes, shëndeti dhe mirëqenia familjare; rritja e popullsisë dhe strukturat demografike; shtrirja e popullsisë dhe migrimet) qoftë në mënyrë të tërthortë (Konferenca Ndërkombëtare mbi Barazinë, Zhvillimin dhe Paqen, 1985; Samiti Botëror mbi Fëmijët, 1990; Konferenca Botërore mbi Ushqimin, 1992; Konferenca e KB mbi Mjedisin Njerëzor dhe Zhvillimin, 1992; Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut, 1993; Viti Ndërkombëtar i Familjes, 1994, etj.). Konferenca nxori *Programin e Aksionit në Sferën e Popullsisë* si dokument kryesor, i cili përfshinte 16 kaptina, ku si pjesë qendrore shquhej kaptina mbi të drejtën riprodhuese dhe shëndetin reproduktiv. Dokumenti përqendrohej kryesisht në ndërlidhjen e popullsisë me

---

rreptësisht lindjen e dytë dhe ta pengojnë lindjen e tretë dhe martesat e vona, intervalet e gjata kohore midis lindjeve dhe një çift - një fëmijë, është në kundërshtim të plotë me parimet humane, të drejtat dhe liritë elementare njerëzore. Pushteti zbatonte edhe politikën e tatimeve ndaj çifteve bashkëshortore për lindjen e fëmijës së tretë, veçanërisht në fshat. Si mjete për reduktimin e numrit të lindjeve shfrytëzoheshin falas shërbimet për dështime, përdoreshin masivisht mjeteve intrauterinare dhe kontraceptive, si dhe sterilizimi (R. Pressat, "Mesures antinatalistes en Chine", *Population,* No 4, INED, Paris, 1979, pp. 908-909; i njëjti, "Évolution des naissances en Chine", *Population,* No 4-5, INED, Paris, 1980, pp. 968-972). Pasojat e këtij represioni ishin evidente: u shtua numri i lindjeve ilegale, ku përmes ndërrimit të vendbanimit të përhershëm femrat shtatzënë që kishin lindur më parë një fëmijë, duke shkuar te farefisi apo te të afërmit e tyre në vendin tjetër, merrnin lejen sikur për lindjen e parë; pasuan huazimet e fëmijëve nga fqinjët; në fshatra dhe rajone të izoluara u shfaq "kanibalizmi" sui generis: mbytja e fëmijëve të posalindur të gjinisë femërore nga vetë prindërit vetëm e vetëm që brenda numrit të paraparë të lindin djalë etj.

Për aspekte të ndryshme të politikës popullative të variantit antinatalist shih më gjerë në: Y. Blayo, *Des politiques démographiques en Chine,* Presses universitaires de France et Institut National d'Études Démographiques, Cahier no 137, Paris, 1997, pp. 1-410.

[21] United nations, *Program of Actions of the United Nations International Conference on Population and Development,* International Conference on Population and Development, Cairo, 5-13 September 1994; "Medjunarodna konferencija o stanovništvu i razvoju", 5-13. septembar 1994, *Stanovništvo,* nr. 1-4, CDI, IDN, Beograd, 1995, ff. 147-180.

rritjen ekonomike dhe zhvillimin, ndërsa në parimet e proklamuara theksohej se qëllimet dhe politika popullative janë pjesë integrale të zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor dhe në funksion të përparimit të cilësisë së jetës së të gjithë njerëzve pa marrë parasysh përkatësinë racore, etnike, fetare, sociale etj. dhe zbatimi i Programit të Aksionit është e drejtë sovrane e çdo vendi, e drejtë që nënkupton respektimin e legjislacionit kombëtar dhe të vlerave kulturore, konfesionale e morale të popujve. Programi i Aksionit edhe pse paraqiste përpjekjen për një strategji të re, megjithatë mbështetej fuqimisht në dokumentet politike të dy konferencave të mëparshme.

Edhe në këtë Konferencë, sikundër edhe në konferencat e mëparshme, deri në aprovimin e dokumentit përfundimtar, pati polarizime të konsiderueshme në qëndrime rreth lindshmërisë dhe planifikimit të familjes. Mospajtimet ishin kryesisht rreth dështimeve (abortit) si mjet dhe metodë e rregullimit të lindjes dhe planifikimit të familjes, ku kundërshtime të ashpra shprehën vendet katolike të Amerikës Latine, Vatikani dhe vendet myslimane (arabe). Këto vende, veçanërisht Vatikani, abortin e cilësuan si politikë autoritare të kontrollit të lindjeve, që i shkatërron vlerat themelore të familjes; sipas tyre aborti mund të lejohet vetëm kur jeta e nënës është në rrezik.[22] Mirëpo, para miratimit të dokumentit kryesor të Konferencës, Programit të Aksionit në Sferën e Popullsisë, u arrit kompromisi, që mundësoi miratimin e tij.

Kompromisi shtrihej në drejtim të formulimit të këtyre qëndrimeve: që qeveritë të ndërmarrin hapa adekuatë që t'u ndihmojnë femrave për ta evituar abortin, i cili në asnjë mënyrë nuk mund të promovohej si metodë për planifikimin e familjes dhe, në të gjitha rastet femrave që kërkonin ndihmë për abort t'u sigurohej trajtimi dhe kështillimi human; që e drejta e mashkullit dhe e femrës në zgjedhjen e metodave për planifikimin e familjes dhe rregullimin e fertilitetit nuk mund të ishte në kundërshtim me legjislacionin kombëtar, si dhe dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe dokumentet e tjera relevante ndërkombëtare; që zbatimi i Programit ishte e drejtë sovrane e çdo shteti, e drejtë e cila mbështetej në respektimin e legjislacionit kombëtar dhe në vlerat fetare, kulturore e morale të popujve të tyre, në përputhje me parimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara; të sigurohej që planifikimi i familjes të bëhej pa përdorimin e dhunës, duke u respektuar të drejtat e njeriut, normat etike e konfesionale, si dhe përgjegjësia e individit dhe e çiftëve bashkëshortorë për shëndetin reproduktiv të tyre. Në Programin e Aksionit, me nocionin "shëndet reproduktiv" nënkuptohej gjendja e aftësisë së plotë fizike e

[22] Në protestën që Papa Gjon Pali II i kishte dërguar OKB-së dhe shefave të shteteve me këtë rast, përveç tjerash, thuhej: "Ne nuk mund të shkojmë drejt ardhmërisë me projekte të mbytjes sistematike të fëmijëve të palindur".

mentale dhe e sigurisë sociale sa i përket regjimit të përtëritjes; që njerëzit, të aftë për jetë të mjaftueshme e të sigurt seksuale dhe riprodhim, të jenë të lirë që të vendosin vetë për këtë; që meshkujt dhe femrat të kenë të drejtë të informohen dhe të kenë mundësi t'i përdorin metodat e sigurta, efikase dhe përgjithësisht të pranueshme për rregullimin e lindshmërisë, si dhe të drejtën e shfrytëzimit të institucioneve shëndetësore në mënyrë që gruas t'i mundësohet shtatzënësia dhe lindja e sigurt, ndërsa çifteve bashkëshortore fëmija i dëshiruar dhe i shëndoshë.

Nga pasqyra e qëndrimeve në tubimet e përmendura ndërkombëtare shihet qartë se konflikti midis realizimit të të drejtave të njerëzve që lirisht të vendosnin për lindjen e fëmijëve dhe interesit të shoqërisë si dhe mundësisë së ndikimit të saj në vëllimin e riprodhimit dhe, më gjerë, në lëvizjet demografike - i cili konflikt vetëm duket se ekziston -, ishte e mundur të zgjidhej jo me masa të drejtpërdrejta të bashkësisë shoqërore, por me masa të politikave zhvillimore sociale, ekonomike, arsimore, edukative, shëndetësore etj., ndikimi i të cilave është i tërthortë. Vetëm mbi këtë bazë, theksohej në dokumentet ndërkombëtare, që trajtojnë problematikën e popullsisë, mund të krijohen kushtet për prindëri të lirë e me përgjegjësi dhe të zgjidheshin konfliktet e mundshme midis interesit të shoqërisë, qoftë kur është fjala për shkallën e lartë të natalitetit, qoftë në rastin e natalitetit të ulët -, dhe realizimit të të drejtave për lindjen e lirë. Insistimi që të bëhej kufizimi i lindjeve me këto apo me ato mjete jashtë interesave reale të të gjithë pjesëmarrësve në procesin e përtëritjes biologjike, me qëllim që të zvogëlohej rritja e popullsisë dhe në këtë mënyrë të zgjidheshin problemet ekonomike dhe sociale, u cilësua si frymë neomaltusianiste. Prandaj, të gjitha dokumentet ndërkombëtare hodhën poshtë qasjet maltusianiste dhe neomaltusianiste në zgjidhjen e çështjeve popullative, ndërsa planifikimi i familjes do të marrë një kualitet të ri - të drejtën e njeriut dhe të familjes në njohuri, këshilla e porosi që të vendosnin mbi numrin e pasardhësve dhe rritjen demografike, por pa u shkelur ndjenjat, vullneti dhe arsyeja e tyre. Për lindjet e dëshiruara e të shëndosha, si dhe për përpjekjet që individët dhe çiftët bashkëshortorë ta mbizotëronin riprodhimin biologjik, në të gjitha dokumentet relevante ndërkombëtare si e domosdoshme u shtrua përmirësimi i pozitës së gjithmbarshme të femrës dhe humanizimi i raporteve midis gjinive. Nga qeveritë e të gjitha vendeve pjesëmarrëse në tubimet e inicuara e të organizuara nga OKB-ja dhe nënshkruese të dokumenteve të tyre kërkohej që t'i zbatonin në jetë porositë dhe programet e tyre lidhur me eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të femrës, të keqpërdorimit e të dhunës ndaj tyre, si dhe të fëmijëve të gjinisë femërore në funksion të prostitucionit, të pornografisë, të tregtisë etj. Pikë e veçantë e angazhimit të qeverive ishte arsimimi, ngritja kulturore dhe punësimi i

femrave. Mirëpo, edhe detyrat e meshkujve në drejtim të barazisë dhe humanizimit të raporteve midis gjinive, sipas planeve aksionale dhe deklaratave të konferencave ndërkombëtare mbi popullsinë dhe tubimeve të tjera, mbetën të përmbusheshin. Në dokumentet kryesore të tri konferencave të fundit mbi popullsinë u ftuan qeveritë që ta nënshkruanin dhe ratifikonin Konventën e OKB-së mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të femrës, të miratuar në Ditën e të Drejtave të Njeriut (1966).

Në fund duhet theksuar se nga Konferenca V Botërore mbi Popullsinë (Kajro, 1994) nuk organizohen më konferenca mbi popullsinë në nivel botëror për arsye se qëllimet rreth zvogëlimit të natalitetit tashmë jo vetëm që janë arritur, por në shumë vende duket se edhe janë tejkaluar. Në disa vende, kryesisht të zhvilluara, shkalla e natalitetit është nën nivelin e zëvendësimit (më pak se 2.1 fëmijë për grua) dhe nuk do të kishte kuptim që ende të diskutohet për planifikimin e familjes, shëndetin reproduktiv apo për mjetet dhe metodat për kontrollin e lindjeve derisa popullsia ka filluar të ballafaqohet me anën e kundërt të këtij problemi. Në mbështetje të këtij fakti, në shtator të vitit 2000, ekspertët e OKB-së për çështje të popullsisë, IMF (International Monetary Fund), OECD (Organisation for Economic Cooperation and Development) dhe Banka Botërore paraqesin idenë e planit të ashtuquajtur **Millenium Developement Goals** (Synimet zhvillimore të Mijëvjeçarit) i cili parasheh zgjidhjen e disa problemeve të njerëzimit konform zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike, por gjithnjë duke mos u larguar shumë nga qëllimet e konferencave të mëparshme, ngase kjo është vetëm një vazhdimësi e tyre dhe se zvogëlimi i natalitetit ende nuk është arritur në vendet e pazhvilluara dhe në ato zhvillim. Pra, ende baza e të gjithave çështjeve që do të shqyrtohen, në mënyrë indirekte do të jetë e lidhur me shëndetin reproduktiv.

Sipas këtij plani janë paraparë tetë pika, realizimi i të cilave deri në një masë të caktuar do të arrihet në vitin 2015. Këto pika, që konsiderohen si qëllime, janë: 1. *zvogëlimi i varfërisë dhe urisë;* 2. *zhdukja e analfabetizmit* (shkollimi fillor të jetë shkalla më e ulët e shkollimit në mbarë botën); *3. arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i femrës* (që është një ndër pikat kryesore dhe ka të bëjë kryesisht me shëndetin reproduktiv); 4. *zvogëlimi i mortalitetit infantil*; 5. *përmirësimi i shëndetit të femrës në periudhën fertile* (zvogëlimi i mortalitetit maternal); 6. *ndalimi i përhapjes së SIDA-s, malaries, tuberkulozit dhe sëmundjeve tjera*; 7. *sigurimi i qëndrueshmërisë së rrethinës – ambientit* (ekuilibrimi në mes shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe problemeve ekologjike, si dhe ndalimi i migrimeve fshat-qytet); dhe 8. *formimi i partneritetit global për zhvillim* (mbledhja e mjeteve materiale nga donatorët për realizimin e qëllimeve të popullsisë në

një shkallë të caktuar). Shtatë pikat e para kanë të bëjnë me çështje të ndryshme të popullsisë në nivel botëror, ndërsa e fundit, pika e tetë, ka të bëjë vetëm me çështje materiale. Sipas kësaj, të gjitha shtetet e botës duhet të paraqesin raportet mbi problemet e popullsisë së vendeve të tyre, sipas pikave të parapara në Selinë e OKB-së. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj Selie, për çdo vit do të publikojë raportin mbi punën e bërë dhe progresin e arritur në këtë drejtim. Mbledhja e parë rreth këtyre çështjeve është mbajtur me 9 shtator të vitit 2005, në Zyrën Qendrore të OKB-së në Nju Jork, nga edhe është lëshuar publikimi i raportit të parë mbi situatën e popullsisë nga viti 1990-2005, si dhe është përpiluar plani i veprimit, për realizimin e pikave të parapara.[23]

[23] Shih më gjerë: Jason L. Finkle and C. Alison McIntosh, United Nation Populatin Conferences: Shaping the Policy Agenda for the Twenty-First Centry, *Studies on Family Planing*, Vol.33, No.1, 2002, pp. 11-23 (Shih gjithashtu në: M.. Dushi-H.Islami, *Lindshmëria – sjellja ripridhuese dhe shoqëria,* Dukagjini, Pejë, 2006, ff. 64-67.

Pjesa e dytë

LËVIZJA NATYRORE E POPULLSISË SË KOSOVËS

I. EVOLUCIONI I LINDSHMËRISË DHE I RIPRODHIMIT TË POPULLSISË

1. Lindshmëria (nataliteti, fertiliteti) dhe riprodhimi i popullsisë si dukuri shumëdimensionale

Lindshmëria (nataliteti) si dukuri shumëdimensionale dhe afatgjate paraqet komponentin pozitiv dhe dinamik në zhvillimin e popullsisë. Për shkak të karakterit afatgjatë të natalitetit dhe të proceseve demografike në përgjithësi, "në demografi vitet konsiderohen si dhjetëvjetësha, ndërsa dhjetëvjetëshat si shekuj".[1] Nataliteti dhe ndryshimet në nivelin e tij paraqesin variablën qendrore të zhvillimit të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë të lëvizjes së popullsisë, veçanërisht të lëvizjes natyrore dhe strukturës së popullsisë, kryesisht të asaj sipas moshës dhe gjinisë, ndërsa nataliteti duke ndikuar në ndryshimet demografike e shtrinë ndikimin e tij në shumë rrjedha sociale dhe ekonomike të një territori.

Sikundër që nuk janë të përhershme ligjësitë e zhvillimit të popullsisë, ashtu edhe nataliteti[2] dhe fertiliteti[3] si komponente shumë të rëndësishme të këtij zhvillimi nuk janë fenomene të automatizuara dhe madhësi të pandryshuara e statike, siç mendonin maltusianistët, por janë dukuri të ndryshueshme në hapësirë dhe kohë të caktuar. Niveli dhe lëvizja e natalitetit përcaktohen nga një sistem i ndërlikuar biosocial,[4] që do të thotë varen nga një varg faktorësh biologjikë, socioekonomikë dhe sociopsikologjikë, të cilët, në ndikimin e tyre në procesin e lindjes, janë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar dhe kanë karakter të drejtpërdrejtë dhe të ndërmjetshëm. *Faktorët e drejtpërdrejtë* të natalitetit dhe fertilitetit janë aftësia prokreative (fekonditeti),[5] steriliteti, mosha e hyrjes në martesë dhe, lidhur me të, zgjatja e periudhës riprodhuese, moshyrja fare në martesë (celibati i përhershëm), vëllimi i formimit apo i mosformimit të bashkësive martesore ose hyrja vetëm për një kohë në këtë bashkësi gjatë periudhës fertile për shkak të prishjes së saj, pastaj

---

[1] D. Vogelnik, "Slovenski demografski trenutek: 1750-2000", *Ekonomska revija*, št. 3-4, Ljubljana, 1982, f. 541.

[2] *Nataliteti* paraqet numrin e të lindurve të gjallë në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë në njësi të caktuar kohore, kryesisht gjatë një viti.

[3] *Fertiliteti* nënkupton numrin e të lindurve gjallë në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë femërore në periudhën fertile (15-49 vjet).

[4] R. Pressat, *Démographie sociale,* Presses universitaires de France, Paris, 1978, pp. 89-104.

[5] Fekonditeti nënkupton aftësinë fiziologjike ose pjellorinë potenciale të akterëve në procesin e përtëritjes biologjike të popullsisë (femrat, meshkujt, çiftët bashkëshortorë).

planifikimi i familjes, i realizuar përmes abstinencës seksuale me qëllim ose pa qëllim (impotenca, sëmundja), zbatimit të kontracepcionit, aborteve etj. Ndërsa *faktorët me ndikim të ndërmjetshëm* ose *të tërthortë,* të cilët vetëm përmes faktorëve të drejtpërdrejtë manifestohen në nivelin e lindshmërisë janë të ashtuquajturit faktorët e modernizimit të shoqërisë, sikurse aktiviteti ekonomik, profesioni dhe niveli i të ardhurave, shkalla e arsimit, emancipimi sociokulturor i femrës, tipi i vendbanimit dhe niveli i urbanizimit, roli, struktura dhe funksioni i familjes në shoqëri, ndërvarësia midis mortalitetit dhe fertilitetit, mobiliteti social etj.[6]

Fertiliteti diferencues është, siç mund të shihet, rezultat i ndikimit të përbashkët të të gjithë faktorëve të përmendur si të karakterit biologjik, ashtu edhe të atij social-ekonomik dhe social-psikologjik. Studimet sociologjiko-demografike kanë treguar se në shoqëritë e pazhvilluara (tradicionale) ndikim dominant në nivelin e lindshmërisë kanë determinantet e drejtpërdrejta të natyrës biologjike (fekonditeti, mosha e hyrjes në martesë, steriliteti, abstinenca seksuale për arsye konfesionale etj.), ndërsa në shoqëritë bashkëkohore rol vendimtar në këtë drejtim kanë faktorët e drejtpërdrejtë të karakterit social-ekonomik (kontracepcioni, dështimet, celibati etj.).[7]

Riprodhimi biologjik i popullsisë si problem qendror demografik dhe shumë më gjerë i ka ligjësitë e veta specifike, që kushtëzohen nga ligjësitë e përgjithshme socio-ekonomike, si dhe nga vetë rrjedhat dhe ligjësitë demografike. Riprodhimi nuk është racialisht, etnikisht dhe konfesionalisht i determinuar, por vëllimi i tij varet nga faktorët shoqëroro-ekonomikë në kuptimin e tyre më të gjerë. Riprodhimi biologjik paraqet sferën më intime, më të ndërlikuar dhe më të decentralizuar të jetës shoqërore të njeriut. Riprodhimi biologjik i popullsisë nënkupton procesin e përtëritjes së *brezave* brenda popullsisë. Indikatorët e riprodhimit të popullsisë, të cilët më shpesh përdoren,

---

[6] Më gjerë në: J. Caldwell, *Theory of fertility Decline,* Academic Press, Londres, 1982, pp. 1-386.

[7] Për ndikimin e faktorëve të drejtpërdrejtë dhe të ndërmjetshëm dhe klasifikimin e tyre shih më hollësisht: K. Davis and J. Blake, "Social Structure and Fertility: An Analityc Framowerk", *Economic Development and Cultural Change*, Vol. IV, No 2,, Chicago, 1956, pp. 221-235; United Nations, W*orld Population Conference*, Volume I, Summary Report, New York, 1965, p. 37; R. Freedman, "The Sociology of Human Fertility, në publikimin T. J. Ford and G. F. De Jong, *Social demography*, Prentice Hall, London, 1970, pp. 45-46; R. Reedman, "Fertility Determinants", në J. Cleland and C. Scott (eds.), *The World Fertility Survey, an assessment*, Clarendon Press, Oxford, 1987; M. Rašević, *Determinante fertiliteta stanovništva Jugoslavije*, Centar za demografska istraživanja (CDI), Institut društvenih nauka (IDN), Beograd, 1971, ff. 9-52; A. W.-Baletić, *Demografija (Stanovništvo i ekonomski razvitak)*, Zagreb, 1982, ff. 142-153; N. Raduški, "Karakteristike i značaj neposrednih faktora fertiliteta stanovništva", *Stanovništvo*, br. 3-4/1993 - 1-2/1994, IDN, CDI, Beograd, 1994, ff. 29-43.

quhen *norma të riprodhimit.* Dallohet *norma bruto e riprodhimit,* ku nuk merret parasysh vdekshmëria para përfundimit të periudhës prokreative, dhe *norma neto e riprodhimit,* ku merret në konsiderim vdekshmëria. Këto norma të riprodhimit paraqesin raportin e numrit të përgjithshëm të fëmijëve të lindur gjallë të gjinisë femërore, përkatësisht të gjinisë mashkullore ndaj numrit të përgjithshëm fillestar të personave në kohortën femërore, përkatësisht mashkullore, që këta fëmijë i kanë lindur.[8]

Procesi i riprodhimit, sipas rregullit, është stihik, sepse individi dhe çiftët bashkëshortorë nuk preokupohen me efektet e ndryshme të lindjes në planin e përgjithshëm. Në këtë drejtim nuk kanë ndikim thirrjet e qarqeve politike apo të shoqërisë se nga norma e ulët e natalitetit po rrezikohet kombi, ose nga norma e lartë po krijohen probleme sociale-ekonomike etj. Në procesin e përtëritjes njerëzore femra është aktori kryesor, ndërsa martesa dhe familja janë suaza themelore ku realizohet procesi i lindjes dhe amësia. Stabiliteti dhe forca e një shoqërie varet nga stabiliteti i familjes, ndërsa stabiliteti dhe forca e familjes varet nga stabiliteti i martesës. Kapaciteti gjenetik ka rol të rëndësishëm në përcaktimin e nivelit të fertilitetit të grave, mirëpo ndikimi i këtij komponenti është i njëjtë te popullatat me përkatësi të ndryshme racore, etnike dhe fetare, që do të thotë se dallimet në aftësinë prokreative krijohen para dhe gjatë periudhës riprodhuese të individit, ku determinantet sociale në kuptim të gjerë kanë rolin kryesor.[9] Në kuadër të familjes, përveç funksionit riprodhues si formë e saj afatgjate, gjatë etapave të ndryshme të zhvillimit shoqëroro-historik janë kryer edhe shumë funksione të tjera, por që me kohë janë ndryshuar, reduktuar apo shtuar, varësisht nga intensiteti i transformimit të kushteve materiale të jetës dhe të organizimit shoqëror. Në shoqëritë e zhvilluara familja si institucion shoqëror gjithnjë e më tepër po e humbë rolin e transmisionit të vlerave kolektive, ndërsa individualizmi dhe tjetërsimi i prindërve po bëhen vlera dominante. Riprodhimi i popullsisë në pikëpamje kohore nuk është i kufizuar, ndërsa përtëritja e familjes ka kontinuitetin vetëm gjatë pjesës reproduktive të ciklusit familjar, e që fillon me hyrje në bashkësinë martesore. Shoqëria, përmes institucionit të martesës, si rregullim shoqëror i marrëdhënieve seksuale, dhe institucionit të familjes, ku fëmijët lindin, rriten dhe socializohen ka ushtruar gjithnjë ndikim në procesin e lindshmërisë.

Për t'u riprodhuar një popullatë në përmasën e thjeshtë është e domosdoshme që brezi i grave në periudhën fertile (15-49 vjet) në tërësi të

---

[8] Shih më gjerë në: United Nations, *Višejezički demografski rečnik - srpskohrvatska verzija,* Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1971, ff. 70-71.

[9] D. Breznik - M. Sentić, "Etničke, religiozne i rasne grupe", *Stanovništvo*, br. 3-4, CDI, IDN, Beograd, 1968, ff. 174-175.

përtëritet përmes vajzave të tyre. Dhe, pa hyrë në shpjegime të hollësishme të konceptit të riprodhimit të popullsisë, në kushtëzimet dhe supozimet teorike të tij, një popullatë për t'u riprodhuar në vëllim të thjeshtë, *është e nevojshme që çdo femër në periudhën e përtëritjes biologjike apo të prokreativitetit të lindë mesatarisht mbi dy fëmijë ose më saktësisht, 2,15 fëmijë*. Mirëpo, meqenëse të gjitha femrat nuk marrin pjesë në procesin e përtëritjes për shkak se një kontingjent i tyre nuk e përjeton fare periudhën fertile (vdes pa i mbushur 50 vjet); një numër tjetër nuk hynë fare në martesë; një kontingjent tjetër hynë në martesë, por nuk mund të lindë fëmijë për shkak të sterilitetit të trashëguar apo të fituar; ose një kontingjent tjetër i femrave nuk dëshiron të lindë fëmijë për shkaqe të ndryshme - *atëherë çdo femër duhet të lindë 2,53 fëmijë.* Këto janë, u mor vesh, vetëm kategori dhe mesatare statistike. Më konkretisht, në qoftë se një grua gjatë periudhës së saj fertile ka lindur *një fëmijë të gjinisë femërore* (neto-norma e riprodhimit), popullata do të ketë stagnim, ndërsa mbi një do të shënojë rritje ose nën një rënie.[10] Në shumë shtete të zhvilluara të botës, edhe norma bruto e edhe norma neto e riprodhimit[11] ka sa vite që janë nën një, që do të thotë nën nivelin e duhur për përtëritje biologjike të popullsisë dhe zëvendësim të brezave, sikurse edhe në Serbi dhe Vojvodinë në 45 vjetët e fundit (në vitin 2000 Serbia 0,68 dhe Vojvodina 0,69), ndërsa në Kosovë këto dy norma deri në gjysmën e viteve të 80-ta ishin rreth dy fëmijë të kësaj gjinie, që do të thotë se popullata jonë ende riprodhohej në vëllim të zgjeruar dhe siguronte dyfishimin e popullsisë. Pas vitit 1990, për shkak të proceseve intensive migruese të të rinjve shqiptarë në botën e jashtme, nën presion të pushtetit okupues serb dhe lidhur me to edhe të ndikimit të faktorëve të tjerë me karakter politiko-psikologjik dhe sociopsikologjik, edhe në Kosovë norma

---

[10] A. Wertheimer-Baletić, *Demografija (Stanovništvo i ekonomski razvitak)*, Zagreb, 1982, ff. 180-181.

[11] *Norma neto e riprodhimit* tregon numrin mesatar të fëmijëve të lindur gjallë të gjinisë femërore, të cilin vajza e lindur gjallë sot do ta lindë gjatë periudhës fertile, duke marrë parasysh mortalitetin e grave para dhe gjatë periudhës prokreative (15-49 vjet).
Norma bruto e riprodhimit, ndërkaq, tregon numrin mesatar të fëmijëve të lindur gjallë të gjinisë femërore, të cilin vajza e lindur gjallë sot do ta lindë gjatë periudhës së saj riprodhuese, me kusht që fertiliteti të mbetej i njëjtë sikurse edhe fertiliteti i brezave të grave në vitin e vështruar dhe me kusht që asnjë vajzë e lindur gjallë të mos vdesë pa e përfunduar periudhën fertile (15-49 vjet).
Për shkak se një numër i femrave vdes para se të hyjë në periudhën fertile ose gjatë saj, nuk martohet apo nuk mund të lindë fëmijë për arsye të ndryshme, norma bruto e riprodhimit duhet të korrigjohet përkatësisht të zvogëlohet përreth 15%. Norma e korrigjuar për këtë përqindje në të vërtetë paraqet normën neto të riprodhimit (R. Pressat, *Dictionaire de démographie*, PUF, Paris, 1979, pp. 248, 273; G. Tapinos, *La Démographie. Population, économie et sociétés*, Le livre de poche, Éditions de Fallois, Paris, 1996, pp. 74-75).

neto e riprodhimit nis të zvogëlohet për të arritur nivelin 1,20 në vitin 1995 dhe diçka mbi një fëmi në vitin 2000 (tabela 10), por që ende ishte mbi kufirin e riprodhimit normal të popullsisë.

2. Përtëritja e popullsisë në vendet e zhvilluara perëndimore nga Maltusi deri më sot

Eksperienca e zhvillimit demografik të vendeve sot të zhvilluara të cilat e kanë kaluar etapën e transicionit demografik,[12] tregon se ligjësitë e zhvillimit të popullsisë nuk janë të përhershme, por varen nga ndryshimi i kushteve shoqërore në kohë dhe hapësirë, që tregon se rënia e mortalitetit dhe e natalitetit janë zhvilluar në përputhmëri me transformimet radikale të bazës ekonomike të shoqërisë dhe me ndryshimin e rrethanave socialo-ekonomike të popullsisë. Progresi i tyre ekonomik dhe shoqëror i demantuan në themel pikëpamjet pesimiste të Maltusit[13] dhe ithtarëve të tij, si dhe neomaltusianistëve[14] të shekullit XX lidhur me zhvillimin e popullsisë dhe të mirat materiale në të ardhmen.

---

[12] Siç theksuam edhe më parë, teoria e transicionit demografik shqyrton procesin e zhvillimit të popullsisë nëpër etapa të caktuara të zhvillimit shoqëroro-ekonomik, duke u bazuar në përgjithësimin e fakteve empirike të ndryshimit të komponenteve të lëvizjes natyrore të popullsisë të vendeve të zhvilluara perëndimore të Evropës. Transicioni demografik, sipas teorisë së transicionit demografik, nënkupton së pari rënien e mortalitetit nën 30 promilë dhe, më vonë, edhe rënien e natalitetit gjithashtu nën 30 promilë. Mirëpo, transicioni demografik, sipas teorisë së transicionit demografik, nuk nënkupton vetëm transformimin e regjimit të riprodhimit biologjik prej tipit tradicional në tip bashkëkohor, por edhe ndryshimet në komponentet dhe strukturat e tjera të popullsisë.
Transicioni demografik është proces afatgjatë dhe i ndërlikuar, ndërsa në pikëpamje hapësinore dhe kohore variabil. Për shkak të zgjerimit suksesiv të transicionit demografik në të gjitha vendet e botës, për të sot mund të flitet si për një proces botëror (D. Tabutin-T. Eggerickx-C.Gourbin, Transitions démographiques et sociétés, Actes de la Chaire Quetelet 1992, Louvain-la-neuve, Academia-L'Harmathan, 1995, pp. 1-694; A. W. - Baletić, "Demografska tranzicija kao svjetski proces", *Ekonomska revija,* št. 3-4, Zbornik člankov in razprav ob življenskem delu in jubileju prof. Dolfeta Vogelnika, Ljubljana, 1982, ff. 271-280).

[13] Tomas Robert Malthus-i lindshmërinë dhe popullsinë në përgjithësi i konsideronte madhësi të pandryshuar në hapësirë dhe kohë. Popullsia dhe varfërimi i saj, sipas tij, nuk vareshin nga kushtet shoqëroro-historike dhe institucionet sociale, por nga të ashtuquajturat ligjet konstante natyrore. Sipas tij, duhej ndërmarrë një varg masash të karakterit preventiv (abstenimi moral dhe ngurrimi seksual, shtyrja e martesave dhe moshyrja në martesa apo celibati), dhe pozitiv (epidemitë, uria dhe luftërat) për zvogëlimin e lindjeve. Si e tillë, teoria e tij ishte thellësisht antihumane dhe antishkencore.

[14] Pas teorisë së Malthus-it paraqitet një doktrinë tjetër, neomaltusianizmi, që del në formë të neomaltusianizmit të hershëm, që zgjatë nga vdekja e Maltusit e deri në Luftën II Botërore, dhe të neomaltusianizmit bashkëkohor, që paraqitet pas kësaj lufte në disa vende perëndimore. Kjo teori ka mbështetje edhe sot nga autorë dhe qarqe të caktuara.
Siç nënvizuam më parë, doktrina maltusianiste dhe ajo neomaltusianiste qëllimet i kanë

Në truallin e vendeve sot të zhvilluara të Evropës, siç dihet, u paraqit revolucioni industrial dhe kthesat sociale, shkencoro-teknike dhe medicinalo-sanitare e së bashku me to edhe transicioni, përkatësisht revolucioni demografik.[15] Përparimi shkencor dhe teknik ndikuan si në përmirësimin e kushteve për jetesë, ashtu edhe në transformimin demografik në drejtim të zvogëlimit të rritjes së popullsisë. Në këto vende filloi zhvillimi intensiv i marrëdhënieve kapitaliste, i industrializimit dhe urbanizimit të jetës, i komunikacionit etj. Të gjitha këto krijuan mundësi të mëdha dhe hapën perspektiva të reja për zhvillimin e njerëzimit. Të arriturat në këto sfera, para së gjithash, ato në shkencën mjekësore dhe në shëndetësinë publike, që mundësuan eliminimin e sëmundjeve të ndryshme të karakterit epidemik dhe endemik, ndryshimet e mëdha në rritjen e sasisë së ushqimit në saje të zgjerimit të kulturave të reja agrare dhe të mekanizimit etj.-, ndikuan drejtpërdrejt në zvogëlimin e mortalitetit, veçanërisht mortalitetit të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël.[16] Në shekullin XIX dhe më tepër në shekullin XX, siç theksuam edhe më parë, në vendet sot të zhvilluara të Evropës nisi zvogëlimi i të dy komponentëve reproduktive, së pari i vdekshmërisë dhe pastaj edhe i lindshmërisë, duke pësuar ndryshime harta demografike e kësaj pjese të kontinentit plak;[17] deri nga fundi i shekullit XX procesi i lindshmërisë i përkiste të ashtuquajturit tip "natyror të fertilitetit".[18] Zvogëlimin e natalitetit në këto vende e diktonin dhe e shpejtonin proceset e industrializimit e të zgjerimit të strukturave urbane dhe lidhur me to edhe proceset e shkrim-leximit, të ngritjes së nivelit kulturo-arsimor, të përmirësimit të pozitës materialo-sociale e qeverisëse të femrës në familje e në shoqëri, të moshyrjes në martesë të një kontingjenti të femrave apo hyrjes së vonshme në bashkësi martesore të një numri tjetër të tyre, kur aftësia prokreative e femrës nisi të zvogëlohej, pastaj të zvogëlimit të mortalitetit të foshnjave, të mobilitetit më të madh hapësinor e social, të shkatërrimit të familjes tradicionale dhe ndryshimit të funksioneve të saj, të socializimit të aspekteve kryesore të jetës,

---

të njëjta, ndërsa dallojnë vetëm në mjetet e ndërmarra. Neomaltusianistët insistojnë që problemet ekzistuese socialo-ekonomike të zgjidhen me kufizimin e lindjeve dhe pengimin e rritjes së numrit të popullsisë, duke zbatuar mjetet kontraceptive, abortimet, madje edhe sterilizimin (R. Pressat, *Dictionaire de démographie*, PUF, Paris, 1979, pp. 138-139; shih edhe në: UN: *Višejezčki demografski rečnik*, srpskohrvatska verzija, CDI, IDN, Beograd, 1971, pika 90).

[15] A. Landry, *La révolution démographique*, Librairie Sirey, Paris, 1934.

[16] A. Armangaud, *Démographie et sociétés*, Stock, Paris, 1966, ff. 45-68.

[17] F. de Singly, *Sociologie de la famille contemporaine*, Sociologie 128, Nathan Université, Paris, 1993.

[18] H. Leridon et J. Menken (sous la dir. de) *Natural fertility/ Fécondité naturelle. Niveaux et déterminants de la fécondité naturelle,* Liège, Ordina, 1979, pp. XV-556; P. Festy, *La fécondité des pays occidentaux de 1870 à 1970*, Institut National d'Études Démographiques, Cahier no 85, PUF, Paris, 1979, pp. 7-47.

të barazisë së gjinive, të rritjes së lirisë personale, të zgjerimit të individualizmit si konsideratë e rëndësishme në vendosje në procesin e lindjes, etj.[19] Edhe në Slloveni, shtet i ri që doli pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë (1992), nga të njëjtat arsye ka pasuar përqafimi i normave sociale mbi familjen e vogël dhe natalitetin e ulët deri nga fundi i shek. XIX edhe këtu shkalla e natalitetit ishte mjaft e lartë, sidomos te shtresa fshatare dhe punëtore.[20]

Tabela 1. Lëvizja natyrore e popullsisë së disa vendeve të zhvilluara të Evropës prej 1751 e deri më 1999[21]

	1751-1755	1801-1805	1851-1855	1905-1909	1935-1939	1950-1954	1985-1990	1995-1999
Nataliteti								
B. e Madhe	35,0	34,0	33,9	26,7	15,9	15,9	14,0	12,1
Franca	35,0	31,7	26,1	20,0	15,1	19,5	14,0	12,5
Suedia	37,1	31,4	31,8	25,6	15,5	15,5	13,0	10,0
Sllovenia	-	-	33,5	32,7	22,5	22,8	13,6	9,4
Mortaliteti								
B. e Madhe	30,0	23,0	22,7	15,1	12,2	11,7	11,0	10,2
Franca	-	26,3	24,1	19,5	15,7	12,4	10,0	9,1
Suedia	26,3	24,4	21,7	14,6	11,7	9,8	11,0	10,6
Sllovenia	-	-	27,0	23,5	13,6	11,4	10,3	9,5
Shtimi natyror								
B. e Madhe	5,0	11,0	11,2	11,6	3,1	4,2	3,0	1,9
Franca	-	5,4	2,0	0,6	-0,6	6,8	4,0	3,4
Suedia	10,8	7,0	10,1	11,0	2,8	5,7	2,0	-0,6
Sllovenia	-	-	6,5	8,2	8,9	10,4	3,3	-0,1

[19] A. Armengaud, *Po aty.*

[20] Në vitet 1880-1900 shkalla e natalitetit në Slloveni sillej rreth 35 promilë, prej fillimit të shekullit XX e deri në në gjysmën e e tij kjo shkallë sillej midis 30 e 23 promilë, ndërsa prej atëherë rënia është konstante, kështu që në vitin 1990 nataliteti ishte 11,5, mortaliteti 9,5 dhe shtimi natyror 2,0 promilë. Shih më gjerë në: Ž. Šifrer, "Razvitak stanovništva Slovenije u poslednjih sto godina", *Stanovništvo*, br. 3, CDI, IDN, Beograd, 1963; D. Vogelnik, "Razvoj prebivalstva Slovenije zadnjih dvesto let z jugoslovanske in evropske perspektive", *Ekonomski zbornik*, VII, Letnik, Ljubljana, 1965; D. Breznik (redaktor), *Fertilitet stanovništva i planiranje porodice u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd, 1980, ff. 66-67; *Statistički godišnjak Jugoslavije 1992*, SZS, Beograd, 1992, f. 424.

[21] Burimi: C. Cipolla, *The Economic History of World Population*, Penguin Books, 1962, pp. 84-85; A. W.-Baletić, *Po aty*, f. 93; UN: W*orld Population 1992*, New York, 1992; Ž. Šifrer, "Razvitak stanovništva Slovenije u poslednjih sto godina", *Stanovništvo,* br. 3, CDI, IDN, Beograd, 1963, f. 362; *Statistički godišnjak Jugoslavije* (vite të ndryshme), SZS, Beograd; *Recent demographic developments in Europe 2000,* Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2000, pp. 70, 86.

Rënia e natalitetit në vendet e zhvilluara të Evropës ishte rezultat i ndryshimeve radikale të tipit të ekonomizimit dhe kushteve të tjera jetësore e jo pasojë e zgjerimit të zbatimit masiv të mjeteve kontraceptive apo të zbatimit të ndonjë politike demografike të konceptuar qartë. Këto rrethana pikërisht ndikuan që individët e çiftët bashkëshortorë t'i ndryshonin fuqimisht normat, qëndrimet dhe sistemin e vlerave që e përcaktojnë nivelin e përtëritjes së popullsisë dhe formojnë qëndrime krejtësisht të reja ndaj numrit të fëmijëve dhe madhësisë së familjes. Në këto vende faktori më i rëndësishëm i transformimit të regjimit të riprodhimit ishte përvetësimi i të ashtuquajturit kontroll i lindjes. Tendenca e rënies së nivelit të natalitetit gjeti shprehje në kohën e depresionit të madh ekonomik në vitet e 30-ta të shekullit XX dhe atë në Angli, Francë, Gjermani, Austri, Zvicërr, në vendet nordike etj.[22] Ndonëse disa elemente të kontrollit të lindjes i gjejmë qysh në shoqëritë e pazhvilluara dhe në bashkësitë primitive[23], megjithatë, ky faktor do të luajë rol të madh në zvogëlimin e natalitetit në vendet evropiane pas revolucionit industrial, kur edhe nis të formohet një sistem modern demografik, ku nataliteti i lartë dhe familja e tipit të zgjeruar do të humbnin funksionin e tyre ekonomik e shoqëror, ndërsa me përparimin industrial dhe teknologjik dhe me krijimin e kushteve të reja të punësimit produktiv mbi këtë bazë, do të ndërpritet nevoja e angazhimit të fëmijëve në jetën ekonomike.

Tabela 2. Lëvizja natyrore e popullsisë urbane dhe rurale në disa vende evropiane në vitet e 80-ta të shekullit XX[24]

	Qytetet			Fshatrat		
Shteti	N	M	SHN	N	M	SHN
Franca (1982)	15,5	9,3	6,2	12,9	12,5	0,4
Gjermania (1981)	14,0	13,4	0,6	14,9	15,3	-0,4
Finlanda (1983)	13,7	8,6	5,1	12,5	10,2	2,3
Austria (1981)	10,8	13,4	-2,6	14,4	10,9	3,5

[22] Në gjysmën e këtyre viteve fertiliteti bie nën nivelin që siguron përtëritjen afatgjate të popullsisë në Francë, Angli, Gjermani, Austri, Zvicër, vendet nordike etj. Pas periudhës së kompensimit demografik në vitet e 50-ta, në këto vende përsëri pason rënia e fertilitetit nën nivelin e riprodhimit të brezave (Shih të dhënat në revistën *Population*, No 2, INED, Paris, 1983, pp. 386-387).

[23] Siç vumë në pah edhe më parë, planifikimin e familjes me elemente për dhe kundër lindshmërisë e hasim edhe në Evropën Antike. Hulumtimet tregonin se si metodë më efikase për kufizimin e lindjeve qysh herët është shfrytëzuar dështimi (aborti). Aborti edhe në fillim të fazës së transicionit demografik ishte mjet kryesor i planifikimit të familjes, ndërsa nga fundi i kësaj faze do të dominojë zbatimi masiv i mjeteve kontraceptive.

[24] Burimi: United Nations, *Demographic Yearbook 1984*, New York, 1986.

Hungaria (1983)	13,1	12,5	0,6	12,9	15,7	-2,9
Bullgaria (1982)	14,2	7,9	6,8	13,1	15,6	-2,9
Polonia (1983)	17,8	8,5	9,3	20,5	10,1	10,4

N=nataliteti; M=mortaliteti; SHN=shtimi natyror

Shumë vende të Evropës sot ballafaqohen me probleme të mëdha në zhvillimin e tyre demografik, veçanërisht në sferën e riprodhimit të popullsisë dhe atë si në fshat, ashtu edhe në qytet. Në disa vende shtimi natyror ka tashmë tendencë negative, me mundësi që të hyjë në një fazë të thellë të shpopullimit (denataliteti). Në vitin 1999 p. sh. Gjermania, Suedia, Italia dhe Austria kishin shtim negativ natyror, vendet baltike (Estonia, Letonia dhe Lituania) gjithashtu, Franca, Anglia, Belgjika, Finlanda, Danimarka dhe Holanda gati zero shtim natyror, ndërsa në shumë vende të Evropës JL shtimi natyror ishte negativ, sikurse Fedarata Ruse, Bellorusia, Rumania, Bullgaria, Hungaria, Moldavia, Çekia, Kroacia dhe Sllovenia.[25] Rreth dy të tretat e vendeve të këtij kontinenti këto 2-3 dekadat e fundit ka normën e riprodhimit neto nën një.[26] Në fund të shekullit XX (1999) në të gjitha vendet e zhvilluara të Evropës dhe në vendet e Evropës JL norma neto e riprodhimit ishte nën një, madje edhe nën 0,65 (Austria, Bullgaria, Çekia, Sllovakia, Hungaria, Letonia, Lituania, Estonia, Rumania, Federata Ruse, Sllovenia etj.).[27] Dhe po të mos ishte imigrimi i fuqisë punëtore dhe i popullsisë nga vendet e tjera të pazhvilluara, shumë shtete të Evropës do të ballafaqoheshin me një krizë edhe më të thellë demografike, me implikime të mëdha për zhvillimin e tyre shoqëror, ekonomik dhe politik. Shumë vende evropiane me masa të ndryshme stimulative sot bëjnë përpjekje për rehabilitimin e procesit të riprodhimit, por rezultatet nuk janë inkurajuese.

3. Specificiteti i regjimit të riprodhimit të popullsisë së Kosovës dhe shqiptarëve

Studimi i problematikës demografike ka rëndësi të madhe për njohjen e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror të çdo vendi dhe populli. Prandaj, në të

[25] *Recent Demographic developments in Europe 2000,* Council of Europe Publishing, Strasbourg, December 2000, p. 31.

[26] J. Bourgeois-Pichat, "La baisse actuelle de la fécondité en Europe s'inscrit-elle dans le modèle de la transition démographique", *Population,* no 2, INED, Paris, 1979, pp. 267-301.

[27] *Recent Demographic developments in Europe 2000,* Council of Europe Publishing, Strasbourg, December 2000, p. 81; *Recent Demographic developments in Europe 2004,* Council of Europe Publishing, Strasbourg, December 2005, p. 71.

gjitha vendet demografia si shkencë mbi zhvillimin kompleks të popullsisë gjithnjë e më tepër po zë vend të merituar në shkencat shoqërore dhe po shtohet nevoja për një qasje interdisiplinare të studimit të popullsisë. Në kuadër të zhvillimit demografik të çdo territori dhe bashkësie kombëtare, kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet lëvizjes natyrore të popullsisë, vështruar qoftë në kuptim të ngushtë (nataliteti, mortaliteti dhe shtimi natyror), qoftë në kuptim të gjerë, ku përveç këtyre komponentëve hyjnë edhe gjendja martesore, kurorëzimet dhe shkurorëzimet. Përmes nivelit dhe ecurisë së lëvizjes natyrore të popullsisë pasqyrohet e tërë gjendja dhe tendencat e ndryshimeve në kompleksin demografik, si dhe ndikimet e drejtpërdrejta dhe të ndërmjetshme të zhvillimit social-ekonomik dhe kulturor të së kaluarës së largët e të afërme dhe të sotmes, ndërsa dinamika natyrore si pjesë përbërëse e zhvillimit demografik dhe shoqëroro-ekonomik, me veçoritë, shkaqet e ndryshimit të saj dhe implikimet që dalin nga ajo në planin afatgjatë është edhe bartëse e së ardhmes.

Popullsinë shqiptare në të gjitha trojet kompakte etnike, siç e zumë tashmë në gojë, e karakterizon një gjendje specifike demografike, si rezultat të rrethanave të ndërlikuara e të rënda historike, shoqërore, ekonomike, arsimore, kulturore e shëndetësore për një kohë të gjatë. Ky specificitet edhe shtron domosdoshmërinë e hulumtimit të të gjitha aspekteve të zhvillimit demografik të shqiptarëve. Në këtë kontekst, vend shumë të rëndësishëm zë, pa dyshim, lëvizja natyrore dhe nataliteti brenda saj, si një ndër variablat kyçe të dinamikës dhe strukturës së popullsisë dhe të zhvillimit shoqëroro-ekonomik. Ky indikator, me karakterin dhe shumëdimensionalitetin e tij, zgjon interesim si në qarqet shkencore, ekonomike e politike, ashtu edhe në opinionin e gjerë. Për secilin komb sikur nuk ka gjë më të rëndësishme se njohja dhe studimi i popullsisë së tij, i gjendjes numerike dhe i karakteristikave dinamike e strukturale të saj, veçanërisht i natalitetit. Mirëpo, vendet dhe popujt, duke dëshiruar ta njohin qenien e tyre përmes popullsisë, nuk janë indiferent as ndaj faktit se çka po ndodh në rrafshin demografik edhe me vendet dhe popujt e tjerë. Le të na kujtohet diskursi sa irracional, aq edhe neomaltusianist e shovinist ndaj natalitetit të shqiptarëve në dhjetëvjetëshat e fundit të këtij shekulli në ish-Jugosllavi dhe në Serbinë e sotme, i cili nuk kishte për qëllim përmirësimin e cilësisë së lindjes, të riprodhimit dhe të jetës së shqiptarëve, por dobësimin e fuqisë vitalo-demografike të tyre me masa të represionit ekonomik, social, politik e psikologjik dhe mposhtjen e epërsisë numerike e reproduktive të shqiptarëve dhe të vënies së baraspeshës etnike përmes kolonizimit të serbëve dhe dëbimit të shqiptarëve.

Vëllimi, rritja demografike dhe shtrirja territorialisht e pakëputur etnike e shqiptarëve edhe historikisht marrë ishin një ndër faktorët më të fuqishëm të

rezistencës ndaj asimilimit dhe të ruajtjes së qenies sonë kombëtare, sikundër që në Ballkanin e trazuar si duket do të jetë edhe faktor i perspektivës politike dhe kombëtare të shqiptarëve. Prandaj, dimensioni demografik i çështjes së Kosovës tashmë më tepër se një shekull është bërë objekt diskutimi i të gjitha qarqeve dhe regjimeve serbo-jugosllave, të cilat për t'i jetësuar aspiratat për dominim dhe hegjemoni ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, përveç me të ashtuquajturën "të drejtë historike" dhe Kosovën si "territor të shpirtit mesjetar serb", spekulonin dhe ende manipulojnë edhe me argumentin demografik. Aspekti demografik i problemit të Kosovës nuk do të pushojë së qeni aktual në qarqet shkencore e shtetërore dhe në opinionin serb derisa Kosova të mos dalë edhe faktikisht nga Serbia dhe derisa të mos zgjidhet definitivisht çështja jonë.

Për shkak të rolit që luan në rrjedhat demografike dhe rëndësisë që ka në zhvillimin e përgjithshëm shoqëroro-ekonomik e politik, në një anë, dhe për arsye se që nga fillimi i viteve të 80-ta të shekullit XX në ish-Jugosllavi zhvillohej një diskurs me karakter irracional dhe racist ndaj natalitetit të shqiptarëve, në anën tjetër, këtë studim edhe po e fillojmë me shqyrtimin e evolucionit të natalitetit dhe të riprodhimit të popullsisë së Kosovës e të shqiptarëve në tërë kompleksitetin e tyre.

3.1. Funksioni riprodhues në shoqërinë tradicionale shqiptare

Në shoqëritë paraindustriale, sikurse na është e njohur, zhvillimi demografik i bartte me vete të gjitha veçoritë e jetës klasike shoqërore, ku, në të gjitha sferat e jetës familjare, sociale dhe prodhuese, ruheshin mbeturinat e marrëdhënieve feudale dhe gjysëmfeudale. Në rrethana të rënda ekonomike, sociale, kulturore dhe shëndetësore në popullata gjeografikisht të izoluara, në pikëpamje sociale homogjene dhe me "pjellori natyrore",[28] riprodhimi i popullsisë zhvillohej përgjithësisht shumë joracionalisht, sepse ekuilibri demografik midis lindjes dhe shuarjes së jetës arrihej me humbje të mëdha njerëzish, gjë që edhe ndodhi edhe me popullatën e shoqërisë tradicionale shqiptare, ku shtimi natyror formohej përgjithësisht në mënyrë stihike.

Mirëpo, është vështirë të bëhet një përvijim i prerë kohor midis shoqërisë tradicionale dhe shoqërisë së transformuar shqiptare se deri kur zgjati e para e kur filloi e dyta. Shpeshherë zihet në gojë Lufta e Dytë Botërore. Mirëpo, në praktikë vështirë mund të haset në një distinksion të tillë në planin kohor, sepse edhe deri vonë pas kësaj lufte në shumë mjedise rurale, në shumë shtresa sociale (në fshat e në qytet) dhe në shumë sfera të jetës

[28] P. Festy, *La fécondité des pays occidentaux de 1870 à 1970*, INED, Cahier no 85, PUF, Paris, 1979, pp. 7-47.

shoqërore do të ruheshin mbeturinat e karakteristikave të shoqërisë klasike agrare, disa prej të cilave gjallojnë edhe sot e gjithë ditën, ndonëse janë bërë sikur të padukshme nën ndikimin e depërtimit të proceseve të industrializimit dhe të urbanizimit në kuptim e tyre të gjerë. Veçoritë e jetës tradicionale dhe ato të jetës bashkëkohore sot reciprokisht përshkohen dhe janë në konflikt të vazhdueshëm.[29]

Rikonstruimi i kompleksit demografik dhe social, e në këtë kuadër edhe i lëvizjes natyrore të popullsisë, në mungesë të të dhënave, nuk është e mundur të bëhet për një periudhë të gjatë kohore. Të dhënat e para të komponentëve vitale të popullsisë së Kosovës i hasim në fillim të dhjetëvjetëshit të dytë të shek. XX, ndërsa për popullsinë e Shqipërisë edhe më vonë, nga fundi i viteve të 30-ta të këtij shekulli. Edhe pse jo të plota e parciale, të dhënat mbi ngjarjet themelore vitale kanë një rëndësi të veçantë për njohjen e retrospektivës demografike të popullatës sonë.

Shkallët e natalitetit të popullatës sonë në pikëpamje kohore ishin mjaft variabile, ndërsa në aspektin territorial dhe social mjaft homogjene, por në nivel shumë të lartë. Në periudhën prej kur disponohet me të dhëna e deri në Luftën II Botërore, nataliteti në Kosovë sillej midis 35,0 dhe 50,0 promilë mesatarisht në vit, ndërsa mortaliteti midis 38,0 e 20,0 promilë. Nga ky trend i natalitetit dhe i mortalitetit ndryshonin shumë shkallët e shtimit natyror, të cilat në disa vite dhe periudha të shkurta, ishin shumë të ulëta, në hapësira të ngushta madje edhe rreth nivelit zero. Për këto arsye fluktuonte bukur shumë edhe lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë, ndonëse, marrë në kontekst më të gjatë kohor, kishte tendencë të rritjes. Depresionet ciklike të popullsisë vareshin nga sigurimi i kushteve ekzistenciale, që krejt lidhej me sasinë e prodhimtarisë agrare, të cilën e diktonin ritmet natyrore, pastaj nga intensiteti i sëmundjeve epidemike me përmasa të mëdha (mortaja, kolera, lia, malaria, tuberkulozi, tifoja etj.), të cilat mjekësia popullore, e vetmja që zbatohej, nuk mund t'i shëronte. Luftërat e shpeshta ishin një faktor tjetër që, duke shkaktuar humbje të drejtpërdrejta dhe indirekte, çrregullonin strukturat bazë demografike dhe kufizonin rritjen e përgjithshme të popullsisë.[30]

---

[29] H. Islami, *Fshati i Kosovës (Kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural)*, Rilindja, Prishtinë, 1985, ff. 23-25.

[30] H.Islami, *Kosova dhe shqiptarët (Çështje demografike)*, Pena, Prishtinë, 1990, ff. 90-92.

Tabela 3. Lëvizja e numrit absolut dhe e normës së lindjeve në Kosovë prej vitit 1911-1940[31]

Viti	Numri i të lindurve gjallë	Në 1.000 banorë	Viti	Numri i të lindurve gjallë	Në 1.000 banorë
1911	19.691	45,0	1926	22.528	44,9
1912	18.445	41,7	1927	22.798	44,4
1913	17.600	39,2	1928	22.584	44,9
1914	15.975	35,5	1929	22.531	42,0
1915	12.166	27,7	1930	22.003	40,0
1916	14.437	32,9	1931	22.446	40,4
1917	13.995	32,1	1932	22.927	40,5
1918	13.351	31,4	1933	22.696	39,4
1919	19.173	44,6	1934	23.198	39,5
1920	21.555	49,9	1935	22.315	37,3
1921	23.412	52,1	1936	22.119	36,4
1922	22.857	50,0	1937	22.004	35,4
1923	21.126	49,9	1938	22.565	35,9
1924	23.378	48,7	1939	20.735	32,4
1925	23.049	46,9	1940	21.254	32,7

Tabela 4. Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës prej 1911-1940 sipas periudhave pesëvjeçare (në promilë)[32]

Periudha	Nataliteti	Mortaliteti	Shtimi natyror	Mortaliteti i foshnjave
1911-1915	38,0	34,0	4,0	-
1916-1920	39,0	38,0	1,0	-
1921-1925	49,0	30,0	19,0	-
1926-1930	43,0	25,0	18,0	-
1931-1935	39,0	21,0	18,0	198,2
1936-1940	35,0	18,0	17,0	161,8

[31] Burimi: *Prirodno kretanje stanovništva Srbije od 1863. do 1954. godine, Prikazi 20,* Zavod za statistiku NR Srbije, Beograd, novembar 1957, ff. 52-53, 68-71.

[32] Burimi: *Prirodno kretanje stanovništva NR Srbije od 1863. do 1954. godine, Prikazi 20,* Zavod za statistiku Srbije, Beograd, novembar 1957, ff. 52-53, 68-71; *The Population of Yugoslavia,* Demographic Research Center, Institut of Social Sciences, Belgrade, 1974, p. 14; H. Islami, *Rrjedha demografike shqiptare,* Dukagjini, Pejë, 1994, f. 37; *Statistički godšinjak Jugoslavije* (vitet përkatëse), SZS, Beograd, 1991-1994; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku,* br. 024, Beograd, 30.01.1997, ff. 10-12.

3.1.1. Domosdoshmëria e natalitetit të lartë

Për shkak të vdekjeve të shumta e të hershme, e gjithë popullsia e aftë për riprodhim nuk përjetonte tërë periudhën fertile (moshën 50-vjeçare). Sidomos vdisnin foshnjat dhe fëmijët e vegjël dhe femrat në periudhën e riprodhimit. Mortaliteti i foshnjave arrinte deri 200 promilë mesatarisht në vit, që në demografi njihet si nivel ekstrem maksimal. Në këtë mënyrë baza e piramidës së moshës dhe e përtëritjes së mëtejme të popullsisë jo vetëm që nuk zgjerohej, por herë-herë, në disa grup-mosha, edhe ngushtohej.[33] Nga demografia historike dhe antropologjia mund të mësohet se në popullatat e shoqërisë paraindustriale ekzistonte shkallë e lartë e paralelizmit midis nivelit të mortalitetit dhe nivelit të natalitetit, që do të thotë se vdekshmëria e lartë kushtëzonte lindshmërinë e lartë dhe e kundërta.[34] Një qëndrim të tillë duket se më fuqishëm e mbronte demografi amerikan F. Notestein, duke theksuar se çdo shoqëri që ballafaqohej me shkallë të lartë të mortalitetit, karakteristikë për periudhën paraindustriale, për të mbijetuar duhej patjetër të kishte nivel të lartë të natalitetit.[35]

Mortaliteti shumë i lartë, sidomos ai i foshnjave dhe i fëmijëve të vegjël si pasojë e kushteve të pavolitshme socialo-shëndetësore, jeta dhe ekonomia e mbyllur agraro-blegtorale, shkalla shumë e ulët e arsimit dhe mbi të gjitha analfabetizmi si përcjellës shekullor i shoqërisë shqiptare kanë kushtëzuar nivel shumë të lartë të natalitetit dhe të fertilitetit. Shkalla e fertilitetit ishte shumë e lartë te femrat që hynin herët në bashkësi martesore, kur zgjatej periudha riprodhuese dhe kur në vitet e hershme aftësia fiziologjike e gruas për lindje ishte më e lartë.[36] Lindshmëria shpeshherë te shumë gra shqiptare arrinte

---

[33] H. Islami, "Osvrt na razvitak stanovništva Kosova", *Sociologija*, nr. 1, Beograd, 1977, ff. 155-156.

[34] A. Sauvy, *Théorie générale de la population (La vie des populations)*, Vol. II, Presses Universitaires de France, Paris, 1966, pp. 72-100, 128-158.

[35] Një qëndrim të tillë duket se më fuqishëm e mbronte demografi amerikan F. Notestein, duke theksuar se çdo shoqëri që ballafaqohej me shkallë të lartë të mortalitetit, karakteristikë për periudhën paraindustriale, për të mbijetuar duhej patjetër të kishte nivel të lartë të natalitetit (Shih më gjerë: F. Notestein, "Population - The Long View", në publikimin *Food for the World,* University of Chicago Press, Chicago, 1945).

[36] F. Lorimeri, në bazë të modelit hipotetik, ka llogaritur kapacitetin mesatar prokreativ të femrës, i cili ndryshon me vitet e moshës, ku në fillim të periudhës riprodhuese është shumë i ulët, pastaj rritet dhe pas moshës 35-vjeçare përsëri zvogëlohet. Sipas tij, përqindja e femrave të afta për lindje në moshën 14-vjeçare është 1,4%, në të 15-ën 4,6%, në të 17-ën rritet në 33,9%, në atë 18-vjeçare 61,5%, ndërsa numri maksimal i femrave fertile është në moshën 22-vjeçare (93%). Pas moshës 22-vjeçare hetohet rënie e ngadalshme, ndërsa pas moshës 35-vjeçare rënie e shpejtë e aftësisë fiziologjike të femrës: në moshën 30-vjeçare kjo përqindje është 87,2%, në të 35-ën 80,5%, në të 40-ën

kufirin maksimal të fekonditetit, që do të thotë se gruaja lindte aq fëmijë sa që e konsumonte tërë potencialin prokreativ apo aftësinë fiziologjike për lindje.[37] Disa të dhëna tregojnë se niveli i pjellorisë së popullsisë së Kosovës ishte pothuajse identik me atë të popullatave paraindustriale. P.sh. numri i fëmijëve të lindur gjallë në 1.000 gra të moshave të caktuara midis popullsisë së Kosovës në vitin 1950 dhe 13 bashkësive popullative të periudhës paraindustriale (9 nga Evropa - para vitit 1800, 3 nga Azia dhe një nga Afrika) ishte: 329:435 fëmijë të lindur gjallë në periudhën 20-24 vjet; 343:407 në periudhën 25-29 vjet; 348:371 në periudhën 30-34 vjet; 251:298 në periudhën 35-39 vjet; 156:152 në periudhën 40-44 vjet dhe 67:22 fëmijë të lindur gjallë në periudhën 45-49 vjet.[38]

Siç mund të vërehet nga kjo pasqyrë krahasuese, pas moshës 40-vjeçare numri i fëmijëve të lindur gjallë ishte më i madh në Kosovë se sa te 13 popullatat paraindustriale, sigurisht për shkak të jetës më të gjatë të femrave, ndërsa numri i lindjeve pothuajse të barazuara në periudhat 25-39 vjeçare dhe më i vogël te grup-moshat e hershme fertile. Këto të dhëna njëkohësisht tregojnë se në kuptimin demografik, por jo vetëm demografik, rreth vitit 1950 Kosova i përkiste popullatave paraindustriale.

Në rrethana të tilla nevoja dhe vetëdija për numër më të madh të lindjeve, si dhe për familje të tipit të zgjeruar, siç është familja e madhe si njësi dhe institucion i rëndësishëm në shoqërinë tradicionale rurale shqiptare, ishin kërkesë pothuajse universale. Autorët që kishin studiuar rolin e fëmijëve në ekonominë natyrale dhe gjendjet demografiko-sociale të shoqërive paraindustriale në hapësirat e Ballkanit kishin shënuar:"Pak ka aspirata

---

69,9%, në të 45-ën 38,1%, në moshën 50-vjeçare bie në 1,2%, ndërsa në moshën 53-vjeçare është vetëm 0,01% (F. Lorimer, *Culture and Human Fertility*, UNESCO, Paris, 1954, ff. 49-51).

[37] Kapaciteti mesatar i fëmijëve që mund t'i lindë një grua gjatë periudhës së saj fertile është, sipas Lorimerit, 8,32 fëmijë (F. Lorimer, *Po aty*), ndërsa sipas Henry-së rreth 12 fëmijë (L. Henry, *Démographie, analyse et modèles,* Librairie Larousse, Paris, 1972, p. 121; L. Henry, "La fécondité naturelle: observation - théories - résultats", *Population*, nr. 4, Institut National d'Éudes Démographiques, Paris, 196l, pp. 625-636). Në bazë të hulumtimit të popullatës së sektës kristiane Huterita në Amerikën Veriore, territorialisht të izoluar dhe në pikëpamje sociale e arsimore homogjene, është shënuar fertiliteti më i lartë i grave, afër maksimumit biologjik, përkatësisht 12 deri 14 fëmijë (Shih për këtë më gjerë: C. Tietze, "Reproduktive Span and Rate of Reproduction among Hutterite Women", *Fertility and Sterility*, 1957, VII-1, pp. 89-97; M. C. Sheps, "An Analyses of Reproductive Patterns in an American Isolate", *Population Studies*, XIX, no. 1, 1965, pp. 65-80; A. W.-Baletić, *Po aty*, ff. 145-146; L. Henry, *Po aty.*

[38] Për 13 popullata paraindustriale: L. Henry, *Po aty*: për Kosovën: *Fertilitet stanovništva u Jugoslaviji*, Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1972, f. 73.

njerëzore të cilat janë aq të përgjithshme, aq unanime dhe aq të pakusht çfarë është dëshira për fëmijë në mjedisin patriarkal. Fëmijët nuk janë vetëm të dëshirueshëm në kushte të caktuara, por gjithmonë dhe me çdo kusht të domosdoshëm. Njerëzit këtu e njohin vetëm një burim të pasurisë, e ky është plleshmëria. Ka vetëm një mjet për lehtësimin e jetës dhe për zvogëlimin e mundimeve fizike: të kesh në shtëpi të rinj, fëmijë, reja, nipa, të cilët për të vjetrit janë zëvendësim, dorë e djathtë dhe krah...Çdo anëtar i familjes vlen si fuqi punëtore; barinjtë, amviset absolutisht janë të nevojshme. Kujdesi material nuk është problem për ambientin ku krejt në shtëpi prodhohet, ku fëmijët herët ndihmojnë, ku kërkesat janë modeste".[39]

Në shoqërinë tradicionale shqiptare si çështje themelore shtrohej ekzistenca: si të mbesnin njerëzit gjallë dhe si të ruhej në jetë një numër i caktuar i fëmijëve nga numri i madh i tyre të lindur gjallë në martesa. Prindërit qysh më parë e dinin se në kushtet e vështira shëndetësore dhe ekonomike, një numër i mirë i fëmijëve, në shumë familje madje edhe rreth gjysma, do të vdisnin në ditët dhe vitet e para të jetës. Prandaj, te çiftët bashkëshortorë domosdoshmërisht u krijuan normat dhe qëndrimet se për ta ruajtur një numër të caktuar të fëmijëve në jetë, mundësia e parë ishte të lindnin sa më shumë fëmijë. Nga numri i fëmijëve që do të mbesnin në jetë dhe do të hynin në periudhën e punës do të varej funksionimi i ekonomisë së tipit natyral, ngase si fuqi ekstensive punëtore do të angazhoheshin herët në punët përkatëse, sikurse në fushë, rreth bagëtisë etj., në një anë, dhe do t'i siguronin familjes perspektivën dhe kontinuitetin social, në anën tjetër.[40]

Femra jonë hynte herët në martesë, për ç'arsye zgjatej periudha e saj fertile dhe rritej mundësia e lindjes së numrit më të madh të fëmijëve. Intervali midis momentit të themelimit të bashkësisë martesore dhe lindjes së fëmijës së parë në këtë bashkësi (intervali protogjenezik) ishte shumë i shkurtër, shpeshherë 9 deri 12 muaj, sikundër që edhe intervali midis lindjeve të ardhshme ishte po ashtu tepër i shkurtër (intervali intergjenezik),[41] ndërkaq,

---

[39] V. St. Erlich, *Jugoslavenska porodica u transformaciji. Studija u tristotine sela*, Liber, Zagreb, 1971, ff. 262, 267.

[40] "Në shumë shoqëri, natyrisht, nuk ka asgjë të tipit të sigurimit social dhe prindërit shpesh mbështeten në fëmijët e tyre të rritur që të kujdesen për ta në pleqëri. Nëse konsiderojnë se fëmijët e tyre kanë gjasa të vdesin të rinj, atëherë prindërit nxiten fuqimisht të lindin më shumë fëmijë që të sigurohen që së paku disa prej tyre të mbijetojnë deri në moshën madhore; në ekonomitë që vetëmbahen, fëmijët mund të ndihmojnë në mbledhjen e drunjve dhe ujit, mbledhjen e të korrave, në mirëmbajtjen e kopshtit dhe në ruajtjen e bagëtisë" (Al Gore, *Toka në baraspeshë - ekologjia dhe fryma njerëzore*, Dukagjini, Pejë, 1994, f. 244).

[41] Për intervalin protogjenezik dhe intervalin intergjenezik shih: R. Pressat, *Dictionnaire de démographie,* PUF, Paris, 1979, p. 98.

mosha mesatare e grave me rastin e lindjes së fëmijës së parë ishte mjaft e ulët. Intervalet e shkurta kohore midis lindjeve, sidomos intervalet më pak se dy vjet, bartnin rreziqe të mëdha për shëndetin e gruas, që manifestoheshin në lindjet e parakohshme, në peshën e vogël të të posalindurve, në zvogëlimin e sasisë së qumështit të nënës (thithja), në mundësinë e zgjerimit të sëmundjeve të ndryshme infektive etj.; konsekuencë e këtyre problemeve ishte vdekshmëria e lartë e foshnjave. Nga numri i madh i fëmijëve të lindur, të gjallë apo të vdekur, rraskapitej gruaja dhe plakej para kohe. Mirëpo, ndonëse për jetën rurale dhe në esencë agrare fëmijët ishin vlerë dhe pasuri e madhe, megjithatë vetë aktit të lindjes shumë pak i është kushtuar kujdes. Në mjedise të ndryshme ndodhte që gruaja të lindte edhe jashtë shtëpisë dhe për një kohë shumë të shkurtër t'i përvishej punës qoftë në amvisëri, qoftë në oborrin ekonomik apo në fushë. Por këtë shpeshherë e diktonte vetë ritmi i punëve dhe i nevojave jetësore, veçanërisht në vlugun e punëve në bujqësi. Në popull shpeshherë me përbuzje thuhej: "Gruaja i ka shtatë shpirta", "Gruaja ka shpirt mace"etj.! [42]

3.1.2. Martesa, familja dhe lindja si vlera të larta

Mbi bazën e tipit të prodhimtarisë agraro-natyrale dhe të izolimit social e hapësinor dhe të jetës së krijuar mbi to të popullatës shqiptare, familja i ruante të gjitha funksionet e njësisë ekonomike, ndërsa femra, për shkak të varshmërisë ekonomike, shkallës shumë të ulët të arsimimit, ngulitjes për shtëpi dhe suaza familjare, objektivisht nuk ka mundur t'i theksonte aspiratat dhe qëllimet e saj personale jashtë jetës familjare dhe ekonomisë shtëpiake. Familja si institucion shoqëror luante funksionin e transmisionit të vlerave kolektive. Në kuadër të familjes, përveç funksionit riprodhues si formë e saj afatgjate, kryheshin të gjitha funksionet e tjera: ekonomike, konsumuese, arsimore, edukative, mbrojtëse, shëndetësore etj. Ishte shumë e ngushtë lidhja midis funksionit ekonomik të familjes dhe funksionit të saj reproduktiv. Familja e madhe ishte jo vetëm formë karakteristike, por edhe territorialisht shumë e zgjeruar e organizimit shoqëror të shqiptarëve.

Në shoqërinë patriarkale shqiptare, martesa, familja dhe lindshmëria vlerësoheshin lart. Në rrethana të përmendura shoqëroro-ekonomike, sipas traditës popullore, martesa konsiderohej si ngjarje më e rëndësishme familjare, sepse sillte sukses, fat dhe mbi të gjitha pasardhës dhe krah të ri të punës,[43]

---

[42] H. Islami, "Nataliteti te shqiptarët", në publikimin *Çështje të studimeve albanologjike, II,* Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1987, ff. 403-421.

[43] Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit komponentët kryesorë të martesës ishin lindja e

ndërkaq fëmijët, veçanërisht ata të gjinisë mashkullore, paraqiteshin si faktor i domosdoshëm i kontinuitetit të familjes e të ekonomisë shtëpiake si njësi ekonomike, të trashëgimit të pasurisë dhe të emrit të familjes dhe si mbajtës të prindërve në pleqëri, meqenëse do t'u mungojë baza e gjerë sociale, siç janë sigurimi social, shëndetësor, pensional e invalidor. Në këtë shoqëri pozita e gjithmbarshme e gruas ishte tepër e rëndë, ku në të gjitha sferat e vendosjes e të aktivitetit i nënshtrohej vullnetit të burrit dhe interesave kolektive të familjes, ndërsa sa i takonte kontrollit të lindjes, dominonte forma tradicionale e tij, *coitus interruptusi* ose ndërpritja e kontaktit (aktit) seksual (gjenital).[44]

Në shoqërinë klasike shqiptare, sikundër edhe në të gjitha shoqëritë paraindustriale, qëllimi më i lartë i femrës në bashkësi martesore, por edhe në jetë në përgjithësi ishte lindja e fëmijëve. Prandaj, familjet pa fëmijë dhe familjet me një gjeneratë janë konsideruar si të shkreta dhe pa perspektivë sociale pikërisht për shkak të mungesës së trashëgimtarit e të fuqisë punëtore dhe të ngushtimit të mundësive të ekzistencës. Prej faktit se a do të lindte nusja fëmijë, madje në disa familje edhe të cilës gjini i lindte, varej edhe pozita e saj në familje. Ishte dukuri që të prishej kurora për shkak të moslindjes së fëmijëve. Ndonëse kurrë nuk vërtetohej se kush ishte steril, gruaja apo burri, megjithatë faji i hidhej gjithmonë gruas; ky fakt e mbante gruan në pozitë labile, madje edhe e nxirrte krejtësisht nga shtëpia. Gruaja që lindte fëmijë respektohej aq shumë sa që i atribuoheshin disa veti të mira fizike dhe morale dhe përforcohej pozita e saj në familje. Në disa vise shqiptare dëgjohej edhe shprehja: më mirë pjellëmirë e grua e keqe se grua e mirë e pjellëkeqe. Shpenzimet e mbajtjes së familjes dhe të ngritjes së fëmijëve në popullatën shqiptare, sikundër edhe në çdo popullatë tjetër që ka ekzistuar në kushte të tilla të moszhvillimit gjithmonë kanë qenë shumë modeste. Nga të gjitha këto arsye edhe shpjegohen normat dhe pikëpamjet mbi martesën, siç janë hyrja e hershme në të, ruajtja e karakterit të institucionit universal të saj, hyrja përsëri në martesa pas shkurorëzimeve etj.

fëmijëve dhe nevoja për ta si fuqi punëtore. Në përkufizimin e martesës dominojnë qartë funksioni reproduktiv dhe funksioni ekonomik: "M'u martue më kanun do' me thânë m'u bâ shpi, me ia shtue shpis nji rob mâ teper, sa per krah të pûnve, sa per ta shtuem të fmive" (*Kanuni i Lekë Dukagjinit,* Përmbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1972, Paragrafi 28, f. 10).

[44] H. Islami, *Kosova dhe shqiptarët (Çështje demografike)*, Pena, Prishtinë, 1990, ff. 96-97.

3.2. Funksioni riprodhues në shoqërinë shqiptare të kohës sonë

Kur të vështrohet lëvizja e natalitetit në Kosovë në shekullin XX vërehet se niveli i tij deri rreth gjysmës së dytë të viteve të 60-ta ishte shumë i lartë, mbi 40 promilë mesatarisht në vit. Pas këtyre viteve nataliteti nis të zvogëlohet nën nivelin prej 40 promilësh dhe kjo tendencë pak më ndjeshëm shpejtohet në vitet e 70-ta, për t'u stabilizuar në rreth 30 promilë në vitet e 80-ta. Pas vitit 1965 edhe shkalla e mortalitetit të përgjithshëm bie nën nivelin prej 10 promilësh, ndërsa mortaliteti i foshnjave, me gjithë rënien e konsiderueshme në raport me periudhat e mëparshme, deri në fund të viteve të 70-ta mbetet në nivel shumë të lartë (mbi 100 promilë). Pas gjysmës së dytë të viteve të 60-ta, me rritjen e numrit të popullsisë së përgjithshme dhe veçanërisht me shtimin e kontingjentit të popullsisë në periudhën e përtëritjes biologjike, si dhe me rënien e mortalitetit, numri absolut i lindjeve dhe shtimi natyror deri në fund të viteve të 80-ta gjithnjë shënojnë rritje, ku vlerat më të larta arrihen midis viteve 1987 dhe 1990.

Nga eksperienca e popullatave që e kanë kaluar fazën e plotë të transicionit demografik (rënia e mortalitetit dhe e natalitetit, zgjatja e jetës së njeriut dhe transformimi i gjithë zhvillimit demografik), shihet qartë se fillimi i rënies së natalitetit nuk paraqitet në tërësinë e popullatës, por në ato pjesë dhe shtresa të saj te të cilat janë krijuar kushtet e ndryshimit të sjelljes riprodhuese. Barra e riprodhimit në asnjë popullatë nuk është njësoj e shtrirë në të gjitha tipat e vendbanimeve, shtresat sociale të shoqërisë, kohortat e popullsisë sipas moshës etj. Në territoret e pazhvilluara, që nuk janë gjendur nën çrregullime të fuqishme të proceseve dhe strukturave bazë demografike, sipas rregullit, barra kryesore e riprodhimit biologjik bie në popullatën rurale, bujqësore dhe të paarsimuar.

Tabela 5. Lëvizja e natalitetit, e shtimit natyror të popullsisë dhe e numrit të martesave dhe shkurorëzimeve në Kosovë prej 1950-2006[45]

Viti	Numri i lindjeve	në 1.000 banorë	Shtimi natyror	në 1.000 banorë	Numri i martesave	Numri i shkurorëzimeve
1950	35.222	46,1	22.231	29,1	8.636	481
1951	29.299	37,6	14.446	18,5	7.300	474
1952	35.619	44,9	21.752	27,4	7.052	406
1953	34.595	42,6	17.869	22,0	7.208	382
1954	38.595	46,4	25.394	30,0	7.390	352
1955	36.736	43,6	21.444	25,5	6.815	445
1956	37.819	44,0	24.127	28,1	5.723	426
1957	34.159	39,1	18.859	21,6	5.860	403
1958	39.285	44,1	27.687	31,1	6.924	374
1959	37.364	40,6	24.486	26,6	6.794	498
1960	41.631	44,1	28.266	29,9	6.822	417
1961	40.561	41,9	28.802	29,8	7.426	479
1962	41.336	41,6	26.312	26,5	7.481	451
1963	41.525	40,6	29.102	28,5	7.133	346
1964	42.557	40,5	29.826	28,4	8.340	385
1965	43.569	40,5	31.802	29,6	8.226	347
1966	42.429	38,0	32.163	28,8	8.246	514
1967	44.001	38,2	32.693	28,4	7.569	314
1968	44.627	37,7	33.846	28,6	8.719	244
1969	46.480	39,1	35.588	29,9	10.083	226
1970	44.496	36,5	33.667	27,6	11.280	258
1971	47.060	37,5	36.748	29,3	11.006	238
1972	47.943	37,1	37.673	29,2	10.571	272
1973	47.714	35,9	37.356	28,1	11.139	198
1974	49.847	36,5	39.772	29,1	9.885	337
1975	49.310	35,1	39.292	28,0	9.928	261
1976	51.355	35,5	41.206	28,5	10.268	248
1977	49.849	33,5	40.038	26,9	10.470	472
1978	49.027	32,1	39.251	25,7	11.562	460
1979	48.125	30,7	38.550	24,6	11.568	355
1980	53.147	34,2	44.238	28,5	12.666	333
1981	48.111	30,2	38.434	24,1	11.936	280

[45] Burimi: *Demografska statistika 1990,* SZS, Beograd, 1992, ff. 27, 32; *Statistički godišnjak Jugoslavije*, SZS, Beograd 1987, ff. 438-439; *Demografska statistika 1993*, SZS, Beograd, 1996, ff. 54, 57; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku*, br. 012, Beograd, 17. 01. 1996, ff. 10-16; *Demografska statistika 2000*, SZS, Beograd, 2002, ff. 62-63, 74-75; për vitet 1997-2000 vlerësimi, ndërsa për vitet 2002-2006 burimi: *Statistikat vitale të Kosovës 2006,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2007, f. 9.

1982	52.865	32,3	42.386	25,9	12.368	289
1983	49.645	29,6	38.605	23,0	12.406	256
1984	55.243	32,2	44.670	26,0	12.560	237
1985	53.920	30,6	42.099	23,9	12.483	332
1986	55.519	30,2	44.073	24,4	11.912	364
1987	56.221	30,4	45.914	24,8	13.644	260
1988	56.283	29,7	46.026	24,3	14.613	389
1989	53.656	27,7	43.475	22,4	14.343	320
1990	55.175	27,8	46.961	23,6	12.742	509
1991	52.293	26,6	43.737	22,2	12.559	354
1992	44.418	22,1	36.414	18,1	13.367	266
1993	44.132	21,6	36.328	17,8	13.372	248
1994	43.150	20,9	35.783	17,2	11.959	299
1995	44.776	21,2	36.105	17,1	12.979	352
1996	46.041	21,4	37.649	17,5	12.244	559
1997	42.920	19,6	34.296	15,7	11.866	396
1998	42.920	19,3	34.296	15,4	11.866	396
1999	42.920	19,0	34.296	15,2	11.866	396
2000	42.920	18,7	34.296	15,0	11.866	396
2002[46]	36.136	18,2	30.482	15,4	18.280	-
2003	31.994	15,9	25.577	12,7	17.034	-
2004	35.063	17,2	28.668	14,0	16.989	1.293
2005	37.218	18,0	30.011	14,5	15.732	1.445
2006	34.187	16,3	26.708	12,7	12.825	1.480

Të gjitha kërkimet demografike në botë, të bëra në këtë shekull, veçanërisht këto 50 vjetët e fundit, treguan se femrat ekonomikisht aktive lindin më pak fëmijë se femrat e mbajtura, se edhe femrat aktive edhe ato të mbajtura të profesioneve bujqësore kanë shkallë mesatarisht më të lartë të fertilitetit se femrat e profesioneve jobujqësore dhe se më shumë fëmijë lindin

[46] Si në numrin absolut, ashtu edhe në atë relativ dallimet në ngjarjet vitale janë të mëdha para dhe pas luftës. Rënia kaq e madhe pas vitit 1991 dhe pas vitit 2000 (për vitin 2001 nuk ka të dhëna) është rrjedhojë e shpërnguljes së të rinjve shqiptarë, nënregjistrimit të lindjeve, vdekjeve dhe martesave, atmosferës së luftës në afërsi, pasigurisë sociale, etj. Mirëpo kemi një fluktuim në vëllimin e këtyre fenomeneve pas vitit 2000 dhe sidomos midis viteve 2002 dhe 2003, përkatësisht një rënie të konsiderueshme, p.sh. për më se 4.000 lindje më pak brenda një viti, që mund të shpjegohet nga dobësitë në evidencimin e lindjeve dhe vdekjeve. Ose, zvogëlimi i madh relativ i numrit të lindjeve dhe vdekjeve në vitet 2002-2003, por rritja e numrit të martesave në këto vite në raport me vitet e para luftës etj. Duhet theksuar gjithashtu se zvogëlimi i vëllimit absolut të fenomeneve vitale është dhe rezultat i refuzimit të srbëve që të bashkëpunojnë me shërbimet civile të Kosovës, që vërehet qartë midis viteve 2000-2002; ata të dhënat për këto ngjarje sigurisht u dërgojnë institucioneve statistikore në Serbi.

femrat analfabete dhe ato pa përgatitje shkollore, ndërsa më pak femrat me nivel më të lartë të arsimit. Prandaj, teza mbi determinimin etnik dhe konfesional të natalitetit, lidhjes së riprodhimit me veçori ataviste apo me ideologji të caktuar, nuk ka mbështetje shkencore. Dëshira të lindura për numër më të madh apo më të vogël të pasardhësve nuk ka, por ato krijohen gjatë ciklusit jetësor, sikundër që lindja si akt dhe nataliteti si proces prej *homo sapiensit* e deri më sot kurrë nuk janë cilësuar si çështje etnike apo nacionaliste. Niveli jo i njëjtë i natalitetit te popullatat e ndryshme nuk mund t'i atribuohet as dallimeve në kapacitetin fiziologjik të gruas dhe në komponentin trashëgues.[47]

3.2.1. Determinantet e transicionit të vonuar demografik

Në planin ekonomik, siç dihet, Kosova dhe shqiptarët në ish-Jugosllavi kishin gjithnjë pozitë të një kolonie, ndërsa në fund të shekullit XX paraqisnin shembullin më tipik të okupimit dhe të kolonisë klasike. Prandaj, pa një analizë kritike të një politike të tillë ndaj Kosovës dhe shqiptarëve nuk është e mundur as të kuptohen rrjedhat demografike në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare, veçanërisht në sferën e përtëritjes së popullsisë. Lënia pas dore e Kosovës dhe e shqiptarëve në politikën zhvillimore për një kohë të gjatë ishte strategji e paramenduar dhe e konceptuar mirë. Kosova jo vetëm që hyri vonë në rrjedhat e industrializimit dhe të urbanizimit të jetës, por edhe struktura e ekonomisë së saj ishte dhe mbeti shumë e njëanshme. Prandaj edhe u vonua transicioni demografik dhe Kosova gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XX paraqiste dhe ajo edhe sot paraqet transicionin e fundit demografik në Evropë.[48] Deri në shkatërrimin e Jugosllavisë së Dytë, industria ekstraktive në bazë të plumbit dhe zinkut dhe enrgjetika në bazë të thëngjillit gëlltitnin pjesën më të madhe të investimeve, ndërsa ky tip i industrisë, siç është e njohur, kishte efekte të vogla në akumulim, në të ardhura dhe në punësim. Strategjia e tillë në politikën e investimeve në masë më të madhe përfaqësonte interesin e Serbisë dhe të ish-Jugosllavisë. Kjo industri ka punësuar kryesisht fuqinë punëtore mashkullore, kurse kapacitetet e pamjaftueshme të industrisë përpunuese nuk kanë mundur ta absorbonin fuqinë e re punëtore dhe në mënyrë të veçantë fuqinë punëtore të gjinisë femërore.

---

[47] F. Lorimer, *Po aty*.

[48] Për shkaqet e transicionit të vonuar demografik shih: H. Islami, "Zakasnjela demografska tranzicija na Kosovu u okviru demografskog prelaznog razdoblja u Jugoslaviji i Evropi", *Sociologija*, nr. 3, Beograd, 1985, ff. 372-374; H. Islami, "Zadnja demografska tranzicija v Evropi: primer Kosova", *Časopis za kritiko znanosti*, št. 79-80, Ljubljana, 1985, ff. 29-45.

Tabela 6. Lëvizja e natalitetit, e shtimit natyror dhe e numrit të martesave dhe shkurorëzimeve në Shqipëri në disa vite karakteristike[49]

Viti	Numri i lindjeve	në 1.000 banorë	Shtimi natyror	në 1.000 banorë	Numri i martesave	Numri i shkurorëzimeve
1950	47.291	38,5	30.076	24,5	12.341	968
1960	69.686	43,3	52.911	32.9	12.571	850
1970	69.507	32,5	49.733	23.3	14.449	1.625
1980	70.680	26,5	53.698	20,1	21.729	2.024
1985	77.535	26,6	60.356	20,4	25.271	2.451
1990	82.125	25,0	63.392	20,2	27.655	2.628
1995	72.081	23,6	50.758	17,7	26.989	2.586
2000	51.242	16,7	34.821	11,3	25.820	2.168
2001	54.283	17,7	38.470	12,5	25.717	2.462
2004	43.022	13,8	25.273	8,1	20.949	2.968

Në rrjedhat e ndryshimeve intensive shoqërore vonë e ngadalë janë përfshirë sektorët më kryesorë të riprodhimit të popullsisë, e këta janë: femra si faktor kryesor i përtëritjes biologjike, familja si suazë vendimtare e lindjes, e amësisë dhe e riprodhimit dhe si bartëse e shumë funksioneve të tjera shoqëroro-ekonomike dhe fshati si strukturë dominante e popullimit në shoqërinë kosovaro-shqiptare. Fshati ku edhe sot jeton pjesa dërmuese e popullatës sonë, për shkak të lënies pas dore në politikën e zhvillimit, si dhe të stabilitetit në strukturat themelore demografike për një kohë të gjatë (sipas gjinisë, moshës, gjendjes martesore etj.) ishte dhe mbeti forcë vitale e popullsisë dhe e shoqërisë sonë. Mirëpo, nga fundi i viteve të 60-ta, e sidomos pas viteve të 70-ta, me zbërthimin gradual të strukturës homogjene social-ekonomike dhe kulturo-arsimore përmes rritjes së popullsisë urbane dhe zgjerimit të profesioneve joagrare, zvogëlimit të analfabetizmit dhe rritjes së shtresave të arsimuara të popullsisë, përmirësimit të hetueshëm të pozitës së gruas dhe rritjes së aspiratave profesionale të saj, rënies së mortalitetit etj., edhe te popullata shqiptare nisi të zvogëlohej nataliteti nga niveli tepër i lartë dhe të diferencohej shkalla e tij në pikëpamje territoriale dhe shoqërore. Prandaj, sikurse te çdo popullatë në pikëpamje sociale dhe rajonale me strukturë heteronome, edhe te popullata shqiptare niveli i riprodhimit duhet të vështrohet i diferencuar sipas veçorive territoriale, sociale, profesionale, arsimore, shkallës së urbanizimit, veçorive të mobilitetit hapësinor dhe social etj. Një qasje e tillë nxjerr në pah thyerjen e lindshmërisë nëpër prizmin e shtresëzimit shoqëror, ndërsa ndikimet e vlerave e të institucioneve tradicionale, të dokeve e të besimeve

[49] *Vjetari Statistikor i RPS të Shqipërisë 1990,* Drejtoria e Statistikës, Tiranë, 1990, ff. 52-53; *Vjetari i treguesve socialë,* INSTAT, Tiranë, 2000, ff. 5, 10; *Shqipëria në shifra 2005*, INSTAT, Tiranë, 2006, ff. 10-11; *Treguesit socialë,* INSTAT, Republika e Shqipërisë, Tiranë, 2007 (sipas: http://www.instat.gov.al).

ndaj fëmijëve dhe madhësisë së familjes, për të cilat shpeshherë mendohet se kanë origjinë etnike, janë vetëm të ndërmjetshme, përmes stratifikimit përkatës social dhe nivelit të caktuar të arsimit.[50]

Tabela 7. Normat e fertilitetit të përgjithshëm dhe normat e riprodhimit në Kosovë në periudhën 1950-2000[51]

Viti	Norma e fertilitetit të përgjithshëm[52]	Norma bruto e riprodhimit[53]	Norma neto e riprodhimit[54]
1950	7,85	3,73	2,52
1955	6,68	3,20	2,09
1960	6,73	3,23	2,35
1965	6,02	2,87	2,30
1970	5,45	2,61	2,22
1975	5,21	2,49	2,19
1980	4,82	2,29	2,10
1985	4,30	2,07	1,90
1990	3,60	1,70	1,62
1995	2,61[55]	1,23	1,20
2000	2,20	1,03	1,00

[50] H. Islami, *Rrjedha demografike shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 1994, f. 19 e tutje.

[51] G. Penev, "Tendencije i osobine fertiliteta", në publikimin *Žena i radjanje na Kosovu i Metohiji,* CDI, IDN, Beograd, 1998, f. 17; *Demografska statistika 2000*, SZS, Beograd, 2002, f. 101.

[52] Norma e fertilitetit të përgjithshëm nënkupton numrin e fëmijëve të lindur gjallë të dy gjinive që do ta lindte vajza e lindur në vitin e vështruar gjatë periudhës së saj prokreative (riprodhuese), me kusht që fertiliteti sipas moshës të mbetej i pandryshuar sikurse edhe në vitin e vështruar, ndërsa të gjitha gratë të përjetonin fundin e periudhës riprodhuese (50 vjet), që do të thotë të abstrahohet vdekshmëria e tyre.

[53] *Norma bruto e riprodhimit* tregon numrin mesatar të fëmijëve të lindur gjallë të gjinisë femërore, të cilin vajza e lindur sot do ta lindë gjatë periudhës së saj riprodhuese, me kusht që fertiliteti të mbetet i njëjtë sikurse edhe fertiliteti i brezave të grave në vitin e vështruar dhe me kusht që asnjë vajzë e lindur gjallë të mos vdesë pa e përfunduar periudhën fertile.

[54] *Norma neto e riprodhimit* tregon numrin mesatar të fëmijëve të lindur gjallë të gjinisë femërore, të cilin vajza e lindur gjallë sot do ta lindë gjatë periudhës fertile, duke marrë parasysh mortalitetin e grave para dhe gjatë periudhës prokreative (15-49 vjet). Për shkak se një numër i femrave vdes para se të hyjë në periudhën fertile ose gjatë saj, nuk martohet apo nuk lindë fëmijë për arsye të ndryshme, norma bruto e riprodhimit duhet të korrigjohet, përkatësisht të zvogëlohet përreth 15%. Norma e korrigjuar për këtë vlerë, në të vërtetë, paraqet normën neto të riprodhimit (R. Pressat, *Dictionaire de démographie*, PUF, Paris, 1979, pp. 248, 273; G. Tapinos, *La Démographie. Population, économie et sociétés*, Le livre de poche, Éditions de Fallois, Paris, 1996, pp. 74-75).

[55] Në vitin 1996 kjo normë e fertilitetit në vendet më të pazhvilluara të botës ishte 5,37, në vendet më pak të zhvilluara 3,29, në vendet e zhvilluara 1,71, ndërsa në botë si tërësi ishte 2,98 fëmijë (Shih: *The State of World Population 1996,* UNFPA, New York, 1996, p. 122).

Menjëherë pas Luftës II Botërore popullsia e Kosovës kishte shkallë të lartë të fertilitetit të përgjithshëm, që i përkiste modelit tradicional të përtëritjes biologjike. Në vitin 1950 ky fertilitet ishte rreth 8 fëmijë për një grua, por gjatë këtyre pesë dhjetëvjetëshave të fundit vërehet një tendencë e zvogëlimit të dukshëm, kështu që në vitin 1995 arrin në 2,6 fëmijë për një grua. Me rënien e fertilitetit hetohet një rritje e konsiderueshme e pjesëmarrjes së lindjeve në moshën e re, p. sh. deri 30 vjet; derisa në vitin 1950 gratë deri në moshën e tyre 30-vjeçare kishin realizuar gati gjysmën e fertilitetit të tyre të përgjithshëm (rreth 46%), ndërkaq në gjysmën e viteve të 90-ta kjo përqindje ishte ngritur në dy të tretat (rreth 66%).

Derisa në Serbi dhe Vojvodinë, në 40 vjetët e fundit (pas vitit 1955) dhe në disa ish-njësi federale pas viteve të 70-ta norma neto e riprodhimit të popullsisë femërore ishte nën një, me tëndencë gjithnjë të zvogëlimit, ndërkaq në Kosovë kjo normë deri në gjysmën e viteve të 80-ta ishtë rreth dy fëmijë të kësaj gjinie, që do të thotë se popullata jonë ende riprodhohej në vëllim të zgjeruar dhe siguronte dyfishimin e popullsisë. Nga fillimi i viteve të 90-ta, me shpërnguljen masive të të rinjve në vendet e huaja, edhe në Kosovë norma neto e riprodhimit nisi të zvogëlohet. Në fund të shekullit XX zvogëlimi arrin në rreth 1,20, por që ende ishte mbi kufirin e përtëritjes së thjeshtë. Në gjithë periudhën pas Luftës II Botërore fertiliteti në Kosovë gjithnjë ishte mbi nivelin e duhur për riprodhimin e thjeshtë dhe norma neto e riprodhimit të popullsisë femërore të Kosovës ishte shumë mbi disa ish-njësi federale të ish-Jugosllavisë (tabela 8).[56] Normat e larta reproduktive në Kosovë veçanërisht janë karakteristike për shtresat e paarsimuara dhe të varfëra të popullsisë së Kosovës.

[56] Kjo normë e riprodhimit në Shqipëri ishte nën nivelin e normës në Kosovë: në vitin 1980 ishte 1,60, më 1985 1,47 dhe në vitin 1990 1,38 (*Vjetari Statistikor i R.P.S. të Shqipërisë 1990*, Tiranë, 1990, f. 66; *Recent demographic developments in Europe 2000,* Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2000, p. 81).

Tabela 8. Norma neto e riprodhimit të popullsisë femërore në Kosovë dhe në disa ish-njësi federale të ish-Jugosllavisë në periudhën 1950-2000[57]

	Ish-Jug.	B e H	Sllovenia	Serbia	Vojvodina	Kosova
1950	1,54	1,93	1,36	1,44	1,31	2,28
1960	1,19	1,63	1,00	0,92	0,96	2,40
1970	0,98	1,12	1,00	0,82	0,75	2,02
1980	0,96	0,86	1,00	0,86	0,86	2,04
1990	0,88	0,81	0,76	0,82	0,81	1,59
1995	-	-	-	0,78	0,82	1,20
1996	-	-	-	0,75	0,75	1,21
2000	-	-	-	0,68	0,69	1,00

3.2.2. Shkaqet e një thyerjeje demografike në fund të shekullit XX

Numri më i madh absolut i lindjeve në Kosovë është realizuar në gjysmën e dytë të viteve të 80-ta, ndërsa nga fillimi i viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, sipas statistikës vitale të shërbimeve civile, që i drejtonte pushteti serb, vërehet tendenca e rënies së shpejtë të numrit absolut dhe relativ të lindjeve. Thyerje shumë e madhe ka ndodhur midis viteve 1990 dhe 1992 dhe veçanërisht midis viteve 1991 dhe 1992, kur numri absolut i lindjeve bie nga rreth 52.000 në 44.000 ose nga rreth 27 në rreth 22 promilë, ndërsa shtimi natyror zvogëlohet nga rreth 44.000 në rreth 36.000 ose nga rreth 22 në rreth 18 promilë. Një tendencë e tillë edhe është pritur, duke pasur parasysh emigrimin masiv të shqiptarëve, veçanërisht të rinjve. Me selektivitetin e shpërnguljeve sipas moshës (të rinjtë) dhe gjinisë (meshkujt) u zvogëlua vëllimi i përtëritjes biologjike, që pritej të krijonte jo vetëm pasoja të pavolitshme demografike, por edhe sociale, politike e kombëtare, gjë që edhe ndodhi në një pjesë të mirë.

Kjo prerje demografike mund të shpjegohet sigurisht edhe me ndikimin e një varg variablash që i përkasin rrafshit politiko-psikologjik dhe sociopsikologjik, siç janë frika nga lufta, e cila vetëm sa nuk kishte shpërthyer në Kosovë, ku ish-Jugosllavia kishte përqendruar një potencial të madh ushtarak e policor, duke ushtruar një represion të paparë kundër shqiptarëve, pastaj krijimi i ndjenjës së pasigurisë sociale dhe paperspektivës jetësore dhe

[57] *Demografska statistika 1990,* Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1992, f. 53; D. Breznik, *Stanovništvo Jugoslavije,* Chronos, Titograd, 1991, f. 62; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku,* br. 024, Beograd, 30.01.1997, f. 17; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku,* br. 052, Beograd, 24.02.1998, f. 16; *Demografska statistika 2000*, SZS, Beograd, 2002, f. 10.

komponenteve të tjera të krizës psikologjike dhe materiale, që lidheshin me gjendjen e përgjithshme të krijuar në atë kohë në shtetin që i numëronte ditën e fundit të tij. Nën ndikim të eksodit, psikozës së luftës, ndjenjës së frikës dhe varfërisë shumë të rinj nuk lidhën bashkësi martesore, ku numri i martesave në Kosovë u zvogëlua prej 14.343 në vitin 1989 në 11.959 në vitin 1994, që pati ndikim të drejtpërdrejtë në rrudhjen e vëllimit të riprodhimit, ndërsa shumë çifte bashkëshortorë vendosën t'i shtyjnë për më vonë edhe lindjet e dëshiruara e të planifikuara.

Mirëpo, këtu duhet përmendur edhe faktin se pikërisht nga fundi i viteve të 80-ta dhe fillimi i viteve të 90-ta të shekullit XX, pas suprimimit të të gjitha mekanizmave qeverisëse në Kosovë, krijimit të atmosferës së mosbesimit ndaj institucioneve shtetërore e civile, që i udhëhiqnin serbët, dhe përjashtimit të punëtorëve shqiptarë nga puna, vërehej përfshirja *jo e plotë e ngjarjeve vitale* (lindjeve dhe vdekjeve), që në statistikën demografike njihet si *nënregjistrim* i këtyre ngjarjeve. Nënregjistrimi lidhet pikërisht me shkëputjen e shqiptarëve nga institucionet e shoqërisë së deriatëhershme serbo-jugosllave dhe formimin e institucioneve të tyre (mbajtja e Referendumit për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur në shtator të vitit 1991 dhe mbajtja e zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në maj të vitit 1992). Mund të vlerësohet se në fillim të viteve të 90-ta mospërfshirja mund të arrinte për lindjet rreth 20%, ndërsa për vdekjet rreth 25%, para së gjithash për shkak të mosevidencimit të foshnjave të vdekura. Faktin e nënregjistrimit të ngjarjeve vitale, veçanërisht të natalitetit dhe të mortalitetit të foshnjave, e pranonin edhe vetë autorët dhe institucionet statistikore e shkencore serbe.[58]

Para kësaj, një thyerje tjetër demografike në Kosovë, por dukshëm më e vogël, që mund të cilësohet si një çrregullim i rrjedhës normale të indikatorëve bazë demografikë, ndodhi në vitet e 50-ta dhe pikërisht midis viteve 1954 dhe

---

[58] Shih: G. Penev, S. Pavkov, E. Jovanović, "Naselja u Srbiji sa negativnim ili nultim prirodnim priraštajem u 1991. godini", *Stanovništvo*, br. 1-4/1992 - 1-2/1993, CDI, IDN, Beograd 1993, f. 227; G. Penev, "Područja Srbije bez prirodnog priraštaja stanovništva. Analiza po naseljima za 1991. godinu", *Demografske sveske,* CDI, IDN, br. 24, Beograd, 1995, f. 30.

Për *nënregjistrimin e ngjarjeve vitale* në Kosovë, këta autorë, si shembull karakteristik përmendin komunën e Skenderajt, e cila në vitin 1991 kishte shkallë të natalitetit 8,8 promilë (më 1990 20,5 promilë) dhe shkallë të mortalitetit 1,4 promilë, ndërsa në vitin 1986 në këtë komunë shkalla e natalitetit ishte 33,4 dhe e mortalitetit 5,4 promilë. Një rënie kaq e madhe, sado që të ishte masiv emigrimi i të rinjve, nuk është e mundur.

Ka edhe vlerësime se nënregjistrimi i komponentëve vitalë te shqiptarët në të gjitha territoret e ish-Jugosllavisë vërehej qysh nga fundi i viteve të 80-ta dhe fillimi i viteve të 90-ta të shekullit të kaluar (Shih: *Stanovništvo*, br. 1-4/1992 - 1-2/1993, CDI, IDN, Beograd, f. 185).

1958, që përputhet me shpërnguljen masive të shqiptarëve në Turqi, të përcjellë me aksionin e mbledhjes së armëve, me torturat e egra policore dhe mbi këtë bazë të krijimit të një gjendjeje depresive. Në këto vite në Kosovë është shënuar një rënie e madhe e numrit të lindjeve dhe e shtimit natyror, ku pika maksimale arrihet në vitin 1957: shkalla e natalitetit zvogëlohet nga 46,4 promilë më 1954 në 39,1 promil më 1957, e shtimit natyror nga 30,5 në 21,6 promilë. Çrregullimi më i madh, natyrisht, do të ketë ndodhur te shqiptarët kur shkalla e natalitetit midis këtyre viteve u zvogëlua nga 50,3 në 41,4 promilë dhe e shtimit natyror nga 30,9 në 20,7 promilë (tabela 16). Ndonëse numri i martesave joformale në Kosovë, të njohura si martesa "të egra", sikundër edhe i shkurorëzimeve, siç dihet është i madh, sidomos deri në vitet e 70-ta, të cilat edhe nuk janë evidencuar në shërbimet e gjendjes civile, megjithatë edhe fluktuimi i kësaj karakteristike është indikator i rëndësishëm që flet për një rrjedhë jonormale demografike, të shkaktuar nga emigrimi masiv në Turqi: numri i martesave bie nga 7.390 më 1954 në 5.860 më 1957 (tabela 5). Ndonëse në këto vite thyerja është evidente, megjithatë, duke pasur parasysh rritjen e numrit absolut dhe relativ të lindjeve dhe të shtimit natyror në vitin 1958, sikundër edhe të martesave, pastaj përsëri fluktuimin (rënie e rritje) e tyre, mund të konkludohet se në këtë ecuri të indikatorëve themelorë demografikë kanë ndikuar edhe dobësitë në evidencimin e tyre.

Me gjithë këto çrregullime demografike, të shkaktuara nga faktorët e përmendur, popullsia e Kosovës në pesëdhjetëvjetëshat e fundit ka shënuar rritje, me fluktuime të mëdha ose të vogla.[59] Në periudhën 1948-1991, sipas regjistrimeve të popullsisë (për vitin 1991 vlerësimi) numri i popullsisë së Kosovës u rrit nga 733.034 në 2.018.500 banorë ose për 1.285.466 banorë apo për 175,0% dhe rritja mesatare vjetore në tërë këtë periudhë nuk ka rënë nën 20 promilë. Në periudhën 1981-1991 numri i popullsisë së Kosovës u shtua për 434.060 banorë apo për 27,3%. Mirëpo, është fakt se në të gjitha periudhat midis regjistrimeve të popullsisë rritja e numrit të përgjithshëm është më e vogël se shuma e shtimit natyror, që do të thotë se emigirimi ka gëlltitur një shumë të konsiderueshme të këtij shtimi dhe saldoja migruese ka qenë negative. Për këtë bëhet fjalë më vonë te dinamika e shtimit natyror dhe e rritjes së përgjithshme të popullsisë.

[59] Për tempon e rritjes së popullsisë së Kosovës deri në vitin 1981 shih: H. Islami, "La croissance démographique du Kosovo (Yougoslavie)", *Population,* No 4-5, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1979, pp. 915-919. Ndërsa, për rritjen dhe shtrirjen e popullsisë shqiptare në ish-Jugosllavi deri në këtë vit shih: H. Islami, "La population albanaise de Yougoslavie: accroissement numérique et répartition spatiale", *Population,* No 1, INED, Paris, 1983, pp. 166-173.

3.2.3. Femra dhe roli i saj në ndryshimin e regjimit të riprodhimit

Duke vështruar procesin e riprodhimit të popullsisë, ndryshimet në nivelin e tij dhe rolin e femrës në të, duhet theksuar dy fakte shumë të rëndësishme. Së pari, popullsia femërore gati çdokund, në rrethanat e zhvillimit të popullsisë pa çrregullime, përbën gjysmën e popullatës dhe gjysmën e shoqërisë e të kombit, dhe së dyti, femra është jo vetëm aktori kryesor në procesin e përtëritjes njerëzore, por mban edhe barrën kryesore në ngritjen dhe edukimin e fëmijëve. Në jetën e bashkësisë njerëzore, pos rolit që ka femra në zhvillimin e përgjithshëm të saj, natyra ia ka përcaktuar edhe një rol tjetër të madh, por të vështirë dhe me përgjegjësi - përtëritjen e gjinisë njerëzore. Prandaj, rol dominant në ndryshimin e regjimit të riprodhimit biologjik ka përfshirja e femrës në të gjitha sferat e jetës materiale dhe shoqërore, pastaj përmirësimi i pozitës së gjithmbarshme të saj në familje dhe shoqëri, mbrojtja shëndetësore e nënave dhe e fëmijëve, zvogëlimi i mortalitetit të foshnjave etj.

Rezultatet e deritanishme të kërkimeve sociologjiko-demografike si në rrafshin teorik, ashtu edhe në atë empirik në mënyrë të posaçme kanë treguar se aktiviteti ekonomik dhe arsimimi janë faktorë kryesorë, të cilët, përmes ndikimit në transformimin e jetës familjare dhe shoqërore, të institucioneve e të normave sociale, ndikojnë në rënien e natalitetit e të fertilitetit. Aktiviteti ekonomik, punësimi, orientimi në jetën profesionale dhe arsimimi i femrës krijojnë qëndrime krejtësisht të tjera ndaj funksionit të kohës së punës dhe funksionit të kohës së lirë, duke e reduktuar dukshëm funksionin e saj biologjik. Pikërisht këta faktorë të zhvillimit dhe modernizimit kanë ndikuar që edhe femrat e Kosovës ta përfundojnë periudhën e tyre riprodhuese më herët. Nga të dhënat (tabela 9) vërehet qartë rënia e fertilitetit në periudhën dyzetvjeçare (1950-1990) dhe atë në të gjitha kohortat, me një intensitet mjaft të shpejtuar nga fundi i periudhës prokreative. P. sh. kohorta e grave 45-49 vjet në vitin 1990 kishte lindur afër 16 herë më pak fëmijë se sa grupi i moshës së njëjtë në vitin 1950, ose rreth 40 herë më pak në vitin 1996 në raport me vitin 1950. Rënia e fertilitetit, nën ndikimin e transformimit socioekonomik dhe arsimor, është e konsiderueshme edhe te kohortat e reja të femrave kosovare. Te femrat më të reja se 40 e 35 vjet (brezat e lindur pas vitit 1950 dhe 1955) vërehet një rënie e madhe e fertilitetit, që tregon procesin e transicionit të shpejtuar demografik në sferën e lindshmërisë. Procesi i rënies së lindshmërisë te të gjitha grup-moshat është më intensiv pas viteve të 70-ta, kur fillon të rritet edhe mosha mesatare e nënës me rastin e lindjes së fëmijës së parë, që do të bëhet tashmë veçori e lindshmërisë së popullsisë së Kosovës, veçanërisht te femrat e shkolluara, të punësuara dhe te ato që jetojnë në vendbanime urbane.

Tabela 9. Normat specifike[60] të fertilitetit të popullsisë femërore në Kosovë, sipas moshës, në periudhën 1950-2000[61]

Mosha	Numri i fëmijëve të lindur gjallë në 1000 femra sipas moshës						
	1950	1960	1970	1980	1990	1996	2000
15-19	46,1	78,4	58,2	50,8	36,2	25,9	22,2
20-24	329,9	288,8	270,0	239,7	192,7	143,2	125,1
25-29	343,7	330,0	287,6	265,9	228,2	168,6	144,7
30-34	348,5	267,6	218,8	209,8	154,2	108,2	90,0
35-39	250,8	195,3	158,9	136,4	78,6	49,5	41,2
40-44	156,3	132,4	70,3	51,0	24,8	14,3	9,9
45-49	66,9	42,1	16,4	10,0	4,2	1,7	2,6
Gjithsej 15-49	214,4	205,5	165,4	150,1	116,9	85,9	73,2

Femra ekonomikisht e varur dhe e paarsimuar i ka gjithnjë mundësitë e kufizuara për t'i shprehur aspiratat personale dhe nevojat jetësore jashtë familjes si bërthamë themelore e procesit të lindjes dhe riprodhimit. Nëpërmjet angazhimit në procesin e punës, i cili objektivisht kërkon edhe nivel përkatës të arsimit profesional dhe atij të përgjithshëm, femra ka mundësi që t'i shfaqë dëshirat, aspiratat, nevojat, qëllimet dhe interesat e tjera jetësore jashtë suazave familjare dhe lokale. Në këtë mënyrë, ajo bëhet mobile në hapësirë dhe në shkallën shoqërore dhe ndaj martesës, kohës së hyrjes në të dhe ndaj familjes, lindjes së fëmijëve dhe intervalit kohor midis lindjeve, si dhe ndaj jetës dhe vdekjes formon vetëdije dhe qëndrime krejtësisht të tjera. Mbi këtë bazë krijohen edhe supozimet objektive për motivacione dhe vetëdije të re për planifikimin e madhësisë së familjes, përqafimit të kontrollit të lindjes në martesa si "stil" të jetës dhe për natalitet të ulët dhe familje të vogël. Nën ndikimin e këtyre proceseve, edhe femrat kosovare jo vetëm që e përfundojnë më herët periudhën e tyre riprodhuese, por edhe më vonë hynë në martesë. P.sh. mosha e hyrjes së tyre në martesë në vitet 2002-2003 ishte rreth 26 vjet (meshkujt rreth 29 vjet).[62] Në këtë mënyrë reduktohet periudha e përtëritjes biologjike dhe natyrisht zvogëlohen mundësitë për numër më të madh të lindjeve.

[60] Norma specifike e fertilitetit të popullsisë sipas moshës paraqet raportin e numrit të fëmijëve të lindur gjallë që e kanë lindur nënat e moshës së caktuar dhe numrit të të gjitha grave të moshës përkatëse.

[61] Burimi*: Demografska statistika* (vitet përkatëse), Savezni zavod za statistiku, Beograd; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku***,** br. 052, Beograd, 24.02.1998, f.14; *Demografska statistika 2000*, SZS, Beograd, 2002, ff. 97-99.

[62] *Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003,* ESK, Prishtinë, 2004, f. 14.

Tabela 10. Norma neto e riprodhimit të popullsisë femërore në Kosovë dhe në disa ish-njësi federale të ish-Jugosllavisë në periudhën 1950-2000[63]

	Ish-Jug.	B e H	Sllovenia	Serbia	Vojvodina	Kosova
1950	1,54	1,93	1,36	1,44	1,31	2,28
1960	1,19	1,63	1,00	0,92	0,96	2,40
1970	0,98	1,12	1,00	0,82	0,75	2,02
1980	0,96	0,86	1,00	0,86	0,86	2,04
1990	0,88	0,81	0,76	0,82	0,81	1,59
1995	-	-	-	0,78	0,82	1,20
1996	-	-	-	0,75	0,75	1,21
2000	-	-	-	0,68	0,69	1,00

3.2.4. Fertiliteti sipas radhës së lindjes, moshës së nënës, përgatitjes shkollore dhe profesionit

Nga numri i të lindurve gjallë sipas radhës së lindjes shihet se midis Kosovës (numri i përgjithshëm i lindjeve më 1990 është 55.175) dhe Shqipërisë (67.567 lindje më 1989) nuk ka dallime, ndërsa në raport me Sllovenine (22.368 lindje më 1990), si vend i zhvilluar, dallimet janë të mëdha. Vërehet se përqindja e femrave që kanë lindur nga një dhe dy fëmijë është rritur te popullata e të tri vendeve, ndërsa pjesëmarrja e femrave që kanë lindur 3-4 fëmijë në Kosovë ka stagnuar (rreth 29,0%), kurse në Shqipëri dhe Sllloveni ka shënuar rënie të konsiderueshme, sikundër që hetohet tendenca e rënies së madhe te radhët e tjera të lindjes, me 5 e më shumë fëmijë. Por edhe në Kosovë numri i femrave që kanë lindur mbi 5 fëmijë pothuajse është përgjysmuar, përkatësisht ka rënë nga 28,9% më 1958 në 16,4% më 1990 (tabela 11), gjë që tregon se me ngritjen e nivelit kulturo-arsimor dhe emancipimit social të gruas është zgjeruar vetëdija mbi fertilitetin e ulët dhe planifikimin e familjes.

[63] *Demografska statistika 1990,* Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1992, f. 53; D. Breznik, *Stanovništvo Jugoslavije,* Chronos, Titograd, 1991, f. 62; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku,* br. 024, Beograd, 30.1.1997, f. 17; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku,* br. 052, Beograd, 24.2.1998, f. 16; *Demografska statistika 2000*, SZS, Beograd, 2002, f. 101.

Tabela 11. Të lindurit gjallë sipas radhës së lindjes[64] në Kosovë, në Shqipëri dhe në Slloveni në vitet përkatëse[65]

Radha e lindjes së fëmijëve	Kosova		Shqipëria		Sllovenia	
	1958	1990	1960	1989	1958	1990
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
1	21,1	29,8	19,9	35,7	38,1	47,8
2	20,4	23,4	19,5	28,9	26,2	39,4
3-4	29,4	28,8	31,2	24,7	22,2	11,8
5-6	17,0	10,7	18,3	7,0	8,0	0,8
7 +	11,9	5,7	10,0	3,4	6,4	0,1
Të panjohur	0,1	1,9	1,1	0,3	0,1	-

Tabela 12. Të lindurit gjallë sipas moshës së nënës dhe radhës së lindjes në vitin 1995[66]

Mosha e nënës	Radha e lindjes së fëmijëve						
	Gjithsej	1	2	3	4	5	6 e më tepër
Gjithsej	44.776 100,0	15.742 35,1	11.556 25,1	8.252 18,3	4.646 10,2	2.298 5,0	2.282 5,8
Nën 15 vjet	1 100,0	1 100,0	- -	- -	- -	- -	- -
15 – 19	2.908 100,0	2.345 80,6	502 17,3	52 1,8	9 0,3	- -	- -
20 – 24	14.401 100,0	7.531 52,6	4.725 32,8	1.682 11,7	373 2,3	79 0,5	11 0,0
25 – 29	14.705 100,0	3.830 26,0	4.409 30,3	3.699 25,1	1.857 12,6	652 4,4	258 2,4

[64] Të lindurit gjallë sipas radhës së lindjes nënkupton të gjithë fëmijët e lindur gjallë nga e njëjta nënë (UN, *Višejezički demografski rečnik - srpskohrvatska verzija,* CDI, IDN, Beograd, 1971, f. 63 (pika 611).

[65] Burimi: *Demografska statistika 1988,* SZS, Beograd, 1990, ff. 145-146; *Demografska statistika 1990,* SZS, Beograd, 1992, ff. 145-146; *Vjetari Statistikor i RPS të Shqipërisë,* Drejtoria e Statistikës, Tiranë, 1990, f. 63.

[66] Burimi: *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, f. 153.
Është interesant se sipas statistikave vitale të Entit Statistikor të Kosovës në vitet 2002 dhe 2003 sa i përket radhës së lindjes së fëmijëve dhe grup-moshave të nënës nuk ka ndryshime në raport me vitin 1995. Gjendja gjithsej (100,0%) për vitet 2002 dhe 2003 tregon këtë pasqyrë: 38,1% dhe 37,4% e nënave kanë lindur një fëmi, 26,2% dhe 28,3% dy fëmijë, 17,7% dhe 18,4% tre fëmijë, 9,9% dhe 9,4% katër fëmijë, 4,3% dhe 3,8% pesë fëmijë dhe 3,6% dhe 2,7% gjashtë e më tepër fëmijë (*Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003,* ESK, Prishtinë, 2004, ff. 10, 57).

30 – 34	8.124 100,0	1.125 13,8	1.422 17,5	2.048 25,2	1.696 20,8	993 12,2	842 10,3
35 – 39	2.880 100,0	266 9,2	254 8,8	565 19,5	568 19,7	440 15,2	796 27,5
40 – 44	676 100,0	79 11,7	53 7,8	86 12,7	80 11,8	89 13,1	289 42,7
45 – 49	69 100,0	18 26,0	5 7,2	6 8,7	5 7,2	10 14,5	25 36,1
Mbi 50 vjet	21 100,0	8 38,0	4 19,0	2 9,5	1 4,8	1 4,8	5 23,8
Të panjohur	982 100,0	539 55,0	182 18,5	112 11,4	59 6,0	34 3,5	56 6,1

Analizat tregojnë se arsimi është determinant shumë i rëndësishëm i nivelit të fertilitetit, ndërsa me nivelin e përgatitjes shkollore dhe të arsimit në përgjithësi të popullsisë femërore lidhet edhe ndikimi i faktorëve të tjerë, sikurse janë shkalla e aktivitetit sipas veprimtarive, punësimi jashtë bujqësisë, niveli i urbanizimit, shkalla e zhvillimit kulturor të mjedisit etj. Me zgjerimin e arsimit në Kosovë, shihet se numri i femrave pa shkollë ose me shkollë jo të plotë fillore është gjithnjë e më i vogël. Prandaj edhe numri i përgjithshëm i lindjeve të gjalla dhe i të lindurve gjallë sipas radhës së lindjes te këto kategori në gjysmën e parë të viteve të 90-ta ishte tepër i ulët, ndërsa pjesa më e madhe e lindjeve i përket femrave me shkollë fillore (62,1%). Gjithashtu vërehej se te femrat me shkollë fillore ishte përqindja më e lartë e radhës së lindjes me 5 (rreth 70%) dhe 6 e më tepër fëmijë (rreth 64%), ndërsa më e ulët dhe gjithnjë në rënie te femrat me shkollë të mesme (me 5 e më shumë fëmijë rreth 18%) dhe me shkollë të lartë e fakultet (as 2% me 5 e më tepër fëmijë). E gjithë kjo tregon se shkalla e arsimit është një ndër shkaqet kryesore të zvogëlimit të numrit të lindjeve (tabela 13). Te femrat me nivel më të lartë të arsimit, siç tregojnë edhe disa hulumtime të kufizuara anketuese, është edhe mosha mesatare me rastin e mbarësimit të parë, si dhe lindjes së parë; te femrat me shkollë të mesme dhe arsim superior kjo moshë është tashmë mbi 25 vjet.[67]

Sa i përket përgatitjes shkollore, në të gjitha grup-moshat në gjysmën e viteve të 90-ta të shekullit të kaluar dominonte numri i lindjeve te femrat me shkollë fillore, për arsye që i zumë në gojë më lart, me një zvogëlim të hetueshëm te femrat e moshës mbi 35 e 40 vjet për shkak të përqindjes së lartë të kategorisë së femrave pa përgatitje shkollore dhe me shkollë jo të plotë

[67] Shih rezultatet e një hulumtimi anketues, të realizuar nga demografët e Qendrës për Hulumtime Demografike të Institutit të Shkencave Shoqërore të Beogradit: *Žena i radjanje na Kosovu i Metohiji,* CDI, IDN, Beograd, 1998, f. 116 e tutje.

fillore. Po kështu, në grup-moshat mbi 30 vjet vërehet rënie e numrit të lindjeve te femrat me shkollë të mesme dhe me shkollë të lartë e fakultet. Në vitin 1990, te femrat e këtyre dy kategorive të përgatitjes shkollore të moshës mbi 50 vjet nuk ishte shënuar asnjë lindje, ndërkaq në vitin 1995, te femrat me përgatitje superiore shkollore të moshës madje mbi 45 vjet nuk ishte shënuar gjithashtu asnjë lindje, por edhe te gratë me shkollë të mesme numri absolut i lindjeve mbi këtë moshë ishte simbolik, gjithsej 2 raste (tabela 14).

Tabela 13. Të lindurit gjallë sipas radhës së lindjes dhe përgatitjes shkollore në Kosovë në vitin 1995[68]

Radha e lindjes	Gjithsej	Përgatitja shkollore					
		Pa përgatitje shkollore	Shkolla jo e plotë fillore	Shkolla fillore	Shkolla e mesme	Shkolla e lartë dhe fakulteti	Të pa-njohur
Gjithsej	44.776 100,0	1.783 4,0	3.172 7,1	27.849 62,1	10.350 23,1	1.333 3,0	289 0,7
1	15.742 100,0	485 3,1	489 6,2	9.598 61,1	4.042 25,9	487 3,2	241 1,5
2	11.559 100,0	367 3,2	700 6,0	6.932 60,0	3.106 26,9	427 3,7	24 0,2
3	8.252 100,0	294 3,6	539 6,5	5.147 62,4	1.977 24,0	285 3,4	10 0,1
4	4.646 100,0	235 5,0	413 8,9	3.121 67,2	767 16,6	102 2,2	8 0,1
5	2.298 100,0	153 6,7	2,72 11,8	1.592 69,3	257 11,2	22 1,0	2 0,0
6 e më tepër	2.282 100,00	249 11,0	399 17,5	1.459 63,9	161 7,0	10 0,4	4 0,1

Edhe në vitin 2003 vërehet e njëjta gjendje: dominojnë lindjet te femrat me shkollë fillore (60,0%), pastaj me shkollë të mesme (24,1%) dhe kategoria pa shkollë dhe me shkollë jo të plotë fillore (6,3%), ndërsa 3,6% e lindjeve i përket femrave me përgatitje superiore shkollore.[69]

[68] Burimi: *Demografska statistika 1995*, SZS, Beograd, 1998, f. 160.
[69] Burimi: *Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003,* ESK, Prishtinë, 2004, f. 66.

Tabela 14. Të lindurit gjallë sipas moshës së nënës dhe përgatitjes shkollore në Kosovë në vitin 1995[70]

Mosha e nënës	Gjithsej	Përgatitja shkollore					
		Pa përgatitje shkollore	Shkolla jo e plotë fillore	Shkolla fillore	Shkolla e mesme	Shkolla e lartë dhe fakulteti	Të panjohur
Nën 15 vjet	1 100,0	1 100,0	- -	- -	- -	- -	- -
15-19	2.908 100,0	168 5,8	233 8,0	1.981 68,2	504 17,3	1 0,0	21 0,7
20-24	14.401 100,0	462 3,2	846 6,0	9.379 65,1	3.472 24,1	153 1,0	89 0,6
25-29	14.705 100,0	409 2,8	866 5,9	9.390 63,9	3.496 23,8	462 3,1	82 0,5
30-34	8.124 100,0	364 4,5	676 8,3	4.704 58,0	1.878 23,0	461 5,7	41 0,5
35-39	2.889 100,0	176 6,0	336 11,6	1.517 52,6	653 22,7	195 6,7	12 0,4
40-44	676 100,0	676 10,9	124 18,2	341 50,0	101 15,0	37 5,5	6 0,9
45-49	69 100,0	12 17,4	8 11,6	41 59,4	8 11,6	- -	- -
Mbi 50 vjet	21 100,0	4 19,3	1 4,7	14 66,6	2 9,4	- -	- -
Të pa-njohur	982 100,0	120 12,2	82 8,4	482 49,0	236 24,0	24 2,4	38 4,0

Studimi i të dhënave të regjistrimit të vitit 1981 edhe në shembullin e popullatës së Kosovës dëshmoi se nataliteti është çështje e shtresëzimeve sociale*:* një femër kosovare aktive në jetën ekonomike lindi 3,07 fëmijë, ndërsa ajo e mbajtur 5,49 fëmijë; femra e mbajtur në bujqësi lindi 6,74 fëmijë, kurse femra aktive në profesionet jobujqësore 2,74 fëmijë; femra analfabete dhe pa përgatitje shkollore lindi 7,04 fëmijë, me shkollë të mesme 2,24 dhe me arsim superior 2,18 fëmijë.[71] Gjithashtu, edhe disa të dhëna të statistikës vijuese demografike, që përmbajnë treguesit themelorë vitalë, e dëshmojnë këtë gjendje. Sipas tyre, në Kosovë, në vitin 1995, 89,5% e grave që ushtronin ndonjë profesion kishin lindur 1-3 fëmijë, 7,3% 4 fëmijë dhe vetëm rreth 3,0% të tyre mbi 5 fëmijë; 32,8% e tyre kishte lindur madje vetëm një fëmijë. Numër më të vogël të fëmijëve kanë lindur gratë e profesioneve jobujqësore,

[70] Burimi: *Demografska statistika 1995***,** SZS, Beograd, 1998*,* f. 160.

[71] G. Todorović, "Dejstvo aktivnosti i obrazovanja žene na njeno radjanje i stav o njemu na području SR Srbije", *Stanovništvo,* nr. 1, CDI, IDN, Beograd 1984/85, f. 58.

mbi 70,0% e tyre 1-2 fëmijë. Përqindje më të lartë me 1-2 fëmijë kishin gratë në vende udhëheqëse (mbi 95%), pastaj në administratë, drejtorate e profesione të ngjashme dhe femrat eksperte dhe artiste (mbi 70%). Femrat e mbajtura (amviset), që përbëjnë pjesën dërmuese të numrit të përgjithshëm të lindjeve në Kosovë (në vitin 1995 40.290 ose 90,0%) kanë lindur numër më të madh të fëmijëve: 21,9% mbi 4 fëmijë dhe 10,9% e tyre mbi 5 fëmijë, 1-3 fëmijë kanë lindur 78,0% dhe 1-2 fëmijë 59,5% e tyre, ndërsa 29,8% të femrave të mbajtura në bujqësi kanë lindur mbi 4 fëmijë dhe 16,4% e tyre mbi 5 fëmijë.[72] Kontingjente të konsiderueshme të brezave të sotme të grave të shkolluara dhe ekonomikisht aktive, që ende gjenden në periudhën e riprodhimit ose e kanë kaluar tashmë atë, e që kanë mesatarisht nga 2-3 fëmijë, sapo janë ndarë nga analfabetizmi i prindërve të tyre dhe nga bujqësia si profesion dhe mënyrë e jetës, që është dëshmi e thyerjes së shpejtë të procesit të lindshmërisë në prizmin e stratifikimit shoqëror.

Në vitin 1990, dallimet midis popullsisë femërore aktive dhe popullsisë femërore të mbajtur ishin të konsiderueshme, ku numri i femrave aktive në jetën ekonomike (sidomos numri absolut) me 5 e më shumë fëmijë ishte shumëfish më i vogël se te femrat e mbajtura. Ndërsa në kuadër të popullsisë aktive femërore vëreheshin gjithashtu dallime të mëdha midis grupeve profesionale, mirëpo veçori e përbashkët e të gjitha këtyre grupeve ishte se dominonte numri i femrave me një dhe dy fëmijë, ndërsa ishte shumë e vogël përqindja me 5 e më tepër fëmijë. Te femrat në vende udhëheqëse madje përqindja me 1-2 fëmijë arrinte në 80%, te femrat në administratë, drejtorate e profesione të ngjashme dhe te femrat eksperte dhe artiste mbi 65%, ndërsa te të gjitha profesionet e tjera përqindja e femrave që kishin lindur 1 dhe 2 fëmijë ishte mbi 60%, përveç femrave aktive në bujqësi e profesione të ngjashme, ku kjo përqindje sillej rreth 50% (tabela 15).

[72] *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, ff. 163, 189.

Tabela 15. Të lindurit gjallë sipas profesionit të nënës dhe radhës së lindjes së fëmijëve në Kosovë në vitin 1990[73]

	Radha e lindjes					
Profesioni i nënës	Gjithsej	1	2	3-4	5-6	Mbi 7 fëmijë
Gjithsej	100,0 55.175	29,8 16.394	23,4 12.930	28,8 15.860	10,8 5.936	5,7 3.167
Persona aktivë	100,0 7.750	34,3 2.665	26,6 2.071	26,4 2.050	4,6 359	1,4 113
Bujq e të ngjashëm	100,0	28,0	20,4	29,6	14,5	7,2
Xeh. punëtorë industr. e të ngjashëm	100,0	33,9	27,9	28,6	6,7	1,5
Punëtorë në tregti	100,0	28,6	33,0	32,9	5,4	0,1
Punëtorë në shërbime	100,0	40,0	23,1	26,9	6,9	3,1
Punëtorë në drejtorate, administratë e të ngjashëm	100,0	31,4	34,7	31,1	2,3	0,1
Punëtorë udhëheqës	100,0	33,3	50,0	16,7	-	-
Ekspertë dhe artistë	100,0	35,2	31,9	28,3	3,1	1,2
Punëtorë pa profesione	100,0	36,2	22,0	22,5	3,6	0,8
Punëtorë të mbajtur	100,0 47,425	28,9 13.727	23,1 10.859	29,2 13.808	11,8 5.576	7,1 3.054

Vërejtje: deri "gjithsej" (100,0%) e përbëjnë të panjohurit, ndërsa te kategoritë "gjithsej", "persona aktivë" dhe "persona të mbajtur" janë shënuar edhe numrat absolutë.

3.2.5. Niveli dhe lëvizja e natalitetit dhe fertilitetit sipas kombësisë

Analizat dhe studimet e shumta demografike dhe sociologjike të institucioneve shkencore të ish-Jugosllavisë si bashkësi multietnike treguan se dallimet në nivelin e natalitetit e të fertilitetit midis pjesëtarëve

[73] Burimi: *Demografska statistika 1990,* SZS, Beograd, 1992, f. 130.

të nacionalitetit dhe konfesionalitetit të njëjtë ekzistonin nëse ata jetonin në territore me shkallë të ndryshme të zhvillimit shoqëroro-ekonomik dhe kishin pozitë jo të njëjtë në shkallën socio-profesionale dhe arsimore. Përkatësia kombëtare e fetare këtu paraqiste vetëm një nga veçoritë sociale dhe në asnjë rast nuk kishte rëndësi relevante në nivelin e pjellorisë.[74] Përkatësia etnike e konfesionale përputhej me ndikimin e përkatësisë sipas grupeve socioekonomike, profesionale, arsimore dhe pavarësisë materiale të femrës etj.[75] Por, edhe në qoftë se mund të thuhet se disa determinante të lindshmërisë, në këtë apo në atë masë, janë të lidhura me përkatësinë etnike, siç janë p.sh. zakonet, qëndrimi ndaj fëmijëve dhe madhësisë së familjes, roli dhe vendi i femrës në familje dhe shoqëri, mosha e hyrjes në martesë, ndikimi i konfesionit, vlerësimi i situatave jetësore etj., megjithatë, edhe këto "nuk janë veçori etnike të dhëna njëherë e përgjithmonë, por janë dukuri shoqërore që kanë traditë shekullore dhe në këtë kohëzgjatje historike marrin formën e ligjësive shoqërore deri në momentin kur pikëpamja tradicionale nuk ndeshet me kushtet e ndryshuara materiale të jetës. Ndeshja e mënyrës tradicionale të jetës, e pikëpamjeve dhe e kushteve të ndryshuara materiale është në vazhdë, por ajo nuk i ka përfshirë me intensitet të njëjtë të gjitha rajonet, të gjitha grupet etnike, të gjitha brezat".[76]

---

[74] I. Ginić, "Sastav stanovništva Jugoslavije po nacionalnosti", në studimin *Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti*, CDI, IDN, Beograd, 1978, ff. 96-97.

[75] Shih më gjerë: M. Rašević, *Determinante fertiliteta stanovništva u Jugoslaviji*, Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1971, f. 134 e tutje; Grup autorësh, *Fertilitet stanovništva u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd, 1971, f. 93 e tutje; Z. Grebo, *Čovjek, radjanje, društvo*, Svjetlost, Sarajevo, 1975, ff. 216-226.

[76] K. Miljovski, "Bitnije demografske izmene i elementi populacione politike", *Ekonomska misao*, br. 3, Beograd, 1974, f. 46.
"Rrethi magjik i mjerimit dhe i mosdijës mund të thyhet vetëm nga jashtë, me ndryshimin e mënyrës së ekonomizimit (e cila do ta nxjerrë gruan nga mbyllja në rrethin e ngushtë të ekonomisë shtëpiake dhe do ta shndërrojë në molekulë të klasës punëtore) dhe me arsimin e detyrueshëm minimal tetëklasësh që do të zbatohet" (K. Miljovski, *Po aty*).

Tabela 16. Niveli dhe lëvizja e natalitetit dhe e shtimit natyror te popullsia shqiptare, serbe dhe malazeze në Kosovë prej 1950-1990 (në promilë)[77]

	Nataliteti			Shtimi natyror		
Viti	Shqiptarë	Serbë	Malazezë	Shqiptarë	Serbë	Malazezë
1950	51,2	45,8	37,8	30,2	34,1	28,8
1951	41,4	36,8	30,5	18,1	23,9	20,6
1952	49,4	43,8	36,3	28,0	31,9	27,2
1953	46,0	40,7	37,3	20,9	26,9	26,6
1954	50,3	44,2	40,5	30,9	33,6	32,3
1955	36,8	38,2	36,8	25,9	24,8	26,8
1956	46,9	38,3	36,8	28,6	26,6	28,1
1957	41,5	33,8	32,5	20,7	22,5	23,2
1958	47,6	34,8	35,0	32,7	26,0	27,6
1959	43,4	33,2	33,9	27,4	23,3	25,4
1960	48,1	33,1	36,0	31,7	23,8	26,6
1961	46,2	31,4	35,4	32,1	22,8	28,3
1962	46,6	29,9	33,4	28,8	19,7	24,9
1963	46,1	27,3	32,6	31,9	19,5	25,0
1964	46,2	26,8	28,9	31,8	19,4	22,4
1965	45,8	26,9	28,9	31,5	19,5	22,4
1966	43,3	25,7	27,5	29,7	18,7	21,3
1967	43,5	26,1	27,9	29,9	19,0	21.6
1968	45,3	19,8	16,5	35,0	12,5	10,5
1969	45,5	20,0	17,0	35,2	12,8	10,8
1970	42,1	18,9	16,1	32,6	12,1	10,3
1971	42,5	22,4	19,6	33,8	15,6	12,2
1972	42,2	21,5	16,2	33,9	14,2	10,4
1973	40,5	21,2	14,7	32,4	14,7	7,9
1974	41,3	20,7	11,2	33,5	14,5	5,1
1975	39,6	20,1	10,2	32,1	13,8	4,0
1976	40,2	19,6	11,5	32,9	13,4	5,8
1977	37,9	18,3	10,5	31,1	12,4	4,0
1978	36,3	17,4	7,4	29,6	11,6	2,6
1979	34,9	15,8	8,1	28,7	9,8	3,3
1980	37,5	16,5	6,3	31,9	11,2	2,6
1981	33,9	17,5	4,3	27,6	10,6	-0,3

[77] Burimi: *Vitalna statistika* dhe *Demografska statistika*, SZS, Beograd (vite të ndryshme); *Prirodno kretanje stanovništva prema nacionalnom sastavu u periodu 1980-1990*, SZS, Beograd, 1992; B. Krstić, *Kosovo izmedju istorijskog i etničkog prava*, Beograd, 1994, f. 298.

1982	35,9	19,6	6,5	29,6	11,6	0,0
1983	32,7	17,6	7,1	26,1	10,2	0,3
1984	35,4	18,8	8,5	29,4	11,6	2,7
1986	33,4	16,5	6,6	27,9	9,3	0,3
1987	33,7	16,4	7,6	28,3	9,3	2,5
1988	33,0	15,4	8,7	27,7	8,2	2,2
1989	30,6	14,3	7,2	25,6	7,0	2,2
1990	30,5	15,1	8,8	26,8	8,9	4,9

Në gjysmën e dytë të shekullit XX, p. sh., të gjitha nacionalitetet në ish-Jugosllavi kishin fertilitet shumë më të lartë në territoret e pazhvilluara: serbët në Kosovë dhe BeH, malazezët në Mal të Zi (deri vonë edhe në Kosovë), boshnjakët në rajonin e Sanxhakut dhe në BeH, kroatët në BeH dhe në Kosovë dhe shqiptarët në të gjitha rajonet e ish-Jugosllavisë, me disa dallime të vogla. P. sh. raporti i numrit mesatar të fëmijëve të lindur gjallë te femrat serbe në vitin 1961 ishte: në Kosovë 4,2 dhe në BeH 3,5 fëmijë, ndërsa në Serbi 2,3 dhe në Slloveni 1,8 fëmijë; te femrat kroate në Kosovë 4,6 dhe në BeH 3,2, në Kroaci 2,2 dhe në Slloveni 2,1 fëmijë; te femrat shqiptare në territoret e pazhvilluara ky numër sillej prej 5,5 (Kosova) e deri në 5,0 (Mali i Zi) fëmijë, ndërsa në rajonet e zhvilluara, si p. sh. në Kroaci ky numër arrinte në 3,9 fëmijë.[78]

Në vitin 1981 dallimet do të bëhen edhe më të dukshme si midis nacionaliteteve të ndryshme, por në rajone me nivel jo të njëjtë të zhvillimit, ashtu edhe midis nacionalitetit të njëjtë, po në territore me shkallë të ndryshme të zhvillimit. Në këtë vit p. sh. femrat serbe periudhën e përtëritjes biologjike e kishin përfunduar me lindjen e këtij numri të fëmijëve: në Kosovë 3,42, në BeH 2,81, në Kroaci 2,02, në Vojvodinë 1,87, në Serbi 1,85 dhe në Slloveni 1,65 fëmijë; femrat malaziase kishin lindur gjithsej: në Kosovë 3,16, në Mal të Zi 2,98, në Maqedoni 2,59, në Serbi 2,12 në BeH 2,05, në Slloveni 1,98, në Vojvodinë 1,99 dhe më së paku në Kroaci, 1,84 fëmijë. Sipas regjistrimit të vitit 1981, në Kosovë një numër relativisht i madh i femrave të të gjitha nacionaliteteve, të cilat pas Luftës II Botërore kishin hyrë në periudhën e riprodhimit biologjik, kishte lindur mbi 5 e 6 fëmijë: më se 15.000 femra serbe ose rreth 20% e tyre kishin lindur 5 e më tepër fëmijë, prej të cilave më se 10.000 sish (13%) kishin lindur madje mbi 6 fëmijë; mbi 5 fëmijë kishin lindur rreth 18% e femrave malaziase, rreth 33% e femrave boshnjake, rreth 34% e atyre kroate dhe rreth 32% e femrave turke.[79] Femrat shqiptare, të cilat e kishin

[78] M. Rašević, *Po aty,* f. 135.

[79] *Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 1981 (Žene stare 15 i više godina prema vitalnim, etničkim, obrazovnim i ekonomskim obeležjima u SAP Kosovu), Bilten 47,* Pokrajinski zavod za statistiku, Priština, 1984, f. 24.

përfunduar periudhën e riprodhimit, ndërkaq, kishin lindur në Kosovë 6,66 fëmijë, në Maqedoni 5,60, në Serbi 5,75 dhe në Mal të Zi, për shkak të shpërnguljeve të vazhdueshme të të rinjve, 4,43 fëmijë, ndërsa në Slloveni femrat tona kishin lindur 3,07, në Kroaci 3,56 dhe në BeH 4,29 fëmijë.[80] Në viset ku shqiptarët jetonin në numër të madh dhe kishin shtrirje territorialisht homogjene në ish-Jugosllavi dallimet në komponentët e lëvizjes natyrore dhe në zhvillimin demografik në përgjithësi midis shqiptarëve nuk ishin shumë të mëdha.[81] Ndërsa dallimet në numrin e fëmijëve të lindur gjallë midis grave serbe në Kosovë dhe grave serbe në Serbi ishin të konsiderueshme në gjithë pjesën e dytë të shekullit të kaluar. Në vitin 1991 p. sh. norma e fertilitetit të përgjithshëm te gratë serbe të moshës 45-49 vjet në Kosovë ishte 2,8, ndërsa në Serbi 1,8 fëmijë.[82]

Të gjitha të dhënat dhe analizat demografike tumirin pikëpamjen se nataliteti nuk lidhet me përkatësinë etnike dhe fetare, sikundër që nuk është çështje me porosi nacionale apo nacionaliste, por është rezultat i nivelit të zhvillimit shoqëroro-ekonomik në kuptim të gjerë dhe të vetëdijes së krijuar riprodhuese mbi këtë bazë (mjedisi social).[83] Edhe te nacionalitetet që kishin dhe ende kanë shkallë të lartë të fertilitetit hetohet tendencë e qartë e zvogëlimit të numrit të të lindurve gjallë - mbi 4 e më tepër fëmijë. P. sh. në vitin 1990, në krahasim me vitin 1981, te shqiptarët pjesëmarrja me 5 e më tepër fëmijë është zvogëluar nga 38% në 18%, te serbët nga 13% në 3%, te malazezët nga 18% në 6%, te boshnjakët nga 33% në 8%, te turqit nga 32% në 10%, ndërsa në vitin 1995, gjithashtu sipas të dhënave vitale të statistikës vijuese demografike serbe, përqindja me mbi 5 fëmijë zvogëlohet edhe më shumë te të gjitha përkatësitë etnike: te shqiptarët në 11,3%, te serbët në 2,2%, te malazezët në 3,5%, te boshnjakët në 7,0%, te turqit në 5,9% dhe te romët (nga 19,5% më 1990) në 12,4%. Sa i përket pjesëmarrjes me 1-2 fëmijë, në vitin 1995 në raport me vitin 1990, rritje e konsiderueshme është shënuar te shqiptarët (62,4%:51,4%), ndërsa te të tjerët, pos romëve, kjo pjesëmarrje ka mbetur e pandryshuar (tabela 18).

Femrat shqiptare në të gjitha viset e pazhvilluara kishin lindur vërtet më shumë fëmijë se femrat e nacionaliteteve të tjera. Mirëpo, është fakt se pozita e

---

[80] *Demografski razvoj i populaciona politika SAP Kosova (interna studija),* Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1988, f. 62.

[81] M. Roux, *Les Albanais en Yougoslavie,* Editions de la Maison des sciences de l'homme, Paris, 1992, pp. 103-158.

[82] G. Penev, "Tendencije i osobine fertiliteta", në *Žena i radjanje na Kosovu i Metohiji",* CDI, IDN, Beograd, 1998, ff. 17-22.

[83] G. Desplanques et J.-C. Deville, "Fécondité et milieu social: les différences demeurent", *Économie et statistique,* No 111, INSEE, Paris, mai 1979, pp. 27-40.

tyre socioekonomike dhe kulturore ishte shumë e pavolitshme. Në vitin 1966 p. sh. norma e punësimit të saj në sektorin shoqëror në Kosovë ishte vetëm 8,2% nga numri i përgjithshëm i shqiptarëve të punësuar (femrat serbe 25,4%; femrat malazeze 31,7%), ndërsa në vitin 1988 kjo përqindje ngritet mezi në 18,4 (serbet 35,5%; malazezet 41,5%); pas përjashtimit nga puna (1990) kjo pjesëmarrje nuk mund të ishte mbi 5%. Ndërsa në territoret e tjera norma e punësimit të femrave shqiptare ishte përgjysmë më e ulët. Sipas regjistrimit të vitit 1981, femra jonë ekonomikisht ishte ende e varur, ngase vetëm 7,4% të tyre ishin aktive në jetën ekonomike, në fshat përgjysmë më pak (3,9%), sikundër edhe jo e arsimuar (mbi 26% ishin analfabete, në fshat rreth 30%, kurse te brezat mbi 35 vjet arrinte në rreth 60%).[84] Edhe sipas disa vlerësimeve për vitin 1991, përqindja e femrave aktive që kanë ushtruar ndonjë profesion në popullsinë e përgjithshme femërore nuk kalonte 12%. Të gjithë këta indikatorë tregojnë se pozita e gjithmbarshme e femrës shqiptare rrënjësisht duhet të transformohet në mënyrë që të përmirësohen para së gjithash sjellja dhe qëndrimet e saj në sferën e vendimeve në bashkësinë martesore dhe në rrjedhat e përtëritjes biologjike dhe të depërtojë më shpejt procesi i vetëdijes kritike ndaj pozitës së saj në familje dhe shoqëri.

Sipas të dhënave të statistikës demografike serbo-jugosllave, deri në vitet e 80-ta rreth gjysma e numrit të lindjeve në Kosovë realizoheshin jashtë institucioneve shëndetësore (në fillim të viteve të 50-ta madje rreth 95%) dhe po aq pa ndihmë profesionale (në fillim të viteve të 50-ta rreth 92%), ndërsa te popullata shqiptare gjendja në këta indikatorë ishte edhe më e pavolitshme se mesatarja kosovare. Në vitin 1990 kjo situatë ndryshohet dhe përqindja e lindjeve në institucionet shëndetësore rritet në rreth 74% dhe e lindjeve me ndihmë profesionale në rreth 77%. Ndërkaq, sipas të dhënave të statistikave vitale të Entit Statistikor të Kosovës, në vitin 2003 rreth 85% e lindjeve u realizuan në institucionet shëndetësore dhe rreth 15% jashtë tyre, por 11,7% me ndihmë mjekësore dhe vetëm 2,9% pa këtë ndihmë.[85]

Gjithashtu, në Kosovë përqindja e të shëruarve para vdekjes deri vonë në Kosovë nuk ishte e kënaqshme: në vitin 1950 rreth 77% kishin vdekur pa u shëruar, më 1980 rreth 38% dhe në vitin 1990 rreth 27%.[86] Ndërsa shkalla e mortalitetit të foshnjave deri në gjysmën e viteve të 60-ta ishte shumë e lartë (mbi 123 promilë), sikurse në vendet e pazhvilluara, por edhe më vonë, me gjithë rënien, mbetet në nivel të lartë, me dominimin e shkaqeve ekzogjene të vdekjes. Pas përjashtimit të punëtorëve shqiptarë nga entet e shëndetësisë publike, nga spitalet, klinikat dhe ambulancat, në të gjithë këta dhe indikatorë

[84] H. Islami, *Fshati i Kosovës,* ff. 145, 165-168.
[85] *Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003*, ESK, Prishtinë, 2004, f. 63.
[86] *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, ff. 63-64, 85.

të tjerë gjendja shëndetësore e popullit keqësohet edhe më tepër, gjë që la pasoja të shumta edhe në pozitën sociale të femrës sonë dhe veçanërisht në shëndetin reproduktiv të saj.

Tabela 17. Popullsia femërore e moshës 15 e më tepër vjet sipas kombësisë dhe numrit të fëmijëve të lindur gjallë në Kosovë sipas regjistrimit të vitit 1981[87]

Të lindur	Gjithsej	Shqiptare	Serbe	Malazeze	Boshnjake	Kroate	Turke
	446.385 100,0	324.045 100,0	75.906 100,0	10.669 100,0	17.976 100,0	2.684 100,0	3.997 100,0
S'ka lindur	146.194 32,7	108.237 33,4	23.094 30,4	3.861 36,1	5.483 30,5	833 30,3	1.403 35,1
1	29.255 6,5	19.360 5,9	6.009 8,0	946 8,8	1.290 7,1	198 7,3	280 7,0
2	41.593 9,3	22.583 6,9	13.624 17,9	1.665 15.6	1.698 9,4	262 9,7	252 7,0
3	40.241 9,0	24.546 7,5	10.854 14,2	1.342 12,5	1.839 10,2	247 9,2	438 10,9
4	36.579 8,1	25.384 7,8	7.134 9,3	943 8,8	1.719 9,5	217 8,0	381 9,0
5	32.923 7,3	24.451 7,5	5.063 6,6	626 5,8	1.477 8,2	155 5,7	301 7,5
6	30.752 6,7	24.384 7,5	3.577 4,7	443 4,1	1.314 7,3	174 6,4	231 5,7
7	26.204 5,8	21.424 6,6	2.530 3,3	302 2,8	1.020 5,7	154 5,7	185 6,0
8	22.214 4,8	18.727 5,7	1.729 2,2	219 2,0	801 4,4	130 4,8	136 3,4
9	15.403 3,4	13.132 4,0	1.023 1,3	141 1,3	570 3,1	124 4,6	78 1,9
Më se 10 fëmijë	25.027 5,6	21.727 6,7	1.179 1,5	181 1,6	752 4,1	190 7,0	293 7,3

Vërejtje: Deri "gjithsej" (100,0%) e përbëjnë nacionalitetet tjera dhe të panjohurit.

[87] Burimi: *Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 1981 (Žene stare 15 i više godina prema vitalnim, etničkim, obrazovnim i ekonomskim obeležjima u SAP Kosovu), Bilten 47*, Pokrajinski zavod za statistiku, Priština, 1984, f. 24.

Tabela 18. Të lindurit gjallë sipas radhës së lindjes në Kosovë në vitin 1995 sipas kombësisë së nënës[88]

Radha e lindjes	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Malazezë	Boshnjakë	Romë	Turq
Gjithsej	44.776 100.0	37.589 100,0	4.165 100,0	225 100,0	1.167 100,0	1.087 100,0	242 100,0
1	15.742 35,1	12.994 37,6	1.591 38,2	88 39,2	419 35,8	428 39,4	91 37,6
2	11.556 25,6	9.329 24,8	1.429 34,3	64 28,4	336 28,8	263 24,2	60 28,5
3	8.252 18,3	6.879 18,3	829 19,9	49 21,8	240 20,4	157 14,4	51 21,0
4	4.646 10,2	4.161 11,0	223 5,4	16 7,1	90 7,0	104 9,6	19 7,8
5	2.298 5,0	2.094 5,6	69 1,7	6 2,7	48 4,1	62 5,7	8 3,3
6 e më tepër fëmijë	2.282 5,1	2.132 5,7	24 0,5	2 0,8	34 2,9	73 6,7	4 1,6

Vërejtje: Deri "gjithsej" e përbëjnë nacionalitetet tjera dhe të panjohurit.

Në fund të shqyrtimeve mbi lëvizjen e lindshmërisë dhe të përtëritjes së popullsisë mund të konkludohet se si rrjedhojë e ndikimit të një kompleksi rrethanash për një periudhë të gjatë kohore, shoqëria kosovaro-shqiptare kishte një evolucion karakteristik demografik, i cili kryesisht përshkohej me shkallë të larta të natalitetit dhe të mortalitetit, ku baraspesha demografike midis lindjes dhe shuarjes së jetës arrihej me humbje të mëdha njerëzish. Duke vështruar rrjedhën e natalitetit dhe të fertilitetit të popullsisë mund të konkludohet se determinantet e nivelit të lartë dhe të rënies së ngadalshme të tyre lidhen me dominimin e tipit agrar të ekonomisë dhe të strukturës rurale të shoqërisë dhe të izolimit social e hapësinor, me nivelin shumë të ulët të shkrim-leximit e të arsimit, veçanërisht të femrave, me mortalitetin shumë të lartë të foshnjave e të fëmijëve të vegjël, me funksionimin specifik të familjes e të ekonomisë shtëpiake në kuadër të së cilave kryheshin shumë funksione, para së gjithash funksioni biologjik dhe ekonomik, me nevojën dhe vetëdijen për numër më të madh të lindjeve si domosdoshmëri në ekonominë e karakterit natyral dhe për kontinuitetin familjar dhe social.

Rritja demografike e shqiptarëve, marrë historikisht, ishte faktor i fuqishëm i ruajtjes së qenies sonë kombëtare dhe rezistencës ndaj të gjitha ndërmarrjeve gjenocidale. Mirëpo, me ndryshimet socioekonomike, arsimore, shëndetësore, infrastrukturore etj. dhe veçanërisht me përfshirjen e një

[88] Burimi: *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, f. 177.

kontingjenti të konsiderueshëm të femrave në proceset materiale dhe shoqërore, edhe regjimi i riprodhimit biologjik pësoi ndryshime të dukshme; u krijuan supozimet objektive për depërtimin e motivacioneve dhe vetëdijes së re për përqafimin e kontrollit të lindjes në martesa si "stil" të jetës dhe për shkallë të ulët të natalitetit dhe familje të vogël.

4. Planifikimi i familjes dhe përtëritja biologjike e popullsisë në sfidat e civilizimit bashkëkohor

Studimi i problematikës demografike ka rëndësi të madhe për njohjen e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror të çdo vendi dhe populli. Prandaj në të gjitha vendet demografia si shkencë mbi zhvillimin kompleks të popullsisë gjithnjë e më tepër po zë vend të merituar në shkencat shoqërore dhe po shtohet nevoja për një qasje interdisiplinare të studimit të popullsisë. Shqyrtimi i rolit të faktorit demografik në jetën shoqërore dhe ekonomike dhe e kundërta, veçanërisht lindshmëria dhe më gjerë, përtëritja biologjike e popullsisë, tashmë një kohë të gjatë janë bërë objekt diskutimi në qarqe shkencore, shoqërore, ekonomike e politike në nivele kombëtare, rajonale e ndërkombëtare për arsye sociale, ekonomike, eugjenike, pastaj për shkak të emancipimit dhe shëndetit të femrës, të reduktimit të vdekshmërisë së nënave dhe fëmijëve, sidomos të foshnjave e deri për motive shoviniste e raciste.

Për dallim nga lindshmëria, ku ka pikëpamje *contra* dhe *pro* nivelit të saj, sot ekziston pajtueshmëri e plotë se duhet të bëhen përpjekje sa më të mëdha për zvogëlimin e vdekshmërisë si qëllim universal. Lufta kundër mortalitetit të lartë, shkaktarëve dhe diferencimit shoqëror të tij nënkupton luftën kundër vdekjes dhe përpjekjet për ruajtjen dhe zgjatjen e jetës si një nga synimet më të larta jo vetëm të shkencës së mjekësisë, por të gjithë gjinisë njerëzore. Dilema në këtë drejtim nuk ekzistojnë edhe për faktin se, me sa dihet, në të gjitha civilizimet dhe pikëpamjet filozofike mbi botën, jeta e njeriut është vlerësuar lart.[89]

Një ndër sfidat e shumta të civilizimit të sotëm padyshim janë edhe planifikimi i familjes dhe riprodhimi i popullsisë, si dhe kontraverzat lidhur me rritjen demografike dhe kontrollin e lindjes, që paraqiten si në rrafshin nacional e rajonal, ashtu edhe në atë global.

---

[89] A. Sauvy, *Théorie générale de la population (La vie des populations),* Vol. II, Presses Universitaires de France, Paris, 1966, pp. 73-100.

4.1. Konceptimi i planifikimit të familjes

Mirëpo, konceptimi i lindshmërisë, i kontrollit të saj, i planifikimit të familjes dhe i riprodhimit të popullsisë në përgjithësi është shumë më i gjerë dhe më kompleks se sa në të vërtetë mendonin dhe u dukej ithtarëve të rrymave të caktuara. Qarqet të cilat dëshironin t'i zgjidhnin problemet shoqërore, e disa ende përpiqen t'i zgjidhin përmes frenimit të "eksplosionit demografik", përmbajtjen e planifikimit të familjes e reduktojnë në teknikën e kufizimit të lindjeve. Për problemet jetësore e sociale të popullatave të pazhvilluara, këto qarqe ua hedhin fajin shtresave shoqërore që lindin më shumë fëmijë. Angazhimi i këtyre qarqeve për suksesin e politikës popullative antinataliste në vendet dhe popullatat e pazhvilluara është i orientuar shumë më pak për arsye humaniste-altruiste e shumë më tepër për shkaqe frustrative-egoiste. Në një qasje të tillë edhe duhet kërkuar konceptimin e paqartë e konfuz terminologjik dhe ideor, duke identifikuar planifikimin e familjes me politikën popullative të variantit antinatalist dhe duke e parë atë si çështje vetëm mjekësore, ndërsa përtëritjen biologjike si një proces të thjeshtë.

Planifikimi i familjes si dukuri dhe sistem i caktuar i qëllimeve dhe riprodhimi i popullsisë si sferë më intime dhe më e decentralizuar e jetës së njeriut janë çështje komplekse dhe shumëdimensionale, në shqyrtimin e të cilave duhet domosdo të merren në konsiderim qasje dhe aspekte të ndryshme: demografike, sociologjike, mjekësore, psikologjike, juridike, shoqëroro-politike, moralo-etike, filozofike etj. Duke qenë element i vetëdijes individuale reproduktive, planifikimi i familjes sot paraqet pjesën integrale të të drejtave të njeriut, të cilat nisën të afirmohen më fuqimisht nga fillimi i viteve të 60-ta të shekullit XX. Por kjo dukuri është edhe pjesë e vetëdijes shoqërore riprodhuese, prandaj shtrohet edhe si nevojë dhe kërkesë sociale. Planifikimi i familjes, në dimensionin dhe përmbajtjen e vërtetë për civilizimin e sotëm është një komponent i rëndësishëm i stilit të jetës dhe një e arritur e madhe e transformimit shoqëror.[90]

Filozofia e jetesës si gjithmonë, ashtu edhe sot, para njerëzve shtron kërkesa dhe qëllime nga më të ndryshmet. Në vargun e shumë aspiratave themelimi i familjes dhe lindja e fëmijëve janë ndër më dominantet, ndërsa emocionet paraqiten si dimension kryesor në themelimin e bashkësisë martesore. “Janë shumë pak sfera të jetës, që aq thellë i përkasin qenies së njeriut, ekzistencës, kuptimit jetësor dhe aksioneve të tij, emocioneve dhe rrjedhave motivuese të tij, personalitetit të tërësishëm të tij, çfarë janë lindja

[90] A. Coale, ”The Demographic Transition Reconcidered”, in *Contracepcion and Family Planning,* United Nations*,* New York*, 1993.*

dhe prindëria. Funksioni riprodhues angazhon sferat më intime dhe më të sinqerta të personalitetit të njeriut dhe në aktivitetet e shumta të njeriut, veçanërisht të femrës, ky funksion është shkak dhe pasojë e procedeve të ndryshme".[91]

Në çdo shoqëri progresive, në përpjekjet për marrëdhënie humane, pikënisje për planifikim të familjes nuk është numri ideal i fëmijëve të lindur e as madhësia ideale e familjes, por si qëllim i drejtpërdrejtë dhe ideal vleror pranohen raportet e caktuara në shoqëri e në familje dhe veçanërisht raportet midis meshkujve e femrave dhe mbi të gjitha emancipimi i femrës dhe roli aktiv i saj në familje e shoqëri. Në kuadër të humanizimit të raporteve midis gjinive, të mbrojtjes së shëndetit të gruas dhe përpjekjeve që individi, çiftet bashkëshortore, familja dhe popullsia të mbizotërojnë riprodhimin e vet, sot planifikimi i familjes nga aspekti shkencor dhe human, por edhe interesi i gjerë shoqëror, konsiderohet i pranueshëm dhe qëllim i dëshirueshëm, sepse është fjala për synimet që çdo fëmijë i lindur të jetë edhe i dëshirueshëm për lirinë dhe përgjegjësinë e çdo prindi që, duke mbizotëruar ligjet e riprodhimit biologjik, fëmijët të lindin të dëshiruar dhe të shëndoshë. Planifikimi i familjes nuk ka për qëllim sasinë e as nuk përpiqet për më pak ose për më shumë fëmijë, por nënkupton ndryshimin dhe cilësinë e marrëdhënieve njerëzore në përtëritjen biologjike, konsumimin sa më të vogël ekstensiv të shëndetit të gruas, që njëherit është edhe bazë për një jetë të lumtur dhe stabile familjare. Qëllimi tjetër, shumë i rëndësishëm i planifikimit të familjes, që realizohet përmes vetëdijes dhe vullnetit të femrës, është që ajo të bëhet subjekt i vendimit për lindjen e fëmijës dhe jo objekt për ta shfrytëzuar të tjerët, duke filluar nga burri e deri te strukturat pushtetore e shtetërore.[92] Në shoqërinë moderne, gjatë procesit të transicionit demografik, praktika e planifikimit të familjes nuk konsiston vetëm në numrin e fëmijëve që do të lindin, por ka të bëjë edhe me ndryshimet e realizimit të lindjes gjatë periudhës riprodhuese (nisja e vonshme dhe përfundimi i hershëm i lindjeve, rritja e intervaleve midis lindjeve etj.). Planifikimi i familjes nënkupton edhe shërimin e bashkëshortëve, të cilët, për arsye të ndryshme, nuk mund të kenë fëmijë, pastaj mbrojtjen e plotë shëndetësore të nënave dhe fëmijëve, ruajtjen e fëmijëve, sigurimin e kushteve të tjera sociale për foshnje, fëmijë të vegjël dhe nëna etj.[93]

---

[91] N. K. - Stanulović, "Porodica i njena reproduktivna funkcija u savremenom društvu", *Socijalna politika,* nr. 11-12, Beograd, 1987, f. 36.

[92] V. Tomšič, "Planiranje porodice i populaciona politika", në publikimin *Izgradnja društvenih stavova o populacionoj politici u Jugoslaviji,* Beograd, 1975, ff. 583-592.

[93] E. Hofsten, "Spor oko planiranja porodice", *Ekonomska misao,* nr. 3, Beograd, 1974, f. 107.

Studimet antropologjike, mjekësore, etnologjike dhe demografike tregojnë se disa forma "të kontrollit të lindjes" dhe "të planifikimit të familjes" në drejtim të mënyrës restriktive të vendosjes mbi mbarësimin dhe numrin e fëmijëve i hasim qysh në bashkësitë primitive. Elementet pro dhe contra lindshmërisë dhe të riprodhimit të popullsisë në përgjithësi i gjejmë edhe në Evropën Antike (Greqia e Vjetër, Roma Antike), por edhe jashtë saj (Kina klasike), përmes ndikimit të faktorëve të ndryshëm, para së gjithash të atyre demografikë, siç janë mosha e hyrjes në martesë apo moshyrja në bashkësi martesore, monogamia, poligamia etj. dhe zbatimit të metodave të ndryshme të kontrollit të lindjes, sikurse janë coitus interruptus-i, metoda e periudhës së sigurt, zgjatja e periudhës së laktacionit (koha sa është fëmija në gji), abstinenca seksuale për arsye konfesionale e etike etj. Edhe në vendet sot të zhvilluara perëndimore deri përafërsisht para një shekulli, rrjedha e fertilitetit nuk ishte "e dirigjuar", por i përkiste tipit "natyror".[94]

Njohuritë e deritanishme mbi planifikimin e familjes flasin se kontrolli i lindjes reduktohet kryesisht në përdorimin e mjeteve kontraceptive (pengimi i shtatzënësisë së padëshiruar) dhe në abort (ndërprerja me dhunë e shtatzënësisë). Si metodë më efikase për kufizimin e lindjeve, edhe në popullatat paratransitive, siç dihet, është shfrytëzuar *aborti*[95], i cili më vonë, në fillim të fazës së transicionit demografik në vendet sot të zhvilluara, bëhet mjet kryesor i kontrollit të lindjes dhe i planifikimit të familjes, ndërsa nga fundi i kësaj faze në këtë drejtim do të dominojë zbatimi masiv i mjeteve të kontracepcionit.[96] Megjithatë, në shumë vende të botës sot, një numër i madh i femrave, pa marrë parasysh moshën, nivelin socioprofesional, gjendjen martesore dhe veçoritë e tjera sociokulturore e psikologjike, e shfrytëzon abortin si formë të kontrollit të lindjes dhe të planifikimit të familjes, rreth të cilit ka kohë që po zhvillohet një debat i gjerë në drejtim pro dhe contra tij edhe në organizatat ndërkombëtare dhe në nivele të tjera të karakterit kontinental, rajonal dhe nacional mbi popullsinë dhe zhvillimin, familjen dhe femrën. Mirëpo, edhe përkundër të arriturave të mëdha në sferën mjekësore,

---

[94] P. Festy, *La fécondité des pays occidentaux de 1870 à 1970,* Institut National d'Études Démographiques, Travaux et Documents, Cahier no 85, PUF, Paris, 1979, pp. 7-47.

[95] Në fillim të shekullit të kaluar aborti (dështimi) nuk kishte shtrirje universale. Liberalizimin e tij e kundërshtonin qarqet politike dhe qeveritare. BRSS-ja ishte e para që bëri liberalizimin e plotë të dështimit në vitin 1920, pastaj midis dy luftërave botërore këtë e bëjnë disa vende nordike, ndërsa Japonia në vitin 1948 dhe më vonë shumë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe vendet e tjera të zhvilluara dhe në zhvillim (*Natalité et politique de population en France et en Europe de l'Est,* Institut National d'Études Démographiques et Presses universitaires de France, Cahier no 98, Paris, 1982).

[96] R. Pressat, *Démographie sociale,* Presses universitaires de France, Paris, 1978, pp. 63-88.

socioekonomike dhe arsimore, popullata dhe veçanërisht çiftët bashkëshortorë ende, në shumë mjedise shoqërore, janë nën ndikim të madh të botëkuptimeve tradicionale në sjelljet e tyre në raportet seksuale dhe familjare, gjithsesi të dëmshme për shëndetin dhe jetën e tyre, sidomos të femrave.

Normat religjioze, zakonet dhe tradita gjatë evolucionit të shoqërisë dhe popullsisë, natyrisht, kanë ushtruar ndikim të konsiderueshëm në "kontrollin e lindjes" në drejtim për apo kundër tij dhe, me sa dihet, qëndrimet e të gjitha konfesioneve, ndonëse në ndikimin e tyre në regjimin e riprodhimit ekzistojnë disa dallime midis tyre, në përgjithësi kanë karakter pronatalist. Duke ndikuar në gjendjet dhe vetëdijen individuale dhe sociopsikologjike, religjioni është manifestuar edhe në sjelljen riprodhuese dhe normat fetare-etike në etapa të caktuara të zhvillimit shoqëroro-historik, në të cilat edhe janë formuar, kanë pasur fuqinë jetësore dhe kanë shprehur nevojat socialo-ekonomike të popullsisë dhe mbi të gjitha, duke favorizuar natalitetin e lartë, iu kanë kundërvënë mortalitetit të lartë. Mbi këtë bazë janë krijuar edhe normat religjioze dhe pikëpamjet filozofike, të cilat e kanë favorizuar numrin më të madh të lindjeve në bashkësitë martesore. Prandaj, ndikimin e konfesionit në rrjedhën dhe nivelin e lindshmërisë duhet parë në kontekst të kompleksit dhe rrethanave socioekonomike dhe sociopsikologjike.[97]

Institucionet e martesës dhe familjes në të gjitha format historike të tyre ishin dhe mbetën suaza themelore të riprodhimit biologjik. Përmes tyre shoqëria ka ushtruar ndikimet e saj në nivelin dhe rrjedhat e lindshmërisë. Familja ishte forma e parë e ndikimit të shoqërisë në procesin e lindjes, përmes së cilës janë bartur dhe kanë influencuar edhe faktorët e tjerë. Në shoqëritë në të cilat ka dominuar tipi i prodhimtarisë agraro-natyrale martesa, familja dhe lindja janë vlerësuar lart. Martesa ka sjellë fat, pasardhës dhe krah të ri të punës, ndërsa fëmijët e gjinisë mashkullore paraqiteshin edhe si faktor i domosdoshëm i kontinuitetit të familjes, të trashëgimit të pasurisë dhe të emrit të familjes, por edhe si mbajtës i prindërve në pleqëri. Ndërsa familja i ka ruajtur të gjitha funksionet e njësisë ekonomike, por brenda saj, pos funksionit riprodhues si formë e saj afatgjate, janë kryer edhe funksionet e tjera.[98] Në popullatat e këtij tipi, të gjithë indikatorët socio-ekonomikë e kulturorë dëshmojnë se lidhja midis funksionit ekonomik të familjes dhe funksionit të saj reproduktiv është shumë e ngushtë. Në këto popullata, familja si grup i

---

[97] Shih për këtë më gjerë studimin në shembullin e një mjedisi multietnik dhe multikonfesional: Z. Grebo, *Čovjek, radjanje i društvo (Socijalna uslovljenost nataliteta i demografska politika u BiH),* Svjetlost, Sarajevo, 1975, ff. 203-238.

[98] Për funksionet e familjes (biologjike, ekonomike, edukative, sociale, shëndetësore, mbrojtëse, etj.) shumëdimensionalitetin dhe karakterin historik të tyre shih: Z. Golubović, P*orodica kao ljudska zajednica,* Naprijed, Zagreb, 1981, ff. 141-150.

rëndësishëm primar, luan rolin mbikëqyrës të sjelljes së individit, madje pa marrë parasysh moshën, pra edhe të sjelljes në sferën e përtëritjes biologjike.[99]

Në popullatat e pazhvilluara një numër i madh i funksioneve shoqëroro-ekonomike të femrës deri vonë, në shumë sish edhe sot e gjithë ditën, nuk ka mundur të dalë nga suazat familjare, oborri ekonomik dhe bashkësia rurale. Femra, për shkak të varshmërisë ekonomike dhe shkallës së ulët të arsimimit mbeti e lidhur për punët e shtëpisë dhe përtëritjen biologjike, gjë që objektivisht nuk kishte mundësi t'i theksonte aspiratat dhe qëllimet e saj personale jashtë jetës familjare dhe ekonomisë shtëpiake, ndërsa nevoja për ndryshimin e sjelljes riprodhuese, racionalizimin e riprodhimit dhe kalimin nga fertiliteti "i pakontrolluar" në fertilitet "të kontrolluar" dhe humanizimin e raporteve midis gjinive, kërkon ndryshim rrënjësor të pozitës së gjithmbarshme të femrës në familje e shoqëri dhe shoqërizimin e jetës e të punës së familjes. Eksperienca e popullatave që e kanë kaluar fazën e plotë të transicionit demografik tregon se aktiviteti ekonomik, orientimi në jetën profesionale dhe arsimimi i femrës krijojnë qëndrime krejtësisht të tjera ndaj funksionit të kohës së punës dhe funksionit të kohës së lirë, duke reduktuar dukshëm funksionin e saj biologjik. Angazhimi i femrës jashtë rrethit familjar dhe pavarësia e saj ekonomike krijojnë një hapësirë të gjerë për rritjen e lirisë personale dhe, lidhur me të, për prishjen e martesave jostabile, për hyrje të vonshme apo moshyrje fare në bashkësinë martesore, për përqafim të martesave koncesuale, për lindje të fëmijëve jashtë martesës etj., që kanë si rezultat numrin e vogël të lindjeve.

4.2. Mikroniveli dhe përtëritja biologjike e popullsisë

Në përtëritjen biosociale mund të ushtrohet ndikim vetëm në mënyrë të tërthortë dhe vetë pozita ekonomike, sociale dhe arsimore e individit, e çiftit bashkëshortor dhe e familjes përcakton normat shoqëroro-demografike të sjelljes riprodhuese: dëshira të lindura për numër më të vogël ose më të madh të pasardhësve nuk ka, por ato krijohen gjatë ciklit jetësor, që do të thotë se synimi drejt fertilitetit të ulët apo të lartë nuk ka bazë të fortë gjenetike.[100] Krijimi i kushteve të caktuara sociale, materiale, arsimore, shëndetësore etj. duhet t'i paraprijë tendencës drejt "orientimit" dhe "centralizimit" të lindjes si

[99] H. Islami, *Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës,* Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1997, ff. 31-39.

[100] F. Lorimer, *Culture and Human Fertility,* UNESCO, Paris, 1954, p. 22 e tutje; R. Cliquet, "Below-Replacement Fertility: A Case of Individual-societal Antagonism, Sociobiologically Explained", në *Prilozi demografskim i ekonomskim naukama,* SANU, Knj. 103, Beograd, 1994, ff. 44-45.

materie më e ndërlikuar dhe më intime e jetës së njeriut dhe e formimit të paradispozitave psikologjike e të vetëdijes në kuptim të përqafimit të qëndrimeve e normave mbi racionalizimin e riprodhimit të popullsisë. Elementet e vetëdijes, të cilat në procesin e lindjes dhe në rrjedhat demografike në përgjithësi manifestohen përmes nevojave, aspiratave, dëshirave, qëllimeve, interesave, motivacioneve, sigurisë sociale, vlerave, qëndrimeve ndaj jetës seksuale etj., janë rezultat i kushteve të përmendura jetësore. Vetëdija mbi natalitetin e ulët dhe familjen e vogël nuk mund të krijohet me përhapjen e propagandës në favor të zvogëlimit të tyre, duke zbatuar metodat dhe mjetet "artificiale" për rregullimin e lindjes dhe duke theksuar efektet negative të normës së lartë të natalitetit, e cila relativizon rezultatet e zhvillimit shoqëroro-ekonomik. Përzierja e shtetit dhe ndërmarrjet e dhunshme eventuale të tij në procesin e lindjes në mënyrë të diferencuar ndaj grupacioneve etnike në shoqëritë multietnike nëpërmjet motivacioneve të dyshimta, presioneve, politizimit dhe shkeljes së të drejtave për vendosjen e lirë mbi numrin e pasardhësve, mund të shkaktojë te bartësit e riprodhimit vetëm sjellje kontraefektive, por edhe konflikte afatgjata mbi baza etnike, fetare e raciale. Variablat e përmendura të vetëdijes dhe normat etike sa i përket martesës, familjes dhe lindjes as nuk krijohen e as nuk ndryshohen nga "kontrolli i lindjes" dhe "planifikimi i familjes" përmes zbatimit të mjeteve të ndryshme të dhunës, por me ndryshimin e sistemit të gjerë socioekonomik. Ky sistem, në mënyrë të tërthortë edhe përbën bazën determinuese të fertilitetit dhe të perspektivës demografike.

Në vendet sot të zhvilluara perëndimore fillimi i rënies së natalitetit dhe përqafimi i kontrollit të lindjes në martesa nuk kanë pasuar me zbatimin e ndonjë politike të konceptuar popullative, por spontanisht, me ndryshimin e kushteve jetësore, të cilat në themel i ndryshuan qëndrimet dhe normat ndaj lindshmërisë dhe madhësisë së familjes. Regjimi modern i riprodhimit është përvetësuar së pari nga shtresat e larta shoqërore, popullsia urbane, femrat e arsimuara dhe ekonomikisht të pavarura, të përgatitura t'i përvetësojnë botëkuptimet dhe krijesat bashkëkohore etj. Te këto shtresa sociale lindja është bërë akt i vendimit të vetëdijshëm dhe i zgjedhjes së çiftit bashkëshortor, ndërsa normat dhe institucionet fetare e konservative nuk kanë mundur të paraqesin rezistencë për përdorimin e mjeteve për pengimin e shtatzënësisë së padëshiruar apo për ndërprerjen me dhunë të saj. Në këto vende, të cilat aktualisht kanë hyrë në revolucionin e dytë global të kohës sonë, të quajtur modernizim, ku industrializimi dhe tjetërsimi i jetës janë dukuri përcjellëse, investimi ekonomik dhe psikologjik në fëmijë është mjaft i madh. Në shoqëritë e këtij tipi, numri i martesave kohabituese si formë e re e ekonomisë familjare

dhe si stil i jetës që synohet është në ekspansion.[101] Këto martesa nënkuptojnë banimin e përbashkët të "çiftëve bashkëshortorë", por janë jashtëligjore dhe jashtëmartesore (unmarried cohabitation), të cilat, herët a vonë përfundojnë me shkëputje përmes marrëveshjes dhe natyrisht pa pasardhës.[102] Në anën tjetër, edhe braktisja e shtëpive të prindërve nga fëmijët e tyre është gjithnjë në rritje; fëmijët e tillë ose jetojnë vetëm, jashtë shtëpive të prindërve të tyre dhe me të ardhurat vetanake ose hyjnë në martesa kohabituese.[103]

Në vitet e para të jetës së fëmijës sikur shpenzimi kryesor është "çmimi i kohës së nënës"; derisa resurset e tjera mund të shtohen, koha si resurs themelor për ngritjen dhe edukimin e fëmijëve vetëm mund të ridistribuohet. Koha sot po bëhet faktor gjithnjë e më i rëndësishëm i standardit personal dhe i cilësisë së jetës, pra edhe i reduktimit të numrit të lindjeve. Prandaj prindërit, duke investuar në ngritjen e standardit dhe cilësinë e jetës, investojnë jo në numrin e fëmijëve, por edhe në cilësinë e tyre. Në rrafshin individual dhe familjar (mikroniveli) te shumë shtresa sociale të civilizimit perëndimor ka kohë që është krijuar bindja se numri i vogël i fëmijëve është përparësi ekonomike, sociale, shëndetësore dhe psikologjike.[104] Interesat dhe vlerat kolektive janë zëvendësuar me qëllimet dhe kërkesat individuale, ndërsa martesat tradicionale me martesa "me dashuri", me efekte të ndryshme demografike dhe sociale në njërat dhe tjerat. Për t'i përmbushur nevojat emotive për prindëri, një pjesë e konsiderueshme e çifteve bashkëshortore vendosin të kenë vetëm një fëmijë, ndërkaq, pasi që gjinia njerëzore është dygjinore, te një numër jo i vogël i tyre, vullneti për fëmijën e dytë del nga dëshira për të pasur fëmijë të gjinisë së kundërt. Mirëpo, fëmija i tretë e redukton deri në atë masë vëllimin e opcioneve jetësore të prindërve, veçanërisht të nënave, sa që lindja e tij është tepër e rrallë.[105]

---

[101] P. A. Audirac, "Cohabitation et mariage: qui vit avec qui?", *Économie et statistique,* No 145, INSEE,Paris, juin 1982.

[102] N. Keilman, "Recent Trends in Family and Houschold Composition in Europa", në *European Jurnal of Population*, Louvain-la-Neuve, No 2, 1986, pp. 117-184.

[103] H. Leidon-C.Villeneuve-Gokolp, "Les nouveaux couples: nombre, caracteristiques et atitudes", *Population,* No 43, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1988, pp. 331-374.

[104] G. S. Becker - H. G. Lewis, "On the interaction between the quantity and quality of children", *Journal of Political Economy,* No 2, London, 1973; R. Cliquet, "The second demographic transition: fact or fiction? *Council of Europe, Population Studies,* No 23, Strasbourg, 1991.

[105] D. Avramov, *Pojedinac, porodica i stanovništvo u raskoraku,* Naučna knjiga, Beograd, 1993, f. 4.

4.3. Individualizmi dhe egoizmi si vlera të rëndësishme në riprodhimin e popullsisë

Shoqëritë të cilat sot i afirmojnë përmbajtjet humane të së drejtës së njeriut për lindjen e lirë dhe planifikimin e familjes luftojnë për ta çliruar individin nga shumëçka, edhe pse mënyra e jetës, të cilën e diktojnë proceset e zhvillimit modern industrial, shpie drejt krijimit të shumë problemeve të tjera, në këtë kuadër edhe të rritjes së tjetërsimit me të gjitha pasojat që dalin edhe për jetën prokreative edhe për jetën familjare e shoqërore. Në shoqëritë e zhvilluara industriale gjithnjë e më tepër po kuptohet si realitet fakti se familja e vogël, e ashtuquajtur nukleare, si model gjendet në krizë, prandaj në krizë gjendet edhe vetë procesi i përtëritjes biologjike, me normën neto të riprodhimit nën një, që nuk siguron as përtëritjen e thjeshtë të popullsisë. Në këto shoqëri martesa nuk është më as universale e as stabile, familja gjithnjë e më tepër po e humb rolin e transmisionit të vlerave kolektive, ndërsa individualizmi dhe tjetërsimi i prindërve po bëhen vlera dominante. Ekspansioni i individualizmit, i egoizmit, i hedonizmit po e shtrin ndikimin e tij në rritjen e normës së celibatit, në martesat kohabituese, në hyrjet e vonshme në martesë, ku shumë çifte bashkëshortore vonë i nisin e herët i përfundojnë lindjet, disa nuk dëshirojnë të lindin fare fëmijë, pastaj në rritjen e patologjisë familjare, në rritjen e numrit të martesave të shkurorëzuara e të lindjeve jashtëmartesore, të fëmijëve dhe familjeve të braktisura, të shtimit të numrit të delikuentëve, të rritjes së neurozave individuale e familjare etj. Në shoqëritë moderne, ku jeta ekonomike ka marrë tipare krejtësisht tjera, ndërsa egoizmi dhe altruizmi janë bërë forma dominante të sjelljes së individit, arsyet e numrit më të madh të lindjeve janë zvogëluar, sepse fëmijët nuk i kontribuojnë më buxhetit familjar, nuk janë më mbajtës të prindërve në pleqëri, por as faktor i kontinuitetit dhe emrit të familjes dhe trashëgimit të pasurisë. Në vendet dhe shoqëritë e pazhvilluara ose në zhvillim, nuk ka dyshim se niveli i ulët i zhvillimit shoqëror-ekonomik është një nga determinantet kryesore të transicionit të vonuar demografik në sferën e fertilitetit. Mbi këtë bazë nuk ka si të mos lidhet edhe koekzistimi i institucioneve dhe i vetëdijes tradicionale dhe ndikimi i tyre në procesin e përtëritjes biosociale, ku ndikim i madh ushtrohet përmes ruajtjes së pozitës dhe rolit klasik të femrës në familje dhe shoqëri, ndonëse është zvogëluar paralelizmi midis lindshmërisë dhe vdekshmërisë, ku janë reduktuar motivet themelore tradicionale të natalitetit të lartë për shkak të zvogëlimit të vdekshmërisë së foshnjave e të fëmijëve të vegjël, si dhe rëndësia ekonomike e numrit të madh të fëmijëve në ekonomitë familjare agraro-rurale. Pas Luftës II Botërore kishte shkencëtarë që thonin se në këto vende eliminimi i urisë do të

ndikojë në zvogëlimin e rritjes demografike. Parulla e tyre "Tavolina e bukës së të varfrit është e varfër, por shtrati i tij është i pëlleshëm"[106] tregon se kushtet jetësore determinojnë evolucionin demografik, pra edhe sferën riprodhuese.

Sot në të gjitha vendet, pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit, nuk do të thotë se popullatës nuk duhet t'u ofrohen njohuri dhe mjete mbi mundësitë e kontrollit të lindjes për ata individë dhe çifte bashkëshortore që e dëshirojnë vetë. Angazhimi dhe përpjekjet e shoqërisë me qëllim që t'i informojë njerëzit mbi mundësinë e vendosjes për mbarësimin, lindjen dhe krijimin e marrëdhënieve të vetëdijshme e me përgjegjësi midis gjinive ndaj lindjes së fëmijëve, si dhe përparimi i planifikimit të familjes me qëllim të riprodhimit human e racional nuk duhet të kuptohet si kontrollim i popullatës, të orientuar drejt reduktimit të saj, por si mbizotërim i përtëritjes biologjike. Kjo do të thotë se çiftët bashkëshortorë dhe prindërit potencialet dhe aftësitë e tyre natyrore nuk duhet t'ia lënë mekanizmave jashtë vetes. Mjetet mekanike dhe kimike të kontracepcionit,[107] që nuk paraqesin rrezik për shëndetin e partnerëve, edhe kanë mundësuar ndarjen e seksit nga prokreacioni (lindja), ndërsa njohuritë mbi mundësinë e zbatimit të këtyre mjeteve, paraqiten si faktor i rëndësishëm në krijimin e motiveve, qëndrimeve dhe normave riprodhuese, pra të planifikimit të familjes si një përparim i madh i transformimit social dhe kulturor të civilizimit të sotëm.

Në anën tjetër, njohja e mënyrave dhe e motiveve të riprodhimit të popullsisë nuk jep të drejtë që arbitrarisht të intervenohet në procesin e lindjes jashtë interesave reale të të gjithë pjesëmarrësve në të për arsye se pikërisht ky interes i vërtetë i pjesëmarrësve në riprodhim është ai që vendos për nivelin e riprodhimit, por edhe që manifestohet vetëm përmes vendimit të individit mbi nivelin e tij. Nga demografia historike na është e njohur se të gjitha shoqëritë kurrë nuk kanë qenë indiferente ndaj faktit se çfarë janë sjelljet individuale që i prekin interesat e bashkësisë, që do të thotë se lindshmëria kurrë nuk është konsideruar vetëm çështje e individit dhe e çiftëve bashkëshortorë. Normat riprodhuese si pjesë përbërëse të normave shoqërore, siç dihet, gjithnjë ishin pjesë të përmbajtjeve të të gjitha konfesioneve dhe sistemeve ideologjike e juridike. Por, të gjitha masat eventuale që mund t'i ndërmarrë shoqëria në këtë

---

[106] Shih për këtë: J. de Castro, *Géopolitique de la Faim,* Édition ouvrières, Économie et humanisme, Paris, 1952.

[107] Mjetet dhe metodat kontraceptive ose për mbrojtje nga mbarësimi janë: pilula, spirala, dijafragma, kondomi, periudha e sigurt (ditët e plleshme), coitus interruptusi (ndërprerja e aktit seksual), shpërlarja, mjetet intrauterinare dhe kimike (shkuma, melhemi etj.) etj. Në pengimin e mbarësimit ndonjëherë përdoret edhe kombinimi i disa mjeteve e metodave etj.

drejtim në kuadër të politikës popullative duhet të jenë në përputhje me aspiratat, interesat dhe qëllimet e individit, veçanërisht të femrës, të prindërve dhe njerëzve për ardhmërinë e tyre dhe të fëmijëve të tyre. Për t'i përvetësuar normat e reja të përtëritjes biologjike dhe për ta ndryshuar regjimin e riprodhimit duhet të formohen bindjet dhe qëndrimet përkatëse në rrafshin individual dhe familjar. Në kontekstin e ndryshuar shoqëror, ku raporti i prindërve ndaj fëmijëve del jashtë nevojës së familjes për fëmijë si fuqi të domosdoshme punëtore dhe si mbajtës të prindërve në pleqëri dhe reduktohet në rrafshin e nevojave emocionale, thirrjen e shoqërisë p. sh. për rritjen e numrit të lindjeve, individi e përjeton si dhunë ndaj tij dhe përzierje në marrëdhëniet intime martesore.

Në përtëritjen biologjike të popullsisë rezultate të dëshiruara mund të priten vetëm në qoftë se arrihet të bëhet ndryshimi i sjelljes demografike të individit. Faktori personal sot luan rol gjithnjë e më të rëndësishëm sa i përket mbarësimit, numrit të lindjeve dhe intervalit suksesiv midis tyre. Kur të arrihet që mikroniveli - individi dhe familja t'i marrin vetë vendimet mbi lindjen e fëmijëve, numrin e tyre, intervalin midis lindjeve, vitin e fillimit të lindjes dhe vitin e përfundimit të këtij procesi, atëherë mund të pritet krijimi i vetëdijes së re riprodhuese dhe natyrisht, në popullatat ku është nataliteti i lartë, edhe zvogëlimi i tij. Mirëpo, meqenëse familja është celula kryesore e shoqërisë dhe e nivelit të fertilitetit të popullsisë, transformimi i strukturës dhe i funksionit të këtij institucioni përmes ndryshimeve ekonomike, shoqërore dhe kulturore ka gjithashtu rëndësi të madhe për ndryshimin e tipit të riprodhimit biologjik. Në favor të këtij ndryshimi shkojnë fuqimisht raportet demokratike në sjelljen e vendimeve familjare, lidhjet stabile familjare, kënaqësitë në bashkësi martesore, çlirimi nga vlerat tradicionale sa i përket sjelljeve në raportet seksuale e familjare dhe qëllimeve, mjeteve dhe metodave në planifikimin e familjes. Sa ka rëndësi të madhe familja në këtë drejtim, por edhe shumë më gjerë, tregon edhe fakti se në kuadër të familjes zhvillohen tri ngjarje të rëndësishme demografike: jeta martesore, e cila shënon bashkëshortësinë dhe shkurorëzimin, jeta riprodhuese, që shënon lindjen dhe vetë jeta që përfundon me vdekjen.[108] Ndërkaq, emancipimi i femrës dhe ndryshimi i rolit dhe i pozitës së saj në shoqëri është faktor qenësor për transformimin e raporteve të brendshme familjare e të krijimit të orientimeve të tjera vlerore dhe të një sistemi krejtësisht tjetër sa i përket prokreacionit dhe martesës.

---

[108] D. Courgeau, "Interférences entre phénomènes démographiques", *Population,* Numéro Spécial, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1977, pp. 81-94; H. Le Bras, *Child and family,* Demographic Developement in the OECD countries, OECD, Paris, 1979.

Një shtet me institucionet e tij mund të intervenojë dhe të presë sukses në masat e ndërmarra vetëm nëse individët dhe opinioni i gjerë e pranojnë këtë, siç është rasti p.sh. me përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullit dhe zvogëlimin e mortalitetit (vaksinimi i obligueshëm i popullsisë me qëllim që të pengohen apo eliminohen sëmundjet infektive e të tjera), pastaj me shkollimin e obligueshëm fillor etj. Shoqëria e zhvilluar dhe e organizuar u ofron çiftëve bashkëshortorë njohuri dhe mjete që të mund të vendosin në mënyrë të lirë dhe me përgjegjësi se a do të lindin, kur dhe sa fëmijë do të lindin. Por vetëdijen riprodhuese në kuptim të përtëritjes racionale të popullsisë e përcaktojnë faktorët e modernizimit të shoqërisë, ku është e sigurt se aktorët e riprodhimit biologjikë, në përputhje me rrethanat e ndryshuara shoqëroro-ekomomike në kuptim të gjerë, do t'i përvetësojnë dhe zbatojnë shpejt njohuritë dhe mjetet për rregullimin e lindjes.

Shoqëria e interesuar për "orientimin" e fertilitetit e të rrjedhave demografike në drejtim të dëshiruar dhe për harmonizimin e interesave personale me ato shoqërore, duhet të angazhohet në punësimin e femrës dhe shoqërizimin e funksionit riprodhues dhe funksionit të familjes, që një pjesë të obligimeve dhe funksioneve prindërore t'i ushtrojë në atë mënyrë që të krijojë ente shoqërore si vazhdim dhe pjesë përbërëse të shtëpisë prindërore, ku edhe prindërit, veçanërisht nënat do t'i ndjejnë si të vetat këto ente. Hyrja e gruas në procesin e punës, të punës së paguar, shtron nevojën e institucionalizimit të kujdesit ndaj fëmijëve të nënave të punësuara, ndërsa gratë e punësuara, për fëmijët e të cilave ekziston kujdesi shoqëror, janë më efikase dhe më produktive në punë. Në rrethanat kur ky institucionalizim mungon apo është i pamjaftueshëm, gruaja e punësuar më parë merr vendim që të mos lindë ose të lindë vetëm një fëmijë sesa ta ndërpresë punën. Ndonëse politika e kujdesit ndaj fëmijëve, familjes dhe punës ndikon në formë të tërthortë apo të drejtpërdrejtë në procesin e lindshmërisë, megjithatë ajo i kapërcen suazat e qëllimeve demografike.

Pa kushte dhe supozime të përmendura, siç dëshmon eksperienca e popullatave që e kanë kaluar fazën e transicionit demografik, praktikisht nuk është e mundur të zbatohet dhe zgjerohet i ashtuquajturi kontroll i lindjes në martesa dhe të përputhet numri i fëmijëve të lindur me numrin e fëmijëve të dëshiruar në bashkësitë martesore. Pikëpamjet dhe sjelljet ndaj riprodhimit të popullsisë, ashtu siç krijohen në sistemin e caktuar socioekonomik, gjithashtu edhe transformohen nga modernizimi i këtij sistemi. Vetëm mbi bazën e një sistemi të tillë të transformuar krijohen pikëpamjet dhe normat e reja sociale mbi martesën dhe kohën e hyrjes në të, numrin e fëmijëve dhe intervalin kohor

midis lindjeve dhe madhësinë e familjes, ndërsa përqafimi i kontrollit të lindjes në martesa bëhet "stil" i jetës.[109]

Zhvillimi shkencor, material dhe mendor u mundësoi njerëzve që e drejta e vendosjes në procesin e përtëritjes biologjike t'i merret forcës së papërmbajtur, vendimeve "të zotit", dhe të bëhet e drejtë njerëzore, e drejtë që do t'i sjellë të mira e lumturi fëmijëve, familjes dhe natyrisht shoqërisë. Mirëpo, edhe këtu ka ende pengesa që duhet të kapërcehen, sidomos konflikti midis individit dhe shtetit, ku paraqiten përpjekje që forcën e papërmbajtur, stihinë natyrore në procesin e riprodhimit ta zëvendësojnë forcat burokratike, duke propaguar dhe zbatuar të gjitha masat për parandalimin e mbarësimeve të padëshiruara (deri te sterilizimi) dhe për të imponuar forma të reja të presionit dhe tjetërsimit të personalitetit të njeriut.

Intervenimi i shoqërisë përmes masave të drejtpërdrejta dhe represive në sferën kaq delikate dhe të decentralizuar të jetës së njeriut nuk është i lejueshëm, sepse shndërrohet në manipulim burokratik; dhuna në procesin e lindjes nuk përkon me natyrën e njeriut, ndjenjat dhe arsyen e tij. Në rrethana të tilla rezultatet mund të jenë vetëm kontraproduktive, ngase i tërë procesi i përtëritjes biologjike zhvillohet në nivel të ulët, ku individët dhe çiftët bashkëshortorë janë bartës të tij dhe ata vendosin për numrin e fëmijëve dhe intervalin kohor midis lindjeve, sikundër që, për shkak të karakterit të ndërlikuar dhe shumëdimensional të natalitetit, ata nuk preokupohen fare me atë se çka po ndodh në planin e përgjithshëm, a po rritet apo po zvogëlohet niveli i tij. Në të gjitha popullatat, pa marrë parasysh tipin e riprodhimit, ekziston një shpërputhje e konsiderueshme midis nivelit makroshoqëror dhe atij mikroindividual, që do të thotë se dëshirat dhe aspiratat e individit nuk përputhen me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë dhe sikur interesi individual dhe interesi shoqëror sa i përket riprodhimit biologjik janë gjithnjë në konflikt.[110] Deri tash p. sh. nuk dihet se një shoqëri progresive e humane i ka detyruar individët të martohen dhe çiftët bashkëshortorë detyrimisht të lindin fëmijë ose ta pengojë shkurorëzimin, duke ashpërsuar masat edhe përmes legjislacionit.

4.4. Problemi i "planifikimit të familjes" dhe i "kontrollit të lindjes" në dy vende karakteristike

Shembull më tipik për përzierjen e shtetit në procesin e lindjes dhe të shkeljeve drastike të vullnetit dhe arsyes së njeriut, por edhe për mossuksesin e politikës popullative në sferën e lindjes dhe implikimet sociale, politike,

[109] D. Breznik, *Stanovništvo Jugoslavije,* Chronos, Titograd, 1991, ff. 45-94.
[110] Lj. Randić - L. Andolšek, *Planiranje obitelji,* Rijeka, 1984, ff. 58-66.0

psikologjike e morale ishin pikërisht India[111] dhe Kina,[112] dy vende të mëdha aziatike si për nga sipërfaqja, ashtu edhe për nga numri i popullsisë, më plot specificitete socioekonomike dhe kulturore. India[113] dhe Kina[114] merreshin dhe shpeshherë merren edhe sot e gjithë ditën si modele pozitive për zvogëlimin e natalitetit.[115] Mirëpo, eksperiencat lidhur me politikën popullative në rrafshin e lindshmërisë në këto vende janë tashmë të hidhura. Në 560.000 vendbanimet e Indisë në fillim të viteve të 50-ta të shekullit të kaluar u ndërmor një fushatë e gjerë e "kontrollit të lindjes" dhe e "planifikimit të familjes" përmes pengimit të mbarësimeve dhe lindjes. Për këtë qëllim u organizuan 9.000 klinika të cilat distribuuan gratis mjete kundër mbarësimeve dhe 138 klinika për sterilizim gratis. Prej vitit 1956 u sterilizuan rreth 5 milionë njerëz dhe u realizuan rreth 6 milionë abortime në vit.[116] Me këtë

---

[111] Në vitin 2002 India kishte më se 1 miliard banorë me dendësi të popullsisë 319,2 banorë në një kilometër katror, me shkallë të urbanizimit rreth 28%, me normë të analfabetizmit 42% dhe këto shkallë të lëvizjes natyrore në vitin 2001: nataliteti 26, mortaliteti 9, shtimi natyror 17 dhe mortaliteti i foshnjave 68 promilë (*Images économiques du monde 2004*, A. Colin, Paris, 2004, p. 169).

[112] Kina është vendi me numër më të madh të njerëzve në botë, që përbën sot më se 1/5 e popullsisë botërore. Në vitin 2002 kishte 1 miliard e 281 milionë banorë dhe dendësi të popullsisë 133,4 banorë në një kilometër katrore, nivel të urbanizimit 37%, shkallë të analfabetizmit 16% dhe këto norma të lëvizjes natyrore të popullsisë në vitin 2001: nataliteti 13, mortaliteti 6, shtimi natyror 7 dhe mortaliteti i foshnjave 31 promilë (*Images économiques du monde 2004*, p. 129). Më 6 janar 2005 numri i popullsisë në Kinë arriti në 1 miliard e 300 milionë, ndërsa sot ajo ka rreth 1.330 milionë banorë.

[113] Për shkak të vrazhdësisë së masave të ndërmarra për zvogëlimin e lindshmërisë, për eksperiencat "e Indisë, çfarëdo që të ishin metodat, nuk e vlen të bisedohet" (B. Horvat, *Zbornik Kosovo - Srbija - Jugoslavija* (Diskusija), Ljubljana, 1989, f. 78).

[114] Në kohën e histerisë antishqiptare dhe natalitetit të popullatës shqiptare, demografi i njohur slloven, prof. D. Breznik, për kërkesën që në Kosovë të zbatohej modeli kinez, theksonte "se shembulli i Kinës nuk i përgjigjet rrethanave tona" (D. Breznik, "Jesu li diferencijalne mere moguće", *Problemi politike obnavljanja stanovništva u Srbiji, Demografski zbornik, Knj. I,* SANU, Beograd, 1989, f. 369).

[115] "Nuk është e mundur të kuptohet situata e sotme botërore nëse nuk kuptohet se forcat imperialiste i kontrollojnë marrëdhëniet midis vendeve të pasura e vendeve të varfëra dhe, tërthorazi, gjithashtu edhe marrëdhëniet brenda vendeve të varfëra. Derisa këto forca të mos neutralizohen dhe eliminohen, nuk do të arrihet te zhvillimi i vërtetë i vendeve të Botës së Tretë. Ndërsa, zhvillimi ekonomik dhe shoqëror është parakusht i domosdoshëm për rënien e shpejtë të numrit të lindjeve në vendet të cilat sot i karakterizon rritja e shpejtë e popullsisë" (E. Hofsten, "Spor oko planiranja porodice", *Ekonomska misao,* br. 3, Beograd, 1974, fq. 111).

[116] D. Valentej, "Problemi stanovništva nedovoljno razvijenih zemalja i kritika demografskog puta njihovih rešenja", *Stanovništvo*, nr. 2-3, Beograd, 1965, f. 105; B. L. Raina, "Population Policy in India", *IUSP Conference*, London, 1969; A. W. Baletić, *Po aty*, f. 413-415; "Stérilisations massives en Inde", *Population,* No 4-5, INED, Paris, 1973, ff. 954-957.

politikë jo vetëm që u cënuan të drejtat dhe liritë elementare njerëzore, por edhe rezultatet ishin shumë modeste: nataliteti edhe pas dhjetë vjetësh mbeti në nivelin mbi 40 promilë. Jo vetëm në Indi dhe Kinë, por edhe në Pakistan, Egjipt etj. politika restriktive popullative, pra e kufizimit të fertilitetit përmes të ashtuquajturve programe të planifikimit të familjes në vitet e 50-ta dhe më vonë, nuk dha rezultate. "Shkaqet e mosuksesit të këtyre përpjekjeve të hershme të sendërtimit të politikës së frenimit të lindshmërisë nëpërmjet masave dhe aksioneve në kuadër të programeve të planifikimit të familjes qëndronin në faktin se ato atëherë realizoheshin të izoluara nga programet e përgjithshme, si dhe të programeve të vetë zhvillimit, do të thotë në kushtet kur ende nuk do të kishin ndodhur transformimet e duhura në kushtet e jetës, të cilat janë parakusht themelor për ndryshimin e normave ekzistuese të sjelljes riprodhuese".[117] Shumë vite para këtyre aktiviteteteve në sferën e riprodhimit biologjik të popullsisë, një shkencëtar, demograf i Indisë si faktor vendimtar në transformimin e regjimit të riprodhimit të popullsisë së këtij vendi e vinte në pah industrializimin, duke theksuar: "Industrializimi ka rëndësi të madhe për zgjidhjen e problemeve demografike të Indisë për dy arsye. Së pari, varfërinë e sotme ekonomike e kthen në bollëk dhe së dyti, dhe më me rëndësi për Indinë, industrializimi do ta fusë mënyrën e jetesës në qytet, rrjedhojë e së cilës do të jetë reduktimi me vullnet i lindshmërisë. Kështu ka ndodhur në Angli, në SHBA, në Perëndim në përgjithësi dhe në Japoni. Nuk ka arsye që edhe industrializimi i Indisë, sikurse në vendet e tjera, të mos ndikojë në zvogëlimin e nivelit të lindshmërisë."[118]

Duke parë se nuk u arritën rezultate të dëshiruara, ithtarët e flaktë të dikurshëm të zgjidhjes së problemeve shoqëroro-ekonomike përmes frenimit të "eksplosionit demografik" ndërruan mendimin dhe në Konferencën III Botërore mbi Popullsinë në Bukuresht në vitin 1974 u angazhuan që problemet popullative të zgjidhen vetëm në kuadër të planeve të zhvillimit intensiv shoqëroro-ekonomik.[119] Në këtë Konferencë, ndonëse u paraqitën mospajtime të ndryshme, megjithatë, në *Planin Botëror të Aksionit në Sferën e Popullsisë*,

---

Në vitet 1966-1969 në Indi u bë sterilizimi i rreth 2 milionë e gjysmë njerzëve (A. Sauvy, "La limitation des naissances en Inde", *Population,* No 3, INED, Paris, 1970, ff. 662-664).

[117] A. Verthajmer-Baletić, "Medjunarodni aspekti populacione politike", në *Problemi politike obnavljanja stanovništva u Srbiji, Demografski zbornik, Knj. I,* SANU, Beograd, 1989, f. 131.

[118] V. S. Chandrasekhar, *Indiaws Population. Fact and Policy,* Indian Institute for Population Studies, Annamalai University, India, 1946.

[119] J. D. Rockefeller 3rd, "Population Growth: The Role of Developed World", *Lecture Series on Population*, International Union for the Scientific Study of Population, Bucharest, 1974; A. W.- Baletić, *Po aty*, f. 67.

si dokument themelor i saj, politika popullative u shtrua vetëm në kontekst të politikës së zhvillimit shoqëroro-ekonomik, duke i respektuar efektet indirekte të ndikimit të këtij zhvillimi në procesin e përtëritjes së popullsisë dhe duke pasur parasysh konsideratat humane në kuadër të humanizimit të raporteve midis gjinive dhe të raporteve të përgjithshme njerëzore.[120]

Në Konferencën IV Botërore mbi Popullsinë, që u mbajt në Meksiko Siti në vitin 1984, u konfirmua realizimi i suksesshëm i *Planit Botëror të Aksionit,* me qëllim të përmirësimit të standardit jetësor dhe të cilësisë së jetës të të gjithë popujve në planetin tonë. Prandaj, kjo Konferencë, duke marrë përsipër përmbushjen e detyrave nga dokumenti i Bukureshtit nxori po*rositë* për realizimin e mëtejmë të *Planit Botëror të Aksionit në Sferën e Popullsisë,* si dokument kryesor të saj.[121]

Kina është gjithashtu shembull në vete sa i përket kontrollit të lindjes dhe kufizimit të rritjes demografike.[122] Në këtë drejtim, në aksionin që ndërmori pushteti dhe partia komuniste kineze dallohen tri periudha fushatash: fushata e parë në vitet 1956-1957, e cila justifikohej nga shkaqet ekonomike dhe të ruajtjes së shëndetit të nënave dhe fëmijëve; fushata e dytë në vitet 1962-1966, ku reduktimit të natalitetit i shtohej edhe një dimension i rëndë social, cenimi i lirive të individëve që të zgjidhnin mënyrën e martesës dhe të përtëritjes biologjike dhe fushata e tretë, pas vitit 1971, që bëhet më agresive për shkaqe klasore, ku çdo rezistencë ndaj kontrollit të lindjes dhe planifikimit të familjes kualifikohet si vepër e armiqve klasorë. Të gjitha fushatat janë të lidhura me ngjarjet dhe qëllimet politike dhe politiko-demografike.[123]

Mirëpo, edhe më herët (1955) ishte hapur një diskurs mbi kontrollin e popullatës dhe kufizimin e lindjeve nga intelektualët dhe pikërisht nga rektori i Universitetit të Pekinit, ku "përmes arsimit rekomandohej lufta kundër konceptit tradicional të madhësisë së familjes, propozoheshin martesat e vona (23 vjet për vajza dhe 25 vjet për meshkuj) dhe përdorimi i metodave administrative për kontrollin e popullatës. Ekonomia e planifikuar duhej të përcillej me planifikimin e lindjeve".[124] Ndërsa në kuadër të programit kombëtar për zhvillimin e bujqësisë vetë Mao Ce Duni kishte kërkuar që "me

---

[120] Shih më hollësisht: "Le plan d'action mondial de la population", *Population,* No 1, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1975, p. 103-138.

[121] Shih dokumentin, të botuar në revistën *Stanovništvo,* br. 1-4/1984-85, CDI, IDN, Beograd, f. 155-180.

[122] Për të gjitha aspektet e politikës popullative në Kinë shih më hollësisht në: Y. Blayo, *Des politiques démographiques en Chine,* Presses universitaires de France et Institut National d'Études Démographiques, Cahier no 137, Paris, 1997, pp. 1-410.

[123] Y. Blayo, "Événements politiques et fécondité en Chine depuis 1950", *Population*, No 6, INED, Paris, 1991, pp. 1589-1616.

[124] Y. Blayo, *Des politiques démographiques en Chine,* p. 143.

përjashtim të zonave të banuara nga pakicat, është e domosdoshme të njihet dhe të popullarizohet kontrolli i fertilitetit dhe të promovohet kufizimi i lindjeve në të gjitha rajonet dendur të banuara".[125] Në vitin 1956 Ministria e Shëndetësisë i publikon rregullat mbi kontracepcionin, duke kërkuar përmes shërbimeve të caktuara jetësimin e reduktimit të lindjeve (informatat, klinikat për kontracepcion, kuadrot përkatëse). Në vitin 1957 kjo Ministri shpall dhe liberalizon sterilizimin dhe dështimet.[126] Mirëpo, për disa arsye (rezistenca e pikëpamjeve tradicionale, numri i vogël i mjekëve dhe i shërbimeve të tjera mjekësore), në periudhën 1956-1957 aksioni mbeti margjinal. Propaganda mediale dhe partiako-politike për fushatën antinataliste reduktohet në parullën "së pari në qytete e pastaj në zonat rurale dhe njëherë krijimi i kuadrove e pastaj masat". Kështu në vitin 1958 ndërpritet propaganda përmes mediave dhe veprimi i komiteteve, si dhe prodhimi i mjeteve kontraceptive.

Në fushatën e dytë, në vitet 1962-1966, politika e ndërtimit socialist si një nga komponentët kryesore do ta ketë edhe limitimin e lindjeve si në qytete, ashtu edhe në rajonet fshatare të banuara dendur. Parulla ishte: "nga lindjet e pakontrolluara në lindjet e planifikuara". Në këtë periudhë, masa e parë e kontrollit të popullatës do të bëhet përmes martesave të vona, që do të lidhet me objektivat tjera: reduktimi i madhësisë së familjes, reduktimi i numrit të lindjeve në dy fëmijë për një çift bashkëshortor, intervalet midis lindjeve prej 3-5 vjet, ndërsa fëmija i tretë mund të vijë në jetë vetëm nëse e lejon situata familjare. Nis një propagandë në favor të lindjeve të planifikuara dhe të mjeteve të përdorura (kontraceptivët dhe dështimet gratis për femrat që e kërkojnë). Në vitin 1964 krijohet Byroja e Planifikimit të Lindjeve, ndërsa në vitin 1965 Mao kërkon nga shkencëtarët që të shpikin një pilulë të thjeshtë kontraceptive. Mirëpo, së shpejti paraqiten pikëpamjet konfrontuese, si p.sh. popullsia është e rëndësishme për ndërtimin e shtetit socialist, dhe natyrisht pasuan kundërshtimet e hapëta në periudhën e Revolucionit Kulturor nga viti 1966, ku në gjysmën e tij suprimohet Byroja e Planifikimit të Familjes, ndërpritet prodhimi i mjeteve kontraceptive, si dhe distribuimi i tyre. Në periudhën 1966-1969 ndërpritet praktikisht çdo aktivitet i kufizimit të lindjeve dhe haptas del në shesh lufta për pushtet e klasës politike.

Mirëpo, në gjysmën e vitit 1971, me iniciativën e Këshillit të Ministrave e të kryetarit të tij Çu En Laj, filloi të zbatohej një politikë energjike demografike në sferën e lindshmërisë, që u bë pjesë e Planit Pesëvjeçar 1971-1975. Fushata kishte si mbulesë një thënie të Maos: "Anarkia në riprodhimin e popullatës nuk duhet të tolerohet. Është e domosdoshme të planifikohen

[125] Y. Blayo, *Po aty,* p. 144.
[126] Y. Blayo, *Po aty,* pp. 144-147.

lindjet".[127] Në këto vite, në konferencat botërore mbi popullsinë dhe në Komisionin për Popullsi në OKB Kina zyrtare nuk e pranonte faktin se është vend i stërdendur, sikundër që teoritë maltusianiste i quante të gabueshme, por theksonte se "planifikimi i lindjeve dhe zhvillimi i ekonomisë socialiste duhet të shkojnë paralelisht" dhe "rritja e popullsisë duhet të jetë proporcionale me zhvillimin ekonomik". Në vitin 1973 Qeveria formon një grup që do ta drejtojë planifikimin e lindjeve, i cili në vitin 1974 lëshon një qarkore në të cilën kërkohet që mjetet kontraceptive të jepen gratis; hera e parë që objektivat demografike futen në planin e zhvillimit ekonomik. Mao edhe njëherë nga fundi i vitit 1974 do të nënvizojë se "rritja demografike duhet të mbizotërohet".[128] Midis viteve 1972 dhe 1978 mbahen 5 konferenca mbi planifikimin e lindjeve, ndërsa kërkimet shkencore mbi popullsinë rriten. Në vitin 1974 në Pekin themelohet një institut për hulumtime demografike, preokupimi qendror i të cilit do të ishte kontrolli i lindshmërisë dhe kufizimi i rritjes së popullsisë.

Në fund të vitit 1973 nga instancat përkatëse të fushatës përmes një konference nacionale për planifikim të lindjeve do të jepen porositë sipas kësaj radhe: *më vonë, më gjatë dhe më pak.* Sa i përket kuotës së lindjeve, në fillim për çift bashkëshortor lejoheshin në fshat tre fëmijë (bënin përjashtim minoritetet kombëtare), ndërsa në qytet dy fëmijë, mirëpo pas vitit 1977 edhe në zonat rurale kuota u limitua në dy fëmijë; intervalet midis lindjeve lejoheshin për fshat tri vjet dhe për qytet pesë vjet. Përkundër ligjit mbi martesën të vitit 1950, sipas të cilit meshkujt mund të hynin në bashkësi martesore pas moshës 20-vjeçare dhe vajzat pas moshës 18-vjeçare, pas vitit 1977 autoritetet u impononin të rinjve hyrjet sa më të vonshme në martesë: djemve në zonat rurale pas moshës 25-vjeçare dhe vajzave pas moshës 23-vjeçare, kurse në zonat urbane djemve pas moshës 27 vjeçare dhe vajzave pas moshës 25-vjeçare.[129]

Në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar dekretet partiako-shtetërore kineze thonin: "të nxiten çiftët bashkëshortorë që të kenë një fëmijë, ta kontrollojnë rreptësisht lindjen e dytë dhe ta pengojnë lindjen e tretë". Në fshatra zbatohej edhe politika fiskale: çiftët bashkëshortorë detyroheshin të paguanin taksa shtetërore për lindjen e fëmijës së dytë, të fëmijës së tretë e kështu me radhë. Synimet e tilla përfshiheshin edhe në dokumentin themelor të shtetit, në

[127] L. Leonard Chu, "Planned Births Campaigns in China 1949-1976", *Case Study*, No 5, East-West Center, East-West Communication Institute, Honolulu, 1977, p. 24; sipas Y. Blayo, *Po aty*, p. 155.

[128] W. Hou, "Population Policy", in *China's Population: Problems and Prospects*, New World Press, Pékin, 1981, p. 66; sipas Y. Blayo, p. 157.

[129] Sipas: Y. Blayo, *Po aty,* pp.159-160.

Kushtetutë (1978), ndërsa PK e Kinës u urdhëronte anëtarëve të saj që të tregoheshin në vepër, pra t'i prinin aksionit. [130] Si mjete për reduktimin e numrit të lindjeve shfrytëzoheshin falas shërbimet për dështime, sterilizim dhe përdorim masiv të mjeteve intrauterinare dhe kontraceptive.[131] Këto masa zbatoheshin në suaza lokale, në kuadër të komunës dhe të organizatave punuese. Shkohej aq larg në përzierjen e shtetit në procesin e lindjes sa që kryepunëtorët kontrollonin edhe ciklin menstrual të femrave në organizatën e punës. Al Gore, ish-nënkryetar i SHBA-ve, në librin e tij të njohur për problemet ekologjike, nuk i fsheh shqetësimet për raportet nga Kina për abortet e detyrueshme dhe për depërtimin e totalitarizmit edhe në vendin e punës.[132] Nën këtë presion, fertiliteti i përgjithshëm zvogëlohet nga 6 fëmijë mesatarisht për një grua në vitin 1970 në 2,25 fëmijë për një grua në vitin 1989 ose shtimi natyror reduktohet nga 22 promilë në vitin 1972 në 12 promilë në vitin 1978.[133] Mirëpo, nga gjysma e viteve të 80-ta normat e imponuara të përtëritjes biologjike gjithnjë e më pak do të respektohen, rezistenca ndaj kontrollit të lindjes do të rritet, sistemi i një fëmije do të braktiset në zonat rurale dhe nga viti 1984 fshatarët mund të lindnin edhe fëmijën e dytë; [134] në vitin 1988 lindjet jashtë planit do të paraqesin 1/3 e lindjeve të përgjithshme.[135]

Ndonëse nuk ka informata të hollësishme se çka po ndodh në Kinë këto vitet e fundit lidhur me politikën restriktive në sferën e natalitetit, megjithatë mund të thuhet se me rritjen e rezistencës ndaj politikës antinataliste po dobësohet dukshëm e gjithë fushata ndaj kontrollit të lindjes. Mirëpo, gjithë ajo që u ndërmor në këtë vend këto 3-4 dekadat e fundit, në frymën jo vetëm të apelit, por edhe të urdhrit "më vonë, më gjatë dhe më pak", që do të thoshte martesat e vona, intervalet e gjata kohore midis lindjeve dhe një çift-një fëmijë, ishte në kundërshtim të plotë me parimet humane, me arsyen, të drejtat dhe liritë elementare njerëzore dhe kjo la pasoja të shumënduarshme e afatgjata. Sistemi i një fëmije dhe politika e kontrollit të lindjes në përgjithësi

---

[130] L. Bianco, "Planification de naissances en Chine – Quelle confiance accorder aux données locales", *Population,* No 1, INED, Paris, 1981, pp. 123-146.

[131] Shih më gjerë: R. Pressat, "Mesures anti-natalistes en Chine", *Population*, No 4-5, INED, Paris, 1979, pp. 908-909; R. Pressat, "Évolution des naissances en Chine", *Population*, No 4-5, INED, Paris, 1980, pp. 968-972.

[132] Al Gore, *Toka në baraspeshë - ekologjia dhe fryma njerëzore*, Dukagjini, Pejë, 1994, f. 346.

[133] Y. Blayo, *Po aty,* f. 353.

[134] E. Croll, "La Chine assouplit sa politique de l'enfant unique", *Peuples,* vol. 2, No 2, 1985, p. 26; Y. Blayo, " Surmasculinité et politique de l'enfant unique en Chine", *Communication au XXII-ème Congrès Général de la Population de l'Union Internationale pour l'Étude Scientifique de la Population* (UIESP), Montréal, 1992, p. 14.

[135] Y. Blayo, *Po aty,* f. 354.

zbatoheshin me elemente të dhunës dhe të izoluara nga programet e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror dhe pa ndryshime të nevojshme në kushtet e jetesës. Efektet e një politike të tillë represive në sferën e lindjes, duke ngulfatur rëndë fatin personal të njeriut, ishin tashmë evidente: ishin shtuar lindjet ilegale, në "të zezë", përmes ndërrimit të vendbanimit të përhershëm (femra shtatzënë, që ka lindur më parë fëmijë, duke shkuar te farefisi apo te të afërmit e saj në vendin tjetër, e merrte lejen sikur për lindjen e parë), kishin pasuar huazime të fëmijëve nga fqinjët, si dhe ishte paraqitur dukuria e një "kanibalizmi socialist" sui generis në fshatra dhe rajone të izoluara: mbytja masive e fëmijëve të posalindur të gjinisë femërore nga vetë prindërit vetëm e vetëm që në kuadër të kuotës së paraparë të lindnin djalë.[136] Pas disa viteve pasoja të mëdha e të menjëhershme do të ndjehen në mungesën e kontingjenteve të punës dhe në rritjen e kontingjenteve të të moshuarve, ku Kina do të bëhet vendi me numër më të madh të pleqve, me ngarkesa të mëdha të fondeve sociale dhe pensionale. Mbytja e fëmijëve të gjinisë femërore ende të palindur, në barkun e nënës (fetusi), e pranishme si dukuri këto tri dhjetëvjetëshat e fundit, sot ka si pasojë zvogëlimin e numrit të femrave dhe rrezikimin serioz të përtëritjes biologjike të popullsisë.

Në vitin 1987 Kongresi i SHBA-ve, refuzoi që përmes Fondit të OKB-së për aktivitete popullative dhe Federatës Ndërkombëtare për Planifikim të Familjes, t'i jepte ndihmë materiale Kinës me arsyetim se atje me mjete johumane po ushtrohej një represion i paparë në sferën më intime të jetës së njeriut, në lindjen e fëmijëve.[137] Në këtë mënyrë SHBA-ja prej Bukureshtit (1974) deri në Meksiko Siti (1984) formuluan edhe qëndrimin më të qartë se rritja e shpejtë e popullsisë nuk do të thoshte se e pengonte zhvillimin dhe u bënë kundërshtarë të rreptë të ndërpritjes më dhunë të shtatzënësisë.[138] Këtë qëndrim nuk e ndërruan edhe në Konferencën V Botërore mbi Popullsinë, e cila u mbajt në Kairo në vitin 1994. Diskutimet e ashpra rreth qasjes së kontrollit të lindjes dhe planifikimit të familjes u zhvilluan këto dhjetëvjetëshat e fundit edhe në instancat më të larta ndërkombëtare, në konferencat botërore mbi popullsinë dhe zhvillimin (Bukuresht, 1974; Meksiko Siti, 1984; Kairo, 1994). Përfaqësuesi i Kinës në Konferencën III Botërore mbi Popullsinë në Bukuresht për problemet demografike të vendeve në zhvillim i akuzoi BRSS-në dhe SHBA-në si fuqi eksploatuese dhe kolonialiste të këtyre vendeve dhe theksoi se “revolucioni dhe prodhimi mund t’i zgjidhin problemet e ushqimit

[136] "Kina: Jedan par - jedno dijete", *Žena*, br. 5, Zagreb, 1987, ff. 6-9.

[137] Shih më gjerë në: *Stanovništvo,* br. 1-4/1984-85, CDI, IDN, Beograd, ff. 148-149; "Kina: Jedan par - jedno dijete", *Žena*, br. 5, Zagreb, 1987, ff. 6-9.

[138] P. Demeny, "Bucarest, Mexico City and Bleyond", *Europen Juornal of Population,* No 1-2, 1985, p. 132-134; *Stanovništvo,* br. 1-4/1984-85, f. 149.

të popullatës".[139] Kina në këtë konferencë kishte një qëndrim kontraverz, sepse, në një anë tashmë e kishte aprovuar kërkesën e Maos se "është e domosdoshme të planifikohen lindjet" dhe ndodhej në prag të përvetësimit të sistemit të një fëmije, ndërsa në anën tjetër insistonte që në dokumentin e konferencës të hyjë mendimi tjetër i Maos se "njerëzit janë vlera më e lartë".

Në konferencën e Kairos ishin të ndryshme qëndrimet rreth lindshmërisë dhe planifikimit të familjes dhe kryesisht rreth abortit si mjet dhe metodë e kontrollit të lindjes. Mospajtime shprehën vendet katolike të Amerikës Latine, Vatikani dhe vendet myslimane, të cilat dështimin (abortin) e cilësuan si politikë autoritare të kontrollit të lindjeve dhe sulm të vrazhdë në vlerat themelore të familjes; u pajtuan që dështimet (abortet) mund të lejoheshin vetëm atëherë kur jeta e nënës është në rrezik. Megjithatë, në fund, siç theksuam edhe më parë, u arrit kompromisi në drejtim të formulimit të qëndrimit që të sigurohej që planifikimi i familjes të bëhej pa përdorimin e dhunës, duke u respektuar të drejtat e njeriut, vlerat kulturore dhe normat etike e konfesionale të popujve, si dhe përgjegjësia e individit dhe e çiftëve bashkëshortorë për shëndetin reproduktiv të tyre, nocion ky i kuptuar, siç theksuam edhe më parë, si gjendje e aftësisë së plotë fizike e mentale dhe e sigurisë sociale sa i përket sistemit të përtëritjes biologjike; që njerëzit, të aftë për jetë të mjaftueshme e të sigurt seksuale dhe riprodhim të jenë të lirë që të vendosin për këtë vetë; që meshkujt dhe femrat të kenë të drejtë të informohen dhe të kenë mundësi t'i përdorin metodat e sigurta, efikase dhe përgjithësisht të pranueshme për rregullimin e lindshmërisë, si dhe të drejtën e shfrytëzimit të institucioneve shëndetësore në mënyrë që gruas t'i mundësohet shtatzënësia dhe lindja e sigurt, ndërsa çiftëve bashkëshortorë fëmija i dëshiruar dhe i shëndoshë.[140]

5. Hipokrizia e ish-Jugosllavisë: fryma neomaltusianiste sui generis

Qarqet shkencore dhe qeveritare serbo-jugosllave para se të ndërmerrnin një fushatë dhune dhe terrori të hapur ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, kulturës dhe qenies autonome shtetërore, së pari shtruan çështjen e natalitetit dhe të planifikimit të familjes te shqiptarët, gjithnjë në frymën e një neomaltusianizmi sui generis, me elemente mjaft transparente të një racizmi. Institucionet dhe pushteti serbo-jugosllav problemin e planifikimit të familjes dhe të riprodhimit të popullsisë shqiptare e shtronin në formë të kërkesës për

[139] Y. Blayo, *Po aty,* f. 156.

[140] United Nations, *Program of Actions of the United Nations, International Conference on Population and Development,* Cairo, 5-13 September 1994.

kufizimin e mbarësimeve e të lindjeve me qëllim të zvogëlimit të rritjes së popullsisë shqiptare. Shpjegimet e para të tyre bazoheshin në kinse pengesat e shkallës së lartë të natalitetit për zhvillimin shoqëroro-ekonomik të shqiptarëve, por duke e lidhur procesin e lindjes me komponentin etnik, modelet e kulturës tradicionale, veçoritë ataviste me variablat specifike të vetëdijes, madje edhe me interesa dhe ideologji nacionaliste, me porosi shtetomëdha dhe me qëllim që, kinse duke i ndjekur serbët nga vatrat e tyre mesjetare, ta rrezikonin prosperitetin gjeodemografik, shtetëror e kombëtar të Serbisë dhe serbëve dhe të krijonin "Kosovën etnikisht të pastër" dhe "Shqipërinë e Madhe". Këtë tezë do ta gjejmë shumë më herët te "babai" i kombit serb, D. Qosiq, inspiruesit të të gjitha tragjedive njerëzore në ish-Jugosllavi kundër popujve joserbë, veçanërisht kundër shqiptarëve. Qysh në maj të vitit 1968, i pakënaqur me rënien e A. Rankoviqit, në një forum të lartë partiak të Serbisë, përveç tjerash, ai e shtroi si rrezik për serbët dhe sllavët e jugut edhe "ekspansionin e fuqishëm demografik të shqiptarëve dhe epërsinë numerike të tyre në territoret që i banojnë në hapësirat jugosllave".[141]

Një nga konstruksionet e një autori të Memorandumit famëkeq të ASSHA (1986), i cili që nga fillimi i viteve të 80-ta problemit të lindshmërisë së shqiptarëve i dha kahe negative, ishte: "Procesin eksploziv demografik, për të cilin bëhet fjalë, askush deri më sot nuk është përpjekur efektivisht ta qetësojë. Ky proces pa pengesë po përparon, me përkrahjen morale të ideologjisë secesioniste, të bazuar në ekskluzivitetin nacional të përmbledhur në parullën mbi Kosovën etnikisht të pastër",[142] ndërsa një anëtar i kreut partiak e shtetëror i ish-Jugosllavisë thoshte: "Ne e njohim shumë mirë njërën nga parullat kryesore të irridentës: blej tokë dhe lind fëmijë".[143]

Mirëpo, diskursi serbo-jugosllav nuk kishte për qëllim përmirësimin e cilësisë së lindjes, të riprodhimit dhe të jetës së shqiptarëve, por dobësimin e fuqisë vitalo-demografike të tyre me masa të represionit ekonomik, social, politik e psikologjik. Për ta mposhtur dominimin numerik dhe reproduktiv të

---

[141] Nga fjala e D. Qosiqit në Plenumin e XIV të KQ të LK të Serbisë më 29 maj 1968. Shih: D. Ćosić, *Kosovo,* Novosti, Beograd, 2004, f. 19. Libri, i përgatitur nga e bija e tij, Ana Qosiq-Vukiq, përmban shënimet dhe tekstet nga ditarët për Kosovën të babait të saj dhe "babait të kombit", përmbajtja e të cilëve është mirë e njohur tashmë 40 e më shumë vjet.

[142] M. Macura, "Predpostavke, načela i ciljevi populacione politike", në publikimin *Problemi politike obnavljanja stanovništva u Srbiji, Demografski zbornik,* Knj. I, SANU, Beograd, 1989, f. 240.
Po këto qëndrime do t'i gjejmë edhe në Memorandumin e Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve, që janë sigurisht të këtij autori (Shih *Memorandum SANU, 1-2, Naše teme,* Zagreb, 1988, ff. 153-157).

[143] S. Dolanc, Intervistë në të përjavshmen "*Teleks",* Lublanë, nëntor 1988.

shqiptarëve disa qarqe serbe dolën edhe me projekte për rikomponimin territorial të Kosovës, krijimin e autonomisë diferenciale dhe rrjedhimisht ndarjen e Kosovës,[144] që do të sillte vetëm rezultate gjenocidiale: eksod masiv të popullsisë shqiptare, dhunë dhe gjakderdhje.

Shqiptarofobia dhe shovinizmi serbojugosllav u shtrinë gjerë në gjithë opinionin dhe shoqërinë e atëhershme, ndërsa indoktrinimi dhe angazhimi antinatalist ishte pjesë përbërëse e strategjisë antishqiptare, ku fyhej rëndë femra shqiptare; në mitingjet histerike të serbëve në vitet e 80-ta jo rrallë dëgjohej edhe parulla: "Shqiptarët shumohen shumë, por farën e kanë të prishur".[145] Disa hulumtime anketuese me femrat serbe gjithashtu tregojnë se shqiptarofobia dhe shovinizmi serb u shtrinë gjerë në të gjitha shtresat e shoqërisë serbe: femrat e anketuara si një nga problemet kryesore në Serbi e konsideronin "ndjenjën e rrezikimit kombëtar për shkak të shkallës së lartë të natalitetit në Kosovë".[146] Në luftën antinataliste ndaj shqiptarëve me masa administrative, antisociale dhe anticivilizuese të tipit indiano-kinez ishte krijuar një bllok i fuqishëm serbo-malazezo-maqedonas, i mbështetur nga gjithë ish-Jugosllavia, ku Serbia përmes ish-Federatës e përdorte Maqedoninë dhe Tetovën si territor me kompaktësi etnike të shqiptarëve si *territor provues* dhe atë jo vetëm për ta kufizuar rritjen demografike të shqiptarëve, por edhe perspektivën e përgjithshme të tyre (shkollimi, punësimi etj.).[147] Pushteti

---

[144] B. Krstić*, Kosovo izmedju istorijskog i etničkog prava*, Kuća VID, Beograd, 1994, ff. 1-318.
Një vështrim kritik të këtij projekti të B. Kërstiqit, shih: H. Islami, *Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës*, ETMMK, Prishtinë, 1997, ff. 233-250.

[145] Kjo parullë ishte dëgjuar në vjeshtë të vitit 1987, në demonstratat e organizuara të grave serbo-malazeze kundër Fadil Hoxhës (ish-funksionar i lartë në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi) kinse i kishte fyer femrat serbe. Përveç kësaj parulle aty ishte shtruar kërkesa për armë dhe për vënien e Kosovës nën adiministrim ushtarak.

[146] M. Rašević, "Istraživačko iskustvo relevantno za program planiranja porodice", *Demografske sveske,* br. 24, CDI, IDN, Beograd, 1995, f. 16.
Disa femra serbe, në pesriatjet e tyre lidhur me natalitetin në Serbi kishin theksuar edhe këtë: "Po, natyrisht se problemi ynë është më i rëndë se i tjerëve. Shqiptarët nga 12 fëmijë, ndërsa ne asnjë" (gjellbërsja, 39-vjeçare, 5 herë kishte abortuar); "Na hëngrën shqiptarët" (nëpunëse bankare, 36-vjeçare, abortimi i tretë) (M. Rašević, *Po aty*).

[147] Kritikat ndaj kësaj qasjeje të pushtetit ndaj lindshmërisë së shqiptarëve ishin tepër të rralla. Megjithatë, një revistë javore e Zagrebit nga fundi i viteve të 80-ta të shekullit të kaluar mori guximin të thoshte diçka dhe ja çka shënoi: “Politika restriktive në sferën e natalitetit ka filluar të aplikohet që nga muaji i kaluar. Në të vërtetë, vetëm në nivel komunal, por është logjike të mendohet se shembulli i Tetovës dhe i RS të Maqedonisë mund të shërbejë edhe si model i përgjithshëm, aq më parë kur disa propozime të ngjashme u paraqitën edhe në nivel federativ. Në komunën e Tetovës u vendos që problemi i eksplosionit demografik të zgjidhet me masa administrative. Organizatat shoqërore-politike dhe këshilli ekzekutiv i komunës miratuan rezolutën mbi zhvillimin

maqedon, si në nivel të Republikës,[148] ashtu edhe në nivel të komunave, ku dominonin shqiptarët, nxori disa ligje për të ushtruar presion në sferën e lindjes, ku printe komuna e Tetovës.[149]

Madje tentohej që opinionit jugosllav t'i imponohej edhe bindja kinse përparimi i Kosovës dhe zgjidhja e problemeve sociale-ekonomike dhe e konflikteve ndëretnike nuk është e mundur pa zvogëlimin e natalitetit te shqiptarët.[150] Ndërsa, diskursi me qëllim të pengimit të lindjeve të një populli të tërë me masa të ndryshme administrative e represive, në Konventën e OKB-së mbi Pengimin dhe Dënimin e Krimeve Gjenocidale, njihet si veprim gjenocidal.[151]

Në kohën kur kundër shqiptarëve pushteti serbo-jugosllav ndërmerrte masa të hapëta të diskriminimit e të terrorit dhe zbatonte politikën e re kolonizuese me qëllim të vënies së baraspeshës etnike në Kosovë, ndërsa për serbët, maqedonët etj. [152] kërkonte rritjen e shkallës së natalitetit, madje me një

---

shoqëror-ekonomik të qytetit, e cila ka edhe pjesën e veçantë mbi popitikën popullative. Rezolutës si bazë do t'i shërbejë modeli i familjes katëranëtarëshe, që do të thotë se çdo familje e cila ka më shumë se dy fëmijë, për këtë arsye do të bartë pasoja konkrete ekonomike; fëmija i tretë (e tutje) nuk do të mund të gëzojë të drejtën shëndetësore dhe për këtë fëmijë nuk do të mund të merret as shtesa fëmijërore...Parashihet edhe ndërrimi i rregullores mbi ndarjen e banesave e të kredive, përcaktimi i lartësisë së të ardhurave dhe përparësitë në lëmin e punësimit" (S. Drakulić, "Natalitet i represija – zakon kroji porodicu", *Danas,* br. 311, Zagreb, 2. veljače, 1988, f. 68).

[148] Më 10 dhjetor 1987 Kuvendi i Maqedonisë miratoi rezolutën mbi politikën popullative në RS të Maqedonisë. Rezoluta të njëjta miratuan edhe Kuvendi i RSFJ-së në vitin 1989 (Službeni list SFRJ, br. 27, 28. april 1989), Kuvendi i RS të Serbisë dhe Kuvendi i KSA të Kosovës, ndërsa në favor të politikës popullative restriktive u angazhuan energjikisht komitetet e të gjitha niveleve të LK-së, Lidhja Socialiste e Kosovës, Serbisë dhe Jugosllavisë, entet federative, serbe dhe kosovare për shëndetësi, punë dhe politikë sociale dhe veçanërisht shtypi, radio dhe televizioni. Me politikën restriktive në sferën e lindshmërisë në veçanti u muar *Programi jugosllav i masave dhe i aktiviteteve për parandalimin e shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve nga Kosova.*

[149] "Në Tetovë organet kompetente të pushtetit luftën kundër natalitetit problematik e filluan me ligj. Meqenëse shtimi natyror i popullsisë në këtë komunë është shumë më i lartë se ai i dëshiruari, u vendos që një familje mund të ketë më së shumti dy fëmijë. Në të kundërtën, çiftët bashkëshortorë do të bartin edhe pasoja ekonomike, sepse prej fëmijës së tretë e tutje vetë do t'i paguajnë shërbimet mjekësore, barnat dhe shkollimin, ndërsa nuk do të marrin as shtesa fëmijërore" (S. Drakulić, "Natalitet i politika", *Danas,* br. 310, Zagreb, 26. siječnja 1988, f. 30).

[150] S. Stojanović, "Beleške o jugoslovenskoj krizi i nacionalnom pitanju", *Theoria,* nr. 3-4, B%ograd, 1987, f. 28.

[151] United Nations, *Convention on the Prevention and the Crime of Genocide (1948),* në publikimin *Human Rights: A Compilation of International Instruments,* New York, 1988 (neni II, pika d), pp. 143-144.

[152] Është interesant se edhe për popujt e tjerë që nuk janë me prejardhje sllave e jugosllave,

varg masash stimulative - shqiptarët si opinion dhe komb nuk kishin si ta përjetonin ndryshe diskursin për planifikimin e familjes dhe zvogëlimin e natalitetit të tyre pos si kërkesë dhe metodë gjenocidale të të menduarit dhe të sjelljes së shtetit jugosllav ndaj tyre.[153] Zaten, të gjitha regjimet serbe e jugosllave problemin e Kosovës u përpoqën ta zgjidhnin me shpërnguljen e shqiptarëve dhe kolonizimin e serbëve. Këto regjime e dëshironin edhe Kosovën e kolonizuar prej serbëve, edhe Kosovën e pazhvilluar dhe me nivel të ulët të natalitetit të tipit evropian për shqiptarët. Prandaj, edhe ky fakt ndikoi që pushteti të mos mund të bënte asnjë hap në drejtim të reduktimit të nivelit të natalitetit dhe të zgjidhjes kinse të konfliktit midis realizimit të të drejtave për lindje të lirë të shqiptarëve, në një anë, dhe interesit të tyre dhe të shoqërisë serbojugosllave, në anën tjetër.

Dështimi i pushtetit serbojugosllav në këtë drejtim lidhej edhe me faktin se si bazë për formimin e vetëdijes riprodhuese të karakterit shoqëror gjithnjë e me shumë shtrohej zgjerimi i njohurive mbi rolin e madh të riprodhimit të popullsisë për vazhdimësinë dhe substancën kombëtare të sllavëve të jugut, veçanërisht të serbëve, të cilën tendencë shqiptarët e shikonin si angazhim hegjemonist dhe antishqiptar. Mirëpo, për t'u arritur ky qëllim duhej të depërtohej thellë në ndryshimin e vetëdijes riprodhuese në nivel individual dhe familjar, ku popujt sllavë ka kohë që përjetojnë një krizë serioze, me implikime të mëdha, para së gjithash demografike, për çka dështmon procesi i denatalitetit, i shtimit negativ natyror dhe i moshënimit demografik, sidomos te serbët, te të cilët këto 40 vjetët e fundit norma neto e riprodhimit është nën nivelin e duhur për përtëritjen e popullsisë dhe zëvendësimin e brezave.[154]

---

siç janë p. sh. hungarezët e vllehët, të cilët ka kohë që shënojnë një regres të fuqishëm demografik në ish-Jugosllavi dhe Serbi jo që nuk brengosej askush, por në mënyra të ndryshme përkrahej politika e asimilimit të tyre. P. sh. në Serbi dhe Vojvodinë së bashku numri i hungarezëve zvogëlohet prej 449.857 në vitin 1961 në 345.376 në vitin 1991, ndërsa sipas regjistrimit të vitit 1981 në Serbi rreth 130.000 vetë deklaruan se gjuhë amëtare e kanë vllahishten, kurse me kombësi vllehe u përcaktuan vetëm rreth 25.000 persona; sipas regjistrimit të vitit 1991 në Serbi regjistrohen edhe më pak vllehë, vetëm 17.557 veta.

[153] "Disa thirrje, të cilat vijnë nga brengosjet për shkak të ekspansionit biologjik të popullatës në mjedisin e pazhvilluar, çfarë është Kosova, se thirrjet e tilla njënacionale që të pengohet lindja e numrit kaq të madh të shqiptarëve...kanë diçka në vete që hyn në modelin gjenocidal të të menduarit dhe të sjelljes" (Nga intervista e viktimologut të njohur prof. dr. Zvonimir Šeparović*, Start,* nr. 526, Zagreb, 18.03.1989, f. 17).

[154] G. Penev, "Područja Srbije bez prirodnog priraštaja stanovništva. Analiza po naseljima za 1991. godinu", *Demografske sveske,* nr. 24, CDI, IDN, Beograd, 1995, ff. 27-41.
Në gjysmën e viteve të 90-ta, sipas gjinekologëve serbë, në Serbinë "e gjerë", në 100 foshnja të lindura, 64 ishin joserbe, ndërsa shkalla e abortit ishte katërfishuar (NIN, 8. 11. 1996).

Një insistim i tillë ishte në kundërshtim të plotë me tërë qasjen e Jugosllavisë së atëhershme lidhur me planifikimin e familjes dhe kontrollin e lindjes, si dhe me angazhimin e saj për një qëndrim human edhe në suaza ndërkombëtare. Në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar në botë u proklamua dhe fuqimisht u afirmua parimi mbi të drejtën e njeriut që lirisht të vendosë për pasardhësit e tij. Ky parim, përveç të drejtave të njeriut për jetë dhe liri, hyn në radhën e të drejtave më elementare njerëzore, që ishte inkuadruar në të gjitha deklaratat dhe proklamatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ish-Jugosllavia, që ishte nënshkruese e shumë konventave, proklamatave dhe deklaratave ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, në rastin e Kosovës e të shqiptarëve në vitet e 80-ta i kishte shkelur në mënyrë drastike të gjitha dokumentet ndërkombëtare, ku bëhej fjalë për të drejtat e njeriut, siç janë: *Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut e OKB*-së (Nju-Jork, 1948), *Deklarata mbi të Drejtat e Fëmijës* (Nju-Jork, 1959), *Plani Botëror i Aksionit* për realizimin e qëllimeve të vitit ndërkombëtar të femrës (Meksiko Siti, 1975) dhe *Programi i Aksioneve* për gjysmën e dytë të dhjetëvjetëshit të OKB-së për femra (Kopenhagë, 1980), *Deklarata e Konferencës Ndërkombëtare mbi Mbrojtjen Primare Shëndetësore* (Alma-Ata, 1978), *Plani Botëror i Aksionit në Sferën e Popullsisë* (Bukuresht, 1974), *Deklarata mbi Popullsinë dhe Zhvillimin* dhe *Porositë për Realizimin e Mëtejmë të Planit Botëror të Aksionit në Sferën e Popullsisë* (Meksiko Siti, 1984) etj.

Ish-Jugosllavia nuk kishte pranuar të anëtarësohej edhe në Federatën Ndërkombëtare për Planifikim të Familjes derisa në Statutin e saj, nën presion të pjesës progresive të botës, nuk ishin hequr nenet me përmbajtje kryesisht neomaltusianiste. Edhe në tubimet më të larta botërore mbi popullsinë, që kishin jo vetëm karakter shkencor, por edhe politik, ish-Jugosllavia zyrtare, në zgjidhjen e problemeve të popullsisë, ishte kundër të ashtuquajturës "rrugë demografike".[155] Koncepti jugosllav, planifikimin e familjes e vinte në kontekst të zhvillimit të gjithmbarshëm socialo-ekonomik, duke i respektuar porositë humanitare në kuadër të raporteve midis gjinive dhe raporteve të përgjithshme njerëzore dhe të drejtat e njerëzve që lirisht të vendosin për numrin e fëmijëve dhe intervalin kohor midis lindjeve.[156] Në Rezolutën mbi

[155] "Me rastin e përcaktimit të masave të politikës demografike duhet patjetër të ekzistojë vetëdija dhe njohuria e qartë se problemet shoqërore nuk mund të zgjidhen përmes rrugës demografike, por me zhvillim ekonomik dhe social, si dhe me zhvillim të përhershëm të marrëdhënieve socialiste vetëqeverisëse" (Z. Grebo, *Čovjek, radjanje, društvo,* Svjetlost, Sarajevo, 1975, f. 266).

[156] "Duhet, para së gjithash, të theksohet se koncepti ynë i planifikimit të familjes është në kundërshtim të rreptë me botëkuptimin dhe qasjen neomaltusianiste, sipas së cilës ajo kuptohet si kufizim i lindjeve me qëllim që të zvogëlohet rritja e popullsisë (sidomos në vendet në zhvillim), përkatësisht si "ilaç" për zgjidhjen e të gjitha problemeve

Planifikimin e Familjes (1969)[157] dhe në Kushtetutën e vitit 1974, ajo angazhohej për karakterin decentralizues të përtëritjes njerëzore dhe flakte ndikimin e drejtpërdrejtë të shtetit dhe të shoqërisë në procesin e riprodhimit biologjik. Rezoluta mbi Planifikimin e Familjes e vitit 1969 nuk ishte proklamuar për qëllime demografike, por për shkaqe humanitare me synim që të përmirësohej pozita dhe shëndeti i femrës, si dhe pozita e brezave të ardhshëm. Në alinenë e parë të kësaj rezolute thuhej: "Realizimi i mundësive të prindërve që vetë të përcaktojnë numrin e fëmijëve dhe intervalin midis lindjeve është një ndër të drejtat dhe obligimet elementare njerëzore".[158] Ndërkaq, me formulimin kushtetues se "Është e drejtë e njeriut që lirisht të vendosë për lindjen e fëmijëve" dhe se "Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm për shkak të mbrojtjes së shëndetit",[159] vendosja e lirë për lindjen e fëmijëve bëhet edhe kategori e pavarur kushtetuese. Me këtë theksohej qartë fakti se roli i faktorit personal kishte rëndësi gjithnjë e më të madhe sa i përket mbarësimit, vëllimit të lindjeve dhe intervalit suksesiv midis tyre dhe madhësisë së familjes.

Delegacionet e ish-Jugosllavisë në konferencat botërore mbi popullsinë mbronin qëndrimin se problemet e popullsisë janë të ndërlidhura me zhvillimin ekonomik e shoqëror dhe në sferën e lindjes gjithnjë kishin parasysh të drejtat dhe liritë elementare njerëzore dhe konsideratat humane në kuadër të raporteve midis gjinive dhe të raporteve të përgjithshme njerëzore. Kështu në Konferencën III Botërore mbi Popullsinë (Bukuresht, 1974), shefi i delegacionit jugosllav dr. Anton Vratusha, kishte theksuar: "Garanci për realizimin e qëllimeve të shtruara në Jugosllavi janë shkalla e arritur e zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe kulturor, sistemi i vetëqeverisjes socialiste, Kushtetuta, e cila ndër të drejtat themelore të njerëzve përmban edhe të drejtën e vendosjes së lirë për lindjen e fëmijëve".[160] Ndërkaq, në Konferencën IV

ekonomike dhe sociale. Ngecja në zhvillim e shumë vendeve në botë, zhvillimi jo i shpejtë aktual, ndërkaq në instancë të fundit edhe "eksplosioni demografik" i kanë rrënjët e tyre në sundimin kolonial për një kohë të gjatë, në marrëdhëniet jo të drejta ekonomike ndërkombëtare, në çmimet e ulëta të atyre prodhimeve që i kanë vendet më pak të zhvilluara. Zvogëlimi i rritjes së popullsisë nuk i zgjidh problemet e përmendura vetvetiu, por është i domosdoshëm zhvillimi sa më i shpejtë i vendeve më pak të zhvilluara dhe vetëm në kushte të tilla mund të pritet se do të zgjidhen edhe problemet demografike" (D. Breznik, "Demografska kretanja u SR Srbiji i mere za rešavanje problema", *Stanovništvo,* br. 3-4/1975 - 1-2/1976, CDI, IDN, Beograd, ff. 28-29).

[157] *Rezolucija o planiranju porodice,* Savezna skupština, Beograd, 25. aprila 1969 (ac br. 1185).

[158] Po aty, alinea 1.

[159] *Ustav Socijalističke Federativne Republike Jugoslavije,* Beograd, 1974 (neni 191).

[160] "Svetska konferencija o stanovništvu", *Stanovništvo*, br. 3-4/1973 - 1-2/1974, CDI, IDN, Beograd, f. 212.

Botërore mbi Popullsinë (Meksiko, 1984), shefi i delegacionit jugosllav dr. Mijat Shukoviqi, për planifikimin e familjes kishte nënvizuar: "Kështu mendojmë se qëllimi i planifikimit të familjes është ngritja e cilësisë së jetës dhe realizimi i të drejtave të njeriut, e jo reduktimi i padëshirueshëm i fertilitetit, dhe se planifikimi i familjes do të jetë më cilësor dhe më efikas në qoftë se janë të volitshëm niveli i arsimit, i kulturës, i gjendjes shëndetësore dhe i rrethanave ekonomike të njerzëve".[161]

Mirëpo, në rastin e Kosovës e të shqiptarëve, ish-Jugosllavia në vitet e 80-ta i shkeli të gjitha këto qëndrime. Megjithatë, dështuan të gjitha tendencat neomaltusianiste e raciste, si dhe "rruga demografike" e zgjidhjes së problemeve ekonomiko-sociale dhe politike në Kosovë dhe te shqiptarët, të cilat donte t'i impononte ish-shteti jugosllav nën presion të hegjemonizmit serbomadh. Përkundër një thyerjeje të fuqishme demografike pas vitit 1991, me shpërnguljen masive të të rinjve shqiptarë, proces ky që është në vazhdë e sipër, përtëritja biologjike në Kosovë dhe te shqiptarët nuk është e rrezikuar.[162]

[161] Govor Dr Mijata Šukovića, šefa Jugoslovenske delegacije na svjetskoj konferenciji Ujedinjenih nacija o stanovništvu, Meksiko 1984, *Stanovništvo*, br. 1-4/1984-85, CDI, IDN, Beograd, f. 146.

[162] H. Islami, *Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës,* ETMMK, Prishtinë, 1997, f. 57.

II. EVOLUCIONI I MORTALITETIT TË POPULLSISË SË KOSOVËS

Për dallim nga nataliteti (lindshmëria), mortaliteti (vdekshmëria)[1] është komponentë negative në lëvizjen natyrore dhe në lëvizjen e përgjithshme të popullsisë. Shkalla e mortalitetit të përgjithshëm dhe më tepër e mortalitetit të foshnjave është indikator i rëndësishëm i gjendjes shëndetësore dhe i nivelit të zhvillimit socioekonomik e kulturor të një popullate. Mortaliteti është nën ndikim të drejtpërdrejtë dhe reciprokisht të lidhur të faktorëve biologjikë, ekonomikë, sociokulturorë dhe shëndetësorë, prandaj lëvizja e tij edhe duhet të trajtohet nën prizmin e këtyre determinanteve dhe rrethanave. Shumë më shpejt se nataliteti, mortaliteti i nënshtrohet ndikimit të të arriturave në sferën shëndetësore dhe socioekonomike në kuptim më të gjerë. Dallimet në nivelin e mortalitetit, si të përgjithshëm, ashtu edhe të atij specifik, midis popullatave të ndryshme janë rezultat i ndryshimeve të strukturës së popullsisë sipas moshës si faktor biologjik dhe i zhvillimit kompleks shoqëroro-ekonomik.

Meqenëse është dukuri negative dhe ndikon në zvogëlimin e numrit të përgjithshëm të popullsisë, për dallim nga nataliteti, ku ka pikëpamje pro dhe contra nivelit të tij, sot ekziston pajtueshmëri e plotë se duhet të bëhen përpjekje të mëdha që, sa më shumë që është e mundur, të zvogëlohet mortaliteti te të gjitha grup-moshat dhe të dy gjinitë e të gjitha popullatave atje ku ai është ende i lartë. Ky është qëllim përgjithësisht i dëshiruar jo vetëm i shkencës së mjekësisë, por edhe i gjithë gjinisë njerëzore pa marrë parasysh përkatësinë racore, etnike apo fetare. Zvogëlimi i mortalitetit deri në kufijtë e mundshëm biologjikë do të thotë zgjatje e jetës së njeriut dhe zgjatje e mesatares së jetës të të posalindurve, në një anë, dhe riprodhim racional e human i popullsisë dhe reduktim i konsumimit ekstensiv të shëndetit të femrës, në anën tjetër. Zgjatja e jetës së njeriut dhe zgjatja e mesatares së jetës të të posalindurve në demografi merret edhe si indikator sintetik i nivelit dhe i intensitetit të vdekshmërisë së një popullate.[2]

---

[1] Disa autorë angazhohen për një precizitet më të madh të nocionit të mortalitetit, meqenëse duhet të bëhet dallimi midis vdekshmërisë "normale" dhe vdekshmërisë "së jashtëzakonshme" (Shih: M. Livi Bacci, "Définition des crises de mortalité: théorie, pratique, méthodes", në *Prilozi demografskim i ekonomskim naukama,* SANU, Knj. 103, Beograd, 1994, pp. 75-76.

[2] Siç theksuam tashmë, m*esatarja e jetës* është pasqyrë e vdekshmërisë (mortalitetit) së të gjitha grupeve të popullsisë sipas moshës, ndërsa mesatarja e jetës së të posalindurve nënkupton numrin mesatar të vjetëve që do t'i jetojë fëmija i lindur sot (shansi për jetë), me kusht që të mos ndryshohet mortaliteti sipas moshës nga gjendja që vështrohet në atë vit.

Deri në Luftën II Botërore shkalla e mortalitetit, si të përgjithshëm, ashtu edhe të atij specifik (vdekshmëria e foshnjave, e fëmijëve të vegjël, e grave në periudhën prokreative etj.) në botë ishte në nivel shumë të lartë. Natyrisht, prinin vendet dhe popujt e pazhvilluar të botës. Mirëpo, me aksionet që ndërmori OKB-ja dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) për likuidimin e shumë sëmundjeve të karakterit endemik dhe epidemik, në këto vende mortaliteti u zvogëlua shpejt. Rënia e shpejtë e tij, në rrethanat e natalitetit ende mjaft të lartë, edhe ka kushtëzuar rritjen e shkallës së shtimit natyror dhe të numrit të përgjithshëm të popullsisë në këto vende. Intensiteti i rënies së mortalitetit në vendet dhe rajonet e pazhvilluara duket më i shpejtë edhe për shkak se niveli i tij në këto pjesë të botës, deri vonë në shekullin XX, ishte tepër i lartë, edhe pse procesi i transicionit demografik nisi t'i përfshijë vonë.[3] Në disa vende të botës, veçanërisht në Afrikë dhe në Amerikën Latine, përkundër reduktimit të konsiderueshëm, shkalla e vdekshmërisë është ende e lartë, sidomos e vdekshmërisë së foshnjave.[4]

1. Tipi tradicional i mortalitetit

Derisa te popullatat e shumë vendeve dhe territoreve të gjera apo të ngushta brenda tyre, në saje të të dhënave mbi ngjarjet vitale, mbi lëvizjen natyrore, pra edhe mortaliteti si komponentë e saj shumë i rëndësishëm, mund të përcillet qysh para disa shekujve, ndërkaq në Kosovë dhe te shqiptarët, në mungesë të regjistrave të gjendjes civile apo informatave të ngjashme statistikore, ku evidencohen dukuritë themelore demografike, rrjedhën e mortalitetit mund ta përcjellim vetëm nga fillimi i shekullit të kaluar, përkatësisht nga viti 1911,[5] ndërsa për popullsinë e Shqipërisë edhe më vonë,

[3] F. Meslé-J. Vallin, "La mortalité dans le monde: tendances et perspectives", *Les dossiers du CEPED*, No 30, Paris, 1995, pp. 12-15.

[4] Në vendet e pazhvilluara norma e mortalitetit të përgjithshëm është zvogëluar dukshëm për shkak të rritjes së mbrojtjes shëndetësore të popullatës, por edhe të strukturës shumë të re të popullsisë, ndërsa në vendet e zhvilluara shkalla e këtij mortaliteti duket e lartë, madje me tendencë të rritjes për shkak të procesit të moshënimit demografik (Anglia 11,6, Danimarka 11,1, Gjermania, Belgjika, Suedia mbi 10 promilë). Derisa mesatarja e mortalitetit të foshnjave në vitin 2001 në Evropë ishte rreth 8 promilë (vendet më të zhvilluara të kontinentit nën 5 promilë), në shumë vende të Afrikës është mbi 50 promilë, si p. sh. në Madagaskar 96, në Nigeri 75, në Senegal 68, në Zimbabve 65 promilë etj., ndërsa në Indi është 68 dhe në Kinë 31 promilë (*Images économiques du monde 2004,* A. Colin, Paris, 2004, pp. 34-35).

[5] Shih më gjerë: R. Njegić, "Prirodno kretanje stanovništva NR Srbije od 1863. do 1954. godine", *Prikazi*, br. 20, Zavod za statistiku Srbije, Beograd, 1957; V. Simeunović,

vetëm nga fundi i viteve të 30-ta.[6] Edhe pse nuk janë të plota, këto të dhëna ofrojnë një mundësi për ta përcjellë lëvizjen e mortalitetit dhe të zhvillimit bazë demografik të kohës që i referohen, në një anë, dhe për ta bërë rikonstruimin edhe të gjendjes sociodemografike të periudhës para shekullit XX, kur popullsia kishte rrjedha ciklike të zhvillimit, gjë që krejt varej nga intensiteti i sëmundjeve epidemike, të cilat në pamundësi që të lokalizoheshin e eliminoheshin, merrnin përmasa të gjera dhe viktima të mëdha (murtaja, kolera, lia, malaria, tifoja, tuberkulozi etj.),[7] pastaj vitet e thatësisë, luftërat etj., ku më së shumti e pësonin foshnjat, fëmijët dhe femrat në periudhën e përtëritjes biologjike (15-49 vjet). *Për këto arsye edhe përparimi demografik ishte tepër i ngadalshëm, sikurse te të gjitha popullatat e periudhës paraindustriale*.[8]

Deri në dhjetëvjetëshin e gjashtë të shekullit XX, në Kosovë dhe në trojet shqiptare në përgjithësi, për shkak të mbrojtjes së dobët shëndetësore,[9] standardit shumë të ulët jetësor,[10] ku lufta për të siguruar ekzistencën ishte dukuri përcjellëse, kushteve të rënda higjienike, nivelit të ulët të kulturës shëndetësore etj., shkalla e mortalitetit ishte shumë e lartë, ndërsa në shumë mjedise rurale dhe agrare ishte shumë mbi mesataren e Kosovës. Në vitet e 50-ta ushqimi ishte tepër i njëtrajtshëm dhe i pamjaftueshëm, prandaj ekspertët

---

"Stanovništvo Jugoslavije i socijalističkih republika 1921-1961", *Studije, analize i prikazi,* br. 22, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1964.

[6] *Vjetari Statistikor i RPSH 1969 dhe 1970,* Drejtoria e Statistikës, Tiranë, 1970, ff. 25-26.

[7] Për viktimat nga murtaja në Francë, në Mesdhe dhe në Evropë është shkruar një libër i madh në dy vëllime. Shih: J.-N. Biraben, *Les Hommes et la peste en France et dans les pays européens et méditerranéens,* Mouton, Paris, 2 tomes, pp. 1-456.

[8] M. Reinhard, A. Armengaud et J. Dupaquier, *Histoire générale de la population mondiale,* III éd., Montchrestien, Paris, 1968, pp. 9-174; A. Armengaud, *Démographie et sociétés*, Stock, Paris, 1966, pp. 13-67.

[9] Çfarë ishte gjendja në lëmin e shëndetësisë në Kosovë para dhe menjëherë pas Luftës II Botërore tregojnë këto të dhëna: në prag të kësaj lufte Kosova kishte 5 spitale me gjithsej 390 shtretër, 5 shtëpi të shëndetit (me 5 mjekë); gjithsej kishte 39 mjekë dhe 14 kuadro ndihmësmjeku (me shkollë të mesme dhe pa të). Në vitin 1945 ky numër zvogëlohet në 14 mjekë dhe 7 ndihmësmjeku, kurse numri i farmacistëve është gjithsej 9. Në vitin 1952 në një mjek vinin 8.526 banorë, ishin 101 ndihmësmjeku dhe 1.308 shtretër. I gjithë ky kuadër shëndetësor ishte i përqëndruar në vendbanimet e atëhershme urbane (Më gjerë në: *Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror i KSA të Kosovës 1947-1972,* Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1974, f. 133).

[10] Kosova ishte territor ku në strukturën e ushqimit deri vonë pas Luftës II Botërore dominonin gjërat ushqimore bimore (rreth 82%), ku buka përbënte rreth 75%; dominonte buka e misrit dhe rreth 90% të prodhimit të tij është përdorur për ushqimin e njerzëve (Shih më gjerë: S. Tošović, "Potrošnja prehrambenih proizvoda u seoskim domaćinstvima NR Srbije", *Poljoprivreda i zadrugarstvo,* br. 9, Beograd, 1961, ff. 18-19; S. Šuvar, "Životni i društveni standard u našem današnjem selu", *Naše teme,* br. 12, Zagreb, 1964, f. 1980).

konstatuan se "në pjesën dërmuese të popullsisë ushqimi është në atë masë larg parimeve themelore të fiziologjisë sa që mund të thuhet se ai i kundërvihet ligjeve të fiziologjisë së ushqimit dhe është për t'u habitur se si mund të mbahet organizmi me këtë ushqim ".[11]

Në shekullin XX, në lëvizjen e vdekshmërisë nuk janë pa ndikim edhe faktorët e jashtëm, në radhë të parë luftërat, që shihet nga numri i madh i vdekjeve midis viteve 1914-1918 (Luftërat Ballkanike, Lufta I Botërore). Prandaj, deri në fund të gjysmës së parë të këtij shekulli, ndërsa në shumë mjedise rurale edhe më vonë, shtimi natyror ishte i ulët dhe përgjithësisht me rrjedha ciklike dhe përparimi demografik i ngadalshëm. Deri në vitet e 50-ta shkalla e mortalitetit në Kosovë mund të krahasohej me vlerat ekstreme në botë, ndërsa fluktuimet në nivelin e tij ishin karakteristikë e përgjithshme.

Deri në vitet e 50-ta të shekullit të kaluar, shkalla e mortalitetit në Kosovë mund të krahasohej me shumë vende të pazhvilluara të botës: p.sh. në gjysmën e viteve të 50-ta me Egjiptin (21 promilë), Sudanin (19 promilë) etj.[12] Deri në këto vite, për nga të gjitha veçoritë e vdekshmërisë, Kosova i përkiste tipit tradicional të mortalitetit: shumë e lartë shkalla e mortalitetit të përgjithshëm[13] te të dy gjinitë, por me fluktuime të konsiderueshme, shumë i lartë mortaliteti i foshnjave[14] dhe i fëmijëve të vegjël, vdekja më e madhe te femrat në të gjitha grup-moshat, veçanërisht në vitet e para të jetës dhe në periudhën e riprodhimit biologjik, dominimi i shkaqeve ekzogjene të vdekjes, zgjatja e mesatares së pritur të jetës mjaft e ulët (nën 50 vjet), [15] sidomos te femrat etj.

---

[11] K. Šnajder, "Ishrana i njen uticaj na biološku snagu stanovništva u Autonomnoj Kosovsko-Metohijskoj Oblasti", *Zbornik radova SAN,* XXVII, Institut za izučavanje ishrane naroda, knj. 2, Beograd 1953; *Stanje i mogućnosti razvoja privrede Kosova i Metohije,* Priština, 1957, f. 27.

[12] Shih më gjerë: F. Gendreau, *La population de l'Afrique. Manual de démographie,* Khartala, CEPED, Paris, 1993, pp. 1-463.

[13] Mortaliteti i përgjithshëm nënkupton numrin e të vdekurve në 1.000 banorë gjatë një viti.

[14] *Mortaliteti i foshnjave* ose mortaliteti infantil nënkupton numrin e foshnjave të vdekura në 1.000 lindje të gjalla (0 - 365 ditë).

[15] Mesatarja e jetës së të posalindurve në Kosovë në fillim të viteve të 50-ta ishte për meshkujt rreth 49 vjet, ndërsa për femrat rreth 45 vjet (Suedia 71 dhe 74 vjet).

Tabela 1. Lëvizja e numrit absolut dhe e normës së vdekjeve në Kosovë në periudhën 1911-1940[16]

Viti	Numri i të vdekurve	Në 1.000 banorë	Viti	Numri i të të vdekurve	Në 1.000 banorë
1911	12.522	26,6	1926	13.629	27,1
1912	12.230	27,5	1927	13.462	26,6
1913	12.939	28,8	1928	13.699	26.1
1914	15.465	34,4	1929	12.887	24,0
1915	22.185	50,5	1930	13.016	23,7
1916	14.504	33,0	1931	13.020	23,5
1917	17.766	40,8	1932	12.058	21,3
1918	24.163	57,8	1933	12.245	21,2
1919	13.222	30,7	1934	12.622	21,5
1920	13.133	29,9	1935	11.903	19,9
1921	13.451	30,0	1936	11.430	18,8
1922	13.049	29,0	1937	11.160	18,1
1923	13.665	29,5	1938	12.286	19,9
1924	13.600	28,3	1939	11.541	18,0
1925	13.666	28,0	1940	12.230	19,0

Tabela 2. Lëvizja e mortalitetit të përgjithshëm dhe e mortalitetit të foshnjave në Kosovë prej 1947-2005[17]

Viti	Numri i vdekjeve	Në 1000 banorë	Numri i foshnjave të vdekura	Në 1000 foshnje të lindura
1947	9.325	13,0	-	-
1950	12.991	17,0	4.977	141,3
1955	15.292	18,2	6.025	164,0
1960	13.365	14,2	5.518	132,5
1965	11.767	10,9	5.341	122,6
1970	10.829	8,7	4,296	96,3

[16] *Prirodno kretanje stanovništva Srbije od 1863. do 1954. godine, Prikazi 20*, Zavod za statistiku NR Srbije, Beograd, novembar 1957, ff. 60-61, 68-71.

[17] Burimi: *Demografska statistika 1990,* SZS, Beograd, 1992, ff. 27, 32; *Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës, IX,* Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1984, f. 27; *Statistički godišnjak Jugoslavije,* SZS, Beograd, 1987, ff. 438-439; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku,* br. 052, Beograd, 24.02.1998, ff. 6-11; *Demografska statistika 2000*, SZS, Beograd, 2002, ff. 63-74; për vitet 1997-2000 vlerësimi, ndërsa për vitet 2002-2006 *Statistikat vitale të Kosovës 2006,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2007, f. 9.

1975	10.018	7,1	3.961	80,3
1980	8.909	5,7	3.069	57,7
1985	11.826	6,7	3.026	56,1
1990	8.214	4,1	1.897	34,4
1995	8.671	4,1	1.058	23,6
2000	8.624	3,7	781	18,2
2005	7.207	3.5	357	9.6

Tabela 3. Lëvizja e shkallës së mortalitetit të përgjithshëm dhe e mortalitetit të foshnjave në Kosovë 1911-2005 sipas periudhave pesëvjeçare (në promilë)[18]

	Morataliteti i përgjithshëm	Mortaliteti i foshnjave
1911-1915	34,0	-
1916-1920	38,0	-
1921-1925	30,0	-
1926-1930	25,0	-
1931-1935	21,0	198,2
1936-1940	18,0	161,8
1947-1950	15,5	159,7
1951-1955	18,2	155,6
1956-1960	14,9	145,1
1961-1965	12,4	132,4
1966-1970	9,7	105,7
1971-1975	8,1	84,1
1976-1980	6,5	72,8
1981-1985	6,2	64,2
1986-1990	5,3	52,1
1991-1995	3,9	29,2
1996-2000	3,8	17,2
2002-2005[19]	3.2	12.0

[18] Burimi: *Prirodno kretanje stanovništva NR Srbije od 1863. do 1954, Prikazi 20,* Zavod za statistiku NR Srbije, Beograd, 1957, ff. 60-61, 68-71; *Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës, IX,* Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1984, f. 27; *Statistički godišnjak Jugoslavije* (vitet përkatëse), SZS, Beograd, 1987, ff. 438-439; H. Islami, *Rrjedha demografike shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 1994, f. 37; *Saopštenje SZS,* br. 052, 24.02.1998, f. 11; *Demografska statistika 2000,* SZS, Beograd, 2002, ff. 63-74; për vitet 1997-2000 vlerësimi; për vitin 2002-2006 *Statistikat vitale të Kosovës 2006,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2007, f. 9.

[19] Për vitin 2001 mungojnë të dhënat.

Nga të dhënat shihet se ka pasur fluktuime në nivelin e mortalitetit, sidomos në fillim të shekullit XX dhe në vitet e 50-ta të tij, ku sikur del se më i ulët ishte mortaliteti në periudhën 1911-1915 se më vonë apo menjëherë pas Luftës II Botërore më i ulët se në fillim të viteve të 50-ta. Ose, p.sh., nuk është e mundur që në vitin 1950 shkalla e mortalitetit të foshnjave të jetë më e lartë te meshkujt se sa te femrat etj. Një gjendje dhe lëvizje e tillë e mortalitetit mund të shpjegohet pikërisht me faktin e zënë në gojë se nuk janë regjistruar të gjitha rastet e vdekjeve, sikundër edhe të lindjeve, madje për periudhën e fillimit të shekullit as që mund të flitet për funksionimin e shërbimeve civile dhe evidencimin e saktë të lindjeve, vdekjeve, martesave dhe shkurorëzimeve. Por edhe menjëherë pas Luftës II Botërore, shërbimet e gjendjes civile karakterizoheshin me dobësi të mëdha, ku në bazë të disa hulumtimeve, defektet në statistikën vitale kishin të bënim vëçanërisht me Kosovën, shqiptarët dhe popullsinë e konfesionit mysliman. Kështu, p.sh., për Kosovë dhe Sanxhak konsiderohet se numri i rasteve të vdekjeve jo të regjistruara në periudhën 1948-1953 ka mundur të arrijë madje edhe deri 10.000 veta.[20] Në bazë të rezultateve të kontrollit të statistikës vitale, të bërë sipas metodës së mostrës nga fundi i vitit 1955, si dhe të një ankete mbi përfshirjen e ngjarjeve vitale të realizuar në vitet 1967-1970 del se në Kosovë mospërfshirja për vitin 1955 ishte 12,6% (Mali i Zi 24,6%; BeH 9,1%), ndërsa në vitet 1967-1970 13,0% (BeH 13,6%; Maqedonia 9,2%).[21] Ose, kur të krahasohen të dhënat absolute dhe relative për mortalitetin midis Kosovës dhe Shqipërisë në vitin 1939, shihet qartë se është fjala për defekte të mëdha, sepse nuk është e mundur që në Kosovë të jenë të dy këto vlera më të larta se në Shqipëri, kur dihet se, sipas vlerësimeve për të dy popullatat, Shqipëria kishte diçka mbi një milion banorë, ndërsa Kosova rreth 650.000 banorë. Në anën tjetër, gjendja shëndetësore dhe socioekonomike në asnjë mënyrë nuk ka mundur të ishte më e mirë në Shqipëri se në Kosovë.

Variacione në shkallën e mortalitetit hetohen edhe më vonë, me kërcime të mëdha në disa vite si te mortaliteti i përgjithshëm, ashtu edhe te ai i foshnjave. Një dukuri e tillë vërehej pothuajse në të gjitha territoret e ish-Jugosllavisë në vitet 1951, 1953, 1955, 1957 dhe 1962, por më karakteristike ishte në Kosovë dhe në Maqedoni. Dallimet në shkallën e mortalitetit të përgjithshëm në këto vite në raport me vitet e mëparshme në Kosovë arrijnë deri në 3 promilë, ndërsa në Maqedoni deri në 2 promilë. Por fluktuimet më të mëdha janë pikërisht te mortaliteti i foshnjave, të cilat në Kosovë sillen deri në 33 promilë dhe në Maqedoni deri në 25 promilë.[22] Një fluktuim i tillë

[20] Shih më gjerë: *Prvi rezultati popisa stanovništva NR Srbije od 31. III. 1953. godine*, Zavod za statistiku i evidenciju NR Srbije, Beograd, 1953, Serija B, sv. 3, f. VII.

[21] *Demografska statistika 1990,* SZS, Beograd, 1992, f. 7.

[22] N. Stojkov - Z. Jevtić, *Uticaj sezonskih i ostalih faktora na mortalitet stanovništva*

shpjegohet si rrjedhim i rrethanave jo të volitishme klimatike, të paraqitjes së gripit etj.,[23] por në këto territore nuk përjashtohet edhe mundësia e mosregjistrimit të të gjitha rasteve të vdekjes.

Është e vërtetë se këto vitet e fundit shkalla e mortalitetit të përgjithshëm (por jo edhe e atij të foshnjave) në Kosovë ka arritur nivelin shumë të ulët, ku pos faktorëve socialë, ekonomikë e shëndetësorë, ka ndikuar edhe vetë faktori demografik dhe, më konkretisht, struktura shumë e re e popullsisë, por edhe përfshirja jo e plotë e të gjitha rasteve të vdekjeve nga fundi i viteve të 80-ta dhe fillimi i viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, siç vëmë në pah më parë, te rrjedha e natalitetit. Prandaj, me rastin e prezentimit të të dhënave të statistikës demografike serbo-jugosllave për ngjarjet vitale (lindjet dhe vdekjet) në Kosovë dhe te shqiptarët në vitet e zëna në gojë duhet pasur parasysh faktin dhe tendencën e përfshirjes jo të plotë të lindjeve dhe vdekjeve, si dhe të kurorëzimeve dhe shkurorëzimeve apo nënregjistrimin e tyre, që e pranojnë edhe autorët dhe institucionet statistike serbe.[24] Sepse, kurrë nuk është e mundur që vdekshmëria e foshnjave në vitet e 90-ta të zvogëlohej aq shumë, gati në nivel të vendeve më të zhvilluara të botës, kur diheshin rrethanat e përgjithshme në Kosovë pas okupimit të saj (1989), të cilat kanë ndikuar vetëm në rritjen e saj.

Tabela 4. Ecuria e mortalitetit të përgjithshëm në Kosovë dhe në Shqipëri në disa vite karakteristike (në vlera absolute dhe relative)[25]

Viti	Kosova		Shqipëria	
	Numri i vdekjeve	Në 1000 banorë	Numri i vdekjeve	Në 1000 banorë
1939	20.725	17,6	16.013	15.1
1950	12.991	17,0	17.215	14,0
1960	13.365	14,2	16.775	10,4

Jugoslavije 1950-1969, Studije, analize i prikazi, 59, SZS, Beograd, 1972, ff. 10, 18.

[23] Grup autorësh, *Demografski razvitak Kosova i Metohije* (interna studija), CD, IDN, Beograd, 1963, f. 3; N. Stojkov - Z. Jevtić, *Po aty,* ff. 7-25.

[24] G. Penev, "Područja Srbije bez prirodnog priraštaja stanovništva. Analiza po naseljima za 1991. godinu", *Demografske sveske,* CDI, IDN, nr. 24, Beograd, 1995, f. 30; Grup autorësh, "Naselja u Srbiji sa negativnim ili nultim prirodnim priraštajem u 1991. godini", *Stanovništvo,* nr.1-4/1992 - 1-2/1993, CDI, IDN, Beograd, 1993, f. 227.

[25] Burimi për Kosovën: V. Simeunović, *Stanovništvo Jugoslavije i socijalističkih republika 1921-1961,* Studije, analize i prikazi, SZS, Beograd, 1964, ff. 42-46; *Saopštenje SZS,* br. 052, Beograd, 24.02.1998, ff. 10-11; *Statistikat vitale të Kosovës 2006,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2007, f. 9; burimi për Shqipërinë: *Vjetari Statistikor i RPSH 1969 dhe 1970,* Drejtoria e Statistikës, Tiranë, 1970, ff. 25-26; *Vjetari Statistikor i RPS të Shqipërisë 1991,* Drejtoria e Statistikës, Tiranë, 1991, ff. 52-53; *Shqipëria në shifra 2005,* INSTAT, Tiranë, 2006, f. 10; *Treguesit socialë,* INSTAT, Tiranë, 2007 (sipas: http://www.instat.gov.al).

1970	10.829	8,9	19.774	9,2
1980	8.909	5,7	16.981	6,4
1990	8.214	4,1	18.193	5,6
1995	8.078	3,9	18.060	5,6
2000	8.624	3,7	16.421	5,4
2004	7.395	3,2	17.749	5,7

2. Mortaliteti sipas gjinisë dhe moshës

Në vendet dhe popullatat e zhvilluara niveli i mortalitetit në të gjitha grup-moshat është më i lartë te meshkujt dhe dallimet rriten pas moshës 20-vjeçare dhe sidomos pas moshës 50-vjeçare, që shihet qartë në shembullin e Sllovenisë, ndërsa në vendet dhe popullatat e pazhvilluara është e kundërta, bile deri në moshën 40-vjeçare, që vërehet në shembullin e Kosovës; në gjithë periudhën pas Luftës II Botërore në Kosovë dominonin meshkujt, ku numri i meshkujve në 100 femra të lindura gjallë sillej midis 110 dhe 108. Në bazë të hulumtimeve të deritanishme të shkencës mjekësore, demografike etj., del se në tipin e parë të popullatave ndikim dominant ka faktori biologjik, që do të thotë se ndër të lindur gjallë më tepër janë fëmijë të gjinisë mashkullore (5 deri 7%), ndërsa në tipin e dytë determinantet socioekonomike kanë ndikim të madh në dallimet e përmendura.[26]

Po të formohej struktura e popullsisë sipas gjinisë nën ndikimin e natalitetit diferencial dhe mortalitetit gjithashtu diferencial, atëherë duhet pritur që vdekja e fëmijëve të gjinisë mashkullore të jetë më e madhe, veçanërisht në vitin e parë të jetës, ngase lindin më shumë fëmijë të kësaj gjinie. Mirëpo, meqenëse pikërisht në vendet e zhvilluara jeta e njeriut është e gjatë dhe duke pasur parasysh edhe mobilitetin hapësinor të popullatës, raporti numerik midis meshkujve dhe femrave ndryshon. Edhe pse dukuria e natalitetit diferencial në shkencë ende duhet të shpjegohet, supozohet se në këto vende arsyet pse meshkujt vdesin më shumë se femrat pas moshës 20-vjeçare mund të përmblidhen në faktin se ushtrojnë profesione më të rënda (xehetarët, ndërtimtarët, bujqit deri në moshën 60-vjeçare etj.), se më shumë pësojnë në fatkeqësi të komunikacionit dhe më shumë i nënshtrohen vdekjeve të dhunshme (vetëvrasjet, vrasjet), disa sëmundje më shumë i godasin meshkujt se sa femrat, siç janë ato kardiovaskulare, sëmundjet kancerogjene në përgjithësi etj., pastaj faktori alkool dhe duhan, i cili lë pasoja të rënda në shëndetin e njeriut, më tepër i godet meshkujt, sepse ata më shumë i konsumojnë etj.[27]

---

[26] Më gjerë në*:* A. Wertheimer-Baletić, *Demografija (Stanovništvo i ekonomski razvitak),* Zagreb, 1982, ff. 167, 222-224.

[27] Shih më hollësisht*:* D. Breznik, "Neke demografske karakteristike smrtnosti stanovništva Jugoslavije"*, Stanovništvo*, 1-4/1989 dhe 1-2/1990, CDI, IDN, Beograd, 1990, ff. 13-19.

Tabela 5. Shkallët specifike të mortalitetit në Kosovë sipas moshës dhe gjinisë prej vitit 1950-1990 dhe në Slloveni më 1950 dhe 1990[28]

Mosha	Gjinia	Kosova					Sllovenia	
		1950	1960	1970	1980	1990	1950	1990
0	M.	156,7	152,8	97,0	65,2	34,5	95,3	9,9
	F.	135,9	167,4	110,9	67,2	35,4	74,5	6,7
1-4	M.	21,8	16,8	5,5	2,4	1,7	3,8	0,3
	F.	22,8	22,1	6,9	2,5	1,6	3,3	0,2
5-9	M.	3,9	1,6	0,9	0,6	0,6	1,4	0,3
	F.	2,2	1,0	0,6	0,4	0,5	1,0	0,2
10-14	M.	2,2	1,0	0,6	0,4	0,4	1,1	0,3
	F.	2,4	1,1	0,5	0,3	0,3	0,8	0,1
15-19	M.	2,9	1,2	0,7	0,8	0,5	2,3	0,8
	F.	5,2	2,5	0,9	0,4	0,2	1,2	0,3
20-24	M.	5,8	2,1	1,5	0,7	0,6	3,6	1,4
	F.	9,6	3,2	0,9	0,6	0,3	1,7	0,5
25-29	M.	6,0	1,6	1,4	0,8	0,7	3,6	1,5
	F.	8,5	3,8	1,4	0,7	0,6	2,3	0,4
30-34	M.	7,1	2,7	1,6	1,4	0,9	4,0	1,8
	F.	10,5	3,8	2,1	0,9	0,7	2,5	0,6
35-39	M.	6,3	2,5	1,8	1,7	0,4	4,4	2,3
	F.	7,7	4,9	2,7	1,3	1,0	2,2	1,0
40-44	M.	8,0	4,4	3,8	2,8	2,4	6,4	3,7
	F.	8,0	5,2	3,2	2,2	1,3	3,7	1,6
45-49	M.	7,9	7,2	5,6	4,6	3,7	9,1	6,6
	F.	7,9	5,7	3,7	3,0	2,1	4,8	2,5
50-54	M.	11,8	9,3	9,8	6,1	6,0	13,0	10,1
	F.	8,8	10,3	5,4	4,3	3,7	7,0	4,1
55-59	M.	12,5	18,2	14,0	10,9	10,8	18,8	18,5
	F.	11,2	11,9	10,3	5,9	4,8	11,3	6,1
60-64	M.	24,3	24,9	22,4	16,5	16,9	26,8	24,4
	F.	18,0	22,1	16,6	9,5	9,8	19,7	9,4
65-69	M.	26,9	37,9	30,2	25,3	25,8	39,3	35,6
	F.	19,7	29,2	21,2	16,0	15,5	31,3	16,1
70-74	M.	49,2	49,9	50,1	43,9	38,5	62,7	52,6
	F.	41,8	40,5	43,2	30,9	19,6	54,5	29,8
75-79	M.	63,8	68,2	71,6	59,0	55,5	101,4	89,3
	F.	51,6	53,7	51,9	42,9	35,8	95,3	55,4
80-84	M.	87,5	83,5	92,4	81,3	80,7	158,0	133,9
	F.	87,3	73,5	78,1	73,4	57,3	163,4	95,2
85 e më	M.	157,5	135,4	67,7	105,6	83,9	254,5	162,3
tepër	F.	134,0	88,5	111,2	88,6	57,4	241,2	165,6

[28] Burimi: *Demografska statistika, 1990,* SZS, Beograd, 1992, ff. 74, 77.

Në vendet e pazhvilluara, çfarë është Kosova dhe trojet e tjera etnike shqiptare, mortaliteti më i madh i femrave ka të bëjë kryesisht me vitet e para të jetës dhe me periudhën e riprodhimit (fertiliteti i lartë), si rezultat i kushteve të pavolitshme shëndetësore dhe i lindjeve të shumta jasht enteve përkatëse (maternitetit), por edhe ndikimit të botëkuptimeve tradicionale etj. Në familjet shqiptare, siç dihet, gjithmonë u kanë kushtuar kujdes më të madh fëmijëve të gjinisë mashkullore, duke i lënë pas dore fëmijët e gjinisë femërore, të cilët, në rrethanat edhe ashtu të rënda socialo-shëndetësore e të tjera, edhe vdisnin më tepër, shpeshherë në pikëpamje fiziologjike të shëndoshë. Një qëndrim i tillë ka një traditë të gjatë, por në shumë mjedise ruralo-patriarkale është ruajtur edhe sot e gjithë ditën, ndërsa shkaqet lidhen me nevojën për meshkuj si krah i punës në ekonominë natyrale dhe si faktor i domosdoshëm i kontinuitetit të familjes, të trashëgimit të pasurisë, si mbajtës të prindërve në pleqëri etj.[29] Ndonëse në rrethana të caktuara shoqëroro-historike, ku dominonte tipi i ekonomisë agrare natyrale, pikëpamjet dhe qëndrimet patriarkale lidhur me vlerësimin e funksionit të femrës në përgjithësi kanë mundur (natyrisht padrejtësisht) të gjenin mbështetje, sot ato në asnjë mënyrë nuk mund të justifikohen. Përveç rolit që ajo gjithnjë kishte dhe ka në zhvillimin e bashkësisë njerëzore, natyra ia kishte përcaktuar edhe një rol tjetër të madh, të rëndë dhe me përgjegjësi - përtëritjen e gjinisë njerëzore. Sot, në rrethanat e reja të shoqërisë shqiptare në përgjithësi, qëndrimi ndaj fëmijëve të gjinisë femërore dhe femrës në përgjithësi ka pësuar ndryshime të konsiderueshme, por jo edhe të mjaftueshme. Se çfarë është rrjedha e mortalitetit sipas moshës dhe në çfarë shkalle janë dallimet midis Kosovës si vend i pazhvilluar dhe Sllovenisë si vend i zhvilluar në periudhën pas Luftës II Botërore, më së miri shihet nga të dhënat (tabela 5).

3. Mortaliteti i foshnjave dhe shkaqet e tij

Pas viteve të 60-ta vërehet tendenca e zvogëlimit të mortalitetit, si të përgjithshëm (numri i të vdekurve në 1.000 banorë brenda një viti), ashtu edhe mortalitetit të foshnjave ose mortalitetit infantil (numri i të vdekurve në 1.000 lindje të gjalla prej 0 - 365 ditë), me një tempo të shpejtuar pas viteve të 70-ta, ndonëse në krahasim me vendet e zhvilluara evropiane e të tjera (në vitin 1984 mortaliteti i foshnjave sillej në Japoni rreth 6, në Suedi rreth 7 dhe në Norvegji rreth 8 promilë) dhe ish-republikat e Jugosllavisë së

[29] H. Islami, *Fshati i Kosovës*, ff. 139-140.

Dytë (më 1989 Sllovenia rreth 8, Kroacia dhe Serbia rreth 11 promilë) mortalitei mbetet në nivel akoma shumë të lartë.

Është fakt se rënia relativisht e shpejtë e mortalitetit është rezultat i përmirësimit të kushteve sociale dhe jetësore të popullsisë, duke u nisur nga ushqimi dhe struktura e tij, përmirësimi i kushteve të banimit, të higjienës, të veshmbathjes, të shërbimeve shëndetësore dhe zgjerimit të mjeteve sanitare e deri te ngritja e vetëdijes për ruajtjen e shëndetit, për shërim dhe lindje në entet shëndetësore dhe për vlerësimin e jetës në përgjithësi. Mirëpo, mortaliteti i foshnjave ka mbetur ende shumë i lartë në nivel të Kosovës dhe më tepër sipas përkatësisë rajonale, sociale dhe etnike. Deri në fund të viteve të 60-ta mortaliteti i foshnjave në Kosovë ishte tepër i lartë, ku ndër fëmijtë e vdekur të moshës deri 4-vjeçare gëlltitte më se gjysmën: në vitin 1968 p.sh. në 100 të vdekur të kësaj moshe 67,3% përbënin foshnjat (Serbia 48,1%; Sllovenia 45,4%), ndërsa deri në vitin 1965 mesatarisht në vit vdisnin mbi 5.000 foshnje, që përbënte më se një të katërtën e të gjitha foshnjave të vdekura në ish-Jugosllavi, ndërsa pas okupimit të Kosovës dhe përjashtimit të mjekëve dhe personelit ndihmës mjekësorë shqiptarë, supozohet se edhe numri i foshnjave të vdekura ishte në rritje, ndonëse sipas të dhënave të burimeve zyrtare serbe del e kundërta; edhe rezultatet e projeksioneve të autorëve dhe institucioneve serbe për periudhën 1991-2016 sipas variantit me migrime, tregonin p. sh. se në vitin 1996 mortaliteti i foshnjave në Kosovë duhej të ishte rreth 47 promilë. Vlerësohet se numri i foshnjave të vdekura mund të përbënte deri rreth një të pestën e të gjithë të vdekurve në Kosovë, dukuri kjo që mund të haset vetëm në vendet më të pazhvilluara. Niveli i lartë i tij shihet më së miri kur të krahasohet me vendet e zhvilluara në vitet e fundit, ku kjo vdekshmëri sillej në Japoni, Suedi dhe Finlandë rreth 5 promilë, në Norvegji, Danimarkë, Britani të Madhe dhe Sllloveni rreth 7 promilë dhe në Kroaci rreth 9 promilë.[30] Ky mortalitet me nivelin relativ dhe vëllimin absolut që ka sot në Kosovë paraqet një problem të madh jo vetëm shëndetësor, por edhe human dhe shoqëror në përgjithësi.

Mortaliteti i foshnjave, siç dihet, paraqet indikatorin më të rëndësishëm jo vetëm në pasqyrimin e gjendjes së vërtetë shëndetësore të popullit, por edhe të të arriturave në sferën sociale, ekonomike dhe kulturore të tij. Në vargun e shumë fatkeqësive që e kanë përcjellë zhvillimin e popullatës sonë gjatë historisë ishte edhe mortaliteti i foshnjave, sepse viktimë ishin të posalindurit, ndërsa pasojat ishin të shumënduarshme shëndetësore, sociale dhe demografike. Ky mortalitet, siç dihet, paraqet

[30] *The State of World Population 1996,* UNFPA, New York, 1996, pp. 114-117.

indikatorin më të rëndësishëm jo vetëm në pasqyrimin e gjendjes së vërtetë shëndetësore të popullit, por edhe të të arriturave në sferën sociale, ekonomike dhe kulturore të tij. Foshnja është shumë e ndjeshme ndaj të gjitha rrethanave jetësore e sociale, sikurse janë ushqimi, banimi, kujdesi etj. Dhe niveli deri vonë mjaft i lartë i mortalitetit të përgjithshëm ishte kushtëzuar pikërisht nga shkalla shumë e lartë e mortalitetit të foshnjave, e cila deri në vitet e 50-ta të shekullit të kaluar ishte ndër më të lartat në botë (midis 180 e 200 promilë mesatarisht në vit). Se pos faktorëve të tjerë, në zvogëlimin e mortalitetit të përgjithshëm ka ndikuar natyrisht vetë faktori demografik dhe, më konkretisht, struktura shumë e re e popullisë, më së miri tregon niveli dhe rrjedha e mortalitetit të foshnjave.

Kur të vështrohen shkaqet e vdekjes së foshnjave midis popullatave të pazhvilluara dhe atyre të zhvilluara, vërehet një fakt karakteristik. Në popullatat e para, të cilave i përket Kosova, niveli i lartë i mortalitetit të foshnjave është rezultat i ndikimit të *shkaqeve ekzogjene (të jashtme) të vdekjes,* siç janë p.sh. pazhvillueshmëria e rrjetit shëndetësor dhe, lidhur me të, përfshirja jo e mjaftueshme e lindjeve në entet shëndetësore, ku deri në fillim të viteve të 90-ta jashtë tyre dhe pa ndihmë profesionale lindnin rreth një e treta e foshnjave, pastaj mbrojtja e pamjaftueshme e nënave dhe e të posalindurve, kushtet jo të volitshme socioekonomike të jetës (ushqimi, banimi), shkalla e ulët e arsimimit shëndetësor të nënave dhe popullatës në përgjithësi etj. Shëndeti i fëmijëve, sidomos i atyre në vitet e para të jetës, varet shumë nga shëndeti i nënës gjatë shtatzënësisë dhe lindjes. Ndërsa, në popullatat e dyta, që u takon p.sh. Suedia, Norvegjia, Sllovenia etj., dominojnë *shkaqet endogjene (të brendshme) të vdekjes,* sikurse janë malformacionet gjenetike, lindjet e hershme (dështimet), lëndimet dhe rastet e fatkeqësive me rastin e lindjes, shkaqet që lidhen me veçoritë trashëguese etj.

Duke pasur parasysh *moshën e foshnjes* (0 - 365 ditë), shkaqet e përgjithshme të mortalitetit të foshnjave, si ato socioekonomike, ashtu edhe shkaqet e tjera, në demografi ndahen në *mortalitet neonatal,* që përfshin vdekjen e foshnjave deri në 28 ditët e para të jetës dhe në *mortalitet postneonatal,* që ka të bëjë me foshnjat e vdekura në periudhën prej 28 deri 365 ditë të jetës. Derisa në vendet e zhvilluara gjithnjë ka dominuar mortaliteti neonatal (në vitet e 80-ta në Sllloveni rreth 70%, në Suedi rreth 64%), ndërsa në Kosovë deri vonë dominoi, por edhe sot dominon mortaliteti postneonatal. Në vitet e para të pas Luftës II Botërore, në Kosovë p.sh., nga numri i përgjithshëm i foshnjave të vdekura, rreth 30% i përkiste mortalitetit neonatal, ndërsa rreth 70% mortalitetit postneonatal, kurse rreth viteve të 90-ta ndikimi i shkaqeve ekzogjene dhe i mortalitetit postneonatal është

zvogëluar, por dallimet ende mbesin të mëdha (55%:45%).[31] Ndërkaq, në vitin 1995, sipas statistikës demografike serbe, që duhet të merret me rezervë për arsye që i përmendëm më parë, hetohet një ndryshim i dukshëm pozitiv, ku raporti midis mortalitetit neonatal dhe mortalitetit postneonatal ishte 60,0%:40,0%.[32] Një raport i tillë, sipas vlerësimeve, mbeti deri në fund të shekullit XX.[33] Në Kosovë, sikurse në të gjitha viset e pazhvilluara, më tepër vdesin foshnjat e gjinisë femërore, ndërsa në Slloveni si vend i zhvilluar është e kundërta, por pas viteve të 80-ta në këto dy territore dallimet vijnë duke u zvogëluar, kurse në vitet e 90-ta, sipas të dhënave të statistikës vitale, edhe në Kosovë normë më të lartë të mortalitetit të foshnjave kanë meshkujt (tabela 6); mortaliteti i foshnjave i të dy gjinive në Kosovë në vitin 1997 ishte 18,2, ndërsa në Slloveni në vitin 2001 ishte 4,9 promilë.

Tabela 6. Shkallët e mortalitetit të foshnjave sipas gjinisë në Kosovë dhe në Slloveni në disa vite karakteristike[34]

Gjinia	Kosova						Sllovenia	
	1950	1960	1970	1980	1990	1995	1950	1990
Meshkuj	156,7	152,8	97,0	65,2	34,5	25,6	95,3	9,9
Femra	135,9	167,4	110,9	67,2	35,4	21,4	74,5	6,7

Tabela 7. Lëvizja e mortalitetit të përgjithshëm dhe e mortalitetit të foshnjave në Kosovë prej 1947-2006[35]

Viti	Numri i vdekjeve	Në 1.000 banorë	Numri i foshnjave të vdekura	Në 1.000 foshnje të lindura
1947	9.325	13,0	-	-
1950	12.991	17,0	4.977	141,3
1951	14.833	19,0	5.103	174,2
1952	13.867	17,5	5.197	145,9
1953	16.726	20,6	5.999	173,4

[31] *Demografska statistika 1990,* SZS, Beograd, 1992, f. 96.
[32] *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, f. 228.
[33] *Demografska statistika 2000,* SZS, Beograd, 2002, f. 276.
[34] Burimi: *Demografska statistika 1990,* SZS, Beograd, 1992, ff. 74, 77; *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, f. 94; *Images économiques du monde 2004,* A.Colin, Paris, 2004, p. 247.
[35] Burimi: *Demografska statistika, 1990,* SZS, Beograd 1992, ff. 27, 32; *Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës, IX,* Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1984, f. 27*; Statistički godišnjak Jugoslavije,* SZS, Beograd, 1987, ff. 438-439; *Demografska statistika 1993,* SZS, Beograd, 1996, ff. 54, 57; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku,* br. 012, Beograd, 17.01.1996, ff. 10-16; *Demografska statistika 2000*, SZS, Beograd, 2002, ff. 63-74; *Statistikat vitale të Kosovës 2006,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2007, f. 9.

1954	13.201	15,9	5.520	143,0
1955	15.292	18,2	6.025	164,0
1956	13.692	15,9	5.175	136,8
1957	15.300	17,5	5.464	160,0
1958	11.598	13,0	4.928	125,4
1959	12.878	14,0	5.190	138,9
1960	13.365	14,2	5.518	132,5
1961	11.759	12,2	5.108	125,9
1962	15.024	15,1	6.072	146,9
1963	12.423	12,2	5.351	128,9
1964	12.731	12,1	5.418	127,3
1965	11.767	10,9	5.341	122,6
1966	10.266	9,2	4.357	102,7
1967	11.308	9,8	4.739	107,7
1968	10.781	9,1	4.552	102,0
1969	10.892	9,2	4.404	94,8
1970	10.829	8,9	4.296	96,3
1971	10.312	8,2	4.215	89,6
1972	10.270	8,0	3.753	78,3
1973	10.358	7,8	4.053	84,9
1974	10.075	7,4	4.069	81,6
1975	10.018	7,1	3.961	80,3
1976	10.149	7,0	3.678	71,6
1977	9.811	6,6	3.681	73,8
1978	9.776	6,4	3.409	69,5
1979	9.575	6,1	3.424	71,1
1980	8.909	5,7	3.069	57,7
1981	9.677	6,1	3.024	62,9
1982	10.479	6,4	3.466	65,6
1983	11.040	6,6	3.437	69,2
1984	10.573	6,2	2.921	52,9
1985	11.826	6,7	3.026	56,1
1986	10.446	5,8	2.819	51,7
1987	10.307	5,6	2.848	50,7
1988	10.257	5,4	2.916	51,8
1989	10.181	5,3	2.745	51,2
1990	8.214	4,1	1.897	34,4
1991	8.526	4,3	1.757	33,9
1992	8.004	4,0	1.726	34,4
1993	7.804	3,8	1.471	33,3
1994	7.667	3,7	1.081	24,9
1995	8.671	4,1	1.058	23,6

1996	8.392	3,9	734	15,9
1997[36]	8.624	3,9	781	18,2
1998	8.624	3,7	781	18,2
1999	8.624	3,7	781	18,2
2000	8.624	3,7	781	18,2
2002	5.654	2,8	403	11,2
2003	6.417	3,2	483	15,1
2004	6.399	3,1	415	11,8
2005	7.207	3,5	357	9,6
2006	7.479	3,6	410	12,0

Deri vonë pas Luftës II Botërore, pos sëmundjeve të tjera, *tuberkulozi* ishte shumë i zgjeruar te fëmijtë: në vitin 1951 në 100.000 fëmijë të moshës përkatëse në Kosovë nga tuberkulozi kishin vdekur mbi 150 fëmijë (Sllovenia 20), ndërsa në vitin 1961 norma e mortalitetit nga tuberkulozi te fëmijtë në Kosovë ishte 34,7 (Sllovenia 1,4).[37] Mortaliteti nga tuberkulozi si te fëmijët, ashtu edhe te të rriturit deri vonë duhet të ishte shumë më i madh, sepse raportet e shërbimeve përkatëse mbi shkaqet e vdekjes ishin plot mangësi, ku nga numri i përgjithshëm i të vdekurve në vitin 1955 vetëm 8,2% kishin vdekur në organizatat shëndetësore, vetëm 27,0% ishin shëruar para vdekjes dhe vetëm për 24,3% të të vdekurve dihej shkaku i konstatuar nga mjeku, që do të thotë se të gjitha rastet as që kanë mundur të zbuloheshin. Pas viteve të 70-ta e të 80-ta këto raporte ishin ndryshuar dukshëm pozitivisht, por ende nuk ishin të kënaqshëm në krahasim me territoret e tjera të ish-Jugosllavisë dhe vendeve të zhvilluara.[38]

Me përjashtimin e punëtorëve shqiptarë nga institucionet e shëndetësisë publike (1990), gjendja shëndetësore e popullit ishte keqësuar dhe, lidhur me këtë, ishte thelluar raporti i shkaqeve të vdekjes së foshnjave në favor të faktorëve ekzogjenë (mortaliteti postneonatal), ku vend të rëndësishëm zinin sëmundjet infektive, e në kuadër të tyre edhe tuberkulozi, që konsiderohet si sëmundje sociale, meqenëse paraqitja e saj, përveç standardit shëndetësor, lidhet me një varg faktorësh të karakterit social. Kjo do të thotë se në Kosovë dhe te shqiptarët në përgjithësi shkaqet kryesore të mortalitetit të lartë të foshnjave janë rezultat shumë më pak të faktorëve të natyrës biologjike e shumë më tepër të rrethanave të pavolitshme shëndetësore dhe socioekonomike. Në numrin më të madh të rasteve të vdekjes është, pra, fjala për foshnjat fiziologjikisht të shëndosha.[39]

---

[36] Sipas të dhënave të statistikës demografike të Beogradit për vitin 2000, prej vitit 1997-2000 gjendja është e pandryshueshme.

[37] N. Stojkov, "Mortalitet dece od tuberkuloze u Jugoslaviji od 1951-1962. godine", *Stanovništvo,* br. 4, CDI, IDN, Beograd , 1964, ff. 352-353.

[38] *Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës, XIII,* Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1988, f. 36.

[39] Me aspektet demografike të mortalitetit të foshnjave dhe shkaqeve të tij më së shumti është marrrë demografi francez J. B.-Pichat (Shih më gjerë: J. Bourgeois-Pichat, "De la

Mirëpo, *struktura e të vdekurve sipas shkaqeve të vdekjes* në Kosovë tregon një gjendje edhe më karakteristike, pothuajse pa dallime sipas gjinisë: në vitin 1988, nga numri i gjithëmbarshëm i të vdekurve të dy gjinive, vendin e parë e zinin sëmundjet e sistemit cirkulator ose të enëve të gjakut (rreth 31%), pastaj gjendjet jo mjaft të definuara dhe simptomet (rreth 29%), neoplazmat dhe sëmundjet kancerogjene (8,3% për meshkuj dhe 6,3% për femra), sëmundjet e sistemit respirator (rreth 8%), sëmundjet infektive dhe parazitore (rreth 7%), lëndimet dhe helmimet (rreth 7% për femra dhe rreth 2,5% për meshkuj), sëmundjet e sistemit digjestiv (rreth 2%) etj. Ndërkaq, në vitin 1995 në raport me vitin 1985, radha e sëmundjeve nuk ndryshonte, por dallimet ishin në pjesëmarrjen e tyre. Gjendja dukej kështu: nga numri i gjithmbarshëm i të vdekurve të dy gjinive, vendin e parë e zënin sëmundjet e sistemit cirkulator ose të enëve të gjakut (55,0%:36,0%), pastaj gjendjet jo mjaft të definuara dhe simptomet (7,0%:15,0%), neoplazmat dhe sëmundjet kancerogjene (11,0%:6,0%), sëmundjet e sistemit respirator (5,0%:18,0%), sëmundjet infektive dhe parazitore (4,0%:10,0%), lëndimet dhe helmimet (2,0%:3,0%), sëmundjet e sistemit digjestiv (2,0:2,0%) etj.[40]

Në ish-njësitë e zhvilluara të ish-Jugosllavisë, me dallime të theksuara sipas gjinisë, dominonin sëmundjet e sistemit cirkulator (Vojvodina 65,8% për femra dhe 54,1% për meshkuj; Serbia 60,5% për femra dhe 50,8% për meshkuj; Kroacia 58,8% për femra dhe 44,8% për meshkuj; Sllovenia 55,2% për femra dhe 42,4% për meshkuj), pastaj vinin sëmundjet kancerogjene (Sllovenia 23,2% për meshkuj dhe 18,7% për femra; Kroacia 22,0% për meshkuj dhe 16,8% për femra; Vojvodina 19,1% për meshkuj dhe 16,1% për femra; Serbia 17,0% për meshkuj dhe 15,7% për femra), ndërsa në raport me Kosovën përqindja e gjendjeve jo mjaft të definuara dhe simptomeve ishte shumë e ulët dhe pa dallime sipas gjinisë (Serbia dhe Kroacia rreth 6%, Vojvodina rreth 4% dhe Sllovenia rreth 2%). Ndërkaq, sa i përket vdekjeve të dhunshme (fatkeqësitë, vetëvrasjet dhe vrasjet), në Kosovë në vitin 1950 në 100.000 banorë vinin 21,0 veta (Sllovenia 59; Vojvodina 44,9; Kroacia 42,1; Serbia 26,9), ndërsa në vitin 1988 ky numër zvogëlohet në 6,4 veta (Sllovenia 66,3; Kroacia 63,4; Vojvodina 38,4; Serbia 38,3).[41] Më herët, *përqindja e shkaqeve jo mjaft të definuara të mortalitetit të foshnjave* ishte shumë më e madhe; në vitin 1967 p.sh. në

mesure de la mortalité infantile", *Population,* janvier-mars, INED, Paris, 1946; "La mesure de la mortalité: les causes de décès", *Population,* juillet-septembre, INED, Paris, 1951; "La mesure de la mortalité infantile: principes et méthodes", *Population,* avril-juin, INED, Paris, 1961; "Évolution récente de la mortalité infantile", *Population,* 3, INED, Paris, 1964, etj.).

[40] *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, f. 100.

[41] D. Breznik, *Stanovništvo Jugoslavije*, f. 103.

Kosovë kjo përqindje arrinte në 64,2% (Serbia 36,3%; Kroacia 31,8%; Vojvodina 14,9%; Sllovenia 7,2%).[42]

Tabela 8. Lëvizja e mortalitetit të përgjithshëm dhe e mortalitetit të foshnjave në Serbi dhe në Vojvodinë prej 1950-2000[43]

Viti	Numri i vdekjeve	në 1.000 banorë	Numri i foshnjave të vdekura	Në 1.000 foshnje të lindura
Serbia				
1950	53.361	12,4	12.243	101,7
1960	43.283	9,0	5.941	68,7
1970	47.295	9,1	3.075	39,9
1980	52.953	9,3	1.899	23,5
1990	60.287	10,3	1.162	17,2
1995	67.493	11,5	955	15,0
2000	73.966	12,9	587	10,7
Vojvodina				
1950	23.490	14,0	6.223	145,1
1960	18.589	10,1	2.407	73,4
1970	19.916	10,2	906	35,7
1980	23.227	11,4	549	19,1
1990	25.228	12,3	322	14,1
1995	27.266	13,7	238	10,6
2000	30.076	15,5	198	10,5

4. Zgjatja e mesatares së jetës të të posalindurve

Kur të vështrohet evolucioni i mortalitetit në çdo popullatë, duhet të vihet në pah ndikimi i një faktori shumë me rëndësi, e kjo është *zgjatja e mesatares së jetës të të posalindurve*, i cili në demografi merret edhe si indikator sintetik i nivelit dhe i intensitetit të vdekshmërisë së një popullate.[44]

[42] N. Stojkov, *Smrtnost dece i omladine u Jugoslaviji od 1951-1968,* Studije, analize i prikazi, 58, SZS, Beograd, 1971, f. 30.

[43] Burimi: *Demografska statistika 1993,* SZS, Beograd 1996, ff. 52-57; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku,* br. 012, Beograd, 17. 01. 1996, ff. 7-16; *Demografska statistika 2000*, SZS, Beograd, 2002, ff. 71-73.

[44] Mesatarja e jetës është pasqyrë e mortalitetit të të gjitha grupeve të popullsisë sipas moshës, ndërsa mesatarja e jetës së të posalindurve nënkupton numrin mesatar të vjetëve që do t'i jetojë fëmija i lindur sot (shansi për jetë), me kusht që të mos ndryshohet mortaliteti sipas moshës nga gjendja që vështrohet në atë vit.

Sa i përket mesatares së jetës të të posalindurve midis vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim rreth viteve të 90-ta të shekullit XX dallimet janë të mëdha: në të parat sillej rreth 74 vjet, kurse në të dytat rreth 60 vjet. Në qoftë se krahasohet mesatarja e jetës të të posalindurve në fillim të viteve të 80-ta në raport me fillimin e viteve të 50-ta të shekullit të kaluar në Kosovë, shihet qartë se është bërë një ndryshim i madh te të dy gjinitë: për meshkujt është rritur për rreth 20 vjet, ndërsa për femrat për rreth 26 vjet. Midis Kosovës dhe ish-republikave të zhvilluara të ish-Jugosllavisë në fillim të viteve të 50-ta, edhe në këtë indikator dallimet ishin mjaft të mëdha, sidomos te femrat, sikundër që këto dallime nuk ishin të vogla edhe në raport me Shqipërinë, ndërsa me vendet e zhvilluara (Suedia etj.) dallimet arrinin për femra rreth 30 vjet dhe për meshkuj rreth 22 vjet.

Tabela 9. Lëvizja e zgjatjes së mesatares së jetës të të posalindurve në Kosovë dhe në disa vende të tjera me shkallë të ndryshme të zhvillimit, sipas gjinisë[45]

Vendi	Gjinia	1952-1954	1980-1982	1985	1990	2001
Kosova	M.	48,6	68,1	-	70,5	-
	F.	45,3	71,5	-	74,9	-
Serbia	M.	59,1	61,1	-	70,1	-
	F.	69,4	73,9	-	75,0	-
Sllovenia	M.	63,0	68,1	-	69,3	72,0
	F.	67,3	75,2	-	77,1	79,0
Japonia	M.	-	-	75,5	-	78,0
	F.	-	-	81,6	-	85,0
Suedia	M.	70,8 (1957)	-	73,8	-	77,0
	F.	74,3	-	79,9	-	82,0
Norvegjia	M.	-	-	72,6	-	76,0
	F.	-	-	79,9	-	81,0
Shqipëria	M.	52,6 (1950-	67,7	68,7 (1980-	-	72,0
	F.	54,4 1951)	72,2	75,5 1981)	-	76,0

Për analizën dhe përcjelljen e nivelit dhe lëvizjes së mortalitetit të popullsisë duhet përmendur edhe dy indikatorë të tjerë, gjithashtu të karaktert sintetik. Është fjala për *moshën mesatare të të vdekurve* dhe *përqindjen e të*

[45] Burimi: *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku, br. 510,* Beograd; D. Breznik, *Stanovništvo Jugoslavije*, Chronos, Titograd, 1991, f. 108; *Demografska statistika, 1990*, SZS, Beograd, 1992; OUN, *Demographic Yearbook,* New York, 1988; *Vjetari Statistikor i RPSSH-së*, Drejtoria e Statistikës, Tiranë, 1990, f. 50; *L'État du monde 2004*, La Découverte, Paris, 2004, pp. 90-251.

vdekurve të moshës mbi 50 vjet në numrin e përgjithshëm të të vdekurve. Me zvogëlimin e mortalitetit, mosha mesatare e të vdekurve suksesivisht rritet dhe këtë rrjedhë e dikton kryesisht rënia e mortalitetit të foshnjave, e fëmijëve të vegjël dhe e të rinjve në përgjithësi. Në krahasim me vendet dhe popullatat e zhvilluara, në Kosovë te të dy gjinitë kjo moshë mesatare është e ulët pikërisht për shkak të shkallës së lartë të mortalitetit të foshnjave. Rreth viteve të 50-ta kjo mesatare në Kosovë për meshkujt ishte 21,5 vjet (Serbia 37,7; Sllovenia 48,7) dhe për femrat 23,0 vjet (Serbia 42,1; Sllovenia 55,0). Ndërsa në vitin 1989 edhe në Kosovë vërehej rritje e konsiderueshme e kësaj moshe, si pasojë e zvogëlimit të mortalitetit të foshnjave dhe e fëmijëve të vegjël: për meshkujt mosha mesatare e të vdekurve ishte 45,3 vjet (Serbia 66,2; Sllovenia 64,6) dhe për femrat 42,9 vjet (Serbia 71,0; Sllovenia 73,2).

Sa i përket numrit absolut dhe relativ të të vdekurve mbi 50 vjet, gjithashtu në Kosovë, në numrin e përgjithshëm të të vdekurve vërehet përqindje e ulët e personave mbi këtë moshë përsëri për arsye të përqindjes së lartë të të vdekurve nën 5 vjet. Rreth viteve të 50-ta të shekullit të kaluar përqindja e personave të vdekur të moshës mbi 50 vjet në numrin e përgjithshëm të të vdekurve në Kosovë për meshkujt ishte 21,3% (Serbia 41,4%; Sllovenia 58,1%) dhe për femrat 21,0% (Serbia 48,1%; Sllovenia 68,6%), kurse rreth viteve të 90-ta në Kosovë shënohen ndryshime pozitive, por jo edhe të kënaqshme në raport me vendet e tjera. Kështu, përqindja e të vdekurve mbi këtë moshë rritet për meshkuj në 55,6% (Serbia 86,9%; Sllovenia 83,4%) dhe për femra në 49,2% (Serbia 91,2%; Sllovenia 92,8%).[46]

5. Diferencimi shoqëror i vdekshmërisë

Me rastin e hulumtimit të evolucionit të vdekshmërisë të çdo popullate, pasqyrën më komplete të nivelit dhe lëvizjes së mortalitetit e ofron diferencimi i tij sipas karakteristikave të ndryshme shoqërore**,** para së gjithash sipas aktivitetit ekonomik, përkatësisë socioprofesionale, arsimore, rurale, urbane, etnike etj., por si problem kryesor dalin mungesa e të dhënave dhe disa të meta të natyrës metodologjike, të cilat këtu, për shkak të hapësirës së kufizuar, nuk mund t'i trajtojmë hollësisht. Mirëpo, sipas hulumtimeve të deritanishme, është vërejtur një rregullsi e përgjithshme: shkalla më e lartë e mortalitetit është te popullsia e mbajtur, popullsia bujqësore, popullsia e pashkolluar, popullsia rurale, pastaj te personat aktivë ose te pensionistët, që i përkasin ose i përkisnin sektorit primar dhe sekondar të veprimtarisë ekonomike (bujqit, minatorët,

[46] *Demografska statistika*, SZS, Beograd, 1990; D. Breznik, *Stanovništvo Jugoslavije*, f. 110.

ndërtimtarët etj.), si dhe kategoria e personave të sektorit terciar (punëtorët e komunikacionit). Rregullsia e përgjithshme e diferencimit shoqëror të mortalitetit mund të përmblidhet në faktin se sa më e lartë që të jetë pozita sociale e një kategorie të popullsisë në strukturën shoqërore, aq më i ulët është niveli i mortalitetit dhe e kundërta.[47]

Sa i përket *përkatësisë etnike,* si një nga kategoritë sociale, në ish-Jugosllavi p.sh., shkallë më të lartë të mortalitetit kanë pasur shqiptarët: mortalitet të përgjithshëm deri në gjysmën e viteve të 60-ta të shekullit XX, ndërsa mortalitet të foshnjave deri në fund të këtij shekulli. Në vitin 1953 shkalla e mortalitetit të përgjithshëm te shqiptarët ishte 25,2 promilë (serbët 11,2; sllovenët 10,0), më 1961 14,1 promilë (serbët 8,2; sllovenët 8,9), ndërsa mortaliteti i foshnjave në vitin 1953 te shqiptarët ishte 194,5 promilë (serbët 99,6; sllovenët 58,7) dhe më 1961 142,3 promilë (serbët 69,7; sllovenët 29,5).[48] Në mungesë të të dhënave të regjistrimeve të mëvonshme për shkallët specifike të mortalitetit dhe konkretisht për moshën 0 - 365 ditë sipas kombësisë, po i japim të dhënat për grup-moshën 0 - 4 vjet: në vitin 1971 shkalla e mortalitetit te shqiptarët për meshkuj ishte 27,3 promilë (serbët 10,2; sllovenët 6,4), ndërsa për femra 31,1 promilë (serbët 8,8; sllovenët 5,8).[49]

Mirëpo, sipas statistikës vijuese demografike, ku jepen të dhënat themelore për zhvillimin e popullsisë dhe më hollësisht për ngjarjet vitale, në Kosovë në vitin 1990, nga numri i përgjithshëm i të vdekurve sipas kombësisë, gjinisë dhe moshës te shqiptarët, turqit dhe romët përqindja e foshnjave të të dy gjinitë ishte shumë e lartë, ndërsa te serbët dhe malazezët, por edhe te boshnjakët ishte shumë më e ulët. Pasqyra e përqindjes së foshnjave në numrin e gjithëmbarshëm të të vdekurve sipas kombësisë dhe gjinisë në këtë vit në Kosovë dukej kështu: te shqiptarët pjesëmarrja për femra ishte 33,1% dhe për meshkuj 25,6%, te turqit 28,0%:15,0% dhe te romët 23,6%:12,6%, ndërsa këto raporte ishin te serbët 4,6% për femra dhe 3,6% për meshkuj, te malazezët 5,4%:1,8% dhe te boshnjakët 12,2%:10,5%.[50] Sipas të dhënave të statistikës së njëjtë, në vitin 1995 gjendja ka ndryshuar shumë, ku janë zvogëluar dallimet si midis grupacioneve etnike, ashtu edhe midis gjinisë: te shqiptarët 17,7%:13,4%, te turqit 3,7%:2,3%, te romët 11,5%:9,6%, te serbët 3,7%:5,7%, te boshnjakët 8,3%:13,3%, ndërsa te malazezët në këtë vit nuk është shënuar

---

[47] Shih më gjerë: R. Petrović, "Socijalne i ekonomske determinante mortaliteta", *Ekonomska misao*, br. 3, Beograd, 1974, ff. 24-39.

[48] A. Plavec, *Smrtnost stanovništva u Jugoslaviji 1950-1964*, Studije, analize i prikazi, 37, SZS, Beograd, 1968, f. 25.

[49] Grup autorësh, *Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti,* CDI, IDN, Beograd, 1978, ff. 38-39.

[50] *Demografska statistika 1990,* SZS, Beograd, 1992, f. 178.

asnjë foshnje e vdekur (!) Në vitin 1995, numri i foshnjave të vdekura të nacionalitetit shqiptar përbënte 10,0% të të gjithë të vdekurve, ndërsa 81,9% të numrit të përgjithshëm të foshnjave të vdekura në Kosovë.[51]

Shkalla e lartë e mortalitetit të foshnjave dhe e fëmijëve në Kosovë dhe te shqiptarët gjithmonë ka kushtëzuar shkallë të lartë të natalitetit; në disa familje dhe mjedise kjo ndodh edhe në ditët tona. Në historinë demografike, në shembullin e shumë popullatave, është vërtetuar ekzistimi i një shkalle të lartë të paralelizmit midis mortalitetit të lartë dhe natalitetit të lartë.[52] Prandaj, në demografi dhe në shkencat e ngjashme konsiderohet se zvogëlimi i mortalitetit të foshnjave paraqet faktor me rëndësi jo vetëm për përparimin shëndetësor, social dhe kulturor, por edhe për rënien e natalitetit; te çiftët bashkëshortorë krijohet një siguri më e madhe sociopsikologjike se fëmijët e lindur gjallë do të mbesin në jetë dhe ky fakt do të ndikojë që të lindin më pak fëmijë.[53]

Përveç mortalitetit të foshnjave, në Kosovë, në raport me vendet e zhvilluara, ende është i lartë mortaliteti i fëmijëve prej 1 - 4 vjet, ndonëse në pjesën e dytë të shekullit XX dhe veçanërisht pas viteve të 80-ta të tij ka shënuar rënie të konsiderueshme. Por edhe më të mëdha janë dallimet midis gjinive, ku në Kosovë si përpara, ashtu edhe sot ende vdesin më tepër foshnje dhe fëmijë të vegjël të gjinisë femërore, ndonëse me kohë edhe këtu po vërehet tendenca e barazimit, ndërsa në vendet e zhvilluara është e kundërta, gjë që shihet nga të dhënat në shembullin e Kosovës dhe Sllovenisë në tabelën e mësipërme. Në Kosovë, në periudhën më efektive të përtëritjes biologjike (20-35 vjet), gjithashtu është më i lartë niveli i mortalitetit të femrave, që është pasojë e komplikimeve të ndryshme lidhur me shtatzënësinë dhe me një numri të madh të lindjeve, që ende realizohen në shtëpi dhe pa ndihmë profesionale. Në komunat e pazhvilluara dhe veçanërisht në mjediset rurale shkalla e mortalitetit të foshnjave, të fëmijëve të vegjël dhe të femrave është shumë më e lartë për arsye të mungesës së shërbimeve shëndetësore dhe distancës së konsiderueshme hapësinore të tyre nga qendrat urbane, ku ekzistojnë entet përkatëse shëndetësore. Pas përjashtimit të mjekëve shqiptarë dhe ndihmësve të tyre nga spitalet dhe klinikat, veçanërisht ato gjinekologjiko-akusherike, vdekshmëria e femrave në periudhën e riprodhimit, ndonëse nuk kemi të dhëna të sakta, supozohet se ishte në rritje në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar. Ndërkaq, në vitet 2002 dhe 2003 më se 60% e rasteve të vdekjeve ndodhën në shtëpi, kurse vetëm 40% në spital. Prandaj, për vdekjet në shtëpi mbetet i padefinuar shkaku i vdekjes.[54]

---

[51] *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, f. 203.
[52] *A. Landry, Traité de démographie*, Payot, Paris, 1949, pp. 538-540.
[53] A. Gore, *Toka në baraspeshë (Ekologjia dhe fryma njerëzore),* Dukagjini, Pejë, 1994, ff. 242-244.
[54] *Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2004, f. 13.

Nga analiza e të dhënave mbi evolucionin e vdekshmërisë mund të konkludohet se nuk ka mbështetje as shkencore e as humane pikëpamja dhe qëndrimi se në rrethanat e fertilitetit (natalitetit) të lartë nuk mund të zvogëlohet mortaliteti i foshnjave dhe i kategorive të tjera të popullsisë. Rënia e mortalitetit të foshnjave mund të arrihet me mbrojtjen shëndetësore të nënave dhe fëmijëve, mbrojtjen e nënave para dhe gjatë shtatzënësisë dhe veçanërisht pas lindjes, pastaj me zhvillim socioekonomik, me ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe të atij shëndetësor në veçanti dhe, lidhur me këtë, me ngritjen e vetëdijes për ruajtjen e shëndetit e të jetës, sidomos të foshnjave e të fëmijëve të vegjël, etj.[55]

Qëllimi tjetër shkencor dhe human i gjithë njerëzimit është zgjatja e mesatares së jetës, që në Kosovë mund të arrihet kryesisht përmes eliminimit të shkaqeve ekzogjene të vdekjes (sëmundjet infektive dhe respiratore, sëmundjet e karakterit social etj.). Lufta kundër shkaktarëve të mortalitetit dhe diferencimit shoqëror të tij në të gjitha format e manifestimit, nënkupton luftën kundër vdekjes dhe përpjekjet për zgjatjen e jetës dhe për jetë të shëndoshë, si një nga qëllimet më të larta të çdo individi dhe shoqërie.

[55] *Grup autorësh, Razvitak stanovništva Jugoslavije u posleratnom periodu*, CDI, IDN, Beograd, 1974, ff. 68, 70.

III. DINAMIKA E SHTIMIT NATYROR DHE E RRITJES SË PËRGJITHSHME TË POPULLSISË

Një nga karakteristikat kryesore të zhvillimit të popullsisë së Kosovës për një kohë të gjatë është *rritja e numrit të saj,* madje edhe përkundër proceseve intensive emigruese dhe rrethanave të tjera të pavolitshme në periudha të caktuara shoqërore-historike. Ndonëse në kuadër të politikës kolonialiste serbe dhe të spastrimit etnik të tokave shqiptare u realizuan disa valë të kolonizimit të Kosovës me serbë, megjithatë bazë determinuese e rritjes së gjithmbarshme të popullsisë së Kosovës është jo komponentë mekanike, por shtimi natyror si rezultat i shkallës së lartë të natalitetit dhe rënies së mortalitetit. Deri në Luftën II Botërore, vëllimi absolut i shtimit natyror dhe norma e tij në Kosovë kanë shënuar fluktuime të mëdha ose të vogla, varësisht nga lëvizja e lindjeve dhe vdekjeve, të kushtëzuara nga ndikimi i një varg faktorësh socialo-ekonomikë, por edhe evidencimi jo i plotë i këtyre ngjarjeve vitale (nënregjistrimi), siç vumë në pah te lëvizja e lindshmërisë. Në disa vite e periudha shtimi natyror ishte tepër i ulët, rreth nivelit zero, por edhe negativ, për çka oscilonte edhe numri i përgjithshëm i popullsisë. Një gjendje e tillë vazhdoi deri vonë, përafërsisht deri në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar.

Nga fillimi i viteve të 60-ta të shekullit XX vlerat absolute të shtimit natyror, si dhe norma e tij ishin në rritje të vazhdueshme (tabela 1) për shkak të zvogëlimit të mortalitetit, si dhe rritjes së pandërprerë të kontingjenteve të popullsisë femërore në periudhën fertile (15-49 vjet). Zvogëlimi i madh i numrit të lindjeve në vitin 1996 (45.343 lindje dhe shtimi natyror 37.201) në krahasim me vitin 1990 (55.175 lindje dhe shtimi natyror 46.961), që, siç u theksua më parë, shënojnë maksimumin në gjithë periudhën e vështruar, apo i thyerjes edhe më të madhe demografike midis viteve 1990 dhe 1992 dhe veçanërisht midis viteve 1991 dhe 1992, është pasojë e shpërnguljes masive të të rinjve shqiptarë në botën e jashtme, komponenteve të tjera sociopsikologjike (shtyrja e martesave dhe e lindjeve për arsye të luftës rreth nesh), si dhe i mospërfshirjes së të gjitha lindjeve dhe vdekjeve.

Tabela 1. Lëvizja e shtimit natyror në Kosovë në periudhën 1911-2006[1]

Viti	Numri	Në 1000 banorë	Viti	Numri	Në 1000 banorë
1911	7.169	16,4	1926	8.899	17,8
1915	-10.019	-22,8	1930	8.987	16,3
1920	8.422	20,0	1935	10.412	17,4
1925	9.383	18,9	1940	9.024	13,7
1950	22.231	29,1	1994	35.783	17,2
1955	21.444	25,5	1995	36.105	17,2
1960	28.266	29,9	1996	37.649	17,5
1965	31.802	29,6	1997	34.296	15,7
1970	33.667	27,6	1998	34.296	15,4
1975	39.292	28,0	1999	34.296	15,2
1980	44.238	28,5	2000	34.296	15,0
1985	42.099	23,9	2002[2]	30.482	15.4
1990	46.961	23,6	2003	25.577	12,7
1991	43.737	22,2	2004	28.664	14,0
1992	36.414	18,1	2005	30.011	14,5
1993	36.328	17,8	2006	26.708	12,7

Popullsia e Kosovës në periudhën 1880-1980 rritet për më se 600%. Në vitin 1880 vlerësohet se Kosova kishte rreth 240.000 banorë,[3] ndërsa sot ka rreth 2.500.000 banorë (popullata rezidenciale), që nënkupton një rritje për më se 900%. Sipas regjistrimit të vitit 1921 në Kosovë jetonin 439.010 veta[4] dhe numri i saj dyfishohet nga fundi i viteve të 50-ta, pra përreth 36 vjet. Mirëpo, popullsia e Kosovës në procesin e "shpërthimit demografik" ka hyrë kryesisht në vitet e 60-ta të shekullit XX, i cili si në pikëpamje të rritjes absolute, ashtu edhe të asaj relative ishte deri atëherë më i fuqishëm. Në periudhën 1961-1991 popullsia e Kosovës rritet për 1.054.512 banorë, që do të thotë dyfishimin e saj për më pak se

[1] Burimi: *Prirodno kretanje stanovništva Srbije od 1963-1954. godine, Prikazi 20,* Zavod za statistiku NR Srbije, Beograd, novembar 1957, ff. 52-53, 60-61, 68-71; *Statistički godišnjak Jugoslavije,* SZS, Beograd, 1987, ff. 438-439; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku,* br. 052, Beograd, 24.02.1998, ff. 6-11; *Demografska statistika 2000*, SZS, Beograd, 2002, ff. 63-74; *Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003,* ESK, Prishtinë, 2004, ff. 9-12; *Statistikat vitale të Kosovës 2006,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2007, f. 9.

[2] Edhe te lëvizja e shtimit natyror dallimet, veçanërisht midis viteve 2002 dhe 2003, mund të arsyetohen nga shkaqet e njëjta sikurse te lëvizja e natalitetit dhe mortalitetit.

[3] *The Population of Yugoslavia,* The Demographic Research Center, Institute of Social Sciences, Belgrade, 1974, p. 11.

[4] *Prethodni rezultati Popisa stanovništva u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca 31. januara 1921,* Državna štamparija, Sarajevo, 1924, ff. 3-24.

30 vjet. Në periudhën 1948-1991,[5] numri i popullsisë së Kosovës rritet nga 733.034 në 2.018.500 banorë ose për 1.285.466 banorë (për 175%), ndërsa në tërë gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, sipas vlerësimeve, shënohet një rritje demografike përreth 1.800.000 banorë (për afër 240%), dhe në periudhën 1948-2005 kemi një rritje prej 241,3%. (tabela 2).

Tabela 2. Rritja e popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2005[6]

Viti	Numri i popullsisë	Rritja në periudhat midis regjistrimeve		
		Periudha	Numri absolut	%
1948	733.034	1948-1953	83.874	11,4
1953	816.908	1953-1961	147.080	18,1
1961	963.989	1961-1971	279.705	29,0
1971	1.243.693	1971-1981	340.747	27,3
1981	1.584.440	1981-1991	434.060	27,0
1991	2.018.500	1948-1991	1.285.466	175,0
2000	2.370.000	1948-2000	1.637.000	223,3
2005	2.502.000	1948-2005	1.769.000	241.3

Në tërë periudhën 1948-1991 rritja mesatare vjetore nuk ka rënë nën 20 promilë. Në periudhën 1981-1991 numri i popullsisë së Kosovës shtohet për 434.060 banorë apo për 27,0%. Mirëpo, është fakt se në të gjitha periudhat midis regjistrimeve të popullsisë rritja e numrit të popullsisë është më e vogël se shuma e shtimit natyror, që do të thotë se emigrimi ka gëlltitur një shumë të konsiderueshme të këtij shtimi dhe saldoja migruese ka qenë negative (tabela 3). Është interesant të zihet në gojë fakti se në Shqipëri në periudhën 1989-2001 kemi rënie të numrit të popullsisë së përgjithshme për 113.142 banorë. Sipas regjistrimit të vitit 1989 Shqipëria kishte 3.182.417 banorë, ndërsa regjistrimi i vitit 2001 shënoi 3.069.275 banorë. Sipas dinamikës së shtimit natyror në këtë periudhë ky vend do të duhej të kishte mbi 3.800.000 banorë. Në qoftë se nuk ka defekte të tjera (nënregjistrimi i ngjarjeve vitale), atëherë del se në periudhën e transicionit Shqipërinë e kanë braktisur rreth një milion banorë ose afër 25 e popullsisë së përgjithshme, kryesisht të rinj dhe mbi 70% meshkuj, në mesin e të cilëve ka mjaft kuadro të shkolluara.[7]

---

[5] Për vitin 1991 vlerësimi, meqenëse në regjistrimin e popullsisë të këtij viti shqiptarët nuk morën pjesë për arsye se nuk ekzistonin as kushtet minimale (Shih: H. Islami, *Rrjedha demografike shqiptare,* Dukagjini, Pejë, 1994, ff. 115-125).

[6] Burimi: për vitet 1948-1981 regjistrimet zyrtare të popullsisë, ndërsa për vitin 1991 vlerësimi (Për vlerësimin shih: A. Pushka, "Porast, Beograd, 1992, f. 81). Edhe për vitin 2000 vlerësimi. Për vitin 2005 vlerësimi: *Statistikat vitale të Kosovës 2006,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2007, f. 9. stanovništva kosovskih gradova", *Stanovništvo,* nr. 3-4/1990 dhe 1-2/1991, CDI, IDN

[7] Për aspekte të ndryshme të emigrimit shih më gjerë në: V. Misja, *Emigracioni ndërkombëtar në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit,* M. Barleti, Tiranë, 1998, ff. 1-96.

Tabela 3. Lëvizja e popullsisë së Kosovës prej 1948-1991 sipas regjistrimeve

	Periudhat midis regjistrimeve				
	1948-1953	1953-1961	1961-1971	1971-1981	1981-1991
Rritja mesatare vjetore	16.575	18.510	27.971	34.075	37.176
Shtimi natyror mesatar vjetor	19.104	23.858	31.579	39.455	43.397
Norma e rritjes mesatare vjetore në ‰	22,8	20,8	25,3	24,1	21,0
Norma mesatare vjetore e shtimit natyror në ‰	24,8	26,6	28,4	27,7	24,4

Vështruar në pikëpamje territoriale, në vitin 1991 (vlerësimi) të gjitha komunat e Kosovës kanë pasur shtim pozitiv natyror, ndërsa nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve shtim negativ natyror kishin vetëm 61, shtim natyror zero vetëm 52 dhe vetëm në 54 vendbanime nuk ishte shënuar asnjë foshnje e lindur gjallë. Shtim natyror negativ ose stagnant kishin shënuar këto komuna me këtë numër të vendbanimeve: Zubin Potoku (38), Leposaviqi (31), Zveçani (14), Kamenica (9), Shtërpca (5), Istogu (3), Novobërda (3), Gjilani (2), Dragashi (Gora, 2), Peja (2), Prizreni (1), Lipjani (1) dhe Obiliqi (1). Të gjitha këto vendbanime ishin fshatra të banuara nga *popullsia shumicë serbe.*[8] Në vitin 1990, në Kosovë, sipas të dhënave të statistikës demografike të ish-Jugosllavisë, numri i të lindurve të gjallë te shqiptarët (sipas kombësisë së nënës) ishte 47.865, numri i të vdekurve 5.840 dhe shtimi natyror 42.025 veta, ndërsa te serbët numri i të lindurve gjallë ishte 3.458, numri i të vdekurve 1.437 dhe shtimi natyror 2.021 persona.[9] Ndërkaq, në vitin 1995, në Kosovë, numri i lindjeve te shqiptarët zvogëlohet në 37.589 veta, numri i vdekjeve mbetet i njëjtë (5.749) dhe shtimi natyror zvogëlohet në 31.840 veta. Te serbët në këtë vit numri i lindjeve shënon rritje (4.165), numri i vdekjeve rritet në 2.030, ndërsa shtimi natyror mbetet pothuajse i njëjtë (2.135).[10]

[8] G. Penev, "Područja Srbije bez prirodnog priraštaja stanovništva. Analiza po naseljima za 1991. godinu", *Demografske sveske,* br. 24, CDI, IDN, Beograd, 1995, f. 32.

[9] Burimi: "Naselja u SR Jugoslaviji sa negativnim ili nultim prirodnim priraštajem u 1991. godini", *Stanovništvo,* nr. 1-4/1992 - 1-2/1993, CDI, IDN, Beograd, ff. 272-274.

[10] *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, ff. 177, 203.

Tabela 4. Lëvizja e shtimit natyror të popullsisë së Kosovës sipas përkatësisë kombëtare në vitet 1990 dhe 1995[11]

	1990	1995
	Shtimi natyror	Shtimi natyror
Gjithsej	46.961	36.105
%	100,0	100,0
Shqiptarë	42.025	31.840
%	89,5	88,2
Serbë	2.021	2.135
%	4,3	5,9
Myslimanë	1.210	877
%	2,6	2,4
Malazezë	133	98
%	0,3	0,3
Romë	936	865
%	2,0	2,4
Kroatë	237	47
%	0,5	0,1
Turq	225	173
%	0,5	0,5
Jugosllavë	9	-9
%	0,0	0,0
Të tjerë	172	79
%	0,4	0,2

Në anën tjetër, agresioni serbohegjemonist, që eskaloi në luftë të hapur kundër popullsisë civile shqiptare në Kosovë me qëllim të një spastrimi etnik sui generis, pos viktimave në njerëz dhe shkatërrimeve materiale, ka edhe pasoja si momentale, ashtu edhe afatgjata edhe në rrafshin demografik, veçanërisht në strukturën e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë, në indikatorët vitalë demografikë dhe në numrin e përgjithshëm të shqiptarëve. Mirëpo, për pasojat demografike të kësaj lufte duhet të hartohen studime të veçanta për Kosovën dhe shqiptarët vetëm pasi të mblidhen të dhënat.

Pasqyra krahasuese me Serbinë dhe Vojvodinën në treguesit themelorë të zhvillimit të popullsisë së tyre, pa hyrë në shqyrtime të hollësishme të shkaqeve dhe pasojave të rrjedhave të tyre, tregon një gjendje mjaft karakteristike. Në Serbi dhe Vojvodinë kriza në variablat kyçe demografike vazhdon të thellohet deri në shkallë të tendencave ekstreme

[11] Burimi: *Demografska statistika 1990,* SZS, Beograd, 1992, f. 146; *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, ff. 177, 203.

negative. Potenciali biologjik i tyre është reduktuar aq shumë sa që edhe njëra edhe tjetra kanë hyrë në fazën e procesit të shpopullimit të shpejtuar, si pasojë e rënies së natalitetit, shtimit natyror negativ dhe rënies së numrit të përgjithshëm të popullsisë, proces ky që në demografi njihet si denatalitet;[12]procesi i denatalitetit kishte marrë hov sidomos te popullsia bujqësore e Serbisë, e cila në vitin 1981 kishte moshë mesatare 44,2 vjet dhe lëvizje negative natyrore: nataliteti 5,2, mortaliteti 15,6 dhe shtimi natyror minus 10,4 promilë.[13] Por edhe këtu thyerje e madhe vërehet midis viteve 1991 dhe 1992, që është sigurisht pasojë e psikozës së luftës dhe e implikimit të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në luftë në Kroaci dhe BeH. Ndërsa tendenca e vazhdueshme e rënies së numrit të martesave (nupcialiteti) në Serbi ishte kryesisht e lidhur me ndryshimet në strukturën e popullsisë sipas moshës dhe me faktorët që i kushtëzojnë këto ndryshime, por edhe me psikozën e luftës dhe krizën socioekonomike e familjare në përgjithësi .[14]

Sipas hulumtimeve të demografëve serbë, në vitin 1991, nga 4.217 vendbanime sa i ka Serbia, shtim negativ natyror kishin 2.656 ose 63,0% dhe shtim natyror zero 474 ose 11,2%, ndërsa shtim pozitiv natyror ishte shënuar vetëm në 1.087 vendbanime, që përbënin 25,8% të tyre. Në këtë vit në 761 (18,0%) vendbanime të Serbisë, të gjitha të karakterit rural, nuk kishte lindur asnjë foshnje. Situatë e njëjtë e karakterizonte edhe Vojvodinën: nga 464 vendbanime, 311 (67,0%) kishin shtim negativ natyror, 17 (3,7%) shtim natyror zero, shtim natyror pozitiv kishin shënuar 136 (29,3%), ndërsa në 9 (1,9%) vendbanime, të gjitha fshatra, nuk kishte lindur asnjë fëmijë. Sipas regjistrimeve të popullsisë, në periudhën 1981-1991 popullsia e Serbisë ishte rritur nga 5.694.464 në 5.808.906 banorë ose vetëm për 114.442 veta apo për 2,0% (Kosova 27,3%), ndërsa popullsia e Vojvodinës ka shënuar madje rënie nga 2.034.772 në 2.013.889 banorë ose për minus 20.883 (minus 1,0%). Në periudhën 1948-1991, popullsia e Serbisë shtohet për 1.649.517 banorë ose për 39,6%, ndërsa e Vojvodinës për 373.132 veta ose për 22,7%

---

[12] UN, *Višejezički demografski rečnik,* CDI, IDN, Beograd, 1971, f. 83 (pika 930).

[13] G. Penev-G. Kostić, "Starenje i feminizacija poljoprivrednog stanovništva Srbije bez pokrajina", *Stanovništvo,* br. 1-4/1983-1984, CDI, IDN, Beograd, ff. 117-123.

[14] Ka kohë që në shoqërinë serbe është në rritje patologjia familjare, e cila manifestohet në rritjen e normës së celibatit (moshyrja në martesë), në hyrjen e vonshme në martesa, ku shumë çifte bashkëshortore nuk dëshirojnë të lindin fëmijë ose vonë i nisin dhe herët i përfundojnë lindjet, pastaj në shtimin e numrit të martesave të shkurorëzuara, të fëmijëve e familjeve të braktisura, të neurozave e delikuentëve nga radha e të miturve etj. (Shih. M. Mladenović, *Porodica izmedju usamljenosti i društvenosti,* Savremena administracija, Beograd, 1976, f. 10).

(Kosova 175,0%). Që nga fillimi i viteve të 90-ta në Serbi dhe në Vojvodinë shtimi natyror është negativ: në vitin 1997 në Serbi ishin shënuar 59.650 lindje dhe 69.564 vdekje (shtimi natyror negativ për 9.914 veta), ndërsa në Vojvodinë 19.984 lindje dhe 28.244 vdekje (shtimi natyror minus 8.360 veta).[15] Në këtë vit shtimi natyror në Serbi ishte minus 1,4 promil, ndërsa në Vojvodinë minus 3,8 promilë.[16] Ndërkaq, gjendja demografike në Serbi, e diferencuar sipas kombësisë del edhe më drastike për serbët, sepse qysh në vitin 1990 shtimi natyror i tyre ishte vetëm për 760 veta, ndërsa në fillim të viteve të 90-ta ky shtim ishte tashmë negativ dhe kjo tendencë vazhdon me një intensitet shumë të shpejtuar, kështu që në vitin 2000 në Serbi shtimi negativ natyror është për gati 20.000 veta, që ka të bëjë pothuajse tërësisht me popullatën serbe.[17]

Tabela 5. Lëvizja e natalitetit, e shtimit natyror dhe e numrit të martesave dhe shkurorëzimeve në Serbi dhe në Vojvodinë prej 1950-2000[18]

Viti	Numri i lindjeve	në 1.000 banorë	Shtimi natyror	në 1.000 banorë	Numri i martesave	Numri i shkurorëzimeve
Serbia						
1950	120.412	28,1	67.051	15,6	57.068	6.922
1960	86.492	18,0	43.209	9,0	44.294	7.403
1970	77.073	14,8	29.778	5,7	48.211	6.009
1980	80.916	14,3	27.963	4,9	41.821	7.471
1990	67.567	11,6	7.280	1,2	35.949	7.228
1991	67.443	11,6	4.290	0,8	33.698	5.459
1992	64.828	11,2	-741	-0,1	34.271	4.780
1993	65.913	11,3	-1.218	-0,2	33.338	5.114
1994	63.693	11,0	-1.796	-0,3	33.043	4.444
1995	65.509	11,3	-2.233	-0,4	32.400	4.890
2000	54.972	9,6	-18.944	-3,3	31.116	5.529

[15] *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku, br. 052,* 24.02. 1999, Beograd, f. 6.

[16] *Statistički kalendar SR Jugoslavije,* SZS, Beograd, 1998, f. 12.

[17] Shih: Lj. Gaćeša, "Statistički prilozi", *Stanovništvo,* nr. 3-4, CDI, IDN, Beograd, 1994, f. 210; *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, ff. 177, 196; *Demografska statistika 2000,* SZS, Beograd, 2002, f. 58.

[18] Burimi: *Demografska statistika 1993,* SZS, Beograd, 1996, ff. 54-57; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku*, br. 012, Beograd, 17. 01. 1996, ff. 10-16; *Demografska statistika 2000,* SZS, Beograd, 2002, ff. 58-73.

Vojvodina						
1950	42.885	25,5	19.395	11,4	19.681	2.701
1960	32.806	17,8	14.217	7,7	18.047	3.182
1970	25.380	13,0	5.464	2,8	18.508	3.120
1980	28.681	14,1	5.454	2,7	15.679	3.369
1990	22.900	11,2	-2.328	-1,1	12.312	2.661
1991	22.935	11,4	-3.614	-1,8	11.447	2.559
1992	22.049	11,0	-5.857	-2,9	11.884	1.721
1993	22.018	11,0	-5.972	-3,0	11.462	1.678
1994	21.595	10,8	-5.923	-3,0	11.048	1.914
1995	21.213	10,8	-6.053	-3,0	11.349	2.301
2000	18.792	9,7	-11.284	-5,4	11.470	2.160

Në Serbi dhe Vojvodinë, sa i përket numrit të përgjithshëm të popullsisë, duket se situata është përmirësuar me ardhjen e serbëve si refugjatë dhe në mënyra të tjera nga Kroacia dhe BeH. Mirëpo, gjithashtu duhet pasur parasysh edhe *humbjet demografike*, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, sepse një numër i konsiderueshëm i të rinjve nga Serbia dhe Vojvodina është vrarë në luftëra, pastaj ka pasuar eksodi i të rinjve serbë në botën e jashtme për ta evituar pjesëmarrjen në luftëra, janë shtyrë lidhjet e bashkësive martesore dhe lindja e fëmijëve të dëshiruar etj. Dhe, duke marrë parasysh krizën e thellë ekonomike, politike, sociale, familjare, psikologjike e morale që e kishte kapluar gjithë shoqërinë serbe, presionin e madh ndërkombëtar, si dhe praninë e psikozës së luftës, asnjë masë e politikës popullative nuk mund të kishte ndikim në përmirësimin e gjendjes demografike në Serbi e në Vojvodinë dhe te serbët në përgjithësi. As sot nuk mund të bëhet një rahabilitim i situatës shumë të pavolitshme demografike në Serbi dhe në Vojvodinë aq më tepër kur një e treta e martesave është pa fëmijë, ndërsa një e treta e popullsisë nuk martohet kurrë.

Popullsia e Serbisë, duke përfshirë edhe Vojvodinën, midis dy regjistrimeve të fundit të popullsisë është zvogëluar nga 7.547.978 në vitin 1991 në 7.479.437 banorë në vitin 2002, pra për 69.541 banorë. Po të mos ishte ardhja e popullsisë serbe në Serbi nga Kroacia dhe BeH, që vlerësohet në rreth 600.000 veta, rënia e numrit të popullsisë do të ishte shumë më e madhe, sepse në periudhën 1992-2002, krahas shtimit negativ natyror, nga Serbia janë shpërngulur rreth 300.000 veta. Procesi i moshënimit demografik ka avancuar shumë, ku mosha mesatare në Serbi ka arritur në më se 40 vjet, dhe së pari herë në historinë e Serbisë numri i popullsisë mbi 65 vjet është më i madh se numri i popullsisë më të re se 18 vjet; edhe

Vojvodina ka të njëjtin indeks të moshënimit. Ekspertët e Beogradit në fund të vitit 2004 vlerësojnë se në Serbi rreth vitit 2025 do të jenë rreth 3.800.000 banorë të kombësisë serbe me moshë mesatare mbi 50 vjet, që flet për një proces të thellë të moshënimit, me pasoja të shumënduarshme demografike, sociale, ekonomike etj. Popullsia e Serbisë hyn sot në radhën e dhjetë popullatave më të moshënuara në botë. Nga 115 komuna në Serbi, 111 sosh në pikëpamje demografike janë hapësira të moshënuara. Në shumë mjedise, madje edhe komuna të Serbisë indeksi i moshënimit është edhe më alarmant, ku mosha mesatare është mbi 50, madje edhe mbi 60 vjet.[19]

[19] *Bilten vesti*, 30. jun 2002, Beograd; *Nezavisna svetlost*, br. 383, januar-februar 2003, Beograd.

Pjesa e tretë

STRUKTURAT E POPULLSISË DHE NDRYSHIMET NË PËRBËRJEN E EKONOMIVE FAMILJARE

I. STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS MOSHËS DHE GJINISË

Në kuadër të kërkimeve demografike dhe, më gjerë, të hulumtimeve sociale-ekonomike, rol jashtëzakonisht të rëndësishëm ka përbërja e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Inkuadrimi i tyre, por edhe i strukturave të tjera të popullsisë në kornizat e studimit të popullsisë së çdo territori del si nevojë e domosdoshme për shkak të ekzistimit të lidhjes interaktive, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, midis lëvizjes së përgjithshme të popullsisë dhe strukturave të popullsisë. Strukturat e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë formohen për një periudhë të gjatë kohore dhe janë pasqyrë e zhvillimit të popullsisë dhe rrethanave të tjera shoqërore për një periudhë gati njëshekullore. Janë funksion i lëvizjes natyrore (natalitetit dhe mortalitetit) dhe mekanike (migrimeve) të popullsisë, por njëkohësisht edhe faktor i tyre.[1] Në tipin e popullatës së mbyllur, që sot në çdo vend është një supozim teorik, determinantja më kryesore dhe më dinamike e strukturës së popullsisë sipas moshës është niveli i fertilitetit, ndërsa në popullatat e hapura, që sot kudo janë një realitet, migrimet e popullsisë luajnë një rol të madh në formimin e kësaj strukture dhe të përbërjes së popullsisë sipas gjinisë.

Këto dy struktura tregojnë jo vetëm *të kaluarën demografike, por edhe rrjedhat e tashme dhe të ardhshme të zhvillimit demografik.* Të zbërthyera sipas grup-moshave pesëvjeçare, këto struktura janë bazë për prognozat e popullsisë së një vendi në kontekst afatgjatë. Pa njohjen dhe shqyrtimin e këtyre strukturave të popullsisë nuk është e mundur të vështrohen dhe kuptohen në mënyrë të plotë edhe shumë struktura të tjera të popullsisë, siç janë p. sh. struktura sipas aktivitetit ekonomik, përbërja arsimore, etnike, struktura martesore dhe variablat e saj etj. Këto dy struktura të popullsisë janë bazë themelore për ndarjen fiziologjike të punës, e me këtë edhe për përcaktimin e suazave demografike të ndarjes shoqërore të punës. Vështruar nga aspekti politik, politikologjik dhe sociologjik, p. sh. kontingjenti mbi 18 vjet ka rëndësi të madhe për hulumtimin e opinionit publik dhe për procesin e zgjedhjeve.

[1] Në tipin e popullatës së mbyllur, determinantja kryesore dhe më dinamike e strukturës së popullsisë sipas moshës është pikërisht niveli i fertilitetit (A. Sauvy, "Le vieillessement de population et l'alongement de la vie", *Population,* No 4, INED, Paris, 1954, pp. 675-682).

1. Shtrirja e popullsisë së përgjithshme sipas moshës dhe gjinisë

Ndër veçoritë e posaçme të zhvillimit demografik të Kosovës dhe të shqiptarëve është pikërisht përbërja e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë, që janë formuar si rezultat i ndikimit të shumë determinanteve demografike dhe socioekonomike, por nga të cilat dalin edhe shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin e popullsisë së tyre. Popullsia e Kosovës dhe e trojeve të tjera etnike shqiptare është ende shumë e re, me moshë mesatare në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar rreth 24-25 vjet, i përket tipit progresiv, me bazë të zgjeruar të piramidës sipas moshës, që e përbën grup-mosha 0-4 vjet, si indikator i rëndësishëm i shkallës së lartë të lindshmërisë sot dhe në të ardhmen. Aktualisht rreth gjysmën e popullsisë së Kosovës e përbën mosha deri 19-vjeçare, ndërsa më herët kjo moshë përbënte edhe 54% të popullsisë së gjithmbarshme. Një strukturë e tillë është rezultat i shkallëve të larta të natalitetit dhe shkallëve të ulëta dhe gjithnjë në rënie të mortalitetit, të cilat gjithnjë i kundërviheshin procesit të moshënimit demografik; përqindja e popullsisë 60 e më tepër vjet edhe sot nuk e kalon 7%. Ndonëse vërehet një rënie e përqindjes së të rinjve në vitin 1991 (48,3%) në raport me vitet e mëparshme, kur ajo ishte mbi 50%, megjithatë numri absolut i të rinjve të moshës 0-19 vjet është gjithnjë në rritje si pasojë e rritjes së vëllimit absolut të lindjeve dhe shtimit natyror; vetëm në periudhën 1961-1991 kontingjenti i kësaj moshe edhe përkundër rënies së normës së lindshmërisë gati është dyfishuar.

Kur të vështrohet kjo strukturë e popullsisë sipas vendbanimeve rurale dhe vendbanimeve urbane të Kosovës, vërehen dallime të hetueshme: përqindja e saj deri në moshën 19-vjeçare në territorin e saj rural në vitin 1981 ishte 54,1% dhe në vitin 1991 zvogëlohet në 50,5% (Serbia 24,5%), ndërkaq në hapësirën urbane ishte 48,7% më 1981 dhe 44,6% më 1991 (Serbia 27,5%). Derisa në Kosovë përqindja e kësaj moshe, për shkak të dallimeve në normën e lindshmërisë midis këtyre tipave të vendbanimeve (nataliteti më i lartë në fshat) është më e lartë në fshat, në Serbi, për shkak të migrimeve intensive në drejtimin fshat-qytet, kjo përqindje është më e re në qytet. Mirëpo, migrimet intensive, por gjithnjë të ngadalësuara viteve të fundit në relacion fshat-qytet, kanë ndikuar që kontingjenti i popullsisë së moshës së mesme (20-59 vjet) në vitin 1991 të jetë më i madh në vendbanimet urbane (49,0%) dhe më i ulët në ato rurale (42,2%).

Derisa mosha mesatare e popullsisë së Kosovës deri në vitin 1981 sillej rreth 24 vjet dhe në vitin 1991 rreth 25 vjet, që merret si popullsi e re, ndërsa popullsia e Serbisë dhe e Vojvodinës ka një moshë mesatare mbi 40 vjet, e cila sipas stadit të moshënimit demografik cilësohet si popullatë që ka

hyrë në një fazë të thellë të moshënimit. Indeksi i moshënimit të popullsisë, që tregon raportin e popullsisë të moshës 60 e më tepër vjet ndaj popullsisë së moshës 0-19 vjet, në Kosovë në vitin 1981 ishte 12,3, në vitin 1991 14,2, ndërsa në Kosovë sot mund të jetë rreth 19 vjet (Serbia 89,0 vjet). Zgjerimi i procesit të shtimit negativ natyror, si dhe i moshënimit demografik në Serbi dhe në Vojvodinë pritet që në ardhmen të jetë edhe më i madh, duke i përfshirë edhe qendrat e mëdha urbane të tyre. Mirëpo, edhe në Kosovë, me gjithë dallimet e mëdha sa i përket strukturës së popullsisë sipas moshës në raport me Serbinë dhe Vojvodinën, pas shpërnguljeve të mëdha të të rinjve shqiptarë si pasojë e agresionit serb në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, veçanërisht që nga fillimi i vitit 1998, mosha mesatare sigurisht ka shënuar rritje, por jo edhe deri në atë shkallë sa të çrregullojë seriozisht riprodhimin normal të popullsisë. Kjo moshë sot mund të sillet midis 27-28 vjet. Ndër mendimtarë shpeshherë dëgjohet thënia: "Populli që ka popullatë të re është popull më një të ardhme të mirë dhe e kundërta".

Tabela 1. Popullsia e Kosovës sipas grup-moshave kryesore dhe gjinisë në periudhën 1921-1991[2]

	1921	1948	1961	1981	1991
Gjithsej	439.010	727.820	963.988	1.584.440	1.956.196
maskuliniteti	1006,8	1040,0	1045,1	1068,3	1066,3
0-19	22.037	378.654	493.551	828.271	943.810
%	50,6	52,0	51,2	52,4	48,3
maskuliniteti	1195,0	1116,7	1098,2	1087,3	1076,4
20-39	92.725	176.667	265.587	419.799	586.114
%	21,1	24,3	27,6	26,6	30,0
maskuliniteti	715,9	992,7	1021,7	1085,3	1104,0
40-59	81.437	116.827	133.581	229.594	286.662
%	18,6	16,1	13,9	14,5	14,7
maskuliniteti	942,4	963,3	1024,8	1027,6	1034,5
60 +	42.806	55.667	70.354	101.729	136.889
%	9,8	7,6	7,3	6,4	7,0
maskuliniteti	997,5	872,9	834,3	948,3	915,3
Mosha mesatare	26,6	25,1	24,4	24,2	25,4

[2] Burimi: Të dhënat zyrtare të regjistrimeve të popullsisë; për vitin 1991 vlerësimi; shih gjithashtu: *Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47*, SZS – CDI, Beograd, 1995, f. 126.

Tabela 2. Mosha mesatare dhe indeksi i moshënimit të popullsisë në Serbi, në Vojvodinë dhe në Kosovë në periudhën 1948-1996[3]

	Serbia	Vojvodina	Kosova
Mosha mesatare e popullsisë[4]			
1948	29.02	30.78	25.31
1953	29.47	31.34	24.93
1961	31.08	32.26	24.27
1971	33.60	34.58	23.82
1981	33.52	36.15	24.14
1991	37.37	37.49	25.21
1993	38.18	38.41	26.12
1996	38.82	39.33	27.11
Indeksi i moshënimit të popullsisë[5]			
1948	21.3	27.8	15.5
1953	23.8	31.0	15.2
1961	30.3	35.9	14.3
1971	43.6	49.5	13.5
1981	68.6	55.7	12.3
1991	68.6	69.3	14.2
1993	78.1	84.2	16.2
1996	86.1	89.0	18.6

2. Kontingjentet funksionale të popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Shqyrtimi dhe analiza e përbërjes së popullsisë sipas moshës dhe gjinisë nga aspekti i kontingjenteve të rëndësishme funksionale të saj, ka rëndësi të veçantë si për gjendjen dhe evolucionin e këtyre kontingjenteve gjatë një periudhe 40-vjeçare (1953-1991), ashtu edhe për ecuritë e ardhshme të tyre dhe të zhvillimit demografik në përgjithësi. Midis Kosovës dhe Serbisë jo vetëm që dalin në shesh dallime të mëdha sa i përket disa kontingjenteve funksionale në popullsinë e tyre të gjithmbarshme në periudhën e përmendur, por edhe ndryshimet janë zhvilluar në drejtime krejtësisht të kundërta.

[3] Burimi: *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku,* br. 052, Beograd, 24.02.1998, f. 12.

[4] Mosha mesatare e popullsisë sipas vlerësimit të popullsisë në gjysmën e vitit të vështruar (30.VI).

[5] Indeksi i moshënimit të popullsisë paraqet raportin e popullsisë së vlerësuar në gjysmën e vitit të vështruar (30.VI) të moshës 60 e më tepër vjet ndaj popullsisë së moshës 0-19 vjet.

Rënia e normës së natalitetit ka ndikuar që në Kosovë të zvogëlohet përqindja e kontingjentit 0-6 vjet në numrin e përgjithshëm të popullsisë, mirëpo numri i fëmijëve të kësaj moshe është dyfishuar në periudhën 1953-1991. Në Serbi, ndërkaq, shënohet rënie e konsiderueshme edhe e numrit relativ, edhe e numrit absolut të kontingjentit parashkollor, kështu që Serbia në të ardhmen do të ketë tepricë të madhe të hapësirës shkollore. Zaten, këto 30 vjetët e fundit, që kur ka nisur të zvogëlohej numri i lindjeve, në shumë mjedise të Serbisë, sidomos në ato fshatare, nuk ka pasur nevojë të ndërtohen shkolla fillore. Ndërsa, sa i përket kontingjentit të shkollimit të obligueshëm në Kosovë vërehet një tendencë e rritjes së fuqishme (për 151%), ndërsa në Serbi që nga fillimi i viteve të 60-ta shënohet zvogëlim relativ dhe absolut i këtij kontingjenti. Këto kontingjente të popullsisë, me këtë vitalitet, duke pasur parasysh varshmërinë reciproke midis përbërjes së popullsisë sipas moshës dhe proceseve të tjera demografike dhe sociale-ekonomike, natyrisht krijojnë efekte të ndryshme në rrafshin demografik (vëllimi i lindjeve) dhe shtrojnë kërkesa të shumëfishta në jetën shoqërore-ekonomike në kontekst afatgjatë kohor (punësimi, shkollimi, mbrojtja shëndetësore, entet parashkollore etj.).

Popullsia fertile femërore në Kosovë gjatë gjithë periudhës pas Luftës II Botërore ka shënuar rritje, më pak relative e shumë më tepër sa i përket numrit absolut (prej 1953-1991 për 149,4%), sikundër që është rritur kontingjenti i femrave në moshën optimale riprodhuese (për 167,7%). Kjo do të thotë se me gjithë rënien e konsiderueshme të lindshmërisë këto vitet e fundit, më tepër si pasojë e emigrimit të të rinjve, popullsia kosovare do të riprodhohej në të ardhmen në vëllim të kënaqshëm, sigurisht mbi riprodhimin e thjeshtë. Në Serbi, përkundrazi, që të dy kontingjentet riprodhuese deri nga gjysma e viteve të 60-ta janë rritur, ndërsa pas këtyre viteve, absolutisht dhe relativisht, janë në rënie.

Kontingjenti i punës në periudhën 1953-1991 në Kosovë është rritur për më se dy herë e gjysmë. Mirëpo, për shkak të strukturës relativisht të re të popullsisë përqindja e këtij kontingjenti në popullsinë e përgjithshme në dy vitet e vështruara është nën atë të Serbisë, ndonëse ka shënuar rritje prej 53,3% më 1953 në 56,9% më 1991. Ndërkaq në Serbi deri nga fundi i viteve të 70-ta ky kontingjent funksional është rritur, kurse pastaj ka shënuar rënie të madhe për arsye të procesit intensiv të moshënimit demografik; në periudhën 1981-1991 është zvogëluar prej 682.650 në 577.995 persona. Sa i përket kontingjentit të parë mobilizues, shumë i rëndësishëm nga aspekti i mbrojtjes së vendit, në këtë periudhë në Kosovë ndodh gati trefishimi i tij; rritje shënohet në popullsinë e gjithmbarshme madje edhe në pikëpamje relative. Në Serbi ky kontingjent funksional shënon rënie si në pikëpamje të numrit, ashtu edhe të përqindjes në popullsinë e përgjithshme.

Derisa në Kosovë kontingjenti mbi 80 vjet, me gjithë rritjen për 128,3% në periudhën 1953-1991, është mjaft i ulët në pikëpamje absolute dhe relative, ndërkaq në Serbi është në rritje ekspansive si pasojë e moshënimit të popullsisë së saj.

Sa i përket strukturës së popullsisë sipas gjinisë, sipas të dhënave që disponojmë në periudhën 1921-1991, në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare dominojnë meshkujt si në popullsinë e gjithmbarshme, ashtu edhe deri në moshën 60-vjeçare, pas së cilës vërehet dominim i dukshëm i femrave. Në Kosovë në 1.000 femra vinin 1.068,3 meshkuj më 1981 dhe 1.066,3 femra në vitin 1991. Prej moshës 20 deri në moshën 40-vjeçare norma e maskulinitetit rritet (1.104,0 më 1991), 40-60-vjeçare zvogëlohet, por ende dominojnë meshkujt, ndërsa pas moshës 60-vjeçare kjo normë dukshëm zvogëlohet (948,3 më 1981 dhe 915,3 më 1991).

Determinantet të cilat në suazat e përgjithshme i përcaktojnë raportet numerike midis meshkujve dhe femrave, siç dihet, janë të karakterit biologjik dhe socioekonomik: faktori biologjik ka ndikim përcaktues në popullatat më pak të zhvilluara, ndërsa determinantet socioekonomike në popullatat e zhvilluara, gjithnjë kur është fjala për popullsinë e gjithmbarshme. Një fakt që në bazë të hulumtimeve të deritanishme përgjithësisht dihet, është dukuria se ndër të lindur gjallë janë më tepër fëmijë të gjinisë mashkullore (6 deri 7%).[6] Dhe po të formohej struktura e popullsisë sipas gjinisë nën ndikimin e lindshmërisë diferenciale dhe vdekshmërisë gjithashtu diferenciale, atëherë duhet pritur që vdekja e fëmijëve të gjinisë mashkullore të jetë më e madhe, veçanërisht në vitin e parë të jetës, pasi që lindin më shumë fëmijë të kësaj gjinie. Mirëpo, meqenëse jeta e njeriut është e gjatë, sidomos në vendet e zhvilluara, dhe duke pasur parasysh edhe migrimet intensive të popullatës, raporti midis meshkujve dhe femrave gjatë kohës ndryshon, por në favor të gjinisë femërore. Arsyeja pse lindin më tepër meshkuj në të gjitha popullatat, pa marrë parasysh përkatësinë racore dhe etnike, ende duhet të hulumtohet, por pse vdesin meshkujt më shumë se femrat pas moshës 20-vjeçare mund të përmblidhen në faktin se ushtrojnë profesione më të rënda, se më shumë pësojnë në fatkeqësi të komunikacionit, pasi që janë më mobilë në hapësirë dhe më shumë i nënshtrohen vdekjeve të dhunshme (vetëvrasjet, vrasjet), disa sëmundje më shumë i godasin meshkujt se sa femrat (sëmundjet kardiovaskulare, kancerogjene etj.), alkooli dhe duhani, që lënë pasoja të rënda në jetën e njeriut, më shumë i godasin meshkujt nga se ata më shumë i konsumojnë etj.[7]

---

[6] D. Breznik, *Demografija (Analiza, metodi i modeli),* CDI, IDN, Beograd, 1977, f. 301.

[7] D. Breznik, "Neke karakteristike smrtnosti stanovništva Jugoslavije", *Stanovništvo,* nr. 1-4/1989-1-2/1990, CDI, IDN, Beograd, 1990, ff. 13-19.

Tabela 3. Kontingjentet e rëndësishme funksionale të strukturës së popullsisë sipas moshës dhe gjinisë në Kosovë dhe në Serbi[8]

		1953		1991	
		Numri	%	Numri	%
Kontingjenti parashkollor (0-6 vjet)	Kosova	182.525	22,4	364.007	18,6
	Serbia	665.680	14,9	485.370	8,5
Kontingjenti i shkollimit të obligueshëm (7-14 vjet)	Kosova	145.647	17,9	366.522	18,8
	Serbia	564.667	12,7	615.116	10,8
Popullsia fertile femërore (15-49 vjet)	Kosova	183.464	22,5	457.588	23,4
	Serbia	1.235.479	27,7	1.382.061	24,2
Femrat në periudhën optimale riprodhuese (20-34 vjet)	Kosova	85.509	10,5	228.921	11,7
	Serbia	621.689	13,9	577.995	10,1
Kontingjenti i punës (15-64/m dhe 15-59/f)	Kosova	434.839	53,3	1.110.952	56,9
	Serbia	2.894.278	64,6	3.752.966	65,6
Kontingjenti i parë mobilizues (18-34 vjet/m)	Kosova	104.731	12,8	296.111	15,2
	Serbia	686.590	15,4	661.798	11,6
Kontingjenti i moshuar (80 e më tepër vjet)	Kosova	7.313	0,9	16.701	0,9
	Serbia	30.971	0,7	116.212	2,0

Edhe në rastin e popullsisë së Kosovës, sipas regjistrimeve të viteve 1921 dhe 1948, shihen qartë pasojat e dy luftërave botërore, për çka dëshmojnë normat e maskulinitetit pas moshës 20-vjeçare (Tabela 1). Mortaliteti më i latë i popullsisë mashkullore sipas moshës, i cili do të ndikojë në eliminimin e ngadalshëm të dominimit numerik të meshkujve mbi femrat biologjikisht të determinuar, në Kosovë dhe te shqiptarët do të vërehet vetëm pas moshës 60-vjeçare, kur femra do të ketë më tepër se meshkuj. Para kësaj moshe vdekshmëria më e lartë te femrat ka të bëjë me vitet e para të jetës dhe me periudhën e përtëritjes biologjike (fertiliteti i lartë), si rezultat i kushteve të pavolitshme shëndetësore dhe i lindjeve të shumta jashtë enteve përkatëse, por edhe i ndikimit të botëkuptimeve tradicionale, që kishin një shtrirje të gjerë deri vonë dhe zvarriten edhe sot e gjithë ditën në disa mjedise ruralo-agrare të Kosovës dhe viseve të tjera ku jetojnë shqiptarët.

Shkaqet e debalansit në strukturën e popullsisë sipas gjinisë në Kosovë dhe te shqiptarët duhet kërkuar në moszhvillim socialo-ekonomik në kuptim të gjerë dhe në botëkuptimet tradicionale. Nga dashuria e madhe që kanë prindërit për fëmijë të gjinisë mashkullore, kujdes më të madh u kushtojnë

[8] Burimi: Rezultatet e regjistrimit të popullsisë 1953 dhe për Serbinë rezultatet e regjistrimit të vitit 1991; për Kosovën për vitin 1991 vlerësimet *(Razvitak stanovništva Srbije 1950-1991,* Beograd, 1995, f. 110). Shih gjithashtu: *Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47*, SZS – CDI, Beograd, 1995, f. 135.

atyre, duke i lënë pas dore fëmijët e gjinisë së kundërt, të cilët, për këtë, por edhe për arsye të tjera, edhe vdesin më tepër (vdekshmëria ekzogjene).[9] Fëmijët e gjinisë femërore, sipas pikëpamjeve patriarkale, janë konsideruar "derë e huaj" e jo "shtyllë e shtëpisë", vlerësim ky që rezulton nga e kaluara dhe kjo traditë është ruajtur deri në ditët tona në mjediset fshatare, ndërsa arsyet kryesore, si duket, janë të natyrës ekonomike dhe sociale: në viset ku jetojnë shqiptarët me shekuj ka dominuar bujqësia dhe blegtoria, ku si fuqi potenciale punëtore është llogaritur mashkulli, i cili qysh në fëmijëri është inkuadruar në procesin e punës në tipin e tillë të ekonomisë. Në anën tjetër, teprica e meshkujve në grup-moshat e reja dhe të mesme, veçanërisht në periudhën e riprodhimit (15-49 vjet) është pasojë e mortalitetit më të lartë të grave në këtë periudhë 35-vjeçare. Së fundi, raportin jobalancues duhet kërkuar edhe në mosparaqitjen e fëmijëve të lindur gjallë të gjinisë femërore, por deri vonë edhe të asaj mashkullore, në shërbimet e gjendjes civile (ofiqaria), gjë që përsëri lidhet me moskujdesin e prindërve ndaj fëmijëve të kësaj gjinie.

Pas okupimit të Kosovës (1989) dhe veçanërisht pas vitit 1991, kur eksodi selektiv i të rinjve shqiptarë në botën e jashtme mori përmasa të gjera, që vërehej nga rënia e numrit të lindjeve, ndodhi një çrregullim i ri në strukturën e popullsisë sipas gjinisë. Shpërngulja i përfshiu kryesisht meshkujt e moshës 18 deri në 30 vjet, prandaj mund të konstatohet se për herë të parë në historinë e popullatës sonë dominojnë femrat dhe atë në periudhën më optimale riprodhuese (20-35 vjet). Priteshin edhe probleme të tjera socialo-demografike dhe politike, ndërsa çrregullime të natyrës thjesht demografike hetoheshin sa i përket martesave si në fshat, ashtu edhe në qytet, por edhe në rënien e normës së lindshmërisë. Një realitet krejtësisht i ri demografik u krijua në Kosovë pas deportimit masiv të shqiptarëve nga forcat e regjimit të Millosheviqit. Mirëpo, pas përfundimit të luftës (qershor 1999), me kthyerjen e shqiptarëve dhe rinisë së tyre, u stabilizua gjendja e përgjithshme demografike, duke përfshirë në radhë të parë raportet në strukturat bazë demografike (mosha, gjinia, struktura martesore etj.).

[9] Është fjala për zhvillimin e dobët të rrjetit shëndetësor, përfshirjen jo të mjaftueshme të lindjeve në entet shëndetësore, pastaj mbrojtja e pamjaftueshme e nënave dhe e të posalindurve, kushtet jo të volitshme socioekonomike të jetës (ushqimi, banimi), shkalla e ulët e arsimimit shëndetësor të nënave dhe popullatës në përgjithësi etj. Shkaqet e jashtme të vdekshmërisë janë studiuar sidomos nga demografi i njohur francez, J. Bourgeois-Pichat. Shih studimet e tij: "De la mesure de la mortalité infantile", *Population,* janvier-mars, INED, Paris, 1946; "La mesure de la mortalité: les causes de décès", *Population,* juillet-septembre, INED, Paris, 1951; "La mesure de la mortalité infantile: principes et méthodes", *Population,* avril-juin, INED, Paris, 1961; "Évolution récente de la mortalité infantile", *Population,* 3, INED, Paris, 1964, etj.

II. ARSIMI DHE LËVIZJA E ANALFABETIZMIT NË KOSOVË

Një ndër problemet shumëdimensionale dhe me rëndësi të madhe për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë është padyshim arsimi. Arsimi hyn në radhën e faktorëve më të rëndësishëm të formimit dhe të zhvillimit të individit dhe të transformimit të popullsisë, ekonomisë dhe shoqërisë, ndërsa brenda strukturës së arsimit vend më të rëndësishëm zë niveli i shkrim-leximit. Për shkak të lidhjes së ngushtë midis arsimit dhe zhvillimit të të gjitha sferave të jetës shoqërore, problemi i arsimit nuk mund të vështrohet i izoluar dhe në mënyrë autonome, por vetëm në kuadër të ndikimit të një varg faktorësh të tjerë kulturorë, socialë, ekonomikë dhe politikë.

Niveli i shkrim-leximit paraqet indikatorin themelor të shkallës së zhvillimit të arsimit, të kulturës dhe të zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi. Meqenëse shkaqet e analfabetizmit si dukuri negative shoqërore janë të ndryshme, ndërsa pasojat shumë të pavolitshme dhe afatgjata në të gjitha segmentet e jetës sociokulturore, ekonomike, politike, demografike, shëndetësore etj., problemi i analfabetizmit, i krijimit dhe i ruajtjes së tij duhet të njihet e studiohet në tërësinë dhe kompleksitetin e tij, sikundër që duhet të punohet pandërprerë në likuidimin e tij. Ky duhet të jetë angazhim prioritar i të gjitha subjekteve shoqëroro-arsimore dhe shkencore.

Derisa te shumë popuj të Evropës së zhvilluar analfabetizmi ka kohë që është zhdukur plotësisht dhe te disa popuj të tjerë në Evropën Juglindore është reduktuar në minimum, ndërsa në Kosovë dhe te shqiptarët në ish-Jugosllavi ende është e lartë përqindja e analfabetëve, madje me tendencë të rritjes së mëtejme edhe të numrit relativ edhe të atij absolut për shkak të vështirësive të mëdha të funksionimit të shkollës shqipe në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, që i ka imponuar pushteti okupues. Analfabetizmi si përcjellës shekullor i popullatës shqiptare dhe prania e tij deri në ditët tona, jo vetëm në fshat, por edhe në qytet, është paraqitur dhe akoma paraqitet si pengesë serioze për transformimin rrënjësor të strukturës arsimore, sociale, ekonomike dhe demografike dhe të ndryshimit të pikëpamjeve dhe marrëdhënieve të jetës klasike shoqërore. Problemi i analfabetizmit, në formën e tij më të ashpër, manifestohet në hapësirën rurale të Kosovës dhe të viseve të tjera etnike shqiptare, ku gjenden rreth dy të tretat e numrit të përgjithshëm të analfabetëve, veçanërisht te popullata femërore e të gjitha grup-moshave, duke përfshirë edhe moshën më të re. Fshati ynë ishte dhe mbeti deri vonë burim i

analfabetizmit. Madje edhe ndër punëtorë të punësuar në sektorin shoqëror të ekonomisë në kohën e komunizmit kishte analfabetë.

Në vazhdim, në mbështetje të të dhënave të regjistrimeve të popullsisë (si burim i vetëm që ofrojnë të dhëna të hollësishme për analfabetët dhe strukturën arsimore në përgjithësi), vështrohet problemi i analfabetizmit dhe lëvizja e tij për një periudhë të gjatë kohore (1921-1981), anatomia e analfabetëve dhe shkaqet e kësaj dukurie negative në Kosovë dhe te shqiptarët. Meqenëse për arsye tashmë të njohura shqiptarët nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë të vitit 1991, përcjellja dhe studimi i hollësishëm i analfabetizmit mund të bëhet vetëm deri në vitin 1981. Pas këtij viti, për këtë çështje, mund të flitet vetëm në bazë të vlerësimeve, mospërfshirjes së fëmijëve në shkollimin e obligueshëm apo braktisjes së arsimit elementar (eksodi), gjithnjë në kontekst të rrethanave të rënda politike dhe sociale-arsimore të imponuara nga hegjemonizmi serb. Edhe disa hulumtime të kufizuara, të bëra pas luftës nga të huajt dhe vendorët, ofrojnë disa të dhëna për normën e analfabetizmit në Kosovë, e cila sillet midis 5-8%, që duket vlerësim tepër i ulët.

1. Roli i shkollës në sigurimin e shkrim-leximit

Pas tërheqjes së Turqisë, në asnjë sferë të jetës shoqërore, nuk ndryshoi gjë në të mirë të shqiptarëve. Regjimi hegjemonist i Jugosllavisë së Versajës (1919) jo vetëm që nuk lejoi hapjen e shkollave dhe veprimtarinë botuese në gjuhën shqipe, por edhe e ndaloi përdorimin e kësaj gjuhe në jetën publike. Në këtë periudhë gati e tërë popullsia shqiptare ishte analfabete. Ky regjim as që kishte gatishmëri dhe përpjekje që njerëzve t'u siguronte bazat e arsimit elementar dhe të njohurive profesionale, veçanërisht jo për kombin shqiptar, i cili shkollat e para në gjuhën e vet do t'i fitojë vetëm pas Luftës II Botërore.[1] Pas kësaj lufte Kosova dhe shqiptarët trashëguan një përqindje shumë të lartë të analfabetizmit, prandaj edhe ky fakt paraqitej si pengesë e madhe në çrrënjosjen e tij të plotë.

Në vitin 1948 përqindja e analfabetizmit të përgjithshëm te shqiptarët në ish-Jugosllavi ishte shumë mbi mesataren e Kosovës (62,5%) dhe sillej rreth 74%, ndërsa te femrat shqiptare rreth 93% dhe te femrat mbi 35 vjet afër

[1] Dihet se disa shkolla shqipe kanë funksionuar edhe më parë, në shekullin XVII, madje edhe më herët, por ndonjë ndikim të gjerë në arsimimin e popullatës nuk kanë pasur (Shih më hollësisht studimin: J. Rexhepagiq, *Zhvillimi i arësimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1970, ff. 1-351).

100%. Ndërkaq, në vitin 1953 me gjithë zvogëlimin e shkallës së përgjithshme të analfabetizmit (Kosova rreth 55%), ajo ende mbetet mjaft e lartë te shqiptarët në Kosovë (rreth 66%) dhe në ish-Jugosllavi (rreth 63%). Deri nga fundi i viteve të 50-ta çdo i treti a i katërti shqiptar i moshës 10-19 vjet nuk dinte shkrim-lexim, ndërsa në fshat madje edhe çdo i dyti a i treti. Në vitin 1961 në disa komuna të Kosovës më se gjysma e popullsisë ishte analfabete (Gllogoci, Kaçaniku, Rahoveci), ndërsa 11 komuna kishin popullsi analfabete midis 45 dhe 50%.

Në vitin 1981 numri i analfabetëve në Kosovë ishte 198.566 veta ose 17,6% nga numri i përgjithshëm i popullsisë të moshës mbi 10 vjet (147.357 ose 19,7% në fshat dhe 51.197 ose 14,3% në qytet), prej të cilëve femra ishin 144.150 (26,3%) dhe meshkuj 54.406 (9,3%), ndërsa në tërë ish-Jugosllavinë numri absolut i analfabetëve ishte rreth 260.000 ose 21% nga numri i përgjithshëm i tyre të moshës mbi 10 vjet, përafërsisht me të njëjtat raporte sipas gjinisë dhe tipit të vendbanimit sikurse në Kosovë. Dhjetë vjet më parë (1971) në tërë ish-Jugosllavinë kishte 307.619 analfabetë shqiptarë ose 34,9%: përqindja më e lartë ishte në Kosovë (36,2%), ndërsa më e ulët në Slloveni (4,0%). Në hapësirat e pazhvilluara, ku shqiptarët jetojnë në numër më të madh dhe territorialisht kompakt, shkalla e analfabetizmit ishte dhe mbeti më e lartë në të gjitha grupet e moshës.[2]

Numri relativisht i madh i fëmijëve që nuk përfshihej në shkollimin e obligueshëm fillor dhe braktisja e bankave të arsimit elementar të një numri gjithashtu jo të vogël të nxënësve, janë indikatorë brengosës për gjendjen në arsimin tonë. Sipas të dhënave të Entit Pedagogjik të Kosovës, në vitin shkollor 1995/96 në arsimin fillor janë regjistruar 268.543 nxënës, ndërsa kontingjenti i brezave të moshës së këtij niveli të shkollimit (7 deri 14 vjet), arrinte në rreth 367.000 veta, që mund të jetë vlerësuar pak lart, ndonëse është marrë parasysh mortaliteti i kësaj grup-moshe për periudhën e caktuar. Kjo do të thotë se, sipas vlerësimit të këtij Enti, shkalla e mospërfshirjes së fëmijëve të moshës shkollore në këtë vit shkollor arrinte në afër 98.500 veta ose rreth 27%. Prej këtij numri, sa nuk janë përfshirë fare në arsimin elementar të të dy cikleve, sa e kanë braktisur këtë nivel të shkollimit dhe sa fëmijë apo nxënës kanë emigruar me prindërit e tyre në botën e jashtme, nuk na është e njohur. Mirëpo, prej numrit të përmendur të papërfshirë në shkollimin fillor sot, është krejtësisht e sigurt se një pjesë relativisht e madhe e tyre do të mbetej pa i siguruar bazat e arsimit elementar.

---

[2] H. Islami, "Kretanje nepismenosti u Albanaca u Jugoslaviji", *Sociologija*, nr. 2-3, Beograd, 1978, ff. 313-322.

Tabela 1. Shkalla e analfabetizmit në Kosovë, sipas regjistrimeve të popullsisë 1921-1981, sipas gjinisë (në %)[3]

Gjinia	1921	1931	1948	1953	1961	1971	1981
Meshkujt	94,8	74,5	46,9	39,0	29,8	21,3	9,0
Femrat	98,5	93,9	78,4	72,1	59,4	43,5	26,3
Gjithsej	95,5	84,2	62,5	54,8	43,9	32,0	17,6

Te shqiptarët përqindja e atyre që nuk dinin shkrim-lexim dhe u mungonte arsimi dhe edukimi institucional, deri në fund të viteve të 60-ta ishte ende shumë e lartë, sidomos te brezat e moshuara dhe te femrat. Megjithatë, përparimi i madh në zhvillimin e shkollimit fillor ndikoi dukshëm në zvogëlimin e shkallës së analfabetizmit: me futjen e dispozitave të reja ligjore mbi obligimin shkollor dhe çrrënjosjen e analfabetizmit u zgjerua rrjeti i shkollave fillore dhe u bë përfshirja sa më e madhe e fëmijëve të moshës shkollore, që pati si rrjedhojë pozitive pengimin e krijimit të analfabetëve të rinj nga radhët e popullsisë së re. Roli i shkollës në zgjerimin e shkrim-leximit dhe të arsimit të përgjithshëm e profesional ishte dhe mbeti deri më sot i pazëvendësueshëm, ndërsa shkolla fillore ishte institucioni më i rëndësishëm shoqëror e kulturor në fshat, që ofronte jo vetëm bazat e arsimit elementar e të edukimit publik, por ishte deri vonë edhe vatër e iniciativave dhe proceseve të reja.

Përveç shkollimit të obligueshëm të rregullt, Pas Luftës II Botërore, në likuidimin e analfabetizmit të trashëguar, u ndërmorën edhe forma të tjera të përvetësimit të shkrim-leximit e të dijes, siç ishin *kurset analfabetike*[4] dhe kurset e tjera: higjienike, shëndetësore, bujqësore etj., të organizuara nga organizatat politike, të grave, të rinisë, të sindikatës etj., në të cilat fitoheshin njohuritë e arsimit elementar dhe të përgjithshëm, të arsimit shëndetësor, të prodhimit bujqësor etj., ndërsa në kurset e mësuesisë, në mungesë të mësuesve të kualifikuar, aftësoheshin kuadro për funksionimin e shkollës fillore. Mirëpo, vlerësohet se për shkak të organizimit në formë fushate dhe josistematike,

[3] *Popis stanovništva i stanova 1971. Pismenost i školovanost, Knjiga II*, Zavezni zavod za statistiku, Beograd, 1974, ff. 47-50; Lj. Škara, "Nepismenost - dug pratilac društveno-ekonomskog razvoja SR Srbije", *Kultura*, nr. 19, Beograd, 1972, f. 98; *Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave në vitin 1981, Buletini 17*, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1982, f. 21.

[4] Në fillim të vitit 1947 në Kosovë kanë funksionuar 2.485 kurse kundër analfabetizmit, ku janë përfshirë 52. 413 veta (*Rilindja,* 14 shkurt 1947), ndërsa gjatë viteve 1945-1949 kishin mësuar shkrim-lexim më tepër se 100.000 analfabetë (*Rilindja*, 1 janar 1949); sipas *Rilindja*, 31 dhjetor 2004, f. 18.

kurset e analfabetizmit nuk kanë mundur të siguronin bazat e shkrim-leximit të plotë dhe afatgjatë.[5] Analizat e bëra në vitet e 50-ta treguan se numri i personave, për të cilët është konsideruar se i kanë përvetësuar bazat e shkrim-leximit në kurset analfabetike, është shumë më i vogël jo vetëm pse ato kishin karakter fushate, por edhe pse pas kurseve një numër i atyre që kishin mësuar shkrim-lexim nuk kanë pasur mundësi më tutje ta përdornin atë, prandaj kanë mbetur analfabetë,[6] veçanërisht në fshat, që mund të vërehet edhe nga përqindja e lartë e analfabetëve te të rriturit. Njohuritë e fituara të shkrim-leximit, edhe ashtu të pamjaftueshme, për shkak të mundësive të kufizuara, nuk kanë mundur t'i shfrytëzojnë më vonë sidomos femrat, ndërsa meshkujt kishin mundësi më të mëdha t'i përdornin njohuritë e fituara ose t'i fitonin bazat bile elementare të shkrim-leximit në shërbimin ushtarak.

Tabela 2. Popullsia analfabete te shqiptarët dhe te disa bashkësi të tjera kombëtare në ish-Jugosllavi 1948-1981[7]

Viti	Ish-Jugosllavia	Sllovenët	Malazezët	Serbët	Turqit	Shqiptarët
1948	25,4	3,5	35,5	36,6	63,9	73,7
1953	25,0	2,5	27,0	28,5	54,8	63,2
1971	15,1	1,1	13,4	17,3	31,0	34,9
1981	9,5	0,5	9,0	10,5	17,0	21,0

Kur të kihet parasysh fakti se personi që me të vërtetë di shkrim-lexim konsiderohet ai te i cili niveli i njohurive të leximit e të shkrimit i përgjigjet programit të shkollës fillore ose së paku programit të ciklit të ulët të saj, atëherë del se ata që kanë kaluar nëpër kurset e përmendura nuk kanë mundur t'i fitojnë bazat e shkrim-leximit të qëndrueshëm. Edhe aktivistët e rinisë sonë, në përpjekjet për likuidimin e analfabetizmit, dhe një shoqatë e formuar për këtë qëllim (më shumë për shqiptarët në botën e jashtme se sa në Kosovë!), në kuadër të fushatës euforike "Me laps në Evropë" në vitin 1990, mendonin se kjo dukuri do të mund të çrrënjosej shumë shpejt, madje vetëm për 6 deri 12 muaj! Dhe, pas një zhurme kaq të madhe, duke mos ditur se problemi ishte

[5] M. Rašević, "Pismenost stanovništva Jugoslavije", *Cvijićev zbornik*, SANU, Beograd, 1968, ff. 317-318.

[6] I. Dimnik - D. Breznik, "Popisi stanovništva i statistika školstva", *Statistička revija*, nr. 3, Beograd, 1955.

[7] Grup autorësh, *Demografska kretanja i karakteristike štanovnistva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti*, Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1978, ff. 110-111; Popis stanovništva 1981, SZS, Beograd; H. Islami, *Po aty*.

shumë më kompleks se sa dukej, kurrë nuk u prezantuan publikisht rezultatet e këtij aktiviteti. Por nuk ka dyshim se rezultate nuk mund të kishte për shkak të vetë karakterit të problemit.

2. Dobësitë metodologjike në evidencimin e analfabetëve

Kur të flitet për nivelin e analfabetizmit, të konstatuar me rezultatet e regjistrimeve të popullsisë, duhet pasur parasysh disa dobësi të natyrës metodologjike dhe atë në gjithë ish-Jugosllavinë. Në regjistrimin e vitit 1948 është konsideruar se *shkrim-lexim di personi i cili ka deklaruar se di të lexojë, por nuk di të shkruajë,* e këta janë në të vërtetë gjysmanalfabetët, ndërsa në regjistrimet e viteve 1953-1981 është zbatuar definicioni i njëjtë i shkrim-leximit, që përmblidhej në sa vijon: *konsiderohet se shkrim-lexim di personi i cili mund të lexojë dhe të shkruajë tekstin që lidhet me jetën e përditshme.* Këto dy definicione janë aq më tepër problematike ngase me rastin e regjistrimit të popullsisë regjistruesi nuk ka qenë i detyruar praktikisht të vërtetojë a di personi përkatës të lexojë e të shkruajë, por në bazë të deklarimit të tij e ka rrumbullakësuar përgjigjen. Kjo do të thotë se shkalla e vërtetë e analfabetizmit ishte shumë më e lartë se sa tregonin regjistrimet e popullsisë. Të metat metodologjike shfaqeshin edhe më tepër në dy regjistrimet e para (1948 dhe 1953), që përputhet me kohën e funksionimit të kurseve analfabetike, ngase një numër i madh i analfabetëve, sidomos i femrave tona, për të mos i ndjekur këto kurse, në regjistrime deklaronte se di të lexojë e të shkruajë. Por edhe në regjistrimet e mëvonshme ka pasur persona (që i kanë ndjekur kurset analfabetike) të cilët kanë deklaruar se dinë shkrim-lexim, ndërsa ata, në të vërtetë, kanë qenë analfabetë ose së paku gjysmanalfabetë. Këtyre dobësive metodologjike i shtohet edhe fakti se në mesin e personave të kategorive "pa përgatitje shkollore" dhe "me 1 deri 3 klasë të shkollës fillore", gjithashtu ka analfabetë dhe gjysmanalfabetë.

3. Anatomia e analfabetëve

Kur vështrohet struktura e analfabetëve sipas moshës del në pah një rregullsi e përgjithshme: analfabetizmi si dukuri është më i zgjeruar te brezat e moshuara dhe se niveli i tij rritet me moshë. Kjo tendencë veçanërisht manifestohet në fshat, te popullsia bujqësore dhe te femrat. Sipas regjistrimit të vitit 1981 në Kosovë p.sh. nga numri i përgjithshëm i analfabetëve rreth 85% e

përbënin brezat mbi 35 vjet, që do të thotë se brezat e paraluftës nuk kanë qenë të përfshirë në shkollim fillor për shkak të rrethanave që i zumë në gojë në fillim, por edhe pse të gjithë njerëzit e brezave deri në moshën 35-vjeçare pas kësaj lufte nuk kanë mundur të mësonin shkrim-lexim dhe të arsimoheshin. Fëmijët e fshatit para se të hynin në shkollë, por edhe jashtë shkollës, në mungesë të mjeteve të komunikimit masiv dhe të krijesave të tjera të jetës bashkëkohore, nuk kanë pasur si të fitojnë njohuri mbi natyrën dhe shoqërinë; ata njohuritë i fitonin vetëm përmes edukimit familjar dhe traditës gojore. Mirëpo, ekzistimi i analfabetëve deri në ditët tona te brezat e rinj dhe formimi i analfabetëve të rinj, veçanërisht në fshat, dëshmon për faktin se të gjithë të rinjtë nuk kanë qenë të përfshirë në shkollim të obligueshëm fillor, ndonëse analfabetizmi relativ ndër të rinj gjithnjë shënonte rënie. Sipas regjistrimit të vitit 1971 brenda grup-moshës 10-19 vjet 12,0% ishin analfabetë, ndërsa në vitin 1981 kjo pjesëmarrje zvogëlohet në rreth 5%. Numri i analfabetëve prej rreth 10.000 vetave të moshës 10-19 vjet (1981), ku më se 63% e tyre gjenden në fshat, ishte indikator i funksionimit të dobët të shkollës fillore në Kosovë dhe njëra ndër tendencat e pavolitshme për perspektivën e zgjerimit dhe masovizimit të shkrim-leximit, por edhe të efekteve të tjera negative për zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.

Tabela 3. Popullsia analfabete e Kosovës sipas grup-moshave, sipas regjistrimeve të popullsisë 1948-1981 (në %)[8]

Viti	10-19	20-34	35-64	65 e më tepër vjet
1948	46,7	50,9	77,9	94,7
1953	31,2	46,0	77,0	92,6
1961	13,7	37,7	69,4	91,3
1971	11,0	16,5	56,7	87,3
1981	2,5	6,1	33,3	78,0

Analiza e analfabetëve sipas gjinisë tregon se ekzistojnë dallime të mëdha në dëm të popullsisë femërore edhe në aspektin rajonal edhe në tërësi. Nga numri i gjithmbarshëm i analfabetëve në Kosovë (1981) rreth 73% i përket femrave dhe po aq femrave në fshat. Por edhe në vendbanimet urbane

[8] Burimi: *Popis stanovništva i stanova 1971. Pismenost i školovanost, Knjiga II*, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1974, ff. 47-50; Lj. Škara, "Nepismenost - dug pratilac društveno-ekonomskog razvoja SR Srbije", *Kultura*, nr. 19, Beograd, 1972, f. 98; *Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave në vitin 1981, Buletini 17*, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1982, f. 21.

çdo e pesta femër ishte analfabete dhe rreth 76% të të gjithë analfabetëve e përbënin femrat. Në Kosovë përqindja e analfabetëve te popullsia bujqësore ishte 27,7% (meshkujt 18,9% dhe femrat 36,6%), ndërsa te popullsia jobujqësore 14,8% (meshkujt 6,5% dhe femrat 23,2%). Është interesant se me rastin e vlerësimit të nivelit të shkrim-leximit midis meshkujve dhe femrave hetohen dy tendenca karakteristike: *së pari,* shkrim-leximi më herët është zgjeruar te meshkujt e më vonë te femrat, që lidhet me mobilitetin më të madh hapësinor e social dhe aspiratat profesionale të popullatës mashkullore, ndërsa me ngulitjen më të theksuar të femrës për suaza familjare, ekonomi shtëpiake dhe bashkësi lokale; dhe *së dyti,* dallimet në nivelin e shkrim-leximit midis meshkujve dhe femrave para 5-6 dhjetëvjetëshave ishin më të vogla, por me kalimin e kohës, me rënien e shkallës së përgjithshme të analfabetizmit, këto dallime u rritën. Në vitin 1981 derisa në fshat çdo i dhjeti banor i gjinisë mashkullore ishte analfabet, ndërsa çdo e treta femër e moshës mbi 10 vjet nuk dinte të lexonte e të shkruante. Analfabetizmi te femrat ka efekte të shumëfishta në jetën shoqërore dhe paraqitet si pengesë e madhe në emancipimin social-kulturor dhe në pavarësinë materiale të saj. Femra e paarsimuar, e cila njëkohësisht është edhe e varur ekonomikisht, i ka mundësitë shumë të kufizuara për t'i shprehur aspiratat personale dhe nevojat e interesat e tjera jetësore jashtë suazave familjare dhe lokale.

Tabela 4. Numri i përgjithshëm i analfabetëve në Kosovë sipas tipit të vendbanimit dhe moshës, sipas regjistrimit të vitit 1981[9]

Tipi i vendbanimit	Numri i analfabetëve	% nga numri i përgjithshëm	10 – 19		20 – 34		35 – 64		65 e më tepër vjet e të panjohur	
			Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Qyteti	51.197	13,4	3.451	3,0	6.551	5,2	27.302	23,0	13.893	67,1
Fshati	147.359	19,7	6.118	2,3	14.290	6,5	84.340	38,9	42.611	82,3
Gjithsej	198.556	17,6	9.569	2,5	21.142	6,1	111.642	33,3	56.504	78,0

Brengos fakti se analfabetë kishte edhe ndër *punëtorë të punësuar në sektorin shoqëror të ekonomisë së Kosovës deri sa ajo funksionontе.* Në vitin 1980 p.sh. nga numri i përgjithshëm i punëtorëve në këtë sektor në Kosovë, 12.573 ose 7,1% ishin pa përgatitje shkollore dhe me 1 deri 3 klasë të shkollës

[9] R*egjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave, Buletini 17*, EKS, Prishtinë, 1982, f. 21.

fillore, ndërsa prej tyre 8.699 ose 69,1% ishin shqiptarë. Ndër ta padyshim kishte mjaft analfabetë dhe gjysmanalfabetë. Sa i përket veprimtarisë dhe strukturës profesionale këta punëtorë ishin të punësuar në industri e në miniera, në ndërtimtari, në veprimtari komunale etj. Në vitin 1989 numri i punëtorëve me këtë përgatitje shkollore zvogëlohet në 9.421 (6.355 shqiptarë) sigurisht për shkak të pensionimit të një pjese të tyre, por struktura sipas veprimtarisë dhe profesionit mbetet e njëjtë.

Kur të vështrohet niveli dhe struktura e analfabetëve sipas gjinisë, moshës, fuqisë punëtore etj. midis komunave të Kosovës, vërehet se ka dallime, por ato nuk janë të mëdha. *Në mjediset homogjene shqiptare përqindja e analfabetizmit është më e lartë se mesatarja e Kosovës dhe e kundërta për arsye që i zumë në gojë më lartë.* Ndërsa gjendja e analfabetizmit në hapësirën rurale të komunave sillet kryesisht rreth mesatares së hapësirës rurale të Kosovës; territori fshatar i Kosovës sa i përket shkrim-leximit dhe determinanteve të tjera të mënyrës së jetesës ishte dhe mbeti relativisht homogjen, ku përjashtim në drejtim të pavolitshëm bënin fshatrat kodrinore-malore.[10] Në vitin 1981 p.sh. dallimet në shkallën e analfabetizmit midis territorit rural të komunës së Prishtinës, si komuna më e zhvilluar, dhe territoreve fshatare të komunave të pazhvilluara ishin fare simbolike: në hapësirën rurale të Prishtinës ishte për meshkuj 9,0% dhe për femra 27,0%, kurse në hapësirën rurale të Suharekës për meshkuj ishte 10,6% dhe për femra 27,4%, të Klinës për meshkuj 12,3% dhe për femra 29,4% etj. Dallimet në shkallën e analfabetizmit brenda hapësirës komunale janë të konsiderueshme midis selisë komunale dhe pjesës tjetër të territorit komunal për shkak të mungesës së shkollave fillore në fshatra, si dhe përfshirjes jo të njëjtë të fëmijëve në këto shkolla. Por edhe qytetet kishin numër të konsiderueshëm të popullsisë analfabete dhe atë jo vetëm brezat e moshuara, por edhe brezat e ndërmjetshëm dhe të reja, që është kryesisht pasojë e imigrimeve nga fshati në dhjetëvjetëshat e fundit të transformimit të qendrave urbane.

[10] H. Islami, "Nepismenost u današnjem kosovskom selu", *Sociologija sela,* br. 77/78, Zagreb, 1982, ff. 219-232.

Tabela 5. Popullsia analfabete e Kosovës sipas tipit të vendbanimit, gjinisë dhe moshës, sipas regjistrimit të vitit 1981[11]

Tipi i vendba-nimit	Gjinia	Numri i analfabetëve	% nga numri i përgjithshëm	10 – 19		20 – 34		35 – 64		65 e më tepër vjet e të panjohur	
				Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Qyteti	M	11.889	6,1	843	1,4	1.165	1,8	5.032	8,3	4.821	50,9
	F	39.308	20,9	2.608	4,7	5.386	8,6	22.242	38,0	9.072	80,8
Fshati	M	42.571	10,9	1.173	0,8	2.429	2,0	20.654	18,8	18.261	70,2
	F	104.842	29,2	4.945	4,0	11.861	11,6	63.685	59,4	24.350	94,6
Gjithsej	M	54.406	9,3	2.016	1,0	3.594	2,0	25.686	15,1	23.082	65,0
	F	144.150	26,3	7.553	4,2	17.242	10,5	85.927	51,8	33.422	90,4

Gjendja jo e kënaqshme në fushën e arsimit, para së gjithash të arsimit elementar, vërehet edhe nga të dhënat për personat pa përgatitje shkollore dhe me arsim të pakryer fillor. Sipas regjistrimit të vitit 1981 numri i personave pa përgatitje shkollore në Kosovë ishte 238.808, që do të thotë 40.252 veta më tepër se që ishte numri i analfabetëve të regjistruar, ndërsa 19.763 veta kishin 1 deri 3 klasë dhe 158.767 veta të moshës 15 e më tepër vjet 4 deri 7 klasë të shkollës fillore. A i kanë përvetësuar bazat e shkrim-leximit të gjithë këta persona, të cilët nuk e kanë kryer as shkollën e plotë fillore, është vështirë të thuhet, veçanërisht jo për personat pa përgatitje shkollore dhe me 1 deri 3 klasë të shkollës fillore.

Situata më e pakënaqshme ishte në fshat dhe ndër popullsinë aktive bujqësore. Në vitin 1981, përveç 147.359 analfabetëve statistikisht të evidencuar në fshat, 29.279 veta nuk kishin kurrfarë përgatitje shkollore, 14.000 veta kishin prej 1 deri 3 klasë të shkollës fillore dhe 118.619 veta kishin prej 4 deri 7 klasë të shkollës fillore. Ndër personat e kategorive pa përgatitje shkollore dhe prej 1 deri 3 klasë të shkollës fillore, duhet të ketë shumë gjysmanalfabetë, por edhe analfabetë. Veçanërisht është i ulët niveli i popullsisë aktive në bujqësi, ku në vitin 1981 nga gjithsej 82.257 veta, 33.504 veta ose 40,7% të tyre ishin pa përgatitje shkollore dhe me 1 deri 3 klasë të shkollës fillore, prej të cilëve 24.123 veta ose 72% të tyre kishin deklaruar se janë analfabetë.[12] Një gjendje e tillë e pavolitshme manifestohej sigurisht në

[11] *Po aty*, fq. 21.

[12] *Regjistrimi i popullsisë, ekonomive shtëpiake dhe i banesave më 1981, Buletini 20*, EKS, Prishtinë, 1982. f. 105.

zvogëlimin e shkallës së aftësisë së fuqisë punëtore që t'i përvetësojë format e reja teknologjike dhe organizative të punës në sektorin agrar të ekonomisë.

Kur të kihet parasysh se konceptimi bashkëkohor (standardet ndërkombëtare) i shkrim-leximit përmblidhet në faktin se personi që me të vërtetë di të shkruajë e të lexojë konsiderohet ai te i cili niveli i njohurive të leximit e të shkrimit i përgjigjet programit të shkollës së obligueshme fillore, atëherë është e qartë se shkalla e analfabetizmit faktik është shumë më e lartë se ajo që pasqyron gjendjen e shkrim-leximit statistik.

4. Shkaqet e analfabetizmit

Është fakt se shkalla e analfabetizmit në Kosovë dhe te shqiptarët është mjaft e lartë, veçanërisht në rajonet rurale dhe te popullata femërore në të gjitha tipat e vendbanimeve. Shkaqet themelore që kanë ndikuar në krijimin dhe ruajtjen deri në ditët tona të analfabetizmit mund të përmblidhen në disa, të cilët, në ndikimin e tyre, shpeshherë ishin reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar. Këto shkaqe, sipas analizave tona, janë:

Së pari, përqindja e lartë e popullsisë analfabete në Kosovë dhe te popullata shqiptare është rezultat i gjendjes shumë të pavolitshme të trashëguar në fushën e arsimit e të kulturës, siç janë mungesa e plotë e shkollave fillore në gjuhën shqipe dhe diskriminimi kombëtar, social dhe kulturor i shqiptarëve për një kohë shumë të gjatë, që dëshmon niveli i analfabetizmit i brezave të të dy gjinive të moshës mbi 65 vjet.

Së dyti, ndonëse përpjekjet kryesore të zgjerimit të shkrim-leximit iu lanë sistemit të obligueshëm shkollor, të zbatuar pas Luftës II Botërore, megjithatë një numër i madh i të rinjve, të lindur pas kësaj lufte, mbeti analfabetë, që do të thotë se shkolla fillore si vatër kryesore e fitimit dhe e zgjerimit të shkrim-leximit dhe të dijes, veçanërisht në fshat, nuk e përmbushi detyrën e saj shumë të rëndësishme shoqëroro-arsimore që iu destinua. Një ndër arsyet e mospërmbushjes së këtij funksioni qëndron në faktin se në gjithë periudhën e pasluftës rrjeti i shkollave fillore nuk i mbulonte të gjitha vendbanimet (fshatrat), prandaj edhe mospërfshirja e fëmijëve ishte shumë e madhe, sidomos deri nga fundi i viteve të 60-ta (p.sh. në vitin shkollor 1970/71 ishin të përfshirë vetëm 86% të fëmijëve të moshës 7-14 vjet, ndërsa më vonë edhe pse kjo gjendje u përmirësua, përfshirja nuk ishte e plotë). Në anën tjetër, *dispersiteti dhe shkapërderdhja e vendbanimeve fshatare* është një ndër faktorët e rëndësishëm që kanë kushtëzuar që të gjitha fshatrat të mos kenë shkolla fillore deri vonë, e disa sish edhe sot. Por vështirësitë në përfshirjen e

të gjithë fëmijëve të moshës shkollore, sidomos të gjinisë femërore, janë të lidhura edhe me faktin se edhe numri ekzistues i shkollave territorialisht nuk është as sot i distribuuar si duhet. Prandaj edhe largësia prej shtëpisë deri në shkollë ishte e madhe, ku fëmijët duhej ta bënin udhëtimin në këmbë nëpër terrene jo të përshtatshme kodrinore-malore. Sipas ligjit të atëhershëm të arsimit dhe edukimit elementar të Kosovës (1973), nxënësit e moshës 7-11 vjet liroheshin nga shkollimi i obligueshëm fillor nëse shkolla ishte larg më tepër se 4 km, si dhe nxënësit e moshës 11-15 vjet nëse kjo largësi ishte më tepër se 6 km. Në fakt, ky ligj u linte në kompetencë kuvendeve komunale që, për fëmijët e moshave të përmendura dhe për distancat e zëna në gojë të kujdeseshin lidhur me organizimin e transportit, të vendosjes dhe të hapjes së paraleleve të ndara.[13] Mirëpo, dihej mirë se kujdesi i këtyre kuvendeve ishte nën çdo nivel, gjë që ndikoi në formimin e analfabetëve të rinj.

Së treti, efikasiteti i dobët i shkollimit, i cili pa dyshim varej nga rrethanat e përmendura, gjithashtu është shkak i mospërfshirjes së mjaftueshme të fëmijëve të moshës së shkollimit të obligueshëm, e me këtë edhe të krijimit të analfabetëve të rinj, veçanërisht te ata fëmijë, të cilët, pa i kryer klasat e ciklit të ulët, i linin bankat e shkollës fillore, ndërsa ligji mbi shkollën fillore, pa marrë parasysh se a e kanë përmbushur fëmijët obligimin e shkollimit tetëvjeçar, lejonte që nxënësit ta braktisnin shkollimin pasi t'i mbushnin 15 vjet. Deri në vitet e shtatëdhjeta shkapërderdhja e nxënësve ishte aq e madhe sa që në vitin shkollor 1964/65 në Kosovë ishin regjistruar në klasën e parë të shkollës fillore 34.884 nxënës (18.548 meshkuj dhe 16.236 femra), ndërsa në vitin shkollor 1971/72 shkollën e plotë të obligueshme fillore e kishin kryer vetëm 16.316 ose 47,0% të nxënësve (10.346 meshkuj dhe 5.970 femra); çdo i nënti ose i dhjeti banor i Kosovës i moshës 10-19 vjet nuk kishte fituar as arsim më elementar shkollor, ndërsa në fshat madje çdo i shtati apo i teti banor i kësaj moshe. Qoftë me mospërfshirje të plotë, qoftë me braktisjen e shkollës fillore pas disa viteve të kaluara në të, në vitin 1981 janë rekrutuar 9.569 analfabetë të moshës 10-19 vjeçare, prej të cilëve 6.118 në fshat. Sipas regjistrimit të vitit 1981, 15.789 fëmijë të moshës 7-11 vjet dhe 4.728 fëmijë të moshës 12-15 vjet nuk e vijonin shkollimin e obligueshëm fillor. Ndonëse sa i përket përfshirjes së fëmijëve në shkollim, pas rrënimit të subjektivitetit politik të Kosovës dhe vënies së gjendjes okupuese, nuk kemi të dhëna, tendenca e mospërfshirjes apo e braktisjes së shkollës fillore ka vazhduar me intensitet edhe më të madh dhe është rritur numri absolut dhe relativ i analfabetëve, veçanërisht nga radhët e femrave.

[13] *Zakon o osnovnom obrazovanju i vaspitanju SAP Kosovo, 42/73*, Priština, 1973, neni 77.

Së katërti, analfabetizmi i prindërve dhe konzervativizmi dhe fanatizmi i tyre fetar, veçanërisht në territorin ruralo-agrar, siç dihet, përpara paraqitnin pengesë të madhe në zgjerimin e pikëpamjeve të reja mbi botën edhe jetën, prandaj edhe në zgjerimin e shkrim-leximit dhe të dijës te fëmijët e tyre. Dominonin qëndrime dhe sjellje të veçanta ndaj femrës dhe rolit të saj, që deri vonë pati për pasojë pengimin e fëmijëve të gjinisë femërore që të vijojnë shkollimin dhe në këtë mënyrë të mbesin analfabetë dhe të paarsimuar tërë jetën. Rezistenca në këtë drejtim ka pasur deri vonë në mjediset fshatare, ndërsa aty-këtu mund të hetohen edhe sot. Fakti se në Kosovë më 1981 mbi 7.553 fëmijë të gjinisë femërore (78,9%), prej të cilëve në fshat 4.945 (65,4%) nga grup-mosha 10-19 vjet nuk dinin shkrim-lexim, tregon se deri në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar ishte e pranishme prapambeturia dhe psikologjia e rrënjosur me shekuj se pozita dhe funksioni i femrës janë të lidhura me suazat familjare të jetës dhe riprodhimin biologjik.

Së pesti, dominimi i derivonshëm i ekonomisë natyrale agrare dhe i autarkisë demografike, kur e gjithë jeta ishte e lidhur për ekonomi shtëpiake, për pronë tokësore dhe bashkësi rurale, kushtëzoi nevojën për angazhim ekstensiv të fëmijëve në punët bujqësore. Ky tip i ekonomizimit ndikoi që fëmijët të mos ndjekin shkollimin apo ta ndërpritnin shkollimin e filluar vetëm pas disa klasave të kryera dhe në këtë mënyrë të mbetnin analfabetë për një kohë të gjatë, madje edhe tërë jetën. Por, me ndryshimet sociokulturore dhe ekonomike pas viteve të 70-ta të shekullit XX dhe me ndryshimin e qëndrimit të popullatës rurale ndaj shkollës, si arsimi fillor, ashtu edhe arsimi i përgjithshëm dhe profesional gjerësisht është përqafuar si bazë për transformimin rrënjësor të mënyrës së jetesës në fshat dhe hapjen e perspektivave të reja për zhvillimin e përgjithshëm.

Së gjashti, ndonëse nuk kemi të dhëna të hollësishme për lëvizjen e analfabetizmit pas vitit 1981, megjithatë të gjitha vlerësimet dhe analizat flasin për krijimin e analfabetëve të rinj dhe rritjen e numrit të personave pa përgatitje shkollore. Gjendja jo e kënaqshme në sferën e arsimit elementar këto 20 vjetët e fundit është padyshim rezultat, së pari i pengesave të ndryshme të regjimit serb, e pastaj, pas vitit 1990, edhe i agresionit të haptë serbomadh në të gjitha nivelet e arsimit shqiptar, ku mospërfshirja dhe shkapërderdhja e nxënësve arriti shkallën maksimale, e me këtë edhe mundësinë e rekrutimit të analfabetëve të rinj. Sipas të dhënave të Entit Pedagogjik të Kosovës në vitin shkollor 1995/96 mospërfshirja e fëmijëve të moshës 7 deri 14 vjeç në shkollën fillore sillet rreth 27% (në klasat e ulëta rreth 24% dhe në klasat e larta rreth 30%). Shkalla e shkapërderdhjes së nxënësve në arsimin fillor është aq e madhe sa, sipas të dhënave të këtij Enti, në këtë vit shkollor, në klasën e tetë kanë arritur vetëm rreth 64% të nxënësve që ishin regjistruar në klasën e

parë. Vlerësohet se një numër i madh i fëmijëve, qoftë të papërfshirë në arsim elementar, qoftë duke e braktisur shkollimin e filluar, do të mbetet analfabetë ose së paku gjysmanalfabetë për tërë jetën.

Si përfundim mund të theksohet se me analfabetizmin, si fakt të pamohueshëm të pazhvillueshmërisë dhe prapambeturisë, Kosova dhe shqiptarët hynë edhe në shekullin XXI dhe, si duket, do të ballafaqohen me të edhe një kohë relativisht të gjatë. Roli i shkollës fillore edhe më tutje do të mbetet kryesori në sigurimin e bazave të shkrim-leximit dhe në pengimin e krijimit të analfabetëve të rinj. Mirëpo, në likuidimin e analfabetizmit te të gjitha grup-moshat duhet të inkuadrohen patjetër edhe institucionet e tjera shoqërore, kulturore dhe politike. Por njëkohësisht duhet pasur të qartë se kjo e keqe e madhe shoqërore nuk eliminohet aq lehtë dhe shpejt. Aktiviteti në drejtim të zhdukjes së analfabetizmit dhe të ngritjes kulturo-arsimore të popullsisë duhet të jetë profesionalisht mirë i organizuar, sistematik dhe afatgjatë. Kosovën e re dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi i presin në të ardhmen detyra të mëdha dhe me përgjegjësi edhe në këtë drejtim.

III. PËRBËRJA KOMBËTARE E POPULLSISË SË KOSOVËS

Gadishulli Ballkanik gjatë gjithë historisë së tij, siç dihet, ishte vatër e lëvizjeve, kontakteve dhe konflikteve të popujve dhe kryqëzimit e shtresëzimit të kulturave dhe civilizimeve të ndryshme.[1] Përveç konflikteve të brendshme të pandërprera, veçanërisht këto dy shekujt e fundit, hapësirat ballkanike u bënë joshëse edhe për okupimet dhe dominimet e huaja, ndërsa Ballkani Qendror, ku shtrihet Kosova dhe viset e tjera etnike shqiptare, ishte dhe mbeti nyja më neuralgjike historiko-politike, gjeopolitike dhe etnodemografike. Me depërtimin e romakëve, sundimin e gjatë të Bizantit në mesjetë, ardhjen e sllavëve, e më vonë edhe të turqve, në Ballkan u krijuan raporte të reja në strukturën e popullimit dhe ndodhën ndryshime të konsiderueshme në pasqyrën etnike, ku më së shumti pësoi etnikumi iliro-shqiptar, i cili dikur i shtrirë në tërë Siujdhesën Ballkanike, me romanizimin e një pjese të madhe,[2] do të rrudhet dukshëm në kohën e vonë antike, proces ky që do të vazhdojë edhe në mesjetë, kur do të sllavizohen masa të mëdha shqiptarësh.[3] Në truallin gjeoetnik të shqiptarëve u bë edhe prerja e kulturave perëndimore dhe lindore, që la pasoja të shumënduarshme, ndërsa ndarjet e njëpasnjëshme të hapësirës etnike shqiptare, popullit shqiptar i sollën tragjeditë më të mëdha në të gjitha rrafshet, me të cilat edhe sot e gjithë ditën po ballafaqohet.[4]

---

[1] "Në këtë mes do shtuar edhe diçka tjetër: dendësia etnike në të gjitha trevat e Ballkanit nuk ishte njësoj; në disa pika të tij ishin rrasur shumë popuj duke u shtruar njëri mbi tjetrin" (I. Ajeti, në vështrimin mbi librin e Sh. Demirajt "Gjuhësi ballkanike", *Studime*, 2/1995, ASHAK, Prishtinë, 1996, f. 289).

[2] Z. Mirdita, *Studime dardane*, Rilindja, Prishtinë, 1979, ff. 118-128.

[3] Shih më gjerë: A. Handžić, "Nekoliko vijesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV vijeka", *Simpozium për Skënderbeun*, Prishtinë, 1969, ff. 201-209; H. Hadžibegić, A. Handžić, E. Kovačević, *Oblast Brankovića - opširni katastarski popis iz 1445 godine*, Sarajevo, 1972; S. Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI*, Tiranë, 1984, ff. 1-721; S. Pulaha, "Nahija e Altun-ilisë dhe popullsia e saj në fund të shekullit XV", *Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike*, I-1971, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1972, ff. 193-272; S. Pulaha, "Krahinat verilindore të sanxhakut të Dukagjinit - Hasi dhe popullsia e tyre në gjysmën e shekullit XVI", *Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike*, II-1972, Prishtinë, 1974, ff. 185-336; M. Tërnava, "Shqiptarët në qytetet e Kosovës në shekullin XV-XVI", *Studime historike*, 2, Tiranë, 1979, ff. 105-145; M. Tërnava, *Studime për mesjetën,* Dukagjini, Pejë, 2000, ff. 85-278.

[4] R. Ismajli, "Shqiptarët dhe Evropa Juglindore", *Thema, 11*, Prishtinë, 1993, ff. 29-38.

1. Manipulimet serbe rreth dimensionit etnodemografik të Kosovës

Dimensioni etnik-demografik i Kosovës dhe i shqiptarëve tashmë një kohë të gjatë është bërë objekt spekulimi i historiografisë dhe i antropogjeografisë serbe dhe pastaj edhe i qarqeve dhe regjimeve politike serbo-jugosllave. Qarqet shkencore dhe politike serbe, për t'i jetësuar aspiratat shekullore për dominim dhe hegjemoni ndaj Kosovës, përveç me të ashtuquajturën "të drejtë historike" dhe Kosovën si "territor të shpirtit mesjetar serb", spekulonin pandërprerë edhe me "argumentin demografik" me qëllim që Kosova të kundrohej si "çështje ekskluzivisht serbe" dhe "ekzistencë e popullit serb",[5] ndërsa shqiptarët të privoheshin edhe nga të drejtat e tyre historike, edhe të drejtat e tyre aktuale, dhe atë jo vetëm për të vendosur vetë për fatin e tyre, por edhe për të jetuar në Kosovë! Sipas tyre, shqiptarët na qenkan këtu "element i huaj", "i ardhur" këto 2-3 shekujt e fundit, madje edhe pas vitit 1941 si "uzurpatorë" në territorin e "shpirtit mesjetar serb", etj.[6] Prandaj, të gjitha pushtetet serbo-jugosllave ndërmorën aksione të vazhdueshme për sakatosjen e homogjenitetit etnik të trojeve shqiptare, ndërrimin e përbërjes etnodemografike dhe dobësimin e fuqisë vitale të popullatës shqiptare me masa të ndryshme të presionit e të terrorit.

Në këtë vazhdë duhet parë veçanërisht fushatën e gjerë dhe shumë transparente kundër Kosovës dhe shqiptarëve gjatë gjithë viteve të 80-ta dhe të 90-ta të shekullit të kaluar. Në kuadër të kësaj fushate *vend të rëndësishëm zinte edhe diskursi mbi problemet demografike të shqiptarëve;* sektori demografik madje sikur u bë rrafshi qendror i akuzave dhe atakimeve kundër shqiptarëve. Duke dashur që përmes Kosovës, kërcënimeve dhe represionit brutal ndaj shqiptarëve ta hapin të ashtuquajturën "çështje të pazgjidhur serbe" në Jugosllavinë e Dytë dhe të trumbetonin kinse pozitën diskriminuese, degraduese dhe inferiore të Serbisë e të serbëve në planin ekonomik, politik e juridik në ish-Jugosllavi, veçanërisht në Kosovë,[7] të gjitha instancat serbe dhe jugosllave, nga ato politike e shtetërore e deri te ato shkencore, kulturore, publicistike, informative etj. nisën të shpifin teza të ndryshme, por më transparente ishin: se shqiptarët në mënyrë të organizuar po u blejnë serbëve tokën dhe po lindin shumë fëmijë për shkaqe nacionaliste me qëllim që t'i

---

[5] Shih më gjerë: D. Bogdanović, *Knjiga o Kosovu,* SANU, Beograd, 1986.

[6] Shih më gjerë: H. Islami, *Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1997, ff. 219-220, 233-234.

[7] *Memorandum SANU,* Beograd, 1986. Teksti i plotë i "Memorandumit" u botua në revistën *Naše teme,* br. 1-2, Zagreb, 1988, ff. 128-163. Në gjuhën shqipe botohet në: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve)*, Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 304-363.

ndjekin serbët nga Kosova si "territor i shenjtë i tyre" dhe të krijojnë "Kosovën etnikisht të pastër" dhe "Shqipërinë e Madhe".

Diskursi ndaj natalitetit të shqiptarëve ishte sa neomaltusianist, aq edhe shovinist; ai zhvillohej në mungesë të plotë të gjykimit racional, duke u injoruar ligjësitë objektive të zhvillimit shoqëror dhe qasjet humaniste e shkencore ndaj zhvillimit të popullsisë së një kombi të tërë. Jo vetëm që me të madhe përdoreshin termat "eksplozion demografik" dhe "ekspansion demografik" i shqiptarëve të kohës së dominimeve kolonialiste dhe neokolonialiste, por indoktrinimi antinatalist dhe antishqiptar kishte marrë përmasa të gjera në të gjitha shtresat e shoqërisë serbo-jugosllave sa që fyhej rëndë femra shqiptare, e cila në çdo forum politik dhe në mediume cilësohej si "makinë për prodhimin e fëmijëve". Në mitingjet populiste-nacionaliste, ku bëhej homogjenizimi dhe mobilizimi etnik i masave serbe dhe ku shfrytëzohej e tërë energjia e popullit "hyjnor" serb kundër shqiptarëve dhe përgatitjes për konfrontim me të gjithë popujt joserbë, nxirreshin parulla me përmbajtje thjesht raciste e gjenocidale, si p. sh. "Shqiptarët shumohen shumë, por farën e kanë të prishur", "Shqiptarët duhet dëbuar", "Shqiptarët duhet vrarë" etj!

Diskursi për Kosovën dhe problemet demografike të shqiptarëve nuk zhvillohej me qëllim të zgjidhjes së drejtë të çështjes kosovaro-shqiptare ose për shkak të përmirësimit të cilësisë së lindjes, të riprodhimit biologjik dhe të jetës së shqiptarëve, por shtrohej për arsye të një frike nga shqiptarët, veçanërisht numrit të madh, rritjes së shpejtë demografike, shtrirjes së gjerë dhe territorialisht kompakte dhe perspektivës së tyre demografike në ish-Jugosllavi. *Shqiptarofobia mori përmasa shqetësuese, shqiptarët nisën të numërohen,* ndërsa regresi evident demografik i disa nacionaliteteve joserbe dhe josllave, si i hungarezëve, vllehve etj., as që u interesonte![8] Ish-shteti, me të gjitha mekanizmat e tij, angazhohej haptazi për dobësimin e fuqisë vitalo-demografike të shqiptarëve me masa të diskriminimit dhe represionit ekonomik, social, juridik, politik, psikologjik etj. dhe mposhtjen e epërsisë numerike dhe reproduktive të shqiptarëve dhe të vënies së baraspeshës etnike përmes kolonizimit të serbëve dhe dëbimit të shqiptarëve. Për këtë qëllim

[8] Ndaj këtyre komuniteteve u zgjodh rruga e asimilimit të tyre. P. sh. numri i hungarezëve në ish-Jugosllavi shënonte zvogëlim permanent: 504.369 më 1961, 426.867 më 1981 dhe 378.011 më 1991. Ndërsa, vllehët pothuajse e humbën përkatësinë etnike dhe u shkrinë në serbë. Sipas regjistrimit të vitit 1981 në Serbi rreth 130.000 vetë deklaruan se gjuhë amtare e kanë vllahishten, ndërsa me kombësi vllehe u përcaktuan vetëm rreth 25.000 veta. Ndërkaq, sipas regjistrimit të vitit 1991, në Serbi vllehët edhe si grup linguistik u asimiluan: me kombësi u deklaruan 17.642 dhe me gjuhë amtare 16.497 veta!

pasuan disa valë të kolonizimit të serbëve në Kosovë dhe të ndjekjes së shqiptarëve nga Kosova.[9]

Mirëpo, kolonizimi i Kosovës dhe ndërrimi i përbërjes etnike të saj në favor të serbëve, me gjithë përpjekjet energjike të gjithë shtetit të atëhershëm, sikundër edhe të regjimeve të mëparshme serbo-jugosllave nuk patën sukses. Këto përpjekje dështuan, përveç tjerash, edhe pse Serbia dhe të gjitha Jugosllavitë, parakomuniste e komuniste, e dëshironin edhe Kosovën e kolonizuar dhe joshëse për serbët, edhe Kosovën e pazhvilluar dhe me normë të lindshmërisë të tipit evropian për shqiptarët. Këto qëllime, natyrisht, nuk shkonin së bashku. Por, duhet konstatuar një fakt: aspekti demografik i problemit të Kosovës nuk do të pushojë së qeni aktual jo vetëm në qarqet shtetërore e shkencore serbe, por edhe në gjithë shoqërinë serbe derisa Kosova të mos dalë edhe faktikisht nga Serbia dhe derisa të mos zgjidhet definitivisht çështja shqiptare në Ballkan. Serbët, por edhe disa fqinj të tjerë ballkanikë, faktorin demografik shqiptar gjithnjë do ta shohin si rrezikim të prosperitetit shtetëror, kombëtar dhe gjeodemografik të tyre.

Manipulimet dhe spekulimet e para me të vërtetën rreth kompozicionit etnodemografik të Kosovës dhe lëvizjeve migruese të popullsisë dalin nga J. Cvijiqi (1865-1927) dhe shkolla e tij antropogjeografike, të cilat në kontinuitet përsëriten gjatë gjithë shekullit XX. Mirëpo, teza e Cvijiqit dhe e ithtarëve të tij për ardhjen kinse masive të shqiptarëve këto 2-3 shekujt e fundit në Kosovë nga Shqipëria Veriore, kur ajo, me "dyndjen" e serbëve në drejtim të veriut pas luftërave të përmendura austriako-turke të viteve 1689-1690 dhe 1737-1739 na qenka shndërruar në një "vakum demografik",[10] nuk qëndron për shumë arsye, para së gjithash gjeografike dhe demografike: Shqipëria Veriore si territor malor, me resurse të kufizuara ekzistenciale, nuk ka mundur të ketë popullsi kaq të madhe për ta popullzuar gjithë Kosovën dhe viset rreth saj, ku siç dëshmojnë regjistrimet e përmendura kadastrale turke, qysh në shek. XV dhe XVI kjo pjesë e Shqipërisë së sotme malore kishte disa herë më pak popullsi dhe vendbanime sesa Rrafshi i Dukagjinit dhe Fusha e Kosovës. Këtë e dëshmon studimi i

---

[9] Për valët e kolonizimit të Kosovës me serbë me masa të ndryshme të stimulimit e të privilegjeve dhe të shpërnguljes së shqiptarëve me një varg mjetesh presioni e dhune shih më hollësisht: H. Islami, *Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës,* Prishtinë, 1997, ff. 177-205.

[10] Shih: J. Cvijić, *Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije*, knjiga treća, Srpska kraljevska akademija, Beograd, 1911, ff. 1161-1272; *Govori i članci,* Knjiga 3, Beograd, 1987, f. 139 (botuar më 1913); *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje. Osnove antropogeografije*, Zagreb, 1922, ff. 393-394.
Ndër ithtarët e shkollës antropogjeografike të Cvijiqit, që e përkrahnin këtë tezë, ishin A. Urosheviq, M. Lutovac, M. Filipoviq, V. Radovanoviq, R. Nikoliq, J. Trifunoski, M. Barjaktareviq, K. Ristiq, pastaj shumë etnografë, historianë dhe diplomatë serbë.

gjendjes socialo-demografike dhe i pasqyrës etnike, në bazë të të dhënave që i ofron dokumentacioni osman, defterët kadastralë. Në gjysmën e dytë të shek. XV trevat malore të Shqipërisë së Veriut, për shkak të kushteve jo të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike, kishin 115 fshatra me 1.799 shtëpi (0,5 shtëpi për një kilometër katror), ndërsa krahinat e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Fushës së Kosovës kishin 1.202 vendbanime me 28.141 shtëpi (2-3 shtëpi për një kilometër katror). Ndërkaq, në fund të shek. XVI në trevat malore të Shqipërisë së Veriut popullsia shtrihej në 156 fshatra me 3.201 shtëpi, kurse hapësira e Rrafshit të Dukagjinit dhe e Fushës së Kosovës kishte 1.758 vendbanime me 38. 844 shtëpi;[11] vlerësohet se në këtë kohë një shtëpi kishte 8-10 anëtare.[12] Historiani i njohur anglez N. Malcolm, duke iu referuar rezultateve të studimeve të përmendura të M. Tërnavës dhe të S. Pulahës, konkludon se "Popullata e Kosovës gjatë kësaj periudhe ishte më e madhe sesa popullata e Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Veriut, ku nataliteti ishte më i ulët se në Kosovë".[13]

Si dëshmi bindëse për paqëndrueshmërinë e tezës së ardhjes së shqiptarëve në Kosovë nga Shqipëria Veriore, është numri i kryefamiljarëve të ardhur sipas përkatësisë etnike në vendbanimet ku ishin të ngulitur, ashtu siç i kanë shënuar zyrtarët osmanë në regjistrimet e tokave dhe të popullsisë. Sipas këtyre regjistrave, një numër i konsiderueshëm i kryefamiljarëve të regjistruar cilësohen si ardhacakë (prishliq, priselica, doshlak etj.). Në defterin e Vilajetit Vëllk (territori i sotëm i Kosovës) në vitin 1455 nga 679 kryefamiljarë, që cilësohen si ardhës, asnjëri nuk ka emër shqiptar.[14] Në vitin 1485, në nahinë e Pejës, nga 121 të ardhur, shumica dërmuese kishin emra sllavë; në Sanxhakun e Prizrenit, në vitin 1591, në mesin e 41 shqiptarëve të lindur aty, vetëm 5 janë të ardhur; në qytetet e Kosovës, në vitet 1580 dhe 1590, prej 158 kryefamiljarëve të ardhur, vetëm 25 janë me antroponimi shqipe, ndërsa 133 sish janë me emra sllavë, disa prej të cilëve kanë ardhur nga Bosnja.[15] Në anën

---

[11] S. Pulaha, "Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shekujve XV-XVI", *Studime historike,* nr. 3, Tiranë, 1985, ff. 175-184; ky punim është botuar edhe në publikimin *Studime për epokën e Skënderbeut, 1,* Tiranë, 1989, ff. 44-55. Shih edhe burimet e tjera që shënohen te Pulaha, sikurse: H. Inalcik, *Sureti defterleri sancaki arvanid,* Ankara, 1954; N. Todorov, "Za demografskoto sostojanije na balkanskija poluostrov prez XV-XVI vek", *Godišnjak na Sofiskija Universitet,* tom LII, 2, Sofija, 1960; *Başbakanlik arşivi,* defter nr. 231, 508; H. Hadžibegić, A. Handžić, E. Kovačević, *Po aty.*

[12] S. Pulaha, *Po aty.*

[13] N. Malcolm, *Kosova. Një histori e shkurtër,* Koha, Prishtinë, 1988, f. 116.

[14] M. Tërnava, "Migrimet e popullsisë në territorin e sotëm të Kosovës gjatë shekujve XV-XVI", *Kosova, 5,* Prishtinë, 1976, ff. 295, 304-309.

[15] M. Tërnava, *Po aty,* ff. 304-309; S. Pulaha, "Qytetet e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës gjatë gjysmës së dytë të shek. XVI në dritën e të dhënave të regjistrimeve kadastrale osmane, *Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike,* IX/1979, Prishtinë, 1980, ff. 11-43.

tjetër, deri tash nuk janë gjetur as dokumente të shkruara të kohës që do ta dëshmonin konstatimin e historiografisë serbe se të gjithë serbët kishin ikur në drejtim të veriut dhe Kosova në pikëpamje demografike kishte mbetur e shkretë.[16]

Me gjithë reduktimet e konsiderueshme territoriale, si pasojë e politikave ekspansioniste të perandorive dhe pushtuesve të ndryshëm, shqiptarët do të qëndrojnë pandërprerë në hapësirat etniko-gjeografike të paraardhësve të tyre, ilirëve, si popullatë indoevropiane dhe në të gjitha periudhat historike aty ku jetojnë sot do të përbënin shumicën dërmuese të popullsisë, natyrisht me fluktuime të vëllimit të tyre demografik në kohë dhe hapësira të ndryshme, për shkak të ndikimit të një varg faktorësh në zhvillimin demografik, si veçori e përgjithshme e të gjitha popullatave paraindustriale. Për ekzistencën dhe dominimin e shqiptarëve në të gjitha kohët historike dëshmojnë rezultatet shkencore të albanologëve dhe ballkanologëve të njohur, të huaj[17] dhe shqiptarë,[18] regjistrimet kadastrale osmane (defterët) të kohës me të dhëna të bollshme të karakterit etnik, demografik dhe social, që u deshifruan dhe u

---

[16] Shih më hollësisht: S. Pulaha, *Po aty;* A. Handžić, *Po aty;* H. Hadžibegić, *Po aty;* M. Tërnava, *Po aty,* etj.

[17] "Sidoqoftë, trualli antroponimik ilir na sjell një saktësim më të ri. Shqipja, pra, nuk ka më si parashikues gjeografik një truall ilir të gjerë dhe të papërcaktuar mirë, por një formacion të konkretizuar qartë, pasardhësja reale e të cilit është ajo vetë. Trualli shqiptar, në dritën e këtyre fakteve onomastike, nuk paraqitet më si një transformim krijues e jetësor i një entiteti që përbën një element të përhershëm në jetën historike dhe në kuadrin etnik të Ballkanit... Vazhdimësia iliro-shqiptare fiton në këtë mënyrë një përmasë të re. Nuk është më një abstraksion etnologjik i papërcaktuar dhe konfuz. Arrihet të kapet realiteti historik dhe të shikohet formacioni etnik i vërtetë që përbën substratin e kësaj vazhdimësie" (R. Katičić, "Antroponimia ilire dhe etnogjeneza e shqiptarëve", *Kuvendi I i studimeve ilire, II*, Tiranë, 1974, f. 98).
Shih gjithashtu: A. Stipčević, *Iliri*, Zagreb, 1974, f. 7 e tutje; M Šufflay, "Povijest sjevernih Arbanasa", *Arhiv za Arbanašku starinu, jezik i etnologiju,* knjiga II, Beograd, 1925, ff. 193-242.

[18] Shih studimet e albanologut më të madh të të gjitha kohëve E. Çabej: "Ilirishtja dhe shqipja", në librin *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve,* Tiranë, 1969, ff. 41-52; "Problemi i formimit të gjuhës shqipe", *Kuvendi I i studimeve ilire, II,* Tiranë, 1974, ff. 7-26; "Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emravet të vendevet", *Studime Gjuhësore, IV,* Prishtinë, 1977, ff. 143-153; "Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës e të emrave të vendeve", *Studime Gjuhësore, IV,* Prishtinë, 1974, ff. 155-162.
Shih gjithashtu studimet e dijetarëve të tjerë shqiptarë: S. Anamali, "Nga ilirët tek arbërit", *Kuvendi I i studimeve ilire, II,* Tiranë, 1974, ff. 27-47; M. Korkuti-S. Anamali, "Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve në dritën e kërkimeve arkeologjike shqiptare", në librin *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve,* Tiranë, 1969, ff. 11-40; I. Ajeti, *Sudime gjuhësore në fushë të shqipes, I,* Prishtinë, 1982; R. Ismajli, *Artikuj mbi gjuhën shqipe,* Prishtinë, 1987, etj.

studiuan nga autorët shqiptarë[19] dhe sllavë,[20] pastaj vetë dokumentet e shumta mesjetare të monumenteve ligjore serbe (krisobulat, dhuratat etj.),[21] raportet e ndryshme të misionarëve të propagandës Fide në Romë,[22] shënimet e udhëpërshkruesve të ndryshëm,[23] pjesëmarrja masive e shqiptarëve në luftërat e shumta para shek. XVII dhe XVIII, përkatësisht në luftërat e njohura austriako-turke të viteve 1689-1690 dhe 1737-1739,[24] duke përfshirë edhe Luftën e Kosovës (1389)[25] dhe faktet e tjera shkencore. Dhe, përkundër

---

[19] S. Pulaha, *Po aty*; M. Tërnava, *Po aty*.

[20] H. Hadžibegić, Po aty; A. Handžić, Po aty; E. Kovačević, *Po aty.*

[21] S. Novaković, *Zakonik Stevana Dušana (1349-1354),* Beograd, 1870, čl. 180; S. Novaković, *Zakonski spomenici,* SKA, Beograd, 1912, 578, 579, 580, 620, 692 667, 688, 695, 697, 739; J. Safarik, "Hrisovulja cara Dušana kojom osniva manastir Sv. Arhandjela Mihaila i Gavrila kod Prizrena 1348", *Glasnik srpskog učenog društva,* knj. XV, Beograd, 1892, f. 289; K. Jireček-J. Radonić, *Istorija Srba, II,* Beograd, 1952, f. 164 ; P. Ivić-M. Grković, *Dečanske hrisovulje,* Novi Sad, 1976, ff. 304-305, etj.

[22] I. Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII,* vëllimi I, Tiranë, 1963, ff. 341, 339, 435, 451; K. Draganović, "Izvješće apostolskog vizitatora Petra Masarechija o prilikama katoličkog naroda u Bugarskoj, Srbiji, Srijemu, Slavoniji i Bosni g. 1623 i 1624, *STARINE JAZU,* knj. XXXIX, Zagreb, 1938, f. 28;

[23] E. Čelebi, *Putopis. Odlomci o jugoslovenskim zemljama,* Sarajevo, 1979, ff. 276, 288; J. Radonić, *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od 17. do 19. veka,* Beograd, 1950, f. 275; S. Novaković, "Hadži Kalfa Ćatib-Čelebija, turski geograf 17. veka o Balkanskom poluostrvu", *Spomenik Srpske kraljevske akademije,* XVII, Beograd, 1892, f. 36.

[24] *Historija naroda Jugoslavije, II,* Zagreb, MCMLIX, ff. 816, 817, 818, 1118; *Istorija naroda Jugoslavije, II,* Beograd, 1960, ff. 767, 768, 769, 787, 1043; M. Kostić, "Prilozi istoriji srpsko-arbanaškog ustanka 1689-1690", *Arhiv za arbanašku starinu, jezik i etnologiju, knj. II*, Beograd, 1925, f. 14; M. Kostić, Arnautsko naselje u Sremu", Južna Srbija, III, 1923, ff. 273-279; J. von Hammer, *Historija turskog (osmanskog) carstva, 3,* Zagreb, 1979, ff. 47, 164-169; J. Radonić-M. Kostić, *Srpske privilegije od 1690. do 1792,* Beograd, 1954, ff. 19, 90; M. Kostić, "O postanku i značenju tzv. Invitatorija Leopolda I balkanskim narodima od 6 aprila 1690", *Istorijski časopis, II,* SAN, Beograd, 1951, f. 150; C. Contarini, *Istoria della guerra di Leopoldo Primo Imperadore e deëprincipi collegati contro il Turco dallëanno 1683 fino allapace, Parce seconda,* In Venezia 1710, pp. 170-171; M. Premrou, "Katolički nadbiskupi u Skoplju po Vatikanskim izvorima", *Glasnik Srpskog naučnog društva,* Knj. I, Sv. II, Skoplje, 1926, ff. 331-332; J. Radonić, *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od 17. do 19. veka,* Beograd, 1950, f. 402; *Enciklopedija Jugoslavije, I, (A. Bosk),* Zagreb, 1955, f. 155; *Vojna enciklopedija, 4,* Drugo izdanje, Beograd, 1972, f. 655; N. Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër,* Koha, Prishtinë, 1998, ff. 144-168.

[25] J. von Hammer, *Historija turskog (osmanskog) carstva, 1,* Zagreb, 1979, ff. 73-74; S. Pulaha, *Luftat shqiptaro-turke në shekullin XV - Burime osmane,* Tiranë, 1968; S. Pollo et A. Puto, *Histoire de l'Albanie des origines à nos jours,* Editions Horvath, Paris, 1974, pp. 64-67; S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII,* Prishtinë, 1972, f. 18; S. Brestovci, *Marrëdhëniet shqiptare-serbo-malazeze (1830-1878),* Prishtinë, 1983, f. 13; *Historia e popullit shqiptar, I* (sipas ribotimit të ETMM të KSA të Kosovës), Botim i tretë, Prishtinë, 1976, f. 222; G. Ll. Arsh - G. Senkeviç - N. D. Smirnova, *Histori e shkurtë e Shqipnisë,* Prishtinë, 1967, f. 15; N. Malcolm, *Po aty,* ff. 59-83.

presioneve shumëshekullore të invadimeve e të pushtimeve të perandorive e të mbretërive të mëdha, shqiptarët arritën ta ruanin identitetin dhe integritetin e tyre edhe si popull, edhe në pikëpamje gjeotnike.

Serbët, të ardhur në territorin e Kosovës në kohën e pushtimit serb (si kolonistë, por kryesisht si feudalë, ushtarakë, funksionarë, klerikë, tregtarë etj.), ndonëse në pikëpamje politiko-shoqërore ishin shtresë sunduese, përbënin një pakicë.[26] Të dhënat e regjistrimeve të tokave dhe të popullsisë, që i bëri pushteti osman, kryesisht për qëllime fiskale, e që u studiuan nga dijetarë të ndryshëm, shembën përfundimisht konstruksionin dhe mitin e historiografisë dhe të antropogjeografisë serbe mbi epërsinë demografike të popullatës serbe në Kosovë që nga instalimi i tyre në kohën e zgjerimit të shtetit mesjetar serb.

Këto teza serbe u përsëritën aq shumë në vitet e 80-ta e të 90-ta të shekullit të kaluar nga institucionet shkencore e politike serbe, veçanërisht nga liderët ekstremë partiakë, por duke e shpifur edhe një tezë tjetër: se shqiptarët "e vërshuan" Kosovën pas vitit 1941, si "kolonistë, uzurpatorë e musolinistë" në "territoret e shpirtit mesjetar serb", "të djepit të shtetësisë serbe" etj. Të gjitha këto teza ishin dhe mbetën në funksion të politikës hegjemoniste e raciste serbe. Le të na kujtohen vetëm kërkesat publike të qarqeve ekstreme e fashizoide të liderëve të pozitës dhe opozitës serbe (Z. Liliqi, V. Shesheli, Zh. R.- Arkani, M. Paroshki, V. Drashkoviqi etj.) që shqiptarët, si "element i huaj" dhe "i ardhur", por edhe si qytetarë të padëgjueshëm dhe jolojalë ndaj shtetit serb, duhet të dëbohen përtej Bjeshkëve të Nemuna me mjete gjenocidale![27]

2. Spekulimet serbe të fundit të shekullit XX rreth realitetit etnik të Kosovës dhe zhvillimin demografik të shqiptarëve

Para se t'i japim të dhënat zyrtare statistike për gjendjen numerike të të gjitha bashkësive kombëtare në Kosovë dhe analizën e tyre pas Luftës Dytë Botërore duhet të theksojmë se në bazë të të dhënave të statistikave zyrtare të të gjitha pushteteve serbo-jugosllave në shekullin XX, popullsia shqiptare ka dominuar në përbërjen etnike të Kosovës, ndonëse autorët serbë sa herë e kërkonte momenti politik nuk ngurronin të spekulonin me të dhëna. Kështu, pos të tjerëve, një demografe serbe, përgjegjëse e Qendrës për Hulumtime Demografike, thoshte se "sipas vlerësimeve në vitet e 20-ta të shek. XX

[26] S. Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI,* Tiranë, 1984, f. 5.

[27] Ata flitnin për ardhjen e kinse 1.500.000 shqiptarëve nga Shqipëria këto 50 vjetët e fundit, të cilët duhej dëbuar (V. Salvoldi - L. Gjergji, *Rezistenza nonviolenta nella ex-Yugoslavia,* Bologna, 1993, f. 52; sipas N. Malkolm, *Po aty,* ff. 366-367).

popullata shqiptare përbënte rreth 50% të popullsisë së Kosovës".[28] Në regjistrimin e parë të vitit 1921, Jugosllavia e atëhershme e ka regjistruar popullsinë vetëm sipas përkatësisë gjuhësore dhe fetare, ndërsa përkatësia kombëtare, për shkaqe të politikës unitariste serbomadhe, është injoruar. Mirëpo, me gjithë manipulimet që janë bërë në dëm të shqiptarëve dhe popullsive josllave, shqiptarët, në bazë të gjuhës amtare shqipe (arnautski, siç e quanin), dominuan në pasqyrën etnike të Kosovës sepse përbënin 65,8%, ndërsa grupacioni i gjuhës serbokroate përbënte 25,9% dhe i asaj turke 6,3% (tabela 1).

Tabela 1. Popullsia e Kosovës sipas gjuhës amtare, sipas regjistrimit të vitit 1921[29]

	Gjuha						
	Gjithsej	Shqipe	Serbo-kroate	Turke	Rumuno-cincare	Gjermane	Hungareze
Numri	439.010	288.907	114.095	27.915	402	30	12
%	100,0	65,8	25,9	6,3	0,0	0,0	0,0

Vërejtje: Deri "gjithsej" e përbëjnë folësit e gjuhëve të tjera dhe të panjohurit.

Përkundër të gjitha masave të ndërmarra dhe angazhimeve antishqiptare, të papara në përfundim të mijëvjeçarit të kaluar, qarqet shkencore dhe pushtetore serbe konkluaduan se *në pikëpamje etnodemografike Kosova definitivisht u shqiptarizua, ndërsa grupacioni serb u tëhollua aq shumë sa që më nuk ekziston.* Ky përfundim i të gjitha qarqeve serbe vlente deri në mars të vitit 1998 (masakra e Drenicës).[30] Interesimi i të gjitha instancave serbe për çështjet demografike të Kosovës pasoi përsëri, pas "rebelimit" dhe "veprimit terrorist" të shqiptarëve dhe ndërkombëtarizimit kulminant të problemit të Kosovës, kur domosdoshmërisht duhej të gjendej zgjidhja e pranueshme dhe e qëndrueshme politike. Mirëpo, angazhimi dhe përfundimi serb, përsëri për

[28] D. Avramov, "Opadanje stanovništva: od populacionog fenomena do populacionog problema", *Stanovništvo*, 3-4/1990 - 1-2/1991, CDI, IDN, Beograd, 1991, f. 240.

[29] Burimi: *Prethodni rezultati. Popisa stanovništva u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca 31. januara 1921,* Državna štamparija, Sarajevo, 1924, f. 3-34; *Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47,* Savezni zavod za statistiku, Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1995, f. 205.

[30] Autorja e përmendur serbe D. Avramov në funksion të interesave të politikës së ditës, para së gjithash të politizimit të shtimit natyror të shqiptarëve dhe migrimeve të serbëve nxorri konstatimin "se në vitin 1987 përqindja e popullsisë shqiptare në Kosovë u rrit në rreth 90% të popullsisë së përgjithshme" (D. Avramov, *Po aty*, f. 240).

qëllime manipulative politike, tash nisi të shkojë në një drejtim tjetër: në strukturën etnike të Kosovës nuk dominojnë shqiptarët, por bashkësitë e tjera kombëtare, disa prej të cilave as që kanë ekzistuar ndonjëherë. Kur faktori demografik dhe fakti statistik bëhen çelës edhe të zgjidhjes së problemeve dhe të raporteve politike, atëherë ishte krejtësisht i kuptueshëm angazhimi i Serbisë kundër realitetit etnodemografik të Kosovës dhe insistimi energjik për një regjistrim sipas kuteve të saj për të manipuluar me të dhëna statistikore.

Serbia tash bëhej sikur kishte të drejta njerëzore e të tjera "me bollëk", prandaj ishte e gatshme t'u japë të gjithë njerëzve dhe popujve në planetin tonë, veçanërisht "pakicave kombëtare", sidomos shqiptarëve në Kosovë dhe në "Metohi". Në përputhje me "standardet evropiane", shteti serb dhe partitë "opozitare" të saj kishin vendosur t'u ofronin të gjitha të drejtat shqiptarëve, mirëpo kërkonin të respektohej realiteti i ri demografiko-etnik i Kosovës, i cili nuk është më ai që e konfirmonin dhe e vajtonin deri dje. Fillon fushata fantastike e zvogëlimit të numrit të shqiptarëve dhe e rritjes së numrit të të tjerëve, veçanërisht e serbëve, e cila bëhet më transparente në prag dhe gjatë Konferencës së Rambujesë (fillim i vitit 1999) nga ana e përfaqësuesve të Serbisë dhe veçanërisht të kryetarit të atëhershëm të saj M. Millutinoviq, i cili, pa fije turpi, theksonte se në Kosovë shqiptarët nuk janë shumicë, por janë nën 50% e madje nën 40%, duke i abstrahuar vlerësimet e vetë institucioneve përkatëse të Beogradit se shqiptarët më 1991 përbënin 82,2% në popullsinë e përgjithshme të Kosovës.

Serbia pushtetore dhe "opozitare" tash nuk i pranon as rezultatet e regjistrimeve zyrtare, të cilat i kanë organizuar dhe realizuar vetë autoritetet statistikore e shtetërore të Beogradit, duke filluar nga regjistrimi i parë i popullsisë në vitin 1921, në Mbretërinë Serbo-Kroato-Sllovene (Jugosllavia e Versajës) e deri te regjistrimet në Jugosllavinë Komuniste (1948, 1953, 1961, 1971, 1981 dhe 1991, të cilin shqiptarët, për shkaqe shumë të arsyeshme, e bojkotuan).[31] Serbia tash po i mohon edhe vlerësimet që i ka dhënë vetë për numrin e shqiptarëve të Kosovës dhe në tri komunat në përbërje administrativo-politike të Serbisë (Presheva, Bujanovci dhe Medvegja) për vitin 1991, si dhe rezultatet e statistikës vijuese demografike, të cilën vetë e drejton dhe të dhënat e ngjarjeve vitale e të tjera statistikore që çdo vit vetë i publikon. Ajo i mohon edhe rezultatet e projeksioneve demografike, sipas të cilave shqiptarët do të kenë epërsi të madhe në përbërjen etnogjeografike të Kosovës në të ardhmen, ndërsa këto projeksione nuk i kanë përpiluar autorët

[31] Për arsyet e mospjesëmarrjes së shqiptarëve në regjistrimin e popullsisë të vitit 1991 shih më hollësisht: H. Islami, *Rrjedha demografike shqiptare,* Dukagjini, Pejë, 1994, ff. 115-125.

shqiptarë dhe institucionet shkencore të Prishtinës, por autorët serbë dhe institucionet shkencore të Beogradit.

Për qëllime politike, tashmë të zëna në gojë, pushteti qendror i Serbisë nisi një fushatë fantastike: ta rrisë numrin e popullsisë serbe dhe të nacionaliteteve të tjera joshqiptare deri në absurd, ku disa grupe etnike gjithnjë numerikisht kanë qenë margjinale. Por absurdi më i madh është shpifja e disa grupeve etnike, të cilat kurrë, as në pikëpamje etnike, as linguistike e as statistike nuk kanë ekzistuar, çfarë është rasti p. sh. me "goranët" dhe "egjiptianët". Sipas klasifikimit unik të përkatësisë kombëtare, të zbatuar në të gjitha regjistrimet zyrtare të viteve 1948-1991, nga 20-25 bashkësi nacionale ku gjenden edhe vllehtë, bunjevcasit, rusinët dhe shokcasit, për të cilët pakkush ka dëgjuar, por askund nuk figurojnë "goranët" dhe "egjiptianët"; nuk i gjejmë as sipas përkatësisë gjuhësore. Në të gjitha regjistrimet "goranët" janë regjistruar si vijon: "myslimanë-të papërcaktuar" ose si "myslimanë-jugosllavë" ("serbë-myslimanë", "kroatë-myslimanë", "maqedonë-myslimanë") (1948), "jugosllavë-të papërcaktuar" (1953), "myslimanë në kuptim të përkatësisë etnike" (1961) dhe prej 1971-1991 si "myslimanë në kuptim kombëtar". Ndërkaq, "egjiptianët" në të gjitha këto regjistrime janë regjistruar si ciganë ose romë. Fluktuimi i numrit të myslimanëve, romëve dhe "jugosllavëve", si pasojë e deklarimeve të ndryshme, sidomos deri në vitin 1971, ishte karakteristikë e njohur në gjithë ish-Jugosllavinë. Sa është dhe si ka lëvizur numri i popullsisë së bashkësive kombëtare sipas regjistrimeve zyrtare të viteve 1948-1991, më së miri shihet nga pasqyra që pason (tabela 2). Për shqiptarët e Kosovës për vitin 1991 nga institucionet statistikore dhe shkencore të Beogradit janë bërë dy vlerësime: i pari, si preliminar, sipas të cilit numri i shqiptarëve ishte 1.607.690 ose 82,2%,[32] dhe i dyti, si përfundimtar, sipas të cilit numri i shqiptarëve ishte 1.596.072, pra më i vogël për 11.618 banorë ose për 0,6%.

[32] *Prvi rezultati Popisa stanovništva, domaćinstava, stanova i poljoprivrednih gazdinstava 1991. godine. Nacionalni sastav stanovništva po opštinama,* Statistički bilten, br. 1934, SZS, Beograd, 1992, f. 28.

Tabela 2. Përbërja kombëtare e popullsisë së Kosovës sipas regjistrimeve të popullsisë 1948-1991[33]

	1948	1953	1961	1971	1981	1991
Shqiptarë	498.242 68,5	524.559 64,9	646.605 67,2	917.167 73,7	1.226.736 77,4	1.596.072 81,6
Serbë	171.914 23,6	189.869 23,5	227.016 23,6	228.261 18,4	209.497 13,2	194.190 9,9
Malazezë	28.050 3,9	31.343 3,9	37.588 3,9	31.555 2,5	27.028 1,7	20.365 1,0
Boshnjakë	6.679 1,3	6.241 0,8	8.026 0,8	26.351 2,1	58.562 3,6	66.189 3,4
Turq	1.315 0,2	34.583 4,3	25.764 2,7	12.244 1,0	12.513 0,7	10.445 0,5
Romë	11.230 1,5	11.904 1,5	3.202 0,3	14.593 1,2	34.126 2,1	45.745 2,3
Kroatë	5.290 0,7	6.201 0,8	7.251 0,8	8.263 0,7	8.718 0,6	8.062 0,4
Jugosllavë	…. ….	…. ….	5.206 0,5	920 0,0	2.676 0,1	3.457 0,2
Të tjerë	11.100 1,5	10.999 1,3	3.330 0,3	4.338 0,3	4.585 0,3	11.671 0,6
Gjithsej	733.820 100,0	815.798 100,0	963.988 100,0	1.243.693 100,0	1.584.440 100,0	1.956.196 100,0

Vërejtje: Për shqiptarët për vitin 1991 Enti Federativ i Statistikës dhe Qendra për Hulumtime Demografike e Institutit të Shkencave Shoqërore të Beogradit kanë bërë vlerësimin e numrit të tyre.

Numri i shqiptarëve dhe i të tjerëve në Kosovë gjatë viteve të 90-ta të shekullit të kaluar përsëri problematizohet nga qarqet serbe. Prandaj jemi të detyruar t'u referohemi të dhënave të institucioneve zyrtare statistikore serbe si të vetmeve për atë periudhë e që kanë të bëjnë me ngjarjet themelore vitalo-demografike (lindjet, vdekjet dhe shtimin natyror) sipas përkatësisë kombëtare. I marrim dy vite karakteristike: vitin 1990, kur ende ekzistonte Jugosllavia dhe shërbimet civile funksiononin relativisht mirë, dhe vitin 1995, kur ish-shteti ishte shpërbërë dhe kur pas suprimimit të të gjitha mekanizmave qeverisëse në Kosovë, krijimit të atmosferës së mosbesimit në institucionet

[33] Burimi: *Popis stanovništva, domaćinstava i stanova u 1981. godini. Nacionalni sastav stanovništva po opštinama, Statistički bilten 1295,* Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 16; *Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47,* Savezni zavod za statistiku, Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1995, f. 213.

shtetërore dhe civile (ofiqaria), që i udhëhiqnin serbët, *vërehet përfshirja jo e plotë e ngjarjeve vitale (lindjeve dhe vdekjeve), dukuri kjo që në statistikën demografike njihet si nënregjistrim i këtyre ngjarjeve.* Nënregjistrimin e kanë pranuar edhe vetë institucionet statistikore dhe shkencore serbe.[34] Dukuria e nënregjistrimit lidhet pikërisht me shkëputjen e shqiptarëve nga institucionet e shoqërisë së deriatëhershme serbo-jugosllave dhe plebishitet për vetëvendosje dhe pavarësi (Referendumi për Kosovën sovrane e të pavarur në vitin 1991 dhe Zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në vitin 1992). Mirëpo, këto institucione ende dominoheshin nga serbët, gjë që bëri që shqiptarët, për nevoja të domosdoshme, të lidheshin akoma me institucionet që i udhëhiqnin serbët, çfarë ishte rasti p. sh. me shërbimet civile (ofiçaria etj.).

Përkundër gjithë kësaj, si dhe ndikimit të një varg variablash që i përkasin rrafshit politiko-psikologjik dhe sociopsikologjik, siç janë frika nga lufta, krijimi i ndjenjës së pasigurisë sociale, paperspektivës jetësore dhe komponentëve të tjera të krizës psikologjike e materiale, të cilat intensifikuan eksodin e një numri të madh të të rinjve, shtynë lidhjen e shumë bashkësive martesore, që influencuan drejtpërdrejt në rrudhjen e vëllimit të riprodhimit biologjik, kur shumë çifte bashkëshortore vendosën t'i shtyjnë për më vonë edhe lindjet e dëshiruara të fëmijëve -, në bazë të të dhënave që i ofrojnë vetë burimet serbe, shqiptarët ruajnë epërsi të madhe në strukturën nacionale të Kosovës. Por njëkohësisht dalin në shesh edhe spekulimet e autoriteteve qendrore serbe për numrin e rrejshëm të popullsisë së komuniteteve joshqiptare, para së gjithash të myslimanëve, romëve, serbëve e malazezëve, e të mos flasim për shpifjen e grupacioneve të tjera, siç janë "goranët" dhe "egjiptianët" (tabela 2). Mirëpo, siç theksonte "babai" i kombit serb, inspiruesi kryesor shpirtëror i shkatërrimit të ish-Jugosllavisë dhe i luftërave të përgjakshme dhe kryetari i dështuar i "Jugosllavisë së Tretë", D. Qosiq, për serbët "Gënjeshtra është formë e patriotizmit tonë dhe dështmi e inteligjencisë sonë natyrore. Ne gënjejmë në mënyrë krijuese, fantastike, inventive".[35]

Gjithashtu është interesant të analizohet lëvizja e shtimit natyror të popullsisë së Kosovës prej vitit 1990 deri në vitin 1998, ku mund të vërehej

---

[34] Grup autorësh, "Naselja u Srbiji sa negativnim ili nultim prirodnim priraštajem u 1991 godini", *Stanovništvo,* br. 1-4/1992 dhe 1-2/1993, CDI, IDN, Beograd, 1993, f. 227; G. Penev," Područja Srbije bez prirodnog priraštaja. Analiza po naseljima za 1991 godinu", *Demografske sveske,* br. 24, CDI, IDN, Beograd, 1995, f. 30; po ky artikull i këtij autori, me të njëjtin titull, është botuar edhe në publikimin: *Osnovi populacione politike: ciljevi, institucije, mere, Demografski zbornik,* Knj. IV, SANU, Beograd, 1997, ff. 27-40.

[35] Nga romani i D. Qosiqit "Deobe"; sipas: *Velika Epohina enciklopedija aforizama,* Zagreb, 1968, f. 264.

një prerje e madhe midis viteve 1990-1992 (zvogëlimi për 10.547 veta), që në rrjedha normale demografike dhe shoqërore nuk mund të ndodhë, por që shpjegohet me ndikimin e determinanteve të përmendura më lart. Në bazë të vëllimit të këtij shtimi, duke marrë parasysh pjesëmarrjen e shqiptarëve në të (89,5% më 1990 dhe 88,2% më 1995), shtimi natyror i shqiptarëve për periudhën pas regjistrimit të popullsisë të vitit 1991 deri më 1998 ishte rreth 265.000 veta ose me pjesëmarrje prej rreth 89% në shumën e shtimit të përgjithshëm natyror (tabela 3). Kur këtij numri i shtohet mospërfshirja e të gjitha ngjarjeve vitale (nënregjistrimi, siç njihet në statistikë), e që mund të vlerësohet në rreth 50.000 persona (rreth 18%), atëherë del se shtimi natyror i shqiptarëve në periudhën 1991-1998 është rreth 315.000 veta, shumë kjo e cila kur të mblidhet me numrin e vlerësuar të shqiptarëve nga vetë institucionet serbo-jugosllave në vitin 1991 (1.596.072) jep numrin e përgjithshëm të tyre, i cili në fund të vitit 1998 është rreth 1.911.000 veta ose rreth 87% në numrin e gjithmbarshëm të Kosovës, i cili vlerësohej në rreth 2.250.000 banorë. Numri i popullsisë së bashkësive të tjera kombëtare është rreth 289.000 veta ose rreth 13%. Numri i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës, numri i shqiptarëve dhe numri i të tjerëve, siç theksuam, është nxjerrë vetëm duke u mbështetur në të dhënat që i ofronin institucionet statistikore dhe shkencore serbe në Beograd.

Tabela 3. Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës sipas përkatësisë kombëtare në vitet 1990 dhe 1995[36]

	1990			1995		
	Lindjet	Vdekjet	Shtimi natyror	Lindjet	Vdekjet	Shtimi natyror
Gjithsej	55.175	8.214	46.961	44.776	8.671	36.105
%	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
Shqiptarë	47.865	5.840	42.025	37.589	5.749	31.840
%	86,7	71.0	89,5	83,9	66,3	88,2
Serbë	3.458	1.437	2.021	4.165	2.030	2.135
%	6,3	17,5	4,3	9,3	23,4	5,9
Myslimanë	1.552	342	1.210	1.167	290	877
%	2,8	4,1	2,6	2,4	3,3	2,4
Malazezë	241	108	133	225	127	98
%	0,4	1,3	0,3	0,5	1,5	0,3
Romë	1.111	175	936	1.087	222	865
%	2,0	2,1	2,0	2,4	2,6	2,4

[36] Burimi: *Demografska statistika 1990,* SZS, Beograd, 1992, f. 146; *Demografska statistika 1995,* SZS, Beograd, 1998, ff. 177, 203.

Kroatë %	282 0,5	49 0,6	237 0,5	71 0,2	24 0,3	47 0,1
Turq %	270 0,4	45 0,5	225 0,5	242 0,5	69 0,8	173 0,5
Jugosllavë %	11 0,0	2 0,0	9 0,0	14 0,0	23 0,3	-9 0,0
Të tjerë %	385 0,7	216 2,6	172 0,4	216 0,5	137 1,6	79 0,2

Në fund të gjithë kësaj analize duhet të theksohet se numri absolut i çfarëdo pjese të popullsisë mund të ndryshojë, do të thotë që edhe numri i shqiptarëve në Kosovë të jetë më i vogël (ose më i madh) se rreth 1.900.000 në fund të shekullit të kaluar, por raportet relative janë shumë të qarta: sipas të dhënave zyrtare serbe, përqindja e shqiptarëve, në bazë të pjesëmarrjes në shumën e përgjithshme të shtimit natyror, sillej rreth 89%, e kjo në statistikën demografike, por edhe në analizat e tjera sociologjike e demografike merret si 90%, sikundër që edhe numri prej më se 1.900.000 shqiptarësh mund të rrumbullaksohej në rreth 2 milionë.

Pushteti serb dhe instancat ndërkombëtare, si p. sh. OSBE-ja, amerikanët përmes projektit të zyrtarit të lartë amerikan K. Hill, të cilin e mbështeste edhe Bashkësia Evropiane për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, në vitin 1998 insistonin që të bëhej një regjistrim i popullsisë në Kosovë,[37] sipas *koncepcionit të popullsisë së pranishme*[38] (population présente), rezultatet e të cilit do të shkonin plotësisht në favor të kërkesave të regjimit serb. Sepse, sipas këtij koncepcioni do të regjistroheshin vetëm ata persona të cilët në momentin

[37] As autoritetet serbe e as instancat ndërkombëtare nuk ishin të interesuara për një regjistrim të plotë të popullsisë, ku do të përfshiheshin të gjitha të dhënat mbi dinamikën dhe karakteristikat strukturale të popullsisë, por për një regjistrim tepër të kufizuar. Në projekt-propozimin e tretë të ambasadorit amerikan K. Hill për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, p. sh. parashihej të mblidheshin "vetëm të dhënat për emër, vendlindje, adresë, gjini, moshë, shtetësi, përkatësi kombëtare dhe përkatësi fetare" (Shih dokumentin e botuar në "Koha ditore", dt. 12. 12. 1998, f. 7, kaptina IX, pika 5 - a), që do të thotë se praktikisht atyre u interesonte vetëm numri i shqiptarëve në një anë, dhe numri i nacionaliteteve të tjera, kryesisht i serbëve, në anën tjetër.
Edhe në Marrëveshjen e Rambujesë (Francë) parashihej që të bëhej regjistrimi i popullsisë me të njëjtën përmbajtje dhe i realizuar "nën mbikëqyrjen e OSBE-së dhe me pjesëmarrjen e zyrtarëve të Kosovës e të ekspertëve të emëruar nga bashkësitë nacionale në Kosovë dhe që u përkasin atyre, të zyrtarëve federativë që do të udhëheqin regjistrimin e popullsisë në mënyrë objektive dhe të lirë…" ("Koha ditore", 1. 3. 1999, f. 8, kap. V, neni IV, pika 3-a).

[38] Ky koncepcion është zbatuar vetëm në dy regjistrimet e popullsisë të viteve 1921 dhe 1931 (Jugosllavia e Versajës).

kritik të regjistrimit (data dhe ora e caktuar) gjendeshin në vendin apo vendbanimin e caktuar, ndonëse aty mund të ndodheshin vetëm përkohësisht apo rastësisht. Dobësia serioze e këtij koncepcioni është se në regjistrim nuk përfshihen të gjithë ata persona të cilët për arsye të ndryshme përkohësisht mungojnë. Rezultatet e këtij koncepcioni mund t'i dëmtonin shumë shqiptarët, meqenëse një numër i madh i tyre i kishte braktisur vendet e tyre të përhershme të banimit si pasojë e dhunës dhe terrorit policor e ushtarak. Këtë fakt e dinte shumë mirë regjimi serb.

Që nga formimi i OKB-së (1945) dhe i Komisionit Popullativ të saj (1946), të gjitha regjistrimet (1948-1991) në ish-Jugosllavi dhe në pjesën dërmuese të vendeve në botë janë bërë në bazë të *koncepcionit të popullsisë së përhershme* ose *të popullsisë rezidenciale (population résidente),* që nënkupton regjistrimin e çdo personi si banor të përhershëm të atij vendi të banimit në të cilin ai përherë jeton, pa marrë parasysh se në momentin kritik të regjistrimit mund të mos gjendet në vendin e përhershëm të banimit për shkak të punësimit, shkollimit, shërbimit ushtarak, udhëtimit, shërimit, vuajtjes së dënimit, persekutimeve politike etj. Sipas këtij koncepcioni, të gjithë punëtorët e ish-Jugosllavisë që gjendeshin në punë në botën e jashtme dhe kategoritë e tjera të popullsisë që kishin status të ndryshëm qëndrimi në vendet e huaja, në regjistrimet 1971, 1981 dhe 1991 janë regjistruar si popullsi e përhershme në vendet me qëndrim të përhershëm të banimit.

Në regjistrimin e vitit 1991, një ndër arsyet pse shqiptarët nuk morën pjesë ishte kërkesa e tyre për suprimimin e gjendjes së jashtëzakonshme, kthimin e gjendjes kushtetuese, krijimin e klimës së volitshme politike e psikologjike dhe kthimin e të gjithë punëtorëve shqiptarë (128) në Entin Statistikor, nga i cili ishin përjashtuar në vitin 1990. Pa këto dhe kushtet e tjera elementare për regjistrim, nuk mund të realizohej regjistrimi objektiv dhe cilësor.[39] Për një regjistrim të tillë, me interes të posaçëm për shkencën, praktikën jetësore, planifikimin e zhvillimit shoqëror, opinionin e gjerë dhe individin, shqiptarët ishin të interesuar para të gjithë atyre që e kërkonin. Edhe regjistrimin e vitit 1991 e shihnin në këtë drejtim, por edhe si detyrë qytetare e civilizuese. Këtë regjistrim e penguan pikërisht ata të cilët e kërkonin regjistrimin tjetër (qarqet serbe), me një dallim se kjo kërkesë serbe kishte gjetur mbështetjen edhe te disa faktorë autoritativë ndërkombëtarë, kinse si kusht për mbajtjen e zgjedhjeve eventuale në Kosovë! Rezultatet e regjistrimeve të popullsisë nuk mund të përdoreshin për përpilimin e regjistrave të votuesve, sepse të gjitha të dhënat nga regjistrimet e popullsisë

[39] Shih më gjerë: H. Islami, *Rrjedha demografike shqiptare,* Dukagjini, Pejë, 1994, f. 115-125.

janë sekret zyrtar dhe përdoren vetëm për qëllime statistike. Në rrethanat ekzistuese, këto kërkesa për shqiptarët ishin të papranueshme.

Autoritetet serbe dhe institucionet statistikore të tyre, të bindura se do të kenë sukses në propagandën e tyre edhe me të dhëna statistike, përpiqeshin ta gënjenin edhe opinionin serb edhe atë botëror përmes publikimit "Statistički kalendar Jugolavije", që e botonte çdo vit Enti i Statistikës, njëkohësisht në gjuhën serbe dhe angleze (Statistical Pocket Book). Aty mund të gjendeshin shënime edhe për popullsinë e Maldivit (Azia), të Ujdhesave Komore (Afrika) ose të Surinamit (Amerika J.), për të cilat pak njerëz në botë dinë, por në këtë publikim nuk ekzistonin të dhëna për popullsinë e shteteve të reja dhe ndërkombëtarisht të pranuara, si p.sh. Kroacia. Sllovenia, BeH dhe Maqedonia,[40] që tregonte se urrejtja serbe ndaj "të padëgjueshmëve" dhe "secesionistëve" vërehej edhe në statistikë.

[40] Këto shtete të reja në vitin 1996 kishin një popullsi prej më se 12 milionë banorësh *(The State of World Population 1996,* UNFPA, New York, 1996, p. 126).

IV. STRUKTURA EKONOMIKE E POPULLSISË

1. Disa veçori të përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Kosovës

Fillimi i shekullit XX e gjen Kosovën me mbeturina të bollshme të shoqërisë feudale në shumë segmente të jetës familjare dhe prodhuese. Pas tërheqjes së Turqisë në vitin 1912 gjendja e përgjithshme në Kosovë dhe rreth saj jo vetëm që nuk ndryshoi, por sikur u keqësua edhe më shumë nga okupimi serb; marrëdhëniet feudalo-çifligare nuk u suprimuan. Pushteti i instaluar serb ua mori tokën agallarëve dhe bejlerëve, por nuk ua dha fshatarëve të varfër shqiptarë; ky pushtet, në kuadër të politikës kolonizuese që e zbatoi anembanë Kosovës, tokën ua ndau kolonëve serbë. Fshatarësia shqiptare që dominonte në strukturën e shoqërisë së atëhershme, ku afër 90% e popullsisë ishte bujqësore, numri absolut i së cilës rritej vazhdimisht, merrej me blegtori dhe me kultura të ndryshme agrare, kultivimi i të cilave varej kryesisht nga kushtet klimatike e pedologjike dhe konfiguracioni i terrenit. Toka punohej në mënyrë shumë primitive, me parmendë dhe shumë pak me plug, kurse si fuqi tërheqëse ishin kafshët. Sipas disa burimeve, në vitin 1939 rreth 60% të bujqve përdornin parmendën, ndërkaq gjithsej kishte 4 traktorë, 5 makina mbjellëse, 6 makina korrëse, 145 makina shirëse, 242 trierë dhe 11 makina të tjera bujqësore.[1]

Pas Luftës II Botërore Kosova hyri me një gjendje ekonomike dhe sociale-kulturore që e kishte përafërsisht në dhjetëvjetëshat e parë të shekullit XX, kur nuk ishte ngritur asnjë objekt industrial. Dhe deri vonë pas kësaj lufte ajo ruajti strukturën relativisht homogjene shoqërore-ekonomike, veçanërisht në territorin rural, duke mbetur pjesa më e pazhvilluar në ish-Jugosllavi. Socializmi këtu nisi të ndërtohej pa asnjë bazë materiale të shoqërisë. Në Planin e parë pesëvjeçar të zhvillimit 1947-1951 në Kosovë u vuan kornizat shumë të ngushta të aktiviteteve ekonomike (industria e tjegullave, e tullave dhe e gëlqeres, industria e drurit dhe furrat e bukës, zeja e qilimave dhe e llamarinës), ndërsa "Trepça" dhe minierat e tjera ishin nën planin e Serbisë dhe të Jugosllavisë.[2] Deri në fund të viteve të 50-ta Kosova e shekullit të kaluar edhe në pikëpamje ekonomike trajtohej si problem brendaserbian, ndërsa pasojat ishin ngecja e vazhdueshme në raport me territoret e tjera të ish-Jugosllavisë. Vetëm pas vitit 1956 Kosova trajtohet si rajon jo mjaft i zhvilluar

---

[1] *Proizvodne snage NR Srbije,* Beograd, 1953, f. 158.

[2] N. Bashota, "Ekonomia e KSA të Kosovës dhe transformimi i saj në shoqërinë socialiste", *Përparimi*, nr. 6, Prishtinë, 1984, ff. 821-822.

i Jugosllavisë, ndërkaq Bosnja e Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi që nga fillimi merrnin mjete të garantuara të shtetit, pa obligim kthimi.[3]

Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror, përkatësisht industrializimi inicial e përfshiu Kosovën vetëm në fillim të viteve të 60-ta dhe lidhej me Planin pesëvjeçar 1957-1961. Por ky zhvillim nuk kishte ndikim të madh në transformimin e përgjithshëm shoqëror dhe veçanërisht jo në rrjedhat demografike për arsye se vëllimi i investimeve ishte jo vetëm i vogël, por edhe shumë i njëanshëm: investohej më tepër në industrinë ekstraktive e të lëndëve të para (metalurgjia e ngjyrosur në bazë të plumbit e zinkut) dhe në energjetikë (thëngjilli), degë dominante në strukturën e ekonomisë së Kosovës. Këto degë kërkonin kapital të lartë organik, por kishin aftësi të vogël akumuluese e riprodhuese, pa efekte të mëdha në rritjen e normës së punësimit, veçanërisht të femrave, ndërsa kishin ndikim të madh në ndotjen e mjedisit jetësor. Orientimi i politikës së investimeve në zhvillimin e industrisë ekstraktive dhe të energjetikës në Kosovë dominoi gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit XX dhe si destinim kryesor ishte përmbushja e nevojave të zhvillimit industrial të Serbisë e të ish-Jugosllavisë;[4] këto pasuri të Kosovës konsideroheshin me interes ekonomiko-strategjik për Serbo-Jugosllavinë.[5] Deri vonë pas Luftës II Botërore në Kosovë nuk është investuar në kapacitetet përpunuese dhe në degët intensive-punuese, që janë joshëse për rritjen e normës së punësimit të të dy gjinive. Ndonëse të gjitha synimet e zhvillimit ekonomik ishin të orientuara në zhvillimin e bujqësisë, megjithatë edhe kjo degë me gjithë kushtet e volitshme nuk u transformua; mbeti ekstensive, natyrale dhe autarkike.

---

[3] M. Limani, *Investicije i privredni razvoj Socijalističke Autonomne Pokrajine Kosovo,* Priština, 1980, ff. 227-235.

[4] Lidhur me prodhimin e plumbit e të zinkut dhe shkallën e finalizimit të tyre në Kosovë, si dhe me çështjen e rrymës elektrike veçojmë një vlerësim të ekspertëve të fillimit të viteve të 70-ta të shek. XX, ku thuhet "...se më se 90% të prodhimit të vet të papërpunuar të plumbit dhe të zinkut Kombinati "Trepça" ua shet vlerësve jashtë rajonit të Kosovës. Pjesa që shkon për t'i plotësuar nevojat e vendit tonë nuk shitet sipas çmimeve të tregut botëror, por me çmime të brendshme, të caktuara me marrëveshje, të cilat shpeshherë janë (gjer 20%) nën çmimet botërore...Nuk është aspak më e mirë gjendja në Kombinatin "Kosova", i cili pothuajse ¾ e energjisë elektrike i eksporton në RS të Maqedonisë dhe në RS të Serbisë...Energjia elektrike që eksportohet sidomos në Maqedoni, është e shitur me çmime 2-3 herë më të ulëta sesa që e shesin kombinatet e tjera të këtij lloji. Një pjesë e energjisë elektrike, e cila i përcillet elektroekonomisë së Serbisë, realizohet me çmime gjithashtu shumë të ulëta në krahasim me çmimet me të cilat ne e blejmë të njëtën energji elektrike nga elektrodistribucioni i Serbisë" (Xh. Bakraçi, "Pozita e KSA të Kosovës si faktor i diferencimeve interregjionale", *Economia*, nr. 2, Prishtinë, 1973, f. 159).

[5] *Aktuelni problemi proizvodne strukture Kosova,* Ekonomski institut, Beograd, 1971, f. 42 e tutje.

Edhe përkundër përpjekjeve dhe të arriturave në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës dhe veçanërisht të ngritjes së objekteve industriale dhe të infrastrukturës në vitet e 70-ta, që lidhej me avancimin e statusit të saj politiko-konstitucional në ish-Federatën Jugosllave, Kosova deri në shkatërrimin e ish-Jugosllavisë mbeti edhe në pikëpamje absolute edhe relative territori më i pazhvilluar dhe dallimet midis saj dhe rajoneve tjera gjithnjë shtoheshin. P. sh. nga gjysma e viteve të 80-ta ajo ishte gjashtë herë më pak e zhvilluar se Sllovenia, katër herë më pak e zhvilluar se Kroacia e Vojvodina, tri herë më pak se Serbia dhe mesatarja e ish-shtetit dhe dy herë më pak e zhvilluar se ish-republikat e tjera jo mjaft të zhvilluara (B e H, Mali i Zi dhe Maqedonia). Deri në përfundim të shekullit XX zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës e karakterizonin tri probleme të mëdha: struktura jo e volitshme e ekonomisë, aftësia e dobët akumuluese dhe papunësia.[6] Në vitet e 80-ta e të 90-ta të këtij Kosova u shndërrua në koloni dhe zonë të okupimit klasik serb.

Nga struktura kryesisht agrare dhe mungesa e industrializimit të Kosovës deri vonë pas Luftës II Botërore rezultoi një tip jo i volitshëm i strukturës ekonomike të popullsisë aktive, që u reflektua edhe në veçoritë e tjera të popullsisë dhe në rrjedhat e urbanizimit. Pasqyra e tipit të strukturës ekonomike midis Kosovës dhe territoreve të ish-Jugosllavisë tregon një dallim të madh. Sllovenia p. sh. kishte arritur ta reduktonte përqindjen e popullsisë bujqësore në rreth 20% në vitin 1971 (Kosova 51,1%) dhe në më pak se 10% në vitin 1981 (Kosova 24.6%). Niveli i kësaj popullsie në Slloveni ishte më i ulët më 1948 (46,7%) se sa në Kosovë në vitin 1971. Sllovenia kishte arritur tipin më të volitshëm të strukturës ekonomike në ish-Jugosllavi, me rënie të konsiderueshme të sektorit primar dhe me rritje të ndjeshme të sektorit sekondar dhe terciaro-kuartar dhe pas saj vinin Kroacia e të tjerat, ndërsa Kosova mbeti në fund të shkallës ekonomike, me dominimin e sektorit primar në vitet 1961-1971 dhe me rritje të ndjeshme të numrit absolut të popullsisë agrare si fenomen më i pavolitshëm në procesin e zhvillimit ekonomik (tepricat agrare). Në vitin 1970 p. sh. bruto prodhimi kombëtar për kokë banori në Slloveni ishte 1.550 $, ndërsa në Kosovë pesë herë më i ulët ose rreth 300 $ (ish-Jugosllavia 860 $).

[6] N. Bashota, "Osnovni problemi privrede Kosova", *Pogledi* (Kosovo danas i sutra), Split, 1988, pp. 405-418.

Tabela 1. Struktura ekonomike e popullsisë aktive sipas sektorëve të veprimtarisë ekonomike në ish-Jugosllavi, në Slloveni dhe në Kosovë në periudhën 1961-1971[7]

Territori	Viti	I	II	III	IV	Jashtë veprimtarisë e të panjohur	Punëtorët në punë në botën e jashtme	Tipi i strukturës ekonomike
Ish-Jugosllavia	1961	57,0	17,4	11,2	9,3	4,6	-	I-II-III-IV
	1971	44,6	22,1	14,3	10,3	1,8	6,6	I-II-III-IV
Sllovenia	1961	37,9	29,1	16,6	12,2	4,2	-	I-II-III-IV
	1971	25,4	36,8	18,8	12,2	1,1	5,4	I-II-III-IV
Kosova	1961	70,7	11,5	5,6	7,2	5,0	-	I-II-IV-III
	1971	52,7	17,7	8,5	10,3	3,5	6,4	I-II-IV-III

Sot nuk kemi shumë të dhëna për zhvillimin ekonomik dhe veçanërisht për punësim. Sipas një hulumtimi të Institutit për Hulumtime Zhvillimore aktualisht në Kosovë norma e popullsisë ekonomikisht aktive është 58% (femrat 41%, meshkujt 76%), ku përfshihen të punësuarit dhe personat që kërkojnë punë. Afër 70% të të punësuarve punojnë në sektorin privat, do të thotë në biznese private dhe bujqësi. Derisa në vitin 1988, në sektorin publik, në ndërmarrjet shoqërore e publike dhe në institucionet qeveritare kishin zënë punë 245.400 punëtorë, ndërkaq në vitin 2002 ky numër zvogëlohet në 126.000 ose për 52%. Sipas hulumtimit anketues norma e papunësisë vlerësohet në rreth 49%, ndërsa te femrat në rreth 63%.[8] Ndërkaq Enti i Statistikës i Kosovës për vitin 2001 për normën e aktivitetit të popullsisë dhe për shkallën e punësimit kishte dhënë shifra të tjera: për popullsinë ekonomikisht aktive rreth 47% (femrat 27%, meshkujt 66%), ndërsa për normën e papunësisë rreth 57% (femrat 70%, meshkujt 52%).[9]

2. Popullsia bujqësore dhe lëvizja e saj

2.1. Çështje metodologjike të zbatimit të definicionit të popullsisë bujqësore

Është dukuri e njohur që në kuadër të zvogëlimit të pjesëmarrjes së bujqësisë në ekonominë e përgjithshme të zvogëlohet edhe përqindja e popullsisë bujqësore në popullsinë e përgjithshme. Zvogëlimi i popullsisë

[7] Të dhënat nga regjistrimet zyrtare të popullsisë (i përpunoi autori).
[8] *Tregu i punës dhe papunësia në Kosovë,* Riinvest, Prishtinë, janar 2003, f. 8.
[9] Enti i Statistikës i Kosovës, Material, dhjetor 2001.

bujqësore bëhet kryesisht me kalimin e saj në veprimtari jobujqësore përmes lëvizjes sociale (vertikale) dhe hapësinore (horizontale). Të bëhet përkufizimi i këtyre formave të migrimeve dhe të procesit të deagrarizimit, si dhe të formave të tjera të transferit, sikurse p.sh. përmes migrimeve të martesave, është çështje shumë e ndërlikuar në pikëpamje metodologjike. Është vështirë të përcaktohet vëllimi i këtyre formave të mobilitetit të popullsisë, pra i kalimit të popullsisë nga bujqësia në jobujqësi aq më tepër kur lëvizjet sociale dhe hapësinore në mes veti shpeshherë gërshetohen dhe përshkohen.

Tempon e zvogëlimit të popullsisë bujqësore e problematizon edhe më shumë *ndryshimi i vetë definicionit* të popullsisë bujqësore në regjistrimin e popullsisë të vitit 1981 në krahasim me regjistrimet e mëparshme të popullsisë. Në regjistrimet e viteve 1953, 1961 dhe 1971 në popullsi bujqësore janë përfshirë të gjithë personat aktivë të cilët profesionin e tyre e ushtronin në veprimtaritë si bujqësia, peshkataria dhe hidroekonomia, si dhe të gjithë personat e mbajtur nga ata. Në popullsinë bujqësore pra janë përfshirë edhe personat të cilët ushtronin profesione jobujqësore (farkëtarët, mekanikët, kontabilistët etj.), por që ishin të punësuar në organizatat që i përkasin bujqësisë si veprimtari. Në popullsi bujqësore hynin (1971) edhe personat në punë të përkohshme në botën e jashtme, të cilët para shkuarjes në punë i përkisnin popullsisë bujqësie. Ndërsa në regjistrimin e vitit 1981 në popullsi bujqësore nuk janë përfshirë bujqit të cilët përkohësisht punonin në botën e jashtme dhe personat e mbajtur nga ata, si dhe numri i personelit të punësuar që ka ushtruar profesione jobujqësore në organizatat ekonomike që u takonin veprimtarive jobujqësore, përkatësisht sektorit shoqëror të bujqësisë (bujqësia, pylltaria, peshkataria dhe hidroekonomia) dhe personat e mbajtur nga ata. Më regjistrimin e vitit 1981 popullsia bujqësore është definuar pra sipas kriterit *profesion*, ndërsa në regjistrimet e mëparshme sipas kriterit *veprimtari*.[10]

Për shkak të aplikimit të definicionit e të kritereve jo të njëjta në përcaktimin e popullsisë bujqësore, të dhënat e regjistrimit të fundit nuk janë të krahasueshme me ato të regjistrimeve të mëparshme. Për këtë arsye, për ta vlerësuar dinamikën krahasuese të ndryshimeve në numrin e popullsisë bujqësore kemi shfrytëzuar edhe vlerësimin e Entit Federativ të Statistikës për vitin 1981. Ndoshta, sipas këtij vlerësimi, numri i popullsisë bujqësore për Kosovën, por edhe për të gjitha territoret e tjera të Jugosllavisë, është i mbivlerësuar për shkak të përfshirjes së popullsisë të

[10] Shih vërejtjet metodologjike të regjistrimeve të popullsisë në: Z. Aničić – D. Breznik, *Po aty*, ff. 19-37; V. Puljiz, "Teze o socijalnim promjenama i agrarnom razvoju", në *Problemi socijalističkog razvoja poljoprivrede i sela*, Ljubljana – Beograd, 1983, f. 579.

kategorive të përmendura kontestuese të popullsisë bujqësore. Mirëpo, edhe e dhëna prej 23,9% të popullsisë bujqësore në popullsinë e përgjithshme të Kosovës në vitin 1981 duket se është kontestuese. Për këtë zvogëlim kaq të madh të numrit relativ të popullsisë bujqësore në periudhën 1971-1981 është shumë i rëndësishëm një indikator – rritja e numrit absolut të të punësuarve në sektorin shoqëror, ku një person aktiv në këtë sektor i mban disa anëtarë të tjerë të ekonomisë familjare (tipi i zgjeruar) dhe të gjithë këta në regjistrim të popullsisë merren si popullsi jobujqësore. Por edhe ky element duket se nuk mund ta shpjegojë një rënie kaq të madhe të popullsisë bujqësore në periudhën 1971-1981.

Ishte e arsyeshme që në regjistrimin e vitit 1981 në popullsi bujqësore nuk ishin përfshirë personat aktivë, të cilët profesionin e tyre e kanë ushtruar në veprimtaritë si bujqësia, pylltaria, peshkataria dhe hidroekonomia në sektorin shoqëror të ekonomisë dhe kishin status të të punësuarve, si dhe nga këta personat e mbajtur. Këta persona si të punësuar kishin të ardhura të rregullta mujore dhe ishte e sigurt se kishin pozitë me të mirë materiale, p.sh. edhe se punëtorët në xehetari dhe ndërtimtari apo edhe në disa profesione tjera; kjo kishte sigurisht edhe efekte të ndryshme në transformimin e veçorive të tjera kualitative të dinamikës dhe të strukturës së popullsisë. Korrigjimi në këtë drejtim ishte pra i arsyeshëm. Numri i kësaj popullsie aktive (të punësuar në sektorin shoqëror) më 30. IX. 1981 ishte rreth 9.300 vetë. Ky numër kur shumëzohej me madhësinë mesatare të ekonomive familjare të Kosovës (6,9 anëtarë) jepte numrin prej rreth 65.000 vetash ose 4,0 % nga numri i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës.

Në rastin e Kosovës e dhëna prej 380.024 ose 23,9 % të popullsisë bujqësore më 1981 është diskutabile para së gjithash për shkak të mospërfshirjes në popullsi bujqësore të punëtorëve në botën e jashtme të cilët para shkuarjes ishin bujq dhe nga ata popullsia e mbajtur, si dhe numri i personave të cilët në ekonomitë familjare të këtyre punëtorëve edhe sot merren me bujqësi. Sa i përket profesionit të këtyre punëtorëve para migrimit në kurbet, nga Kosova ishin 48,4 % bujq dhe punëtorët të tjerë të sektorit primar, pra gjithsej rreth 14.000 punëtorë, fati i të cilëve, sa i përket asaj se a do të mbetnin në bujqësi apo do ta braktisin atë, mbetej akoma i paqartë. Kur të shumëzohet numri prej 14.000 punëtorëve me madhësinë mesatare të ekonomive familjare fshatare (7,9 anëtarë), del se kjo kategori së bashku me ata që i mbante ishte rreth 112.000 vetë. Kjo do të thotë se – kur t'i zbritet numrit të vlerësuar të popullsisë bujqësore nga Enti Federativ i Statistikës prej 685.000 vetash numri i të punësuarve në organizatat bujqësore të sektorit shoqëror të ekonomisë prej 65.000 vetash dhe numri i punëtorëve përkohësisht të punësuar në botën e jashtme që nuk janë marrë

para shkuarjes me veprimtari bujqësore prej rreth 118.500 vetash (së bashku me të mbajturit) ose t'i shtohet numri i përmendur prej rreth 112.000 vetash (migrantët para shkuarjes në botën e jashtme të profesionit bujqësor) numrit të konstatuar me regjistrim të popullsisë bujqësore prej 380.000 vetash – numri i vërtetë i popullsisë bujqësore të Kosovës në vitin 1981 është së paku diku rreth 500.000 vetash ose rreth 31.5 % nga numri i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës. Për këtë dëshmon edhe fakti se më 1981 119.428 ose 52,1 % të ekonomive familjare ishin bujqësore dhe të përziera.

Problemi i përcaktimit të popullsisë bujqësore dhe jobujqësore, sikurse edhe i përcaktimit të popullsisë në fshatare dhe urbane, në popullsinë aktive e të mbajtur në bujqësi, pastaj të popullsisë analfabete etj. – në ish-Jugosllavi metodologjikisht nuk ishte zgjidhur si duhet. Kontesti rreth përcaktimit të popullsisë bujqësore duhet të hulumtohet më thellë, sepse ndoshta ka të meta të caktuara edhe në përpunimin e materialit të regjistrimit apo edhe në vetë realizimin e regjistrimit të popullsisë sa i përket kësaj çështjeje, meqenëse disproporcioni më i madh në mes të numrit të vlerësuar dhe numrit të konstatuar të popullsisë bujqësore me regjistrim ishte pikërisht në Kosovë (18,5 %), ndërsa në territoret e tjera të ish-Jugosllavisë ky disproporcion ishte më i vogël: ish-Jugosllavia 8,8 %, BeH 13,3 %, Mali i Zi 12,8 %, Vojvodina 11,8 %, Maqedonia 7,7 %, Kroacia 7,1 %, Serbia 6,0 % dhe Sllovenia vetëm 1%. Konsiderojmë se do të jetë sukses i madh për transformimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës në qoftë se në fillim të shekullit të ri përqindja e vërtetë e popullsisë bujqësore zvogëlohet në rreth 20,0% nga popullsia e gjithmbarshme.

2.2. Lëvizja e numrit të popullsisë bujqësore në periudhën 1948-1981

Siç theksuam edhe më parë Kosova menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore trashëgoi një përqindje të lartë të popullsisë bujqësore, si pasojë e lënies krejtësisht pasdore të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Në periudhën pas Luftës II Botërore kalimi i popullsisë bujqësore në veprimtari jobujqësore ishte i konsiderueshëm, gjë që është ligjësi e përgjithshme në kuadër të zhvillimit ekonomik. Transferi i popullsisë nga bujqësia dhe të shumtën edhe nga fshati në veprimtari jobujqësore dhe në qytet apo në qendra komunale zhvillohej në mënyrë të *drejtpërdrejtë*, pa përgatitje profesionale dhe arsimore, në një anë, dhe në mënyrë *indirekte*, përmes shkollimit të gjeneratës së re dhe të ndryshimit të pozitës socialo-ekonomike të popullsisë, në anën tjetër. Është karakteristikë e përgjithshme se bujqësinë e braktis popullsia e re, vitale dhe e arsimuar. Por, është vështirë të

konstatohet numri i saktë i kalimit të popullsisë agrare në veprimtari joagrare përmes formave të përmendura të transferit.

Mirëpo, tempoja dhe vëllimi i deagrarizimit nuk janë zhvilluar me të njëjtën dinamikë në tërë ish-Jugosllavinë dhe në Kosovë në gjithë gjysmën e dytë të shekullit XX. Në dy dekadat e para të zhvillimit, ndonëse përqindja e popullsisë agrare në Kosovë u zvogëlua dukshëm, megjithatë, për shkak të transformimit të ngadalshëm ekonomik (industrializimi i vonë) dhe strukturës jo të volitshme të investimeve, te përcjella me rritje të lartë të popullsisë bujqësore – vëllimi dhe intensiteti i deagrarizimit nuk ishin aq të theksuara sa mund të ndikonin edhe në zvogëlimin e *numrit absolut* të popullsisë bujqësore. Rritja e numrit absolut të popullsisë bujqësore ishte dhe mbeti deri në vitet shtatëdhjetë fenomeni më i pavolitshëm në zhvillimin socialo-ekonomik të fshatit e të bujqësisë dhe të zhvillimit shoqëroro-ekonomik të Kosovës në përgjithësi. Kosova ishte i vetmi territor në ish-Jugosllavi që shënoi deri vonë rritje të numrit absolut të popullsisë agrare (tabela 3); përqindja e popullsisë bujqësore në Kosovë ishte në vitin 1971 për 8 % më e lartë se niveli i përqindjes së kësaj popullsie në Slloveni në vitin 1948. Kështu në Kosovë, nga pamundësia e shkarkimit të bujqësisë nga fuqia e tepërt punëtore, krijohen kontingjente të mëdha të popullsisë jo mjaft të punësuar dhe të papunësuar në ekonomi shtëpiake bujqësore dhe natyrisht krijohen probleme të rënda sociale dhe jetësore në fshat.

Tabela 2. Përqindja e popullsisë bujqësore në popullsinë e përgjithshme në ish-njësitë federale sipas regjistrimeve të popullsisë 1948–1981[11]

Ish-njësitë federale	1948	1953	1961	1971	1981
Jugosllavia	62,7	60,9	49,6	38,2	19,9
B e H	71,8	62,2	50,2	39,9	17,3
Mali i Zi	71,6	61,5	47,0	35,0	13,5
Kroacia	62,4	56,4	43,9	32,3	15,2
Maqedonia	70,0	62,7	51,3	39,9	21,7
Sllovenia	44,1	41,1	31,3	20,4	9,4
Serbia	72,4	67,2	56,2	44,1	27,6
Vojvodina	68,1	62,9	51,8	39,0	19,9
Kosova	80,9	72,4	64,2	51,5	24,6

[11] *Statistički kalendar Jugoslavije 1983*, SZS, Beograd, 1984, f. 38.

Sipas analizave të bëra, transferi i popullsisë bujqësore në veprimtari jobujqësore në Kosovë numerikisht është më i vogël se shuma e shtimit natyror të popullsisë bujqësore. Vlerësohet se në periudhën 1948-1961 rritja e përgjithshme e popullsisë bujqësore ishte rreth 169.000 banorë, kurse kalimi në veprimtari jobujqësore rreth 120.000 vetë,[12] e kjo do të thotë se teprica e numrit absolut të popullsisë bujqësore është rreth 50.000 vetë. Moszhvillimi i industrisë dhe komponenti natyror i shtimit të popullsisë janë faktorët kryesorë të kësaj rritje. Komponenti imigrues nuk mund të ketë ndonjë peshë të rëndësishme në këtë drejtim, meqenëse popullsia e ardhur në Kosovë në këtë periudhë, para së gjithash nga Serbia dhe Mali i Zi, nuk punësohet në bujqësi, por në veprimtari jobujqësore. Në anën tjetër, po të mos ishte shpërngulur një numër i madh i popullsisë në Turqi në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar, ku një pjesë e mirë ishte fshatare dhe bujqësore, numri absolut i popullsisë bujqësore dhe i tepricave të saj agrare do të ishte shumë më i madh. Me regjistrimet e popullsisë të viteve 1948 dhe 1961 konstatohet teprica e numrit absolut të popullsisë bujqësore përreth 37.000 vetë. Disa analiza tregojnë se në këtë periudhë në Kosovë ka mbetur e lidhur për punimin e tokës më se gjysma e shtimit natyror të ekonomive shtëpiake individuale.[13] Transferi mesatar vjetor i popullsisë agrare në veprimtaritë joagrare në periudhën 1948-1961 në Kosovë ishte më i ulët se në të gjitha territoret e ish-shtetit (15,2 në 1.000 banorë bujqësorë).[14]

---

[12] B. Maksimović, "Prelazak poljoprivrednog stanovništva u nepoljoprivredne delatnosti", *Stanovništvo*, br. 1, CDI, IDN, Beograd, 1963, ff. 16-17.

[13] P. Marković, *Migracije i promene agrarne strukture*, Zagreb, 1974, f. 39.

[14] Vlen të theksohet se transferi i popullsisë bujqësore në veprimtaritë jobujqësore është sigurisht më i madh, duke pasur parasysh se M. Maksimoviqi i ka shfrytëzuar të dhënat paraprake të popullsisë bujqësore të regjistrimit të vitit 1961. Sipas këtyre të dhënave del më i madh numri i popullsisë bujqësore sesa është konstatuar me rezultatet definitive të regjistrimit të popullsisë, prandaj për vitin 1961 ne i kemi shfrytëzuar të dhënat definitive të regjistrimit të popullsisë. Mospajtimi në mes të dhënave definitive dhe të atyre që i jep B. Maksimoviqi për Kosovën është rreth 120.000 banorë bujqësorë. Kjo deri diku e korrigjon edhe të dhënën e një studimi demografik (*Demografski razvitak Kosova i Metohije*, CDI, IDN, Beograd, 1963, f. 68), sipas të cilit kalimi i popullsisë bujqësore në veprimtari jobujqësore për periudhën 1948-1961 sillet rreth 150.000 vetë.

Tabela 3. Rritja ose rënia e popullsisë bujqësore të Kosovës në periudhën 1948-1981 sipas regjistrimeve të popullsisë[15]

Regjistrimi	Numri i popullsisë bujqësore	Përqindja e popullsisë bujqësore	Rritja (+) ose rënia (-) e numrit absolut të popullsisë bujqësore	
1948	581.000	80,9	1948 – 1953	+ 10.000
1953	591.000	72,4	1953 – 1961	+ 27.381
1961	618.381	64,2	1961 – 1971	+ 22.248
1971	640.629	51,5	1971 – 1981	- 260.605
1981	380.024	24,6	1948 – 1981	- 200.976

Në periudhën 1961-1971 transferi i popullsisë bujqësore në veprimtaritë jobujqësore në Kosovë ishte më i madh. Sipas disa vlerësimeve në këtë periudhë, kalimi i përgjithshëm në jobujqësi ishte rreth 189.000 vetë (30,4 në 1.000 banorë bujqësorë), ndërsa shtimi natyror rreth 197.000 vetë, që do të thotë se rreth 8.000 banorë të rinj shtoheshin në bujqësinë e Kosovës.[16] Në territore të tjera të ish-Jugosllavisë, përkundrazi, kalimi i popullsisë bujqësore në veprimtaritë jobujqësore ishte më i madh se shtimi natyror i kësaj popullsie.[17] Kalimi më i madh i popullsisë agrare në veprimtari jobujqësore në këtë periudhë koincidonte me faktin se Kosova përjetoi një dinamikë të ndryshimeve të ndjeshme shoqërore dhe ekonomike, por jo edhe aq të fuqishme sa të kishte mundur ta absorbonte tërë shumën e shtimit natyror, i cili, me zvogëlimin e mortalitetit si pasojë të ndryshimeve shëndetësore, sociale etj., vazhdimisht rritej (rreth 30 promilë mesatarisht në vit në periudhën 1961-1971). Për periudhën 1971-1981, për shkak të ndryshimit të definicionit të popullsisë bujqësore, transformimet në strukturën agrare nuk janë të krahasueshme. Mirëpo, po të ishte zbatuar definicioni i vitit 1981 edhe në regjistrimet e mëparshme, vëllimi i popullsisë bujqësore do të kishte qenë më i vogël, por numri absolut i popullsisë bujqësore gjithashtu do të kishte shënuar rritje.

[15] B. Maksimović, *Po aty*, f. 8; *Popis stanovništva 1961, Poljoprivredno stanovništvo*. Knj. XV, SZS, Beograd, 1966, f. 3; *Popis stanovništva i stanova 1971. Poljoprivredno stanovništvo*, knj. XV. SZS, Beograd, 1973, f. 1; R*egjistrimi i popullsisë, ekonomive shtëpiake dhe i banesave më1981*, Buletini 17, f. 26.

[16] *Društvene promjene u selu,* Zagreb-Beograd, 1974, f. 51; V, Puljiz, *Eksodus poljoprivrednika,* Zagreb, 1977, f. 118.

[17] *Društvene promjene u selu*, f. 51.

2.3. Aspekti territorial i popullsisë bujqësore

Është interesant të vështrohet pasqyra rajonale e pjesëmarrjes së popullsisë bujqësore dhe procesi i transformimit të saj. Meqenëse shtrirja territoriale e objekteve industriale dhe e veprimtarive të tjera bujqësore në Kosovë nuk është e harmonizuar, edhe ndryshimet në lëvizjen, përkatësisht zvogëlimin e numrit relativ dhe absolut të popullsisë bujqësore nuk janë manifestuar njësoj në pikëpamje hapësinore. Këto 50 vjetët e fundit numri i popullsisë bujqësore më tepër është zvogëluar në rajonin e Kosovës sesa në atë të Dukagjinit, sepse ky rajon disponon resurse të mëdha natyrore në bazë të të cilave së pari është zhvilluar industria ekstraktive dhe energjetika dhe më vonë edhe degët tjera të industrisë. Në tërë territorin e Kosovës shtatë qendrat e mëdha urbane (për rrethanat kosovare) dhe pastaj edhe selitë e tjera komunale me funksionet e tyre të ndryshme janë bërthamat kryesore të absorbimit të masave të popullsisë bujqësore nga rrethina. Ndryshime të mëdha të popullsisë agrare shënohen në rripin industrialo-urban të Kosovës, që shtrihet prej pjesës veriore të Leposaviqit, duke përfshirë Mitrovicën me rrethinë, Vushtrinë, Prishtinën me rrethinën e gjerë, pastaj Lipjanin, Ferizajn dhe Kaçanikun.

Deri në vitet gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar një numër i madh i fshatrave dhe i rajoneve të tëra fshatare kishte kryesisht strukturë agrare dhe jetë të mbyllur sociale. Në vitin 1961 p.sh. rreth 500 fshatra kishin 90-100 % popullsi bujqësore, ndërsa 350 sish 80-90% këso popullsie, kurse të gjitha fshatrat tjera kishin më se 75% të popullsisë agrare. Me gjithë rënien relative të popullsisë bujqësore në vitin 1971, prapëseprapë rreth 600 fshatra kishin midis 80 dhe 100% të kësaj popullsie. Territoret me popullsi dominante bujqësore janë kryesisht rajonet kodrinore-malore dhe territoret e orientimit tradicional agrar. Në këto territore jo vetëm që nuk është zvogëluar numri relativ i popullsisë bujqësore deri në vitet shtatëdhjetë, por kanë shënuar rritje të konsiderueshme të numrit absolut të kësaj popullsie. Këto janë kryesisht fshatrat që kanë të shumtën pozitë periferike gjeografike, të izoluara në pikëpamje komunikative deri vonë, me mënyrë ekstensive të ekonomizimit, me standard të ulët jetësor e shoqëror, me përqindje të lartë të analfabetëve, me strukturë të pazhvilluar demografike etj. Në këto rajone në masë të madhe është ashpërsuar edhe problemi i dendësisë agrare, i cili një zbutje të përkohshme duket se e ka gjetur vetëm pas shkuarjes së fuqisë punëtore në botën e jashtme; një numër i madh i fshatrave të këtyre rajoneve në vitin 1971 kishte shkallë më të lartë të punësimit në vendet e huaja sesa në Kosovë.

Ndryshimet në përqindjen e popullsisë bujqësore, por edhe në rritjen apo zvogëlimin e numrit absolut të kësaj popullsie, shihen më së miri nga

pasqyra sipas komunave. Lëvizja e popullsisë bujqësore është zhvilluar në përputhshmëri me dinamikën e industrializmit e të urbanizmit të komunave dhe qendrave të tyre. Ndryshime më të mëdha shënohen në zonat ku qendrat industriale dhe urbane marrin funksione të reja të zhvillimit. Mirëpo, në anën tjetër, një numër i konsiderueshëm i komunave shënon rritje të numrit absolut të popullsisë bujqësore në periudhën 1961-1971, veçanërisht komuna e Rahovecit, e Klinës, e Gjakovës, e Therandës, e Pejës, e Deçanit, e Burimit etj. Në periudhën 1971-1981 në të gjitha komunat zvogëlohet edhe numri absolut i popullsisë bujqësore, mirëpo pasqyrën krahasuese e vështirëson ndryshimi i definicionit të popullsisë bujqësore në regjistrimin e vitit 1981. Në komunat më të zhvilluara, në Prishtinë dhe Mitrovicë, në vitin 1981 përqindja e popullsisë bujqësore reduktohet në 7,0% (nën nivelin mesatar të Sllovenisë, 9,4%). Një të pestën e popullsisë agrare e kanë komunat e Kaçanikut, e Vuçitërnës dhe e Dragashit, ndërsa përqindje më të lartë të kësaj popullsie kanë komunat të cilat përpara ishin kryesisht agrare (Rahoveci, Klina, Burimi, Theranda, Vitia).

Për zvogëlimin e popullsisë bujqësore në komunat e përmendura, si dhe në Kosovë në tërësi, kahet e zhvillimit të gjithmbarshëm, e para së gjithash industrializimi – zhvillimi e industrisë përpunuese, finalizimi i lëndëve të para të cilat i disponon vetë Kosova, zhvillimi i qyteteve, i infrastrukturës etj. – duhet të jenë një ndër preokupimet themelore dhe të kenë rrjedhë të harmonizuar territoriale në mënyrë që t'i përfshijë edhe rajonet fshatare dhe bujqësore.

3. Popullsia aktive dhe karakteristikat e saj

Në kuadër të zhvillimit të popullsisë dhe të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror-ekonomik të Kosovës duhet veçanërisht të përmendet edhe shkalla e ulët e popullsisë ekonomikisht aktive. Përqindja e angazhimit të popullsisë në veprimtarinë ekonomike jo vetëm që është e ulët në gjithë shekullin XX., por vazhdimisht është zvogëluar në periudhën pas Luftës II Botërore: në vitin 1953 ishte 32,9 %, më 1961, 34,6 % më 1971 bie në 26,0 % dhe më 1981 zvogëlohet edhe më tepër, në 22,6 %. Niveli dhe tendenca e tillë e pavolitshme, veçanërisht kur rritet vëllimi i popullatës së përgjithshme, janë rezultat të një varg faktorësh dhe para së gjithash të moszhvillimit ekonomik e të strukturës së pavolitshme të ekonomisë për një kohë të gjatë, strukturës shumë të re të popullsisë si pasojë e shkallës së lartë të shtimit natyror, përfshirjes së vogël të femrave në aktivitetet prodhuese dhe shoqërore në kuadër të ndarjes shoqërore të punës, pastaj të rritjes ekspansive të numrit të

nxënësve e të studentëve, të ndikimit të disa faktorëve të tjerë shoqërorë (tradita, zakonet) lidhur me angazhimin e femrës në jetën ekonomike dhe shoqërore, të metave në regjistrimin e popullsisë aktive (që është faktor shumë i rëndësishëm në oscilimet e përmendura), të shkaktuara nga vetë definicioni i ndërlikuar i kësaj popullsie etj.[18]

Tabela 4. Popullsia aktive në popullsinë e përgjithshme në vendbanimet fshatare dhe urbane sipas gjinisë (regjistrimi i vitit 1981)[19]

Tipi i popullsisë	Gjithsej		Meshkujt		Femrat	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Fshatare	211.636	20,3	191.787	36,1	19.849	3,9
Urbane	138.226	27,3	101.286	39,5	36.940	14,7
Gjithsej	349.862	22,6	293.073	37,2	56.789	7,4

Kur të zbërthehet shkalla e përgjithshme e popullsisë aktive e Kosovës sipas vendbanimeve urbane e fshatare dhe sidomos sipas gjinisë, gjendja del edhe më e pavolitshme. Në vitin 1981 p.sh. vetëm një e pesta e popullsisë fshatare ishte aktive (20,6 %) dhe nga kjo vetëm 9,1 % i përket popullsisë femërore. Në vendbanimet urbane shkalla e angazhimit të popullsisë në jetën ekonomike është shumë më e kënaqshme (tabela 4). Në kuadër të popullsisë aktive bujqësore dallimet janë shumë më të mëdha midis popullsisë femërore dhe popullsisë mashkullore; rreth 96,0 % të popullsisë së përgjithshme aktive në bujqësi e përbëjnë meshkujt, ndërsa vetëm rreth 4,0% femrat.[20] Derisa për Kosovën si tërësi në vitin 1961 në 100 persona aktivë vinin 177,4 të mbajtur, në vitin 1981 ky numër rritet në 238,6 persona

[18] Më gjerë: H. Islami, *Popullsia e Kosovës*, f. 70-74; shih gjithashtu: M. Sentić, M. Rančić, D. Đošić, *Ocena nekih definicija i klasifikacija u popisu stanoništva 1971. godine,* CDI, IDN, Beograd, 1976, ff. 7-26; M. Rašević, T. Mulina, M. Macura, *Determinante ekonomske aktivnosti stanovništva,* Ekonomski institut, Beograd, 1976; A. W. Baletić, *Ekonomska aktivnost stanovništva – Demografski aspekti,* Školska knjiga, Zagreb, 1978, etj.

[19] *Regjistrimi i popullsisë, ekonomive shtëpiake dhe i banesave,* Buletini 17, f. 26.

[20] Te femrat në bujqësinë individuale në përgjithësi është problem i madh përcaktimi i popullsisë aktive dhe asaj të mbajtur, veçanërisht deri në vitin 1981, si një nga të metat themelore në vetë metodologjinë jo të njëjtë të zbatimit në të gjitha regjistrimet e popullsisë. P. sh. në regjistrimin e vitit 1953 shkalla e përgjithshme e popullsisë aktive femërore ishte 10,9 %, më 1961 17,6 %, më 1971 8,4 % (M. Sentić, M. Rančić, D. Đošić, *Po aty,* fq. 17; M. Rašević, T. Mulina, M. Macura, *Po aty,* ff. 73-78.

të mbajtur. Kontingjenti i popullsisë aktive bujqësore të të dy gjinive dhe veçanërisht të femrave është shumë i ngarkuar me popullsi të mbajtur (tabela 5).

Tabela 5. Popullsia aktive dhe popullsia e mbajtur bujqësore sipas gjinisë (regjistrimi i vitit 1981)[21]

Gjinia	Numri i popull-sisë bujqësore		Popullsia aktive		Popullsia e mbajtur		Numri i të mbajturve në 100 persona aktivë
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	
Meshkujt	193.873	100,0	75.544	39,8	118.329	61,1	156
Femrat	186.151	100,0	6.819	3,8	179.332	96,4	2.629
Gjithsej	380.024	100,0	82.363	21,6	297.661	78,4	361

4. Dendësia e përgjithshme dhe dendësia agrare

Për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit absolut dhe relativ të popullsisë së Kosovës është rritur edhe dendësia e përgjithshme e popullsisë. Derisa në Kosovë në vitin 1948 në 1 km^2 jetonin 67,3 banorë, ndërsa në vitin 1981 dendësia rritet në 145,5 banorë. Dendësi më të madhe Kosova shënon sidomos pas vitit 1961, kur në 1 km^2 jetonin 88,5 banorë, kurse më 1971 114,2 banorë. Kosova sot është territori më i banuar në Ballkan: dendësia është dy herë më e madhe se mesatarja e vendeve në rajon dhe deri tri herë më e madhe se në shumë territore të tjera.

Vështruar regjionalisht, më të banuara janë territoret e rrafshit të Kosovës, pastaj ato rreth qendrave urbane e të urbanizuara, në të cilat, në komponentin e rritjes së popullsisë, përveç shtimit natyror, kanë ndikuar edhe migrimet e popullsisë. Dendësi më të vogël të banimit (nën mesataren kosovare) kanë kryesisht rajonet periferike rurale, në të cilat procesi i emigrimit të popullsisë ka marrë hov të dukshëm, si dhe rajonet kodrinore-malore, ku dominojnë pyjet dhe kullotat (rajonet në komunën e Dragashit, të Kaçanikut, të Deçanit, të Leposaviqit etj.), por edhe që janë tipike emigruese. Mirëpo, në asnjë komunë në vitin 1981, përveç në atë të Leposaviqit (31,5) dhe të Dragashit (81,1), dendësia e popullsisë nuk është

[21] *Regjistrimi i popullsisë, ekonomive shtëpiake dhe i banesave,* Buletini 17, f. 26.

nën 100 banorë në 1 km^2; ka madje rajone, në pjesët e zhvilluara të Kosovës, të cilat kanë dendësi edhe mbi 200 e 300 banorë në 1 km^2 (komuna e Prishtinës 245,9 e Prizrenit 210,1). Në komunën e Leposaviqit, për shkak të stagnimit të numrit të popullsisë dhe të strukturës së pavolitshme natyrore-gjeografike, dendësia e popullsisë në tërë periudhën e gjysmës së dytë të shekullit XX pas luftës asnjëherë nuk ka qenë mbi 35 banorë në 1 km^2. Dendësia e përgjithshme në Kosovë sot është shumë më e madhe, mbi 200 banorë në 1 km^2.

Në kuadër të dendësisë së popullsisë në fshatin kosovar veçanërisht shtrohet çështja e dendësisë agrare me pasoja të shumta në jetën sociale-ekonomike të popullatës bujqësore. Tendencat e përmendura të zhvillimit të ngadalshëm ekonomik, të strukturës së njëanshme të tij dhe të rritjes së vazhdueshme të popullsisë bujqësore kushtëzuan që të krijohen kontingjente të mëdha të mosinkuadrimit ose të gjysëminkuadrimit të fuqisë punëtore në bujqësinë e Kosovës; deri vonë në fshatin tonë fuqia punëtore e shtresave të varfra punëtore punonte në pronat e bujqve të pasur (argatët). Kështu u rrit presioni i popullsisë bujqësore në sipërfaqet bujqësore dhe në ato të punueshme: zvogëlohen pronat tokësore dhe rritet copëzimi edhe ashtu i madh i tyre, vështirësohet shfrytëzimi intensiv i tyre, rritet "uria" për tokë, e cila gjithnjë shtrenjtohet dhe vështirësohet gjendja e përgjithshme jetësore në fshat.

Tabela 6. Ekonomitë familjare bujqësore të Kosovës sipas madhësisë së tokës së shfrytëzuar, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1981 (në ha)[22]

Sipërfaqja e shfrytëzuar	Numri	%
Pa tokë	1.401	1,1
Deri 0,10 ha	3.526	2,9
0,11 – 0,50	11.638	9,7
0,51 – 1,00	13.200	11,0
1,01 – 3,00	48.575	40,6
3,01 – 5,00	21.915	18,3
5,01 – 8,00	11.847	9,9
8,01 – 10,00	3.480	2,9
10 e më tepër ha	3.846	3,2

[22] *Regjistrimi i popullsisë, ekonomike shtëpiake dhe i banesave më 1981. Ekonomitë shtëpiake*, Buletini 21, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1983, f. 17.

Një ndër pasojat më të mëdha të dendësisë së theksuar agrare apo të stërdendësisë agrare (kushtimisht ta quajmë kështu) është krijimi i fuqisë së tepërt punëtore në bujqësi, por konstatimi i masave të tepërta të popullsisë bujqësore është problem mjaft i ndërlikuar. Kjo tepricë llogaritet duke marrë për bazë kushtet e caktuara natyrore dhe shkallën e caktuar të zhvillimit teknologjik (pajimeve teknike) në bujqësi.[23] Në ish-Jugosllavi midis dy luftërave të fundit, duke marrë parasysh nivelin e atëhershëm të zhvillimit teknologjik në bujqësi, tepricat e fuqisë punëtore llogariteshin në rreth 35% të popullsisë së përgjithshme agrare.[24] Në Kosovë, në vitin 1961 tepricat e fuqisë punëtore në bujqësi vlerësoheshin në rreth 111.000 vetë ose 46,5% nga kontingjenti i vërtetë i fuqisë punëtore.[25] Sipas llogarive të tjera në vitin 1961 në të dy sektorët, tepricat latente të popullsisë bujqësore vlerësohen në rreth 222.000 vetë, ndërsa në vitin 1971 ky numër rritet në rreth 247.000 banorë të tillë bujqësorë. Në sektorin privat ky kontingjent është shumë më i madh: në vitin 1961 rreth 265.000 vetë dhe në vitin 1971 rreth 290.000 vetë.

Tabela 7. Lëvizja e sipërfaqeve bujqësore në ha dhe dendësia e popullsisë bujqësore në këto sipërfaqe në Kosovë prej 1948 deri 1981[26]

Lëvizja e sipërfaqeve bujqësore në ha në vitet dhe periudhat e caktuara				Ndryshimet e dendësisë agrare në vitet e caktuara	
1948	391.000	1948 – 1953	118.000	1948	148,5
1953	509.000	1953 – 1961	65.000	1953	116,1
1961	574.000	1961 – 1971	15.000	1961	107,6
1971	589.000	1971 – 1981	- 7.000	1971	108,8
1981	582.000	1948 – 1981	191.000	1981	65,2

Në këto vlerësimet e fundit teprica latente e popullsisë bujqësore merret në raport me sipërfaqet e punueshme.[27] Në vitin 1971 në një banor bujqësor vinin 0,61 ha të sipërfaqeve të punueshme (duke i përfshirë edhe livadhet) dhe 0,47 ha të sipërfaqeve nën ara, ndërsa në vitin 1981, me zvogëlimin e popullsisë bujqësore për shkak të ndryshimit të definicionit të

[23] Më gjerë për këtë shih: V. Puljiz, *Eksodus poljoprivrednika*, Zagreb, 1977, ff. 92-93.

[24] M. Macura – T. Mulina, "Perspektive korišćenja radnog potencijala Jugoslavije", *Ekonomska misao*, br. 1, Beograd, 1973, f. 95.

[25] I. Klauzer, "Viškovi radne snage u poljoprivredi Jugoslavije", *Sociologija sela*, br. 7-8, Zagreb, 1965, f. 106.

[26] Të dhënat nga burimet e ndryshme të Entit të Statistikor të Kosovës; H. Islami, *Popullsia e Kosovës*, f. 82.

[27] A. Pushka, "Latentni suvišak poljoprivrednog stanovništva u SAP Kosovo", *Sociologija sela*, br. 73/74, ff. 129-131.

saj, rritet numri i hektarëve për një banor: në 1,6 ha dhe në 0,8 ha për një banor bujqësor.

Deri në vitin 1971 numri i popullsisë bujqësore si në raport me sipërfaqet bujqësore (arat, kopshtet, pemishtet, vreshtat, livadhet, kullotat, hurdhat e peshqve), ashtu edhe në raport me sipërfaqet e punueshme (arat e kopshtet, pemishtet dhe vreshtat) ishte shumë i madh.[28] Në vitin 1981 që të dy këto kategori të dendësisë agrare – në sipërfaqe bujqësore dhe të punueshme – në Kosovë zvogëlohen dukshëm, mirëpo duhet pasur parasysh ndërrimin e definicionit të popullsisë bujqësore, sipas të cilit numri i kësaj popullsisë është shumë më i vogël se në regjistrimet e mëparshme. Sidoqoftë, të dy këto dendësi agrare janë shumë më të mëdha se në territoret e tjera të ish-Jugosllavisë dhe të vendeve të Ballkanit.

Tabela 8. Lëvizja e sipërfaqeve të punueshme dhe ndryshimi i dendësisë së popullsisë agrare në këto sipërfaqe në Kosovë prej 1948 deri 1981[29]

Viti	Sipërfaqet e punueshme në ha	Rritja e sipërfaqeve të punueshme në ha		Ndryshimi i dendësisë së popullsisë agrare në sipërfaqet e punueshme	
1948	275.000	1948 – 1953	10.000	1948	211
1953	284.000	1953 – 1961	15.000	1953	207
1961	309.000	1961 – 1971	14.000	1961	200
1971	323.000	1971 – 1981	- 2.000	1971	198
1981	321.000	1948 – 1981	46.000	1981	118

Paraqitja e dendësisë agrare dhe e pasojave që e përcjellin në formë mjaft të ashpër ishte padyshim një ndër shkaqet e emigrimit të fuqisë punëtore bujqësore në viset e zhvilluara veriperëndimore të ish-Jugosllavisë dhe veçanërisht në migrimin e punës në botën e jashtme në këto dekadat e fundit.

[28] Mendojmë se raporti i popullsisë bujqësore ndaj sipërfaqeve bujqësore nuk është masë objektive e dendësisë së vërtetë agrare dhe e problemeve që dalin nga ajo. Popullsia agrare ndaj sipërfaqeve të punueshme, por pa livadhet, është treguesi më i mirë i dendësisë reale agrare.

[29] H. Islami, *Popullsia e Kosovës*, f. 82.

V. EKONOMITË FAMILJARE DHE TRANSFORMIMI I TYRE

1. Përkufizimi i koncepteve familje dhe ekonomi familjare

Para se ta shqyrtojmë transformimin e lëvizjes së ekonomive familjare, të numrit, të madhësisë dhe të përbërjes së tyre në Kosovë, do të ndalemi shkurtazi në përkufizimin e koncepteve *familje* dhe *ekonomi familjare* ose *ekonomi shtëpiake.* Me problemin e definicionit dhe të përkufizimit të kategorive familje dhe ekonomi familjare (ekonomi shtëpiake) janë marrë shkencëtarë profilesh të ndryshme, siç janë sociologët, etnologët, linguistët, demografët, juristët, historianët etj. Në shumë fjalorë hasim gjithashtu shpjegime të ndryshme të këtyre koncepteve, ndërsa edhe për nevoja të regjistrimeve të popullsisë janë dhënë definicione përkatëse për këto njësi biosociale dhe ekonomike. Këtu do t'i përmendim vetëm disa definicione të këtyre nocioneve sa për të bërë dallimin e qartë midis tyre.

Ndër definicionet e shumta të familjes vërehet se ajo përkufizohet si *lidhje gjaku* apo *lidhje afrie.* Në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" familja definohet si "Njësi e vogël e organizimit të jetës shoqërore, që përbëhet nga burri, gruaja, fëmijët ose edhe nga njerëz të tjerë të afërt, të cilët jetojnë e banojnë bashkë".[1] I afërt me definicionin e këtij "Fjalori" është edhe ai i përqafuar në Fjalorin e parë enciklopedik demografik shqiptar, ku thuhej: "Familja - njësi shoqërore biologjike që përfshin persona, të cilët jetojnë së bashku, që karakterizohen nga marrëdhënie gjinie midis tyre dhe karakteristika të tjera, si buxheti dhe banesa e përbashkët".[2] Ndërsa në "Fjalorin enciklopedik shqiptar" familja përcaktohej si "Grup i vogël personash, të cilët me anë të martesës, gjinisë ose birësimit, janë të lidhur midis tyre me marrëdhënie psikologjike, morale e juridike dhe jetojnë në një ekonomi të përbashkët".[3] Në "Fjalorin shumëgjuhësh demografik të OKB-së" për familjen thuhet: "Në shoqëritë (bashkësitë) e tipit evropian, familja kryesisht bazohet, në një anë, në lidhje me bashkëshortët dhe, në anën tjetër, në lidhje afrie të prindërve - babait e nënës dhe fëmijëve të tyre - djemve dhe vajzave".[4] Sipas një enciklopedie të përgjithshme, "Familja është formë shoqërore e bashkësisë natyrore të

---

[1] *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe,* Tiranë, 1980, f. 449.

[2] F. Sheri, *Fjalori enciklopedik i demografisë,* Botimet enciklopedike, Tiranë, 1997, f. 77.

[3] *Fjalori Enciklopedik Shqiptar,* Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1985, f. 255.

[4] UN: *Višejezički demografski rečnik,* Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1971, f. 7.

njerëzve, pjesëtarë të gjinive të ndryshme (martesa) dhe brezave të ndryshme (prindërit dhe fëmijët). Gjatë historisë ajo i ka ndryshuar format, varësisht nga ndryshimet në bazat e saj: formës së martesës dhe mënyrës së prodhimit".[5] Ndërkaq, në regjistrime të popullsisë konsiderohet se "Familja është bashkësi familjare, e cila përbëhet vetëm nga bashkëshortët apo nga prindërit (të dy apo njëri) dhe nga fëmijët e tyre që nuk janë të martuar".[6] Edhe definicionet e tjera për familjen, para së gjithash ato sociologjike dhe linguistike, nuk dallojnë shumë nga këto të mësipërmet.[7] Edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit e gjejmë një përcaktim të familjes, ku thuhet: "Familja âsht nji të mbledhun gjymtyrësh, të cillët gjallisin nen nji kulm, qellimi të cillvet âsht të shtuemt e gjindes nper mjet të martesës, të mkambunt e tyne kah zhdrivillimi i shtatit e kah zhvillimi i mendes e i shises".[8] Mirëpo, është e qartë se ky definicion nuk është i plotë, sepse nuk del nga terreni, nga populli. Gjeçovi atë e merr nga një autor i huaj, nga Abate Felice (Filosofia del Diritto, no 2762).

Ekonomia familjare[9] është nocion shumë më i gjerë se familja. "Ekonomia familjare, si njësi e ndërlikuar statistike, me rëndësi sociologjiko-ekonomike, paraqet bashkësinë e personave të cilët jetojnë në të njëjtën shtëpi ose banesë dhe të cilët ushqehen bashkërisht".[10] Ndërsa në regjistrimet e popullsisë të viteve 1953-1981 në ish-Jugosllavi, që përputheshin me metodologjinë dhe koncepcionet bashkëkohore, ekonomia familjare konceptohej si "Familje apo bashkësi tjetër e personave, për të cilën regjistruesit iu është deklaruar se banojnë së bashku dhe së bashku i shpenzojnë të ardhurat e veta për plotësimin e nevojave themelore jetësore (banimi, ushqimi e të tjera), pa marrë parasysh se a gjenden gjithnjë të gjithë anëtarët në vendim ku është vendosur ekonomia shtëpiake apo ndonjëri prej tyre qëndron një kohë të gjatë në vendbanimin tjetër për shkak të punës, shkollimit apo për shkaqe të tjera".[11] Ekonomi familjare (shtëpiake) e veçantë,

---

[5] *Mala enciklopedija Prosveta (Opšta enciklopedija),* Treće izdanje, 2, Jugoslavija, K-P, Beograd, 1978, ff. 881-882.

[6] *Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave më 1981, Ekonomitë shtëpiake, Buletini 21,* Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1983, f. 7; shih gjithashtu: *Popis stanovništva i stanova 1971. Domaćinstva i porodice,* knj. V, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1974, f. XXIV.

[7] Për definicionet e familjes shih më gjerë: R. First, *Seoska porodica danas - kontinuitet ili promjene,* Institut za društvena istraživanja Sveučilista u Zagrebu, Zagreb, 1981, ff. 26-29.

[8] *Kanuni i Lekë Dukagjinit,* Përmbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1972, Paragrafi 18, f. 7.

[9] Për nevoja të regjistrimit të popullsisë të vitit 1981 në vend të nocionit ekonomi familjare është përdorur termi *ekonomi shtëpiake.*

[10] UN: *Višejezički demografski rečnik,* f. 6.

[11] *Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave më 1981, Ekonomitë shtëpiake, Buletini 21,* f. 7.

sipas statistikës, "është konsideruar edhe secili person i cili në vendin e regjistrimit jeton vetëm dhe i cili nuk ka ekonomi shtëpiake të veten në vendin tjetër (ekonomia shtëpiake vetanake), pa marrë parasysh se a jeton në banesë të veçantë apo të ndarë, si qiraxhi apo në hotelin e beqarëve etj., si dhe a banon në të njëjtën dhomë me ndonjë beqar apo me anëtarët e ekonomisë shtëpiake - qiradhënësit, por me ta nuk i shpenzon së bashku të ardhurat e veta. Prandaj, në regjistrim janë përfshirë të gjitha ekonomitë shtëpiake (familjare dhe vetmitare) me qëndrim të përhershëm në territorin e regjistrimit, duke i përfshirë edhe ato të cilat në momentin e regjistrimit janë gjendur me qëndrim të përkohshëm në botën e jashtme".[12]

2. Ndryshimet në numrin dhe përbërjen e ekonomive familjare

Një ndër karakteristikat e veçanta të zhvillimit demografik dhe shoqëror të Kosovës janë edhe numri, madhësia mesatare dhe përbërja e ekonomive familjare, të cilat janë të kushtëzuara nga ndikimi i faktorëve ekonomikë, socialë, demografikë etj. Krahas ndryshimeve të përgjithshme që kanë ndodhur në Kosovë në gjysmën e dytë të shekullit XX, para së gjithash transformimi i strukturës ekonomike të popullsisë, transferi i popullsisë bujqësore në veprimtari jobujqësore, migrimet fshat-qytet, ngritja e nivelit kulturo-arsimor, tendenca drejt individualizimit të jetës etj., kanë evoluuar edhe numri dhe ndryshimet strukturale të ekonomive familjare. Në gjithë periudhën e vështruar në Kosovë shënohet një rritje mjaft e shpejtë e numrit të ekonomive familjare (për 150,9%), e cila megjithatë është nën rritjen e numrit të popullsisë së përgjithshme (166,9%). Mirëpo, proceset jo aq të shpejta të deagrarizimit, të urbanizimit dhe të mobilitetit territorial kanë bërë që ndryshimet në veçoritë strukturale të ekonomive familjare të mos jenë në përputhje me ndryshimet në vëllimin e tyre.

Edhe pse në regjistrimet e popullsisë të gjysmës së dytë të shekullit XX nuk evidencohej numri i familjeve në një ekonomi familjare, si dhe ekonomitë familjare me shumë anëtarë (familjet e mëdha), megjithatë numri dhe përqindja e madhe e ekonomive familjare me tetë e më tepër anëtarë dëshmon se në Kosovë deri në fund të këtij shekulli ekzistonin, por edhe sot e gjithë ditën ekzistojnë bashkësi familjare me shumë anëtarë, që njihen si *familje të mëdha,* ndonëse procesi i dekompozimit të tyre është intensiv.

[12] *Po aty,* f. 7.

Tabela 1. Lëvizja e numrit dhe madhësisë mesatare të ekonomive familjare në Kosovë në periudhën 1948-1991[13]

Viti	Rritja			Madhësia mesatare	
	Numri	Periudha	%		
1948	115.241	1948/53	10,2	1948	6,4
1953	126.956	1953/61	20,2	1953	6,4
1961	152.559	1961/71	23,3	1961	6,3
1971	188.169	1971/81	21,7	1971	6,6
1981	228.884	1981/91	26,4	1981	6,9
1991	289.246	1948/91	150,9	1991	6,8

Kosova është një nga territoret që, shikuar nga perspektiva evropiane, ka jo vetëm shumë anëtarë për një ekonomi familjare, por madhësia mesatare e tyre ka shënuar edhe rritje. Në anën tjetër, deri në vitin 1981 përqindja e ekonomive familjare me 8 e më shumë anëtarë gjithashtu është rritur si sa i përket numrit relativ, ashtu edhe numrit absolut. Në mungesë të të dhënave për vitin 1991 për strukturën e ekonomive familjare dhe në pamundësi që të bënin vlerësimin e tyre, do të ndalemi në gjendjen deri në vitin 1981, e cila, megjithatë, flet për disa ndryshime dhe procese interesante. Në vitin 1961 p. sh. Kosova kishte 43.707 ose 28,7% të ekonomive familjare me 8 e më tepër anëtarë, ndërsa në vitin 1981 ky numër rritet në 80.823 ose 35,3% nga numri i përgjithshëm i tyre, që tregon se ekziston tipi i familjeve të zgjeruara, ku shumica dërmuese jeton në pjesët rurale, të cilat për nga përbërja, organizimi dhe funksioni i përkasin familjeve të mëdha. Këto grupe shoqërore deri vonë në fshatin shqiptar ishin insitucioni më karakteristik dhe dominant i organizimit shoqëror të shqiptarëve. Në to, si njësi e fortë dhe autonome ekonomike në mjedisin rural, plotësoheshin pothuajse të gjitha nevojat e përditshme jetësore të të gjithë anëtarëve, meqenëse, në mungesë të shoqërizimit të jetës e të punës, kryheshin të gjitha funksionet ekonomike dhe shoqërore.

Pjesëmarrja e vogël e ekonomive familjare me 1-3 anëtarë dhe zvogëlimi i mëtejmë i tyre është një dëshmi se, me gjithë transformimet e dukshme socioekonomike e të tjera, proceset e modernizimit të shoqërisë kosovare nuk kanë qenë të fuqishme për të kushtëzuar ndryshime rrënjësore në përbërjen e ekonomive familjare përmes shthurjes intensive të ekonomive të zgjeruara tradicionale familjare në të ashtuquajtura familje nukleare, siç ka ndodhur në vendet e tjera të zhvilluara evropiane, por edhe në hapësirat

[13] Burimi: Për vitet 1948-1981 regjistrimet zyrtare të popullsisë; për vitin 1991 vlerësimi.

ballkanike. Megjithatë, rritja e numrit absolut të ekonomive të vogla familjare, veçanërisht në vendbanimet urbane e të urbanizuara të Kosovës paralajmëron zgjerimin e familjeve industriale, nukleare, të përbëra nga çifti bashkëshortor dhe fëmijët e tyre; në rritje është edhe numri absolut i ekonomive vetanake familjare.

Tabela 2. Përbërja e ekonomive familjare të Kosovës sipas regjistrimeve 1948-1991[14]

Viti	Përqindja me nga							
	1	2	3	4	5	6	7	8+
1948	5,9	7,4	9,8	11,9	13,2	12,4	10,0	28,9
1961	6,4	7,2	8,9	11,9	13,2	12,2	10,9	28,7
1971	4,7	6,8	8,9	11,9	12,2	12,5	11,1	31,9
1981	3,6	5,8	7,0	11,7	12,6	12,3	10,8	35,3
1991	3,8	6,5	7,3	11,9	12,5	12,9	10,4	35,6

Deri në vitin 1981, qoftë sa i përket madhësisë mesatare, apo edhe përbërjes së ekonomive familjare, dallimet ishin të mëdha midis vendbanimeve rurale dhe atyre urbane. Në vitin 1981, në të parat përqindja e ekonomive të vogla familjare me 1-3 anëtarë ishte 12,6%, ndërsa në të dytat 21,9%. Dallimet midis tyre me 8 e më shumë anëtarë ishin edhe më të mëdha (45,3%:20,5%). Në vendbanimet rurale vërehet një dukuri interesante: në ekonomitë familjare që kishin pronë bujqësore, përqindja me 8 e më tepër anëtarë ishte edhe më e lartë (49,7%), ndërsa te ato që nuk kishin pronë bujqësore, por jetonin në fshat, përqindja e tyre në numrin e përgjithshëm ishte më e ulët (26,5%). Në këtë vit 61.727 ekonomi familjare në fshat kishin 8 e më shumë anëtarë, të cilat përbënin 711.720 anëtarë, me madhësi mesatare 11,5 anëtarë. Por, edhe në qytet, edhe pse gjendja ishte krejtësisht ndryshe nga ajo në fshat, megjithatë 19.096 ekonomi familjare kishin më shumë se 8 veta, që përbënin gjithsej 190.220 veta (mesatarja 9,9 anëtarë), ndërkaq 37,4% të ekonomive familjare që posedonin pronë bujqësore, por jetonin në qytet, kishin 8 e më shumë anëtarë.

Në saje të ndryshimeve shoqërore-ekonomike pas viteve të 60-ta të shekullit të kaluar dhe veçanërisht pas punësimit në botën e jashtme pas viteve të 70-ta janë bërë ndryshime të rëndësishme në strukturën sociale-ekonomike të popullsisë dhe të ekonomive familjare, ku vazhdimisht është rritur pjesëmarrja e ekonomive familjare me burime të përziera dhe jobujqësore të

[14] Për vitin 1991 vlerësimi.

jetës. Me kalimin e popullsisë bujqësore në veprimtari jobujqësore dhe të popullsisë fshatare në qytete, si dhe me rritjen e numrit të të punësuarve jashtë bujqësisë, por të cilët jetonin në fshat, procesi i mobilitetit social (vertikal) në fshatin kosovar ishte intensifikuar shumë pas viteve të 60-ta të shekullit XX. Me zvogëlimin e pronave tokësore dhe rritjen e numrit absolut të popullsisë agrare, pas viteve të 60-ta ndjehej nevojë e madhe për burime plotësuese ekzistenciale, e cila në një masë u plotësua përmes punësimit në Kosovë dhe, më shumë, jashtë saj. Duke i kombinuar të ardhurat nga ekonomia bujqësore, ku punonin anëtarët e tjerë të familjes dhe duke siguruar të ardhurat e tjera nga jobujqësia, ku punonte së paku një anëtar i familjes, përmbusheshin nevojat jetësore. Në anën tjetër, hapen mundësi të reja për rritjen dhe mekanizimin e prodhimtarisë bujqësore në fshat, veçanërisht nga mjetet e fituara në botën e jashtme, por njëkohësisht edhe për kalimin definitiv në veprimtari jobujqësore dhe në qytet. *Ekzistimi i ekonomive familjare me burime të përziera të jetës ishte edhe fazë përgatitore për transformim dhe emigrim definitiv.*

Tabela 3. Përbërja e ekonomive familjare në vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës sipas regjistrimit të vitit 1981[15]

Vend-banimi	Madhësia mesatare	Përbërja me nga							
		1	2	3	4	5	6	7	8+
Fshati	7,9	2,7	4,8	5,1	8,0	10,2	11,6	11,5	45,3
Qyteti	5,5	4,9	7,3	9,7	17,0	16,0	13,3	9,9	20,5

Tabela 4. Struktura e ekonomive familjare të Kosovës sipas burimeve të të ardhurave, sipas regjistrimeve 1961-1981[16]

Tipi i ekonomisë familjare	1961	1971	1981
Bujqësore	43,7	34,6	14,9
Të përziera	24,9	16,3	13,4
Jobujqësore	31,4	49,1	71,7
Gjithsej	100,0	100,0	100,0

[15] *Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave në vitin 1981,* Rezultatet përfundimtare, Buletini 17, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1982, f. 38.

[16] H. Islami, *Fshati i Kosovës (Kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural),* Rilindja, Prishtinë, 1985, f. 195; *Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991. Stanovništvo 47,* SZS, CDI, IDN, Beograd, 1995, f. 281.

Format e dyfishta të jetës i mundësonte dhe i favorizonte zhvillimi i aktiviteteve sekondare dhe terciaro-kuartare në rrethinë dhe zhvillimi i infrastrukturës komunikative, duke lëvizur fuqia punëtore gjatë ditës prej vendit të banimit në vendin e punës dhe anasjelltas. Vepronin edhe faktorë të tjerë të ruajtjes dhe rritjes së ekonomive të përziera familjare, si p. sh. motivet socialo-emocionale dhe psikologjike të lidhjes për ekonomi bujqësore (dëshira që të ruhej me çdo kusht pasuria agrare nga frika se po të pushohej nga puna mbajtësi i familjes, bashkësia familjare do të mbetej pa burime ekzistenciale, gjë që u dëshmua pas përjashtimit të punëtorëve shqiptarë nga puna, etj.). Këto shtresa sociale, me dy profesione dhe dy burime sollën edhe një varg ndryshimesh të tjera si në familje dhe në ekonomi familjare, ashtu edhe në vetë rajonin rural: shpejtuan procesin e deagrarizimit, bartën shumë risi materiale e shpirtërore, duke ndryshuar shumëçka në strukturën tradicionale.

3. Ekzistimi i familjeve të mëdha

Popullatën kosovare dhe në veçanti shqiptarët si shumicë i ndoqi me shekuj prapambeturia e përgjithshme ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Në rrethana të tilla u formua një kompleks i fortë i mënyrës së jetesës tradicionale, i cili u manifestua në krijimin e një sistemi të tërë të institucioneve të jetës sociale, siç janë tradita, tarshëgimia e paragjykimeve, botëkuptimet religjioze, doket e shprehitë e ndryshme kolektive, normat specifike morale etj. Ky sistem i jetës shoqërore ishte i bazuar para së gjithash në ekonominë e mbyllur agrare, si dhe në strukturën e raporteve tradicionale dhe në etikën patriarkale. Këto forma të jetës shoqërore, për shkak të krijimit e të ekzistimit të tyre në një periudhë të gjatë të civilizimit paraindustrial dhe të transferit të tyre nga një brez në tjetrin, barten edhe në kushtet e reja të zhvillimit të jetës urbano-industriale dhe dalin natyrisht si pengesë në shumë sfera të jetës socialo-kulturore si në bashkësinë rurale, ashtu edhe në bashkësinë urbane.

Ky kompleks i rrethanave karakteristike deri vonë ushtroi ndikim të fuqishëm në rregullimin e jetës shoqërore dhe në evolucionin, organizimin social, funksionin dhe strukturën e familjes si njësi biologjiko-sociale dhe të ekonomive familjare si kategori biosocio-ekonomike. Në fshatin tradicional kosovar dhe në shoqërinë shqiptare në përgjithësi dominonte rregullimi fisnor dhe i lidhjeve të gjakut nën ndikimin e të drejtës zakonore, që zbatohej të shumtën në frymën e normave të drejtës së pashkruar të periudhës mesjetare, të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Sipas normave dhe instituteve të kësaj të drejte rregullohej i tërë organizimi dhe jeta familjare e shoqërore e shqiptarëve. Deri në përfundim të shekullit XX, por pak apo shumë edhe sot në territorin fshatar

kosovar, disa raporte të organizimit dhe të jetës shoqërore ende rregullohen sipas normave të këtij kodeksi.[17] Ishin rigoroze normat morale, botëkuptimet religjioze dhe suazat e jetës patriarkale. Organizimi familjar karakterizohej me lidhje të ngushta të gjakut dhe të afrisë. Sigurinë e tij sociale dhe mbrojtëse fshatari e shihte vetëm në suaza të familjes, të afrisë dhe të fshatit. Dominonte familja e tipit të zgjeruar, me shumë anëtarë.

Forma dhe institucioni më karakteristik dhe dominant i organizimit shoqëror të shqiptarëve ishte *familja e madhe.*[18] Por familje të mëdha në fshatin e Kosovës ka pasur jo vetëm te shqiptarët, por edhe te serbët deri në vitet e 60-ta të shekullit XX, veçanërisht në Siriniq, Sreckë dhe në disa pjesë të tjera të rajonit të Dukagjinit.[19] Familja e madhe ka ekzistuar deri vonë në shekullin XX te të gjithë sllavët e jugut.[20] Veçoritë themelore të krijimit dhe të ruajtjes së familjeve të mëdha dhe të zbatimit të normave dokësore në këto dhe në gjithë familjen shqiptare ishin autarkia ekonomike agraro-rurale, fragmentimi i pronave, dendësia e madhe agrare dhe izolimi sociodemografik.[21] Strukturës së tillë të prodhimit material dhe organizimit patriarkal

---

[17] "Në Kosovë si rajon më i pazhvilluar në Jugosllavi, akoma janë ruajtur mbeturina të jetës patriarkale dhe të konzervativizmit në vetëdijën e disa individëve, sidomos nëpër fshatra. Andaj mbetën të gjalla edhe gjurma të një pjese të Kanunit të Lekë Dukagjinit, edhe pse bëhen gjithnjë më të zbehta" (*Kanuni i Lekë Dukagjinit,* Përmbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi, Prishtinë, 1972, f. LXXXIII e parathënies së dr. Syrja Pupovcit).

[18] Studiuesi Aleks Luarasi në studimin e tij të vlefshëm "Marrëdhëniet familjare", duke iu referuar literaturës juridike, familjen e madhe e definon sa vijon: "Familje të madhe kjo literaturë quan atë familje që përbëhet nga shumë vëllezër, me gratë e fëmijët e tyre dhe nga disa breza, nën drejtimin e të zotit të shtëpisë. Sipas rastit, ky mund të ishte i paralinduri i anëtarëve të familjes, më i vjetri në moshë ose njëri prej bijve të tij a cilido tjetër prej tyre i ngarkuar me këtë detyrë". Ndërsa, kjo literaturë "Familje të vogël quan atë familje, që i zoti i shtëpisë është njikohësisht edhe i ati i fëmijve, qofshin këta edhe të martuar" (A. Luarasi, *Marrëdhëniet familjare,* Luarasi, Tiranë, 2001, f. 41).

[19] Shih: M. Radovanović, "Stanovništvo Prizrenskog podgora", *Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, IX*, Priština, 1964, f. 408; Gj. Rapi, "O pojedinim aspektima starog i novog u kosovskom selu", *Sociološki pregled,* br. 3, Beograd, 1978, f. 127.

[20] Familjet e mëdha ishin ruajtur deri në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX edhe te popujt e tjerë ballkanikë, te sllavët e jugut, duke i përfshirë edhe bullgarët. Në territoret jugosllave, organizimi i tillë i jetës familjare ishte i përqafuar si normë (V. St. Erlich, *Jugoslavenska porodica u transformaciji. Studija u tri stotine sela,* Liber, Zagreb, 1971, ff. 343-362).

[21] "Në esencë mbeturinat e ekonomisë së mbyllur, si dhe pronësia private mbi ngastrat e vogla të tokës nëpër fshatra, sidomos në Kosovë, janë në instancën e fundit pikëmbështetje e mentalitetit të pronarit të imët, konzervativizmit dhe zbatimit të normave të Kanunit të Lekë Dukagjinit" (*Kanuni i Lekë Dukagjinit,* Përmbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi, Prishtinë, 1972, f. LXXXIII e parathënies së dr. Syrja Pupovcit).

social i përgjigjej tipi i zgjeruar i familjes, sepse familjet me shumë anëtarë kishin numër më të madh të fuqisë punëtore dhe disiplinë të fortë të punës, fond më të madh të tokës së punueshme dhe të asaj bujqësore, numër të konsiderueshëm të kafshëve, inventar të pasur agrar, ndarje të gjerë të punës etj. Përveç kësaj, familjet e këtij tipi dhe veçanërisht familjet e mëdha kishin edhe prestigj më të madh shoqëror në mjedisin tradicional fshatar të Kosovës e më gjerë. Ato edhe çmoheshin më tepër nga banorët e tjerë të bashkësisë rurale si shtëpi e madhe, me autoritet, disiplinë të punës etj.[22]

Në familjet dhe ekonomitë e tilla familjare dhe veçanërisht në familjen e madhe si njësi e fortë dhe autonome ekonomike në mjedisin rural plotësoheshin pothuajse të gjitha nevojat e përditshme jetësore të të gjithë anëtarëve. Në kuadër të këtyre bashkësive familjare, në mungesë të shoqërorizimit të jetës e të punës, kryheshin të gjitha funksionet shoqërore dhe ekonomike, duke u nisur nga funksioni i përtëritjes biologjike, funksioni prodhues e konsumues i popullsisë e deri te funksioni edukativ, mbrojtës, shëndetësor etj. Në familje formohej edhe personaliteti i çdo anëtari të saj dhe në të përgatiteshin të gjithë anëtarët për jetë të mëtejme në shoqëri. Në familjet e mëdha ndarja e punës ishte shumë më e gjerë se në familjet me pak anëtarë, mirëpo edhe aty dominonte ndarja fiziologjike e punës: punët ndaheshin midis femrave dhe meshkujve, në një anë, dhe fëmijëve dhe të rriturve të të dy gjinive, në anën tjetër. Anëtarët e rritur të gjinisë mashkullore i kryenin punët e fushës dhe punët rreth bagëtisë, por disa angazhoheshin edhe jashtë ekonomisë bujqësore. Gratë kujdeseshin për fëmijët e tyre dhe i kryenin punët e shtëpisë, të cilat kërkonin angazhim maksimal (kujdesi për fëmijë, përgatitja e ushqimit, fshirja, larja etj.), ndërsa vajzat u ndihmonin nënave në punët e amvisnisë, kujdeseshin për vëllezërit dhe motrat më të vogla dhe përgatiteshin për nusëri (çejzi, paja). Në kryerjen e detyrave të femrave ekzistonte edhe rendi i caktuar: një ose dy gra nga disa ditë mbanin rendin e maxhes, kurse femrat e tjera kujdeseshin për prodhimet e kafshëve (bylmeti) dhe kryenin punë të tjera në oborrin ekonomik, kryesisht për nevoja të familjes. Disa prej tyre, në disa rajone fshatare, punonin edhe në ekonomi bujqësore, në fushë. Fëmijët e gjinisë mashkullore i ruanin kafshët dhe bënin punë të tjera të vogla e të lehta në ekonominë bujqësore, varësisht nga mosha e tyre. Vetë struktura klasike agraro-blegtorale, me mënyrë homogjene të jetës, punët e rënda dhe angazhimi ekstensiv në jetën ekonomike kërkonte numër të madh të anëtarëve dhe të

[22] M. Krasniqi, "Šiptarska porodična zadruga u Kosovsko-Metohijskoj Oblasti", *Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, III*, Priština, 1958, ff. 107-127; I njëjti, "Organizimi i jetës shoqnore në nji familje të madhe në rrethin e Pejës", *Përparimi,* nr. 5, Prishtinë, 1959, ff. 303-313.

fëmijëve,[23] sidomos të gjinisë mashkullore, ndaj të cilëve edhe kujdesi ishte më i madh. Familjet pa fëmijë jo vetëm që konsideroheshin të shkreta, pa trashëgimtarë, por edhe pa krah pune dhe pa perspektivë sociale. Norma e lartë e lindshmërisë dhe numri i madh i fëmijëve përkundër vdekshmërisë së lartë ishte faktor i rëndësishëm demografik në rritjen e vëllimit të familjes dhe në krijimin e shpejtë të familjes së madhe. Katër familje të ngushta p. sh. mund të përbënin një familje të madhe deri 30 anëtarë. Sipas regjistrimit të vitit 1971 në Kosovë rreth 9.000 ekonomi familjare kishin më shumë se 15 anëtarë, ndërsa rreth 2.800 sish kishin më se 20 anëtarë. Prej tyre në fshat janë evidencuar rreth 93% të ekonomive familjare me më se 15 anëtarë, kurse rreth 98% të këtyre grupeve shoqërore kishin më tepër se 20 anëtarë. Gjithsej rreth 28.200 ekonomi familjare kishin midis 10 e 20 anëtarë[24]. Në gjithsej 228.884 ekonomi familjare, sa kishte Kosova në vitin 1981, jetonin 317.313 familje të ngushta (çiftë bashkëshortorësh pa fëmijë, me fëmijë dhe me njërin nga prindërit), ndërsa në fshat në 136.036 ekonomi familjare jetonin 207.773 familje të tilla të ngushta.[25]

Në krye të bashkësive të tilla familjare gjendej *i zoti i shtëpisë*, i cili për nga mosha zakonisht ishte më i vjetri, më me eksperiencë dhe me aftësi më të madhe organizative, ndërsa për nga gjinia rregullisht ishte mashkull. I zoti i shtëpisë jo vetëm në familje të madhe, por përgjithësisht në familjen patriarkale, pa marrë parasysh madhësinë, kishte autonomi të gjerë në udhëheqje. Në çështjet kyçe të ekzistimit e të zhvillimit të familjes ai i konsultonte edhe anëtarët e tjerë të familjes (jo të gjithë), sidomos rreth shitjes apo blerjes së tokës (gati rregullisht blerjes), ngritjes së shtëpisë së re apo objekteve të tjera ekonomike, pastaj rreth martesave, dasmave, shkuarjes së ndonjë anëtari jashtë familjes etj. Mirëpo, fjala e tij, megjithatë, ishte me peshë të madhe, në mos edhe vendimtare. Në shumë fshatra, përkundër ndryshimeve të shumta në pjesën e dytë të shekullit XX dhe zbehjes së autoritetit të zotit të shtëpisë, deri vonë vërehej pozita e tij e fortë në strukturën qeverisëse mbi të gjitha të mirat materiale dhe në sferat e tjera të jetës e të punës. I zoti i shtëpisë

[23] "Në fazën e ekonomisë natyrale, kërkesa për njerëz është e madhe, ndërsa tokë ka me bollëk.; ajo është gati e pavlefshme, por punëtorët janë të dobishëm. Në këtë shkallë të zhvillimit në viset tona nuk ka fare punëtorë me pagë, teknikisht janë primitivë dhe kërkojnë shumë kohë, treg nuk ka, krejt prodhohet në familje të madhe. Vetëm bashkësia me shumë anëtarë mund t'i bëjë ballë natyrës dhe punëve të rënda të përditshme. Çdo anëtar i familjes vlen si fuqi punëtore; çobanët, amviset janë absolutisht të nevojshme" (V. St. Erlich, *Po aty,* f. 267).

[24] *Popis stanovništva i stanova 1971. Domaćinstva i porodice*, knj. V, SZS, Beograd, 1974, f. 38.

[25] *Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave në vitin 1981*, Buletini 17, EKS, Prishtinë, 1982, f. 38.

gjithnjë ishte pronar i pasurisë dhe në emër të tij është evidencuar pasuria dhe është paguar tatimi.

Para 3-4 dhjetëvjetëshave struktura sociale, profesionale dhe arsimore e familjeve të mëdha më tepër ishte bujqësore-blegtorale dhe pa asnjë anëtar që dinte shkrim-lexim (pos ndonjë përjashtimi) e të mos flasim për anëtarët e shkolluar, ndërkaq nga fundi i viteve të 70-ta të shekullit të kaluar, në kushtet e ndryshuara socioekonomike, familjet e mëdha ishin bërë mjaft komplekse sa i përket strukturës sociale dhe arsimore, me ndryshime të shumta në raportet e brendshme midis brezave dhe gjinive. Autoriteti dhe pushteti i udhëheqësit të saj, të zotit të shtëpisë, në udhëheqje gjithnjë zbehej e dobësohej. Nga fundi i shekullit XX p.sh. një ose dy e më tepër anëtarë të familjes së madhe punësohen jashtë ekonomisë familjare shtëpiake dhe jashtë bujqësisë dhe fshatit (migrantët ditorë në Kosovë, punëtorët në viset e ish-Jugosllavisë dhe në botën e jashtme) dhe "kanë anëtarë që dinë jo vetëm shkrim-lexim, por edhe anëtarë të shkolluar, anëtarë të profesioneve të ndryshme, duke u nisur nga punëtorët fizikë dhe nëpunësit e ndryshëm e deri te mësuesit, arsimtarët e profesorët, mjekët, ekonomistët, juristët etj. Por edhe përkundër strukturës së heterogjenizuar ato ende qëndrojnë, që do të thotë se është i konsiderueshëm ndikimi i disa faktorëve. Vetë strukturimi intensiv social i këtij kolektivi familjar paralajmëron dekompozimin e shpejtuar të tij në fshatin tonë".[26]

[26] H. Islami, *Fshati i Kosovës (Kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural),* Prishtinë, 1985, f. 189.

Pjesa e katërt

SHQIPTARËT NË TROJET E TJERA ETNIKE

I. KARAKTERISTIKAT THEMELORE DEMOGRAFIKE TË SHQIPTARËVE NË TROJET E TJERA ETNIKE

1. Shqiptarët në Maqedoni

Shqiptarët në Maqedoni gjatë gjithë historisë së tyre ishin pjesë përbërëse e tërësisë etnike, duke marrë pjesë aktive në të gjitha proceset dhe lëvizjet kombëtare, politike dhe ekonomike të kombit shqiptar. Ata këtu sot jetojnë në një numër të madh dhe kanë një shtrirje territorialisht kompakte. Numrin e vërtetë të tyre pushteti maqedon gjithnjë e ka fshehur, duke i falsifikuar të dhënat në të gjitha regjistrimet zyrtare të popullsisë. Edhe në regjistrimin e vitit 1994, të bërë kinse nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, ligji maqedon mbi regjistrimin e popullsisë nuk mundësoi përfshirjen e plotë të shqiptarëve, ku vlerësohej se rreth 30% të shqiptarëve mbetën pa u regjistruar.[1]

Shqiptarët në Maqedoni sot shtrihen në 355 vendbanime, ku pjesa dërmuese janë të karakterit rural dhe atë kryesisht në Maqedoninë Perëndimore. Përveç në anën lindore, në të gjitha anët e tjera kufizohen me rajonet e banuara me shqiptarë: me Shqipërinë, Kosovën dhe komunën e Preshevës, ku shumica dërmuese janë shqiptarë. Më tepër shqiptarë në Maqedoni jetojnë në rajonin e Shkupit, pastaj në Tetovë me rrethinë, ku dominojnë (mbi 70%), në Gostivar me rrethinë (mbi 65%), në Dibër me rrethinë (mbi 50%), në rrethinat e Strugës dhe të Kërçovës (mbi 50%), të Kumanovës (rreth 40%) etj., ndërsa në numër më të vogël jetojnë në rrethinat e Manastirit, të Ohrit, të Resnës, të Krushevës, të Velesit etj. Në zonën e qytetit të Shkupit ose në bashkësinë e komunave të Shkupit jetojnë rreth 200.000 shqiptarë, ndonëse statistika zyrtare i paraqet më pak në saje të ndarjeve territoriale-administrative që i konvenojnë pushtetit maqedon (më 1981 86.804 ose 22,5%, më 1991 99.225 ose 17.6% dhe më pak sipas regjistrimit të vitit 2002, 71.483 ose 15,2% në popullsinë e gjithmbarshme).[2] Shkupi deri vonë, pas Tiranës, njihej si qendra e dytë urbane me numër të shqiptarëve, ndërsa sot, sipas instancave zyrtare maqedonase, vjen jo vetëm pas Prishtinës, por edhe pas Prizrenit dhe Pejës.

---

[1] H. Islami, *Rrjedha demografike shqiptare,* Dukagjini, Pejë, 1994, f. 135.

[2] Regjistrimi i vitit 2002 është realizuar në bazë të ndarjes administrativo-territoriale të vitit 1996, që ishte më e dëmshmja për shqiptarët, sepse disa vendbanime ku dominonte popullata shqiptare, që i takonin zonës urbane të Shkupit, i lente jashtë saj.

Edhe në fillim të shekullit XX Shkupi kishte shumë shqiptarë, madje mbi gjysma e popullsisë ishte shqiptare. Gjeografi i parë shqiptar nga Kosova, prof. Ahmet Gashi, duke iu referuar një libri të Institutit Kartografik të Sofjes të vitit 1903, që përmban një statistikë të plotë të vilajeteve të Selanikut, të Kosovës e të Manastirit, thekson se nga gjithsej 10.355 shtëpi sa kishte kazaja e Shkupit, 5.941 ose 57,3% ishin shtëpi shqiptare (të tjerat ishin bullgare e serbe dhe pak turke, vllahe e çifute), ndërkaq nga 4.474 shtëpitë e qytetit të Shkupit, 2.336 ose 52,8% ishin shqiptare (të tjerat ishin cigane, çifute dhe vllahe).[3] Këto të dhëna për qytetin e Shkupit pothuajse përputhen me rezultatet e statistikës turke të viteve 1908-1909, sipas të cilave shqiptarët përbënin 55,5% të popullsisë së gjithmbarshme të qytetit.[4] Ndërsa menjëherë pas Luftës II Botërore, përkatësisht në vitin 1948 shqiptarët përbënin 1/4 e popullsisë së Shkupit. Më vonë, përbërja etnike e qytetit u ndërrua në saje të ardhjes më masive të maqedonasve në të nga viset e tjera të Maqedonisë, veçanërisht pas tërmetit të vitit 1963. Në përgjithësi është rritur përqindja e popullsisë maqedone në qytete pas Luftës II Botërore; niveli i urbanizimit të saj në vitin 1991 ishte rreth 60%. Ndër të gjitha komunitetet kombëtare koncentrimi më i vogël në qytete është i shqiptarëve; sipas vlerësimit të vitit 1991 vetëm një e treta e shqiptarëve jetonte në qendrat urbane të Maqedonisë (32,8%).

[3] Monografi e prof. Ahmet Gashit, *Shqipnija- ethnike edhe vërejtjet e shqiptarëve për Shqipninë e robnueme,* Tiranë, 1941, f. 21. Monografia ruhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë; materialin ma dha për shfrytëzim mr. Zija Bylykbashi nga Prishtina, për çka i jam mirënjohës.

[4] *Shqipnia përpara Konferencës së Paqës*, Ble i Parë (dokumenta zyrtarë të paraqitun nga ana e Dërgatës Shqiptare, qysh prej 12 shkurt e deri më 5 qershor 1919, e të botuem nga ana e Qeverriës së Përkohshme), Roma, 1919, f. 39.

Tabela 1. Numri i shqiptarëve në Maqedoni në periudhën 1948-2003 sipas regjistrimeve zyrtare[5]

Viti	Numri	%
1948	197.389	17,1
1953	162.524	12,5
1961	183.108	13,0
1971	279.871	17,0
1981	377.208	19,8
1991[6]	441.987	21,7
1994[7]	441.104	22,7
2003	509.083	25,2

Nuk ka dallime të mëdha midis popullatës shqiptare në Maqedoni dhe asaj në Kosovë dhe trojet e tjera etnike në komponentët e lëvizjes natyrore të popullsisë (nataliteti, mortaliteti, shtimi natyror). Shkalla e natalitetit, p. sh., ishte mjaft e lartë: në vitin 1953 52,7 promilë (Kosova 45,9), më 1961 47,4 (Kosova 46,3), më 1971 39,4 (Kosova 42,3) dhe në vitin 1981 29,5 promilë (Kosova 33,6). Ndërsa norma e mortalitetit sillej midis 9 dhe 6 promilë.[8] Nga niveli i këtyre komponentëve vitalë të popullatës shqiptare dilte një strukturë mjaft e re e popullsisë sipas moshës, sikurse edhe në Kosovë: mosha mesatare në vitin 1981 ishte rreth 24, në vitin 1991 rreth 25 dhe në vitin 2001 rreth 28 vjet.

---

[5] Burimi: Nacionalni *sastav stanovništva po opštinama (Konačni rezultati), Statistčki bilten 1295*, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 12. Regjistrimin e vitit 1991 edhe shqiptarët e Maqedonisë e bojkotuan për arsye të njëjta sikurse shqiptarët e Kosovës, ndërsa vlerësimin për numrin e shqiptarëve të atjeshëm për këtë vit e bëri Enti Statistikor i Maqedonisë (Shih: *Broj i struktura na naselenieto vo republika Makedonija po opštini i nacionalna pripadnost,* Sostojba 31.03.1991. godina, RZS, Skopje, 1991; Popis '94, Podatoci za segašnosta i idninata. Prvi rezultati. Soopštenie 1, Soopštenie 2, RZS, Skopje, 1994; V. Friedman, "Observing the Observers: Language, Ethnicity, and Power in the 1994 Macedonian Census and Beyond", in *Toward Comprehensive Peace in Southeast Europe. Coflict Prevention in the South Balkans,* The Twentieth Century Fund Press, New York, 1996, pp. 90-91; *Statistički godišnik na Republika Makedonija,* Državen zavod za statistika, Skopje, 2003, f. 48).

[6] Vlerësim i Entit Statistikor të Maqedonisë (*Statistički godišnik na Republika Makedonija,* Državen zavod za statistika, Skopje, 2003, f. 48).

[7] Regjistrim i bërë nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, ku, siç vumë në pah, për shkak të ligjit diskriminues mbi regjistrimin, u dëmtuan përsëri shqiptarët.

[8] Burimi: *Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti,* CDI, IDN, Beograd, 1978, ff. 27-31; *Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku*, br. 178, 15. 6. 1983 (Osnovni podaci o natalitetu u SFRJ, 1951-1981).

Trendi i lindshmërisë dhe i rritjes së numrit të popullsisë shqiptare në Maqedoni një kohë relativisht të gjatë ishte bërë faktor shumë shqetësues për qarqet politike dhe kulturore maqedone. Në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar pushteti maqedon nxori disa rezoluta e dekretligje dhe ndërmori një varg masash administrative të tipit indiano-kinez për pengimin e lindjeve të shqiptarëve, por edhe për kufizimin e ardhjeve të tyre në Maqedoni nga viset jashtë saj dhe nga fshati në qytet brenda vetë Maqedonisë. Edhe në nivel të komunave u nxorën vendime dhe dekrete për të ushtruar presion në sferën e lindjes, duke insistuar që familjeve që kishin mbi dy fëmijë t'u kufizohej e drejta për shkollim, punësim, mbrojtje shëndetësore të fëmijëve etj. Për ngushtimin e perspektivës së përgjithshme të shqiptarëve dhe trajtimit të tyre si qytetarë të dorës së dytë dhe si pakicë kombëtare, Maqedonia u bë territor provues për të gjithë shqiptarët në ish-Jugosllavi. Politika shtetërore e Serbisë dhe institucionet shkencore e kulturore të saj gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit XX përpiqeshin që të gjitha metodat e egra të mundshme kundër shqiptarëve në Kosovë dhe në tri komunat në lindje të Kosovës (Presheva, Bujanoci dhe Medvegja) më parë të provoheshin te shqiptarët e Maqedonisë në mënyrë që më lehtë t'i zbatonin pastaj edhe në Kosovë, çfarë ishte p. sh. rasti me reduktimin natalitetin, arsimin në gjuhën shqipe, statusin politik të shqiptarëve etj.

Shqiptarët në Maqedoni kishin një shpërngulje masive, që u reflektua drejtpërdrejt në lëvizjen e numrit të popullsisë së tyre (tabela 1). Si para Luftës II Botërore, ashtu edhe pas saj shumë shqiptarë nga Maqedonia ishin të përfshirë në valët intensive të emigrimit në Turqi, ndonëse të gjitha instancat maqedono-jugosllave i cilësonin si turq. Meqenëse vetëm si turq mund të shpërnguleshin me lehtë në Turqi, në vitet e 50-ta e 60-ta (regjistrimet zyrtare 1953 dhe 1961) filloi deklarimi masiv i shqiptarëve si turq, gjë që vërehej edhe nga rritja ekspansive e numrit të turqve. Në Shkup funksiononin shërbime speciale, të cilat përgatitnin dokumentet e shpërnguljes, pasaportat dhe vizat ("visikat") dhe ndërrimin e përkatësisë kombëtare. Atmosfera në të cilën është zhvilluar procesi i shpërnguljes ishte dramatike, ndërsa shpërngulja la pasoja të shumta në të gjitha sferat e jetës, para së gjithash në shpopullimin e shumë fshatrave që banoheshin nga shqiptarët. Një numër i madh i fshatrave mbeti krejtësisht pa njerëz, ku shumë sipërfaqe të punueshme u shndërruan në kullota dhe lëndina, kurse në qytete pothuajse u zhdukën disa zanate e veprimtari të tjera shërbyese me të cilat merrej popullsia e shpërngulur.[9]

[9] M. Panov, "O nekim posledicama nastalim u vezi sa iseljavanjem Turaka iz SR Makedonije posle drugog svetskog rata", *Zbornik VI Kongresa geografa FNRJ,* Ljubljana, 1962, ff. 353-356.

Edhe pas ndërrimit të raporteve politike në ish-Federatën Jugosllave (1966 e këndej) dhe ndërprerjes së shpërnguljes në Turqi, në Maqedoni vazhdon politika e reduktimit të të drejtave kombëtare e qytetare të shqiptarëve. Për këtë arsye shumë shqiptarë nga Maqedonia nisën të vinin në Kosovë, kryesisht të rinjtë përmes shkollimit. Pasi Kosova fitoi një shkallë të autonomisë dhe nisi të trajtohej si entitet i veçantë në ish-Federatën, u hap Universiteti dhe shumë shkolla të mesme, të cilat për shqiptarët në Maqedoni mungonin, shqiptarët e atjeshëm vinin në Kosovë, veçanërisht në Prishtinë për t'u shkolluar dhe një numër i konsiderueshëm i tyre, pas kryerjes së shkollave dhe fakulteteve, mbetej përgjithmonë në Kosovë, sepse në vendet e lindjes nuk mund të punësoheshin. Nuk ishte numri i vogël edhe i atyre që vinin drejtpërdrejt me familje për të njëjtat arsye. Madje, edhe pas vitit 1981, kur në Kosovë gjendja ishte mjaft e nderë, pozita e shqiptarëve në Maqedoni ishte edhe më e rëndë, prandaj shumë familje dhe individë, përmes lidhjeve tashmë të krijuara miqësore e familjare, gjenin strehim dhe punë në Kosovë.

Një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve nga Maqedonia, duke mos pasur kurrfarë mundësie që të punësohej në vendlindje, merr rrugën e mërgimit për në viset e tjera të ish-Jugosllavisë si fuqi punëtore dhe si kurbetçinj dhe më masivisht për në Evropë. Sa i përket shpërnguljes dukuria më brengosëse ishte emigrimi i shqiptarëve përtej oqeanit, në SHBA, Kanada dhe Australi. Ky emigrim, si gjithmonë nisi i përkohshëm, por gradualisht u shndërrua në emigrim pa kthim. Shumë familje i kanë mbyllur me vite të tëra shtëpitë e banimit, ndërsa toka ka mbetur djerrë.

Që nga paraqitja e pluralizmit politik në ish-Jugosllavi edhe shqiptarët e Maqedonisë formuan partitë politike rreth të cilave u tubuan dhe i artikuluan kërkesat e tyre për barazi në të gjitha rrafshet. Gjithnjë participuan në jetën institucionale, në Parlament dhe në Qeveri. Pas konfliktit të armatosur në vitin 2001 pasoi Marrëveshja e Ohrit, përmes së cilës duhet t'i realizojnë të drejtat qytetare dhe kombëtare. Lufta politike e shqiptarëve për pozitën e tyre konstitutive vazhdon. Shqiptarët e Maqedonisë u treguan shumë solidarë, duke i ndihmuar shqiptarët e Kosovës me para, ushqim, veshmbathje gjatë gjithë viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, pastaj në luftën e armatosur të viteve 1998-1999 dhe në strehimin e qindra mijëra shqiptarëve të Kosovës me rastin e deportimit masiv nga 24 marsi e deri më 10 qershor 1999, etj.

2. Shqiptarët në tri komunat e Luginës së Preshevës

Lugina e Preshevës në kohën turke ishte pjesë përbërëse e Vilajetit të Kosovës, ndërsa pas vitit 1919 bënte pjesë në Banovinën e Vardarit. Pas Luftës II Botërore, ky territor sërish në pikëpamje administrative mbeti jashtë hapësirës së pakëputur etnike. Megjithatë, shqiptarët e këtij rajoni ishin dhe mbetën në të gjitha rrafshet pjesë përbërëse e një tërësie me popullatën shqiptare të Kosovës dhe të Maqedonisë. Ata morën pjesë aktive në të gjitha rrjedhat dhe lëvizjet kombëtare e çlirimtare, duke i përfshirë edhe këto të dhjetëvjetëshit të fundit (ndihmat solidare; pjesëmarrja në konfliktin në Kosovë në vitet 1998-1999 dhe në Maqedoni në vitin 2001).

Në tri komunat e Luginës së Preshevës (Presheva, Bujanoci dhe Medvegja) që përfshinë rreth 1.250 km katrorë, si popullatë rezidenciale sot jetojnë rreth 100.000 shqiptarë, të shtrirë në 65 fshatra dhe në tri qendra urbane. Komuna e Preshevës sot hyn në radhën e komunave më homogjene kombëtare, ku mbi 95% të popullsisë së gjithmbarshme janë shqiptarë, ndërsa në komunën e Bujanocit shqiptarët përbëjnë rreth 70% të popullsisë. Ndërsa në komunën e Medvegjës, për shkak të shpërnguljeve intensive, numri i shqiptarëve gjithnjë po zvogëlohet dhe ata sot përbëjnë vetëm rreth një të tretën e popullsisë.

Nga të dhënat zyrtare vërehet qartë tendenca e rritjes se numrit të popullsisë shqiptare dhe të numrit të popullsisë së përgjithshme. Mirëpo, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2002 në Serbi ka pasuar një rënie drastike të numrit të shqiptarëve. Sa i përket këtij zvogëlimi duhet dhënë një shpjegim si për numrin e përgjithshëm të popullsisë në nivel të rajonit dhe komunave, ashtu edhe kur është fjala për rënien e numrit absolut dhe relativ të shqiptarëve. Në regjistrimet e popullsisë 1948-1991 në gjithë ish-Jugosllavinë është zbatuar koncepcioni i popullsisë së përhershme apo rezidenciale, që do të thotë se të gjithë personat që kanë munguar përkohësisht në momentin e regjistrimit janë evidencuar si banorë të përhershëm të atij vendi apo vendbanimi. Ndërkaq, në regjistrimin e vitit 2002 Serbia e ka ndërruar këtë koncepcion dhe ka aplikuar koncepcionin e popullsisë së pranishme (gjendja faktike). Sipas këtij koncepcioni, të gjithë personat të cilët në momentin kritik të regjistrimit (31 mars 2002) më shumë se një vit nuk kishin jetuar në vendin e tyre të përhershëm të banimit kishin mbetur pa u përfshirë në regjistrim, çfarë ishte rasti me punëtorët tanë përkohësisht të punësuar në botën e jashtme dhe disa kategori të tjera të popullsisë. Mospërfshirja, që ka të bëjë vetëm me pjesën e popullatës së përkohshme në botën e jashtme, sipas vlerësimeve të ekspertëve vendorë

(komunalë), arrin deri 27%.[10] Do të thotë se në tri komunat e Luginës së Preshevës nuk janë përfshirë në regjistrim më se 22.000 shqiptarë. Kur të merret parasysh fakti se ka shqiptarë të instaluar përkohësisht edhe në Kosovë, atëherë del se numri i shqiptarëve të papërfshirë në regjistrimin e vitit 2002 është më i madh.

Tabela 2. Lëvizja e numrit të shqiptarëve në Serbi (pa Vojvodinën) sipas regjistrimeve zyrtare 1948-2002[11]

Viti	Numri	%
1948	33.289	0,8
1953	39.989	0,9
1961	51.173	1,1
1971	65.507	1,3
1981	72.484	1,3
1991	76.012	1,3
2002	59.952	1,1

Tabela 3. Lëvizja e numrit të shqiptarëve në tri komunat e Luginës së Preshevës 1971-2002 sipas regjistrimeve të popullsisë[12]

Komuna			1971	1981	1991	2002
Presheva	Gjithsej	Numri	30.056	33.948	37.791	34.904
		%	100,0	100,0	100,0	100,0
	Shqiptarë	Numri	23.625	28.961	37.791	31.098
		%	78,6	85,3	90,2	89,0

[10] Shih analizën për komunën e Preshevës: N. Hyseni, *Popullsia si fakor i zhvillimit ekonomik të komunës së Preshevës*, Preshevë, 2004 (shqyrtim për nevoja interne).

[11] Nacionalni *sastav stanovništva po opštinama (Konačni rezultati), Statistički bilten 1295*, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 15; Nacionalni *sastav stanovništva po opštinama (Konačni rezultati), Statistički bilten 727,* Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1972, ff. 32-34*;* Nacionalni *sastav stanovništva po opštinama (Konačni rezultati), Statistički bilten 1295*, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 32; *Saopštenje Republičkog zavoda za statistiku Srbije,* br. 282, Beograd, 1991; Popis stanovništva iz 31. marta 2002. godine, Saop*štenje br. 295,* RZS, Beograd, 2002, f. 2. Për vitin 1991 vlerësimi i Entit Statistikor të Serbisë, sepse shqiptarët e bojkotuan regjistrimin për arsye tashmë të njohura.

[12] Burimi: Nacionalni *sastav stanovništva po opštinama (Konačni rezultati), Statistički bilten 727,* Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1972, ff. 32-34*;* Nacionalni *sastav stanovništva po opštinama (Konačni rezultati), Statistički bilten 1295*, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 32; *Saopštenje Republičkog zavoda za statistiku Srbije,* br. 282, Beograd, 1991 (për vitin 1991 vlerësimi i Entit Statistikor të Serbisë); Popis stanovništva iz 31. marta 2002. godine, Saop*štenje br. 295,* RZS, Beograd, 2002, f. 12.

Bujanoci	Gjithsej	Numri	43.522	46.689	49.472	43.302
		%	100,0	100,0	100,0	100,0
	Shqiptarë	Numri	21.209	25.848	29.968	23.681
		%	48,7	55,3	60,6	54,6
Medvegja	Gjithsej	Numri	20.792	17.290	13.346	10.760
		%	100,0	100,0	100,0	100,0
	Shqiptarë	Numri	5.410	5.509	3.763	2.816
		%	26,0	32,0	28,2	26,1

Lugina e Preshevës, administrativisht sot nën Serbi, në pikëpamje ekonomike, sociale, arsimore, kulturore e shëndetësore është ndër rajonet më të pazhvilluara në këtë vend; për nga të ardhurat kombëtare është pesë herë nën mesataren e Serbisë. Sa u përket veçorive demografike, popullata shqiptare nuk dallohet nga popullsia shqiptare e Kosovës dhe e viseve të tjera. Bashkësia shqiptare karakterizohet me popullatë të re, me moshë mesatare në vitin 1981 rreth 24 vjet, në vitin 1991 rreth 25 vjet dhe në vitin 2002 rreth 28 vjet. Në popullsinë e përgjithshme dominojnë meshkujt nga arsyet e njëjta sikurse në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare. Shqiptarët këtu kanë shkallë të lartë të lindshmërisë dhe të shtimit natyror, shkallë të ulët të mortalitetit të përgjithshëm dhe shkallë të lartë të vdekshmërisë së foshnjave. Në vitin 1981 p. sh. shkalla e lindshmërisë ishte rreth 26 promilë. Popullsia serbe e këtij rajoni, sikurse edhe në tërë Serbinë, ka kohë që ka shtim negativ natyror dhe moshë mesatare rreth 40 vjet.

Për shkak të varfërisë ekonomike dhe dhunës policore-komuniste, një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve e ka braktisur rajonin dhe është ngulitur në Kosovë, veçanërisht në Prishtinë me rrethinë (Fushë Kosova, Ajvalia, Matiçani, Sofalia), në Gjilan e gjetiu dhe në Evropë, së pari si fuqi punëtore dhe pastaj edhe me familje. Për shkak të ngecjes së vazhdueshme ekonomike e arsimore, si dhe për arsye të presionit të pushtetit serb, shqiptarët i braktisën pothuajse të gjitha vendbanimet e komunës së Medvegjës, duke i lënë pronat e paluajtshme.

Në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, kur ushtria agresore serbe bënte mobilizimin e të rinjve shqiptarë në luftë kundër popujve të pafajshëm, shumë të rinj ikën në Evropë, në Turqi, në Shqipëri etj. Shpërnguljet e shqiptarëve ishin intensive edhe midis dy luftërave botërore, si dhe pas Luftës II Botërore për Turqi. Në këtë vend aziatik vlerësohet se sot nga Lugina e Preshevës, me pasardhës, ka një numër relativisht të madh të shqiptarëve.

Shqiptarët e Luginës së Preshevës në kohën e okupimit të Kosovës dhe të terrorit ndaj shqiptarëve u dolën krah shqiptarëve të Kosovës, duke i

ndihmuar materialisht dhe ushtarakisht. Ata bënë përpjekje për çlirimin e tyre, për demokratizimin e jetës dhe zhvillim të gjithmbarshëm, ndërsa përmes formave demokratike të veprimit edhe për bashkim me Kosovën. Pas ndjekjes së forcave ushtarake-policore dhe paramilitare serbe nga Kosova në gjysmën e vitit 1999, nga fundi i këtij viti shpërtheu një konflikt i armatosur midis shqiptarëve dhe forcave serbe, i cili zgjati gjatë gjithë vitit 2000. Me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht amerikanëve konflikti përfundoi më një marrëveshje të brishtë, ndërsa lufta politike e shqiptarëve për realizimin e të drejtave njerëzore e kombëtare dhe shtetformuese sikurse në trojet e tjera po vazhdon.

3. Shqiptarët në Mal të Zi

Shqiptarët e Malit të Zi, si pjesë përbërëse të tërësisë etnike, gjatë kohës iu nënshtruan copëtimeve administrativo-politike dhe territoriale, por si i gjithë kombi shqiptar morën pjesë aktive në të gjitha proceset dhe lëvizjet kombëtare e politike për pavarësi, çlirim e bashkim dhe të drejta kombëtare e sociale. Me vendimin e Kongresit të Berlinit në vitin 1878 Malit të Zi iu dha një pjesë e mirë e territoreve shqiptare, sikurse Tivari, Plava, Gucia, Koja, Trieshi, pjesa VP e Krajës me Shestanin, pjesët kufitare të Podgoricës etj. [13] Dy vjet më vonë, fuqitë e mëdha ia dhanë Mali të Zi edhe Ulqinin, me ç'rast pasoi një shpërngulje e madhe e shqiptarëve.[14]

Numri i tyre sot në Mal të Zi duket se nuk është më i madh se 50.000 veta, të shtrirë në më se 120 vendbanime, kryesisht malore-shkëmbore, me madhësi deri 500 banorë; në rreth 75 vendbanime rurale shqiptarët përbëjnë shumicën dërmuese (mbi 75%). Territori ku ata shtrihen kufizohet me Shqipërinë dhe Kosovën. Shumicën absolute shqiptarët e përbëjnë në komunën e Ulqinit, ku përbëjnë më se 80% të popullsisë së përgjithshme të kësaj komune dhe e udhëheqin edhe pushtetin e kufizuar lokal. Në hapësirën e Plavës e të Gucisë marrin pjesë me rreth 25%, në komunën e Tivarit me 15%, të Podgoricës me rreth 12% dhe të Rozhajës me rreth 5%.

[13] N. Draga, *Shqiptarët në Mali të Zi,* Art Club, Ulqin, 1994, f. 20.
[14] N. Draga, *Po aty,* f. 21.

Tabela 4. Lëvizja e numrit të shqiptarëve në Mal të Zi sipas regjistrimeve zyrtare 1948-2003[15]

Viti	Numri	%
1948	19.425	5,2
1953	23.460	5,6
1961	26.803	5,5
1971	35.671	6,7
1981	37.671	6,5
1991	40.880	6,7
2003	47.682	7,0

Problemet ekonomike, infrastrukturore dhe kulturore dhe mungesa e perspektivës i detyruan shqiptarët e Malit të Zi, veçanërisht të zonës kufitare këto katër dhjetëvjetëshat e fundit të shpërnguleshin në drejtim të Kosovës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.[16] Për këto arsye numri absolut i tyre ka shënuar një rritje shumë të ngadalshme, ndërsa numri relativ ka stagnuar. Meqenëse në këtë proces të vazhdueshëm të emigrimit intensiv janë përfshirë kryesisht të rinjtë, shkalla e lindshmërisë është më e ulët se te shqiptarët e viseve të tjera dhe gjithnjë në rënie. Ekziston frika objektive që procesi i shpopullimit të shumë vendbanimeve që ata i banojnë sot, veçanërisht në Malësi, të marrë dimensione brengosëse, që do të thotë se në këto hapësira në një të ardhme jo fortë të largët mund të ndodhë shuarja e plotë e jetës, me pasoja të mëdha demografike e kombëtare.

Shqiptarët në këtë vend, të tubuar rreth partive të tyre politike, kanë hyrë në Qeveri dhe Parlament, ku po bëjnë përpjekje për prosperitet ekonomik, kulturor dhe kombëtar dhe për një jetë vërtet demokratike të bashkësisë së tyre dhe të Malit të Zi në tërësi.

[15] Nacionalni *sastav stanovništva po opstinama (Konačni rezultati), Statistički bilten 1295*, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 10; *Saopštenje Republičkog zavoda za statistiku, br. 42*, Titograd, 25. 06. 1991; Popis stanovništva od 1. novembra 2003, Republički zavod za statistiku Crne Gore, Titograd, 2004.

[16] A. Berisha, *Shndërrimi i etnisë,* Dukagjini, Pejë, 1998, ff. 32-39; N. Draga, *Po aty*, ff. 19-28.

4. Shqiptarët në viset e tjera të ish-Jugosllavisë

Për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe sociale dhe politikës diskriminuese serbo-maqedono-malazeze për një kohë të gjatë në hapësirën kompakte etnike, shumë shqiptarë, si fuqi punëtore shkuan në qendrat e mëdha industriale dhe urbane të Sllovenisë, të Serbisë, të Kroacisë, të BeH dhe në punët sezonale në bujqësinë e Vojvodinës (vjelja e misrit dhe e rrepës). Në këto ish-republika bënin punë të rënda dhe ishin të përbuzur e të keqtrajtuar. Ky emigrim, i përkohshëm dhe sezonal, deri në fund të viteve të 60-ta të shekullit të kaluar ishte i konsiderueshëm. Pas këtyre viteve nisi të zvogëlohej, sepse hapen mundësi të reja të punësimit në vendet e zhvilluara të Evropës. Fitimet më të mëdha dhe përparësitë e tjera në këto vende të kontinentit plak reduktuan dukshëm emigrimin e shqiptarëve në territoret e ish-Jugosllavisë.

Punëtorët tanë shkuan në kryeqendrat dhe qytetet e zhvilluara të këtyre ish-republikave si të pakualifikuar dhe si të tillë patën mundësi të punësoheshin vetëm në ato vende të punës dhe në ato veprimtari që i refuzonin punëtorët e vendit, që paguheshin pak, ndërsa kërkonin mund të madh fizik, siç janë xehetaria, kryesisht minierat, metalurgjia e zezë, ndërtimtaria, hekurudha, veprimtaritë komunale (pastrimi i rrugëve), pastaj punonin si hamallxhinj, sharrëxhinj, etj. Shumë gurbetçinj shqiptarë në këto vende ushtronin edhe veprimtaritë e tyre për të cilat ishin të specializuar dhe realizonin fitime të mira, si p.sh. ëmbëlsirëbërësit, bukëpjekësit, gjellëbërësit etj. Këta ishin kryesisht shqiptarët nga rrethinat e Tetovës e të Gostivarit, pastaj të Opojës, të Hasit etj., si dhe goranët nga Gora. Një numër jo i vogël i shqiptarëve të Kosovës, kryesisht nga Janjeva, Ferizaj, Gjakova, Peja etj. u vendosën në qytetet e Kroacisë dhe të Sllovenisë, të cilët ushtronin zejen e argjendarisë.

Një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve, si të përndjekur politikë, si ushtarë e si rekrutë, nga sjellja gjithnjë e më agresive e regjimit militarist serb, gjeti strehim në Slloveni, Kroaci dhe B e H. Pas vitit 1990, kur u rrëzua sistemi komunist, edhe shqiptarët në këto ish-republika formuan klubet dhe partitë e tyre politike dhe zhvilluan aktivitete të dendura politike e kulturore; u dalluan edhe si luftëtarë në anën e forcave ushtarake të këtyre vendeve në luftë kundër okupatorit serb.

Numri i saktë i shqiptarëve në këto dhe në territore të tjera të ish-Jugosllavisë nuk është ditur kurrë, që pjesërisht në regjistrime të popullsisë ishte pasojë e zbatimit të kriterit "popullsi e përhershme", që do të thotë se në momentin e regjistrimit ata evidencoheshin si popullsi në vendet prej nga vinin, pra në Kosovë, Maqedoni e gjetiu. Vlerësohej se para luftërave të

përgjakshme në Kroaci, Slloveni dhe B e H jetonin dhe punonin rreth 80.000 shqiptarë, ndërsa në Serbi, kryesisht në Beograd, rreth 60.000 shqiptarë. Me qëllim të punësimit, përveç në kryeqendrat e ish-republikave, shqiptarët i gjenim qoftë si popullatë e përhershme, qoftë si popullatë e përkohshme edhe në qytetet bregdetare të Kroacisë (Dubrovnik, Split, Rijekë, Rovinj, Poreç, Zarë etj.) dhe në Osijek, Vukovar, Vinkovc, Bjellovar etj., pastaj në Smederevë, Bor, Nish, Pozharevc, Kragujevc, në Cele, Kranj, Banjallukë, Zenicë, Bijelinë, Mostar, Bërçko, në Novi Sad, Suboticë, Zrenjanin, Pançevë, Sombor etj.

Në Slloveni dhe në Kroaci shqiptarët trajtoheshin më mirë, mirëpo pas pavarësisë së këtyre republikave (1991), pozita e tyre nuk ishte si më parë, ku me shumë vështirësi u jepej shtetësia dhe të drejtat e tjera qytetare; regjimi i Tugjmanit ishte i egër ndaj shqiptarëve dhe jokroatëve. Një numër i shqiptarëve madje edhe dëbohej nga këto shtete të reja. Ndërsa në Serbi shqiptarët gjithnjë janë përbuzur e ndjekur, veçanërisht pas vitit 1981, kur filloi djegia e dyqaneve dhe shkatërrimi i pasurisë së tyre e deri te sulmet fizike dhe vrasjet. Pas vënies së sistemit diktatorial në Serbi, me ardhjen e Millosheviqit në pushtet (1986), shqiptarët që ushtronin zejet e tyre tradicionale dhe punët në veprimtari të tjera, u detyruan t'i braktisin qytetet dhe vendbanimet industriale të Serbisë dhe të ktheheshin në vendet e tyre të lindjes në Kosovë, në Maqedoni etj.

Pjesa e pestë

MIGRIMET E POPULLSISË DHE SPASTRIMET ETNIKE

I. MIGRIMET E POPULLSISË SË KOSOVËS DHE SPEKULIMET SERBE RRETH TYRE

Migrimet e popullsisë pothuajse në çdo vend të botës bashkëkohore janë bërë proces i pafrenueshëm i evolucionit kuantitativ dhe kualitativ të popullatës. Në kushtet e dallimeve të theksuara ekonomike, socialo-profesionale dhe demografike, veçanërisht këto 5-6 dhjetëvjetëshat e fundit janë intensifikuar si midis regjioneve e vendeve, ashtu edhe brenda vetë shteteve. Migrimet e popullsisë sot paraqesin një problem shumëdimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar. Ato sot janë bërë determinant gjithnjë e më i fuqishëm të transformimit të lëvizjes dhe strukturës demografike si dhe e mënyrës së jetesës së njerëzve përgjithësisht. Krijimi i vendbanimeve, ndryshimet në madhësinë dhe në karakteristikat demografike dhe sociale të tyre, deri te shuarja e jetës në to, përveç tjerash, ishin dhe mbetën nën ndikim të fuqishëm të emigrimeve dhe imigrimeve të popullatës.[1]

Migrimet e para definitive në kuadër të kufijve shtetërorë kanë nisur në vendet evropiane pas revolucionit klasik industrial, kur u krijuan qendrat urbano-industriale si bërthama të atraktivitetit për popullatën ruralo-agrare, siç ndodhi në Angli dhe më vonë në vendet e tjera të kontinentit evropian dhe jashtë tij. Në qoftë se i vështrojmë migrimet e popullsisë nga një kontekst i perspektivës historike, mund të vërejmë se ato ishin përcjellës permanent të evolucionit të përgjithshëm të njerëzimit, faktor kyç në zhvillimin e popullatave njerëzore dhe dukuri shumë e rëndësishme në jetën e popujve, të grupeve të ndryshme të popullsisë, të familjes, të individit. Çdo periudhë historike, sikundër edhe çdo fazë kthesore të zhvillimit shoqëror e kanë karakterizuar migrime të tipave të ndryshme, me shkaqe dhe pasoja specifike për bashkësitë popullative apo grupet e caktuara etnike, racore, konfesionale dhe gjuhësore që kanë qenë të përfshira në rrjedhat e migrimeve. Lëvizjet migruese kurrë gjatë historisë nuk ishin procese spontane dhe autonome, por janë nxitur nga një varg faktorësh, të lidhur e të kushtëzuar në kohë dhe hapësirë të caktuar. Migrimet as sot nuk janë spontane, ndonëse kanë ndryshuar motivet, drejtimet, distanca hapësinore, efektet e tyre për zhvillimin demografik dhe jetën shoqërore-ekonomike etj.[2]

---

[1] H. Islami, "O nekim metodološkim pitanjima istraživanja migracija", *Sveske,* br. 7-8, Institut za proučavanje nacionalnih odnosa, Sarajevo, 1984, ff. 171-176.

[2] L. Dollot, *Les migrations humaines*, Presses universitaires de France, Paris, 1976, pp. 1-126.

Shumëdimensionaliteti dhe ndërlikueshmëria e migrimeve hapësinore-horizontale dhe sociale-vertikale e popullsisë imponojnë nevojën e studimit shkencor të të gjitha formave, drejtimeve, distancës territoriale, aspektit kohor, vëllimit, karakterit etnik, gjuhësor e konfesional dhe veçanërisht të shkaqeve dhe pasojave të tyre. Për ta kuptuar strukturën e popullimit, disa rrjedha retrospektive dhe aktuale demografike, por edhe disa forma të migrimeve të sotme të popullsisë së Kosovës dhe rreth saj analiza duhet të shtrihet së paku për këto 130 vjetët e fundit, që është edhe kohë e ardhjeve dhe e shpërnguljeve të mëdha të popullsisë sipas përkatësisë etnike dhe konfesionale. Në gjithë këtë periudhë, dimensioni etnik dhe demografik i çështjes së Kosovës e i shqiptarëve dhe i migrimeve të popullsisë brenda tyre tashmë është bërë objekt diskutimi e manipulimi i të gjitha regjimeve dhe qarqeve antishqiptare, para së gjithash i regjimeve serbo-jugosllave.

1. Lufta kundër faktorit demografik shqiptar si strategji antishqiptare

Tendencat gjithnjë në kontinuitet të qarqeve hegjemoniste serbe për shkatërrimin e homogjenitetit etnik të trojeve shqiptare, për kolonizimin e Kosovës me elementin serb, për ndërrimin e kompozicionit etnodemografik dhe spastrimin etnik të tokave shqiptare, për dobësimin e forcës vitale të popullatës shqiptare dhe pengimin e përtëritjes normale biologjike përmes masave të ndryshme të presionit e të dhunës deri te ndërmarrjet e hapëta gjenocidale, para së gjithash përmes ndjekjes së të rinjve dhe deportimit masiv të popullsisë shqiptare nuk pushuan deri me hyrjen e forcave ndërkombëtare në Kosovë në gjysmën e qershorit të vitit 1999 kur u mposht definitivisht makineria militariste dhe policore serbe.

Për këto shkaqe, si dhe për ta njohur situatën e tyre popullative, gjendjen numerike e reproduktive dhe qenien e perspektivën e tyre demografike e kombëtare, shqiptarët janë ndër popujt e rrallë në botë që kanë më shumë arsye ta studiojnë problematikën e tyre demografike, aq më tepër kur, vështruar nga perspektiva historike, *vëllimi, rritja demografike dhe shtrirja e pakëputur etnike ishin ndër faktorët më të fuqishëm të rezistencës ndaj asimilimit, ruajtjes së identitetit dhe substancës së tyre kombëtare.* Si duket, në perspektivë, në zgjidhjen definitive të problemit kosovaro-shqiptar dhe të çështjes shqiptare në përgjithësi në Evropën JL, faktori demografik do të mbetet i pakapërcyeshëm. Prandaj, nuk është asgjë e rastit që në vargun e veprimeve gjenocidale serbe mbi kombin shqiptar vendin e parë e zënë ndërmarrjet gjenocidale në rrafshin demografik. Në të gjitha synimet dhe projektet serbe të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjatë gjithë shekullit XX ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, si

pjesë të programit nacional serb, *plleshmëria e femrës shqiptare konsiderohej si një nga pengesat më të mëdha në mposhtjen e faktorit demografik shqiptar* dhe në realizimin e aspiratave shtetmëdha serbe. Shkolla e Cvijiqit dhe në mënyrë më transparente ajo e Çubrilloviqit qysh në elaboratin e parë fashistoid kundër shqiptarëve e veçonin këtë komponent të progresit demografik të shqiptarëve.[3]

Vërsuljet gjenocidale të pushtetit serb mbi shqiptarët në sferën demografiko-territoriale i hasim që nga Kriza Lindore dhe Kongresi i Berlinit (1878). Me qëllim të spastrimit etnik Serbia shpërnguli me dhunë dhe represalie shqiptarët e më se 600 fshatrave të rrethit të Prokuples, të Vranjës, të Leskovcit e të Nishit, si dhe të vetë qyteteve të këtyre rretheve. Të dëbuarit shqiptarë, të njohur si muhaxhirë, u vendosën në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare.[4] Cvijiqi, që ishte angazhuar t'i gjente të gjitha justifikimet gjeografike dhe politike të hegjemonizmit serb në Ballkan, nuk mund të mos e pohonte dëbimin e shqiptarëve nga Serbia "pas marrjes së viseve të reja".[5] Politika e dëbimit të shqiptarëve vazhdoi gjatë gjithë gjysmës së parë të shekullit XX, por dhe pas Luftës II Botërore *preokupim kryesor i Serbisë dhe i ish-Jugosllavisë ishte që problemi i shqiptarëve përsëri të zgjidhej me shpërngulje në Turqi, por edhe me asimilim.*

Nga fillimi i viteve të 80-ta të shekullit XX, në kuadër të fushatës së gjerë kundër Kosovës dhe shqiptarëve, pushteti serb, i përkrahur pa asnjë

---

[3] Si përfundim, në elaboratin e tij, qartë racist, V. Çubrilloviqi theksonte: "Në rastin tonë duhet pasur parasysh aq më parë që kemi të bëjmë me një racë të gjallë, të fuqishme dhe pjellore për të cilën i ndjeri Cvijiq ka thënë se është raca më ekspansive në Ballkan. Gjermania prej vitit 1870 deri në vitin 1914 ka shpenzuar shumë miliarda marka që, gradualisht, duke e blerë tokën nga polakët, t'i kolonizojë trevat e veta lindore. Por, pllshmëria e nënave polake ka ngadhënjyer mbi organizimin gjerman dhe paratë gjermane. Në vitin 1918 Polonia e mori prapë Poznanjin e vet. Statistikat tona të vitit 1921 dhe të vitit 1931, që i përmendëm më parë, tregojnë se edhe pjellshmëria e grave shqiptare ka ngadhënjyer mbi politikën tonë të kolonizimit" (V. Čubrilović, *Iseljavanje Arnauta*, Predavanje održano u Srpskom kulturnom klubu od Dr. Vase Čubrilovića, 7. marta 1937. godine, Vojnoistorijski institut, Arhiv bivše jugoslovenske vojske, Br.2, Fasc. 4, Kutija 69; në shtojcë: një hartë, dy tabela dhe dy grafikone; teksti ka 19 faqe makine, i shkruar me alfabet cirilik, në origjinal është i nënshkruar me dorë; fotokopja e elaboratit gjendet te autori i këtij botimi).

[4] Për dëbimin e shqiptarëve nga Serbia dhe vendosjen e tyre në Kosovë pas vitit 1878 shih studimet dhe vështrimet: S. Uka, "Vendbanimet e Sanxhakut të Nishit të banuara me popullatë shqiptare dhe të përzier në vitet 1877/78", *Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave historike, XII,* Prishtinë, 1983, ff. 105-124; i njëjti, *Dëbimi i shqiptarëve nga sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Kosovë 1878-1912,* librat 1+2, 3, Valton, Prishtinë, 1994.

[5] J. Cvijić, *Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije, knj. III,* Beograd, 1911, f. 1166.

rezervë nga ish-republikat dhe popujt e tjerë joserbë, përsëri iu kthye diskursit, manipulimeve e spekulimeve rreth faktorit demografik shqiptar dhe aktiviteteve institucionale e publike kundër tij. Problemet demografike të shqiptarëve nuk shtroheshin me qëllim të përmirësimit të cilësisë së riprodhimit biologjik dhe të jetës sociale të shqiptarëve e të humanizimit të raporteve midis gjinive apo të zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës, siç justifikohej atëherë. Të gjitha institucionet serbe e jugosllave, nga ato politike e shtetërore e deri te ato shkencore, kulturore, publicistike, informative, kishtare etj., nisën të shpifin teza të ndryshme, ndër të cilat më transparente ishin: se shqiptarët në mënyrë të organizuar po ua blejnë serbëve tokën dhe po lindin shumë fëmijë për shkaqe nacionaliste me qëllim që t'i ndjekin serbët nga Kosova dhe të krijojnë "Kosovën etnikisht të pastër" dhe "Shqipërinë e Madhe".[6] Një nga konstruksionet më transparente dhe njikohësisht ndërsyese ishte teza e demografit të njohur serb, njërit nga autorët e "Memorandumit", i cili gjatë gjithë viteve të 80-ta të shekullit XX kishte qëndrim ekstrem dhe shovinist ndaj natalitetit të shqiptarëve: "Procesin eksploziv demografik, askush deri më sot nuk është përpjekur efektivisht ta qetësojë. Ky proces pa pengesë po përparon, me përkrahjen morale të ideologjisë secesioniste, të bazuar në ekskluzivitetin nacional, të përmbledhur në idenë mbi Kosovën etnikisht të pastër dhe kërkesën ekstreme që Kosova të bëhet republikë".[7] Ndërkaq një udhëheqës i lartë partiako-shtetëror i ish-Jugosllavisë nuk ngurroi të deklaronte: ne e njohim shumë mirë njërën nga parullat kryesore të irredentës: blej tokë dhe lind fëmijë".[8]

Indoktrinimi antinatalist dhe, në esencë, antishqiptar kishte marrë tashmë përmasa të gjera në të gjitha shtresat e shoqërisë serbo-jugosllave, duke e fyer rëndë femrën shqiptare, të cilën në çdo forum politik, në mediume, në rrugë e cilësonin si "makinë për prodhimin e fëmijëve". Në mitingjet populliste nacionaliste, ku bëhej homogjenizimi dhe mobilizimi etnik i masave serbe dhe ku shfrytëzohej e tërë energjia e popullit "hyjnor" serb kundër shqiptarëve dhe përgatitjes për konfrontim me të gjithë popujt joserbë, u nxorën parulla dhe kërkesa me *përmbajtje thjesht raciste e gjenocidale,* si p.sh. "Shqiptarët shumohen shumë, por farën e kanë të prishur", "Shqiptarët duhet dëbuar nga Kosova", "Shqiptarët duhet vrarë" etj. Histeria antishqiptare kishte arritur kulminacionin në pjesën e dytë të viteve të 80-ta".[9] Idetë e intelektualëve të

[6] H. Islami, "Demografski problemi Kosova i njihovo tumačenje", *Zbornik Kosovo-Srbija-Jugoslavija,* KRT, Ljubljana, 1989, ff. 42-43.

[7] M. Macura, *Perspektive, ciljevi i načela politike obnavljanja stanovništva* (proširene teze za uvodnu reč u diskusiji oko okruglog stola, 21. I 22. V. 1987), SANU, Beograd, 1987, ff. 11-12.

[8] S. Dolanc, intervistë në revistën *"Teleks",* Lublanë, nëntor 1988.

[9] H. Islami, *Po aty.*

krisur", theksonte ambasadori W. Zimmermann, "mbisundonin kudo në shoqërinë serbe, që nga dyqanxhinjtë e deri te fshatarët dhe gazetarët".[10] Këto dhe kërkesat e tjera për zvogëlimin e natalitetit përmes të ashtuquajturit kontroll të lindjes dhe planifikim të familjes shqiptarët i kuptuan shumë drejt: si kërkesa që hynin në modelin gjenocidal të të menduarit dhe të sjelljes së ish-shtetit ndaj tyre.[11] Mirëpo, fatmirësisht, ashtu edhe siç pritej nga shqiptarët, nuk u përmbush asnjë rezultat i pritur nga serbët në këtë drejtim.

Të frikësuar nga numri i madh i shqiptarëve, shtrirja e gjerë dhe territorialisht kompakte dhe perspektiva e tyre demografike dhe kinse për shkak të rrezikimit të hapësirës serbo-jugosllave dhe prosperitetit gjeodemografik, kombëtar, politik dhe ekonomik të sllavëve të jugut, të gjitha qarqet ish-jugosllave nisën t'i numëronin shqiptarët dhe ta shtrinin shqiptarofobinë në të gjitha rajonet dhe shtresat shoqërore të sllavëve të jugut, veçanërisht të serbëve, maqedonëve dhe malazezëve. Çdo zgjerim demografik të shqiptarëve drejt Serbisë së Jugut, Maqedonisë Qendrore dhe Podgoricës këto qarqe e shpjegonin si "zgjerim të hartës nacionaliste të Shqipërisë së Madhe".[12] Ish-shteti, me të gjitha mekanizmat e tij, duke financuar segregacionizmin dhe aparatin represiv, vazhdoi të angazhohej haptazi për mposhtjen e epërsisë numerike dhe reproduktive të shqiptarëve dhe të vënies së baraspeshës etnike përmes kolonizimit të serbëve dhe dëbimit të shqiptarëve. Në funksion të këtij qëllimi pasuan disa valë të kolonizimit të serbëve dhe të shpërnguljes së shqiptarëve nga Kosova. Në këtë mënyrë, *lufta kundër faktorit demografik shqiptar u bë pjesë përbërëse e strategjisë antishqiptare.* Në dy dhjetëvjetëshat e fundit të shekullit XX, shqiptarofobia madje ishte aq transparente sa që nuk fshihej fare prapavija neomaltusianiste, raciste dhe gjenocidale. Prandaj na duket më e pranueshme qasja që çështjen e migrimeve ta shtrojmë nga vitet e 80-ta të shekullit të kaluar për të

---

[10] "Më kujtohet një mbrëmje takova një historiane arti. Ishte grua e gjatë, tërheqëse dhe e ndjeshme, që kishte qenë në Nju-Jork shumë herë dhe e donte Amerikën dhe kulturën e saj. Pas një bisede të mrekullueshme për një rreth të gjerë çështjesh, unë e pyeta se si do ta trajtonte ajo problemin e Kosovës. "Fare thjesht, - tha ajo.- Të vihen të gjithë shqiptarët në një mur dhe të pushkatohen" (W Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, Tiranë, 1996, ff. 17-18).

[11] Viktimologu i njohur kroat, atëherë rektor i Universitetit të Zagrebit, prof. Zvonimir Sheparoviq, ishte ndër njerëzit e rrallë në ish-Jugosllavi që mori guximin ta kualifikonte fushatën për "kontrollin e lindjes" dhe "planifikimin e familjes" te shqiptarët si angazhim gjenocidal. Ai shkruante: "Disa thirrje njënacionale të cilat vijnë nga brengosjet për shkak të ekspansionit biologjik të popullatës në mjedisin e pazhvilluar, çfarë është Kosova, që të pengohet lindshmëria e numrit kaq të madh të shqiptarëve… kanë diçka në vete që hyn në modelin gjenocidal të të menduarit dhe të sjelljes" (Z. Šeparović, intervista në revistën "Start", nr. 526, Zagreb, 18. 3. 1989, f. 17).

[12] S. Šuvar, "Kosovska zbivanja i nacionalistička euforija", *NIN*, br. 600, Beograd, 1981, f. 15.

vazhduar me pjesën e parë të këtij shekulli dhe pastaj me periudhën pas Luftës II Botërore.

2. Manipulimet serbe rreth migrimeve të popullsisë në vitet e 80-ta të shek. XX

Në kuadër të fushatës së gjerë kundër Kosovës dhe shqiptarëve pas vitit 1981 ishte hapur një diskurs në ish-Jugosllavi, më tepër për shkaqe politike-spekulative, vetëm rreth migrimeve të popullsisë së Kosovës, edhe pse të gjitha cipet e migrimeve kishin marrë përmasa të gjera në të gjitha njësitë adimistrativo-politike dhe rajonet e ish-shtetit, duke përfshirë të gjitha shtresat shoqërore dhe pjesëtarët e nacionaliteteve. Diskursi rreth migrimeve në Kosovë dhe rreth saj mjerisht zhvillohej në mungesë të plotë të gjykimit racional, me një qasje mekanike e joshkencore, madje edhe shoviniste. Injorohej shumëdimensionaliteti dhe problemet relevante të lëvizjeve hapësinore dhe manipulohej veçanërisht rreth drejtimeve, aspektit kohor, të dhënave dhe sidomos rreth motiveve të migrimeve, duke bërë një seleksionim tepër negativ sipas përbërjes kombëtare. I tërë diskursi rreth migrimeve etnike përqendrohej në migrimet e serbëve dhe malazezëve, të cilët kinse ndiqeshin nga shqiptarët, ndërkaq migrimet dhe problemet jetësore të shqiptarëve plotësisht injoroheshin. Disa të dhëna zyrtare dhe fakte që do t'i ofrojmë lidhur me lëvizjet migruese në përgjithësi dhe sipas përbërjes etnike në veçanti janë në kundërshtim të plotë me këtë diskurs.

Brenda hapësirës së ish-njësive federale, forma më masive e mobilitetit hapësinor dhe social të popullsisë në gjysmën e dytë të shekullit XX ishin migrimet nga të gjitha cipet e vendbanimeve, veçanërisht nga fshati në drejtim të qendrave të mëdha me funksione të fuqishme ekonomike, politike dhe kulturore dhe sidomos drejt kryeqendrave të këtyre ish-njësive. I nxitën kushtet e kufizuara jetësore e infrastrukturore, para së gjithash stërdendësia agrare në mjediset rurale, në një anë, dhe procesi i industrializimit të disa rajoneve, zhvillimi i qyteteve, i arsimit, i sistemeve infrastrukturore etj., në anën tjetër. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1981, 9.184.451 banorë e ndërruan vendin e lindjes, që përbënin 41,0% të popullsisë së gjithmbarshme të ish-Jugosllavisë. Territoret e pazhvilluara ishin gjithnjë emigruese dhe territoret e zhvilluara imigruese, ndërsa disa drejtime të migrimeve ishin tashmë tradicionale.

2.1. Atraktiviteti i "amave" kombëtare dhe i qendrave të tyre të mëdha urbane

Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 1981, kufijtë e ish-republikave dhe krahinave i kaluan 1.760.333 banorë, kryesisht pjesëtarë të atyre bashkësive etnike të cilët "amat" e tyre kombëtare i kishin në rajonet e tjera. Popullsia e çdo nacionaliteti pothuajse gjithnjë ishte e orientuar drejt hapësirave të cilat ishin territorialisht afër, por shpeshherë edhe larg komunitetit të saj kombëtar, si dhe atje ku gjuha, konfesioni, doket, kultura dhe veçoritë e tjera etnike ishin të njëjta apo të ngjashme dhe veçanërisht në qoftë se rajonet imigruese ofronin më shumë kushte ekonomike dhe kulturore. Në këto lëvizje migruese padyshim kishin ndikuar edhe konfliktet dhe nacionalizmat e popujve të mëdhenj, që shënonin agrisivitet gjithnjë e më të madh.

Territoret e zhvilluara dhe qendrat e mëdha urbane ishin bërë shumë tërheqëse dhe atraktiviteti i tyre hapësinor shkonte edhe deri 400 km, çfarë ishte rasti me Beogradin, Zagrebin, Sarajevën, Novi Sadin, Prishtinën etj. Në distanca më të gjata dhe në një numër më të madh, sipas rregullit, lëviznin ato nacionalitete që kishin traditë më të madhe në migrime dhe kulturë më të gjatë urbane. Në këtë mënyrë krijoheshin bërthamat dhe territoret e centralitetetеve kombëtare: *serbët* nga të gjitha territoret, para së gjithash nga BeH, Kroacia dhe Kosova shkonin në drejtim të Serbisë e të kryeqendrës së saj Beogradit dhe të Vojvodinës e të kryeqendrës Novi Sadit; *kroatët* nga BeH dhe Serbia në drejtim të Kroacisë e të kryeqendrës Zagrebit; *myslimanët* nga Serbia, Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia shkonin drejt BeH e të kryeqendrës së saj Sarajevës; *shqiptarët* nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia e Jugut në drejtim të Kosovës dhe kryeqendrës së saj Prishtinës. Kishte pjesëtarë të nacionaliteteve që shkonin edhe në mjediset ku gjuha dhe kultura nuk ishin të njëjta, çfarë ishte rasti me shqiptarët në Beograd, Lublanë, Sarajevë, Zagreb etj., ose me myslimanët dhe të tjerët në qytetet sllovene. Kjo ishte kryesisht fuqi punëtore.

Të dhënat tregonin se *BeH ishte republika me emigrim më të fuqishëm, ndërsa Serbia territori më i madh imigrues.* Sipas regjistrimit të vitit 1981 BeH ndaj ish-republikave dhe ish-krahinave ka pasur bilanc negativ migrues për 397.272 banorë (538.602 emigrues dhe 141.330 imigrues). Saldo negative migruese BeH kishte ndaj rajoneve të zhvilluara: Kroacisë (182.602 veta), Vojvodinës (125.910 veta), Serbisë (72.971 veta) dhe Sllovenisë (28.200 veta). Në Serbi, në të gjitha periudhat, sipas këtij regjistrimi, nga territoret e tjera dhe nga bota e jashtme kishin ardhur 637.399 banorë; ardhjet ishin më të mëdha nga Vojvodina (144.075 veta ose

22,6% nga të gjithë të ardhurit), nga BeH (111.828 veta ose 17,5%), nga Koacia (110.704 ose 17,3%), nga Kosova (110.675 0se 17,3%), pastaj nga Maqedonia (50.011 veta ose 7,8%) dhe Mali i Zi (42.755 ose 6,7%). Nga bota e jashtme kishin ardhur 24.299 veta ose 3,8% dhe të panjohur ishin 30.066 veta ose 4,7%. Ardhjet më të mëdha në Serbi i përkisnin periudhës 1961-1981, kur vijnë 363.239 banorë ose 56,8% nga numri i përgjithshëm i imigrantëve, ndërsa vetëm në periudhën 1876-1981 imigrojnë 101.502 veta ose 15,9% nga të gjithë të ardhurit. Nga Kosova në Serbi, sipas periudhave, vijnë: 1961-1970 34.227 veta, 1971-1975 22.792 dhe në periudhën 1976-1981 28.617 veta.

Rajoni më atraktiv për imigrantët në Serbi ishte rajoni i Beogradit, i cili nga numri i përgjithshëm i të ardhurve nga territoret e tjera absorboi 404.394 veta. Më së shumti erdhën nga Vojvodina (104.046 veta), Kroacia (90.517 veta), BeH (75.191), pastaj nga Kosova (41.955), Maqedonia (27.260), Mali i Zi (23.965), Sllovenia (8.502), bota e jashtme (16.620 dhe të panjohur ishin 16.298 veta. Në rajonin e Beogradit nga Kroacia kanë ardhur 81,7% nga të gjithë të ardhurit nga kjo republikë, nga Vojvodina 72,2%, BeH 67,2%, Sllovenia 65,9%, Mali i Zi 56,0%, Maqedonia 54,5%, nga Kosova 37,9%, nga bota e jashtme 68,3% dhe të panjohurve u përkiste 54,2%. Në rajonin e Shumadisë dhe të Pomoravles nga Kosova ishin ngulitur 16,5%, në atë të Kralevës 15,3%, të Podunavles 9,8%, të Nishit 9,5% etj.

Edhe më intensive ishin *migrimet brenda vetë hapësirës së Serbisë.* Sipas regjistrimit të vitit 1981 1.753.116 banorë të Serbisë e ndërruan vendin e lindjes (migruan), që ishte gati 1/3 e popullsisë së Serbisë (nga vendi tjetër i komunës së njëjtë migruan 819.355 veta dhe nga komunat e tjera të Serbisë 133.781 veta). Kishte një rrjedhë dramatike të braktisjes së fshatit në Serbi (578.000 veta) dhe të bujqësisë (687.000 veta), që rezultoi me një tronditje të fuqishme demografike të fshatit serbian (moshënimi, shpopullimi, shuarja e jetës). Deagrarizimi e kishte bartur riprodhimin biologjik, por edhe socioekonomik nga fshatrat në qytete, ndërsa shtimi natyror i popullsisë bujqësore të Serbisë në vitin 1981 ishte negativ për minus 10,4 promilë (nataliteti u zvogëlua nga 27,2 promilë më 1953 në 5,8 promilë më 1981, ndërsa mortaliteti kishte shënuar rritje nga 12,3 më 1953 në 16,2 promilë më 1981).[13] Një tendencë e tillë negative në riprodhimin e popullsisë, që nuk kishte assesi mundësi të rehabilitohej, ishte dhe mbeti karakteristike deri në ditët tona jo vetëm në Serbi, por edhe në Kroaci,

[13] S. Livada, "Socijalno-demografske promjene u selu i poljoprivredi", *Sociologija sela,* nr. 99-100, Zagreb, 1988, ff. 4-41.

Vojvodinë, Slloveni etj. Në anën tjetër, nga migrimet intensive erdhi deri te një koncentrim i madh i pakontrolluar i popullatës në qytete të Serbisë, ku u krijuan probleme të mëdha në të gjitha aspektet e urbanizimit (funksional, demografik dhe hapësinor). Ishte kjo një qasje e gabueshme në politikën e zhvillimit për një kohë të gjatë. Dhe, në vend se Serbia të merrej me këto dhe me probleme të tjera të zhvillimit, ajo vëmendjen e përqendroi në mesjetë, në frymën e Car Llazarit e të Shën Savës, në ortodoksizmin më ekstrem të shekullit XX, që ishte dhe mbeti pjesë e rëndësishme e sistemit të të menduarit hegjemonist dhe e strukturës pushtetore në Serbi.

Në fillim të viteve të 80-ta të shekullit XX, nga lëvizjet etnike migruese, në disa territore vjen deri te homogjenizimi i përbërjes kombëtare, ndërsa në territoret e tjera deri te heterogjenizimi i kësaj përbërjeje dhe atë përmes punësimit, shkollimit, martesave etj. Problemi sikur bëhet i ndjeshëm për shkak të frikës se do të ndërroheshin raportet në strukturën e popullimit. Serbia më tepër preokupohej me aspektin territorialo-politik të migrimeve. Në rastin e Kosovës ajo e shihte rrezikun nga homogjenizimi i saj etnik me rritjen e popullsisë shqiptare (sipas regjistrimit zyrtar 77,4% ishin shqiptarë) dhe shpërnguljen e serbëve. Por Serbia frikësonte edhe nga shpërngulja e serbëve dhe rënia e numrit të tyre në Kroaci, BeH, në rajonin e Sanxhakut, në Serbinë Jugore etj. Mbi këtë bazë ajo arriti t'ia imponojë gjithë ish-Jugosllavisë tezat e rrejshme se nacionalizmi shqiptar po lufton për krijimin e "Kosovës etnikisht të pastër", "shqiptarizimin e Kosovës", "Shqipërinë e dytë në Serbi", "Shqipërinë e Madhe" etj. gjoja si ide të kamotshme të shqiptarëve – nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878) dhe nga Konferenca e Bujanit (1943-1944).

2.2. Migrimet e popullsisë sipas kombësisë dhe motivet e tyre pas vitit 1981

Të dhënat autentike nuk tumirnin asnjë tezë serbo-jugosllave të shpërnguljes së serbo-malazezëve nën presion të shqiptarëve. Evidencat autentike për të shpërngulurit, sikurse edhe për të ardhurit flisnin për motive krejt tjera nga ato që i theksonte politika e ditës dhe mjetet e komunikimit. Të shtyrë nga pushteti serbo-jugosllav, Qeveria e atëhershme e Kosovës, që njihej si Këshill Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës mori vendim që përmes Sekretariatit të Punëve të Brendshme dhe Entit të Statistikës të Kosovës, si dhe shërbimeve të lajmërimit e të çlajmërimit të sekretariateve komunale të punëve të brendshme, prej 1.6.1983 në Kosovë në mënyrë të organizuar të përcilleshin shkuarjet e njerëzve nga Kosova në viset e tjera të ish-Jugosllavisë dhe ardhjet e tyre në Kosovë. Evidencat ishin autentike dhe

të dhënat mblidheshin sipas shumë karakteristikave: kombësisë, gjinisë, moshës, aktivitetit, profesionit dhe marrëdhënies së punës, përgatitjes shkollore dhe shkallës së arsimit profesional, shkaqeve të shpërnguljes dhe shkaqeve të ardhjes, sipas komunave dhe rajoneve të vendosjes etj. Vlera e të dhënave ishte shumë e madhe, sepse çdo migrant vetë i jepte shënimet në formularë të posaçëm. Sipas kësaj evidence, prej 1. 6. 1983 deri më 31. 12. 1988 nga Kosova emigruan 39.605 veta (16.958 serbë, 10.858 shqiptarë, 3.552 myslimanë, 2.613 malazezë dhe 5.624 të tjerë), ndërsa në Kosovë erdhën 14.001 veta (6.757 shqiptarë, 3.463 serbë, 1.425 myslimanë, 596 malazezë dhe 1.760 të tjerë).[14]

Pjesëtarët e të gjitha nacionaliteteve deklaronin se emigronin kryesisht për shkaqe ekonomike (dominonte punësimi) dhe përqindja e këtij motivi në periudhën e përmendur sillet prej 46,1% te serbët deri 73,4% te shqiptarët, pastaj për shkaqe familjare, ku përqindja e këtij motivi sillej prej 23,7% te shqiptarët deri 48,6% te serbët, ndërsa përqindja e shkollimit si motiv i shkuarjes ishte mjaft e ulët dhe sillej prej 0,6% te romët deri 6,2% te myslimanët. Presionin si motiv të braktisjes së Kosovës e kanë vënë gjithsej 14 veta. Se presioni si tezë nuk mund të qëndronte e vërtetonin edhe disa rezultate të anketimeve që i kishte bërë vetë Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve në 500 familje (3.000 persona) serbe e malazeze të shpërngulura nga Kosova e të ngulitura në 25 vendbanime të Serbisë nga fundi i viteve të 60-ta e deri në fund të viteve të 80-ta të shekullit të kaluar. Presionin nga shqiptarët si motiv të shpërnguljes e kishin vënë vetëm 15% të të anketuarve,[15] pra në mjedise ku me deklaratat e tyre në kohën e klimës së krijuar antishqiptare kishin mundur t'i siguronin vetes privilegje të mëdha.

Edhe te personat e ardhur në Kosovë nga rajonet e tjera të ish-Jugosllavisë, sipas evidencave të përmendura vërehen motive të njëjta; dallimet qëndronin në atë se ardhja e serbëve nga shkaqet ekonomike ishte sipas vijës së privilegjeve. Përqindja e motivit ekonomik sillej nga 57,2% te myslimanët deri 37,5% te romët, pastaj vinin shkaqet familjare, përqindja e të cilave sillej prej 33,4% te të "tjerët" deri 60,9% te romët (te serbët 44,1%; te shqiptarët 33,4%), ndërsa motivi i shkollimit është më i pranishëm te shqiptarët (11,1%) dhe më i ulët te romët (1,3%). Është interesant se në formularët e evidencave autentike të shërbimeve të lajmërim-çlajmërimit të SPB-së për personat që vijnë në Kosovë nga viset tjera nuk figuronte *shkaku*

[14] *Personat e shpërngulur nga Kosova dhe personat e ardhur në Kosovë*, Buletinat 25, 50, 72, 89, 109 dhe 125, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1984-1989.

[15] R. Petrović, "Islejavanje Srba i Crnogoraca sa Kosova", *Pogledi,* br. 2, Split, 1988, f. 546.

tjetër, që nënkuptonte presionet, prandaj edhe nuk kishte të dhëna për këtë motiv.

Nga pasqyra e motiveve të personave të shpërngulur dhe të ardhur shihet se ishte fjala për motive të njëjta te të gjitha nacionalitetet, që tregonte e dëshmonte për lëvizjet e lira të njerëzve nga arsyet ekonomike, familjare, arsimore, individuale etj. Ndërkaq, koncentrimi i njerëzve nga arsyet kombëtare, si karakteristikë e përgjithshme në gjithë ish-Jugosllavinë, duhet të studiohej mirë përmes hulumtimeve sociologjike, politikologjike e të tjera, gjë që nuk u bë kurrë. Një gjë që dihej në kuadër të rrjedhave të përgjithshme politike e shoqërore ishte fakti se njerëzit frikësoheshin nga ekstremizmi serb dhe populizmi nacionalist i regjimit të Millosheviqit.

2.3. Maqedonia si territor provues për ndjekjen e shqiptarëve

Serbia përmes ish-Federatës Jugosllave donte ta përdorte Maqedoninë si territor provues jo vetëm për ta kufizuar rritjen demografike të shqiptarëve, por edhe për ta reduktuar shkollimin shqip dhe perspektivën e përgjithshme të shqiptarëve në Kosovë. Menjëherë pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë në vijën antishqiptare ishte krijuar blloku serbo-malazezo-maqedon, kurse pas gjysmës së këtyre viteve në këtë front ishin inkuadruar edhe boshnjakët, kroatët dhe sllovenët. Maqedonia sikur shihte frikë edhe më të madhe nga numri i shqiptarëve dhe dinamika e tyre natyrore demografike. Numri zyrtar i shqiptarëve në vitin 1981 në Maqedoni ishte 377.726 ose 19,8% në popullsinë e përgjithshme (në punësim merrnin pjesë vetëm me 6,7%). Nën parullën kinse të nacionalizmit agresiv shqiptar, pushteti maqedon e theksonte vazhdimisht problemin e natalitetit të shqiptarëve dhe ardhjen e tyre "masive" nga Kosova në territorin e saj. E ndaloi rreptësisht ardhjen e shqiptarëve nga Kosova dhe trojet e tjera etnike shqiptare, ndërsa ndaj popullatës shqiptare në Maqedoni ndërmori një varg masash në reduktimin e të drejtave në lëmin e shkollimit e të komunikimit publik në gjuhën shqipe, në kufizimet në punësim, në shtesa të fëmijëve, në mbrojtje shëndetësore të fëmijëve tepricë etj. Ky pushtet nxori edhe ligjin mbi kufizimin e ardhjeve të shqiptarëve në vendbanimet e Maqedonisë, ku përsëri, sikurse edhe te nataliteti, filloi nga Tetova.[16] Ai frikësohej se nga shtimi mekanik (imigrimi) dhe shtimi natyror shqiptarët kinse do ta krijojnë "Kosovën e Dytë në Maqedoni, "Shqipërinë e Dytë" në Maqedoni dhe "Shqipërinë e Madhe".

[16] S. Drakulić, "Natalitet i represija", *Danas,* br. 310, 26. siječnja 1988, Zagreb, f. 30

Çdo kërkesë elementare njerëzore dhe kushtetuese e shqiptarëve nga politika zyrtare maqedonase dhe jugosllave kualifikohej si kërkesë "kundërrevolucionare". Teza për "vërshimin" e shqiptarëve nga Kosova në Maqedoni shfrytëzohej si sulm i paparë kundër shqiptarëve të atjeshëm. Sa e sa herë është folur e shkruar për tezën e rrejshme se vetëm në komunën e Tetovës në vitet e fundit nga Kosova kanë ardhur më tepër se 15.000 shqiptarë, ndonëse sipas regjistrimit zyrtar të vitit 1981 në tërë territorin e Maqedonisë nga Kosova kishin ardhur 21.245 veta në të gjitha periudhat, ndërkaq ardhja më e madhe ishte shënuar në periudhën 1946-1970 (migrimet e martesave), ndërsa sipas të dhënave të lajmërim-çlajmërimit, prej 1. 6.1983 deri më 31. 12. 1988 nga Kosova në Maqedoni kanë ardhur gjithsej 1.154 persona.

Maqedonia ishte atraktive për shqiptarët në vitet e 50-ta e të 60-ta të shekullit kaluar, kur rridhte intensivisht shpërngulja për në Turqi, ku territor etapor ishte kjo republikë, përkatësisht kryeqyteti i saj Shkupi. Këtu ndërrohej përkatësia kombëtare në atë turke dhe këtu merreshin pasaportat dhe vizat (visikat). Për këto qëllime funksiononin shërbimet speciale ditën dhe natën, të cilat përgatitnin dokumentet e shpërnguljes. Periudha e shpërnguljes masive ishte ajo e viteve 1953-1961, por numri i popullsisë së shpërngulur dhe sipas nacionaliteteve nuk dihej. Përmendet se vetëm "në periudhën 1955-1958 janë shpërngulur nga Maqedonia 160.000 turq",[17] ndërkaq ky emigrim ka qenë më markant më vonë, pas vitit 1958. Theksohej gjithashtu se "migrimi i popullsisë myslimane në periudhën 1953-1961, marrë johistorikisht, është fenomen që bën përjashtim". [18] Atmosfera në të cilën është zhvilluar procesi i shpërnguljes në Turqi ishte dramatike.[19]

---

[17] D. Anakiovski, "Kretanja zaposlenosti i promene u socijalnoj strukturi stanovništva SR Makedonije", *Stanovništvo,* br. 4, CDI, IDN, Beograd, 1967, f. 294.

[18] D. Vogelnik, "Obim i neke karakteristike unutrašnje migracije u Jugoslaviji u razdoblju 1953-1961", *Ekonomski anali,* br. 12-13, Beograd, 1962.

[19] "Për atë që nuk ka mundur ta përcjellë atmosferën në të cilën në periudhën e mëparshme është zhvilluar shpërngulja masive dhe qëndrimit ndaj pjesëtarëve të kombësisë shqiptare dhe turke, kjo dukuri mund të duket sot shumë enigmatike. Mirëpo, ajo bëhet e kuptueshme vetëm kur të kihen parasysh këto fakte: së pari, procesi i shpërnguljes masive të turqve dhe shqiptarëve ka filluar pas vitit 1958, edhe pse grupet e para të pjesëtarëve të tyre nisën të shpërngulen nga Maqedonia që nga vitit 1953 dhe diçka më herët; së dyti, të përfshirë në psikozën e shpërnguljes masive dhe nën ndikim të drejtpërdrejtë të saj, shqiptarët filluan në pikëpamje kombëtare të deklarohen si turq; më shumë u deklaruan kështu ata të cilët si të papërcaktuar në pikëpamje kombëtare filluan të vijnë suksesivisht nga Kosova, Sanxhaku dhe BeH... Si një nga shkaqet e shpërnguljes mund të konsiderohet gjithsesi edhe fakti se pjesëtarët e këtyre kombësive e kanë ndier veten si të huaj në kushtet e reja të ndërtimit socialist në Jugosllavi" (J.

Se si manipulohej me përkatësinë kombëtare më së miri tregon gjuha amtare që e ka folur atë kohë bashkësia turke. Sipas regjistrimit të vitit 1953 për kombësi turke ishin deklaruar në ish-Jugosllavi 259.535 banorë, ndërsa kishin deklaruar se gjuhën turke e flisnin vetëm 181.887 veta.[20] Ndërsa, sipas regjistrimit të vitit 1961, e në bazë të të dhënave që i kishte përpunuar Qendra për Hulumtime Demografike e Beogradit, prej 182.964 turqve sa ishin evidentuar me deklarim, vetëm 90.883 (50%) e kanë folur gjuhën turke.[21]

Shpërngulja në Turqi la pasoja të shumta në të gjitha sferat e jetës, e para së gjithash në pasqyrën etnodemografike të shumë fshatrave shqiptare (shpopullimi). Një numër i madh i fshatrave mbeti krejtësisht pa njerëz, ku shumë sipërfaqe të punueshme u shndërruan në kullota e lëndina, kurse në qytete pothuajse u zhdukën disa zanate e veprimtari të tjera shërbyese me të cilat merrej popullsia e shpërngulur.[22]

Mirëpo, numri i saktë i të ardhurve nga Kosova dhe nga viset e tjera në Maqedoni nuk dihet, sikundër që nuk dihet as numri i saktë i të shpërngulurve shqiptarë në Turqi ngase këto të dhëna ishin fshehtësi shtetërore. Në rrethanat kur në mënyrë ekspansive shtoheshin përpjekjet për reduktimin e të drejtave të shqiptarëve dhe represionin e madh ndaj tyre në Maqedoni (burgosjet, përjashtimet e arsimtarëve nga puna, mbyllja e shkollave, rrënimi i mureve, ndjekja e zejtarëve privatë etj.) ishte krejtësisht e qartë se kjo republikë nuk mund të ishte atraktive për imigrantë shqiptarë nga Kosova dhe rajonet e tjera. Qëllimi i pushtetit maqedon, sikurse edhe i pushtetit serbo-jugosllav ishte që të krijohej klima e mosdurimit dhe ata të merrnin rrugën e braktisjes së vendit të tyre.

Çdo zgjerim demografik të shqiptarëve drejt Maqedonisë Qendrore, Podgoricës dhe Serbisë së Jugut përmes komponentit imigrues në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar shpjegohej, siç theksuam më parë, si "zgjerim i hartës nacionaliste të Shqipërisë së Madhe".[23] Në anën tjetër, pushteti jugosllav i akuzonte pandërprerë shqiptarët se vetë po hyjnë në geto etnike, kulturore dhe sociale. Pas viteve të 80-ta të shekullit XX shqiptarëve u ndalohej madje edhe

---

Sinadinovski, "Osnovne strukturalne promene stanovništva SR Makedonije u posleratnom periodu razvitka", *Cvijićev zbornik*, SANU, Beograd, 1968, f. 269).

[20] *Popis stanovništva 1953. Narodnost i maternji jezik,* knj. VIII, SZS, Beograd, 1959, f. 377.

[21] *Demografske, socijalne i ekonomske karakteristike stanovništva nacionalnosti u Jugoslaviji,* CDI, IDN, Beograd, 1978, f. 171 (studim për nevoja interne).

[22] M Panov, "O nekim posledicama nastalim u vezi sa iseljavanjem Turaka iz SR Makedonije posle drugog svetskog rata", *Zbornik VI Kongresa geografa FNRJ,* Ljubljana, 1962, f. 353-356.

[23] S. Šuvar, "Kosovska zbivanja i nacionalistička euforija", *NIN*, br. 1600, Beograd, 1981, f. 15.

ardhja në fshatrat serbe dhe serbo-shqiptare. P. sh., me insistimin e ideologut dhe ish-kryetarit të Serbisë Ivan Stambolliq,[24] në fshatin Batusë afër Prishtinës, pas rrënimit të shtëpisë para kamerave televizive, familja shqiptare me 10 anëtarë u dëbua nga fshati, ndërsa me kërkesën e kryetarit të organizatës partiake të Beogradit, Dragisha Pavlloviq, në fabrikën e porsandërtuar në këtë fshat (1987) nuk u pranua në punë asnjë shqiptar. Këto monumente segregacioniste dhe raciste, që i ngriti pushteti serb, nuk kishin se si të fshiheshin nga kujtesa e qytetarëve të kombësisë shqiptare.

[24] Hegjemonin Ivan Stambolliq, pasi forcat neofashiste të Millosheviqit, në luftë për pushtet, e menjanuan nga skena politike në vitin 1987, në gusht të vitit 2000 e eleminuan edhe fizikisht: u gjet i varrosur në një gropë speciale, të bërë nga gëlqerja, në Frushka Gorë, më se 200 km larg Beogradit!

II. HEGJEMONIZMI SERB DHE POLITIKA SERBE E SPASTRIMEVE ETNIKE TË SHQIPTARËVE

1. Nocioni dhe ideja e "spastrimeve etnike"

Aspiratat hegjemoniste dhe shoviniste të qarqeve, regjimeve, madje edhe popujve të tërë në kohën tonë kanë nxitur edhe një tip krejtësisht të ri të migrimeve, me përmbajtje specifike, të ashtuquajtur "migrime humane", "këmbim popullatash" apo "spastrim etnik". Këto nocione, veçanërisht "spastrimi etnik", në teori dhe në praktikë duken të reja, të përdorura nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare humanitare dhe nga vetë OKB-ja gjatë luftërave në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX në ish-Jugosllavi (Kroacia, BeH, Kosova), të cilat i provokoi dhe i zhvilloi Serbia dhe serbët për realizimin e qëllimeve të tyre hegjemoniste, grabitjen e territoreve të popujve të tjerë. Mirëpo, kur të vështrohet përmbajtja e "pastrimit etnik" si model gjenocidal i të menduarit dhe të sjelljes dhe realizimi praktik i këtij lloj krimi, atë mund ta gjejmë indirekt të specifikuar në dokumentet e OKB-së që nga formimi i saj në kuadër "të parandalimit dhe të dënimit të krimit të gjenocidit" dhe atë si akt qëllimi për shfarosjen e plotë apo të pjesërishëm të një grupi kombëtar, etnik, racor apo fetar.[1] Në kuadër të krimeve kundër njerëzimit, shpërngulja e qëllimshme, e planifikuar, sistematike dhe e dhunshme e popullsisë së një etnikumi, në sistemet juridike të shumë vendeve, duke përfshirë edhe legjislacionet e vetë vendeve që ushtrojnë ndërmarrje me karakter gjenocidi, konsiderohet si krim gjenocidal.[2]

Idenë për spastrime etnike dhe shkatërrime sistematike të popujve dhe realizimin praktik të saj në kuptimin e sotëm qoftë sa i përket vëllimit të viktimave dhe teknikave të realizimit, ashtu edhe qëllimit, justifikimit ideologjik etj., nuk e gjejmë në periudha të hershme historike. Megjithatë, disa elemente si të idesë, ashtu edhe të realizimit praktik i hasim herët, p. sh. që nga dyndjet e mëdha të popujve, te migrimet e karakterit invadues në kohën e sundimit të mbretërive të mëdha, çfarë ishte rasti me pushtimet e romakëve, mongolëve, avarëve, turqve etj., duke shkaktuar dëbime masive të popullatave autoktone dhe imigrime po ashtu masive të popullsive të

---

[1] *Resolution 96, I,* NU, 1946*; Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide,* Article II, 9. 12. 1948, në *Human Rights: A Compilation of International Instruments,* NU, New York, 1988, pp. 143-144.

[2] *Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndej,* Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1995, f. 15 (Fjala e hyrjes e G. Zajmit).

pushtuesve.[3] Ndërkaq, në kohën e re dhe më të re, me rritjen e aspiratave shtetmëdha paraqiten migrimet e pakicave të tëra etnike, madje edhe të popujve për arsye kryesisht gjeopolitike dhe politiko-fetare: tendenca për homogjenizimin dhe integrimin kombëtar, çfarë ishte rasti me Serbinë pas vitit 1878, kur i dëboi shqiptarët nga qindra vendbanime të tyre dhe Serbinë e viteve të 90-ta të shekullit XX, kur bëri pastrimin etnik të disa miliona joserbëve në hapësirat e ish-Jugosllavisë; me Greqinë në gjysmën e parë të shekullit XX, kur ndoqi qindra mijëra turq e shqiptarë; me Bullgarinë në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar, kur përzuri qindra mijëra turq; me përzënien e një numri të madh të çifutëve nga Gjermania e Hitlerit, si dhe me shpërnguljen e më se 9 milionë gjermanëve nga vendet e Evropës Lindore pas kapitullimit të nazizmit; pastaj aspiratat për konsolidimin territorialo-shtetëror e politik, çfarë ndodhi me Izraelin në vitin 1948 e këndej, i cili vetëm në vitin e formimit të tij instaloi afër 1 milion çifutë dhe shpërnguli rreth 700.000 arabë, apo dëbimet për shkaqe të mostolerimit fetar, sikurse ngjau me Indinë dhe Pakistanin më 1947, ku në dy drejtime u këmbyen rreth 17 milionë njerëz.[4] "Spastrime" etnike kishte edhe në kuadër të marrëveshjeve për këmbimin e popullatave midis Greqisë dhe Turqisë më 1923, kur u këmbyen rreth 1,5 milion banorë;[5] ndër të transferuarit në Turqi "me dhunë kishte edhe 20.000 familje shqiptare që nuk dinin asnjë fjalë turqisht"[6] etj. Të veçanta janë spastrimet etnike që bëri Bashkimi Sovjetik në kohën e Stalinit në vitet e 30-ta e të 40-ta të shekullit XX, me përzënien dhe deportimin e korelasve, të koreanëve, të kinezëve, të polakëve, të gjermanëve etj. dhe të sjelljes së rusëve e të bjellorusëve në territoret e këtyre popujve dhe në vendet baltike (Estonia, Letonia dhe Lituania) për ta thyer homogjenitetin etnik të tyre.

Qarqet politike e shtetërore dhe institucionet shkencore e kulturore serbe, që i akuzojnë popujt e tjerë (veçanërisht shqiptarët) për spastrime etnike, krime e veprime gjenocidale, në të vërtetë vetë janë bartës të kamotshëm të

---

[3] M. Sorre, *Les migrations des peuples (Essai sur la mobilité géographique)*, Flammarion, Paris, 1955, pp. 8-18 e tutje.

[4] M. Friganović, *Demogeografija (Stanovništvo svijeta)*, Školska knjiga, Zagreb, 1990, ff. 142-143.

[5] Këmbimi i detyrueshëm i popullatave midis këtyre dy vendeve ishte bërë në bazë të Traktatit të Lozanës më 1923, të mbështetur edhe nga fuqitë e mëdha. Nga 1 maji i vitit 1923 kishte filluar transferi i dhunshëm i popullsisë, i cili u përcoll me dhunë, shkatërrime dhe viktima në njerëz (Shih: Treaty of Lausanne, 1923: sipas *The Lausanne Principe: Multiethnicity, Territory and the Future of Kosovo's Serbs, European Stability Initiative (ESI),* Berlin/Pristina, June 7, 2004).

[6] Monografi e prof. Ahmet Gashit, *Shqipnija- ethnike edhe vërejtjet e shqiptarëve për Shqipninë e robnueme,* Tiranë, 1941, f. 13. Monografia, siç vëmë në pah më parë, ruhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë.

këtyre ideve, madje jo vetëm të ideve, por edhe të veprimeve konkrete. Dëbimet e popujve dhe spastrimet etnike në kuptimin e përmbajtjes së sotme të nocionit "spastrim etnik" në hapësirat ballkanike, për shkaqe hegjemoniste dhe shoviniste, i ka bërë Serbia ndaj shqiptarëve që nga gjysma e dytë e shekullit XIX e deri në përfundim të shekullit XX dhe në mënyrë më fashisoide ndaj boshnjakëve në dekadën e fundit të shekullit të kaluar (masakrat, dhunimet sistematike, grabitja e pronave dhe dëbimi masiv si qëllim dhe strategji e luftës). Pas luftërave serbo-turke (1876-1878) dhe Kongresit të Berlinit (1878), siç dihet, pushteti serb, në përpjekje për ta realizuar synimin e tij kombëtar e shtetëror serbomadh, që e konsideronte si më të shenjtin, kishte formuluar qëndrimin gjenocidal që sa më pak shqiptarë të mbesin në territoret e çliruara nga Turqia, aq më i madh do të jetë kontributi për shtetin dhe kush shpërngul sa më shumë shqiptarë do të ketë merita më të mëdha për atdhe.[7] Vetë Jovan Cvijiqi (1865-1927), që i kishte vënë bazat gjeografike dhe gjeopolitike të synimeve ekspansioniste serbe në Ballkan, nuk mund të mos e pohonte dëbimin e shqiptarëve nga Serbia në këtë periudhë.[8] Dijetari francez, si njohës shumë i mirë i çështjes së Kosovës dhe të shqiptarëve, Michel Roux, thekson se "menjëherë pas Kongresit të Berlinit autoritetet serbe ndërmorën dëbimin e popullatës vendëse shqiptare".[9] Sipas tij, Serbia dëbime të tilla të bashkësive myslimane ka bërë edhe më herët. "Që nga marrja e autonomisë (1815) dhe në kohën e zgjerimeve të saj (1833, 1878, 1912) Serbia ka përzënë nga territori i saj popullatat islamike, turqit, shqiptarët dhe myslimanët sllavë, por nga vitit 1912 ajo tentoi t'i asimilojë edhe maqedonasit prej kur bullgarët kishin nisur të grindeshin me të".[10] Këtu edhe i gjejmë fillet e spastrimeve etnike të kohës moderne në praktikë.

Ideja për pushtimin e territoreve joserbe, për spastrime etnike të popujve joserbë dhe për Serbinë e Madhe është e kamotshme. Formulimin e parë të Serbisë së Madhe si ide dhe koncepcion hegjemonist në nivel të një plani e gjejmë që nga mesi i shekullit XIX në principatën e atëhershme serbe dhe buron pikërisht nga qarqet qeveritare serbe që sforcohet në kontinuitet, ndërsa pastaj mbështetet nga institucionet kulturore, shkencore e kishtare serbe. Këtë projekt si ide dhe sendërtim në praktikë e hasim duke filluar nga "Naçertania" e Ilija Garashaninit (1844), si projekt strategjik për

---

[7] J. Hadživasiljević, *Arbanska liga,* Beograd, 1909, f. 14.

[8] J. Cvijić, *Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije,* knj. III, Beograd, 1911, f. 1166.

[9] M. Roux, "Lo scenario bosniaco: pulizia etnica e spartizione territoriale", *Limes,* Rivista italiana di geopolitica, 1-2, Roma, 1993, p. 32.

[10] M. Roux, "La purification ethnique. Théorie et pratique", *Nations et nationalismes*, La Découverte, Paris, 1994, p. 155.

zgjerimin e Serbisë, shkrimet e Cvijiqit midis viteve 1912 dhe 1921, elaboratet e Çubrilloviqit (1937 dhe 1944), projektet e I. Andriqit (1939) e të S. Moleviqit (1941), e deri te ”Memorandumi” i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (1986), projekti i regjimit të Millosheviqit “Të gjithë serbët në një shtet të vetëm” (1990 e këndej) dhe programi neofashist i Partisë Radikale të Sheshelit. ”Memorandumi” dhe projekti i regjimit të Millosheviqit sollën shkatërrimin e Jugosllavisë komuniste, luftërat e përgjakshme, spastrimet etnike dhe ndërmarrjet e tjera gjenocidale në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar.

2. Hegjemonizmi serb si koncepcion afatgjatë i politikës dhe i shoqërisë serbe

Hegjemonizmi serb si ide dhe koncepcion ka një histori mjaft të gjatë, më se 160- vjeçare. Me sa dihet deri tash, projekti i parë, ku janë vënë bazat e idesë së Serbisë Madhe është “Naçertanije”[11] e Ilija Garashaninit e vitit 1844. Të gjitha hulumtimet e deritashme tregojnë se “Naçertanija” ishte një projekt sekret i Qeverisë së Serbisë së atëhershme, ku në emër të homogjenizimit dhe integrimit të popullit serb insistonte në krijimin e Serbisë së Madhe, përkatësisht të një shteti të sllavëve të jugut ku do të dominonin dhe sundonin serbët. Që në fillim të projektit theksohet se “themeli i politikës serbe” është se Serbia *“nuk mund të ngushtohet në kufijtë e sotëm, veçse ajo synon t’i afrojë e bashkojë të gjithë serbët që e rrethojnë”*. Se projekti bazohej në mitet e së kaluarës shihet nga kërkesa për përtëritjen e Mbretërisë Serbe të car Dushanit: “Shteti serb...tabanin e fortë e kishte në mbretërinë serbe të shek. 13 dhe 14 dhe në historinë e pasur e të lavdishme serbe”, sikundër që “Koha jonë e tanishme, pra, nuk do të jetë e këputur nga e kaluara, veçse do të jetë një tërësi e varur, e lidhur, e organizuar, prandaj kombi serb, nacionaliteti i tij dhe jeta shtetërore e tij qëndron në mbrojtjen e së drejtës së shenjtë historike”. Serbia e Madhe, sipas Naçertanisë, do të nënkuptonte një shtrirje të gjerë territoriale: Serbia, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Sllavonia, Sremi, Banati, Bačka, pjesa më e madhe e Kroacisë së sotme. Ajo do të kishte një ndikim të madh në Bullgari përmes shkollimit e arsimit, letërsisë, librave të lutjeve kishtare dhe të tjera, kuadrit fetar, emisarëve të ndryshëm sekretë, ndërsa përmes propagandës serbe do t’i mbështeste bullgarët në rast rreziku etj. Ndërkaq,

[11] Shih tekstin e plotë të “Naçertanisë” në librin: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 95-111.

përmes lidhjeve tregtare parashihej një ndikim i madh i Serbisë në Shqipërinë e Veriut, që ishte projektuar si zonë e interesave serbe.

Ndër projektet serbomëdha dhe veprimet e organizuara të bandave çetnike kundër popujve joserbë duhet përmendur edhe organizatën *"Crna ruka"* ("Dora e Zezë"), e cila për nga idetë, qëllimet dhe metodat e veprimit ishte padyshim terroriste dhe kriminele që ishte formuar qysh në vitin 1903 nga strukturat militante dhe kriminele të ushtrisë serbe. Pas një përçarjeje të brendshme, në vitin 1911 "Crna ruka" e ndërron emrin dhe shndërrohet në organizatën "Bashkim ose Vdekje". Mirëpo, për nga orientimi nuk ndërron asgjë, mbetet *organizatë sekrete, që merret me komplote, atentate dhe veprime terroriste çetnike.*[12] Detyra kryesore e saj, sipas Kushtetutës dhe Rregullores[13] që e kishin, ishte bashkimi i popullit serb në një Serbi të madhe dhe komplotet kundër të drejtave dhe lirive të popujve joserbë në gjithë territorin e ish-Jugosllavisë. Në nenin 1 të Kushtetutës kështu definohej qëllimi i organizatës: "Me qëllim të realizimit të idealeve të popullit – *bashkimit të serbizmit* – krijohet organizata, anëtar i së cilës mund të jetë çdo serb, pa marrë parasysh gjininë, fenë, vendin e lindjes, si dhe secili që do t'i shërbejë sinqerisht kësaj ideje". Kushtetuta konsistonte në idenë hegjemoniste serbe, sepse gjithë territorin e Jugosllavisë së Parë, në nenin 7, e konsideronte serbe: "Përveç anëtarëve nga Mbretëria Serbe, Drejtorinë Supreme Qendrore (DSQ) e përbën edhe nga një delegat i autorizuar i organizatave të të gjitha krahinave serbe: nga Bosnja e Hercegovina, nga Mali i Zi, nga Serbia e Vjetër dhe Maqedonia, nga Kroacia, nga Sllavonia dhe Sremi, nga Vojvodina, nga viset bregdetare".

---

[12] Në një enciklopedi serbe të vitit 1978 për organizatën "Crna ruka", përveç tjerash, thuhet: "Organizatë komplotiste serbe të cilën e përbënin kryesisht oficerët pjesëmarrës të përmbysjes së oborrit në vitin 1903; pas ndarjes së saj një pjesë formoi organizatën sekrete nacionaliste me emër "Ujedinjenje ili smrt" ("Bashkim ose Vdekje") ose "Crna ruka" (Dora e Zezë"), si e kanë quajtur pastaj, ndërkaq pjesën tjetër e quanin "Bela ruka" (Dora e Bardhë"). Qëllimi i "Dorës së Zezë" ishte që të gjithë serbët t'i bashkojë në Mbretërinë Serbe si piemont të serbizmit; forca kryesore e realizimit të qëllimit do të ishte Mbretëria Serbe, ndërsa organizatat e ndryshme komplotiste ndër serbë jashtë Serbisë do ta ndihmonin me propagandë, atentate dhe veprime çetnike. Organizata ka konsideruar se këtë detyrë mund ta realizon vetëm nëse vetë e merr udhëheqjen dhe të gjitha forcat e Mbretërisë së Serbisë dhe lëvizjet e serbëve jashtë Serbisë i orienton në drejtim të krijimit të Serbisë së Madhe" (*Mala enciklopedija Prosveta*, Treće izdanje, 3, R-Š, Prosveta, Beograd, 1978, f. 644). Udhëheqësit kryesorë të kësaj organizate në një proces gjyqësor, të mbajtur në Selanik në qershor të vitit 1917, për shkak të vrasjes së regjentit Aleksandër më 1903, u dënuan me pushkatim (Po aty, ff. 262-263).

[13] Shih tekstin e plotë të Kushtetutës dhe të Rregullores së "Dorës së Zezë" në librin: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 112-127.

Eksperiencat e kësaj organizate dhe e bandave të tjera çetnike në krimet ndaj shqiptarëve janë shfrytëzuar gjatë gjithë shekullit XX.[14] E. Durham, duke iu referuar raporteve të Komisionit Karnexhi, bën me dije se në vitet 1913-1914, pas aneksimit të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nga Serbia më 1912, "masakrat ishin planifikuar dhe ishin kryer nga shoqëria "Dora e Zezë". Damjan Popoviqi, drejtuesi i bandës së mbretvrasesve, udhëhoqi masakrat në Kosovë. Dhe e gjithë kjo bënte pjesë në planin e parapërgatitur serbomadh…Meqë "Dora e Zezë" është një qeveri brenda qeverisë, por jo zyrtare, Beogradi gjithnjë ngre pretendimin se nuk di gjë për bëmat e saj".[15] Për mizoritë dhe krimet që i kishin bërë këto organizime serbe dhe ushtria serbe e xhandarmëria më së miri dëshmojnë rrëfimet e dokumentuara trishtuese të Leo Frojndlihut, të bëra publike në Vienë në kohën kur edhe janë kryer (1912-1913), me titull "Golgota shqiptare".[16]

3. Shqyrtimet etnodemografike dhe gjeopolitike të Cvijiqit në favor të ekspansionizmit serb në Ballkan

Krizat dhe luftërat në përmasa botërore dhe rajonale në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX patën si rezultat formimin e shteteve të reja dhe krijimin e raporteve të tjera etnike, demografike dhe sociale në Ballkan. Pas këtyre konflikteve dhe ndryshimeve paraqiteshin shkencëtarët serbë me argumentet, kunkluzionet dhe porositë e tyre, por

[14] Famullitarët shqiptarë në raportin e tyre drejtuar Lidhjes së Kombeve në vitin 1930 për krimet e pushtetit serb ndaj shqiptarëve, i zënë në gojë shpesh krimet e organizatave çetnike si "Narodna odbrana" dhe "Bella ruka" si krah i shkëputur i "Cërna rukës" (*La situation de la minorité albanaise en Yougoslavie.* Memoire presenté à la Société des Nations par Don Bisaku, Don Etienne Kurti et Don Louis Gashi), Genève, le 5 mai 1930).

[15] E. Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, 8 Nëntori, Tiranë, 1991, f. 405.

[16] Leo Freundlich, *Albaniens Gologota,* Vienna, 1913. Të vetmen kopje të broshurës "Golgota shqiptare" të Frojndlihut e zbuloi në Bibliotekën e Harvardit z. Safete S. Juka, të cilën nga gjuha gjermane e perktheu në gjuhën angleze në vitin 1991. Ndërkaq, në vitin 1992 rrëfimet u botuan në gjuhën gjermane dhe kroate në Hamburg, me një parathënie të Hans Peter Rullman-it. Në vitin 2001, broshura me titull "Shfarosja e shqiptarëve" doli në gjuhën shqipe në Prishtinë, në përkthim të Salih Maqedoncit. Broshurën nga gjermanishtja në anglisht e përktheu edhe Robert Elsie. Shih: R. Elsie, *Gathering Clouds. The roots of ethnic cleansing in Kosovo and Macedonia*, Balkan Books, Dukagjini, Pejë, 2002. Shih tekstin e plotë të broshurës në librin: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 128-174.

gjithnjë nga pozitat e hegjemonizmit serb. Ndër ta dallohej veçanërisht *Jovan Cvijiqi* (1865-1927), një figurë e njohur në shkencën dhe politikën serbe të kohës. Veproi dhe në shumë çështje influencoi në kohën e thyerjeve të rëndësishme historiko-politike, gjeopolitike dhe etnodemografike në Ballkan pas Krizës Lindore dhe Kongresit të Berlinit (1878), përfundimit të sundimit pesëqindvjeçar osman (1912), luftërave ballkanike (1912-1914), copëtimit të tërësisë etnike shqiptare (1913), Luftës I Botërore (1914-1918), krijimit të Jugosllavisë Serbe të Versajës (1919) etj. Serbinë e Madhe si ide dhe aspiratë politike, të përpunuar "shkencërisht" e gjejmë pikërisht në veprat antropogjeografike dhe etnografike të Cvijiqit, por të paraqitur edhe para tij dhe të përsëritur agresivisht shumë herë pas tij.

Për Kosovën dhe shqiptarët Cvijiqi bën fjalë në shkrimet e botuara kryesisht midis viteve 1912 dhe 1921, të cilët i trajton në kuadër të çështjeve mbi Siujdhesën Ballkanike, gjeomorfologjinë, antropogjeografinë dhe etnologjinë e tij, mbi daljen e Serbisë në Detin Adriatik etj. Për arsye se këto shkrime gjenden të shkapërderdhura në organe të ndryshme të kohës brenda temave të ndryshme etnogjeografike dhe më tepër si fragmente në to, këtu edhe nuk mund t'i sjellim si dokumente apo shqyrtime të veçanta. Pikëpamjet e Cvijiqit do t'i analizojmë dhe komentojmë në këtë pjesë të shqyrtimeve tona më hollësisht, duke i cituar besnikërisht nga tekstet e shumta të tij, të publikuara në "Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije", "Glasnik Srpskog geografškog društva", "Govori i članci", "Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje", "Etnografski spisi" etj.

Cvijiqi shquhej sidomos në Konferencën e Paqes në Versajë (1918-1919), ku në cilësinë e ekspertit kishte një rol jo të vogël edhe politik në vlerësimin e rrethanave dhe argumenteve "nga terreni" për caktimin e kufijve midis shteteve dhe bashkësive etnike, ku më së shumti u dëmtuan shqiptarët. Ai ishte shef i delegacionit serb në këtë konferencë dhe drejtonte edhe seksionin etnografiko-historik të saj, ku bëheshin edhe hartat etnike dhe caktoheshin kufijtë. Në shoqërinë e atëhershme serbe, por edhe në qarqe të caktuara evropiane Cvijiqi konsiderohej si njohës më i mirë i Ballkanit, i gjeomorfologjisë së tij, i strukturës shoqërore dhe i marrëdhënieve midis popujve, ndërsa në fillim të shekullit të kaluar do të bëhej shumë i angazhuar edhe në skenën publike të Serbisë (dy herë rektor i Universitetit të Beogradit; shumë vjet kryetar i Akademisë Mbretërore të Shkencave, etj.)[17]. Ai kishte themeluar shkollën gjeografike të drejtimit

[17] J. Cvijiqi ishte edhe mik i shquar i klubit "Slovenski jug", anëtarët e të cilit vepronin legalisht në klub, ndërsa ilegalisht në organizatën terroriste "Crna ruka" (B. Čović, "Politika, obmana i nasilja", Grup autorësh, *Izvori velikosrpske agresije,* Rasprave-dokumenti, (Red. B. Čović), A. Cesarec-Š. knjiga, Zagreb, 1991, f. 32).

antropogjeografik, në kuadër të të cilit themeloi edicionin "Vendbanimet dhe prejardhja e popullsisë", brenda të cilit deri më sot dolën dhjetëra libra e monografi, ku përveç tjerash, lëndohej rëndë e kaluara, veçoritë antropologjike dhe psikologjike të shqiptarëve, realiteti etnik e demografik i Kosovës dhe i viseve përreth etj. Prandaj, nuk është gjë e rastit që viteve të 80-ta të shekullit të kaluar kërkohej nga qarqet shkencore dhe ortodoksiste serbe të ringjallej shkolla antropogjeografike e Cvijiqit.[18]

Në veprat e tij, që kishin të bënin me Siujdhesën Ballkanike, i kishte vënë *bazat gjeografike dhe gjeopolitike të synimeve ekspansioniste serbe ndaj vendeve fqinje dhe popujve joserbë, në veçanti josllavë.* Me një perfiditet e dinakëri spekulonte me argumentet etnodemografike dhe gjeopolitike në favor të serbëve e në dëm të të tjerëve, duke e hedhur tezën se serbët kanë një shtrirje të gjerë gjeografike në Ballkan dhe në Evropën JL dhe në këtë shtrirje nënkuptonte edhe territoret të cilat serbët, sipas tij, i kishin populluar më herët, por që për shkaqe të ndryshme i kishin braktisur dhe tashmë kishin mbetur pakicë. Se në interpretimet e tij politiko-gjeografike, në emër të shkencës zbatonte kritere joshkencore dhe mbështeste e nxiste aspiratat hegjemoniste dhe nacionalshoviniste e raciste serbe shihet më së miri në konstatimin e tij se *"serbët janë një popull relativisht i madh, i cili është gjithnjë në rritje. Ne jemi popull me vetëdije më të lartë kombëtare në Ballkan",*[19] *duke u kërcënuar se Serbia "në pikëpamje kombëtare-politike është shtet i rrezikshëm".*[20]

Për ta justifikuar ekspansionin territorial të Serbisë dhe të serbëve Cvijiqi gjithnjë përpiqej të gjente dhe ofronte argumente dhe përfundime se serbët si historikisht, ashtu edhe në pikëpamje etnografike dhe antropogjeografike, si *"popull në rritje"* dhe me *"vetëdije më të fortë kombëtare"*, kishin të drejtë që në shtetin serb të përfshinin edhe vendet e tjera rreth Serbisë dhe natyrisht të dominojnë politikisht dhe në aspektin ekonomik. Megjithatë, duhet theksuar se në këto kërkesa Cvijiqi nuk ishte krejtësisht origjinal, sepse insistimet mbi ekspansionin e Serbisë edhe jashtë kufijve të saj i gjejmë së pari te I. Garashanini në formulimin "Shteti serb duhet patjetër të zgjerohet dhe forcohet". Është ky një angazhim i Cvijiqit për "hapësirën jetësore" të serbëve, identike me qëllimet gjeopolitike të qarqeve naciste midis dy luftërave botërore. Kur i duhej t'i arsyetonte kërkesat shtetomëdha dhe ekspansioniste serbe, i shkelte parimet etnografike apo historike që i proklamonte si bazë për "të drejtat historike" të serbëve dhe si argumentim i merrte kriteret gjeopolitike, fiziko-

[18] D. Bogdanović, Intervistë në *Književne novine*, nr. 679, 1. 01. 1985, Beograd, f. 10.
[19] J. Cvijić, *Govori i članci, I,* Beograd, 1921, f., 63 (fjalë e mbajtur në vitin 1907).
[20] J. Cvijić, *Po aty*, f. 58 (fjalë e mbajtur në vitin 1907), nënvizoi H. I.

gjeografike dhe përmbajtjet e të ashtuquajturit determinizëm gjeografik. Në raste të tjera bënte të kundërtën. Duke konsideruar të pazgjidhur çështjen serbe, kërkonte madje që edhe "me forcë të zgjidhej problemi serb".[21]

I mohonte të drejtat historike të popujve të tjerë, veçanërisht të atyre fqinj me Serbinë, madje edhe i nënçmonte përmes glorifikimit të kombit serb, superioritetit dhe idealizimit të tij në Ballkan si "më i vetëdijësuari", "me tradita të gjalla", "me moral të lartë kombëtar" etj. Malazezët nuk i pranonte si komb dhe i konsideronte si një fis serb. Bullgarët gjithashtu i konsideronte si komunitet të paqartë në pikëpamje etnike, linguistike e psikologjike, por, sipas tij, të afërt me serbët, ndërsa maqedonasit i quante "masë flotante", pa vetëdije kombëtare, egoistë, trashanikë e tinëzarë, strukturë kombëtare serbo-bullgare[22] dhe Maqedoninë e cilësonte si "Serbi të Vardarit".[23]

Mirëpo, Cvijiqi me qëndrimet dhe pikëpamjet e tij "shkencore" më së largu shkoi kundër shqiptarëve, të cilëve: u mohonte qenien politike-kombëtare, i cilësonte si të paaftë për jetë autonome shtetërore dhe për të zhvilluar kulturën popullore, i quante pa traditë historike dhe pa vetëdije kombëtare, pa klasë intelektuale kombëtare, të prirur për dhunë dhe sjellje jokulturore dhe shtypje të egër të të tjerëve, sidomos të serbëve, barbarë, gjakpirës etj.[24] Këto teza, në themel raciste, do të hidheshin poshtë nga intelektualë të spikatur të kohës, çfarë ishte p. sh. shkrimtari dhe intelektuali i shquar kroat, Mirosllav Kërlezha.[25]

Cvijiqi ishte ithtar kryesor i ëndrrës dhe i kërkesës së kahmotshme për daljen e Serbisë në detin Adriatik (duke e imituar përsëri Garashaninin) dhe atë duke okupuar Bosnjën dhe Shqipërinë. Pas aneksimit të BeH (1908), Cvijiqi në kontekstin e synimeve të formimit të Serbisë së Madhe e arsyetonte kërkesën "që Serbia të marrë një pjesë të konsiderueshme të

---

[21] J. Cvijić, *Govori i članci, I*, 1921, f. 233 (botuar në vitin 1908).

[22] J. Cvijić, *Promatranja o etnografiji Makedonije, në Govori i članci,* Knjiga 3, Beograd, 1987, f. 153 (botuar më 1905 dhe 1906).

[23] J. Cvijić, *Govori i članci, II*, 1921, f. 47 (botuar në "Glasnik Srpskog geografskog društva", 1914).

[24] J. Cvijić, *Govori i članci,* Beograd, 1987, f. 139 (botuar më 1913); *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje. Osnove antropogeografije,* Zagreb, 1922, f. 393.

[25] Këto teori të Cvijiqit, por edhe të autorëve të tjerë serbë, ku shqiptarët cilësoheshin "me bishta, me bishta të kalit apo të dhisë", "krijesa të egra", "melezë të tipave të ndryshëm etnologjikë", "banda", "hajdutë" etj., Kërlezha i quajti "kanibaliste" dhe i demaskoi rëndë (*Izabrana dela Miroslava Krleže u deset knjiga,* Deset krvavih godina, Sloboda, Beograd, 1977, f. 390-394; *Srbija i Albanci. Pregled politike Srbije prema Albancima od 1878. do 1914. godine,* Knjiga prva, Ljubljana, 1989, ff. 94-101).

territorit të banuar me serbë me qëllim të daljes në Detin Adriatik".[26] Ndërkaq, në shkrimin e tij, atëherë shumë aktual në qarqet serbe dhe më gjerë, "Dalja e Serbisë në Detin Adriatik" (1912)[27], ai thekson se "nga aspekti gjeografik Serbia kishte dy mundësi që me zgjerimin e territorit të saj të del në det" dhe atë përmes luginës së Moravës dhe të Vardarit në gjiun e Selanikut (në Detin Egje) dhe përmes luginës së Drinit dhe Matit që shpie në portet e Durrësit dhe Medovës (në Detin Adriatik).[28] Ishte e kahmotshme ideja megalomane e Serbisë që këto dy lugina, e Moravës dhe e Vardarit, të bëheshin të lundrueshme përmes një sistemi të komplikuar dhe shumë të shtrenjtë të lundrimit, duke kaluar madje edhe pengesën jo të vogël relievore midis Preshevës dhe Kumanovës! Ai kishte përpunuar edhe idenë për daljen e Serbisë në Detin Adriatik përmes ndërtimit të një hekurudhe që duhej të kalonte nëpër luginën e Drinit.[29]

Në shkrimet e tij, Cvijiqi i shkel të gjitha parimet shkencore dhe i ndërron tezat vetëm e vetëm për t'i arsyetuar qëllimet okupuese serbe ndaj hapësirës shqiptare dhe nënvizon *"se synimet e Serbisë për bregdetin shqiptar janë të arsyeshme dhe të kushtëzuara jo vetëm gjeografikisht, por kanë edhe një traditë historike"* dhe *" kur është fjala për vendet të cilat në traditën historike kanë një rëndësi të madhe, atëherë parimi historik në vetëdijen popullore është më i rëndësishëm se parimi etnografik".*[30] Insistimi i tij veçanërisht në injorimin e realitetit etniko-demografik të popujve joserbë, në këtë rast të shqiptarëve, shihet në konstatimin se "Populli më shumë entuziazmohet me vendin i cili në të kaluarën historike ishte i tij, me traditat e tij, dhe gati nuk i intereson se cili popull sot jeton aty. Territoret e tilla i konsideron si trashëgimi të tyre të veten, në të cilin, për fatkeqësi të tij, është ngulitur një popull tjetër, dhe kjo nuk është pengesë që të ketë të drejtë ta marrë vendin".[31] Ndërsa, më vonë, në raste të tjera, thoshte: "Kufiri etnografik është mbi kufirin gjeografik",[32] por në rastin e zgjerimit territorial të Serbisë, të drejtat e saj për të pushtuar Kosovën dhe Shqipërinë e Veriut, i bazon në tërësinë territoriale natyrore-gjeografike të Serbisë. Mësimet e Cvijiqit i përdorte shkenca dhe politika serbe në vitet e 80-ta e të 90-ta të shekullit të kaluar në ngjarjet e Kroacisë

[26] J. Cvijić, *Govori i članci,I*, 1921, f. 211 (botuar më 1908).
[27] J. Cvijić, "Izlazak Srbije na Jadransko more", *Glasnik Srpskog geografskog društva*, God. 1, br. 2, Beograd, 1912, ff. 192-205.
[28] J. Cvijić, Po aty, ff. 195-196.
[29] J. Cvijić, Po aty, f. 197.
[30] J. Cvijić, *Govori i članci, II*, 1921, ff. 18-19 (botuar më 1912), nënvizoi H. I.
[31] J. Cvijić, *Govori i članci, II*, 1921, f. 41 (botuar më 1914).
[32] J. Cvijić, *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje. Osnove antropogeografije*, Zagreb, 1922, ff. 254-255.

dhe të Kosovës. Në Kroaci kërkonte ta zbatonte parimin etnografik (territoret me shumicë serbe), ndërsa në Kosovë parimin historik (miti mbi Kosovën, shteti mesjetar serb, kishat dhe manastiret)!

Në kohën e luftërave ballkanike dhe veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Cvijiqi do t'i radikalizojë edhe më shumë qëndrimet e tij "shkencore" ndaj shqiptarëve dhe truallit të tyre gjeoetnik, duke u angazhuar haptazi në anën e politikës serbe për okupimin e territorit etnik shqiptar. Në aspiratat për dalje në detin Adriatik dhe uzurpimin e territorit shqiptar kërkon mbështetje edhe në tezën absurde të përzierjes *sui generis* të shqiptarëve dhe serbëve, duke theksuar se "Serbia për shkak të pavarësisë së saj ekonomike duhet patjetër të del në Detin Adriatik dhe në një pjesë të bregdetit shqiptar qoftë me uzurpimin e territorit, qoftë përmes sigurimit të të drejtave ekonomike dhe komunikative për këtë hapësirë. Kjo vërtet do të thotë marrjen e një krahine të huaj etnografike, por që duhet të merret për shkak të interesave të veçanta ekonomike, përkatësisht për shkak të nevojave jetësore. Një uzurpim i tillë ndoshta do të mund të quhej domosdoshmëri antietnografike dhe në këtë formë ai nuk është as kundër parimit të kombësisë. Në këtë rast, një uzurpim i tillë edhe mund të gjejë arsyetim në faktin se shqiptarët e Shqipërisë së Veriut janë produkt i një amalgami shqiptaro-serbësh dhe se aty gjenden gjurmët e popullsisë serbe"![33]

Një nga tezat kryesore të Cvijiqit ishte se *shqiptarët janë të ardhur masivisht nga Shqipëria Veriore në territoret "e shpirtit mesjetar serb",* pra në Kosovë e gjetiu dhe kjo kinse paska ndodhur pas "dyndjes masive" të serbëve në drejtim të veriut pas luftërave austriako-turke të viteve 1689-1690 dhe 1737-1739, kur kjo hapësirë na qenka shndërruar në një "vakum demografik", të cilën e paskan mbushur shqiptarët, duke i "islamizuar dhe shqiptarizuar" në përmasa të mëdha serbët e mbetur. "Shqiptarët përmes Dukagjinit dhe Kosovës depërtuan në VP deri në Leskovc, ndërsa përmes Karadakut në oaza të vogla deri në Kumanovë…dhe u larguan nga territori i vërtetë etnik i tyre më se 200 km; duket se ky vërshim i shqiptarëve më së shumti ka përparuar në shek. XVII, VXIII dhe në gjysmën e parë të shek. XIX, duke bërë islamizimin dhe shqiptarizimin e serbëve në përmasa të mëdha dhe shpejt"![34] Kjo tezë gjeti ithtarë edhe në diskurset politike të serbëve kundër

[33] J. Cvijić, "Izlazak Srbije na Jadransko more", *Glasnik Srpskog geografskog drustva*, God. 1, br. 2, Beograd, 1912, f. 202-203; shih edhe në *Govori i članci, II*, 1921, f. 22-23 dhe *Govori i članci,* knjiga 5, 1989, f. 20 (teksti i vitit 1912).

[34] J. Cvijić, *Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije*, knjiga treća, Srpska kraljevska akademija, Beograd, 1911, 1161-1272; Govori i članci, Knjiga 3, Beograd, 1987, f. 139 (botuar më 1913); *Balkansko poluostrvo i južnoslovenskje zemlje. Osnove antropogeografije*, Zagreb, 1922, f. 393-394.

shqiptarëve gjatë viteve të 80-ta e këndej të shekullit XX. Mirëpo, kjo tezë e Cvijiqit dhe e ithtarëve të tij, siç theksuam edhe më parë, nuk qëndron për shumë arsye, para së gjithash për *shkaqe gjeografike dhe demografike*: Shqipëria Veriore si territor malor, me resurse të kufizuara ekzistenciale, nuk ka mundur të ketë popullsi kaq të madhe për ta popullzuar gjithë Kosovën dhe viset rreth saj, sepse siç dëshmojnë regjistrimet e përmendura kadastrale turke, qysh në shek. XV dhe XVI kjo pjesë e Shqipërisë së sotme malore kishte disa herë më pak popullsi dhe vendbanime sesa Rrafshi i Dukagjinit dhe Fusha e Kosovës. Këtë e dëshmon studimi i gjendjes sociale-demografike dhe i pasqyrës etnike, në bazë të të dhënave që i ofron dokumentacioni osman, defterët kadastralë. Në gjysmën e dytë të shek. XV trevat malore të Shqipërisë së Veriut, për shkak të kushteve jo të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike, kishin 115 fshatra me 1.799 shtëpi (0,5 shtëpi për një kilometër katror), ndërsa krahinat e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Fushës së Kosovës kishin 1.202 vendbanime me 28.141 shtëpi (2-3 shtëpi për një kilometër katror); sipas burimeve osmane vetëm sanxhaku i Prizrenit dhe i Dukagjinit kishin më tepër se 20.800 shtëpi.[35] Ndërkaq, në fund të shek. XVI në trevat malore të Shqipërisë së Veriut popullsia shtrihej në 156 fshatra me 3.201 shtëpi, kurse hapësira e Rrafshit të Dukagjinit dhe e Fushës së Kosovës kishte 1.758 vendbanime me 38.844 shtëpi.[36] Historiani anglez N. Malcolm, duke iu referuar rezultateve të studimeve të M. Tërnavës [37] dhe të S. Pulahës, konkludon se "Popullata e Kosovës gjatë kësaj periudhe ishte më e madhe se popullata e Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Veriut, ku nataliteti ishte më i ulët se në Kosovë".[38]

Ndonëse posedonte shumë informacione dhe të dhëna nga terreni, në interpretimin e tyre Cvijiqi ishte joobjektiv, spekulant e konstruktues i konkluzioneve, shovinist e hegjemon. Sipas nevojës së situatave dhe interesave të politikës gllabëruese serbe ai ndërronte tezat dhe kriteret në vlerësimin e dukurive, ngjarjeve, fakteve dhe realitetit hapësinor. Për një të vërtetë shkencore thoshte duhen argumente dhe kritere të qarta e të

---

[35] A. Buda, *Shkrime historike, 4*, Toena, 2000, f. 292.

[36] S. Pulaha, "Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shekujve XV-XVI", *Studime historike,* nr. 3, Tiranë, 1985, ff. 175-184; ky punim është botuar edhe në publikimin *Studime për epokën e Skënderbeut, 1,* Tiranë, 1989, ff. 44-55. Shih edhe burimet e tjera që shënohen te Pulaha, sikurse: H. Inalcik, *Sureti defteri sancaki arvanid,* Ankara, 1954; N. Todorov, "Za demografskoto sostojanije na balkanskija poluostrov prez XV-XVI vek", *Godišnjak na Sofiskija Universitet,* tom LII, 2, Sofija, 1960; *Başbakanlik arşivi,* defter nr. 231, 508; H. Hadžibegić, A. Handžić, E. Kovačević, *Po aty.*

[37] M. Tërnava, "Migrimet e popullsisë në territorin e sotëm të Kosovës gjatë shekujve XV-XVI", *Kosova, 5,* Prishtinë, 1976, ff. 295, 304-309.

[38] N. Malkolm, *Kosova. Një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 1998, f. 116.

verifikuara, por në favor të Serbisë e të serbëve i gjente të gjitha argumentet dhe i zbatonte të gjitha kriteret, duke filluar nga ato gjeomorfologjike e gjeografike e deri te faktorët gjeopolitikë, etnodemografikë dhe historikë, ndërkaq për vendet fqinje dhe popujt joserbë argumentet dhe faktorët e njëjtë i kontestonte. Thoshte p.sh. "Hartat etnografike dhe shkrimet etnografike, sipas rregullit, janë shoviniste: ata që i kanë bërë ose që i kanë shkruar krahinat kalimtare, etnikisht të përziera, kryesisht i kanë konsideruar të kombësisë të cilës vetë i përkisnin".[39] Por Cvijiqi ishte vetë ai që më së shumti kishte vizatuar harta etnike dhe kishte bërë shkrime etnografike, gjithnjë në favor të serbëve e në dëm të të tjerëve dhe atë pikërisht për territoret e tilla etnikisht të përziera.[40]

Vlerësimet dhe konkluzionet kontraverze dhe natyrisht joshkencore të Cvijiqit kishin pasoja afatgjata negative për vendet fqinje dhe popujt joserbë, veçanërisht sa i përket përkufizimeve territoriale dhe raporteve politike e të tjera midis Serbisë dhe serbëve dhe shteteve e popujve të tjerë, sidomos shqiptarëve. Projekti i regjimit të Millosheviqit i fundit të shek. XX "Të gjithë serbët në një shtet të vetëm" ose britmat e Drashkoviqit se "atje ku është edhe varri i vetëm serb, ajo është tokë serbe",[41] që në të dy rastet nënkupton formimin e Serbisë së Madhe me mjete të dhunës dhe me metoda gjenocidale, përveç tjerash, bazoheshin edhe në mësimet e Cvijiqit.

---

[39] J. Cvijić, *Govori i članci,II*, 1921, f. 203 (botuar më 1920).

[40] Shih më gjerë: S. Žuljić, "Antropogeografske podvale Jovana Cvijića", *Izvori velikosrpske agresije,* Rasprave-dokumenti, (Red. B. Čović), A. Cesarec-Školska knjiga, Zagreb, 1991, ff. 327-380.

[41] "Vuk Drashkoviqi, figura më interesante e opozitës serbe. Kishte qenë romansier fjalëshumë, tani kërceu në skenën politike si ekstremist, i plotësuar me mjekrën si të dhiatës së vjetër, me ide raciste dhe me pamjen e një fshatari serb" (W. Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, Besa - Libra për një shoqëri të hapur, Tiranë, 1996, f.107).

Në Këshillin iniciativ të Partisë së Përtëritjes Popullore Serbe në Nova Pazovë (më 6. I. 1990, në ditën para Kërshëndellave ortodokse), që i parapriu formimit të partisë së sotme të Vuk Drashkoviqit, Lëvizjes Serbe të Pëtëritjes, Drashkoviqi, përveç tjerash, theksoi se kjo parti do të angazhohet për "demontimin e shtetit shqiptar në Kosovë e Metohi" në atë mënyrë që "të gjithë shqiptarët, të cilët, që nga 6 prilli 1941 e deri më sot janë vendosur në Kosmet ose kudo në Serbi, do të kthehen në Shqipëri së bashku me pasardhës", "për mbylljen e shkollave në gjuhën shqipe, ndalimin e përdorimit të simboleve kombëtare" etj. (D. Vukomanović, "Hronologija nastanka političkih partija", në librin *Srbija između prošlosti i budućnosti - Uzroci i obeležja društvene i političke situacije izmedju 1987-1994. i mogućnosti demokratizacije*, Institut društvenih nauka, Forum za etničke odnose, Beograd, 1995, f. 175).

III. PROJEKTET SERBE TË PJESËS SË PARË TË SHEK. XX PËR DËBIMIN E SHQIPTARËVE DHE SERBIZIMIN E TROJEVE TË TYRE

1. Politika kolonizuese serbe dhe reforma agrare në funksion të dëbimit të shqiptarëve midis dy luftërave botërore

Jugosllavia e Versajës (1919) në mënyra të ndryshme bëri përpjekje ta zvogëlonte numrin e shqiptarëve, ta shkatërronte tërësinë kompakte hapësinore etnike të tyre dhe, përmes politikës kolonizuese ta krijonte territorin e pastër etnik në rajonet e banuara nga shqiptarët. Për këto qëllime ndërmori një varg masash drastike të natyrës ekonomike, sociale, juridike e politike, masa për shpërnguljen e dhunshme në Turqi, Shqipëri e në vende të tjera, për asimilim, pastaj ushtroi tortura fizike policore e deri te përpjekjet për shfarosje fizike.[1] Famullitarët shqiptarë në Memorandumin e tyre drejtuar Lidhjes së Kombeve në Gjenevë në vitin 1930[2] theksonin "gjendjen e pikëllueshme që ua ka shkaktuar shqiptarëve dominimi serb; ne me siguri nuk do të jemi të fundit që do të reklamojmë para kësaj instance të lartë të drejtësisë ndërkombëtare nëse nuk ndryshon në themel e në procede politika e qeverisë së Beogradit ndaj subjekteve shqiptare. Kjo politikë tashmë tepër e pasur me eksese e me fatkeqësi, përmblidhet me dy fjalë: *të ndryshohet me çdo kusht karakteri etnik i regjioneve të banuara nga shqiptarët*. Procedetë janë vijueset: a) përndjekje të çdo lloji për t'i shtrënguar të shpërngulen; b) përdorim i dhunës për shkombëtarizimin e detyrueshëm të popullatës, të vënë në pamundësi të reagojë; c) ndjekje dhe shfarosje e elementeve që nuk pajtohen as ta braktisin vendin, as t'i nënshtrohen gjakftohtësisht sllavizimit".[3]

Kjo Jugosllavi, si kreaturë artificiale, që nga ditët e para të krijimit të saj, nisi me reforma agrare dhe kolonizime, të cilat, në të vërtetë, ishin vazhdim i atyre nga viti 1912, kur Serbia e okupoi Kosovën, duke bërë krime të mëdha

---

[1] Shih më gjerë punimet e autorit H. Hoxha: "Elemente të presionit ekonomik ndaj shqiptarëve në Jugosllavinë e vjetër, *Përparimi*, nr. 4, Prishtinë 1970; "Politika e eliminimit të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë së vjetër", *Përparimi*, nr. 5, 1970; "Proces nacionalne afirmacije albanske narodnosti u Jugoslaviji", *Časopis za kritiko znanosti*, št. 51-52, Ljubljana, 1982, ff. 244 - 318.

[2] Shih tekstin e plotë të këtij "Memorandumi" në librin: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 189-224.

[3] *La situation de la minorité albanaise en Yougoslavie* (Memoire presenté à la Société des Nations par Don Bisaku, Don Etienne Kurti et Don Louis Gashi), Genève, le 5 mai 1930.

në popullatën shqiptare.[4] Për këto qëllime u nxorën një varg ligjesh, dekretesh, rregulloresh, udhëzimesh, urdhrash, instruksionesh e vendimesh, madje u formuan edhe banka të veçanta agrare.[5] Në vitet e para, kolonizimi nuk funksiononte ashtu siç pritej, sepse nuk ishin kryer mirë përgatitjet, prandaj vala e parë e kolonistëve nuk ishte e kënaqur me premtimet e shtetit sa i përket tokës së marrë dhe beneficioneve të tjera. Por, më vonë, pas vitit 1923, pasi u studiuan mirë rrethanat dhe u nxorën dekretligje të reja mbi kolonizimin dhe "për të krijuar komplekse kolonizuese edhe atje ku nuk kishte tokë të lirë, të komunës apo të shtetit, pushteti angazhohej t'u merrte sa më shumë tokë të bukës shqiptarëve... Atëherë shumë familje shqiptare mbesin pa asnjë pëllëmbë toke ose iu la vetëm toka rreth shtëpive".[6] Shqiptarëve iu morën shumë sipërfaqe të tokës së punueshme dhe të tokës bujqësore. Sipas raportit të njërit nga ideologët kryesorë të reformës agrare midis dy luftërave botërore Gjorgje Kërstiqit,[7] vetëm deri në vitin 1928 në rajonin e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës u ndanë më tepër se 45.000 hektarë tokë,[8] ndërkaq deri në vitin 1940, sipas raporteve të Drejtoratit Suprem të Reformës Agrare në Shkup, vetëm disa drejtorate agrare në Kosovë dhe Shkup për nevoja të reformës agrare morën 381.245 hektarë tokë. Prej kësaj sipërfaqe 228.080 hektarë tokë i morën drejtoratet agrare në rrethinën e Pejës, të Ferizajt, të Mitrovicës dhe të Prizrenit.[9] Edhe pas marrjes së "tokës së lirë", shqiptarët ishin të detyruar të

---

[4] L. Rushiti, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912 - 1918*, Prishtinë, 1986, ff. 105 - 127. Në vitet 1912-1913 në disa vise të Kosovës pati përpjekje të pushtuesve serbo-malazezë që t'ua ndërronin edhe fenë shqiptarëve myslimanë, t'i konvertonin në ortodoksë (Shih për këtë: Z. M. Harapi, *Ditët e trishtimit në Pejë e nder rrethe, 1912-1913,* Dukagjini, Pejë, 2004, ff. 53-64).

[5] J. Osmani, "Zakonski propisi o agrarnoj reformi i kolonizaciji na Kosovu između dva svetska rata", *Vjetar - Godišnjak*, XX, Prishtinë, 1985, ff. 169 - 189.

[6] M. Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918 - 1941)*, Institut za istoriju Kosova, Priština, 1981, f. 231.

[7] I biri i Gjorgje Kërstiqit, Branisllav Kërstiqi (1922), arkitekt i pensionuar, nga viti 1994 e këndej paraqitet si eksponent i politikës së shkatërrimit të individualitetit të Kosovës dhe të politikës kolonizuese në Kosovë. Sa herë që kishin dhe kanë nevojë qarqet qeveritare serbe dhe kisha ortodokse serbe për copëtimin e territorit të Kosovës paraqitet B. Kërstiqi me projektet e tij. Ai ishte mbështetës i flaktë i politikës së centralizimit në ish-Jugosllavi dhe kundërshtar i politikës së decentralizimit (B. Krstić, *Kosovo između istorijskog i etničkog prava,* Beograd, 1994; *Kosovo pred sudom istorije,* Beograd, 2000).

[8] Đ. Krstić, *Kolonizacija u Južnoj Srbiji*, Bosanska pošta, Sarajevo, 1928, ff. 5, 52.

[9] *Arhiv Jugoslavije*, F. 48 (Statistički pregled obavljenih radova do 1940), Tehničkog odseka Vrhovnog povereništva agrarne reforme u Skoplju na dan 11. XI. 1940; sipas A. Hadri, "Pozita dhe gjendja e Kosovës në mbretërinë e Jugosllavisë (1918 - 1941)", *Gjurmime albanologjike*, nr. 2, Prishtinë, 1968, f. 167.

paguanin tatim për "tokat e huaja".[10]

Deri në vitin 1936 u bë kolonizimi i 15.594 familjeve, u ngritën për kolonistë 11.289 shtëpi,[11] ndërsa deri në vitin 1940 në të ashtuquajturat "viset jugore" u ndërtuan 15.943 shtëpi për kolonistë.[12] Sipas M. Obradoviqit në Kosovë midis dy luftërave botërore u bë kolonizimi i 11.383 familjeve me 53.883 anëtarë dhe i 11.729 anëtarëve të tjerë, si kolonistë të rëndomtë (kolonistë, optantë, çetnikë, autokolonistë). Mirëpo, thekson ky autor, ky numër mund të jetë edhe më i madh. Më tepër kolonistë u sollën në viset kufitare me Shqipërinë, në rrethet e atëhershme të Gjakovës (2.638 familje me 11.181 anëtarë) e të Pejës (1.594 familje me 7.175 anëtarë), pastaj të Gjilanit (1.497 familje me 7.945 anëtarë), të Istogut (711 familje me 3.208 anëtarë), të Graçanicës (1.065 familje me 5.491 anëtarë), të Podrimës (711 familje me 4.886 anëtarë), të Drenicës (563 familje me 2.321 anëtarë), të Llapit (585 familje me 3.421 anëtarë), të Vushtrisë (553 familje me 2.086 anëtarë) etj.[13]

Numri i familjeve që morën tokë ishte 11.722 (10.714 familje kolonistësh, 508 familje autokolonistësh, 248 familje vullnetarësh, 172 familje optantësh dhe 80 familje çetnikësh) në fond prej 99.308 hektarësh.[14] Shrytëzues të reformës agrare ishin edhe të ashtuquajturat ekonomitë shembullore, shkollat bujqësore, shkollat popullore fillore, kishat ortodokse dhe manastiret, ushtria e gjandarmëria, institucionet kulturore etj., të cilave u ishin ndarë gjithsej 104.139 hektarë tokë.[15] Secila familje mori mesatarisht nga 8,47 hektarë tokë, ndërsa mbi këtë mesatare morën optantët (11,11 hektarë) dhe çetnikët (9,48 ha); çetnikët morën më tepër për familje në rrethin e Gjakovës (23,5 ha), të Graçanicës (13,0 ha), të Drenicës (12,20 ha) dhe të Pejës (10,07 ha). Vështruar sipas viteve, intensiteti më i madh i kolonizimit ka qenë në vitet 1928, 1936 dhe 1937.[16] Një numër i kolonistëve, veçanërisht në Rrafshin e Dukagjinit, që mori tokat më pjellore, kurrë nuk u mor me bujqësi dhe jetonte në qytet, duke e dhënë tokën përgjysmë.[17] Pushteti u dha tokë edhe komunarëve, gjindarmëve, vullnetarëve, çetnikëve, optantëve, organeve të

---

[10] H. Hoxha, "Elemente të presionit ekonomik ndaj shqiptarëve në Jugosllavinë e vjetër", f. 329.

[11] A. Urošević, "Agrarna reforma i naseljavanje u Južnoj Srbiji", *Spomenica 25. godišnjice oslobodjenja Južne Srbije*, Skoplje, 1936, ff. 826 - 932.

[12] *Arhiv Jugoslavije*, F. 48; A. Hadri, *Lëvizja nacionalçlirimtare në Kosovë (1941 - 1945)*, Prishtinë ,1971, ff. 22 - 23.

[13] M. Obradović, *Po aty*, ff. 221-222.

[14] M. Obradović, *Po aty*, ff. 210-211.

[15] M. Obradović, *Po aty*, ff. 215-217.

[16] M. Obradović, *Po aty*, ff. 210, 213-214.

[17] R. Abdyli, *Gjendja dhe pozita e klasës punëtore në Kosovë ndërmjet dy luftërave 1918 - 1941* (Disertacion i doktoratës në dorëshkrim), Prishtinë, 1982, f. 49.

besueshme të reformës agrare etj.[18]

Qëllimi i reformës agrare dhe i kolonizimit nuk ishte që të likuidoheshin mbeturinat e marrëdhënieve çifligare feudale dhe të zgjidheshin problemet jetësore të popullsisë autoktone dhe të kolonizuar në Kosovë dhe në Maqedoni, siç proklamohej,[19] por që shqiptarët të persekutoheshin dhe të varfëroheshin deri në atë masë sa të shpërnguleshin në Turqi e Shqipëri dhe në këtë mënyrë të ndërrohej përbërja kombëtare e popullsisë së këtyre territoreve, ose, siç shkruante M. Obradoviq "të bëhej serbizimi i Kosovës".[20] "Me kolonizimin e serbëve dhe malazezëve duhej të ndryshohej përbërja kombëtare e Kosovës në dëm të shqiptarëve, ndërsa, duke u mbështetur në eksponentët e regjimit (serbë, malazezë, pjesërisht edhe shqiptarë) duhej të sigurohej pozita shoqërore-ekonomike dhe politike e hegjemonistëve serbomëdhenj. Borgjezia serbe është përpjekur që t'i asimilojë shqiptarët në Kosovë, t'i çkombëtarizojë, por edhe t'i zhdukë fizikisht. Gjendja e tillë ka shkaktuar urrejtjen e tyre ndaj Jugosllavisë borgjeze deri në atë masë sa që mezi pritnin që regjimi i tillë të ndryshohej, madje edhe me intervenim të jashtëm".[21]

F. S. Noli theksonte: "Është fjala për afro një milion fshatarë të privuar nga të drejtat më elementare. S'ka asnjë të vetme shkollë shqiptare për këtë popullatë kompakte që në sasi kapërcen atë të Shqipërisë ...asnjë shoqëri, bile as mirëbërëse s'iu është lejuar shqiptarëve. Asnjë deputet nuk i përfaqësonte në Skupçinë e shpërndarë...Sa për turmat fshatare, këto i çfarosin me zbrazje mitrolozash, ose i shtrëngojnë të emigrojnë. Me dhjetëra mijë fatzezë shtrëngohen kësisoj t'i lënë vatrat e tyre çdo mot.

Ajo që është ca më e keqe, asnjë shtet nuk do t'i pranojë këta refugjatë. Turqia mori sa deshi, Shqipëria është tepër e varfër për t'iu treguar një fole e re, vendet e tjera janë mbyllur për këtë lloj emigranti me shumicë. Përpara Evropës përsëritet një tragjedi aq e përgjakshme sa ajo e armenëve në Azinë e Vogël. Po tragjedia e armenëve ndodhi në kohën e Luftës Mondiale kur ishte zor të qenët njerëzor, kurse tragjedia shqiptare në Jugosllavi ndodh përpara syve tanë në paqe të plotë, kur është zor të mendohet që njeriu mund të jetë kaq gjakpirës".[22]

---

[18] Đ. Krstić, *Po aty*, f. 5; "Pitanje agrarne reforme (mišljenja i zahtevi muslimana u Južnoj Srbiji), *Južni pregled*, br. 10, Skoplje, 1922, f. 66, 70.

[19] A. Urošević, Kosovo, SANU, Beograd, 1965, f. 22 e tutje.

[20] M. Obradović, *Po aty*, f. 5.

[21] *Vojna enciklopedija, II* izdanje, Beograd, 1972; *Srbija i Albanci. Pregled politike Srbije prema Albancima od 1944. do 1989. godine,* Knjiga druga, Časopis za kritiko znanosti (izredna števila), Ljubljana, 1989, f. 11.

[22] Fan S. Noli, "Një tragjedi në tri akte: çpasurim, çpërngulje, çfarosje", *Liria Kombëtare*, nr. 110, 10 prill 1929, Gjenevë; Fan S. Noli, *Vepra*, 3, 1988, ff. 177 – 178.

Dendësia e madhe agrare, në disa pjesë të Kosovës madje edhe deri 400 banorë në 1 km katrore të tokës së punueshme, pastaj copëzimi i theksuar i pronave, shkalla e ulët e forcave prodhuese në bujqësi,[23] skamja dhe uria e pjesës dërmuese të popullatës ishin rrethana objektive që nuk lejonin popullzim plotësues të Kosovës. Meqenëse më tepër se 90% e popullsisë jetonte në fshat, ku kushti kryesor material i jetës ishte toka e punueshme, pushteti i atëhershëm e dinte mirë se me rrëmbimin e kësaj kafshate të vetme të bukës, shqiptarëve nuk u mbetej asgjë tjetër pos të shpërnguleshin në rajonet feudale e të shkreta të Anadollisë dhe në viset moçalike të Shqipërisë. Vetëm midis viteve 1928 dhe 1938, nga Kosova emigruan në Shqipëri rreth 11.000 shqiptarë,[24] ndërsa në periudhën 1924-1941, sipas disa vlerësimeve, në këtë vend emigruan rreth 50.000 shqiptarë, kurse sipas vlerësimit të famullitarëve shqiptarë, prej krijimit të Jugosllavisë së Versajës e deri në pranverë të vitit 1930 "140.000 shqiptarë e më tepër qenë të detyruar t'i braktisin vatrat e tyre dhe pasuritë dhe të shpërngulen në Turqi, në Shqipëri dhe në shtete të tjera fqinje, ngado që të shpresonin të gjenin strehim, një copë bukë dhe sidomos pak më shumë njerëzi".[25] Vlerësohet se prej vitit 1918 deri në vitin 1940 nga trualli i Jugosllavisë së atëhershme janë shpërngulur në Turqi, Shqipëri dhe në vende të tjera rreth 240.000 shqiptarë,[26] ndërsa sipas disa vlerësimeve të tjera ky numër mund të jetë edhe më i madh. Mirëpo, mbetet të hulumtohet dokumentacioni i kohës për t'u konstatuar jo vetëm numri i të shpërngulurve shqiptarë në Turqi, Shqipëri dhe në vende të tjera, por edhe përbërja e tyre sociale dhe faktet e tjera relevante të këtij procesi.

Nga vlerësimet e periudhës së shpërnguljes, si dhe ato të pas Luftës II Botërore shihen qartë qëllimet reaksionare dhe antipopullore të reformës agrare dhe të kolonizimit në Kosovë. "Kulmi i shfrytëzimit ekonomik ishte reforma agrare e cila kishte për qëllim: ashpërsimin e urrejtjes midis shqiptarëve, serbëve dhe malazezëve, që t'i varfëronte shqiptarët deri në atë shkallë sa të detyroheshin të shpërnguleshin, të krijonte një vatër reaksionare në Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit, e t'i dobësonte masat revolucionare popullore në Mal të Zi, duke iu dhënë tokë në Kosovë dhe në Rrafsh të

[23] Në vitin 1939 rreth 60% të bujqve në Kosovë përdornin parmendën, ndërsa në tërë Kosovën kishte gjithsej 4 traktorë, 5 mbjellëse, 6 makina të korrjes, 145 makina shirëse, 242 makina të tipit "Trier" dhe 11 makina të tjera bujqësore (*Proizvodne snage NR Srbije*, Beograd, 1953, f. 158).

[24] A. Ostreni, *Gjeografia e Shqipërisë,*Tiranë, 1976, f. 102.

[25] *La situation de la minorité albanaise en Yougoslavie*, Genève, le 5 mai 1930.

[26] H. Hoxha, "Proces nacionalne afirmacije albanske narodnosti u Jugoslaviji", Č*asopis za kritiko znanosti*, 51 - 52, Ljubljana, 1982; H. Bajrami, *Rrethanant shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918 - 1941*, Prishtinë, 1981, f. 177.

Dukagjinit".[27] Ndërkaq, në një vlerësim tjetër thuhej: "Masa e veçantë e presionit, e cila ua hante shpirtin më së shumti turmave shqiptare, ishte e ashtuquajtura reforma agrare, që ishte përsëritur disa herë dhe kishte qëllim të vërtetë reaksionar dhe politik. Qëllimi i saj nuk ishte që të zhdukeshin mbeturinat e feudalizmit dhe toka t'u ndahej fshatarëve që e punonin, por në radhë të parë t'u merrej shqiptarëve dhe te ata të krijohej pakënaqësi edhe më e madhe dhe ndjenjë e pasigurisë në mënyrë që të detyroheshin të shpërnguleshin për t'i kënaqur kortezhet politike dhe njerëzit e regjimit". [28]

Me rastin e realizimit të reformës agrare e të kolonizimit, masat ishin më represive ndaj shqiptarëve pikërisht në ato pjesë të Kosovës në të cilat jetonte një numër i madh dhe territorialisht kompakt i tyre, si p.sh. në Rrafshin e Dukagjinit. Në një gazetë të kohës thuhej: "Rrafshi i Dukagjinit si dhe viset e tjera ku jetojnë shqiptarët, kanë hequr shumë nga klikat e ndryshme të regjimeve, të cilat me gjithë mend e kanë grirë popullin; populli këtë nuk e ka vërejtur sa duhet. Më së shumti ka pasur sukses që interesat e shqiptarëve të paraqiteshin si kundërshtim i interesave të kolonistëve. Shqiptarëve u thuhej se të ardhurit janë shkaktarë të të këqijave dhe të varfërisë së kolonistëve, ndërsa kolonistëve u thuhej se nuk ka formë tjetër për përmirësimin e jetës së tyre, përpos shpërnguljes së shqiptarëve".[29]

Për ta arsyetuar dhunën dhe terrorin ndaj shqiptarëve me qëllim të shpërnguljes së tyre, trilloheshin veprime kriminale të shqiptarëve mbi serbët, si dhe provokacione të shumta, që plotësisht u përngjanin skenarëve të viteve të 80-ta e të 90-ta të shekullit XX. *Dragisha Vasiqi* (1885-1945), shovinist e serbomadh, këshilltar i kryeçetnikut Drazha Mihajlloviq, duke qëndruar në viset shqiptare në fillim të viteve të 20-ta të shekullit të kaluar në librin e tij "Dy muaj në Siberinë Jugosllave", në rrethinën e Prizrenit u bind edhe vetë se regjimi serb "këtu çdo muaj shpif nga një masakër mbi serbët. Dihet pse dhe kjo gjë nuk është e re".[30] Kështu kishte vepruar edhe regjimi osman; këtë e kishte vërejtur edhe Cvijiqi (që i akuzonte shqiptarët si proosmanë) gjatë hulumtimeve të tij në terren, duke theksuar se "gjatë qëndrimit tim në Prizren, në shtator të vitit 1910, çdo mëngjes shihej në treg nga një shqiptar i varur gjatë natës".[31] Qarqet politike serbe kështu vepronin edhe nga fundi i shekullit

---

[27] *Narodni Odbor Autonomne Kosovsko-Metohijske Oblasti, Osnovni materijali sa zasedanja,* Knj. I, Priština, 1955, ff. 7-8 (nënvozoi H. I.).

[28] P. Jovićević,"Politička situacija i rad partijske organizacije na Kosovu i Metohiji pred rat 1941", në *Zbornik Ustanak naroda Jugoslavije 1941*, knj. II, Beograd, 1963, f. 214.

[29] *Glas Crne Gore*. Legalni organ KPJ za Crnu Goru, br. 3, 15. XII. 1939.

[30] D. Vasić, *Dva meseca u Jugoslovenskom Sibiru*, Gece Kona, Beograd, 1921, f. 60.

[31] J. Cvijić, *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje. Osnove antropogeografije,* Knjiga prva, Zagreb, 1922, f. 395.

XIX, për çka dëshmon edhe një libër në formë të memorandumit, e ashtuquajtura "Bella knjiga", që e botoi Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë, qëllimi i të cilit ka qenë të "tregojë" për "presionet e mëdha të shqiptarëve" mbi popullatën serbe në Kosovë. Mirëpo, nga korrespodenca midis Beogradit dhe Stambollit, që është botuar në këtë libër, mund të vërehet lehtë se qeveria serbe, përmes të deleguarve dhe agjentëve të vet, i ka trilluar jo vetëm plaçkitjet, njerëzit e vrarë, dhunimet, djegiet, rrënimin e varrezave, por madje edhe emrat e vendeve, të cilat në të vërtetë nuk kanë ekzistuar.[32]

2. Elaboratet gjenocidale serbe të viteve të 30-ta

Qarqet sunduese, kulturore e shkencore serbe dhe veçanërisht ideologët e krijimit të hapësirave të pastra etnike, me gjithë masat e ndërrmara ndaj shqiptarëve, nuk ishin të kënaqura me rezultatet e kolonizimit dhe të shpërnguljes së shqiptarëve në vendet e tjera. Edhe përkundër të gjitha masave drastike, numri i shqiptarëve nuk u zvogëlua, por, përkundrazi shënonte rritje në saje të natalitetit të lartë, ndonëse niveli i mortalitetit, sidomos i foshnjave dhe i fëmijëve të vegjël, ishte shumë i lartë, në kushtet e rënda të jetës e të punës dhe veçanërisht të pamundësisë së mbrojtjes shëndetësore, ku sëmundjet e ndryshme epidemike e të tjera bënin kërdinë (kolera, lia, malaria, tifoja, tuberkulozi, difteria etj.). Prandaj, pushteti i atëhershëm vendosi që këto qëllime të vetat t'i realizojë me shpërnguljen me dhunë e terror të të gjithë shqiptarëve nga trualli i Kosovës dhe territoreve rreth saj, në një anë, dhe kolonizimin sa më intensiv të serbëve në Kosovë, por edhe në Maqedoninë Perëndimore, në anën tjetër. Për këto qëllime u përpiluan një varg elaboratesh dhe planesh, të cilat këtu, për shkak të pasojave që kishin gjatë gjithë shekullit XX, do t'i komentojmë pak më gjatë.

Një elaborat të tillë me karakter fashisoid e gjenocidal me titull "Shpërngulja e shqiptarëve", i paraqitur në Klubin Kulturor Serb me 7 mars 1937, e hartoi dr. Vasa Çubrilloviqi (1898-1990).[33] Në këtë elaborat,

---

[32] Shih më hollësisht: *Prepiska o arbanaškim nasiljima u Staroj Srbiji 1898-1899*, Beograd, 1899.

[33] *Iseljavanje Arnauta,* Predavanje održano u Srpskom kulturnom klubu od Dr. Vase Čubrilovića, 7. marta 1937. godine, Vojnoistorijski institut, Arhiv bivše jugoslovenske vojske, Br.2, Fasc. 4, Kutija 69 (në shtojcë: një hartë, dy tabela dhe dy grafikone; teksti ka 19 faqe makine, i shkruar me alfabet cirilik, në origjinal është i nënshkruar me dorë; fotokopja e elaboratit gjendet te autori i këtij botimi (nënvizoi H. I.). Shih tekstin e plotë të elaboratit në: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 225-250.

Çubrilloviqi, duke theksuar se pasi që "ndjekja e shqiptarëve me kolonizimin tonë gradual është joefikase, mbetet që shpërngulja e tyre të bëhet sa më masive. Me këtë rast, dy vende vijnë në konsiderim: Shqipëria dhe Turqia. Turqia, siç po dëgjohet, *pajtohet që në fillim t'i pranojë rreth 200.000 të shpërngulur tanë, me kusht që të jenë shqiptarë*, për çka neve më së miri na përgjigjet. Dëshirën e Turqisë duhet ta pranojmë me dy duar dhe sa më parë ta *nënshkruajmë konventën për shpërngulje*. Me rastin e shpërnguljes së shqiptarëve duhet studiuar konventat, të cilat Turqia për këtë problem i ka nënshkruar viteve të fundit me Greqinë, Rumaninë dhe Bullgarinë dhe t'i kushtohet kujdes dy çështjeve: nga Turqia të kërkohet që të pranojë kuotën sa më të madhe, ndërsa në pikëpamje financiare t'i plotësohen të gjitha kërkesat dhe në mënyrë të veçantë të zgjidhet çështja e *transportimit të shpejtë*...

Për t'u arritur shpërngulja masive, *kushti i parë* është që të *krijohet psikoza e përshtatshme*...Për këtë, së pari duhet ndër shqiptarë të *përfitohen hoxhallarët dhe paria*, që kanë ndikim të madh në masa, dhe atë ose me para ose me kërcënime...*Mjet i dytë* do të jetë *presioni i aparatit shtetëror*. Ai duhet t'i shfrytëzojë deri në fund ligjet për t'ia *bërë shqiptarëve jetën sa më të hidhur*: gjobat, arrestimet, zbatimi i pamëshirshëm i të gjitha rregullave policore, dënimi i kontrabandës, i prerjes së pyjeve, ndjekja për lëshimin e qenve, puna në angari dhe të gjitha ato mjete që është në gjendje t'i gjejë një polici praktike. Ndërsa, në *jetën ekonomike* duhet të mos pranohen tapitë e moçme, puna në kadastër të ndërpritet, të mblidhen pamëshirë tatimi dhe huatë publike e private; të ndërpriten koncesionet, të mos jepen leje afariste për kafene, tregti, zanate, të merren lejet e monopolit, të përjashtohen nga shërbimet shtetërore, private e vetëqeverisëse etj. - të gjitha këto do ta shpejtojnë shpërnguljen. *Masat sanitare:* ekzekutimi me dhunë i të gjitha dispozitave edhe në shtëpia, rrënimi i mureve dhe i gardhishteve të mëdha rreth shtëpive,[34] zbatimi i rreptë i masave në fushën e veterinarisë, që do ta pengojnë nxjerrjen e kafshëve në pazar etj. gjithashtu do të jenë efikase dhe praktike. Në *çështjet e fesë*, shqiptarët janë më të ndjeshëm, prandaj edhe këtu duhet mirë të atakohen. Kjo mund të arrihet me ndjekjen e hoxhallarëve, rrënimin e varrezave, ndalimin e poligamisë dhe veçanërisht me zbatimin e pamëshirë të ligjeve që edhe fëmijët e gjinisë femërore duhet patjetër të përfshihen në shkolla fillore, por vetëm atje ku ekzistojnë shkollat.

Edhe iniciativat private në këto çështje mund të ndihmojnë shumë. *Kolonistëve tanë, sipas nevojës, duhet t'u ndahen armë*. Në këto vise duhet të ndërmerret aksioni i vjetër çetnik, i cili në mënyrë sekrete duhet të ndihmohet

[34] Rrënimin e mureve e të gardhishteve, si ide fashistoide të Çubrilloviqit, që nuk u zbatua atëherë, në vitet e 80-ta të shek. XX filloi ta zbatojë ndaj shqiptarëve pushteti komunist dhe organet në Maqedoni.

në detyrat e tij. Veçanërisht duhet mundësuar *një valë të malazezëve malësorë që të nxisin konflikte me shqiptarët në Rrafsh të Dukagjinit*. Përmes njerëzve të besueshëm këtë konflikt duhet përgatitur mirë; konflikti duhet të masivizohet, sepse do të jetë më lehtë të shpjegohet se shqiptarët kanë ngritur krye, ndërsa tërë rastin duhet paraqitur si konflikt midis vëllazërive e fiseve dhe sipas nevojës t'i jepet karakter ekonomik. Në instancën e fundit mund të shkaktohen edhe *kryengritje lokale, të cilat do të shuheshin me gjak me mjete më efikase, por jo aq me ushtri sa me kolonistë, fise malazeze dhe çetnikë. Mbetet edhe një mjet, të cilin Serbia në mënyrë shumë praktike e kishte përdorur pas vitit 1878: djegiet e fshehta të fshatrave shqiptare dhe të kuarteve të qyteteve të tyre...*Duhet pasur parasysh në radhë të parë *shpërnguljen e fshatrave e pastaj të qyteteve.* Fshatrat janë më stabile, prandaj edhe më të rrezikshme. Mandej, nuk guxohet të bëhen gabime dhe të shpërngulen vetëm të varfrit: në çdo popull boshtin e përbën shtresa e mesme dhe e pasur, prandaj edhe këto shtresa duhet të ndiqen e të shpërngulen".

Çubrilloviqi më tutje thekson se "*me rastin e krijimit të psikozës për shpërngulje duhet bërë përpjekje që të lëvizin fshatrat e tëra, ose të paktën familjet e tëra.* Me çdo kusht duhet penguar që një pjesë e familjes të shpërngulet, ndërsa pjesa tjetër të mbetet te ne. Shteti ynë nuk do t'i harxhojë të mirat e veta në mënyrë që t'u lehtësojë jetën shqiptarëve, por që ata t'i heq qafesh sa më shpejtë". Atje ku nuk i përfshinë vala e shpërnguljes të gjitha fshatrat, "në ato fshatra duhet së pari të sillen malazezët si njerëz pa mirësjellje, të vrazhdë dhe agresivë, të cilët me sulmet e tyre do ta detyrojnë pjesën e shqiptarëve të mbetur të shpërngulet, kurse pastaj duhet të sillen edhe kolonistët nga viset e tjera". Që shpërngulja e shqiptarëve të rrjedhë shpejt e të jetë masive, "*duhet patjetër të thjeshtësohet administrata, të paguhen shpejt pasuritë, të jepen dokumentet e udhëtimit pa kurrfarë formalitetesh, t'u ndihmohet migrantëve të vijnë shpejt deri te stacioni i parë hekurudhor, t'u lihen në dispozicion trenat deri në Selanik dhe menjëherë të përplasen në Azi. Është shumë me rëndësi që shkuarja të jetë e lehtë, e rehatshme dhe e lirë...*

Vetëm duke e ndjekur këtë rrugë, duke ditur çka dëshirohet dhe duke mos kursyer as para e as gjak shteti ynë do të mund që Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit ta shndërrojë në Toplicë të re" dhe "kur mundet Gjermania t'i shpërngulë dhjeta mijëra çifutë, Rusia të shpërngulë miliona njerëz nga një anë e kontinentit në tjetrin, nuk do të ndodhë ndonjë luftë botërore për shkak të shpërnguljes së qindra mijëra shqiptarëve". Ndërkaq, “e vetmja mënyrë e mundshme e kolonizimit masiv të elementit tonë në këto treva do të ishte marrja e tokës nga shqiptarët”. Mirëpo, "me rastin e krijimit të kolonive të reja, sa herë që është nevoja, *duhet përdorur forcën ushtarak*e...Me punët e përgjithshme do të udhëhiqte Gjeneralshtabi përmes një këshilli shtetëror për

kolonizim. Akademia Mbretërore Serbe e Shkencave dhe Universiteti i Beogradit janë më kompetentët të marrin mbi vete iniciativën për organizimin shkencor të studimit të problemit të kolonizimit te ne...Ato duhet patjetër të ndërmarrin edhe iniciativën për formimin e një Instituti të Kolonizimit...Shpërngulja e 40.000 familjeve shqiptare (shpenzimet mesatare për familje nga 15.000 dinarë) do të kushtonte maksimalisht 600.000.000 dinarë".

Mbi bazë të këtij elaborati të Vasa Çubrilloviqit, si dhe të disa bisedave me rastin e vizitave më parë të bëra të njerëzve të qeverisë së Stojadinoviqit dhe të vetë Stojadinoviqit në Turqi (1936), në vitin 1938 ishte arritur marrëveshja që të nënshkruhej konventa për shpërnguljen e 40.000 familjeve shqiptare me një numër të madh të anëtarëve për familje, gjë që i përgjigjej qeverisë jugosllave, meqë pagesa bëhej sipas numrit të familjeve. Me shqiptarët bëhej pazar sikurse me robërit e Afrikës Perëndimore në gjysmën e dytë të shek. XVIII dhe në fillimin e shek. XIX, kur transportoheshin në Amerikë. Në të dy rastet *zbatohej gjenocidi, por sigurohej edhe profiti*.

Në kuadër të numrit prej 40.000 familjeve përfshiheshin të gjitha territoret e banuara me shqiptarë në Jugosllavinë e atëhershme, ndërsa parashihej që shpërngulja të realizohej sipas kësaj dinamike dhe shkalle: në vitin 1939 4.000 familje, më 1940 6.000, më 1941 dhe 1942 nga 7.000 familje, më 1943 dhe 1944 nga 8.000 familje. Konventa ishte e përpiluar në gjuhën frënge dhe përmbante 21 nene.[35] Në një letër sekrete dërguar Legatës Jugosllave në Turqi, thuhej se "Konventa është e redaktuar në atë mënyrë që të mund të zbatohet jo vetëm në popullsinë turke, por edhe *në atë shqiptare*. Dhe shpërngulja e popullatës shqiptare është në të vërtetë esenca boshte sekrete e saj" (pika 6).[36] Mirëpo, kjo konventë *nuk u ratifikua* në Parlament për arsye të frikës se nuk do të kalonte pa debat të ashpër dhe ashtu çfarë ishte ajo dhe nuk gjeti zbatim për disa arsye të kohës, para së gjithash për shkak të shpërthimit të Luftës II Botërore, mungesës së mjeteve financiare, vdekjes së Ataturkut, rënies së qeverisë së Stojadinoviqit etj.

Për këtë elaborat të Çubrilloviqit, B. Horvati shkruan: "Po të ishte realizuar ky plan ai padyshim do t'i kishte spastruar shqiptarët, por në të njëjtën kohë do ta kishte fashistizuar Jugosllavinë, ndërsa popullit serb do t'ia kishte

---

[35] "Konventa jugosllavo-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve", *Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave historike, XII,* Prishtinë, 1982, ff. 243-271. Shih tekstin e plotë të Konventës në: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 251-259.

[36] *Konvencija sa Turskom o iseljavanju iz Južne Srbije muslimanskog stanovništva*, DASIP, Beograd: Poslanstvo u Turskoj F. 31. D/9 pov.,1938; "Konventa jugosllavo-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve", *Po aty*, ff. 268-269.

vënë një njollë, të cilën brezat e tëra nuk do të kishin mund t'ia lanin. Për fat kjo nuk ndodhi, e as që do të mund të ndodhte. Përveç të gjitha atavizmave ballkanike, Jugosllavia ishte vendi më i evropeizuar se sa i dukej Çubrilloviqit. Një gjë e tillë shihet edhe nga fakti se qeveria nuk ka pasur guxim që Konventën për shpërngulje ta vë në rend dite të Asamblesë, duke u frikësuar se nuk do të kapërcente dhe do të mund të shkaktonte një skandal.

Duhet zënë në gojë edhe një aspekt fashistoid të këtij plani. Disa ide megjithatë janë realizuar: fshatarët janë maltretuar, toka u është shndërruar në pronë të shtetit me kërcënime famëkeqe se do t'u merret, e ku pastaj me të vërtetë u është marrë, shpërngulja është kontraktuar me Turqinë etj... Krejt kjo është bërë në prag të luftës botërore. Padyshim, edhe një qasje idiotike nga aspekti i rezonit shtetëror të vetë Mbretërisë Jugosllave! Shovinizmi nacional dhe vështrimi racional i interesave vetanake është e qartë se nuk mund të kenë asgjë të përbashkët".[37]

Për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, asimilimin e shqiptarëve të fesë katolike, si dhe për copëtimin e shtetit shqiptar është angazhuar edhe *Ivo Andriqi* (1892-1975) i cili në vitin 1961 mori çmimin "Nobël". Andriqi me kërkesën e Stojadinoviqit, në vitin 1939, hartoi elaboratin special[38] në të cilin përpunoi idenë e kamotshme ekspansioniste të Serbisë për dalje në Detin Adriatik, madje edhe me hekurudhë, identike me idenë e Cvijiqit të vitit 1912; ai angazhohej për ndarjen e Shqipërisë midis Jugosllavisë dhe Italisë dhe në këtë kontekst edhe të okupimit të Shqipërisë së Veriut. Midis tjerash, në elaborat thuhej: "Lugina e Drinit dhe Shkodra përbëjnë një tërësi gjeografike me Malin e Zi dhe viset kufitare të Serbisë. Për Serbinë e Mesme dhe Malin e Zi lugina e Drinit është e vetmja rrugë e drejtpërdrejtë dhe e shkurtër për Adriatik. Hekurudha e rëndësishme Danub-Adriatik duhet të kalojë nëpër luginën e Drinit. Konferenca e Ambasadorëve e Londrës në vitin 1913 ia ka pranuar Serbisë të drejtën e daljes në det…Shkodra është në lidhje edhe me lumin Buna, e cila ia hap tregtisë malazeze rrugën e natyrshme për në det…Marrja e Shkodrës, në këtë rast, do të kishte rëndësi të madhe morale dhe ekonomike. Kjo do të na mundësonte zhvillimin e punimeve të mëdha hidroteknike dhe përfitimin e tokës pjellore për ushqimin e Malit të Zi. Shqipëria Veriore, në kuadrin e Jugosllavisë, do të mundësonte krijimin e lidhjeve të reja të komunikacionit të Serbisë Veriore e Jugore me Adriatikun". Nuk ishte gjë e re ideja e Andriqit për Shqipërinë e Veriut, që e shihte në gjirin e Jugosllavisë së Versajës. Shqipëria e Veriut edhe sipas Naçertanies së I. Garashaninit edhe sipas shkrimeve të Cvijiqit projektohej qoftë si zonë e

[37] B. Horvat, *Kosovsko pitanje*, Globus, Zagreb, 1988, ff. 46-47.

[38] Shih tekstin e plotë të elaboratit në: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 260-272.

interesave serbe, qoftë si pjesë përbërëse e Serbisë.

Elaborati i Andriqit përfundon me kërkesën për *ndarjen e Shqipërisë dhe asimilimin dhe shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi:* "Me ndarjen e Shqipërisë nuk do të ekzistonte qendra atraktive për pakicën shqiptare në Kosovë, e cila, në një situatë të re, më lehtë do të ishte asimiluar. Ne do të kishim marrë eventualisht edhe 200.000-300.000 shqiptarë, por ata janë më tepër katolikë, raporti i të cilëve me shqiptarët myslimanë kurrë nuk ka qenë i mirë. Shpërngulja e shqiptarëve myslimanë në Turqi gjithashtu do të ishte realizuar në rrethana të reja, sepse nuk do të ekzistonte asnjë aksion i fortë për pengimin e saj".[39]

3. Elaboratet gjenocidale serbe të viteve të 40-ta

Planet dhe elaboratet e përmendura për shpërnguljen e të gjithë shqiptarëve dhe "zgjidhja" e çështjes shqiptare në Jugosllavinë e Parë janë bërë me iniciativën e Qeverisë së atëhershme dhe Gjeneralshtabit, ndërsa bartës të këtyre ideve të errëta ishin qarqet kulturore e shkencore të Serbisë, veçanërisht Klubi Kulturor Serb. Mirëpo, pas Çubrilloviqit dhe Andriqit, elaborate me përmbajtje plotësisht identike hartuan edhe çetnikët e Drazha Mihajlloviqit në vitin 1941 e më vonë[40] Një plan me përmbajtje fashistoide dhe hegjemoniste do ta hartojë edhe S. Moleviqi, njëri nga ideologët e lëvizjes çetnike dhe në vitet e 30-ta kur hartoheshin planet për dëbimin e shqiptarëve ai ishte edhe kryetar i Klubit Kulturor Serb, ku prezantoheshin këto plane. Projekti i Moleviqit "Serbia homogjene"[41] në të vërtetë ishte dokument programor i kreut të çetnikëve të Mihajlloviqit, ku parashihej jo vetëm krijimi i Serbisë së Madhe, por edhe dominimi i tyre në Ballkan. Në këtë projekt Moleviqi thoshte**:** *"Serbët duhet ta kenë patjetër hegjemoninë në Ballkan, e për ta pasur hegjemoninë në Ballkan duhet ta kenë më parë hegjemoninë në Jugosllavi".* Apetitet e qarqeve zyrtare dhe jozyrtare të Serbisë së kohës së

---

[39] B. Krizman, "Elaborat dra Ive Andrića o Albaniji iz 1939. godine", *Časopis za suvremenu povijest, II,* Zagreb, 1977, f. 89.

[40] Shih: *Dokument br. 37 od 20.XII.1941 godine,* Arhiv Vojno-istorijskog instituta, Beograd (me nënshkrimin e Drazha Mihajlloviqit).

[41] S. Molević, "Homogena Srbija", *Zbornik dokumenata i podataka o narodnooslobodilačkom ratu naroda Jugoslavije, XIV,* knjiga 1, Dokumenti četničkog pokreta Draže Mihailovića 1941-1942, Vojnoistorijski institut, Beograd, 1981, ff. 1-10; *Izvori velikosrpske agresije,* Rasprave-dokumenti, (Red. B. Čović), A. Cesarec-Školska knjiga, Zagreb, 1991. Teksti i plotë i këtij plani u botua në: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 273-280.

Millosheviqit për krijimin e një Serbie të Madhe apo të një Jugosllavie serbe janë identike me këto të Garashaninit, Çubrilloviqit, Moleviqit, Andriqit dhe çetnikëve të tjerë.

Realizimin e reformës agrare dhe të kolonizimit të popullsisë nga viset e tjera në Kosovë dhe rreth saj, presionin social e nacional mbi popullsinë shqiptare me qëllim që të shpërngulej, si edhe vetë shpërnguljen në Turqi, e gjykonte aty-këtu shtypi i atëhershëm përparimtar. Ndërkaq, pas Luftës II Botërore, në kuadër të reformës agrare dhe revidimit të padrejtësive, u nxor Ligji mbi reformën agrare për Kosovë dhe Maqedoni (3 gusht 1945), sipas të cilit kolonëve u ndalohej të ktheheshin në tokat e shqiptarëve. Megjithatë, të gjithë pronarëve shqiptarë nuk iu kthye e gjithë toka e marrë, por vetëm rreth 20.000 hektarë.[42] Prandaj, deri në fund të shek. XX, deri kur dominonte regjimi represiv dhe agresiv serb zvarriteshin problemet pronësore-juridike dhe mbi këtë bazë kishte edhe konflikte të ndryshme midis shqiptarëve si pronarë të tokës dhe serbomalazezëve si kolonë të dikurshëm, ndërsa pasojat zvarriten edhe sot e gjithë ditën.

Midis dy luftërave botërore shqiptarët ishin popull i rrallë, ndoshta edhe i vetmi në atë Jugosllavi që i nënshtroheshin kaq haptë terrorit dhe gjenocidit. Mirëpo, edhe ky shembull i këtij shteti tregon se përkundër të gjitha përpjekjeve nuk është arritur që Kosova të bëhej territor etnikisht i pastër dhe është vërtetuar eksperienca historike se ndjekja e një populli nga trojet e tij dhe zhdukja fizike e tij, sado i vogël të jetë ai, nuk është e mundur. Është në natyrë të popullit që si komunitet specifik popullor t'i bëjë ballë të gjitha ndërmarrjeve agresive e brutale të shtetit.

Presionet dhe planet fashistoide për ta pastruar Jugosllavinë nga shqiptarët megjithatë nuk ndërpriten as gjatë Luftës II Botërore, as pas saj. Për t'i kuptuar më hollësisht qëllimet e shpërnguljes së shqiptarëve, por edhe të bashkësive të tjera kombëtare - josllave, është e domosdoshme të zëmë në gojë edhe një elaborat tjetër të dr.Vasa Çubrilloviqit me titull "Problemi i pakicave në Jugosllavinë e Re",[43] i hartuar menjëherë pas çlirimit të Beogradit, përkatësisht më 3.XI.1944.[44] Prof. Çubrilloviqi, si ministër i disa resorëve (nuk

---

[42] M. Krasnići, *Savremene društveno-geografske promene na Kosovu i Metohiji*, Priština, 1963, ff. 38, 90

[43] Elaboratin e dytë të vitit 1944 e gjeti gjatë hulumtimeve në një arkiv të Beogradit në fillim të viteve të 80-ta dr. Seit Lipa.

[44] Elaborati ka 11 faqe makine (tekst i dendur) cirilicë. Në shtojcë ka një tabelë (Broj Arnauta u Staroj Srbiji, Makedoniji i Crnoj Gori po srezovima od 31 mart 1931 godine") dhe një hartë (Broj Arnauta i Rumuna na sto stanovnika"). Në origjinal është nënshkruar me dorë; fotokopja e këtij elaborati gjendet te autori i këtij studimi. Pjesët e citateve nga elaborati i ka nënvizuar H. I. Shih tekstin e plotë të elaboratit në: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 281-303.

ishte e rastit që si historian ishte ministër i bujqësisë dhe i pylltarisë) në Jugosllavinë e Titos, duke u udhëhequr nga pikëpamjet e teorikëve nacional-socialistë gjermanë dhe tashmë si njeri me eksperiencë në përpilimin e planeve të etnisë së pastër dhe duke u thirrur në eksperiencat e Bashkimit Sovjetik me rastin e përzënies së koreanëve, kinezëve, gjermanëve të Besarabisë, polakëve etj. gjatë viteve të 30-ta e të 40-ta të shekullit XX -, në këtë elaborat shkon shumë më larg se në elaboratin e vitit 1937. Ai këtu në mënyrë edhe më brutale dhe më fashistoide kërkon dëbimin e miliona njerëzve, pjesëtarë të bashkësive kombëtare josllave, me shtetet amë të të cilave rrethohej ish-Jugosllavia. Qëllimi kryesor i elaboratit të tij ishte që Jugosllavia të bëhej një *shtet etnikisht i pastër, i populluar vetëm me popullatë sllave apo jugosllave.* Çubrilloviqi theksonte: "Jugosllavia Demokratike Federative mund të ketë qetësi dhe zhvillim të sigurt vetëm atëherë kur të *bëhet etnikisht e pastër* dhe me zgjidhjen e çështjes së pakicave njëherë e përgjithmonë do t'i evitojë shkaqet e grindjeve midis vetes dhe shteteve fqinje...Kur të kihet parasysh fakti se zgjidhja e drejtë e çështjes së pakicave për ne është *shpërngulja,* imponohet një varg i tërë i detyrave, të cilat me këtë rast duhen të zgjidhen. *Athua të shpërngulen të gjitha pakicat, ose vetëm disa popuj,* nga cilat vise duhet para së gjithash të ndiqet elementi i pakicave, si të organizohet shpërngulja, dhe, çka është më me rëndësi, si të kolonizohen fshatrat dhe qytetet e braktisura.

Sa i përket çështjes se cilët popuj është me rëndësi të shpërngulen, jam i mendimit se duhet shkuar me këtë radhë: *gjermanët, hungarezët, shqiptarët, italianët, rumunët*... Pakicat tona më nuk janë për ne të rrezikshme për shkak të numrit sa janë të rrezikshme për shkak të pozitës së tyre gjeopolitike dhe lidhjes së tyre me popujt fqinjë që i përkasin...Për ne paraqesin rrezik këto blloqe të pakicave në territoret kufitare me rëndësi të madhe strategjike dhe ekonomike. Veçanërisht këto blloqe të pakicave etnike janë të rrezikshme atëherë kur kufizohen me popujt e njëjtë fqinjë. Duke u nisur nga ky aspekt, për ne është me rëndësi *të pastrohen gjermanët dhe hungarezët nga Vojvodina dhe shqiptarët nga Serbia e Vjetër dhe Maqedonia*.

Sikurse edhe në elaboratin e vitit 1937, ashtu edhe në këtë elaborat, për realizimin sa më efikas të dëbimit të bashkësive të përmendura kombëtare nga Jugosllavia e atëhershme, Çubrilloviqi thekson se "përveç fuqisë së gjithmbarshme të shtetit përmes qeverisë federale...*roli i ushtrisë në këtë punë është më i rëndësishmi. Ushtria duhet ta zbatojë forcën e armatosur me rastin e përzënies së pakicave nga shteti ynë*...Kjo çështje është aq e rëndësishme sa që ndoshta do të ishte shumë e dobishme që Mareshali Tito, si komandant suprem i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, duke i dhënë udhëzime ushtrisë, t'i jepte sa më parë udhëzime të posaçme edhe Këshillave Nacionalçlirimtare se si të veprohet në këtë çështje. Problemi është shumë urgjent, ndërkaq themelimi i

ministrisë së veçantë dhe organizimi i saj kërkon mjaft punë".

Sipas Çubrilloviqit del se asnjë pjesëtar i nacionaliteteve të përmendura nuk kishte marrë pjesë në luftën kundër fashizmit gjatë Luftës II Botërore dhe sikur nuk ka pasur kuislingë dhe kundërshtarë të kësaj lufte nga radhët e pjesëtarëve të popujve të tjerë sllavë e jugosllavë. Pasi i shpalli popujt josllavë tradhtarë, ai vazhdon: "Përveç spastrimit nga ana e ushtrisë gjatë operacioneve, duhet përdorur edhe mjete të tjera për t'i detyruar pakicat kombëtare të shpërngulen. Për shkak të qëndrimit të tyre në këtë luftë, duhet t'u merren të gjitha të drejtat që i përkasin pakicave. Duhet nxjerrë pa mëshirë para gjyqit të luftës të gjithë ata anëtarë të pakicave kombëtare të cilat në mënyra të ndryshme ishin vënë në shërbim të okupatorit. Për këtë duhet *formuar kampet e përqendrimit, pasuritë e tyre duhet konfiskuar, ndërsa familjet gjithashtu duhet dërguar në kampe dhe, në rastin e parë, të transferohen në shtetet e tyre nacionale*. Në këtë çështje, në rastin e hungarezëve dhe gjermanëve, mund të na *ndihmojë shumë ushtria vëllazërore sovjetike*. Gjatë spastrimit të pakicave sidomos duhet kushtuar kujdes inteligjencisë dhe shtresave të pasura shoqërore. Këto edhe kanë qenë ndaj nesh më të këqijat... *Interesat shtetërore kërkojnë që vendet e braktisura nga pakicat sa më parë të kolonizohen për t'i vënë edhe pakicat e edhe tërë Evropën para aktit të kryer...*

Referati im mbi problemin e pakicave ndoshta doli mjaft i gjatë. Mirëpo, çështja ka aq rëndësi të madhe për jetën tonë shtetërore sa që kam frikë mos kam harruar diçka. *Është e mundur që kurrë nuk na vjen rasti që shtetin tonë ta bëjmë etnikisht të pastër*. Të gjitha problemet e mëdha të së sotmes në shtetin tonë, qoftë ato me rëndësi nacional-politike, sociale apo ekonomike, disa më pak e disa më shumë, mund të presin zgjidhjen e tyre. Mirëpo, *problemin e pakicave nëse nuk e zgjidhim tash, kurrë më nuk do ta zgjidhim".*

Edhe pse rrethanat ndërkombëtare të kohës nuk shkonin në favor të realizimit të këtyre qëllimeve të errëta e fashistoide në radhë të parë, Çubrilloviqi, megjithatë, kishte shpresë të madhe në "ushtrinë vëllazërore sovjetike", por edhe në "Shqipërinë e vërtetë", siç e quante ai, sepse "simpatitë që i kemi ne ndaj popullit në Shqipëri, nuk guxojnë të na pengojnë që t'i qërojmë hesapet me banditët kuislingë të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit".

Nuk na është e njohur athua Çubrilloviqi me iniciativë të vetën e hartoi këtë elaborat apo dikush e kërkoi nga ai, sikurse në vitin 1937 kur elaboratin e parë e përpiloi me porosi të Shtatmadhorisë dhe të Qeverisë. Gjithashtu nuk na është e njohur kujt ia ka dërguar këtë elaborat. Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se për realizimin e tij Çubrilloviqi thirret në Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe Këshillat Nacionalçlirimtare, nuk ka dyshim se elaborati iu dërgua Mareshalit Tito. Janë disa dëshmi, por ende të paverifikuara mirë, se vetë Titoja ka marrë pjesë në bisedimet me përfaqësuesit e Qeverisë së Turqisë për

marrëveshjen e përtërirë të shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi në vitin 1953 në Bled. Por kjo mbetet të dokumentohet me material arkivor, sikundër që mbetet të ndriçohet pse ky projekt i Çubrilloviqit nuk u realizua menjëherë derisa ende zhvillohej Lufta e Dytë Botërore.

Po të ishin dëbuar bashkësitë kombëtare me origjinë josllave në mënyrë frontale dhe brutale, me masa represive policore e ushtarake, siç kërkonte Çubrilloviqi, çfarë pasoja do të kishte pasur në marrëdhëniet e kësaj Jugosllavie me 4 vendet fqinje, si shtete amë të këtyre bashkësive me të cilat rrethohej Jugosllavia Komuniste (Shqipëria, Rumania, Hungaria dhe Italia), përveç Bullgarisë. Në rastin e gjermanëve një gjë e tillë edhe është realizuar midis dy luftërave botërore (në Jugosllavinë e Versajës ka pasur rreth 500.000 gjermanë, pas Luftës II Botërore nuk kishte më shumë se 8.000), por duke pasur parasysh kompromitimin e Gjermanisë si shtet fashist gjatë Luftës II Botërore, ky akt gjenocidal ka kaluar pa reagime në botë; pas kësaj lufte, me dhunë apo me vullnet, territoret e Evropës Lindore i kanë braktisur rreth 9 milionë gjermanë.[45] Në rastin e shqiptarëve, ky elaborat nuk gjeti aplikim menjëherë, sepse rrethanat ishin të tilla, para së gjithash kanë ndikuar marrëdhëniet e mira që ekzistonin midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Por, pas prishjes së këtyre marrëdhënieve me Shqipërinë (1948), në bazë të një marrëveshjeje të fshehtë të përtëritur jugosllavo-turke, menjëherë nisi vala e shpërnguljes masive të shqiptarëve me dhunë në Turqi, që zgjati gjatë gjithë viteve të 50-ta dhe gjysmës së parë të viteve të 60-ta të shekullit XX.[46] Emigrimi me presion ndodhi në rrethanat e bllokadës së plotë informatave për pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë dhe të botës.

Shkrimtari dhe intelektuali kroat Mirosllav Kërlezha (1892-1981), në bisedat me Enes Çengiqin, ndonëse nuk i përmend këto elaborate, për të cilat është krejt e sigurt se i ka ditur, kështu e përshkruan personalitetin e Vasa Çubrilloviqit: "Krejt po vështroj nga perspektiva e zotëriut plak që po shkon dhe, derisa po flas, ndërmend e kam të ju pyes: a e keni përcjellë një mbrëmje në televizion atentatorin sarajevas dhe, më vonë, profesorin, një zotëri plak, Vasa Çubrilloviqin? Jo! Dëm. Çubrilloviqi, si do të thoshim, plak i lodhur, fliste si prej varri. Ai në pikëpamje intelektualo-morale ka vdekur para 25 vjetësh. Si ish-anëtar i Partisë Fshatare, si serbomadh, vendin e ka, vëllaçko, pas dyerve të hekurta. Nuk e di pse po i japim publicitet. Nuk fliste në emrin e tij personal dhe po e marr si shembull, sepse kështu mendon një pjesë e inteligjencisë serbe dhe këto nuk janë punë të vogla".[47]

---

[45] M. Friganović, *Demogeografija (Stanovništvo svijeta)*, Školska knjiga, Zagreb, 1978, f. 140.

[46] Më gjerë shih: H. Hoxha, "Kosovo in Albanci u novi Jugoslaviji", në librin *Albanci,* Cankarjeva založba, Ljubljana, 1984, f. 214 e tutje.

[47] E. Čengić, *S Krležom iz dana u dan (1980-1981). U sjeni smrti*, Globus, Zagreb, 1985, f. 178.

Për shkak të elaboratit të parë të vitit 1937, sepse për elaboratin e dytë dihej vetëm prej fillimit të viteve të 80-ta, propozimi që Çubrilloviqit t'i jepej shpërblimi i AVNOJ-it (KAÇKJ-së) u refuzua në gjysmën e viteve të 70-ta në Komisionin e Shkencave Shoqërore të Këshillit për ndarjen e këtij shpërblimi. Këtë propozim e kundërshtoi rreptë përfaqësuesi nga Kosova në atë Komision, prof. dr. Fehmi Agani, i cili e njoftoi Komision për elaboratin e parë (për elaboratin e dytë të tij nuk dihej atëherë ende), duke theksuar se dhënia e një çmimi të tillë njeriut që ka hartuar projekte gjenocidale ndaj një populli të tërë, në Kosovë dhe nga shqiptarët do të pritet me pezëm të madh. Mirëpo, prof. Aganit, për këtë kundërshtim ia kishte tërhequr vërejtjen një udhëheqës i atëhershëm i lartë i Kosovës, duke insistuar që përfaqësuesi ynë në mbledhjen tjetër të mos e kundërshtojë propozimin me arsyetim se Çubrilloviqi është emër i madh për serbët.

Mirëpo, ndonëse Çubrilloviqi kurrë nuk e mori çmimin e AVNOJ-it, megjithatë, më vonë, kur atij do t'i rezymohen meritat, do ta marrë një shpërblim tjetër më të madh të shtetit jugosllav, të cilin, mjerisht, do t'ia nënshkruajë një shqiptar "i ndershëm", atëherë edhe anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, tradhtari i popullit, Sinan Hasani, i cili sipas çelësit ishte Kryetar i Kryesisë së ish-Jugosllavisë! Çubrilloviqi në vitin 1987, me rastin e 90-vjetorit të lindjes do të dekorohet nga Kryesia e ish-RSFJ-së me Urdhrin e Yllit Jugosllav me Fjongo! Me këtë akt bëhej shumë i qartë qëndrimi i organeve më të larta shtetërore ndaj shqiptarëve dhe bashkësive të tjera kombëtare me prejardhje josllave dhe jojugosllave. Kreu i shtetit të atëhershëm nuk ngurronte fare që t'i shpërblente edhe ata që kishin bërë vepra me karakter terrori e gjenocidi kundër njerëzve dhe popujve, çfarë ishte Çubrilloviqi e të tjerët.

IV. PROJEKTET SERBO-JUGOSLLAVE PËR SHTYPJEN DHE SHPËRNGULJEN E SHQIPTARËVE NË GJYSMËN E DYTË TË SHEKULLIT XX

1. Kriza e Kosovës dhe fillimi i shkatërrimit të Jugosllavisë së Dytë

Kontesti rreth Kosovës dhe për Kosovën, që zhvillohet midis shqiptarëve dhe serbëve, ka një histori shekullore. Kontesti deri në ditët tona zhvillohej mbi bazë të argumenteve të njëjta, por të ndryshme për palët e konfrontuara; argumentet janë të karakterit historik dhe etnikodemografik. Serbët qysh në kohën e sundimit turk kishin aspirata që Kosovën ta fusnin nën juridiksionin e tyre me arsyetim se edhe në mesjetë i përkiste shtetit serb dhe se Kosova paraqet "zemrën dhe shpirtin serb". Ndërkaq, shqiptarët e konsideronin si pjesë të pandashme të tërësisë etnike dhe, më vonë, të shtetit shqiptar, me arsyetim se është popull shumë më i vjetër se serbët dhe sllavët në Ballkan, se shumica absolute e popullatës është shqiptare dhe se lëvizja shqiptare për çlirim dhe pavarësi ishte pikërisht më e forta në Kosovë. Mirëpo, me vendimet e Konferencës së Londrës (1913) dhe me vonë të Versajës (1919) dhe të Parisit (1945), përkundër vullnetit të popullit shumicë, Kosova mbeti nën Serbi/Jugosllavi. Në truallin gjeoetnik të shqiptarëve u bë edhe prerja e kulturave perëndimore dhe lindore, që la pasoja të shumënduarshme në shumë sfera të jetës.[1]

Edhe pse shqiptarët, nga rilindësit e deri më sot, gjithnjë si synim kishin hyrjen në Evropë dhe thuhej se "për shqiptarët dielli lind në perëndim". Por Evropa nuk u tregua e gatshme që t'u hapë rrugën. Qëndrimi i saj më tepër se një shekull nuk evoluoi pozitivisht ndaj çështjes shqiptare. Përkundrazi, Evropa u rreshtua në anën e hegjemonizmit serb dhe të fuqive të tjera antishqiptare, duke i ndarë edhe territorialisht, kështu që sot e gjithë ditën ndjehen pasojat kombëtare, ekonomike, politike, sociale, familjare etj. të copëtimit. Kosova dhe trojet e tjera etnike, që përbëjnë rreth gjysmën e kombit shqiptar, sot jetojnë jashtë Shqipërisë politike të vitit 1912, me të cilën edhe kufizohen.[2]

---

[1] R. Ismalji, "Shqiptarët dhe Evropa Juglindore", *Thema,* 11, Prishtinë, 1993, ff. 29-38.

[2] Siç dihet, janë raste shumë të rralla në botë, ku rreth dy të tretat e popullsisë, që i përket një kombi të jetojë jashtë kufijve të shtetit kombëtar, ndërkombëtarisht të pranuar. Nuk është identik as rasti i irlandezëve, të cilët, së bashku me pasardhës, ndonëse disa herë janë më shumë jashtë shtetit të tyre kombëtar, megjithatë kjo ndarje është pasojë e eksodit përtej oqeanit. Irlandezë në hapësirën kompakte etnike, por jashtë Irlandës si shtet amë (Alsteri që është në përbërje territoriale të Irlandës Veriore dhe pjesë e

Të gjitha regjimet serbe dhe jugosllave u përpoqën që çështjen e Kosovës ta zgjidhnin me shpërnguljen masive të shqiptarëve dhe kolonizimin e serbëve. Këto regjime e dëshironin edhe Kosovën e pazhvilluar dhe me nivel të ulët të natalitetit të tipit evropian, edhe Kosovën e kolonizuar dhe joshëse për serbët, qëllime këto që në asnjë mënyrë nuk shkonin së bashku. Ndërkaq, në vitin 1981 kriza e sistemit jugosllav nisi në Kosovë në formë të konfrontimit të Serbisë me shqiptarët. Krizën në Kosovë, pos disa specifikave, duhet parë në kuadër të krizës së përgjithshme në Jugosllavinë komuniste, që rezultoi nga kundërthëniet dhe konfliktet e brendshme, të akumuluara gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të kësaj Jugosllavie, e këto janë moszgjidhja e çështjes nacionale dhe mungesa e demokratizimit të shoqërisë. Por në këto hapësira ballkanike konfliktet e brendshme dhe antagonizmat ndëretnike ishin më të mëdha se çdokund tjetër.

Tri Jugosllavitë ashtu siç ishin krijuar mbi bazë të forcës ushtarake dhe të politikës hegjemoniste serbe, ashtu edhe u shkatërruan nga veprimi i konceptit të shtetit unitaristo-militarist. Titoja (1892-1980), me reformën e ish-Federatës dhe formimin e udhëheqjes kolektive federative donte ta pengonte vendosjen e çfarëdo hegjemonie pas tij. Mirëpo, trashëgimtarët e tij nuk u treguan të aftë ta zgjidhnin krizën si ekonomike, ashtu edhe politike dhe t'u kundërviheshin tendencave të hegjemonizmit serb; mungesën e autoritetit suprem politik të gjitha qarqet serbe nisën ta shfrytëzojnë si përgatitje për dominim, që në fund çoi në shpërbërjen e Jugosllavisë. Ushtria mbeti pa komandant suprem, ndërsa në këtë fazë elitës ushtarake i përgjigjej një njeri i tipit të Millosheviqit, i cili angazhohej për ruajtjen e Jugosllavisë njëpartiake, unitare dhe autoritare, ku do të sundonin serbët. "Kur u themelua Jugosllavia pas Luftës I Botërore, interesi kryesor i Serbisë ishte që gjithë serbët të jetonin në një shtet të vetëm. Para Titos Serbia e kishte dominuar këtë shtet. Tashti pas Titos Millosheviqi kërkonte të rivendoste këtë dominim. Në fund të viteve 1980 pengesa e tij kryesore ishte Sllovenia, ironikisht e vetmja republikë që nuk kishte një numër të madh serbësh. Sllovenët ishin të parët që i bënë sfidë unitetit të Jugosllavisë".[3] Mirëpo, pas vdekjes së Titos dhe sidomos pas shkatërrimit të

Anglisë), ka shumëfish më pak. Numri kaq i madh i shqiptarëve jashtë kufijve të Shqipërisë është në radhë të parë rezultat i ndarjes me kufi artificialë; natyrisht që ka edhe shpërngulje jo të vogla nga trualli gjeoetnik i tyre dhe ngulitje larg territorit të pakëputur etnik në Evropë dhe përtej oqeanit. Prandaj, si dje, ashtu edhe sot në kuptimin demografik, por jo vetëm demografik, është vështirë të thuhet se Shqipëria është amë, ndërsa Kosova dhe trojet e tjera etnike përreth saj degë (Shih: H. Islami, *Rrjedha demografike shqiptare,* Dukagjini, Pejë, 1994, ff. 7-11).

[3] W. Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, Besa (Libra për një shoqëri të hapur), Tiranë, 1996, f. 27.

LKJ-së (1990), Armata Jugosllave, e cila dominohej nga serbët, bënte politikën shtetërore.[4]

Kosova, që ballafaqohej me probleme të mëdha ekonomike, sociale e nacionale, në krizën e sistemit federativ ishte hallka më e dobët. Pas vdekjes së Titos, forcat hegjemoniste e shfrytëzuan Kosovën për hapjen e çështjes serbe në Jugosllavi nga pozitat nacionaliste dhe shtetmëdha, duke propaguar tezën se Serbia nuk është e barabartë me republikat e tjera, ndërsa serbët si popull më i madh gjithkund janë të shtypur: në Kosovë, në Kroaci, në BeH etj. Së pari në Kosovë u zbulua "populli i keq", "armiqtë e serbëve", "kundërrevolucionarët", "separatistët", ”irredentistët”, "rrënuesit e Jugosllavisë" etj. Shqiptarofobia dhe shovinizmi serb u shtrinë gjerësisht në të gjitha shtresat e shoqërisë serbe, duke shpikur teza që hynë në modelin gjenocidal të të menduarit dhe të sjelljes. U nxorën disa dokumente partiako-shtetërore me përmbajtje neomaltusianiste dhe raciste për pengimin e natalitetit të shqiptarëve.[5] Por, “zbulimi” më i madh që bënë forcat neohegjemoniste serbe qëndronte në faktin se burim i të gjitha problemeve në Serbi dhe në ish-Jugosllavi ishte se *barazia e shqiptarëve me serbët* mbi bazë të Kushtetutës së vitit 1974 dhe statusit konstitucional-politik të Kosovës, i arritur pa vullnetin e Serbisë. Regjimi i Millosheviqit vazhdonte ta shihte Kosovën vetëm nën juridiksionin e Serbisë, por me numër shumë të reduktuar të shqiptarëve, më së shumti deri 800.000 shqiptarë ose madje edhe pa shqiptarë në saje të zbatimit të politikës së spastrimit etnik dhe të kolonizimit të saj me serbë.

Në vazhdën e ideve dhe projekteve të shumta të qarqeve e institucioneve shkencore, kulturore dhe kishtare serbe, si dhe të të gjitha regjimeve serbe për pastrime etnike, krime e veprime gjenocidale me qëllime ekspansioniste e shtetmëdha këto 150 vjetët e fundit duhet veçuar një projekt të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, të inicuar jo nga një grup akademikësh, siç thuhej në fillim, por nga organet më të larta të këtij institucioni në gjysmën e viteve të 80-ta të shekullit të kaluar dhe më saktësisht në vitin 1986, kur edhe doli në opinion me emrin “Memorandumi”.[6] Në hartimin e tij morën pjesë emra të njohur të shkencës

---

[4] M. Hadžić, “Srpski kraj jugoslovenske armije”, në *Srbija izmedu prošlosti i budućnosti*, Beograd, 1995, ff. 281-299; D. Janjić, “Srbija između krize identiteta i izazova modernizacije”, në *Srbija između prošlosti i budućnosti*, f. 24.

[5] Një shkrimtar i njohur serb, me ndikim në jetën intelektuale dhe shoqërore në Serbi (M. Beçkoviq), në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar, në kohën e përforcimit të regjimit të Millosheviqit, me rastin e një vizite në Izrael, kishte deklaruar: "Më vjen shumë keq që nuk kam marrë me vete një kafaz me një shqiptar që të shihni se çfarë egërsirash janë"!

[6] Shih tekstin e plotë në: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 309-363.

dhe të kulturës serbe, të cilët, pas ngjarjeve të vitit 1981 në Kosovë ishin angazhuar në përpilimin e suazave shkencore, politike dhe legale në zbatimin e dhunës, të migrimeve "humane"dhe të gjenocidit ndaj popujve joserbë. Akademikët dhe intelektualët serbë kishin vënë bazat ideologjike dhe shkencore për dëbimin dhe shfarosjen biologjike të shqiptarëve edhe midis dy luftërave botërore dhe menjëherë pas saj, siç bënë akademiku Vasa Çubrilloviqi më 1937 e 1944 dhe nobelisti Ivo Andriqi më 1939.

Qëllimi i "Memorandumit" ishte pa dyshim krijimi i Serbisë së Madhe ose dominimi serb në gjithë Jugosllavinë komuniste, që duhej të arrihej me përdorimin e forcës ushtarake (APJ-së) përmes ndërrimit të dhunshëm të Kushtetutës së vitit 1974, zbatimit të represionit, luftës dhe krimeve masive e gjenocidit ndaj shqiptarëve, kroatëve dhe boshnjakëve, gjë që edhe ndodhi midis viteve 1990 dhe 1999, derisa nuk u mposht definitivisht makineria ushtarako-policore serbe me intervenimin e forcave të NATO-s në fillim të qershorit 1999. "Memorandumi" i paraqiste shqiptarët si armiq shekullor, të cilët, njëherë biologjikisht e pastaj edhe politikisht kinse po e rrezikonin popullin serb, hapësirën e tij jetësore dhe prosperitetin gjeodemografik, kombëtar dhe ekonomik të sllavëve të jugut, veçanërisht të serbëve.

Krimi dhe gjenocidi ishin të paramenduar dhe të planifikuar nga strukturat politike, shtetërore dhe ushtarake të Serbisë, ndërsa arsyetimin dhe legjitimimin e tyre e bënë intelektualët,[7] shkencëtarët, shkrimtarët serbë, mediat serbe dhe kisha ortodokse serbe. Në këtë funksion ishte pikërisht projekti i përmendur i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, i shkruar dhe i arsyetuar "shkencërisht". Për ta arritur këtë objektiv duhej të shkatërrohej Jugosllavia dhe atë jo me rrugë paqësore, por me krime dhe gjakderdhje masive. Që në fillim "Memorandumi" parashihte se kriza e shtetit të atëhershëm nuk "përjashton përfundimin edhe ashtu katastrofik, çfarë është rrënimi i bashkësisë shtetërore jugosllave". Për regjimin e Millosheviqit ky projekt ishte platforma kryesore e veprimit për 15 vjet

[7] Intelektualët serbë ishin pikërisht ata të cilët në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar inicuan idenë dhe projektin e "pacifikimit" të Kosovës sipas modelit izraelit. Këtë e bëri me dije sociologu i njohur slloven, Rudi Rizman, në simpoziumin "Kosovo-Serbija-Jugoslavija" në fillim të vitit 1989: "Kam menduar se është ky një konstruksion utopik, por më duhet të them se nga shokët e mi serbë, intelektualët, kam marrë një kundërargument që flet për mundësinë e pacifikimit, duke pasur parasysh atë që ka ndodhur në Izrael, pra që një popull pas një mijë vjetëve përsëri të kthehet në vendin e vet, pacifikimi madje në një funksion civilizues. Kjo ide është e mundur të shpjegohet dhe kuptohet racionalisht në atë mënyrë që plotësisht pajtohem me rrezikun e imitimit të një modeli, të një paradigme e cila në përmasa jugosllave do të ishte e trishtueshme dhe e cila do të kishte efekte fatale, më shumë se që kishte kthimi i hebrejve në Palestinë" (Diskutimi i Rudi Rizmanit në publikimin *Zbornik Kosovo-Srbija-Jugoslavija*, Ljubljana, 1989, ff. 66-67).

rresht. "Memorandumi" ishte një lloj *in memoriami* për Jugosllavinë komuniste dhe hyrje në luftërat e përgjakshme. Historiania serbe dhe udhëheqësja e dikurshme e Serbisë, Llatinka Peroviq, ishte ndër autorët e rrallë që theksonte se objektivat militariste të Serbisë ishin "revidimi i kufijve të brendshëm, këmbimi i popullatave dhe ristrukturimi i hapësirës politike ballkanike".[8] Një analizë të thuktë përmbajtjes dhe porosive të "Memorandumit" ia kishte bërë F. Agani.[9]

Pas kërkesave të drejta për barazi dhe pavarësi të shqiptarëve në demonstratat masive të vitit 1981, e tërë ish-Jugosllavia u ngrit kundër tyre. Kundër shqiptarëve filloi një represion i egër policor e ushtarak. Në Kosovë nisën diskriminimet dhe krimet kundër njerëzve dhe një kolektiviteti nacional dymilionësh;[10] këtu u shfaqën praktikisht tendencat për shkatërrimin e kësaj Jugosllavie dhe dominimin e serbëve mbi popujt e tjerë. Regjimi serbo-jugosllav filloi në Kosovë me vrasjen e demonstrantëve, burgosjen masive të të rinjve, diferencimet dhe izolimet e intelektualëve, arrestimet arbitrare, torturat dhe keqtrajtimet e të burgosurve, helmimet e nxënësve, bastisjet dhe ekspeditat ndëshkuese, me rrënimin e plotë të autonomisë (federative), suprimimin e organeve legale të pushtetit (Kuvendit, Qeverisë, Kryesisë), përjashtimin e shqiptarëve nga institucionet e sistemit, mbylljen e mjeteve të informimit, mbylljen e shkollave e të Universitetit, përjashtimin masiv të shqiptarëve nga organizatat ekonomike, institucionet sociale, humanitare, shëndetësore, kulturore e shkencore, rrënimin e bazës ekonomike të Kosovës, plaçkitjen e teknologjisë dhe të pronës private të shqiptarëve dhe me masa të presionit policor, ushtarak, politik dhe ekonomik shpërnguli një numër të madh të shqiptarëve. Nisi kolonizimi i ri i Kosovës si aspiratë shekullore për ndërrimin e strukturës etnike të Kosovës, me valën e fuqishme të terrorit shtetëror. Mirëpo, ndaj të gjitha formave të dhunës shqiptarët u përgjigjën me sjellje jo të dhunshme si mjet për ta evituar konfliktin dhe për ta realizuar vullnetin politik.[11]

---

[8] L. Perović, "Yugoslavia was defeated from inside", in S. Biserko (éd.), *Yugoslavia: Collaps, War, crimes, Center for Antiwar Action,* Belgrade, 1993, p. 63; sipas V. Pešić, "La guerre pour les États nationaux", në *Radiologie d'un nationalisme. Les crimes serbes du conflit yougoslave* (Sous la direction de N. Popov), Les Editions de l'Atelier (Editions Ouvrières), Paris, 1998, p. 51.

[9] F. Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja,* Dukagjini, Pejë, 1994.

[10] "Kosova viktimë! Të uritur, të përjashtuar nga puna, të dënuar, të plagosur, të vdekur. Kosova nën çizmën e policisë dhe ushtrisë. Gjithë pushtetin e mban 10% e popullsisë. Autonomia e suprimuar. Bllokimi i plotë i informimit. Shkollat dhe Universiteti të mbyllura për popullin shumicë" (Z. Šeparović, "Krv i suze Kosova", në botimin: Šeparović – Ademaj, *Kosovo žrtva (Studija i dokumentacija o stradanjima Albanaca na Kosovu), VIKTIMOLOGIJA, Č*asopis za pitanja stradanja ljudi, br. 1-2, Zagreb, 1991, f. 7).

[11] Të dhëna dhe fakte të bollshme për dhunën serbe në Kosovë dhe ndaj shqiptarëve në dy

Ish-Federata dhe ish-republikat joserbe, të bindura se Serbia do të ndalet në Kosovë, i dhanë përkrahje të plotë asaj në veprimet policore e ushtarake dhe e ndihmuan materialisht represionin dhe segregacionin ndaj shqiptarëve. Përkundër sjelljeve joviolente të shqiptarëve, të gjithë e dhanë pëlqimin që në Kosovë të vihej gjendja e jashtëzakonshme, të likuidohej me forcë autonomia federale, të vendosej sistemi diskriminues e kolonial dhe të stimulohej politika e kolonizimit të serbëve dhe e spastrimit të qetë etnik të shqiptarëve me qëllim që të ndërrohej struktura etnike e Kosovës. Konflikti mori përmasat e një konfrontimi të ashpër të shtetit jugosllav me gjithë popullin shqiptar.

Pas aneksimit të Kosovës më 1989, faktikisht u paralizua funksionimi kushtetues dhe legal i Kuvendit të Jugosllavisë dhe i të gjitha organeve të Federatës, meqenëse Kosova me Kushtetutën e vitit 1974 ishte e pavarur nga Serbia dhe *kishte të drejtën e vetos në Federatë.* Millosheviqi e shfrytëzoi mirë këtë përkrahje të ish-Jugosllavisë dhe duke manipuluar me mitin mbi Kosovën dhe duke i instrumentalizuar serbët e Kosovës, e forcoi pushtetin. Duke shpifur tezën mbi pozitën diskriminuese, degraduese e inferiore të Serbisë e të serbëve në planin ekonomik, politik e juridik në ish-Jugosllavi, establishmenti militarist i Millosheviqit mobilizoi energjitë e popullit serb për konfrontim dhe luftëra me popujt e tjerë. Mitingjet populiste, homogjenizimi dhe mobilizimi etnik i masave vazhdonte; Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë alarmonte opinionin serb për rrezikimin e popullit serb; u krijua psikozë e tmerrshme e rrezikimit; fabrikoheshin armiqtë dhe glorifikohej kombi serb: serbët si "popull hyjnor" "i urren" Evropa, "i urren bota"; pushteti serb nxit inteligjencinë nacionaliste, të tubuar rreth Akademisë së Shkencave, Shoqatës së Shkrimtarëve, Universitetit të Beogradit, mediumet dhe kishën ortodokse për konfrontime me të gjithë joserbët.

Mitologjia nacionale, e sublimuar në mitin mbi Kosovën, arrin kulminacionin në tubimin e 29 qershorit 1989 afër Prishtinës, që e organizuan Kisha 0rtodokse Serbe dhe pushteti i Serbisë, ku foli kasapi i Ballkanit, S. Millosheviqi. Në tubim mori pjesë pothuajse e gjithë udhëheqja jugosllave, kreu i APJ-së dhe shumë diplomatë të huaj, përveç ambasadorit të SHBA-së W. Zimmermann. Fjalimi luftënxitës i Millosheviqit bëri homogjenizimin edhe më të madh të serbëve, ndërsa prej kësaj dite e gjithë energjia nacionale e serbëve orientohet nga serbët jashtë Serbisë dhe drejt konfliktit serbo-kroat. Populizmi histerik arrin kulminacionin pas vitit 1991. Deri në vitin 1994 ideja mbi Serbinë e Madhe në kufijtë Viroviticë-Karllovc-Karllobag, sikurse mit u zgjerua në Serbi dhe te populli serb, si

dekadat e fundit të shekullit XX, shumë të rëndësishme për historianët e ardhshëm, shih në librin: J. Hubrecht, *Kosovo 1981-1989-1999-2001, Établir les faits,* Éditions Esprit, Paris, 2001.

bindje se bashkimi i të gjithë serbëve në një shtet të vetëm është vetëm çështje e ditës, pa llogaritur se çka do të thotë bashkësia ndërkombëtare. Në këtë ide, bashkë me regjimin ishte edhe opozita nacionaliste e Serbisë, e cila herë pas here gjendej edhe në pushtet. Teza e kahershme e shkrimtarit serb D. Qosiq, i cili atëherë konsiderohej "baba" i kombit, e që do të bëhej kryetar i parë i Jugosllavisë së Tretë *"Serbët fitojnë në luftë, por humbin në paqe",*[12] pothuajse në mënyrë plebishitare gjen përkrahje në Serbi dhe te serbët në përgjithësi dhe tezat si "serbët në luftë e zgjidhin çështjen e tyre nacionale", "serbët janë luftëtarë më të mirë", "kemi ushtrinë më të fortë në Evropë" etj. bëhen nxitje të fuqishme për luftë kundër popujve joserbë. Qosiqi ishte mbrojtësi më i madh i A. Rankoviqit dhe i politikës së tij shtypëse ndaj shqiptarëve dhe inspirues i gjakderdhjeve në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi; menjëherë pas mënjanimit të Rankoviqit nga politika shtetërore në korrik të vitit 1966 (jo për shkak të shtypjes së shqiptarëve!) Qosiqi deklaroi se "Kosova është vend i shenjtë serb, që do të mbrohet, nëse është nevoja, edhe me pushkë..."[13] "Babai" i serbëve, për serbët thoshte: "Gënjeshtra është formë e patriotizmit tonë dhe dëshmi e inteligjencisë sonë natyrore. Ne gënjejmë në mënyrë krijuese, fantastike, inventive".[14]

Përkrahja që i dhanë republikat e tjera Serbisë kundër Kosovës dhe shqiptarëve iu kthyen të gjithave bumerang; kriza eskaloi në konfrontim të hapët të Serbisë e të serbëve edhe me komunitetet e tjera etnike me synim të realizimit të projektit ekspansionist *"Të gjithë serbët në një shtet të vetëm"*. Popujt joserbë, me prejardhje sllave e jugosllave, të frikësuar nga hegjemonizmi serb, u detyruan të dalin nga ish-Jugosllavia (sllovenët, kroatët, boshnjakët, maqedonët). Duke pasur parasysh përbërjen e përzier etnike të territoreve që serbët dëshironin t'ia bashkëngjitnin Serbisë, një projekt i tillë mund të realizohej vetëm me pastrim etnik, që edhe ndodhi në sy të gjithë botës; pastrimi etnik edhe ishte koncept, strategji dhe qëllim i luftës së serbëve. Më vonë, pas shpërthimit të luftës në Slloveni, Kroaci dhe

---

[12] "Çfarë populli jemi ne, çfarë njerëz jemi ne, të cilët në luftë aq shumë vdesin për liri, ndërsa me vetë fitoret mbesin pa të? Si është e mundur që dikush midis nesh, dikush në shtëpinë tonë, të na i grabitë atë që nuk ka mundur të na i grabitë në luftë armiku shumëfish më i fortë? Si është e mundur që njerëzit aq shumë dinjitozë, që mburren, janë trima në luftë, pranojnë që në paqe të jenë të përulur, të nënshtruar? (…) dhe është tragjike të jesh pasardhës i atyre që janë të detyruar të kenë më shumë forcë për luftë sesa për paqe, të cilët pas fitores më të rëndë dhe më të madhe të luftës në historinë serbe, kanë mbetur pa fuqi që ta verifikojnë në paqe" (D. Ćosić, *Stvarno i moguće. Članci i ogledi,* O. Keršovani, Rijeka, 1982, ff. 171-172).

[13] I. Supek, *Krivovjernik na ljevici*, Globus nakladni zavod, Zagreb, 1992, f. 164.

[14] Nga romani i D. Qosiqit "Deobe"; sipas: *Velika Epohina enciklopedija aforizama,* Zagreb, 1968, f. 264.

BeH, Serbia dhe serbët do të konfrontohen edhe me bashkësinë ndërkombëtare dhe këtë konfrontim do ta shpjegojnë si komplot kundër popullit serb (Vatikani, Gjermania, CIA, Turqia, Xhihadi).[15] Pasi u sollën dëme të mëdha popujve joserbë, në fund e shkatërruan edhe vetë shoqërinë serbe në Serbi dhe jashtë saj, duke u ballafaquar me një krizë serioze ekonomike, politike e morale me pasoja afatgjata.

Si reagim ndaj aparteidit dhe terrorit shtetëror, suprimimit me dhunë të gjendjes kushtetuese dhe vendosjes së gjendjes okupuese e koloniale, si dhe ngjarjeve në krejt Jugosllavinë (referendumet për pavarësi), Parlamenti i Kosovës më 2 korrik 1990 shpalli Dekleratën e Pavarësisë, më 7 shtator 1990 shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës, prej 26-30 shtator 1991 mbajti Referendumin për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, ndërsa më 24 maj 1992 dhe 8 mars 1998 u mbajtën zgjedhjet parlamentare e presidenciale.

Projekti i lëvizjes politike shqiptare ishte që problemi i Kosovës të zgjidhet me mjete paqësore dhe me dialog. Duke pasur kujdes që të mos i fusin në luftë 7 milionë shqiptarë dhe të mos e destabilizojnë rajonin, por edhe duke u udhëhequr nga parimet e proklamuara të bashkësisë ndërkombëtare se të gjitha problemet e hapura duhet të zgjidhen me rrugë demokratike dhe me bisedime, shqiptarët duruan një represion kaq brutal të Serbisë. Mirëpo, këto sakrifica të tyre nuk u shpërblyen nga bashkësia ndërkombëtare deri në mars të vitit 1999. Të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe OKB-ja, në një anë, e dënonin shkeljen e të drejtave njerëzore dhe politike të shqiptarëve, por në anën tjetër e toleronin këtë shkelje. Megjithatë, Kosova nuk ishte problem i të drejtave të njeriut, ndonëse ato deri dje shkileshin nga regjimi serb në mënyrën më brutale, e as problem i pakicave. Kosova ishte çështje e dekolonizimit dhe e pavarësisë në bazë të së drejtës për vetëvendosje të popullit shumicë, si dhe çështje politike ndërkombëtare. Tashmë ishte e qartë edhe në suaza ndërkombëtare se pa u zgjidhur çështja e Kosovës mbi bazë të parimit të vetëvendosjes nuk kishte zgjidhje as të çështjes shqiptare në hapësirat e ish-Jugosllavisë dhe në Ballkan, por as paqe dhe stabilitet në Evropën JL. Mirëpo, mungonin hapat konkret në këtë drejtim, veçanërisht nga ana e BE, qoftë pse nuk e kuptoi realitetin politik në hapësirat e ish-Jugosllavisë[16] dhe të Ballkanit dhe

[15] D. Janjić, *Po aty,* f. 34.

[16] Përveç shumë shkrimeve në revista e gazeta dhe pjesëmarrjes në debate të ndryshme për Kosovën në vitet e 90-ta dhe më herët, profesori Michel Roux nga Universiteti i Toulouse-it në Francë, si njohësi më i mirë i çështjes së Kosovës dhe të shqiptarëve në ish-Jugosllavi nga të huajtë, menjëherë pas hyrjes së forcave ndërkombëtare në Kosovë shkroi librin *"*Lufta e Kosovës. Dhjetë çelësa për ta kuptuar*"*. Shih: M. Roux, *La guerre du Kosovo. Dix clés pour comprendre,* Éditions la Découverte, Paris, 1999, pp. 1-127.

agresivitetin e neohegjemonizmit serb, qoftë pse nuk ishte e aftë t'i zgjidhte problemet në truallin e vet.

Bashkësia evropiane dhe bashkësia ndërkombëtare përgjithësisht, me konferencat mbi ish-Jugosllavinë, që nga Brukseli (1990) e Haga (1991) dhe Komisioni i Badinterit e deri te Dejtoni (1995) bëri gabime me pasoja të mëdha kur Kosovën nuk e trajtoi të barabartë me njësitë e tjera të ish-Federatës, element konstitutiv i së cilës ishte sipas Kushtetutës së vitit 1974 dhe me të drejtë të vetos në të gjitha nivelet politike në ish-Jugosllavi, por u nis nga gjendja e krijuar pas vitit 1989, e vënë me mjete policore dhe ushtarake. Me indiferencën ndaj dhunës në Kosovë deri më 1991 dhe me pranimin e gjendjes faktike, të krijuar pas suprimimit të autonomisë federale, Evropa dhe bashkësia ndërkombëtare e pranonin politikën e aktit të kryer, që e kurajonte Serbinë për sjellje edhe më agresive ndaj shqiptarëve. Nga fajtori kryesor i tragjedive njerëzore, i shkatërrimit të qyteteve dhe fshatrave të tëra në ish-Jugosllavi, kjo bashkësi e pranonte Millosheviqin si një njeri të paqes dhe, duke i bërë koncesione të vazhdueshme deri në fillim të vitit 1999, e largonte Serbinë nga dialogu serioz me shqiptarët në praninë e faktorit të jashtëm. Çështja e Kosovës nuk qe e përfshirë as në Marrëveshjen e Dejtonit më 1995. "Diplomacia perëndimore ishte shndërrua në njëfarë teatri cinik" dhe "diplomacia pa forcën ishte bërë një armë e zbrazët, e pafuqishme dhe qesharake", shkruante ambasadori i fundit (1992) i SHBA-së në Beograd, W. Zimmermann.[17]

Përkundër të gjitha masave të ndërmarra dhe angazhimeve antishqiptare deri në nivel të një histerie të paparë deri në përfundim të mileniumit të kaluar, nga të gjitha qarqet dhe në të gjitha kohët, veçanërisht pas viteve të 80-ta, përfundimi ishte: në pikëpamje etnodemografike Kosova definitivisht u shqiptarizua, ndërsa grupacioni serb u tëhollua aq shumë sa që më nuk ekziston. Ky përfundim vlente deri në fillimin e luftës, derisa shqiptarët ishin "të pacifizuar", që do të thotë deri në mars të vitit 1998. Aktiviteti dhe rritja ekspansive e interesit të të gjitha instancave serbe për çështjet demografike të Kosovës pasoi përsëri, pas "rebelimit" dhe "veprimit terrorist" të shqiptarëve dhe ndërkombëtarizimit kulminant të problemit të Kosovës. Mirëpo, konkludimi serb, u mor vesh, për qëllime politike, përmblidhet në faktin: në përbërjen etniko-demografike të Kosovës nuk dominojnë më shqiptarët, por bashkësitë e tjera kombëtare, disa prej të cilave gjithnjë ishin numerikisht margjinale e disa të tjera as që kanë ekzistuar ndonjëherë si në pikëpamje etnike, ashtu edhe në linguistike e statistike, çfarë ishte rasti p. sh. me "goranët" dhe "egjiptianët".

---

[17] W. Zimmermann, *Burimet e një katastrofe,* Tiranë, 1996, ff. 230-231.

Serbia tash do të bëhej zemërgjerë sa i përket dhënies së të drejtave njerëzore e të drejtave të tjera shqiptarëve. Në përputhje me "standardet evropiane", regjimi i Millosheviqit kishte vendosur t'u ofronte të gjitha të drejtat shqiptarëve, por me kusht që të respektohej realiteti i ri demografiko-etnik i Kosovës, ku nuk dominonin më shqiptarët. Fushata fantastike e zvogëlimit të numrit të shqiptarëve dhe e rritjes së numrit të të tjerëve, veçanërisht e serbëve bëhet më transparente në prag dhe gjatë Konferencës së Rambujesë në fillim të vitit 1999 nga ana e përfaqësuesve të Serbisë.[18]

2. Shpërngulja e shqiptarëve dhe valët e kolonizimit serb të Kosovës në vitet e 50-ta e të 60-ta të shekullit XX

Politika e dëbimit të shqiptarëve do të vazhdojë edhe pas Luftës II Botërore, ku zgjidhja e problemit të shqiptarëve përmes shpërnguljes dhe asimilimit do të bëhej preokupimi kryesor i Serbisë dhe i ish-Jugosllavisë. Projekti i dytë i Çubrilloviqit në prag të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore për shpërnguljen e të gjithë shqiptarëve përmes forcës ushtarake pret zbatimin dhe në bazë të një marrëveshjeje të fshehtë jugosllavo-turke të përtëritur në fillim të viteve të 50-ta në Split apo në Bled, ku mendohet se ka marrë pjesë edhe vetë Titoja, dhe përsëri nisi vala e shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi. Për shpërnguljen e tyre, si presione të drejtpërdrejta ishin krijimi i atmosferës së frikës e të pasigurisë, deklarimi i dhunshëm i shqiptarëve për kombësi turke në regjistrimet e popullsisë të viteve 1953 dhe 1961, aksioni i mbledhjes së armëve në vitet 1955-1956, i përcjellë me represione të tmerrshme (rreth 50.000 veta u torturuan) dhe me vrasje (109 veta), me arsyetim se shqiptarët po përgatiteshin për kryengritje të armatosur dhe bashkim me Shqipërinë, ndjekja e inteligjencisë, e punëtorëve arsimorë, inskenimi i grupeve dhe i aksioneve "armiqësore", reduktimi edhe i atyre të drejtave të pakta qytetare e kombëtare të shqiptarëve, siç ishin ndalimi i përdorimit të gjuhës shqipe në jetën publike dhe i simboleve kombëtare, mbyllja e Institutit Albanologjik (i hapur më 1953, ndërsa u mbyll më 1955) dhe e Bibliotekës Popullore të Kosovës, ndalimi i punës së Ansamblit të Këngëve dhe Valleve të Kosovës dhe mbyllja e shkollave shqipe e deri te maltretimet masive dhe likuidimet e fshehta fizike të shqiptarëve.[19] Deri nga

[18] Kryetari i Serbisë M. Millutinoviq, p. sh. theksonte se në Kosovë shqiptarët nuk janë shumicë, por janë nën 50% e madje nën 40%, duke i abstrahuar vlerësimet e vetë institucioneve përkatëse të Beogradit se shqiptarët më 1991 përbënin 82,2% në popullsinë e përgjithshme të Kosovës.

[19] Shih më gjerë: H. Hoxha, "Kosovo in Albanci u novi Jugoslaviji", në librin *Albanci,* C.

gjysma e viteve të 60-ta vlerësohet se nga Kosova dhe trojet e tjera etnike shqiptare u shpërngulën në Turqi rreth 250.000 veta.[20] Ndërkaq, në periudhën 1945-1966 në Kosovë u instaluan rreth 50.000 serbë e malazezë, të privilegjuar në disa baza.[21]

Shkalla e lartë e nataliteti, përkundër mortalitetit gjithashtu të lartë, ishte faktor i fuqishëm i kompensimit demografik të popullatës shqiptare. Duhet theksuar gjithashtu se deri në fund të këtyre viteve ishin rreptësisht të ndaluara kontaktet e bashkatdhetarëve tanë me të afërmit e tyre dhe me vendlindjen, sepse pushteti serbo-jugosllav frikësohej se informimi i drejtë për jetën në Turqi mund ta ngadalësonte procesin e shpërnguljes, meqenëse pjesa dërmuese e migrantëve shqiptarë ishin ngulitur në rajonet e varfra të Turqisë dhe në pjesët po kështu të varfra të qyteteve të saj, ku bënin një jetë të mjerueshme. Kontaktet u mundësuan vetëm pas ndryshimeve që u bënë në kreun politik të shtetit jugosllav (1966), decentralizimit të funksioneve të ish-Federatës dhe forcimit të subjektivitetit politik të Kosovës në këtë Federatë (1968;1974).

Derisa vazhdonte shpërngulja e shqiptarëve në Turqi, në Kosovë pasoi *vala e dytë e fuqishme e kolonizimit:* shumë serbë dhe malazezë nga Serbia dhe Mali i Zi vijnë si kuadro me kualifikime të ulëta, të mesme ose që dinin vetëm shkrim-lexim, por një numër i konsiderueshëm instalohet me familje. I zënë vendet e punës në organet administrative e shtetërore, në drejtorate, në instuticione sociale dhe shërbime komunale, në ente shëndetësore dhe kulturore etj. Të ardhurit ishin kryesisht nga viset e Serbisë së Jugut dhe nga rajoni i Plavës, Gucisë, Podgoricës etj., të cilët më vonë, pas përfundimit të karrierës së punës dhe pasurimit, kthehen në vendlindjet e tyre, ku edhe i kishin pronat e patundshme dhe farefisin.

Nga fundi i viteve të 60-ta, kryesisht për shkak të dendësisë së madhe agrare dhe ngushtimit të perspektivës jetësore, nisi emigrimi i punëtorëve shqiptarë në vendet e zhvilluara të Evropës, por një numër i konsiderueshëm i tyre kishte emigruar në shumë qytete të ish-Jugosllavisë, kryesisht si punëtorë krahu e një numër edhe si zejtarë kurbetçarë. Migrantët e punës ishin kryesisht të rinj dhe të gjinisë mashkullore. Ky proces vazhdoi deri më 1999 në rrethana të presioneve edhe më të mëdha ekonomike dhe politiko-policore, që ushtrohej nga pushteti okupues serb. Numri më i madh i emigrantëve ekonomikë, së bashku me azilantët shqiptarë të viteve të 80-ta dhe të 90-ta dhe të strehuarit e tjerë pas gjenocidit serb në pranverën e vitit 1999 është në Evropën Qendrore

---

založba, Ljubljana, 1984, f. 214 e tutje.

[20] P. Nushi, "Karakter i osobenosti prilaza izučavanju iseljeništva naroda i narodnosti pokrajine Kosova*", Iseljeništvo naroda i narodnosti Jugoslavije,* Zagreb, 1978, f. 586.

[21] H. Islami*, Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës,* f. 185.

dhe VP. Meqenëse ky emigrim deri para disa viteve kishte të shumtën karakter të përkohshëm dhe nuk ishte tepër selektiv sipas moshës dhe gjinisë, nuk rrezikohej riprodhimi normal i popullsisë në rajonet emigruese të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare. Mirëpo, intensifikimi i procesit të shpërnguljes dhe rritja e shkallës së selektivitetit sipas veçorive biologjike (emigrojnë kryesisht të rinjtë dhe të shumtën meshkujt) hapi mundësi objektive që në një të ardhme të afërt të shkaktoheshin pasoja të pavolitshme në nivelin e natalitetit e të fertilitetit, në martesa, në strukturat bazë demografike, në vëllimin e fuqisë punëtore në disa zona rurale të Kosovës etj.

Periudha pas vitit 1966 shënoi padyshim një kthesë të madhe politike dhe shoqërore në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi. Me ndryshimet e kuadrove në udhëheqjen më të lartë të ish-shtetit dhe hedhjen poshtë të konceptit nacionalist dhe hegjemonist të politikës rankoviqiste, në Kosovë nisi procesi i trajtimit të barabartë të shqiptarëve me serbët dhe malazezët dhe afirmimi i tyre nacional e kulturor. Në një klimë të tillë të krijuar politike serbët dhe malazezët nisën ta braktisin Kosovën, ndërsa në Kosovë të vijnë shqiptarët nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia e Jugut, por edhe myslimanët nga rajoni i Sanxhakut. Ardhja e shqiptarëve në Kosovë u bë për shkak të reduktimit të të drejtave kombëtare e qytetare dhe politikës shtypëse maqedono-serbo-malazeze. Pasi Kosova fitoi një shkallë të autonomisë, u hap Universiteti (1970) dhe shumë shkolla të mesme dhe u rrit numri i vendeve të punës, shqiptarët nga rajonet e përmendura vinin në Kosovë, veçanërisht në Prishtinë dhe në qytetet e tjera për t'u shkolluar. Një numër i madh i tyre pas kryerjes së shkollave dhe fakulteteve mbetej përgjithmonë në Kosovë, sepse atje nuk mund të punësoheshin, por edhe ndiqeshin nga pushtetet e atjeshme. Kishte mjaft të ardhur edhe në kuadër të migrimeve të martesave. Hapja e Universitetit të Prishtinës intensifikoi migrimet ndërshqiptare dhe përmes kontakteve midis të rinjve dhe martesave midis tyre hapi mundësi të gjera për një integrim të rajoneve shqiptare në shumë sfera të jetës.

Mirëpo, nuk ishte i vogël numri i atyre shqiptarëve që vinin nga trojet e përmendura në Kosovë drejtpërdrejt me familje për të njëjtat arsye. Madje edhe pas vitit 1981, ndonëse Kosova ishte në gjendje shtetrrethimi, ende bënin rezistencë institucionet e subjektivitetit të saj autonom, ndërsa në Maqedoni dhe në viset e tjera shqiptare situata ishte edhe më e rëndë, prandaj shumë familje e individë, derisa nuk u rrënua në tërësi autonomia e Kosovës (1989), gjenin strehim në Kosovë. Ka pasur shpërngulje edhe në drejtimin Kosovë-Maqedoni, por më tepër për shkaqe familjare (martesat). Mund të vlerësohej se prej vitit 1966 e deri më sot në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia në Kosovë kanë ardhur rreth 45.000 shqiptarë.

Qarqet serbe, pushtetore dhe të tjera, si kisha ortodokse, Shoqata e Shkrimtarëve, Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve, që ishin edhe nxitëset e dhunës e të krimeve në Kosovë, manipuluan shumë me shpërnguljen e serbëve nga Kosova. Mirëpo, shpërngulja e tyre nga Kosova pas vitit 1966 nuk ishte bërë për shkak të presioneve të shqiptarëve mbi ta, kinse me qëllim të krijimit të "Kosovës etnikisht të pastër" dhe të "Shqipërisë së Madhe", siç e paraqiste pushteti serbo-jugosllav pas vitit 1981, por për shkak të humbjes së privilegjeve që gëzonin deri atëherë dhe mostolerimit të barazisë së shqiptarëve me ta, pastaj për shkaqe të pasigurisë së atyre serbëve që i përkisnin aparatit shtetëror e policor e që u kishin bërë shumë të këqija shqiptarëve (në kohën e sundimit të Rankoviqit), për arsye të gjendjes shumë më të mirë ekonomike në Serbi dhe fitimeve të mëdha nga shitja e pasurisë së patundshme në Kosovë dhe në mënyra të tjera. Një numër i madh i serbëve të shpërngulur ishte me origjinë kolonizuese, të valës së parë dhe valës së dytë të kolonizimit të Kosovës, prandaj edhe kthehej në vatrat e tyre, në Serbi dhe Mal të Zi. Një numër tjetër i serbëve të shpërngulur i përkiste eprorëve ushtarakë, të cilët, në kuadër të ndërrimit të vendit të shërbimit, evidencoheshin si të shpërngulur, madje nën "presion" të shqiptarëve!

Në anën tjetër, dallimet në nivelin e zhvillimit midis Kosovës dhe territoreve tjera të ish-Jugosllavisë gjithnjë e më shumë thelloheshin, prandaj njerëzit në pamundësi që të gjenin punë në Kosovë shkonin në rajonet e zhvilluara të Serbisë, Sllovenisë etj., por edhe migrimet për shkaqe familjare, individuale e arsye të tjera ishin dukuri normale, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare dhe fetare. Çështje tjetër ishte se, përveç Beogradit dhe qyteteve tjera të mëdha, Serbia kishte edhe disa qendra tjera ekonomike, urbane e kulturore në jug të saj, sikurse Vranja, Leskovci, Kurshumlia, Prokupla, Aleksinci, Krushevci, Kraleva, Çaçaku, Uzhica etj. Duke marrë parasysh afërsinë e tyre, në kuadër të migrimeve intensive fshat-qytet, popullata serbe e Kosovës kur vendoste ta braktiste fshatin, shpërngulej drejtpërdrejt në këto qytete, ndërsa vetëm një numër i vogël vinte në qytetet e Kosovës. Identike ishte situata edhe me shqiptarët, të cilët, duke i braktisur fshatrat dhe qendrat urbane të Luginës së Preshevës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi drejtpërdrejt vinin në qytetet e mëdha të Kosovës, veçanërisht në Prishtinë. Fshatarët-bujqit serbë, me shitjen e pasurisë me çmime shumë të larta në Kosovë, blinin tokë, shtëpi, objekte ekonomike dhe mjete të punës në rajonet bujqësore, kryesisht rreth qyteteve me çmime shumëfish më të ulëta në raport me ato të shitjes, për çka edhe u mbeteshin mjete të bollshme për kursim. Serbët të cilët kishin mënyrë më të gjatë të jetës urbane në Kosovë, sipas rregullit, vendoseshin në qendrat e mëdha në Serbi, para së gjithash në Beograd dhe në rrethinën e tij, që u ofronin kushte shumë më të volitshme dhe më cilësore të jetës e të punës. P.

sh., sipas regjistrimit të vitit 1981, rreth 38% të popullsisë së shpërngulur nga Kosova janë ngulitur në rajonin e Beogradit.

Shpërnguljen e serbëve dhe e malazezëve nga Kosova strukturat politike e shtetërore të Kosovës, të Serbisë dhe të ish-Jugosllavisë e shpjegonin si presion të shqiptarëve në ta për arsye kinse të synimit për ta krijuar "Kosovën etnikisht të pastër". Ishte kjo një floskulë politike. Organet policore kështu i kishin shpjeguar edhe migrimet krejtësisht të lira ekonomike të serbëve nga Kosova, duke theksuar si detyrë patriotike ruajtjen e Kosovës nga shqiptarët. [22] Udhëheqja dogmatike, e paarsimuar dhe karrieriste e Kosovës, duke mos e ditur prapavinë politike të kësaj teze dhe duke mos e njohur karakterin e ndërlikuar të procesit të migrimeve, që në fillim, shumë lehtë, e pranoi vlerësimin e Serbisë se deri sa të shpërngulej vetëm edhe një serb apo malazias nga Kosova, situata politike në Kosovë nuk mund të konsiderohej stabile!

Gjendja faktike nuk përkonte me kualifikimet se serbët dhe malazezët shpërnguleshin nga Kosova për shkak "të presioneve", "diskriminimit", "terrorit", "gjenocidit" dhe "shfarosjes" nga ana e shqiptarëve. Këto akuza, që përsëriteshin si refren në jetën e përditshme, ishin vërtet shumë të rënda, ofendim për popullin shqiptar, sepse ai dëshirohej të paraqitej si komunitet gjenetikisht i prirur për vepra antisociale dhe keqbërje, por fatmirësisht ato shqiptoheshin pa asnjë argument. Shqiptarët tashmë ishin shpallur si fajtorë kujdestarë për gjithçka dhe komb i dyshimtë në ish-Jugosllavi, natyrisht përveç "shqiptarëve të ndershëm" dhe "me orientim jugosllav".

Asnjë e dhënë nuk fliste në të mirë të tezës se serbët dhe malazezët në vitet e 70-ta e të 80-ta të shekullit të kaluar ishin të diskriminuar, ndërsa shqiptarët si shumicë e popullsisë të privilegjuar. Numri absolut i serbëve të punësuar në sektorin shoqëror ishte në rritje të vazhdueshme në këtë periudhë: në vitin 1970 32.739, më 1980 45.183 dhe në vitin 1986, në kohën e histerisë antishqiptare, 48.429 (në periudhën 1970-1986 punësimi i tyre kishte shënuar rritje për 47,9%). Sipas regjistrimit të vitit 1971 norma e punësimit ishte te malazezët 22,7, te serbët 14,3, te shqiptarët 5,8 dhe te turqit 5,0 (mesatarja kosovare 7,8), ndërsa në vitin 1981 kjo normë rritet te të gjithë, por shumë më e lartë ishte te malazezët (27,5) dhe serbët (21,5) se sa te shqiptarët (9,3) dhe turqit (17,9). Ose, në vitin 1971, në sektorin shoqëror ishte i punësuar çdo i katërti malazez, çdo i shtati serb, çdo i nënti turk dhe çdo i shtatëmbëdhjeti shqiptar (mesatarja e Kosovës 8,9). Serbët dhe malazezët më tepër ishin të punësuar në administratë, në drejtorate, në banka, në kontabilitet, në mbrojtjen sociale e shëndetësore, në ish-BVI-të,, pastaj si persona udhëheqës, në tregti,

[22] H. Hoxha, "Proces nacionalne afirmacije albanske nacionalnosti u Jugoslaviji", *Časopis ka kritiko znanosti,* šr. 51-52, Ljubljana, 1982, f. 349.

komunikacion, hotelieri dhe në veprimtaritë sekondare, ndërsa shqiptarët më tepër në veprimtaritë e sektorit primar (profesionet bujqësore) dhe në kurbet (ish-Jugosllavia dhe bota e jashtme).

Serbët dhe malazezët kishin shkallë më të lartë të urbanizimit dhe normë më të ulët të ruralitetit në Kosovë. Sipas regjistrimit të vitit 1961 në qytete jetonin 36,3% të malazezëve dhe 20,3% të serbëve, ndërsa në vitin 1981 këto përqindje rriten te malazezët në 70,0% dhe te serbët në 38,1%. Shqiptarët, përkundrazi, kishin shkallë më të ulët të urbanizimit dhe më të lartë të ruralitetit në Kosovë: në vitin 1961 16,7% dhe më 1981 28,9% e tyre jetonte në qytet (mesatarja kosovare 19,7% dhe 24,4%). Serbët dhe malazezët ishin të koncentruar në bërthamat e qendrave urbane, kryesisht në banesa shtetërore (mënyra urbane e jetës), kurse shqiptarët në periferitë e qyteteve dhe kryesisht në shtëpi private, shpeshherë pa elemente të sistemeve urbane (mënyra rurale e jetës). Sipas regjistrimit të vitit 1981, nga numri i përgjithshëm i banesave në pronësinë shoqërore në Prishtinë (8.075 banesa, që përbënte 1/3 e fondit të Kosovës), 41,0% u takonte shqiptarëve (ndaj 70,1% në popullsinë e qytetit), 38,0% serbëve (ndaj 15,6% në popullsi), 11,0% malazezëve (ndaj 3,8% në popullsi), 3,0% myslimanëve (ndaj 2,3% në popullsi), 2,0% turqve (ndaj 1,7% në popullsi) dhe 1,0% romëve (ndaj 1,4% në popullsi). Me banesa shoqërore më tepër dispononinmalazezët (84,7% e tyre), "jugosllavët" (82,7%), serbët (70,3%) dhe myslimanët (60,5% të tyre), ndërsa më pak shqiptarët (26,9%) dhe turqit (35,9%).[23]

Për arsye të përmendura vlerësohet se prej vitit 1966-1981 nga Kosova janë shpërngulur drejtpërdrejt rreth 52.000, ndërsa prej vitit 1981-1988 rreth 20.000 serbë; pjesa dërmuese e të shpërngulurve u ngulit në Serbi, kryesisht në zonën urbane të Beogradit (rreth 40%) dhe të qyteteve të tjera të mëdha e të mesme, që ofronin kushte shumë më të mira të jetës e të punës. Por për krejt këtë periudhë, anipse saldoja e migrimeve është negative, kishte edhe ardhje të serbëve brenda migrimeve të martesave dhe stimulimit të rikolonizimit të Kosovës pas vitit 1981. Pas rrënimit të plotë të autonomisë dhe subjektivitetit politik të Kosovës në ish-Federatën jugosllave në mars të vitit 1989, shpërngulja e serbëve vazhdon me intensitet të dukshëm, por pushteti serb tash këtë proces nuk e problematizon, sepse shqiptarët më nuk mund t'i fajësonte para botës dhe opinionit serb. Po ta pranonte faktin e shpërnguljes së serbëve pas aneksimit dhe okupimit të plotë të Kosovës, ky pushtet publikisht do ta pranonte politikën e tij të dështuar në Kosovë.

[23] *Sociološka studija grada Prištine,* Ekonomski institut, Priština, 1986, ff. 40-41.

3. Programi jugosllav për Kosovën në funksion të politikës së re kolonizuese serbe dhe ndjekjes së shqiptarëve

Pasi u krijua atmosfera për fajësimin kolektiv të shqiptarëve, nga represioni i shtetit policor dhe partiak komunist pasoi një valë e konsiderueshme e ikjes së tyre, kryesisht të rinjve, ndërsa pas nxjerrjes me dhunë nga puna të më se 150.000 punëtorëve shqiptarë prej vitit 1990 e këndej, emigrimi për motive ekzistenciale u intensifikua edhe më tepër. Pasi pëlciti lufta në Slloveni e Kroaci (1991) dhe në BeH (1992) ushtarët shqiptarë, duke mos dashur të luftojnë në anën e ushtrisë agresore serbo-jugosllave dhe kundër popujve të pafajshëm joserbë, e braktisën këtë ushtri dhe ikën kryesisht në vendet perëndimore. Një numër i madh i shqiptarëve gjeti strehim politik në këto vende, veçanërisht të rinjtë. Ish-APJ-ja, që nga viti 1981 kishte montuar shumë procese politike kundër ushtarëve shqiptarë, me ç'rast kishte burgosur dhe vrarë shumë shqiptarë, të cilët i kthente në arkivole hermetikisht të mbyllura, duke mos u ofruar dëshmi as familjeve e as opinionit për vrasjen e tyre.

Pas shpërthimit të luftës në ish-Jugosllavi në vitin 1991 shumë shtete perëndimore e kushtëzonin hyrjen përmes vizave. Mirëpo, shumë shqiptarë, me familje dhe si individë, vazhdonin të shpërnguleshin në shtetet e tjera evropiane ku ende mundësohej hyrja dhe përmes tyre ilegalisht hynin në vendet që kishin vënë viza. Shumë të rinj shqiptarë të ndjekur nga autoritetet ushtarake e policore serbe u strehuan te të afërmit e tyre në Turqi, Shqipëri, Maqedoni dhe në vende të tjera. Më brengosëse u bë atëherë dukuria e shkuarjes së shqiptarëve, sidomos të rinjve, përtej oqeanit: në SHBA, Kanadë dhe Australi, meqenëse ekzistonte frika objektive se emigrimi i përkohshëm në këto vende do të shndërrohej në shkuarje pa kthim. Vala e re e terrorit me pretekst të kërkimit të armëve ishte faktori tjetër në funksion të drejtpërdrejtë të shpërnguljes së shqiptarëve. Në këtë funksion ishte edhe përjashtimi i punëtorëve shqiptarë nga puna, shkatërrimi i bazës ekonomike të Kosovës përmes plaçkitjes së fondeve dhe teknologjisë, taksat dhe dënimi i afaristëve shqiptarë, ndjekja e vazhdueshme e rekrutëve shqiptarë, si dhe okupimi i hapësirave shkollore dhe universitare për nxënësit dhe studentët shqiptarë dhe pengimi i funksionimit të arsimit shqiptar të të gjitha niveleve.

Në fillim të vitit 1992 institucionet e atëhershme të Kosovës dhe partitë politike që i tubonin shqiptarët në ish-Jugosllavi organizuan një regjistrim të shqiptarëve në botën e jashtme,[24] pos në Turqi, ku kishte vështirësi të një

[24] Regjistrimin, që zgjati prej 1-15 mars 1992, e koordinoi Komisioni Qendror i përbërë nga ekspertët nga Prishtina dhe komisionet në nivel të vendeve të ngulitjes, të përbëra nga

natyre specifike. Sipas rezultateve të para të këtij regjistrimi u evidentuan 217.141 shqiptarë. Numri më i madh i tyre u evidentua në Gjermani (82.348 ose 38,0%) dhe në Zvicër (72.448 ose 33,4%), pastaj në Suedi (15.652 ose 7,2%), Austri (12.300 ose 5,7%), Kroaci (9.087 ose 4,2%) dhe numri tjetër prej rreth 12% në vendet e tjera të Evropës. Me gjithë angazhimet e mëdha të komisionit qendror të regjistrimit dhe komisioneve në nivel të shteteve dhe gjithë diasporës një numër i madh i shqiptarëve mbeti pa u përfshirë në regjistrim, sepse pikërisht atëherë vazhdonte vala e shpërnguljes intensive dhe shumë shqiptarë gjendeshin në lëvizje ose me vendqëndrime të përkohshme dhe si të tillë nuk ishin të evidentuar nga shoqatat, klubet dhe degët e partive politike shqiptare në vendet evropiane. Edhe në SHBA dhe Kanada u provua të bëhej regjistrimi i shqiptarëve, por shtrirja e gjerë hapësinore dhe distancat e mëdha territoriale, por edhe disa probleme tjera të ndërlikuara (dobësitë në organizimin e komunitetit, ndikimet ideologjike, fetare, rajonale etj.) ndikuan që të evidentoheshin pak shqiptarë. Vlerësohet se sot numri i shqiptarëve në truallin amerikan mund të arrijë në rreth gjysmë milioni. Përgjithësisht deri në sulmet e Aleancës Veriatlantike mbi caqet serbe (1999), sipas disa vlerësimeve më se 400.000 shqiptarë nga trojet e tyre të ish-Jugosllavisë, kryesisht nga Kosova, punonin dhe me status të ndryshëm qëndronin në Gjermani (rreth 170.000 ose rreth 45% nga numri i gjithmbarshëm i të shpërngulurve shqiptarë), në Zvicër (rreth 130.000 ose 30%), ndërsa pjesa tjetër prej 25% kishte shkuar në vende të tjera: në Suedi (rreth 35.000, kryesisht si azilantë), Austri (rreth 23.000), Belgjikë (rreth 8.000), Francë (rreth 5.000), Danimarkë (rreth 5.000), Itali (rreth 4.000), Norvegji (rreth 4.000), Angli (rreth 3.000), Holandë (rreth 2000), Finlandë (rreth 600), Luksemburg (rreth 200), pastaj në Kroaci (rreth 40.000), Slloveni (rreth 15.000), Shqipëri (rreth 25.000), ndërsa në BeH, deri në vitin 1992, vlerësohej se kishte rreth 30.000 shqiptarë me status të ndryshëm qëndrimi.

Në dhjetëvjetëshat e fundit të shek XX, për arsye tashmë të njohura ekonomike dhe politike, shumë shqiptarë emigruan në SHBA, të cilët iu bashkuan diasporës së madhe të hershme dhe arritën madje deri në Alaskë, pastaj në Kanada, Australi e Zelandë të Re. Pas eksodit masiv të shqiptarëve të Kosovës nga ndërmarrjet gjenocidale serbe gjatë kohës së bombardimeve (24 mars deri 10 qershor 1999) shumë shqiptarë u strehuan në vende të ndryshme të Evropës dhe jashtë saj, ku një numër edhe mbeti atje. Por kjo mbetje e tyre duket se nuk e ka ndryshuar shumë gjendjen numerike në raport me atë të para 24 marsit 1999. Vlerësohet se sot jashtë hapësirës gjeoetnike të shqiptarëve në vendet perëndimore gjenden afër 1 milion shqiptarë dhe rreth gjysma e tyre emigruan në këto tri dekadat e fundit. Bashkatdhetarët nuk kursyen asgjë për ta

aktivistët e dalluar të organizimeve shqiptare (klubet, shoqatat, degët e partive politike).

ndihmuar materialisht, moralisht, politikisht dhe ushtarakisht Kosovën e okupuar dhe shqiptarët e frustruar në të gjitha trojet etnike në ish-Jugosllavi, veçanërisht në vitet kur shpërthyen konfliktet midis shqiptarëve të Kosovës dhe Serbisë (1998-1999), shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe Serbisë (2000-2001) dhe pushtetit maqedonas dhe shqiptarëve (2001).

Me propozimin e Qeverisë së "reformatorit" Ante Markoviq[25] të ish-Jugosllavisë, natyrisht me kërkesën e Serbisë, në vitin 1989 u miratua në Kuvendin e këtij ish-shteti i ashtuquajturi Program jugosllav për Kosovën. Përmes këtij Programi, në të vërtetë, filloi *vala e tretë e kolonizimit të Kosovës*. Kjo politikë e re kolonizuese ishte pjesë e programit ekstrem nacional serb, që gjithashtu kishte për qëllim instalimin e serbëve për ta vënë baraspeshën etnike në Kosovë. "Programi jugosllav" u siguronte kolonëve serbë 3.284 banesa dhe 1.422 troje falas për ndërtim, ndërsa vetëm në periudhën 1989-1993 parashihej ndërtimi i 2.000 banesave dhe i 710 shtëpive individuale me kushte tepër të volitshme, me kredi afatgjata dhe pa kamatë. Ish-Federata jugosllave dhe republikat e saj ndanin mjete të mëdha për stimulimin e ardhjes sa më masive të serbëve në Kosovë, që përkrahej edhe nga ish-udhëheqja komuniste shqiptare e Kosovës. Privilegjet e serbëve ishin shumë të mëdha: sigurimi i punësimit, i banesave, i trojeve falas, i kredive afatgjata pa kamatë, për të njëjtin vend pune të ardhurat shumë më të mëdha se të shqiptarëve dhe beneficione të tjera. Në vargun e shumë paradokseve këtu del në shesh edhe një tjetër: Serbo-Jugosllavia e dëshironte edhe Kosovën e kolonizuar nga serbët, edhe Kosovën e pazhvilluar për shqiptarët!

Në vitet e 80-ta filloi ngritja e reparteve industriale në enklavat serbe dhe ndërtimi i objekteve segregacioniste të banimit në funksion të rikolonizimit. Kjo valë e kolonizimit filloi me sjelljen e policëve, të instruktorëve të lartë ushtarakë, të gjykatësve dhe administratorëve për t'i ndjekur e torturuar sa më tepër shqiptarët. Ish-Federata dhe njësitë e saj në këtë mënyrë stimulonin represionin dhe segregacionin në Kosovë dhe e ndihmonin realizimin e synimeve të kamotshme të politikës hegjemoniste të Serbisë, rikolonizimin e Kosovës. Ndërkaq, në kuadër të Programit jugosllav për Kosovë, për shqiptarë ofrohej si ndihmë punësimi në miniera, në industrinë e rëndë, në shërbime komunale (pastrimi i rrugëve) dhe në ndërtimtari në Serbi dhe në rajonet e tjera të ish-Jugosllavisë kinse për ta përmirësuar situatën punuese dhe jetësore të tyre. Ishin këto vende të punës që refuzoheshin nga punëtorët e atjeshëm, sikurse edhe në botën e jashtme,

[25] Më 28 mars 1989, kur Kuvendi i Serbisë definitivisht rrënoi subjektivitetin politiko-konstitucional të Kosovës me forcë dhe u derdh gjaku në Kosovë, A. Markoviqi festonte në Beograd me udhëheqjen e Serbisë, duke e copëtuar pogaçën!

që paguheshin pak, ndërsa kërkonin mund të madh fizik dhe me pasoja afatgjata negative në kondicionin punues dhe në shëndet.

Pas demonstratave masive të shqiptarëve në vitin 1981 pushteti serbo-jugosllav nisi të zbatojë programe konkrete zhvillimore vetëm për ato mjedise në Kosovë ku jetonin serbo-malazezët, ndërsa prej vitit 1987 formoi disa komuna të reja ku ose dominonin serbo-malazezët ose përbënin deri 50% në popullsinë e gjithmbarshme (Zubin Potoku, Zveçani, Fushë-Kosova, Shtimja, Shtërpca, Obiliqi, Novobërda), në të cilat menjëherë nisi ngritja e disa reparteve industriale dhe e infrastrukturës, ndërsa në komunën e Malishevës, si komunë e vetme e re që banohej nga shqiptarët, prej themelimit në vitin 1985 nuk ishte ngritur asnjë objekt industrial e infrastrukturor. Kështu vargoheshin monumentet segregacioniste, me pasoja të shumëfishta ekonomike e politike. Serbo-malazezët gëzonin privilegje nga tre nivele: kosovare, serbe dhe jugosllave, ndërsa shqiptarët, historia dhe kultura e tyre, përjetonte represionin e këtyre tre niveleve. Derisa shqiptarët për një parullë, p. sh. "Kosova-republikë", të cilën mund ta shkruante vetë policia, kalbeshin nëpër burgjet serbe e jugosllave, serbo-malazezët gëzonin të drejtën që në tubime të rrugëve ta shanin Kushtetutën në fuqi, shtetin e pushtetin, udhëheqjet dhe t'i fyenin popujt e tërë, të kërkonin armë për vrasjen e shqiptarëve e të mos ftoheshin as në "biseda informative" nga organet kompetente. Madje as për programet çetniko-fashistoide që i prezantonin para kamerave televizive askush nuk i merrte në përgjegjësi.

Për nxënësit e kombësisë serbe e malazeze, por edhe turke formoheshin paralele "xhuxhe" me 2-10 nxënës, numri i të cilave sillej deri 500 sish, ndërsa në Fakultetin e Mjekësisë dhe në degët e tjera atraktive regjistroheshin përtej numrit të paraparë dhe pa provim pranues. Në anën tjetër, për shqiptarët vazhdimisht kërkohej që të mbylleshin shkollat në gjuhën amtare, ndërsa me ligjet e Serbisë parashihej suprimimi i mësimit në gjuhën shqipe në Universitet. Prej vitit 1988, nxënësit serbo-malazezë në shkollat fillore e të mesme i ndiqnin mësimet vetëm para dite, ndërsa fëmijët shqiptarë vetëm pas dite. Nxënësit serbo-malazezë dhe prindërit e tyre, të nxitur nga organet e pushtetit e të partisë, kërkonin që arsimtarët shqiptarë, të përjashtuar nga partia, të pushoheshin edhe nga puna, duke paraqitur edhe kushte ultimative se nëse nxënësit shqiptarë nuk largoheshin nga shkollat e përbashkëta, ata do ta bënin këtë dhe do të shpërnguleshin nga Kosova. Këto kërkesa edhe përfilleshin (rasti i përjashtimit të 10 profesorëve nga shkolla e mesme "Boro e Ramizi" në Gjilan dhe përzënia nga shkolla fillore në fshatin Priluzhë, afër Vushtrisë, ku nxënësit shqiptarë mësonin në shtëpi private, etj.). Ndërsa për ndasitë e përmendura e veprime të tjera para opinionit jugosllav i fajësonin shqiptarët. Më se 11.000 nxënës shqiptarë mbetën pa u regjistruar në shkolla të mesme në vitin shkollor 1989/90, më se 1.100 nxënës shqiptarë nuk morën

vizën moralo-politike për t'u regjistruar në Universitetin e Prishtinës, u përjashtuan nga procesi mësimor më se 700 arsimtarë shqiptarë.[26] Pas vitit 1990 u ndoqën të gjithë studentët dhe arsimtarët shqiptarë nga objektet e UP, të gjithë nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë nga ndërtesat e shkollave të mesme, por edhe nxënësit dhe arsimtarët nga objektet e shumë shkollave fillore.

Me kërkesat e udhëheqësve serbo-malazezë të Kosovës dhe të politikës zyrtare të Serbisë, që i miratonte fare lehtë udhëheqja karrieriste shqiptare, në komunën e Lipjanit, të Ferizajt, të Pejës, të Klinës etj., u bë ndërrimi me dhunë i emrave të shkollave dhe të rrugëve, që i mbanin emrat e luftëtarëve, rilindasëve, patriotëve dhe humanistëve të njohur (vëllezërit Frashëri, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Luigj Gurakuqi, Haxhi Zeka etj.). Edhe në Preshevë iu hoq emri i Skënderbeut qendrës së shkollës së mesme dhe për shkak të kundërshtimit të këtij ndërrimi nga ana e arsimtarëve, nga puna u përjashtuan 10 profesorë shqiptarë. Emrin e Luigj Gurakuqit mund ta mbante një nga rrugët kryesore të Barit të Italisë e jo qendra shkollore në Klinë, ose në Horë të arbëreshëve (Sicili) shkolla fillore mund ta mbante emrin e Skënderbeut, por jo në Preshevë. Ndërrimi i emrave të të gjitha shkollave dhe rrugëve në Kosovë vazhdoi me arrogancë deri në serbizimin e plotë të tyre. Në këtë mënyrë, duke zbatuar metodat e ndjekjes staliniste ndaj shqiptarëve, pushteti policor e militarist ndërsente nacionalizmin serbomadh si në Kosovë, ashtu edhe në trojet e tjera etnike shqiptare.

Organet e shtetit partiak e policor ndërsenin nacionalizmin serb dhe askush nuk brengosej në shoqërinë jugosllave, as udhëheqja e Kosovës, për emigrimin pa kthim të shqiptarëve nga Maqedonia, Mali i Zi dhe nga Kosova në SHBA dhe në vendet e zhvilluara të Evropës e as për ardhjen e tyre në Kosovë për shkak të sjelljeve brutale dhe reduktimit të arsimimit në gjuhën shqipe të shqiptarëve nga viset e tjera, sikundër që askush nuk u dënua më asnjë ditë burg për ndjekjen e shqiptarëve në Serbi, thyerjes së dyqaneve të tyre (267 raste në periudhën 1984-1987), bojkotimin e shërbimeve, madje edhe vrasjen e tyre. Sipas të dhënave të Shoqatës për Popujt e Rrezikuar (Gesellschaft für Bedrohte Völker) në Göttingen (RF e Gjermanisë), vetëm deri në fund të viteve të 80-ta, për shkaqe ekonomike dhe politike, rreth 250.000 shqiptarë i kishin braktisur territoret e tyre në ish-Jugosllavi dhe ishin vendosur rreth 100.000 në Gjermaninë Federale, rreth 60.000 në Zvicër, rreth 40.000 në vendet e tjera perëndimore dhe rreth 50.000 në viset veriore të ish-Jugosllavisë.[27] Me dhjeta mijëra shqiptarë kërkonin azil politik në vendet

[26] *"Borba"*, 20. 01. 1990, Beograd.

[27] Këto të dhëna i kishte kumtuar Amnesty International (Londër), ndërsa i kishin botuar gazetat më të mëdha, si Frankfurter Allgemeine (Franfurt), Corriere della Sera (Milano) etj. në fillim të shtatorit të vitit 1988.

perëndimore, ndërsa flitej e planifikohej dëbimi i qindra-mijëra shqiptarëve nga Kosova, kinse të ardhur nga Shqipëria etj.

Metodat mesjetare të linçimit ishin në ekspansion: më se 584.000 shqiptarë, sidomos të rinj, deri 25 vjet (200 në ditë) në mënyra të ndryshme kaluan nëpër trajtimin dhe represionin policor.[28] Këto të dhëna, që i kumtoi para delegatëve të Kuvendit të KSA të Kosovës përgjegjësi i policisë së Kosovës, i referoheshin periudhës prej mars 1981 deri në tetor të vitit 1988 dhe i përkisnin vetëm shqiptarëve të Kosovës. Ndërsa sa ishin burgosur e përpunuar në polici dhe dënuar në gjyqe pas kësaj kohe dhe sa ishin trajtuar nëpër këto organe në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Serbi të Jugut nuk dihej.

Ishte e pabesueshme se sa ishte diskrepanca e madhe në zbatimin e ligjeve ndaj shqiptarëve dhe ndaj të tjerëve për të njëjtat vepra. Për shqiptarë p. sh. më se 10 herë shqiptoheshin dënime më të rënda se sa për serbë e malazezë: i mituri shqiptar nga fshati Plemetin afër Prishtinës për tentim dhunimi ndaj një të miture të kombësisë serbe (të kurdisur) u dënua me 10 vjet burg, ndërsa serbi i moshës madhore për dhunimin e të miturës së kombësisë shqiptare dënohet vetëm me një vit burgim, etj.

Edhe Lidhja Socialiste e Kosovës ishte inkuadruar në ndjekjen e shqiptarëve. Ajo kërkonte që edhe për veprime të paverifikuara dhe pseudovepra, si dhe për konflikte të rëndomta në jetën e përditshme midis serbo-malazezëve dhe shqiptarëve, këta të fundit të ndëshkoheshin me norma të dyfishta: me ligje pozitive në fuqi dhe me norma negative zakonore, çfarë ishte p. sh. lëçitja. Profesori i Fakultetit të Drejtësisë, akademik Syrja Pupovci, i cili më parë si studiues i normave të Kanunit të Lekë Dukagjinit ishte ngritur kundër aplikimit të normave dhe vetëdijes patriarkalo-feudale, në vitin 1986, në kohën e histerisë antishqiptare, me këmbëngulje kërkonte zbatimin e tyre ndaj shqiptarëve, madje, siç thoshte ai, "në mënyrë shembullore",[29] sikurse në mesjetë. Pupovci e dinte shumë mirë se lëçitjen si normë ndëshkimore e së drejtës zakonore të shqiptarëve, në fshatrat e Kosovës gjatë LNÇ-së, në luftë kundër partizanëve, e kishte zbatuar okupatori fashist, ku familjet shqiptare, që kishin partizanë, lëçiteshin me dhunë nga farefisi, fqinjët dhe fshati.

Në vazhdën e ndjekjes së shqiptarëve duhet zënë në gojë inskenimet dhe shpifjet e përditshme të veprave keqbërëse të shqiptarëve mbi serbët, siç janë dhunimet, rrënimi i varrezave etj., për të cilat udhëheqësit e atëhershëm

---

[28] "*Rilindja*", 15. 10. 1988, Prishtinë.

[29] S. Pupovci, "Si të luftohen dukuritë dhe sjelljet devijante në Kosovë", *Rilindja,* 13. 12. 1986. Lidhur me këtë shih kritikën: H. Islami, "Albansko-običajno pravo in socialističke norme (Ob zahtevi akademika Pupovcija po uveljavanju običajnih norm Zakonika Leke Dukagjinija danes)", *Časopis za kritiko znanosti,* nr. 103/104, Ljubljana, 1987, ff. 36-45.

kosovarë nuk merrnin guximin të thoshin publikisht se janë gënjeshtra, madje, në disa raste, me përkrahjen parezervë që i jepnin, edhe vetë i prinin gënjeshtrave të tilla. Kështu, deri në shtator të vitit 1988, sipas përgjegjësve të organeve të Kosovës, u shpifën 12 raste të dhunimit të femrave serbo-malazeze nga ana e shqiptarëve, mbi të cilat ishte ngritur një strategji e tërë antishqiptare ("Rilindja", 12.11.1988). Çdo kriminaliteti, madje edhe në ekonomi, i jepej vula nacionale apo nacionaliste, dhe sipas skenarit të përgatitur më parë, fajtori dihej – shqiptari! Kurrë nuk u organizuan biseda me mjekë, gjyqtarë, psikologë dhe me "dhunues" e "të dhunuara" që të sqarohej dhunimi si akt, si vepër penale dhe antinjerëzore.[30] Gjithashtu, kurrë nuk u dha emri i ndonjë shqiptari që "rrënoi" varrezat ortodokse serbe, sikundër që asnjë organizate ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut nuk iu ofruan të dhënat dhe faktet konkrete, siç janë emri i kryerësit të veprës, vendi, lloji i veprës etj., për shkeljen e të drejtave të serbëve nga ana e shqiptarëve me qëllim që të shpërnguleshin nga Kosova, edhe pse ato i kërkonin që nga viti 1981.

Nën parullën e stabilizimit të gjendjes në Kosovë dhe parandalimin e shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve nga "presionet" e shqiptarëve, u nxorën ligje speciale në Kosovë dhe atë pa pëlqimin e Kosovës e të shqiptarëve, si p.sh. ligji mbi gjuhën, përdorimin dhe formën e flamurit, shitblerjen, izolimin, shkollat dhe Universitetin, pensionimin e dhunshëm të arsimtarëve, kthimin e kolonëve e shumë ligje të tjera, me të cilat reduktoheshin të drejtat e shqiptarëve dhe shtohej represioni ndaj tyre. Zbatimi i masave represive dhe okupimi policor e ushtarak në fund të viteve të 80-ta arritën kulminacionin: qindra mijëra shqiptarë kaluan nëpër duar të policisë, qindra të vrarë e të plagosur, dhjetëra e mijëra të përjashtuar nga puna, plaçkitjet e papara të parave e të kolektivave, qindra të izoluar, mijëra të helmuar, proceset e montuara politike dhe i ashtuquajturi diferencim ideor i karakterit inkuizicional, i zbatuar vetëm në periudhat më të errëta të vendeve të komunizmit ortodoksist dhe të ndjekjeve staliniste.

4. Tezat dhe kërkesat fashistoide të tipit sheshelian

Pas rrënimit të sistemit kushtetues dhe mekanizmave të autonomitetit të Kosovës me dhunë, me tanke më 27. 3. 1989 nuk përmenden më "presionet" dhe "gjenocidi" shqiptar mbi serbomalazezët me qëllim të ndjekjes së tyre nga Kosova (dhunimet, rrënimi i varrezave, zjarret, sulmet fizike, dëmet në fushë

[30] Shqiptarët akuzoheshin edhe për raste perverse, çfarë ishte rasti Martinoviq, kur ky serb i sëmurë nga Gjilani, në maj të vitit 1985 në arën e tij, për motive vetëknaqësie, kishte futur një shishe në prapanicë! Për këtë rast, të kualifikuar edhe si "gjenocid fizik" mbi serbët, u shkrua edhe një libër prej rreth 500 faqesh. Shih: S. Stanojević, *Slučaj Martinović,* Beograd, 1986, ff. 1-485.

etj.). Pos konflikteve, që ishin të rëndomta në jetën e përbashkët, të ngarkuar me probleme socioekonomike, këto vepra as që ishin kryer ndonjëherë. "Presioni" i shqiptarëve mbi serbo-malazezët ishte një shpifje e rëndë dhe mbi këtë konstruksion u krijua një klimë dhe strategji antishqiptare jo vetëm në Serbi, por në tërë ish-Jugosllavinë. Por kur strategjia "e presioneve" mbi serbët pas Kosovës nisi të bartej në territorin e BeH, të Kroacisë dhe në viset e tjera, sipas nevojës së qëllimeve politike të Serbisë, çfarë ishte rasti me Kninin, Lublanën, Stara Pazovën etj., atëherë politika serbe doli sheshazi para opinionit jugosllav.

Nga fillimi i viteve të 80-ta të shekullit XX, nga qarqet reaksionare serbe dhe instancat politike serbo-jugosllave doli edhe një tezë tjetër absurde, që u përsërit edhe në mitingjet populiste dhe shoviniste serbe, se kinse një numër i madh i shqiptarëve, rreth 400.000 sish, kanë ardhur nga Shqipëria në Kosovë pas vitit 1941 dhe gjoja në saje të këtij imigrimi shqiptarët paskan krijuar një epërsi në strukturën etnike të Kosovës. Ndërsa faktet pasqyronin gjendje krejtësisht tjetër: sipas regjistrimit të vitit 1981, nga bota e jashtme në Kosovë kishin ardhur 3.33l persona. Prej tyre nga Shqipëria kishin ardhur 1.543 veta, prej të cilëve në Kosovë, sipas raporteve të policisë (1986) jetonin gjithsej 704 veta. Teza mbi numrin masiv të imigrantëve nga Shqipëria ishte në të vërtetë pjesë e një strategjie hegjemoniste serbe për spastrimin etnik të Kosovës, dëbimin jo vetëm të 400.000 shqiptarëve, por edhe të pasardhësve të tyre, e kjo praktikisht do të thoshte të të gjithë shqiptarëve. Insistimi kaq i madh i qarqeve politike e shkencore serbe në këtë tezë, si "argument demografik", kishte për qëllim që shqiptarët t'i paraqesë si "kolonizatorë" dhe "ndjekës" të serbëve dhe se vetëm serbët na e kishin "të drejtën historike, e në mbështetje të saj edhe "të drejtën aktuale" për të jetuar dhe qeverisur në Kosovë, ndërsa shqiptarët si "të ardhur" na qenkëshin të privuar nga këto të drejta. Për këto arsye, por edhe për shkak të jolojalitetit ndaj shtetit serb dhe si "shtetas të huaj", sipas tyre, duhej të dëboheshin nga Kosova, "përtej Bjeshkëve të Nemuna", me mjete dhe metoda gjenocidale si një ëndërr e kamotshme e të gjitha regjimeve serbe, e cila fatmirësisht mbeti vetëm aspiratë hegjemoniste.

Politika shtetërore serbe në fillim të vitit 1990 doli haptas me ligje, projekte dhe programe hegjemoniste, destinimi kryesor i të cilave ishte ndërrimi i strukturës së popullsisë së Kosovës përmes kolonizimit të serbëve dhe spastrimeve të qeta etnike të shqiptarëve. Ky program politik u miratua në Kuvendin e Serbisë dhe në Komitetin Qendror të LKS-së me një titull tepër perfid dhe cinik "Për paqe, liri, barazi, demokraci dhe prosperitet të Kosovës", që kur të krahasohet me dokumentet e politikës së atëhershme zyrtare serbe dhe veçanërisht me "Memorandumin" e Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve ndaj Kosovës del vërtet kopje e tyre: gënjeshtra,

inskenime, akuza dhe tendenca për kolonizim dhe ndërrim të strukturës kombëtare të popullsisë me masa të ndryshme, para së gjithash me masa represive të aparatit shtetëror-policor. Programi doli edhe në "Fletën zyrtare" të Kuvendit të Serbisë,[31] ndërsa u përkrah edhe nga të gjitha partitë e porsaformuara politike serbe.

Në të, përveç tjerash, thuhej: "Është e pakontestueshme se serbët, malazezët, por edhe myslimanët, kroatët, turqit, romët dhe të tjerët në Kosovë vite me radhë jetojnë në kushtet e mungesës së lirisë dhe sigurisë, të sigurisë personale dhe të pasurisë. Prandaj nuk është për t'u habitur që në 50 vitet e fundit nga Kosova janë shpërngulur 400.000, ndërsa vetëm në periudhën 1961-1989 më shumë se 135.000 serbë dhe malazezë. Pjesëmarrja e tyre në popullsinë e përgjithshme të Kosovës në prag të Luftës II Botërore ishte rreth 43%,[32] kurse, për shkak të shpërnguljes masive të tyre dhe ndalimit të kthyerjes në vatrat e tyre, në një anë, dhe eksplosionit demografik të popullsisë së kombësisë shqiptare, në anën tjetër, në vitin 1981 kjo përqindje u zvogëlua në rreth 15%, për t'u reduktuar sot në më pak se 10%.

Është e pakontestueshme se presioni nacionalist ishte shkaku kryesor i shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve nga Kosova, ndonëse kishte

---

[31] "Za mir, slobodu, ravnopravnost, demokratiju i prosperitet SAP Kosovo", *Službeni list*, br. 15, Beograd, 30. mart 1990.

[32] Mirëpo, siç vumë në pah edhe më parë, nga të dhënat zyrtare mbi përkatësinë gjuhësore, megjithë manipulimet që janë bërë në dëm të shqiptarëve dhe popullsisë josllave, shqiptarët, në bazë të gjuhës amtare shqipe (arnautski, siç e quanin), dominuan në pasqyrën etnike të Kosovës qysh në vitet e 20-ta të shek. XX, sepse përbënin 65,8% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës, ndërsa grupacioni i gjuhës serbokroate përbënte 25,9% dhe i asaj turke 6,3% (*Prethodni rezultati popisa stanovništva u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca 31. januara 1921,* Državna štamparija, Sarajevo, 1924, f. 3-34; *Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47,* Savezni zavod za statistiku, Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1995, f. 205). Ndërkaq, sipas regjistrimit të vitit 1931 (të dhënat e të cilit u përpunuan vetëm më 1945, por nuk u publikuan) në Kosovë u shënuan gjithsej 552.064 banorë, kurse prej tyre, sipas gjuhës amtare, u evidentuan 331.549 shqiptarë ose 60,1% nga numri i përgjithshëm i popullsisë *(Stanovništvo predratne Jugoslavije po veroispovesti i maternjem jeziku po popisu 1931. godine (nepublikovano izdanje),* Državni statistički ured DF Jugoslavije, Beograd, 1945).

Ndërsa, sipas regjistrimit të vitit 1948 serbët dhe malazezët në popullsinë e gjithëmbarshme të Kosovës përbënin 27,5% (serbët 23,6%), kurse shqiptarët 68,5% (*Popis stanovništva, domaćinstava i stanova u 1981. godini. Nacionalni sastav stanovništva po opštinama, Statistički bilten 1295,* Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 16; *Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47,* Savezni zavod za statistiku, Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1955, f. 213).

shpërngulje edhe për arsye ekonomike dhe të tjera. Format e këtij presioni ishin të ndryshme, pak a shumë agresive. Këto, përveç tjerash, ishin rrezikimi i sigurisë personale dhe i pasurisë, mosofrimi i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore qytetare, përkatësisht të mosfunksionimit të shtetit juridik në Kosovë, para së gjitha kur është fjala për mbrojtjen e serbëve dhe malazezëve, kërcënimet e hapëta dhe kërkesat që ta braktisin Kosovën dhe sidomos sjelljet skajshmërisht johumane, jocivilizuese, gjenocidale – rrënimi i varrezave dhe i përmendoreve, dhunimet, torturimet dhe frikësimet e fëmijëve etj.

Disa herë – të përmendim vitin 1968, pastaj 1981, e deri në vitin e kaluar dhe në këtë vit – erdhi deri te demonstratat agresive dhe shkatërrimtare, madje edhe deri te aktivitetet terroriste, që i organizuan dhe i nxitën nacionalistët dhe separatistët shqiptarë me qëllim që të shpejtohej shpërngulja e serbëve dhe e malazezëve dhe të realizohej Kosova etnikisht e pastër, për të marrë një "argument të fuqishëm" në dorë për realizimin e qëllimit themelor – shkëputjes së Kosovës nga Serbia dhe më vonë edhe nga Jugosllavia dhe krijimi i Shqipërisë së Madhe…"

Kuvendi i Republikës Socialiste të Serbisë sjell Programin për realizimin e paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit të KSA të Kosovës në kuadër të mosshkeljes së integritetit të Serbisë dhe Jugosllavisë. Serbëve dhe malazezëve dhe kombeve dhe kombësive të tjera të rrezikuara me të gjitha mjetet e shtetit juridik do t'u sigurohet paqja dhe liria e plotë dhe siguria e plotë personale dhe e pasurisë…Në qoftë se nacionalistët dhe terroristët shqiptarë vazhdojnë t'i kundërvihen politikës së paqes, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit të KSA të Kosovës në kuadër të Serbisë…Serbia do të jetë e detyruar të ndërmarrë masa të tjera shtetërore-juridike dhe ekonomike…"

Edhe pas shthurjes së ish-Federatës jugosllave, objektivat kryesore të Serbisë mbetën aspiratat shtetmëdha dhe serbizimi i Kosovës. Menjëherë pas nxjerrjes së kësaj platforme, që kishte fuqinë e një programi nacional, politik dhe shtetëror serb, në vitin 1991 Kuvendi i Serbisë nxori ligjin për kushtet e ndarjes së tokave bujqësore në Kosovë me qëllim të realizimit të synimeve kolonizuese. Pas këtij viti, me qëllim të serbizimit të Kosovës, regjimi serb, krahas ndjekjes së shqiptarëve, nisi të sjellë edhe refugjatë-kolonistë nga Kroacia e BeH, si dhe serbomalazezë nga Shqipëria. Instalimi i këtyre kolonëve në Kosovë njihet si *valë e katërt e kolonizimit të Kosovës.* Këto programe të Serbisë tërthorazi në fillim u ndihmuan edhe nga Komisariati i Lartë i OKB-së për Refugjatë me seli në Prishtinë. Këta refugjatë serbë pushteti okupues i vendosi në pjesë të ndryshme të Kosovës, më tepër në objektet arsimore, edukative e rekreative të nxënësve dhe studentëve dhe në

objektet hoteliere e turistike. Numri i këtyre refugjatëve nuk është i madh, por qëllimet e sjelljes së tyre ishin tepër djallëzore. Sipas vetë burimeve serbe ky numër sillej rreth 10.000 veta, por ata nga sjelljet duket se ishin pjesa më militante dhe kryesisht kriminelë të luftës të cilët pushteti serb po i ndërsente çdo ditë kundër shqiptarëve. Kjo bëhej kryesisht në frymën e porosive të projekteve të V. Çubrilloviqit për spastrime etnike, në të cilin kërkohej që në Kosovë, ku vala e shpërnguljes nuk i përfshin të gjitha vendbanimet shqiptare, në ato vendbanime duhej "të silleshin njerëz pa mirësjellje, të vrazhdët e agresivë, të cilët me sulmet e tyre do ta detyronin pjesën e shqiptarëve të mbetur të shpërngulej, ndërsa pastaj të silleshin kolonë nga viset tjera".

Meqenëse për ndërrimin e shpejtë të strukturës kombëtare të popullsisë së Kosovës, kolonizimi përmes programit të përmendur të ish-Jugosllavisë, programit të Serbisë të vitit 1990 dhe sjelljes së refugjatëve-kolonëve serbë e malazezë nga Kroacia, BeH dhe Shqipëria nuk dha rezultate inkurajuese, pushteti policor e militarist serb intensifikoi terrorin mbi shqiptarët, veçanërisht mbi të rinjtë me qëllim që Kosova të braktisej dhe boshatisej. Presioni më i madh ushtrohej në rajonet kufitare me Shqipërinë dhe në mjediset homogjene shqiptare, ku si pretekst përdorej mbledhja e armëve, sipas skenarit të aksionit të mbledhjes së armëve në vitet e 50-ta, si dhe ndjekja e të rinjve shqiptarë të moshës së ushtrisë. Me qëllim të pastrimit të qetë etnik dhe të rrudhjes së dimensionit demografik të shqiptarëve si në vëllim, ashtu edhe në shtrirje hapësinore, provokimet, dhuna dhe terrori e përfshiu gjithë Kosovën e aneksuar dhe të okupuar, si dhe rajonin e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Në funksion të drejtpërdrejtë të këtij qëllimi vazhdonin të ishin gjithashtu largimi i shqiptarëve nga puna, shkatërrimi i bazës ekonomike përmes plaçkitjes së fondeve dhe teknologjisë, taksat dhe gjobat ndaj tregtarëve dhe zejtarëve shqiptarë, ndjekja e të rinjve shqiptarë për rekrutim në ushtrinë serbe dhe përzënia e nxënësve, studentëve dhe arsimtarëve shqiptarë nga objektet shkollore dhe universitare. Punktet policore nëpër rrugët më qarkulluese të Kosovës, për shembull, ku ushtrohej një tmerr mbi shqiptarët, gjithashtu ishin të destinuara për këtë qëllim. Ngritjen e tyre e kishte propozuar në Parlamentin e Serbisë nazisti V. Sheshel.

Politika zyrtare serbe nuk do të heqë dorë në asnjë mënyrë nga objektivi për rikolonizimin e Kosovës dhe ndjekjen e shqiptarëve me qëllim të ndërrimit të përbërjes kombëtare dhe serbizimit të plotë të Kosovës. Pas projekteve të shumta, të hartuara për këtë qëllim, por, për shumë arsye të kohës, jo të zbatuara në tërësi, në fillim të vitit 1995 organet shtetërore të Serbisë e të "Jugosllavisë së tretë" përmes një dekretligji paralajmëruan një aksion tjetër të ri për kolonizimin e Kosovës, për të cilin nuk ekzistonte asnjë rrethanë, as hapësinore (dendësia e madhe), as ekonomike (moszhvillimi, struktura e

pavolitshme e ekonomisë, shkatërrimi edhe i asaj baze ekzistuese të ekonomisë, plaçkitja e fondeve dhe e teknologjisë), as sociale (papunësia, varfëria) dhe as politike (ashpërsimi i marrëdhënieve edhe ashtu të tensionuara ndëretnike). Kjo ndodhi në fund të shek. XX kur e tërë bota demokratike i dënonte kolonizimet e tilla si ndërmarrje gjenocidale që kishin për qëllim transferin e dhunshëm të popullatës dhe ndërrimin e përbërjes etnike. Përveç formimit të disa enklavave të vogla me kolonë (Deçan, Vushtri, Klinë, Kishnicë), për kolonët e rinj parashihej ndarja e trojeve falas në Istog (Burim), Prishtinë, Gjilan, Lipjan, Mitrovicë, Pejë, Obiliq (Kastriot) etj. Numri prej 100.000 kolonëve serbë, që parashihte ta instalonte regjimi i Millosheviqit në Kosovë, paraqiste valën më të fuqishme të paralajmëruar në vargun e valëve të kolonizimit të Kosovës midis dy luftërave botërore dhe pas Luftës II Botërore. Sipas këtij dekretligji kolonëve u ofroheshin kredi me kushte shumë të volitshme për ndërtimin e shtëpive, troje falas, vende të punës dhe shumë beneficione të tjera. Projekti pjesërisht gjeti zbatim, veçanërisht pas "Stuhisë" kroate më 5 gusht 1995, kur, përkundër vullnetit të tyre, u instaluan në Kosovë disa mija serbë nga Kroacia.

Pos nxjerrjes së ligjit të vitit 1991 mbi kushtet dhe mënyrën e ndarjes së tokave bujqësore në Kosovë, politikës së re kolonizuese dëshirohej t'i jepej forma tjetër institucionale me paralajmërimin e nxjerrjes së një ligji të ri kadastral mbi rregullimin e pronave të paluajtshme që nga viti 1945 e deri më sot, që mund t'i godiste shqiptarët më shumë se çdo ligj tjetër i deriatëhershëm i nxjerrë për këto qëllime. Nxjerrjen e këtij ligji pushteti serb e bënte me arsyetim kinse "të vërtetojë pronësinë e vërtetë mbi patundshmëritë që i posedojnë qytetarët e Kosmetit dhe t'i korrigjojë gabimet eventuale. Është e njohur se pas vitit 1945 në krahinën tonë ka pasur regjistrime të ndryshme joligjore në librat kadastrale, pa dokumentacion juridik.[33] Qytetarët që posedojnë patundshmëri do të jenë të obliguar që komisionit përkatës profesional t'ia dorëzojnë dokumentacionin juridik mbi shfrytëzimin ose pronësinë. Në qoftë se nuk posedojnë dokumentacionin e duhur, ata nuk do të mund ta fitojnë të drejtën e patundshmërisë në librat kadastrale. Në këtë mënyrë do të vërtetohet saktësisht se cilët janë shfrytëzuesit, ndërsa cilët janë pronarët e vërtetë të tokës".[34] Nga fondi i tokave, i cili do të formohej nga tokat komunale, tokat e organizatave bujqësore dhe nga tokat që do t'i falnin personat juridikë e fizikë, me këtë ligj parashihej që serbëve të Kosovës t'u jepej toka falas, ndërsa për ndërtimin e shtëpive do të siguroheshin kredi me afat kthimi prej 25 vjetësh.

Qëllimi i nxjerrjes së këtij dhe ligjeve të ngjashme ishte më se i qartë: ta

[33] Deri në vitin 1966, siç dihet, administratën juridike si në nivel të komunave, ashtu edhe në nivel të Kosovës e udhëhiqnin vetë kuadrot serbe.

[34] *"Jedinstvo"*, Priština, 2. 02. 1995.

intensifikonin kolonizimin e serbëve dhe t'i varfëronin shqiptarët në mënyrë që të shpërnguleshin, por edhe të krijoheshin tensionime të reja, meqenëse, me marrjen e tokave shqiptarët jo vetëm që do t'i godiste në bazën ekzistenciale, por edhe në rrafshin emocional dhe individualo-psikologjik, ku mund edhe të provokoheshin më lehtë, provokim ky i cili më vonë do të shuhej me gjak. Mirëpo, regjimi serb e dinte mirë se fondi i tokave që formohej për destinime provokative e reaksionare nuk ishte i serbëve, por më se 90% ishte i shqiptarëve. Serbëve u takonte vetëm ajo tokë e cila me të gjitha bazat ishte pronë e tyre, ndërsa u ishte marrë me Ligjin mbi fondin e tokave bujqësore nga viti 1953 në emër të kufizimit të maksimumit në 10 hektarë, si dhe toka e konfiskuar për mospërmbushjen e detyrimeve nga grumbullimi i dhunshëm i prodhimeve agrare menjëherë pas Luftës II Botërore. Dihej se në Kosovë me këtë ligj më së shumti ishin goditur familjet shqiptare, meqenëse, për shkak të numrit të madh të anëtarëve, kishin më shumë prona me mbi 10 ha. Nga fondi komunal i tokës së punueshme, i kullotave të përbashkëta dhe nga toka e kooperativave bujqësore regjimi nuk kishte të drejtë të grabiste asnjë metër katror, ndërsa tokat që i kishin blerë shqiptarët, madje shumë sipërfaqe edhe nga disa herë, ishin të tyre dhe nuk mund të tjetërsoheshin ndryshe, pos me dhunë dhe brutalitet.

Me aksionin e paralajmëruar të kolonizimit prej 100.000 serbëve, pos që tentohej të futej frika e pasiguria në mesin e shqiptarëve, qëllimi ishte edhe të fashiteshin epshet e serbëve të instrumentalizuar të Kosovës. Serbët e këtushëm, të pakënaqur me premtimet e Millosheviqit dhe të qarqeve ekstreme e fashistoide serbe se një numër të madh të shqiptarëve do ta përzinin përtej Bjeshkëve të Nemuna, siç kishin premtuar qarqet shesheliane, dhe se në Kosovë shumë shpejt do ta vinin baraspeshën etnike, në gjysmën e parë të vitit 1995, me peticione e kërcënime, sipas skenarëve të viteve të 80-ta, sërish ngrehën zërin se në Kosovë dhe ndaj shqiptarëve regjimi aktual ka dështuar, ndërsa shqiptarët kanë formuar institucionet e veta, të cilat po funksionojnë pa pengesa. Me këtë kërkonin masa edhe më brutale ndaj shqiptarëve me qëllim të dëbimit sa më masiv nga Kosova.

Angazhimet serbe për gjetjen e instrumenteve me qëllim të vënies së baraspeshës etnike në Kosovë dhe kufizimit të lindjeve te shqiptarët nuk ndërpriteshin. E zhytur thellë në problemet ekonomike e sociale, në konfliktet e brendshme dhe në izolimin ndërkombëtar, Serbia vazhdonte ta drejtonte vëmendjen e opinionit serb nga Kosova dhe shqiptarët. Për dështimin e projektit të Serbisë së Madhe "Të gjithë serbët në një shtet", për krizën demografike e morale dhe për politikën dështuese në Kosovë dhe në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror të Serbisë, regjimi i Millosheviqit orvatej t'i fajësonte popujt e tjerë, veçanërisht shqiptarët. Pas mitingjeve populiste dhe

tubimeve e tryezave kinse shkencore për Kosovën në vitet e 80-ta, nga fundi i marsit të vitit 1995 u mbajt një tubim "shkencor" mbi popullsinë e të ashtuquajturës Jugosllavi, ku si temë qendrore doli jo popullsia e këtij vendi, por ajo shqiptare. Tubimi ishte plotësisht në funksion të politikës serbomadhe, ku nuk u fshehën fare kërkesat neomaltusianiste dhe raciste ndaj shqiptarëve. Në tubim u nxor edhe njëfarë "Memorandumi", që i paraprinte një instrumentalizimi të ri të serbëve të Kosovës dhe tubimeve të tyre nacionaliste që paralajmëroheshin ato ditë, për t'i kënaqur shpirtrat shoviniste serbe. Tubimi i propozoi Qeverisë së Serbisë dhe të Jugosllavisë së vetëquajtur që të nxjerrë hiq më pak se 13 ligje, që do të ishin në funksion të mposhtjes së plotë të dominimit numerik e reproduktiv të shqiptarëve, vënies së baraspeshës etnike në Kosovë dhe rrudhjes së dimensionit demografik të shqiptarëve përmes kolonizimit të më se 400.000 serbëve, dëbimit të po aq shqiptarëve si "shtetas të huaj", kufizimit të lindjeve dhe dobësimit të fuqisë vitalodemografike të shqiptarëve me masa administrative, antisociale dhe anticivilizuese të tipit indiano-kinez. Qasjet e këtilla padyshim hynin në radhën e modelit gjenocidal të të menduarit dhe të sjelljes, por, fatmirësisht, pa asnjë mundësi që të gjenin aplikim, sepse Serbia ua kishte suprimua shqiptarëve të gjitha të drejtat (punësimin, arsimin, mbrojtjen shëndetësore, pensionimin etj.).

Pas ofensivës kroate "Stuhia" më 5 gusht të vitit 1995, pasoi eksodi masiv i serbëve nga territoret deriatëherë të okupuara të Kroacisë nga serbët, që ishte padyshim eksodi më i madh pas shkatërrimit të Jugosllavisë së dytë. Një numër të konsiderueshëm të tyre regjimi serb nisi ta instalojë në Kosovë, që me të drejtë mund të cilësohej si *valë e pestë e kolonizimit të Kosovës.* Me këtë ndërmarrje pushteti serb nuk kishte për qëllim t'i zgjidhte tragjeditë individuale e familjare të të ikurve, të instrumentalizuar sikurse serbët e Kosovës nga politika agresive e militariste e Beogradit, por për të realizuar aspiratat tashmë të njohura hegjemoniste ndaj Kosovës gjatë realizimit të katër valëve të mëparshme të kolonizimit të saj. Për këtë qëllim pushteti okupues serb formoi trupin koordinues në nivel të Kosovës, si dhe disa shtabe komunale.

Vendosja e serbëve në Kosovë nuk mund të cilësohej si "vendosje e përkohshme" e as të ardhurit si "refugjatë", siç përpiqej t'i shpjegonte regjimi serb dhe organizatat humanitare joshqiptare, por si tendencë e instalimit të përhershëm dhe në funksion të ndërrimit të përbërjes kombëtare të popullsisë së Kosovës, ndërsa të ardhurit si kolonë. Kolonizimi bëhet me dhunë nga se vetë kolonët refuzonin kategorikisht që të vendoseshin në Kosovë, si territor i okupimit klasik dhe i konflikteve potenciale në Ballkan, me pasoja të paparashikueshme. Serbia zyrtare dhe forcat opozitare këtë tragjedi njerëzore e shihnin si rast të volitshëm për realizimin e projektit të përmendur për

kolonizimin e 100.000 serbëve në Kosovë. Se nuk ishte fjala për zgjidhjen e një problemi humanitar, por për kolonizim me qëllim politiko-hegjemonist dëshmon edhe fakti se regjimi serb të ikurit nuk i vendoste në Serbi, ku kishte hapësirë të bollshme jetësore: tokë të punueshme, objekte të zbrazëta banimi, por edhe mungesë të fuqisë punëtore dhe thyerje të plotë demografike të fshatit serbian. Në favor të këtij qëllimi ishte edhe vendosja e kolonëve serbë në objektet shkollore, në konviktet e nxënësve e të studentëve, prej nga ishin përzënë nxënësit dhe studentët shqiptarë, pastaj në çerdhet e fëmijëve, në shtëpitë e jetimëve, në objektet hoteliere e turistike dhe industriale, prej nga ishin nxjerrë me dhunë punëtorët shqiptarë, e deri te përmendoret kulturo-historike, siç është rasti me kompleksin memorial të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që paraqiste një provokacion të rëndë dhe mundësi të hapur për keqësimin e mëtejme të situatës në Kosovë e më gjerë. Provokacioni tjetër plotësues ishte paralajmërimi i pushtetit okupues që një numër të kolonëve ta vendoste edhe në shtëpitë private, pronarë të të cilave ishin shqiptarët.

Sipas të dhënave të organizatave joserbe, që kujdeseshin dhe në mënyra të ndryshme i ndihmonin kolonët serbë (nga se ua njihnin statusin e refugjatëve të luftës), numri i tyre në Kosovë deri në fund të shtatorit 1995 arrinte në rreth 13.000 veta, të instaluar në të gjitha mjediset e Kosovës, por më së shumti në komunën e Prishtinës (rreth 3.400), të Prizrenit (rreth 1.100), të Fushë-Kosovës (rreth 1.000), të Pejës (rreth 800), të Gjilanit (rreth 750), të Mitrovicës (rreth 700), të Obiliqit (afër 650), të Gjakovës (rreth 500) etj. Mirëpo, sjellja e kolonëve vazhdonte dhe autoritetet serbe parashihnin që ky numër së paku të dyfishohej. Për shkak të rezistencës që bënin vetë kolonët për t'u vendosur në Kosovë, numri i tyre nuk u rrit shumë dhe sillej midis 15.000 e 20.000 vetave. Prej tyre rreth 40% i përkisnin moshës mbi 60 vjet, ndërsa numrin tjetër e përbënin gratë dhe fëmijët. Pjesën dërmuese të meshkujve të moshës 19 deri 59 vjet, të martuar e të pamartuar, pushteti serb nuk e ka lejuar as të hyjë në territorin e Jugosllavisë së vetëshpallur, por e ka kthyer në BeH për të luftuar kundër myslimanëve dhe kroatëve. Përbërja kombëtare e Kosovës për 1% në favor të serbëve mund të ndërrohej po qe se këtu silleshin rreth 22.500 kolonë serbë, për 2% rreth 45.000 veta etj., që do të thoshte se numri i kolonëve nuk mund të kishte peshë të madhe në prishjen e raporteve etnike. Mirëpo, duke pasur parasysh qëllimin hegjemonist të Serbisë ndaj Kosovës, instrumentalizimin e kolonëve për qëllime ekskluzivisht politike, ardhjen e kolonëve nga një territor dhe atmosferë lufte, frustrimin e tyre, si dhe gjendjen e përgjithshme edhe ashtu të tensionuar për shkak të terrorit serb ndaj shqiptarëve - edhe numri më i vogël i kolonëve mund të provokonte një konflikt të gjerë në Kosovë dhe në rajon. Pikërisht në kolonët me prejardhje nga Kraina, Lika, Bania, Korduni dhe viset e tjera karstike të ish-Jugosllavisë

si "njerëz pa mirësjellje, të vrazhdë e agresivë", siç i cilësonte Çubrilloviqi, edhe llogaritej shumë midis dy luftërave që "tipi violent dinarik", siç i vlerësonte Cvijiqi, të shfrytëzohej për ndjekjen masive të shqiptarëve në Turqi. Fundja, kolonët e këtyre rajoneve, në të gjitha periudhat, veçanërisht në kohën e Rankoviqit dhe pas vitit 1981, janë shquar për sjelljet brutale ndaj shqiptarëve.

Meqenëse pjesa dërmuese e kolonëve nga Kroacia, veçanërisht nga rajoni i Krainës, ishte me profesion agrar, pushteti okupues po parashihte që ata në fazën e dytë t'i vendoste në mjedise rurale shqiptare në mënyrë që t'u jepej tokë e punueshme qoftë nga fondi i sipërfaqeve të kooperativave e kombinateve bujqësore, të formuara nga reforma agrare e vitit 1953 (në emër të kufizimit të maksimumit në 10 ha), qoftë nga fondi i formuar nga konfiskimi për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve nga grumbullimi i "tepricave" bujqësore në vitet e para të funksionimit të regjimit komunist, të cilat prona duhet t'u kthehen shqiptarëve sot. Këtu edhe duhej parë një sukses të politikës kolonizuese dhe rrezikimin e hapësirës jetësore të shqiptarëve dhe mbi këtë bazë ashpërsimin e marrëdhënieve shqiptaro-serbe deri në konfrontim të hapët. Në gjitha rajonet ruralo-agrare të Serbisë lëvizja natyrore e popullsisë serbe ishte negative, ku dominonte popullata e moshuar, qindra fshatra tashmë kishin mbetur gati pa njerëz ose qindra të tjera gjendeshin para shuarjes gati të plotë të jetës, por atje pushteti nuk i vendoste refugjatët serbë, ndërsa refugjatët boshnjakë nga BeH nuk i lejonte të vendoseshin në Kosovë, sikundër që e pengonte kthimin e refugjatëve shqiptarë nga shtetet evroperëndimore.

As sa i përket qëllimit e as numrit të kolonëve, regjimi i Millosheviqit nuk është origjinal, sepse koncepti kolonizues bazohej në projektet ekstreme, si pjesë të programit nacional serb nga e kaluara e largët dhe e afërme, tashmë të zëna në gojë, ndërsa qysh në vitin 1989 vendosjen e 100.000 kolonëve në Kosovë e kërkoi ekstremisti i njohur serb Vojisllav Sheshel në qarqet neoçetnike në Perëndim dhe më vonë disa herë e përsëriti këtë kërkesë në tribuna publike dhe në vetë Parlamentin e Serbisë. Për t'u realizuar kjo aspiratë, Shesheli në kushtrimin famëkeq "Spremte se, spremte četnici",[35] kërkonte që Prishtina të bëhej kryeqytet i Serbisë dhe i Jugosllavisë, ku do të përqendroheshin të gjitha institucionet shtetërore, shkollat policore e ushtarake, shumë policë, oficerë e nëpunës me familje (Toronto, 1989). Ndërkaq, Vukashin Jokanoviqi, në cilësi të kryetarit të Kuvendit të Kosovës (1989) shkoi edhe shumë më larg dhe kërkoi atëherë që Kosova të kolonizohej

[35] V. Šešelj, "Spremte se, spremte četnici", *Glas kanadskih Srba*, Toronto, 1989.

me 300.000 serbomalazezë.[36] Qarqet shoviniste serbe flitnin atëherë edhe për sjelljen e 400.000 serbëve nga Rumania në Kosovë, ndonëse në këtë vend, sipas vetë burimeve serbo-jugosllave, nuk jetonin më shumë se 24.000 serbë![37]

Formulimin më të qartë programor për krijimin e Serbisë së Madhe dhe serbizimin e plotë të Kosovës me dëbimin e shqiptarëve dhe kolonizimin me serbë e gjejmë në Programin e Partisë Radikale Serbe të Vojisllav Sheshelit.[38] Që në pikën e parë të tij thuhet se krijimi i shtetit serb *"do të përfshijë tërë popullin serb, të gjitha tokat serbe,* që do të thotë se ajo do t'i përfshijë përbrenda kufijve të saj njësinë e zvogëluar Federale Serbe, Malin e Zi, Bosnjën Serbe, Hercegovinën Serbe, Dubrovnikun Serb, Dalmacinë Serbe, Liken Serbe, Kordunin Serb, Banijën Serbe, Sllavoninë Serbe, Sremin Perëndimor Serb, Baranjën Serbe dhe Maqedoninë Serbe". Si politikisht, ashtu edhe ekonomikisht në program kërkohet largimi i "Serbisë së Madhe" nga Bashkësia Evropiane dhe forcimi i lidhjeve ekonomiko-politike me vendet me sisteme ende dogmatike – me Rusinë, Kinën dhe Korenë e Jugut.

Një pikë i kushtohet Kosovës, por me 16 nënpika si masa kundër shqiptarëve dhe spastrimit etnik të tyre. Në funksion të spastrimit etnik të shqiptarëve parashiheshin këto masa: dëbimi i shqiptarëve "emigrantë" së bashku me pasardhësit, që kapin shifrën prej rreth 1,5 milion shqiptar të Kosovës, dhënia pa pengesë e pasaportave në mënyrë që të shpërnguleshin, dëbimi i plotë i shqiptarëve në zonën deri 50 km në rripin kufitar me Shqipërinë, pengimi i gjithë shqiptarëve që kishin qëllime "separatiste", ngritja e minierave të thëngjillit dhe e kapaciteteve elektroenergjetike në zonat më dendur të banuara me shqiptarë për arsye shpërnguljeje, ndalimi i përdorimit të gjuhës shqipe për shqiptarët e mbetur, pengimi i lindshmërisë me masa sociale dhe administrative etj. Ana tjetër e serbizimit të Kosovës, sipas programit të kësaj partie, konsistonte në "zhvendosjen nga Serbia dhe vendosjen në Kosovë të akademive policore e ushtarake dhe institucioneve të tjera ushtarake" dhe "vendosjen e dhjeta-mijëra oficerëve, nënoficerëve, policëve, punëtorëve shtetërorë dhe anëtarëve të familjeve të tyre"; të gjithë këtyre "do t'u ofroheshin apartamente të mëdha e komfore në Kosovë e Metohi si zgjidhje e përhershme për problemet e tyre të banimit". Kolonëve serbë në Kosovë do t'u "jepej tokë e punueshme dhe shumë tokë ku ata

---

[36] *"Jedinstvo",* Priština, 28-29. 12. 1989.

[37] *"Tanjug",* 23. 12. 1989.

[38] Marrë nga: "Program of the Radical Party", *Yugoslav Survey*, XXXIV, 1, Belgrade, 1993, pp. 56-61.
Teksti i plotë i programit të kësaj partie është botuar në: H. Islami, *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003, ff. 374-383.

mund të ndërtojnë shtëpi për familjet e tyre dhe për biznes", ndërsa punëtorët serbë që do të punësoheshin në Kosovë do të kishin të ardhura mesatare "dy herë më të larta se mesatarja e të ardhurave në pjesë të tjera të Serbisë" dhe lehtësime të tjera. Ndërkaq në "Universitetin e Prishtinës do të krijoheshin kushte shumë të favorshme për të studiuar vetëm në gjuhën serbe" etj., etj.

5. Gjenocidi faktik masiv ndaj shqiptarëve dhe reagimi i shqiptarëve

Veprimet e dhunës e të terrorit të pushtetit serb jo vetëm që nuk u ndërprenë, por ato u intensifikuan, duke marrë përmasa të krimit të vërtetë gjenocidal. Politika diskriminuese, segregacioniste dhe represive serbe dhe jugosllave e viteve të 80-ta u zëvendësua në vitet e 90-ta me të gjitha format dhe aktivitetet gjenocidale dhe me një politikë të përgatitur për një kohë të gjatë dhe të konceptuar mirë të krimit gjenocidal ndaj shqiptarëve. Ndërkaq, deri në ekzistimin e ish-Federatës jugosllave, nën ombrellën e organeve të së cilës vepronte shovinizmi dhe terrori serb ndaj shqiptarëve, aktet e bollshme gjenocidale serbe në të gjitha sferat e jetës e të punës së shqiptarëve kamufloheshin dhe cilësoheshin si akte sporadike dhe si luftë kundër "individëve e grupeve nacionaliste, separatiste dhe terroriste shqiptare". Pas veprimeve të tilla gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve dukej se më shumë qëndronin idetë dhe synimet gjenocidale, sidomos në rrafshin demografik, çfarë ishte rasti me përpjekjet për të penguar procesin normal të lindshmërisë sesa projektet dhe programet e veprimit gjenocidal të drejtuara nga qendrat e pushtetit. Bashkësia ndërkombëtare nuk besonte madje as në përpjekjet dhe motivet gjenocidale e lëre më në aktet dhe elementet e krimit gjenocidal, çfarë ishte p. sh. spastrimi i qetë etnik i Kosovës dhe sulmet në substancën biologjike e kombëtare të shqiptarëve, por fliste për shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe atë vetëm pas vitit 1989.

Mirëpo, suprimimi i autonomisë së Kosovës në mars të vitit 1989 dhe, së bashku me të, rrënimi i të gjitha institucioneve politike, administrative, ekonomike, sociale, kulturore, shëndetësore etj., dhe përjashtimi masiv i punëtorëve shqiptarë pas grevës së përgjithshme të 3 shtatorit 1990 tregonin qartë se nuk ishte fjala më për një pushtet që kishte si synim vetëm okupimin, kolonizimin dhe vënien e sistemit kolonialist në Kosovë, por diçka shumë më të tmerrshme: kishte për qëllim degradimin sistematik të shqiptarëve, varfërimin, rrezikimin e shëndetit, të ekzistencës biologjike dhe shpërnguljen e tyre.

Në vitin 1998 dhe veçanërisht në vitin 1999, në sytë e gjithë botës, idetë dhe synimet e kamotshme të regjimeve dhe qarqeve të ndryshme serbe brenda tyre u shndërruan në gjenocid faktik masiv ndaj shqiptarëve. Sipas të dhënave ende jo të plota, mbi 15 mijë shqiptarë civilë, ku kishte fëmijë, gra dhe pleq, u vranë, u masakruan ose u dogjën të gjallë dhe u futën në qindra varreza masive; mbi 120.000 shtëpi, të shtrira në rreth 1100 vendbanime, u dogjën, u rrënuan e u dëmtuan; fshatra të tëra e shumë qendra urbane, me sistemet e tyre infrastrukturore, u shkatërruan; rreth një milion shqiptarë u deportuan jashtë Kosovës me mjete të ndryshme, me trena, kamionë, autobusë, vetura, këmbë nëpër male, gjithnjë rrugës duke u poshtëruar, torturuar e dhunuar; disa qindra mijëra të tjerë nën dhunë e kërcënime u ndoqën nga shtëpitë e tyre, duke bredhur brenda territorit të Kosovës, më tepër nëpër terrenet malore. As gjysma e varrezave masive të shqiptarëve ende nuk janë hapur as në Kosovë e as në Serbi.

Regjimi fashistoid serb, me të gjitha mjetet u vërsul mbi identitetin etnik, historik dhe kulturor të shqiptarëve dhe mbi themelet e jetës së tyre. Rrënimi i monumenteve kulturo-historike, p. sh. i 218 xhamive, i kompleksit memorial të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, zhdukja e busteve të figurave të shquara të rilindësve tanë dhe ndërrimi i gjithë onomastikës së Kosovës kishte për qëllim ringjalljen e miteve kishtare mesjetare serbe dhe serbizimin e plotë të Kosovës. Përmes deportimit masiv që i ngjante plotësisht deportimit të çifutëve gjatë Luftës II Botërore dhe zhdukjes së dokumentacionit (letërnjoftimet, pasaportat, regjistrat kadastrale, librat amë të të lindurve, të kurorëzuarve dhe të të vdekurve, numrat personalë, librat e nënshtetësisë etj.) në pranverën e vitit 1999, ky regjim donte ta dehumanizonte njeriun e përkatësisë etnike shqiptare dhe gjithë bashkësinë shqiptare dhe ta këpuste çdo lidhje juridike të shqiptarëve me truallin gjeoetnik të tyre, ta rrënonte një etni, një kulturë, një shoqëri me të gjitha institucionet e saj.

Të gjitha këto veprime, të qëllimshme e të dhunshme ndaj popullatës së etnikumit shqiptar, me të gjitha konventat ndërkombëtare konsiderohen si krime gjenocidale, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, që shënojnë anën më të errët në historinë e njerëzimit dhe tragjedinë më të madhe në jetën e kombit që i ka përjetuar. Evitimi i kësaj tragjedie njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve u bë në saje të intervenimit të NATO-s, në krye me SHBA-në, dhe rezistencës së brendshme gjithëpopullore. Dëbimi definitiv i të gjitha forcave të regjimit të Millosheviqit u bë pas hyrjes së forcave të NATO-s (KFOR) më 12 qershor 1999 dhe vënies së Kosovës nën protektoratin ushtarak dhe civil ndërkombëtar sui generis.

Kthyerja e shqiptarëve, e një mase kaq të madhe të tyre për një kohë kaq

të shkurtër, madje përkundër apeleve të bashkësisë ndërkombëtare që të mos nguten të kthehen sepse nuk ka kushte për ekzistencë, me shtëpi të rrënuara e të dëmtuara, pa ushqim, pa ujë, me rreziqe të mëdha nga minat që i kishin vënë forcat serbe, megjithatë, tregonte se sa është e fuqishme te popullata shqiptare lidhja emocionale për truallin gjeoetnik të tyre, për pronën e paluajtshme, për shtëpinë dhe tokën. Ishte ky një fenomen që bënte përjashtim në historinë e eksodeve masive etnike në epokën bashkëkohore, që e habiti gjithë botën, e forcoi imazhin e shqiptarëve të Kosovës dhe siguroi një simpati edhe më të madhe se sa para bombardimeve dhe në kohën e bombardimeve të forcave të NATO-s mbi caqet serbe. Këtë imazh, mjerisht, e prishën disa grupe të shqiptarëve me sjelljet e tyre (uzurpimet, plaçkitjet, vrasjet, frikësimet) në ditët e para të kthyerjes dhe, më vonë, liderët e shqiptarëve me grindjet e tyre në luftë për pushtet, ndonëse ishte e qartë se Kosova ishte vënë nën protektorat ushtarak dhe civil ndërkombëtar.

Pasqyra etnike e Kosovës sot ka pësuar ndryshime të konsiderueshme, ku shqiptarët përbëjnë shumicën dërmuese, mbi 90%. Së bashku me tërheqjen e forcave policore, militare dhe paramilitare serbe pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës më 3 qershor 1999, siç dihet, afër gjysma e serbëve u tërhoq nga Kosova (100.000 veta), ndërkaq rreth 100.000 të tjerë mbetën të jetonin në Kosovë. Organizatat ndërkombëtare bëjnë me dije se sot (gjysma e vitit 2004) në Kosovë jetojnë rreth 130.000 serbë. Konkretisht, sipas organizatës Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI) "ende ka rreth 130.000 serbë që jetojnë në Kosovë, të cilët përfaqësojnë 2/3 e serbëve që kanë jetuar para luftës. Prej tyre 75 mijë janë duke jetuar në pjesën jugore të lumit Ibër, në zonat kryesisht të banuara nga shqiptarët. Gati të gjithë serbët e qendrave urbane e kanë braktisur vendin, ndërkaq pjesa më e madhe e serbëve të zonave rurale nuk i kanë braktisur asnjëherë shtëpitë e tyre. Situata reale e tyre sot mund të përshkruhet si një komunitet i fermerëve të shpërndarë në tërë Kosovën".[39]

Serbët e Kosovës aktualisht janë të përqendruar në enklava etnike në zonat rurale, të cilat shtrihen në komunën e Prishtinës, të Gjilanit, të Kamenicës, të Shtërpcës, të Lipjanit, të Vitisë, të Novobërdës, si dhe në komunat serbe të Leposaviqit, të Zveçanit e të Zubin Potokut dhe në veri të qytetit të ndarë të Mitrovicës. Në qytete, ku dominojnë shqiptarët, kanë mbetur shumë pak serbë, të cilët ruhen nga forcat ndërkombëtare. Pjesa më e madhe e tyre po ua shesin shqiptarëve pronat, shtëpitë dhe banesat, madje edhe tokën e punueshme dhe në këtë mënyrë kapitali i shqiptarëve po bartet në Serbi.

---

[39] Shih: Treaty of Lausanne, 1923: sipas The Lausanne Principe: Multiethnicity, Territory and the Future of Kosovo's Serbs, *European Stability Initiative (ESI*), Berlin/Pristina, June 7, 2004.

Kur flitet për shpërnguljen e një numri të serbëve nga Kosova pas hyrjes së forcave të NATO-s, përkatësisht shpërnguljen e 100.000 vetave dhe siç po propagandohet këto kohët e fundit nga regjimi serb dhe disa ndërkombëtarë, kthyerjen e 200.000-300.000 vetave (!), doemos duhet dhënë disa shpjegime. *Së pari,* një numër i konsiderueshëm i serbëve e kishte braktisur Kosovën dhe ishte nisur për në Serbi së bashku me tërheqjen e forcave ushtarako-policore dhe paramilitare serbe pa u kthyer ende shqiptarët e deportuar. Nuk ka ekzistuar ndonjë koncept i ndjekjes së serbëve, sepse shqiptarët nuk ishin të organizuar në institucione që do të hartonin projekte të tilla, e as që kishin hartuar ndonjëherë ndonjë projekt të ngjashëm. Të gjithë të ikurit serbë ishin fajtorë për krimet në Kosovë, ose e kishin ndjenjën e fajit, prandaj ikën së bashku me ushtrinë e tyre pa i ndjekur askush nga shqiptarët. Sjelljet ekstreme ishin të grupeve shqiptare, të cilët, të disponuar për plaçkitje, uzurpime, kërcënime dhe vrasje - më shumë të shqiptarëve sesa të serbëve - i bënë shumë dëm çështjes shqiptare pasojat e të cilëve po i vuan Kosova edhe sot. Por, fatmirësisht, popullata shqiptare nuk i mbështeti këto grupe ekstreme, sepse i dinte mirë motivet e sjelljes së tyre. Ndjenja e frikës objektivisht ekzistonte te serbët, sepse shumica dërmuese, në mënyra të ndryshme, ishte e implikuar në operacionet kriminale kundër civilëve shqiptarë. Faktin e ikjes së serbëve pa u kthyer shqiptarët e kishte theksuar disa herë vetë komandanti i forcave të KFOR-it, gjenerali gjerman Klaus Reinhard; për të ishte e paqartë pse u larguan rreth gjysma e serbëve nga Kosova (100.000 veta) para se të ktheheshin shqiptarët. Iniciativa Evropiane për Stabilitet në Ballkan (ESI) përsëri bën me dije "se nga Kosova për pesë vjetët e fundit janë larguar 65.000 e jo 200.000 serbë, sa thonë autoritetet e Beogradit".[40]

Nuk është e kufizuar vetëm lëvizja e serbëve. Edhe lëvizja e shqiptarëve në enklavat serbe ishte dhe mbeti e kufizuar, ku, saherë që t'u teket serbëve i bllokojnë rrugët, i gjuajnë makinat, i sulmojnë shqiptarët dhe ndërkombëtarët, siç ndodhi në fillim të djetorit 2007, kur në fshatin Gorazhdec (enklavë serbe në rrethinën e Pejës) u sulmuan ushtarët e KFOR-it, të cilët ishin në përcjellje të komandatit të tyre, gjeneralit francez Xavier Bout de Marnhac, dhe kryeadministratorit të Kosovës Joachim Ruecker!; Kosova Veriore edhe në këtë drejtim është një çështje në vete. *Së dyti,* Serbia kërkon t'i kthejë në Kosovë edhe serbët që kurrë nuk kanë jetuar këtu. Kërkon t'i kthejë edhe serbët e Kroacisë e të BeH, të cilët kishte filluar t'i sjellë para intervenimit të NATO-s. Këta, pra, ishin pjesëtarë të valëve të kolonizimit të Kosovës në vitet e 90-ta me serbë nga Kroacia dhe BeH. Po

[40] E dhëna vjen nga APA (Agjencia Austriake e Lajmeve), e cila i referohet ESI-it (sipas: *Koha ditore*, Prishtinë, 30 tetor 2004).

Serbia po kërkon t'i kthejë edhe serbët që tashmë i kanë shitur pronat për para të majme. Dhe, *së treti,* ku dëshiron Serbia t'i vendosë këta serbë: në enklavat ekzistuese apo rreth tyre, në tokat shoqërore, komunale dhe të organizatave bujqësore (kooperativat), në mënyrë që t'i krijojë territoret etnikisht të pastra, me pushtet të caktuar, të dirigjuar ekskluzivisht nga Beogradi dhe në këtë drejtim po bën përpjekje për të përfituar mbështetjen e faktorit ndërkombëtar dhe të institucioneve kosovare?! Në strategjinë e kthyerjes së serbëve, në përpjekjet për ndarjen e Kosovës kujdes i rëndësishëm po i kushtohet pikërisht kadastrit, ku shumë çështje nuk janë të zgjidhura apo janë në dëm të shqiptarëve.

Realizimi i planit të Qeverisë së Beogradit për kthyerjen e serbëve në Kosovë, ku kryeideolog përsëri na del arkitekti e urbanisti Branisllav Kërstiqi, e që përmendet shifra deri 300.000 sosh, parasheh instalimin e tyre në dhjetëra lokacione, që do të thotë në ngritjen e shtëpive, madje edhe të vendbanimeve të reja brenda enklavave dhe përreth tyre në sipërfaqe jo të privatizuara, ku në shumicën e rasteve ishte pronë e dikurshme e shqiptarëve, e marrë në kuadër të reformës agrare pas Luftës II Botërore dhe në emër të kufizimit të maksimumit në 10 hektarë. Kthyerja parashihej të stimulohej në disa baza, sikurse gjatë viteve të 80-ta të shekullit të kaluar, prej sigurimit të vendeve të punës e deri te ndërtimi i shtëpive dhe ngritja e sistemeve urbane infrastrukturore, që do t'i lidhnin enklavat, pastaj parashiheshin shumë shërbime gratis për ta, sikurse sot, ku serbët në enklava dhe jashtë tyre nuk paguajnë rrymë, ujë, telefon etj., me fjalë të tjera janë shumë të privilegjuar. Ky tip i instalimit ka vetëm një emër: kolonizim i ri, por tani në rrethana të reja. Dhe pse mos të kthehen serbët në Kosovë me këto kushte tepër të favorshme, ku edhe ata që i kanë shitur pronat do të kërkojnë të kthehen në Kosovë, në shtëpi të reja, të cilat, ndoshta sërish do t'ua shesin shqiptarëve! Kryeideolog i këtij projekti përsëri na del arkitekti e urbanisti i përmendur Branisllav Kërstiq.

V. VERSIONET SERBE PËR NDARJEN DHE RIKOMPONIMIN TERRITORIAL TË KOSOVËS

Kosova, një hapësirë relativisht e vogël, me pozitë të ndërlikuar gjeopolitike, me shumë histori, kontradikta, tensione latente e të hapura interetnike dhe konfrontime deri në nivel të luftërave, vend shumë i pasur dhe në të njëjtën kohë shumë i varfër - gjithnjë paraqiste një nyje të rëndësishme dhe neuralgjike në Ballkan dhe në fund të shekullit XX (1999) ajo bëhet një problem i madh edhe në shkallë evropiane dhe botërore. Në këtë nyje të trungut gjeoetnik të shqiptarëve, siç theksuam edhe më parë, u ndeshën edhe dy civilizime, perëndimore dhe lindore, që lanë pasoja të shumënduarshme. Mirëpo, tragjeditë më të mëdha nacionale, ekonomike, politike, sociale, familjare e të tjera shqiptarëve u kanë sjellë injorimi i vullnetit politik dhe ndarjet e njëpasnjëshme, të imponuara e të dhunshme.[1]

Në qoftë se e vështrojmë territorin etnik shqiptar nga një perspektivë 100-vjeçare do të vërejmë ndarje dhe copëtime të tij nga më të ndryshmet, që i kishin bërë pushtetet e huaja me qëllim që të sundonin më lehtë. Deri në ditët e fundit të Perandorisë 0smane (1912) ky territor ishte i ndarë në katër vilajete. Pas shumë pazarllëqeve midis vendeve ballkanike dhe evropiane për ta copëtuar tërësinë e pakëputur etniko-demografike të shqiptarëve, me vendimet e Konferencës së Londrës (1913), kjo tërësi ndahet në dy pjesë: Shqipëria bëhet shtet i pavarur në kufijtë e sotëm, ndërkaq Kosova dhe viset e tjera etnike shqiptare okupohen nga Serbia me forcë ushtarake. Këtë gjendje e verifikon Konferenca e Versajës (1919). Midis dy luftërave botërore territori shqiptar jashtë Shqipërisë copëtohet në tri banovina (e Moravës, e Zetës dhe e Vardarit), ndërsa gjatë Luftës II Botërore ndahet në tri zona okupuese (italiane, bullgare dhe gjermane). Pas kësaj lufte nuk bëhet bashkimi i hapësirës etnike shqiptare në një shtet të vetëm në frymën e Rezolutës së Bujanit (1943-1944), por Kosova (me 70% të popullsisë shqiptare), përkundër vullnetit të popullit, futet me forcë ushtarake nën Serbi/Jugosllavi si "krahinë autonome", me status konstitucionalo-politik më të ulët se Vojvodina (ku mbi 50% ishin serbë). Me këtë pozitë mbetet deri në Kushtetutën e tretë të Jugosllavisë (1963), kur edhe barazohet me Vojvodinën, ndërkaq territoret e tjera shqiptare nuk iu bashkuan Kosovës, por mbetën në kuadër të tri republikave të tjera (Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi).

---

[1] R. Ismalji, "Shqiptarët dhe Evropa Juglindore", *Thema,* 11, Prishtinë, 1993, ff. 29-38.

1. Ndryshimi i madhësisë territoriale të Kosovës

Kosova ka sot 10.887 km katrorë. Deri në vitin 1954 ajo kishte një territor prej 10.690 km², ndërsa në vitin 1958 sipërfaqja e saj rritet përreth 200 km² dhe madhësia e saj territoriale prej 10.887 km² nuk ndryshon deri më sot. Si ndodhi ndryshimi i kufijve midis Kosovës dhe Serbisë? Në vitin 1958 Serbia, duke ia marrë rrethit të vet të Rashkës 197 km² dhe duke ia bashkuar rrethit të Mitrovicës dhe brenda tij komunës së Leposaviqit, ia "dhuroi" Kosovës këtë sipërfaqe (shih hartën). Në këtë mënyrë numri i vendbanimeve të Kosovës rritet nga 1389 më 1954 në 1438 më 1958. Nuk është këtu fjala për kurrfarë këmbimi territoresh me Preshevën apo Bujanovcin. "Dhurimi" nuk kishte qëllim tjetër pos që Leposaviqi si komunë të zgjerohej territorialisht dhe në pikëpamje etnodemografike, ku, përveç tri fshatrave shqiptare, të gjitha vendbanimet e tjera ishin serbe dhe sot e gjithë ditën mbetën serbe. Ndryshimet territorialo-administrative u përligjën edhe me akte adekuate juridike (shih hartën në kaptinën e tretë të pjesës së nëntë, në faqen 502).

2. Zgjidhja nga copëtimi deri te spastrimi etnik

Në të vërtetë, sa i përket çështjes së Kosovës, qarqet e ndryshme serbomëdha, por edhe vetë Serbia zyrtare që nga fundi i viteve të 60-ta të shekullit të kaluar e deri në hyrjen e forcave ndërkombëtare më 12 qershor 1999 kishin pasur disa variante të zgjidhjes së saj, por gjithnjë në dëm të shqiptarëve. Statusi konstitucional-politik i Kosovës me Kushtetutën e vitit 1974 bënte përjashtim, sepse në raportin e atëhershëm të forcave politike në ish-shtetin, ishte arritur pa vullnetin e Serbisë. Me këtë Kushtetutë kufijtë e Kosovës ishin të pacenueshëm dhe Kosova kishte të drejtën e vetos në ish-Federatën. Mirëpo, agresiviteti dhe shovinizmi serb, me ardhjen e Millosheviqit në pushtet dhe me "Memorandumin" e Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (1986),[2] arritën që në mars të vitit 1989 ta rrënonin

[2] Edhe pas humbjes së Kosovës në vitin 1999, Serbia zyrtare, së bashku me qarqet shkencore dhe kulturore, nuk heq dorë nga synimet hegjemoniste ndaj Kosovës. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë, e njohur për nxitjen e luftërave dhe politikën shkatërruese të ish-Jugosllavisë, pas "Memorandumit" famëkeq dhe shumë botimeve për Kosovë, sërish doli me një shqyrtim "shkencor" për Kosovën. Në mars të vitit 2006 mbajti kinse një tubim ndërkombëtar për Kosovën, ma disa autorë proserbë (rusë, grekë, anglezë, bullgarë etj.). Nga ky tubim doli edhe publikimi në rreth 500 faqe, ku u përsritën tezat e moçme për Kosovën dhe shqiptarët, përfshirë edhe copëtimin hapësinor të Kosovës. Shih: *Kosovo i Metohija: prošlost, sadašnjost, budućnost,*

me dhunë subjektivitetin federal të Kosovës dhe autonominë e saj, duke suprimuar të gjitha organet legale të pushtetit. Përveç mbetjes së Kosovës brenda sistemit juridiko-politik të Serbisë, variantet, me shumë ose me pak përkrahje, varësisht nga evolucioni i pozitës së përgjithshme të Serbisë në ish-Jugosllavi dhe më gjerë, ishin edhe rikolonizimi në vitet e 80-ta e të 90-ta, ridefinimi territorial i Kosovës, enklavizimi, ndarja e saj në dy entitete apo edhe ndarja midis shqiptarëve dhe serbëve, që e mbështette "babai" i kombit serb dhe inspiruesi i të gjitha tragjedive në ish-Jugosllavi, Dobrica Qosiqi.

Me tezën për ndarjen e Kosovës, Qosiqi kishte dalë qysh në vitin 1968. Kur u bë kryetar i të ashtuquajturës Jugosllavi e Zhablakut (1992), si zgjidhje definitive të problemit të Kosovës dhe, më konkretisht, të çështjes shqiptaro-serbe, siç thoshte ai, projektin për ndarjen e Kosovës më 5 janar 1993 (60:40% në favor të serbëve) ia paraqiti edhe bashkëkryetarëve të Konferencës së Gjenevës për ish-Jugosllavi, S. Vensit dhe D. Ovenit në selinë e OKB-së në Gjenevë. Mirëpo, siç shihet nga shënimet e vetë Qosiqit, këta dy diplomatë të rangut të lartë, këtë projekt e hodhën poshtë, duke theksuar se me ndarjen e Kosovës bëhet edhe ndarja e Maqedonisë, që nuk e dëshiron as UE e as Amerika.[3] Ndarjen e Kosovës përmes enklavizimit etnik gjatë gjithë viteve të 90-ta e mbështeste, madje edhe e nxiste Kisha Ortodokse Serbe. Qosiqi, në librin e tij të fundit "Kosova", të botuar në Beograd në tetor të vitit 2004, jo vetëm që e përsërit tezën për ndarjen e Kosovës dhe ndarjen (përkufizimin) territoriale midis serbëve dhe shqiptarëve, por duke i ofenduar rëndë shqiptarët nxit urrejtjen dhe kurajën fashizmin serb, ashtu siç ka bërë që nga viti 1968 e më herët. Ndarja dhe përkufizimi do të bëheshin natyrisht në proporcione territoriale sipas leverdisë së Qosiqit dhe politikës shekullore hegjemoniste serbe. Meqenëse "Serbia nuk ka forcë biologjike që ta ruajë territorin e saj",[4] atëherë Kosova duhet të ndahet. Me ndarjen e Kosovës dhe ndarjen (përkufizimin) territoriale midis shqiptarëve dhe serbëve, tezë kjo që qarkullon më se 40 vjet në përsiatjet e Qosiqit, "babai" i serbëve nënkupton që pjesa që do ta merrnin shqiptarët mund të bashkohet me Shqipëri dhe dy popujt dhe dy shtetet mund të jetojnë njëri skaj tjetrit dhe për këtë qëllim autoritetet e Beogradit duhet të bisedojnë drejtpërdrejt me Tiranën zyrtare, duke e kapërcyer Prishtinën. Sipas tij, ndarja dhe përkufizimi i tillë paraqesin

SANU, Odeljenje društvenih nauka, Knjiga 28, Beograd, 2007, ff. 1-499.

[3] D. Ćosić, *Kosovo, Novosti,* Beograd, 2004, ff. 77-78. Libri, që në 257 faqe përmban shënimet dhe tekstet nga ditarët e babait të saj dhe "babait të kombit" serb, për Kosovën është përgatitur nga vajza e tij, Ana Qosiq-Vukiq.

[4] D. Ćosić, *Po aty,* f. 182.

"kompromisin midis të drejtës historike dhe të drejtës etnike dhe zgjidhjen racionale të antagonizmave shekullore ndëretnike".[5] "Në Kosovë dhe Metohi, rreth manastireve të mëdha serbe dhe enklavave etnike, duhet formuar shtete të vogla të pavarura sikurse San Marino, Andora, Vatikani, Lihtenshtajni dhe bashkësi të ngjashme shtetërore-juridike e sovrane në Evropë, çfarë është Alandi në Finlandë. Territoret serbe në veri të Kosovës duhet t'i bashkohen Serbisë, të cilat i përkisnin që nga çlirimi nga Turqia deri në vitin 1878, ndërsa territoret jugore të Kosovës dhe një pjesë e Metohisë, ku jeton shumica shqiptare, t'i bashkohen Shqipërisë ose shtetit të pavarur shqiptar, në qoftë se këtë e dëshirojnë shqiptarët e Kosovës".[6]

Tendenca e haptë e një ndarjeje të brendshme të Kosovës, në formë të enklavave etnike në vitet e 80-ta, ishte formimi i komunave ku ose dominonte popullsia serbe ose përbënte afër 50% në popullsinë e përgjithshme. Këto komuna ishin: Zubin Potoku, Zveçani, Shtërpca, Artana (Novobërda), Fushë-Kosova, Kastrioti (Obiliqi), Shtimja, Gora etj. Formimi i tyre nuk ishte bërë për shkak të nevojave të popullatës dhe organizimit më të mirë të pushtetit, por për arsye politike. Ekzistonin edhe projekte të tjera të rikomponimit territorial të Kosovës në kuadër të Planit hapësinor të Serbisë dhe të njësive zgjedhore në Serbi; përfshirja e një pjese të mirë të territorit të Kosovës në njësinë zgjedhore të Leskovcit në fillim të viteve të 90-ta gjithashtu ishte në këtë funksion. Megjithatë, regjimi i Millosheviqit pasi e rrënoi në tërësi subjektivitetin politik të Kosovës (1989) vazhdonte ta shihte atë vetëm si pjesë integrale të Serbisë, me numër të reduktuar të shqiptarëve (600.000 deri 800.000) ose madje pa shqiptarë në saje të zbatimit të politikës së spastrimit etnik etj., që doli sheshazi në Rambuje (1999) nga kryetari i atëhershëm i Serbisë M. Millutinoviq dhe nga dëshmitarë të vetë kombësisë serbe në procesin gjyqësor kundër Millosheviqit në Hagë në vitin 2003 (R. Taniq etj).[7]

Në përurimin e këtij libri më 4 nëtor 2004 në Beograd, i cili në Serbinë e tërbuar nga nacionalshovinizmi për më pak se dy javë u shit në 30.000 ekzemplarë, autori në fjalën e tij theksoi: "Totalitarizmi dhe nacionalizmi ekspansionist i shqiptarëve, i mbrojtur me ideologjinë islamiste dhe me energjitë e islamizmit nuk është i drejtuar vetëm kundër serbëve, maqedonasve, malazezëve dhe grekëve; nacionalizmi shqiptar është i drejtuar kundër Evropës dhe qytetërimit të saj...Ta lirojmë Serbinë nga Kosova. Ta mbrojmë Serbinë nga shqiptarizmi barbar. Ta bindim BE-në se në Kosovë po punohet kundër Evropës, kurse SHBA-të se në Kosovë nuk po punojnë për veten" (Sipas raportit të korrespodentes së *Kohës ditore* nga Beogradi Naile Imami, "Babai" i kombit serb vazhdon me nxitjen e urrejtjes", *Koha ditore*, 6 nëntor 2004).

[5] D. Ćosić, *Po aty*, f. 256.

[6] D. Ćosić, *Po aty,* f. 133.

[7] Dëshmitari i partisë "Nova demokratija", kundër S. Millosheviqit në Tribunalin e Hagës, Ratomir Taniq, disa herë në koalicion qeveritar me Partinë Socialiste të Millosheviqit,

3. Projektet më të reja të rikomponimit territorial

Mirëpo, ideja e rikomponimit territorial të Kosovës në vitet e 90-ta u aktualizua sërish në versione të ndryshme nga qarqe të caktuara të regjimit të Serbisë. Në gjysmën e vitit 1993, me tezën për ndarjen e Kosovës doli drejtori i Institutit Gjeografik "J. Cvijiq" të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve dhe njëherit nënkryetar i këshillit të partisë politike "Nova demokratija", atëherë satelite e partisë së Millosheviqit, ndërsa më vonë (2001 e këndej) kryetari i kësaj partie është shef i policisë së Serbisë. Interesim për t'u marrë me aspekte të ndryshme të çështjes së Kosovës dhe veçanërisht me ridefinimin territorial të saj treguan edhe të tjerët. Njëri ndër ta ishte edhe urbanisti i pensionuar nga Beogradi, Branisllav Kërstiq (1922), si eksponent kryesor i politikës së shkatërrimit të individualitetit të Kosovës dhe të politikës kolonizuese në Kosovë, i biri i ideologut kryesor të reformës agrare në Kosovë midis dy luftërave botërore, Gjorgje Kërstiq.[8] Në vitin 1994 B. Kërstiqi paraqitet me projektin "Kosova midis të drejtës historike dhe të drejtës etnike",[9] ku, për dallim nga publikimet e deriatëhershme në Serbi për Kosovën dhe shqiptarët, ishte shkruar me një ton të matur, pa mitizime të tepruara dhe pa ofendime ndaj shqiptarëve, por për nga përfundimet që nxirreshin dhe porositë që jepeshin për zgjidhjen e çështjes së Kosovës paraqiste botimin më të rrezikshëm jo vetëm për Kosovën dhe shqiptarët, por edhe për serbët dhe Ballkanin. Ndërkaq, pas çlirimit të Kosovës, në vitin 2000 Kërstiq del me projektin tjetër "Kosova para gjyqit të historisë",[10] me të njëjtat porosi. Pas këtyre projekteve qëndronin qarqe dhe institucione të Serbisë, që u dëshmua më vonë kur Qendra Koordinuese e Qeverisë së Serbisë për Kosovë (shefi i saj N. Çoviq) dhe Kisha Ortodokse Serbe konsulent kryesor e kishin B. Kërstiqin, i cili ishte edhe nënkryetar i kësaj Qendre.

Shqetësimi i tij kryesor ishte individualiteti juridiko-politik i Kosovës, pastaj shtrirja territorialisht kompakte, numri dhe perspektiva demografike e shqiptarëve dhe brengosja për kinse rrezikimin e prosperitetit demografik, kombëtar e shtetëror të Serbisë dhe të serbëve. Për realizimin e interesit serb dhe vënien e Kosovës nën sovranitet të plotë të Serbisë, sipas tij, duhej amortizuar "albanizimin e Kosovës" dhe duhej "thyer plotësisht" dominimin

---

përveç tjerash theksoi se politika e reduktimit të numrit të shqiptarëve në Kosovë përmes spastrimit etnik ishte qëllim dhe strategji e regjimit të Millosheviqi (Shih: *Koha ditore*, 21-22 maj 2002).

[8] Đ. Krstić, *Kolonizacija u Južnoj Srbiji*, Bosanska pošta, Sarajevo, 1928.

[9] B. Krstić, *Kosovo između istorijskog i etničkog prava*, Beograd, 1994.

[10] B. Krstić, *Kosovo pred sudom istorije*, Beograd, 2000.

numerik dhe reproduktiv të shqiptarëve dhe atë përmes rikomponimit territorial të Kosovës, krijimit të autonomisë diferenciale dhe rrjedhimisht ndarjes së Kosovës, synime këto që nuk kishin lidhje me tendencat e një regjionalizimi të ri evropian dhe me integrimet ballkanike e më gjerë, por ishin thjesht një aspiratë shtetmadhe dhe hegjemoniste serbe, ku serbët do t'i sendërtonin "të drejtat e tyre historike" mbi bazë të monumenteve kulture-historike (kishat dhe manastiret), të cilat sipas tij, ishin të uzurpuara nga shqiptarët, si dhe rrëmbimin e territoreve të pasura me resurse nëntokësore dhe mbitokësore, ku shqiptarët përbënin shumicën dërmuese.[11]

Sa herë që kishin dhe sot e gjithë ditën kanë nevojë qarqet qeveritare serbe (Qendra e Çoviqit etj.) dhe kisha ortodokse serbe për copëtimin e territorit të Kosovës paraqitet B. Kërstiqi me projektet e tij. Me projektin "Kosova para gjyqit të historisë" të vitit 2000 pranon ndarjen e Kosovës në dy entitete. Mirëpo, evoluimi i ngjarjeve në Kosovë e shtyri këtë ideator që në marrëveshje me Qeverinë e Serbisë më vitin 2002 ta hartojë projektin për kthyerjen e serbëve në 24 lokacione. Ndërkaq serbët e Kosovës, të udhëhequr nga qarqet kishtare, kërkonin që të organizoheshin në kantone, që nuk ishte projekt i ri, sepse me të kishte dalë para luftës historiani D. Batakoviq (1998), përfaqësues i kishës ortodokse dhe njeriu i besueshëm i Koshtunicës, i emëruar nga ky i fundit në vitin 2000 ambasador në Londër, pastaj në Athinë. Por ky projekt nuk u pranua nga bashkësia ndërkombëtare. Në fillim të vitit 2004 Kërstiq sërish kërkon ndarjen e Kosovës në dy entitete sipas modelit të Qipros, ku që të dy entitetet do të mbetnin nën protektoratin e OKB-së.

---

[11] B. Krstić, *Po aty.*

Ekziston një arsye e madhe pse vazhdimisht paraqitet Kërstiqi si eksponent i politikës së shkatërrimit të individualitetit të Kosovës dhe të politikës kolonizuese në Kosovë. Babai i tij, Gjorgje Kërstiq, ishte njëri nga ideologët kryesor të kolonizimit të "Serbisë Jugore" midis dy luftërave botërore, i njohur me projektin "Kolonizacija u Južnoj Srbiji" (1928). I biri i tij e paska shkruar librin "Kosova midis të drejtës historike dhe të drejtës etnike" (1994), siç thotë vetë, i nxitur nga angazhimi i babait për ta bërë "Ksovën dhe Metohinë pjesë të zhvilluar të Serbisë", natyrisht pasi të jetë serbizuar përmes kolonizimit të serbëve dhe dëbimit të shqiptarëve në shkretëtirat e Anadollisë! Dhe, sipas të birit, pas Luftës II Botërore, babai paska pyetur: "Pse të konstituohet Krahina e Kosovës krahas Serbisë?" Ai kinse e paska marrë përgjigjen: "Për t'u rregulluar më mirë raportet midis serbëve dhe shqiptarëve" dhe babai Gjorgji qenka përgjigjur: "Nuk është mirë kur njerëzit nuk e dinë në cilin shtet jetojnë", ndërkaq i biri, Branisllavi, duke iu referuar eksperiencës jetësore të babait, siç thotë vetë, do të konfirmojë se "serbët janë shpërngulur nga Kosova sepse nuk e kanë ndjerë veten në Serbi"(!). Nga të dhënat e tij biografike mund të mësohet se B. Kërstiqi ishte mbështetës i flakët i politikës së centralizimit në Jgosllavinë e Dytë dhe për shkak të kundërvënies së decentralizimit të pushtetit në ish-Federatën Jugosllave në sferën e rregullimit hapësinor ishte pushuar nga puna në vitin 1980.

Kryeadministratori H. Hakerup kishte nënshkruar në nëntor 2001 një marrëveshje në Beograd me Qeverinë e Serbisë, që ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244 dhe me Kornizën Kushtetuese. Në emër të nxitjes së serbëve që të dilnin në zgjedhjet e 17 nëntorit 2001, marrëveshja paralajmëronte koncesione të reja politike, ekonomike dhe mbase edhe territoriale, duke i hapur rrugë paralelizmit të pushtetit dhe enklavizimit të Kosovës. Në favor të tendencës së legalizimit të enklavave serbe dhe të veprimit të strukturave paralele sot shkon edhe projekti i Këshillit të Evropës për reformimin e pushtetit lokal, i përgatitur jo mbi baza të kritereve gjeografike dhe demografike, por në mbështetje të kriterit etnik. Veprimi i strukturave paralele dhe enklavizimi, të mbështetura nga Beogradi dhe të toleruara nga UNMIK-u dhe instancat e tjera ndërkombëtare, janë burim i përhershëm i konflikteve dhe një nga pengesat serioze në përmbushjen e tetë standardeve të propozuara nga përfaqësuesi amerikan në nëntor të vitit 2003 dhe të mbështetura nga tërë bashkësia ndërkombëtare. [12]

Koshtunica që kur erdhi në krye të Qeverisë së Serbisë në fillim të vitit 2004 kërkoi menjëherë ndarjen e Kosovës në dy entitete ose kantonizimin e saj; kantonizimi nënkupton edhe ndarje të re të brendshme administrativo-territoriale, përkatësisht ndërrimin e kufijve komunalë. Këto ditë (maj 2004) Qeveria e Serbisë në krye me Koshtunicën miratoi projektin e ndarjes së Kosovës në pesë kantone: i Anamoravës, i Sharrit, i Qendrës, i Dukagjinit dhe i Veriut. Projekti, sipas qarqeve serbe, nënkupton për serbët "autonomi brenda autonomisë". Këtë projekt Serbia ia dorëzoi edhe qendrave ndërkombëtare të vendosjes, të cilat po "e studiojnë". Projekti mund të realizohet vetëm me spastrime masive etnike të të dy palëve, shqiptarëve dhe serbëve, dhe rrjedhimisht me dhunën dhe tragjedinë e komuniteteve etnike.[13] Mirëpo, një gjë është shumë e qartë: derisa të pyetet

---

[12] Këto standarde janë: institucionet demokratike funksionale; sundimi i ligjit; lëvizja e lirë e njerëzve; kthimi i të shpërngulurve dhe riintegrimi i pakicave; ekonomia; të drejtat pronësore; dialogu me Beogradin dhe TMK-ja.
Morton Abramowich, një ish-udhëheqës i lartë në Qeverinë Amerikane, sot anëtar i Grupit Ndërkombëtar të Krizave (ICG) dhe pjesëmarrës në Konferencën e Rambujesë në fillim të vitit 1999 theksonte se në "Kosovë i kanë vendosur standardet e tilla, që në këtë botë të sotme vetëm Danimarka dhe Norvegjia mund t'i përmbushin"! (Intervista për "Evropën e lirë", e botoi "Bota sot", dt. 15.1.2004).

[13] Organizatat e paanshme ndërkombëtare, duke u marrë me versionin e ndarjes apo të kantonizimit të Kosovës, të paraqitur nga Qeveria e V. Koshtunicës, këmbimin e detyrueshëm të bashkësive etnike shqiptare dhe serbe e konsiderojnë shumë të rrezikshëm dhe si të tillë të papranueshëm. Ato tërheqin një paralele midis këtij varianti, nëse pranohet ndërkombëtarisht, dhe Traktatit të Lozanës më 1923, të mbështetur edhe nga fuqitë e mëdha, kur transferi i dhunshëm i popullsisë turke dhe greke u përcoll me dhunë, shkatërrime dhe viktima në njerëz (Shih: *Treaty of Lausanne, 1923*: sipas *The*

Beogradi është i pamundshëm zbatimi i standardeve të përmendura dhe përbashkësia midis shqiptarëve dhe serbëve. Nuk habisin qëndrimet e Koshtunicës, ngase ai njihet si nacionalist ortodoksist që nga koha e Titos, sepse ishte kundër Kushtetutës së vitit 1974, sot është kundër bashkëpinimit me Tribunalin e Hagës, ishte dhe mbetet mbështetës i Karaxhiqit dhe i Mlladiqit, luftoi kundër shqiptarëve në Kosovë në vitet 1998-1999 etj., por janë të habitshme deklaratat e "reformistëve" serbë, që kërkojnë ndarjen e Kosovës në kantone apo entitete, të cilat madje duhet të sigurohen nga forcat policore-ushtarake serbe, pa llogaritur se të njëjtën gjë mund ta kërkojnë shqiptarët në Luginën e Preshevës, myslimanët në Sanxhak, bullgarët në lindje të Serbisë etj. Regjimi i tashëm i Beogradit mbetet pengesa kryesore për zbatimin e standardeve, zgjidhjen e problemeve jetësore të serbëve të Kosovës dhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare, si dhe për paqen në rajon. Mirëpo, Kosova ka vetëm një rrugë të pandalshme: e pavarur, territorialisht një dhe e pandashme.

Lausanne Principe: Multiethnicity, Territory and the Future of Kosovo's Serbs, European Stability Initiative (ESI), Berlin/Pristina, June 7, 2004).

Pjesa e gjashtë

ASPEKTI DEMOGRAFIK-FUNKSIONAL I VENDBANIMEVE TË KOSOVËS

I. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË VENDBANIMEVE

1. Vendbanimet si vatra të para të bashkësisë njerëzore

Vendbanimet janë vatra të jetës dhe veprimtarive të përgjithshme shoqërore. Janë ndër format e para të bashkësisë shoqërore, të krijuara gjatë fazave të gjata e të rënda të zhvillimit shoqëror-historik. Njeriu si individ dhe popullsia si bashkësi specifike njerëzish, me jetën dhe veprimtarinë e tyre, lidhen për hapësira të caktuara, me qëllim që me aftësitë e tyre fizike, mendore e materiale, ta shfrytëzojë dhe organizojë jetën. Ndërsa bërthamat e jetës e të punës së përhershme të tyre në këto territore (vendbanimet) lidhen me popullsinë. Krijimi dhe zhvillimi i asociacioneve të para të njerëzve (vendbanimeve) pra varet nga popullsia dhe nga numri dhe përbërja e caktuar e saj. Në anën tjetër, ndikim të konsiderueshëm në këtë drejtim kanë luajtur një varg faktorësh të bazës natyrore-gjeografike dhe të nivelit të zhvillimit ekonomik, shoqëror, historik dhe kulturor të njerëzimit.

Njerëzit së pari janë grupuar rreth pikave të caktuara territoriale, të cilat kanë pasur pozitë të volitshme gjeografike, ndërsa rrethina e tyre edhe kushtet e tjera natyrore, të cilat, në fazën e parë të krijimit të vendbanimeve, kufizoheshin në reliev, klimë, ujëra, vegjetacion dhe botë shtazore të përshtatshme për zhvillimin e jetës. Kjo periudhë, siç dihet, i përket epokës së parë të bashkësisë së parë njerëzore, *epokës së egërsisë*.[1] Baza ekzistenciale e jetës në këtë kohë ishte mbledhja e gatshme e frutave ashtu si i jepte natyra, pastaj gjuetia dhe peshkimi. Njerëzit jetonin të grupuar në horda. Në fazën e mëvonshme të kësaj epoke njerëzit grupohen në bashkësi më të mëdha, të bazuara në lidhje të gjakut, të afërsisë (gensi), e bashkojnë punën dhe krijojnë edhe pronën e përbashkët; dallime në bazë ekonomike nuk kishte. Në këtë periudhë shpiket zjarri, harku, kordha e shigjeta dhe veglat e punës nga guri. Më vonë, në epokën tjetër të bashkësisë së parë njerëzore, në *epokën e barbarisë*, njerëzit veprimtarinë e tyre ekonomike e

[1] Sociologu dhe etnologu i njohur amerikan Henri L. Morgan (1818-1881) bëri periodizimin e bashkësisë së parë njerëzore në tri epoka: të egërsisë, të barbarisë dhe të civilizimit. F. Engelsi, duke përqafuar këtë ndarje të Morganit dhe në mbështetje të materialeve dhe rezultateve shkencore të tij, në vitin 1884 shkroi një libër, në të cilin e zhvillon më tej këtë periodizim, duke marrë për bazë shkallën e zhvillimit teknik dhe tipin e ekonomizimit. Ai me këtë rast i thekson edhe dallimet midis shoqërisë klasore dhe shoqërisë pa klasa (F. Engels, *Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit*, Prishtinë, 1976, ff. 27-35).

zgjerojnë në blegtori dhe bujqësi (punimi i tokës), duke qenë të varur akoma shumë nga rrethanat natyrore-gjeografike, para së gjithash nga kullosat, pyjet dhe sipërfaqet e punueshme, dhe organizimi i punës kolektive dhe rregullimi fisnor. Në shkallët e caktuara të kësaj epoke fillon kultivimi i bimëve ushqimore, përpunimi i metalit, i lëkurës, konservimi i ushqimit etj. Veglat e punës (sëpata, parmenda etj.) dhe armët (shpata, thika, mburoja etj.) përsosen dhe njerëzit aftësohen për organizimin e punës në bujqësi. Paraqitja e bujqësisë dhe lidhja e njerëzve për territore të caktuara kushtëzon kalimin nga mënyra nomade-endacake e jetës në mënyrën e jetës së ngulitur, në një anë, dhe krijimin e vendbanimeve të përhershme, të fshatrave, shtëpitë e të cilave janë të bëra nga druri, balta dhe guri, në anën tjetër. Këto vendbanime (fshatra), përveç suazave të caktuara territoriale, tash kanë edhe karakteristikat e tyre prodhuese. Zhvillimi i blegtorisë dhe i bujqësisë, por edhe i disa zejeve dhe përsosja e mëtejme e mjeteve të punës mundëson jo vetëm që të plotësohen nevojat vetanake ekzistenciale, por krijon edhe njëfarë teprice të prodhimit. Në këtë mënyrë, nga bashkësia farefisnore ndahen familjet e vogla në njësi të pavarura ekonomike, të cilat vetë prodhojnë, dhe shfaqen edhe diferenca të caktuara midis tyre. Kështu paraqiten format e para të pronës private.[2] Diferencimi i njerëzve në bazë ekonomike kushtëzon shkatërrimin e bashkësisë së parë njerëzore dhe paraqitjen e shoqërisë me dy klasa, të shoqërisë skllavopronare.[3]

2. Shtrirja, ndryshimet në madhësi dhe klasifikimi i vendbanimeve

Edhe për nga shumë veçori gjeodemografike, Kosova, siç dihet, paraqet një singularitet në këtë pjesë të Evropës. Popullsia e saj është e shtrirë në një numër të madh të vendbanimeve, gjithsej në 1445 sish. Prej tyre sot vetëm 26 vendbanime i përkasin tipit urban, ndërsa të tjerat janë fshatra, kryesisht të shkapërderdhura, me numër të vogël të popullsisë dhe të lidhura dobët në pikëpamje komunikative. Fshati dhe struktura e imtë e popullimit në Kosovë ishin dhe mbetën formë dominante në strukturën e popullimit, të cilat, në kuadër të zhvillimit demografik dhe të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror paraqesin gjithashtu një specificitet. Në vitin 1948 një vendbanim i Kosovës mesatarisht kishte 510 banorë, ndërsa në vitin 1981, me rritjen e popullsisë, ky numër rritet në 1.096 banorë.

---

[2] F. Engels, *Po aty.*

[3] T. Vlaškalić, *Postanak ljudskog društva i osnovne karakteristike prvobitne zajednice*, Rad, Beograd, 1976.

Në qoftë se vështrohet madhësia e vendbanimeve në gjysmën e dytë të shekullit XX, vërehen ndryshime të konsiderueshme. Në vitin 1948 p. sh. 1060 vendbanime rurale ose 77% e tyre kishin më pak se 600 banorë, në të cilat jetonin rreth 33% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës. Në vitin 1981 struktura e popullimit, nën ndikimin të fuqishëm të rritjes demografike, përmirësohet ngase numri i fshatrave me më pak se 600 banorë reduktohet në 712 sish. Derisa në vitin 1971 81 fshatra kishin deri 100 banorë dhe 138 sish prej 100 deri 199 banorë, ndërsa në vitin 1981 numri i vendbanimeve të këtij tipi deri 100 banorë rritet në 117, kurse prej 100 deri 199 banorë zvogëlohet në 105 fshatra. Derisa në vitin 1948 në vendbanimet prej 200 deri 2.000 banorë jetonin 72,1% të popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës, në vitin 1981 në vendbanimet e kësaj madhësie jetonin 53,5%. Për vitin 1991, kur u bë regjistrimi i popullsisë në Jugosllavinë e atëhershme, nuk kemi të dhëna, sepse për shkaqe tashmë të njohura, shqiptarët nuk morën pjesë në këtë regjistrim. Mirëpo, sipas vlerësimeve, në mbështetje të proceseve të manifestuara demografike deri në vitin 1981, ka vazhduar tendenca e zvogëlimit të numrit të fshatrave me pak banorë dhe e rritjes së numrit të vendbanimeve fshatare me madhësi mbi 200 e 300 banorë. Por, kjo strukturë e popullimit gjithsesi nuk është e volitshme dhe në shumë fshatra paraqitet si pengesë në zgjerimin e sistemeve urbane infrastrukturore dhe të elementeve të tjera të jetës bashkëkohore.

Veçoritë e bazës natyrore-gjeografike, siç janë kushtet gjeomorfologjike, hidrologjike, pedologjike etj., dhe rrethanat shoqëroro-historike dhe ekonomike kanë ndikuar në krijimin, shtrirjen dhe zhvillimin e vendbanimeve të Kosovës. Shumë vendbanime të sotme rurale janë krijuar ose në mënyrë stihike, në etapën themelore të popullimit, ose në kuadër të kushteve përkatëse jetësore dhe shoqërore në të kaluarën. Ndërkaq, sa i përket vendbanimeve urbane përgjithësisht mund të vlerësohet se për Kosovën ishte një rrethanë lehtësuese që trashëgoi një shtrirje të volitshme hapësinore të shtatë qendrave urbane (Prishtina, Peja, Prizreni, Gjakova, Mitrovica, Gjilani dhe Ferizaji), të cilat zhvillimi i mëvonshëm i forcoi edhe më tepër dhe mbi këtë bazë mundësuan një zhvillim relativisht të harmonizuar territorialo-urban.

Tabela 1. Struktura e popullsisë së Kosovës sipas madhësisë së vendbanimeve, sipas regjistrimeve të viteve 1948 dhe 1981[4]

	1948	1981
Deri 199 banorë	3,4	1,4
200 – 499	20,4	8,8
500 – 1.99	31,3	19,6
1.000 – 1.999	20,4	25,1
2.000 – 4.000	5,6	13,3
5.000 – 9.999	1,6	3,2
10.000 – 19.000	2,5	2,7
20.000 – 49.000	14,8	8,5
50.000 – 99.999	-	10,7
100.000 e më tepër	-	6,8
Gjithsej	100,0	100,0

Kur është fjala për fshatrat dallohen disa tipa. Në rajonet e rrafshëta dominon *tipi i dendur i fshatrave*, ndërsa në territoret kodrinore-malore, ku elementet e ekonomisë natyrale dhe gjysmënatyrale janë ende të theksuara është karakteristik *tipi i shpërndarë*, ku shumë fshatra të këtij tipi përbëhen nga *mëhallët*. Në të kaluarën, në rrethana të caktuara socialo-historike, në Kosovë ka ekzistuar edhe tipi i vendbanimeve *sezonale blegtorale*, të njohura si *stane* ose *tbane*. Lëvizja sezonale e njerëzve dhe e bagëtisë në këto vendbanime, sikurse në kohën e gjysmënomadizmit, determinohej nga ritmi klimatik vjetor dhe ngushtimi i suazave jetësore; popullsia kishte vendbanimin e përhershëm në vise të rrafshëta ose rrëzë maleve, ku një pjesë e familjeve, së bashku me bagëtinë, në fillim të verës i popullonte stanet, ndërsa në fillim të vjeshtës i braktiste, zdirgjej në vendbanime të përhershme. Mirëpo, numri i vendbanimeve sezonale, me rënien e rolit të blegtorisë ekstensive, si bazë plotësuese e diku edhe si bazë dominante e jetës gjithnjë është zvogëluar, por nuk është zhdukur në tërësi. Këtë tip të vendbanimeve ende e gjejmë në Bjeshkët e Nemuna dhe në disa pjesë të tjera malore të Kosovës dhe rreth saj. Tipi i shtëpisë dhe materiali i ndërtimit të saj në vendbanimet fshatare të Kosovës zakonisht i përgjigjej mjedisit natyror-gjeografik dhe mënyrës së jetesës. Një tip i veçantë i shtëpisë së fortifikuar në Kosovë, veçanërisht në rrafshin e Dukagjinit, është *kulla*, e cila është ndërtuar në rrethana specifike shoqëroro-historike. Në planet shkatërrimtare dhe gjenocidale serbe ndaj

[4] Burimi: M. Ban, *Naselja u Jugoslaviji i njihov razvoj u periodu 1948-1961*, IDN, CDI, Beograd, 1970, f. 56; D. Breznik, *Stanovništvo Jugoslavije*, Konzorcijum instituta društvenih nauka, Chronos, Titograd, 1991, f. 136.

shqiptarëve njëri nga caqet ishte edhe djegia dhe rrënimi i kullave shqiptare në Kosovë; okupatori serb shkatërroi një numër të madh të tyre (rreth 500).

Vendbanimet rurale të Kosovës shtrihen kryesisht në zonat kaluese morfologjike: midis territoreve të rrafshëta dhe atyre kodrinore-malore, në lartësi mbidetare prej 400 deri 700 metra. Këto janë pjesët më të përshtatshme, sepse ofrojnë mundësi joshëse për jetë të kombinuar, bujqësore dhe blegtorale. Popullsia shtrihet kryesisht në ato pjesë të kësaj zone morfologjike që kanë tokë pjellore dhe kullosa, burime të bollshme të ujit të pijshëm dhe kthyerje në anët nga dielli. Lënia pasdore e fshatrave malore, nënçmimi i potencialeve të tyre natyrore e demografike, dendësia e madhe agrare dhe mungesa e sistemeve urbane infrastrukturore, në një anë, dhe atraktiviteti i fshatrave të rajoneve të rrafshëta e rreth qyteteve dhe zhvillimi i qyteteve, i selive komunale, i qendrave të vogla administrative, etj., të cilat, në saje të ndryshimit të profesionit dhe migrimeve ditore, transformohen në vendbanime të përziera (as fshat, as qytet), në anën tjetër, kanë kushtëzuar ndryshime të dukshme në shtrirjen dhe rigrupimin e popullsisë, duke krijuar ndryshime edhe në madhësinë e vendbanimeve dhe përbërjen e popullsisë dhe përgjithësisht raporte të reja në strukturën e popullimit në Kosovë. Nga arsyet e përmendura, pjesa dërmuese e fshatrave kodrinore-malore, në pikëpamje demografike shënoi një regres, ndërsa vendbanimet e mëdha rurale në rajonet e rrafshëta dhe ato urbane e të urbanizuara shënuan rritje gjithnjë më të madhe demografike. Në periudhën 1971-1981 në më se 400 fshatra të Kosovës, të banuara kryesisht me serbë kishte rënë numri i popullsisë, ndërsa në vitin 1991, sipas disa vlerësimeve, tendencë të tillë regresive demografike kanë pasur afër 500 fshatra. Nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve rurale, në vitin 1991, në 113 sish, kryesisht të shtrira në rajonet kodrinore-malore është shënuar shtim natyror negativ ose zero, që është dukuria më e pavolitshme afatgjate në zhvillimin demografik të çdo vendbanimi apo territori, ndërsa në Serbi, në Vojvodinë dhe në Mal të Zi gjendja ishte dramatike.[5]

Migrimet e popullsisë fshatare lënë shumë pasoja të pavolitshme, të cilat drejtpërdrejt manifestohen në tendencat shpopulluese, në shndërrimin e sipërfaqeve të punueshme në "ugar social", pastaj në ngecjen e dukshme të blegtorisë si degë ekonomike, ku vazhdimisht po zvogëlohet fondi i kafshëve etj. Në anën tjetër, nga migrimi i pakontrolluar, qytetet po "fshatarizohen" dhe në to po krijohen probleme të shumënduarshme. Mirëpo, me gjithë braktisjen

[5] Sipas regjistrimit të vitit 1991, nga 4217 vendbanime sa i kishte Serbia, 3130 sish kishin shtim natyror negativ apo shtim natyror zero, në Vojvodinë nga 464 vendbanime, në 328 sish ishte shënuar shtim natyror negativ ose zero shtim dhe në Mal të Zi nga 1225 vendbanime, 828 sish kishin shtim të tillë negativ apo stagnim (Shih: "Statistički prilozi", *Stanovništvo*, CDI, IDN, br. 1-4/1992 dhe 1-2/1993, Beograd, 1993, ff. 227-278).

intensive nga fshati, deri në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar emigrimi nuk ishte në masë të madhe selektiv sipas moshës dhe gjinisë dhe procesi i migrimit zhvillohej ashtu që fshatin e braktiste ose e gjithë familja ose një pjesë e saj, ndërsa riprodhimi biologjik, bile ai në vëllim të thjeshtë, nuk rrezikohej. Por, pas këtyre viteve proceset migruese marrin kahe jo të volitshme në drejtime të ndryshme, për çka u bë fjalë më parë.

Kur vështrohet shtrirja e vendbanimeve dhe e popullsisë sipas lartësisë mbidetare, vërehet një gjendje shumë karakteristike. Sipas regjistrimit të vitit 1981, në lartësinë mbidetare deri 400 metra shtriheshin 350 vendbanime,[6] të cilat përfshinin rreth 30% të popullsisë dhe rreth 16% të sipërfaqes së Kosovës; midis 500 e 600 metra të kësaj lartësie shtriheshin 460 vendbanime në rreth 21% të sipërfaqes së Kosovës, ku jetonin rreth 45% të popullsisë së saj; në lartësi mbidetare mbi 700 metra gjendeshin rreth 400 vendbanime, të shtrira në rreth 47% të sipërfaqes, ku jetonin rreth 12% të popullsisë së Kosovës. Mbi 500 metra, në sipërfaqe prej afër 16% të hapësirës së Kosovës shtriheshin rreth 350 vendbanime, në të cilat jetonte rreth 30% të popullsisë, ndërsa mbi 1000 metra lartësie mbidetare shtriheshin 103 vendbanime, që përfshinin 21% të sipërfaqes, por me vetëm 3,4% të popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës.[7]

Në çdo vend bëhet klasifikimi i vendbanimeve në fshatra dhe qytete, varësisht nga specifikat e tyre, ndërsa në disa vende dallohet edhe tipi i tretë, ai kalimtar ose i përzier (as fshat, as qytet). Me këtë rast zbatohen kritere të ndryshme, siç janë p.sh. numri i popullsisë, përqindja e popullsisë jobujqësore, statusi historiko-juridik i vendbanimit, shkalla e pajimeve të tyre komunale etj.[8] Mirëpo, duket se për ndarjen e vendbanimeve në ato urbane dhe rurale kriteri i kombinuar është më i përshtatshëm. Raporti midis popullsisë rurale dhe asaj urbane është indikator i rëndësishëm i nivelit të zhvillimit ekonomik e social dhe i ndarjes shoqërore të punës, por edhe i strukturës së popullimit dhe i intensitetit të procesit të deagrarizimit, deruralizimit dhe urbanizimit.[9]

---

[6] Jetesa në territore të rrafshta dhe në lartësi të ulët mbidetare është karakteristikë e përgjithshme e shtrirjes së njerëzimit: prej 0 - 200 metra të lartësisë mbidetare sot jeton rreth 56% e popullsisë së botës, kurse në lartësi nën 500 metra jeton rreth 80% e njerëzimit (M. Friganović, *Demogeografija (Stanovništvo svijeta)*, Školska knjiga, Zagreb, 1990, f. 198).

[7] A. Pushka, "Korelacioni në mes të madhësisë së vendbanimeve, dendësisë së popullsisë dhe lartësisë mbidetare të KSA të Kosovës", *Kërkime gjeografike*, nr. 4, Prishtinë, 1983, f. 122.

[8] Për definimin e popullsisë urbane sipas kritereve të ndryshme, të zbatuara në shumë vende në zhvillim, si dhe për rritjen demografike të qyteteve të tyre, shih: Y. Blayo, "L'urbanisation dans les régions en developpement", *Population*, No 6, INED, Paris, 1980, pp. 1165-1171.

[9] Shih më gjerë: D. Noin, *Géographie de la population*, Masson, Paris-New York-Barcelone-Milan, 1979, pp. 97-121.

Në Kosovë dhe përgjithësisht në ish-Jugosllavi tipizimi i vendbanimeve është bërë në bazë të kriterit të kombinuar demografiko-ekonomik, duke marrë parasysh madhësinë e vandbanimit dhe raportin midis popullsisë bujqësore dhe asaj jobujqësore, ku numri i popullsisë dhe përqindja e popullsisë jobujqësore qëndronin në raport proporcionalisht të kundërt, që do të thotë se sa më i vogël që të ishte numri i popullsisë aq më e lartë duhej të ishte përqindja e popullsisë jobujqësore në vendbanim; nën 2.000 banorë, pa marrë parasysh përbërjen socioekonomike, të gjitha vendbanimet konsideroheshin fshatra.[10] Në regjistrimet e popullsisë prej 1953 deri 1971 në ish-Jugosllavi është dalluar edhe tipi i tretë - *vendbanimet e përziera,* që posedojnë edhe karakteristika fshatare edhe urbane,[11] ndërsa në regjistrimin e vitit 1981 ndarja është bërë në vendbanime të qytetit dhe në vendbanime të tjera, përkatësisht në vendbanime fshatare, në bazë të ligjit mbi organizimin territorial të komunave, në përputhje me statutet e tyre. Në këtë regjistrim, për definimin e vendbanimeve urbane është zbatuar, pra, kriteri administrativ, ndërsa në popullsi fshatare është përfshirë edhe popullsia e vendbanimeve të përziera. Ndonëse vendbanimet e tipi të përzier tregojnë tendencën e përhershme të transformimit të tyre në qytete dhe popullsia e tyre në popullsi jobujqësore, megjithatë, në rastin e Kosovës për shumë arsye nuk gabohet nëse popullsia e këtyre vendbanimeve përfshihet në vendbanimet rurale.[12]

---

[10] Sipas skemës së përvetësuar për përkufizimin e popullsisë në atë urbane dhe fshatare në fillim të viteve të 50-ta, të bazuar në madhësinë e vandbanimit dhe përqindjen e popullsisë jobujqësore, vendbanime urbane konsideroheshin: a) vendbanimet prej 2.000 deri 2.999 banorë, me së paku 90% të popullsisë jobujqësore; b) vendbanimet prej 3.000 deri 9.999 banorë, me së paku 70% të popullsisë jobujqësore; c) vendbanimet prej 10.000 deri 14.999 banorë, me së paku 40% të popullsisë jobujqësore dhe ç) vendbanimet me më shumë se 15.000 banorë dhe me më tepër se 30% të popullsisë jobujqësore (M. Macura, "Kriterijumi za razgraničenje gradskog i seoskog stanovništva", *Statistička revija*, br. 3-4, Beograd, 1954; I. Ginić, *Dinamika i struktura gradskog stanovništva Jugoslavije (Demografski aspekt urbanizacije),* Institut društvenih nauka, Centar za demografska istraživanja, Beograd, 1967, f. 20).

[11] Sipas skemës së përmendur të klasifikimit të vendbanimeve, si vendbanime të tipit kalues ose të përzier janë definuar: a) vendbanimet prej 500-1.000 banorë me më tepër se 70% të popullsisë jobujqësore; b) prej 100 deri 2.000 banorë me 60% e më tepër të kësaj popullsie; c) vendbanimet prej 2.000 deri 3.000 banorë dhe 60-90% të popullsisë jobujqësore; ç) vendbanimet prej 3.000 deri 10.000 banorë dhe 40-70% të kësaj popullsie; dhe d) vendbanimet prej 10.000 deri 15.000 banorë dhe 30-40% të popullsisë jobujqësore (M. Macura, *Po aty;* Grup autorësh, *Ocena nekih definicija i klasifikacija u popisu stanovništva 1971. godine,* CDI, IDN, Beograd, 1976, f. 36).

[12] Sociologët ruralë, duke studiuar raportet mjaft komplekse fshat-qytet, theksonin se vendbanimet e përziera janë më tepër fshatra sesa qytete dhe popullsia e tyre më tepër është bujqësore sesa jobujqësore (Shih: S. Šuvar, *Između zaseoka i megalopolisa*, I, Zagreb, 1973, f. 32).

Të dhënat e fundit për popullsinë, ekonomitë shtëpiake, banesat dhe ekonomitë bujqësore për Kosovën i kemi nga regjistrimi i vitit 1981, të cilave të shumtën edhe jemi të detyruar t'u referohemi në këto shqyrtime. Regjistrimet e radhës (1991 dhe 2001)[13] nuk janë bërë, ndërsa gjendja demografike, sociale dhe ekonomike si në vendbanimet rurale, ashtu edhe në ato urbane ka ndryshuar shumë, në radhë të parë për shkak të shpërnguljeve të dhunshme selektive gjatë viteve të 80-ta dhe të 90-ta të shekullit të kaluar, veçanërisht shkatërrimeve e plaçkitjeve të okupatorit serb në vitin 1999. Pas luftës, për shkak të djegies së më se 120.000 shtëpive dhe minave të vëna nga ushtria serbe, në shumë rajone rurale të Kosovës një numër i madh i popullsisë nuk u kthye, por u vendos në qytete dhe një pjesë tjetër doli jashtë vendit.

[13] Në regjistrimin e 31 marsit 1991, që është organizuar në ish-Jugosllavi, shqiptarët nuk morën pjesë për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme që kishte vënë ish-shteti në Kosovë, përjashtimit të gjithë punëtorëve shqiptarë (128) nga Enti Statistikor i Kosovës, shpërnguljes së shqiptarëve, veçanërisht të rinjve në botën e jashtme dhe mungesës së të gjitha kushteve të tjera elementare për realizimin e një ndarmarrjeje të tillë. Ndërkaq pas luftës, edhe pse shqiptarët kërkuan disa herë të bëhej regjistrimi i popullsisë, megjithatë UNMIK-u, me kërkesën e autoriteteve të Beogradit, nuk po e lejon. Edhe pas miratimit të Ligjit mbi Regjistrimin e Popullsisë në Parlamentin e Kosovës në fillim të vitit 2004, regjistrimi prap nuk u realizua, sepse përfaqësuesi special nuk e nënshkroi! Vetëm në fund të vitit 2004 administratori ndërkombëtar e nënshkroi këtë Ligj dhe pritej që të mbahej regjistrimi, mirëpo kjo nuk ndodhi as në vitin 2006 dhe as në vitin 2007. Pengesat ishin të jashtme (UNMIK-u me Serbinë) dhe të brendshme: ministrja e Shërbimeve Publike dhe kryetarja Komisionit Qendror të Regjistrimit Melihate Tërmkolli doli pengesa kryesore; ajo e shkatërroi Entin Statistikor të Kosovës, si bartës profesional të kësaj ndërmarrjeje, duke i ndjekur të gjithë ekspertët. Projektin e regjistrimit e shndërroi në përfitim financiar dhe politik. Shih më gjerë kaptinën e dytë të pjesës së nëntë të këtij studimi.

II. BASHKËSIA RURALE E KOSOVËS NË RRJEDHAT SOCIODEMOGRAFIKE

1. Struktura homogjene dhe e pazhvilluar

Në rrethana të moszhvillimit të përgjithshëm për një kohë të gjatë, në Kosovë dhe në trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë në përgjithësi u formua një strukturë shumë karakteristike socialodemografike. Kjo strukturë deri në vitet e 50-ta të këtij shekulli ishte territorialisht kryesisht homogjene dhe autarkike në pikëpamje ekonomiko-demografike, me të gjitha veçoritë që bart shoqëria klasike agrare. Ndonëse shumë e pasur me resurse natyrore, nëntokësore dhe mbitokësore dhe me potenciale njerëzore, Kosova dhe viset e tjera shqiptare, për shkak të lënies pas dore në politikën e investimeve dhe pozitës kolonialiste, që e kishin vënë ish-Jugosllavitë, ishin dhe mbetën sot e gjithë ditën më të pazhvilluarat në çdo pikëpamje. Deri vonë pas Luftës II Botërore këto territore do të karakterizoheshin me më se 85% të popullsisë rurale dhe me po aq të popullsisë agrare, ndërsa në fshat dhe në bujqësi individuale do të ruheshin shumë mbeturina të marrëdhënieve parakapitaliste.

Të gjitha strukturat socialo-ekonomike dhe arsimore të popullsisë rurale ishin të njëtrajtshme, ndërsa diferencat sociale kufizoheshin vetëm në pasurinë agrare: në kuantumin e tokës, numrin dhe llojet e bagëtisë dhe në inventarin tjetër bujqësor; analfabetizmi si përcjellës i kahershëm i popullatës sonë, veçanërisht i grupacionit fshatar, ishte në nivel shumë të lartë, sidomos te popullsia shqiptare, e cila shkollat e para në gjuhën e saj do t'i fitojë vetëm në gjysmën e dytë të këtij shekulli. Popullsia rurale e ngulitur për rrethin familjar, ekonominë bujqësore dhe bashkësinë jashturbane në pikëpamje gjeografike dhe sociale ishte gjatë kohë e izoluar, pa rrugë e rrymë elektrike dhe elemente të tjera të komunikimit hapësinor e social dhe jashtë rrjedhave të shoqërisë globale. Në kuadër të organizimit tradicional të jetës familjare dhe në mungesë të institucioneve kyçe shoqëroro-ekonomike, brenda familjes realizoheshin pothuajse të gjitha funksionet socialo-ekonomike: prodhuese, konsumuese, reproduktive, arsimore, edukative, mbrojtëse, shëndetësore, socializuese etj. Riprodhimi i popullsisë zhvillohej shumë joracionalisht, ku baraspesha vitalo-demografike midis lindjes dhe vdekjes arrihej me humbje të mëdha njerëzish për shkak të nivelit të lartë të natalitetit dhe të mortalitetit, veçanërisht mortalitetit të foshnjave, fëmijëve të vegjël dhe femrave në periudhën e riprodhimit biologjik, për çka realizohej shtim i ulët natyror dhe përgjithësisht përparim i ngadalshëm demografik.

Moszhvillimi shoqëroro-ekonomik i Kosovës, veçanërisht mungesa e industrializimit deri nga fundi i viteve të 60-ta është manifestuar në ndryshimet e vogla në lëvizjen dhe shtrirjen territoriale të popullsisë dhe në mobilitetin e pamjaftueshëm social dhe profesional të saj, si dhe në koncentrimin e vogël demografik, në moszhvillimin e qyteteve dhe të mënyrës urbane të jetës dhe zgjerimin territorial të strukturave urbane në territorin rural.

2. Fillimi i transformimeve socialo-demografike dhe krijimi i grupeve të reja socioprofesionale

Pas viteve të 60-ta e të 70-ta të shekullit të kaluar, procesi relativisht i shpejtë i zhvillimit industrialo-urban dhe kulturo-arsimor, ka inicuar ndryshime të theksuara në lëvizjen dhe përbërjen e popullsisë së Kosovës. Mbi këtë bazë ka nisur të thyhej homogjeniteti demografiko-social i Kosovës dhe të krijoheshin struktura të reja socialo-profesionale dhe tipa të veçanta regjionalo-demografike. Në procesin e këtij transformimi vërehej përqindja gjithnjë më e vogël e popullsisë bujqësore me kalimin në veprimtari joagrare përmes mobilitetit profesional dhe shkollimit të brezave të reja, por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa përgatitje profesionale dhe arsimore. Rritja e përqindjes së popullsisë joagrare në fshat ishte edhe kusht i parë për fillimin e transformimit të strukturës socialo-profesionale dhe demografike të pjesës rurale të shoqërisë kosovare.

Mirëpo, përkundër ndryshimeve të konsiderueshme në zhvillimin shoqëroro-ekonomik dhe në strukturën socialo-profesionale të popullsisë pas viteve të përmendura, për shkak të politikës së njëanshme në sferën e investimeve dhe politikës dështuese në lëmin agrar, vazhdoi edhe më tutje lënia pas dore e fshatit, fshatarësisë dhe bujqësisë. Dukuria më e pavolitshme në zhvillimin socialo-ekonomik të fshatit e të bujqësisë dhe në zhvillimin shoqëroro-ekonomik të Kosovës në përgjithësi ishte rritja e vazhdueshme e numrit absolut të popullsisë bujqësore. Kjo rritje, me akumulimin e tepricave agrare, ashpërsonte problemet e dendësisë agrare, ushtronte presion në sipërfaqet e punueshme dhe në ato bujqësore, ndikonte në rritjen edhe ashtu të madhe të fragmentimit të pronave tokësore dhe e vështirësonte shfrytëzimin e tyre intensiv, pastaj ndikonte në rritjen e vazhdueshme të "urisë" për tokë dhe në ngritjen e çmimeve të saj, si dhe kushtëzonte rritjen e papunësisë latente dhe të gjysmëpunësimit në bujqësinë individuale.

Transferi i popullsisë bujqësore në veprimtaritë jobujqësore deri në vitet e 80-ta të shekullit XX ishte i konsiderueshëm. Ky kalim nënkupton në një pjesë të mirë edhe mobilitetin hapësinor të popullsisë dhe koncentrimin e saj

në vendbanime urbane, në qendra komunale dhe në vendbanime të tipit të përzier. Edhe pse eksodusi rural në këtë periudhë ishte relativisht intensiv, megjithatë ende mbeti shumë më e lartë përqindja e popullsisë fshatare (rreth 65%) nga ajo bujqësore (rreth 25% më 1981), që tregon nivel të lartë të ruralitetit, në një anë, dhe të transformimit të ngadalshëm të karakteristikave të vendbanimeve nga ndryshimi i strukturës socialo-ekonomike të popullsisë, në anën tjetër.

Me transformimet e përmendura pas viteve të 60-ta të shekullit të kaluar nisi të thyhej edhe përputhshmëria gati e plotë e dikurshme e popullsisë rurale me popullsinë agrare dhe dallimet sociale, pos në bazën pronësore (toka, bagëtia, inventari bujqësor etj.) filluan gjithnjë e më shumë të manifestoheshin edhe në bazë socialo-profesionale. Mori hov tendenca e zbërthimit dhe e transformimit të strukturës dikur homogjene klasike agrare të fshatit me shtresëzimin social të popullsisë së tij përmes kalimit nga profesionet bujqësore në ato jobujqësore, por duke mbetur popullsia në fshat dhe në ekonomi bujqësore. Posa nisi të thyhej struktura homogjene shoqëroro-ekonomike, u paraqitën dallimet rajonale në shkallën e zhvillimit, ndërsa me to u intensifikuan edhe lëvizjet migruese, të cilat nuk u kufizuan vetëm në rigrupimin e popullsisë, por kushtëzuan edhe ndryshime në madhësinë dhe strukturën e popullsisë. Në anën tjetër shënuan rritje të konsiderueshme grupet dhe strukturat e reja socialo-profesionale të popullsisë, sikurse janë: *fshatarët-punëtorët*, që merren me bujqësi dhe punojnë edhe në sektorin joagrar të ekonomisë; *fshatarët-jobujqit*, që jetojnë në fshat, por nuk merren me punimin e tokës, sepse janë të punësuar në veprimtari jobujqësore; *nëpunësit*, të cilët punojnë qoftë në shërbimet e caktuara në fshat, qoftë janë të punësuar në qytet dhe udhëtojnë çdo ditë; *inteligjencia*, të cilën e përbëjnë kryesisht të rinjtë e shkolluar, etj. Përparësitë e punësimit jashtë bujqësisë janë evidente, sepse përmes tij sigurohen të ardhura të përhershme mujore dhe sigurimi shëndetësor e pensional dhe me të edhe siguria sociale e njerëzve.

Numri i popullsisë jobujqësore në vendbanimet rurale të Kosovës gjithnjë shënonte rritje (u rrit prej 54.868 në vitin 1953 në 586.804 veta në vitin 1981 ose për 596,8%). Kjo kategori e popullsisë ishte dhe mbeti një ndër faktorët e rëndësishëm të zgjerimit të strukturave urbane dhe të ngritjes së cilësisë së jetës. Mirëpo, në një numër të konsiderueshëm të fshatrave, të cilat kryesisht kanë pozitë periferike gjeografike dhe shtrihen në rajonet kodrinore-malore, baza dominante e jetës deri vonë mbeti bujqësia dhe blegtoria e karakterit ekstensiv. Por edhe në këto vendbanime kohët e fundit, me migrimin dhe punësimin në botën e jashtme, është rritur numri i fshatarëve-jobujqësor dhe është përmirësuar standardi jetësor. Ndërsa vendbanimet rurale të tipit joagrar, të cilat posedojnë disa sisteme urbane infrastrukturore dhe institucione

themelore shoqërore, e që ushtrojnë një ndikim të rëndësishëm në mikrorajonet e tyre luajnë rolin gjithnjë më të madh të vendbanimeve me funksione qendrore.[1]

Rritja dhe difuzioni territorial i formave të përziera (bujqësore-jobujqësore) dhe jobujqësore të jetës në çdo bashkësi rurale e shpejtojnë procesin e deagrarizimit dhe të ndarjes graduale nga ekonomia bujqësore, i zgjerojnë krijesat urbane dhe elementet e reja në fshat, kushtëzojnë ndryshime të shumta në jetën familjare dhe në grupet e tjera primare shoqërore, i ashpërsojnë konfliktet midis brezave të moshuara dhe brezave të reja, sjellin ndryshime në ekonominë bujqësore (mekanizimi) dhe në territorin rural etj. Bartësit e ekonomive familjare me dy profesione dhe të një varg ndryshimeve shoqëroro-ekonomike në fshat janë migrantët ditorë, si lidhje e përditshme midis fshatit dhe qytetit (në vitin 1981 në Kosovë ishin 52.781 migrantë ditorë). Mirëpo, pjesa dërmuese e ekonomive familjare me burime të përziera të të ardhurave dhe të ekonomive familjare fshatare-punëtore kishin aspirata të tjera: në rastin e parë ta braktisin bujqësinë, e të shumtën edhe fshatin, dhe të kalonin në veprimtari jobujqësore dhe në qytet. Këto aspirata ishin shumë më të theksuara para okupimit të Kosovës dhe krizës ekonomiko-politike të ish-Jugosllavisë se që janë sot. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë rurale të Kosovës nuk tregonte interes për ta përparuar prodhimtarinë bujqësore dhe për të mbetur në fshat dhe në ekonomi bujqësore. Për këtë dëshmon fakti se ekonomitë shtëpiake bujqësore dhe të përziera më shumë mjete investonin në amvisëri se sa në pronë bujqësore. Rezultatet e disa anketimeve tregonin p.sh. se ekonomitë familjare bujqësore të Kosovës kanë ndarë vetëm 16% të mjeteve për ekonomi bujqësore, ndërsa ekonomitë e përziera edhe më pak, vetëm 12%, ndërsa 79% të të anketuarve mendonin se janë më të rëndësishme të ardhurat jashtë ekonomisë bujqësore. Përpara, kur pasuria agrare kishte vlerë shumë më të madhe se që ka sot, ishte e kundërta: fshatari shqiptar më tepër investonte në blerjen e tokës, të bagëtisë dhe të pajimeve bujqësore.

---

[1] "Formimi i vendbanimeve rurale të tipit joagrar në Kosovë është dukuri e pasluftës. Para luftës nocioni i rurales e i agrares ka qenë i pandarë në hapësirë e në pikëpamje funksionale. Ato duken në dekadën e fundit të zhvillimit ekonomik e shoqëror të Kosovës. Paraqiten në afërsi të qendrave urbane, sidomos të atyre më të mëdha e më dinamike, pastaj pranë qendrave të rëndësishme administrative, në afërsi të xeheroreve, objekteve industriale, punkteve të rëndësishme hekurudhore e rrugore.
Lokalitetet rurale të këtij varianti (vendbanimet rurale qendrore) kanë njëfarë centraliteti në raport me mikroregjionet e tyre (...), që rrjedh nga pozita e tyre më e volitshme lokale në krahasim me fshatrat përreth, kështu që në to janë të grumbullluara disa servise elementare (administrative, tregtare, shkollore, shëndetësore) (Q. Lleshi, *Qytetet e Kosovës. Studim urbanologjik*, FSHMN, Prishtinë, 1977, f. 107).

Një ndër bartësit kryesorë të lëvizjes territoriale dhe të mobilitetit social, por edhe të shumë ndryshimeve të tjera socialo-kulturore, në fshatin tonë këto 3-4 dhjetëvjetëshat e fundit janë *brezat e reja të shkolluara.* Numri i të shkolluarve, i të gjitha niveleve të arsimit, është rritur sidomos nga fundi i viteve të 60-ta. Sipas regjistrimit të vitit 1981, në vendbanimet rurale me arsim fillor ishin 215.133 veta, me arsim të mesëm 74.828, me arsim të lartë 5.558 dhe me arsim superior 2.877 veta, ndërsa numri i nxënësve në këto vendbanime ishte në shkollat fillore 226.520, në shkollat e mesme 54.688 dhe numri i studentëve në shkolla të larta dhe fakultete ishte 18.568. Sa i përket edhe numrit të të shkolluarve dhe numrit të nxënësve e studentëve midis fshatit dhe qytetit, raportet numerike relative duket se janë ruajtur edhe sot. Masa e njerëzve të shkolluar është bërë faktor shumë i rëndësishëm i ndryshimeve të përgjithshme, por kjo strukturë njëkohësisht ishte dhe mbeti kanal i braktisjes indirekte të fshatit dhe bujqësisë.

3. Problemi i përvetësimit dhe i zgjerimit të inovacioneve në fshat

Me zgjerimin e ndikimit të procesit të industrializimit e të urbanizimit, të komunikacionit, të arsimit, të kulturës etj. bashkësia rurale e Kosovës gjithnjë e më shumë po i përvetëson dhe zbaton risitë materiale dhe shpirtërore. Depërtimi i strukturave dhe i krijesave urbane e kulturore në fshat është shpejtuar këto dhjetëvjetëshat e fundit, edhe pse jo me intensitet të njëjtë në të gjitha fshatrat dhe rajonet rurale. Elementet e kulturës urbane materiale dhe shpirtërore më herët kanë depërtuar në fshatrat rreth qyteteve dhe selive komunale, ndërsa zgjerimi i tyre është intensifikuar dukshëm me migrimin dhe punësimin e fuqisë punëtore fshatare në vendet e Evropës Perëndimore. Zaten, në fshatin me veçori klasike të jetës, risitë vazhdimisht vijnë nga jashtë përmes qytetit dhe strukturës jobujqësore, ndonëse ka iniciativa edhe nga brenda, nga vetë fshatarët, sidomos në sferën materiale.

Hulumtimet ruralo-sociologjike kanë treguar se popullsia rurale më shpejt i përvetëson inovacionet prodhuese apo materiale se sa ato shpirtërore dhe zgjerimi i një risie kalon nëpër disa faza, të cilat zhvillohen në një periudhë relativisht të gjatë kohore: në fazën e parë inovacioni prodhues prezantohet, në të dytën fshatarët vendosin ta përvetësojnë, kurse në fazën e tretë fshatarët atë e fusin në praktikën ekonomike.[2] Edhe popullsia rurale e Kosovës më shpejt i ka përvetësuar risitë materiale. Një numër i madh i

[2] Krh. V. Djurić, "Proizvodne inovacije i naši seljaci", *Sociologija*, br. 1, Beograd, 1974, ff. 92-93.

ekonomive shtëpiake fshatare sot posedon aparate radiotelevizive, pajime bashkëkohore për amvisëri, aparate elektrike, orendi, hidroforë për ujë të pijshëm, motorë e aparate të ndryshëm, ndërsa ende ekzistojnë probleme të mëdha lidhur me pajimin e ekonomive familjare dhe të banesave me instalimet themelore. Mirëpo, kjo nuk është bërë për arsye të rezistencës së fshatarëve ndaj këtyre risive, por për shkak të mungesës së iniciativave të faktorit shoqëror dhe mjeteve financiare. Sipas regjistrimit të vitit 1981 (të dhëna të tjera nuk posedojmë për shkak të mosrealizimit të regjistrimit të vitit 1991 dhe regjistrimit pas luftës për shkaqe tashmë të njohura) nga gjithsej 139.991 banesa për banim të përhershëm në vendbanimet rurale, 11.336 ose 8,0% të banesave ishin pa instalime (ujësjellës, kanalizim dhe rrymë elektrike), 104.208 ose 74,4% të banesave kishin vetëm rrymë elektrike, 167 ose 0,1% vetëm ujësjellës, 14.025 ose 10,0% ujësjellës dhe rrymë elektrike dhe 10.222 ose 7,3% të banesave posedonin ujësjellës, kanalizim dhe dritë elektrike. Vlerësohet se sot sa i përket pajimeve dhe instalimeve themelore gjendja nuk ka ndryshuar shumë.

Këto tri-katër dhjetëvjetëshat e fundit dhe veçanërisht me punësimin e fuqisë punëtore në botën e jashtme, një numër i konsiderueshëm i ekonomive shtëpiake fshatare ka ndërtuar shtëpi të reja dhe objekte ekonomike, me vetëkontribut dhe punë të organizuar vullnetare ka ndërtuar rrugë, ura, ujësjellës dhe ka futur në praktikën e tyre risi prodhuese nga sfera e teknologjisë agrare (traktorët, motorët për ujitje, makinat kositëse, shirëse etj.). Mirëpo, në bujqësinë ku kuantumi i tokës së punueshme është mjaft i kufizuar, ndërsa pronat mjaft të copëzuara, paraqiten probleme të tjera: ky mekanizim (inovacionet bazike) nuk mund të shfrytëzohet në kapacitet të plotë. P.sh. traktorët (15.116 sish sipas regjistrimit të vitit 1981:10.999 dyboshtorë dhe 4.117 njëboshtorë) më pak po përdoren në punët bujqësore e më shumë në transport. Pas luftës nuk kemi të dhëna për numrin e traktorëve dhe teknologjisë tjetër, por dihet se regjimi i Millosheviqit dhe serbët e vendit, pas deportimit të shqiptarëve, vodhën gjithë teknologjinë agrare.

Rezistencë të konsiderueshme në ndryshimet në jetën familjare dhe shoqërore, si dhe në depërtimin e të gjitha formave të risive në rajonin rural ka ushtruar mungesa e rrymës elektrike, ku deri në vitin 1972 ishin të paelektrifikuara rreth gjysma e fshatrave (650), ndërsa elektrifikimi i të gjitha fshatrave të Kosovës u krye nga fundi i viteve të 80-ta, ndonëse edhe më vonë pjesë të fshatrave apo mëhallë të tyre mbetën pa dritë elektrike. Mirëpo edhe në fshatrat më parë të elektrifikuara, rrjeti është vjetruar dhe nuk i përgjigjet nevojave të sotme. Deri vonë faktor i fuqishëm i rezistencës, në grupacionin ruralo-agrar, ishin edhe raportet tradicionalo-patriarkale, me shekuj të rrënjosur, ku baza e jetës ishte bujqësia natyrale. Derisa fshatari

nuk bindet në efektet e një risie, materiale apo shpirtërore, jo vetëm që vështirë e përvetëson, por shpeshherë bie edhe në konflikt me inovacionet e caktuara, gjë që shumë varet nga mënyra e prezantimit dhe intensiteti i zgjerimit të informatës për risitë.

4. Lëvizja dhe përbërja e popullsisë rurale

Ndër ndryshimet më të mëdha demografike në territorin fshatar padyshim është rënia e shkallës së mortalitetit të përgjithshëm: nga rreth 20 promilë në fillim të viteve të 50-ta u zvogëlua në rreth 6 promilë në fillim të viteve të 90-ta të shekullit të kaluar. Kjo rënie është arritur me përmirësimin e kushteve sociale dhe jetësore të popullatës, siç janë ushqimi, banimi, veshmbathja, pastaj zgjerimi i shërbimeve shëndetësore e sanitare, ngritja e vetëdijes për ruajtjen e shëndetit, për shërim dhe lindje në bërthamat shëndetësore dhe për vlerësimin e drejtë të jetës në përgjithësi. Mirëpo, shkalla e mortalitetit të foshnjave, megjithë zvogëlimin e madh (menjëherë pas Luftës II Botërore arrinte deri 180 promilë) mbeti ende mjaft e lartë (në fillim të viteve të 90-ta sillej rreth 50 promilë), ku dominonin shkaqet ekzogjene të vdekjes, sikurse janë përfshirja jo e mjaftueshme e lindjeve në entet shëndetësore, kushtet jo të volitshme socialo-materiale të jetës te një pjesë e popullatës rurale etj. Gjendja shëndetësore e popullit ishte keqësuar edhe më tepër pas përjashtimit të shqiptarëve nga institucionet e shëndetësisë publike në vitin 1990 e më vonë. Meqenëse në vështrimin e situatës socialo-demografike të një popullate niveli i mortalitetit të foshnjave merret se indikator shumë i rëndësishëm i shkallës së zhvillimit socialo-ekonomik dhe higjieniko-medicinal, në popullsinë e Kosovës dhe në pjesën rurale të saj vlerësohet si ende shumë i lartë dhe paraqet problem të veçantë social, shëndetësor dhe human. Njëkohësisht, mortaliteti i lartë i foshnjave gjithnjë ishte edhe faktor që kushtëzonte nivelin e lartë të natalitetit. Në fillim të viteve të 90-ta përqindja e të shëruarve para vdekjes arrinte vetëm deri 70%, ndërsa një e treta e lindjeve realizohej jashtë organizatave shëndetësore dhe pa ndihmë profesionale. Pas ndjekjes së punëtorëve shëndetësorë të kombësisë shqiptare nga spitalet, nga klinikat e ambulancat shumë sëmundje infektive ishin zgjeruar e shtuar, veçanërisht te shtresat e varfra dhe atë si në vendbanimet rurale, ashtu edhe në ato urbane.

Pas rënies së mortalitetit të përgjithshëm dhe ruajtjes së nivelit ende të lartë të natalitetit në bashkësinë rurale (më 1971 39,0 dhe më 1981 33,9 promilë), shtimi natyror mbeti shumë i lartë (më 1971 30,3 dhe më 1981 27,7 promilë), ndërsa shtimi i përgjithshëm i popullsisë së saj u rrit prej 689.310 në vitin 1953 në 1.069.685 në vitin 1981 ose përreth 55%. Një nga problemet më

të mëdha nga fillimi i viteve të 70-ta të shekullit XX në fshatin shqiptar ishte padyshim emigrimi i popullsisë përtej kufirit shtetëror dhe rritja e shkallës së selektivitetit të tij sipas karakteristikave biologjike, ku shpërnguleshin kryesisht të rinjtë dhe meshkujt. Meqenëse proceset demografike, për nga karakteri i tyre, janë afatgjate, duket sikur nuk u shfaqën probleme në jetën demografike dhe socialo-ekonomike të popullatës. Mirëpo, pikërisht për shkak të tendencës afatgjate të këtyre rrjedhave, në një të ardhme jo fort të largët nga ky proces migrues do të dalin efekte të pavolitshme në nivelin e natalitetit, të fertilitetit e të shtimit natyror, pastaj në martesa, në strukturat bazë demografike, në vëllimin e fuqisë punëtore etj.

Karakteristikë e veçantë e zhvillimit demografik të Kosovës dhe të shqiptarëve është struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Specificiteti i këtyre strukturave biologjike është rezultat i zhvillimit të popullsisë për një kohë të gjatë, ndërsa nga kjo veçanti dalin edhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin e popullsisë. Siç dihet, Kosova është territor me popullatë shumë të re, ku përqindja e popullsisë së saj deri në moshën 19-vjeçare në gjithë gjysmën e dytë të shekullit XX ishte rreth 50%, ndërsa në territorin rural të saj madje edhe mbi 50%, që mund të cilësohet si dukuri e veçantë edhe në përmasa botërore. Edhe popullsia urbane e Kosovës, për shkak të shkallëve të larta vitale, në një anë, dhe imigrimit intensiv të popullsisë nga fshati këto dhjetëvjetëshat e fundit, gjithashtu ka popullsi të re, ku grup-mosha deri 19-vjeçare në vitin 1981 përbënte rreth 41%.

Popullsia rurale e Kosovës, që përbën rreth 65% të popullsisë së gjithmbarshme të saj, i përket tipit progresiv të strukturës së popullsisë sipas moshës, ku mosha mesatare sot sillet 25-26 vjet, ndërsa përqindja e popullsisë 60 e më tepër vjet është 6-7%. Kjo strukturë e re e popullsisë është rezultat i shkallës së lartë të natalitetit dhe i shtimit natyror. Me gjithë eksodin masiv të të rinjve shqiptarë, si popullsia rurale, ashtu edhe popullsia e përgjithshme e Kosovës ende ruajnë biodinamikën e tyre, meqenëse riprodhohen në suaza normale. Prandaj, struktura e popullsisë së Kosovës dhe e territorit të saj fshatar sipas moshës është e re dhe natyrisht shtron efekte të shumëfishta në rrafshin demografik dhe në jetën shoqëroro-ekonomike. Në Kosovë dhe në territoret e tjera etnike shqiptare, sa i përket përbërjes së popullsisë sipas gjinisë, dominojnë meshkujt. Në Kosovë, p.sh në vitin 1981, në 100 femra vinin 104,4 meshkuj, ndërsa në rajonin fshatar të saj 108,3 meshkuj (rajoni urban 102,7). Sipas këtij regjistrimi, në Kosovë u evidencuan 52.344 meshkuj më tepër dhe prej tyre 43.065 ose 82,5% i përkisnin territorit rural.[3]

[3] *Regjistrimi i popullsisë, ekonomive shtëpiake dhe i banesave në vitin 1981, Buletini 17*, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1982, f. 11.

Sipas hulumtimeve tona shumëvjeçare demografike, duke vështruar edhe rrethanat etnografike, "shkaqet e këtij debalansi në strukturën e popullsisë sipas gjinisë, që nuk është karakteristikë vetëm për Kosovën, por për të gjitha territoret dhe popullatat e pazhvilluara, qëndrojnë kryesisht në moszhvillimin social të trevës së caktuar dhe në botëkuptimet tradicionale. *Së pari*, te popullsia fshatare shqiptare nga dashuria e madhe që kanë prindërit për fëmijët e gjinisë mashkullore, u kushtojnë kujdes më të madh atyre, kurse i lënë pas dore fëmijët e gjinisë femërore, të cilët për këtë arsye edhe vdesin më tepër, shpeshherë, në pikëpamje fiziologjike, të shëndoshë (mortaliteti ekzogjen); fëmijët e kësaj gjinie kurrë nuk janë konsideruar "shtyllë" e shtëpisë, por vetëm "derë e huaj". Vlerësimi i tillë i fëmijëve të gjinisë mashkullore rezulton nga e kaluara dhe kjo traditë në fshat është ruajtur, mund të thuhet deri sot, ndërsa arsyet kryesore, si duket, janë të natyrës ekonomike dhe sociale: viset ku jetojnë shqiptarët me shekuj ishin kryesisht bujqësore dhe blegtorale, ku si fuqi potenciale punëtore është llogaritur mashkulli, meqenëse ai qysh herët është inkuadruar në procesin e punës në ekonominë autarkike dhe ekstensive. *Së dyti*, teprica e meshkujve pothuajse në të gjitha grup-moshat dhe veçanërisht në periudhën e riprodhimit biosocial është pasojë e mortalitetit më të madh te femrat në periudhën fertile (15-49 vjet); p.sh. në periudhën më efektive të riprodhimit (20-34 vjet) në territorin fshatar të Kosovës në vitin 1981 në 100 meshkuj vinin 87,6 femra. *Së treti*, raportin jobalancues duhet kërkuar edhe në mosparaqitjen e fëmijëve të lindur të gjallë të gjinisë femërore (por shpeshherë edhe të gjinisë mashkullore, sidomos përpara) në shërbimet përkatëse, gjë që prapë lidhet me moskujdesin e prindërve ndaj fëmijëve të kësaj gjinie".[4] Për raportin e krijuar në strukturën gjinore pas viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, kur eksodi selektiv i të rinjve në botën e jashtme mori përmasa të gjera, nuk kemi të dhëna. Mirëpo, gjykuar sipas faktit se shpërngulja përfshiu kryesisht meshkujt e rinj, të moshës midis 18 e 28 vjet, mund të konstatohet se për herë të parë në historinë e popullatës sonë dominojnë femrat dhe atë femrat e moshës më efektive fertile. Prandaj, në perspektivë mund të priten edhe probleme të ndryshme të natyrës demografike dhe sociale-ekonomike. Nivel të lartë të ruralitetit në Kosovë kanë shqiptarët, ndërsa të gjitha bashkësitë e tjera kombëtare kanë shkallë më të lartë të urbanizimit. Në vitin 1961, nga numri i përgjithshëm i shqiptarëve, 83.3% (Kosova 80,3%) të tyre jetonin në fshat, ndërsa në vitin 1981 kjo përqindje zvogëlohet në 71,1% (mesatarja kosovare 67,6%). Ndryshime më të mëdha vërehen te serbët (79,7%:62,9%), malazezët (63,7%:30,0%) dhe turqit (44,9%:26,0%).

---

[4] H. Islami, *Fshati i Kosovës (Kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural)*, Rilindja, Prishtinë, 1985, ff. 139-140.

Tabela 1. Përbërja kombëtare e vendbanimeve rurale të Kosovës në periudhën 1961-1981[5]

Kombësia	1961	1971	1981
Shqiptarë	538.342 69,7	701.308 77,1	871.589 81,4
Serbë	18.739 23,4	158.303 17,4	131.636 12,3
Malazezë	23.928 3,1	13.873 1,5	8.096 0,7
Myslimanë	- -	17.837 1,9	37,406 3,4
Turq	11.564 1,4	4.234 0,4	3.246 0,3
Romë	- -	3.558 0,3	7.669 0,7
Të tjerë	16.965 2,1	9.561 1,0	10.043 0,9
Gjithsej	771.558 100,0	908.674 100,0	1.069.685 100,0

5. Çështje të urbanizimit dhe të standardit të vendbanimeve rurale

5.1. Procesi i urbanizimit dhe tendencat e zgjerimit të strukturave urbane infrastrukturore

Urbanizimi assesi nuk mund të kufizohet vetëm në rritjen e numrit të popullsisë së qyteteve, por ai është një proces kompleks, i cili, përveç rritjes demografike të qyteteve, para së gjithash nga komponenti imigrues, nënkupton edhe transformimin e përbërjes sociale-ekonomike të popullsisë dhe të mënyrës së jetesës në përgjithësi. Ndikimi i urbanizimit si i tillë nuk mund të reduktohet vetëm në transformimin e jetës, të punës dhe zhvillimit të të gjitha shërbimeve shoqërore-ekonomike të qytetit, por ai shtrihet edhe në rrethinën e ngushtë apo të gjerë (suburbanizimi), varësisht nga intensiteti i transformimit para së gjithash funksional të qendrave urbane.

Veçoritë fiziko-gjeografike, trashëgimia specifike shoqërore-historike dhe moszhvillimi ekonomik, veçanërisht mungesa e industrializimit, depërtimi i vonë i elementeve të ekonomisë kapitaliste etj. kushtëzuan tipa karakteristike të

[5] Burimi: Regjistrimet e popullsisë 1961-1981; H. Islami, *Fshati i Kosovës*, f. 178.

popullimit (të numrit, të rrjetit dhe të funksioneve të vendbanimeve) dhe të urbanizimit në Kosovë. Pas Luftës II Botërore Kosova trashëgoi një nivel shumë të ulët të urbanizimit, pa marrë parasysh se si ai kuptohet, qoftë si pjesëmarrje e popullsisë së qytetit në popullsinë e përgjithshme dhe rritjen e tij, qoftë si proces i transformimit të të gjitha determinanteve të mënyrës së jetesës. Ky proces territorialisht ishte mjaft i kufizuar dhe, siç do të shohim, i rrudhur vetëm në shtatë qendra urbane (Prishtina, Peja, Prizreni, Gjakova, Mitrovica, Gjilani dhe Ferizaji) dhe disa bërthama të tjera të karakterit urban. Mirëpo, zhvillimi i përgjithshëm shoqëror-ekonomik i Kosovës dhe lëvizjet demografike, veçanërisht pas viteve të 70-ta të shekullit të kaluar inicuan procese të reja në strukturën e popullimit dhe në rrjedhat e urbanizimit. Në anën tjetër, me zhvillimin e sistemit komunal, u zhvillua ekonomia lokale dhe u zgjeruan shërbimet shoqërore-ekonomike dhe vendbanimet e përmendura u bënë qendra të rëndësishme të koncentrimit të potencialit prodhues dhe të funksioneve shoqërore e politike. Por edhe selitë e tjera komunale dhe qendrat e vogla industriale morën një numër të konsiderueshëm funksionesh shoqërore, ekonomike, arsimore, administrative dhe politike. Kështu u zgjerua rrjeti urban i Kosovës nga qendrat rajonale edhe në qendrat urbane nënrajonale dhe lokale.[6]

Industrializimi dhe urbanizmi e zgjerimi hapësinor i tyre përcillen nga procesi i deagrarizimit dhe i transformimit socialo-profesional të vendbanimeve të tjera. Krijohet një tip i veçantë i vendbanimeve, të cilat për nga funksioni (përqindja e popullsisë jobujqësore, mënyra e jetës etj.) dhe numri i popullsisë njihen, siç theksuam edhe më parë, si *vendbanime të përziera*, të cilat posedojnë edhe karakteristika fshatare e edhe urbane. Këto rrjedha dhe ndikime të urbanizmit përmes punësimit në sektorin shoqëror dhe migrimeve (migrantët ditorë etj.), nuk i lënë anash as vendbanimet fshatare, të cilat – me gjithë veçoritë specifike të jetës shoqërore dhe ngecjes në zhvillim, sidomos në disa territore të Kosovës, gjithnjë po transformohen si sa i përket sistemeve infrastrukturore (elektrifikimi, rrugët, diku edhe ujësjellësi etj.) dhe institucioneve shoqërore-ekonomike (shkolla, zyra e vendit apo e bashkësisë lokale, biblioteka, tregtia etj.), ashtu edhe në pikëpamje të determinantave të tjera të mënyrës së jetesës (banimi, ushqimi, veshmbathja) dhe të zgjerimit të shumë risive në lëmin e prodhimtarisë bujqësore (mekanizmi, kimizimi, llojet e tjera të kulturave agrare dhe të kafshëve etj.). Fshatrat që posedojnë këto apo disa nga këto shërbime dhe institucione luajnë rolin e vendbanimeve fshatare me funksione qendrore.[7]

---

[6] Shih më gjerë: Q. Lleshi, *Qytetet e Kosovës. Studim urbanologjik*, FSHMN, Prishtinë, 1977.

[7] "Formimi i vendbanimeve rurale të tipit joagrar në Kosovë është dukuri e pasluftës. Para luftës nocioni i rurales e i agrares ka qenë i pandarë në hapësirë e në pikëpamje

Transformimi social dhe profesional përmes punësimit në veprimtari jobujqësore, rritjes së numrit të ekonomive familjare me burime të përziera dhe jobujqësore të të ardhurave dhe zgjerimit të strukturave e krijesave të tjera urbane në këto vitet e fundit të zhvillimit të gjithmbarshëm të Kosovës ndikoi që në fshat të rritet numri i strukturave dhe i kategorive të reja socialo-profesionale. U thye përputhshmëria e plotë e dikurshme e popullsisë rurale me popullsinë agrare: menjëherë pas Luftës II Botërore raporti ishte rreth 90,0% ndaj rreth 80,0%, ndërsa në vitin 1981 në dy këto struktura të moszhvillimit zvogëlohen dhe diferenca midis tyre shtohet: rreth 68,0% të popullsisë fshatare ndaj rreth 25,0% të popullsisë bujqësore (u maur vesh me ndryshimin e definicionit të popullsisë bujqësore). Të dhënat dëshmojnë se krahas rritjes së vazhdueshme të numrit të përgjithshëm të popullsisë jobujqësore në Kosovë është rritur fuqishëm edhe numri i kësaj popullsie në vendbanimet jashtë qyteteve, pra në vendbanimet e karakterit rural (tabela 2).

Tabela 2. Popullsia e përgjithshme jobujqësore e urbane dhe popullsia jobujqësore jashtë vendbanimeve urbane në Kosovë në periudhën 1953-1981, sipas regjistrimeve të popullsisë

Viti	Popullsia e përgjithshme				Popullsia jobujqësore jashtë vendbanimeve urbane		
	Jobujqësore	Urbane	Numri	%	Rritja në mes regjistrimeve		
					Periudha	Numri	%
1953	225.908	127.598	98.310	43,5	1953-61	54.868	55,8
1961	345.608	192.430	153.178	44,3	1961-71	114.867	74,9
1971	603.064	335.019	268.045	44,4	1971-81	417.068	155,5
1981	1.204.410	506.297	685.114	57,9	1953-81	586.804	596,8

Vetëm pas vitit 1980 popullata bujqësore e Kosovës gëzon mbrojtjen e plotë shëndetësore, ndërsa deri atëherë këtë e ka realizuar vetëm pjesërisht. Pas rrënimit të autonomitetit të Kosovës me mjete të dhunës nga regjimi serb në vitin 1989 ndërpritet edhe kjo mbrojtje.

funksionale. Ato duken në dekadën e fundit të zhvillimit ekonomik e shoqëror të Kosovës. Paraqiten në afërsi të qendrave urbane, sidomos të atyre më të mëdha e më dinamike, pastaj pranë qendrave të rëndësishme administrative, në afërsi të xeheroreve, objekteve industriale, punkteve të rëndësishme hekurudhore e rrugore.
Lokalitetet rurale të këtij varianti (vendbanimet rurale qendrore) kanë njëfarë centraliteti në raport me mikroregjionet e tyre (…) që rrjedh nga pozita e tyre më e volitshme lokale në krahasim me fshatrat përreth kështu që në to janë të grumbulluara disa servise elementare (administrative, tregtare, shkollore, shëndetësore). (Q. Lleshi, *Po aty*, f. 107).

Mirëpo, proceset e reja të zhvillimit shoqëroro-urban nuk i përfshinë të gjitha fshatrat dhe tërë popullsinë fshatare me dinamikë dhe intensitet të njëjtë. Një numër i madh i fshatrave dhe i popullsisë në to deri vonë karakterizohej me shumë veçori të jetës tradicionale agrare, të cilat nxjerrin krye edhe sot në shumë fshatra në procesin e zhvillimit të tyre të përgjithshëm shoqëror. Në fshatra të cilat kanë pozitë periferike gjeografike dhe shtrihen në rajonet malore, të izoluara në pikëpamje komunikative dhe pa dritë elektrike deri vonë në shekullin e kaluar, grupet dhe organizimet primare shoqërore (familja, martesa, raportet farefisnore e fqinjësore etj.) ende i ruajnë karakteristikat tipike për shoqërinë me mënyrë të ekonomizimit ekstensiv autarkik agrar. Problem i hapur jo vetëm për popullsinë rurale, por edhe për fshatarët-bujq dhe gjithë popullatën shqiptare të Kosovës mbetet ende çështja se kur do t'i gëzojnë të drejtat në sigurimin personal dhe invalidor etj.

Krahas ndryshimeve në bazë ekonomiko-sociale të fshatit u zgjeruan edhe një varg objektesh infrastrukturale dhe institucione të tjera të standardit shoqëror shumë të rëndësishme për transformimin e përgjithshëm të jetës në fshat. U ngritën shumë shkolla fillore, u bë elektrifikimi gati i tërësishëm i fshatrave (edhe pse në shumë sish vetëm pas tri dekadash), shumë fshatra u lidhën me rrugë me qytetin apo qendrën e tyre komunale, u ndërtuan shumë ura, madje edhe ujësjellës në disa fshatra me vetëkontributin e vetë fshatrave, në fshatra më të mëdha u ngritën ambulanca, shitore të vogla, seli të bashkësive lokale etj.; kohëve të fundit, veçanërisht me shkuarjen e fuqisë punëtore në punë të përkohshme në botën e jashtme është rritur mjaft edhe numri i automobilave në fshat. Mirëpo, në anën tjetër, ekziston një numër i madh i fshatrave që nuk posedojnë objekte dhe sisteme elementare jetësore dhe shoqërore, siç janë rrugët, shërbimet shëndetësore, kulturore, nuk kanë madje as shitore me artikuj të konsumit të përditshëm. Mungesa e këtyre objekteve infrastrukturore dhe urbane, sistemi i vjetruar i elektrifikimit, sidomos në fshatrat e shkapërderdhura të territoreve malore deri vonë të izoluara në pikëpamje gjeografike dhe sociale, veçanërisht në stinën e dimrit i lë të izoluar nga jeta dhe rrjedhat e përgjithshme të zhvillimit shoqëror. Në anën tjetër, për shkak të dispersitetit të theksuar të vendbanimeve fshatare është joracionale, e diku edhe e pamundur që të mbulohet çdo fshat me institucionet dhe elementet e përmendura infrastrukturore.

Elektrifikimi është padyshim njëri ndër faktorët shumë të rëndësishëm që sjell ndryshime të mëdha në jetën familjare dhe shoqërore në përgjithësi në fshat. Elektrifikimi ndali popullatën të mbetet në fshat e bujqësi dhe e ndihmoi dhe shpejtoi depërtimin e risive materiale dhe shpirtërore në ekonomitë familjare dhe në fshat. Edhe në Kosovë pas Luftës II Botërore, në

kuadër të masave të shumta në transformimin e jetës, u bënë përpjekje të mëdha për elektrifikimin e fshatit. Mirëpo, përkundër kësaj, pjesa dërmuese e fshatrave deri vonë mbeti pa dritë elektrike, ndërsa disa fshatra (dhjetëra sish) mbetën pa të deri në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar. U elektrifikuan shumë vonë disa fshatra të rajoneve malore, larg qyteteve dhe centraleve elektrike.

Dinamika e elektrifikimit të fshatit kosovar në gjysmën e dytë të shekullit XX dukej kështu: në vitin 1951 vetëm 2.000 ekonomi familjare ose 2% të tyre, në fillim të vitit 1983 ishin të paelektrifikuara 83 fshatra ose 2% e tyre kishin dritë elektrike. Sipas të dhënave të regjistrimit të bujqësisë në vitin 1960 p.sh. gjithsej 103.000 ekonomi familjare bujqësore, vetëm 13.000 ose 12,6 % të tyre kishin rrymë elektrike, ndërsa në vitin 1969, sipas regjistrimit të dytë të bujqësisë, ndonëse gjendja ishte përmirësuar dukshëm, megjithatë prej 111.000 ekonomive shtëpiake bujqësore vetëm 52.000 ose 46.8 % të tyre u elektrifikuan.[8] Në vitin 1965 pa dritë elektrike ishin më se 1.000 fshatra ose 70% të tyre,[9] në vitin 1972 rreth 650 fshatra ose 45% të tyre,[10] në vitin 1979 249 fshatra ose 18% të tyre,[11] në fund të vitit 1981 mbetën pa dritë elektrike edhe 165 fshatra ose 12% të tyre, në fillim të vitit 1983 ishin të paelektrifikuara 83 fshatra ose 6% të tyre të shtrira në territorin e 7 komunave (Mitrovica, Peja (Rugova) 13, Kaçaniku 8, Gjilani 4, Ferizaji 4, Vushtria 2 dhe Dardana 1.[12] Përfundimisht me vitin 1983 u elektrifikuan 13 fshatrat e Rugovës dhe 25 fshatra të komunës së Mitrovicës.[13] Ndërsa rreth 45 fshatra të komunave të përmendura hynë në vitin 1984 pa dritë elektrike. Dita kur u krye elektrifikimi i Rugovës, katër dekada pas ngadhënjimit të socializmit, i cili përparimin e tij e mate me tempon e industrializimit dhe elektrifikimit, u quajt "Ditë e dritës".[14]

Efektet pozitive të elektrifikimit, me gjithë vonesën e madhe, ishin të konsiderueshme para së gjithash në ndaljen e procesit të braktisjes se fshatit, të shpopullimit e të shuarjes së jetës dhe rrjedhimisht të zhvillimit të

---

[8] *Indeks Saveznog zavoda za statistiku*, br.8; *Radni dokument Saveznog zavoda za statistiku*, br.31. *Prvi rezultati popisa poljoprivrednih gazdinstava* 1969, f. 16.

[9] *Konferenca IX Krahinore e LKS për Kosovën e Metohi,* Prishtinë 1965; Revista K*osova, 11,* Instituti i Historisë, Prishtinë, 1982, ff 183-185.

[10] *Regionalni prostorni plan SAP Kosovo, Faza B – predkoncept,* Zavod za urbanizam i projektovanje, Priština, 1972, f. 34.

[11] "Edhe 249 fshatra të paelektrifikuara", *Gazeta e delegatëve*, nr. 57, Prishtinë, 28 dhjetor 1977, f. 9.

[12] "Ekzistojnë mundësi reale për kryerjen e elektrifikimit të fshatrave deri në fund të vitit 1983". *Gazeta e delegatëve*, nr. 173, Prishtinë, 5 mars 1983, f. 6.

[13] *Rilindja*, 1. XII. 1983.

[14] *Rilindja*, 7. XI. 1983.

bujqësisë e të blegtorisë. Organet komunale dhe fshatarët duhet të bëjnë përpjekje që rrjeti i vjetruar i elektrifikimit të zëvendësohet, meqenëse nevojat janë shtuar shumë për ekonomitë shtëpiake. Ndonëse pjesa më e madhe e fshatrave vonë të elektrifikuara dhe me rrjet të vjetruar shtrihen në terrene të papërshtatshme malore dhe i përkasin të shumtën tipit të shpërndarë, megjithatë vonesa kaq e madhe në elektrifikimin e tyre nuk mund të arsyetohej me asgjë, aq më tepër kur numri më i madh i këtyre fshatrave gjendej në komunat më të zhvilluara (Mitrovica dhe Prishtina, në të cilën deri në vitin 1975 19 fshatra nuk kishin dritë elektrike).[15] Nuk ishin gjithmonë problem mjetet, por mungonte iniciativa e faktorëve lokalë shoqërorë (komunave), sepse një pjesë të mirë të mjeteve dhe të punës fizike në fshatrat ku është kryer elektrifikimi gjithnjë e kanë siguruar vetë fshatarët.

Rruga, qoftë vijë hekurudhore, automobilistike apo e llojit tjetër është faktor shumë i rëndësishëm në transformimin e jetës në fshat, në stimulimin e zhvillimit të bujqësisë, si dhe të zhvillimit të qyteteve si organizma të ndërlikuara dhe dinamike. Territori i Kosovës shumë kohë nuk ishte i mbuluar me rrjetin e rrugëve. Vija e parë hekurudhore Selanik-Shkup-Mitrovicë, e ndërtuar para një shekulli (1874), ka kaluar vetëm nëpër një pjesë të Kosovës. Në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar ndërtohet hekurudha Fushë-Kosovë-Pejë (1936), Prishtinë-Kurshumli nis atëherë dhe kryhet pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1948, ndërsa edhe vija hekurudhore Prishtinë-Pejë do të vazhdohet përmes Klinës deri në Prizren dhe do të përfundojë në vitin 1963. Kosova deri në vitin 1988 kishte rreth 333 km hekurudhë, por hekurudhat kosovare kanë mbetur të pamodernizuara.[16]

Pas luftës ndërtohen një varg rrugësh automobilistike të rendeve të ndryshme dhe kohëve të fundit shumë prej tyre asfaltohen dhe i lidhin të gjitha qendrat komunale dhe shumë rajone fshatare. Në fund të viteve të 80-ta të shekullit XX Kosova kishte rreth 5.000 km rrugë automobilistike rendesh të ndryshme: 1950 km (39,0%) ishin rrugë moderne, 1.675 km (33,5%) rrugë me gur të thyer dhe 1.372 km (27,4%) rrugë dheu.[17] Pas luftës rrjeti rrugor është zgjeruar. Një numër i madh i fshatrave graviton nga këto rrugë dhe lidhen me to, por një numër shumë më i madh i tyre gjendet larg rrugëve. Kohëve të fundit janë duke u bërë përpjekje të mëdha në ndërtimin e shumë rrugëve lokale, deri në rrugë kryesore automobilistike e hekurudhore ose deri në qendrat komunale, ku qarkullimi dhe jeta po

[15] *Rilindja*, 27. VIII. 1975.
[16] Grup autorësh, *Gjeografia e Kosovës,* Enti i Teksteve, Prishtinë, 1995, ff. 129-130.
[17] Grup autorësh, *Gjeografia e Kosovës*, f. 130.

lehtësohen dukshëm. Në këto iniciativa dhe aksione rol të rëndësishëm po luajnë vetë fshatrat me vetëkontributet e tyre. Fshatrat afër qyteteve dhe të lidhura mirë me to kanë kontakte të shumta me jetën urbane, të cilën e bartin edhe në familje dhe në fshat. Në anën tjetër, përmes shitjes së prodhimeve të tyre bujqësore e blegtorale dhe blerjes së prodhimeve industriale, ato lidhen mirë me treg dhe në këtë mënyrë po dalin nga suazat e jetës natyrale dhe po stimulohet zhvillimi i bujqësisë e i blegtorisë; po lehtësohet lëvizja ditore e fuqisë punëtore, shkollimi i fëmijëve fshatarë në shkolla të mesme dhe fakultete etj. Gjithashtu po mundësohet pa pengesë qarkullimi i automobilave, numri i të cilëve gjithnjë po rritej edhe në fshat.[18] Ndërtimi i rrugëve po kushtëzon edhe ngritjen e shitoreve me artikuj të konsumit të përditshëm, të ambulancave, të postave etj.

Mirëpo, shumë fshatra që shtrihen në terrene kodrinore-malore dhe të shumtën të tipit të shpërndarë ende janë të lidhura dobët ose fare të palidhura me rrugë. Fshatrat e izoluara dhe larg qyteteve e qendrave komunale jo vetëm që i kanë kontaktet më të rralla me qytetin, por ato janë të vështira, veçanërisht në kohën e dimrit. Mungesa e rrugëve dhe e objekteve dhe e institucioneve të tjera kyçe jetësore e shoqërore në këto fshatra janë faktor i rëndësishëm i nxitjes së largimit nga ekonomia bujqësore dhe braktisja definitive e fshatit. Mbetet që të bëhen përpjekje të mëdha për t'i mbuluar të gjitha fshatrat me rrjetin e rrugëve edhe pse diku objektivisht, për shumë arsye, është e pamundur të lidhet çdo fshat me rrugë, si dhe të mbulohet me objekte dhe elemente të tjera të standardit shoqëror, sepse vetëm në këtë mënyrë do të pengohet shpopullimi, do të stimulohet zhvillimi i bujqësisë dhe i blegtorisë në një anë, dhe do të zbuten problemet e shumënduarshme të qyteteve si pasojë e imigrimeve të shumta nga fshati, në anën tjetër.

5.2. Shkolla fillore dhe efektet e saj në fshat

Ndonëse shkolla fillore ka rëndësi primare për arsimin dhe edukimin e brezave të reja, por edhe për tërë popullsinë fshatare, megjithatë kombësia shqiptare në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi përgjithësisht shkollat e para në gjuhën shqipe i fiton vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XX, në kuadër të përpjekjeve për të siguruar funksionimin e shkollimit të obligueshëm fillor u hapën shumë shkolla fillore, ku u përfshinë shumë nxënës në to. Deri në

[18] Në vitin 1981 në sektorin e pronësisë individuale në Kosovë kishte 47.544 automobila ose në 1.000 banorë vinin 30 automobila *(Kosova përmes shifrave 1982*, Prishtinë, 1983, f. 101).

vitin shkollor 1938/39 në Kosovë funksiononin gjithsej 258 shkolla fillore, por asnjë në gjuhën shqipe, ndërsa në vitin shkollor 1981/82 ky numër rritet në 908 shkolla të tilla me 326.041 nxënës. Prej tyre 771 shkolla fillore me 8.830 paralele dhe 271.867 nxënës ishin me mësim në gjuhën shqipe, 339 shkolla me 2.057 paralele dhe 50.677 nxënës me mësim në gjuhën serbokroate dhe 10 shkolla fillore me 74 paralele dhe 1.582 nxënës me mësim në gjuhën turke; do të thotë se 112 shkolla fillore në Kosovë ishin me mësim të përzier.[19]

Roli i shkollës fillore, në shumë fshatra si institucion i vetëm ka qenë dhe ka mbetur shumë i madh. Shkolla fillore është institucioni më i rëndësishëm shoqëror dhe kulturor në fshat. Shkolla fillore këtu nuk ofron vetëm mundësitë e fitimit të bazave të shkrim-leximit dhe të arsimit e të edukimit publik, por është edhe vatër e shumë institucioneve dhe inovacioneve në fshat. Ky institucion, së bashku me institucionet tjera, është faktor qenësor i integrimit të bashkësisë fshatare në rrjedhat e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror.[20]

Në pjesën mbi strukturën arsimore të popullsisë fshatare pamë se sa është zvogëluar analfabetizmi te të rinjtë; në moshën 10-19 vjet në fshat ishin 4,0% analfabetë (Kosova 2,5%). Prindërit sot në themel i kanë ndryshuar qëndrimet ndaj shkollës fillore dhe ndjekjes së saj nga fëmijët e tyre. Më jo vetëm që nuk ka rezistencë ose janë raste të rralla të kësaj dukurie, por të gjithë fshatarët, atje ku deri vonë nuk kishte ose ku edhe sot nuk ka shkolla të plota fillore, kërkojnë nga faktorët shoqërorë hapjen e tyre. Shkolla fillore dhe shkollimi në përgjithësi në fshat sot është përqafuar si mjet për transformimin e mënyrës së jetesës dhe të pikëpamjeve mbi botën dhe jetën. Në saje të numrit gjithnjë më të madh të atyre që dinë shkrim-lexim nga radhët e të rriturve dhe të depërtimit të njohurive të reja të ditës e

---

[19] *Kosova përmes shifrave 1982,* EKS, Prishtinë, 1983, ff. 67-79. Është interesant se nga numri i përgjithshëm i nxënësve (31.731) të cilët e kishin kryer shkollën e plotë fillore në Kosovë në vitin shkollor 1981/82, shkollën e mesme drejtpërdrejt nuk e kishin vijuar të gjithë, por vetëm një numër i caktuar, i cili mjerisht gjithnjë ishte duke u zvogëluar: në vitin shkollor 1977/78 85,1% shkollat e mesme i vijonin 85,1%, ndërsa në vitin shkollor 1981/82 vetëm 67,3% të nxënësve.
Në territoret e tjera të ish-Jugosllavi gjendja e këtij vijimi në vitet shkollore 1977/78 ndaj 1981/82 ishte kështu: Jugosllavia 90,4%: 86,4%, Sllovenia 95,9%: 102,9% (rritje për arsye se një numër shkollën fillore e ka kryer në territoret jashtë Sllovenisë, ndërsa shkollën e mesme e ka vazhduar në Sllloveni), Vojvodina 95,1%: 93,9%, Kroacia 92,2%: 92,8%, Serbia 94,3%: 87,0%, BeH 85,6%: 82,2%, Mali i Zi 83,5%: 87,1% dhe Maqedonia 97,7%: 82,3% (*Statistički kalendar Jugoslavije 1983,* f. 35).

[20] Më gjerë: S. Šuvar, "Osnovna škola i njeni učinci u selu", në librin e tij *Između zaseoka i megalopolisa*, 1, Zagreb, 1973, ff. 47-57; M. Župančić, "Kulturne institucije u seoskoj sredini", *Sociologija sela*, br. 71/72, Zagreb, 1981, ff. 43-54.

të arsimit të përgjithshëm (radio, televizioni shtypi etj.), fëmijët e fshatit edhe para se të hynë në bankat shkollore disponojnë një fond të caktuar të njohurive të ndryshme, të cilat përpara merreshin vetëm përmes traditës gojore dhe përcjelljes brez pas brezi. Depërtimi i shkrim-leximit dhe i arsimit të përgjithshëm përmes shkollës fillore dhe formave të tjera kushtëzoi edhe depërtimin e librit, të gazetave, krijesave të tjera kulturore në fshat; shkolla fillore u bë vatër e jetës kulturore, zbavitëse, sportive etj. Kohëve të fundit këtë jetë po e begaton edhe veprimi i shoqërive amatore kulturo-artistike në disa fshatra më të mëdha të Kosovës.

Në një fazë të zhvillimit, mungesa e shkollës fillore dhe e elementeve të tjera infrastrukturale dhe shoqërore në shumë fshatra kushtëzoi braktisjen e tyre, mirëpo, në anën tjetër, shkollimi i fëmijëve të shumtën kushtëzoi largimin indirekt jo vetëm nga bujqësia, por edhe nga fshati duke kaluar në veprimtari jobujqësore dhe në qytet. Kjo është dukuri e përgjithshme për shumë vende të tjera të botës.

6. Zgjerimi i risive materiale dhe shpirtërore në fshat dhe në bujqësi

Nën ndikimin e industrializimit, të urbanizimit, të komunikacionit, të arsimit etj. në territoret fshatare të Kosovës gjithnjë e më shumë po zgjerohen, përvetësohen dhe zbatohen inovacionet materiale dhe shpirtërore. Depërtimi i strukturave, i krijesave bashkëkohore urbane dhe i proceseve kulturore në fshat është shpejtuar sidomos këto dekadat e fundit. Efekte të dukshme në këtë drejtim kanë mundësuar punësimi i fuqisë punëtore në Kosovë, më tepër në qendrat e afërme urbane dhe industriale, pastaj në viset e tjera të ish-Jugosllavisë dhe veçanërisht në punë të përkohshme në botën e jashtme. Punësimi në sektorët joagrarë të veprimtarisë dhe shkollimi i të rinjve në fshat janë ndër faktorët qenësorë të transformimeve të shumta në jetën familjare, shoqërore dhe materiale, si dhe të institucioneve tradicionale, të cilat me shekuj gjallisnin në bashkësinë fshataro-agrare.

Mirëpo, proceset inovative nuk i kanë përfshirë me intensitet të njëjtë të gjitha fshatrat dhe tërë popullsinë fshatare. Elementet e kulturës urbane materiale dhe shpirtërore më herët kryesisht kanë depërtuar në fshatrat përreth qyteteve dhe në ato fshatra të cilat ishin në pikëpamje komunikative të lidhura mirë me qytete, me dritë elektrike, me numër të madh të migrantëve ditorë etj. Popullsia rurale e Kosovës ishte e gatshme më shpejtë t'i përvetësonte risitë prodhuese, materiale (ato që preken) nga ato

shpirtërore.[21] Një numër i madh i ekonomive familjare fshatare që në fillim të viteve të 80-ta të shekullit të kaluar posedonte aparate radiotelevizive[22] dhe pajime bashkëkohore për amvisëri, siç janë aparatet elektrike,[23] orenditë, hidroforët për ujë të pijshëm etj., por njëkohësisht ekzistojnë akoma shumë probleme lidhur me pajimin e ekonomive shtëpiake dhe të banesave me instalime themelore (që shihet te gjendja e banimit në fshat, tabela 38).

Në këto vitet e fundit, sidomos me shkuarjen e fuqisë punëtore në punë të përkohshme në botën e jashtme, një numër i konsiderueshëm i ekonomive familjare fshatare ka futur në praktikën e tyre ekonomike inovacionet prodhuese nga sfera e teknologjisë bashkëkohore agrare, si p.sh. traktorët, makinat kositëse, makinat shirëse, motorët për ujitje, kombajnat etj. Mirëpo, në bujqësinë e kuantumit të kufizuar të tokës së punueshme dhe të pronave të copëzuara, çfarë janë në Kosovë, paraqiten probleme tjera: ky mekanizim (inovacionet bazike) nuk mund të shfrytëzohet në masë të mjaftueshme (tabela 3); vërehet një konflikt serioz në mes të mekanizimit dhe fragmentimit të pronave. P.sh. traktorët, numri i të cilëve në ekonomitë bujqësore, sipas regjistrimit të vitit 1981, ishte 15.116 (4.117 njëboshtorë dhe 10.999 dyboshtorë), por që më tepër përdoreshin në transportimin e materialit ndërtimor ose për punë tjera sesa në punët bujqësore (ekonomitë bujqësore pa tokë dhe deri 0,10 ha ose 1.000 m^2 tokë kanë 399 traktorë).

---

[21] Ekzistojnë disa arsye pse popullsia rurale përgjithësisht më shpejtë i përvetëson inovacionet prodhuese, materiale nga ato shpirtërore. Sipas sociologëve zgjerimi i një inovacioni kalon nëpër disa faza: "Në kuadër të fazës së parë inovacioni prodhues i prezentohet fshatrëve: ata marrin vesh se ai ekziston. Në kuadër të fazës së dytë ata vendosin ta përvetësojnë, ndërsa në kuadër të fazës së tretë ata e fusin në praktikën ekonomike. Këto faza mund të zhvillohen në afat minimal kohor, por më shpesh zhvillohen në periudhë relativisht të gjatë kohore" (V. Đurić, "Proizvodne inovacije i naši selaci", *Sociologija*, br. 1, Beograd, 974, ff. 92-93).

[22] Derisa në Kosovë numri i ekonomive familjare në një radioparapagues në vitin 1947 ishte 88,1, në vitin 1980 ky numër zvogëlohet në 2,4 ekonomi familjare (Jugosllavia 16,2 dhe 1,5; Sllovenia 8,5 dhe 1,2). Numri i ekonomive familjare në një TV parapagues më 1965 ishte 26,7, ndërsa në 1980 zvogëlohet në 3,4 (Jugosllavia 8,5 dhe 1,7; Sllovenia 4,9 dhe 1,3) (*Razvoj Jugoslavije 1947-1981*, Beograd, 1982, f. 238).

[23] Në vitin 1968 në Kosovë 27,6% të ekonomive familjare kishin shporeta elektrikë dhe të plinit dhe 13,0% të tyre frigoriferë (Jugosllavia 36,9% dhe 25,1%; Sllovenia 47,7% dhe 41,2%). Mirëpo, në vitin 1978 përqindja e ekonomive familjare që posedojnë shporeta elektrikë dhe të plinit rritet në 54,1% dhe e atyre që kanë frigoriferë në 38,7% (Jugosllavia 81,0% dhe 70,4%; Sllovenia 91,3% dhe 78,7% (*Po aty*, f. 234).

Tabela 3. Numri i traktorëve dhe i kombajnave në ekonomi bujqësore sipas madhësisë së pronave të tokës më 1981[24]

Madhësia e pronës	Traktorë		Kombajna
	Njëboshtorë	Dyboshtorë	
Pa tokë	32	90	3
Deri 0,10 ha	45	132	6
0,11 – 0,50	122	177	7
0,51 – 1,00	247	328	10
0,01 – 3,00	1,352	2.931	102
3,01 – 5,00	1.014	3.046	110
5,01 – 8,00	746	2.455	86
8,01 – 10,00	258	868	43
10,00 e më tepër ha	301	972	60
Gjithsej	4.117	10.999	427

Në anën tjetër, në fillim të viteve të 80-ta të shekullit XX, në sektorin individual të bujqësisë, për shkak të nivelit të ulët të arsimit e të kualifikimit, fuqia punëtore nuk dispononte njohuri dhe shkathtësi për drejtimin e makinave: as atëherë nuk kishte e as sot nuk ka traktoristë të kualifikuar për punë bujqësore; shumë sish nuk e kanë as provimin e dhënë për ta drejtuar traktorin. Prandaj, në këtë sektor, probleme të veçanta paraqiten jo vetëm në vështirësitë në përvetësimin e inovacioneve teknikoteknologjike dhe të formave organizative të punës, por janë bërë dukuri e shpeshtë lëndimet trupore dhe vdekjet. Që të eliminohen këto probleme, shtrohet nevoja e profesionalizimit dhe e specializimit të bujqve aktivë (shkollat bujqësore, kurset, shërbimet profesionale etj.).

Përkundër ndryshimeve të mëdha në jetën kulturore të fshatit tonë në krahasim me periudhën para tri e më tepër dekadash, shumë norma të jetës tradicionale apo mbeturina të tyre, ruajtja e të cilave është afatgjate në zhvillimin kulturor të një populli, nuk janë zhdukur, gjallisin në kushte të reja. Ndikimi i raporteve patriarkale në popullsinë rurale paraqitet edhe si faktor i rezistencës ndaj shumë proceseve inovative në sferën shpirtërore dhe kulturore, sidomos në pjesën fshataro-agrare të shoqërisë, baza e jetës e së cilës është ende bujqësia e karakterit kryesisht natyral dhe autarkik dhe të cilën ende e përshkon shkalla e lartë e analfabetizmit. Në shumë fshatra

[24] *Regjistrimi i popullsisë, ekonomive shtëpiake dhe i banesave më 1981. Ekonomitë shtëpiake*, Buletini 21, f. 54.
Në tërë Kosovën në vitin 1981 ka pasur gjithsej 15.677 traktorë (561 jashtë ekonomisë bujqësore) dhe 458 kombajna (31 jashtë ekonomisë bujqësore) (*Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave në vitin 1981*, Buletini 17, f. 44).

hapja ndaj qytetit dhe shoqërisë akoma nuk është e duhur për shkak të mungesës së sistemeve dhe institucioneve kyçe jetësore dhe shoqërore.

Lidhur me depërtimin e strukturave dhe të vlerave të reja në fshatin kosovar duhet zënë në gojë edhe disa anomali që ndodhin në jetën shoqërore-kulturore me rastin e përvetësimit të formave të reja të jetës, të cilat i ka sjellë koha jonë. Depërtimi i mjeteve teknike dhe masmediumet: radio, manjetofoni, televizori etj. kanë shkaktuar që të reduktohet mjaft komunikimi interpersonal. Vetëm deri para disa vjetëve, dukuri kjo që është e pranishme edhe sot, fshatarët tuboheshin para xhamisë, shkollës, kooperativës ose para ndonjë vendi tjetër kurdo që kishin kohë të lirë. Ishte dukuri e zakonshme tubimi nëpër oda dhe ndeja, sidomos kur vinte ndonjë mysafir. Sot në masë të mirë vërehet dukuria e tjetërsimit në fshat, por jo pse fshatari është individualizuar aq shumë për shkak se ka përmirësuar gjendjen e përgjithshme të tij jetësore dhe sociokulturore, por kjo po ndodh nën influencën e gjithmbarshme të kohës në të cilën jetojmë. Prandaj, fshatari ynë, duke mos qenë në gjendje të ballafaqohet me kërkesat që i shtron koha e sotme, e që janë shumë të mëdha, ikën nga këto probleme mjaft komplekse, duke konsumuar të shumtën e herëve vlera të rrejshme kulturore. Këtu do parë edhe procesin e identifikimit me heronjtë e kulturës së masës, të një identifikimi do të thoshim patologjik, sepse duke ikur nga problemet ekzistuese, pjesën më të madhe të energjisë e shpenzon për ta realizuar unin e idealizuar, por në këtë mënyrë e harron unin real. Koha e lirë te fshatarët sot është shtuar, por ajo nuk është e organizuar dhe më tepër kalohet duke konsumuar vlera të kulturës së gjerë, të shpërndarë nëpërmjet masmediumeve, ose, pas rënies së komunizmit dhe formimit të partive politike, duke komentuar aktivitetet partiake dhe proceset politike në Kosovë dhe më gjerë.

Në fshatin tonë është zbehur mjaft edhe solidariteti si formë reciproke tradicionale shoqërore, që përpara shprehej me rastin e korrjes, kositjes, ndërtimit apo prishjes së shtëpive, mbledhjes e vjeljes së frutave të ndryshme etj. Zvogëlimi i ndihmës shoqërore si traditë popullore është më tepër rezultat i zilisë dhe i raporteve të tjera se sa i individualizimit të jetës. Në rrethana të rreziqeve të përgjithshme, çfarë ndodhi në kohën e sundimit të regjimit represiv dhe agresiv të Millosheviqit, solidariteti funksionoi mirë, por menjëherë pas çlirimit solidariteti u zbeh aq shumë sa sot sikur u kthye në zili të përgjithshme dhe sikur u harruan shpejt të gjitha ato të këqija e tragjedi që i kishte shkaktuar regjimi serb.

Në anën tjetër, nevojat artificiale në fshatin tonë vazhdimisht po shtohen. Vrapimi drejt përmbushjes së këtyre nevojave po i lë anash nevojat vitale jetësore e shoqërore. Kjo po kushtëzon forma të ndryshme të tjetërsimit – grumbullimin e sendeve për të cilat objektivisht nuk ka nevojë. Nuk janë raste të rralla kur fshatarët tanë të kenë automobil – risi mjaft e

zgjeruar teknike në fshat, veçanërisht pas emigrimit të fuqisë punëtore në botën e jashtme, apo ndonjë mjet tjetër e të mos kenë p.sh. gjera të tjera para tij, p.sh. shporet elektrik, frigorifer dhe aparate të tjera të domosdoshme për amvisëri dhe ekonomi bujqësore. Automobili sot është kërkesë e nevojshme e kohës, por fshati ynë para tij ka nevoja të tjera; së fundit sot nuk është edhe lehtë të mbahet automobili, sidomos pas shtrenjtimit të karburanteve, pjesëve rezervë dhe shërbimeve të mirëmbajtjes.[25]

7. Gjendja e banimit në fshat

Banimi së bashku me ushqimin dhe veshmbathjen paraqet determinantin kryesor të mënyrës së jetesës. Banimi si dukuri e standardit jetësor dhe shoqëror në jetën e njeriut vazhdimisht ka qenë kusht themelor jetësor. Në qoftë se formën dhe mënyrën e banimit e vështrojmë në kontekstin historik-jetësor, vërejmë se ato janë rezultat i disa rrethanave: mënyrës dhe tipit të ekonomizimit, kushteve jetësore, vlerave të caktuara shoqërore-kulturore, tipit të familjes (përbërjes dhe organizimit të saj), përkatësisë së shtresës së caktuar sociale, tipit të vendbanimit (fshat, qytet), sistemit shoqëror etj.[26]

Në Kosovë dhe veçanërisht në fshatin e saj është gjithashtu shumë interesant të analizohen kushtet e banimit si një nga elementet e rëndësishme të kulturës materiale. Gjendja e pavolitshme e banimit para Luftës II Botërore dhe deri vonë pas saj manifestohej në fondin e vogël të banesave të ndërtuara kryesisht nga materiali i dobët, të cilin e ofronte ambienti natyror (qerpiçi, guri, druri) dhe të ngushta, pa instalime e pajime të nevojshme dhe shumica dërmuese e popullsisë flinte në tokë (rreth 57% të saj në vitin 1955),[27] pa shtrojë e mbulojë të mjaftueshme. Mirëpo, në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar u bënë ndryshime të konsiderueshme edhe në këtë segment të mënyrës së jetesës: u rrit fondi i banesave, ndërtimi u bë cilësor (materiali i fortë), u ndryshua pamja morfologjiko-arkitektonike dhe funksioni, u bë pajisja me instalime bashkëkohore, duke iu përshtatur nevojave të reja jetësore dhe kulturore. Këto ndryshime janë shumë të mëdha veçanërisht te popullsia urbane e Kosovës, mirëpo ato nuk e lënë anash as fshatin e saj.

---

[25] Krh: H. Islami, "Disa karakteristika shoqërore-kulturore të fshatit të Kosovës", *Gjurmime albanologjike – Folklor dhe etnologji*, VIII 1978, Prishtinë, 1979, ff. 70-71.

[26] Shih më gjerë: V. Đurić, "Stanovanje kao društvena pojava i predmet socioloških proučavanja", *Sociologija*, br. 3, Beograd,1969, ff. 417-440.

[27] *Anketa o vidovima stanovanja na selu* – stanje decembar 1955. Statistički bilten 127.

Sipas regjistrimit të popullsisë, ekonomive shtëpiake dhe të banesave të vitit 1981, Kosova kishte gjithsej 227.618 banesa dhe prej tyre përherë të banueshme ishin 221.268 (135.311 në fshat dhe 85.957 në qytet). Madhësia mesatare e një banese ishte 70,3 m^2; nga materiali i fortë ishin bërë 67,4% në qytet dhe 46,1% në fshat. Se sa është shtuar fondi i banesave dhe sipërfaqja e tyre shihet nga tabela 4.

Tabela 4. Ndryshimet në fondin e banesave dhe madhësisë së tyre në vendbanimet urbane dhe fshatare të Kosovës në periudhën 1951-1981[28]

	1951		1961		1971		1981	
	Qyteti	Fshati	Qyteti	Fshati	Qyteti	Fshati	Qyteti	Fshati
Numri i banesave	21.000	93.000	30.000	114.000	60.000	121.000	88.000	140.000
m^2 në një banesë	45,8	46,5	41,1	50,8	49,8	56,5	65,5	73,2

Sa i përket kohës së ndërtimit, 62,0% të banesave në fshat dhe 68,0% të tyre në qytet ishin ngritur pas viteve gjashtëdhjetë, gjë që shpjegohet me situatën e pavolitshme të trashëguar, rritjen e popullsisë, sidomos të qyteteve, procesin e dekompozimit të familjeve të zgjeruara, përmirësimin e situatës materiale të një pjese të popullsisë në qytet dhe në fshat nga puna e përkohshme në botën e jashtme, shfrytëzimin e kushteve të volitshme të kredive për ndërtim në vitet e 70-ta e të 80-ta të shekullit të kaluar etj. Nga mesatarja e Kosovës, si dhe midis vendbanimeve urbane dhe rurale të komunave ka dallime të theksuara.

Tabela 5. Banesat sipas vitit të ndërtimit në vendbanimet urbane dhe fshatare të Kosovës më 1981[29]

Vendbanimet	Gjithsej	Deri 1918	1919-1945	1946-1960	1961-1970	1971-1981	Të panjohura
Urbane	87.627 100,0	5.902 6,2	4.485 5,1	14.268 16,2	28.165 32,1	32.473 35,8	3.334 3,8
Fshatare	139.991 100,0	5.228 3,7	14.469 10,3	29.572 21,1	37.082 26,3	49.765 37,5	3.875 2,7

[28] *Regjistrimet e popullsisë 1953-1981; Statistički godišnjaci* (vitet e ndryshme); *Društvene promjene u selu*, 3, Zagreb, 1974, ff. 76-77.

[29] *Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave në vitin 1981*, Buletini 17, f. 54.

Nga të gjitha banesat e ndërtuara në fshat, 32,2% të tyre ishin mbi 4-dhomëshe, 30% tridhomëshe, 28,4% dydhomëshe dhe të tjerat njëdhomëshe e më të vogla, ndërsa në qytet mbi katërdhomëshe ishin 18,1%, tridhomëshe 24,7%, dydhomëshe 40,3% dhe pjesa tjetër njëdhomëshe e më të vogla. Në pikëpamje të pajimit të banesave me instalime të nevojshme, ndryshimet ishin të mëdha në periudhën 1971-1981, mirëpo gjendja nuk ishte e kënaqshme dhe dallimet ishin të mëdha midis fshatit dhe qytetit. Sa i përket pajimeve me lokale ndihmëse në vitin 1981 gjendja në qytet dhe fshat ishte kështu: banjat 51,4% dhe 5,0%, tualet me shpërlarje 45,1%, tualet pa shpërlarje 9,9% dhe 3,6%.

Tabela 6. Instalimet në banesa në vendbanimet urbane dhe fshatare të Kosovës në vitin 1971 dhe 1981[30]

Vendba-nimet	Viti	Gjithsej	Ujësjellës, kanalizim dhe rrymë elektrike	Ujësjellës dhe rrymë elektrike	Vetëm rrymë elektrike	Pa instalime
Urbane	1971	60.000 100,0	2.000[31] 4,0	21.000 35,4	35.000 57,8	2.000 3,0
	1981	87.627 100,0	55.575 63,4	14.054 16,0	16.829 19,1	1.144 1,3
Fshatare	1971	120.432 100,0	208 0,1	3.297 2,7	72.465 60,2	44.462 37,0
	1981	139.991 100,0	10.222 7,3	14.025 10,0	104.208 74,4	11.336 8,9

Gjendja e pavolitshme në fshat ishte rezultat i mungesës së plotë të infrastrukturës komunale, por dallimet midis fshatit dhe qytetit manifestojnë edhe ndikimin e kulturës tradicionale të banimit. Në të gjitha territoret e ish-Jugosllavisë vërehej një gjendje e tillë;[32] dallimet nga mesatarja e Kosovës dhe në mes të vendbanimeve urbane dhe rurale ishin të konsiderueshme.

[30] *Po aty*, f. 56; *Popis stanovništva* 1971, knj. VII.

[31] Pjesëmarrja shumë e ulët në vitin 1971 në krahasim me vitin 1981 del nga fakti se është përfshirë edhe nxemja qendrore, të cilën e kanë pasur vetëm një pjesë e banesave në Prishtinë dhe disa objekte shoqërore e banesa private në qendrat tjera.

[32] A. Hodžić, "Inovacije u stanovanju i opremljenosti domaćinstava te orijentacija u potrošnji seoskog stanovništva", *Sociologija sela* (numër tematik), nr. 53-54, Zagreb, 1976, ff. 54-56.

8. Ushqimi dhe konsumi i popullsisë

Ushqimi është gjithashtu një nga komponentët e rëndësishme të mënyrës së jetesës dhe të kulturës popullore, si materiale, ashtu edhe shpirtërore. Ushqimi dhe përbërja e tij, siç dihet, ngadalë pësojnë ndryshime në krahasim me shumë karakteristika tjera të jetës popullore fshatare. Mënyra dhe struktura e ushqimit janë manifestim i mirëqenies materiale, por edhe të ndikimit të faktorëve tjerë shoqërorë, sikurse janë shprehitë, doket, niveli i zhvillimit kulturor etj. Kur të flitet për popullsinë fshatare të Kosovës deri në vitet gjashtëdhjetë të shekullit XX, në shumë territore rurralo-agrare dhe më vonë, duhet të kihet parasysh fakti se të gjitha përpjekjet ishin të orientuara për sigurimin e minimumit jetësor. Nuk kishte sasi të mjaftueshme as të bukës së misrit ndër popullsinë fshatare-bujqësore të shumë vendbanimeve, të mos flasim për konsumin e mjaftueshëm të bukës së grurit dhe të artikujve të tjerë ushqimorë kalorikë.

Të dhënat tregojnë se Kosova ishte territor ku në strukturën e ushqimit deri vonë pas Luftës II Botërore dominonin gjërat ushqimore bimore (rreth 82%), ku buka përbënte rreth 75%[33]. Dominonte buka e misrit (rreth 65%)[34] dhe rreth 90% të prodhimit të misrit është përdorur për ushqimin e njerëzve. Ushqimi ishte aq i njëtrajtshëm dhe i pamjaftueshëm sa që ekspertët, duke studiuar atë para plot 50 vjetëve, konstatuan se "… në pjesën dërmuese të popullsisë ushqimi është në atë masë larg principeve themelore të fiziologjisë sa që mund të thuhet se ai i kundërvihet ligjeve të fiziologjisë së ushqimit dhe është për t'u habitur se si mund të mbahet organizmi me këtë ushqim".[35] Artikujt e tjerë ushqimorë kalorikë, të domosdoshëm për organizmin e njeriut, si p.sh. mishi, sheqeri etj. pothuajse mungonin krejtësisht në strukturën e ushqimit ose shumë rrallë konsumoheshin; artikujt e tillë ushqimorë madje konsideroheshin edhe si luks dhe konsumoheshin vetëm gjatë festave fetare, kur vinte ndonjë mysafirë dhe në raste të tjera.

---

[33] K.Šnajder – A. Milošević, *Prilog proučavanju ishrane Kosmeta*, SAN, posebno izdanje, ff. 70-71; Đ. Rapi, "O pojedinim aspektima starog i novog u kosovskom selu", *Sociološki pregled*, br. 3, Beograd, 1978, f. 128.

[34] S. Tošović, "Potrošnja prehrambenih proizvoda u seoskim domaćinstvima NR Srbije", *Poljoprivreda i zagrugarstvo*, br. 9, Beograd, 1961, ff. 18-19; S. Šuvar, "Životni i društveni standard u našem današnjem selu", *Naše teme,* br. 12, Zagreb, 1964, f. 1980.

[35] *Stanje i mogućnost razvoja privrede Kosova i Metohije*, Priština, 1957, f. 27; shih gjithashtu: K. Šnajder, "Ishrana i njen uticaj na biološku snagu stanovništva u Autonomnoj Kosovsko-Metohijskoj Oblasti", *Zbornik radova SAN*, XXVII, Institut za izučavanje ishrane naroda, knj. 2, Beograd, 1953.

Sa i përket strukturës së ushqimit, kohëve të fundit janë bërë ndryshime të konsiderueshme, por jo edhe të duhura në krahasim me segmentet e tjera të mënyrës së jetesës, siç është p.sh. veshmbathja apo banimi; ndryshime të vogla vërehen edhe në higjienën personale të popullatës fshatare. Të dhënat tregojnë se në ekonomitë shtëpiake bujqësore gjithnjë rriteshin mjetet disponible në para, si formë shumë të rëndësishme të integrimit të jetës fshatare në jetën e përgjithshme të shoqërisë globale. Anketa mbi mjetet në disponim dhe të shpenzuara për vitin 1973 tregonin se këto ekonomi shtëpiake disponononin në para 71,2% të mjeteve (gjysma nga bota e jashtme) dhe 28,8% të mjeteve nga vlera natyrale e konsumit. Nga këto mjete 33,1% konsumoheshin për ushqim, 2,3% për pije e duhan, 16,1% për veshmbathje, banim, nxehje e ndriçim, orendi shtëpiake dhe për higjienë e ruajtje të shëndetit, 6,1% për arsim, kulturë, shërbime të komunikacionit, tatime e taksa dhe mallra të tjera, 15,8% i kursenin dhe 26,6% i shpenzonin për banesë (shtëpi).[36] Ndërsa në vitin 1979 në ekonomitë shtëpiake bujqësore vëllimi i mjeteve disponible në para rritet diçka edhe më tepër (rreth 73%), mirëpo në kuadër të tyre rriten më shumë mjetet e fituara nga marrëdhënia e punës, kryesisht nga bota e jashtme (rreth 70,0%). Nga mjetet e përgjithshme 62,7% i konsumuan për nevoja vetanake (nga këto 67,4% për ushqim e pije, 10,5% për veshmbathje, 14,2% për banesë, nxehje, ndriçim, orendi, higjienë e shëndet, 8,5% për nevoja të arsimit, kulturës, argëtimit dhe shpenzime tjera), 2,9% për ndërtimin e shtëpive, 11,5% për ekonomi bujqësore dhe 22,5% për nevoja të tjera.[37]

U ndryshua edhe shpenzimi vjetor i gjërave ushqimore për një anëtar. U zvogëlua sasia e miellit, sidomos e atij të misrit, pastaj e pemëve dhe e pijeve alkoolike, ndërsa u rrit sasia e qumështit, e veve, e mishit, e perimeve dhe e sheqerit. Derisa në vitin 1975 për një anëtar shpenzoheshin 239 kg miell (dhe prej tyre 47 kg miell misri), ndërsa në vitin 1979 kjo sasi zvogëlohet në 181 kg (dhe e miellit të misrit në 17 kg). Në vitin 1979 për një banor shpenzoheshin në ekonominë shtëpiake fshatare 19 kg mish, 117 litra qumësht, 97 copë vezë, 26 kg perime, 34 kg pemë, 15 kg sheqer e mjaltë dhe nga një litër raki e verë.[38]

---

[36] *Vjetari Statistkor i KSA të Kosovës*, I, EKS, Prishtinë, 1976, f. 303.
[37] *Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës*, VI, 1981, f. 294.
[38] Po aty, f. 294.

9. Përvijimi midis fshatit tradicional dhe fshatit bashkëkohor

Është fakt i pakontestueshëm se bashkësia rurale e Kosovës ka pësuar transformime të konsiderueshme në pikëpamje socialo-profesionale, demografike, arsimore, infrastrukturore, në mënyrën e jetesës dhe në vetëdijen e njerëzve etj. Megjithatë, në disa vendbanime rurale apo pjesë të tyre dhe shtresa të popullsisë janë të pranishme një varg problemesh, çfarë janë dendësia e madhe agrare dhe copëzimi i madh i pronave, papunësia dhe papunësia e fshehur (latente), mungesa e institucioneve shoqërore dhe e sistemeve urbane infra-strukturore, një numër i madh i kontesteve dhe i konflikteve pronësore-juridike si burim i hakmarrjes dhe formës më të vrazhdët të saj, gjakmarrjes, pastaj pasiguria sociale e shëndetësore, përqindja e lartë e analfabetizmit, sidomos te femrat, vdekshmëria e lartë e foshnjave etj. Fshati, fshatarësia dhe bujqit individualë gjatë kohë mbetën nën mëshirën e burokracisë së vrazhdë të sistemit totalitar të të gjitha niveleve. Shumë familje, veçanërisht pas okupimit serb dhe përjashtimit të shqiptarëve nga puna janë sjellë në kufi të minimumit jetësor, prandaj shumë sish edhe kanë marrë rrugën e mërgimit në Evropën e zhvilluar dhe jashtë saj, në Amerikë, Kanadë, Australi etj.

Sikurse në të gjitha vendet në zhvillim,[39] ashtu edhe në Kosovë dhe në bashkësinë shqiptare në përgjithësi, është vështirë të bëhet në pikëpamje sociologjiko-demografike një përvijim në mënyrë të prerë midis fshatit absolutisht tradicional dhe fshatit absolutisht të transformuar me të gjitha karakteristikat që i përcjellin. Tipi i parë është akoma i pranishëm, ani pse nuk i karakterizon të gjitha fshatrat, gjithë popullsinë fshatare dhe të gjitha sferat e jetës shoqërore, ndërsa tipi i dytë ende nuk është krijuar plotësisht, por e ka përfshirë një pjesë të madhe të popullatës fshatare, me tendencë të zgjerimit të përhershëm të veçorive të tij. Karakteristikat e jetës klasike shoqërore dhe të jetës bashkëkohore të fshatit tonë sot reciprokisht përshkohen dhe janë në konflikt të vazhdueshëm. Konfliktet sikur janë më të dukshme në fshatrat me transformim më të shpejtë. Mospajtimet dhe thyerjet më të rrepta sot vërehen midis brezave në të gjitha fshatrat, si dhe në kuadër të familjes, funksioneve dhe organizimit social të saj, ashtu siç ka ndodhur edhe në shoqëritë sot të zhvilluara perëndimore kur brezat e vjetra dëshironin t'i mbanin sa më gjatë rolet shoqërore dhe t'i pengonin të rinjtë në krijimin e pikëpamjeve të tyre mbi

[39] Për karakteristikat e strukturës homogjene dhe heterogjene të bashkësisë rurale dhe raportet e saj me shoqërinë globale gjatë historisë shih më gjerë: H. Mendras, *Seljačka društva,* Globus, Zagreb, 1986, ff. 107-127.

botën dhe jetën.[40] Strukturat tradicionale socialo-demografike në bashkësinë rurale të Kosovës janë në proces të shthurjes intensive.

[40] Më gjerë në: B. Bettelheim, "The Problem of generations", në E. Erickson (ed.), *Youth: Change and Challenge,* Basic Books Publ., New York, 1963, p. 70; Z. Golubović, *Porodica kao ljudska zajednica,* Naprijed, Zagreb, 1981, ff. 194-196.

III. BASHKËSIA URBANE DHE PROBLEMET E SAJ

Dukuria e eksodit rural dhe e koncentrimit urban, siç dihet, mori hov pas revolucionit klasik industrial dhe kthesave të fuqishme demografike në Evropën Perëndimore në gjysmën e dytë të shekullit XVIII dhe në shekullin XIX, si pasojë e procesit të industrializimit dhe të deagrarizimit, ndërsa në shekullin XX dhe veçanërisht pas Luftës II Botërore koncentrimi i popullsisë në qytete dhe zgjerimi i funksioneve të vendbanimeve urbane i përfshiu të gjitha vendet e botës, veçanërisht vendet në zhvillim ("Bota e Tretë").[1] Mirëpo, e tërë popullsia që jeton në qytet nuk do të thotë se ka kulturë dhe mënyrë urbane të jetës, sidomos në këto vendet e fundit, sikundër që manifestimet e strukturave dhe proceseve të urbanizimit hetohen, më shumë ose më pak, edhe në rrethinën e ngushtë apo të gjerë (suburbanizimi), varësisht nga intensiteti i ndryshimeve të përgjithshme të vendbanimeve urbane.

Urbanizimi është proces shumë më kompleks se sa mendohet. Urbanizimi nuk mund të reduktohet vetëm në numrin e popullsisë së qytetit, në popullsinë e gjithmbarshme dhe rritjen e tij, por nënkupton edhe ndryshimet në strukturën socioekonomike të popullsisë, në funksionet e qytetit dhe në mënyrën e jetesës në bashkësitë urbane në përgjithësi. Zhvillimi i procesit të urbanizimit, përkufizimi territorial dhe funksional i tij, sikurse edhe te përcaktimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së tyre në fshatare dhe urbane në Kosovë dhe gjetiu vështirë mund të matet me indikatorët që zbatohen sot në shumicën e vendeve, veçanërisht në ato të zhvilluara, ku më fshati në kuptimin klasik nuk ekziston, prandaj edhe dallime midis fshatit dhe qytetit gati nuk ka.

Pas hyrjes së forcave ndërkombëtare në qershor të vitit 1999 dhe kthyerjes së shqiptarëve në Kosovë nga deportimi, në gjithë Kosovën dhe sidomos në qytetet e saj nisi të dinamizohej jeta në shkallë të gjerë. Filloi rindërtimi i shtëpive të shkatërruara dhe ndërtimi i shtëpive të reja në tërë vendin dhe të rritej si numri, ashtu edhe dendësia e popullsisë në disa vendbanime. Për shkak të shtëpive të djegura e të dëmtuara të shqiptarëve në rajonet rurale të Kosovës nga forcat ushtarake, policore, paramilitare dhe serbët vendës, popullsia shqiptare koncentrohej në qytete dhe qendra të urbanizuara. Numri i automjeteve shtohej me një shpejtësi të madhe deri në atë shkallë sa që vështirë e absorbonin dhe e absorbojnë sot e gjithë ditën sistemet ekzistuese infrastrukturore, sidomos në Prishtinë. Dhe deri në

[1] J. Beaujeu-Garnier, *Géographie urbaine,* A. Colin, Paris, 1980, pp. 11-24; Jean-Pierre Paulet, *Géographie urbaine,* A. Colin, Paris, 2000, pp. 65-85.

konsolidimin e organeve të sigurisë dhe të pushtetit, vendore e ndërkombëtare, rritej anarkia, më tepër ajo urbane, me të gjitha konsekuencat që dalin nga kjo dukuri.

1. Rrjedhat specifike të urbanizimit

Urbanizimi dhe zhvillimi i jetës urbane në Kosovë me tërë ritmin dhe dimensionet e tij është i ri, edhe pse disa qytete, siç dihet, kanë histori dhe traditë relativisht të gjatë. Baza natyrore-gjeografike, trashëgimia specifike shoqëroro-historike, depërtimi i vonë i elementeve të ekonomisë kapitaliste, pozita koloniale e Kosovës gjatë tërë shekullit XX dhe moszhvillimi ekonomik në përgjithësi krijuan tip të veçantë të popullimit në Kosovë. Zhvillimi i pamjaftueshëm dhe i vonshëm ekonomik, veçanërisht mungesa e industrializimit dhe transformimi i ngadalshëm hapësinor-funksional i Kosovës kushtëzoi nivel dhe rrjedhë specifike të urbanizimit, si dhe zhvillim të dobët të rrjetit të qendrave urbane dhe funksionalitetit të tyre. Strukturat dhe mënyra e jetës urbane në Kosovë ishin deri vonë territorialisht mjaft të kufizuara dhe të rrudhura vetëm në disa qendra, siç janë Prishtina, Peja, Prizreni, Gjakova, Mitrovica, Gjilani dhe Ferizaji dhe në disa bërthama të tjera të karakterit urban. Më vonë, me zhvillimin e sistemit komunal, në disa qendra komunale u zhvillua ekonomia lokale dhe u zgjeruan funksionet shoqërore, arsimore, administrative, politike etj. Në këtë mënyrë rrjeti urban i Kosovës nga qendrat rajonale u zgjerua edhe në qendrat nënrajonale dhe lokale, ndërsa vendbanimet rurale të tipit joagrar qysh para katër dekadave ushtronin rolin e vendbanimeve me funksione qendrore.[2] Kështu në vitin 1948 në Kosovë status të qytetit, sipas kriterit të atëhershëm, vlerësohet se kishin vetëm 5 vendbanime, të cilat në popullsinë e përgjithshme merrnin pjesë vetëm me rreth 10%. Të gjitha këto qytete kishin më pak se 20.000 banorë (Prishtina 19.761, Peja 17.831, Gjakova 15.190, Mitrovica 13.901), pos Prizrenit i cili kishte 20.540 banorë, ku ishin të përqendruara edhe disa funksione të rëndësishme shoqërore dhe politike të Kosovës.[3]

Në vitin 1953 popullsia urbane përbënte 15,6%, më 1981 32,4% dhe më 1991 (vlerësimi) rreth 36% në popullsinë e gjithmbarshme. Derisa në vitin

[2] Shih më hollësisht: Q. Lleshi, *Po aty,* ff. 83-106.

[3] Dy qendrat e Kosovës, sot me funksione mezorajonale, në vitin 1948 kishin një madhësi popullative sa disa fshatra të mëdha të Kosovës në vitin 1981: Gjilani 8.613 banorë, sa Kastrioti (ish-Obiliqi) më 1981 (8.709 banorë), dhe Ferizaji 6.685 banorë, sa Shtimja (6.657) ose pak më shumë se Vitomirica (6.348), Dushanova (5.982) dhe Juniku (5.490) në vitin 1991.

1948 numri i popullsisë urbane ishte rreth 71.000, në vitin 1991 ai rritet në rreth 730.000 banorë. Në periudhën 1953-1981 popullsia urbane rritet për 388.300 banorë ose për 306,9%, ndërsa në periudhën 1953-1991 përreth 600.000 banorë ose përreth 480%. Vlerësohet se aktualisht midis 45-50% të popullsisë së Kosovës jeton në qytete.

Në vitin 1971, kur nisi të merr hov procesi i urbanizimit dhe të bëhet më kompleks rrjeti i qendrave urbane, sipas kritereve të atëhershme të përcaktimit të popullsisë urbane, nga 22 qendrat komunale sa kishte Kosova, 12 ishin qytete, 8 i përkisnin tipit të përzier (as fshat, as qytet) dhe 2 seli komunale ishin fshatra (Klina dhe Skënderaj). Në vitin 1981 status qyteti kishin të gjitha qendrat komunale (pos Skenderajt) dhe Fushë Kosova e Kastrioti (ish-Obiliq), të cilat ende nuk ishin formuar si komuna. Derisa deri në regjistrimin e popullsisë të vitit 1971 klasifikimi i vendbanimeve në qytete, fshatra dhe tip të përzier është bërë në bazë të madhësisë së tyre numerike dhe raportit midis popullsisë bujqësore dhe asaj jobujqësore në vendbanim, ndërkaq, në vitin 1981, siç theksuam më parë, ky klasifikim bëhet në bazë të ligjit mbi organizimin territorial të komunave. Në mbështetje të këtij ligji, sot të gjitha qendrat komunale konsiderohen vendbanime qyteti.

Në pjesën e dytë të shekullit XX shpërpjesëtimi midis rritjes demografike dhe dimensionit fuksional të urbanizimit (kapacitetet e përgjithshme të qytetit) shënoi një rritje të madhe, sepse ngeci urbanizimi sekondar si indikator i rëndësishëm i procesit të urbanizimit (transformimi i vendbanimeve të tipit rural në qytete), ndërsa u forcua edhe më tepër urbanizimi primar (koncentrimi i popullsisë në qendra ekzistuese urbane). Rrjeti i qendrave urbane vërtet zgjerohet me qendrat komunale, por në shumicën e tyre, në strukturën funksionale dominojnë aktivitetet joprodhuese, të njohura si funksione jobazike, siç janë administrata, arsimi, shëndetësia, komunaliet, shërbimet shoqërore etj., ndërsa u mungojnë funksionet bazë të zhvillimit urban dhe të atraktivitetit, e këto janë vendet e punës dhe fondi banesor. Një specificitet tjetër urbano-gjeografik me të cilin shquhen shtatë qendrat kryesore urbane të Kosovës është shtrirja periferike e tyre.[4] Rrethanat historike-shoqërore ishin të tilla që Kosova trashëgoi një shtrirje të përshtatshme rajonale të këtyre shtatë qendrave, ndërsa me zhvillimin e mëvonshëm të tyre u forcuan edhe më tepër dhe mundësuan një zhvillim relativisht të harmonizuar territorialo-urban. Raportet e sotme territorialo-demografike ende i karakterizon një diferencim i dobët brendarajonal, ku kryesisht dominojnë migrimet lokale, të cilat, me okupimin e Kosovës dhe përzënien e punëtorëve shqiptarë nga puna (1990 e këndej), nuk

[4] Q. Lleshi, *Po aty.*

zhvillohen në vëllim intensiv në drejtimin fshat - qytet sikurse deri në vitet e 90-ta të shekullit XX.

Tabela 1. Numri i vendbanimeve dhe i popullsisë dhe niveli i urbanizimit në Kosovë në periudhën 1948-1991[5]

Viti	Numri i vendbanimeve	Numri i popullsisë	Niveli i urbanizmit %
1948	1.449	733.034	9,7
1953	1.438	815.908	15,5
1961	1.437	963.988	19,5
1971	1.438	1.243.693	26,9
1981	1.445	1.584.441	32,5
1991	1.445	2.018.500	37,0

Tabela 2. Numri i vendbanimeve dhe i popullsisë sipas tipit të vendbanimeve në periudhën 1948-1991[6]

	Vendbanimet urbane		Vendbanimet e përziera		Vendbanimet rurale	
Viti	Numri i vendbani-meve	Numri i popullsisë	Numri i vendbani-meve	Numri i popullsisë	Numri i vendbani-meve	Numri i popullsisë
1948	4	71.349	-	-	1.445	661.685
1953	8	126.139	21	25.786	1.409	663.983
1961	12	187.560	38	40.144	1.388	736.284
1971	18	335.019	109	120.612	1.308	788.062
1981	26	514.755	-	-	1.419	1.069.686
1991	26	733.700	-	-	1.419	1.284.800

Për shkak të moszhvillimit të zënë në gojë, deri në fund të viteve të 60-ta të shekullit XX ndryshimet ishin të vogla në mobilitetin hapësinor dhe social të popullsisë, në koncentrimin e vogël të saj dhe në moszhvillimin e qyteteve dhe zgjerimin territorial të strukturave urbane. Pas këtyre viteve ndodhin ndryshime të konsiderueshme si në koncentrimin demografik dhe

[5] Burimi: për vitet 1948-1981 regjistrimet e popullsisë; për vitin 1991 vlerësimi (A. Pushka, "Porast stanovništva kosovskih gradova", *Stanovnišvo*, br. 3-4/1990 - 1-2/1991, Beograd, CDI, IDN, f. 181).

[6] Burimi: për periudhën 1948-1981: *Stanovništvo i domaćinstva SR Srbije prema popisu 1981*, RZSS, Beograd, 1984, f. 231; për vitin 1991: vlerësimi (A. Pushka, *Po aty*).

zgjerimin hapësinor të qyteteve, ashtu edhe në të gjitha segmentet e mënyrës së jetesës, siç janë banimi, ushqimi, veshmbathja, higjiena personale etj. Fondi i banesave dhe sipërfaqja e tyre shënojnë rritje si në fshat, ashtu edhe në qytet. Në vendbanimet urbane të Kosovës numri i banesave rritet nga 21.000 në vitin 1951 në 88.000 në vitin 1981, ndërsa sipërfaqja e tyre do të shtohet prej 45,8 në 65,5 metra katrore në një banesë. Sa i përket kohës së ndërtimit, 68,0% të banesave janë ngritur pas viteve të 60-ta, që shpjegohet më situatën e pavolitshme të trashëguar, me rritjen e popullsisë së qyteteve, procesin e dekompozimit të familjeve, përmirësimin e situatës materiale nga puna brenda Kosovës dhe nga fitimet në botën e jashtme, me shfrytëzimin e kushteve të volitshme për ndërtim (kreditë), etj. Në periudhën 1961-1970 në qytetet e Kosovës ndërtohen 32,1% të banesave, ndërsa në periudhën 1971-1980 35,8% të tyre. Ndërtimi bëhet kryesisht me material të fortë, me pamje të përshtatshme morfologjiko-arkitektonike, si dhe me instalime bashkëkohore. Por në vitet e 70-ta dhe të 80-ta të shekullit të kaluar është investuar shumë edhe në ndërtimin jofunksional, në prestigj dhe luks.[7] Në vitet e 90-ta, ndërkaq, për arsye tashmë të njohura, stagnon ndërtimi, sidomos në sektorin shoqëror; banesat ndërtohen ekskluzivisht për serbë, kryesisht pjesëtarë të aparatit represiv dhe administrativ.

2. Rritja demografike e qyteteve

Baza kryesore e rritës së qyteteve të Kosovës në këto dhjetëvjetëshat e fundit janë rrjedhat demografike, pra numri i popullsisë dhe shtimi i vazhdueshëm i tij nga komponenti natyror (shtimi natyror) dhe më shumë nga ai mekanik (imigrimi). Por dimensionin demografik të urbanizimit nuk e ndoqën në masë të duhur edhe rrjedhat funksionale të këtij procesi, siç janë punësimi, infrastruktura përkatëse komunale, fondi i banesave, hapësira shkollore, shërbimet shëndetësore dhe institucionet e tjera të domosdoshme për zhvillimin normal të qytetit si organizëm dinamik dhe kompleks. Burim themelor i rritjes demografike të qyteteve tona deri në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar ishte ardhja nga fshatrat e rrethinave të afërme, por edhe të largëta, varësisht nga dinamika e zhvillimit dhe funksionet shërbyese dhe atraktive të vendbanimeve urbane. Pjesëmarrja e popullsisë në vendbanimet me më shumë se 15.000 banorë rritet prej rreth 12% më 1948 në rreth 25% më 1981 dhe në rreth 30% më 1991. Përveç Prishtinës, pas viteve të 80-ta Mitrovica,

[7] H. Islami, *Fshati i Kosovës (Kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural),* Rilindja, Prishtinë, 1985, ff. 199-222.

Prizreni, Peja, Gjakova, Gjilani dhe Ferizaj, për rrethanat kosovare do të bëhen qendra të fuqishme urbane mezorajonale, të cilat paraqesin shtyllat e strukturës shoqëroro-ekonomike dhe demografike të Kosovës. Në këto dhjetëvjetëshat e fundit, në këto 7 qendra ishin të përqendruara rreth 40% të aktiviteteve sekondare të Kosovës, më se 50% të aktiviteteve terciare, më se 60% të aktiviteteve kuartare dhe afër 30% të popullsisë.

Që nga fillimi i viteve të 70-ta venbanimet urbane të Kosovës nuk ishin atraktive vetëm për popullsinë rurale të Kosovës, por edhe për fshatrat dhe qytetet e viseve të tjera etnike shqiptare të ish-Jugosllavisë. Veçanërisht ishte tërheqëse Prishtina me funksione të shumëfishta shoqërore-ekonomike, politike, arsimore, shëndetësore dhe administrative, e cila u afirmua dhe u ngrit në kryeqendër kosovaro-shqiptare. Prishtina me 108.000 banorë në vitin 1981 do të hyjë në kategorinë e qyteteve të mëdha dhe përbënte edhe atëherë, edhe në fillim të viteve të 90-ta (155.000 banorë më 1991) rreth një të pestën e popullsisë së përgjithshme urbane të Kosovës. Ky zhvillim i vrullshëm demografik i bashkësisë sonë urbane edhe sot e gjithë ditën përcillet nga një varg problemesh socioekonomike, kulturore, infrastrukturore etj., sikurse në të gjitha vendet e "Botës së Tretë", natyrisht me disa specificitete të mjedisit socioetnik.

Tabela 3. Popullsia urbane e Kosovës sipas kategorisë së madhësisë së qyteteve 1948-1991 (në mijë)[8]

Madhësia e qyteteve	1948	1953	1961	1971	1981	1991
Më pak se 2.000 banorë	10.9	9.4	7.0	6.7	1.1	1.4
2.000 – 1.000 (qytezat)	6.5	12.0	23.9	23.9	23.0	19.3
5.000 – 10.000 10.000 – 20.000 (qytetet e vogla)	26.7 6.0	30.4 35.2	15.4 24.4	22.4 22.3	33.3 41.9	49.2 29.6
20.000 – 50.000 50.000- 100.000 (qytetet e mesme)	20.5 -	68.1 -	143.1 -	200.0 69.5	135.0 169.2	74.7 400.0
Më se 100.000 banorë (qytetet e mëdha)	-	-	-	-	108.1	155.0
Numri i popullsisë urbane gjithsej	130.6	154.1	213.8	345.1	511.6	733.7
Shkalla e urbanizmit (%)	9,7	15,5	19,5	26,9	32,5	37,0

Me forcimin e atraktivitetit funksional të qyteteve dhe të selive komunale të Kosovës nga fillimi i viteve të 70-ta (forcimi i autonomisë,

[8] Burimi: për vitet 1948-1981 regjistrimet zyrtare të popullsisë; për vitin 1991 vlerësimi.

zhvillimi ekonomik, hapja e Universitetit etj.) ndikoi në imigrimin e popullsisë si nga mjediset rurale të Kosovës, ashtu edhe nga viset e tjera etnike shqiptare. Sa i përket ndikimit të komponentit migrues në rritjen e popullsisë urbane të Kosovës në periudhën 1981-1991 (vlerësimi), në mbështetje të metodës vitalo-statistike, nga rritja e përgjithshme e popullsisë së qyteteve të Kosovës në këtë periudhë (215.145 banorë ose 41,5%), saldoja migruese në këtë rritje është 73.620 banorë ose 34,2%, ndërsa pjesa tjetër e rritjes prej 131.525 banorë ose 65,8% i takon shtimit natyror. Shtim më të madh mekanik në këtë periudhë kanë shënuar vendbanimet urbane me madhësi prej 50.000-100.000 banorë (për 36,8%), ndërsa më të vogël qytetet deri 20.000 banorë (për 28,0%); vendbanimet me madhësi prej 20.000-50.000 banorë kishin rritje për 35,0%, kurse Prishtina si i vetmi qytet me mbi 100.000 banorë shënoi rritje përmes komponentit migrues për 32,8%. Pasqyra e dallimit midis shtimit natyror dhe rritjes mekanike të qyteteve tona (vlerësimi) shihet nga tabela 4.

Tabela 4. Vendbanimet urbane të Kosovës sipas komponentëve të rritjes së popullsisë së tyre në periudhën 1981-1991[9]

Qyteti	Numri i popullsisë		Rritja e përgjithshme	Shtimi natyror	Saldoja migruese
	1991	1981	1981-1991	1981-1991	1981-1991
Prishtina	155.499	108.083	47.416	31.877	15.539
Prizreni	92.303	61.801	30.502	15.588	16.914
Peja	68.163	54.497	13.666	11.215	2.451
Mitrovica	64.323	52.866	11.457	12.576	-1.119
Gjakova	59.008	42.031	16.977	9.186	7.791
Ferizaji	57.918	37.659	20.259	12.385	7.874
Gjilani	51.912	35.229	16.683	10.256	6.427
Vushtria	30.651	20.204	10.447	6.088	4.359
Besiana	25.847	15.894	9.953	7.165	2.788
Rahoveci	18.296	13.134	5.162	3.566	1.596
F. Kosova	16.154	12.917	3.237	3.770	-533
Kastrioti	11.612	8.769	2.843	2.281	562
Suhareka	10.497	6.653	3.844	2.870	974
Kaçaniku	9.800	6.629	3.171	2.348	823
Dardana	9.312	5.383	3.929	1.510	2.419
Lipjani	9.047	6.065	2.982	2.128	854
Klina	8.050	4.512	3.538	1.581	1.957
Burimi	6.384	4.478	1.906	1.053	853

[9] Burimi (vlerësimi): *Stanovništvo*, br. 3-4, CDI, IDN, Beograd, 1994, f. 96.

Drenasi	4.499	2.440	2.059	2.196	-137
Deçani	4.440	3.280	1.160	1.125	35
Vitia	4.309	3.108	1.201	985	216
Zveçani	3.261	2.785	476	413	63
Leposaviqi	3.105	2.384	721	464	257
Banja	2.126	1.168	958	378	580
Leshaku	1.852	1.672	180	184	-4
Sharri	1.532	1.114	418	337	81

3. Shkalla e urbanizimit sipas kombësisë

Përbërja kombëtare e popullsisë së qyteteve të Kosovës, veçanërisht e shtatë qendrave të karakterit mezorajonal, deri në fund të viteve të 60-ta të shekullit të kaluar ishte shumë e pavolitshme për shqiptarët, por imigrimi i popullsisë shqiptare pas këtyre viteve ndikoi në përmirësimin e saj. Prishtina si kryeqendër në vitin 1961 p. sh. kishte më pak se 50% shqiptarë (49,3%), më 1971 58,6%, më 1981 70,1% dhe në vitin 1991 (vlerësimi) kjo pjesëmarrje e tyre rritet në rreth 77,0%. Në vitin 1961 p.sh. rreth 17%, më 1971 rreth 23% dhe më 1981 vetëm rreth 29% të shqiptarëve jetonin në qytete dhe kryesisht në periferi të tyre, nëpër shtëpi private, shpeshherë pa elemente themelore të jetës urbane. Në vitin 1981 në numrin e gjithmbarshëm të popullsisë urbane shqiptarët merrnin pjesë me 68,9%, edhe pse ata përbënin më se 77% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës; sa i përket pjesëmarrjes së tyre në qytete shqiptarët ishin nën mesataren e Kosovës, ndërsa në fshat mbi këtë mesatare.[10] Këto raporte janë ruajtur kryesisht deri në mars të vitit 1999, meqenëse migrimet fshat-qytet, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike në vendbanimet urbane, të imponuar nga pushteti okupues serb, nuk ishin intensive sikurse deri në gjysmën e viteve të 80-ta.

Shkallë më të lartë të urbanizimit dhe më të ulët të ruralitetit në Kosovë kishin nacionalitetet joshqiptare: romët, malazezët, turqit, serbët dhe myslimanët. Sipas regjistrimit të vitit 1961 në qytete jetonin 36,3% të malazezëve dhe 20,3% të serbëve, ndërsa më 1981 kjo pjesëmarrje rritet te malazezët në 70,0% dhe te serbët në 38,1%. Mirëpo, sa i përket anës kualitative të urbanizimit malazezët dhe serbët kishin pozitë edhe më të mirë, sepse gati të gjithë pjesëtarët e tyre të moshës aktive ishin të punësuar në sektorin shoqëror të ekonomisë; norma e punësimit më 1971 dhe 1981 ishte te malazezët 22,7 dhe 27,5; te serbët 14,3 dhe 21,5; te shqiptarët 5,8 dhe 9,3.

[10] H. Islami, *Fshati i Kosovës,* f. 178.

Serbët dhe malazezët ishin të koncentruar në bërthamat e qendrave urbane, kryesisht në banesat shoqërore (mënyra urbane e jetës) dhe më tepër ishin të punësuar në administratë, në drejtorate, kontabilitet, banka, në shërbimet sociale e shëndetësore, në komunikacion, tregti dhe në veprimtari sekondare, ndërsa më pak në botën e jashtme.[11]

Edhe sa i përket fondit të banesave serbët dhe malazezët gjithashtu ishin shumë të privilegjuar: sipas regjistrimit të vitit 1981, nga numri i përgjithshëm i banesave në pronësinë shoqërore në Prishtinë (8.075 banesa, që përbënte një të tretën e fondit banesor të Kosovës), raporti në fondin e banesave dhe në popullsinë e qytetit ishte: serbët 38,0%:15,6%; malazezët 11,0%:3,8%; shqiptarët 41,0%:70,1%; myslimanët 3,0%:2,3%; turqit 2,0%:1,7% dhe romët 1,0%:1,4%. Me banesa shoqërore më shumë dispononinin malazezët (84,7% të tyre), "jugosllavët" (82,7%) dhe myslimanët (60,5%), ndërsa më pak shqiptarët (vetëm 26,9%).[12] Prandaj, teza e shpifur nga qarqet serbo-jugosllave në vitet e 80-ta të shekullit XX se joshqiptarët, veçanërisht serbët ishin të diskriminuar, ndërsa shqiptarët të privilegjuar nuk kishte asnjë mbështetje. Teza ishte një konstruksion i kulluar me qëllim të ndjekjes sa më të madhe të shqiptarëve, për çka Serbia e kishte përfituar gjithë Jugosllavinë e atëhershme, e cila edhe e financonte represionin policor dhe politikën segregacioniste ndaj shqiptarëve. Pas vitit 1981 shqiptarët haptas diskriminohen në të gjitha sferat e jetës, pra edhe në fondin e banesave, ndërsa pas rrënimit të autonomisë më 1989 shqiptarët nuk marrin më pothuajse asnjë banesë në pronësinë shoqërore, kurse një vit më vonë, pas përjashtimit nga puna, një numri jo të vogël të tyre do t'u merren edhe banesat që i posedonin. Në vitet e 90-ta ardhja e shqiptarëve në qytete bëhet simbolike.

4. Imigrimi i popullsisë dhe kultura urbane

Imigrimet e konsiderueshme në qytetet e Kosovës që nga fundi i viteve të 60-ta ndikuan në rritjen dhe ashpërsimin e shumë problemeve edhe ashtu të grumbulluara: mori përmasa të gjera ndërtimi "i egër", që solli vështirësi dhe pasoja të reja, për çka organet komunale ishin të detyruara të ndërmerrnin masa përkatëse në evitimin e kësaj dukurie, dhe u rrit shkalla e papunësisë.

---

[11] H. Islami, "Razlike u nivou urbanizacije između stanovništva nacionalnosti Kosova", *Geographica Slovenica,* 10, Ljubljana, 1980, f. 177-183; H. Islami, "Demografski problemi Kosova i njihovo tumačenje", *Zbornik Kosovo-Srbija-Jugoslavija,* KRT, Ljubljana, 1989, f. 39-66.

[12] *Sociološka studija grada Prištine,* Ekonomski institut, Priština, 1986, f. 40-41.

Shumë pjesë të periferive të qyteteve tona, veçanërisht të shtatë qendrave rajonale të Kosovës (Prishtina, Mitrovica, Peja, Prizreni, Gjakova, Gjilani dhe Ferizaji), me funksione të shumënduarshme shoqëroro-ekonomike, kulturore, administrative dhe politike, nuk arritën të inkuadroheshin në dinamikën shoqëroro-urbane edhe sot e gjithë ditën. Në këto pjesë të bashkësisë sonë urbane si për nga fizionomia, ashtu edhe për nga determinantet e mënyrës së jetesës vërehen elementet dhe strukturat rurale, e të mos flasim për mentalitetin fshatar. Disa nga këto pjesë madje janë edhe pa elemente të standardit jetësor e shoqëror, të ndotura deri në skajshmëri, etj. Imigrantët nga fshati, në këto pjesë bartën me vete një varg karakteristikash të kulturës dhe sjelljeve tradicionale, sepse te shumë sish, me kalimin nga fshati në qytet ose nuk ndryshoi, ose fare pak ndryshoi edhe pozita e tyre sociale dhe veçanërisht mënyra e tyre e jetesës: kultura e ushqimit, e banimit, e higjienës, e veshmbathjes, e mentalitetit, e sjelljes etj. Një dukuri e tillë në sociologji njihet si "ruralizim" ose si "fshatarizim" i qyteteve", e që shpeshherë përdoret me ironi dhe pejorativizëm.

Shumë qendra komunale dhe bërthama urbane të Kosovës në vitet e 70-ta, në krahasim me vitet e mëparme, pikërisht për shkak të imigrimeve intensive nga vendbanimet rurale kishin shënuar rritje të numrit absolut të popullsisë agrare, si një nga indikatorët e rëndësishëm të ruralizimit të qyteteve, shumë ekonomi familjare do të ruanin kafshë në qytete dhe do të ndërtonin stalla për to, të ballafaquara me mungesë të pajimit të banesave me instalime themelore (ujësjellës, kanalizim, rrymë elektrike etj.), me përqindje të konsiderueshme të analfabetëve edhe të moshave të reja dhe të mesme, me numër relativisht të madh të anëtarëve për një ekonomi familjare, etj. Në periudhën 1961-1971 rritje të konsiderueshme të kësaj popullsie kishin shënuar Ferizaji, Gjilani, Prishtina, Mitrovica, Podujeva, Deçani, Rahoveci, Suhareka, Klina etj. Në këto qendra rritja e numrit absolut të popullsisë bujqësore është rezultat i ardhjeve të konsiderueshme të popullsisë nga fshati me profesion agrar, ndërsa në disa vendbanime të tjera të urbanizuara më vonë, përveç imigrimeve, rritja e kësaj popullsie është pasojë e strukturës së tyre të pavolitshme socioekonomike. P.sh. Rahoveci si qendër komunale kishte në vitin 1971 53% të popullsisë bujqësore, edhe pse kishte përqindje më të vogël të popullsisë allohtone (vetëm 12%), ndërsa Klina, Vitia e Suhareka mbi 45% dhe Deçani, Burimi e Drenasi mbi 35%, etj. Edhe sipas regjistrimit të vitit 1981, ndonëse ndërrimi i definicionit të popullsisë bujqësore shkonte në favor të zvogëlimit të kësaj popullsie, megjithatë disa vendbanime urbane e të urbanizuara ruajtën përqindje të lartë të popullsisë agrare, sikurse Rahoveci (32%), Vitia (19%), Deçani (17%), Suhareka (14%), Istogu (13%) etj.

Për ekzistimin e strukturave rurale në qytetet e Kosovës dëshmon edhe fakti se, sipas regjistrimit të vitit 1981, këto vendbanime kishin 8.960 ekonomi

familjare bujqësore, të cilat ruanin 9.448 krerë gjedhe, 1.698 kuaj, 9.836 copë dhen, 4.174 derra, 76.587 copë shpezë dhe 3.845 zgjoje bletësh. Para viteve të 80-ta numri i ekonomive familjare që merreshin me bujqësi, si dhe fondi i shtazëve që i ruanin ato në qytete ishte shumë më i madh. Në qendrat urbane të Kosovës si rezultat i imigrimit të ekonomive familjare nga fshati me numër të konsiderueshëm anëtarësh, ka shënuar rritje edhe madhësia e tyre mesatare: prej 5,0 anëtarë në vitin 1971 në 5,5 anëtarë në vitin 1981, ndërsa përqindja e ekonomive familjare me 8 e më tepër anëtarë në vitin 1981 ishte 20,5%, që ende tregon praninë e tipit të familjes së zgjeruar.

Vendbanimet urbane e të urbanizuara të Kosovës kishin deri vonë në gjysmën e dytë të shekullit XX një numër të konsiderueshëm edhe të *popullsisë analfabete*. Sipas regjistrimit të vitit 1971 më se 25% të popullsisë që nuk dinte shkrim-lexim e kishin Deçani, Vuçitërna, Suhareka, Rahoveci, Gjakova, Gllogoci, Podujeva, Gjilani, Klina dhe Ferizaji, ndërsa të gjitha qytetet dhe qendrat tjera komunale, pos Leposaviqit (nën 10%), kishin mbi 20% të popullsisë analfabete (Istogu, Kamenica, Lipjani, Peja, Prishtina, Prizreni, Skenderaj dhe Vitia). Sipas regjistrimit të vitit 1981, përkundër zvogëlimit të dukshëm të shkallës së analfabetizmit, në vendbanimet urbane të Kosovës mbetën 51.197 ose 13,4% të analfabetëve të moshës mbi 10 vjet dhe ndër ta 3.451 ose 3,0% të moshës 10-19 vjet. Midis 10% dhe 20% të popullsisë analfabete kishin Rahoveci, Kaçaniku, Vushtria, Podujeva, Deçani, Istogu, Gjilani, Ferizaji, Gllogovci dhe Gjakova, kurse qytetet dhe qendrat e tjera komunale kishin nivel të analfabetizmit kryesisht rreth mesatares së bashkësisë urbane të Kosovës.

Sa i përket *pajimit të banesave me instalime të nevojshme*, ndonëse ndryshimet janë të mëdha në periudhën 1971-1981, megjithatë gjendja nuk është e kënaqshme. Në vendbanimet urbane të Kosovës në vitin 1981 nga 87.627 banesa sa ishin të evidencuara, 55.575 ose 63,4% kishin ujësjellës, kanalizim dhe rrymë elektrike, 14.054 ose 16,0% ujësjellës dhe rrymë elektrike dhe 19.829 banesa ose 19,1% e tyre posedonin vetëm rrymë elektrike; pa asnjë instalim ishin 1.144 banesa ose 1,3% e tyre. Dhjetë vjet më parë, për shkak të mungesës së infrastrukturës komunale, situata ishte më e pavolitshme. Në instalimet themelore dallimet janë shumë të mëdha midis shtatë qendrave urbane me funksione rajonale dhe vendbanimeve të tjera urbane dhe selive komunale. Shumë qendra urbane e bërthama të urbanizuara, më pak se 50% nga numri i përgjithshëm i banesave dhe shumë nën mesataren e Kosovës (63,4%) kishin ujësjellës, kanalizim dhe rrymë elektrike, sikundër ishte rasti me Podujevën (21,8%), Vitinë (27,3%), Deçanin (34,3%), Suharekën (35,3%), Burimin (36,3%), Kaçanikun (38,4%), Vushtrinë (42,8%), Sharrin (Dragashi) (43,0%), Ferizajn (45,3%), Drenasin (Gllogoci) (46,6%).

Sa i përket pajimeve komplete, gjendje më të volitshme kishin Prizreni (83,9%), Prishtina (71,8%), Leposaviqi (71,4%), Mitrovica (68,5%), Gjilani (65,9%), Gjakova (60,9%) dhe Peja (59,0%). Në qendrat e urbanizuara më vonë numri më i madh i banesave kishte vetëm rrymë elektrike (Podujeva 57,4%, Vitia 49,0%, Deçani 45,2%, Ferizaji 42,8%, Burimi 42,1% etj.), sikundër që pa instalime themelore numri më i madh i banesave gjendej në këto qendra. Në vitin 1991, disa qendra komunale, në mbështetje të ligjit mbi organizimin territorial të komunave nga viti 1981 nuk përmbushnin kushtin e statusit të qytetit, çfarë ishte rasti me Artanën (Novobërda) (463 banorë), Z. Potokun (2.033), Shtërpcën (2.200), Malishevën (2.656), Shtimen (6.657), Skenderajn (4.692).

Çështja e asimilimit dhe e integrimit të të ardhurve nga fshati në mënyrën urbane të jetës dhe në kulturën e qytetit në përgjithësi është mjaft e vështirë dhe afatgjate. Dhe sapo kishte nisur integrimi i shqiptarëve të ardhur në këto tredhjetëvjetsha nga fshatrat në qytete, pas dëbimit të forcave serbe në qershor të vitit 1999 dhe djegies e shkatërrimit të më se 100.00 shtëpive të shqiptarëve në zonat rurale, pasoi një valë e re "e fshatarizimit" të qendrave tona urbane, e panjohur deri atëherë. "Ruralizimi" ekspansiv dhe i pakontrolluar i përfshiu sidomos qendrat mezorajonale dhe në mënyrë të veçantë kryeqendrën, Prishtinën, me ç'rast u ashpërsuan shumë probleme, para së gjithash sociale: norma e papunësisë sot mund sillet midis 65 dhe 70%, ku një numër i madh i familjeve, pas ndërprerjes së ndihmave humanitare, ballafaqohet edhe me minimumin ekzistencial. Ndërkaq, pasojat e braktisjes së fshatrave janë po ashtu të mëdha si në rrafshin demografik, ashtu edhe në atë socioekonomik.

Studimi i mirëfilltë i të gjitha aspekteve të jetës dhe kulturës urbane në qytetet tona dhe në qendrat e urbanizuara do të nxirrte në shesh shumë dallime dhe probleme, të cilat tashmë edhe pa hyrë në procese të brendshme mund të hetohen edhe në pikëpamje fizionomike. Vështrimi i hollësishëm i sjelljes dhe i elementeve të tjera urbane nxjerr në pah se këta komponentë të kulturës urbane mungojnë edhe te një pjesë e popullsisë autoktone të vendbanimeve tona kryesisht vonë të urbanizuara, por edhe të qendrave urbane që kanë histori më të gjatë dhe atë jo vetëm te ajo pjesë që jeton në pjesët periferike të qyteteve, por edhe në brendinë e tij, madje edhe në bërthamën e tij. Qytet konsiderohen shumë pjesë të qendrave tona komunale, që nuk kanë asnjë objekt të infrastrukturës bashkëkohore urbane, me stalla të kafshëve, kotece të pulave dhe shumë të ndotura. Pjesëtarë të bashkësisë urbane e trajtojnë veten edhe ata banorë të cilët në qytet ushtrojnë profesione bujqësore, nuk dinë shkrim-lexim dhe në përgjithësi nuk posedojnë kulturë urbane.

Plaçkitjet, uzurpimet, kërcënimet, sjelljet agresive dhe deliktet e ndryshme, gatishmëria për të krijuar situata kaotike, mosrespektimi i normave urbane, gjuajtja e bërllokut përmes dritareve, derdhja e ujit, zhurma në orët e vonshme të natës dhe mungesa e edukatës urbane etj., janë pjesë përbërëse e procesit të "fshatarizimit" të qyteteve tona pas gjysmës së qershorit 1999. Imigrantët nga zonat rurale të instaluar në mjediset urbane, pa asnjë përgatitje për jetë të qytetit, vazhdojnë të bëjnë jetë fshatare dhe ta kultivojnë mentalitetin rural në gjithë dimensionin e tij. Ndërkaq sjelljet e disa grupeve të shqiptarëve, veçanërisht vjedhjet, kërcënimet, vrasjet e njerëzve për motive të ulëta dhe uzurpimet dëmtuan rëndë imazhin e Kosovës dhe të shqiptarëve në botë. Janë këto probleme që kërkojnë zgjidhje shumëdimensionale dhe afatgjate. Ndër sociologë ekzistojnë mendime se imigrantët e tillë integrohen në mjedisin e ri zakonisht në brezin e ardhshëm, për çka mund të konkludohet se fazat e para të asimilimit të brezit të parë të imigrantëve janë të rënda dhe të ndërlikuara. Në rrethanat e një pushteti të brishtë, të vakumit institucional dhe të mungesës së kulturës urbane në përgjithësi, kjo zgjidhje bëhet edhe më e ndërlikuar dhe më afatgjate në gjithë bashkësinë urbane të Kosovës.

5. Prishtina: nga qyteza deri te metropoli kaotik

Prishtina nga kasaba ballkanike në kohën turke, apo qyteza e vogël në pjesën e parë të shekullit XX jo vetëm për nga numri i popullsisë, por edhe për nga aspekti funksional shndërrohet në një metropol tipike për zhvillimet shoqëroro-urbane në Evropën Juglindore. Nga qyteza më 1948 nën 20.000 banorë (më e vogël se Prizreni), ku deri në fillim të viteve të 60-ta të shekullit të kaluar në jetën ekonomike do të dominojnë tregtia, zejtaria dhe bujqësia, kurse në jetën politike, administrative dhe tregtare do të dominojnë gjuha serbe dhe turke, në zhvillimet mëvonshme struktura funksionale do të bëhet e shumënduarshme, me reduktim të ndjeshëm të veprimtarisë bujqësore dhe gjithë sektorit primar, ndërsa këto gjuhë do të zëvendësohen me dominimin e gjuhës shqipe (nga 49,3% më 1961, numri relativ i shqiptarëve do të rritet në 70,1% më 1981 dhe sot mbi 95%).

Pas vënies së Kosovës nën protektorat ushtarak dhe civil ndërkombëtar, Prishtina do të shndërrohet në një metropol sui generis, ku, në një territor aq të vogël, pos shqiptarëve si popullatë dominante, do t'i gjejmë pjesëtarët pothuajse të të gjitha bashkësive etnike, gjuhësore, konfesionale dhe racore. Ndërsa sa i përket koncentrimit të popullsisë, në një anë, dhe kaosit urbano-shoqëror, në anën tjetër, ndër qendrat urbane të Kosovës, pa dyshim, do të prijë Prishtina si kryeqytet i vendit, ku mundësitë e uzurpimit të lokaleve dhe të

strehimit ishin më të mëdha për shkak të fondit më të madh të banesave në pronësi të serbëve, të cilët, për shkak të krimeve që kishin bërë mbi shqiptarët ose në mënyra të ndryshme ishin implikuar në to, kishin marrë arratinë dhe ishin ngulitur në zona urbane dhe rurale të Serbisë. Pas valës së parë të imigrimit nga fundi i viteve të 60-ta dhe fillimi i viteve të 70-ta, nga gjysma e vitit 1999 pasoi vala e dytë e imigrimit, e pashënuar deri atëherë në historikun e këtij qyteti. Dhe, krahas lindjes së brezave të reja në qytet dhe rritjes së përqindjes së popullsisë autoktone, sidomos të asaj shqiptare, dhe integrimit të pjesës dërmuese të saj në jetën urbane vërshoi ardhja e popullatës nga rrethinat e afërme, që sot po cilësohet si "fshatarizim" i ri i Prishtinës, me pasoja të shumënduarshme për jetën dhe kulturën urbane. Për grupet plaçkitëse, individët agresivë e "harambashët" dhe "komandantët e luftës" Prishtina vlente si qytet me pasuri përrallore.

5.1. Evolucioni popullativ i kryeqendrës

Sa mund të jetë numri i popullsisë së ardhur (i shqiptarëve) dhe, lidhur me të, sa banorë mund të ketë Prishtina sot, është një pyetje që shtrohet vazhdimisht këto vitet e fundit. Flitet për shifra të ndryshme, madje deri në 700.000 banorë! Të shohim së pari evolucionin e vëllimit demografik të Prishtinës në periudhën 1948-1999.

Tabela 5. Lëvizja e numrit të popullsisë së Prishtinës në periudhën 1948-1999[13]

Viti	Numri i popullsisë	Rritja në % në periudhën	
1948	19.631	1948-53	22,7
1953	24.081	1953-61	60.3
1961	38.593	1961-71	80,1
1971	69.514	1971-81	55,5
1981	108.083	1981-91	43,9
1991	155.499	1991-99	26,0
1999	195.000	1948-99	893,3

Në vitin 1948 Prishtina përbënte vetëm 15% të popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës dhe më 1961 18%, ndërkaq në vitet 1971-1991 kjo përqindje rritet në një të pestën e popullsisë urbane të Kosovës. Në periudhën 1948-1991 nga rritja e përgjithshme e popullsisë urbane të

[13] Burimi: për vitet 1948-1981 regjistrimet zyrtare të popullsisë; për vitet 1991 dhe 1999 (deri në fund të marsit) vlerësimi.

Kosovës, Prishtina merrte pjesë me rreth 23%. Duke u mbështetur në dinamikën e shtimit natyror të popullsisë së qytetit të Prishtinës në periudhën 1981-1991, që është rreth 32.000 banorë, dhe rritjes së përgjithshme të numrit të popullsisë, e cila sillet afër 50.000 banorë, kryeqendra jonë para krimeve gjenocidale të viteve 1998-1999 duhej të kishte afër 200.000 banorë. Në periudhën 1981-1991, përmes komponentit imigrues rritja ishte përreth 18.000 veta ose për afër 33%, ndërsa në periudhën 1991-1998 rritja e numrit të popullsisë përmes kësaj komponente do të sillej përreth 20.000 banorë, pa ndonjë dallim të madh nga periudha e mëparshme, sepse shqiptarët nuk vinin më në qytete as nga viset e tjera jashtë Kosovës e as nga vendbanimet e tjera brenda Kosovës si përpara për shkak të përjashtimeve masive nga puna, shkatërrimit të bazës ekonomike, përzënies së nxënësve dhe studentëve nga objektet shkollore e universitare, pengesave në marrjen e lejeve për ndërtimin e shtëpive, pasigurisë e paperspektivës sociale dhe komponentëve të tjerë të krizës materiale e psikologjike, etj. Ata që kishin vendosur ta braktisnin vendlindjen nuk kishin më pse të orientoheshin në Prishtinë, por ia mësynin Evropës. Në anën tjetër, është e vërtetë se një numër i serbëve vinte në Kosovë në kuadër të "kthyerjes" së tyre dhe kolonizimit, madje edhe serbë nga Kroacia dhe BeH, por në mënyrë të qetë një numër jo i vogël edhe e braktiste Kosovën, kryesisht ata të cilët, pas fitimeve të mira në Kosovë (nga të ardhurat personale dhe shitja më shtrenjtë e patundshmërisë) dhe përfundimit të karrierës së punës kishin krijuar të gjitha mundësitë për jetë të volitshme në zonat urbane të Serbisë (ndërtimi i shtëpive, blerja e banesave, kursimet etj.).

Para se të përgjigjemi në pyetjen sa banorë mund të ketë sot Prishtina, t'i vështrojmë disa të dhëna, të cilat janë të rëndësishme për të konstatuar gjendjen numerike të popullsisë, e që kanë të bëjnë me numrin e popullsisë sipas përkatësisë etnike dhe fondin e banesave. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 1961 Prishtina kishte vetëm 49,3% shqiptarë, më 1971 58,6%, ndërkaq më 1981 (regjistrimi), numri i shqiptarëve në Prishtinë ishte 75.803 (70,1%), i serbëve 16.898 (15,6%), i malazezëve 4.169 (3,9%), i romëve 5.101 (4,7%), i boshnjakëve 2.504 (2,3%), i turqve 1.922 (1,8%) etj. Serbomlazezët së bashku përbënin rreth 21.000 banorë (19,5%) ose afër 10% të numrit të gjithmbarshëm të tyre në Kosovë më 1981 (rreth 215.000 veta). Në vitin 1991 nga gjithsej 155.499 banorë, Prishtina kishte rreth 120.000 shqiptarë (rreth 77%), rreth 21.000 serbomalazezë (afër 13%), rreth 7.000 romë (4,5%) etj. Në bazë të statistikës vijuese vitale-demografike, shtimi natyror i shqiptarëve në Kosovë në periudhën prej 1991 deri 1999 (fillimi i muajit qershor) ishte

rreth 350.000 veta. Shtimi i përgjithshëm natyror i serbomalazezëve në periudhën 1991-1999 për Prishtinën është rreth 2.500 veta dhe i romëve afër 1.500 veta, që do të thotë se numri i serbomalazezëve në Prishtinë deri në gjysmën e vitit 1999 ishte rreth 24.000, të cilët përbënin rreth13,5% në numrin e gjithmbarshëm të popullsisë, i romëve rreth 8.000 (rreth 4,1%). Numri tjetër i takonte pakicave të tjera. Në prag të hyrjes së forcave ndërkombëtare, mund të vlerësohet se Prishtina ka pasur midis 30.000 dhe 35.000 serbomalazezë, romë e të tjerë joshqiptarë, ku pjesa dërmuese e tyre e kanë braktisur qytetin, duke i lënë pronat e paluajtshme. Këtu natyrisht është fjala për popullsinë e përhershme apo rezidenciale, e jo edhe për praninë e pjesëtarëve të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare.

Fondi i përgjithshëm i banesave shoqërore në Prishtinë në vitin 1981 (regjistrimi zyrtar) ishte 8.075 dhe serbomalazezët posedonin gjysmën e tyre (49,0%), pra 4.000 sish, ndërsa numri i shtëpive të tyre private sillej rreth 500 sish. Gjatë viteve të 80-ta, në emër të kthyerjes së serbomalazezëve dhe kolonizimit të Kosovës, me mjetet e ish-Federatës Jugosllave janë ndërtuar rreth 2.000 banesa, ku pjesa dërmuese u ishte ndarë serbëve, ndërsa gjatë viteve të 90-ta janë ndërtuar edhe 1.000 banesa të tjera, të gjitha për serbët. Gjithsej fondi i banesave shoqërore në Prishtinë për serbomalazezët deri në hyrjen e forcave ndërkombëtare duhet të sillej rreth 7.000 dhe rreth 500 shtëpi private, ndërsa madhësia mesatare e ekonomive familjare serbomalazeze nuk ka qenë më e madhe se 3,5 anëtarë. Afër 90% e këtij fondi sot banohet nga shqiptarët dhe madhësia mesatare e ekonomive të tyre familjare është dyfish më e madhe (7,5 anëtarë), që do të thotë se rreth 70.000 shqiptarë kanë mundur të vendosen në banesat serbomalazeze. Po le të jetë ky numër edhe më i madh, p.sh. 100.000 shqiptarë, të ardhur kryesisht nga fshatrat e Drenicës dhe të Llapit, dhe le të jenë ndërtuar këto vitet e fundit edhe rreth 2000 shtëpi banimi me afër 15.000 banorë. Kur t'i shtohet ky numër bazës demografike prej 155.000 shqiptarëve, atëherë del se Prishtina ka sot rreth 270.000 shqiptarë. Le të jenë edhe disa mijëra të tjerë, turq, boshnjakë, serbomalazezë të mbetur, Prishtina në asnjë mënyrë nuk mund të ketë më shumë se 300.000 ose më shumë se 350.000 banorë, si popullatë e përhershme apo rezidenciale, sepse fondi i banesave, me gjithë rritjen e ndërtimeve individuale, nuk mund të absorbojë më shumë; disa banesa e shtëpi të serbëve, edhe nëse i kanë blerë shqiptarët, i shfrytëzojnë të huajt me qira. Ndërsa pjesa më e madhe e shtëpive të romëve nuk janë të banuara nga shqiptarët për arsye se shumica janë të djegura. Prishtina duket se është dendësuar shumë nga prezenca e të huajve: ushtarë, policë, humanitarë, vëzhgues, turistë, kalimtarë etj., por edhe e shqiptarëve që qarkullojnë gjatë ditës me vetura të shumta nga rrethinat e afërme dhe

ushtrojnë presion në jetën e gjithmbarshme të qytetit. Për Prishtinën numri prej 300.000 deri 350.000 banorëve të përhershëm nuk është i vogël kur të kihen parasysh problemet në sferën e punësimit, të banimit, të infrastrukturës, të shërbimeve shëndetësore, të hapësirës shkollore, të funksioneve të tjera bazë të zhvillimit urban etj.

5.2. Ana funksionale e urbanizimit

Forcimi i pozitës politike-konstitucionale të Kosovës (1968) dhe hapja e Universitetit të Prishtinës (1970) ishin ndër faktorët më të rëndësishëm të koncentrimit demografik - imigrimit të popullsisë si nga vendbanimet rurale dhe urbane të Kosovës, ashtu edhe nga territoret e tjera etnike shqiptare: Maqedonia, Mali i Zi dhe tri komunat në lindje të Kosovës (Presheva, Bujanoci dhe Medvegja). Kthesën më të madhe si duket e bëri Universiteti i Prishtinës dhe zgjerimi i arsimit i të gjitha niveleve. Universiteti intensifikoi migrimet ndërshqiptare dhe hapi mundësi për një integrim të madh të trojeve etnike shqiptare në shumë sfera të jetës, në radhë të parë të afrisë përmes bashkësive e martesave. Këtë rol në sistemin totalitar të seleksionimit negativ të studentëve nuk e kishte luajtur p. sh. Universiteti i Tiranës.

Tempon e zhvillimit urban të Prishtinës e shpejtoi edhe përqendrimi i funksioneve të tjera, siç janë funksioni ekonomik, veçanërisht në rrethinën e saj të drejtpërdrejtë, funksioni shëndetësor, tregtar, i komunikacionit, koncentrimi i enteve dhe i institucioneve të tjera shoqërore, kulturore dhe shkencore. Krijimi i ekonomive familjare me dy burime të të ardhurave, bujqësore dhe jobujqësore, në rrethinën e Prishtinës dhe lëvizja e fuqisë punëtore brenda ditës prej vendit të banimit në vendin e punës dhe anasjelltas, mundësoi kontaktet e përditshme me qytetin dhe bartjen e elementeve bashkëkohore në rrethinë. Duke kaluar nëpër fazën përgatitore, kalimi i kësaj popullsie nga rrethinat rurale në Prishtinë e lehtësoi adaptimin në jetën shoqëroro-urbane.

Shumë struktura dhe karakteristika të jetës tradicionale, siç dihet, e përshkonin Prishtinën, por ato sikur vëreheshin më qartë pas valës së parë të imigrimit para më se tre dhjetëvjetëshave përmes gjendjes jo të kënaqshme të banimit, mënyrës dhe strukturës së ushqimit, veshmbathjes, infrastrukturës komunale, mentalitetit, sjelljes etj. Shfaqeshin anomali të shumta, veçanërisht te pjesa e ardhur e popullsisë nga vendbanimet rurale, e cila sikur gjendej në një vakum: ishte shkëputur ose së paku ekzistonte tendenca e vazhdueshme që të shkëputej nga mjedisi dhe vlerat rurale, autentike dhe burimore, mirëpo vështirë dhe ngadalë i përvetësonte vlerat e

reja të kulturës urbane, që është e kuptueshme nga se integrimi në jetën plotësisht urbane është proces i ndërlikuar dhe afatgjatë. Kjo shtresë e popullsisë, e ngulitur kryesisht në periferi të qytetit, në mungesë të angazhimit shoqëror, ishte lënë gjatë kohë në mëshirën e vetvetes. Prandaj, ndjenja e inferioritetit social dhe kulturor e imigrantëve nga mjediset rurale manifestohej në forma të ndryshme, shpeshherë me shkeljen e normave të sjelljes urbane dhe agresivitetin e shtuar.

Sa i përket pajimeve me instalime themelore, Prishtina para 30 viteve, ndonëse gjendej në situatë shumë më të volitshme në krahasim me qendrat e tjera urbane, megjithatë, rreth 28% të banesave nuk posedonin instalimet e nevojshme. Madhësia mesatare e ekonomive familjare ishte rreth 5 anëtarë (te shqiptarët mbi 7 anëtarë), ndërsa përqindja e popullsisë që nuk dinte shkrim-lexim arrinte në një të pestën e popullatës mbi 10 vjet. Regjistrimi i vitit 1971 nxori në pah një indikator shumë interesant: pjesëmarrja e popullsisë autoktone, pra e popullsisë që kishte lindur në Prishtinë, ishte rreth 45%, ndërsa 55% e popullsisë ishte e ardhur nga rrethinat e ndryshme të Kosovës dhe jashtë saj. Ndonëse nuk kemi të dhëna për saldon e vërtetë migruese, megjithatë, në bazë të një imigrimi markant të popullsisë shqiptare pas qershorit të vitit 1999, kryesisht nga zonat rurale përqindja e popullsisë autoktone e kryeqendrës sonë nuk duhet të jetë shumë e lartë dhe mund të sillet jo më tepër se midis 60-65%.

5.3. Urbanizimi i dhunshëm dhe problemet aktuale

Është çështje shumë diskutabile se a janë të gjithë banorët e Prishtinës së sotme njëmend popullsi urbane. Prishtinë i thuhet edhe pjesës midis dy hoteleve në qendër, "Grandit" dhe "Ilirisë", por Prishtinë janë edhe plotë pjesë më larg qendrës, dendur të banuara, ku mungojnë objektet përkatëse infrastrukturore dhe të standardit, të domosdoshme për jetë urbane. Prishtina është ndër qytetet e rralla në Evropën Juglindore që nuk ka objekte për nevoja ditore të qytetarëve: nevojtore, çezme, banja publike etj. Vetëm disa qindra metra larg qendrës së kryeqytetit i hasim stallat e kafshëve, kotecet e pulave, grumbujt e plehut, rrethojat prej llamarinës, etj, ndërsa bërllokun do ta gjejmë edhe në bërthamën e qytetit! Ndonëse qytet i ri, Prishtina nuk ka parkingje, parqe etj. Atëherë çka mbetet për të thënë për mënyrën e jetesës dhe kulturën e sjelljes në pjesët periferike të Prishtinës dhe sidomos të qendrave të tjera urbane e të urbanizuara të Kosovës, çfarë është rasti me disa seli komunale, që me asnjë kriter nuk mund të konsiderohen qytet. Prishtinas e konsiderojnë veten edhe ata pjesëtarë të cilët si profesion e kanë bujqësinë apo çdo ditë shiten si argatë dhe hamallxhinj, janë analfabetë dhe

pa kulturë urbane, ndërsa ekonomitë e tyre shtëpiake me shumë anëtarë dhe pa elemente të domosdoshme për jetë të qytetit (kanalizimi, ujësjellësi, telefoni, madje edhe rryma elektrike).

Kur të vështrohen dallimet në aspektin kualitativ të urbanizimit dhe të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror të Prishtinës sikur hetohen shumë fshehtësi: nuk është njësoj të jetosh në qytet, madje të jesh edhe i punësuar, por është me rëndësi ku jetohet në qytet, në cilën pjesë të tij, si jetohet në të, cilit profesion apo grupacion social i përket, çfarë është vendi i të punësuarve në shkallën e të ardhurave, çfarë është cilësia e jetës dhe niveli kulturor i popullsisë urbane, etj. Nga aspekti i kulturës urbane është shumë me rëndësi se sa është tradita e gjatë e jetesës në bashkësinë urbane. Imigrimi më markant dhe më i pakontrolluar pas luftës në Prishtinë ka krijuar një gjendje, që mund të cilësohet si anarkike ose "terror urban". Konflikti midis mentalitetit bashkëkohor-urban dhe atij tradicional-rural, nga vala e fundit e imigrimit, si dhe integrimi i imigrantëve në jetën urbane me gjasë do të zgjasë të paktën edhe një brez, dukuri kjo që njihet edhe në sociologjinë urbane.

Koncentrimi i madh, që ka krijuar urbanizimin e dhunshëm, ka shkaktuar probleme të mëdha edhe në rrafshin social, ku shumë ekonomi familjare, pas ndërpritjes së ndihmave humanitare kanë ardhur buzë ekzistencës dhe kësisoji është lënduar rëndë kultura urbane dhe zhvillimi i qytetit në përgjithësi. Infrastruktura dhe fondet sociale e komunale ekzistuese nuk mund ta absorbojnë një numër kaq të madh të njerëzve dhe të veturave të llojeve të ndryshme. Komunikacioni automobilistik për rrethanat tona sikur ka marrë përmasa të një "revolucioni" në zhvillimin urban; rrugët, trotuaret, parkingjet janë të ngulfatura dhe infrastruktura aktuale komunikative nuk mund ta gëlltisë lëvizjen dhe numrin e madh të makinave dhe të njerëzve. Ndër veprimtaritë shërbyese dominojnë kafeteritë, bufetë dhe dyqanet e shumta, ndërsa mungojnë kapacitetet prodhuese. Mbeturinat e grumbulluara i hasim në çdo kënd të qytetit! Edhe qentë endacakë, të rrezikshëm për jetën e njerëzve, veçanërisht të fëmijëve, janë bërë pjesë e kësaj përditshmërie të hidhur të kryeqytetit.

Pas hyrjes së forcave ndërkombëtare më 12 qershor 1999 Prishtina si kryeqendër sikur u bë sinonim i së keqes. Sikur dukuria më negative ishin kërcënimet dhe sjelljet agresive të individëve dhe grupeve me qëllim të uzurpimit të pasurisë shoqërore dhe të pronave të joshqiptarëve, por edhe të shqiptarëve, pastaj ndërtimet pa leje dhe shkelja e të gjitha normave të jetës urbane. Po të mos ishin forcat e huaja, të KFOR-it dhe të UNMIK-ut, "terrori urban" nuk do të ndalej. Nuk doli krejtësisht e vërtetë se të pastrehët, kryesisht nga Drenica dhe Llapi, ia mësynë Prishtinës. Nëse një

individ ose një familje i zaptonte nga disa banesa dhe lokale shoqërore, atëherë nuk ishte fjala për njerëz me shtëpi të djegura në zonat rurale. Pastaj ndërtimet mbi kulme, madje mbi ndërtesa të ngritura para 40 e 50 vjetësh, janë një dukuri që sot e gjithë ditën i trembë njerëzit me rreziqe për jetën e dhjetëra familjeve në objektin përkatës. Këto ndërtime, gjithashtu, i bënë ata qa kishin shtëpi dhe banesa në Prishtinë e gjetiu e jo të pastrehët nga zonat e luftës. Dukuria e uzurpimeve dhe e ndërtimeve pa leje ishte edhe më shqetësuese kur bartësit e saj dilnin të ashtuquajturit komandantë rajonalë dhe udhëheqësit e parë vendorë, të vetemëruar, të komunës së Prishtinës. Përpjekja për ta ndalur këtë dukuri shëmtuese për qytetin rezultoi me vrasjen e përgjegjësit të zhvillimit urban të Prishtinës më 11.9.2000, inxh. Rexhep Lucit, që ishte ekspert i njohur në fushën e urbanizmit. [14] Në vitet e para të pasluftës, kërcënimet dhe vrasjet i frikësuan bartësit e organeve komunale të ndërmerrnin diçka në parandalimin e kësaj dukurie.

Organet komunale, vendore dhe ndërkombëtare, si dhe qytetarët e Prishtinës gjithsesi gjenden para sfidave të mëdha në zgjidhjen e problemeve të shumta dhe në kapërcimin e situatës kaotike në qytet, e cila, mjerisht, ende vazhdon. Është domosdoshmëri urgjente ndërpritja e korrupcionit të vetë krerëve të pushtetit komunal dhe ndërtimi i infrastrukturës ligjore dhe ndërmarrja e masave energjike mbi këtë bazë për pengimin e ndërtimeve pa leje. Thirrja e njerëzve më përgjegjës të Kosovës për legalizimin e ndërtimeve "të egra" ishte dëshmia dhe shëmtimi më i madh që mund t'i bëhej kryeqytetit të vendit, thirrje kjo që rezultoi me përfitime të shumëta të strukturave korrupcioniste dhe mafioze.

[14] Pas vrasjes së inxh. Rexhep Lucit, Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, me inxh. Lulëzim Nixhën në krye, u bë bartësi kryesor i ndërtimeve "të egra", i mbindërtimeve, i disa firmave projektuese në emër të tij dhe të familjarëve (tenderët fitimprues për planet rregulluese), i granitit rrezatues në qendër të qytetit dhe i kaosit urban në përgjithësi në kryeqendrën tonë. Qytetarëve të Prishtinës, në kujtesën e tyre, do t'u mbeten të pashlyeshme dhe ëndërrat e Nixhës: "treni qarkor", "metroja", "parkingjet nën dhe", etj.

Pjesa e shtatë

SHQIPTARËT NË DIASPORË

I. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË DIASPORËS HISTORIKE DHE BASHKËKOHORE SHQIPTARE

1. Ndarja nga trungu i përbashkët gjeokombëtar

Në botë ka sot pjesëtarë të shumë popujve dhe grupeve etnike, të cilët për arsye të ndryshme janë ndarë nga trungjet e tyre të para etniko-gjeografike, duke u vendosur larg tyre, madje edhe në kontinentet e tjera. Shprishje të mëdha të popujve ndodhën që nga koha e invadimeve të fiseve barbare, që njihen si dyndje të mëdha të popujve dhe lidhen me kalimin nga jeta endacake në jetën e ngulitur (gjysma e shek. IV deri në gjysmën e shek. VII). Gjatë dhjetë shekujve të fundit dhe veçanërisht pas zbulimeve të mëdha gjeografike dhe kolonizimit të "Botës së re", kur migrimet e bashkësive etnike, raciale e gjuhësore morën përmasa të gjera dhe pasqyra etniko-demografike e ekumenës sonë pësoi ndryshime të mëdha, të cilat u shpejtuan me revolucionin teknik dhe atë të komunikacionit. Procesi i formimit të diasporave[1] lidhet ngushtë edhe me pushtimet e mbretërive të mëdha dhe konfliktet midis shteteve e kombeve dhe konfesioneve të tyre, si dhe me zgjerimin e njerëzimit dhe ndryshimin e hartës popullative të botës.[2] Në këtë mënyrë janë formuar diasporat historike dhe bashkëkohore, të vogla ose të mëdha, të shumë popujve. Migrimet si përcjellës permanent në evolucionin e njerëzimit dhe, lidhur me to, krijimi i diasporave, lanë gjurmë të rëndësishme në jetën e popujve, të grupeve të ndryshme të popullsisë, të familjeve dhe të individëve.[3]

Shqiptarët në periudhat e hershme historike kishin një shtrirje të gjerë gjeografike dhe gjatë kohë jetuan në një truall territorialisht të pakëputur. Mirëpo, më vonë, rrjedhat e pavolitshme historiko-politike dhe rrethanat e rënda ekonomiko-sociale ndikuan që të rrudhej si hapësira e dikurshme etniko-gjeografike, ashtu edhe vëllimi demografik në territorin kompakt etnik të tyre. Së pari, pasoi procesi i *asimilimit*, veçanërisht në periudhën antike (romanizimi)[4] dhe në mesjetë (sllavizimi),[5] ndërsa pastaj, nga trungu i përbashkët

---

[1] Fjala diasporë do të thotë shprishje, shkepje, shpërndarje, shkapërderdhje.

[2] L. Dollot, *Les migrations humaines,* PUF, Paris, 1976, pp. 13-24; W.-H. McNeill (sous la direction de), *Human Migration – Patterns and Policies,* Londres, Indiana University Press, 1978, pp. XVIII-442.

[3] M. Sorre, *Les migrations des peuples (Essai sur la mobilité géographique),* Flammarion, Paris, 1955, pp. 9-18; P. George, *Les migrations internationales,* PUF, Paris, 1976, pp. 1-232.

[4] Z. Mirdita, "Rreth problemit të romanizimit të dardanëve", *Kuvendi I i studimeve ilire, II*, Tiranë, 1974, ff. 171 -180.

[5] Shih më hollësisht: S. Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV - XVI*, Tiranë, 1984, ff.3-712.

gjeokombëtar u hapën rrugët për *shpërngulje intensive e të pandërprera* të shqiptarëve në drejtime të ndryshme. Migrimet e shqiptarëve dhe krijimi i diasporës së tyre lidhen gjithashtu me disa nga ngjarjet dhe zhvillimet e përgjithshme të zëna në gojë, por karakteristike për hapësirat ballkanike.

Shqiptarët u ngulitën në shumë vende dhe vise të botës, madje edhe shumë larg atdheut të tyre, përtej deteve dhe oqeaneve. Prej shekullit XIV e më herët dhe veçanërisht prej shekullit XV, masa të konsiderueshme shqiptarësh shpërngulen nga territoret e tyre të para dhe vendosen në Greqi, Itali dhe më vonë në Rumani, Bullgari, Turqi, Egjipt, Siri etj. Pas shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Serbia (spastrimi etnik) nga fundi i shekullit XIX, pastaj në shekullin XX, prej luftërave ballkanike, gjatë tërë periudhës midis dy luftërave botërore, si dhe pas Luftës II Botërore, një numër i madh i shqiptarëve emigron në SHBA dhe përgjithësisht në truallin e Amerikës, në disa vende të Evropës së Mesme, pastaj në Australi e në Zelandë të Re dhe veçanërisht nga ish-Jugosllavia në Turqi, që paraqet ngulimin më të madh jashtë trungut amë. Në këto 3-4 dhjetëvjetëshat e fundit migrimet relativisht masive të shqiptarëve u orientuan në vendet evropiane, në fillim si fuqi punëtore, që është edhe burim kryesor i zgjerimit numerik dhe hapësinor të komunitetit shqiptar në ato vende, ndërsa më vonë edhe i kategorive të tjera të popullsisë. Derisa në fillim migrantët tanë cilësoheshin si punëtorë përkohësisht të punësuar në vendet industrialisht të zhvilluara evropiane, ndërkaq sot, për nga dimensioni dhe cilësia, tashmë mund të flitet për mërgatë, për diasporë.

Vlerësohet se aktualisht jashtë hapësirës kompakte gjeoetnike të shqiptarëve në vendet perëndimore gjenden afër 1 milion shqiptarë dhe rreth gjysma e tyre emigruan këto katër deceniet e fundit. Prijnë Amerika në tërësi, Gjermania, Zvicra, pastaj vijnë vendet e tjera të zhvilluara të Evropës. Shqiptarët në Turqi, rrjedhat e emigrimit dhe të ngulitjes, numri, problemi i identitetit të tyre etj. janë çështje në vete, sikundër që është problem i veçantë diaspora historike (arvanitasit dhe arbëreshët). Rrudhja e dimensionit etniko-demografik të shqiptarëve, mjerisht, vazhdon edhe sot: Manastiri me rrethinën e gjerë, Medvegja me rrethinë dhe fshatrat e Malësisë së Bujanocit e Preshevës gati u zbrazën!

2. Shkaqet dhe pasojat e shprishjes

Migrimet e jashtme për popullsinë që është e përfshirë në to, implikojnë vendin (shtetin) e prejardhjes dhe vendin e ardhjes apo të ngulitjes. Emigrimet e shqiptarëve nga territoret e para etniko-gjeografike të tyre, në një apo në disa etapa (migrimet dhe ngulimet e disahershme) në asnjë periudhë dhe pothuajse

në asnjë vend nuk kanë ndodhur përnjëherë, por janë kryer në disa valë. Zinxhiri migrues i tyre, i zhvilluar valë-valë dhe në disa etapa, ka qenë herë i intensitetit të madh e herë të vogël, por me shekuj nuk ka pëlcitur. Migrimet e jashtme, për nga shumë rrjedha e karakteristika, janë më të ndërlikuara, për nga distanca territoriale më të gjata, më të shtrenjta dhe bartin edhe rreziqe të ndryshme. Këto migrime i përcjellin edhe dy faza të rëndësishme: faza e adaptimit në mjedisin e ri natyror dhe shoqëror dhe faza e integrimit deri te asimilimi në shoqëritë e vendeve imigruese, ndërsa nostalgjia e migrantëve është komponentë përcjellës e këtyre fazave.[6]

Edhe shpërnguljet e shqiptarëve, të hershme dhe të sotme, duhet parë si një proces zinxhiror, që ka fillimin, por sikurse te të gjithë popujt e tjerë ka edhe përfundimin e tij: ngulitjen definitive. Në këtë mënyrë, në rrethana shumë të ndërlikuara u krijuan *kolonitë shqiptare dhe diaspora e gjerë shqiptare, historike dhe bashkëkohore*. Historinë e popullit shqiptar në kohën e re e përbën në një pjesë të mirë historia e kolonive dhe e diasporës shqiptare.[7]

Karakteri i braktisjes së vendlindjes, i emigrimit në botën e jashtme në përgjithësi është i tillë që nis i përkohshëm, por herët a vonë, varësisht nga ndikimi i shumë rrethanave, shndërrohet në shpërngulje të përhershme. Përvoja shumëshekullore ka treguar se p. sh. migrimi përtej oqeanit te të gjithë popujt e botës ka përfunduar si emigrim pa kthim, veçanërisht emigrimi "i trurit"[8] kombëtar, por edhe migrimi i fuqisë punëtore nga viset dhe vendet e pazhvilluara në vendet e zhvilluara të Evropës, për shumë migrantë, siç po vërehet, do të përfundojë në migrim definitiv.[9]

Skema e përgjithshme e determinanteve të migrimeve të jashtme dhe e formimit të të gjitha diasporave, pra edhe të asaj shqiptare, mund të përmblidhet në ato të natyrës ekonomike, politike, historike, fetare, raciale, klasore etj. Njëri nga këto motive pothuajse gjithmonë është vendimtar rreth të cilit vargohen edhe motive të tjera. Në trojet etnike shqiptare si faktorë nxitës për shpërngulje në botën e jashtme dhe për krijimin e diasporës paraqiten presionet politike, moszhvillimi ekonomik, para së gjithash mungesa e kapaciteteve përpunuese (vendet e punës), hapësira e ngushtë jetësore, shtimi i

---

[6] M. Sorre, *Po aty,* pp. 9-18.

[7] E. Çabej, "Ngulimet shqiptare jashtë atdheut", *Ylli*, VIII, Nr. 1, Tiranë, janar 1967; ky punim është botuar edhe në: *Studime gjuhësore,* V, Prishtinë, 1975, ff. 56-61.

[8] Emigrimi i ekspertëve të fushave të ndryshme, kryesisht të shkencave fundamentale ishte dukuri e shekullit XX. Shpërngulja e tyre, e njohur si emigrim "i trurit" kombëtar shkonte në drejtim të vendeve të zhvilluara perëndimore, SHBA-së dhe Evropës, por edhe i të gjitha vendeve evropiane, përfshirë edhe ato të zhvilluara, në drejtim të SHBA-së. Shih: G. Hermet, *L'exode des cerveaux,* Notes Et. Doc., No 3598, Paris, 1969, pp. 1-78.

[9] G. Tapinos, "Migrations internationales et dévelopement", *Bulletin démographique des Nations Unies*, No 36, New York, 1995, pp. 1-22.

shpejtë i popullsisë dhe rritja e potencialeve të fuqisë punëtore, dendësia e madhe agrare dhe copëzimi i theksuar i pronave, etj. Në Kosovë, përjashtimi i shqiptarëve nga puna pas grevës së 3 shatorit 1990, shkatërrimi i bazës ekonomike, përzënia e nxënësve, studentëve dhe arsimtarëve nga objektet shkollore dhe universitare dhe terrori i shtuar e sistematik nga ana e pushtetit okupues serb në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, ishin rrethana plotësuese që nxitën emigrimin më masiv dhe më selektiv (shpërngulja e të rinjve, kryesisht meshkujve, personat me arsim mbimesatar etj.) të shqiptarëve në botën e jashtme. Por duhet pasur parasysh se edhe në rrethana stabile politike, ekonomike dhe shoqërore migrime të njerëzve tanë do të kishte nga se bota sot është e hapur dhe dalin edhe një varg shkaqesh të tjera të natyrës individualo-psikologjike, siç janë shkuarja pas fatit në vend të panjohur, veçanërisht i të rinjve, dëshira për t'i njohur vendet e huaja dhe për udhëtime në botën perëndimore, shpresat për një jetë më luksoze, motivet e ndryshme aventuriere dhe familjare etj. Këto vitet e fundit jemi dëshmitarë të ndikimit të fuqishëm edhe të këtij grupi të dytë të faktorëve të shpërnguljes.

Shqiptarët jashtë trungut gjeokombëtar populluan dhe kultivuan shumë hapësira të pabanuara e të shkreta, dhanë njerëz të shquar, si punëtorë, tregtarë, zejtarë, luftëtarë për çlirim, pavarësi e reformim shoqëror dhe sundimtarë të njohur në vendet ku u ngulitën, sikundër që kolonitë dhe diaspora shqiptare dhanë kontribut të madh në formimin e qenies kombëtare e kulturore, madje edhe shtetërore të popullit shqiptar. Ata janë dalluar e edhe sot e gjithë ditën dallohen veçanërisht në zhvillimin e aktivitetit kombëtar e kulturor përmes nxjerrjes së revistave të ndryshme dhe organizimit të klubeve e shoqërive të veçanta, sikurse në Sofje, Stamboll, Bukuresht, Palermo, Kozencë, Romë, Napoli, Boston, Çikago, Detroit, Nju-Jork, Damask, Kairo, Aleksandri, e këto 35 vjetët e fundit, me emigrimin në Evropën Perëndimore edhe në të gjitha qendrat e mëdha të vendeve ku jetojnë dhe punojnë. Siç thoshte prof. Çabej "në viset ku kanë ngulitur janë dëftuar një element me cilësi pozitive. Ata nuk kanë qenë vetëm njerëz të aventurave luftarake, si mundohet t'i paraqesë shpeshherë një historiografi tendencioze. Kanë qenë përkundrazi, përveç se ushtarë, edhe njerëz të kulturës. Gjatë kohëve ata kanë populluar dhe kulturuar vise të pabanuara e të shkreta. Nga gjiri i tyre kanë dalë edhe njerëz të shquar, të cilët i kanë lënë nder atdheut të të parëve dhe atdheut të tyre të ri".[10]

Sa i përket pasojave të pavolitshme të shpërnguljes, si të hershme, ashtu edhe të sotme të shqiptarëve në vende të ndryshme të botës, ishin dhe mbetën të mëdha në planin kombëtar, politik e demografik, si dhe në rrafshin ekonomik, psikologjik, familjar etj. Pas një vale të fuqishme të shpërnguljes

[10] E. Çabej, *Studime gjuhësore, V*, f. 61.

pasoi një rrudhje e dimensionit etniko-demografik në vëllim dhe në shtrirje hapësinore. Pas shpërnguljeve të para në gjysmën e dytë të shekullit XV shumë hapësira, të vogla ose të mëdha, të Shqipërisë së Mesme e të Jugut gati u shpopulluan, ndërkaq pas luftërave serbo-turke (1876-1878) dhe Kongresit të Berlinit (1878) u shpërngulën me dhunë shqiptarët e qindra fshatrave të rretheve të Prokuples, Vranjes, Leskovcit e Nishit; gjatë gjithë gjysmës së parë të shekullit XX u shpopulluan territore të tëra të banuara me shqiptarë në Greqi, ndërsa midis dy luftërave dhe pas Luftës II Botërore u shpopulluan fshatra të tëra në Maqedoni, me ç'rast shumë sipërfaqe të punueshme u shndërruan në kullota e lëndina, kurse në qytete u zhdukën disa zanate dhe veprimtari të tjera shërbyese; në gjithë shekullin XX me asimilim e shpërngulje u reduktua pandërprerë territori etnik shqiptar në Mal të Zi; në Kosovë si para, ashtu edhe pas Luftës Dytë Botërore, me gjithë emigrimin e madh në Turqi, Shqipëri etj., të përcjellë me tortura e represion të tmerrshëm, shqiptarët mbetën në shumicë, por pasojat në shumë sfera të jetës ishin dhe mbetën të mëdha.

Pas këtyre proceseve dhe ndërmarrjeve gjenocidale pasoi kolonizimi i territoreve shqiptare me element sllavo-grek dhe lidhur me të edhe tjetërsimi i pronave të paluajtshme dhe i pasurisë tjetër të të shpërngulurve; [11] u krijua psikoza e frikës dhe e pasigurisë për shqiptarët e mbetur në pakicë në shumë territore, duke u shtuar presioni dhe ndjekjet ndaj tyre dhe duke u reduktuar të drejtat më elementare njerëzore e kombëtare deri te ndalimi i përdorimit të gjuhës shqipe në jetën publike, pastaj të simboleve kombëtare dhe diskriminimi në të gjitha sferat e jetës e të punës. Njëri nga efektet padyshim më negative të shpërnguljes ishte ndarja e familjeve dhe deri vonë edhe bllokimi i kontakteve fizike të të shpërngulurve me vendlindjen dhe farefisin. Duke pasur parasysh emigrimin impresiv dhe mjaft selektiv sipas moshës, gjinisë, nivelit të arsimit, shkallës së kualifikimit profesional këto vitet e fundit, veçanërisht pas rrënimit të subjektivitetit politik të Kosovës (1989), përjashtimit të punëtorëve shqiptarë nga puna etj., disa nga pasojat e përmendura dhe shumë të tjera të shpërnguljes do të jenë në të ardhmen po kështu të mëdha dhe afatgjata.

Një nga efektet jo të volitshme të shprishjes shqiptare i takon padyshim rrafshit të identitetit. Identiteti i një pjese të mirë të bashkatdhetarëve tanë, që i përkasin si diasporës së vjetër ashtu edhe asaj të re, sidomos në Amerikë dhe Turqi, ku janë në numër më të madh, është sot mjaft i paqartë, ku disa breza të fundit e kanë humbur edhe gjuhën dhe gjenden në fazën e asimilimit intensiv,

[11] H. Islami, "Kolonizimet serbe të Kosovës dhe eksodi i shqiptarëve", *Studime, 2*/1995, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishinë, 1996, ff. 27-48.

ndërsa pjesëtarët e diasporës sonë historike, me pak përjashtime (arbëreshët e Italisë), e kanë humbur jo vetëm gjuhën dhe elementet e traditës, por edhe vetëdijen mbi përkatësinë etnike shqiptare. Në shkallën e ruajtjes së identitetit, të asimilimit të shpejtë apo të ngadalshëm, përveç tjerash, kanë ndikuar edhe rrethanat konfesionale, shoqëroro-politike, sociogjeografike etj. Mirëpo, përkrye të gjitha pasojave jo të volitshme, nuk mund të vlerësohet gjithmonë si tragjike shpërngulja e njerëzve përtej kufijve të shteteve të tyre, duke marrë parasysh vistrën e motiveve që i nxisin ta braktisin vendlindjen, përfshirë këtu edhe hapjen e botës.

Komuniteti i sotëm shqiptar në botën e jashtme në dy dhjetëvjetëshat e fundit dha një kontribut të madh për të vërtetën për Kosovën dhe shqiptarët, për afirmimin dhe sensibilizimin e çështjes sonë në vendet demokratike, që vendosin për fatet e popujve, si dhe ofroi ndihma të mëdha materiale për shqiptarët në Kosovë dhe në trojet e tjera etnike në ish-Jugosllavi; shqiptarët kudo që gjenden edhe sot vazhdojnë të japin kontribut të çmueshëm në planin kombëtar, politik dhe material. Mirëpo, diaspora shqiptare, për nga kontributi dhënë zhvillimit të njerëzimit, nuk mund të krahasohet me diasporat e disa popujve të tjerë, që sigurisht mund të shpjegohet me organizimin më të dobët si të vetë diasporës sonë, ashtu edhe të trungut gjeokombëtar shqiptar. "Amat" shqiptare, si pjesë të trungut kombëtar, me sistemet e tyre të deridjeshme kishin një rol tepër negativ ndaj diasporës sonë kudo që shtrihej, por, mjerisht as sot nuk kanë një rol aktiv dhe konstruktiv, sidomos jo Shqipëria.

3. Shqiptarët (arvanitasit) në Greqi

Migrimet ishin një faktor shumë i rëndësishëm në shtrirjen e shqiptarëve, qoftë në procesin e rrudhjes, qoftë në procesin e zgjerimit territorial, varësisht nga periudhat kohore dhe rrethanat që pasonin. Lëvizjet migruese së pari u zhvilluan brenda vetë hapësirës ballkanike: nga territoret që i banojnë sot në Ballkan ata u zgjeruan në pjesët e tjera të Siujdhesës, ndërsa më vonë edhe jashtë saj. Greqia ishte joshëse për emigrimin e shqiptarëve, që ishte intensifikuar sidomos gjatë sundimit të Stefan Dushanit. Ata atëherë i popullzuan kryesisht pjesët e pabanuara të Gadishullit Helenik, si pasojë e luftërave të shpeshta dhe murtajës që shkaktoi shumë viktima.[12] "Dyndjet e malësorëve që kishin filluar në shekujt e mëparshëm, morën përpjesëtime të mëdha gjatë sundimit të Stefan Dushanit, i cili lejoi dhe nxiti të vendoseshin në

[12] A. A. Vasiliev, *Historie de l'Empire Byzantin*, Tome II, Paris, 1932, pp. 311-312; sipas J. Milaj, *Raca shqiptare (studim antropologjik e historik)*, Tiranë, 1944, f. 70.

tokat e shpopulluara të Greqisë. Malësorët shpërnguleshin nga vendbanimet e tyre në mënyrë individuale dhe kërkonin punë nëpër qytete. Një shumicë e madhe malësorësh, me gjithë kundërshtimin e guvernatorëve, zbritën nëpër fusha. Ata bashkë me bagëtitë e tyre u shtrinë në veri deri në dyert e Raguzës e në bërrylin e Danubit, kurse në jug u vendosën deri në Epirin e Jugut e në Thesali. Dalëngadalë ata arritën deri në Atikë dhe More duke u hedhur në disa ujdhesa të detit Egje, si në Eube, Hydra, Specia, Paros etj. Pjesa më e madhe e tyre u vendos në tokat e feudalëve grekë e frëngj. Popullsia arbëreshe mbushi tokat e shkretuara të Greqisë dhe ndihmoi në ngritjen e ekonomisë së rrënuar të vendit. Qysh nga shekulli XIV ata vazhdojnë të banojnë akoma në ato vende, por, nën presion të gjatë të helenizimit, shumica e tyre e ka humbur gjuhën shqipe".[13]

Valët migruese të shqiptarëve në Greqi, varësisht nga rrethanat e përgjithshme të kohës së emigrimit dhe imigrimit, ishin të intensitetit të ndryshëm, mirëpo për një kohë të gjatë nuk u ndërprenë. Shqiptarët në Greqi më së largu kanë shkuar gjatë shekullit XV dhe fillimi i shekullit XVI, ndërsa prej atëherë dhe prej aty masa të konsiderueshme shqiptarësh kanë emigruar në Itali, siç mund të shihet nga harta e studimit të T. Johalasit.[14] Shumë valë migruese të shqiptarëve u zhvilluan në etapa, brenda vetë tokave greke. Shqiptarët ishin punëtorë të vyeshëm dhe luftëtarë të njohur, për çka edhe i sollën dobi të madhe territoreve të populluara si në pikëpamje ekonomike, ashtu edhe sa i përket luftës për pavarësinë e këtij vendi. "Lufta greke për liri nuk mund të mendohej pa elementin shqiptar,"[15] ndërsa "kryengritja greke e shekullit XIX, që e shpëtoi Greqinë nga zgjedha turke, qe vepër e shqiptarëve".[16]

Numri dhe shtrirja e shqiptarëve në Greqi ishin objekt interesimi i shumë autorëve këto 150 vjetët e fundit. Konsulli dhe shkencëtari austriak J. G. Hahni shënon se në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Greqi jetonin 173.000 shqiptarë,[17] ndërsa para plot një shekulli Filipsoni shkruante se në këtë vend jetojnë 224.000 shqiptarë ose 11,3% të popullsisë së përgjithshme.[18] Një shkrimtar dhe diplomat i kohës, Gjergj Franxe, mendonte se ky numër më parë ka qenë shumë më i madh dhe se në gjysmën e shek. XV vetëm në More

---

[13] *Historia e popullit shqiptar* I, Prishtinë, 1968, f. 198.
[14] T. Jochalas, *Dissertationes Albanicae,* Trophenik, Munchen, 1971.
[15] G. Stadtmuller, "Historia Shqiptare në pikëpamje të Kombsis si problem gjurmimesh", *Hylli i Dritës*, Shkodër, 1942, f. 222 (përkthim i prof. Karl Gurakuqit).
[16] A. A. Vasiliev, *Po aty*, f. 296.
[17] J.G. Hahn, *Albanesische Studien, I*, Jena, 1854, f. 32.
[18] E. Çabej, *Studime gjuhësore, V*, f. 57.

(Peloponez) jetonin rreth 290.000 shqiptarë, që kishin rreth 30.000 luftëtarë.[19] Shkrimtari dhe diplomati serb B. Nushiqi, ndonëse nuk jepte numrin e shqiptarëve në Greqi, megjithatë, theksonte se në fillim të këtij shekulli "Mbretëria e Greqisë është vërshuar nga shqiptarët toskë".[20] Para Luftës I Botërore, kur Greqisë iu kishin dhënë disa krahina shqiptare, në to jetonin rreth 115.000 shqiptarë: 35.000 në rrethet e Kosturit e të Follorinës dhe 80.000 në Çamëri, e cila përfshin rreth 4.000 km katrorë. Pas ardhjes së Ataturkut në krye të Turqisë dhe pas shpërthimit të konfliktit greko-turk, u bë këmbimi i popullsive: shqiptarët e këtyre krahinave të konfesionit mysliman u deportuan në Turqi dhe rrethet e Kosturit e të Follorinës u pastruan nga shqiptarët, kurse në Çamëri, në nënprefekturat Igumenicë, Margëllëc, Filat e Pargë mund të gjendeshin rreth 25.000 çamë dhe rreth 15.000 shqiptarofonë ortodoksë.[21] "Fati i shqiptarëve të provincës së Çamërisë, provincë e aneksuar prej Greqisë, nuk ndryshon nga ai i kosovarëve. S'është veç një ribotim i tragjedisë në 3 akte: çpasurim, çpërngulje, çfarosje" - shkruante *Noli*.[22] Dëbimi dhe përndjekjet e çamëve, të përcjella me masakra të tmerrshme ndodhën në gjysmën e parë të shekullit XX: në vitet 1912-1914, pas nënshkrimit të Konventës turko-greke në janar të vitit 1923 në Llozanë dhe në vitet 1944-1945. Nga terrori grek shqiptarët e braktisën Çamërinë dhe u vendosën në Shqipëri, në Turqi dhe në Amerikë, ndërsa në vend të tyre pushteti grek instaloi grekët nga Turqia.[23] Sipas të dhënave të një regjistrimi të Shoqatës Politike Çamëria të vitit 1991, në Shqipëri jetojnë 204.255 çamë.[24]

Gjeografi serb, *Jovan Cvijiqi* (1865-1927), në dekadën e dytë të shekullit XX, duke u marrë me lëvizjet migruese (metanastazike) në Ballkan, jepte edhe numrin e shqiptarëve në këtë vend. Sipas tij, "rryma toske, e cila i ka përfshirë kryesisht shqiptarët ortodoksë të Shqipërisë së Jugut e të Epirit, ka shkuar rrugës së Epirit në Greqinë e Mesme, madje edhe drejt Peloponezit. Si duket ky ka qenë migrimi më i madh i shqiptarëve. Edhe tash ka në Greqi rreth 250.000 kësi të ardhur, prej të cilëve shumica flasin shqip; ka edhe në rrethinën e Athinës".[25] Një autor tjetër, duke u mbështetur në statistikat zyrtare

---

[19] Shih botimin: *Bota shqiptare*, Tiranë, 1943, ff. 603-604; J. Milaj, *Po aty*, ff. 71, 113.

[20] B. Nušić, *Kosovo - opis zemlje i naroda*, Matica srpska, Novi Sad, 1902.

[21] L. Skendo, "Popullsia shqiptare më 1922 jashtë Shqipërisë", *Kalendari kombiar*, 1926, f. 35 e tutje; J. Milaj, *Po aty*, ff. 112 - 113.

[22] F. S. Noli, "Një tragjedi në 3 akte; çpasurim, çpërngulje, çfarosje", *Liria kombëtare*, nr. 110, 10 prill 1929, Gjenevë; shih gjithashtu në: F. S. Noli, *Vepra, 3*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 178.

[23] M. Vikers, *Çështja çame*, Prishtinë, 2002, ff. 14-20.

[24] M. Vikers, *Po aty*, f. 51.

[25] J. Cvijić, *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje. Osnovi antropogeografije*, Knj. I-II, Beograd, 1966, f. 140.

përmend numrin prej 200.000 shqiptarësh.[26] Në vitin 1929, sipas disa vlerësimeve, numri i arbëreshëve të Greqisë sillej rreth 90.000 veta, të shtrirë deri në More, [27] ndërsa sipas një regjistrimi që e kishte bërë studiuesi G. Ciampi nga fundi i shekullit të kaluar, në Greqi duhej të kishte midis 160.000 dhe 200.000 arbëreshë (pa i përfshirë 30.000 çamët), të shtrirë në 321 vendbanime në Trakinë Perëndimore, në Maqedoni e deri në Peloponez.[28] Duhet theksuar se me marrëveshjen midis qeverisë greke dhe asaj turke, në vitet e 20-ta të shekullit XX u shpërngulën nga Epiri Jugor dhe pjesët e tjera të Greqisë në Turqi rreth 200.000 shqiptarë të fesë islame.[29]

Duke qenë nën ndikim të gjatë të kulturës helene, shumica e shqiptarëve humbi gjuhën dhe veçoritë tjera etnike. Mirëpo, qindra fshatra të Greqisë, ku ata kanë banuar ose banojnë edhe sot, mbajnë emra shqip, si Lopës, Laras, Kodra, Kulla, Ferrëza, Qyteza, Kurora, Shpellëza, Hekali, Qafadrizi, Klementi, Malizi etj.[30] Sipas prof. *Çabejt*, deri vonë madje në disa pjesë të Greqisë edhe sot dominon gjuha shqipe, toskërishtja e kohës së shpërnguljes.[31]

Sipas K. *Kazazisit*, gjuha shqipe (greqisht, arvanitika) flitej në shumë territore të Greqisë Veriore, të Mesme dhe Jugore, si dhe në shumë ujdhesa. Meqenëse gjuha shqipe nuk përdorej në shkolla dhe në jetën publike e kishtare, ajo mbetej vetëm gjuhë e familjes. Sipas këtij autori, madje ekzistonin disa dallime dialektore të shqipes midis pjesëve të ndryshme të Greqisë të cilat i popullojnë shqiptarët. Gjuha shqipe dhe tradita popullore më tepër janë ruajtur në territore fshatare, ndërsa në qytete gati janë të zhdukur, siç është rasti p. sh. me Korinthin.[32] Një autor yni, duke qëndruar në Athinë dhe në rrethinën e saj para disa vitesh, ka gjetur shumë fshatra në të cilat popullsia jo vetëm që e ka ruajtur vetëdijen mbi origjinën shqiptare, por edhe e flet gjuhën shqipe. P. sh. gjuha shqipe, sipas tij, flitet në Fshatrat Ikonomu, Athiqë, Sofiko, Gallataqi, Armiri, Njikollasti, Thiva, Spata, Markupolon, Keratea, Koropi etj. Ai, gjithashtu, gjeti në hartat e Athinës e të Atikës një numër të madh të shesheve, rrugëve, fshatrave etj., të cilat mbajnë emrat shqip, sikurse

---

[26] Finlay, *History of Grece*, IV, f. 32; sipas J. Milaj, *Po aty*, f. 113.

[27] R. Almagia, *L'Albania*, Roma, 1930, f. 183; J. Milaj, *Po aty*, f. 113.

[28] G. Ciampi, "Le sedi dei Greci Arvaniti", *Rivista geografica italiana*, XCII, fasc. 2, 1985, ff. 75-116. Burimet statistikore sovjetike bëjnë me dije se numri i shqiptarëve në Greqi rreth viteve të 60-ta të shekullit XX sillej rreth 50.000 veta (*Cislenost i rasselenie narodov mira*, An. SSSR, Moskva, 1962, f. 121; sipas: A. Desnickaja, *Albanskij jazyk i jego dijalekty*, Nauka, Leningrad, 1968, f. 11).

[29] Sh. Maliqi, "Nacionalizmima treba vaditi kvadratni koren", *Thema, 7*, Prishtinë, 1986, f. 44.

[30] *Historia e popullit shqiptar, I*, ff. 198-199.

[31] E. Çabej, *Studime gjuhësore, V*, ff. 56-58.

[32] K. Kazasis, "Greek and Arvanitika in Corinthia", *Balkanistica*, Occasional Papers in Southeast European Studies, III, 1976, ff. 42-51.

Marko Boçari, Noti Boçari, Miauli, Kanari, Lekaj, Plaka, Vathi, Vari, Pylli, Skourta, Devolli etj.[33]

4. Shqiptarët (arbëreshët) në Itali

Pas depërtimit të turqve në Ballkan dhe përforcimit definitiv të sundimit të tyre dhe veçanërisht pas vdekjes së Skënderbeut (1468), një numër i madh shqiptarësh nga territori i Shqipërisë së sotme Jugore dhe asaj të Mesme, prej mesit të shekullit XV deri në mesin e shekullit XVIII, i la fshatrat e veta dhe u ngulit në Itali, por një numër i madh, sidomos në fillim, erdhi kryesisht nga Greqia. Shpërngulja u zhvillua edhe këtu në disa valë. Nga fundi i gjysmës së parë dhe fillimi i gjysmës së dytë të shekullit XV, sipas disa autorëve, në Itali u kryen tri valë të imigrimit të shqiptarëve: *vala e parë* ndodhi në vitin 1448 në provincën Katanxaro në Kalabri dhe përfshiu 12 fshatra dhe në Sicili në vitin 1449 dhe përfshiu 4 fshatra; *imigrimi i dytë* u krye në vitin 1459 kur shqiptarët u ngulitën në 15 fshatra në rrethinën e Tarantos në krahinën e Apulisë; *vala e tretë* e imigrimit u zhvillua pas vdekjes së Skënderbeut më 1468. Pas kësaj pason një varg i tërë imigrimesh të shqiptarëve në Italinë Jugore, të cilët në këtë mënyrë e përforcuan dhe territorialisht e zgjeruan praninë e tyre.[34] Ndërkaq prof. Çabej theksonte se valët e fuqishme të imigrimit të shqiptarëve në Itali kishin ndodhur në këto vite: më 1437 në qytetin Ankona, më 1448 në Kalabri e Sicili, më 1484 në Abrucet dhe vala e fundit ndodhi më 1774 në Brindizi di Montagna në Apuli.[35]

Vlerësohet se rreth 200.000 shqiptarë, të cilët në kohën e migrimit mendohej se përbënin rreth një të tretën e popullsisë së gjithmbarshme, duke mos dashur të mbesin nën sundimin otoman dhe terrorin e tyre, u shpërngulën në Itali, veçanërisht në pjesën jugore të këtij vendi dhe atë më së shumti në Kalabri e Sicili, pastaj në Apuli, Venedik etj.[36] Sipas dokumenteve të Arkivit të Napolit, ky numër ishte më i madh dhe arrinte rreth 290.000 veta.[37]

---

[33] R. Zllatku, *Me arbëreshët*, Prishtinë, 1976, ff. 155-189.

[34] Shih më hollësisht: D. Zangari, *Le Colonie Italo- Albanesi di Calabria. Storia e Demografia Secoli XV-XIX,* Caselli, Napoli, 1940, ff. 20-27 e tutje; P. Scaglone, *Historia e shqiptarëve të Italisë*, Saravulli. New York, 1921, f. 3 e tutje; G. Nicholas Nasse, *The Italo-Albanian Villages of Southern Italy*, National Academy of Sciences - National Research Council, Publication 1149, Washington, 1964, ff. 24-26.

[35] E. Çabej, *Studime gjuhësore, V*, ff. 57-58.

[36] *Historia e letërsisë shqipe, I-II*, Tiranë 1959 (sipas ribotimit të Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të KSA të Kosovës, Prishtinë, 1971, ff. 143, 156 e tutje).

[37] K. Kamsi, "Dyndjet e shqiptarëve në Itali", *Bota shqiptare*, 1943, f. 577.

Mendohet se në Itali u themeluan gjithsej 79 fshatra arbëreshe.[38] Numri më i madh i migrantëve, sidomos i atyre që vinin nga Greqia, i përkiste fesë ortodokse.[39] Dihet se arbëreshët e Kalabrisë e të Sicilisë zhvilluan aktivitet të gjerë kulturor e kombëtar, veçanërisht në shekujt XIX dhe XX. Ata dhanë edhe përfaqësues të njohur të kulturës kombëtare,[40] ndërsa u shquan edhe si luftëtarë për çlirimin dhe bashkimin e Italisë, sidomos në lëvizjen garibaldiane të shekullit XIX.[41]

Një pyetje që doemos shtrohet është: si u ruajt pesë shekuj bashkësia arbëreshe në Itali, e cila ka dëshirë veten ta quajë "Arbëri e Vogël"? Faktorët kryesorë të ruajtjes së gjuhës, zakoneve, traditave, folklorit etj. të tyre ishin rrethanat e pavolitshme ekonomike dhe kulturore të krahinave që i popullonin në këtë vend, veçanërisht në territoret malore, me kushte të kufizuara të jetës, përkatësia tjetër fetare e shumicës së tyre (ortodoksë) nga banorët e vendit imigrues (katolikë), nga të cilët edhe ishin me shekuj të izoluar, martesat në mes tyre, pastaj dashuria e madhe për atdhe etj. Në të vërtetë moszhvillimi i përgjithshëm, kompaktësia territoriale e popullimit dhe izolimi gjeografik e sociokulturor, ndikuan që shqiptarët në tërësi të ruheshin si bashkësi etnike e kombëtare, përkundër përpjekjeve shumëshekullore të pushtuesve e sundimtarëve që t'i asimilonin, t'i shpërngulnin larg trojeve të tyre, ose madje edhe biologjikisht t'i zhduknin. Mirëpo, më vonë, me depërtimin e ndikimit të kulturës vendëse, shumë fshatra arbëreshe humbën gjuhën shqipe dhe disa veçori të vetëdijes nacionale. Por me gjithë ndikimet e kulturës italiane, ata mbetën komunitet specifik dhe zhvilluan aktivitet të gjerë kulturor e kombëtar, i cili kohëve të fundit gjithnjë po forcohet e zgjerohet. Për këtë dëshmon ekzistimi i disa katedrave dhe seminareve të albanologjisë (në Romë, në Napoli, në Bari, në Palermo, në Kozencë) të cilat i udhëheqin vetë arbëreshët, botimi i disa revistave në gjuhën shqipe, si *Vija, Zëri i Arbëreshvet, Zjarri, Zgjimi, Katundi Ynë, Lidhja etj.,* në të cilat trajtohen kryesisht probleme të letërsisë, të kulturës, madje edhe çështje të ndryshme shkencore, pastaj funksionimi i tri radio-stacioneve lokale etj,[42]. Mbetet kërkesa e tyre e kamotshme, ende e parealizuar - hapja e shkollave në gjuhën shqipe; për këtë gjuhë, të emocionuar, theksojnë se "është e ëmbël si qumështi i nënës, se është gjuhë e dritësuar".

---

[38] K. Xoxi, *Shqiptarët dhe Garibaldi*, Prishtinë, 1983, f. 15.

[39] Në bazë të të dhënave të publikimit të përmendur të D. Zangarit (ff. 48-50), si dhe në bazë të vrojtimeve të veta në Lukani dhe Sicili, G. N. Nasse shënon se në 44 fshatra, ku në 32 prej tyre popullsia flet shqip, raporti i pjesëtarëve të konfesionit ortodoks dhe katolik sillet 50%:50% (G. N. Nasse. *Po aty*, f. 81).

[40] Shih më gjerë në : *Historia e letërsisë shqipe, I-II,* Tiranë, 1959.

[41] K. Xoxi, *Po aty*, f. 8 e tutje.

[42] R. Ismajli, *Rrënjë e fortë,* Prishtinë, 1978, ff. 5-31.

Shqiptarët e Italisë, sikurse edhe ata të Greqisë, veten e quajnë *arbëresh (*Albanesi d'Italia), ndërsa gjuhën shqipe gjuhë *arbëreshe, arbërishte* (lingua albanese). Kështu, në mesjetë, në kohën paraturke, i tërë populli shqiptar veten e quante arbër, arbën dhe arbënesh, ndërsa atdheun e vet *Arbëri, Arbëni*; atëherë ende nuk ishin formuar e përgjithësuar emrat *shqiptar* e *Shqipëri*. Me bazën alb-, arb-, edhe përpara edhe sot i quajnë popujt e tjerë, sikurse, Albanese, Albanenses, Albanais, Albanian, Albanec, Albanci, Albanija, Alvanija, Arbania etj. [43] Emri *shqiptar* së pari herë paraqitet në dokumentet e shkruara në *Kuvendin e Arbënit* në vitin 1706.[44]

Numri i shqiptarëve në Itali gjithashtu ishte objekt trajtimi i shumë autorëve në shekujt XIX e XX. Prandaj ky numër është mjaft variabil. Vlerësohet se në shekullin XIX në këtë vend kishte rreth 200.000 arbëreshë.[45] Nga fillimi i këtij shekulli vërehet tendenca gjithnjë e rritjes: në vitin 1806 numri i përgjithshëm i arbëreshëve në Itali ishte 110.955 veta, në vitin 1846 168.802, në vitin 1886 rritet në 196.768 dhe në fund të këtij shekulli në rreth 200.000 veta.[46] Në enciklopedinë historike dhe gjeografike, autor i së cilës është rilindasi i njohur *Sami Frashëri,* theksohet se në Kalabri kishte rreth 150.000 arbëreshë.[47] Në fillim të shekullit XX, respektivisht në vitin 1901, sipas disa burimeve, në Itali jetonin gjithsej 21.554 familje arbëreshe me 96.000 banorë, më 1911 20.467 familje me 90.670 banorë dhe me 1921 20.113 familje arbëreshe me 80.282 banorë[48]. Ndërsa sipas të dhënave të një autori arbëresh, në vitin 1901 kishte 203.239 arbëreshë.[49] Mirëpo, disa autorë përmendin se dikur ka pasur rreth 300.000 e madje edhe 400.000 arbëreshë, të shtrirë në 80 fshatra, në lartësi mbidetare prej 1.000 m.[50] Të dhënat e vitit 1921, të plotësuara më 1927, plotësisht përputhen me të dhënat e statistikës italiane.[51] Edhe disa burime e hulumtime të tjera tregojnë përafërsisht numrin e njëjtë të shqiptarëve që e kishin theksuar disa autorë në fillim të shekullit XX,

---

[43] E. Çabej, *"Për gjenezën e literaturës shqipe",* Prishtinë, 1970, ff. 12-22; shih gjithashtu artikujt e tjerë të këtij autori; "Emri i vjetër nacional i shqiptarëve", *Studime gjuhësore*, V, ff. 62-67, dhe "Emrat nacionale të shqiptarëve", *Studime gjuhësore,* V, ff. 68-70; shih gjithashtu R. Ismajli, *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987, ff. 96-104.

[44] R. Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, Prishtinë, 1985, f. 228.

[45] E. Barbarich, *Albania*, Roma 1905; sipas *Historia e letërsisë shqipe*, I-II, f. 156.

[46] A. Stratico, *Manuale di litteratura albanese*, Milano, 1896, f. 20; *Historia e letërsisë shqipe, I-II*, ff. 142-156 e tutje.

[47] *Camus-ul-Alam*, tom 5, Istambul, 1896, f. 3350; K. Xoxi, *Po aty*, f.15

[48] T. de Mauro, *Storia linguistica dell'Italia unita, Larerza, Roma-Bari*, 1974, f. 283.

[49] A. Scura, *Gli Albanesi in Italia*, Saggi e reviste, Milano, 1865; K. Xoxi, *Po aty*, f. 27.

[50] D. Zangari, *Po aty*, ff.48-50; P. Scaglione, *Po aty*, ff. 75-80, *II, Contributo Degli Arbreshi Alla Letteraturo Albanese, Associazone*-Italiana per raporti culturali tra L'Italia e L'Albania, Roma, 1955, f. 7; G. N. Nasse, *Po aty*, f. 80.

[51] *Historia e letërsisë shqipe*, I-II, f. 156.

kurse në burimet tjera hasim në numër më të madh të shqiptarëve. Sipas të dhënave të statistikës italiane më 4 nëntor të vitit 1951 në Italinë Jugore dhe në Sicili kishte 101.878 arbëreshë të shtrirë në 36 fshatra, ndërkaq më 31 dhjetor të vitit 1955 ky numër rritet në 103.234 arbëreshë në të njëjtat fshatra, lartësia mbidetare e cila është prej 320 m (Spezzano Albanese) deri në 930 m (Plataci).[52] Në burimet ruse përmendet se në vitin 1959 në Itali jetonin rreth 80.000 shqiptarë.[53] Ka edhe vlerësime se sot, me ngritjen e vetëdijes kombëtare të arbëreshëve, numri i tyre në Itali sillet rreth 200.000 veta,[54] kurse sipas vlerësimeve të tjera edhe deri 300.000 banorë.[55] Komuniteti arbëresh sot, pa dyshim, paraqet pakicën më të fortë etnike në Italinë Jugore dhe kurrë nuk është sjellë si pakicë e nënshtruar as ndaj italianëve.[56]

Bashkësia arbëreshe në Itali sot zhvillon një aktivitet të gjerë në fushën e letërsisë, të kulturës e të shkencës dhe gjithnjë po ngrihet vetëdija mbi përkatësinë kombëtare shqiptare. Kësaj veçanërisht i kontribuuan kontaktet e shpeshta të krijuesve arbëreshë me instuticionet kulturore e shkencore të Shqipërisë dhe të Kosovës. Me Kosovën lidhjet intensive ishin përmes Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare që nisi të organizohej nga viti 1974 dhe vazhdon të mbahet edhe sot; nën presionin serbomadh nga fundi i viteve të 80-ta ndërpreu punën. Në Italinë Jugore sot ekziston një numër i madh fshatrash ku flitet gjuha shqipe. Në dhjetëra fshatra të krahinave gjeografike Palermo, Taranto, Foxha, Kampabaso, Avelino, Kozenca, Peskara, Katanxaro, Teramo etj., gjuha folëse, përveç italishtes është edhe shqipja (45 fshatra), ndërsa në rreth 38 fshatra, në të cilat sot nuk flitet gjuha shqipe, popullsia është me prejardhje shqiptare dhe në disa prej tyre ruhen traditat popullore dhe shënohet një aktivitet kulturor e kombëtar.[57] Dialekti i të folmes shqipe në fshatrat e këtyre krahinave ishte dhe mbeti kryesisht afër variantit të toskërishtes së arbëreshëve të Greqisë.[58]

---

[52] *Annuario Statistico Nea Communi Italiani, Instituto Centrale Di Statistica* - Ministeri Dell'Interno, Roma, 1958, ff. 47-50; sipas G. N. Nasse, *Po aty*, f. 80.

[53] *Cislenost i rasselenie narodov mira*, An. SSSR, Moskva, 1962, f. 121; A. Desnickaja, *Albanskij jazyk i jego dijalekty*, Nauka, Leningrad, 1968, f. 11.

[54] F. Altimari, "Albanci v Italiji", në librin *Albanci*, Cankarjeva založba, Ljubljana, 1984, f. 116.

[55] E. Tavolaro, *Origini e Svillup delle comunita albanesi in Calabria, Cosenza*, f. 3; K. Xoxi, *Po aty*, f. 15.

[56] E. Heršak, "Sociohistorijski uvod u problematiku etničkih manjina na talijanskom Jugu", *Migracijske teme,* nr. 2, Zagreb, 1987, ff. 205-210. Hershak këtë konstatim e merr nga: Claus, Jan-Ulrich-B.de Uitte, "Linguistic minorities in Southern Italy: A peryphery far from the border", në *Boundaries and Minorities in Uestern Europe,* Milano, 1982, ff. 229-244.

[57] K. Xoxi, *Po aty*, ff. 12-14

[58] M. Shufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, Prishtinë, 1968, f. 174, E. Çabej, *Studime gjuhësore*, V, ff. 48-55.

Numri dhe shtrirja karakteristike e arbëreshëve dhe historia, gjuha, folklori dhe jeta e tyre interesante zgjuan edhe interes të madh për studiues të profileve të ndryshme, veçanërisht gjuhëtarëve dhe etnologëve. Kështu, gjuhëtari i njohur amerikan *Erik Hemp*, në vitet e para të pas Luftës II Botërore, për të studiuar gjuhën arbëreshe (shqipe) qëndroi një kohë të gjatë në katundet e krahinave të përmendura. Ai bëri një doktoratë lidhur me gjuhën dhe traditat e arbëreshëve. Me atë rast, Hempi në këto krahina gjeti 93.378 folës të sigurt të gjuhës shqipe, të shtrirë në 47 fshatra. Mirëpo, theksonte ai, ekzistonin edhe 6 fshatra të mundshme në të cilat flitej gjuha shqipe. Sipas hulumtimeve të tij, në gjithsej 53 fshatra, gjuhën shqipe e flisnin 115.443 banorë. Sipas tij, më së shumti arbëreshë kishte në krahinat: Kozencë (46.526), Palermo (19.462), Katanxaro (13.526), Kampabaso (12.518), Potenza (11.506), ndërsa në krahinat e tjera jetonin rreth 5.000 arbëreshë.[59] Studimet e prof. Çabejt të gjysmës së dytë të viteve të 60-ta të shekullit të kaluar gjithashtu i dëshmojnë këto të dhëna. Ai shkruante 3e "sot flitet shqip në 49 lokalitete e katunde të Italisë Jugore e të Sicilisë, me një popullsi rreth 100.000 frymë".[60] Të dhënat që i jep gjuhëtari arbëresh Imanuil Jordani mbi arbëreshët dhe gjuhën shqipe të tyre në krahinat e përmendura në bazë të statistikës italiane, tregonin numër diçka më të madh të vendbanimeve dhe të popullsisë arbëreshe nga numri që kanë dhënë autorët e tjerë. Sipas Jordanos ekzistonin 55 fshatra në të cilat gjuhën shqipe e flisnin 135.811 banorë. Më parë, theksonte ai, edhe në 44 fshatra të tjera flitej gjuha shqipe dhe gjithsej në 94 fshatra, numri i shqipfolësve, i shtrirë nëpër krahina, dukej sa vijon: Kozenca 54.617, Katanzaro 11.632, Palermo 11.081, Taranto 6.249, Avelino 2.468 dhe Peskaro 637 veta. Prej tyre më pak flisnin shqip rreth 15.000 veta dhe atë më së shumti në krahinën e Tarantos dhe të Katanxaros.[61] Këto të dhëna, siç po shihet, i kanë dhënë gjuhëtarët. Ndër gjuhëtarë që u morën me studimin e ngulitjeve arbëreshe në dritën e gjuhës së tyre, dallohen veçanërisht dijetari me origjinë gjermane Maksimilian Lamberci dhe dijetari i njohur shqiptar E. Çabej. Punimet e tyre i hasim në organe të ndryshme shkencore e profesionale të kohës.

Të dhëna për arbëreshët ofruan edhe demografët. Kështu sipas demografit Gjuzepe de Bartolo nga Kalabria (Kozencë), duke iu referuar rezultateve të regjistrimit të vitit 1981, në provincat e Kozencës e të Katanxaros numri i arbëreshëve është diçka më i vogël (Kozenca 42.305; Katanxaro 9.332), që dëshmon për tendencën gjithnjë në rënie të numrit të

[59] E. P. Hamp, *Vaccarizzo albaneso phonologythe sound-system of Calabro-albanian dialect*, Disertacion i doktoratës (dorëshkrim), Chicago, 1951, ff. XXIV-XXV (a).

[60] E. Çabej, *Po aty*, f. 49.

[61] E. Giordano, *Dizionario degli Albanesi d' Italia,* Edicioni Paoline, Bari, 1963 (tabela në fund të fjalorit).

tyre. Numër më të madh arbëreshët në këto dy provinca, sipas këtij autori, shënojnë në regjistrimet e viteve 1951 (Kozenca 51.504; Katanxaro 11.856) dhe 1961 (Kozenca 47.787 Katanxaro 12.033 . Edhe shkalla e natalitetit te bashkësia arbëreshe e këtyre dy provincave para 100 vjetësh ishte mjaft e lartë (rreth 40 promilë), ndërsa në vitin 1972 bie në 10,5 promilë (Kalabria 17,5; Italia 16,3 promilë) dhe në vitin 1983 zvogëlohet në 12,3 promilë (Kalabria 13,9; Italia 10,6 promilë).[62]

Arbëreshët e Italisë para disa shekujsh e braktisën atdheun e tyre të parë. Vendbanimi më i madh në Sicili, Hora e Arbëreshëve - Fusha e Shqiptarëve (Piana degli Albanesi) u themelua në vitin 1488 si ngulim i parë i madh në Itali (vendbanim i përhershëm). Horasit thonë se e kanë origjinën nga Shkodra, Himara e Çamëria dhe nga Morea (Peloponezi). Lartësia mbidetare e Horës është 700 m, ndërsa tokë nuk ka mjaft. Në kohën e ngulitjes ishte vend i shkretë, por arbëreshët e kultivuan dhe e shndërruan në ara e vreshta dhe në ullishte e pemishte. Në vitin 1988 u kremtua 500 vjetori i themelimit të Horës, ku në Kongresin II Ndërkombëtar që u mbajt me atë rast dhe iu kushtua pakicave etnike e gjuhësore, erdhën studiues shqiptarë e të tjerë nga shumë vende të botës. Arbëreshët e Horës dhe të vendbanimeve të tjera, për të kërkuar punë, gjithnjë po emigrojnë në qytetet e Italisë dhe po martohen me femra italiane. Mirëpo, është shumë interesant se ndonëse arbëreshët moti u shkëputën nga trungu i përbashkët, Arbëria, siç e quajnë me plot gojë dhe më vonë shumica iu nënshtrua katolicizmit dhe kulturës romane, megjithatë, në saje të numrit relativisht të madh dhe sidomos të vendosjes së tyre kompakte hapësinore, arritën që edhe sot e gjithë ditën të ruanin shumë veçori etnike, veçanërisht gjuhën dhe vetëdijen kombëtare.

Një autor yni para disa vitesh vizitoi shumë fshatra arbëreshe në Italinë Jugore dhe me atë rast shënoi shumë fakte lidhur me jetën, gjuhën, traditat, folklorin e tyre etj. Nga shumë procese që i kishin goditur arbëreshët nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, së bashku me italianët e krahinave të përmendura të Italisë, shkruan ky autor, një numër i madh shpërngulet në Argjentinë, Brazil, Uruguai, SHBA etj. dhe këta ishin emigrantët e parë shqiptarë që u ngulitën në truallin e Amerikës. Disa priftërinj arbëresh që punonin në Buenos Aires, madje tregonin se vetëm në këtë qytet të Argjentinës kanë imigruar rreth 40.000 arbëreshë nga krahina e Kozencës.[63] Një udhëpërshkrues e studiues tjetër yni, që këto vitet e fundit qëndroi pothuajse në të gjitha pjesët e ngulimeve arbëreshe, midis tjerash shkruan: "Të mos shkojmë më tej, le të marrim kolonitë shqiptare të Amerikës, në SHBA,

[62] G. de Bartolo, "La démographie des minorités albanaises de Calabre. Premières resultats", *Conférence Européene de demographie 1987,* Jyvasküla, 11-18 juin, Finlande.

[63] R. Zllatku, *Me arbëreshët*, Prishtinë, 1976, f. 1 e tutje.

Argjentinë, Brazil e gjetkë, ku fillimet e lëvizjes patriotike janë të lidhura me arbëreshët. Në Argjentinë e Brazil shoqëritë e para patriotike i kanë krijuar arbëreshët, si më të hershëm që ishin në kontinent. Po faqet më të bukura i shkruan në SHBA, ku përpjekjet e tyre u shkrinë në një me vëllezërit e një gjaku, të ardhur nga Shqipëria. Këtu shqiptarët ishin më të organizuar dhe, kur nisi lëvizja, arbëreshët qenë mbështetje e fortë. Vetëm në Nju-Jork e Boston kishte mbi 20.000 arbëreshë (të Italisë H. I.) dhe këta do t'i gjeje në çdo veprimtari patriotike"[64]. Prof. Çabej theksonte se arbëreshët ishin shpërngulur jo vetëm në Amerikën Veriore dhe Amerikën Jugore, por edhe në qytetet e mëdha të Italisë së Veriut.[65] Ndërsa dijetari arbëresh Françesko Altimari nga Kalabria, shkruan se arbëreshët, përveç në rajonet industriale të Italisë së Veriut, nga fundi i viteve të 50-ta të shekullit XX nisën të shpërnguleshin edhe në Evropën Perëndimore.[66]

5. Shqiptarët në Bullgari, Rumani, Rusi dhe Dalmaci

Në këta shekujt e fundit, veçanërisht në shekullin e kaluar, në rrethana të rënda historiko-politike dhe socialo-ekonomike ndodhën migrime të konsiderueshme të shqiptarëve edhe në vendet e tjera brenda dhe jashtë Siujdhesës Ballkanike. Shpërngulje të shqiptarëve pati shumë herët, madje edhe që nga shekulli XIV pati në Bullgari, të cilët u ngulitën në shumë pjesë të saj, më tepër në rajonin e Rodopeve Lindore. U formuan disa fshatra shqiptarësh, në të cilat deri vonë u ruajtën gjuha dhe veçoritë e tjera etnike. Këto fshatra janë Arbanasi, Mandrica, Kopillovec, Çiprovec, Zhelezna në rajonin e Mihajllov Gradit (VP i Bullgarisë), pastaj vendbanimet Veliko Tërnovo, Stara i Nova Zagora, Gorna e Dollna Orjahovica etj. Pas sulmeve të pandërprera ndaj këtyre fshatrave në këta dy shekujt e fundit, shqiptarët braktisën ato në tërësi apo mbetën vetëm disa veta; të ikurit u ngulitën në Vllahi, Moldavi, Rusi etj.[67] Shqiptarët në këtë vend, veçanërisht kolonia shqiptare në Sofje, zhvilluan aktivitete të shumta kombëtare e kulturore.[68]

---

[64] N. Jorgaqi, *Larg dhe afër*, Tiranë, 1987, f. 183.

[65] E. Çabej, *Studime gjuhësore*, V, f. 50.

[66] F. Altimari, *Po aty*, f. 121.

[67] Për këto dhe hollësi të tjera të shqiptarëve në këtë vend, shih: I. Dermaku, *Rilindja kombëtare shqiptare dhe kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe Bullgari,* Prishtinë, 1983, ff. 12-16.

[68] B. Sokollova, "Roli i kolonisë shqiptare të Sofjes për zhvillimin e letërsisë shqipe në kohën e Rilindjes", S*eminari mbi kulturën shqiptare për të huaj*, 4, Prishtinë, 1978, ff. 233-245; I. Dermaku, *Po aty.*

Shqiptarët, gjithashtu herët, që nga depërtimi i turqve në Ballkan, e veçanërisht pas gjysmës së shekullit XVII u ngulitën edhe në Rumani, në provincat e Vllahisë, Moldavisë, Dobruxhës, Transilvanisë, Besarabisë etj. Luftërat e shumta dhe varfëria ekonomike i detyroi t'i braktisin trojet e veta dhe t'i marrin rrugët e mërgimit të largët. Në Rumani formuan koloni të forta si në Bukuresht, Konstancë, Krajovë, Ploesht, Brashovë etj., ku u shquan si zejtarë, tregtarë, luftëtarë të merituar në kryengritjet rumune, madje edhe si sundimtarë të njohur; përmendet se 16 princa shqiptarë sunduan në Moldavi e Vllahi. Kolonitë shqiptare në këtë vend, përmes klubeve e shoqërive, në masë të konsiderueshme zhvilluan veprimtarinë e tyre për çlirimin kombëtar, pastaj në fushë të letërsisë, të arsimit dhe përgjithësisht të kulturës shqiptare.[69]

Ngulimet shqiptare në këto dy shekujt e fundit dhe kryesisht në etapa u bënë edhe në Rusi. *Agnja Desnickaja*, gjuhëtare e njohur, theksonte se shqiptarë kishte në katër fshatra: Gamovska, Georgievska dhe Devnensko në rajonin e Prijazovit të krahinës Zaporozhje dhe fshati Zhovtnevoe në krahinën Karakurte. Në vitin 1951, sipas disa burimeve, në këto fshatra të BRSS-së jetonin 2.586 shqiptarë, ndërsa në tërë Bashkimin Sovjetik rreth 4.800 shqiptarë.[70] Shqiptarët u shpërngulën edhe në Egjipt e Siri, ku në kohën e Rilindjes kombëtare zhvilluan aktivitete të gjera kulturore e kombëtare. Në Siri dhe Egjipt u ngulitën në qytete dhe si koloni të forta u dalluan veçanërisht në Damask, në Aleksandri dhe në Kajro; në Egjipt jetuan dhe vepruan Çajupi, Thimi Mitkoja etj.[71]

Shtegtime e ngulitje të shqiptarëve pati edhe në disa vise në truallin e ish-Jugosllavisë, si p. sh. në *Dalmaci*, ku fshati Arbënesh afër Zarës u themelua në vitin 1734. Prof. Çabej thoshte se në "Dalmaci gjatë gjithë bregdetit si dhe nëpër ishujt ka pasur edhe të tjera koloni të shpërndara shqiptare"[72] Pas luftërave austriako-turke të viteve 1690 dhe 1737, nga Kosova e Maqedonia shqiptarët emigruan edhe në Srem, ku duke ikur nga zullumet turke, së bashku me serbët dhe austriakët, u grupuan në fshatrat, *Nikinci, Jarak, Hërtkovci* etj. midis Savës e Shabacit,[73] Meqenëse ishin luftëtarë

---

[69] V. Balaj, "Lidhjet kulturore shqiptaro-rumune", *Buletini i shkencave të Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës*, Numër i posaçëm, Shkodër 1964, ff. 53-88; shih më gjerë: I. Dermaku, *Po aty*, f. 16 e tutje.

[70] A. Desnickaja, *Albanskij jazik i jego dijalekty,* Nauka, Leningrad, 1968, ff. 11-12.

[71] E. Çabej, "Ngulimet shqiptare jashtë atdheut", në *Studime gjuhësore, V*, f. 61; shih gjithashtu M. Mufaku, *Shqiptarët në botën arabe (Shek. XVIII – fillimi i shek. XX),* Rilindja, Prishtinë, 1990, ff. 1-182.

[72] E. Çabej, *Po aty*, f. 59.

[73] Shih më gjerë: M. Kostić, "Ustanak Srba i Arbanasa u Sraroj Srbiji protiv Turaka 1737-1739 i Seoba u Ugarsku", *Glasnik Srpskog naučnog društva, knj. VII-VIII, Skoplje, 1930;* i njëjti: "Prilog za istoriju emigracionog pokreta iz Stare Srbije god. 1737", *Južna Srbija,* IV,

trima,[74] qeveria austriake i përdori për mbrojtjen e kufirit nga turqit, si milici kufitare përgjatë Savës. Dhe, derisa në rajonin e kësaj kolonie shqiptare nuk erdhën "hungarezët, gjermanët, serbët dhe një mori kombesh tjera (shek. XVIII), në kishën e Nikincit, Hërtkovcit dhe fshatrave të tjera ushtrohej predikimi i fesë vetëm në gjuhën shqipe"[75] Në këtë oazë shqiptare në fillim të shekullit XX mezi dëgjohej gjuha shqipe, ndërsa sot kjo bashkësi në tërësi është asimiluar.[76] Para më se një shekulli, përkatësisht para luftës serbo-turke të viteve 1876-1878, shqiptarët, në numër të madh, jetonin në rreth 550 fshatra të rrethit të Prokuples (Toplica, Kosanica, Dobriqi, Pusta Reka, Jabllanica etj.), të *Vranjës* (rrethina e Vranjës dhe e Leskovcit, Polanica, Masurica, Veternica, Gërdelica etj.), të *Nishit* (Nishi me rrethinë) si dhe vetë rrethet e këtyre qyteteve (Prokupla, Kurshumlia, Vranja, Leskovci, Nishi, Piroti dhe Bella Pallanka).[77] Mirëpo, pas vitit 1876, siç theksuam edhe më parë, me qëllim të krijimit të shtetit të pastër etnik serb, pushteti serb i dëboi të gjithë shqiptarët nga këto vise. Vetëm nga Toplica me rrethinë, pohonte vetë Cvijiqi, ishin shpërngulur më se 30.000 shqiptarë[78]; ata u ndoqën nën dhunë dhe terror, duke i lënë pasuritë e tyre.

6. Shqiptarët në Turqi

Një numër i madh i shqiptarëve, në periudha të ndryshme historike dhe nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, të Kosovës, të Maqedonisë, të Greqisë e të Bullgarisë emigroi në Turqi. Shqiptarët e ardhur në këtë vend, si për nga numri, ashtu edhe për nga shtrirja hapësinore padyshim paraqesin ngulimin më të madh të tyre jashtë trungut amë etniko-gjeografik. Për qëllime të caktuara politike e hegjemoniste, përmes dhunës dhe formave të ndryshme të presionit që ushtronin regjimet serbe mbi shqiptarët, veçanërisht pas vitit 1912, më së

Skoplje, 1923, ff. 273-279; i njëjti; "Arnautsko naselje u Sremu", *Južna Srbija, III*, 1923; i njëjti; "Prilozi istoriji srpsko-arbanaškog ustanka 1689-1690", *Arhiv za arbansku starinu, jezik i etnologiju*, II, Beograd, 1924, ff. 11-18.

[74] J. von Hammer, *Historija turskog (osmanskog) carstva*, 3, Zagreb, 1979, f. 165.

[75] Z. Cana, *Shpalime historike*, Prishtinë, 1982, ff. 188-190.

[76] E. Çabej, *Po aty*, f. 59.

[77] S. Uka, "Vendbanimet e Sanxhakut të Nishit të banuar me popullatë shqiptare dhe të përzier në vitet 1877/78", *Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike, XII,* Prishtinë, 1983, ff. 105-124.

[78] J. Cvijić, *Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije,* knj. III, Beograd, 1911, f. 1166. Shih gjithashtu: Sh. Rahimi, *Vilajeti i Kosovës*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1969, f. 53.

shumti shqiptarë u shpërngulën në Turqi nga trojet e tyre etnike nga ish-Jugosllavia.

Për nga koha e ngulitjes shqiptarët në Turqi në mes vete diferencohen në "shqiptarë të vjetër" dhe në "shqiptarë të rinj". Sipas të ardhurve të viteve të 50-ta të shekullit XX, "shqiptarë të vjetër" konsiderohen migruesit nga fillimi i shekullit XX e deri në Luftën I Botërore. Nga shqiptarët e ardhur në vitet e 90-ta "shqiptarë të vjetër" njihen edhe të ardhurit e viteve të 50-ta të shekullit të kaluar nga ish-Jugosllavia. Ndërsa "shqiptarë të rinj" cilësohen imigrantët e fundit të shekullit XX, të ikurit shqiptarë të Kosovës nga represioni dhe terrori serb, por edhe shqiptarët e ikur nga Shqipëria pas rënies së komunizmit dhe veçanërisht pas krizës së vitit 1997. Por në Turqi edhe para Luftës I Botërore kishte shqiptarë vendës, të cilët, me marrëveshjet greko-turke për këmbimin e popullsive, u shpërngulën. "Gjer në mbarim të luftës 1914-1918, në Trakenë turke kanë qenë dhjetë katunde shqiptare nga të cilat tri - Aftoni, Klazaki dhe Marmara me 1.200 shtëpi gjithsej - në buzë të detit Marmara dhe shtatë të tjera - Aballar, Karahakli, Alituntash, Bazaar-Dere, Ibrik-Tepe,[79] Mandriç, Sulltan Koei e Zallof, me 2.500 shtëpi - në qarkun e Edrenës. Por kur u bë shkëmbimi i popullsive midis Turqisë e Greqisë[80], të gjithë banonjësit e këtyre fshatrave, duke qenë të besimit ortodoks, u dërguan kundër dëshirës së çfaqur, në Greqi".[81]

Shpërngulja më e madhe e shqiptarëve në Turqi ndodhi në periudhën midis dy luftërave botërore dhe pas Luftës II Botërore. Midis dy luftërave, siç theksuam më parë, vlerësohet se në këtë vend u vendosën rreth 240.000 shqiptarë dhe rreth 50.000 të tjerë në Shqipëri, ndërsa pas përtëritjes së marrëveshjes së vitit 1938 për shpërnguljen e të gjithë shqiptarëve nga ish-Jugosllavia, në periudhën pas Luftës II Botërore në Turqi mendohet se u shpërngulën rreth 250.000 shqiptarë. Numri i shqiptarëve dhe shtrirja e gjerë hapësinore e tyre në Turqi sot është aq e madhe sa janë të grumbulluar në fshatra të tëra dhe në lagje të veçanta e pjesë të tjera të qyteteve të mëdha, si dhe në qendra më të vogla urbane, por ka edhe shumë sish që janë të shpërndarë anembanë Turqisë. Më shumë shqiptarë, siç dihet, ka në Stamboll me rrethinë,[82] në Bursë me rrethinë, pastaj në Izmir, Manisë, Ajdin, Çanakkala, Izmit, Adapazar, Ankarë, Adanë, Kajseri, Samsum, Qemal Pashë,

---

[79] Ibrik-Tepea është vendlindja e Fan S. Nolit.

[80] Këmbimi u bë në bazë të Traktatit të Llozanës të vitit 1923.

[81] J. Milaj, *Raca shqiptare*, Tiranë, 1944, f. 120.

[82] Një studim shumë interesant për shumë aspekte për shqiptarët në Stamboll e ka bërë etnologu francez Gilles de Rapper në kuadër të programit të kërkimeve "Turqi – Kaukaz - Deti i Zi". Shih: G. de Rapper, *Les Albanais à Istambul,* Institut français d'études anatoliennes G. Dumézil, Istambul, 2000, pp. 1-24.

Bafër etj. Më tepër janë territorialisht kompakt të vendosur sipas vendit apo krahinave prej nga kanë ardhur.

Rrjedha variabile e lëvizjes së numrit absolut dhe relativ të turqve në të gjitha territoret e ish-Jugosllavisë pas Luftës II Botërore, veçanërisht në Maqedoni dhe në Kosovë, dhe stagnimi apo edhe zvogëlimi i numri të shqiptarëve në vitet e 50-ta të shekullit të kaluar, është një indikator i rëndësishëm i shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi në këtë periudhë. Shqiptarët në regjistrimin e vitit 1953 në raport me regjistrimin e vitit 1948, në nivel të ish-Jugosllavisë shënuan rritje për vetëm 3.814 banorë, ndërsa në Maqedoni patën zvogëlim prej 197.389 më 1948 në 162.524 veta më 1953 ose për 24.865 veta. Kjo do të thotë se ata, në shumicën e rasteve, deklaroheshin si turq për t'u shpërngulur në Turqi. Kështu, p.sh., në ish-Jugosllavi në vitin 1948 ishin regjistruar 97.954 ose 0,6% turq, në vitin 1953 ky numër rritet në 259.535 (l,5%), më 196l bie në 182.964 (l,0%), më 1971 gjithashtu shënon rënie (127.920 ose 0,6%), ndërsa në regjistrimin e vitit 1981 vërehet rënie edhe më e madhe, në 10l.291 ose 0,5% në popullsinë e gjithmbarshme të ish-Jugosllavisë.[83]

Shkaku kryesor i këtij oscilimi të numrit të turqve qëndron në deklarimin e shqiptarëve për turq, sepse vetëm në atë mënyrë mund të emigronin në Turqi nën presionin e rrethanave, të cilat i kishte krijuar pushteti serbo-jugosllav. Për këtë arsye, "një pjesë e shqiptarëve dhe e kombësive të tjera ishte deklaruar për kombësi turke me qëllim që t'i marrë dokumentet për shpërngulje. Përveç kësaj, një numër i popullsisë turke, shqiptare dhe boshnjake ka ardhur nga viset e tjera të vendit në Maqedoni me qëllim të shpërnguljes në Turqi".[84] Dukuria e shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi në atë kohë "mund të kuptohej vetëm kur të kiheshin parasysh këto fakte: së pari, procesi i shpërnguljes masive të shqiptarëve dhe turqve kishte filluar pas vitit 1958, ndonëse grupet e para të pjesëtarëve të tyre filluan të shpërnguleshin nga Maqedonia që nga vitit 1953 dhe diçka më herët dhe, së dyti, të përfshirë në psikozën e shpërnguljes masive dhe nën ndikim të drejtpërdrejtë të saj, shqiptarët filluan në pikëpamje kombëtare të përcaktoheshin si turq... Edhe pse shumë interesante nga aspekti i barazisë së kombeve dhe të kombësive në vendin tonë, kjo dukuri, mjerisht, ka mbetur deri sot e pastudiuar, për çka flet se si në këtë periudhë është shikuar ky proces i shpërnguljes masive të pjesëtarëve të kombësive të përmendura".[85]

---

[83] Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 1981. Nacionalni sastav stanovništva po opštinama, *Statistički bilten 1295*, Svezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 8.

[84] D. Anakiovski, "Kretanje zaposlenosti i promene u socijalnoj strukturi stanovništva SR Makedonije", *Stanovništvo*, br. 4, Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1967, f. 295.

[85] J. Sinadinovski, "Osnovne strukturalne promene stanovništva SR Makedonije u posleratnom periodu razvitka", Cvijićev *zbornik*, SANU, Beograd, 1968, f. 269.

Në favor të mospërputhjes së numrit të popullsisë, që është deklaruar për kombësi turke, me përkatësinë e vërtetë kombëtare, shkon edhe gjuha amtare që e ka folur vetë kombësia turke. Sipas regjistrimit të vitit 1953 si turq me përkatësi kombëtare ishin përcaktuar, siç theksuam, 259.535 veta, ndërsa në pyetjen mbi gjuhën amtare, kishin deklaruar në atë regjistrim se gjuhën turke e flasin vetëm 181.887 veta ose 70,0%. Ndërkaq, sipas regjistrimit të vitit 1961, prej 182.964 turqve sa ishin evidencuar, vetëm 90.883 ose 50,0% të tyre e kanë folur gjuhën turke, që do të thotë se pjesa tjetër e deklaruar për kombësi turke ka folur gjuhë të tjera, ndër të cilat dominonte gjuha shqipe.[86] Gjuha amtare është karakteristikë shumë e rëndësishme për ndriçimin e përkatësisë kombëtare të çdo bashkësie etnike. Si sferë shumë e ndërlikuar e raporteve shoqërore, gjuha shpreh historinë e një populli, atdheun e tij, tregon përkatësinë prindërore e familjare etj. Gjuha amtare është veçori që nuk ndryshon për një kohë të gjatë, prandaj edhe është indikator shumë i rëndësishëm për ekzistimin e vërtetë të një bashkësie etnike apo kombëtare në territor dhe në kohë të caktuar.

Maqedonia, siç përmendëm edhe më parë, ishte territor në të cilin përfundonte etapa definitive e emigrimit pa kthim në Turqi. Nga të gjitha viset e tjera njerëzit do të vijnë në Maqedoni, përkatësisht në Shkup, drejt të cilit do të rrjedhin valët e migrantëve nga Kosova, Sanxhaku, Bosnja e Hercegovina, Serbia e Jugut dhe në mënyrë të veçantë nga pjesët e tjera të Maqedonisë. Në Shkup gjatë viteve të 50-ta e më vonë funksiononin shërbime speciale për përgatitjen e dokumenteve për shpërngulje dhe për ndërrimin e përkatësisë kombëtare. Motivet e shpërnguljes ishin të njëjta me ato midis dy luftërave, vetëm diçka të modifikuara në rrethana të reja shoqërore e politike. Procesi i emigrimit vazhdonte sipas marrëveshjes së fshehtë, të përtërirë nga marrëveshja e vitit 1938. Shpërngulja përputhej plotësisht me aksionin e mbledhjes së armëve në Kosovë dhe përcillej me maltretimet e shqiptarëve, veçanërisht të inteligjencisë dhe punëtorëve të arsimit. Aksioni i mbledhjes së armëve me arsyetim se kinse shqiptarët kanë ngritur krye dhe po përgatiteshin për kryengritje të armatosur dhe bashkim me Shqipërinë, ishte në të vërtetë i menduar si pretekst për ndjekjen dhe shpërnguljen e tyre në Turqi. Në këtë periudhë edhe shpifeshin akuza të ndryshme ndaj shqiptarëve, madje edhe inskenoheshin organizata sekrete politike "irredentiste" e "shqiptaromëdha".[87]

---

[86] Shih për këtë në studimin: *Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti*, Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1978, ff. 139-142.

[87] "Organet e sigurimit shtetëror në Kosovë zbatuan metoda të ndryshme të presionit, pastaj insinuata dhe inskenime, akuza të rrejshme për krijimin e organizatave sekrete artificiale në dëm të shqiptarëve... Në Plenumin VII të KK të LK të Kosovë e Metohisë, në vitin 1966, u përmendën shumë shembuj të inskenimit të organizatave të rrejshme armiqësore.

Në këtë mënyrë zbatoheshin me përpikëri planet fashistoide të Çubrilloviqit dhe të tjerëve me qëllim që të shpërnguleshin shqiptarët dhe të serbizohej Kosova dhe çështja e Kosovës të kundrohej si çështje ekskluzivisht serbe.[88] Mirëpo edhe pse në vitet e 50-ta të shekullit të kaluar, gjatë kohës së Rankoviqit, Kosovën e përfshiu vala e fuqishme e shpërnguljes së shqiptarëve, në një anë, dhe vala e kolonizimit të serbëve dhe e malazezëve, në anën tjetër, megjithatë përbërja kombëtare e saj nuk u ndryshua. Dhe, "përfundimisht, me Plenumin e Brioneve (1966) iu vë pikë këtij problemi. Para botës Jugosllavia socialiste nuk ka mundur më të angazhohej për çështjen krejtësisht serbe, çfarë ishte ringjallja e Kosovës serbe".[89]

Shumë aspekte të problemit të shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi, por edhe më shumë të diasporës shqiptare në këtë vend, kanë mbetur pa u ndriçuar. Një nga çështjet ende të pandriçuara është gjithsesi numri i saktë i popullsisë së shpërngulur, ku autorë të ndryshëm japin shifra të ndryshme. P. Nushi vlerësonte se prej vitit 1953 deri në vitin 1972 nga e gjithë ish-Jugosllavia në Turqi janë shpërngulur 246.108 veta,[90] H. Hoxha theksonte se prej vitit 1953 deri në vitin 1966 në Turqi janë shpërngulur 230.716 veta, prej të cilëve më se 80% ishin shqiptarë,[91] ndërsa sipas D. Anakiovskit vetëm "në periudhën 1955-1958 nga Maqedonia janë shpërngulur 160.000 veta,[92] por sipas J. Sinadinovskit shpërngulja për në Turqi ka qenë më markante pikërisht pas vitit 1958.[93] Demografi D. Vogelnik, edhe pse nuk jepte numrin e të shpërngulurve në Turqi, megjithatë theksonte se si për nga vëllimi, ashtu edhe për nga rrethanat në të cilat është zhvilluar procesi i shpërnguljeve në Turqi në periudhën 1953-1961, "marrë johistorikisht është fenomen që bën përjashtim".[94]

Gjithashtu ishte bërë dukuri dhe praktikë e përgjithshme që në ditën e festës kombëtare shqiptare, më 28 nëntor, organet e sigurimit shtetëror natën e vënin flamurin shqiptar në vende publike dhe, menjëherë, të nesërmen i arrestonin shqiptarët e pafajshëm" (H. Hoxha, "Proces nacionalne afirmacije albanske narodnosti u Jugoslaviji", *Časopis za kritiko znanosti*, 51- 52, Ljubljana, 1982, f. 349).

[88] Sh. Maliqi, *Nyja e Kosovës*, Knjižna zbirka KRT, Ljubljana, 1990.

[89] Sh. Maliqi, "Nacionalizmima treba vaditi kvadratni koren", *Thema*, nr. 7, Prishtinë, 1986, f. 44.

[90] P. Nushi, "Karakter i osobenosti prilaza izučavanju iseljeništva naroda i narodnosti pokrajine Kosova", në publikimin *Iseljeništvo naroda i narodnosti Jugoslavije*, Zagreb, 1978, f. 586.

[91] H. Hoxha, "Kosovo in Albanci u novi Jugoslaviji", në librin *Albanci*, Cankarjeva založba, Ljubljana, 1984, f. 214.

[92] D. Anakiovski, *Po aty*, f. 294.

[93] J. Sinadinovski, *Po aty*, f. 269.

[94] D. Vogelnik, "Obim i karakteristike unutrašnje migracije u Jugoslaviji u razdoblju 1953-1961", *Ekonomski anali*, nr. 12-13, Beograd, 1962.

Të gjitha vlerësimet e deritanishme flasin se në periudhën e pas Luftës II Botërore numri i shqiptarëve të shpërngulur në Turqi sillet deri afër 250.000 veta. Mirëpo, meqenëse nuk janë hapur të gjitha arkivat, ku ende ruhen shumë fshehtësi lidhur me shpërnguljen masive të shqiptarëve, por edhe të tjerëve në këtë vend aziatik, e sidomos arkivat e ministrive të punëve të jashtme të dy ish-Jugosllavive dhe të Turqisë, ku gjenden fakte dhe të dhëna të hollësishme për këtë çështje, mendojmë se duhet ende të punohet në hulumtimin e të gjitha rrethanave, pasojave dhe veçanërisht numrit të të shpërngulurve shqiptarë në Turqi, si dhe shtrirjen territoriale, procesin e adaptimit e të asimilimit të tyre dhe shumë çështjeve të tjera të diasporës shqiptare në këtë vend aziatik.

Imigrantët nga Shqipëria në Turqi, veçanërisht në Stamboll, ndërkaq, do t'i gjejmë që nga koha e Perandorisë Osmane, madje edhe të konfesionit ortodoks, të cilët u asimiluan kryesisht në grekë, ndërsa shqiptarët myslimanë u shkrinë në turq. Në kohën e Rilindjes Stambolli ishte një koloni e fortë e shqiptarëve, e cila zhvilloi një aktivitet të dendur kulturor dhe u angazhua shumë për çështjen kombëtare; aty vepruan vëllezërit Frashëri, Pashko Vasa, Ismail Qemali etj. Në kohën e diktaturës komuniste Shqipëria u izolua dhe natyrisht nuk kishte më shpërngulje. Mirëpo, pas rënies së komunizmit dhe sidomos pas krizës së vitit 1997 pasoi një valë e ikjeve dhe e ngulitjeve në Turqi, veçanërisht në Stamboll dhe në pjesët e qyteteve të tjera të mëdha ku komuniteti shqiptar ishte tashmë mirë i integruar në shoqërinë turke, duke u ndihmuar nga pjesëtarët e lidhjeve të dikurshme familjare (kushërinjtë etj.), por edhe nga bashkësia shqiptare nga trevat e ish-Jugosllavisë. Sipas të dhënave të Shoqatës së Emigrantëve Shqiptarë në Turqi, në vitin 1997 nga Shqipëria kishin ardhur në Turqi 4.500 familje me 27.000 persona, ndërsa në vitin 1998 2000 familje me 15.000 persona. Mirëpo, një numër i konsiderueshëm i tyre pas një kohe të shkurtër nga Turqia emigroi në SHBA, në Kanada dhe në vende të tjera.[95]

Sa i përket pasojave të shpërnguljes masive të shqiptarëve në Turqi, ato ishin të mëdha si në rrafshin kombëtar, politik e demografik, ashtu edhe në atë ekonomik, psikologjik, familjar etj. Para së gjithash, pas një vale kaq të madhe të shpërnguljes pasoi një rrudhje e dimensionit etnikodemografik të shqiptarëve si në vëllim, ashtu edhe në shtrirje hapësinore; u shpopulluan fshatra të tëra në Maqedoni me ç'rast shumë sipërfaqe të punueshme u shndërruan në kullota e lëndina, ndërsa në qytete u zhdukën disa zanate dhe veprimtari të tjera shërbyese; u bë kolonizimi i territoreve shqiptare me element sllav; u bë tjetërsimi i pronave të paluajtshme dhe i pasurisë tjetër të të

[95] Sipas: G. de Rapper, *Les Albanais à Istambul,* Institut français d'études anatoliennes G. Dumézil, Istambul, 2000, pp. 7-8.

shpërngulurve; u krijua psikoza e frikës dhe e pasigurisë për shqiptarët e mbetur, duke u shtuar presioni dhe ndjekjet ndaj tyre dhe duke u reduktuar të drejtat më elementare njerëzore e kombëtare deri te ndalimi i përdorimit të gjuhës shqipe në jetën publike, pastaj të simboleve kombëtare dhe diskriminimi në të gjitha sferat e jetës e të punës. Njëra nga pasojat padyshim më negative ishte ndarja e familjeve dhe bllokimi i kontakteve fizike të të shpërngulurve me vendlindjen dhe farefisin e tyre etj.

Janë komplekse edhe shumë aspekte të tjera të mërgatës shqiptare në Turqi, sikurse në sferën e identitetit, gjuhës dhe martesave. Identiteti është problemi kryesor i bashkatdhetarëve në Turqi jo vetëm pse shteti turk i njeh vetëm si qytetarë, e jo si grup të posaçëm etnik apo si "minoritet", por pse brezat e lindur në Turqi le që nuk flasin më shqip, por në përpjekjet për t'u integruar tërësisht në shoqërinë turke, e fshehin edhe prejardhjen shqiptare dhe distanca në raport me prejardhjen e tyre gjithnjë e më shumë po thellohet. Identiteti shqiptar ruhet vetëm në sferën e familjes e të farefisit.

Në shumicën e familjeve shqiptare ende flitet gjuha turke dhe shqipe, ndërsa brezat e parë e të dytë si gjuhë të parë mes veti e kishin shqipen. Shumë prej tyre, në kohën e ardhjes në Turqi madje nuk dinin as turqisht, sepse ishin nga rajonet fshatare të ish-Jugosllavisë apo të Greqisë dhe nuk arritën dot ta mësonin mirë këtë gjuhë. Një nga arsyet pse migrantët e para të të gjitha valëve nuk mund të gjenin punë në shërbimet publike ishte mosnjohja e gjuhës turke. Prandaj punonin në sektorin privat, në rajonet rurale në bujqësi, ndërsa në qytete në shitoret tregtare të pronarëve turk. Nga fillimi i viteve të 60-ta të shekullit të kaluar shumë sish, madje edhe me familje shkojnë në punë në Gjermani, në Belgjikë etj. Një numër i madh i tyre deri vonë martesat i bënte mes veti (endogamia), gjë që preferohet edhe sot. Themelimi më i pëlqyeshëm i bashkësive martesore është sipas rregullit "as shumë larg, as shumë afër", që nënkupton martesa midis shqiptarëve, por jo edhe brenda lidhjeve farefisnore.[96]

Edhe shqiptarët në Turqi janë të grupuar dhe të organizuar në shoqata dhe grupe folklorike, që mundësojnë ruajtjen e identitetit të një pjesë e migrimit të vonë, të pas Luftës II Botërore nga trevat etnike të ish-Jugosllavisë. Organizimet e para i përkasin periudhës së Rilindjes Kombëtare, ndërsa të tjerat pas Luftës II Botërore, përkatësisht në vitet e 60-ta e të 70-ta. Është fjala për qytetet e mëdha, siç janë Stambolli, Bursa, Izmiri, Adana, Adapazari etj.Vendosja sipas krahinave prej nga kanë ardhur është pothuajse kriteri kryesor i anëtarësimit në këto shoqata. Mbi katë bazë i mbajnë edhe emrat, si p. sh. Shoqata e gostivarjanëve, e pejanëve, e tetovarëve, e prishtinasve, e

[96] G. de Rapper, *Po aty,* ff. 9-10.

gjilanasve, e kumanovasve, e prizrenasve, e kërçovarëve etj. Në Stamboll (Aksaraj) funksionon edhe Shoqata e kosovarëve, e themeluar në vitin 1994, që përpiqet t'i bashkojë shoqatat kosovare në një dhe t'i artikuloi kërkesat e mërgimtarëve, por edhe të Kosovës në Parlamentin dhe Qeverinë turke.[97] Funksionimi i shoqatave është përgjithësisht i dobët, prandaj edhe nuk ka mundur ta bashkojë komunitetin kaq të madh shqiptar, çfarë ishte rasti me diasporën tonë në Evropë dhe në Amerikë, dhe të ushtrojë ndikim politik në organet e shtetit turk. Kjo u pa edhe në rastin e Kosovës, ku pjesë të mërgatës bënë përpjekje që të ndihmonin shqiptarët e Kosovës, por kjo ndihmë as përafërsisht nuk i përgjigjej vëllimit të mërgatës. Me gjithë ngecjet në organizim, kriza e Kosovës nga fillimi i viteve të 90-ta e kishte sensibilizuar mërgatën tonë në Turqi; nga viti 1996 funksionoi edhe Zyra e Përfaqësisë së Republikës së Kosovës, e afërt me partinë më të madhe të shqiptarëve të Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës. Megjithatë, duhet theksuar se mërgata shqiptare në Turqi përkundër numrit të madh, koncentrimit në vendbanimet e mëdha urbane dhe shtrirjes së gjerë hapësinore, nuk është unike, që shpjegohet me valët imigruese në kohë të ndryshme dhe veçanërisht nga rajone të ndryshme (Shqipëri, Greqi, Bullgari, Kosovë, Maqedoni, Lugina e Preshevës).

7. Shqiptarët në SHBA

Pas ardhjes së arbëreshëve nga Italia në Amerikë rreth gjysmës së shekullit XIX, u mbushën tashmë rreth 130 vjet nga ngulitja e parë e shqiptarëve në truallin amerikan, kryesisht si emigrantë ekonomikë dhe politikë. Imigrantët e parë shqiptarë në truallin amerikan u vendosën në SHBA, kryesisht në Boston, nga fundi i shek. XIX dhe ishin nga Shqipëria e Jugut, nga Korça me rrethinë.[98] Nga organet e kohës, që dilnin në gjuhën shqipe në Amerikë, mësojmë se "shqiptari i parë erdhi në Amerikë më 1876, por shpejt shkoi në Argjentinë. I dyti ishte Kol Kristoferi (1860-1940) nga Katundi i Korçës, që erdhi më 1886."[99] Në Boston, që cilësohej si kryeqendër e shqiptarëve në Amerikë, në fillim të shekullit XX nuk kishte më shumë se 1.000 shqiptarë, që ushtronin profesione të ndryshme, ndërkaq me kohë numri i tyre rritej dhe në vitin 1939, sipas gazetave të atëhershme, në këtë qytet

[97] G. de Rapper, *Po aty,* ff. 12-14.

[98] Për shumë aspekte të imigrimit dhe të jetës së shqiptarëve në Amerikë shih librin voluminoz: V. Bajrami, *Shqiptarët e Amerikës*, Albanian Publishing, New York, 2003, ff. 1-1007.

[99] Sipas: V. Bajrami, *Po aty*, f. 57.

jetonin afër 6.000 shqiptarë.[100] Në bazë të disa kërkimeve, valët më të fuqishme të shpërnguljes së shqiptarëve ishin vitet 1904-1905, 1909-1912 dhe 1913-1914. Të gjitha këto valë emigruese lidheshin me rrethanat e vështira socialo-ekonomike në truallin etniko-gjeografik të shqiptarëve dhe me ngjarjet dhe trysnitë politike, bartës të të cilave ishin pushtetet turke dhe greke.[101]

Është vështirë të dihet numri i shqiptarëve në SHBA në fazën e parë, deri në Luftën I Botërore. Një nga arsyet qëndron në "faktin se shqiptarët, duke qenë shtetas të Perandorisë Osmane, shkonin në Amerikë me pasaporta turke, prandaj edhe në listat e emigracionit të zyrave amerikane ata figuronin si turq, ndërsa një pjesë tjetër regjistroheshin si grekë për shkak të lidhjeve fetare me Patrikanën e Stambollit. Bile shumë emigrantë erdhën edhe nga vendet ballkanike - Bullgaria, Rumani dhe Greqia, ku kishin emigruar prej kohësh. Si të tillë ata erdhën në Amerikë me dokumente identifikimi joshqiptare".[102] Megjithatë, njohësit e mirë të çështjes shqiptare, edhe vetë të mërguar, F. Noli dhe F. Konica, jepnin disa vlerësime për numrin e shqiptarëve në Amerikë. Sipas Nolit, në dhjetëvjetëshin e parë të shek. XX në "Amerikë ndodhen të pakën 30.000 shqiptarë, të cilët dërgojnë në Shqipëri për mot gjer 3 milion dollarë; pothuaj Toskëria rron nga Amerika. Ka fshatra të cilat i kanë gjithë meshkujt nga kjo anë e Atlantikut".[103] Ndërsa, F. Konica, për periudhën 1885-1914, vlerësonte se numri i shqiptarëve i ngulitur në Amerikë ishte shumë më i madh dhe arrinte deri në rreth 80.000 veta.[104]

As sot, mjerisht, nuk dihet numri i shqiptarëve në SHBA dhe përgjithësisht në kontinentin amerikan, madje as shtrirja e saktë hapësinore e tyre. Vlerësimet për numrin e tyre janë të ndryshme, varësisht nga burimet dhe autorët që i japin. Një regjistrim që u provua të bëhej në prill të vitit 1992 nuk pati shumë sukses, kryesisht për arsye të dispersionit të madh të shqiptarëve, problemeve në organizimin e tyre, por edhe të një varg pengesave të tjera. Ka vlerësime se numri i shqiptarëve atje mund të arrijë shifrën rreth gjysmë milioni. Mendohet se në SHBA aktualisht, me pasardhës, numri i shqiptarëve, të ardhur në periudha të ndryshme dhe nga rajone të ndryshme të truallit gjeoetnik, nga Italia (arbëreshët) dhe vendet e trungut të tyre amë, mund të sillet midis 350.00 dhe 400.000 shqiptarë, ku identiteti i një pjese të mirë është gjithsesi i paqartë. Më tepër janë të përqendruar në Nju-Jork me rrethinën e

[100] Sipas: V. Bajrami, *Po aty*, f. 102.
[101] V. Duka, "Diaspora shqiptare e Amerikës (1884 - 1912)", *Bujku*, Prishtinë, 1994, f. 6.
[102] V. Duka, *Po aty*.
[103] Fan S. Noli, "Sabahu dhe shqiptarët", *Dielli e Flamuri*, nr. 74, 2 dhjetor 1910; Fan S. Noli, *Vepra*, 2, Prishtinë, 1988, f. 307.
[104] Sipas: V. Duka, *Po aty*.

gjerë, pastaj në Detroit, Çikago, Boston, në rrethinën e Uashingtonit etj. Disa familje shqiptare kanë arritur madje deri në Alaskë.

Komuniteti shqiptar në SHBA është i organizuar në lidhje, shoqata e klube të shumta dhe deri në vitin 2000 dhe në degë të partive politike shqiptare të Kosovës dhe Maqedonisë. Rreth këtyre organizimeve dhe asociacioneve është e tubuar pjesa dërmuese e bashkëkombësve tanë. E tërë bashkësia shqiptare në SHBA mbeti shumë e angazhuar për zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës dhe të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, si dhe për zhvillimin dhe demokratizimin e Shqipërisë. Kosova, kriza dhe tragjedia e saj, i kishte bashkuar të gjithë shqiptaro-amerikanët, pa marrë parasysh përkatësinë rajonale, fetare dhe ideologjike. Shqiptarët e Amerikës ishin ata që kishin hapur dyert e institucioneve vendimmarrëse në SHBA për të sensibilizuar çështjen e Kosovës dhe për të vetëdijesuar opinionin amerikan deri në mbështetje të vendimit për të intervenuar ushtarakisht kundër regjimit më të egër në Evropën e gjysmës së dytë të shekullit XX.

Për numrin dhe shtrirjen territoriale të shqiptarëve në Australi, Kanada dhe Zelandë të Re nuk kemi të dhëna të hollësishme. Vlerësohet se sot në Australi mund të ketë rreth 30.000, në Kanada rreth 10.000 dhe në Zelandë të Re afër 1000 shqiptarë. Disa sish u ngulitën në këto vende pas deportimit të tyre nga forcat ushtarako-policore të Beogradit në vitin 1999.

8. Shqiptarët në Evropë

Një numër i madh i shqiptarëve, siç dihet, sot jeton, punon dhe me status të ndryshëm qëndron në të gjitha vendet e Evropës së zhvilluar. Ata në këto vende kanë ardhur shumë më pak nga Shqipëria para dhe pas Luftës II Botërore dhe shumë më tepër nga territoret etnike të ish-Jugosllavisë pas kësaj lufte, përkatësisht pas viteve të 60-ta. Nga Shqipëria erdhën kryesisht si migrantë politikë, duke mos u pajtuar me regjimin e E. Hoxhës dhe u vendosën kryesisht në Belgjikë (Bruksel) dhe Francë (Paris), ndërsa në fillim të viteve të 90-ta të shekullit XX edhe në vendet e tjera evropiane. Nga ish-Jugosllavia në fazën e parë erdhën si migrantë të punës, kurse pas viteve të 80-ta edhe si migrantë politikë, nga fillimi i viteve të 90-ta si ushtarë që e braktisën ushtrinë agresore serbo-jugosllave dhe si rekrutë për t'i ikur shërbimit në këtë ushtri.

Për nga ngulitja e hershme shquhet sidomos një bërthamë e komunitetit shqiptar në Paris dhe një tjetër në Bruksel, të formuara nga migrantë të ardhur nga Shqipëria. Ndërsa shqiptarët nga territoret e ish-Jugosllavisë, siç vumë në

pah më parë, në cilësi të ndryshme qëndrojnë kryesisht në Gjermani (rreth 170.000 veta sot), në Zvicër (rreth 130.000 veta), pastaj në Suedi, kryesisht si azilantë (rreth 35.000 veta), në Austri (rreth 25.000), në Belgjikë (rreth 8.000), në Francë, në Danimarkë e në Itali nga rreth 5.000 veta, në Norvegji rreth 3.000, në Holandë rreth 2.000, në Angli rreth 2.500 etj., ndërsa në shtetet e reja, të formuara nga ish-Jugosllavia (Sllovenia, Kroacia, BeH dhe Serbia, pa Luginën e Preshevës) para luftës jetonin dhe punonin më se 100.000 shqiptarë.

Një numër i madh i shqiptarëve në këto vende të Evropës sot jeton me familjet e tyre, të cilat i kanë sjellë nga rajonet prej nga kanë ardhur, ndërsa një numër i konsiderueshëm, meqenëse në kohën e ardhjes i përkiste moshës së re, midis 20 e 30 vjet, kishte themeluar martesa në mjediset ku punonte dhe qëndronte. Si punëtorë në këto vende kanë ardhur edhe shumë bashkatdhetarë tanë nga Turqia dhe arbëreshë nga Italia. Shoqata për Popujt e Rrezikuar me seli në Getingen (Gjermani) vlerësonte se prej fillimit të viteve të 60-ta e deri në fund të viteve të 80-ta të shekullit të kaluar, për shkaqe ekonomike dhe politike, rreth 200.000 shqiptarë nga ish-Jugosllavia kishin emigruar në vendet e përmendura të Evropës dhe rreth 50.000 të tjerë në republikat veriperëndimore të ish-Jugosllavisë. Shqiptarët në Evropë, në kuadër të organizimit të tyre në degë të partive politike të Kosovës etj., në klube, shoqata dhe asociacione të tjera kontribuuan shumë në ndërkombëtarizimin e çështjes sonë dhe dhanë ndihma të mëdha materiale për familjet e rrezikuara, për funksionimin e arsimit shqip të të gjitha niveleve, për institucionalizimin e jetës politike etj.

9. Lidhjet e diasporës me vendlindje

Shqiptarët e diasporës sot po mbajnë lidhje permanente me farefisin dhe vendlindjet e tyre. Këto kontakte më parë ishin tepër të rralla, madje të ndaluara për shkaqe politike. Shqiptarët e Turqisë, si diaspora më e madhe, me trojet e ish-Jugosllavisë, lidhjet i shpeshtuan vetëm pas ndryshimeve që u bënë në kreun politik të shtetit jugosllav në vitin 1966. Deri atëherë rreptësishtë ishin të ndaluara kontaktet e bashkatdhetarëve me familjet dhe vendlindjen, sepse pushteti serbo-jugosllav frikësohej se informimi i drejtë për jetën në Turqi mund ta ngadalësonte procesin e shpërnguljes, ndërkaq kontaktet e pakta ishin mirë të kontrolluara. Lidhjet e pjesës së diasporës me prejardhje nga Shqipëria më së voni u vunë me vendlindjet e tyre apo të prindërve e stërgjyshërve të tyre për shkaqe ideologjike. Kontaktet e diasporës me vendlindjen u intensifikuan vetëm pas rënies së sistemit policor-enverist.

Me shqiptarët që jetojnë dhe punojnë në vendet e Evropës situata është krejtësisht tjetër. Meqenëse pjesa dërmuese i përkasin migrimit ekonomik, lidhjet ishin dhe mbetën permanente me vendlindjen, farefisin dhe familjet e ngushta. Si lidhjet fizike, ashtu edhe kontaktet përmes telefonit dhe internetit sot janë bërë shumë intensive midis bashkatdhetarëve në diasporë dhe vendlindjeve të tyre, duke përfshirë këtu edhe bashkatdhetarët në Amerikë, në Australi e në Zelande të Re. Këto lidhje i mundësuan jo vetëm mjetet e komunikimit modern, por më tepër rënia e sistemeve komuniste në dy anët e kufirit, sepse këto sisteme ishin ndjekës të bashkatdhetarëve kudo që gjendeshin në diasporë dhe njëkohësisht edhe përçarës të mëdhenj të kombit.

10. Disa probleme të diasporës sonë të sotme

Migrimet e popullsisë, në gjithë dimensionin dhe manifestimet e tyre, janë të tilla që paraqesin një proces të pafrenueshëm në evolucionin e përgjithshëm të njerëzimit, veçanërisht në kohën tonë, kur ekzistojnë dallime të theksuara në shkallën e rritjes së vëllimit të fuqisë punëtore dhe nivelit ekonomik midis vendeve dhe rajoneve, kur marrëdhëniet politike, ekonomike e të tjera midis shteteve po bëhen gjithnjë më normale, ndërsa proceset integruese dhe hapja e botës po marrin një dimension të ri dhe shumëdimensional. Në procesin e lëvizjeve migruese, siç theksuam më parë, dalin veçanërisht komplekse migrimet e jashtme, ato përtej kufijve shtetërorë dhe, lidhur me to, formimi i diasporave të cilat meritojnë qasje nga shumë aspekte.

10.1. Shpërnguljet si humbje dhe si dobi

Kur të vështrohen diasporat e popujve nga perspektiva e përgjithshme e deritashme, imponohen patjetër disa dilema. *Dilema e parë* është: athua shpërnguljet intensive e të pandërprera duhet parë gjithmonë vetëm si humbje apo edhe si dobi, si proces vetëm të dëmshëm apo edhe të dobishëm? E njëjta gjë vlen edhe për diasporën shqiptare. Përvojat e deritashme treguan se migrimet e jashtme dhe diasporat, me të gjitha pasojat që kanë në disa fusha të jetës, nuk janë me çdo kusht humbje, sepse nga ato trungu gjeokombëtar ka edhe dobi në situata të caktuara shoqërore dhe politike, madje dobi të mëdha, çfarë ishte deri tash rasti me çifutët, kroatët, shqiptarët etj.

Dilema e dytë e rëndësishme që shtrohet te migrantët e jashtëm është kthyerja e tyre. Nga historia e migrimeve të jashtme mësohet se kurrë nuk

është e mundur të kthehen të gjithë të shpërngulurit, pa marrë parasysh motivet dhe efektet e emigrimit, karakterin e tyre afatgjatë apo afatshkurtër.

Është i njohur fakti se teoria e migrimeve nuk është zhvilluar sa duhet, në përputhje me vëllimin, distancën hapësinore, shkaqet, pasojat, përbërjen e migrantëve etj. në të gjitha nivelet territoriale. [105] Pas shqyrtimeve teorike mbi migrimet e popullsisë në fund të shekullit XIX na del një pauzë e gjatë, deri në vitet e 60-ta të shekullit XX, kur paraqitet teoria e *pull* dhe *push* faktorëve (faktorët tërheqës dhe faktorët refuzues). Megjithatë, sipas teorisë së migrimeve[106] edhe në nivelin që është arritur është e njohur se procesi i migrimit është stihik, sikurse edhe procesi i lindjes, që do të thotë se individi nuk preokupohet me manifestimet, në këtë rast negative, të migrimit në planin e përgjithshëm. Migrantit nuk i intereson se çka po ndodh në nivelin jashtindividual apo jashtfamiljar, a po i sjell dëme shoqërisë dhe bashkësisë etnike e fetare që i përket apo jo. Prandaj është e kotë t'u thuhet njerëzve mos e braktisni vendlindjen, sepse po dëmtohet shoqëria, po rrezikohet kombi apo armikut po i realizohen synimet, sikundër që nuk japin rezultate thirrjet që çiftët bashkëshortorë të lindin sa më shumë fëmijë dhe e kundërta. Subjektet dhe asociacionet që i tubonin shqiptarët në Kosovë e gjetiu në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, në vitet e okupimit e të terrorit serb, bënin thirrje të tilla të pandërprera, ndërsa shpërngulja jo vetëm që nuk u ndërpre, por sikur mori përmasa edhe më të gjera, ku shkalla e lartë e selektivitetit të tyre përbënte veçorinë kryesore. Insistimi që me çdo kusht të kthehen njerëzit nga bota e jashtme nuk është real, por për disa arsye as krejtësisht pozitiv.

Në këtë proces të migrimeve të shqiptarëve, siç dihet, nuk kishte vetëm shkuarje, por edhe kthyerje. Mirëpo, për shumë arsye, përveç migrantëve të punës, kthyerja e kategorive të tjera rridhte me vështirësi të mëdha. Një pjesë e migrantëve që dëshironte të kthehej deri me hyrjen e forcave ndërkombëtare në gjysmën e qershorit të vitit 1999 nuk mund të kthehej, sepse nuk posedonte dokumente përkatëse identifikimi pa të cilat pushteti okupues nuk i lejonte të hynin në Kosovë e gjetiu; një numër jo i vogël i të rinjve, pas braktisjes së ushtrisë agresore serbo-jugosllave, kishte dalë në vendet e tjera me pasaporta të Kroacisë, të Sllovenisë dhe të Bosnjë e Hercegovinës, që konsideroheshin si

[105] Ligjësitë dhe përgjithësimet rreth migrimeve kanë munguar gjatë kohë, ndonëse lëvizjet migriuese e përcjellin njerëzimit gjatë gjithë historisë së tij. Vetëm nga fundi i viteve të 90-ta të shekullit XIX G. Ravenstein përcaktoi disa "ligje dhe gjeneralizime" për migrimet për Anglinë dhe vendet e tjera (Shih: G. E. Ravenstein, *The Theory of Migration*, Journal of the Statistical Society, No 48, VI, London, 1895, pp. 167-227). Prej atëherë e deri në vitet e 60-ta të shekullit XX nuk kishte shqyrtime të tjera teorike mbi migrimet e popullsisë. Në këto vite paraqitet teoria e faktorëve *pull* dhe *push* (faktorët tërheqës dhe faktorët refuzues).

[106] E. Lee, "A theory of migration", *Demography No 3,* Chicago, 1966, pp. 47-57.

shtetas të tyre; një pjese të bashkatdhetarëve tanë u kishte kaluar afati i vazhdimit të pasaportave, por kishte edhe të tillë që kishin shkuar në botën e jashtme edhe pa asnjë dokument apo për të kërkuar strehim politik i kishin ndërruar emrat, duke i asgjësuar edhe dokumentet e identifikimit.

Qeveritë e vendeve evropiane ishin dhe mbetën shumë të preokupuara me kthyerjen e azilkërkuesve dhe të migrantëve shqiptarë nga Kosova. Numrin e azilkërkuesve shqiptarë nga Kosova, që e zinin në gojë këto vende para dhe pas hyrjes së forcave ndërkombëtare më 12 qershor 1999 duhet marrë me shumë rezervë. Për qëllime të ndryshme të vendeve imigruese, ky numër gjithnjë është zmadhuar. Në fund të shekullit të kaluar në vendet anëtare të Këshillit të Evropës përmendej shifra prej rreth 350.000 shqiptarëve nga Kosova që kishin kërkuar azil, ndërsa vetëm për Gjermani numri i azilkërkuesve, sipas disa burimeve, sillej rreth 230.000 sish (!). Pa marrë parasysh pasojat demografike, politike e kombëtare, veçanërisht ato të karakterit afatgjatë, në gjendjen në të cilën ndodhet Kosova nuk është fare joshëse për pranimin e migrantëve. Ata kërkojnë t'u sigurohen puna, banesa dhe kushtet e tjera. Në anën tjetër, të rinjtë që kanë kaluar disa vjet në botën e jashtme, me plot frustrime, vështirë adaptohen në rrethanat tona ekzistuese, meqë mund të shtohen frustrimet e një natyre tjetër. Meqenëse pjesa dërmuese janë të moshës së re, si rrethanë lehtësuese për adaptim dhe "jetë të re" është stabiliteti familjar (martesat), por edhe ky stabilitet lidhet me kushtet e tjera jetësore, para së gjithash me punësimin dhe banesën. Barra do t'u bie vetëm familjeve të tyre, të cilat në shumë raste edhe janë ndihmuar materialisht nga vetë migrantët që kanë punuar në vendet imigruese.

Diaspora shqiptare, me gjithë efektet e pavolitshme në disa rrafshe për trojet emigruese, ishte dhe mbeti kapital i madh kombëtar, material, politik e moral dhe faktor i fuqishëm në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe të asaj shqiptare në përgjithësi. Ajo në situata të rënda u tregua shumë e dobishme: rreth çështjes së Kosovës ishte bashkuar për herë të parë në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar; komuniteti shqiptar në diasporë, pa marrë parasysh dallimet rajonale, ideologjike apo fetare, luajti një rol të madh në sensibilizimin e problemit tonë para opinionin amerikan, evropian dhe ndërkombëtar dhe për ndihmën materiale dhe morale që i dha Kosovës dhe shqiptarëve. Të përmendim vetëm protestat masive të bashkatdhetarëve në vendet perëndimore për çështjen e Kosovës, angazhimin në dhënien e ndihmave financiare për funksionimin e arsimit shqip, për institucionet tjera dhe për rezistencën e armatosur kundër okupatorit serb etj. Shqiptarët e Amerikës ishin ata që e futën çështjen e Kosovës në agjendën e instancave më të larta shtetërore amerikane, në Kongres dhe në Senat.

10.2. Dy fatkeqësitë e mërgatës sonë

Diaspora jonë paraqet një faktor gjithnjë aktual në raportet reciproke me territoret amë. Mirëpo diasporën tonë, historike dhe bashkëkohore, veçanërisht pjesën më të re, përveç vështirësive të tjera, e kanë përcjellë dy fatkeqësi. Fatkeqësia e parë ka të bëjë me moskonsolidimin e trungut gjeoetnik edhe në rrafshin politik-shtetëror, si pasojë e copëtimeve të njëpasnjëshme dhe të dhunshme politike të territorit etnik shqiptar. Nga mungesa e trungut politik-shtetëror rezultoi një ndikim tepër i vogël i "amave" kombëtare në organizimin e diasporës sonë. Fatkeqësia tjetër, që i përket pjesës së dytë të shekullit XX, lidhet me "përqafimin" e regjimeve komuniste në të gjitha "amat" kombëtare, që si përçarës më të mëdhenj të kombit shqiptar patën ndikim vetëm negativ në jetën e mërgatës sonë.

Sistemet komuniste, shqiptare e jugosllave, deri në fillim të viteve të 90-ta të shekullit XX, kryesisht për shkaqe ideologjike, nuk kishin iniciativa dhe përpjekje sistematike institucionale për organizimin e diasporës. Përkundrazi, ishin ndjekës të paskrupullt të bashkatdhetarëve kudo që gjendeshin, duke i konsideruar kryesisht si elemente të dyshimta dhe armiqësore. Edhe Shqipëria e edhe ish-Jugosllavia, përmes organeve të tyre konsulare-diplomatike e policore, që vepronin shpeshherë së bashku, gjithë angazhimin e kishin të orientuar në përçarjen e bashkatdhetarëve tanë, duke ushtruar presion dhe shantazh mbi ta për t'i vënë në funksion spiunimi. Ndikimi i tyre madje shkonte në drejtim të shkatërrimit të organizimit të jetës kulturore e kombëtare të mërgatës sonë: agjenturat policore, Sigurimi i Shqipërisë dhe UDB-a Jugosllave, duke u infiltruar thellë në shoqatat dhe klubet shqiptare në Turqi (Stambolli, Bursa, Izmiri etj.), në vendet evropiane (Brukseli, Parisi, Londra, Shtutgarti etj.) dhe në SHBA (Nju-Jorku, Uashingtoni, Bostoni, Çikago, Detroiti etj.) ngulfatën apo edhe rrënuan edhe ato pak organizime kulturore, shoqërore e politike të bëra nga vetë bashkatdhetarët. Misioni i Shqipërisë në OKB në Nju-Jork ishte njëri ndër përçarësit më të mëdhenj të shqiptarëve të Amerikës, veçanërisht të Njujorkut me rrethinë!

Këto shtete ndihmonin dhe financonin shumë organizata e shoqata marksiste-leniniste dhe projugosllave, të cilat i drejtonin vetë shqiptarët. Drejtuesit dhe organizatat nxiteshin dhe përkraheshin nga segmente të caktuara diplomatike-policore të Shqipërisë zyrtare dhe të ish-Jugosllavisë zyrtare. Të gjithë mërgimtarët që nuk inkuadroheshin në skemën e interesave të këtyre dy shteteve dhe ideologjive të tyre komuniste ndiqeshin në mënyra të ndryshme, madje edhe likuidoheshin fizikisht.

10.3. Diaspora nën mëshirën e fatit

Shqipëria e transicionit vetëkuptohet se nuk mund të luante më një rol të tillë, por nuk mund të thuhet se sot ka një rol aktiv e konstruktiv ndaj diasporës sonë, sepse atë do ta shohë më tepër nga prizmi i përfitimeve të drejtpërdrejta materiale të administratës dhe elitës politike, e jo edhe nga aspekti i investimeve në ekonomi dhe i përfitimit të përvojave të saj në organizimin e jetës ekonomike e demokratike; në fillim të fazës së transicionit bashkatdhetarët treguan gatishmëri që të investonin në Shqipëri, por korrupsioni i aparatit shtetëror bëri që të largoheshin menjëherë, duke lënë atje madje edhe teknologjinë e sjellë. Përkundër mundësive që ka (shtet i pavarur, me plot ambasada, konsullata e shërbime të tjera), Shqipëria dhe diplomacia e saj as sot nuk bën asgjë të mirë për diasporën, madje as për mërgimtarët dhe qytetarët e vet në botën e jashtme. Ambasadat e Shqipërisë kudo në Evropë dhe jashtë saj, të gjitha veprimet e paligjshme të qytetarëve të saj (prostitucioni, droga, vjedhjet etj.) nuk i pranon si të qytetarëve të saj, por gjitha këto ua mbath shqiptarëve të Kosovës. Në fillim të viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, pas përmbysjes së sistemit diktatorial, u ngrit njëfarë drejtorie për diasporë, duke e vënë në krye të saj një kosovar, me të vetmin qëllim që t'i fuste në dorë fondet financiare të mërgimtarëve nga Kosova dhe trojet e tjera etnike, ndërsa nga fundi i kësaj dekade, pas vitit 1997, brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë nisi të veprojë Instituti Kombëtar për Diasporë, i cili gjithashtu, pos synimeve grabitqare, nuk bëri asgjë për mërgatën tonë.

Nga vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, me formimin e partive politike në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare, nisi një organizim më i mirë i diasporës si në Evropë, ashtu edhe në Amerikë. Mirëpo, dobësitë në sektorin e organizimit politik dhe lufta për pushtet ishin reflektuar mjaft keq te bashkatdhetarët tanë në diasporë, ndërsa disa përpjekje për një organizim të ri të diasporës nga gjysma e këtyre viteve ishin po kështu në funksion të liderizmit dhe të privilegjeve politike e materiale të individëve dhe grupeve të caktuara. Pas intervenimit të NATO-s dhe ndjekjes së forcave serbe nga Kosova diaspora jonë, pas gjithë kontributit që kishte dhënë për çlirimin e Kosovës, sikur mbeti nën mëshirën e fatit: ndonjë vizitë të rrallë që i bëjnë liderët politikë janë më tepër në funksion të promovimeve të tyre dhe përfitimeve partiake-politike e financiare. Një bërthamë për diasporën (Departamenti për Çështje Jorezidente) në kuadër të Ministrisë së Kulturës të Qeverisë së Kosovës është vetëm një dekor e asgjë më tepër. Ajo dhe instancat e tjera kosovare nuk bënë gjë as për përfshirjen e shqiptarëve në regjistrimin

civil dhe votues në Kosovë, ku vetëm në Evropë mbetën jashtë procesit votues të paktën 200.000 shqiptarë.

Njohuritë për diasporën tonë sot nuk janë të plota, duke u nisur nga shkaqet e formimit të saj dhe pasojat për trungun gjeokombëtar e deri te numri dhe shtrirja territoriale e pjesëtarëve të saj, pozita sociale dhe ekonomike në vendet e ngulitjes dhe në shoqëritë e tyre, problemi i adaptimit, i nostalgjisë, i integrimit, i asimilimit, i identitetit, i sjelljeve, i lidhjeve me vendlindjen dhe i mundësive të mërgatës për t'i ndihmuar trojet e para etniko-gjeografike etj. Për disa pjesë të komunitetit, qoftë në Evropë, qoftë në "Botën e Re" (SHBA, Kanada, Australi) mungojnë madje edhe informatat më elementare; të dhëna dhe fakte të bollshme, përmes intervistave, reportazheve, kronikave dhe shënimeve të tjera për diasporën tonë në SHBA, siç theksuam më lart, na ka dhënë gazetari Vehbi Bajrami në librin voluminoz, të posabotuar në Nju-Jork, me titull "Shqiptarët e Amerikës".[107]

Territoreve amë dhe pushteteve të tyre qendrore (Shqipëria dhe Kosova), si dhe qendrave të policentrizmit subjektor (Shkupi, Tetova, Presheva, Ulqini etj.) u mbetet që sa më shumë që të jetë e mundur, me përpjekje sistematike e aktive, të punojnë në njohjen, studimin, organizimin institucional dhe kanalizimin e angazhimit të diasporës, duke e mbajtur në lidhje permanente me vendlindjen dhe duke e konsideruar faktor dhe kapital të rëndësishëm për interesin e përgjithshëm kombëtar dhe shoqëror në të gjitha pjesët e trungut tonë gjeoetnik (gjë që u dëshmua në kohët më kritike për "amat"), përfshirë sidomos sferën e investimeve, që kërkon një siguri ligjore dhe institucionale.

[107] V. Bajrami, *Shqiptarët e Amerikës,* Albanian Publishing, New York, 2003, ff. 1-1007. Është kjo pa dyshim një gazetari hulumtuese sui generis (intervista, reportazha, shënime për aspekte të ndryshme të jetës së personaliteteve të shquara shqiptare dhe gjithë bashkësise shqiptare), e vlefshme edhe për historinë.

Pjesa e tetë

PROJEKSIONET E POPULLSISË SË KOSOVËS

I. PARASHIKIMET AFATGJATA DEMOGRAFIKE

1. Disa vërejtje rreth projeksioneve të popullsisë

Një nga sferat që hyn në objektin e studimit të demografisë si shkencë shoqërore janë edhe *politika popullative dhe drejtimet e mundshme të zhvillimit të ardhshëm demografik*. Ndër parashikimet e përgjithshme të lëvizjes së ardhshme të popullsisë dallohen *projeksionet e popullsisë* ose *projeksionet demografike*,[1] si një nga çështjet më problematike, sepse në kohën e hartimit të tyre krejt varet se a do të mund të vihen drejt hipotezat mbi lëvizjen e popullsisë në të ardhmen, dhe atë si kur është fjala për numrin e përgjithshëm të popullsisë, ashtu edhe për komponentët e ndryshëm të saj, para së gjithash për mortalitetin, natalitetin, strukturën e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë, për migrimet etj. Projeksionet e popullsisë sot paraqesin një mjet dhe faktor të rëndësishëm në planifikimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror dhe veçanërisht janë të domosdoshme për planifikimin urbanistik, hapësinor dhe rajonal. Të gjitha projeksionet demografike nuk kanë rëndësi të njëjtë për planifikim; derisa disa prej tyre janë pjesë përbërëse e planeve të zhvillimit shoqëroro-ekonomik, disa të tjerat japim pasqyrën e ndryshimeve të ardhshme në popullsi dhe komponentët e saj Pas Luftës II Botërore. Me ndryshimet e mëdha në lëvizjen e popullsisë së botës, përpilimi i projeksioneve të popullsisë shtrohet si problem universal, ku njohuritë mbi trendët bile aproksimative të numrit të popullsisë në të ardhmen bëhen shumëfish të dobishme. Në gjithë këtë periudhë shërbimet e specializuara të OKB-së për çështje demografike si një nga preokupimet themelore kishin hartimin e vlerësimeve dhe të projeksioneve të popullsisë, ku çdo dy vjet bëjnë revidimin e tyre.[2]

Përveç *projeksioneve demografike*, në parashikimin e përgjithshëm të lëvizjes së popullsisë në të ardhmen, në demografi dallohen edhe konceptet *vlerësim, prognozë* dhe *perspektivë*. *Vlerësimet* jepen për periudhën e sotme ose për periudhën e kaluar, kanë veçori të parashikimit në vija të përgjithshme dhe rëndom bëhen në një variant. *Prognozat* mund të përpilohen për periudhën e ardhshme dhe paraqesin qëndrimin e vetë prognozuesit, p.sh. për popullsinë e përgjithshme, numrin e të lindurve të gjallë, përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë etj. *Perspektivat demografike* jepen po kështu për

---

[1] UN, *Višejezički demografski rečnik (srpskohrvatska verzija),* CDI, IDN, Beograd, 1971, pika 720, f. 72.

[2] United Nations, *World Population Prospects 1992,* New York, 1993. pp. 682; United Nations, *World Population Prospects, The 1994 Revision,* New York, 1995, pp. 1-888.

periudhën e ardhshme, por mbështeten në disa kushte ose hipoteza të mundshme. Mirëpo, projeksionet demografike në të vërtetë nënkuptojnë edhe prognozat edhe perspektivat demografike dhe kanë disa variante.[3]

Te projeksionet demografike një çështje gjithsesi shumë e rëndësishme është gjatësia e periudhës për të cilën parashihet lëvizja e popullsisë dhe realiteti i pritur i projeksionit. Mirëpo, duke pasur parasysh llojin e popullatës së projektuar (popullata e gjithmbarshme, kontingjentet sipas moshës, gjinisë, të fuqisë punëtore etj.), një ndarje e përvijuar qartë në këtë drejtim në demografi nuk ekziston.[4] Megjithatë, në parashikimin e lëvizjes së popullsisë në të ardhmen dallohen tri lloje të projeksioneve: *afatshkurtre, afatmesme* dhe *afatgjate*. Në të gjitha këto projeksione si bazë merren supozimet e caktuara, që mbështeten në normat e mëparshme të rritjes dhe në disa determinante të tjera që kanë ndikimin e tyre në gjendjen numerike të popullsisë. Sipas disa autorëve, këto supozime mund të përmblidhen në disa: që e ardhmja të jetë e njëjtë me të kaluarën; që nuk do të ketë valë të madhe të migrimeve të jashtme ("popullata e mbyllur"); që do të ketë migrime të mëdha të jashtme ("popullata e hapur"); që e ardhmja nuk do të jetë e njëjtë me të kaluarën etj. Në përputhje me këtë vihen edhe parimet nismëtare dhe llogariten parashikimet *pesimiste, të mesme* dhe *optimiste*, ku formulohen edhe tipat e varianteve të *fertilitetit të ulët, të mesëm, të lartë, konstant* etj.

Sa i përket kohëzgjatjes së projeksioneve të popullsisë ekzistojnë mendime të ndryshme. Sipas disa autorëve, projeksionet e popullsisë deri në 5 vjet konsiderohen afatshkurta, 5 deri në 10 vjet afatmesme dhe mbi 10 vjet afatgjate,[5] ndërsa, sipas autorëve të tjerë, duke pasur parasysh fertilitetin si komponentë dhe kontingjentin e popullsisë femërore në periudhën prokreative për përcaktimin e drejtimeve të ardhshme të popullsisë sipas moshës dhe gjinisë thekson se projeksione afatshkurta janë ato deri 15 vjet (të gjithë fëmijët e gjinisë femërore që ishin gjallë në fillim të periudhës projektuese deri në fund të kësaj periudhe do të hyjnë në periudhën e përtëritjes biologjike), afatmesme projeksionet deri në 50 vjet (të gjitha femrat e fillimit të periudhës projektuese deri në fund të kësaj periudhe do të dalin nga periudha fertile) dhe afatgjate projeksionet mbi 50 vjet.[6]

---

[3] G. Todorović, *Projekcije stanovništva (teoretsko-metodološka studija),* CDI, IDN, Beograd, 1978, ff. 9-12.

[4] G. Penev, "Projekcije stanovništva SR Jugoslavije, 1991-2150. u kontekstu dugoročnih projekcija stanovništva sveta", *Stanovništvo,* br. 1-4/1992 - 1-2/1993, CDI, IDN, Beograd, f. 64.

[5] M. Friganović, *Demogeografija (Stanovništvo svijeta)*, Školska knjiga, Zagreb, 1978, ff. 102-103.

[6] G. Penev, *Po aty,* f. 64.

Për shumë arsye projeksionet afatshkurta janë më reale. Por, vështruar nga aspekti i saktësisë dhe zbatimit të projeksionit përkatës, në qoftë se projeksionet trajtojnë komponentët demografikë në kuptim të ngushtë, të cilat transformohen në një afat më të gjatë kohor, siç janë fertiliteti, mortaliteti, numri i bashkësive të lidhura martesore, formimi i popullsisë së përgjithshme pa ndikim të konsiderueshëm të migrimeve etj., në këtë rast edhe projeksionet afatgjata mund të jenë reale. Ndërsa te projeksionet që kanë për objekt shqyrtimi veçoritë socioekonomike të popullsisë, ku migrimet janë shumë më të shprehura, më reale duken projeksionet afatshkurta.[7] Për projeksionin e lëvizjes së ardhshme të popullsisë shfrytëzohen tabelat e fertilitetit dhe mortalitetit specifik sipas grup-moshave pesëvjeçare, analizohen tendencat e manifestuara në stadin e caktuar të transicionit demografik, si dhe ndryshimet afatgjata në sferën e përtëritjes biologjike (fertiliteti dhe mortaliteti) dhe në zgjatjen mesatare të jetës së popullatës për të cilën bëhen projeksionet.

Problemi i dytë te projeksionet demografike nga të cilat varen edhe rezultatet e parashikimeve të lëvizjes së popullsisë janë *metodat*, esenca e zbatimit të të cilave qëndron në përcaktimin e normës hipotetike të rritjes ose rënies së popullsisë, e cila ndryshon gjatë kohës. Metodat e llogaritjes së parashikimeve të popullsisë, të cilat më shpesh përdoren, janë *metoda matematike, metoda analitike* dhe *metoda intermediare*.

Metoda matematike, që është shfrytëzuar në botë në kohën e paraqitjes së planifikimit, bazohet në hipotezën se e ardhmja do të jetë e njëjtë me të kaluarën dhe është më e përshtatshme kur të prognozohet për periudha të shkurta. Ky supozim del i arsyeshëm ngase lëvizja e popullsisë në periudhë të shkurtër kohore nuk mund të ketë fluktuime, por ka rrjedhë të zhvillimit të harmonishëm, me pulsime të ngadalshme, në një anë, dhe proceset demografike, sikundër edhe efektet e tyre, janë të karakterit afatgjatë, në anën tjetër. Në zbatimin e kësaj metode dallohen rastet kur disponohet me të dhëna nga dy, tre e më tepër regjistrime nga e kaluara. Për periudhën midis dy regjistrimeve zbatohet metoda e interpolacionit linear, ndërsa për periudhën pas regjistrimit të fundit zbatohet metoda e ekstrapolacionit linear, duke shfrytëzuar progresionin aritmetik.

Metoda analitike paraqet një kthesë të madhe në projeksionet e popullsisë. Si bazë për zbatimin e kësaj metode është vlerësimi i disa komponentëve demografikë dhe ndikimi i tanishëm i tyre në lëvizjen e popullsisë. Nëse bëhet parashikimi i popullsisë sipas moshës dhe gjinisë, si bazë për këtë tip të projeksionit shërben përbërja aktuale e strukturës së

[7] D. Breznik, *Kretanje, struktura i projekcije stanovništva, 2,* Savezni biro za poslove zapošljavanja, Beograd, 1968, ff. 117-118; D. Todorović, Po aty, f. 21.

popullsisë sipas moshës dhe gjinisë, ndërsa për trendët e komponentëve të tjerë, siç janë fertiliteti, mortaliteti dhe migrimet vihen hipotezat që bazohen në manifestimet e deritashme të tyre dhe në faktorët që kanë ndikuar në këto komponentë. *Metoda intermediare* bazohet në përbërjen e popullsisë sipas moshës, të fituar sipas metodës së mësipërme, por edhe sipas disa modifikimeve të tjera.

Ekspertët e demografisë gjithnjë theksojnë se zgjedhja dhe zbatimi me sukses i metodave në hartimin e projeksioneve demografike varet nga vëllimi i popullatës, "popullata e mbyllur" (pa migrime), "popullata e hapur" (me migrime), tipi i projeksionit dhe kohëzgjatja e tij (afatshkurtre, afatmesme, afatgjate), pastaj nga fakti se a kanë projeksionet për objekt trajtimi komponentët demografikë në kuptim në ngushtë (fertiliteti, mortaliteti, numri i bashkësive martesore, formimi i popullsisë së gjithmbarshme pa ndikim të migrimeve të popullsisë etj.) apo trajtojnë komponentët demografikë në kuptim të gjerë (struktura sociale dhe ekonomike, migrimet e popullsisë).[8]

2. Kosova dhe Serbia: dy pole të kundërta demografike në perspektivë

Industrializimi, urbanizimi dhe procesi i transicionit demografik në periudhën pas Luftës II Botërore në ish-Jugosllavi dhe ndryshimet që i sollën ato në zhvillimin e popullsisë në nivelin e përgjithshëm dhe, më shumë, në atë rajonal, shtruan nevojën e studimit të lëvizjeve demografike si për periudhën e kaluar, ashtu edhe për periudhën nëpër të cilën kalonte ish-shoqëria dhe për të ardhmen. Përpjekjet e para për hulumtimin e aspekteve të ndryshme të zhvillimin të popullsisë paraqiten menjëherë pas kësaj lufte, diku edhe para saj, por gjithnjë në kuadër të statistikës, shkencës ekonomike, shkencave të tjera sociale dhe planifikimit. Mirëpo, kërkimet demografike marrin impulse kualitativisht të reja pas konstituimit të demografisë si disiplinë të veçantë shkencore dhe hulumtimeve të organizuara, me formimin e disa bërthamave institucionale në disa qendra të ish-shtetit. Demografët dhe ekspertët e statistikës, kryesisht sllovenë, pos studimeve të tjera, hartuan edhe prognoza dhe projeksione demografike në kohëzgjatje dhe variante të ndryshme, si për popullsinë e përgjithshme, ashtu edhe për shumë parametra të tjera të popullsisë: sipas moshës, gjinisë, natalitetit, mortalitetit, fuqisë punëtore, ekonomive familjare, projeksione me migrime, pa migrime etj. [9]

---

[8] D. Breznik, *Demografija,* ff. 341-362; G. Todorović, *Po aty,* ff. 22-43.

[9] Shih: I. Lah, "Stanovništvo FNRJ u periodu 1948-1970", *Statistička revija,* br. 3-4, Beograd, 1951, ff. 372-392; D. Breznik, "Zapažanja i prognoze nekih kategorija

Këtu nuk do të merremi me dobësitë apo përparësitë e metodave të zbatuara dhe me faktin se a janë vënë drejt hipotezat, e as me verifikimin e rezultateve të projeksioneve demografike serbo-jugosllave, sikundër që nuk do t'i zëmë në gojë as projeksionet e hartuara prej vitit 1948 deri në fillim të viteve të 90-ta. Në këto shqyrtime, duke iu referuar disa projeksioneve të popullsisë së institucioneve demografike dhe statistike serbo-jugosllave, do të prezantohet gjendja aktuale dhe tendencat zhvillimore të popullsisë së Kosovës dhe të Serbisë në të ardhmen. Meqenëse paragjykimet dhe shovinizmi ndaj Kosovës dhe shqiptarëve mori përmasa të gjera pas vitit 1981, nuk mund të mos dyshohet në porosinë e këtyre projeksioneve nga qarqet politike e shtetërore serbe e jugosllave. Megjithatë, indikatorët themelorë të lëvizjes së popullsisë së projektuar janë të rëndësishme për njohjen e ardhmërisë demografike të dy entiteteve, Kosovës dhe Serbisë, si dy pole popullative diametralisht të kundërta: në Kosovë procesi i transicionit demografik ende nuk ka përfunduar, ndërsa në Serbi ky proces tashmë është kryer dhe kriza demografike, së bashku me krizën ekonomike, politike e morale, tashmë ka hyrë në një fazë kritike me pasoja afatgjata. Paralelja midis Kosovës dhe Serbisë në raportet demografike sot dhe në perspektivë na duket e domosdoshme për shumë arsye.

Projeksionet që prezantohen kanë të bëjnë me periudhën prej vitit 1991 deri në vitin 2150, ku për raportin e perspektivës demografike midis Kosovës dhe Serbisë dhe njëkohësisht edhe për pozitën popullative dhe gjeopolitike të Kosovës dhe shqiptarëve në Ballkan janë të rëndësishme numri i përgjithshëm i popullsisë, norma e fertilitetit, shkalla e mortalitetit të foshnjave dhe struktura e popullsisë sipas moshës. Në të gjitha këto projeksione që do të paraqiten është zbatuar metoda analitike, ndërsa komponenti migrues e popullsisë në shumicën prej tyre nuk është marrë në konsiderim. Për përpilimin e këtyre projeksioneve është shfrytëzuar sistemi programor për analizë statistike SAS (Statistical Analysis System), ndërsa me rastin e vënies së hipotezave dhe formulimit të varianteve të projeksioneve, janë marrë kryesisht parasysh porositë dhe supozimet e shërbimeve profesionale të OKB-së.[10]

budućeg stanovništva FNRJ sa osvrtom na natalitet i mortalitet", *Statistička revija,* br. 3, Beograd, 1956, ff. 217-234; "Perspektivni razvitak stanovništva u periodu 1957-1961", *Socijalna politika,* br. 9, Beograd, 1957, ff. 3-19; D. Vogelnik, "Perspektiva razvoja prebivalstva Slovenije 1953-1963", *Ekonomska revija,* št. 2, Ljubljana, 1958, ff. 321-334.

[10] Shih më hollësisht: United Nations, *World Population Prospects,* New York, 1991; United Nations, *Long-rang World Population Projections. Two Centuries of Populations Growth, 1950-2150,* New York, 1992, pp. 136; United Nations, *World Population Prospects, The 1994 Revision,* New York, 1995, pp. 1-888.

Pothuajse në hartimin e të gjitha projeksioneve, që do të paraqiten këtu, hipotezat mbi mortalitetin janë dhënë në një apo dy variante, ndërsa të fertilitetit (numri i lindjeve të gjalla në raport me popullsinë femërore në periudhën e përtëritjes - 15-49 vjet) prej tri deri në tetë variante; për periudhën 1991-2150 tetë variantet, për shkaqe praktike, janë reduktuar në tri. Këta dy komponentë, mortaliteti dhe fertiliteti, janë edhe vendimtare për ndryshimin e numrit dhe strukturës së popullsisë sipas moshës dhe gjinisë, por edhe të indikatorëve të tjerë demografikë në të ardhmen. Për disa projeksione baza nismëtare edhe për Kosovën edhe për Serbinë është regjistrimi i popullsisë i vitit 1981, ndërsa për një projeksion të hartuar në vitin 1993 për Serbinë është marrë viti 1991 (regjistrimi), kurse për Kosovën është bërë vlerësimi i popullsisë nga autori që e hartoi (G. Penev), meqenëse shqiptarët për arsye tashmë të njohura nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë të këtij viti. Ky projeksion më i ri, i karakterit afatgjatë, si bazë nismëtare merrte gjendjen para shkatërrimit të ish-Jugosllavisë.

Tabela 1. Projeksioni i popullsisë së Kosovës dhe Serbisë 1981-2016, sipas variantit të mesëm të fertilitetit, me migrime[11]

Viti	Kosova	Serbia	Kosova	Serbia
	(në mijë)	(në mijë)	Indeksat 2016-1981 (1981=100)	
1981	1.595	5.701	100,0	100,0
1991	1.953	5.907	122,4	103,6
1996	2.141	5.966	134,2	104,6
2001	2.330	6.001	146,1	105,3
2006	2.505	6.004	157,1	105,3
2011	2.657	5.985	166,6	105,0
2016	2.911	5.957	176,2	104,5

[11] G. Penev, *Projekcije stanovništva Jugoslavije, republika i pokrajina 1981-2016,* Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1990 (interna studija); D. Breznik, *Stanovništvo Jugoslavije***,** Konzorcijum instituta društvenih nauka, Chronos, Titograd, 1991, f. 230.

Tabela 2. Projeksioni i popullsisë së përgjithshme të Kosovës dhe Serbisë 1981-2021, sipas tri varianteve të fertilitetit, pa migrime[12]

Varianti	Viti	Kosova Gjithsej (në mijë)	Serbia Gjithsej (në mijë)
	1981	1.585	5.695
I ulët	2001	2.481	5.781
	2021	3.171	5.334
I mesëm	2001	2.542	5.914
	2021	3,455	5.964
I lartë	2001	2.573	5.964
	2021	3,757	6.043

Tabela 3. Zgjatja mesatare e jetës së fëmijëve të porsalindur në Kosovë dhe në Serbi 1991-2016, sipas projeksioneve me migrime[13]

Viti	Kosova		Serbia	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
1991	67.86	72.78	70.00	73.84
1996	68.89	73.64	70.91	75.57
2001	69.92	74.51	71.81	76.31
2006	70.96	75.36	72.74	77.04
2011	71.98	76.20	73.67	77.77
2016	73.00	77.02	73.18	78.00

Për shkak të gjatësisë së periudhës për të cilën projektohet lëvizja e popullsisë, sa i përket gjendjes numerike edhe të Kosovës edhe të Serbisë, përkatësisht të shqiptarëve dhe të serbëve, për arsye tashmë të përmendura, parashikimet mund të mos realizohen, por është e sigurt se diku rreth vitit 2061 do të krijohet raporti i barabartë numerik, 5 milionë me 5 milionë banorë, ku në Serbi afër 800.000 banorë apo rreth 15% do të jetë popullsi joserbe: boshnjakë, shqiptarë, malazezë, romë, vllahë, të papërcaktuar. Sipas variantit të mesëm të projeksionit, në vitin 2050 Kosova do të kishte 4,5 milionë banorë, ndërsa Serbia rreth 5 milionë banorë. Në vitin 2100 Kosova parashikohet të kishte më se 5 milionë banorë, kurse Serbia rreth 4,5 milionë

[12] Grup autorësh, "Projekcije stanovništva do 2021. godine bez migracija", në publikimin *Demografski problemi i populaciona politika Kosova i Metohije,* Univerzitet u Beogradu, Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1992, f. 227.

[13] G. Penev, *Po aty;* D. Breznik, *Po aty.*

banorë, ndërsa në vitin 2150 këto dallime do të stabilizohen rreth këtyre raporteve numerike ose edhe do të thellohen në favor të vëllimit demografik të Kosovës dhe shqiptarëve.

Sipas variantit të mesëm të projeksionit në fjalë, në periudhën 1991-2150, norma e rritjes vjetore të popullsisë, e shprehur në promilë, për Kosovën do të jetë 6,06, ndërsa për Serbinë minus 1,61. Bashkësia etnike serbe në Kosovë plotësisht do të margjinalizohet, duke u reduktuar qysh në gjysmën e shekullit XXI në më pak se 2% në popullsinë e gjithmbarshme të Kosovës, ndërsa nga numri i përgjithshëm i serbëve në Ballkan, kjo bashkësi do të përbënte vetëm rreth 0,3%.

Kur të flitet për perspektivën demografike midis Kosovës dhe Serbisë dhe shqiptarëve dhe serbëve, në bazë të tendencave deri tash të manifestuara, por edhe më shumë në bazë të projeksioneve, dallimet do të jenë strukturalisht dhe kualitativisht edhe më të mëdha: sipas variantit të mesëm, në vitin 2021 në Kosovë grup-mosha 0-14 vjet do të përbëjë 26,4% dhe grup-mosha mbi 65 vjet vetëm 5,3%, ndërsa në Serbi kontingjenti i grup-moshës 0-14 vjet do të përbëjë 18,7% dhe grup-mosha 65 e më tepër vjet 16,1%, që paralajmëron hyrjen në një fazë të moshënimit të thellë demografik, me tendenca të thellimit të mëtutjeshëm në periudhën pas viteve të 20-ta të shekullit të ardhshëm; pas këtyre viteve në Kosovë parashihet rënia e mortalitetit të foshnjave deri në nivelin e vendeve sot të zhvilluara, që drejtpërdrejt do të ndikojë në rritje të numrit të popullsisë. Sipas këtij varianti të fertilitetit, p. sh., në vitin 2050 midis Kosovës dhe Serbisë në kontingjentet e moshës prej 15-64 vjet (periudha e punës, e pjesës më të madhe të përtëritjes biologjike) edhe absolutisht, edhe relativisht do të barazohen: Serbia me gjithsej 5 milionë banorë do të ketë 2.926.000 veta, ndërsa Kosova me 4.5 milionë banorë 2.889.000 veta të kësaj moshe, që do të thotë se Serbia seriozisht do të ballafaqohet, përveç tjerash, edhe me mungesën e fuqisë punëtore. Në vitet 2100 dhe 2150 vëllimi absolut i kontingjenteve të moshës së re dhe të mesme në Kosovë do të jetë dukshëm më i madh se në Serbi.

Pothuajse të gjitha projeksionet nuk i kushtojnë kujdes të madh hipotezave mbi mortalitetin në Kosovë; në njërin prej tyre theksohet se gjatë periudhave projektuese niveli i tij do të jetë konstant, ndërsa në tjetrin se do të pasojnë ndryshime në drejtim të zvogëlimit të mëtejshëm të tij, veçanërisht të mortalitetit të foshnjave, që do të jetë edhe burim i mëtejshëm i rritjes së popullsisë, ndonëse një projeksion deri në vitin 2016, i hartuar në vitin 1990, nuk parasheh rënie të madhe të mortalitetit të foshnjave. Ndërsa hipotezave mbi fertilitetin (natalitetin) i kushtohet rëndësi shumë më e madhe dhe atë në disa variante, prej të cilave gjithmonë si më realja merret variante e fertilitetit të mesëm. Sipas këtij varianti, fertiliteti në Kosovë, nën influencën e proceseve

të modernizimit të shoqërisë kosovaro-shqiptare dhe, lidhur me këtë, të transicionit të shpejtuar demografik, do të shënojë tendencë të rënies, por nuk do të bie nën nivelin e riprodhimit të thjeshtë të brezave. Në vitin 2016 norma e fertilitetit të përgjithshëm[14] në Kosovë do të jetë 2,60 fëmijë, ndërsa në Serbi 1,9 fëmijë.[15] Në vitin 2021, ndërkaq, sipas variantit të mesëm të fertilitetit, numri i fëmijëve të lindur gjallë në një grua në Kosovë do të ishte 2,5, ndërsa në Serbi 2,1 fëmijë.

Tabela 4. Komponentët e lëvizjes së popullsisë së projektuar të Kosovës dhe Serbisë në periudhën 1991-2021, mesatarisht në vit, sipas variantit të mesëm, me migrime[16]

Periudha	Rritje/ Rënie	Saldoja neto migruese	Shtimi natyror	Të lindur gjallë	Të vdekur
Kosova					
1991-2001	33.431	-7.164	40.594	52.821	12.226
2001-2011	35.563	-8.224	43.786	56.993	13.206
2011-2021	32.478	-6.782	39.260	54.587	15.327
Serbia					
1991-2001	10.663	12.279	-1.616	65.825	67.441
2001-2011	13.377	14.456	-1.279	70.457	71.736
2011-2021	8.052	11.438	-3.386	73.286	76.673

[14] Në demografi kjo normë nënkupton numrin e përgjithshëm të fëmijëve të lindur gjallë në një grua gjatë gjithë periudhës prokreative, që do të thotë se në rrethanat e mortalitetit të sotëm, norma e fertilitetit të përgjithshëm prej 2,15 fëmijë është e mjaftueshme për përtëritjen e thjeshtë të popullsisë.

[15] Në Serbi, siç vumë në pah edhe më parë, qysh në vitin 1990 shtimi natyror ishte 7.280 veta ose 1,2 promilë, ndërsa serbët e këtij vendi ishin shtuar vetëm për 760 veta. Pjesa tjetër e shtimit natyror i përkiste bashkësive të tjera etnike, si p. sh. boshnjakëve, shqiptarëve, romëve etj. (Lj. Gaćeša, "Statistički prilozi", *Stanovništvo,* br. 3-4, CDI, IDN, Beograd, 1994, f. 210). Ose, sipas regjistrimit të vitit 1991, nga 4.217 vendbanime sa kishte Serbia, 3.130 sish kishin shtim negativ natyror apo shtim zero (Grup autorësh, "Naselja u SR Jugoslaviji sa negativnim ili nultim prirodnim priraštajem u 1991. godini", *Stanovništvo,* br. 1-4/1992 - 1-2/1993, CDI, IDN, Beograd, f. 239). Këto tendenca kanë vazhduar me një tempo edhe më të shpejtuar, kështu që sot Serbia ka shtim negativ natyror për më se 20.000 banorë, gati të gjithë serbë, me përqindje të lartë të të moshuarve, me zvogëlim të numrit të martesave dhe rritje të numrit të shkurorëzimeve, ndërsa fshati i saj ka kohë që po përjeton një thyerje të plotë demografike.

[16] Grup autorësh, *Projekcije stanovništva Savezne republike Jugoslavije 1991-2021,* Savezni zavod za statistiku - Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1996, f. 108.

Tabela 5. Komponentet e lëvizjes së popullsisë së projektuar të Kosovës dhe Serbisë, sipas variantit të mesëm në periudhën 1991-2021, me migrime (në promilë)[17]

Periudha	Norma e rritjes së popullsisë	Norma e saldos migruese	Shtimi natyror	Nata-liteti	Mort-aliteti
Kosova					
1991-2001	15,7	-3.4	19,0	24,8	5,7
2001-2011	14,3	-3,3	17,7	23,0	5,7
2011-2021	11,5	-2,4	13,9	19,4	5,4
Serbia					
1991-2001	1,8	2,1	-0.3	11,2	11,5
2001-2011	2,2	2,4	-0,2	11,8	12,0
2011-2021	1,3	1,9	-0,6	12,0	12,6

Tabela 6. Dinamika e popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës dhe Serbisë në periudhën 1991-2051 (ndryshimet spontane), sipas variantit të projeksionit, pa migrime[18]

Viti	Numri i përgjithshëm		Rritja mesatare vjetore		
	Kosova	Serbia	Periudha	Kosova	Serbia
1991	1.956.000	5.809.000	1991-1996	40.000	1.000
1996	2.155.000	5.816.000	1996-2001	42.000	-10.000
2001	2.365.000	5.766.000	2001-2006	45.000	-13.000
2006	2.589.000	5.700.000	2006-2011	44.000	-23.000
2011	2.811.000	5.583.000	2011-2016	42.000	-28.000
2016	3.020.000	5.441.000	2016-2021	38.000	-31.000
2021	3.208.000	5.286.000	2021-2026	34.000	-33.000
2026	3.376.000	5.123.000	2026-2031	30.000	-35.000
2031	3.524.000	4.949.000	2031-2036	25.000	-37.000
2036	3.651.000	4.764.000	2036-2041	21.000	-37.000
2041	3.756.000	4.479.000	2041-2046	16.000	-35.000
2046	3.837.000	4.406.000	2046-2051	11.000	-32.000
2051	3.892.000	4.244.000	1991-2051	32.266	-26.083

[17] *Po aty,* f. 118.

[18] *Razvitak stanovništva Srbije 1950-1991,* Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1995, f. 129.
Vërejtje: Sipas këtij varianti (ndryshimet spontane), hipotezat mbi trendet e ardhshme të popullsisë bazohen në supozimin mbi ndryshimet spontane të fertilitetit, që do të thotë pa zbatimin e ndonjë politike popullative.

Tabela 7. Mortaliteti i foshnjave në Kosovë dhe në Serbi 1991-2016, sipas projeksioneve me migrime (në promilë)[19]

Viti	Kosova		Serbia	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
1991	52,19	51,06	21,15	17,71
1996	47,88	47,62	19,13	16,06
2001	43,56	42,19	17,11	14,36
2006	39,25	37,75	15,09	12,69
2001	34,94	33,31	13,06	11,02
2016	30,63	28,87	11,15	10,39

Mirëpo, përveç përparësive të Kosovës në raport me Serbinë në numrin e përgjithshëm dhe strukturën e popullsisë sipas moshës, edhe Kosova do të ndeshet me problemet që bartin këta komponentë demografikë, para së gjithash me dendësinë e popullsisë, e cila, sipas projeksionit të variantit të mesëm të fertilitetit, do të rritet nga rreth 200 banorë në një kilometër katror, sa ka sot, në rreth 410 në vitin 2050 dhe në rreth 470 banorë në vitin 2100, kur edhe parashihet stabilizimi në këtë nivel. Kjo gjendje demografike, natyrisht, do të ketë efektet e veta edhe në sferat e tjera të jetës shoqërore, me të cilat nuk mund të merremi, për shkak të qëllimit të shqyrtimeve, por edhe të hapësirës së kufizuar. Por, gjithashtu duhet vënë në pah edhe faktin se natyra e projeksioneve afatgjata demografike është e tillë që shpie edhe drejt dramatizimit të pasojave që dalin nga tendencat e parapara të rezultateve të zhvillimit të popullsisë.

Në bazë të strukturës së përmendur të popullsisë sipas moshës dhe rrjedhimisht të numrit mesatar të fëmijëve të lindur gjallë në një grua të moshës fertile (15-49 vjet), të gjitha qarqet serbe e vlerësojnë gjendjen demografike në Serbi si katastrofale, me implikime të mëdha në jetën ekonomike, sociale, nacionale dhe shtetërore në kontekst afatgjatë kohor. Me gjithë përpjekjet dhe, më shumë, zhurmën e institucioneve shkencore e shtetërore serbe, karakteri i proceseve demografike, veçanërisht i riprodhimit të popullsisë si sfera më e ndërlikuar dhe më intime e jetës njerëzore, është i tillë që ekzistojnë shumë pak mundësi që Serbia të arrijë sukses në rehabilitimin e natalitetit dhe në regjenerimin e dëshiruar të lëvizjes dhe strukturës demografike në përgjithësi. Por, me këtë rast, duhet pasur parasysh edhe pasojat e drejtpërdrejta dhe indirekte demografike të shprishjes së ish-

[19] G. Penev, *Projekcije stanovništva Jugoslavije, republika i pokrajina 1981-2016*, CDI, IDN, Beograd, 1990; D. Breznik, *Stanovništvo Jugoslavije,* Chronos, Titograd, 1991, f. 229.

Jugosllavisë dhe të luftës (1991-1995), të cilat në disa njësi të ish-Federatës, pra edhe në Serbi, e cila në mënyra të ndryshme e ka zhvilluar luftën në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, kanë krijuar raporte të reja në strukturën e popullimit dhe në zhvillimin demografik në përgjithësi. Në Serbi një situatë e tillë duket se mund të ketë ndikim të volitshëm në numrin e përgjithshëm të popullsisë (ardhja e rreth 650.000 serbëve nga Kroacia e BeH), edhe pse statusi përfundimtar i refugjatëve nuk dihej deri vonë nga se nuk hynin as në kategorinë e "popullsisë së përhershme".[20] Në anën tjetër, efektet negative të luftës sigurisht janë më të mëdha për shkak të humbjeve të drejtpërdrejta demografike (vdekja e të rinjve nga Serbia në luftërat në ato dy ish-republika, eksodi masiv i të rinjve serbë nga Serbia në botën e jashtme për ta evituar pjesëmarrjen në luftëra etj.) dhe natyrisht të humbjeve indirekte. Hulumtimet për këto humbje dhe pasojat afatgjate të tyre në Serbi dhe te serbët sigurisht do të bëhen më vonë.

Tabela 8. Numri i të lindurve gjallë dhe numri i të vdekurve në Kosovë dhe në Serbi në periudhën 1991-2051 (mesatarisht në vit)[21]

Periudha	Të lindurit gjallë		Të vdekurit	
	Kosova	Serbia	Kosova	Serbia
1991-1996	51.000	66.000	12.000	65.000
1996-2001	55.000	60.000	13.000	70.000
2001-2006	58.000	54.000	13.000	68.000
2006-2011	59.000	50.000	14.000	73.000
2011-2116	57.000	47.000	15.000	76.000
2116-2021	54.000	44.000	17.000	75.000
2021-2026	52.000	40.000	18.000	73.000
2026-2031	50.000	37.000	20.000	72.000
2031-2036	48.000	36.000	22.000	73.000
2036-2041	46.000	34.000	25.000	71.000
2041-2046	44.000	33.000	28.000	68.000
2046-2051	42.000	32.000	31.000	64.000

[20] Në regjistrimin e fundit të popullsisë të vitit 2002 në Serbi është ndërruar koncepcioni i përfshirjes së personave. Sipas këtij regjistrimi (popullsia e pranishme ose gjendja faktike) janë përfshirë të gjithë refugjatët pa shtetësi, pra serbët e BeH dhe të Kroacisë, si dhe ndërkombëtarët që jetojnë në Serbi më gjatë se një vit, ndërsa nuk janë përfshirë personat që ndodhen jashtë më gjatë se një vit (popullsia e përhershme). Prandaj, në Luginën e Preshevës jashtë kontingjentit të popullsisë së përgjithshme kanë mbetur më së paku 30.000 shqiptarë.

[21] *Po aty,* f. 129.

Tabela 9. Projeksionet e shkallëve mesatare vjetore të natalitetit dhe të mortalitetit në Kosovë dhe në Serbi në periudhën 1991-2051, sipas variantit spontan të projeksionit (në promilë)[22]

Periudha	Nataliteti		Mortaliteti	
	Kosova	Serbia	Kosova	Serbia
1991-1996	24,9	11,3	5,6	11,1
1996-2001	24,3	10,3	5,7	12.0
2001-2006	23,2	9,5	5,2	11,8
2006-2011	21,7	8,9	5,2	13,0
2011-2116	19,6	8,5	5,2	13,7
2116-2021	17,4	8,1	5,3	13,9
2021-2026	15,7	7,7	5,5	14,0
2026-2031	14,4	7,3	5,8	14,2
2031-2036	13,2	7,3	6,2	14,9
2036-2041	12,4	7,3	6,7	15,2
2041-2046	11,6	7,3	7,3	15,1
2046-2051	10,7	7,4	7,9	14,9

Tabela 10. Gjendja dhe projeksioni i popullsisë së Kosovës 1948-2051, sipas nacionaliteteve numerikisht më të mëdha[23]

Viti	Gjithsej	Shqiptarë	%	Serbë dhe malazezë	%
1948	733.820	498.242	68,5	199.964	27,5
1961	963.988	646.605	67,1	264.604	27,4
1981	1.584.441	1.226.736	77,4	236.526	14,9
1991	1.965.196	1.596.072	81,6	214.555	11,0
2001	2.400.000	2.041.000	85,0	194.000	8,1
2011	2.900.000	2.540.000	86,6	170.000	5,9
2021	3.360.000	2.995.000	89,1	155.000	4,6
2031	3.800.000	3.425.000	90,1	145.000	3,8
2041	4.180.000	3.795.000	90,8	135.000	3,2
2051	4.500.000	4.105.000	91,2	130.000	2,9

[22] *Po aty,* f. 130.

[23] *Popis stanovništva i stanova 1971. Nacionalni sastav stanovništva po opštinama, Statistički bilten 726,* Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1972, ff. 7-11 dhe *Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 1981. Nacionalni sastav stanovništva po opštinama, Statistički bilten 1295,* Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, ff. 8-17. Ndërsa për projeksionin 1991-2051 shih: M. Kovačević, Savezni zavod za statistiku, Beograd; B. Krstić, *Kosovo izmedju istorijskog i etničkog prava,* Kuća Vid, Beograd, 1994, f. 193.
Vërejtje: Deri "gjithsej" e përbëjnë të tjerët.

Mirëpo, pasojat e shprishjes së ish-Jugosllavisë dhe gjithë asaj që pasoi pas saj, para së gjithash eksodi masiv i të rinjve shqiptarë, nuk mund të mos kenë efekte të drejtpërdrejta dhe indirekte në kontekst afatgjatë edhe për Kosovën dhe shqiptarët dhe atë si për zhvillimin e popullsisë së përgjithshme, ashtu edhe për elementet strukturale të saj. Por dështuan përpjekjet dhe angazhimet e kamotshme dhe gjithnjë në kontinuitet të regjimeve serbe për mposhtjen e dominimit numerik dhe reproduktiv të shqiptarëve dhe të vënies së baraspeshës etnike në Kosovë përmes kolonizimit të serbëve, dëbimit të shqiptarëve, kufizimit të lindjeve dhe rrjedhimisht dobësimit të fuqisë vitale-demografike të shqiptarëve me masa dhe qasje të ndryshme, deri te ato gjenocidale. Edhe historikisht marrë, forca vitale-demografike e shqiptarëve ishte faktor i ruajtjes së qenies së tyre kombëtare. Pos argumenteve të tjera të shumta historiko-gjeografike dhe politiko-konstitucionale, realiteti i sotëm demografik dhe perspektiva demografike e Kosovës dhe e shqiptarëve do të jenë padyshim një nga faktorët e fuqishëm të pavarësisë së Kosovës.

Tabela 11. Vlerësimi dhe projeksioni i popullsisë së Kosovës dhe i Serbisë 1991-2150, sipas tri varianteve të fertilitetit, pa migrime (në mijë)[24]

	Varianti i fertilitetit		
	I ulët	I mesëm	I lartë
Kosova			
1991	1.956	1.956	1.956
2000	2.343	2.363	2.413
2050	3.735	4.469	5.354
2100	3.168	5.147	8.301
2150	2.193	5.113	11.741
Norma e rritjes vjetore të popullsisë 1991-2150 në ‰	0,72	6,06	11,34
Serbia			
1991	5.809	5.809	5.809
2000	5.817	5.848	5.884
2050	4.212	5.039	6.201
2100	2.359	4.586	8.377
2150	1.434	4.494	12.105
Norma e rritjes vjetore të popullsisë 1991-2150 në ‰	-8,76	-1,061	4,63

[24] G. Penev, "Projekcije stanovništva SR Jugoslavije, 1991-2150. u kontekstu dugoročnih projekcija stanovništva sveta", *Stanovništvo*, 1-4/1992, 1-2/1993, Beograd, 1994, f. 79.

Suksesi apo dështimi i projeksioneve varet nga ndikimi i një vistri faktorësh. Prandaj kur të vështrohen rezultatet e projeksioneve dhe mundësia e realizimit të tyre nuk mund të mos shtrohen disa dilema. Në rastin tonë, kohëzgjatja e periudhës projektuese është relativisht e madhe dhe në kohën prej disa dhjetëvjetëshash, por edhe e shekujve, mund të ndodhin ndryshime të papritura si sa i përket proceseve socialo-ekonomike, që janë edhe një ndër determinantet kryesore të tendencave zhvillimore të popullsisë, ashtu edhe të ndikimit të rrethanave të tjera, siç janë migrimet masive, luftërat, epidemitë dhe fatkeqësitë e tjera. Mirëpo, në vështrimin komparativ midis Kosovës dhe Serbisë, të gjitha proceset që do të mund ta pengonin realizimin e këtyre projeksioneve demografike do t'i godasin njësoj këto dy vende, si p.sh. kur është fjala për migrimet e jashtme dhe ndikimin e tyre në numrin e përgjithshëm të popullsisë dhe të veçorive strukturale të saj (sipas moshës, gjinisë, arsimit, profesionit etj.) apo për situata të tjera të paparashikueshme. Nëse në Serbi vazhdojnë tendencat e sotme të pavolitshme demografike (rritja e numrit të të pamartuarve, e divorceve, e martesave kohabituese, e vajzave të martuara pas moshës 27-vjeçare dhe shtyrja e vetëdijshme e lindjes së fëmijëve, thellimi i procesit të moshënimit demografik, emigrimi i të rinjve në botën e jashtme për shkak të gjendjes së keqe ekonomike etj.), parashikimet e mëparshme të institucioneve statistike dhe shkencore serbe do të jenë rreth 50% larg realizimit. Në fund të vitit 2004 ekspertët serbë vlerësuan se në vitin 2100 Serbia do të kishte gjithsej 2.100.000 banorë, ndërsa Kosova madje 4,4 milionë banorë. Në Serbinë e zgjeruar, me Kosovën dhe Vojvodinën, sipas këtyre ekspertëve, në gjysmën e shekullit XXI, serbët do të shndërrohen në pakicë etnike!

Pjesa e nëntë

DISKURSI RRETH DISA PROBLEMEVE AKTUALE TË POPULLSISË SË KOSOVËS DHE NDARJES SË KOSOVËS

I. DISKURSI RRETH REGJISTRIMEVE TË POPULLSISË

1. Rrjedhat dhe problemet e regjistrimit të popullsisë

Pas hyrjes së forcave ndërkombëtare dhe ndjekjes së forcave serbe nga Kosova më 12 qershor 1999 flitej shumë për regjistrimin e popullsisë së Kosovës, që ishte nevojë e domosdoshme për njohjen e gjendjes dhe ndryshimeve demografike dhe socioekonomike të shoqërisë kosovare. Për këtë flisnin përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, të pranishme në Kosovë, si OSBE-ja, UNMIK-u, IOM-i, UNHCR-i etj., subjektet politike shqiptare e serbe, mjetet e informimit (gazetat, radio, televizioni). Në anën tjetër, diskursi rreth problemit të regjistrimit të popullsisë[1] ishte edhe i kuptueshëm, ngase fakti statistik dhe faktori demografik sikur ishin bërë edhe çelës të zgjidhjes së shumë çështjeve dhe raporteve politike, etnike etj. Mirëpo, në të gjitha këto nivele jo vetëm që nuk dallohej se çka është regjistrimi i popullsisë, çka është regjistrimi i zgjedhësve e çka evidencimi i personave me qëllim të identifikimit të tyre, por ishte krijuar një konfuzion dhe paqartësi e madhe. Ishin ngatërruar nocionet, koncepcionet, qasjet dhe destinimet. Flitej për regjistrimin e personave që kishin të drejtë vote, të drejtë që të zgjidhnin dhe të drejtë që të zgjidheshin, e që përfshinin personat që ishin mbi 18 vjet (në Kosovë kjo është përafërsisht gjysma e popullsisë), dhe ky evidencim quhej regjistrim i popullsisë, ndonëse kjo është një procedurë dhe destinim krejtësisht tjetër. Në anën tjetër, evidencimi i personave me qëllim që të siguronin dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e tjera të rëndësishme civile (letërnjoftimi, pasaporta, librat amë të të lindurve, të të kurorëzuarve e të të vdekurve, librat e nënshtetësisë, numrat personalë, regjistrat kadastralë, lejet e vozitjes etj.) gjithashtu identifikoheshin me regjistrimin e popullsisë, edhe pse si për nga procedura dhe përmbajtja, ashtu dhe për nga qëllimi nuk kishin lidhje me të.

---

[1] Diskursi paraqet angazhimin e autorit për një regjistrim gjithëpërfshirës të popullsisë, meqenëse regjistrimi i fundit ishte bërë në vitin 1981 dhe lufta kishte ndikuar në ndryshimin rrënjësor të situatës së përgjithshme shoqërore dhe demografike në territorin e Kosovës, si dhe reagimin e tij, qoftë publikisht qoftë drejtpërdrejt te autoritetet pushtetore, vendore dhe ndërkombëtare, lidhur me disa manipulime rreth numrit të përgjithshëm të serbëve e të shqiptarëve në Kosovë, numrit të serbëve të shpërngulur nga Kosova dhe numrit të serbëve që dëshirojnë të kthehen në Kosovë, pastaj rreth dobësive të regjistrimit civil dhe votues, sjelljes së udhëheqjes kosovare lidhur me këto çështje etj. Meqenëse për të njëjtin problem është reaguar disa herë këto vitet e fundit, aty-këtu ka edhe përputhje të të dhënave të caktuara.

Prandaj, në shqyrtimin vijues e shohim të arsyeshme t'i japim disa shpjegime për opinionin gjerë se çka është regjistrimi i popullsisë, metodologjia, koncepcioni, aktivitetet operative, destinimi i tij etj. Meqenëse popullsia është kategori masive dhe shumëdimensionale shoqërore, me ligjet e veta specifike të zhvillimit e të manifestimit, për njohjen e gjendjes së saj numerike, për lëvizjen natyrore dhe mekanike (migrimet), për strukturat dhe zhvillimin e përgjithshëm demografik të çdo territori apo bashkësie etnike, si çështje kyçe shtrohet burimi i të dhënave dhe baza informative. Të dhëna mbi popullsinë ofrojnë regjistrimet e popullsisë, statistika vitalo-demografike (lindjet, vdekjet, kurorëzimet), statistika vijuese mbi pjesë të ndryshme të popullsisë (shënimet për të punësuarit, për të shkolluarit, për migrantët, për gjendjen shëndetësore të popullit etj.); pastaj shumë të dhëna, fakte e njohuri mundësojnë anketat, arkivat, analizat dhe studimet e disiplinave përkatëse, të cilat, në mënyra të ndryshme e lidhin interesin e tyre me popullsinë etj. Mirëpo, ndër burimet kryesore dhe më të rëndësishme mbi të gjitha komponentët dhe variablat e popullsisë janë regjistrimet e popullsisë, si një ndër realizimet më markante të epokës bashkëkohore dhe një ndër projektet më të shtrenjta të mbledhjes së të dhënave mbi situatën demografike dhe zhvillimin e gjithmbarshëm shoqëroro-ekonomik të një vendi. Teoria statistike dhe metodologjia e përgjithshme në sektorin e regjistrimeve të popullsisë shënuan një përparim të madh në shekullin XX, veçanërisht në pjesën e dytë të tij, sepse u krijua një eksperiencë relativisht e gjatë, u avancua metodologjia e regjistrimit dhe u modernizua teknologjia e përpunimit të materialit të mbledhur.

Regjistrimet e popullsisë paraqesin një aksion të madh statistikor, profesional e teknik me rëndësi të veçantë për jetën shoqërore dhe politike të një vendi, mirëpo nuk mund të jenë aksione autonome dhe të izoluara nga rrethanat politike e shoqërore, nga klima psikologjike e mjedisit ku realizohen dhe atmosfera e besimit ndërnacional në ambientet multietnike dhe e besimit ndaj institucioneve të shtetit. Regjistrimet e popullsisë realizohen periodikisht, zakonisht në çdo 10 vjet, madje në vitin që përfundon me njësh, e që është në përputhje me porositë e OKB-së. Në rrethana normale, koha për regjistrim është 15 ditë, por mund të shtyhet edhe 15 ditë të tjera.

1.1. Koncepcionet dhe njësitë e përfshirjes në regjistrim

Nga historia e regjistrimeve të popullsisë mësojmë se ato janë realizuar sipas dy koncepcioneve: *popullsisë së pranishme (population présente) dhe popullsisë së përhershme ose popullsisë rezidenciale (population résidente).* Në periudhën pas Luftës II Botërore, në pjesën dërmuese të vendeve në botë,

duke përfshirë këtu edhe ish-Jugosllavinë (regjistrimet 1948-1991), regjistrimet e popullsisë janë bërë në bazë të koncepcionit popullsi e përhershme, që ka shumë përparësi mbi koncepcionin e parë. Meqenëse të dhënat duhet të mblidhen sipas datës dhe orës së caktuar, e kjo gjendje njihet si moment kritik (p.sh. 31 marsi, ora 24), koncepcioni i popullsisë së pranishme paraqet dobësi serioze, sepse sipas tij regjistrohen vetëm ata persona të cilët në momentin kritik të regjistrimit gjenden në vendin apo vendbanimin e caktuar, ndonëse aty mund të ndodhen vetëm përkohësisht apo rastësisht. Por dobësia më e madhe e këtij koncepcioni qëndron në faktin se në regjistrim nuk përfshihen të gjithë ata persona të cilët përkohësisht, për arsye të ndryshme, mungojnë. Për zbatimin e këtij koncepcioni në regjistrimin e vitit 2002 edhe përgatitej Serbia, ngase në këtë mënyrë do t'i dëmtonte më së shumti numerikisht shqiptarët, meqenëse një numër i madh i tyre i kishin braktisur vendet e përhershme të banimit si pasojë e dhunës dhe terrorit policor e ushtarak, duke u ngulitur në vende të ndryshme të Evropës dhe botës. Regjistrimi i popullsisë sipas koncepcionit të popullsisë së përhershme ose rezidenciale nënkupton regjistrimin dhe deklarimin e çdo personi si banor të përhershëm të atij vendi të banimit në të cilin ai jeton përherë, pa marrë parasysh se në momentin kritik të regjistrimit mund të mos gjendet në vendin e përhershëm të banimit për shkak të punësimit, shkollimit, shërbimit ushtarak, udhëtimit, shërimit, vuajtjes së dënimit, persekutimeve politike, dhunës etnike, racore etj. Sipas këtij koncepcioni, të gjithë punëtorët e ish-Jugosllavisë që gjendeshin në punë në botën e jashtme dhe kategoritë e tjera të popullsisë që kishin status të ndryshëm qëndrimi në vendet e huaja, në regjistrimet e popullsisë 1971, 1981 dhe 1991 janë regjistruar si popullsi e përhershme në vendet me qëndrim të përhershëm të banimit.[2]

Me regjistrimet e popullsisë, që janë të plota, gjithëpërfshirëse e cilësore dhe të mbështetura në metodologjinë bashkëkohore, sigurohen të dhënat që tregojnë një pasqyrë reale në karakteristikat biologjike, ekonomike, arsimore, etnike, migruese etj. të popullsisë së një vendi, pastaj mundësojnë të dhëna të bollshme për ekonomitë shtëpiake (madhësia mesatare, përbërja sipas numrit të anëtarëve, pasuria), për banesat (sipërfaqja, shfrytëzimi, pronësia, pajimet, instalimet) dhe të dhëna për ekonomitë bujqësore (kategoria e shfrytëzimit të tokës dhe fondet bujqësore). Mbledhja e këtyre dhe e të dhënave të tjera të

[2] Edhe në regjistrimin e vitit 1991, sikundër edhe në regjistrimet e viteve 1948-1981, p. sh. "janë përfshirë shtetasit e RSFJ-së, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, që kanë vend të përhershëm të banimit në RSFJ, pa marrë parasysh se në momentin e regjistrimit gjenden në RSFJ apo në botën e jashtme" (*Metodologija za pripremu, organizovanje i pripremu popisa 1991,* Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1990, f. 16, pika 2 (a).

popullsisë është me interes të posaçëm për shkencën, për zhvillimin shoqëror, planifikimin dhe opinionin e gjerë. Në anën tjetër është detyrë qytetare dhe civilizuese e çdo personi dhe bashkësie kombëtare që të përfshihet në regjistrimet e popullsisë, duke ofruar të dhëna të plota e cilësore.

1.2. Programi i aktiviteteve për realizimin e regjistrimit

Programi i aktiviteteve rreth regjistrimeve të popullsisë është shumë i gjerë; ai ka karakter operativ dhe realizohet në disa faza. Përgatitjet për regjistrimin e ri nisin disa vjet para fillimit të realizimit tdrejtpërdrejtë të tij. Së pari analizohen dhe studiohen eksperiencat, të metat dhe përparësitë e regjistrimeve të mëparshme, përcaktohet koncepcioni, përmbajtja dhe metodologjia e regjistrimit, bëhet aftësimi profesional i kuadrove për të gjitha nivelet (instruktorët, regjistruesit, kontrollorët), organet komunale dhe instancat e tjera të pushtetit përgatisin me kohë skicat dhe tërheqin kufijtë e qarqeve të regjistrimit, shënojnë vendbanimet, rrugët, sheshet, në objekte dhe shtëpi shënojnë numrat, përgatisin fletëregjistrimet ndihmëse për të punësuarit etj., ndërsa mjetet e informimit njoftojnë popullatën për rëndësinë e regjistrimit, mënyrën dhe kohën e realizimit të tij, për të drejtat dhe detyrat që kanë qytetarët në këtë aksion të madh civilizues.

Çdo regjistrimi të popullsisë i paraprin *regjistrimi provues,* i cili zakonisht bëhet 2-3 vjet para regjistrimit të rregullt. Qëllimi i këtij regjistrimi është ta hulumtojë rrjedhën e mbledhjes së të dhënave dhe të jep përgjigje në disa pyetje që janë të lidhura me përmbajtjen, metodologjinë dhe format organizative të regjistrimit në mënyrë që të evitohen dobësitë e mëparshme eventuale dhe të zvogëlohen shpenzimet financiare. Menjëherë pas përfundimit të çdo regjistrimi bëhet edhe *kontrolli statistikor* i cilësisë së të dhënave të mbledhura, përmes të cilit dalin në shesh defektet e metodave të punës. Kontrolli statistikor është kusht i përsosjes së qasjeve të punës në regjistrime dhe i aksionit statistikor në përgjithësi.

Realizimi i regjistrimeve të popullsisë, me gjithë rëndësinë e madhe që ka për ekonominë, shkencën dhe gjithë shoqërinë, kurrë nuk është kusht për mbajtjen e zgjedhjeve në një vend, e as që mund të përdoren rezultatet e regjistrimeve të popullsisë për përpilimin e regjistrave të votuesve, sepse të gjitha të dhënat nga regjistrimet e popullsisë janë sekret zyrtar dhe përdoren vetëm për qëllime statistike.

1.3. Bojkoti i regjistrimit të popullsisë të vitit 1991 nga shqiptarët

Regjistrimi i vitit 1981, meqë përputhej me demonstratat masive të shqiptarëve të Kosovës për barazi me ish-njësitë e tjera të ish-Federatës së Jugosllavisë, menjëherë pasi filloi, u ndërpre për gati një muaj për shkak të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nga organet e Federatës së atëhershme. Ndonëse gjendja e jashtëzakonshme vazhdonte, megjithatë, në saje të angazhimit të madh të të gjitha kuadrove profesioniste të Entit Statistikor të Kosovës, bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe vetë strukturave politike të Kosovës, regjistrimi përfundoi me sukses. Meqenëse ky regjistrim dukej më objektiv se regjistrimet e mëparshme, nga udhëheqësit serbë të Kosovës dhe nga disa qarqe në Serbi pati përpjekje që të bëhej anulimi i tij.

Ndërkaq, në regjistrimin e vitit 1991 shqiptarët nuk morën pjesë për arsye se nuk ekzistonin as kushtet minimale për një regjistrim objektiv dhe cilësor. Enti Statistikor i Kosovës dhe punëtorët shqiptarë të tij (128 sa ishin), deri në përjashtimin e tyre nga puna në gjysmën e muajit korrik 1990 ishin të angazhuar intensivisht në programin e punëve dhe të detyrave për përgatitjen e regjistrimit të popullsisë, të ekonomive shtëpiake, të banesave dhe të ekonomive bujqësore të 31 marsit 1991. Mirëpo, çdo aktivitet i tyre rreth regjistrimit dhe punëve të përhershme në Ent u ndërpre me futjen e masave të dhunshme dhe përjashtimin e të gjithë punëtorëve shqiptarë nga puna. Kjo ndërmarrje e pushtetit serb kishte për qëllim uzurpimin dhe shkatërrimin e tërë sistemit statistikor të Kosovës nga ana e organeve më përgjegjëse të shtetit të atëhershëm, para së gjithash të Kryesisë së ish-Jugosllavisë dhe të ish-Këshillit Ekzekutiv Federativ. Ky hap përveç rrethanave të tjera që nuk mundësonin regjistrim normal, ishte edhe sinjal i parë serioz për bojkotimin e regjistrimit nga ana e shqiptarëve.

Duke e parë rrezikun real të dështimit të regjistrimit dhe të vetëdijshëm për rëndësinë e regjistrimit për shoqërinë kosovare, përfaqësuesit legjitimë shqiptarë të Entit Statistikor, Shoqata e Statistikanëve të Kosovës dhe partitë e atëhershme politike të Kosovës me kohë bënë me dije organet kompetente të ish-Jugosllavisë se regjistrim të popullsisë nuk mund të ketë pa u krijuar rrethanat e nevojshme politike, shoqërore, kadrovike, organizativo-teknike, financiare, psikologjike e të tjera sikurse edhe në pjesët e tjera të ish-shtetit. Kushtet minimale për organizimin dhe kryerjen me sukses të regjistrimit, që i kërkuan partitë politike në një letër të datës 14 mars 1991 drejtuar organeve më të larta të ish-Jugosllavisë u përmblodhën në 13 pika: a) suprimimi i gjendjes së jashtëzakonshme dhe kthimi i gjendjes kushtetuese në Kosovë; b) largimi i forcave policore dhe krijimi i klimës së volitshme politike dhe psikologjike; c) kthimi i të gjithë punëtorëve shqiptarë në punë në Entin

Statistikor të Kosovës; ç) formimi i Këshillit të Regjistrimit, i përbërë nga ekspertët e statistikës nga Enti dhe jashtë tij, pastaj nga demografët, juristët, ekonomistët etj., i cili do të udhëhiqte punët operative rreth regjistrimit; d) formimi i Komisionit mikst dhe neutral për mbikëqyrjen e regjistrimit; dh) formimi i Byrosë për Regjistrim, e cila ishte e formuar më parë, por nuk funksiononte; e) caktimi i komisioneve komunale të regjistrimit në përputhje me përbërjen kombëtare të popullsisë së komunave; ë) përgatitja e regjistruesve dhe e kontrollorëve në afatin e duhur dhe konform strukturës nacionale të popullsisë; f) përgatitja e pyetësorëve (fletëregjistrimet për persona) në dy kopje për t'iu shmangur manipulimeve të mundshme për shkak se ekzistonte atmosferë e mosbesimit ndërnacional dhe shumë më tepër e mosbesimit ndaj institucioneve të shtetit të atëhershëm; g) regjistrimi i popullsisë shqiptare të bëhet nga regjistruesit shqiptarë; gj) shifrimi i të dhënave për popullsinë shqiptare të bëhet nga punëtorët shqiptarë dhe nën mbikëqyrjen të Komisionit të përmendur; h) përpunimi dhe publikimi i shënimeve paraprake të bëhet në Entin Statistikor të Kosovës, sikundër u veprua edhe në regjistrimet e mëparshme; i) dalja e "Rilindjes" si gazetë e vetme e përditshme në gjuhën shqipe dhe funksionimi i Radiotelevizionit të Prishtinës dhe i radiove rajonale si mjete të domosdoshme të informimit për propagimin e regjistrimit të popullsisë.[3]

Meqenëse popullata shqiptare e Kosovës, për arsye të zëna në gojë, e bojkotoi regjistrimin, institucionet statistikore dhe shkencore të Beogradit bënë vlerësimin e numrit të shqiptarëve për vitin 1991. U bënë dy vlerësime, i pari, si preliminar, sipas të cilit numri i shqiptarëve ishte 1.607.690 ose 82,2%, dhe i dyti, si përfundimtar, ku numri i shqiptarëve u vlerësua në 1.596.072 ose 81,6%, pra më i vogël për 11.618 veta ose për 0,6%, ndërsa numri i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës u vlerësua në 1.956.196 banorë. Numri i serbëve në Kosovë, sipas rezultateve përfundimtare, ishte 194.190 ose 9,9%, ndërkaq numri tjetër prej 166.454 vetave (boshnjakë, romë, malazezë, kroatë etj.) përkiste bashkësive të tjera kombëtare.

Kushte elementare për realizimin e regjistrimit të popullsisë kërkuan edhe partitë politike shqiptare në Maqedoni dhe në tri komunat në lindje të Kosovës (Presheva, Bujanoci dhe Medvegja). Mirëpo, organet shtetërore dhe institucionet statistikore të të gjitha niveleve të ish-Jugosllavisë u bënë të shurdhër deri në prak të regjistrimit dhe kurrë nuk i përmbushën parakushtet e domosdoshme. Vetëm shqiptarët e Malit të Zi morën pjesë në regjistrimin e vitit 1991, ndonëse edhe atje rrethanat e përgjithshme nuk ishin plotësisht

[3] Shih më gjerë: H. Islami, "Shqiptarët dhe regjistrimet e popullsisë" në librin *Rrjedha demografike shqiptare,* Dukagjini, Pejë, 1994, ff. 105-125.

normale. Për shkak se fakti demografik konsiderohej faktor i rëndësishëm për përcaktimin e pozitës politike të shqiptarëve në Maqedoni, Konferenca Ndërkombëtare e Gjenevës për ish-Jugosllavinë ndërmori iniciativën për organizimin dhe financimin e regjistrimit të popullsisë në Maqedoni, të cilën e përkrahu edhe Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës. Regjistrimi u mbajt në gjysmën e vitit 1994, por në parime fundamentale, në koncepcionin e regjistrimit pati shmangie të mëdha, që hapën mundësi reale për rezultate joobjektive dhe arbitrare.[4]

Meqenëse kishin eksperienca të hidhura nga regjistrimet e mëparshme, shqiptarët nuk u pajtuan që të tjerët t'i numëronin dhe t'i regjistronin sipas kuteve të tyre. Edhe me marrëveshjen e Rambujesë parashihej të bëhej regjistrimi i popullsisë në Kosovë nën mbikëqyrjen e OSBE-së, me pjesëmarrjen e zyrtarëve të Kosovës dhe të ekspertëve nga të gjitha bashkësitë nacionale, por nën udhëheqjen e zyrtarëve të Beogradit. Derisa mbahej Konferenca Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje (6-23 shkurt) dhe në Paris (14-19 mars), ishim dëshmitarë të përpjekjeve të mëdha manipulative: pushteti qendror i Serbisë (por edhe delegacioni serb në Konferencë) për qëllime politike kishte nisur një fushatë fantastike, duke rritur numrin e popullatës së nacionaliteteve joshqiptare deri në absurd, ku disa grupe etnike gjithnjë numerikisht kanë qenë margjinale, ndërsa duke e zvogëluar përqindjen e shqiptarëve në numrin e gjithmbarshëm të popullsisë së Kosovës në 50 e 40%. Por absurdi më i madh ishte shpifja e disa grupeve etnike, të cilat kurrë, as në pikëpamje etnike, as linguistike e as statistike nuk kanë ekzistuar, çfarë ishte rasti p. sh. me "goranët", “ashkalinjtë” dhe "egjiptianët". Në përpjekjet për të krijuar një realitet të ri etnodemografik të Kosovës, pra Kosovën pa shqiptarë, pas ndërhyrjes ushtarake të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, prej fundit të muajit mars 1999, regjimi serb me të gjitha mjetet u vërsul mbi identitetin dhe themelet e jetës së shqiptarëve, i cili përmes deportimeve masive dhe zhdukjes së dokumentacionit deshi ta këputste çdo lidhje juridike të shqiptarëve me truallin gjeoetnik të tyre, ta rrënonte një etni, një shoqëri dhe një kulturë.

Në fund të këtyre shqyrtimeve mund të konkludojmë se regjistrimin gjithëpërfshirës, objektiv dhe cilësor të popullsisë, sipas metodologjisë bashkëkohore, kritereve dhe standardeve unike ndërkombëtare dhe në përputhje me porositë e OKB-së, si pas luftës, ashtu edhe sot mund ta bëjë vetëm Enti Statistikor i Kosovës, natyrisht me ndihmën e gjithanshme të organizatave ndërkombëtare dhe UNMIK-ut. Ky ent është plotësisht i

[4] Vlerësohet se si pasojë e zbatimit të një koncepcioni konfuz dhe mungesës së dokumenteve të identifikimit e të shtetësisë rreth 30% e shqiptarëve mbetën pa u përfshirë në këtë regjistrim (H. Islami, *Po aty,* ff. 127-136).

përgatitur profesionalisht dhe organizativisht për një regjistrim të tillë. Punëtorët statistikorë dhe ekspertët kosovarë të fushave përkatëse tashmë kanë marrë pjesë në organizimin dhe kryerjen me sukses të disa regjistrimeve të popullsisë, madje në kushte shumë të vështira. Entit Statistikor të Kosovës i nevojiten mjetet financiare e teknike, mbështetja ligjore dhe koha e domosdoshme për të gjitha fazat operative dhe hallkat e regjistrimit. Por vlen të nënvizohet edhe njëherë se regjistrimi modern i popullsisë nuk ka asnjë lidhje me nxjerrjen e dokumenteve të identifikimit dhe me përpilimin e listave të votuesve për zgjedhjet e çfarëdo niveli në Kosovë. Ekzistojnë rrugë të tjera, të natyrës krejtësisht administrative për nxjerrjen e këtyre dokumenteve dhe regjistrimin e votuesve.

2. Regjistrimi civil dhe votues: dilemat dhe problemet

Në gjithë vitet e 90-ta dhe veçanërisht në kohën e deportimit të më se një milion shqiptarëve të Kosovës gjatë periudhës së bombardimeve të forcave të NATO-s mbi forcat serbe (mars – qershor 1999), regjimi represiv dhe gjenocidal serb, pos krimeve të papara në kontinentin e vjetër pas Luftës II Botërore, u kishte asgjësuar shqiptarëve masivisht dokumentacionin (letërnjoftimet, pasaportat, regjistrat kadastralë, librat e shtetësisë, librat amë të të lindurve, librat e të kurorëzuarve, lejet e vozitjes etj.). Me këtë, ky regjim deshi t'i arrijë disa qëllime. *Së pari,* ta rrënonte identitetin, themelet e jetës së shqiptarëve dhe këputjen juridike për truallin gjeoetnik të tyre; *së dyti,* ta shkatërronte një etni dhe një shoqëri të tërë; dhe *së treti,* ta reduktonte kthyerjen vetëm të atyre shqiptarëve që rastësisht posedonin dokumente të identifikimit, pasi që bashkësia ndërkombëtare dhe NATO-ja me SHBA-në krye ishin zotuar se do ta bënin kthyerjen e të gjithë shqiptarëve në Kosovë. Atë që kishte planifikuar ta bënte Serbia në rastin e shqiptarëve të Kosovës, por nuk arriti, këtë e bënte pushteti maqedon ndaj shqiptarëve (2001), sepse ku pushtet nuk i lejonte të ktheheshin shqiptarët refugjatë nga Kosova e gjetiu në vendet e tyre në Maqedoni pa dokumente të identifikimit.

Kthyerja e shqiptarëve ndodhi në rrethana të jashtëzakonshme, në mungesë të më se 120.000 kulmeve mbi kokë, të bukës, të ujit, me terrene të minuara nga forcat serbe etj. Por lidhja emocionale e shqiptarëve për truallin gjeoetnik të tyre ishte më e fuqishme se mungesa e kushteve për jetë dhe rreziqet që mund të pasonin nga minat dhe uji i ndotur. Kthyerja u bë pa u kërkuar dokumentet e identifikimit, meqenëse kontrollin në pikat kufitare e

kishin marrë forcat e NATO-s, ndërkaq policia dhe ushtria serbe tashmë ishin dëbuar.

Pas kthyerjes, pos kërkesave elementare jetësore qytetarët kishin nevojë edhe për dokumentacion përkatës, të cilin nuk e posedonin për arsye të theksuara më lart. Në fillim të vitit 2000 OSBE-ja ndërmori operacionin e madh të regjistrimit të njerëzve në mënyrë që t'u mundësohej sigurimi i dokumentacionit, lëvizja e lirë dhe natyrisht lehtësimi i jetës. Mirëpo, ky nuk ishte regjistrim i popullsisë, por regjistrim civil dhe votues, që dallon qenësisht nga regjistrimi i popullsisë.

2.1. Dallimet midis regjistrimeve

Në bazë të evolucionit të strukturës së popullsisë sipas moshës deri në vitin 1991 ishte interesant të parashihej numri i votuesve për zgjedhjet e paralajmëruara në Kosovë për vjeshtën e vitit 2000. Regjistrimi që sapo kishte filluar ato ditë në organizimin e OSBE-së, nuk ishte regjistrim i popullsisë, por ishte regjistrim që kishte për qëllim përpilimin e regjistrave për nxjerrjen e dokumenteve të identifikimit dhe regjistrimin e personave që kishin të drejtë të merrnin pjesë në zgjedhje.[5] Nuk ka dyshim se regjistrimi civil dhe votues kishte rëndësi të madhe për Kosovën dhe gjithë qytetarët e saj.

Kur flitet për regjistrimin e popullsisë, regjistrimin civil dhe regjistrimin votues, nënkuptohen tri probleme, sepse bëhet fjalë për tri përmbajtje, tri procedura dhe tri destinime. Regjistrimi i popullsisë, siç vumë në pah edhe më parë, realizohet zakonisht çdo 10 vjet dhe në vitin që përfundon me njësh (në përputhje me porositë e OKB-së); përfshin të gjithë personat (regjistruesi hyn në çdo familje) me veçoritë biologjike, ekonomike, arsimore, etnike, fetare, migruese etj.; mblidhen të dhënat për ekonomitë shtëpiake (madhësia dhe pasuria e tyre), për banesat (sipërfaqja, shfrytëzimi, pronësia, pajimet, instalimet) dhe për ekonomitë bujqësore (kategoria e shfrytëzimit të tokës, fondet bujqësore); regjistrimi i popullsisë ka koncepcionin e vet (popullsi e përhershme apo rezidenciale dhe popullsi e pranishme apo faktike); regjistrimi i popullsisë ka datën dhe orën e caktuar ("momenti kritik") dhe zgjatë 15 ditë dhe mund të shtyhet vetëm edhe po për aq ditë; regjistrimin e popullsisë e organizon dhe e financon shteti, për çka nxjerr ligj të veçantë, ndërkaq e realizon institucioni statistikor; çdo regjistrimi të popullsisë i paraprinë regjistrimi provues; me gjithë rëndësinë e madhe që ka për shoqërinë, ekonominë dhe shkencën, regjistrimi i popullsisë kurrë nuk është kusht për mbajtjen e zgjedhjeve; të dhënat që sigurohen përmes regjistrimit të popullsisë

[5] Reagimi ynë është bërë më 27 prill 2000.

janë sekret zyrtar dhe mund të përdoren vetëm për qëllime statistike; të dhënat e regjistrimit të popullsisë nuk mund të përdoren për përpilimin e regjistrave të votuesve e as për nxjerrjen e dokumenteve të identifikimit, etj.

Regjistrimi civil ka të bëjë me moshën mbi 16 vjet, që përfshinë rreth 40% të popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës dhe ka për qëllim sigurimin e dokumenteve të identifikimit të zëna në gojë më lart. Ndërsa regjistrimi i votuesve, i cili ka të bëjë me moshën mbi 18 vjet dhe që përfshin rreth gjysmën e popullatës së Kosovës, shërben për përpilimin e listave të personave që kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen. Këto dy regjistrimet e fundit i përkasin procedurës administrative, prandaj një administratë efikase dhe funksionale komunale mund t'i kryejë shumë shpejtë dhe disa herë me më pak shpenzime se që do të kushtonte regjistrimi i filluar dhe i organizuar nga OSBE-ja.

Pas konfuzioneve të shumta në opinionin kosovar, përgjegjësi i misionit të OSBE-së, arriti me shumë vonesë t'i japë disa shpjegime dhe qartësime lidhur me kriteret, procedetë, planin operativ dhe motivet e regjistrimit civil dhe regjistrimit të votuesve. Për konfuzionet dhe paqartësitë e krijuara, shefi i misionit të OSBE-së fajësoi burokracinë e OKB-së (vonesa e nxjerrjes së rregullores) dhe informimin joadekuat. Mbetën, megjithatë, disa dilema lidhur me të drejtën në votime (regjistri votues) dhe në dokumentet e identifikimit (regjistri civil) të bashkëkombësve tonë në botën e jashtme, numri i të cilëve ishte dhe mbetet mbi 400.000 veta, ku një përqindje e madhe e tyre i përket moshës mbi 16-vjeçare. Nga kriteret që u zbatuan shihej qartë lidhja midis këtyre dy regjistrimeve, sepse në të njëjtin formular përfshiheshin të dhënat për dy regjistrat.

Për të votuar personi duhej të posedonte dokumentin e identifikimit, i cili mund të merrej vetëm në Kosovë. Kushti kryesor për t'u përfshirë personi në regjistrin civil ishte që të jetonte në Kosovë. Në anën tjetër, në regjistrin civil nuk do të përfshiheshin personat që janë tashmë të evidencuar në vendet e huaja. Edhe më të hapura mbetën dilemat për kategoritë "azilkërkues" dhe "refugjatë", që numerikisht nuk ishin të paktë. Një numër i tyre do të regjistrohet vetëm në regjistrin e votuesve, por ata nuk do të mund të votonin as atëherë e as sot e gjithë ditën pa dokument identifikimi të UNMIK-ut, i cili mund të jepet vetëm në Kosovë. Pasojnë dilemat. Por dilema më e madhe mbeti zbatimi i kriterit "përfshirja në regjistrim e të gjithë personave që kanë jetuar në Kosovë mbi 5 vjet". Mundësia e manipulimeve të regjimit të Beogradit këtu ishte tepër e madhe, sepse me bollëk mund të marrin dokumente për të dëshmuar se kanë jetuar jo 5 vjet, por edhe 10 e më tepër vjet pandërprerë në Kosovë. Në vitet e 90-ta, siç dihet, janë realizuar disa valë të kolonizimit të Kosovës me serbë nga Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina,

madje përkundër dëshirës së tyre, por regjimi serb dhe organizatat humanitare ndërkombëtare i konsideronin si refugjatë të luftës. Nuk kishte, sikundër që nuk ka as sot asnjë problem që t'u jepen dokumente serbëve që kurrë nuk kanë jetuar në Kosovë si popullatë e përhershme ose janë shpërngulur nga Kosova para dhjetëra vjetëve. Në anën tjetër, në kuadër të aparatit represiv dhe gjenocidal kanë qëndruar në Kosovë dhjetëra mijëra policë, ushtarë e oficerë, paramilitarë, nëpunës, gjykatës etj., të stimuluar në baza të ndryshme, të cilët mund të marrin dokumente identifikimi dhe çfarëdo dokumenti tjetër me bollëk në Serbi.

Në Referendumin për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, të mbajtur prej 26-30 shtator 1991, numri i qytetarëve me të drejtë vote në Kosovë ishte 1.051.357, gjë që i përgjigjej vlerësimit të kontingjentit mbi 18 vjet në vitin 1991; në Referendum dolën 914.802 veta (87,01%), që përputhej me pjesëmarrjen e popullsisë shumicë, ndonëse në të dolën edhe pjesëtarë të nacionaliteteve të tjera (turqit, myslimanët). Për hartimin e regjistrit të votuesve për zgjedhjet lokale të vjeshtës së vitit 2000 në Kosovë, kriteri bazë që qe zbatuar ishte "lidhja e personit me vendbanimin", që nënkuptonte se në këto zgjedhje mund të votonin vetëm personat që gjendeshin në Kosovë e jo edhe ata që punonin dhe në cilësi (status) të ndryshme qëndronin në botën e jashtme. Zbatimi i këtij kriteri sikur la të kuptohej se këta persona mund të votonin vetëm nëse gjatë rrjedhës së regjistrimit përfshiheshin në regjistra të votuesve me dëshmitë përkatëse që ofronin dhe në momentin e votimit gjendeshin në Kosovë, në vendbanimet e tyre. Shqiptarët e shpërngulur nën dhunën serbe gjatë viteve të 80-ta dhe sidomos pas vitit 1989 nuk e kishin lehtë të ofronin të gjitha dëshmitë e kërkuara sipas këtij kriteri. Më konkretisht, për të votuar ata duhej të ktheheshin në Kosovë. Por, me shqyrtimin e këtij kriteri dhe të kushteve të tjera, me dobësitë apo përparësitë e tyre, ishte tepër vonë të preokupoheshim, pasi që përgjegjësi i OSBE-së që merrej me shpjegimin e gjithë operacionit, theksonte se pyetësorin, që e quanin formular aplikimi, tashmë e kishin shtypur dhe ekspertët ndërkombëtarë për organizimin dhe realizimin e regjistrimit kishin arritur në fillim të muajit prill 2000, që do të thotë se ishin gati për këtë punë! Kosovarët gjendeshin para aktit të kryer. Mund të flitej vetëm për efektet negative që mund të shkaktonte zbatimi i këtyre kritereve.

Sa mund të ishte numri i këtyre personave në Kosovë, të cilët, sipas këtij kriteri, kishin të drejtë vote? Në bazë të vëllimit të shtimit natyror të popullsisë së Kosovës prej vitit 1990 deri më fund të vitit 1999, duke marrë parasysh pjesëmarrjen e shqiptarëve në të (rreth 89,0%), shtimi natyror i shqiptarëve në periudhën pas regjistrimit të vitit 1991 deri në vitin 2000 ishte rreth 300.000 veta. Kur këtij numri i shtohej mospërfshirja e të gjitha ngjarjeve vitale, e që

mund të vlerësohej në rreth 50.000 veta, atëherë dilte se shtimi natyror i shqiptarëve në periudhën e përmendur ishte rreth 350.000 veta. Në anën tjetër, rreth gjysma e këtij numri në këtë periudhë e kishte fituar me moshë të drejtën e votimit. Ndërkaq, numri i gjithmbarshëm i shqiptarëve, në mbështetje të koncepcionit të popullsisë së përhershme apo rezidenciale (population résidente), në fund të vitit 1999 sillej rreth 2 milionë.

I kuptuar në këtë mënyrë, zbatimi i kriterit "lidhja e personit me vendbanimin" do të thoshte se më se 250.000 shqiptarë mund të privoheshin nga e drejta e votës, u mor vesh, nëse në ndërkohë nuk do të ktheheshin me vullnet apo me dhunë të gjithë ata persona që, sipas ligjeve të vendeve imigruese, e kishin humbur të drejtën e qëndrimit. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve të shpërngulur nën dhunën serbe nga pjesa e Gollakut që shtrihet në Serbi (komuna e Medvegjës) dhe nga fshatrat e rripit të Karadakut (komuna e Preshevës dhe e Bujanocit), të vendosur në Kosovë, proces ky që ishte në vazhdë e sipër, sipas kriterit të përmendur, nuk kishte të drejtë as në dokumente të identifikimit e as të merrte pjesë në zgjedhje, ndonëse atdheu i këtyre fatzive dukej se ishte përgjithmonë Kosova. Së këndejmi, nga numri i përgjithshëm i banorëve shqiptarë mbi 18 vjet në Kosovë, që sillej rreth 1.000.000, numri i personave që do të mund të përfshiheshin në listat e votuesve në Kosovë do të ishte midis 750.000 dhe 800.000.

2.2. Gabimet në të dhëna dhe jokonsekuenca në zbatimin e kritereve

Qëllimi kryesor i OSBE-se, ndërkaq, dukej qartë se nuk ishte pajisja e qytetarëve me dokumente identifikimi (letërnjoftimet dhe pasaportat), por përpilimi i regjistrit të votuesve, që lidhej me përgatitjet për zgjedhjet lokale në vjeshtën e vitit 2000. Kjo shihej nga zvarritja e dhënies së letërnjoftimeve, meqë një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës ende nuk i kishin marrë ato, e të mos flasim për pasaporta, të cilat nuk i kishin marrë as 10% e tyre. Operacioni i regjistrimit nuk zhvillohej lehtë. Në prak të këtij regjistrimi dhe gjatë realizimit të tij, në opinionin kosovar, siç u dëshmua më vonë, me të drejtë u shfaqën disa paqartësi, konfuzione, dilema rreth zbatimit të procedeve dhe kritereve, madje edhe dyshime në motivet e tij. Ndërkaq, Rregullorja mbi regjistrimin civil dhe votues, theksonin zyrtarët civilë ndërkombëtarë në Kosovë, kishte legjitimitetin e saj, sepse ishte aprovuar nga OKB-ja në Nju-Jork dhe nga Këshilli i Përkohshëm Administrativ i Kosovës dhe Këshilli Tranzitor i Kosovës.

Megjithatë, mbetën disa konfuzione. Merrej vesh se një pjesë e mirë e materialit të regjistrimit, të papërpunuar, në rrugë për një vend aziatik (Indi),

ku duhej të përpunohej tashmë kishte humbur, ndërsa një sasi shumë e madhe e tij përshkohej me gabime serioze, deri në atë shkallë sa që shumë formularë ishin të papërdorshëm. Prandaj, OSBE-ja edhe i ftonte qytetarët, tashmë të regjistruar, të paraqiteshin përsëri për t'i verifikuar të dhënat e tyre. Një kohë të gjatë për këtë heshtej. Shefi i misionit të OSBE-së përpiqej ta minimizonte sasinë e materialit të humbur dhe me gabime. Derisa ai thoshte se vetëm 5% e të dhënave janë me gabime, ndërkaq zyrtarët e OSBE-së të Vienës theksonin se mbi 20% e materialit, që përfshinte më se 200.000 persona, ishte me gabime serioze. Prandaj, edhe pasuan probleme të mëdha në votimet për zgjedhjet lokale të 28 tetorit të vitit 2000: nuk dihej në cilat lista gjendeshin qytetarët! Qytetarët me të drejtë shtronin edhe problemin e suksesit të këtij regjistrimi, ngase edhe pas përfundimit të tij në gjysmën e parë të muajit korrik të vitit 2000 nuk jepeshin dokumentet e identifikimit dhe të udhëtimit edhe një vit pas, ndërsa kërkesat e kosovarëve ishin të ngutshme, por arsyet për këtë zvarritje nuk bëheshin të njohura për opinion!

Dilema më e madhe që zvarritet edhe sot e gjithë ditën mbetet zbatimi i kritereve, si "lidhja e personit me vendbanimin" dhe veçanërisht kriteri "përfshirja në regjistrim e të gjithë personave që kanë jetuar në Kosovë mbi 5 vjet", me ç'rast nuk qe përcaktuar as koha kur ka jetuar personi në Kosovë. Zbatimi i këtij kriteri hapi mundësi për manipulime të mëdha, prandaj efekti i tij kishte nxitur dyshime dhe natyrisht diskutime të shumta në rastin e regjistrimit të serbëve të Kosovës, të cilët jetojnë qoftë në Kosovë, qoftë të ngulitur në Serbi pas hyrjes së forcave ndërkombëtare, pasi që në mënyra të ndryshme ishin të implikuar në operacionet kriminale kundër shqiptarëve. Si rezultat i zbatimit të këtij kriteri, Serbia me bollëk mund t'u jepte serbëve dokumente për të dëshmuar se kanë jetuar në Kosovë më se 5 vjet.

3. Manipulimet me numrin e serbëve

Përzierja e Serbisë në Kosovë dhe instrumentalizimi i serbëve të Kosovës nga pushteti i Beogradit, si në kohën e Millosheviqit, ashtu edhe sot, është burim i destabilizimit serioz të Kosovës dhe të rajonit. Edhe në Parlament serbët e Kosovës as sot nuk po luajnë një rol konstruktiv dhe nuk po inkuadrohen në shoqërinë e re kosovare pikërisht për arsye të manipulimit të tyre nga Beogradi, por edhe nga humbja e privilegjeve të tjera që kishin në Kosovë vite me radhë; nuk dëshirojnë ta kuptojnë realitetin e ri të krijuar pas çlirimit. Participimin e serbëve të Kosovës në

zgjedhje dhe në institucionet e Kosovës, në mënyrën se si është bërë regjistrimi i votuesve serbë në vitin 2001 dhe si ka rrjedhur gjithë procesi zgjedhor shqiptarët kishin arsye ta shihnin si kthim të Serbisë në Kosovë. Nënkryetari i Qeverisë së Serbisë dhe shefi i Qendrës Koordinuese për Kosovën, N. Çoviq, një shoven dhe demagog i njohur e perfid, ishte bërë më i dëmshmi, madje edhe për vetë serbët e Kosovës.

Shoqëria e sotme kosovare ka këto kontura etnodemografike që ka, ku shqiptarët kanë një dominim absolut, të cilin, me disa fluktuime, varësisht nga shpërngulja me dhunë e tyre dhe kolonizimi i serbëve, e kishin gjatë gjithë shekullit njëzet. Mund të bisedohet për një bashkëjetesë të shumicës me grupet etnike, por multietnicitetit të Kosovës nuk mund t'i jepej dimensioni joreal: gjendja faktike në vitin 2000 mund të vendosej në një raport së paku 90:10%. Në kuadër të këtij dhjetë përqindëshi diçka më shumë se gjysmën e përbëjnë serbët, ndërsa pjesën tjetër boshnjakët, romët dhe grupet e tjera etnike. Aktualisht serbët jetojnë në enklava etnike, të cilat shtrihen rreth Prishtinës, Gjilanit, Dardanë, Shtërpcës, Lipjanit, Vitisë, Artanës, Pejës, Burimit, si dhe në komunat të populluara kryesisht serbë (Leposaviqi, Zveçani, Zubin Potoku) dhe në veri të qytetit të ndarë të Mitrovicës. Në qendrat urbane të Kosovës kanë mbetur shumë pak serbë dhe gati të gjithë ua kanë shitur pronat e paluajtshme shqiptarëve me çmime shumë të larta dhe kësisoji bartej dhe vazhdon të bartet kapitali i shqiptarëve në Serbi.

Në anën tjetër, manipulimet që bëri OSBE-ja dhe shefi i saj, danezi Dann Everts, do të mbahen në mend për një kohë të gjatë. Si habi më e madhe në opinion në vitin 2001 doli numri i serbëve të regjistruar me të drejtë vote. Nga OSBE-ja doli shifra mbi 170.000, ndërsa përfaqësuesi i Qeverisë së Serbisë dha numrin prej 178.000 serbëve të përfshirë në regjistrin votues dhe për këtë shfaqi kënaqësinë. Kjo shifër e serbëve të moshës mbi 18 vjet ishte dhe mbetet absolutisht e kontestueshme. Sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë që kishte bërë Serbo-Jugosllavia në vitin 1991, në Kosovë numri i përgjithshëm i serbëve ishte 194.190 veta, që d.m.th. ata vetë me dorën e tyre i paraqitën kaq, ndërsa sot kërkojnë të kthehen në Kosovë deri 300.000 sosh! Numri prej 194.190 vetash ishte baza demografike që e vënte me arsye në dyshim të madh shifrën e përmendur të OSBE-së. Numri maksimal i serbëve, si popullatë e përhershme (rezidenciale) qoftë që gjenden sot në Kosovë, qoftë që është instaluar në Serbi pas 12 qershorit 1999, me të drejtë vote assesi nuk mund të ishte mbi 100.000 veta. Përveç bazës së përmendur demografike nga viti 1991, këtë e dëshmon edhe dinamika e shtimit natyror të tyre në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, që ishte rreth 2.000 veta mesatarisht në vit, gjithnjë duke iu referuar burimeve zyrtare, statistikës vitale të Entit Statistikor të Beogradit.

Në mbështetje të kësaj statistike, shuma e shtimit natyror të serbëve në periudhën 1991-2001 ishte pra rreth 20.000 veta dhe kur këtij numri i shtohet masa demografike e vitit 1991, atëherë del se numri i përgjithshëm i serbëve ishte rreth 214.000 veta, por me kusht që të mos ishte shpërngulur asnjë serb nga Kosova, gjë që nuk ishte e mundur, sepse serbët, përkundër përpjekjeve të regjimit që ta rrisnin numrin e tyre, gjithnjë kishin saldo negative migruese dhe humbje të një pjese të shtimit natyror përmes emigrimeve. Por këtë fakt regjimi i Millosheviqit nuk e pranonte për arsye se edhe pas okupimit të Kosovës dhe veprimeve gjenocidale, para opinionit serb nuk kishte më si t'i akuzonte shqiptarët për "ndjekjen" e serbëve nga Kosova.

Tabela 1. Lëvizja e numrit të serbëve në Kosovë sipas regjistrimeve zyrtare serbo-jugosllave 1948-2004[6]

Viti	Numri	%
1948	171.914	23,6
1953	189.869	23,5
1961	227.016	23,6
1971	228.261	18,4
1981	209.497	13,2
1991[7]	194.190	9,9
2001[8]	194.000	8,1
2004[9]	130.000	5,2

[6] Burimi për vitet 1948-1991: *Popis stanovništva, domaćinstava i stanova u 1981. godini. Nacionalni sastav stanovništva po opštinama, Statistički bilten 1295,* Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 16; *Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47,* Savezni zavod za statistiku, Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1955, f. 213.

[7] Për vitin 2001 (projeksioni): B. Krstić, *Kosovo između istorijskog i etničkog prava,* Kuća Vid, Beograd, 1994, f. 193;

[8] Për vitin 2001 përfshihen serbët së bashku me malazezët, të cilët sipas regjistrimit të vitit 1991 në Kosovë ishin 20.365 ose 1,0%.
Ka informata se në regjistrimin zyrtar të popullsisë në Serbi më 31 mars 2002 janë përfshirë edhe serbët e Kosovës, por të dhënat nuk janë kumtuar. Nuk dihet gjithashtu se cilët serbë të Kosovës janë përfshirë, vetëm të shpërngulurit pas hyrjes së forcave ndërkombëtare më 12 qershor 1999 apo edhe serbët e tjerë që kanë jetuar në Kosovë edhe para 10, 20 e më shumë vjetëve në cilësi të ndryshme (popullatë e përhershme, administratorë, policë, ushtarakë etj.).

[9] Për vitin 2004 (vlerësimi): The Lausanne Principe: Multiethnicity, Territory and the Future of Kosovo's Serbs, *European Stability Initiative (ESI*), Berlin/Pristina, June 7, 2004.

Duhet theksuar se OSBE-ja, me rastin e përfshirjes së kosovarëve në regjistrimin civil dhe votues, dëshironte të zbatonte një kriter për shqiptarët dhe një tjetër për serbët. Për shqiptarët donte të zbatonte kriterin e gjendjes faktike, që do të thotë aq sa janë në Kosovë, aq duhet të regjistrohen, e këtë e dëshmon edhe shifra shumë e ulët e përfshirjes së tyre në regjistrimin e vitit 2000 në Evropë; në mesin e më se 400.000 shqiptarëve, u regjistruan më pak se 40.000 veta, ndërsa nga regjistrimi i vitit 2001 nuk dihej numri i shqiptarëve të regjistruar të moshës mbi 18 vjet! Si rrjedhojë e zbatimit jokonsekuent të kriterit "lidhja e personit me vendbanimin", në vitin 2000 në zgjedhjet lokale mbetën jashtë procesit votues të paktën rreth 200.000 shqiptarë. Sepse, ata jo që nuk ishin përfshirë në regjistrim, në mungesë të dokumentacionit apo organizimit të dobët, por për të votuar, edhe ata që ishin regjistruar, duhej të vinin në Kosovë. Ndërkaq, për serbët kjo organizatë sikur ishte konsekuente në respektimin e kriterit të gjendjes formale, që nënkupton se kush ka jetuar në Kosovë mbi 5 vjet apo u kanë jetuar prindërit, kishin të drejtë të regjistroheshin, me kusht që të ofronin dokumentacionin. Shqiptarëve në vitin 2000, në zgjedhjet lokale, iu bënë pengesa deri në pamundësi që të votonin në vendet evropiane e gjetiu, ndërsa serbëve iu lejua në vitin 2001, në zgjedhjet parlamentare të Kosovës, të votonin në Serbi, Mal të Zi e gjetiu.

Shifra e përmendur e OSBE-së na kujton, siç theksuam edhe më parë, atë fushatën fantastike të rritjes së numrit të serbëve në kohën e Konferencës së Rambujesë nga ana e përfaqësuesve të Serbisë dhe veçanërisht të kryetarit të saj M. Millutinoviq, i cili, pa fije turpi, theksonte se në Kosovë shqiptarët nuk janë shumicë, por janë nën 50% e madje nën 40%, duke i abstrahuar vlerësimet e institucioneve përkatëse të Beogradit se shqiptarët më 1991 përbënin rreth 82% në popullsinë e përgjithshme të Kosovës. Duke i njohur rrethanat e përfshirjes së popullatës në regjistrim, duhet vënë në pah se në asnjë regjistrim, pa marrë parasysh qëllimin dhe shkallën e organizimit, për shumë arsye kurrë nuk është e mundur të përfshihen të gjithë personat. Në rastin konkret do të thotë se edhe një numër i serbëve ka mbetur i paevidencuar në regjistrin votues, që nënkuptonte se me të drejtë vote ishin më se 200.000 serbë! Sipas kësaj shifre duhej pritur që në regjistrimin e ardhshëm të popullsisë, që parashihej të mbahej në gjysmën e parë të vitit 2003, do të evidencoheshin mbi 350.000 serbë (!), që njëmend do të ishte një absurd.

Lidhur me shifrën e përmendur të serbëve kishin pasuar reagimet publike, ndërsa përfaqësuesit e OSBE-së dhe të instancave të tjera ndërkombëtare qenë treguar mjaft elastikë pasi qenë korrigjuar shpejt, duke deklaruar se shifra e zënë në gojë nuk ka të bëjë vetëm me serbët, por në të

përfshihen edhe të tjerët, si romët, hashkalinjtë, egjiptianët, boshnjakët etj. Ishte kjo një e pavërtetë, sepse prej ditës së fillimit e deri në përfundimin e regjistrimit më 22 shtator 2001, OSBE-ja dhe përfaqësuesit serbë pothuajse çdo ditë jepnin numrin e serbëve të përfshirë në regjistrim, por jo edhe të bashkësive të tjera etnike. Ishte papërgjegjësi e madhe edhe e anëtarëve shqiptarë në Komisionin e OSBE-së për përcjelljen e regjistrimit, të ashtuquajturit ekspertë, të cilët, jo që nuk u tërhoqën nga ky komision, por nuk reaguan as në vitin 2000, e as në vitin 2001 për dobësitë e regjistrimit, në dëm të popullatës shumicë!

Duket se qëllimet e faktorit ndërkombëtar këtu ishin shumë të qarta. Përmes fryrjes së numrit të serbëve, që kishin të drejtë vote, me çdo kusht dëshironin t'i fusnin në procesin votues dhe t'u jepnin në Parlamentin e ardhshëm të Kosovës, pos 10 vendeve të garantuara, të paktën edhe 10 vende të tjera përmes pjesës proporcionale. Në këtë mënyrë doli që, përveç 10 vendeve të garantuara në kuadër të diskriminimit pozitiv, serbët fituan në zgjedhje edhe 12 vende të tjera, por po të kishin dalur edhe 90.000 serbë të tjerë, të përfshirë në regjistrin votues të OSBE-së, ata do t'i fitonin edhe 12 vende të tjera, që do të thotë se pakica prej 6-7% në popullsinë e përgjithshme të Kosovës do të zinte 34 vende në Parlamentin e Kosovës! Absurd mbi absurdet! Në anën tjetër, askush nuk ka pasur kontroll si në procesin e regjistrimit të votuesve, ashtu edhe në procesin zgjedhor të serbëve, e kjo sigurisht do të ndodhë edhe në regjistrimet dhe zgjedhjet e ardhshme. Por duhet theksuar se "paria" karrieriste shqiptare, e preokupuar vetëm me pushtetin, që u dëshmua pas zgjedhjeve të 17 nëntorit 2001, me rastin e ndarjes së posteve, as që u mor me kurthet e përgatitura nga Beogradi dhe OSBE-ja e Dan Eversi! Numri i votuesve serbë dhe numri i deputetëve serbë në Parlament (22) ishte një peshqesh i shkëlqyeshëm që ua dha serbëve ish-shefi i OSBE-së Eversi!

3.1. Vardisja e udhëheqjes shqiptare

Sjellja e udhëheqjes kosovare lidhur me kthyerjen e serbëve në Kosovë na rikujton sjelljen e udhëheqjes kosovare pas vitit 1981 kur e pranoi tezën se edhe një serb i vetëm nëse shpërngulet nga Kosova, pa marrë parasysh motivin, situata nuk mund të konsiderohet stabile! Udhëheqësit më të lartë kosovarë dhe liderët e tri partive kryesore politike,[10] duke iu vardisur të huajve në mënyrë që t'i ruanin postet, nuk pranin ta përkrahnin kthimin e

[10] Bëhet fjalë për kryetarët e tri partive më të mëdha politike shqiptare, si dhe udhëheqësit kryesorë të institucioneve të dala nga zgjedhjet e para parlamentare më 17 nëntor 2001.

serbëve pa marrë parasysh motivin e shpërnguljes së tyre nga Kosova, peshën e fajit të tyre, prejardhjen e të kthyerve dhe vendin e vendosjes së tyre, ndërsa nuk thonin asgjë për zhvendosjet e shqiptarëve brenda vetë Kosovës dhe kthimin në shtëpitë e tyre. Para opinionin kosovar ata arsyetoheshin se po bëjnë politikë të madhe, se me këtë po e përfitojnë bashkësinë ndërkombëtare (!). Kjo mënyrë e të vepruarit, dashtë e padashtë doli analoge me sjelljen e udhëheqjes së dikurshme kosovare të pas vitit 1981, kur deklaronin se po bënin përpjekje për ta siguruar mbështetjen e Jugosllavisë! Një sjellje e tillë, e sotme dhe e djeshme e udhëheqjes sonë, është pjesë e mentalitetit kolonial ose gjysmëkolonial. Shtrohej çështja se a mund të konsiderohej politikë e madhe sjellja ekstreme kur kryetari i Qeverisë së Kosovës (B. Rexhepi), ende pa u konfirmuar nga Parlamenti, shkon dhe jep betimin para dëshmorëve të kombit, ndërsa vetëm pas dy muajve merr turrin për ta dëgjuar liturgjinë kishtare serbe në Patrikanën e Pejës, në institucionin fetar serb që kishte qenë inspiruesi kryesor i luftërave dhe tragjedive të papara ndaj popujve joserbë dhe që nuk kishte bërë asgjë për parandalimin e shkatërrimit të plotë të qytetit të Pejës! Duhet rikujtuar politikanëve tanë se kisha ortodokse serbe ishte pikërisht ajo që kishte kërkuar armë për shfarosjen e shqiptarëve gjatë çdo liturgjie të saj. Ndoshta kryeministri ka pasur presion nga të huajt për të vepruar në atë mënyrë, por ka pasur shumë argumente të qëndrueshme që të refuzohej një vizitë e tillë; ato mund të bëheshin më vonë, pas sqarimit të një mori çështjesh. Mirëpo, kryeministri vetëm disa ditë më pas, së bashku me kryepartiakun e tij, e pati vizituar fshatin Osojan të Burimit, të banuar vetëm me serbë dhe po atë ditë e pati vizituar edhe një kishë tjetër të rrënuar në fshatin Zoçishtë, në rrethinën e Rahovecit. A nuk janë djegur e shkatërruar 218 xhami në Kosovë nga forcat serbe?! A nuk janë djegur e shkatërruar mbi 120.000 shtëpi të shqiptarëve?! Janë vrarë me mija shqiptarë, janë bërë krime më monstruoze mbi shqiptarët, kurse kisha ortodokse serbe ende hesht dhe nuk e ka parë të udhës së paku t'u kërkojë falje shqiptarëve për gjithë ato krime të bëra; nuk e ka parë të udhës t'u kërkojë falje as besimtarëve myslimanë. Më produktive do të kishte qenë sikur kryeministri të ishte marrë me punë nga fushëveprimi i tij. Në anën tjetër, karnavalet e Demaçit për vëllazërim-bashkim fitohej përshtypja se ndoshta mund të gjenin përgjigje vetëm në atë dialektikën e tij *sui generis*: njeriu evoluon! Por ky evoluim na duket se është tepër i bajatshëm, madje neveritës. Sjelljet e tilla edhe nuk të çudisin kur dihet natyra e frymës dhe e ideologjisë ekstreme, sjellja nga një skajshmëri në tjetrën, nga bashkimi kombëtar në bashkësi multietnike, në koekzistencë, në vëllazërim-bashkim! Kjo ishte edhe parulla titoiste, që u përdor për shumë kohë gjatë sundimit komunist në ish-Jugosllavi, por shteti

multietnik nuk funksionoi, sepse e rrënuan pikërisht hegjemonët, që ende nuk janë mposhtur as në frymë e as në veprim.

Ku janë shqiptarët, pse s'po kthehen nga bota e jashtme? Pse nuk po kthehen në shtëpitë e tyre në Kosovë? Pse ata nuk mund të kthehen as nga kurbeti e as brendapërbrenda Kosovës? Pjesa më e madhe e shqiptarëve në botën e jashtme, në saje të qëndrimit të njëanshëm të OSBE-së dhe papërgjegjësisë së të ashtuquajturve ekspertë kosovarë në ato këshilla e komisione mbetën pa u përfshirë në procesin e regjistrimit dhe të votimit; në vitin 2000 p.sh. nga më se 400.000 shqiptarë u regjistruan vetëm rreth 10%! Pos disa pengesave të tjera, ata nuk mund të kthehen, sepse shumë shtëpi të tyre ende janë të djegura e të shkatërruara nga forcat serbe. Shqiptarët ende janë me plot trauma për shkak të krimeve të papara dhe njëkohësisht ballafaqohen me një gjendje tepër të rëndë socioekonomike. Në anën tjetër, numri i familjeve të pastrehë, që bredhin nëpër qytete të Kosovës apo që jetojnë nën tenda në zonat rurale, e ku u është ndërprerë edhe mbështetja emergjente, nuk është i vogël.

Kur bisedohet për kthyerjen e të zhvendosurve sikur mendohet vetëm për serbët. Pjesa dërmuese e shqiptarëve përkohësisht të instaluar në qendrat urbane, veçanërisht në shtat qendrat mezoregjionale, nuk mund të cilësohen si uzurpatorë të banesave dhe të shtëpive të serbëve, por si nevojtarë për të gjetur kulm mbi kokë. Uzurpatorë janë të pasurit dhe pjesëtarët e klaneve politike, bartës të kriminalitetit, të kërcënimeve e keqbërjeve. Nga 120.000 objekte banimi në Kosovë të shkatërruara në shkallë të ndryshme, ndihma për t'i riparuar ato nuk kanë marrë më shumë se një e pesta e familjeve. Në të shumtën e rasteve ndërtimet e riparimet i kanë bërë vetë familjet, me shpenzimet e tyre, duke u futur në borxhe të mëdha. Por shumë shtëpi janë ende të pabanueshme, të shndërruara në gërmadha.

Në fund duhet theksuar se nuk ka se si të mos shfaqeshin pakënaqësitë me gabimet që ishin bërë gjatë këtij lloj regjistrimi sa i përket datave të lindjes, vendeve të lindjes dhe emrave, gabime këto që do të përsëriten sigurisht në vazhdimësi. P.sh. në vend të vendit të lindjes, vendbanimit, në letërnjoftime ishin shënuar emrat e rrugëve, të lagjeve, madje edhe të shteteve, e të mos flasim për deformimet në emrat e njerëzve. Një administratë efikase dhe funksionale komunale, e ndihmuar nga organizatat ndërkombëtare, ka mundur t'i kryejë këto punë shumë më mirë dhe me më pak shpenzime.

4. Bashkëpunimi i organizatave të huaja me ekspertë shqiptarë në sferën demografike

Me hyrjen e forcave ushtarake ndërkombëtare në Kosovë vërshoi edhe ardhja e organizatave humanitare. Një numër i konsiderueshëm i këtyre organizatave erdhi me qëllim që t'i ndihmojë njerëzit e përvuajtur, por ndër to do të gjenden edhe të tilla që më së paku do të bënin punë humanitare ngase do të merren me aktivitete të tjera. Disa organizata joqeveritare në realizimin e projekteve të tyre dëshirojnë të bashkëpunojnë me veprimtarë dhe ekspertë vendës, por ka edhe shumë të tjera që bashkëpunimin e reduktojnë në shoferë, përkthyes dhe mirëmbajtës të zyrave dhe banesave luksoze të veprimtarëve të tyre. Shpeshherë si bashkëpunëtorë të tyre imponohen njerëz tanë, të papërgjegjshëm e diletantë, me qëllim që të përfitojnë materialisht dhe në mënyra të tjera, gjë që u pëlqen edhe stafeve të organizatave të huaja. Sjellja e këtyre organizatave dhe kooperimi ynë me to dhe e kundërta është çështje që kërkon një shqyrtim më kompleks, mirëpo ndriçimi i këtyre raporteve nuk është qëllim i këtij vështrimi.[11]

4.1. Mënjanimi i ekspertëve vendorë

Këtu do të përmendim vetëm një shembull, që, mjerisht, nuk mund të merret si model për të mirë. IOM-i (Organizata Ndërkombëtare për Migrim) dhe UNFPA-ja (Fondi për Aktivitete Popullative i KB-së), në përpjekjet për të siguruar një fond të informatave të natyrës demografike dhe socioekonomike në Kosovë, më se të nevojshme në rrethanat kur mungojnë të dhënat dhe kur lëkundjet e popullatës ishin dhe mbetën të mëdha, qysh në fund të vitit 1999 dhe në fillim të vitit 2000 i kishte hyrë realizimit të një projekti përmes hulumtimit anketues. Si partnerë ndërkombëtarë dhe kosovarë të këtyre dy organizatave ishin paraparë Universiteti i Prishtinës, Enti Statistikor i Kosovës dhe Universiteti i Bordeaux-së (Francë). Enti Statistikor i Kosovës duket se ishte i kyçur deri në një shkallë në këtë projekt), ndërkaq është evidente se që nga fillimi ekspertët e Universitetit të Prishtinës ishin injoruar. Nga Universiteti ynë ishte dashur të merrte pjesë një ekip i përbërë nga sociologë, demografë, ekonomistë, psikologë, mjekë etj. Mirëpo, si mbulesë e të gjithëve dhe e Universitetit të Prishtinës si institucion ishte vënë formalisht vetëm një emër, i një diletanti në profesion, dr. Tefik Basha. Njeriut kryesor të IOM-it në këtë projekt, rusit Igor Monsorov dhe njeriut numër dy, maqedonit Vllatko Avramovski, u kishte mjaftuar ky emër si dekor, si përfshirje e Universitetit

[11] Vështrimi ynë u publikua më 7 prill 2000.

(!). Drejtuesit e Entit Statistikor të Kosovës u kishin tërhequr vërejtjen me kohë përfaqësuesve të këtyre organizatave ndërkombëtare se Universiteti i Prishtinës nuk është i kyçur në këtë ndërmarrje.

Ndoshta Enti Statistikor nuk ka qenë në pozitë që të imponohej për shkak të kthyerjes së punëtorëve shqiptarë në punë pas 9 viteve dhe problemeve financiare-teknike e të tjera. Po të kishte qenë i kyçur ekipi profesionist prej 4-5 vetash nga Universiteti, është e sigurt se Monsorovi dhe Avramovski do të ishin kontestuar si koordinonatorë pothuajse të gjithë punës në projekt dhe të tërë monopolit mbi të dhënat. Nga ana shqiptare më parë do të pranohej ekipi serb, që dihet se është serb, se sa rusi dhe maqedoni, të cilët për bashkësinë ndërkombëtare do të trajtohen si të huaj, por do të veprojnë si të jenë dy herë serbë. Prandaj, kemi arsye të konkludojmë se nuk është e rastit kyçja e rusit dhe e maqedonit në emër të IOM-it në këtë projekt. Edhe sjellja e francezëve në emër të UNFPA-së dhe Universitetit të Bordaux-së lë vend për dilema.

Ishte hartuar pyetësori pa pjesëmarrjen e ekspertëve shqiptarë, prandaj formulimi i disa pyetjeve të rëndësishme ishte i paqartë, nga i cili, u muor vesh, do të dalin përgjigjet konfuze. Indikativ do të mbetet gjithsesi fakti se gjysma e pyetësorit individualë (20 nga gjithsej 42 pyetje) ka të bëjë me shtatzënësitë dhe zbatimin e mjeteve dhe metodave të kontracepcionit. Menjëherë do të shtrohet pyetja: athua pas pasojave kaq të mëdha të krimeve gjenocidale serbe mbi shqiptarët në të gjitha rrafshet, në përmbajtjen e kuestionarit vend kaq të rëndësishëm ishte e nevojshme të zënin pyetjet mbi planifikimin e familjes dhe kontrollin e lindjes e jo humbjet demografike, të drejtpërdrejta e indirekte, dhe situatat emergjente? Si duket IOM-i dhe UNFPA-ja, përmes njerëzve të caktuar kishin marrë përsipër përmbushjen e objektivit që nuk kishte arritur ta realizonte Beogradi këto dy dhjetëvjetëshat e fundit lidhur me reduktimin e lindjeve. Në anën tjetër, hulumtimit anketues me pretendime kaq të mëdha nuk i ka paraprirë një anketim provues. Por edhe më problematike mbetet çështja se anketimi është realizuar veçmas për shqiptarë e veçmas për serbë, ndërsa të dhënat do të hynin në rezultatin kumulativ (në nivel të Kosovës). Te shqiptarët kishte pasur kontroll dhe mbikëqyrje, ndërkaq te serbët të vetmit realizues dhe mbikëqyrës ishin Monsorovi dhe Avramovski. Dyshimet shpien edhe deri te fakti se te serbët fare nuk ishte bërë anketimi, por pyetësorët janë plotësuar në qendra të caktuara. I tërë operacioni hulumtues, si dhe pyetësorët për serbët janë mbajtur në fshehtësi, ndërsa i gjithë materiali gjendej në IOM, atje ku vepronin Monsorovi dhe Avramovski.

Kur është kështu, pse të mos shprehet dyshimi se rusi dhe maqedoni punojnë me kështillat e Beogradit dhe se të gjitha të dhënat e kësaj ankete, për shqiptarët dhe për serbët, tashmë i posedonin instancat e caktuara të Beogradit.

Vetë mënyra e realizimit të kësaj ndërmarrjeje te serbët, mënjanimi i ekipit shkencor-hulumtues nga Universiteti, evitimi i anketimit provues, përmbajtja e pyetësorit etj. flasin se çfarë validiteti do të mund të kishin rezultatet e këtij projekti dhe, lidhur me këtë, çfarë dobie do të kishte Kosova nga krejt kjo punë apo ndoshta rezultatet që do të dilnin nga ky anketim do të shkojnë më tepër në favor të serbëve dhe enklavave të tyre si sa u përket indikatorëve themelorë demografikë dhe socioekonomikë, ashtu edhe politikës dhe programeve të mëtejme zhvillimore e të tjera, që do të mbështeten në këto rezultate.

4.2. Dilemat rreth shkuarjes në Bordeaux

Pas vërejtjeve të disa ekspertëve të pavarur, të informuar mirë për rrjedhat e këtij projekti, sidomos me ato që kanë të bëjnë me evitimin e specialistëve shqiptarë nga Universiteti dhe me mënyrën e realizimit të anketës në enklavat serbe, bartësit e këtij projekti ishin gjetur në një pozitë jo fort të lakmueshme, si të vepronin në fazën e mëtutjeshme, ke ta merrnin nga Universiteti si mbulesë tjetër e gjithë asaj që ishte përgatitur më herët, që nga muajt shtator-tetor 1999. Operacioni hulumtues në terren tashmë kishte përfunduar dhe organizatorët po bëheshin gati që përpunimin dhe analizën e të dhënave ta bënin në Bordeaux të Francës. Pse të shkohej në Bordeaux, ishte kjo një dilemë tjetër që doemos shtrohej. Athua për t'i dhuruar një shumë të mirë të mjeteve Universitetit të Bordeaux-së për një punë që do të mund të kryhej pa asnjë vështirësi në Prishtinë, në secilën qendër kompjuterike, më parë në vetë Entin Statistikor të Kosovës, apo për diçka tjetër.

Shqiptarët dhe institucionet që ata i drejtojnë patjetër duhet të jenë kooperativë me institucionet e bashkësisë ndërkombëtare, por bashkëpunimi duhet të jetë reciprok, në baza të mirëbesimit dhe të sinqeritetit. Çdo margjinalizim apo evitim i shqiptarëve, veçanërisht i ekspertëve në këtë bashkëpunim dhe e kundërta nuk mund të japë rezultate të kënaqshme në asnjë segment të jetës. Rasti i zënë në gojë është një nga shembujt e hidhur në vargun e shumë dështimeve.

Kosovarët në asnjë mënyrë nuk duhet të pranojnë tendencën që anketimi i përmendur dhe rezultatet e tij, qofshin ato edhe valide, ta zëvendësojnë regjistrimin gjithëpërfshirës dhe cilësor të popullsisë dhe rezultatet e tij, për çka po angazhohen të huajt. Enti Statistikor i Kosovës, me gjithë mundësitë e kufizuara në veprimtarinë e tij, duhet të bëjë ç'është e mundur që të përgatitet për regjistrimin e popullsisë të vitit 2001, kur, sipas radhës dhe në përputhje me porositë e OKB-së doemos duhet të mbahet. Enti ka mundësi kadrovike, por i duhen mjete financiare e teknike dhe natyrisht mbështetje përkatëse

ligjore. Në qoftë se Enti me ndihmën e faktorit veprues shqiptar dhe faktorit të huaj nuk imponohet, atëherë do të imponohen të tjerët, para së gjithash Beogradi, qoftë edhe tërthorazi, i cili për realizimin e kësaj ndërmarrjeje me rëndësi të madhe shkencore, shoqërore, ekonomike, politike etj. është tashmë duke punuar ka sa vite. Nëse arrihet të imponohet vetëm ndërrimi i koncepcionit të regjistrimit të popullsisë, të kalohet nga koncepcioni i popullsisë së përhershme apo rezidenciale në koncepcionin e popullsisë së pranishme apo faktike, Kosova dhe shqiptarët do të jenë humbësit më të mëdhenj në historinë e regjistrimeve të popullsisë, me pasoja të shumëfishta për të ardhmen e përgjithshme të tyre.

5. Rezultatet absurde të një publikimi të Entit Statistikor të Kosovës[12]

Dihet se regjistrimi i fundit zyrtar i popullsisë në Kosovës është bërë në vitin 1981, sikundër që janë të njohura shkaqet dhe rrethanat pse popullata shqiptare në Kosovë, në Maqedoni dhe në Luginën e Preshevës e bojkotoi regjistrimin e vitit 1991. Enti Statistikor i ish-RFJ-së bëri vlerësimin e numrit të shqiptarëve, ndërsa numrin e popullsisë së përgjithshme në Kosovë e vlerësoi në 1.956.196 banorë, prej të cilëve 1.596.072 shqiptarë (81,6%); numri i serbëve të regjistruar zyrtarisht ishte 194.190 (9,9%).

Nevoja për regjistrim të popullsisë në çdo vend është e madhe për shkencën, praktikën jetësore, planifikimin e zhvillimin shoqëror, opinionin e gjerë dhe individin. Të vetëdijshëm për rëndësinë e tij dhe duke e kuptuar edhe si detyrë qytetare dhe civilizuese, shqiptarët kërkuan edhe në vitin 1991 të përfshiheshin në regjistrim, me kusht që të krijoheshin rrethanat e nevojshme politike e shoqërore, kadrovike e financiare, organizativo-teknike, klima psikologjike dhe atmosfera e besimit ndaj institucioneve të shtetit, etj. Shteti i atëhershëm në vend që t'i krijojë këto rrethana, ai popullatës shqiptare i ofroi dhunën dhe terrorin.

5.1. Asnjë anketim nuk mund ta zëvendësojë regjistrimin e popullsisë

Veprimet gjenocidale të regjimit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë (masakrat, djegiet e shtëpive, shkatërrimi i monumenteve kulturo-historike dhe i të mirave materiale, shpërnguljet dhe doportimet masive, varrezat

[12] Reagimi ynë publik është bërë më 17 nëntor 2004, menjëherë pas prezentimit të publikimit.

masive, zhdukja e dokumentacionit etj.) dhe redistribuimi i madh i popullatës brenda Kosovës pas hyrjes së forcave ndërkombëtare më 12 qershor 1999, shtruan nevojën e njohjes së gjendjes së përgjithshme. Pas luftës OSBE-ja ndërmori operacionin e madh të regjistrimit të njerëzve në mënyrë që t'u mundësohej sigurimi i dokumentacionit dhe lëvizja e lirë. Mirëpo, ky nuk ishte regjistrim i popullsisë, por regjistrim civil dhe votues, që dallon qenësisht nga regjistrimi i popullsisë. Regjistrimi civil ka të bëjë me moshën mbi 16 vjet (afër 40% e popullsisë së Kosovës) dhe ka për qëllim sigurimin e dokumenteve të identifikimit. Ndërsa, regjistrimi votues ka të bëjë me moshën mbi 18 vjet (rreth gjysma e popullsisë së Kosovës) dhe shërben për përpilimin e listave të personave që kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen. Si rrjedhojë e zbatimit jokonsekuent të kriterit "lidhja e personit me vendbanimin", nuk u përfshinë në regjistrim qindra mijëra shqiptarë në botën e jashtme, të cilët vendin e përhershëm të banimit e kishin në Kosovë, ndërsa jashtë procesit votues mbetën të paktën rreth 200.000 shqiptarë.

Hulumtuesit dhe shfrytëzuesit e të dhënave pas luftës e kërkuan vazhdimisht regjistrimin e popullsisë, por Beogradi zyrtar përmes UNMIK-u nuk e lejoi dhe sot e gjithë ditën po e zhagit. Edhe pas ligjit të votuar në Parlamentin e Kosovës dhe panelit të mbajtur me vendimin e këtij Parlamenti, administratori ndërkombëtar nuk e nënshkroi ligjin; panelin e kundërshtuan edhe disa deputetë shqiptarë, ndonëse ishte në dobi të Kosovës. Te strukturat ndërkombëtare vazhdimisht vërehej tendenca që regjistrimin gjithëpërfshirës të popullsisë ta zëvendësonin me disa anketime të kufizuara e të improvizuara, madje pa pjesëmarrjen e ekspertëve vendorë. Kështu bëri IOM-i (Organizata Ndërkombëtarë për Migrim) dhe UNFPA-ja (Fondi për Aktivitete Popullative i OKB-së) në vitet 1999-2000 kur realizuan anketimin për gjendjen demografike dhe socioekonomike në Kosovë, siç vumë në pah më parë, ku rusi I. Monsorov dhe maqedoni V. Avramovski e koordinonin pothuajse gjithë punën dhe kishin tërë monopolin mbi të dhënat në këtë projekt. Si mënyra e realizimit të kësaj ndërmarrjeje, ashtu edhe rezultatet që dolën u kontestuan publikisht. Ndërkaq, një publikim i Entit Statistikor të Kosovës që doli me titull "Kosova në shifra 2004" (i hartuar edhe në gjuhën angleze dhe serbe), si rezultat, siç thuhet në parathënie dhe që u tha edhe me rastin e prezantimit, të një "projekti të financiuar nga BE-ja, menaxhuar nga AER-i, kurse implementuar nga instituti ICON". Publikimin e kishte prezantuar vetë drejtori i Entit Statistikor Hysni Thaçi. Në parathënie nënvizohej se "të dhënat statistikore të prezantuara në këtë publikim kryesisht rrjedhin nga anketat e ESK-së, por gjithashtu janë përdorur të dhënat nga ministritë,

organizatat dhe agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare". Dhe, në vend se ESK-ja të jetë burim i të dhënave për shfrytëzuesit e të gjitha niveleve, këtu del e kundërta.[13]

5.2. Dëmet e shumëfishta nga improvizimet statistikore

Nga konstatimet e mësipërme hetohej një konfuzitet i madh, sepse nuk dihej se kush ishte autor i vërtetë i publikimit: njëri e financoi, tjetri e menaxhoi, i treti e implementoi, ndërsa i katërti bëri anketimin, ndonëse, siç mund të vërehet, pjesa dërmuese e të dhënave nuk është rezultat i hulumtimit anketues të ESK-së! Nuk i thuhet shfrytëzuesve as fakti se statistika e Kosovës është territorialisht e gjymtë, pa pjesën veriore të Kosovës dhe enklavat e tjera serbe. Në anën tjetër, si pasojë e mungesës së profesionalizmit, improvizimi i të dhënave dhe jovaliditeti i rezultateve e përshkoi në shumë pjesë publikimin dhe me këtë Kosovës i shkaktohej dëm i shumëfishtë, para së gjithash në planin demografik, ekonomik dhe politik. Ne do të ndalemi vetëm te indikatori themelor demografik, numri i përgjithshëm i popullsisë, që është punë e ESK-së, duke potencuar se ku është absurdi më i madh i prezantuar deri tash. Nuk dihet para së gjithash se në mbështetje të cilit koncepcion u nxor numri i përgjithshëm i popullsisë, të koncepcionit *të popullsisë së përhershme apo rezidenciale (population résidente*) apo të koncepcionit *të popullsisë së pranishme apo gjendjes faktike (population présente).* Atje vetëm thuhej se "popullsia rezidente (personat që jetojnë në Kosovë) zakonisht vlerësohet prej 1.8 gjer në 2 milion. *Vlerësimi më i mirë me gjasë është 1.9 milion"* (f. 9). Ose, siç tha drejtori me rastin e prezantimit, "sipas rezultateve të anketave është vlerësuar se Kosova ka 1,9 milion banorë", "prej tyre, përafërsisht 33% janë nën moshën 15-vjeçare dhe 50% nën moshën 22-vjeçare"! Shifrën prej 1.9 milionë banorë, kanë mundur ta japin të gjitha organizatat dhe agjencitë, të huaja dhe të vendit, por assesi një institucion profesional, çfarë është Enti Statistikor i Kosovës. Statistika nuk është politikë për t'u gjetur balancimet, por ESK-ja e paska gjetur kompromisin: as 1.8 e as 2 milionë, por 1.9 milionë! Diletantizmi shkon deri në atë nivel sa te vlerësimet nuk bëhet as rrumbullakësimi i të dhënave, të thuhet p. sh. rreth 2 milionë apo rreth 1.9 milion, që është gjëja elementare në analizat statistike dhe demografike. Ka paqartësi dhe konfuzione edhe në përdorimin e disa nocioneve, të cilat e

[13] Siç u pa nga shkrimet në gazeta, i vetmi pjesëmarrës në përurimin e publikimit që kishte reaguar me të drejtë ndaj kumtimit të rezultateve, veçanërisht sa i përket numrit të përgjithshëm të popullsisë, ishte kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Ismail Kastrati.

hutojnë shfrytëzuesin, që tregon se teksti burimor nuk është në gjuhën shqipe, por është përkthyer nga anglishtja apo serbishtja. P.sh. thuhet "ndryshimet natyrore të popullsisë", "shkalla e vrazhdë e lindjes', "shkalla e vrazhdë e vdekjes", "jetëgjatësia e pritur me rastin e lindjes" (f. 11), etj. Habit fakti se ESK-ja ka ekspertë me eksperiencë të gjatë profesionale, bile edhe statistikanë të shkolluar, që i njohin shumë mirë problemet statistiko-demografike, por nga rezultatet e publikuara nuk shihet se janë konsultuar, gjë që edhe u vërtetua.[14]

5.3. ESK-ja po e ndihmon shtyrjen e regjistrimit të popullsisë

Sipas këtij numri të përgjithshëm (1.9 milionë), Kosova do të duhej të kishte midis 950.000 dhe 1 milion votues, duke marrë parasysh moshën e popullatës mbi 18 vjet, por në zgjedhjet e 23 tetorit 2004 OSBE-ja me të drejtë evidencoi 1.294.802 votues, shifër kjo që përkon me potencialet demografike të Kosovës. Ndërkaq, si theksuam më lart, vetë institucionet statistikore të ish-Federatës Jugosllave numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës në vitin 1991 e kishin vlerësuar në 1.956.196 banorë, pra për 56.000 banorë më tepër se Enti Statistikor i Kosovës pas gati 14 vjetëve! Shtimi natyror del negativ! Ndërkaq vlerësimet e ekspertëve kosovarë shkonin në 2.018.500 banorë.[15] Shifra e këtij enti u ndesh me rrjedhën e shtimit natyror të popullsisë, si dhe me çdo logjikë statistike.

Me gjithë dobësitë që ka evidencimi i të dhënave të statistikës vitale të institucioneve statistikore të Beogradit për Kosovën në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, çfarë është mospërfshirja e të gjitha ngjarjeve vitale (lindjet dhe vdekjet), që në statistikën demografike njihet si nënregjistrim, megjithatë, në mbështetje të kësaj statistike, shtimi natyror i popullsisë së Kosovës sillet midis 44.000 vetave në vitin 1991 dhe 35.000 vetave në vitin 1998. Të dhënat edhe të statistikës së tillë flasin qartë se shtimi natyror i popullsisë së Kosovës ishte në atë vëllim sa Kosova do të duhej të kishte (deri në deportimin e shqiptarëve në mars-qershor 1999) 2.250.000-2.300.000 banorë. Në periudhën 1999-2004 le të jetë vëllimi i shtimit natyror i njëjtë apo edhe më i ulët se në vitin 1998, del se

[14] Pas botimit të publikimit "Kosova në shifra 2004" dhe reagimit tonë publik, të gjitha reagimet e tjera ishin negative, madje edhe vetë Divizioni i Statistikave Demografike i ESK-së u distancua nga publikimi, duke theksuar se publikimi "është bërë pa pjesëmarrjen dhe konsultimin e Sektorit të Statistikave Demografike. Ne nuk jemi as autorë e as bashkautorë të këtij buletini" (Sipas të përditshmes *Lajm ekskluzive,* 22 nëntor 2004, f. 2).

[15] A. Pushka, "Porast stanovništva kosovskih gradova", *Stanovništvo*, nr. 3-4/1990 dhe 1-2/1991, CDI, IDN, Beograd, 1992, f. 81.

Kosova ka sot midis 2.450.000 dhe 2.500.000 banorë, gjë që i përgjigjet numrit të votuesve prej afër 1.300.000 personave. Në vitin 1991, sipas vetë statistikës serbo-jugosllave, me të gjitha defektet që shkonin në dëm të shqiptarëve (nënregjistrimi), nga shuma e përgjithshme e shtimit natyror të popullsisë së Kosovës, shqiptarëve u përkiste 89,8% (serbëve 4,2%), ndërsa në vitin 1995 shqiptarëve 88,2% (serbëve 5,0%); numri tjetër u përkiste boshnjakëve (2,4%), romëve (2,4%), turqve (0,5%), malazezëve (0,3%), kroatëve (0,1%).

Është e qartë se për afër një gjysmë milioni shqiptarë e të tjerë, qoftë si punëtorë, qoftë me status tjetër qëndrimi në botën e jashtme, e që janë pjesë e popullatës së përhershme të Kosovës, projekti në fjalë as që ka çarë kokën, sikundër që në numrin e përgjithshëm nuk i ka përfshirë as shqiptarët e shpërndarë nëpër botë pas deportimit që bëri regjimi i Millosheviqit në pranverë të vitit 1999, që ende përkohësisht qëndrojnë në vendet evropiane, në SHBA, Kanada, Australi etj., por që në momentin e parë do të kthehen në Kosovë, ku shumica kanë një pjesë të familjeve dhe pronat e paluajtshme.

Enti Statistikor i Kosovës, me këtë publikim, me shifrat kuturu që i ofroi jo vetëm që e dëmtoi rëndë shoqërinë kosovare në shumë rrafshe, por drejtpërdrejt e ndihmoi shtyrjen të paktën për 2-3 vjet të regjistrimit të popullsisë, të ekonomive shtëpiake dhe të banesave, që e kërkon Serbia zyrtare përmes disa qarqeve të UNMIK-ut. Ky "anketim" edhe po të sillte rezultate objektive dhe shkencërisht të qëndrueshme, kurrë nuk do të mund të ishte zëvendësim i të dhënave që sigurohen përmes regjistrimit të popullsisë. Vetëm përmes regjistrimit gjithëpërfshirës e cilësor, të mbështetur në metodologjinë bashkëkohore sigurohen të dhëna të plota, që pasqyrojnë gjendjen reale në karakteristikat demografike, ekonomike, arsimore, etnike, migruese etj. të popullsisë dhe të ekonomive familjare. Anketat janë burim plotësues dhe shumë të dobishme për ndriçimin e aspekteve të ndryshme të zhvillimit demografik, socioekonomik dhe kulturor të një vendi, por "anketa" e Entit Statistikor të Kosovës, me konstatimin se *"Vlerësimi më i mirë me gjasë është 1.9 milion"*(!), lëngon nga joprofesionalizmi, mosnjohja totale e metodës së analizës demografike dhe statistike, prandaj rezultatet e saj paraqesin improvizimin më banal që njohin operacionet hulumtuese statistikore në sferën e popullsisë. Si i tillë, publikimi duhet të tërhiqet nga përdorimi.

Për të qenë absurdi edhe më i madh, i njëjti institucion, Enti Statistikor i Kosovës, vetëm pas një muaj e gjysmë (më 28 dhjetor 2004) në një botim tjetër jep një vlerësim krejtësisht tjetër[16] për numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës, më një dallim prej hiq më pak se 573.000 banorë! Prezantimin edhe

[16] Shih: *Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2004, f . 6.

të këtij publikimi e bëri i njëjti drejtor, Hysni Thaçi! Divizioni i Statistikave të Popullsisë të këtij Enti, në mbështetje të të dhënave të statistikave vitale, vlerëson se në vitin 2004 Kosova kishte 2.473.000 banorë, që përafërsisht përputhet me vlerësimin tonë. Në publikimin "Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003", "rezultatet e statistikave demografike përpunohen sipas principit të vendbanimit të përhershëm të personit, që sipas rregullave ndërkombëtare i përgjigjet koncepcionit të popullatës së përhershme (rezidente), e cila aplikohet edhe me rastin e regjistrimit të popullsisë".[17]

[17] *Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003,* Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2004 (parathënia). Autorë të këtij "Buletini" janë Gani Kadriu, drejtor i Divizionit të Statistikave të Popullsisë, dhe Kadri Sojeva, shef i këtij Divizioni.

II. DËSHTIMI I REGJISTRIMIT TË POPULLSISË PAS NXJERRJES SË LIGJIT MBI REGJISTRIMIN TË VITIT 2004

Siç theksuam edhe më parë**,** nevoja për njohjen e realitetit demografik, social, ekonomik dhe politik të Kosovës pas luftës u bë më se e domosdoshme jo vetëm pse nuk kishte pasur regjistrim të popullsisë që nga viti 1981, por pse lufta e viteve 1998-1999 e kishte ndryshuar radikalisht gjendjen në terren, duke sjellë pasoja të mëdha të drejtpërdrejta demografike dhe socioekonomike (shpërnguljet dhe deportimet, vrasjet, shkatërrimet e shtëpive dhe dëmet e tjera materiale, zhdukja e dokumentacionit, emigrimet në botën e jashtme, ridistribuimi i madh i popullatës brenda Kosovës etj.).

Mirëpo, dolën disa pengesa në organizimin dhe realizimin e regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave. Vetëm në korrik të vitit 2004 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, që ishte kopje mekanike e Ligjit të INSTAT-it të Shqipërisë, ndërsa administratori ndërkombëtar e nënshkroi në dhjetor të këtij viti. Në mbështetje të këtij Ligji, në fillim të muajit mars të vitit 2005, Kuvendi i Kosovës e themeloi Komisionin Qendror të Regjistrimit (KQR) si organ përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteteve të regjistrimit. Kryetare e Komisionit u emrua ministrja e Shërbimeve Publike znj. Melihate Tërmkolli, ndërsa zëvendës z. Aziz Lila, zëvendësministër i Pushtetit Lokal. Ky Komision e formoi edhe grupin e ekspertëve dhe drejtimi i tij iu besua Hivzi Islamit. Me këtë u krijuan kushtet institucionale dhe profesionale për organizimin dhe realizmin e regjistrimit. Përgatitjet për regjistrim, që normalisht zgjasin 5-6 vjet, duhej të bëheshin për më pak se një vit. I vetëdijshëm për këtë, grupi i ekspertëve, së bashku me specialistët e Entit Statistikor të Kosovës, menjëherë e filloi punën, duke e vijëzuar paralelisht në dy drejtime: në përgatitjen e projekt-planit të aktiviteteve të regjistrimit dhe në hartimin e pyetësorëve. Ndërkaq, grupi i hartografisë punonte intensivisht në përgatitjen e qarqeve të regjistrimit. Ishte formuar edhe Zyra e Regjistrimit.

1. Bllokadat dhe pengesat në realizimin e projektit

Vështirësitë e para dhe serioze ishin bllokadat e brendshme, ku vetë drejtori i Entit Statistikor. Hysni Thaçi, për të cilin statistika ishte një "anije kozmike", së bashku me aparatin e tij të brendshëm dhe Kadastrin e

Kosovës kishin për detyrë që ta pengonin çdo gjë që shkonte në favor të realizimit të regjistrimit të popullsisë. Në këtë Ent mund të gjendej gjithçka, duke përfshirë keqpërdorimet financiare nga më të ndryshmet, përveç të dhënave statistikore. Nga më se 140 punonjës vetëm tre veta (statisticienë të vjetër, të shkolluar) dinin ta bënin punën e regjistrimit të popullsisë. Përveç dy anketimeve të karakterit demografik dhe socioekonomik, të realizuara së bashku me organizatat e huaja, por me rezultate jocilësore dhe problematike, ky Ent deri sot nuk bëri asnjë hulumtim statistikor për aspekte të ndryshme të popullsisë dhe ekonomisë (të standardit jetësor, të shkollimit, të shëndetësisë, të punësimit, të migrimeve etj.); statistikat ekonomike, që përbëjnë një pjesë të madhe të statistikave dhe janë pjesë e veprimtarisë së rregullt të Entit, nuk të ofrojnë asnjë të dhënë (!). E vetmja punë që është bërë është aktivizimi i statistikave vitale, por pa 1/4 e territorit të Kosovës, sepse serbët sot e gjithë ditën nuk bashkëpunojnë as me sistemin statistikor të Kosovës.

Pengesat tjera vinin nga qarqet e caktuara të UNMIK-ut dhe OJQ-të. Arsyet kryesore ishin përfitimet enorme financiare dhe loja politike me statistikë. P. sh. një OJQ, SIDA e Suedisë, që vepronte përmes statistikave të këtij vendi me seli në Beograd, ka shumë vjet që gjendet në Entin Statistikor të Kosovës, por nuk bëri asnjë ngritje profesionale të personelit: organizonte kurse të gjuhës angleze për punëtorët e Entit thua se ishte shkollë për gjuhë të huaja e jo për ngritjen e cilësisë së sistemit statistikor! Pengesa tjetër ishte përzierja e Serbisë përmes qarqeve të UNMIK-ut dhe individëve të caktuar, me qëllim që Kosovës dhe strukturës së saj etnodemografike t'i jepej dimensioni joreal, multietniciteti i dhunshëm.

Hiq më të vogla nuk ishin pengesat financiare. Mjetet nga buxheti i Kosovës për regjistrimin e popullsisë për vitin 2005 nuk ishin siguruar për shkak të vonesave që lidheshin me nënshkrimin e Ligjit. Askush nga grupet e punës të angazhuar në punët e regjistrimit nuk ishte paguar, ndërsa po ta kishin bërë të huajtë punën do të ishin paguar me kohë dhe dhjetra herë më tepër. Në një dokument të janarit 2005 për ndërkombëtarët, pa u konkretizuar puna e tyre, ishin paraparë 1.612.607 euro ose 20,5% e tërë buxhetit të regjistrimit prej 7.9 milionë eurove!

Regjistrimi është komponent shtetëror, prandaj financimi bëhet nga buxheti i vendit. Mirëpo, më 28 qershor Qeveria e Kosovës kishte marrë një vendim që nga shuma e përgjithshme prej 7,7 milionë eurove të merrte pjesë me vetëm 20%, ndërkaq 80% e tyre do të siguroheshin nga donacionet! Ky vendim ishte marrë nën trysninë e ministres Tërmkolli, ndërsa konsekuencat e këtij vendimi ishin autonomia sa më e vogël në përfshirje dhe cilësi të të dhënave, gjithsesi në dëm të shqiptarëve, sa më shumë diktate nga jashtë dhe së më tepër shpenzime joracionale deri te keqpërdorimet e hapëta

financiare, gjë që edhe ndodhi më vonë. Regjistrimi i popullsisë është komponent shtetëror, prandaj financimi duhet të bëhet nga buxheti i vendit; për një projekt të tillë shumëdomensional nuk janë asgjë 1,2% e mjeteve të buxhetit vjetor të Kosovës apo 0,4% të tyre për vit në tri faza. Tekefundit, donatorët e mundshëm, çfarë janë EUROSTAT-i, Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, Komisioni Ekonomik dhe Divizioni i Statistikave i OKB-së nuk do të derdhin para pa përmbushjen e disa kushteve dhe pa diktate të papërballueshme për ne.

1.1. Ministrja e Shërbimeve Publike - bartëse kryesore e dështimit të regjistrimit

Ndër pengesat më të mëdha tashmë ishte bërë përgjegjësja numër një e tërë projektit të regjistrimit, ministrja e Shërbimeve Publike, e cila njëherit është edhe kryetare e KQR-së, së bashku me këshilltaren e saj Hasnije Ilazi, një kuadër e dështuar në Universitet. Me disa njerëz të tyre, për turizëm dhë përfitim material, pa asnjë njeri të Entit statistikor, shkuan në EUROSTAT në Luksemburg për të raportuar për punën e regjistrimit. E kundërshtova shkuarjen e improvizuar, pa qenë të përgatitur, pa i finalizuar disa çështje shumë delikate rreth koncepcionit të regjistrimit. Megjithatë, vizita u bë dhe grupi i ekspertëve nuk dinte se çka po ndodh. Kur e pyeta ministren pas kthyerjes se me cilin dokument shkuat në Luksemburg, më tha me dokumentin që e hartuam ne dyja, dmth. ministrja dhe këshilltarja e saj! Ekipi punoi 2 muaj të plotë rreth dokumentit të programit të aktiviteteve dhe nuk ishte ende i kënaqur me versionin përfundimtar, ndërsa këto dy zonjat si diletante të materies e kishin "hartuar" për dy ditë, e kishin "përkthyer" anglisht tekstin prej 42 faqesh të dendura dhe ia kishin "prezentuar" EUROSTAT-it! Mirëpo, nga raporti i vetë EUROSTAT-it nga ky takim (1.06.2005) shihej se delegacioni kosovar nuk kishte qenë bindës për ekspertët e atjeshëm se mund të bëhej regjistrimi i përgjithshëm në vitin e ardhshëm (2006).

1.2. Kulmi i papërgjegjësisë me pasoja të rënda dhe politike

Gjithë punën e Grupit të ekspertëve në hartimin e pyetësorëve, që është esenca e regjistrimit, ministrja me këshilltaren e saj e kthyen nga fillimi. Pyetësorin individual (R-1) e lënduan aq shumë sa që Kosovës nuk i duhej më një regjistrim me pyetësor të tillë. *Pyetjen për personat që gjenden jashtë Kosovës në cilësi të ndryshme mbi 12 muaj e kishin hequr krejt! E kishin hequr pyetjen e statusit të qëndrimit jashtë Kosovës dhe pyetjen për shkaqet e braktisjes së Kosovës!* Ne si grup kishin punuar me shumë kujdes

me javë të tëra rreth hartimit të këtyre pyetjeve, me një varg modalitetesh, secila pyetje nga 7-8 modalitete, duke mos iu shmangur rekomandimeve ndërkombëtare, por duke i respektuar edhe specifikat tona. Në një takim me ministren, ia shpreha shqetësimet dhe të gjitha mospajtimet e mija, nga mungesa e kontakteve dhe mënyra e informimit reciprok për organizimin e punës, për ndarjen e saj, për kompetencat dhe përgjegjësitë për çështjet konceptualisht, metodologjikisht dhe profesionalisht shumë të ndërlikuara, me implikime të mëdha politike, kombëtare e shoqërore, e deri te pozita shpërfillëse dhe ofenduese e grupit të ekspertëve (mosrepektimi i mendimit të grupit, anulimi i dokumentit të programit të aktiviteteve, revidimi i pyetësorit individual, kontratat e pabëra me njerëzit për punën e bërë, kushtet joadekuate hapësinore-teknologjike etj.). Kërkova gjithashtu që të mënjanohej këshilltarja e saj nga të gjitha çështjet e regjistrimit, sepse e pengonte punën e Grupit dhe gjithë rrjedhën e operacionit.

Mbetet çështje në vete pse ministrja dhe kryetarja e KQR lejonte involvimin aq të madh të këshilltares së saj në punët e regjistrimit, angazhimi i së cilës çonte në drejtim që Kosova në pikëpamje etnodemografike të sakatosej - të mbetej me më pak se dy milionë banorë gjithsej dhe në këtë kuadër me rreth 70% shqiptarë dhe në Serbi dhe në Mal të Zi të formoheshin qendra speciale të regjistrimit të serbëve, që UNMIK-u do t'i trajtonte si "të zhvendosur", ndërsa shqiptarët në botën e jashtme, pa marrë parasysh statusin e qëndrimit dhe shkaqet e shpërnguljes, të mos i regjistronte si banorë të Kosovës në qoftë se mungonin mbi 12 muaj!

Statistika tashmë një kohë të gjatë ishte bërë dhe çështje politike. Shembull tipik ishte Maqedonia, ku qarqet ndërkombëtare qysh më parë kishin vendosur që përqindja e shqiptarëve në regjistrimin e fundit të mos ishte nën 20%, por as mbi 25%. Mbi këtë bazë u bë edhe Marrëveshja e Ohrit. Për pasojat e zbatimit të një koncepcioni të regjistrimit për shqiptarët dhe të një koncepcioni tjetër për serbët e Kosovës, si dhe për sjelljen e ministres së SHP dhe këshilltares së saj me kohë i kisha informuar edhe udhëheqësit më të lartë të Kosovës, përfshirë kryetarin e atëhershëm të Kosovës, dr. Ibrahim Rugovën,[18] si dhe zëvendësin e KQR dhe zv. Ministrin

[18] Më 24.06.2006 dr. Rugovës ia shkrova këtë letër: "I nderuari z. President, pas bisedës që pata me Ju më 22. 06. 2005, në ora 13, ku Ju informova për problemet dhe pengesat rreth regjistrimit të popullsisë së Kosovës, që parashihet të mbahet më 31 mars 2006, ministrja e Shërbimeve Publike, Melihate Tërmkolli, përmes këshilltares së saj politike Hasnije Ilazi, tashmë më 17 06. 2005 më kishte shkarkuar nga udhëheqësi dhe anëtari i Grupit të ekspertëve pa asnjë arsyetim.
Pengesë ishin sigurisht vërejtjet dhe sugjerimet e mija më 13. 06. 2005 rreth ecurisë së punës dhe veprimit të papërgjegjshëm e abitrar të ministres dhe këshilltares së saj ndaj një problemi kaq të madh jo vetëm statistikor, por edhe shoqëror e politik. Ministrja

e Pushtetit Lokal, z. A. Lila. As Rugova e as Lila nuk ndërmorën asgjë! Ndërkaq, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës akademik Rexhep Ismajli, lidhur me regjistrimin, i shkroi një letër Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dr. Nexhat Dacit.[19] Mjerisht, as Rugova, as Lila dhe

---

vetë më kishte lutur që t'i prija këtij grupi. Këtë detyrë e pranova me shumë frikë dhe përgjegjësi.

Më këtë rast, para se ta sqaroj publikisht tërë çështjen, desha vetëm të Ju informoj për sjelljet kryeneçe të një ministreje vetëm pse i bëhen vërejtje rreth mënyrës së informimit reciprok për organizimin e punës, rreth ndarjes së saj dhe rreth kompetencave për një çështje konceptualisht, metodologjikisht dhe profesionalisht shumë të ndërlikuar. Çdo dështim në këtë drejtim ka pasoja të paparashikueshme për Kosovën dhe ardhmërinë e saj. Me respekt, Hivzi Islami".

[19] Letra iu dërgua më 20 janar 2006 dhe në të thuhej: "I nderuari z. Kryetar, të vetëdijshëm për peshën shoqërore, politike e kombëtare që ka regjistrimi i popullsisë së Kosovës, në ASHAK i kemi ndjekur me vëmendje proceset në këtë fushë veprimi që nga miratimi i Ligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave nga Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2004, te themelimi i Komisionit Qendror të Regjistrimit e deri te veprimtaritë e fundit.

Duke u bazuar në këto vlerësime, i patëm sugjeruar anëtarit tonë, akademik Hivzi Islamit, që të pranonte të merrte pjesë si profesionist në punën e regjistrimit, nëse do të kërkohej nga ai, çka u prit mirë nga përgjegjësit e Qeverisë. Pas angazhimit disamuajsh, akademik Hivzi Islami, për shkak të mospajtimeve për çështje thelbësore, u shtrëngua të tërhiqej nga grupi profesional, në krye të të cilit ishte caktuar.

Duke ndjekur me vëmendje informatat në opinion dhe pas konsultimit me ekspertë, përfshirë akademik Islamin, e ndjejmë nevojën ta shprehim frikën tonë se në zhvillimet e mëtejme mund të dalin shqetësuese disa çështje. Po veçojmë disa nga më të rëndësishmet:

Nga koncepcioni që do të zbatohet në regjistrim, përkatësisht nga përkufizimi i "popullsisë rezidenciale", varet sa banorë do të ketë Kosova dhe shumë elemente të tjera të strukturës së saj. Koncepcioni i pranuar pa shqyrtim paraprak, sipas të cilit personat që në momentin e regjistrimit mungojnë mbi 12 muaj, pa marrë parasysh arsyen e braktisjes së vendit të përhershëm të banimit dhe statusin e qëndrimit në vendin tjetër, nuk do të përfshihen në regjistrim, mund të sjellë shumë pasoja negative për Kosovën.

Regjistrimi i popullsisë është komponentë shtetërore dhe, për të qenë autonom në të gjitha fazat e operacionit, mjetet duhet të jenë vetanake.

- Suksesi i regjistrimit varet drejtpërsëdrejti dhe nga këto rrethana:
  - në regjistrim të përfshihet përnjëherë popullata e të gjitha bashkësive etnike dhe me atë rast të zbatohen kritere unike;
  - qartësimi i specifikave lidhur me koncepcionin që do të zbatohet në përfshirjen e popullatës në regjistrim lidhur me statusin e qëndrimit të banorëve jashtë vendit të lindjes dhe jashtë vendbanimit të përhershëm (të zhvendosur, refugjatë, azilantë apo kategori që kanë ndonjë mbrojtje të përkohshme e të pasigurt në vendet e huaja, që pritet të riatdhesohen);
  - aftësimi optimal i Enti Statistikor të Kosovës në aspektin organizativ e profesional;
  - udhëheqja e punëve profesionale nga grupi i ekspertëve të disiplinave të ndryshme;
  - sigurimi i mjeteve financiare për regjistrim nga buxheti i Kosovës.

as Daci, nuk ndërmorën asgjë! Është për keqardhje edhe indiferenca e institucioneve tjera qeverisëse, e mediave, e shoqërisë civile, etj., që nuk e shtronin këtë problem me përgjegjësi dhe qasje kritike. Vetëkuptohet sjellja e instancave qeveritare, të paafta e të korruptuara deri në skajshmëri, për çka flitet me argumente çdo ditë, ku zëri i Tërmkollit në Qeveri, në saje të mbështetjes së klanit të ish-Presidencës, ka qenë vendimtar në çdo çështje, por të çudisin koketimet apo heshtjet e mediave "të pavarura", "të shoqërisë civile", apo të OJQ-vë, plotësisht të varura nga ndokush dhe gjithsesi profitabile.

2. Dështimi i dy regjistrimeve provuese

Ministrja me këshilltaren e saj do t'i organizojnë pothuajse me dhunë dy regjistrime provuese brenda një viti, të cilat as si praktikë e as si shpenzime financiare nuk mund të ndodhin për një kohë kaq të shkurtër. Regjistrimi i parë provues, i mbajtur nga 31 tetor deri 15 nëntor 2005, ndonëse në tërësi dështoi, kryetarja e Komisionit Qendror të Regjistrimit dhe ministrja e Shërbimeve Publike hiq më larg se të nesërmen, pa pritur asnjë raport nga terreni, pa arritur materiali dhe pa u bërë asnjë analizë nga specialistët përkatës, e pati vlerësuar me notë dhjetëshe (!). Ky regjistrim ishte një aventurë profitable e organizatoreve të projektit, që e dëmtuan buxhetin e Kosovës për rreth 100.000 euro. Mirëpo, pikërisht për shkak të nivelit të ulët profesional dhe organizativ dhe menaxhimit të keq, ekipi i organizatave ndërkombëtare (Eurostati, Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, Komisioni Ekonomik dhe Divizioni për Statistikë i OKB-së etj.), që e kishte vizituar MSHP dhe Entin Statistikor të Kosovës nga 17-20 tetor 2005, nxorri përfundimin se duhet "të mbahet edhe një regjistrim testues në prill të vitit 2006, nëse vlen qëllimi që regjistrimi i përgjithshëm të mbahet në fund të vitit 2006", në të cilin insistonte ministrja. Por për dështimin e regjistrimit të parë provues fajin ua hodhi të tjerëve.

Regjistrimi i dytë provues provues, i mbajtur nga 30 tetori deri më 14 nëntor 2006, pati fatin e njëjtë sikurse edhe i pari. Pos dobisë materiale të

Sipas Ligjit për regjistrimin e popullsisë koha për kryerjen e regjistrimit përcaktohet nga Kuvendi i Kosovës. Nuk na duket e arsyeshme që kjo datë të caktohet pa i shqyrtuar çështjet me ekspertët vendorë dhe me institucionet e specializuara ndërkombëtare.

Zoti Kryetar, i bindur se ky shqetësim yni është dhe Juaji dhe prandaj çështjet e ngritura këtu do ta kenë kujdesin e duhur, ju shpreh konsideratat e mia më të larta. Me respekt, Akademik Rexhep Ismajli".

Këtë letër, kryetari i Akademisë ia dorëzoi edhe pasardhësit të Nexhat Dacit, Kolë Berishës. Por as ky nuk bëri gjë!

ministres dhe klanit të saj, ishte dhe politikisht profitable, sepse operacioni statistikor u përdor dhe për fushatë politike, në favor të një klani mafioz partiak. E keqja tjetër, shumë më e madhe, qëndronte në faktin se organizatorët kryesorë të regjistrimit (ministrja dhe këshilltarja e saj) i kanë shkatërruar të gjitha bërthamat profesionale, organizative dhe menaxhuese të organizimit dhe realizimit të regjistrimit të popullsisë dhe vetë Entin Statistikor, si bartës kryesor profesional të kësaj ndërmarrjeje. I ndoqën të gjithë profesionistët, përfshirë edhe ata që kishin përvojë në punët e statistikës më shumë se tri decenie, dhe sollën diletantë e spekulantë, duke nxitur madje në Ent dhe konflikte të natyrës fizike. Ndonëse vetë theksonte se "Enti i Statistikave të Kosovës është mekanizmi qendror që do të bart të gjitha punët dhe përgjegjësitë për këtë proces", megjithatë, arbitrariteti i kryetares së KQR dhe ministres bëri që askush nga udhëheqësit e Enti Statistikor i Kosovës, të vjetër e të ri, të mos guxonte të prononcohej për asgjë rreth problemeve të statistikës, përfshirë edhe rrjedhën e regjistrimit të popullsisë. Prononcimet i bënin gjithnjë në mënyrë anonime, duke theksuar nivelin shumë të ulët të përgatitjeve dhe mungesën e planit operativ të regjistrimit. ESK për ministren tonë ishte vetëm për të dhënë përgjegjësi, por pa të drejtë që të fliste e të vendoste!

Dy regjistrimet provuese nisën me zallahi, me vetëreklamimet e ministres dhe të këshilltares së saj në mjetet e informimit, e jo me propagandë profesionale, në funksion të detyrave dhe të drejtave të qytetarit. Një ditë pas përfundimit të operacionit, edhe regjistrimin e dytë ministrja e shpalli shumë të suksesshëm dhe paralajmëroi mbajtjen e regjistrimit të përgjithshëm gjatë të vitit 2007! Edhe ky regjistrim provues ishte në dëm të shqiptarëve dhe i kënaqte vetëm ithtarët e multietnicitetit të dhunshëm dhe segmentet e caktuara të UNMIK-ut, të cilëve fare nuk u interesonte dimensioni strukturor i regjistrimit. Por kur regjistrimi i përgjithshëm nuk u mbajtë edhe në vitin 2007, sikundër edhe në vitin 2006, ministrja gjeti si fajtorë bisedimet rreth statusit (kinse dy projekte kaq të mëdha nuk mund të kryhen me sukses në të njëjtën kohë), pastaj instancat financiare, Ligjin për regjistrimin, Kuvendin e Kosovës që nuk e caktonte datën e regjistrimit, Entin Statistikor dhe veçanërisht njerëzit që vetë i kishte ndjekur nga projekti, si dhe "rahovecianët e paaftë", punonjës të Entit!

Regjistrimet provuese nuk do t'i godisnin edhe aq shumë Kosovën dhe shqiptarët sa do të ishte një e keqe e madhe nëse nën drejtimin e përgjegjësve të njëjtë do të mbahej regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë dhe aq më tepër nëse kjo do të ndodhte në procesin e mjegulluar të pozitës statusore politike të Kosovës; që nga fillimi gjithë projekti i regjistrimit ishte futur në agjendën e strukturave korrupcioniste, bartëse dhe të aferave të tjera mafioze. Në emër të regjistrimit, me para të buxhetit të Kosovës, ministrja

me këshilltaren e saj, e shetitën gjithë Evropën dhe Amerikën dhe në këtë mënyrë problemin e regjistrimit e shndërruan në turizëm dhe ahengje!

Pas ardhjes së A. Çekut në krye të Qeverisë në fillim të marsit 2006, ministrja jonë, pas një heshtjeje disamuajshe, u bë tepër agresive në media rreth regjistrimit të popullsisë. Ishte ky një marketing politik i saj vetëm e vetëm që të mbetej në pushtet, ta ruante funksionin e ministres dhe shumë funksione të tjera, nga se Çeku kishte paralajmëruar ndërrime në kabinetin e tij. Dëshironte ta bindte kryeministrin e ri se ajo është duke punuar dhe ka rezultate, përfshirë këtu dhe aktivitetin e saj në përgatitjen e regjistrimit të popullsisë, duke paralajmëruar me shumë pompozitet se regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë do të mbahej me çdo kusht prej 31 mars deri 15 prill 2006, gjë që nuk ndodhi!

3. Kosova - vendi me specifika më të mëdha demografike në Evropë

Kosova nuk ka pasur 25 vjet regjistrim dhe të gjithë qytetarët dëshirojnë ta dinë numrin e përgjithshëm të shqiptarëve në Kosovë dhe statusin e qëndrimit të qytetarëve kosovarë në botën e jashtme. Kosova është vendi me specifika më të mëdha demografike në Evropë, si transicion u fundit demografik i saj. Veçanërisht është specifike sa i përket shkaqeve të braktisjes së popullatës së saj (dhuna policore, ushtarake, politike, ekonomike, racore dhe ndjekja dhe shpërngulja sistematike e shqiptarëve me masa të ndryshme të presionit deri te ndërmarrjet gjenocidale me qëllim të zvogëlimit të numrit të tyre), që në instancë të fundit e detyruan bashkësinë ndërkombëtare të intervenojë edhe ushtarakisht kundër forcave serbe në mars të vitit 1999.

Qarqet e huaja, në emër të disa normave ndërkombëtare, dëshirojnë të imponojnë kritere që janë në kundërshtim me realitetin kosovaro-shqiptar, duke abstraguar faktin se Kosova, përveç se politikisht, edhe në kuptimin statistiko-demografik është rast unik. Një numër shumë i madh i shqiptarëve gjendet në botën e jashtme, mbi 12 muaj, por pa status të rregulluar të qëndrimit, çfarë janë punëtorët sezonalë, të punësuarit në "të zezë", refugjatët, të zhvendosurit, azilantët dhe kategoritë e tjera që kanë ndonjë mbrojtje të përkohshme e të pasigurtë etj., që pritet të riatdhesohen pa dashje. Të dhënat për pjesëtarët e të gjitha këtyre kategorive do të mblidhen gjatë regjistrimeve përmes pyetësorit individual dhe ato do t'i japin familjarët, të afërmit dhe fqinjët e tyre. Një specifikë e veçantë te popullata shqiptare kudo që gjendet është lidhja e fuqishme emocionale e saj për truallin gjeoetnik, për pronën e paluajtshme, për shtëpinë, tokën, farefisin dhe të afërmit. Ata investojnë në vendlindje në ndërtimin e shtëpive, në

bujqësi, në biznese të ndryshme, i ndihmojnë familjarët dhe të afërmit e tyre me të holla dhe në mënyra të tjera. Për këto arsye ekzistojnë dëshira dhe kërkesa të një numri të konsiderueshëm që të kthehen.

Prandaj, Grupi i ekspertëve mendonte se koncepcioni më i pranueshëm është *koncepcioni i popullsisë së përhershme* apo *popullsisë rezidenciale*, që do të thotë se të gjithë banorët e Kosovës që deklarojnë se kanë qëndrim të përhershëm të banimit në Kosovë, ndërsa në momentin e regjistrimit gjenden jashtë Kosovës, në shtetet e tjera dhe kanë status të ndryshëm qëndrimi -, konsiderohen popullsi e përhershme apo rezidenciale në Kosovë. Zbatimi i kriterit të mospërfshirjes nëse mungojnë mbi 12 muaj, çfarë e kërkonin të huajt dhe vetë organizatorët e regjistrimit qysh në gjysmën e vitit 2005, madje pa pasur presion ndërkombëtar, në frymën e konstituimit të një Kosove artificialisht multietnike, pra në dëm të shqiptarëve -, do t'i lente pa u përfshirë në regjistrim qindra mijëra shqiptarë! Nuk mund të eksperimentohet me Kosovën edhe në çështjen e regjistrimit, siç po eksperimentohet në shumë sfera, si p. sh. me shkollimin superior që nga viti 2001 (Universiteti publik)! Vonë e hetoi lojën ministrja jonë, vetëm atëherë kur i dështoi regjistrimi i popullsisë edhe në vitin 2007, pas Planit të M. Ahtisarit, ku kërkohej që regjistrimi i popullsisë të bëhej një vit pas miratimit të tij në KS të OKB-së. Më 10 tetor 2007 ajo deklaroi se "misionet ndërkombëtare zhvillojnë politika të dyfishta kur është rasti në implementimin e standardeve ndërkombëtare", duke "theksuar problemin e regjistrimit të popullsisë, ku, për shqiptarët janë imponuar standardet më të larta ndërkombëtare, ndërkohë që për serbët janë bërë lëshime që mund të jenë të kushtueshmë" ("Zëri", dt. 10 tetor 2007). Megjithatë, doli fat i madh për Kosovën dhe shqiptarët që nuk u mbajt regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë nën udhëheqjen e ministres Tërmkolli, një keqbërëse dhe diletante, e cila nuk mund ta drejtojë me sukses as një zyre të ofiqarisë në fshat.

Është i njohur fakti se në Serbi në regjistrimin e vitit 2002 janë përfshirë edhe serbët e Kosovës, por shifrën nuk e kanë kumtuar, sepse e mbajnë për ta përdorur si shantazh në momentin e duhur. Në bisedimet e Vjenës delegacioni i Serbisë, për formimin e komunave serbe në Kosovë, ka prezantuar versionin e vet të të dhënave, natyrisht të shpifura, por Grupi ynë negociator mjerisht i ka pranuar nga se shifra të veta nuk ka pasur. Serbët do ta refuzojnë çdo regjistrim, por edhe nëse pranojnë të regjistrohen, ata do të regjistrohen sipas dëshirës së tyre, që do të thotë se do të përfshihen në kontingjentin e popullatës së përhershme (rezidenciale) të gjithë serbët që nuk janë në Kosovë qe 7 vjet, por edhe më tepër, ndërsa shqiptarët nuk do të përfshihen në popullatën e gjithmbarshme të përhershme nëse mungojnë mbi 12 muaj! Ekziston plani i UNMIK-ut që të formohen qendra speciale në

Serbi dhe në Mal të Zi, që do ta organizojnë regjistrimin e serbëve të Kosovës atje nëse pajtohet Qeveria e Serbisë dhe atëherë zbatimi i koncepcionit do të jetë i diferencuar: për shqiptarët një, ndërsa për serbët një tjetër! Në qoftë se regjistrimi bëhet me dokumente, siç do të kërkohet me Ligjiin mbi Regjistrimin, e që do të jetë në dëmin e shqiptarëve, atëherë do të regjistrohen qindra mijëra serbë, të cilët në forma të ndryshme kanë qëndruar në Kosovë (ushtarakë, policë, administratorë, gjykatës etj.) dhe posedojnë dokumente identifikimi; dokumente të tilla mund të sigurojnë me bollëk dhe në çdo moment.

Sot jetojmë në Ballkanin e pastabilizuar, ku fakti statistik dhe faktori demografik janë bërë dhe çelës i zgjidhjes së raporteve politike dhe problemeve etnike. Lufta politike po bëhet edhe me shifra. Kosovës nuk mund t'i jepet dhunshëm dimensioni joreal multietnik; ajo ka kompozicionin e tillë etnodemografik ku shqiptarët përbëjnë mbi 90% të popullsisë së përgjithshme. Nuk mund të lejojmë që një gjysëm milioni shqiptarë të Kosovës të mbetet i papërfshirë në regjistrim dhe Kosova të kthehet në 70% të shqiptarëve. Në anën tjetër, një numër i shqiptarëve, për shkak të redistribuimit të madh të popullatës pas luftës dhe mungesës së dokumenteve të identifikimit, edhe brenda Kosovës do të mbetet i papërfshirë në regjistrim.

III. DECENTRALIZIMI AKTUAL SI NDARJE SPECIFIKE TERRITORIALE-POLITIKE E KOSOVËS

Ndarjet e njëpasnjëshme, të imponuara e të dhunshme, të territorit etnogjeografik të shqiptarëve sollën tragjedi të mëdha në rrafshin kombëtar, politik, ekonomik, social, familjar etj. Ndërkaq edhe vetë Kosova, një hapësirë relativisht e vogël (10.887 km²), por si nyje më neuralgjike në Ballkan për një kohë të gjatë, nuk i shpëtoi ndarjeve dhe rikomponimeve të brendshme territoriale të saj.[20] Ndarjet që po ndodhin tash, në emër të një decentralizimi të tipit "evropian", nuk mund të cilësohen ndryshe pos si një copëtim sui generis dhe, më konkretisht, si luftë e Serbisë për territore, në formë të kontrollit shtetëror-etnik të territorit. Zatën, katër luftëra që i zhvilloi Serbia në hapësirat e ish-Jugosllavisë në fund të shekullit XX ishin luftëra për territore, si objektiv i kahmotshëm i politikës serbe për krijimin e Serbisë së Madhe. Për dallim nga këto luftëra të armatosura, Serbia sot në Kosovë luftën agresive për territorializim po e bën me mjete politike dhe diplomatike, duke siguruar një mbështetje të fortë të Rusisë në raportet e krijimit të një "lufte të re të ftoftë" midis saj dhe perëndimit, veçanërisht SHBA-ve.

Në fillim, nga të gjitha instancat ndërkombëtare dhe kosovare, nocioni dhe përmbajtja e decentralizimit dukeshin joshëse, sepse shpjegoheheshin si reformim i pushtetit lokal dhe afrim i shërbimeve pushtetore e shtetërore afër qytetarit. Meqenëse decentralizimi është çështje shumë komplekse, pritej që në vënien në jetë të tij të merreshin parasysh kriteret bazë, reciprokisht të lidhura e të kushtëzuara, para së gjithash kriteri demografik, gjeografik, ekonomik, administrativ, juridik, politik etj. Mirëpo, posa nisi debati rreth tij u pa qartë se decentralizimi nuk u mbështet në këto kritere e as në kriteret e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, sikundër që nuk doli në funksion të qytetarit kosovar, por u reduktua kryekput në funksion të bashkësisë etnike serbe, e cila vazhdon ta injorojë jetën institucionale dhe gjithë realitetin e krijuar në Kosovë pas 12 qershorit 1999. Pa u konsoliduar dhe funksionalizuar (centralizimi) pushteti qendror në

[20] Ndër problemet aktuale të Kosovës, zgjidhjeve ndëretnike dhe rikomponimeve të brendshme të saj deri te ndarjet specifike territoriale-politike të Kosovës, është edhe decentralizimi, i prezantuar në të ashtuquajturin plan të Marti Ahtisarit. Ndonëse në kaptinën e pestë të pjesës së dytë bëhet fjalë për versionet serbe të ndarjes së Kosovës dhe rikomponimin territorial të saj, megjithatë ky tekst është shumë më i plotë dhe pasqyron gjendjen dhe tendencat aktuale të ndarjes së brendshme të Kosovës, të një modeli të copëtimit, të paparë as në rajon e as në Evropë. Prandaj, diku-diku mund të ketë edhe përputhje të teksteve.

gjithë territorin e Kosovës (problemi i Mitrovicës dhe i veriut të Kosovës) nis decentralizimi i tij!

Bashkësia ndërkombëtare, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje politike për Kosovën, para një viti e gjysmë krijoi Grupin Negociator (Grupin e Unitetit!), i cili, siç do të dëshmohet më vonë, u vë plotësisht në funksion të manovrimeve të kësaj bashkësie. Këtë e treguan edhe takimet e Vjenës (nga nëntori 2005 deri në mars 2007), që u zhvilluan pa asnjë transparencë për opinionin kosovar. Në fakt, në Vjenë nuk u negociua, por u bisedua vetëm për privilegjet që do t'i kenë serbët në Kosovë pas përcaktimit të statusit final të Kosovës! E gjithë kjo u shpjegua nga Grupi ynë si çmim që duhet paguar për çfarëdo varianti të pavarësisë së Kosovës.

Në vijim do të përqëndrohemi në katër çështje: 1. në versionet serbe të ndarjes së Kosovës; 2. në modelin e ndarjes së Kosovës sipas ndërkombëtarëve, para planit të Marti Ahtisarit; 3. në skemën e decentralizimit sipas Grupit Negociator të Kosovës; dhe 4. në decentralizimin sipas dokumentit final të Marti Ahtisarit, me një vështrim të posaçëm në vështirësitë e tij, deri te pamundësia e implementimit në praktikë.

1. Versionet serbe të ndarjes së Kosovës

Qarqet e ndryshme serbomëdha, por edhe vetë Serbia zyrtare që nga viti 1945 e deri nën vënien e Kosovës nën protektorat civil dhe ushtarak ndërkombëtar (qershor 1999), kishin pasur disa varianta të zgjidhjes së çështjes së Kosovës, por gjithnjë në dëm të shqiptarëve. Pas Luftës II Botërore nuk bëhet bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, në frymën e Rezolutës së Bujanit (1943-1944), por Kosova (me shumicë dërmuese të popullsisë shqiptare), futet me forcë ushtarake nën Serbi/Jugosllavi si "krahinë autonome", me status konstitucionalo-politik më të ulët se Vojvodina (ku mbi 50% ishin serbë). Me këtë pozitë mbetet deri në Kushtetutën e tretë të Jugosllavisë (1963), kur edhe barazohet me Vojvodinën, ndërkaq territoret e tjera shqiptare nuk iu bashkuan Kosovës, por mbetën në kuadër të tri republikave të tjera (Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi). Përveç mbetjes së Kosovës brenda sistemit juridiko-politik të Serbisë, variantat, me shumë ose me pak përkrahje, varësisht nga evolucioni i pozitës së përgjithshme të Serbisë në ish-Jugosllavi dhe më gjerë, ishin edhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi dhe instalimi i serbëve në Kosovë në vitet e 50-ta të shekullit të kaluar, pastaj rikolonizimi në vitet e 80-ta e të 90-ta, ridefinimi territorial i Kosovës, enklavizimi, ndarja e saj në dy entitete apo edhe ndarja (përkufizimi) midis shqiptarëve dhe serbëve, që e mbështette "babai" i kombit serb dhe inspiruesi i të gjitha tragjedive në ish-

Jugosllavi, Dobrica Qosiqi. Përjashtim këtu bënte pozicioni konstitucional-politik i Kosovës në vitet e 70-ta, kur, sipas Kushtetutës së vitit 1974, Kosova ishte një nga tetë përbërësitë dhe njësitë e ish-Federatës Jugosllave, me të drejtë të vetos në të gjitha organet federative dhe me kufijtë e vet, të cilët nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës. Subjektiviteti politik i Kosovës u rrënua me dhunë, me forca policore dhe ushtarake, në mars të vitit 1989 nga regjimi i Millosheviqit, por me përkrahjen e plotë të të gjitha instancave të atëhershme federative. Bashkësia ndërkombëtare ishte krejtësisht indiferente ndaj kësaj sjelljeje të Serbisë dhe të Jugosllavisë së atëhershme!



1948 *1958*

Ndarja politike-territoriale e Kosovës 1948-1958

Madhësia e territorit të Kosovës prej 10.887 km² dhe kufijtë e sotëm të saj u kornizuan herën e fundit në vitin 1958. Deri në vitin 1954 ajo kishte një territor prej 10.690 km², ndërsa në vitin 1958 sipërfaqja e saj rritet për 197 km² dhe madhësia e sotme territoriale prej 10.887 km² nuk ndryshon. Në vitin 1958, ndërkaq, Serbia, duke ia marrë rrethit të vet të Rashkës 197 km² dhe duke ia bashkuar rrethit të Mitrovicës dhe brenda tij komunës së Leposaviqit, ia "dhuroi" Kosovës këtë sipërfaqe. Në këtë mënyrë numri i vendbanimeve të Kosovës rritet nga 1389 më 1954 në 1438 më 1958. Nuk është këtu fjala për kurrfarë këmbimi territoresh me Preshevën apo Bujanovcin, siç flasin të painformuarit. "Dhurimi" kishte për qëllim që Leposaviqi si komunë të zgjerohej territorialisht dhe në pikëpamje etnodemografike, të rritej numri i serbëve edhe në këtë komunë, edhe në Kosovë; përveç tri fshatrave shqiptare, në këtë komunë të gjitha

vendbanimet e tjera ishin serbe dhe sot e gjithë ditën mbetën serbe. Këto ndryshime territorialo-administrative u përligjën natyrisht edhe me akte adekuate juridike. Deri në fund të shekullit XX skema territorialo-politike e Kosovës pësoi dhe ndryshime të tjera, të gjitha jo në dobi të qytetarëve, veçanërisht të shqiptarëve.

Skema territorialo-politike dhe administrative në 22 komuna ishte stabilizuar për gati dy decenie: nga viti 1962-1985. Tendenca e haptë e një ndarjeje të brendshme të Kosovës, në formë të enklavave etnike në vitet e 80-ta, pas ardhjes së Millosheviqit në pushtet, ishte formimi i komunave të reja. Nga viti 1985 deri në vitin 1991 numri i komunave u rrit nga 22 në 31 sish; në disa prej tyre, sipas regjistrimit të vitit 1991, të bojkotuar nga shqiptarët, dominonte popullsia serbe (Zveçani 79,0%, Shtërpca 66,3%, Zubin Potoku 53,4%), ndërkaq në disa të tjera përbërja e serbëve në popullsinë e përgjithshme sillej midis 20 dhe 30% (Novobërda 31,3%, Fushë-Kosova 25,7%, Obiliqi 19,6%. Gora paraqiste një specifikë, sepse rreth 94% të popullsisë së përgjithshme e përbënin myslimanët (boshnjakët). Opoja (100,0% shqiptarë) kishte mbetur pa status të definuar, pa asnjë organ komunal dhe natyrisht pa buxhet. Leposaviqi si komunë tashmë ekzistonte. Nga komunat e reja, Malisheva (100,0% shqiptarë) ishte komuna e parë e formuar në vitin 1985 dhe ajo shërbeu si pretekst për formimin e komunave të përmendura, ku pushtetin e drejtonin serbët; ajo ishte dhe mbeti komuna më e pazhvilluar. Formimi i tyre nuk ishte bërë për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve dhe për organizimin më të mirë të pushtetit lokal, por për arsye politike, pra për serbët. Ekzistonin edhe projekte të tjera të rikomponimit territorial të Kosovës në kuadër të Planit hapësinor të Serbisë dhe të njësive zgjedhore në Serbi (përfshirja e një pjese të mirë të territorit të Kosovës në njësinë zgjedhore të Leskovcit në fillim të viteve të 90-ta gjithashtu ishte në këtë funksion). Millosheviqi i formoi 8 komuna dhe ai mund të formonte komuna serbe sa të donte, por ai formoi aq sa plotësoheshin kërkesat maksimale të serbëve të Kosovës. Megjithatë, regjimi i Millosheviqit, pasi e rrënoi në tërësi subjektivitetin politik të Kosovës (1989), vazhdonte ta shihte Kosovën vetëm si pjesë integrale të Serbisë, por me numër të reduktuar të shqiptarëve (600.000 deri 800.000) ose madje pa shqiptarë në saje të zbatimit të politikës së spastrimit etnik etj., që doli sheshazi në Rambuje (1999) nga kryetari i atëhershëm i Serbisë M. Millutinoviq.

Në vitet e 90-ta ideja e rikomponimit territorial të Kosovës u aktualizua sërish, së pari në Institutin Gjeografik "J. Cvijiq" të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (1993), dhe në partinë politike "Nova demokratija", si satelite e Partisë Socialiste të Millosheviqit. Për ridefinimin territorial të Kosovës u paraqitën edhe dy projekte të Branisllav Kërstiqit ("Kosova midis të drejtës historike dhe të drejtës etnike", Beograd, 1994,

dhe "Kosova para gjyqit të historisë", Beograd, 2000); Kërstiqi ishte konsulent kryesor dhe nënkryetar i Qendrës Koordinuese të Qeverisë së Serbisë për Kosovën (shefi i Qendrës ishte N. Çoviq) dhe Kishës Ortodokse Serbe, si dhe eksponent i politikës së shkatërrimit të individualitetit të Kosovës dhe të politikës kolonizuese në Kosovë. Shqetësimi i tij kryesor ishte individualiteti juridiko-politik i Kosovës, pastaj shtrirja territorialisht kompakte, numri dhe perspektiva demografike e shqiptarëve dhe brengosja për kinse rrezikimin e prosperitetit demografik, kombëtar e shtetëror të Serbisë dhe të serbëve. Për realizimin e interesit serb dhe vënien e Kosovës nën sovranitet të plotë të Serbisë, sipas tij, duhej amortizuar "albanizimin e Kosovës" dhe duhej "thyer plotësisht" dominimin numerik dhe reproduktiv të shqiptarëve dhe atë përmes rikomponimit territorial të Kosovës, krijimit të autonomisë diferenciale dhe rrjedhimisht ndarjes së Kosovës, ku serbët do t'i sendërtonin "të drejtat e tyre historike" mbi bazë të monumenteve kulturo-historike (kishat dhe manastiret), të cilat, sipas tij, ishin të uzurpuara nga shqiptarët, si dhe rrëmbimin e territoreve të pasura me resurse nëntokësore dhe mbitokësore, ku shqiptarët përbënin shumicën dërmuese. Pas propozimit për ndarjen e Kosovës në dy entitete (2000), Kërstiqi në vitin 2002 harton projektin e tretë për instalimin e serbëve në 24 lokacione. Ndërkaq serbët e Kosovës, të udhëhequr nga qarqet kishtare, kërkonin që të organizoheshin në kantone, që nuk ishte projekt i ri, sepse me të kishte dalë para luftës historiani D. Batakoviq (1998), përfaqësues i kishës ortodokse dhe njeriu i besueshëm i Koshtunicës, ambasador në Londër, pastaj në Athinë, ndërkaq në takimet e Vjenës, gjendej në Delegacionin e Serbisë për çështje të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Në fillim të vitit 2004 Kërstiq del me projektin tjetër për ndarjen e Kosovës në dy entitete sipas modelit të Qipros, ku, sipas tij, që të dy entitetet do të mbeteshin nën protektoratin e OKB-së.

Në fillim të vitit 2004, kryeministri i Serbisë V. Koshtunica kërkoi ndarjen e Kosovës në dy entitete ose kantonizimin e saj, të cilat madje duhet të siguroheshin nga forcat policore-ushtarake serbe. Kantonizimi nënkuptonte edhe ndarje të re të brendshme administrativo-territoriale dhe ndërrimin e kufijve komunalë, përkatësisht atë që delegacioni i Beogradit e arriti në Vjenë në muajtë shkurt-tetor 2006. Në maj të vitit 2004 Qeveria e Serbisë miratoi projektin e ndarjes së Kosovës në pesë kantone: i Anamoravës, i Sharrit, i Qendrës, i Dukagjinit dhe i Veriut. Me këtë projekt, i cili, sipas qarqeve serbe, nënkuptonte për serbët "autonomi brenda autonomisë", Serbia i njoftoi edhe qendrat ndërkombëtare të vendosjes. Projekti mund të realizohej vetëm me spastrime masive etnike të të dy palëve, shqiptarëve dhe serbëve, dhe rrjedhimisht me dhunën dhe tragjedinë e komuniteteve etnike. Ndërkaq, organizatat e paanshme ndërkombëtare,

duke u marrë me versionin e ndarjes së Kosovës, të paraqitura nga Qeveria e V. Koshtunicës, këmbimin e detyrueshëm të bashkësive etnike shqiptare dhe serbe e konsideronin shumë të rrezikshëm dhe si të tillë të papranueshëm. Ato tërhiqnin një paralele midis këtij varianti, nëse pranohej ndërkombëtarisht, dhe Traktatit të Lozanës të vitit 1923, të mbështetur edhe nga fuqitë e mëdha, kur transferi i dhunshëm i popullsisë turke dhe greke u përcoll me dhunë, shkatërrime dhe viktima në njerëz (ESI – European Stability Iniciative, 2004).

Ideja për ndarjen e Kosovës qarkullon më se 40 vjet në përsiatjet e "babait" të kombit serb, D. Qosiqit. Kur u bë kryetar i Jugosllavisë së tretë apo Jugosllavisë së Zhablakut (1992), si zgjidhje definitive të problemit të Kosovës dhe, më konkretisht, të çështjes shqiptaro-serbe, siç thoshte ai, projektin për ndarjen e Kosovës më 5 janar 1993 (60:40% në favor të serbëve) ia paraqiti edhe bashkëkryetarëve të Konferencës së Gjenevës për ish-Jugosllavi, S. Vensit dhe D. Ovenit në selinë e OKB-së në Njujork. Mirëpo, siç shihet nga shënimet e vetë Qosiqit (tetor, 2004), këta dy diplomatë të rangut të lartë, këtë projekt e hodhën poshtë, duke theksuar se me ndarjen e Kosovës bëhet edhe ndarja e Maqedonisë, që nuk e dëshiron as UE e as Amerika. Ndarjen e Kosovës përmes enklavizimit etnik gjatë gjithë viteve të 90-ta e mbështette, madje edhe e nxitte Kisha Ortodokse Serbe.

Në librin e tij të fundit "Kosova", të botuar në Beograd në tetor të vitit 2004, Qosiqi e përsëriti tezën për ndarjen e Kosovës dhe ndarjen ose përkufizimin territorial midis serbëve dhe shqiptarëve, duke theksuar se meqenëse "Serbia nuk ka forcë biologjike që ta ruajë territorin e saj", atëherë Kosova duhet të ndahet. Ndarja e saj dhe përkufizimi territorial midis shqiptarëve dhe serbëve do të bëheshin natyrisht në proporcione hapësinore sipas projeksioneve të Qosiqit, që do të thotë se pjesa që do ta merrnin shqiptarët mund të bashkohet me Shqipëri dhe dy popujt dhe dy shtetet mund të jetojnë njëri skaj tjetrit dhe për këtë qëllim autoritetet e Beogradit duhet të bisedojnë drejpërdrejt me Tiranën zyrtare, duke e kapëcyer Prishtinën. Sipas tij, ndarja dhe përkufizimi i tillë paraqesin "kompromisin midis të drejtës historike dhe të drejtës etnike dhe zgjidhjen racionale të antagonizmave shekullore ndëretnike". "Në Kosovë dhe Metohi, rreth manastireve të mëdha serbe dhe enklavave etnike, duhet formuar shtete të vogla të pavarura sikurse San Marino, Andora, Vatikani, Lihtenshtajni dhe bashkësi të ngjashme shtetërore-juridike e sovrane në Evropë, çfarë është Alandi në Finlandë. Territoret serbe në veri të Kosovës duhet t'i bashkohen Serbisë, të cilat i përkisnin që nga çlirimi nga Turqia deri në vitin 1878, ndërsa territoret jugore të Kosovës dhë një pjesë e Metohisë, ku jeton shumica shqiptare, t'i bashkohen Shqipërisë ose shtetit të

pavarur shqiptar, në qoftë se këtë e dëshirojnë shqiptarët e Kosovës", theksoi ai.

I vetmi shqiptar që angazhohet për ndarjen e Kosovës "në vija etnike" (nëntor 2005), "lëkundjen e kufirit mes Kosovës dhe Serbisë dhe zhvendosjen humane të popullsisë" (janar 2006; nëntor 2006), është Rexhep Qosja. Në këtë pikë Qosja dhe Qosiqi kanë pikëpamje pothuajse të njëjta, ku fare lehtë mund të supozohen pazarllëqet e Qosjes me Qosiqin dhe qarqet e tij në këtë drejtim në vitet e 90-ta të shekullit XX dhe pas çlirimit të Kosovës. Këtë që e daklaron Qosja sot nuk ka dyshim se del si obligim ndaj këtyre pazarllëqeve dhe frika nga zbardhja e takimeve "të fshehëta" me Qosiqin dhe njerëzit e tij për copëtimin e Kosovës. Po çfarë pasoja sjellë ndarja e Kosovës dhe dhurimi i "10% të territorit të Kosovës" dhe "zhvendosja humane e popullsisë" nuk është vështirë të dihet: çka do të ndodhë me rreth 100.000 shqiptarë në një territor prej 1.250 km katrore në tri komunat shqiptare në Luginën e Preshevës? Do të vijnë në Kosovën e stërdendur përmes "zhvendosjes humane", të cilat, deri sot, siç dihet, gjithkund janë përcjell me dhunë, shkatërrime dhe viktima? Vetëm një Kosovë territorialisht një dhe unike, e pavarur, demokratike dhe e zhvilluar mund t'i mban shqiptarët në këto territore dhe ta avancojë pozitën e tyre të përgjithshme. Në fund, shtrohet pyetja: në emër të kujt flet Qosja për dhurimin e 10% të territorit të Kosovës ose 1.100 km katrore? Në emër të popullit?! Po populli, me votën e tij të lirë, që në vitin 2000, në zgjedhjet e para lokale, ia tregoi vendin ku e ka "babai i kombit". Pason domosdoshmërisht dhe pyetja tjetër: kë e përfaqësoi Qosja në Konferencën e Rambujesë në fillim të vitit 1999 dhe në emër të kujt e nënshkroi "Paqjen e përgjakur", siç e quajti vetë? Natyrisht, askend! Nuk mund të mos shtrohet edhe një pyetje tjetër: pse gazetarët dhe analistët tonë heshtin para kësaj qasjeje të Qosjes, më tragjikja në propozimet për zgjidhjen e çështjes së Kosovës? Të tjerët, me qëndrime të tilla, do të linçoheshin nga mediat, analistët politikë dhe vetë politikanët!

2. Modeli i ndarjes së Kosovës sipas ndërkombëtarëve para M. Ahtisarit

Të gjitha instancat relevante ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Këshillin e Sigurimit, sot e kundërshtojnë ndarjen e Kosovës, sikundër që nuk pranojnë që Kosova të kthehet në gjendjen e para vitit 1999 dhe të bashkohet me ndonjë shtet tjetër. Mirëpo, që në ditën e parë të hyrjes së forcave ndërkombëtare më 12 qershor 1999, si misione ushtarake dhe civile, e nxitën ndarjen e Kosovës, nga instalimi i KFOR-it përgjatë lumit Ibër në veri të Kosovës e deri te takimet e Vjenës gjatë vitit 2006. Kryeadministratori i parë i

Kosovës (1999-2001), Bernard Kouchner, në librin e tij, "Les guerriers de la paix, Paris, 2004 ("Luftëtarët e paqes"), shkruan se sot e gjithë ditën mbetet e paqartë pse Mitrovica mbeti e ndarë që nga instalimi i trupave të NATO-s. Në nëntor të vitit 2001 kryeadministratori i dytë, Hans Hakerup, kishte nënshkruar një marrëveshje në Beograd me Qeverinë e Serbisë, që ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244 dhe me Kornizën Kushtetuese të Kosovës; nga marrëveshja kishte dalë një i ashtuquajtur Këshill i Lartë, me shumë ingjerenca. Në emër të nxitjes së serbëve që të dilnin në zgjedhjet e 17 nëntorit 2001, marrëveshja paralajmëronte koncesione të reja politike, ekonomike dhe mbase edhe territoriale, duke i hapur rrugë paralelizmit të pushtetit dhe enklavizimit të Kosovës.

Plani i decentralizimit sipas kryeadministratorit Michael Steiner (2002): 38 njësi komunale për serbët, 5 shqiptarët dhe 2 për sllavo-myslimanët

Në favor të tendencës së legalizimit të enklavave serbe dhe të veprimit të strukturave paralele shkonte edhe projekti i Këshillit të Evropës për reformimin e pushtetit lokal, i përgatitur jo mbi baza të kritereve gjeografike

dhe demografike, por në mbështetje të kriterit etnik. Veprimi i strukturave paralele dhe enklavizimi, të mbështetura nga Beogradi dhe të toleruara nga UNMIK-u dhe instancat e tjera ndërkombëtare, ishin dhe mbetën burim i përhershëm i konflikteve dhe një nga pengesat serioze në implementimin e tetë standardeve të imponuara nga bashkësia ndërkombëtare në nëntor të vitit 2003, të cilat, sipas Morton Abramovichit, ish-udhëheqës i lartë në Qeverinë Amerikane (anëtar i Grupit Ndërkombëtar të Krizave, ICG) dhe pjesëmarrës në Konferencën e Rambujesë (1999), "në këtë botë të sotme vetëm Danimarka dhe Norvegjia mund t'i përmbushin"!

Në tetor të vitit 2002 pasardhësi i Hakerupit, kryeadministratori Michael Steiner kishte përgatitur një projekt të decentralizimit në Kosovë, që përmblidhej në formimin e njësive komunale, të cilat do të kishin këshillat lokale, organet administrative dhe buxhetin, ndërsa çështjet e tjera do të precizoheshin në takimet me Qendrën Koordinuese të Serbisë për Kosovën të N. Çoviqit. Nga harta e prezantuar e Steinerit serbët do të kishin 38 njësi të tilla komunale, shqiptarët 5 dhe sllavo-myslimanët 2. Por ky projekt, për disa arsye, mbeti i parealizuar.

3. Decentralizimi si ndarje e Kosovës sipas Grupit Negociator të Kosovës

Në kuadër kinse të reformimit të pushtetit lokal, nga kosovarët i pari çështjen e decentralizimit e kishte hapur kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, sot ministër i Pushtetit Lokal dhe zëvëndëskryeministër, Lutfi Haziri, gjë të cilën e dëshironin edhe qarqe serbe edhe qarqe të caktuara ndërkombëtare. Ish-kryetari i ndjerë i Kosovës dr. Ibrahim Rugova kishte ndërhyrë, duke kërkuar që decentralizimi të mbetej çështje e brendshme e institucioneve të Kosovës, me ç'rast për një kohë pasoi një heshtje. Megjithatë, më vonë, në bisedat për procesin e decentralizimit u involvua më fuqishëm bashkësia ndërkombëtare dhe vetë Serbia zyrtare. Në bisedimet e Vjenës, që u zhvilluan gjatë vitit 2006, Beogradi kërkonte 17-18 komuna të reja, grupi negociator i Kosovës ofroi 6 komuna ose 5+1 (Graçanica, Novobërda e zgjeruar, Ranillugu, Parteshi, Kllokoti dhe komuna serbe e Mitrovicës veriore, ndërsa bashkësia ndërkombëtare e vështronte me simpati grupin tonë, duke e lavdëruar për konstruktivitet. Koncesionet që u bënë në Vjenë nga ana e ekipit tonë natyrisht se nuk mund më të revidohen, konkretisht të reduktohen. Ky ishte si duket edhe qëllimi kryesor i grupit të Ahtisarit. Ekipi kosovar ofroi më shumë se sa priste edhe bashkësia ndërkombëtare dhe vetë Beogradi. Kërkesat e popullatës shumicë nuk u morën parasysh në Vjenë dhe aq më

pak kërkesat e bashkësive të tjera etnike joserbe, p. sh. të boshnjakëve, si komunitet i dytë për nga vëllimi demografik pas serbëve.

Ekipi Negociator i Kosovës, alias "Elefantët", pothuajse sa herë kthehej nga Vjena jepte deklarata euforike: i mundëm, i nokautuam serbët, rezultati 2 me 0, 8 me 2 në favor të Kosovës e marrëzira të tjera. Në të vërtetë, ky ekip, si "zemërgjerë dhe fleksibil", më tepër ndaj bashkësisë ndërkombëtare, nga takimi në takim, tërhihej, çka shihej nga rritja e numrit të komunave serbe dhe më tepër të vendbanimeve serbe brenda tyre. Kështu, p. sh. në fillim Kllokoti dhe Parteshi nuk figuronin fare si komuna, ndërsa komuna e Graçanicës në versionin e parë kishte 11 (100 km²) dhe në të fundit 16 komuna kadastrale serbe, që përputhet me numrin e vendbanimeve (131 km²). Komuna e Novobërdës, në fillim kishte 16 (130 km²), kurse tash ka 21 vendbanime serbe (196 km²). Komuna e Ranillukut, në versionin e parë kishte më pak, ndërsa tash ka 13 fshatra serbe (69 km²) e kështu me radhë. Edhe komuna kadastrale me 12 banorë serbë (numër ky i deklaruar sipas Delegacionit të Beogradit) ka marrë territor prej 9,14 km², aq sa është mesatarisht madhësia e një komune kadastrale. Koncesioni më i madh u bë lidhur me zonat e veçanta: në fillim serbët kërkuan 40 zona të tilla, ndërsa delegacioni kosovar i refuzoi që të gjitha. Mirëpo, në fund delegacioni i Beogradit kërkoi 42 zona, kurse Grupi ynë pranoi 39 zona të veçanta. Disa objekte në këto zona nuk kanë madje asnjë vlerë kulturo-historike, por janë ngritur për qëllime politike në pjesën e dytë të shekullit XX.

Nga fundi i vitit 2006, kur problemi i decentralizimit nisi të shtrohej seriozisht, së pari u formuan tri "komuna" të reja, dy me shumicë shqiptare (Hani i Elezit dhe Juniku) dhe një me shumicë turke (Mamusha). Këto madje nuk u quajtën as komuna, por pilotnjësi nënkomunale. Sipas një raporti vlerësues të funksionimit të tyre, të bërë nga Ministria e Pushtetit Lokal, OSBE-ja dhe UNMIK-u, edhe në gjysmën e parë të vitit 2007 do të jenë vetëm pilotnjësi nënkomunale, (Koha ditore, 29. 12. 2006), ndërkaq komunat serbe, pa u testuar asnjë instrument i fuksionimit të tyre, u shpallën në Vjenë bashkësi territoriale-politike, me shumë ingjerenca, deri te të drejtat për të bashkëpunuar dhe me shtetet e tjera! Edhe ky fakt flet se komunat e reja joserbe, Mamusha, Juniku dhe Hani i Elezit, janë vetëm një farsë, sikundër ishte rasti me komunën e Malishevës në vitin 1985, formimi i së cilës u shërbeu si pretekst autoriteteve të Serbisë për formimin e 8 komunave serbe, ku ose dominonte popullata serbe, ose përbënte mbi 20% të popullsisë së përgjithshme, por pushtetin lokal e drejtonin serbët.

4. Decentralizimi sipas dokumentit final të M. Ahtisarit

Pas përfundimit të takimeve të Vjenës dhe koncesioneve të mëdha që bëri Delegacioni Kosovar në favor të serbëve, M. Ahtisari prezantoi skemën e tij territoriale-administrative të Kosovës, të përmbledhur në 6 komuna të reja ose 5+1 (aq sa kishte pranuar Delegancioni Kosovar), që do të funksionojnë si mini-shtete specifike. Si mini-shtete serbe do të jenë: komuna e Parteshit, me tri fshatra serbe, të shtrira në 28,7 km² dhe me rreth 5.000 banorë; komuna e Kllokotit, me 4 fshatra, 23,4 km² dhe me rreth 4.500 banorë (në kuadër të kësaj komune në Propozimin Gjithëpërfshirës ishin paraparë edhe katër fshatra tjera: Letnica, Shashari, Vërnezi dhe Vërnakolla, të banuara kryesisht me popullsi të konfesionit katolik, por në Ndryshimet në Propozimin Gjithëpërfshirës u hoqën, sigurisht me insistimin e Ipeshkvisë Katolike); komuna e Ranillugut, me 13 fshatra, të shtrira në 69,28 km² dhe me rreth 4.790 banorë; komuna e Novobërdës, me 24 fshatra, 196 km² dhe afër 7.000 banorë, prej të cilëve 26% janë shqiptarë; Graçanica, me 16 fshtra, 131 km² dhe rreth 18.600 banorë (3,7% shqiptarë). Mini-shtete do të jenë edhe komunat më parë të formuara, në kohën e Millosheviqit (Zubin Potoku, Zveçani, Shtërpca), ndërkaq komuna e Leposaviqit, si e vetmja komunë ku kanë dominuar serbët (me vetëm tri fshatra shqiptare: Ceraja, Koshutova dhe Bistrica e Shalës), me këtë madhësi territoriale është formuar në vitin 1958. Veriu i Kosovës dhe Mitrovica dhe komunat e saj, serbe dhe shqiptare, të propozuara nga ekipi ynë dhe të aprovuara në versionin final të M. Ahtisarit, mbesin çështje në vete. Komunat serbe Mitrovica e V., Graçanica dhe Shtërpca do të marrin dhe kompetenca të zgjeruara (Aneksi III, neni 4 dhe alinetë 4.1.1. dhe 4.2.2).



Ranillugu, një nga komunat e reja serbe, me 13 fshatra, të shtrira në 69,28 km² dhe me rreth 4.790 banorë

Paketa e Ahtisarit nuk duket kurajuese për Kosovën dhe shqiptarët, sepse nga gjithsej 4 temat e paketës, në të gjitha bëhet fjalë vetëm për serbët dhe privilegjet e tyre në Kosovë (decentralizimi; trashëgimia kulturore: kishat dhe manastiret; minoritetet dhe ekonomia: çështja e pronave të serbëve të Kosovës dhe bashkëpunimi i tyre në fushën ekonomike me Serbinë).

Modeli i rikomponimit të tashëm territorial të Kosovës, që po quhet decentralizim, duket se është afër modelit të Qosiqit, versionit të tij të fundit, të vitit 2004 dhe nuk ka asnjë lidhje me dimensionin funksional të njësive territorialo-politike dhe nuk është në funksion të përmirësimit të pozitës politike, kulturore dhe ekonomike të serbëve të Kosovës, por është luftë për territore me mjete politiko-diplomatike. Qosiqi, sic u theksua, propozonte formimin e mini-shteteve serbe brenda Kosovës, sikurse janë San Marino, Lihtenshtajni, Andora, Vatikani etj, për të cilat janë interesante disa të dhëna: San Marino, republika më e vogël në botë (nën mbrojtje të Italisë), me 61 km² dhe 28.117 banorë (2005); Lihtenshtajni (Liechteinstein), një principatë e vogël, në Evropën e Mesme, midis Zvicrës dhe Austrisë, me një sipërfaqe prej 157 km² dhe me 33.987 banorë (2006); Andora (Andorra), republikë me 6 vendbanime, midis Spanjës dhe Francës, me një sipërfaqe prej 453 km² dhe me 67.313 banorë (2006); Vatikani (Città del Vaticano), për të cilin di pothuajse çdo qytetar në botë, ka një sipërfaqe prej 0,44 km² (44 ha) dhe 783 banorë (2005). Shumë më të komplikuara dalin mini-shtetet serbe, komunat dhe hapësirat rreth kishave dhe manastireve, me territore të zgjeruara apo eksterritore, në dëm të tokave të pronarëve shqiptarë. Këto do të jenë madje zona të mbrojtura, me një sistem të posaçëm sigurie (policia vendore dhe ushtarët e EUFOR-it, ndoshta plus rusët)!

5. Vështirësitë e implementimit të planit të M. Ahtisarit

Injorimi i kritereve bazë, që pasqyrojnë realitetin kompleks sociogjeografik, ka bërë që numri i banorëve në komunat e reja serbe të jetë tepër i vogël, struktura ekonomike e njëanshme, përbërja kombëtare homogjene (serbët) dhe forma e tyre gjeometrikisht tepër e parregullt, që vështirëson ngritjen e sistemeve infrastrukturore e të tjera. Komuna e Graçanicës do të ketë një shtrirje deri 20 km gjatësi, që do të thotë se qytetari është shumë larg përmbushjes së nevojave të tij! Qytetari serb i Dobratinit apo i Suvi Dollit, vendbanime këto që tashmë janë pjesë e Lipjanit, për një shërbim civil duhet të udhëtojë së paku 20 km deri në Graçanicë, ose qytetari serb i Koretishtës, që është territorialisht pjesë e Gjilanit nevojat civile duhet t'i përmbush në Novobërdë (Artanë)!

Komunat e reja serbe, sikundër edhe komunat më parë të formuara me shumicë serbe, do të kenë lidhje horizontale mes vete, por e keqja më e madhe është se ato do të kenë edhe lidhje vertikale me Beogradin, që nënkupton se pushteti qendror i Serbisë do t'i dirigjojë strukturat pushtetore serbe dhe do t'i instrumentalizojë edhe më tepër se deri tash serbët e Kosovës. Qysh në gjysmën e dhjetorit 2006, para shpalljes së paketës së Ahtisarit, njeriu më përgjegjës i Evropës në Kosovë, përfaqësues i H. Solanës dhe drejtues i Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) dhe kyesues i ekipit planifikues të misionit të ardhshëm ndërkombëtar në Kosovë, Trobjorn Solstrom, u garantoi serbëve se "decentralizimi do t'u mondësojë komunave serbe të kenë lidhje me njëra tjetrën dhe me autoritetet e Beogradit" (sipas agjencisë serbe të lajmeve "Beta", 12. 12. 2006; "Exspress", 13 dhjetor 2006).

Kjo pa dyshim do të prodhojë jostabilitet dhe tensione e konflikte të reja midis serbëve dhe shqiptarëve. Raportet ndëretnike do t'i vështirësojë edhe më tepër territorializimi i objekteve ortodokse serbe, i kishave dhe i manastrireve, që gjenden në vendbanimet dhe rajonet shqiptare, të cilëve do t'u vihet në dispozicion një sistem i tërë për mbrojtjen e tyre dhe të territorit të tyre; sistemi i mbrojtjes nënkupton aparatin policor e ndoshta edhe ushtarak. Serbia kërkoi 42 zona mbrojtëse, me nga 5.500 ha secila, madje si kërkesë "e zbritur"! Uzurpimi i tokës së pronarëve shqiptarë (rreth 800 ha) rreth Manastirit të Deçanit dhe protestat e qytetarëve të atjeshëm ishin tashmë shenjë se qetësia atje është tepër e brishtë. Vetëm tash jemi të vetëdijshëm se sa dëme na kanë sjellë ngjarjet e 17 dhe 18 marsit 2004, nxitja e të cilave mbeti enigmë edhe sot e gjithë ditën!

Cila do të jetë qëndrueshmëria ekonomike-financiare e komunave serbe, kryesisht rurale, është një çështje në vete? Kush do t'i financojë dhe si do të mbushet buxheti i këtyre komunave, gjithashtu mbetet problem në vete? Kështu si janë dizajnua komunat e reja serbe një pjesë të mjeteve do t'ua sigurojë Serbia, siç e parasheh edhe plani i Ahtisarit, ndërsa pjesa tjetër do të vijë nga buxheti i Kosovës, pra nga shqiptarët; serbët deri më tash nuk kanë paguar taksa për asgjë, madje as rrymë, as ujë etj.

Komunat serbe sigurisht do të kenë gjyqet dhe policinë e tyre. Drejtuesit e tyre do t'i caktojë Beogradi, sigurisht në marrëveshje me Kishën Ortodokse Serbe. A mund t'u besohet planeve se ministri përkatës i Qeverisë së Kosovës do t'i emërojë gjykatësit dhe drejtuesit e policise së komunave serbe?

Gjatë diskutimit për problemin e decentralizimit ekipi ynë në Vjenë nuk e shtroi një çështje esenciale: pozitën e shqiptarëve në Luginën e Preshevës, nëse jo për zgjidhjen e problemeve të tyre, bile për t'i shfrytëzuar si argument për t'i relativizuar dhe amortizuar kërkesat e autoriteteve të Beogradit për privilegjet e serbëve në Kosovë. Për rreth 100.000 shqiptarë,

të shtrirë në tri komuna (Presheva, Bujanoci dhe Medvegja) dhe 65 fshatra brenda tyre, në një sipërfaqe prej 1.250 km², nuk po kujdeset askush, as Kosova, as Shqipëria e as bashkësia ndërkombëtare. Më të sakrifikuarit janë bërë shqiptarët e Luginës: pa lidhje komunikimi madje as në rrafshin kulturor me Kosovën. Janë pamundësuar rrethanat që t'i realizojnë të drejtat e tyre kombëtare, shoqërore, politike-shtetformuese dhe ekonomike brenda Serbisë. Nuk mund t'i zgjidhin as problemet elementare jetësore, sepse, përveç tjerash, kufijtë janë bërë pengesë: duke qenë nën juridiksionin e Serbisë, kufijtë e kontrolluar me Maqedoninë, me Bullgarinë (përmes Serbisë) dhe me Kosovën po e pengojnë seriozisht funksionimin e jetës ekonomike. Ka mbetur pa u kthyer një numër i madh i shqiptarëve në shtëpitë e tyre pas konfliktit të armatosur në vitin 2000; vendbanimet e komunës së Medvegjës dhe të pjesës së Karadakut të Preshevës dhe Bujanocit gati janë braktisur nga shqiptarët, duke i lënë pronat e tyre të paluajtshme. Në anën tjetër, presioni ushtarako-policor është rritur: pas ndjekjes së forcave ushtarake serbe nga Kosova, koncentrimi i tyre është bërë pikërisht në territorin e Luginës së Preshevës.

Insistimi që të vihej një shenjë barazimi midis pozitës së serbëve të Kosovës dhe pozitës së shqiptarëve të Luginës së Preshevës është kërkesa më normale për të gjithë ata që nuk duan të bëjnë diskriminime midis popullatave. Për më tepër, atje ka rrethana për organizimin normal të jetës në disa vendbanime. Pse p. sh. Tërnoci, si fshat më i madh në Serbi, të mos bëhej komunë në vete, ose Rahovica, Miratoci etj. Por kjo do të duhej të shtrohej në Vjenë. Problemi shqiptar në Luginë është aq kompleks sa del mashtruese dhe e dëmshme avokatia mediale e një "elefanti" nga Ekipi Negociator (Veton Surroi), çfarë bëhej gjatë takimeve të Vjenës dhe më vonë. Për avancimin e pozitës së gjithmbarshme të shqiptarëve të Luginës së Preshevës produktive janë vetëm angazhimet konkrete të Kosovës, të Shqipërisë dhe të faktorit ndërkombëtar, por në instancat relevante vendimarrëse.

Delegacioni Kosovar nuk e shtroi as ceshtjen e decentralizimit, që ka mbështetje në argumentin e funksionalitetit dhe në përmbushjen e nevojave të qytetarëve? Në kuadër të decentralizimit athua nuk është e arsyeshme dhe e domosdoshme që të mendohet për ndarjen e Prishtinës dhe të qendrave të mëdha urbane në disa komuna. Nuk do mend se qytetari i Prishtinës, më këtë presion të madh që ushtron përditshmëria e qytetit, sillet vërdallë me ditë e me javë për të marrë një dokument themelor, letërnjoftimin, pasaportën apo ndonjë çertifikatë tjetër. Në anën tjetër, në rrethanat e një kaosi urbano-hapësinor dhe të mungesës së kulturës urbane, çfarë i karakterizon metropolin tonë dhe 6 mezoqendrat, ndarja administrativo-territoriale e këtyre qendrave mundëson një zhvillim të harmonizuar territorialo-urban, zgjidhjen më lehtë

të një varg problemeve socioekonomike, kulturore e infrastrukturore, pengimin e ndërtimit "të egër", të "terrorit urban" etj. Nuk ka shenja që kjo çështje të shtrohej në institucionet e Kosovës, pa u pyetur instancat ndërkombëtare dhe Beogradi zyrtar.

6. Përdorimi i kadastrës si mjet për grabitjen e territorit dhe manipulimet e Beogradit me të dhëna etnodemografike

Edhe pse në rastin e Kosovës dhe të bisedave rreth decentralizimit, angazhimet politike të Serbisë zhvillohen për territore, megjithatë, lufta politike sot po bëhet edhe me shifra. Në hapësirat ballkanike fakti statistiko-demografik është bërë dhe indikator shumë i rëndësishëm në përcaktimin e statusit konstitucional-politik dhe të zgjidhjes së raporteve politike dhe etnike. Prandaj këtu, në këtë segment demografiko-shoqëror bëhën edhe shumë spekulime, ku shquhet pushteti serb dhe institucionet e tij. Në konstituimin e njësive politiko-territoriale e administrative, të vogla apo të mëdha, nuk ka dyshim se një nga kriteret themelore është numri i popullsisë. Nga u nxor në Vjenë numri i popullsisë në vendbanimet e komunave të reja serbe, kur në Kosovë nga vitit 1981 nuk ka pasur regjistrim të popullsisë. Enti Statistikor i Kosovës, në mungesë të regjistrimit, nuk ka dhe natyrisht nuk mund të ketë asnjë të dhënë për indikatorët bazë demografikë, çfarë p. sh. është numri i përgjithshëm i popullsisë. Institucionet e tjera jo se jo. Mbetet të besohet se të dhënat që janë përdorur në takimet shqiptaro-serbe në Vjenë janë të grupit të Beogradit. Për opinionin kosovar, numri i banorëve të bashkësive të reja politiko-territoriale serbe, zonat e mbrojtura dhe shumëçka, mbeti fshehtësi!

Si i siguroi Serbia të dhënat e numrit të serbëve për komunat e reja? Regjistrim të popullatës serbe në Kosovë nuk ka pasur që nga viti 1991, por as ndonjë hulumtim apo vlerësim shkencor. Ndërsa në regjistrimin e popullsisë të vitit 2002 në Serbi, me sa dihet, janë përshirë vetëm serbët e Kosovës të ngulitur gjithandej në Serbi, por edhe këtë numër autoritetet zyrtare serbe nuk e kanë bërë të ditur, duke e ruajtur si shantazh për përdorim politik. Ndërkaq, shifrat që u prezantuan në Vjenë për vendbanimet e komunave të reja nuk janë as të rrumbullaksuara, siç veprohet në analizat statistiko-demografike dhe më shumë në shqyrtimet politike, kur nuk ka të dhëna të sakëta (regjistrimet, anketimet etj.), por ato u dhanë si të dilnin nga ndonjë regjistrim special i popullsisë (të dhënat jepen në njëshe, dhjetëshe, qindshe). Në qoftë se Serbia zyrtare ka bërë fshehtaz ndonjë regjistrim në vendbanimet dhe enklavat serbe në Kosovë në këtë vit apo vitin e kaluar, këtë duhet ta dinë pushtetet tona lokale dhe qendrore.

Diçka të tillë nga institucionet tona nuk kemi dëgjuar. Ndoshta në Vjenë Delegacioni i Beogradit ka treguar burimin nga i ka siguruar të dhënat.

Manipulimet e Delegacionit të Beogradit në Vjenë janë pa dyshim pjesë e fushatës për rritjen e numrit të serbëve në Kosovë për qëllime politike: grabitja sa më e madhe e territorit. Në aktakuzën e Prokurorisë së Tribunalit të Hagës (pika 30 e aktakuzës "Paraqitja e fakteve"), të ngritur kundër Ramush Haradinajt, na kujtohen manipulimet flagrante sa u përket shifrave dhe raporteve të popullatës sipas përbërjes etnike për vitin 1998 në komunat (Burimi, Deçani, Gjakova, Klina dhe Peja) ku ka vepruar ai (ZOD). Shifrat nuk jepeshin të rrumbullaksuara, por spekulohej sikurse tash në Vjenë. Qëllimi ishte që të jepej sa më i madh numri i serbëve dhe joshqiptarëve, kinse të ndjekur nga vendet e tyre dhe për këtë të ngarkohej Haradinaj. Më 15 mars 2005 me fakte kishim bërë një denoncim publik të këtyre spekulimeve, të cilat ia dërguam po atë ditë dhe Tribunalit të Hagës.

Meqenëse bëhet fjalë për luftën për territore, serbët si njësi për strukturën e popullimit në bisedime i përdori komunat kadastrale e jo vendbanimet (Kosova ka 1.300 komuna kadastrale dhe 1.445 vendbanime), ndonëse numri i komunave kadastrale në komunat e reja përputhet me numrin e vendbanimeve, përveç në një rast (në komunën e Novobërdës, në komunën kadastrale të Koretishtës përfshihet edhe një fshat); na kujtohet insistimi i Karaxhiqit që si bazë për ndarjen e Bosnjes të merrej kadastri. Si duket, Grupi ynë le që nuk e ka kuptuar përdorimin e komunave kadastrale nga ana e Beogradit, por, siç po shihet qartë, nuk ka pasur as të dhëna të veta. Në një vizitë që i bëri nga fundi i majit 2006 (atëherë thuhej se përfunduan bisedimet për decentralizimin) Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës kryetari i Delegacionit të Kosovës në bisedimet në Vjenë, Lutfi Haziri, për t'i shpjeguar anëtarëve të saj rrjedhën e këtyre bisedimeve, në pyetjen se nga i ka Delegacioni ynë të dhënat për numrin e banorëve për komunat e reja serbe, së pari tha nga Enti Statistikor i Kosovës, që menjëherë mori përgjigjen negative, pastaj tha nga UNHCR-i, që prapë nuk doli e saktë, dhe herën e tretë iu referua Kryqit të Kuq, ku doli edhe më qesharak. Të gjithë e kuptuan se Delegacioni ynë nuk posedonte asnjë të dhënë!

Shumë komuna kadastrale-vendbanime rurale, të banuara me serbë, në komunat e reja në periudhën midis regjistrimeve 1981-1991 kanë shënuar rënie të numrit të popullsisë apo kanë patur stagnim. Duke iu referuar të dhënave të statistikës vitalo-demografike (N, M dhe SHN) të institucioneve statistikore të Serbisë për vitet e 90-ta të shekullit XX vërehet tendenca e zvogëlimit të numrit të lindjeve dhe e rritjes së numrit të vdekjeve të popullatës serbe në Kosovë, prandaj rezultati është zvogëlimi i vazhdueshëm i shtimit natyror. Në anën tjetër, procesi i shpërnguljes së serbëve nga Kosova

vazhdonte edhe në këto vite, përkundër pushtetit të fuqishëm që kishte vënë Serbia në Kosovë. Në situatën e tendosur politike dhe armiqësisë së futur midis shqiptarëve dhe serbëve dhe instrumentalizimin e serbëve të Kosovës për qëllime politike nga pushteti qendror i Serbisë, serbët e Kosovës në rastin e parë të volitshëm e braktisnin Kosovën. Ndërkaq na është e njohur situata pas hyrjes së forcave ndërkombëtare në vitin 1999: emigrimi i vazhdueshëm. Por edhe po t'i marrim si popullatë rezidenciale (de iure), numri i serbëve nga lëvizja negative natyrore ka treguar gjithnjë tendencën e rënies. Në komunën e Graçanicës, nga 12 vendbanime serbe dhe bashkësive të jera joshqiptare, në versionin e takimeve në Vjenë në 8 sish, madje relativisht të mëdha del rritja e numrit të popullsisë (Graçanica, Çagllavica, Llapnasella, Uglari, dy Gushtericat, Livagja e Shullanova). Në komunën e Kllokotit, sipas këtij versioni në të gjitha vendbanimet (4) popullsia ka bilanc pozitiv (Kllokoti, Mogilla, Vërbovci dhe Gërnçari), ndërsa në periudhën 1981-1991 tri fshatra kishin shtim negativ dhe e katërta shënoi stagnim. Vendbanimet Partesh, Budrigë e P. dhe Pasjan në komunën e re të Parteshit, në periudhën 1981-1991 kishin një rritje fare të vogël të numrit të popullsisë, ndërsa sipas versionit të Vjenës një rritje mjaft të lartë. Nga 12 vendbanime rurale në komunën e re të Ranillukut (100% serbë) dy referohet të kishin rritje të numrit të popullsisë dhe tri stagnim, ndërsa të tjerat rënie, ndërkaq në periudhën 1981-1991 8 prej tyre kishin shënuar rënie dhe dy stagnim. Sipas kësaj tendence, të gjitha vendbanimet e kësaj komune, në mbështetje të dinamikës së shtimit natyror, do të duhej të kishin zvogëlim të ndjeshëm të numrit të popullsisë.

Komuna e Novobërdës (e zgjeruar) paraqet një situatë në vete etniko-demografike, por dallohet edhe në pikëpamje gjeografike, infrastrukturore, zhvillimore etj. Në kohën e regjimit të Millosheviqit ishte komunë me vetëm 10 vendbanime, ndërsa në versionin final të negociatave për decentralizim u zgjerua në 23 komuna kadastrale ose në 24 vendbanime, ku serbët përbëjnë ¾ e popullsisë, ndërsa shqiptarët rreth ¼. Të gjitha fshatrat, veçanërisht ato serbe kanë një strukturë të imët të popullimit: një fshat serb në këtë komunë referohet në Vjenë të ketë vetëm 12 banorë (Mozgova) dhe 6 fshatra midis 25 dhe 80 banorë (Draganca, Miganovci, Tirinca, Bolevci, Turiçevci dhe Manishinca). Në periudhën midis regjistrimeve zyrtare 1981-1991, 11 vendbanime serbe kishin rënie të numrit të popullsisë (Turiçeci, Makreshi E., Makreshi P., Mozgova, Strazha, Carevci, Bolevci, Manishinca, Tirinca, Parallova dhe Miganovci), kurse tri fshatra kishin gjendje pothuajse stagnante demografike (Kufca E., Koretishta, Draganca).

Në vendbanimet serbe të të gjitha komunave të reja, por edhe të komunave ekzistuese serbe (Leposaviqi, Zubin Potoku, Zveçani, Shtërpca) procesi i moshënimit demografik ka hyrë në një fazë të thellë, ndërsa fshatrat me numër të vogël të banorëve gjenden në prag të shuarjes së jetës. Mirëpo,

meqë në angazhimin serb është fjala për luftë për territore e jo lufta qytetari afër pushtetit dhe meqenëse çdo komunë kadastrale mesatarisht ka 9,14 km² dhe çdo vendbanim 8,22 km², Serbia lufton për hapësira e jo për përmirësimin e jetës së srbëve të Kosovës. Edhe vendbanimi me 12 banorë (rasti i Mozgovës) ka territorin e vet kadastral prej më se 9 km² ; për Beogradin edhe vendbanimi pa serbë sot, por që kanë jetuar dikur, e ka territorin me këtë siparfaqe. Prandaj, përdorimi i komunave kadastrale është në funksion të një politike mirë të konceptuar e të paramenduar të Beogradit për grabitjen e territorit.

Në fund, mund të konludohet se decentralizimi, i cili nisi si reformim i pushtetit lokal dhe si afrim i shërbimeve afër qytetarit, perfundoi me një ndarje sui generis të Kosovës. Decentralizimi i karakterit shtetëror-etnik të territorit, do të jetë një paralizim i plotë i jetës funksionale dhe institucionale të Kosovës dhe i gjithë sistemit ekonomik, i përcjellë më vështirësi të pabërballueshme, në radhë të parë për shqiptarët. Pushteti asimetrik i komunave, nënkupton fuqi shumë më të madhe pushtetore të komunave serbe, brenda të cilave do të mbetej edhe një numër i shqiptarëve dhe në këtë mënyrë ata do të bëhen minoritet brenda minoritetit. Kufijtë e komunave serbe janë bërë tashmë pjesë e dokumenteve ndërkombëtare dhe nuk mund të ndryshohen pa pëlqimin e instancave përkatëse ndërkombëtare. Ndonëse serbët e arritën qëllimin e plotë, i grupuan të gjitha fshatrat dhe mahallët e tyre në komuna të reja e të vjetra serbe, megjithatë autoritetet e Beogradit, që negociuan në emër të serbëve të Kosovës, mbetën të pakënaqur, sepse nuk u interesojnë privilegjet e serbëve të Kosovës, që nuk i ka asnjë minoritet tjetër në Evropë, por sovraniteti i Beogradit mbi Kosovën, të cilin e kishte fituar me dhunë ushtarake që nga pushtimi i saj në vitin 1912.

Me pasojat e modelit të decentralizimit, të bërë tashmë transparent nga Marti Ahtisari, Kosova dhe shqiptarët do të përballen pas zgjidhjes së statusit çfarëdo që të jetë ai dhe atë në kontekst afatgjatë kohor, para së gjithash me pengesat në funksionimin praktik të jetës politike, shoqërore dhe ekonomike. Shqetësimet dhe tensionet mund të rriten edhe më tepër nga përkeqësimi i situatës edhe ashtu të rëndë ekonomike (norma e lartë e papunësisë, mungesa e investimeve në degët propulsive, zvarritja e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe transformimi i ndërmarrjeve publike dhe përgjithësisht ngecja e reformave strukturore në ekonomi etj.), izolimi i kosovarëve nga bota për shkak të ashpërsimit të regjimit të vizave dhe mungesës së dokumentave të udhëtimit etj.

Ndërkaq, të gjitha parashikimet janë që pas deklarimit të statusit final në formë të pavarësisë së mbikqyrur nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, serbët sigurisht do ta shpallin entitetin e tyre në formë të Asociacionit apo Bashkësisë së Komunave Serbe, të lidhura vertikalisht me pushtetin qendror të Beogradit,

i cili dhe do ta kontrollojë të paktën rreth 1/5 e territorit të Kosovës, pa llogaritur sipërfaqen e zonave mbrojtëse rreth kishave dhe manastireve, që shtrihen në komunat e banuara me shumicë shqiptare. Në anën tjetër, pas tërheqjes së UNMIK-ut, do të instalohet një forcë evropiane dhe ndërkombëtare e qeverisjes (civile dhe e sigurisë), dhe Kosova, pothuajse sikurse deri tash, do të vazhdojë me një qeverisje tri rrafshesh: e Kosovës, e Serbisë dhe ajo ndërkombëtare! E vogël është Kosova për t'u qeverisur nga disa pushtete, por edhe më e vogël për t'u copëtuar aq shumë!

Pjesa e dhjetë

SHTOJCA GRAFIKE

Figura 1. Lëvizja e popullsisë së botës prej revolucionit industrial deri në vitin 2007, sipas burimeve të ndryshme dhe vlerësimeve të përgjithshme



Figura 2. Indeksi i rritjes së popullsisë së botës prej revolucionit industrial deri në vitin 2007, sipas burimeve të ndryshme dhe vlerësimeve të përgjithshme (1800=100)



Figura 3. Lëvizja e popullsisë së botës, 1800-2000 (në promilë)



Figura 4. Vlerësimet dhe projeksionet e popullsisë së botës dhe rajoneve të saj prej 1650 – 2150 sipas variantit të mesëm (në miliona)



Figura 5. Lëvizja natyrore e popullsisë së disa vendeve të zhvilluara të Evropës prej 1751-2003






Suedia
promilë
40
35
30
25
20
15
10
5
0
-5
1751-1755
1801-1805
1851-1855
1905-1909
1935-1939
1950-1954
1985-1990
1995-1999
2000-2003
nataliteti
mortaliteti
shtimi natyror


Sllovenia
promilë
40
35
30
25
20
15
10
5
0
-5
-10
1751-1755
1801-1805
1851-1855
1905-1909
1935-1939
1950-1954
1985-1990
1995-1999
2000-2003
nataliteti
mortaliteti
shtimi natyror

Figura 6. Lëvizja natyrore e popullsisë urbane dhe rurale në disa vende evropiane në vitet e 80-ta të shekullit XX





N=nataliteti; M=mortaliteti; SHN=shtimi natyror

Figura 7. Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës prej 1911-1940 sipas periudhave pesëvjeçare (në promilë)



Figura 8. Lëvizja e natalitetit në Kosovë prej 1911-2006



Figura 9. Normat e fertilitetit të përgjithshëm në Kosovë në periudhën 1950-2000



Figura 10. Norma neto e riprodhimit të popullsisë femërore në Kosovë, në Serbi dhe në Vojvodinë në periudhën 1950-2000



Figura 11. Të lindurit e gjallë sipas radhës së lindjes në Kosovë në vitet 1958, 1990, 1995, 2004 (në %)



Figura 12. Të lindurit gjallë (6 e më tepër fëmijë) sipas përkatësisë kombëtare të nënës dhe radhës së lindjes në Kosovë në vitet 1881, 1990, 1995 dhe 2004




1990
35
30
25
20
15
10
5
0
përqind
Shq.
Serbe
Mus.
Mala.
Rome
Kroate
Turke


1995
35
30
25
20
15
10
5
0
përqind
Shqiprate
Serbe
Malazeze
Boshnjake
Rome
Turke


2004
35
30
25
20
15
10
5
0
përqind
Shqiprate
Serbe
Boshnjake
Rome
Turke

Figura 13. Përqindja e njohurisë mbi kontraceptivët sipas llojeve në Kosovë, UNFPA, 2003



Figura 14. Përqindja e metodave më të përdorura kontraceptive në Kosovë, UNFPA, 2003



Figura 15. Niveli dhe lëvizja e natalitetit dhe e shtimit natyror te popullsia shqiptare, serbe dhe malazeze në Kosovë prej 1950-1990 (në promilë)





Figura 16. Lëvizja e shtimit natyror në Kosovë prej 1911-2006



Figura 17. Lëvizja e natalitetit dhe e shtimit natyror të popullsisë së Kosovës prej 1950-2005



Figura 18. Lëvizja e mortalitetit të përgjithshëm në Kosovë prej 1911-2006



Figura 19. Lëvizja e mortalitetit të foshnjave në Kosovë prej 1947-2006



Figura 20. Lëvizja e natalitetit dhe shtimit natyror në Shqipëri në periudhën 1950-2004



Figura 21. Lëvizja e mortalitetit në Shqipëri në periudhën 1939-2004



Figura 22. Rritja e popullsisë së Kosovës 1948-2005



Figura 23. Indeksi i rritjes së popullsisë së Kosovës 1948-2005 (1948=100)



Figura 24. Rritja e numrit të popullsisë në vendbanimet urbane të Kosovës 1948-1991



Figura 25. Mosha mesatare e popullsisë në Serbi, në Vojvodinë dhe në Kosovë në periudhën 1948-1996



Figura 26. Indeksi i moshënimit të popullsisë në Serbi, në Vojvodinë dhe në Kosovë në periudhën 1948-1996



Figura 27. Popullsia analfabete te shqiptarët dhe te disa bashkësi të tjera kombëtare në ish-Jugosllavi 1948-1981



Figura 28. Përbërja kombëtare e popullsisë së Kosovës sipas regjistrimeve të popullsisë 1948-1991



Figura 29. Përqindja e popullsisë bujqësore në popullsinë e përgjithshme në ishnjësitë federale sipas regjistrimeve të popullsisë 1948-1981



Figura 30. Përbërja e ekonomive familjare të Kosovës sipas regjistrimeve 1948-1991 (sipas numrit të anëtarëve)



Figura 31. Përbërja kombëtare e vendbanimeve rurale të Kosovës në periudhën 1961-1981



Figura 32. Kolonizimi agrar në Kosovë midis dy Luftërave Botërore, sipas M. Roux-it (në bazë të të dhënave të studimit: M. Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Pristina, 1981)



Figura 33. Prejardhja gjeografike e kolonistëve serbë dhe malazezë midis dy Luftërave Botërore, sipas rretheve të kohës në Kosovë, sipas M. Roux-it (në bazë të të dhënave të studimit: M. Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Priština, 1981)



Figura 34. Gjendja dhe projeksioni i popullsisë së Kosovës 1948-2051, sipas nacionaliteteve numerikisht më të mëdha



Figura 35. Dinamika e popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës dhe Serbisë në periudhën 1991-2051 (ndryshimet spontane), sipas variantit të projeksionit, pa migrime



KONKLUZION

Sikurse në të gjitha shoqëritë paraindustriale, në kushtet e pavolitshme shoqëroro-historike e politike dhe të moszhvillimit ekonomik e kulturor për një kohë të gjatë, edhe në Kosovë u formua një kompleks mjaft karakteristik socialo-demografik, e që deri vonë ishte territorialisht mjaft homogjen, ku si profesion dhe mënyrë dominante e jetës ishte bujqësia natyrale, ndërsa shkalla e analfabetizmit ishte në nivel shumë të lartë, sidomos te popullata femërore. Përtëritja biologjike e popullsisë ishte shumë joracionale dhe përparimi demografik tepër i ngadalshëm, sepse ekuilibri demografik midis lindjes dhe shuarjes së jetës arrihej me humbje të mëdha njerëzish për shkak të vdekshmërisë së lartë, sidomos të foshnjave, ku dominonin shkaqet ekzogjene të vdekjes. Në anën tjetër, moszhvillimi shoqëroro-ekonomik i Kosovës, veçanërisht mungesa e industrializimit u manifestua në ndryshimet e ngadalshme në rishtrirjen e popullsisë (migrimet) dhe në mobilitetin e vogël social dhe profesional të popullsisë, që ndikuan në koncentrimin e vogël demografik dhe në zgjerimin jo të kënaqshëm të mënyrës urbane të jetës. Nga gjithsej 1445 vendbanime, vetëm 26 sish në fund të shekullit XX i përkisnin tipit urban, ndërsa rreth 65% e popullsisë jetonte në fshat. Pas hyrjes së forcave ndërkombëtare në qershor të vitit 1999, një numër i madh i shqiptarëve u kthye nga deportimi dhe për shkak të shtëpive të djegura e të shkatërruara nga forcat ushtarake e policore serbe u koncentrua në qytete, ku u forcua edhe më tepër urbanizimi primar (dimensioni demografik), ndërkaq ngeci urbanizimi sekondar (dimensioni funksional) si indikator i rëndësishëm kualitativ i procesit të urbanizimit, duke u krijua një kaos i vërtetë urbano-shoqëror, veçanërisht në Prishtinë si metropol sui generis për rrethanat kosovare.

Determinantet e evolucionit specifik demografik gjatë shekullit të fundit, veçanërisht sa i përket lëvizjes së shkallës së natalitetit dhe diferencimit të tij të vonshëm në pikëpamje territoriale dhe sociale, lidhen me dominimin e tipit agrar të ekonomisë dhe të strukturës rurale të shoqërisë, me ndryshimet e ngadalshme e të vonshme në karakteristikat ekonomike, sociale e profesionale të popullsisë dhe në shëndetësinë publike, me nivelin shumë të ulët të shkrim-leximit e të arsimit, veçanërisht të femrave, me mobilitetin e vogël hapësinor e social të popullsisë, me inkuadrimin shumë të vogël e të vonë të femrës shqiptare në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore dhe, lidhur me këtë, me mundësitë e kufizuara të afirmimit të saj jashtë suazave familjare, me

mortalitetin shumë të lartë të foshnjave e të fëmijëve të vegjël, me funksionimin specifik të familjes në kuadër të së cilës kryheshin shumë funksione, para së gjithash ekonomike e mbrojtëse, me nevojën për fëmijë si fuqi ekstensive punëtore në ekonominë natyrale dhe si faktor i domosdoshëm i kontinuitetit familjar, të trashëgimit të pasurisë familjare dhe si mbajtës të prindërve në pleqëri, me mënyrën tradicionale të kontracepsionit etj. Këtu edhe e kanë mbështetjen normat dhe pikëpamjet specifike mbi martesën: hyrja e hershme në të, universaliteti i saj, hyrja përsëri në martesa pas shkurorëzimeve dhe veçanërisht nevoja dhe vetëdija për numër më të madh të pasardhësve etj.

Nga gama e gjerë e faktorëve biologjikë, materialë, sociopsikologjikë dhe kulturorë, reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar, që ndikojnë në lëvizjen dhe nivelin e lindshmërisë, u verifikua se aktiviteti ekonomik, punësimi dhe arsimimi i femrës ishin ndër faktorët më kryesorë që determinonin jo vetëm ndryshimet në sjelljen reproduktive, por edhe pozitën e gjithmbarshme të femrës dhe rolin e saj në familje dhe në shoqëri. Me ndryshimet socioekonomike, arsimore, shëndetësore, infrastrukturore etj. dhe veçanërisht me përfshirjen e një kontingjenti të konsiderueshëm të femrave në proceset ekonomike e shoqërore dhe në jetën kulturore nga fillimi i viteve të 70-ta të shekullit të kaluar, regjimi i përtëritjes biologjike nisi ndjeshëm të pësojë ndryshime, të cilat janë çështje edhe të individit dhe çiftëve bashkëshortorë edhe të familjes dhe shoqërisë. Mbi këto baza gjithnjë e më tepër krijoheshin supozimet objektive për depërtimin e motivacioneve dhe vetëdijes së re për përqafimin e kontrollit të lindjes në martesa si "stil" të jetës, për reduktimin e funksionit biologjik të gruas dhe rrjedhimisht për ndryshimin e tipit të riprodhimit.

Mirëpo, me gjithë transformimet e konsiderueshme popullative në pjesën e dytë të shekullit XX, Kosova edhe sot paraqet transicionin e fundit demografik në Evropë, me të gjitha konsekuencat që bart ky proces (norma e lartë e fertilitetit, struktura e re e popullsisë, shkalla e lartë e mortalitetit të foshnjave si problem ende i madh shëndetësor, demografik dhe human etj.). Në periudhën 1880-2004, përkundër mortalitetit të lartë dhe shpërnguljeve intensive, megjithatë popullsia e Kosovës shënoi rritje për më se 900% ose nga rreth 240.000 banorë në rreth 2.500.000 banorë. Në procesin e "bumit demografik" ajo hyri në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar pikërisht në saje të zvogëlimit të vdekshmërisë, por një prerje demografike (rënia e natalitetit dhe e shtimit natyror) ndodhi në fillim të viteve të 90-ta të shekullit të fundit (ikja e të rinjve në botën e jashtme nga terrori serb, zvogëlimi i normës së nupcialitetit dhe i lindjeve të planifikuara). Ndërkaq, në bazë të të dhënave të të gjitha statistikave zyrtare serbo-jugosllave në shek. XX, popullata shqiptare në Kosovë

gjithnjë përbënte shumicën dërmuese (66% më 1921, 82% më 1991, ndërsa sot rreth 90%). Derisa dyfishimi i popullsisë së Kosovës, sipas dinamikës së shtimit natyror, bëhet për rreth 30 vjet, popullata shqiptare e Kosovës dyfishohet për rreth 25 vjet. Rritja demografike e shqiptarëve u bë faktor i fuqishëm i ruajtjes së qenies sonë kombëtare dhe rezistencës ndaj të gjitha ndërmarrjeve gjenocidale, që u provuan me shekuj ndaj shqiptarëve. Shqiptarët arritën ta ruanin identitetin dhe integritetin e tyre edhe si popull e edhe në pikëpamje gjeoetnike.

Në gjithë shekullin XX lufta kundër faktorit demografik shqiptar u bë pjesë përbëre e strategjisë antishqiptare. Në të gjitha synimet dhe projektet serbe të këtij shekulli, plleshmëria e femrës shqiptare konsiderohej si pengesa më e madhe për rrënimin e substancës demografike shqiptare dhe realizimin e aspiratave shtetmëdha serbe. Nga viti 1981 strukturat pushtetore serbo-jugosllave propozuan një varg masash administrative, antisociale dhe anticivilizuese të tipit indiano-kinez për zvogëlimin radikal të lindshmërisë te shqiptarët, me elemente të qarta të dhunës dhe në kundërshtim me të drejtat elementare njerëzore mbi vendosjen e lirë për numrin e pasardhësve dhe intervalin kohor midis lindjeve dhe ndjenjat, arsyen dhe vullnetin e njerëzve. Ishte shumë e qartë se insistimi për mposhtjen e epërsisë numerike dhe reproduktive të shqiptarëve nuk ishte në funksion të përmirësimit të cilësisë së përtëritjes biologjike, humanizimit të raporteve midis gjinive, ruajtjes së shëndetit të femrës apo të ngritjes së standardit jetësor të shqiptarëve, por shtrohej për arsye të frikës nga një bashkësi etnike, me origjinë josllave dhe jojugosllave. Shqiptarofobia mori përmasa të gjera. Megjithatë, përkundër këtij agresiviteti në sferën më intime të jetës së njeriut dhe dëbimit të shqiptarëve nga Kosova me mjete të represionit e të terrorit, regjimi serbo-jugosllav nuk arriti ta rrezikonte riprodhimin biologjik të popullatës shqiptare, kështu që gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit XX shkalla e fertilitetit ishte mbi nivelin e duhur për riprodhimin e thjeshtë; në fund të decenies së tij norma neto e riprodhimit ishte mbi një fëmijë (mbi kufirin e përtëritjes së thjeshtë).

Qëllimi kryesor i të gjitha regjimeve serbe në 130 vjetët e fundit ishte ndërrimi i përbërjes etnike të Kosovës dhe viseve rreth saj me anë të kolonizimit të serbëve dhe shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve. Preokupimi kryesor i pushteteve serbo-jugosllave ishte që çështja e shqiptarëve të zgjidhej me shpërnguljen e tyre në rajonet feudale të Turqisë, në shkretëtirat e Anadollisë. Ndërkaq, në sferën e politikës ekonomike dhe veçanërisht politikës së investimeve Kosova kishte pozitë të një kolonie, ku përmbusheshin interesat e Serbisë dhe të ish-Jugosllavisë (thëngjilli, plumbi, zinku, nikeli, fuqia e lirë punëtore etj.), derisa në fund të shekullit XX nuk u shndërrua në koloni dhe okupim klasik. Një politikë e tillë kishte pasoja sa të tërthorta, aq

edhe të drejtpërdrejta në zhvillimin e popullsisë, veçanërisht në sektorët kryesorë të transformimit të regjimit të riprodhimit biologjik dhe të zhvillimit sociodemografik, çfarë janë pozita socioekonomike e femrës, si determinante kryesore e përtëritjes njerëzore, familja si suazë vendimtare e procesit të lindjes, amësisë dhe si bartëse e shumë funksioneve socioalo-ekonomike dhe bashkësia rurale si strukturë dominante në shoqërinë kosovare.

Nga fillimi i viteve të 80-ta ideja mbi kolonizimin e Kosovës përsëri u aktualizua dhe gjeti mbështetje te të gjitha strukturat shtetërore e partiake të ish-Jugosllavisë dhe filloi realizimi i saj përmes të ashtuquajturit Program jugosllav për Kosovën. Ish-shteti financonte segregacionizmin (privilegjet e serbëve në punësim, në fondin banesor, në dhënien e trojeve falas dhe të kredive afatgjata pa kamatë, për të njëjtin vend pune të ardhurat shumë më të mëdha se të shqiptarëve etj.) dhe aparatin represiv ndaj shqiptarëve, e në këtë pikëpamje shquhej blloku i fuqishëm serbo-malazezo-maqedon. Serbia dhe të gjitha ish-Jugosllavitë e dëshironin edhe Kosovën e kolonizuar nga serbët, edhe Kosovën e pazhvilluar dhe më normë të lindshmërisë të tipit evropian për shqiptarët, qëllime këto që nuk shkonin së bashku; shqiptarëve u ofroheshin vende të punës në republikat e tjera që i refuzonin punëtorët e vendit (industria e rëndë, minierat, ndërtimtaria, pastrimi i rrugëve etj.)

Pas suprimimit të subjektivitetit federal politik-konstitucional të Kosovës në mars të vitit 1989 dhe rrënimit të të gjitha institucioneve kosovare, si dhe përjashtimit masiv të punëtorëve pas grevës së 3 shtatorit 1990 e të këqija të tjera, shihej qartë se pushteti nuk kishte si synim vetëm okupimin, kolonizimin dhe vënien e sistemit kolonialist në Kosovë, por kishte për qëllim degradimin sistematik të shqiptarëve, varfërimin, rrezikimin e ekzistencës biologjike dhe shpërnguljen e një etnie të tërë me mjete gjenocidale, gjë që edhe ndodhi në sytë e gjithë botës në vitet 1998 dhe 1999 (masakrat, dhunimet, djegiet dhe rrënimet e shtëpive e të monumenteve kulturo-historike, deportimet masive, varrezat masive në Kosovë dhe në Serbi etj.). Pas bombardimeve të NATO-s dhe hyrjes së forcave ndërkombëtare në Kosovë më 12 qershor 1999, lidhja e fortë emocionale për truallin gjeoetnik, për pronën e paluajtshme, për shtëpinë dhe tokën bëri që qindra mijëra shqiptarë brenda një muaji të ktheheshin në vatrat e tyre dhe kjo cilësohej si një fenomen që bënte përjashtim në historinë e eksodeve masive etnike të epokës bashkëkohore. Sot është krijuar një realitet krejtësisht i ri etniko-demografik, ku shqiptarët përbëjnë rreth 90% të popullsisë së Kosovës, dhe një stabilitet në strukturat bazë demografike (mosha, gjinia).

Sa i përket perspektivës demografike, sipas projeksionit të variantit të mesëm të fertilitetit, të hartuar para më shumë se dhjetë vitesh, në vitin 2050 Kosova do të kishte rreth 4,5 milionë banorë (Serbia rreth 5 milionë), në vitin

2100 Kosova parashikohet të kishte më se 5 milionë banorë (Serbia rreth 4,5 milionë), ndërsa në vitin 2150 këto dallime do të stabilizoheshin rreth këtyre raporteve numerike, me dallime cilësore strukturale, ose edhe do të thelloheshin në favor të vëllimit demografik të Kosovës dhe shqiptarëve, me të gjitha efektet që do të pasonin. Mirëpo, demografët e Beogradit, duke parë përkeqësimin e situatës demografike në Serbi, në fund të vitit 2004 vlerësuan se në vitin 2100 Serbia do të kishte gjithsej 2.100.000 banorë, ndërsa Kosova madje 4,4 milionë banorë. Edhe ky fakt demografiko-statistik, përveç tjerash, bëhet çelës i zgjidhjes edhe të raporteve politike, në rastin konkret të ndarjes formale të Kosovës nga Serbia.

Hivzi Islami

DEMOGRAPHIC STUDIES

100 YEARS OF KOSOVA DEMOGRAPHIC DEVELOPMENT

SECOND RIVISED EDITION

(Summary)

Similar to other pre-industrial societies, in conditions of inconvenient social, historical, economic and cultural lack of development for a long time, a quite specific socio-demographic complex, territorially very homogenous till recently, was created in Kosova. In such conditions the most frequent occupation and the most dominant way of life was agriculture. The level of illiteracy was very high, especially among female population. Biological reproduction of the population was very irrational and demographic progress was very slow due to the fact that demographic balance between the birth and the death had been achieved by the huge loss of people caused by the high mortality (of babies particularly) effected by the exogenous causes of death. On the other hand, socio-economic non-development of Kosova and the lack of industrialization manifested themselves into slow and unhurried changes in dispersion of population (migrations) as well as into small social and professional mobility of the population. These manifestations had an effect in small demographic concentration of the population and in unsatisfactory extension of urban way of life. Out of 1445 inhabited localities (dwelling places) at the end of the XX century, only 26 of them had the characteristics of the urban type while 65% of the overall population was living in villages. After the entry of international army forces in Kosova, in June 1999, a great number of Albanians returned back (from deportation) to their homes, and most of them concentrated in towns (cities) since Serbian police and military forces burnt and destroyed their houses. So, the primary urbanization (the demographic dimension) became dominant and the secondary urbanization (the functional dimension), as an important quality indicator of the process of urbanization, lagged behind, creating in this way a typical, urban and social chaos, with the emphasis in Prishtina, as a metropolis sui generis for the circumstances in Kosova.

The determinants of the specific demographic evolution during the last century, with particular regards to the change of birthrate (natality) scale

and to its later territorial and social differentiation, are related to the superiority of the agrarian type of economy and to the rural structures of society, to the leisurely and late changes of economic, social, and professional features of the population and of public health institutions, to the very high level of illiteracy and very low level of education (especially among women), to the very decreased spacious and social mobility of the population, to the very late and very small participation of Albanian women in economic, social and cultural life, to the limited opportunities for her out-of-family affirmation, to the very high mortality of babies and young children, to the specific functions of the family (including here the economic and protective functions of the family), to the need for having a child as an extensive labor power in natural economy and as a necessary factor of family continuity, of family care and inheritance, to the traditional way of contraception etc.

The standards and the specific views about marriage, such as: early marriage, marriage universality, remarriage after divorces, and particularly the need and the thought of having a larger number of descendant children etc. base themselves on the above-mentioned principles and needs.

It has been verified that out of the huge number of biological, material, socio-psychological, and cultural factors which are reciprocally arranged and conditioned to have an effect on the change of the birthrate scale, woman's economic activity, her education and employment, were the main factors which determined not only the changes in reproductive behavior, but also had an effect on the overall woman's position and on her role in family and in society. The regime of biological reproduction has started experiencing substantial alterations with the socio-economic, educational, health, and infrastructural changes, particularly with the inclusion of a considerable number of women in economic, cultural and social processes since the 70s of the last century. The above-mentioned alterations are considered to be the concern of individual, of married couples, of the family and of society in general.

Based on these principles, objective assumptions were being made that modern motivations and consciousnesses affected the birth control as a new "style" of living, the reduction of woman's biological function, and as a consequence, the changes in the reproduction type.

However, Kosova presents the last demographic transition in Europe even today, when considerable population transformations have been made in the second half of the XX century, with all the consequences that this process bears with itself (the high standard of fertility, the new structure of population, a high scale of death-rate among babies as a very frequent

health, demographic and human problem, etc.). During the period of time 1880-2004, regardless the high death-rate and the intensive resettlements, the number of people in Kosova increased for more than 900%, which means that it raised the number of population from 240.000 inhabitants to 2.500.000 inhabitants. Kosova entered the process of "demographic boom" in the 60s of the last century thanks to the reduction of the death-rate, but a demographic cut (the reduction of birthrate and the decrease of natural growth-rate) occurred at the beginning of the 90s of the last century (the escape of youth to foreign countries due to the Serbian terror, the reduce of nuptial standards and of planned births). However, according to the official Serbian and Yugoslav statistics and data in the XX century, the Albanian population was still the majority, consisting 66% of the overall population in 1921 and 82% in 1991 and about 90% nowadays. While the duplation (reduplication) of Kosova population based on dynamics of natural growth-rate occurs in 30 years, the Albanian population of Kosova two-folds in about 25 years. The demographic increase of the number of Albanians became a very powerful factor in preserving the national being against every genocidal action performed by centuries. Thanks to it Albanians succeeded in preserving their identity and integrity geo-ethnically and as a nation.

During the whole XX century the war against the Albanian demographic factor became an important part of anti-Albanian strategy. All the Serbian projects and political intentions considered the fertility of Albanian woman the biggest obstacle in ruining the Albanian demographic substance and in realization of their nationalistic aspirations. From 1991 and on, the Serbian and Yugoslav government structures suggested a range of administrative anti-social and anti-civilized measures of the Indo-Chinese type for radical decrease of birthrate among Albanians, the measures which clearly contained the elements of violence and which are in opposition with the elementary human rights for making free decisions regarding the number of child descendants and the time period between the births, regarding the human feelings, reason and will. It was very obvious that the insistence on defeating the Albanian numerical and reproductive advantage did not have the aim to improve neither the quality of biological reproduction, the attempt to humanize the relationship between the sexes nor the living cost of Albanians.

It was up for discussion from the fear of a mixed ethnic community with the Slave and non-Slave origin. Albanian phobia exceeded prominently. Nevertheless, despite this most intimate human life aggression and despite the expulsion of the Albanians from Kosova by means of repression and terror, the Serbian and Yugoslav regime could not succeed in

endangering the biological reproduction of Albanian population whose net standard of reproduction at the end of the last century was above one child (above the simple reproduction limit).

The main objective of all Serbian regimes in the last 120 years was to change the ethnical structure of Kosova and territories around it by means of Serbian colonization and violent expulsion of Albanians. The main preoccupation of Serbian and Yugoslav regimes was to solve the Albanian issue with their resettlement to the feudal parts (regions) of Turkey, in deserts of Anadolia. On the other hand, viewed from the political, economic and investment point of view Kosova had the position of a colony fulfilling the interests of Serbia and former Yugoslavia (mines of coal, lead, zinc, nickel, labor market etc.), to be transformed at the end of the XX century into a classical occupation and colony. Such a policy had direct and indirect effects in the development of population, particularly in the main sectors of transformation of the biological reproduction regime and the socio-demographic development, such as: socio-economic position of women as the most important indicator of human reproduction, family as a crucial framework in the process of birth and maternity as well as in having a lot of socio-economic functions, and rural community as a dominant structure in Kosovar society.

The idea for the colonization of Kosova was actualized at the beginning of the 80s and found support at all levels of state and party structures in former Yugoslavia, by implementing the so-called Yugoslav Programme for Kosova. The former state financed the segregation (the privileges of Serbs in employment, in residential funds, in getting the free parcels of land and long term credits free of banking charge, in having higher incomes than Albanians for the same working place, etc.), and the distinguished Serbian, Montenegrin and Macedonian repressive apparatus against Albanians. Serbia and all the other former Yugoslavia-s wanted a colonized Kosova by Serbs, an undeveloped Kosova with the European birthrate standards for the Albanians. These two objectives have excluded each other, Albanians were being offered working places in other republics, the jobs which had previously been refused by the local workers (heavy industry, construction, road cleaning etc.).

After the suppression of the political, federal and constitutional subjectivity of Kosova in March 1989, which came out with the ruin of all Kosovar institutions and the massive expulsion of workers after the strike of the September 3rd, 1990 etc., it was very obvious that the aim of the Serbian government was not only occupation and colonization of Kosova, but also the systematic degradation of Albanians, bringing them to poverty,

endangering their biological existence, and expulsion of the whole ethnicity by all possible genocidal means, which unfortunately occurred in 1998 and in 1999 in the face of world (massacres, rapes, destruction and burning of houses and cultural and historical monuments, massive deportations, massive graves in Kosova and Serbia, etc.). When the NATO forces entered Kosova, on June 12th, 1999, hundreds of thousands Albanians returned their homes within a month due to the very strong emotional relationship with their geo-ethnical land, the return which was considered an extraordinary phenomenon in the history of massive ethnic exoduses in modern age. There is a completely new ethnic and demographical reality, where Albanians consist about 90% of the overall population of Kosova, and a sort of stability on demographic basis (age, sex).

Regarding the demographic perspective, according to the projection of middle variant of fertility written 10 years ago, in the year 2050 Kosova would have 4,5 million inhabitants (Serbia - round 5 million inhabitants), in the year 2100 Kosova is foreseen to have more than 5 million inhabitants, while Serbia – round 4,5 million of them. In the year 2150 these differences on numerical proportions would be stabilized with some structural distinctions, or, otherwise would be deepened in favor of demographic volume of Kosova and Albanians with all its outcome effects. However, Belgrade demographers, having seen the inconvenient demographic situation in Serbia, estimated at the end of the year 2004 that in the year 2100 Serbia would have 2.100.000 inhabitants and Kosova - even 4, 4 million inhabitants. The above-mentioned demographic and statistical fact becomes the key for the solution of political relations as well, among the others, in our case that of formal separation of Kosova from Serbia.

C O N T E N T S

INTRODUCTORY REMARKS 11

The first part
DEMOGRAPHIC DEVELOPMENT IN MODERN AGE
THE XX CENTURY – THE CENTURY OF GREAT DEMOGRAPHIC TURNABOUTS

I. THE DEVELOPMENT OF POPULATION DURING THE HISTORY IN GLOBAL LEVEL 21
1. Demographic evolution from Homo sapiens to classical industrial revolution 21
2. Streams of demographic transition 26
3. Great regional differences in the population development 33
4. The fundamental results of the population projections in the world till the year 2150 41

II. THE INTERNATIONAL ASPECT OF POPULATION PROBLEMS 43
1. The contraventions regarding the ways for solving the population problems 44
2. Demographic issues in the world conferences on population 45
2.1. The conference I: French "pronatalist" spirit and American neo-Malthusian attitude 45
2.2. The conference II: without big confrontation around population issues 48
2.3. The conference III: interdependence between population and development 49
2.4. The conference IV: fulfilment of obligations from the conference III documents 52
2.5. The conference V: compromise between birth-rate and family planning 54

The second part
NATURAL MOVEMENT OF THE POPULATION IN KOSOVA

I. THE EVOLUTION OF BIRTHRATE AND OF THE REPRODUCTION OF POPULATION 61
1. Birthrate (natality, fertility) and the reproduction of the population as a multidimensional phenomenon 61
2. The reproduction of population in developing countries from Malthus until today 65
3. The peculiarities of the reproduction regime among the population in Kosova and among Albanians 69
3.1. The reproductive function in Albanian traditional society 71

3.1.1. The necessity of high birthrate 74
3.1.2. Marriage, family and birth as high values 77
3.2. The reproductive function in Albanian society today.....79
3.2.1. Determinants of the late demographic transition 82
3.2.2. The reasons for a demographic breakage at the end of the XX century 86
3.2.3. The woman and her role in the change of the reproduction regime.... 89
3.2.4. Fertility according to the order of birth, mother's age, educational background and occupation.....91
3.2.5. The level and the movement of birthrate and fertility in accordance with nations.....97
4. Family planning and biological reproduction of population in modern urban challenges 105
4.1. The conception of family planning 105
4.2. Micro level and biological reproduction of population 106
4.3. Individualization and egoism as important values in the reproduction of population 110
4.4. The problem of "family planning" and "birth control" in two characteristic countries 117
5. The hypocrisy of former Yugoslavia: neo-Malthusian spirit sui generic (of its kind) 125

II. THE EVOLUTION OF THE POPULATION DEATH-RATE (MORTALITY) 133
1. The traditional type of mortality 134
2. Mortality in accordance with sex and age 141
3. Babies' mortality and its causes 143
4. The extension of the average life among just born babies 150
5. Social differentiation of the death rate 152

III. THE DYNAMICS OF THE NATURAL GROWTH-RATE AND OF THE GENERAL INCREASE OF POPULATION.....157

The third part
THE STRUCTURE OF THE POPULATION IN KOSOVA AND THE CHANGES IN THE COMPOSITION OF THE HOUSEHOLDS

I. THE STRUCTURE OF POPULATION BY AGE AND SEX.....169
1. The spread of the overall population by age and sex 170
2. Functional contingents of population by age and sex.....172

II. EDUCATION AND THE CHANGE OF ILLITERACY 177
1. The role of school in providing with writing and reading.....178

2. Methodological defects in evidencing the illiterate people 182
3. The anatomy of illiterate people.....182
4. The causes of illiteracy.....187

III. NATIONALITY OF THE POPULATION AND SERBIAN SPECULATIONS 191
1. Serbian speculations regarding the ethno-demographic dimension of Kosova..... 192
2. The latest Serbian speculations regarding the ethnic composition of Kosova and demographic development of Albanians 198

IV. ECONOMIC STRUCTURE OF POPULATION 209
1. Some fundamental features of economic development of Kosova 209
2. Agricultural population and its movements 212
2.1. Methodological issues regarding the application of the agricultural population definition 212
2.2. The change of the agricultural population number during the period of time 1948-1981 215
2.3. Territorial aspect of agricultural population.....219
3. Active population and its characteristics.....220
4. General density and agrarian density 222

V. HOUSEHOLDS AND THEIR TRANSFORMATION 227
1. The definition of the concepts: family and household 227
2. The changes in number and in composition of the households.....229
3. The existence of big families.....233

The fourth part
ALBANIANS IN OTHER ETHNIC TERRITORIES

I. SOME DEMOGRPHIC FEATURES OF ALBANIANS LIVING IN OTHER ETHNIC TERRITORIES 241
1. Albanians in Macedonia.....241
2. Albanians in the three municipalities of Presheva Valley.....246
3. Albanians in Montenegro 249
4. Albanians in other regions of former Yugoslavia 251

The fifth part
THE MIGRATIONS OF POPULATION AND ETHNIC CLEANSINGS

I. MIGRATIONS OF KOSOVA POPULATION AND SERBIAN SPECULATIONS 255
1. The war against the Albanian demographic factor as an anti-Albanian strategy 256

2. Serbian manipulations and speculations regarding the migrations of population in the 80s of the XX century 260
2.1. The attraction of "national matrixes" and of huge urban centers.....261
2.2. Nationality based migrations of population and their motives after the year 1981.....263
2.3. Macedonia as an experimental territory for the persecution of Albanians 265

II. SERBIAN HEGEMONISM AND SERBIAN POLICY IN ETHNIC CLEANSING OF ALBANIANS 269
1. The notion and idea of "ethnic cleansing" 269
2. Serbian hegemonism as a long-term concept of Serbian policy and society.....272
3. Cvijiq's ethno-demographic and geo-political examinations in favor to Serbian expansion in the Balkans.....274

III. SERBIAN PROJECTS OF THE FIRST PART OF THE XX CENTURY FOR THE DEPORTION OF ALBANIANS IN FAVOR TO THE SERBIZATION OF THEIR TERRITORIES 283
1. Serbian colonial policy and agrarian reform as a means of the deportation of Albanians between the two World Wars.....283
2. Serbian genocidal elaborations of the 30s.....289
3. Serbian genocidal elaborations of the 40s.....294

IV. SERBIAN AND YUGOSLAV PROJECTS FOR THE REPRESSION AND RESETTLEMENT OF ALBANIANS IN FAVOR TO THE SERBIZATION OF THEIR TERRITORIES 301
1. Kosova crisis and the beginning of destruction of the Second Yugoslavia.....301
2. The Albanians resettlements and the Serbian colonization of Kosova during the 50s and the 60s of the XX century 310
3. Yugoslav Programme for Kosova in the function of colonization and repression against Albanians 316
4. The Great-Serbian theses and requests of the fascist and Sheshelian type 322
5. Mass factual genocide against Albanians in the last decade of the XX century 333

V. SERBIAN VERSIONS REGARDING THE SEPARATION AND TERRITORIAL RECOMPOSITION OF KOSOVA 339
1. Changes in the territorial size of Kosova 340
2. The solution of Kosova problem by its fragmentation and ethnic cleansing.....340
3. The latest projects of the territorial recomposition.....343

The sixth part
DEMOGRAPHIC AND FUNCTIONAL ASPECT OF DWELLING PLACES IN KOSOVA

I. GENERAL CHARACTERISTICS OF DWELLING PLACES 349
1. Dwelling places as the first homes of human communities 349
2. The spread, changes and classification of the dwelling places.....350

II. RURAL COMMUNITY IN SOCIO-DEMOGRAPHIC RANGE 357
1. Homogenous and undeveloped structure.....357
2. The beginning of socio-demographic transformations and the formation of new socio-professional groups.....358
3. The problem of acquirement and expansion of innovations in villages.....361
4. Rural population – its movements and composition 363
5. The issues on rural places urbanization and standards.....366
5.1. The process of urbanization and temptations for extending the infrastructural urban structures 366
5.2. The primary school and its effects in the village.....372
6. The expansion of material and spiritual innovations in village and in agriculture 374
7. The conditions of living in the village.....378
8. The food and the consume of the population 381
9. The differences between the traditional and modern village.....383

III. URBAN COMMUNITY AND ITS PROBLEMS 385
1. Specific range of urbanization.....386
2. Demographic increase of cities 389
3. Urbanization scale according to nationality 392
4. Immigration of population and urban culture.....393
5. Prishtina: from a town to chaotic metropolis 397
5.1. The evolution of population 398
5.2. Functional side of urbanization 401
5.3. Violent urbanization and actual problems 402

The seventh part
ALBANIAN DIASPORA

I. THE MAIN CHARACTERISTICS OF THE ALBANIAN HISTORICAL AND MODERN DIASPORA 407
1. The separation from the same geo-national tree.....407
2. The causes and the reasons of separating 408
3. Albanians (arvanitasit) in Greece 412
4. Albanians (arbëreshët) in Italy 416
5. Albanians in Bulgaria, Romania, Russia and Dalmatia 422

6. Albanians in Turkey 424
7. Albanians in the USA and other countries 431
8. Albanians in Europe 433
9. The links of the Albanian Diaspora with the motherland.....434
10. Some problems regarding our Diaspora today 435
10.1. Resettlements as an advantage or disadvantage 435
10.2. Our migrants' two misfortunes 438
10.3. The Diaspora at the mercy of fate 439

The eighth part
THE PROJECTIONS OF KOSOVA POPULATION AND DIVISION OF KOSOVA

I. LONG-TERM DEMOGRAPHIC FORESIGHTS 443
1. Some remarks regarding the population projections 443
2. Kosova and Serbia: two opposite demographic poles in perspective 446

The ninth part
THE DISCOURSE REGARDING SOME CURRENT PROBLEMS OF KOSOVA POPULATION AND KOSOVA DIVISION

I. THE DISCOURSE ABOUT THE REGISTRATION OF POPULATION.... 461
1. The course and the problems of population registration 461
1.1. Conceptions and units of inclusion in registration.....462
1.2. The programme of activities for the realization of the registration 464
1.3. Albanian boycott of population registration in 1991 465
2. Civic and the polls registration: dilemmas and problems.....468
2.1. Differences between registrations 469
2.2. Data mistakes and inconsequence in criteria application 472
3. Manipulations with the number of Serbs.....473
3.1. The seduction of Albanian government 477
4. The co-operation of foreign organizations with Albanian experts 480
4.1. The exclusion of local experts 480
4.2. Dilemmas about going to Bordeaux 482
5. Absurd results regarding a publication of Kosova Statistical Institute.....483
5.1. No poll can substitute the registration of the population 483
5.2. Multiple damages caused by statistical improvisations 485
5.3. Kosova Statistical Institute assists in postponing the registration of population 486

II. POPULATION CENSUS FAILED DUE TO THE 2004' POPULATION REGISTRATION POLICY 489
1. Obstacles and interruptions for project completion.....489

1.1. Minister of Public Services – responsible for the census failure 491
1.2. The peak of irresponsibility with political heavy consequences.....491
2. Failure of two pilot censuses 494
3. Kosova - a place with the utmost demographic characteristics in Europe 496

III. ACTUAL DECENTRALISATION AS A SPECIFIC TERRITORIAL-POLITICAL DIVISION OF KOSOVA 499
1. Serb versions of Kosova division 500
2. The model of Kosova division according to internationals earlier than M. Ahtisar.....505
3. Decentralization as Kosova division according to Kosovo Negotiation Party 507
4. Decentralization according to final documents of M. Ahtisari 509
5. Difficulties on implementation of M. Ahtisari's plan..... 510
6. Use of cadastre as a tool of terriotory gain and manipulation of Belgrade with etno demographic data 513

The tenth part
APENDIX

CONCLUSION 543
SUMMARY.....549
CONTENTS 555
BIBLIOGRPHY..... 563
INDEX OF NAMES 581

LITERATURA DHE BURIMET

Abdyli R., *Gjendja dhe pozita e klasës punëtore në Kosovë (1918-1941),* Instituti i Historisë, Prishtinë, 1986.

Acsádi G. - Nemskeri J., *History of Human Life: Span and Mortality,* Akademiai Kiedó, Budapest, 1970.

Agani F., "Memorandumi i Akademisë Serbe dhe çështja shqiptare", në *Demokracia, kombi, vetëvendosja,* Dukagjini, Pejë, 1994.

Aktuelni problemi proizvodne strukture Kosova, Ekonomski institut, Beograd, 1971.

Almagia R., *L'Albania*, Roma, 1930.

Altimari F., "Albanci v Italiji", në librin *Albanci*, Cankarjeva založba, Ljubljana, 1984.

Anakiovski D., "Kretanje zaoposlenosti i promene u socijalnoj strukturi stanovništva SR Makedonije", *Stanovništvo*, br. 4, Centar za demografska istraživanja (CDI), Institut društvenih nauka (IDN), Beograd, 1967.

Annuario Statistico Nea Communi Italiani, Instituto Centrale Di Statistica - Ministeri Dell'Interno, Roma, 1958.

Anamali S., "Nga ilirët tek arbërit", *Kuvendi I i studimeve ilire, II,* Tiranë, 1974.

Armengaud A., *Démographie et sociétés,* Stock, Paris, 1966.

Armengaud A., *Les français et Malthus*, PUF, Paris, 1975.

Audirac A. P., "Cohabitation et mariage: qui vit avec qui?", *Économie et statistique,* No 145, INSEE, Paris, juin 1982.

Avramov D., *Pojedinac, porodica i stanovništvo u raskoraku,* Naučna knjiga, Beograd, 1993.

Bajrami V., Shqiptarët e Amerikës, Albanian Publishing, New York, 2003.

Bakraçi Xh., "Pozita e KSA të Kosovës si faktor i diferencimeve interregjionale", *Economia,* nr. 2, Instituti Ekonomik, Prishtinë, 1973.

Baletić W.-A., *Demografija (Stanovništvo i ekonomski razvitak),* Školska knjiga, Zagreb, 1982.

Baletić W.-A., "Demografska tranzicija kao svjetski proces", *Ekonomska revija,* st. 3-4, Ljubljana, 1982.

Baletić W.-A., "Medjunarodni aspekti populacione politike", në: *Problemi politike obnavljanja stanovništva u Srbiji, Demografski zbornik,* Knj. I, SANU, Beograd, 1989.

Ban M., *Naselja u Jugoslaviji i njihov razvoj u periodu 1948-1961*, IDN, CDI, Beograd, 1970.

Banac I., *Nacionalno pitanje u Jugoslaviji. Porijeklo, povijest, politika*, Globus, Zagreb, 1988.

Barbarich E., *Albania*, Roma 1905.

Bardet J.-P. et Dupâquier J., *Histoire des populations de l'Europe*, Paris, 1997-1999.
Bartolo de G., "La démographie des minorités albanaises de Calabre. Premières resultats", *Conférence Européene de demographie 1987,* Jyvasküla, 11-18 juin, Finlande.
Bashota N., "Uvodna razmatranja o strukturnoj orijentaciji i ubrzanom razvoju nerazvijenih", *Časopis za kritiko znanosti,* 51-52, Ljubljana, 1982.
Bashota N., "Osnovni problemi privrede Kosova", *Pogledi (Kosovo danas i sutra),* Split, 1988.
Baud P.-Bourgeat S.-Bras C., *Dictionnaire de géographie,* 2 ème éd., Hatier, Paris, 1997.
Beaujeu-Garnier J., *Trois milliards d'hommes. Traité de démogéographie,* Hachètte, Paris, 1965.
Beaujeu-Garnier J., *Géographie urbaine,* A. Colin, Paris, 1980.
Becker S. G. - Lewis G. H., "On the interaction between the quantity and quality of children", *Journal of Political Economy,* No 2, London, 1973.
Berisha A., *Shndërrimi i etnisë,* Dukagjini, Pejë, 1998.
Bianco L., "Planification de naissances en Chine – Quelle confiance accorder aux données locales", *Population,* No 1, INED, Paris, 1981.
Biraben N.-J., *Les hommes et la peste,* Mouton, Paris, 1976.
Biraben N.-J., "Essai sur l'évolution du nombre des hommes", *Population,* No 1, Institut national d'études démographiques, Paris, 1979.
Biserko S. (éd.), *Yugoslavia: Collaps, War, crimes, Center for Antiwar Action,* Belgrade, 1993.
Blayo Y., "Mouvement naturel de la population française de 1740 à 1829", *Population,* Numéro special, INED, Paris, 1975.
Blayo Y., "Événements politiques et fécondité en Chine depuis 1950", *Population*, No 6, INED, Paris, 1991.
Blayo Y., *Des politiques démographiques en Chine,* Presses universitaires de France et Institut National d'Études Démographiques (INED), Cahier no 137, Paris, 1997.
Bota Shqiptare, Tiranë, 1943.
Bourgeois-Pichat J., "La mesure de la mortalité infantile", *Population,* janvier-mars, INED, Paris, 1946.
Bourgeois-Pichat J., "La mesure de la mortalié: les causes de décès", *Population,* juillet-septembre, INED, Paris, 1951.
Bougeois-Pichat J., "La mesure de la mortalité infantile: principes et méthodes", *Population,* avril-juin, INED, Paris, 1961.
Bourgeois-Pichat J., "Évolution récente de la mortalité infantile", *Population,* No 3, INED, Paris, 1964.
Bourgeois-Pichat J., "La baisse actuelle de la fécondité en Europe s'inscrit-elle dans le modèle de la transition démographique", *Population,* no 2, INED, Paris, 1979
Bogdanović D., *Knjiga o Kosovu,* SANU, 1986.
Beaujeu-Garnier J., *Géographie urbaine,* A. Colin, Paris, 1980.

Breznik D. – Sentić M., "Etničke, religiozne i rasne grupe", *Stanovništvo*, br. 3-4, CDI, IDN, Beograd, 1968.

Breznik D., "Demografska kretanja u SR Srbiji i mere za rešavanje problema", *Stanovništvo,* nr. 3-4/1975 - 1-2/1976, CDI, IDN, Beograd, 1976.

Breznik D., *Demografija (Analiza, metodi i modeli),* CDI, IDN, Beograd, 1977.

Breznik D., "Natalitet i fertilitet stanovništva u Jugoslaviji", në: *Fertilitet stanovništva i planiranje porodice,* CDI, IDN, Beograd, 1980.

Breznik D., "Neke demografske karakteristike smrtnosti stanovništva Jugoslavije", *Stanovništvo*, br. 1-4/1989 dhe 1-2/1990, CDI, IDN, Beograd, 1990.

Breznik D., *Stanovništvo Jugoslavije,* Chronos, Titograd, 1991.

Buda A., *Shkrime historike, 4*, Toena, 2000.

Bulatao A. R.- Lee D. R., *Determinants of Fertility in Developing Countries,* Academic Press, 2 vol, New York, 1983.

Caldwell J., *Theory of fertility Decline,* Academic Press, Londres, 1982.

Carr-Saunders M. A., W*orld Population,* Oxford University Press, Fair Laun, 1936.

Castro de J., *Géopolitique de la Faim,* Édition ouvrières, Économie et humanisme, Paris, 1952.

Ciampi G., "Le sedi dei Greci Arvaniti", *Rivista geografica italiana*, XCII, fasc. 2-Giugno Pacini Ed. Pisa, 1985.

Chesnais C.-J., "L'effet multiplicatif de la transition démographique", *Population,* No 6, INED, Paris, 1979.

Chesnais J.-C., *La population du monde de l'Antiquité à 2050,* Paris, 1991.

Chesnais J.-C., *La démographie*, PUF, Paris, 1998.

Cipolla C., *The Economic History of World Population*, Penguin Books, 1962.

Clark C., Population and Land Use, MacMillan, New York, 1967.

Cliquet R., "The second demographic transition: fact or fiction? Council of Europe", *Population Studies*, No 23, Strasbourg, 1991.

Cliquet R., "Below-Replacement Fertility: A Case of Individual-societel Antagonisme, Socialbiologically Explained", në: *Prilozi demografskim i ekonomskim naukama,* SANU, Knj. 103, Beograd, 1994.

Coale A., "The Demographic Transition Reconcidered", in *Contracepcion and Family Planning,* United Nations*,* New York*,* 1993.

Courgeaud D., "Interférences entre phénomènes démographiqe", *Population,* Numéro Special, INED, Paris, 1977.

Croll E., "La Chine assouplit sa politique de l'enfant unique", *Peuples,* vol. 2, No 2, 1985.

Cvijić J., *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje,* Knj. I-II, Beograd, 1966.

Cvijić J., *Govori i članci,* Beograd, 1921 (1987).

Cvijić J., "Izlazak Srbije na Jadransko more", *Glasnik Srpskog geografskog društva,* God. 1, br. 2, Beograd, 1912.

Çabej E., "Ilirishtja dhe shqipja", në: *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve,* Tiranë, 1969.

Çabej, "Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës e të emrave të vendeve", *Studime Gjuhësore,* IV, Rilindja, Prishtinë, 1974.

Çabej E., "Ngulimet shqiptare jashtë atdheut", *Ylli*, VIII, Nr. 1, Tiranë, janar 1967; dhe në: *Studime gjuhësore,* V, Prishtinë, 1975.
Čelebi E., *Putopis. Odlomci o jugoslovenskim zemljama,* Sarajevo, 1979.
Čengić E., *S Krležom iz dana u dan (1980-1981). U sjeni smrti*, Globus, Zagreb, 1985.
Čović B., "Politika obmana i nasilja", në *Izvori velikosrpske agresije,* Rasprave-dokumenti, (Red. Čović B.), A. Cesarec-Školska knjiga, Zagreb, 1991.
Čubrilović V., *Iseljavanje Arnauta* (elaborat), Predavanje održano u Srpskom kulturnom klubu od Dr. Vase Čubrilovića, 7. marta 1937. godine, Vojnoistorijski institut, Arhiv bivše jugoslovenske vojske, Br.2, Fasc. 4, Kutija 69.
Čubrilović V., *Manjinski problem u novoj Jugoslaviji* (elaborat), 4. XI. 1944, Beograd.
Davis K.-Blake J., "Social Structure and Fertility: An Analytic Framowerk", *Economic Development and Culture Change,* Vol. IV, No 2, Chicago, 1956.
Demeny P., "Bucarest, Mexico and Bleyond", *Europen Journal of Population,* No 1-2, 1985.
Demografski razvitak Kosova i Metohije (interna studija), CD, IDN, Beograd, 1963.
Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti, CDI, IDN, Beograd, 1978.
Demografska statistika 1990, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1992.
Demografska statistika 1995, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1998.
Demografska statistika 2000, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 2002.
Demografski problemi i populaciona politika na Kosovu i Metohiji, CDI, IDN, Beograd, 1992.
Dermaku I., *Rilindja kombëtare shqiptare dhe kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe Bullgari,* Prishtinë, 1983.
Desnickaja A., *Albanskij jazik i jego dijalekty,* Nauka, Leningrad, 1968.
Desplanques G. et Deville J.-C., "Fécondité et milieu social: les différences demeurent", *Économie et statistique,* No 111, INSEE, Paris, mai 1979.
Djurić V., "Proizvodne inovacije i naši seljaci", *Sociologija*, br. 1, Beograd, 1974.
Dollot L., *Les migrations humaines*, Presses universitaires de France, Paris, 1976.
Draga N., *Shqiptarët në Mal të Zi,* Art Club, Ulqin, 1994.
Drakulić S., "Natalitet i politika", *Danas,* br. 310, Zagreb, 26. siječnja 1988.
Drakulić S., "Natalitet i represija – zakon kroji porodicu", *Danas,* br. 311, Zagreb, 2. veljače, 1988.
Društvene promjene u selu, Zagreb-Beograd, 1974.
Dupâquier J., "Histoire et démographie", *Population,* Numéro Special, INED, Paris, 1977.
Durand J. D., *Historical estimates of World Population: an evaluation,* Population Studies Center, University of Pensilvania, 1974.
Durand J. D., "The modern Expansion of World Population", *Proceedings of the American Philosofical Society,* Vol. III, No 3, 1967.
Durham E., *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, 8 Nëntori, Tiranë, 1991.

Duka V., "Diaspora shqiptare e Amerikës (1884 - 1912)", *Bujku*, Prishtinë, 1994.
Dumond G.-F., *Le monde et les hommes. Les grandes évolutions démographiques*, Paris, 1995.
Ehrlich P., *The Population Explosion,* New York, 1990.
Engels F., *Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit*, Prishtinë, 1976.
Erlich St. V., *Jugoslavenska porodica u transformaciji (Studija u tristotine sela),* Liber, Zagreb, 1971.
European Stability Initiative (ESI), Berlin/Pristina, June 7, 2004.
Fertilitet stanovništva u Jugoslaviji, CDI, IDN, Beograd, 1972.
Fertilitet i planiranje porodice u Jugoslaviji, CDI, IDN, Beograd, 1980.
Festy P., *La fécondité des pays occidentaux de 1870 à 1970,* INED, Cahier no 85, PUF, Paris, 1979.
First R., *Seoska porodica danas – kontinuitet ili promjene,* Biblioteka sociologije sela, 7, Institut za društvena istraživanja Sveučilista u Zagrebu, Zagreb, 1981.
Fond des Nations Unies pour les activités de population: Etat de la population mondiale, 1994, Choix et responsabilités, New York, 1994.
Ford T. J. and De Jong G. F., *Social demography*, Prentice Hall, London, 1970.
Fourastié J., *Le grand espoir du XX* ème *siècle,* Presses Universitaires de France, Paris, 1953. Fourastié J., "De la vie tradicionnelle à la vie tertiaire", *Population,* No 3, INED, Paris, 1959.
Freedman R., "The Sociology of Human Fertility", në: Ford T. J. and De Jong F. G., *Social Demography,* Prentice Hall, London, 1970.
Friedman V., "Observing the Observers: Language, Ethnicity, and Power in the 1994 Macedonian Census and Beyond", in *Toward Comprehensive Peace in Southeast Europe. Coflict Prevention in the South Balkans,* The Tëwntieth Century Fund Press, New York, 1996.
Friganović M., *Demogeografija (Stanovništvo svijeta),* Školska knjiga, Zagreb, 1990.
Frojndlih L., *Shfarosja e shqiptarëve (Albania's Golgotha),* Prishtinë, 2001.
Gashi A., *Shqipnija- ethnike edhe vërejtjet e shqiptarëve për Shqipninë e robnueme,* Arkivi i shtetit, Tiranë, 1941 (dorëshkrim).
Gaćeša Lj., "Statistički prilozi", *Stanovništvo,* nr. 3-4, CDI, IDN, Beograd, 1994.
George P., *Les migrations internationales,* PUF, Paris, 1976.
George P., *Population et peupelement,* PUF, Paris, 1980.
Glass D. V. - Eversely D. E. C., *Population in history. Essays in historical Demography,* London, 1965.
Ginić I., *Dinamika i struktura gradskog stanovništva Jugoslavije (Demografski aspekt urbanizacije),* Institut društvenih nauka, Centar za demografska istraživanja, Beograd, 1967.
Giordano E., *Dizionario degli Albanesi d' Italia,* Edicioni Paoline, Bari, 1963.
Golubović Z., *Porodica kao ljudska zajednica,* Naprijed, Zagreb, 1981.
Gore A., *Toka në baraspeshë (Ekologjia dhe fryma njerëzore),* Dukagjini, Pejë, 1994.
Grebo Z., *Čovjek, radjanje, društvo,* Svjetlost, Sarajevo, 1975.
Gjeografia e Kosovës (grup autorësh), Enti i Teksteve, Prishtinë, 1995.

Hadri A., "Pozita dhe gjendja e Kosovës në mbretërinë e Jugosllavisë (1918 - 1941)", *Gjurmime albanologjike*, nr. 2, Prishtinë, 1968.

Hadžibegić H., Handžić A., Kovačević E., *Oblast Brankovića - opširni katastarski popis,* Orijentalni institut, Sarajevo, 1972.

Hahn G. J., *Albanesische Studien, I*, Jena, 1854.

Hamp P. E., *Vaccarizzo albaneso phonologythe sound-system of Calabro-albanian dialect*, Disertacion i doktoratës (dorëshkrim), Chicago 1951, ff. XXIV-XXV (a).

Hammer von J., *Historija turskog (osmanskog) carstva,* 3, Zagreb, 1979.

Hauser M. Ph.- Duncan D. O., *The Study of Population: An Inventory and Appraisal,* The University of Chicago Press, 1959.

Henry L., "La fécondité naturelle: observation - théories - résultats", *Population,* No 4, INED, Paris, 1961.

Henry L., "Réflexions sur l'observation en démographie", *Population*, No 2, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1963.

Henry L., *Demographie – Analyse et modèles,* Librairie Larousse, Paris, 1972.

Hermet G., *L'exode des cerveaux,* Notes Et. Doc., No 3598, Paris, 1969.

Heršak E., "Sociohistorijski uvod u problematiku etničkih manjina na talijanskom Jugu", *Migracijske teme,* nr. 2, Zagreb, 1987.

Historia e letërsisë shqipe, I-II, Tiranë 1959 (sipas ribotimit të ETMM të KSA të Kosovës, Prishtinë, 1971).

Historia e popullit shqiptar, I, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Botim i tretë, Prishtinë, 1976.

Hofsten E., "Spor oko planiranja porodice", *Ekonomska misao,* 3, Beograd, 1974.

Horvat B., *Kosovsko pitanje*, Globus, Zagreb, 1988.

Hou W., "Population Policy", in *China's Population: Problems and Prospects*, New World Press, Pékin, 1981.

Hoxha H., "Elemente të presionit ekonomik ndaj shqiptarëve në Jugosllavinë e vjetër, *Përparimi*, nr. 4, Prishtinë 1970.

Hoxha H., "Politika e eliminimit të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë së vjetër", *Përparimi*, nr. 5, 1970.

Hoxha H., "Proces nacionalne afirmacije albanske narodnosti u Jugoslaviji", *Časopis za kritiko znanosti*, 51 - 52, Ljubljana, 1982.

Hubrehcht J., *Kosovo (1981-1989-1999-200)1, Etablir les faits,* Éd. Esprit, Paris, 2001.

Images économiques du monde 2004, A. Colin, Paris, 2004.

Islami H., "Osvrt na razvitak stanovništva Kosova", *Sociologija*, br. 1, Beograd, 1977.

Islami H., "Poljoprivredno stanovništvo Kosova", *Sociologija sela*, br. 55-56, Zagreb, 1977.

Islami H., "Kretanje nepismenosti u Albanaca u Jugoslaviji", *Sociologija*, br. 2-3, Beograd, 1978.

Islami H., "Pregled rasprostranjenosti i porasta broja Albanaca u svetu", *Stanovnistvo,* br. 1-4, Beograd, 1978.

Islami H., "Problemi društvenog razvitka kosovskog sela", *Sociologija,* br. 4, Beograd, 1979.
Islami H., "Le développement démographique du Kosovo (Yougoslavie)", *Revue géographique de l'Est,* No 1-2, Nancy, 1979.
Islami H., "Shtrirja, migrimi dhe numri i shqiptarëve në botë", *Përparimi,* nr. 3, 1979.
Islami H., "Shtrirja dhe lëvizja e numrit të shqiptarëve në Jugosllavi", *Përparimi, n*r. 4, 1979.
Islami H., "La croissance démographique du Kosovo (Yougoslavie)", *Population,* No 4-5, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1979.
Islami H., "Razlike u nivou urbanizacije izmedju stanovništva nacionalnosti Kosova", *Geographica Slovenica,* 10, Ljubljana, 1980.
Islami H., *Popullsia e Kosovës (Studim demografik),* ETMM i KSAK, Prishtinë, 1980.
Islami H., "La diaspora d'un peuple méditerranéen: le cas des Albanais", *Peuples Méditerranéen,* No 15, Avril-Mais, Paris, 1981.
Islami H., "Nepismenost u današnjem kosovskom selu", *Sociologija sela,* br. 77/78, Zagreb, 1982.
Islami H., "La population albanaise de Yougoslavie: accroissement numérique et répartition spatiale", *Population,* No 1, INED, Paris, 1983.
Islami H., "Problemi urbanizacije i standarda ruralnih naselja Kosova", *Sociologija,* br. 3-4, Beograd, 1984.
Islami H., "Zapažanja o preobražaju i problemima socijalno-demografske strukture seoskog stanovništva SAP Kosovo", *Stanovništvo,* 1-4, Beograd, 1984/85.
Islami H., *Fshati i Kosovës (Kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural),* Rilindja, Prishtinë, 1985.
Islami H., "Nataliteti dhe shqiptarët", në: *Çështje të studimeve albanologjike*, II, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1987.
Islami H., *Kosova dhe shqiptarët (Çështje demografike),* Pena, Prishtinë, 1990.
Islami H., "Zadnja demografska tranzicija v Evropi: primer Kosova", Č*asopis za kritiko znanosti,* 79-80, Ljubljana, 1985.
Islami H., "Zakasnela demografska tranzicija na Kosovu u okviru demografskog prelaznog razdoblja u Jugoslaviji i Evropi", *Sociologija,* br. 3, Beograd, 1985.
Islami H., "Problem nataliteta pri Albancih", *Časopis za kritiko znanosti,* št. 89-90, Ljubljana, 1986.
Islami H., "Realiteti etniko-demografik i Kosovës dhe aspiratat serbe", *Thema,* nr. 11, Prishtinë, 1993.
Islami H., "Demographic reality of Kosovo", *Conflict or Dialogue (Serbian-Albanian relations and integration of the Balkans),* Subotica, 1994.
Islami H., *Reality demographic in Kosova,* Kosova Information Center, Prishtinë, 1994.
Islami H, *Rrjedha demografike shqiptare,* Dukagjini, Pejë, 1994.
Islami H., "Manipulimet në fushën e demografisë me synime të rrudhjes së dimensionit demografik shqiptar", në librin *Gjenocidi dhe aktet gjenocidiale të*

pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndej, ASHAK, Prishtinë, 1995.
Islami H., "Shqiptarët në diasporë", *Studime,* 1/1994, ASHAK, Prishtinë, 1995.
Islami H., "Kolonizimet serbe të Kosovës dhe eksodi i shqiptarëve", *Studime,* 2/1995, ASHAK, Prishtinë, 1996.
Islami H., "Nataliteti dhe riprodhimi biologjik në shoqërinë kosovare", Studime, 3/1996, ASHAK, Prishtinë, 1997.
Islami H., *Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës,* ETMMK, Prishtinë, 1997.
Islami H., "Kosova dhe Serbia: një paralele në raportet demografike sot dhe në të ardhmen", *Studime,* 4/1997, ASHAK, Prishtinë, 1998.
Islami H., *Evolucioni dhe transicioni demografik,* Dukagjini, Pejë, 1999.
Islami H., "Kontraverzat rreth planifikimit të familjes dhe riprodhimit të popullsisë", *Studime,* ASHAK, Prishtinë, 2001.
Islami H., "Rjedhat demografike në Kosovë dhe shoqëria civile", *Antologjia e shoqërisë civile,* Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Prishtinë, 2001.
Islami H., "Le Kosovo: un centre névralgique de la péninsile balkanique", *Bulletin de la Société de géographie de Toulouse,* No 281, Toulouse, 2001.
Islami H., "Gjenocidi serb mbi qenien ertnodemografike shqiptare", *Gjenocidi i pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve '90,* ASHAK, Prishtinë, 2001.
Islami H., *Spastrimet etnike (Politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve),* Dukagjini, Pejë, 2003.
Ismajli R., *Rrënjë e fortë,* Rilindja, Prishtinë, 1978.
Ismajli R., "Shqiptarët dhe Evropa Juglindore", *Thema, 11*, Prishtinë, 1993.
Izabrana dela Miroslava Krleže u deset knjiga, Deset krvavih godina, Sloboda, Beograd, 1977.
Izvori velikosrpske agresije, Rasprave-dokumenti, (Red. Čović B.), A. Cesarec-Školska knjiga, Zagreb, 1991.
Janjić D., "Srbija između krize identiteta i izazova modernizacije", në *Srbija između prošlosti i budućnosti,* Beograd, 1995.
Jireček K.-Radonić J., *Istorija Srba, II,* Beograd, 1952.
Jochalas T., *Dissertationes Albanicae,* Trophenik, Munchen, 1971.
Kamsi K., "Dyndjet e shqiptarëve n'Itali", *Bota Shqiptare*, 1943.
Kanuni i Lekë Dukagjinit, Përmbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1972.
Kazasis K., "Greek and Arvanitika in Corinthia", *Balkanistica*, Occasional Papers in Southeast European Studies, III, 1976.
"Kina: Jedan par - jedno dijete", *Žena*, br. 5, Zagreb, 1987.
"Konventa jugosllavo-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve", *Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave historike, XII,* Prishtinë, 1982.
Kostić M., "Arnautsko naselje u Sremu", *Južna Srbija, III*, Skoplje, 1923.
Kostić M., "Prilozi istoriji srpsko-arbanaškog ustanka 1689-1690", *Arhiv za arbansku starinu, jezik i etnologiju*, II, Beograd, 1924.

Krasnići, M., *Savremene društveno-geografske promene na Kosovu i Metohiji,* GMKM, Priština, 1963.

Krasniqi M., "Organizimi i jetës shoqnore në nji familje të madhe në rrethin e Pejës", *Përparimi,* nr. 5, Prishtinë, 1959.

Krasniqi M., *Gjurmë e gjurmime*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1979.

Krizman B., "Elaborat dr Ive Andrića o Albaniji iz 1939", *Časopis za suvremenu povijest, II,* Zagreb, 1977.

Krstić B., *Kosovo izmedju istorijskog i etničkog prava*, Kuća Vid, Beograd, 1994.

Krstić B., *Kosovo pred sudom istorije,* Beograd, 2000.

Krstić Đ., *Kolonizacija u Južnoj Srbiji*, Bosanska pošta, Sarajevo, 1928.

La situation de la minorité albanaise en Yougoslavie (Memoire presenté à la Société des Nations par Don Bisaku, Don Etienne Kurti et Don Louis Gashi), Genève, le 5 mai 1930.

Landry A., *La révolution démographique (Études et essais sur les problèmes de la population),* Librairie Sirey, Paris, 1934 (réédition) INED, Paris, 1982

Landry A., *Traité de démographie,* Payot, Paris, 1949.

Le Bras H., *Child and family, Demographic Developement in the OECD countries,* OECD, Paris, 1979.

Lee E., "A theory of migration", *Demography No 3,* Chicago, 1966.

L'État du monde 2004, La Découverte, Paris, 2003.

"Le plan d'action mondial de la population", *Population,* No 1, INED, Paris, 1975.

"Le Congrès général de l'Union internationale pour l'étude scientifique de la population", Liège, 27 août-1er septembre 1973, *Population,* No 1, INED, Paris, 1974.

Leridon H., et Menken J. (sous la dir. de) *Natural fertility/ Fécondité naturelle. Niveaux et déterminants de la fécondité naturelle,* Liège, Ordina, 1979.

Les grandes tendances du monde, 2003, IFRI-Dunod, Paris, 2003.

Limani M., *Investicije i privredni razvoj Socijalističke Autonomne Pokrajine Kosovo,* Priština, 1980.

Livada S., "Socijalno-demografske promjene u selu i poljoprivredi", *Sociologija sela, b*r. 99-100, Zagreb, 1988.

Livi Bacci M., "Définition de crises de mortalité: théorie, pratique, méthodes", *Prilozi demografskim i ekonomskim naukama,* SANU, Odeljenje društvenih nauka, Knj. 103, Beograd, 1994.

Lorimer F., *Culture and Human Fertility,* UNESCO, Paris, 1954.

Luarasi A., *Marrëdhëniet familjare,* Luarasi, Tiranë 2001.

Lleshi Q., *Qytetet e Kosovës. Studim urbanologjik*, FSHMN, Prishtinë, 1977.

Macura M., "Kriterijumi za razgraničenje gradskog i seoskog stanovništva", *Statistička revija*, br. 3-4, Beograd, 1954.

Macura M., "Predpostavke, načela i ciljevi populacione politike" në: *Problemi politike obnavljanja stanovništva u Srbiji, Demografski zbornik,* Knj. I, SANU, Beograd, 1989.

Malcolm N., *Kosova - një histori e shkurtër,* Koha, Prishtinë, 1998.

Maliqi Sh., "Nacionalizmima treba vaditi kvadratni koren", *Thema, 7*, Prishtinë, 1986.

Maliqi Sh., *Nyja e Kosovës*, Knjižna zbirka KRT, Ljubljana, 1990.
Malthus R. Th., *Essay on the Principle of Population,* London, 1798.
Malthus R. Th., *Essai sur le principe de population* (traduction), INED, Paris 1980.
Maksimović B., "Prelazak poljoprivrednog stanovništva u nepoljoprivredne delatnosti", *Stanovništvo*, br. 1, CDI, IDN, Beograd, 1963,
MeEvedy C.-Jones R., *Atlas of World Population History,* Penguin Books, Harmondsworth, 1978.
Meadows D. H. etj., *The Limits to Growth*, Universe Books, New York, 1972.
Medows D., *Granice rasta,* Stvarnost, Zagreb, 1975.
Memorandum SANU (1986), Naše teme, 1-2, Zagreb, 1988.
Mendras H., *Sociétés paysannes,* A. Colin, Paris, 1976.
Meslé F.-Vallin J., "La mortalité dans le monde: tendances et perspectives", *Les dossiers du CEPED*, No 30, Paris, 1995.
Milaj J., *Raca shqiptare (studim antropologjik e historik)*, Tiranë, 1944.
Miljovski K., "Bitnije demografske izmene i elementi populacione politike", *Ekonomska misao*, br. 3, Beograd, 1974.
Mirdita Z., *Studime Dardane,* Rilindja, Prishtinë, 1979.
Molević S., "Homogena Srbija", *Zbornik dokumenata i podataka o narodnooslobodilačkom ratu naroda Jugoslavije, XIV,* knjiga 1, Dokumenti četničkog pokreta Draže Mihailovića 1941-1942, Vojnoistorijski institut, Beograd, 1981.
Mufaku M., *Shqiptarët në botën arabe (Shek. XVIII – fillimi i shek. XX),* Rilindja, Prishtinë, 1990.
Nasse Nicholas G., *The Italo-Albanian Villages of Southern Italy*, National Academy of Sciences - National Research Council, Publication 1149, Washington, 1964.
Naugier L., *Géographie humaine préhistorique,* Paris, 1959.
Njegić R., *Prirodno kretanje stanovništva NR Srbije od 1863. do 1954. godine, Prikazi 20,* Zavod za statistiku Srbije, Beograd, 1957.
Noin D., *Géographie de la population,* Masson, Paris-New York-Barcelone-Milan, 1979.
Noin D., *La transition démographique dans le monde,* PUF, Paris, 1983.
Noin D., Atlas de la population mondiale, 2 ème éd., Paris, 1996.
Noli S. F., "Një tragjedi në tri akte: çpasurim, çpërngulje, çfarosje", *Liria Kombëtare*, nr. 110, 10 prill 1929, Gjenevë.
Noli S. F., *Vepra*, 3, Rilindja, Prishtinë, 1988.
Notestein F., "Population – The Long Wiew", in T. Shultz (éd.), *Food for the World,* University of Chicago Press, Chicago, 1945.
Obradović M., *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918 - 1941)*, Institut za istoriju Kosova, Priština, 1981.
Ocena nekih definicija i klasifikacija u popisu stanovništva 1971. godine, CDI, IDN, Beograd, 1976.
Osnovi populacione politike: ciljevi, institucije, mere, Demografski zbornik, Knj. IV, SANU, Beograd, 1997.
Ostreni A., *Gjeografia e Shqipërisë,* Tiranë, 1976.
Paillot P., *Problèmes démographiques d'aujourd'hui,* Hatier, Paris, 1976.

Paulet J.-P., *Géographie urbaine,* A. Colin, Paris, 2000.

Pavlik Z., "Les problèmes de la révolution démographique", *IUSP Population Conference, Contributed Papers,* Sidney, 1967.

Penev G., "Projekcije stanovništva Savezne republike Jugoslavije, 1991-2150. u kontekstu dugoročnih projekcija stanovništva sveta", *Stanovništvo,* 1-4/1992 - 1-2/1993, CDI, IDN, Beograd.

Penev G., "Područja Srbije bez prirodnog priraštaja stanovništva. Analiza po naseljima za 1991. godinu", *Demografske sveske,* 24, CDI, IDN, Beograd, 1995.

Penev G., "Tendencije i osobine fertiliteta", *Žena i radjanje na Kosovu i Metohiji,* CDI, IDN, Beograd, 1998.

Perović L., "Yugoslavia was defeated from inside", in S. Biserko (éd.), *Yugoslavia: Collaps, War, crimes, Center for Antiwar Action,* Belgrade, 1993.

Personat e shpërngulur nga Kosova dhe personat e ardhur në Kosovë, Buletinat 25, 50, 72, 89, 109 dhe 125, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1984-1989.

Petrović R., "Socijalne i ekonomske determinante mortaliteta", *Ekonomska misao*, br. 3, Beograd, 1974.

Plavec A., *Smrtnost stanovništva u Jugoslaviji 1950-1964, Studije, analize i prikazi,* 37, SZS, Beograd, 1968.

Pollo S., et Puto A., *Histoire de l'Albanie des origines à nos jours,* Editions Horvath, Paris, 1974.

Popis stanovništva i stanova 1971. Domaćinstva i porodice, knj. V, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1974.

Popis stanovništva i stanova 1971. Pismenost i školovanost, Knjiga II, Zavezni zavod za statistiku, Beograd, 1974.

Popis stanovništva, domaćinstava i stanova u 1981. godini. Nacionalni sastav stanovništva po opštinama, Statistički bilten 1295, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982.

Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 1981 (Žene stare 15 i više godina prema vitalnim, etničkim, obrazovnim i ekonomskim obeležjima u SAP Kosovu), Bilten 47, Pokrajinski zavod za statistiku, Priština, 1984.

Popis '94, Podatoci za segašnosta i idninata. Prvi rezultati. Soopštenie 1, Soopštenie 2, SZS, Skopje, 1994.

Statistički dogišnik na Republika Makedonija, Državen zavod za statistika, Skopje, 2003.

Popis stanovništva iz 31. marta 2002. godine, RZS, Beograd, 2003.

Popis stanovništva od 1. novembra 2003, Republički zavod za statistiku Crne Gore, Titograd, 2004.

Popisi stanovništva 1948-1991 (publikime të ndryshme), SZS, Beograd.

Population Today, Population Reference Bureau, Washington, 1966.

Poursin J.-M., La population mondiale, Editions du Seuil, Paris, 1976.

Pressat R., *Démographie sociale,* PUF, Paris, 1978.

Pressat R., *Dictionaire de démographie,* PUF, Paris, 1979.

Pressat R., “Mesures antinataliste en Chine”, *Population*, No 4, INED, Paris, 1979.
Prethodni rezultati Popisa stanovništva u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca 31. januara 1921, Državna štamparija, Sarajevo, 1924.
Prilozi demografskim i ekonomskim naukama, SANU, Odeljenje društvenih nauka, Knj. 103, Beograd, 1994.
Prirodno kretanje stanovništva Srbije od 1863-1954. godine, Prikazi 20, Zavod za statistiku NR Srbije, Beograd, 1957.
Prirodno kretanje stanovništva prema nacionalnom sastavu u periodu 1980-1990, SZS, Beograd, 1992.
Problemi politike obnavljanja stanovništva u Srbiji, Demografski zbornik, Knj. I, SANU, Beograd, 1989.
“Program of the Radical Party”, *Yugoslav Survey*, XXXIV, 1, Belgrade, 1993.
Projekcije stanovništva Savezne republike Jugoslavije 1991-2021, SZS, CDI, IDN, Beograd, 1996.
Prvi rezultati popisa stanovništva NR Srbije od 31. III. 1953. godine, Zavod za statistiku i evidenciju NR Srbije, Beograd, 1953, Serija B, sv. 3.
Pulaha S., *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI,* Tiranë, 1984.
Pulaha S., "Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shekujve XV-XVI, *Studime historike,* nr. 3, Tiranë, 1985.
Pulaha S., "Qytetet e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës të shek. XVI në dritën e të dhënave të reja të regjistrimeve kadastrale osmane", *Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike,* IX/1979, Prishtinë, 1980.
Pulaha S., *Luftërat shqiptaro-turke në shekullin XV (Burime osmane),* Tiranë, 1968.
Puljiz V., *Eksodus poljoprivrednika,* Zagreb, 1977.
Pushka A., “Latentni suvišak poljoprivrednog stanovništva u SAP Kosovo”, *Sociologija sela*, br. 73/74, Zagreb**,** 1981.
Pushka A., “Porast stanovništva kosovskih gradova”, *Stanovništvo*, Nr. 3-4/1990 – 1-2/1991, CDI, IDN, Beograd.
Ćosić D., *Stvarno i moguće. Članci i ogledi,* O. Keršovani, Rijeka, 1982.
Ćosić D., *Kosovo* (red. Ana Ćosić-Vukić), Novosti, Beograd, 2004.
Raduški N., "Karakteristike i značaj neposrednih faktora fertiliteta stanovništva", *Stanovništvo*, br. 3-4/1993 - 1-2/1994, IDN, CDI, Beograd, 1994.
Raina B. L., "Population Policy in India", *IUSP Conference*, London, 1969.
Randić Lj. – Andolšek L. , *Planiranje obitelji,* Rijeka, 1984.
Rapper de G., *Les Albanais à Istambul,* Institut français d’études anatoliennes G. Dumézil, Istambul, 2000.
Rašević M., *Determinante fertiliteta stanovništva Jugoslavije,* CDI, IDN, Beograd, 1971.
Rašević M., "Kretanje stanovništva sveta sa osvrtom na modernu epohu", *Ekonomska misao,* 3, Beograd, 1974.
Rašević M., “Planiranje porodice kao stil zivota”, *Stanovništvo*, nr. 3-5, CDI, IDN, Beograd, 1996.
Ravenstein E. G., *The Theory of Migration*, Journal of the Statistical Society, No 48, VI, London, 1895.

Razvitak stanovništva Jugoslavije u posleratnom periodu, CDI, IDN, Beograd, 1974.
Razvitak stanovništva Srbije 1950-1991, CDI, IDN, Beograd, 1995.
Recent demographic developments in Europe 2000, Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2000.
Reedman R., "Fertility Determinants", *në: Cleland J. and Scoth C. (eds.), The Ëorld Fertility Sauvy, an assessement,* Clarendon Press, Oxford, 1987.
Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave, Buletini 17, EKS, Prishtinë, 1982.
Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive shtëpiake dhe i banesave më 1981, Buletini 21, EKS, Prishtinë, 1982.
Regjistrimet e popullsisë 1948-1981 (publikime të ndryshme), EKS, Prishtinë.
Reinhard M.-Armangaud A.-Dupâquier J., *Histoire générale de la population mindiale,* III éd., Montchrestien, Paris, 1968.
Rezolucija o planiranju porodice, Savezna skupstina, Beograd, 25. Aprila 1969 (ac br. 1185).
Rexhepagiq J., *Zhvillimi i arësimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në teritorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*, ETMM i KSAK, Prishtinë, 1970.
Rockfeller J. D., 3rd, "Population Groëth: The Rate of Developid World", *Lecture Series on Population*, International Union for the Scientific Study of Population, Bucharest, 1979.
Roux M., *Les Albanais en Yougoslavie*, Editions de la maison de sciences de l'homme, Paris, 1992.
Roux M., *Le Kosovo (Dix clés pour comprendre),* La Découverte, Paris, 1999.
Roux M., "Lo scenario bosniaco: pulizia etnica e spartizione territoriale", *Limes,* Rivista italiana di geopolitica, 1-2, Roma, 1993.
Roux M., "La 'purification ethnique'. Théorie et pratique", *Nations et nationalismes*, La Découverte, Paris, 1994.
Rushiti L., *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912 - 1918*, Prishtinë, 1986.
Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku, br. 024, Beograd, 31.01.1997.
Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku, br. 052, Beograd, 1998.
Sauvy A., "Le vieillessement de population et l'alongement de la vie", *Population,* No 4, INED, Paris, 1954.
Sauvy A., *De Malthus à Mao Tse-Tung. Le problème de la population dans le monde,* Danoël, Paris, 1958.
Sauvy A., *Théorie générale de la population (La vie des populations),* Vol. II, PUF, Paris, 1966.
Sauvy A., "Le deuxième congrès mondial de la population", Belgrade, 30.08 – 10.09.1965, *Population,* No 6, INED, Paris, 1965.
Sauvy A., *La prévention des naissances,* PUF, Coll. "Que sais-je?", No 988, 3 ème éd., Paris, 1967.
Sauvy A., "La Conférence mondiale de la population à Bucarest", 19-30.08.1974, *Population,* No 6, INED, Paris, 1974.
Scaglione P., *Historia e shqiptarëve t'Italisë*, Saravulli. New York, 1921.

Scura A., *Gli Albanesi in Italia*, Saggi e reviste, Milano, 1865.
Singly de F., *Sociologie de la famille contemporaine*, Sociologie 128, Nathan Université, Paris, 1993.
Simeunović V., *Stanovništvo Jugoslavije i socijalističkih republika 1921-1961,* Studije, analize i prikazi, br. 22, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1964.
Sinadinovski J., "Osnovne strukturalne promene stanovništva SR Makedonije u posleratnom periodu razvitka", *Cvijićev zbornik*, SANU, Beograd, 1968.
Skendo L., "Popullsia Shqiptare më 1922 jashtë Shqipërisë", *Kalendari Kombiar*, 1926.
Sociološka studija grada Prištine, Ekonomski institut, Priština, 1986.
Sorre M., *Les migrations des peuples (Essai sur la mobilité géographique)*, Flammarion, Paris, 1955.
Srbija i Albanci. Pregled politike Srbije prema Albancima od 1878. do 1914. godine, Knjiga prva, Časopis za kritiko znanosti (izredna števila), Ljubljana, 1989.
Srbija i Albanci. Pregled politike Srbije prema Albancima od 1913. do 1945. godine, Knjiga druga, Časopis za kritiko znanosti (izredna števila), Ljubljana, 1989
Srbija i Albanci. Pregled politike Srbije prema Albancima od 1944. do 1989. godine, Knjiga treća, Časopis za kritiko znanosti (izredna števila), Ljubljana, 1989.
Srbija između prošlosti i budućnosti - Uzroci i obeležja društvene i političke situacije izmedju 1987-1994. i mogućnosti demokratizacije, Institut društvenih nauka, Forum za etničke odnose, Beograd, 1995.
Stadtmuller G., "Historia Shqiptare në pikëpamje të Kombsis si problem gjurmimesh", *Hylli i Dritës*, Shkodër, 1942.
Stanovništvo i domaćinstva SR Srbije prema popisu 1981, RZSS, Beograd, 1984.
Stanovništvo predratne Jugoslavije po veroispovesti i maternjem jeziku po popisu 1931. godine (nepublikovano izdanje), Državni statistički ured DF Jugoslavije, Beograd, 1945.
Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47, SZS, CDI, IDN, Beograd, 1995.
Stanulović-K.N., "Porodica i njena reproduktivna funkcija u savremenom društvu", *Socijalna politika*, nr. 11-12, Beograd, 1987.
Stanje i mogućnost razvoja privrede Kosova i Metohije, Priština, 1957.
Stassart J., *Malthus et la population,* Liége, 1957.
Statistikat vitale të Kosovës 2002-2003, Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2004.
Statistički godišnjak Jugoslavije (numra të ndryshëm), SZS, Beograd.
Statistički godišnjak Jugoslavije (numra të ndryshëm), SZS, Beograd.
"Statistički prilozi", *Stanovništvo*, CDI, IDN, br. 1-4/1992 dhe 1-2/1993, Beograd, 1993.
Stipčević A., *Iliri,* Zagreb, 1974.
Stojkov N., "Mortalitet dece od tuberkuloze u Jugoslaviji od 1951-1962. godine", *Stanovništvo,* br. 4, CDI, IDN, Beograd ,1964.

Supek I., *Krivovjernik na ljevici*, Globus nakladni zavod, Zagreb, 1992.
"Svetska konferencija o stanovništvu u Beogradu 1965", *Stanovništvo,* nr. 4, CDI, IDN, Beograd, 1965.
"Svetska konferencija o stanovništvu", Bukurešt, 19-30. avgust 1974, *Stanovništvo*, 3-4/1974 – 1-2/1979, CDI, IDN, Beograd, 1974.
Sheps C. M., "An Analysis of Reproductive Patterns in an American Isolate", *Populations Studies*, XIX, No 1, London, 1965.
Sheri, F., *Fjalori enciklopedik i demografisë,* Botime enciklopedike, Tiranë, 1997.
Shqipnia përpara Konferencës së Paqës, Ble i Parë (dokumenta zyrtarë të paraqitun nga ana e Dërgatës Shqiptare, qyshë prej 12 Shkurt e deri më 5 Qershor 1919, e të botuem nga ana e Qeverriës së Përkohshme), Roma, 1919.
Šifrer Ž., "Razvitak stanovništva Slovenije u poslednjih sto godina", *Stanovništvo,* br. 3, CDI, IDN, Beograd, 1963.
Škara Lj., "Nepismenost - dug pratilac društveno-ekonomskog razvoja SR Srbije", *Kultura*, nr. 19, Beograd, 1972.
Šufflay M., "Povijest sjevernih Arbanasa", *Arhiv za Arbanašku starinu, jezik i etnologiju,* knjiga II, Beograd, 1925.
Šuvar S., *Između zaseoka i megalopolisa*, I, Zagreb, 1973.
Tabah L., "Le congrés mondial de la population", Rome, 31-08 – 10.09.1954, *Population*, No 2, INED, Paris, 1955.
Tabutin D. – Eggerickx T. – Gourbin C., *Transitions démographiques et sociétés,* Actes de la Chaire Quetelet 1992, Louvain-la-neuve, Academia-L'Harmathan, 1995.
Tapinos G., *La Démographie (Population, économie et sociétés),* INÉDIT, Sciences sociales, Paris, 1977.
Tapinos G., *Éléments de démographie,* A. Colin, Paris, 1985.
Tapinos, "Migrations internationales et dévelopement", *Bulletin démographique des Nations Unies*, No 36, New York, 1995.
Tërnava M., *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI,* Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1995.
Tërnava M., "Migrimet e popullsisë në territorin e sotëm të Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI", *Kosova,* 5, Prishtinë, 1976.
Tërnava M., "Shqiptarët në qytetet e Kosovës në shek. XV-XVI", *Studime historike,* nr. 2, Tiranë, 1979.
Tërnava M., *Studime për mesjetën,* Dukagjini, Pejë, 2000.
The State of World Population, 1996, UNFPA, New York, 1996.
The Population of Yugoslavia, The Demographic Research Center, Institute of Social Sciences, Belgrade, 1974.
The Lausanne Principe: Multiethnicity, Territory and the Future of Kosovo's Serbs, *European Stability Initiative (ESI*), Berlin/Pristina, June 7, 2004.
Tietze C., "Reproduktive Span and Rate of Reproduction among Hutterite Women", *Fertility and Sterility*, 1957.

Thompson W., *Population and Peace in the Pacific,* University of Chicago Press, Chicago, 1946.

Thumerelle P.-J., *Les populations du monde,* Nathan, Paris, 1996.

Todorović G., "Dejstvo aktivnosti i obrazovanja žene na njeno radjanje i stav o njemu na području SR Srbije", *Stanovništvo,* nr. 1, CDI, IDN, Beograd, 1984/85.

Todorović G., *Projekcije stanovništva (teoretsko-metodoloska studija),* CDI, IDN, Beograd, 1978.

Tomšič V., "Planiranje porodice i populaciona politika", në: *Izgradnja društvenih stanova o populacionoj politici u Jugoslaviji, Beograd, 1985.*

Uka S., "Vendbanimet e Sanxhakut të Nishit të banuara me popullatë shqiptare dhe të përzier në vitet 1877/78", *Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave historike, XII,* Prishtinë, 1983.

Uka S., *Dëbimi i shqiptarëve nga sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Kosovë 1878-1912,* librat 1+2, 3, Valton, Prishtinë, 1994.

United Nations, *The World Population Situation in 1970,* Populations Studies, No 49, Department of Economic and Social Affairs, New York, 1971.

United Nations, *Causes et conséquences de l'évolution démographique,* New York, 1971.

United Nations, *The Determinants and Consequences of Population Trends,* Vol. I, New York, 1973.

United Nations, *Population Bulletin,* No 6, New York, 1963.

United Nations, *Dictionaire démographique multilingue,* Vol. français, UIESP, Liège, 1981.

United Nations, *Višejezički demografski rečnik (srpskohrvatska verzija),* CDI, IDN, Beograd, 1971.

United Nations, W*orld Population Conference*, Volume I, Sammary Report, New York, 1965.

United Nations, W*orld Population Trends and Policies 1987,* New York 1988.

United Nations, *Causes et conséquences de l'évolution démographique,* New York, 1973.

United Nations, *Population Growth and Economic Development,* Resolution No 1838, New York, 18 December 1962.

United Nations, *Program of Actions of the United Nations International Conference on Population and Development,* International Conference on Population and Development, Cairo, 5-13 September 1994.

United Nations, *Convention on the Prevention and the Crime of Genocide (1948), Humans Rights: A Compilation of International Instruments,* New York, 1988.

United Nations, W*orld Population Prospects,* New York, 1991.

United Nations, *Long-rang World Population Projections. Two Centuries of Populations Growth, 1950-2150,* New York, 1992.

United Nations, World Urbanization Prospects 1994, New York, 1995.

United Nations, W*orld Population Prospects, The 1994 Revision,* New York, 1994.

Ustav Socijalističke Federativne Republike Jugoslavije, Beograd, 1974 (neni 191).

Varagnac A., *L'homme avant l'Histoire,* Paris, 1959.

Vasić D., *Dva meseca u Jugoslovenskom Sibiru*, Gece Kona, Beograd, 1921.
Vikers M., *Çështja çame*, Prishtinë, 2002.
Visnjevskij A. G., *Demograficeskaja revolucija,* Statistika, Moskva, 1976.
Vjetari Statistikor i Kosovës, I-XIV, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1976-1990.
Vjetari Statistikor i RPSH 1969 dhe 1970, Drejtoria e Statistikës, Tiranë, 1970.
*Vjetari Statistikor i RPS të Shqipërisë,*1990, Tiranë, 1991.
Willcox W. W., *Studies in American Demography,* Cornell University Press, Ithaca, 1940.
Vogelnik D., "Slovenski demografski trenutek: 1750-2000", *Ekonomska revija*, nr. 3-4, Ljubljana, 1982.
Xoxi K., *Shqiptarët dhe Garibaldi*, Rilindja, Prishtinë, 1983.
Zajmi G., *Vepra, 3,* Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2003.
Zamputi I., *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII*, vëll. I, Tiranë, 1963.
Zangari D., *Le Colonie Italo-Albanesi di Calabria. Storia e Demografia Secoli XV-XIX,* Caselli, Napoli, 1940.
Zbornik Kosovo-Srbija-Jugoslavija, KRT, Ljubljana, 1989.
Zimmermann W., *Burimet e një katastrofe*, Botime për shoqëri të hapur, Tiranë, 1996.
Zllatku R., *Me arbëreshët*, Rilindja, Prishtinë, 1976.
Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror i KSA të Kosovës 1947-1972, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1974.
Žena i radjanje na Kosovu i Metohiji, CDI, IDN, Beograd, 1998.
Žuljić S., "Antropogeografske podvale Jovana Cvijića", *Izvori velikosrpske agresije,* Rasprave-dokumenti, (Red. B. Čović), A. Cesarec-Školska knjiga, Zagreb, 1991.

INDEKSI I EMRAVE

A

Abdyli R., 285
Abramowich M., 345, 507
Academic Press, 29, 62
Acsádi G., 24, 563
Ademaj E., 305
Agani F., 299, 305, 563
Ahtisari M., 497, 499, 500, 501, 502, 505, 507, 509, 510, 511
Ajeti I., 131, 196
Almagia R., 415, 563
Altimari F., 419, 422, 563
Anakiovski D., 266, 425, 428, 563
Anamali S., 196, 563
Andolšek L., 117
Andriq I., 293, 294, 295
Aničić Z., 213
Arkani R., 198
Armengaud A., 22, 24, 26, 27, 28, 29, 30, 67, 135, 563
Arsh G. L., 197
Art Club, 249
ASHAK, 131, 493
Atika, 313
Audirac P. A., 112, 563
Avelino, 419
Avramov D., 112, 199, 563
Avramovski V., 480, 481

B

Bakraçi Xh., 210, 563
Bajrami V., 431, 432, 563
Balaj V., 423
Baletić-W. A., 14, 51, 62, 64, 65, 67, 75, 118, 119, 140, 221, 563
Bardet J.-P., 27, 30
Barjaktareviq M., 194
Barleti M., 159
Ban M., 352, 563
Bartolo de G., 421, 564
Barbarich E., 418, 564
Basha T., 480
Bashota N., 209, 211, 564
Batakoviq D., 345
Beaujeu-G. J., 385, 564
Becker G. S., 112, 564
Beçkoviq M., 303
Bella knjiga, 289
Bella ruka, 273, 274
Berisha A., 250, 564
Berisha K., 494
Beta, 511
Bettelheim B., 384
Bianco L., 123, 564
Biraben J.-N., 22, 24, 26, 135, 564
Bisaku Don, 274, 283,
Biserko S., 305, 564
Blake J., 62, 566
Blayo Y., 27, 54, 120, 121, 122, 123, 125, 354, 564
Bogdanović D., 192, 276, 564
Borba, 320
Bosanska pošta, 284, 343
Bota Shqiptare, 414, 416, 564
Botimet enciklopedike, 227
Bourgeat S., 23, 564
Bout de Marnhac X., 336
Bras C., 23, 564
Brestovci S., 197
Breznik D., 14, 24, 36, 51, 63, 67, 86, 91, 117, 118, 129, 140, 149, 151, 152, 174, 181, 213, 352, 445, 446, 448, 449, 453, 565
Buda A., 280, 565

Bulatao R., 29, 565
Bylykbashi Z., 242

C

Cairo, 43, 54, 125,
Caldwel J., 62
Cana Z., 424
Carr-Saunderrs A. M., 24, 36, 38, 42 565
Castro D. J., 114, 565
CDI, 14, 24, 30, 43, 50, 51, 52, 54, 62, 63, 66, 67, 69, 84, 87, 92, 93, 95, 98, 101, 120, 124, 129, 131, 132, 140, 141, 148, 153, 155, 159, 160, 162, 171, 174, 175, 199, 203, 217, 132, 243, 266, 267, 352, 353, 355, 388, 391, 443, 444, 451, 453
Ce Duni M., 120, 121, 125
CEPED, 134, 136
Chaire, 65
Cipolla C., 67, 565
Claredon Press, 62
Cleland J., 62
Chesnais J.-C., 14, 26, 27, 565
Chicago, 26, 62, 74
Chine, 54
Chronos, 117, 151, 352, 448
CIA, 308
Ciampi G., 415, 565
Cliquet R., 110, 112, 565
Coale A., 106, 565
Contarini C., 197
Colin A., 12, 32, 39, 118, 134, 146, 385
Cornell Yniversity Press, 24, 38, 42
Courgeau D., 115, 565
Croll E., 123, 565
Crna ruka, 273, 274
Curri B., 320
Cvijić (Cvijiqi) J., 8, 194, 257, 271, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 281, 288, 293, 331, 343, 414, 424, 503, 565, 566
Cvijićev zbornik, 181, 272, 267, 425

Ç

Çabej E., 196, 409, 410, 413, 415, 416, 418, 419, 420, 422, 423, 424, 565
Çajupi, 423
Çamëria, 414, 421
Çeku A., 496
Çoviq N., 343, 344, 345, 474, 503, 507
Çubrilloviq V., 257, 289, 290, 292, 294, 295, 296, 297, 298, 299, 304, 310, 326, 331, 428

Č

Časopis za kritiko znanosti, 82, 283, 285, 286, 314, 321, 428
Čović B., 275, 281, 294, 566, 570
Čelebi E., 197, 566
Čengić E., 298, 566
Čubrilović V., 257, 289, 566

Ć

Ćosić D., 126, 307, 341, 342, 574

D

Daci N., 493, 494
Dalmaci, 9, 423
Danas, 128, 265
Danoël, 32
Davis K., 26, 62, 566
Dejtoni, 309
Demeny P., 53, 124, 566
Demaçi, 478
Demiraj Sh., 191
Demografske sveske, 87, 127, 129, 140, 160
Demografski zbornik, 118, 119, 126, 203

Dermaku I., 422, 423, 566
Desnickaja A., 415, 419, 423, 566
Deville J.-C., 101, 566
Desplanques G., 101, 566
De Jong G. F., 62, 567
Dimnik J., 191
Dolanc S., 126, 258
Dollot L., 255, 407, 566
Dora e Bardhë, 273
Dora e Zezë, 273, 274
Drakulić S., 128, 265, 566
Draga N., 249, 250, 566
Draganović K., 197
Drašković V., 198, 281
Drejtoria e statistikës, 83, 92, 135, 140, 151
Državna štamparija, 158, 324
Duka V., 432, 566
Dukagjini, 73, 76, 123, 138, 154, 159, 191, 192, 200, 206, 241, 250, 272, 273, 274, 283, 289, 292, 293, 294, 295, 302, 303, 305, 332, 466
Dumond G. F., 567
Duncan O. D., 14, 568
Durham E., 274, 566
Dupâquier J., 12, 22, 27, 30, 135, 564, 566
Durand D. J., 22, 24, 36, 566
Dushan S., 412
Dushi M., 58, 567

Đ

Đošić D., 221
Đurić V., 361, 375, 378, 566

E

Economia, 210
Économie et humanisme, 114,
Économie et statistique, 101, 112
Éditions Esprit, 306
Éditions de Fallois, 64, 84
Ekonomski institut, 315
Ekonomski zbornik, 67
Eggerickx T., 27, 65
Ehrlich P., 12, 511
Erlich St. V., 76, 234, 236, 511
Ekonomska misao, 25, 51, 98, 107, 118, 153, 224
Ekonomska revija, 61, 65, 447
Elsie R., 274
Engels F., 22, 249, 350, 567
EKS, 184, 186, 236, 382
Enti Krahinor i Statistikës, 135, 137, 138, 146, 148, 183, 223, 224, 228, 232, 364
Enti Statistikor i Kosovës, 154, 212, 356, 487, 488, 489, 490, 494, 512, 514
ESI, 270, 335, 336, 346, 475, 504, 567
ESK, 90, 92, 94, 102, 137, 158, 485, 486
ETMMK, 127, 132, 197, 371
Eube, 413
European Journal of Population, 53, 112, 124,
Eversly D. E. C., 22
Everts D., 477
Express, 511

F

Fair Laun, 24, 36, 38, 42
FAO, 28, 46
Fayard, 15, 27
Festy P., 28, 66, 71, 108, 567
Filat, 414
Filipović M., 194
Filipsoni, 413
Finkle L. Jason, 58
Finlay, 415
First R., 228, 567
Flammarion, 217, 407
Follorina, 414
Ford. T. J., 62, 511
Fourastié J., 11, 12, 24, 567

Franxe Gj., 413
Frashëri S., 418, 429
Freedman R., 62, 567
Friedman V., 243, 567
Friganović M., 26, 32, 37, 270, 294, 354, 444, 567
Frojndlih L., 274, 567
Freundlich L., 274

G

Gaćeša Lj., 451, 567
Gashi A., 242, 270, 567
Gallimard, 28
Garašanin I., 271, 276, 277, 279, 285
Gashi L. D., 274, 283
George P., 407, 567
Gendrean F., 136
Geographica Slovenica, 393
Giordano E., 420, 567
Ginić I., 98, 355, 567
Glas kanadskih Srba, 331
Glass V. D., 22, 567
Globus, 293, 298, 383
Golgota shqiptare, 274
Golubović Z., 109, 384, 567
Gore Al, 76, 123, 154, 567
Gourbin C., 27, 65
Grebo Z., 98, 109, 129, 567
Grković M., 197
Gurakuqi K., 413
Gurakuqi L., 320

Gj

Gjeçovi Sh., 78, 228, 234
Gjergji L., 198

H

Hadri A., 284, 285, 568
Hadžić M., 303
Hadžibegić H., 191, 195, 196, 197, 280, 568
Hadživasiljević J., 271
Haga, 309, 343
Hahn G. J., 413, 568
Hakerup H., 345, 506, 507
Hammer von J., 424, 568
Hamp P. E., 420, 568
Handžić A., 191, 195, 196, 197, 280, 568
Haradinaj R., 514
Henry L., 13, 14, 75, 568
Harapi Z. M., 284
Hasani S., 299
Harmathan, 27, 65
Hatier, 23, 36, 39
Haziri L., 507, 515
Hauser Ph., 14, 568
Hermet G., 409, 568
Heršak E., 419, 568
Hërtkovci, 423
Hill K., 205
Hitleri, 270
Hodžić A., 380
Hofsten E., 51, 107, 118, 568
Homo sapiens, 5, 21, 23
Horvat B., 118, 292, 293, 568
Hou W., 122, 568
Hoxha E., 433
Hoxha F., 127
Hoxha H., 283, 285, 286, 294, 310, 311, 428, 568
Hubreht J., 306, 568
Hydra, 413
Hylli i Dritës, 413
Hyseni N., 247

I

ICG, 345
ICO, 511
IDN, 14, 24, 30, 43, 50, 51, 52, 54, 62, 63, 66, 67, 69, 71, 84, 87, 92, 93, 95, 98, 101, 120, 129, 131, 132, 140, 141, 148, 153, 155, 159, 160, 162, 174, 199, 203, 217, 232,

243, 352, 353, 388, 391, 443, 444, 451, 453
Igumenicë, 414
Ilazi H., 491, 492
Imami N., 342
INED, 12, 24, 26, 27, 43, 46, 49, 52, 54, 69, 71, 88, 118, 119, 120, 123, 124, 149, 169, 176, 266, 267, 354, 355
INEDIT, 14
Inalcik H., 195, 280
INSEE, 101, 112
INSTAT, 83, 140
Institut National d'Études Démographiques, 12, 13, 22, 30, 43, 48, 52, 54, 66, 88, 108, 112, 115, 120
IOM, 461, 480, 481, 484
Islami H., 58, 72, 73, 74, 77, 78, 84, 88, 102, 110, 127, 132, 143, 159, 179, 181, 185, 192, 194, 200, 206, 221, 224, 225, 232, 237, 241, 255, 258, 272, 273, 274, 283, 289, 292, 293, 294, 295, 302, 303, 311, 321, 332, 365, 366, 378, 389, 392, 393, 411, 466, 467, 489, 493, 567, 568, 569, 570
Ismajli R., 191, 196, 301, 339, 417, 418, 493, 494, 570
IUSPC, 46, 50, 118
Ivić P., 197

J

Janjić D., 303, 308, 570
Jarak, 423
Jedinstvo, 327, 332
Jevtić Z., 139
Jireček K., 197, 570
Jochalas T., 413, 570
Jokanović V., 331
Jorgaqi N., 422
Journal of Political Economy, 112
Jovanović E., 87
Jovićević P., 288

K

Kadriu G., 18, 488
Kalabri, 416, 417, 418, 420, 421
Kampabaso, 419
Kamsi K., 416, 570
Kanuni i LD, 78
Karaxhiq R., 346
Kastrati I., 485
Katanxaro, 419, 421
Katičić R., 196
Katundi ynë, 417
Kazasis K., 415, 570
Keilman N., 112
Keršovani O., 307
Kërkime gjeografike, 354
KFOR, 334, 336, 403
Klauzer I., 224
Klubi i Romës, 15
Koha, 197, 280
Koha ditore, 205, 336, 343
Komisioni i Badinterit, 309
Konica F., 432
Korkuti M., 196
Kosova, 195, 370
Kostić M., 197, 423, 570
Kostić G., 162
Kostur, 414
Koshtunica V., 346, 503, 504
Koushner B., 506
Kovačević E., 191, 195, 197, 280, 568
Kozenca, 410, 419, 421
Krasniqi M., 235, 571
Kristoferi K., 431
Krizman B., 294, 571
Krleža M., 277, 298, 570
Krstić B., 94, 127, 284, 337, 343, 344, 345, 455, 475, 502, 503, 571
Krstić Đ., 285, 286, 343, 571
KRT, 258, 393
Kuća VID, 127, 475
Kultura, 180, 183

Kurti E. D., 274, 283
Kuvendi i Arbënit, 418

L

La Découverte, 34, 36, 151, 271, 308
Lah A., 446
Lajm ekskluzive, 486
Landry A., 26, 66, 154, 571
Lee E., 29, 436, 571
Le Bras H., 115, 571
Leridon H., 66, 112, 571
Lleshi Q., 360, 367, 368, 386, 387, 571
Lenard Chu L., 122
Lewis H. G., 112
Liber, 76, 234
Librairie Sirey, 26, 66
Librairie Larousse, 13, 75
Lidhja, 417
Liège, 14, 43, 50, 66
Lihtenshtajn, 342
Lila A., 489, 493
Liliq Z., 198
Limani M., 210, 571
Limes, 271
Lipa S., 295
Liria Kombëtare, 286, 413
Livada S., 262, 571
Livi Bacci M., 25, 133, 571
London, 22, 62, 112, 118
Londres, 62
Lorimer F., 74, 75, 82, 110, 571
Ljubljana, 61, 82, 118
Luci R., 404
Luarasi A., 234, 571
Lutovac M., 194

M

Macura M., 126, 221, 224, 258, 355, 571
Malcolm N., 197, 198, 280, 571
Maliqi Sh., 415, 428, 571
Malthus T. R., 16, 30, 65, 572
Maksimović B., 217, 218, 572
Margëllaq, 414
Markoviq A., 318
Marković P., 217
Maqedonci S., 274
Masson, 35, 354
Mauro D., 418
McEvedy C., 22, 572
McIntosh Alison C., 58
Meadows D. H., 16, 572
Memorandum SANU, 126, 192, 272, 303, 304, 305, 323, 328, 329, 334, 343, 341, 572
Mendras H., 383, 572
Meslé F., 134, 572
Menken J., 66, 571
Mihajlović D., 294
Milaj J., 412, 413, 415, 425, 572
Millosheviq S., 176, 265, 281, 302, 303, 304, 306, 309, 310, 331, 341, 342, 377, 473, 475, 487, 501, 502, 515
Milutinović M., 200, 310, 342, 343, 476, 502
Miljovski K., 98, 572
Mirdita Z., 191, 407, 572
Misja V., 159
Mitkoja Th., 423
Mladenović M., 162
Mlladiqi, 346
Molević S., 294, 295, 572
Monsorov I., 480, 481
Montchrestien, 135
Morgan L. H., 22, 349
Mouton, 26, 135
Mufaku M., 423, 572
Mulina T., 221, 224

N

Načertanije, 271, 272
Naprijed, 109, 384
Nasse N. G., 416, 417, 418, 572

Naše teme, 126, 135, 192
Nathan, 28, 33, 40
NATO, 304, 334, 335, 336, 468, 492
Naučna knjiga, 112
Naugier L., 22, 572
Nemskeri J., 24
Nezavisna svetlost, 165
Nikinci, 423
Nikoliq R., 194
NIN, 259, 267
Noin D., 27, 35, 354, 572
Noli S. F., 286, 413, 425, 432, 572
Novaković S., 197
Nova Pazovë, 281
Novosti, 126, 341
Notestein F., 26, 74, 572
Nushi P., 311, 428
Nušić B., 413

Nj

Njegić R., 134, 572

O

Obradović M., 284, 285, 286, 572
OECD, 115
OKB, 13, 28, 34, 41, 42, 43, 45, 46, 48, 49, 50, 53, 55, 56, 57, 122, 124, 128, 134, 227, 269, 308, 447, 462, 469, 470, 482
Ordina, 66
OSBE, 205, 461, 462, 467, 469, 470, 471, 472, 473, 474, 476, 477, 479, 484
Osmani J., 284
Ostreni A., 286, 572
Oven D., 341, 504
Oxford, 62
Oxford University Press, 24, 26, 36, 38, 42

P

Paillot P., 36, 39, 572
Palermo, 410, 419
Panov M., 244, 267
Papa Gjon Pali II, 55
Pargë, 414
Paros, 413
Paroški M., 198
Pavkov S., 87
Pavlik Z., 573
Pavlović D., 268
Paulet J.-P., 385, 573
Payot, 26, 154
Pena, 72, 78, 84
Penev G., 84, 87, 101, 129, 160, 162, 203, 444, 448, 449, 453, 456, 573
Penguin Books, 22, 67
Perović L., 305, 573
Përparimi, 209, 235, 283
Peskara, 419
Pešić V., 305
Petrović R.,153, 264, 573
Peuples, 123
Pichat-B. J., 27, 69, 148, 176, 564
Plani Botëror i Aksionit, 51, 52, 53, 119, 120, 130
Plavec A., 153, 573
Pollo S., 197, 573
Pogledi, 211, 264
Poljoprivreda i zadrugarstvo, 135, 381
Population, 12, 13, 22, 24, 27, 43, 46, 48, 49, 50, 52, 54, 68, 69, 75, 88, 112, 115, 118, 119, 120, 149, 169, 176, 354
Population Studies, 39, 43, 75, 112, 123
Popov N., 305
Popoviq D., 274
Popović S., 23
Potenza, 419
Poursin M., 26, 27, 32, 573
Premrou M., 197
Prentice Hall, 62

Pressat R., 30, 31, 54, 61, 64, 66, 76, 84, 108, 123, 517, 574
Presses universitaires de France, 12, 54, 61, 74, 95, 108, 120, 255
Prikazi, 135, 137
Prishtina H., 320
PUF, 12, 27, 28, 30, 31, 64, 66, 71, 76, 84, 407
Pulaha S., 191, 195, 196, 197, 198, 280, 407, 574
Puljiz V., 213, 218, 224, 518
Pupovci S., 234, 321
Pushka A., 159, 224, 354, 388, 486, 574
Puto A., 197

Q

Qosiq D., 126, 203, 307, 341, 342, 501, 504, 510
Qosja R., 505
Qosiq V.-A., 126, 341

R

Rad, 23, 350
Raina B. L., 118, 574
Radonić J., 197, 570
Radovanović M., 234
Radovanović V., 194
Raduški N., 62, 574
Rahimi Sh., 424
Rančić M., 221
Randić Lj., 117, 574
Rankoviq A., 307, 313, 331
Rapper de G., 425, 428, 429, 430, 431, 574
Rapi Gj., 234, 381
Rašević M.,25, 62, 98, 100, 127, 181, 221, 574
Ravenstein E., 436, 574
Reedman R., 62, 575
Reinhard M., 22, 26, 27, 135, 336, 575
Rexhepi B., 478
Rexhepagiq J., 178, 575
Riinvest, 212
Rijeka, 117
Rilindja, 72, 180, 191, 232, 321, 322, 365, 370, 371, 389, 413, 422, 423
Ristić K., 194
Rizaj S., 197
Rizman R., 304
Rockfeller J. D., 51, 119, 575
Rome, 15, 43, 46, 242
Rugova I., 492, 493
Roux M., 101, 271, 308, 575
Ruecker J., 336
Rullmann P. H., 274
Rushiti L., 284, 575

S

Safarik J., 197
San Marino, 342
SANU, 25, 36, 110, 118, 119, 126, 133, 181, 192, 203, 258, 267, 286, 425
Sauvy A., 30, 32, 43, 48, 49, 74, 105, 119, 169, 575
Scaglione P., 416, 418, 575
Scott C., 62
Scura A., 418, 576
Senkeviç G., 197
Sentić M., 63, 221
SIDA, 490
SZS, 67, 80, 92, 94, 95, 96, 97, 98,102, 104, 137, 138, 140, 142, 146, 149, 150, 152, 153, 154, 158, 160, 161, 163, 171, 175, 181, 201, 204, 216, 218, 236, 267
Simeunović V., 135, 140, 576
Sinadinovski J., 267, 425, 428, 576
Singly F., 66, 576
Skendo L., 413, 414, 576
Službeni list, 324
Službeni list SFRJ, 127
Smirnova N. D., 197

Socijalna politika, 107
Sociologija, 64, 82, 179, 361, 375, 378
Sociologija sela, 185, 224, 262, 373, 380
Sociološki pregled, 234, 381
Sojeva K., 18, 488
Sokollova B., 422
Solana H., 511
Solstrom T., 511
Sorre M., 270, 407, 409, 576
Specia, 413
Stambolić I., 268
Stanovništvo, 43, 48, 50, 51, 52, 53, 54, 62, 67, 87, 95, 118, 120, 124, 131, 132, 140, 141, 148, 159, 160, 162, 163, 174, 199, 217, 266, 353, 388, 391, 444, 451, 456, 486
Stanulović K. N., 197
Starine, 197,
Start, 128, 259
Statistička revija, 181, 355, 477
Statistički godišnjak Jugoslavije, 67, 73, 80, 137, 138, 158, 216
Steiner M., 507
Stipčević A., 196, 576
Stock, 25, 135
Stojadinoviq M., 293
Stojanović S., 128
Stojkov N., 139, 148, 150, 576
Strasbourg, 12, 31, 67, 69, 85, 112
Studime, 131, 411
Studime gjuhësore, 409, 416, 418, 419
Studime historike, 195
Stadtmuller G., 413, 576
Surroi V., 512
Supek I., 307, 577
Sveske, 255
Svjetlost, 98, 109, 129

SH

Sheps M. C., 75, 577
Sheri F., 227, 577
Shufflay M., 419
Shukoviq M., 132
Shultz T., 26

Š

Šeparović Z., 129, 259, 305
Šešelj V., 198, 326, 331, 332
Školska knjiga, 14, 26, 221, 270, 298, 354
Šifrer Ž., 67, 577
Škara Lj., 183, 577
Šnajder K., 136, 381
Šuković M., 132
Šufflay M., 196, 577
Šuvar S., 135, 259, 267, 355, 373, 381, 577

T

Tabah L., 43, 46, 577
Tabutin D., 27, 65, 577
Tanjug, 332
Tanić R., 342
Tapinos G., 12, 14, 22, 64, 84, 409, 577
Taranto, 419, 420
Tavolaro E., 419
Teleks, 126, 258
Teramo, 419
Tërmkolli M., 356, 489, 490, 491, 494, 497
Tërnava M., 191, 195, 196, 197, 280, 577
Tietze C., 75, 577
Tito, 296, 297, 302, 346
Todorov N., 195, 280
Todorović G., 95, 444, 445, 446, 578
Tompson W., 26, 578
Tomšič V., 107, 578
Tošović S., 135, 381
Trifunoski J., 194

TH

Thaçi H., 484, 489, 491, 492
Thema, 191, 301, 339, 415, 428
Theoria, 128
Thumerelle P.-J., 28, 33, 40, 578

U

UIESP, 14, 123
Uka S., 257, 424, 578
UN, 31, 66, 67, 92, 162, 433
UNESCO, 46, 75, 110
UNFPA, 12, 36, 38, 84, 143, 207, 480, 484
UNICEF, 28
UNHCR, 461
United Nations, 12, 14, 24, 25, 28, 31, 32, 36, 38, 41, 43, 47, 62, 68, 106, 125, 227, 228, 443, 447, 578
UNMIK, 345, 403, 461, 467, 470, 487
University of Chicago Press, 14, 26, 74, 128
Urošević A., 194, 285, 286

V

Valentej D., 118
Vallin J., 134
Valton, 257
Varagnac A., 22, 578
Vasić D., 288, 579
Vasiliev A. A., 412, 413
Vaso P., 429
Vatikan, 308, 342
Vens S., 341, 504
Victoria, 22
Vija, 417
Vikers M., 413, 579
Villeneuve-Gokolp C., 112
Vjetar, 284
Vlaškalić T., 23, 350
Vogelnik D., 61, 67, 266, 428, 447, 579
Vovelle M., 28
Vratusha A., 131
Vukomanović D., 281

W

Washington, 33, 40
WHO, 28, 33, 48, 134
Willcox W. W., 24, 38, 42, 579

X

Xoxi K., 417, 419, 579

Xh

Xhihadi, 308

Y

Yugoslav Survey, 332
Zajmi G., 269, 579
Zangari D., 416, 418, 579
Zamputi I., 197, 579
Zeka H., 320
Zëri i Arbëreshëvet, 417
Zgjimi, 417
Zimmermann W., 259, 281, 302, 306, 309, 579
Zllatku R., 416, 421, 579
Zjarri, 417, 579

Ž

Žena, 124
Žuljić S., 281
Župančić M., 373

Hivzi Islami
STUDIME DEMOGRAFIKE
100 VJET TË ZHVILLIMIT DEMOGRAFIK TË KOSOVËS
2008

Botues
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Mr. Shefqet Riza

Redaktor teknik:
Valon Fetahu

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 37 tabakë shtypi
Tirazhi: 500 copë
Formati: 17x24 cm

Shtypi:
ALFA PRINT
Prishtinë

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

314(496.51)

Islami, Hivzi
Studime demografike : 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës / Hivzi Islami. - Botim i dytë i plotësuar. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2008. - 590 f. : ilustr. ; 24 cm. - (ASHAK : Botime të Veçanta ; LXXXV Seksioni i Shkencave Shoqërore ; Libri 25)

Titulli paralel në gjuhën angleze. - Indeksi i emrave : 581-590

ISBN 978-9951-413-64-0